



100

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju
Ministry of Education, Science and Technology
Departamenti i Shkencës dhe Teknologjisë
Departament za Nauku i Tehnologiju
Department for Science and Technology

KUMTESAT

NGA KONFERENCA VJETORE E SHKENCËS "JAVA E SHKENCËS 2012"

**Prishtinë,
2012**

KUMTESAT

Nga konferenca vjetore e shkencës 'Java e Shkencës 2012'

KUMTESA

KUMTESAT

Nga konferenca vjetore e shkencës 'Java e Shkencës 2012'

Redaktor
Murteza Osdautaj

Kopertinën dhe përgatitjen kompjuterike
Murteza Osdautaj



Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë
Departamenti i Shkencës dhe Teknologjisë

KUMTESAT

Nga konferenca vjetore e shkencës ‘Java e Shkencës 2012’

Prishtinë,
2012

KUMTESA

Lexues të nderuar,

Puna kërkimore-shkencore vlerësohet si mjete më i fuqishëm i avancimit të dijes dhe zhvillimit ekonomik dhe shoqëror në këtë shekull. Konceptimi i hulumtimeve si proces që nuk mund të kufizohet vetëm në formën klasike të dijes dhe transmetimit të saj brenda institucioneve klasike, duket se është marrë si moto e shkencëtarëve këtë vit: hulumtimi si marrëdhënie universale midis individit dhe botës (në kuptimin e gjerë të fjalës natyra, shoqëria, mjedisi rrethues, etj).

Me këtë botim të përmbledhur çmojmë përkushtimet shumë profesionale dhe gjithëpërfshirëse të shkencëtarëve tanë, kjo është dëshmi se e ardhmja e shkencës në Kosovë ka perspektivë të ndritshme. Vazhdimisht me admirim kam përcjell konferencën kombëtare të shkencës "Java e shkencës në Kosovë" organizuar nga ana e Departamentit të Shkencës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, dhe të njëjtin e vlerësoj si një aktivitet shkencor që pasqyron dhe prezanton gjendjen aktuale, sfidat dhe orientimet, kahet e zhvillimit të hulumtimeve dhe kërkimeve shkencore, me synim të nxitjes së zhvillimit ekonomiko-shoqëror të vendit dhe arritjen e standardeve evropiane në hulumtimin shkencor dhe zhvillim. Kosova ka ndryshuar kaq shumë dhe në vigjilje të 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, si në çdo fushë tjetër edhe në botën e shkencës, është në rrugë të një historie suksesi. Shpresojmë se edhe "Java e shkencës 2012" do të shndërrohet në një promotor të ndryshimit dhe modernizimit të shkencës tonë. Pasqyra më e mirë është ky botim që vjen si përmblyllje e aktivitetit "Java e shkencës 2012", i katërti me radhë i organizuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Është kjo një përmbledhje e realizimit të programit të saj, më saktë një antologji shkencore e krijimtarisë të shkencëtarëve të dëshmuar, por edhe atyre të rinj e me perspektivë. MASHT ka ndarë fonde për veprimtari kërkimore shkencore, jo ndoshta në nivel të dëshiruar, por ka arritur të mbështesë projektet që ndihmojnë zhvillimin ekonomik. Brenda këtyre kopertinave po prezantohet "Java e Shkencës" e këtij viti dhe puna kërkimore-shkencore e punonjësve eminentë shkencorë të fushave të ndryshme, të cilët, me kumtesat e tyre, në të cilat shfaqën idetë dhe pikëpamjet e tyre lidhur me të arriturat shkencore, synimet për të ardhmen, gjithnjë duke pasur parasysh ndikimin e shkencës

KUMTESA

në zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomiko-shoqëror të vendit. Shpresoj se këto kumtesa paraqesin të arriturat dhe sfidat e shkencës sonë.

Ky manifestim shkencor ka arritur dhe objektivin tonë të ndërkombëtarizimit të shkencës dhe kërkimit tonë shkencor. Në këtë eveniment zbulohen energjitë e reja shkencore që premtojnë reforma në qasjet e dijës dhe shkencës në raport me kërkesat e realitetit të ri evropian .

Një falënderim të veçantë dëshiroj t'u shpreh të gjithë pjesëmarrësve për bashkëpunimin e frytshëm në realizimin e projekteve tona!

Faleminderit!

Prof.dr.Ramë BUJA

Të dashur lexues,

Para jush po e sjellim përmbledhjen e disa prej kumtesave të paraqitura në konferencën tonë vjetore "Java e Shkencës 2012" në të cilën morën pjesë rreth 350 autorë dhe bashkautorë nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Sllovenia dhe Austria.

Ne shpresojmë që ky botim të hasë në mirëkuptimin tuaj, të hapë para jush horizonte të reja të të menduarit, të paraqesë para jush rezultate të reja shkencore që do t'ju ndihmojnë në hulumtimet e ardhshme. Ky libër, shpresojmë, të paraqesë një kontribut për shkencën tonë dhe, në anën tjetër, të shënojë konsolidim të mëtejshëm të traditës që ka krijuar, tashmë, konferenca kombëtare e shkencës "Java e Shkencës".

Vendosja e kumtesave në libër është bërë duke u bazuar në radhën e paraqitjes së tyre në konferencë sipas seancave. Në anën tjetër, sipas marrëveshjes që kemi pasur me autorët, ata kanë qenë përgjegjës për sigurimin e recensioneve, për përmbajtjen, drejtshkrimin dhe lekturën e kumtesave të tyre. Për të gjitha këto, ne si redaksi, nuk mbajmë asnjë përgjegjësi.

Duke shpresuar në përhapjen e rezultateve hulumtuese që sjell ky libër, shfrytëzojmë rastin t'ju ftojme në konferencën e vitit 2013 që do të mbahet në muajin maj dhe në të cilën e kanë paralajmëruar pjesëmarrjen e tyre shumë shkencëtarë nga të gjitha vendet e Ballkanit dhe nga disa vende të Evropës.

Mirupafshim!
Dr. Murteza Osdautaj

KUMTESA

PËRMBAJTJA

| | |
|--|-----|
| <i>Murteza OSDAUTAJ: GJENDJA E HULUMTIMIT SHKENCOR NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE NË KOSOVË</i> | 15 |
| <i>SHKENCAT GJUHËSORE DHE KULTURORE</i> | 23 |
| <i>Prof. dr. Shezai RROKAJ: ROLI I DIALEKTEVE NË SHTRIRJEN DHE ZGJERIMIN E STANDARDIT</i> | 25 |
| <i>Dr. Elindë RAMADANI-DIBRA: LUIGJ GURAKUQI PËR PAVARËSINË DHE ARSIMIN SHQIPTAR</i> | 31 |
| <i>Fehmi ISMAJLI: HUAZIME TË SHQIPES NË FUSHËN E ARSIMIT - KORNIZA E KURRIKULËS DHE FJALORI I SAJ</i> | 37 |
| <i>Dr. Shpresa HOXHA: PËRKTHIMI I PERFECTIT TË TASHËM TË ANGLISHTES NË SHQIPEN</i> | 45 |
| <i>Alma KUÇAJ: E FOLMJA E QYTETIT TË KAVAJËS, HETIME RRETH NDRYSHORËVE SOCIOLOGJIKË TË GJINISË, MOSHËS E BESIMIT</i> | 53 |
| <i>Zenun Rexhepi: SHKRIMI I LASHTË I ZATRIQIT NË KOSOVË DHE KULTURA DANUBIANE E PERIUJHËS NEOLITIKE</i> | 59 |
| <i>Mr. Muhamet PEÇI: ARTI LETRAR DHE LEXUESI SI KATEGORI ESTETIKE</i> | 67 |
| <i>Rexhep OSMANI: JUSTIN RROTA PËR DIALEKTET E SHQIPES</i> | 73 |
| <i>Shpresa ISMAJLI: PARASHTESAT DHE PRAPASHTESAT E SHQIPES SË BUZUKUT DHE ASAJ TË SOTME</i> | 81 |
| <i>Dr. Mustafa IBRAHIMI: GJENDJA DHE PERSPEKTIVA E ETNOLINGUISTIKËS SHQIPTARE</i> | 87 |
| <i>Prof. dr. Hamit XHAFERI: ÇËSHTJA E IDENTITETIT NË POEZINË E SOTME SHQIPE</i> | 95 |
| <i>Dr. Ismet OSMANI: SEMANTIKA E SHPREHJEVE FRAZELOGJIKE NË SHQIP DHE NË MAQEDONISHT</i> | 99 |
| <i>Prof.dr Vebi BEXHETI: ARBËRESHËT NË POEZINË E MARTIN CAMAJT</i> | 103 |
| <i>Indira ÇIPA: KATALOGIZIMI I VEPRAVE PIANISTIKE TË KOMPOZITORËVE KOSOVAR-ASPEKTI TERCIAR</i> | 109 |
| <i>Edmond MALAJ: FIGURA E SKËNDERBEUT NË NJË VEPRËN „TÜRCKENMACHT VON GOTT VERLACHT“ TË HUMANISTIT GJERMAN JOHANNES LASSENIUS</i> | 115 |
| <i>Ma. ANISA KOSTERI: PËRSHKRIMI I FJALORËVE DIALEKTORË- KRAHINORË TË SHQIPES VERIPERËNDIMORE (STUDIM MBI BARDHIN, GAZULLIN E BENEDIKT DEMËN).</i> | 121 |
| <i>Dr. Shykrane GËRMIZAJI: PËRBALLJA E SHQIPES ME ANGLISHTEN – BEGATIM APO VARFËRIM</i> | 127 |
| <i>Evis CELO 1(Ph.D), Lorenc DANAJ(Ph.D Candidate)2: MASMEDIA MODERNE – PUSHTETI I KOMUNIKIMIT . QENDRIME DHE OPINIONE TE NDRYSHME</i> | 133 |
| <i>Msc. Edlira CERKEZI: TIPARË DHE VECORI TE DRAMËS SË DRITËRO AGOLLIT. (KËNDVËSHTRIM TË DRAMAVE “FYTYRA E DYTË” DHE “MOSHA E BARDHË”)</i> | 141 |
| <i>Dr. Gladiola DURMISHI (ELEZI)1: MJEDISI SHOQËROR KU NDODH KOMUNIKIMI DHE KULTURA GJUHËSORE E INDIVIDIT, SPECIFIKUES TË NJË KOMUNIKIMI TË NDËRSJELLTË NË SHOQËRI</i> | 145 |
| <i>Vjosa OSMANI: KOHEZIONI LEKSIKOR NË ROMANET E ISMAIL KADARESE</i> | 155 |

- Ma. Arjeta CUKAI: VËZHGIME MBI ZHVILLIMIN NË KOHË TË EMËRTIMEVE TË NJERËZVE SIPAS VEPRIMTARIVE QË KRYEJNË* 161
- Dr. Elvira LUMII: DEKONSTRUKSIONI I HISTORISË DHE I PUSHTETIT NË PROZËN E ISMAIL KADARESE* 167
- Sindorela DOLI – KRYEZIU: SHQIPJA STANDARDE DHE PËRDORIMI I SAJ NË KOSOVË* 175
- Prof. asc. dr. Begzad BALIU1: GJENDJA E TOPONIMISË NË BALLKAN* 181
- Asllan HAMITII: DIGLOSIA NË MAQEDONI DHE PROBLEMI I PËRDORIMIT ZYRTAR TË GJUHËS SHQIPE* 187
- Mr. Marjela PROGNI – PECII: KRIJIMTARIA POPULLORE NË LETËRSINË SHQIPE (PROZA E MITRUSH KUTELIT)* 193
- Ma. Rozeta BICII: METAPHORIZATION OF THE TERMS DENOTING HUMAN BODY PARTS IN ENGLISH LANGUAGE* 199
- Prof.ass.dr. SHKËLQIM MILLAKU1: PËRFSHIRJA DHE ZHVILLIMI HISTORIK I KONCEPTEVE GJENERATIVE NË GJUHËSINË (SHQIPTARE)* 207
- Dr. Tonin ÇOBANI: NJË FILL I ESESË SOCIOLOGJIKE SHQIPTARE* 213
- Mr. Zahrie KAPLLANAJ: PALIMPSESTI NË VEPRËN DRANJA TË MARTIN CAMAJT* 219
- Ma. Ermira YMERAJI, Ma. ROVENA VATA2: LETËRSIA DHE IDENTITETI - NDËRTIMI LETRAR I MITEVE IDENTITARE KOMBËTARE, DEKONSTRUKTIVIZMI LETRAR MODERN.....*225
- Prof.dr.bahtijar KRYEZIU1: FJALË E TERMA TË HUAJ NË FUSHËN E ARSIMIT* 230
- Mr. Luljeta ADILI-ÇELIKU1, Mr. JEHONA RUSHIDI- REXHEPI2: ANTONIMIA TE KADAREJA* 235
- Prof. dr. Zeqirja NEZIRI: STUDIMET BUZUKJANE NË PRAGSHEKULLIN E DYTË TË PAVARËSISË KOMBËTARE: BASHKËKOHËSITË E MESHARIT* 241
- Dr. Hasan MUJAJ: KOMUNIKIMI NDËRKULTUROR SI PROCES INTEGRIMI* 247
- Doc. Dr. Valbona TOSKA: MOHIMI SI KOMPONENT SEMANTIK (DHE PRAGMATIK)* 253
- Dr. Meli SHOPII, Dr.RUDINA MITA1: HAFIZ ALI KORÇA, PERSONALITET I ARSIMIT, KULTURËS E GJUHËS SHQIPE* 257
- Mirlinda KRIFCA-BEQIRI: QUO VADIS, LETËRSI ? (POSTMODERNIA DHE PAS SAJ . .)* 261
- Ma. Aida URUÇI: VËSHTRIM KRAHASUES NË GJUHËN E AUTORËVE: CAMAJ, KOLIQI E PIPA. (NË RRAFSHIN FJALËFORMUES)* 267
- Dr. Mirela (MITA) SINANI1: VËSHTRIM FILOSOFIK PËR GJUHËN SHQIPE. RRETH MËNYRËS SE SI NORMA GJUHËSORE E TË SHKRUAJTURIT MUND TË NDIKOHË NË HUMBEN E KUPTIMIT TË FJALËS. (RASTI: NGAFILOSOFIA-DITURIA TEK FILOZOFIA).....*273
- Abdullah ZYMBERI: PRURJE TË REJA LEKSIKORE NGA DISA TË FOLME POPULLORE* 281
- Xhafer BEQIRAJ: SINTAGMA PARAFJALORE* 285
- Dr. Irena GJONII: NDËRTIMI I ARKETIPIT TË MITIT PËR PËRBINDËSHAT DRAGOI DHE KUÇEDRA NË BREGDETIN E JONIT SHQIPTAR*289
- Aida BADO(DOKTORANTE): SJELLJA GJUHËSORE E FOLËSVE SHQIPTAR PAS '90-S* 295
- Sejdi M.GASHII: RRUGA E FORMIMIT TË SHQIPES LETRARE NË KOSOVË*301

- Dr. Sadik IDRIZII: UTICAJ ALBANSKOG JEZIKA NA GOVOR I NARODNU POEZIJU GORE* 305
- Dr. Xheladin ZYMBERAJI: PËR NJË EKOLOGJIZIM TË VARIANTIT TË FOLUR DHE TË SHKRUAR TË GJUHËS STANDARDE* 311
- Dr. Teuta KAFEXHOLLI: PËR MITRUSH KUTELIN DHE KONSTATIMET E TIJ PËR KËNGËT FOLKLORIKE* 311
- Shpresa DORDA (Doktorante): DREJTIMET KRYESORE TË HUAZIMEVE TË SOTME NË GJUHËN SHQIPE* 321
- Prof. Ukë OSMANAJ: PESHA DHE RËNDËSIA E GJUHËS NË INSTITUCIONE* 325
- Naim BERISHAI: KOMPJUTERI (INTERNETI), PËRPARËSITË DHE PASOJAT PËR SHQIPEN* 331
- Denis HIMCII (PHD Student): PËRFYTYRIMI I SHQIPËRISË NË POEZINË E SOTME TË ARBËRESHËVE TË ITALISË* 335
- Agni DIKA, nebi CAKA, Adnan MAXHUNI, Avni REXHEPI, Kadri SYLEJMANI, Haxhi LAJQII: PRINCIPET BAZIKE PËR SINTETIZIMIN E TË FOLURIT PËRMES KOMPJUTERIT TË TEKSTEVE TË SHKRUARA NË GJUHËN SHQIPE* 343
- Msc. Arlinda ALIMEHAJI: NDIKIMI I RENDITJES FAZORE TË KTHIMEVE MAJTAS (LEAD/LAG) NË NIVELIN E SHËRBIMIT TË KRYQËZIMEVE TË ARTERIES "LIDHJA E PEJËS" NË PRISHTINË* 349
- Dr. Ermira Qosja & Floriand Beshku: INOVACIONI DHE SIPËRMARRJA, VËSHTIRËSI DHE SFIDA NË SHQIPËRI* 355
- Hazbije SAHITI, Linda GRAPCI-KOTORI, Agim GASHI, Kemajl BISLIMI, Fetah HALILII: DIZAJNIMI I BIOREKATORIT PËR PRODHIM KONTINUAL BIOLOGJIK TË HIDROGJENIT* 361
- Muhamet AVDYLI, Prof. Asoc. dr. Tamara LUARASI: NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI PËRDORIMIN E TEKNOLOGJIVE TË GPS DHE TË SENSORËVE NË MENAXHIMIN E NJË BIZNESI TRANSPORTI* 367
- Naser SAHITI, Sabit GASHI, Skënder ISUFI: POTENCIALI I KOSOVËS PËR HULUMTIME SHKENCORE DHE ZHVILLIMORE NË FUSHËN E ENERGIJË* 373
- Prof. asoc. Naim HASANII Dr. Makfire SADIKU2: UJËPËRSHKUESHMËRIA E ARGJILËS RANORE* 379
- Dr. Sc. Bashkim BAXHAKU, Msc Hajredin TYTYRII: MËNYRAT ME EFIKASE TE ZVOGËLIMIT TE NDOTËSEVE PREJ EMISIONIT TE GAZRAVE DALËS NE REGJIONIN E PRISHTINËS* 383
- Kadri SYLEJMANII dhe Lule AHMEDII: NJË PROPOZIM PËR NJË SISTEM PËR PLANIFIKIMIN E UDHËTIMEVE TURISTIKE GRUPORE ME TIPARE REAKTIVE I AVANCUAR ME ANALIZËN E RRJETAVE SOCIALE* 391
- Rrahim MAKSUTII, Hamit MEHMETII, Mursel RAMAI, Malush MJAKU3: ANIZOTROPIA E VETIVE MEKANIKE E ÇELIKUT TË PETËZUAR NË TË NXEHTË* 397
- Msc. Vehbi NEZIRII: ROLI I TEKNOLOGJISË NË E-DEMOKRACI – RASTI I KOSOVËS* 405
- Msc. Xhemajl MEHMETII, Dr.sc. Naser LAJQII2, Mr.sc. Shpetim LAJQII2: ZHVILLIMI I MODELIT TË FUNKSIONIMIT TË MIRËMBAJTJES SË AUTOMJETEVE QË NGASEN NË REPUBLIKËN E KOSOVËS* 411
- Msc. Sokol GJEVORIII, Msc. Lira GJEVORIII: RAJONI I ELBASANIT GJATE INVAZIONIT SERB.* 423

- Dr. Rudina MITA, Prof. DR. Hysen KORDHA: VËSHTRIM MBI PROGRAMIN POLITIK TË "PARTISË DEMOKRATE" 429*
- MSc. Ilir SALLATA: NAKO SPIRU NË PLENUMIN II TË BERATIT 23-27 NËNTOR 1944 435*
- Mr.sc. Memli KRASNIQI: RAPORTI POLITIK I GJERGJ QIRIAZIT MBI VILAJETIN E MANASTIRIT 439*
- Mr.sc. Arbër SALIHU: DEMONSTRATAT E VITIT 1981 NË KOSOVË NË KONTEKSTIN E ZHVILLIMEVE TË BRENDSHME TË ISH- JUGOSLLAVISË 443*
- Mr. sc Klodian GJONII: EKZISTENCA DHE FUNKSIONIMI I QYTETËRIMIT ANTIK NE KAONI 447*
- Ma.sc.Shefqet DINAJ: VENDIMET E KONFERENCËS SË AMBASADORËVE NË LONDËR PËR COPËTIMIN E SHQIPËRISË DHE NJOHJEN E SHTETIT TË CUNGUAR SHQIPTAR 453*
- Mirela LAZIMI : LËVIZJA KULTURORE SHQIPTARE NË VITET E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT - SHOQËRIA E TË SHTYPURIT SHKRONJA SHQIP 461*
- Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA: PAVARËSIA E SHQIPËRISË, PIKË REFERIMI PËR VEPRIMTARINË ILEGALE NË KOSOVË (1945-1990) 467*
- Dr. Etleva LALA: MBRETËRIA E ARBËRISË DHE SHQIPTARËT 471*
- Anduana SHAHINI (KERTALLI): BASHKËPUNIMI SHQIPTARO – TURK, TRAKTATI I MIQËSISË I VITIT 1923 477*
- Dr. Teki KURTI: VËZHGIME MBI DOKUMENTET ARKIVORE DHE SHTYPIN E KOHËS NË SHQIPËRI PËR DEMONSTRATAT E VITIT 1968 NË KOSOVË 481*
- Mr.sc Bedri MUHADRI: HISTORIOGRAFI MESJETARE SHQIPTARE NË KOSOVË PËRBALLË HISTORIOGRAFISË SERBE 485*
- Mr.sci. Faik SAHITI: MUZEALE TË KOSOVËS NË VEND DHE NË DISA MUZE TË SERBISË DHE MAQEDONISË 491*
- Prof. dr. Izber HOTI: KRITIKA E MIRËFILLTË HISTORIKE 498*
- SHKENCAT E EDUKIMIT 501*
- Ma.sc. Bekim SAMADRAXHA, Mr.sc. Fehmi KRASNIQI: ECURI E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 503*
- Msc. Majlinda HALAI: TRASHËGIMIA MUZIKORE, PJESË E EDUKIMIT NË KURRIKULAT SHKOLLORE E DOMOSDOSHËMRI PËR RUAJTJEN DHE TRANSMETIMIN E VLERAVE KOMBËTARE 513*
- Dr.sc. Xhevdet THAQI, Mr.sc. Valbonë BERISHAI: KONCEPTI I FUNKSIONIT DHE ÇASJA E TEKSTEVE SHKOLLORE NË KËTË KONCEPT 519*
- Nazmi XHOMARA (PhD Student): KUALIFIKIMI PROFESIONAL I MËSUESVE NË PUNË 525*
- Luljeta KABASHI M.A, Mehmet KASTRATI & Qëndrim PAJAZITAJ: GJITHËPËRFSHIRJA E NXËNËSVE TË VERBËR DHE ME TË PARË TË DOBËSUAR NË KLASA TË RREGULLTA- RASTE STUDIIMI 531*
- Doc. dr. Bojana GLOBACNIK1, Mr. sci. Vedat BAJRAMI2: VËSHTRIME MBI ARSIMIN NË MJEDISËT SHUMËKULTURORE (VIEWS ON EDUCATION IN MULTICULTURAL ENVIRONMENT) 537*
- . Zeqir VESELAJI, DR. Mihallaq QIRJO2, MA. Zenel KRASNIQI3: NXËNËSI SI PROMOTOR I EDUKIMIT DHE VETËDILJËSIMIT MJEDISOR NË SHOQËRINË NË TRANZICION- RASTI I KOSOVËS 543*

| | |
|---|-----|
| <i>Ma .Mirela KARABINA1: PERCEPTIMI I MESUSEVE PER FORMEN DHE STILIN E DREJTIMIT TE SHKOLLES.</i> | 547 |
| <i>Dr.Sc. Mazllom KUMNOVA, Dr.sc.Kastriot BUZA: SFIDAT E VLERËSIMIT NË MËSIMDHËNIEN E FAKULTETIT TË EDUKIMIT</i> | 551 |
| <i>Dr.Prof. Anisa SUBASHI: NDIKIMI I TELEVIZIONIT TEK FËMIJËT E MOSHES 8-12 VJEC</i> | 561 |
| <i>Mirela ÇEPELE – DIMO: PROBLEMATIKA PSIKO-PEDAGOGJIKE TË RIKONCEPTIMIT TË MËSIMDHËNIES SË LETËRSISË NË SHKOLLAT E MESME DREJT NJË MËSIMDHËNIE BASHKËKOHORE.</i> | 565 |
| <i>Msc. Ledia KASHAHUI, MARRËDHËNIA PRIND-MËSUES, PARAGJYKIMET DY PALËSHE DHE ARRITJET AKADEMIKE TË ADOLESHENTËVE.</i> | 569 |
| <i>Ma. Liridona JEMINI – GASHI1: PJEKURIA PËR KARRIERË DHE VENDIMMARJA E ADOLESHENTËVE KOSOVARË PËR ZGJEDHJE TË PROFESIONIT</i> | 575 |
| <i>Msc. Jehona Ferizi MIFTARI, Besa FERIZI: PËRSHKRIMI I FRIKËS SHKOLLORE TE FËMIJËT QË NISIN KLASËN E PARË</i> | 581 |
| <i>Rozafa Ferizi- SHALAI, Violeta BUZA2: SFIDAT DHE MUNDËSITË PËR NGRITJEN E CILËSISË NË EDUKIMIN PARASHKOLLOR</i> | 587 |
| <i>Zamira HYSENI-DURAKUI: NDËRVEPRIMI I FAKTORËVE AKADEMIKË DHE EMOCIONALË NË PËRFORMANCËN E STUDENTËVE TË PROGRAMEVE BACHELOR NË KOSOVË</i> | 593 |
| <i>Albano Zhapaj1: MËSIMI GJATË GJITHË JETËS, RIKTHIMI I ADULTËVE NË SHKOLLA.</i> | 599 |
| <i>Dr.Xhevdet ZEKAJ1, Monika HODAJ2, Albano ZHAPAJ3, Nertila TABAKU4: BARRIERAT PSIKOLOGJIKE NË KOMUNIKIMIN PROFESIONAL-PEDAGOGJIK</i> | 601 |
| <i>Murteza OSDAUTAJ: IDENTIFIKIMI I FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA - PENGESË E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT SPECIAL (INKLUZIV) NË KOSOVË</i> | 607 |
| <i>SHKENCAT EKONOMIKE DHE SOCIALE</i> | 611 |
| <i>Prof. Dr. Sc. Sejdi REXHEPI dhe Altin N. ADEMI: DILEMAT DHE MUNDËSITË E ZHVILLIMIT LOKAL(Rasti i Skenderajt)</i> | 613 |
| <i>Msc Bislim LEKIQII: MOTIVIMI I BURIMEVE NJERËZORE NË PUNË NË KUSHTET E EKONOMISË KOSOVARE.....</i> | 619 |
| <i>Mr. Sc. Sherif DOBRA: PRODHIMI DHE EKSPORTI IMPERATIV PËR EKONOMINË E KOSOVËS.....</i> | 625 |
| <i>Veli LECAJ: ROLI I TREGTISË SE JASHTME NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË KOSOVËS</i> | 633 |

Murteza OSDAUTAJ: GJENDJA E HULUMTIMIT SHKENCOR NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE NË KOSOVË

Hyrje

Ky studim ka për qëllim të paraqesë gjendjen e hulumtimeve shkencore në Ballkanin Perëndimor në kontekst të shpjegimit të arsyeve historike dhe politike të prapambetjes dhe në kontekst të gjetjes së mundësive të reja që edhe në këtë aspekt ky rajon evropian të mund të krahasohet me rajonet e tjera të Evropës me qëllim të rritjes ekonomike, zhvillimit të përgjithshëm shoqëror dhe politik të të gjitha vendeve që njihen si shtete të Ballkanit.

Gjendja e përgjithshme

Deri në vitet tetëdhjeta gjendja e hulumtimeve shkencore dhe investimet në këtë fushë në Ballkanin Perëndimor nuk dallonte shumë me zhvillimet e përgjithshme evropiane. Dihet se ish-Jugosllavia kishte marrëveshje bilaterale dhe multilaterale me pjesën më të madhe të vendeve evropiane që shtriheshin prej aspekteve të hulumtimeve të përbashkëta në shkencë deri në njohjen automatike të diplomave. Gjendja e tillë kishte bërë që disa nga universitetet dhe institutet kërkimoro-shkencore të ish-Jugosllavisë të njiheshin për cilësi kulminante të hulumtimit shkencor dhe për një qasje inovative të këtyre hulumtimeve që kishin bërë të mundur një orientim të industrisë së atëhershme për prodhime me standarde të pranuar evropiane.

Kjo situatë nuk do të zgjaste shumë ngase vitet 1990-1995 do të shënojnë rrënimin përfundimtar të shtetit të atëhershëm. Shkatërrimi i shtetit u manifestua me luftëra të njëpasnjëshme dhe me ndarjen suksesive të ish njësisve federale që rezultoi me krijimin shteteve të reja. Shkatërrimi nga lufta, ndryshimi i strukturës ekonomike dhe shkatërrimi i saj nga lufta, ikja e pandalshme e kuadrit drejt vendeve perëndimore dhe ShBA-së, rënia e të ardhurave për kokë banori si dhe ndryshimi i prioritetëve kombëtare të vendeve të veçanta do të ndikojnë në një rënie të përgjithshme të sasisë dhe cilësisë së hulumtimeve shkencore të këtyre vendeve dhe me këtë, edhe një rënie në rangimin këtyre vendeve në krahasim me vendet perëndimore.

Derisa situata me vendet e ish Jugosllavisë ishte e tillë, Shqipëria në vitet 90-të do të dalë si vendi më i varfët në Evropë me një ekonomi të rrënuar dhe me një ikje të pariparueshme të popullsisë nga vendi. Në Shqipëri, pas një këndelljeje të vogël në vitet 90-të, trazirat e 97-tës do ta shkatërrojnë edhe njëherë, gati tërësisht, infrastrukturën e dobët e cila sa kishte filluar të ringritej.

Kosova, në anën tjetër, ka një histori të veçantë e cila mund të karakterizohet si më e rënda në krahasim me të gjitha vendet për të cilat po flasim në këtë studim. Në këtë vend, që nga viti 1981, fillojnë restriksionet e përgjithshme ndërsa që fusha më e dëmtuar nga të gjitha ishte hulumtimi shkencor. Dëme të parikoperushme, pastaj, shkaktohen nga pushtimi klasik dhjetë vjeçar si pasojë e të cilit, me themel, do të shkatërrohej e tërë infrastruktura e ngritur shkencore, ekonomike dhe industriale e vendit. E përshkruar me një largim të madh të popullsisë, me vdekjen e kuadrove të vjetra me kredo shkencore dhe me mospërsëritjen e këtij kuadri, Kosova do të mbesë tepër mbas vendeve të rajonit të cilat pas përfundimit të luftërave dhe tranzicioneve politike, kishin filluar të mëkëmbeshin. Edhe lufta e viteve 1998-99 do të ndikojë që kjo bazë të shënojë një rënie të mëtutjeshme derisa as pas lufta, nën udhëheqjen e UNMIK-ut, nuk do të arrijë që situatës t'i japë një kthesë pozitive.¹


Gjendja aktuale

Ndryshimet gjeopolitike që ndodhën në Ballkan gjatë viteve për të cilat po flasim kanë qenë të ndryshme për vendet e ndryshme dhe, si të tilla, kanë ndikuar në mënyrë të ndryshme në zhvillimin e secilit vend. Kjo ka bërë që disa vende të gjejnë rrugë më të shpejta zhvillimi dhe, në njëfarë mënyrë, të gjejnë rrugën e duhur të zhvillimit dhe disa të tjera, nëse nuk kanë shënuar rënie, kanë stagnuar në gjendjet e mëhershme.

Megjithatë, edhe pse ka mospërputhje shumë të mëdha në mes të shteteve në rajon, ato nuk duken se dallojnë në një masë të madhe dhe karakterizohen me kërkesë të ulët për hulumtim dhe zhvillim, ikjen e trurit, investime të dobëta të ekonomisë në kërkim shkencor dhe shërbime të kufizuara të TIK. Një gjendje e tillë ka bërë që, thuaja tërësisht, të gjitha vendet e Ballkanit të mbesim tepër më poshtë nga mesatarja e BE-së në investimet për hulumtim shkencor, inovacion dhe zhvillim. Më poshtë po e sjellim një grafik të përgatitur nga Banka Botërore² në të cilin shihet niveli i investimeve (nga bruto prodhimi kombëtar, GDP) për shkencën në vende të ndryshme të rajonit:

¹ Duhet të ceket se deri në vitin 2010 Kosova nuk ka ndarë asnjë shumë buxhetore për kërkime dhe hulumtime shkencore.

² Këtij grafiku, në dokumentin origjinal, i mungon pjesa për Kosovën të cilin e kemi shtuar ne.



Duke u bazuar në mesataren e përqindjes që kanë vendet e BE-së e që është 1.85 nga bruto prodhimi kombëtar, del se Ballkani Perëndimor³ është tepër larg niveleve të dëshiruara. Duke e marrë parasysh se këto investime janë kryesisht shtetërore dhe jo nga sektori i ekonomisë dhe industrisë atëherë gjendja na del edhe më e keqe.

Megjithatë vërehet se vendet si Kroacia dhe Serbia kanë arritur që, në njëfarë forme, ta ndryshojnë gjendjen për të mirë edhe pse edhe këto vende qëndrojnë shumë më poshtë se mesatarja evropiane dhe tepër larg nga dispozitat e Deklaratës së Lisbonës. Kjo gjendje i mban larg këto vende nga qëllimet e përmendura evropiane edhe nga fakti se në këto dy vende, kryesisht, investimet për shkencën vijnë nga sektori i buxhetit shtetëror.

Kosova në këtë mes del shumë keq me normën më të ulët të investimeve për shkencë dhe hulumtim me gjithsej 0.01% nga bruto prodhimi kombëtar⁴. Edhe Shqipëria del tepër keq në një ndarje të tillë. Duke e parë këtë gjendje dhe duke i parë investimet enorme evropiane në hulumtim dhe inovacion, duhet të bëhet shumë më shumë që edhe Ballkani të arrijë normat mesatare të Evropës dhe të ndërrojë strukturën e investimeve nga buxheti i shtetit në sektorin e industrisë dhe ekonomisë. Gjithashtu Ballkani nuk mund të përfshihet në procesin e integritimeve pa arritjen e standardeve mesatare edhe në këtë fushë.


Përveç investimeve në shkencë, edhe procesi i publikimeve shkencore në Ballkan ndryshon nga vendi në vend. Kështu ka vende që e kanë rritur shumë nivelin e botimeve (rasti me Serbinë dhe Kroacinë) karshi numrit të banorëve (numri i botimeve për një milion banorë) po ka vende që edhe në këtë aspekt çalojnë tepër (Kosova dhe Shqipëria që janë nën 100)⁵. Nga grafiku⁶ i mëposhtëm⁷ mund të shihet përparimi apo ngecja e vendeve të veçanta në Ballkan:

³ Nga një studim tjetër i BB, që ka dalë pasi që ky punim, në formë të kumtesës, është paraqitur në konferencë, del se përqindja e Malit të Zi është shumë më e ulët sesa duket në këtë grafik. Kjo bën që mesatarja e përgjithshme e investimeve të Ballkanit Perëndimor të jetë edhe më e ulët.

⁴ Duhet cekur se në Kosovë ndahet buxhet për shkencë vetëm nga viti 2010.

⁵ Pak para se të botohej ky punim morëm informacionin se numri i botimeve të punimeve të shkencëtarëve kosovarë në dy vitet e fundit ka arritur në 400. Kjo shifër paraqet një ngritje shumë sinjifikative dhe ndikon në ndryshimin e ndjeshëm ta grafikut që e kemi paraqitur në punim.


KUMTESA



Në këtë aspekt shihet se disa nga vendet në vitin 2010 gati kanë arrirë në mesataren evropiane derisa të tjerat kanë ngelur në shtigjet e vjetra⁸.

Duhet të cekim këtu se një indikatorë i vlerësimit të punës shkencore të një vendi është edhe norma e citimeve të punimeve shkencore të botuara. Edhe në këtë aspekt vendet e Ballkanit perëndimor, edhe Kosova, nuk kanë normë të kënaqshme të citimeve. Nga tabela e mëposhtme⁹ del se normën më të lartë e kanë Kroacia dhe Maqedonia që kanë 0.9 respektivisht 0.8 citime për një punim derisa normën më të

Citimet për një punim të botuar



⁶ Edhe ky grafik sht pjes e studimit t BB mbi gjendjen e hulumtimeve shkencore n Ballkan. Pjesa pr Kosovn d t kryhet n nntor 2012.


⁷ Grafiku është marrë nga dokumenti ‘Inception Report for Western Balcan Contries’ I Bankës botërore. Pjesën e për Kosovën e kam shtuar bazuar në statistikat që kam mundur t’I nxjerr nga shërbimi elektronik ISI Web of Knowledge. Unë e kuptoj që një numër I shkencëtarëve kosovarë botojnë në revistat regionale e sidomos ato të Shqipërisë dhe të Maqedonisë, por të cilat nuk janë të vendosura në bazën e të dhënave të shtëpive botërore siç është ISI apo ndonjë tjetër e këtij rangi.

⁸ Duhet të ceket se në dy nga vendet me nivel më të ulët në botimet shkencore me impakt faktor, shënohet norma më e lartë e ‘prodhimit’ të titujve shkencorë të doktorit të shkencave.

⁹ Shënimet janë të vitit 2011.


vogël e kanë Kosova dhe Mali i Zi me 0.4 citime për një punim të botuar. Kjo normë kaq e ulët mund të jetë pasojë e botimeve në revista që nuk kanë impakt dhe hirsh faktorë të lartë apo në revista që nuk i plotësojnë kriteret ndërkombëtare të revistave shkencore. Më poshtë e sjellim grafikun e përmendur:

Një nga indikatorët botërorë për vlerësimin e zhvillimit shkencor, teknologjik dhe ekonomik të një vendi është edhe numri i hulumtuesve të punësuar në 1000 punëtorë. Nga të dhënat e UNESCO-s dhe EUROSTAT-it del se, krahasuar me proporcionin e BE-15 dhe BE-27, proporcioni i vendeve të Ballkanit është ende i vogël dhe i pakrahasueshëm. Më së keqi, edhe në këtë indikator, dalin Bosnja, Shqipëria dhe Kosova në të cilat ky proporcion është i papërfillshëm.



Shihet se disa vende të Ballkanit, si Kroacia dhe Maqedonia janë në rrugë të mire që t'i afrohen këtij proporcioni i cili, në anën tjetër, merret e si instrument matës për të konstatuar nivelin e involvimit të industrisë dhe ekonomisë në hulumtime shkencore dhe inovacion.

I vetmi indikator në të cilin vendet e Ballkanit nuk qëndrojnë aq keq është niveli i përdorimit të telefonave mobilë në 1000 banorë, numrit të kompjuterëve të 1000 banorë dhe lidhjet e internet (IP adresat) për 10000 banorë. Të përmbledhur në një grafik të gjithë këta indikatorë paraqesin këte radhitje grafike:



Perspektivat dhe nevojat

Shuma e tërësishme e buxhetit që ndahet nga qeveria e Kosovës, për dy vjet më radhë, është rreth 480 000 euro edhe pse, bazuar në Programin Kombëtar të Shkencës, shtetit, për realizimin e prioriteteve dhe për të arrirë qëllimet e planifikuara, i duhen, deri në vitin 2015, së paku, 16 milionë euro. Duke e marr parasysh se nga FMN dhe institucionet ndërkombëtare financiare Kosova është e detyruar në ngrirjen e buxhetit të saj, nuk mund të presim që, së paku deri më 2016, të ketë ndonjë ngritje të buxhetit për shkencë. Gjithashtu, për shkak të strukturës shumë ekstensive të industrisë dhe ekonomisë kosovare, për shumë vite që vijjnë, nuk mund të presim investime që mund të konsiderohen relevante në këtë fushë. Shpresohet që, në ndërkohë, për shkak të procesit të integrimi evropiane, Kosova të arrijë të përfitojë donacione dhe investime të cilat do të mundësonin kalimin e hendekut të madh që ka vendi ynë në këtë resor.

Çdo ecje përpara e një kombi në fushën e zhvillimit social dhe ekonomik varet kryekëput se sa investon një popull në zhvillimin shkencor dhe të inovacioneve. Pa një investim të tillë, prapambetja në zhvillim do të mbetet permanente dhe me tendenca të thellimit të vazhdueshëm. Nëse institucionet kërkimore shkencore dhe ekonomia e një vendi nuk aftësohet dhe nuk vetëdijësohen që të bashkëveprojnë në funksion të zhvillimit të një vendi, e ardhmja e atij vendi është gjithmonë në pikëpyetje. Nëse zhvillimet shkencore të një vendi nuk bëhen kompetitive dhe kompatible me zhvillimet botërore në shkencë dhe inovacion atëherë kemi të bëjmë me një situatë në të cilën një shtet nuk mund të llogarisë në të ardhme.

Investimet në shkencë nuk sjellin rezultate të menjëhershme. Duhet të kalojnë 5 deri 20 vjet kur një investim fillon të prodhojë zhvillim ekonomik dhe prosperitet. Nga studimi i Bankës Botërore lidhur me investimet në shkencë të disa vendeve bazuar në agjendën e Lisbonës për investime në masën 3% të Bruto-prodhimit kombëtar në hulumtim dhe inovacion del se Kroacia, Rumania, Bullgaria dhe disa vende nga ish Evropa Lindore nëse fillojnë që ta ndajnë një investim të tillë, i njëjti do të ndikojë që në vitin 2025 këto vende të kenë nivel të rritjes së BPK dhe eksportit në përqindjet sipas tabelës që do të paraqesim më poshtë:

Efektet e Agjendës së Lisbonës nëse marrim si cak vitin 2025¹⁰


| | Rritja e GDP në (%) | Rritja e eksporteve në (%) |
|-----------|----------------------------|-----------------------------------|
| Bullgaria | 13.1 | 8.3 |
| Kroacia | 6.0 | 12.9 |
| Hungaria | 6.4 | 8.0 |
| Polonia | 5.5 | 8.5 |
| Rumania | 13.1 | 13.5 |
| Sllovakia | 8.9 | 10.4 |
| Sllovenia | 6.9 | 10.5 |

Shënim: Simulim i bazuar në WorldScan Model. Numrat paraqesin ndërrime kumulative nëse arrihet qëllimi i investimit 3% në shkencë, zhvillim dhe inovacion

¹⁰ World Bank (2009): Croatia's EU Convergence Report: Reaching and Sustaining Higher Rates of Economic Growth. Report No. 48879- HR

Duke u bazuar në këtë tabelë, mund të konstatohet se arritja e 3% si qëllim për investime në shkencë, hulumtim, inovacion dhe zhvillim që bazohet në agjendën e Bolonjës, do të mundësojë një zhvillim ekonomik të paimagjinueshëm nga perspektiva e sotme e çdo vendi ballkanik. Qëllimi për të cilin po flasim duhet të jetë pjesë e agjendës së çdo qeverie të Ballkanit dhe i çdo qeverie që do ta udhëheq vendin tonë, Shqipërinë apo çdo vend tjetër që dëshiron të inkuadrohet në zhvillimet botërore.

Për ta dëshmuar se si ndikon investimi në hulumtime shkencore, zhvillim dhe inovacion, po e sjellim edhe një grafik që ka dalë si rezultat i një studimi që është bërë në vendet e Bashkimit Evropian. Bazuar në këtë grafik mund të konstatojmë se sa më i madh niveli i investimeve aq më e madhe është edhe masa e rritjes së BPK të vendeve të veçanta si dhe e kundërta.



Mbetja në shtigjet e tashme dhe në shifrat e tashme, rrezikon vendin tonë dhe të gjitha vendet tjera me zhvillim të ngjashëm që, në garën botërore për zhvillim, të stagnojnë dhe të cilësohen vazhdimisht si vende të prapambetura. Mjafton të thuhet se në rangimin botëror të universiteteve vetëm tre prej tyre radhiten në 500¹¹ më të mirët në botë, 6 prej tyre ndër 1000 më të mirët në botë dhe pjesa tjetër fillon me numrin 1200 dhe përfundon me radhitjen pas vendit të 12000-të.

Gjithashtu ndërtimi i indikatorëve dhe instrumenteve për matje është e domosdoshme në mënyrë që të arrihen standardet minimale botërore të vlerësimit të punës hulumtuese, zhvillimore dhe të inovacionit të institucioneve kërkimore-shkencore të një vendi. Ndërrimet kualitative janë një domosdoshmëri dhe një

¹¹ Ballkani nuk ka asnjë universitet në 100, 200, 300 apo 400 universitet më të mira në botë. Shih radhitjen nga Times Higher Education ose Lista e Shangait e Universiteteve.

KUMTESA

domosdoshmëri imediate. Investimet, ndërtimi i sistemeve të vlerësimit, cilësia në kuptimin e konkurrentshmërisë dhe krahasueshmërisë, duhet të jenë urgjente. Ne duhet të ecim tepër shpejtë drejt zhvillimeve evropiane.

**SHKENCAT GJUHËSORE DHE
KULTURORE**

KUMTESA

Prof. dr. Shezai RROKAJ: ROLI I DIALEKTEVE NË SHTRIRJEN DHE ZGJERIMIN E STANDARDIT

Qysh prej Kongresit të Drejtshkrimit¹¹ e në vijim, çështja e standardit dhe e raportit të tij me dialektet është bërë objekt diskutimesh e debatesh në mjaft tubime shkencore, në shtypin e shkruar e atë viziv.

Debatet kanë pasur të bëjnë kryesisht me bazën dialektore të standardit: me çfarë u bë mirë dhe çfarë u bë gabim, çfarë u përfshi dhe çfarë u la jashtë tij, çfarë duhet përfshirë nga gegërishtja dhe çfarë duhet rregulluar brenda vetë standardit. Në përgjithësi debatet janë përqendruar te ruajtja dhe përmirësimi i tij nga njëra anë dhe, për një përballje të re me gegërishten, nga ana tjetër. Është bërë e qartë tashmë se si teorikisht¹² edhe nga përvoja e gjuhëve të tjera, mbështetja e standardit në një dialekt (toskë), duke e pasur dialektin (siç është rasti ynë me gegërishten) a dialektet e tjera ndihmëtar/e, është e përligjur. Argumenti i përfaqësimit më të madh numerik për të përligjur *ipso facto* një standard *ad hoc* (popullsia gege sasiorisht më e madhe se ajo toske, duke mos marrë fare parasysh shtrirjen¹³ e standardit të sotëm edhe në arealin dialektor geg), që sillet nga ndonjë gjuhëtar së fundmi¹⁴, në dobi të një ristandardizimi, nga përvoja e formimit të gjuhëve standarde, nuk është domosdoshmëri teorike e praktike. Nga ana tjetër, nuk bën gjë tjetër veçse rihap çështjen e legjitimitimit të standardit të sotëm. Është e vërtetë se përhapja e standardit është një 'shpenzë' për sa i përket mundit të folësve për të përvetësuar kodin normativ të gjuhës së shtetit. Kjo 'kosto' për shtrirjen e standardit në gjithë arealin shqipfolëse pra, edhe përtej arealit toskë duke e përfshirë edhe vetë këtë të fundit) ka pasur rezultate të pamohueshme, sadoqë mbetet ende shumë për të bërë. Por rikthimi në një formë tjetër i tezës së '72-shit për një standard 'mbidialektor'¹⁵ është po aq i gabuar¹⁶ sa edhe vetë pohimi i saj në Kongresin e Drejtshkrimit. Edhe ndonjë tezë për një neostandard¹⁷ metropolitan është po aq e paqëndrueshme sa dhe vetë stabilizimi i popullsisë së ardhur në këtë trevë. Jo vetëm është i gabuar, por edhe i rrezikshëm për të ardhmen e kombit, pasi rihap çështjen e formimit të standardit a të tjetërsimit të tij. Për këdo që merret me probleme teorike të gjuhës e kupton drejt se këtu çështja nuk shtrohet për të ndrequr disa aspekte gjuhësore, një pjesë e mirë e të

¹¹ . Kongresi i Drejtshkrimit, I, II, Tiranë, 1972.

¹² . Richard A. Hudson thekson se zgjedhja e një varianti të caktuar për të kultivuar një gjuhë standarde është mjaft e rëndësishme nga këndvështrimi socio-politik, sepse është e qartë që varieteti i zgjedhur nis e merr më shumë prestigj dhe njerëzit që e flasin atë nisin ta gëzojnë këtë prestigj. Në *Sociolinguistika*, Tiranë, 1995, f. 740.

¹³ . Po aty.

¹⁴ . Konferenca Gjuhësore, Durrës, 2010.

¹⁵ A. Kostallari, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme të drejtshkrimit të saj*. Tiranë, 1973.

¹⁷ L. Shamku – Shkreli, *Standard dhe neostandard. Prirje vetëstrukturuese të shqipes së sotme*. Çabej, Tiranë, 2007.

cilave është vënë në dukje së fundmi edhe nga një punim i kujdesshëm në ‘Fjalor Drejtshkrimor i Gjuhës Shqipe’¹⁸. Nuk është fjala as për përfshirjen e një fjalësi të bollshëm me prejardhje gege¹⁹ i cili, *volendo dolendo*, po i ngjizet standardit pa kurrëfarë pengese. Siç ka pohuar profesor Shkurtaj, “Në mënyrë të veçantë duhet t’i qasemi pasurisë, larmisë dhe forcës shprehëse të leksikut dhe të frazeologjisë së krahinave të Veriut të cilat, qoftë në masën që na janë fiksuar në veprat e autorëve që kanë shkruar në variantin letrar të gegërishtes, qoftë edhe nga gurra e gjallë e gegërishtes së folur ose nga folklori i gegërishtes i Veriut duhet vlerësuar e vështruar kurdoherë si burime të freskisë dhe të prurjeve të domosdoshme për gjuhën letrare të përbashkët.”²⁰ Edhe disa rregulla drejtshkrimore që lidhen me probleme si: shquarsia dhe pashquarsia e disa emrave të përveçëm; emrat gjeografikë që janë togfjalësha, shtrirja e shkronjës së madhe në disa fjalë si; *Bajram, Krishtlindje, Perëndi*; vënia e theksit te disa orientizma si; *téneqe/teneqé, básme/basmá*; një grup emrash mashkullorë që në normën e sotme shkruhen me *ë* si; *djalë, gjalpë, lumë, mjaltë, ballë* etj.; shumësi i disa emrave si; *kabëll, teatër* apo si; *mjeshtër, peditër, otojatër* duhen shqyrtuar dhe dhënë zgjidhje në mënyrë shkencore dhe dhe me miratim prej institucioneve, që merren me problemet e gjuhës në bashkëpunim me Shtetin. Gjithashtu, çështje që lidhen me emrat si: ata që kanë vetëm njëjës apo vetëm një gjini, fjalët e përbëra mbiemërore që lidhen me zanoren *o* a me vizë lidhëse; mbiemra prejëmërore vendesh me papashtesën –ian/-jan, -iot/-jot etj., duhen vënë në tryezën e zgjidhjes. Edhe sistemi foljor ka çështje të debatueshme si: e pakryera e habitores punuakej, lënkej në raport me punuakësh, lënkësh; disa forma të kohëve të thjeshta të habitores që formohen nga pjesorja dhe jo nga tema e së tashmes a ndonjë temë tjetër si: ardhka, thënka, dashka në vend të vika, thënka doka etj; Foljet *bie, shpie* në urdhërore njëjës *bjer* apo *bier, shpjer* apo *shpier*; Gjithashtu ka ngjallur diskutime folje si: *ec, ik, hip* apo *eci, iki, hipi*. Tërheq vëmendjen edhe diskutimi rreth formës *t/s* të foljeve të tipit *mas/mat, nxit/nxis, pëshpërit/pëshpëris* etj. Pra, përveç ndonjë rasti, të pakët janë sot ata studiues, që janë kundër përmirësimeve që duhen bërë në standardin e sotëm dhe se rishikimet aty ku është e nevojshme duhen bërë. Por ta themi qartë: një ndërhyrje e tillë si ajo që propozohet në sistemin foljor, nëpërmjet përfshirjes së paskajores gege, prish sistemin e standardit të sotëm dhe rihap procesin e standardizimit të gjuhës shqipe nga e para, sepse krijon shtratin për një standard tjetër me bazë gegërishten. Duke qenë se folja është bërthama e thënies, pra themeli i gjuhës, ndryshimi i kësaj bërthame trondit themelet e standardit. Me përfshirjen e paskajores gege si formë përfaqësuese, standardi që krijohet nuk mund të jetë as ky që është ‘gjoja i përmirësuar’ as një mbidialektor ‘gjoja gjithëpërfshirës’. Me përfshirjen e paskajores gege, ky i riu që mëtohet të fabrikohet *ex catedra* nuk mund të jetë as më shumë e as më pak veçse një përpjekje për një standard tjetër me bazë gegërishten. Çfarë do t’i mbetej në sistem këtij standardi me përfshirjen e paskajores? Le të ndalemi vetëm në disa prej argumenteve, që vijnë në mbështetje të çfarë theksuam më lart:

1. Problemi i parë është se cilin variant të paskajores do të përdoret: ai *me punu* apo *me punue, kam me bo/kam me ba*. Futja e paskajores ndryshon gjithë kohët e përbëra të sistemit foljor: *kam punuar/kam punu/e; kisha punuar/kisha punu/e* etj..

¹⁸ A. Dhrimo, R. Memushaj, Fjalor Drejtshkrimor i Gjuhës Shqipe, Infobotues, Tiranë, 2011.

¹⁹ Sh. Rrokaj, *Fjalësi me –shëm në veprën e Ismail Kadaresë*, botuar në Çështje të gjuhës shqipe, vëll. I, Arbëria, Tiranë, 2007.

²⁰ Gj. Shkurtaj, Pasuri leksikore e gegërishtes dhe gjuha e njësuar, Konf. shkenc. Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot, Tiranë, 2003, f. 278.

2. Ndryshojnë format e pashtjelluara si: *për të punuar, duke punuar, pa punuar, me të/një të punuar: me punu/e, tu/j punu/e, pa punu/e, me te punu/e(?)*, një të punu/e etj..
3. Ndryshon drejtshkrimi i emrave prejfoljorë si: a) *men(d)oj – men(d)im m(b)jell – m(b)jellje, n(d)aj – n(d)arje*: b) emra që formohen prej foljesh që kanë ë nistore a ë mesore, siç është rasti i mëposhtëm i pikës gjashtë etj..
4. Dalin jashtë sistemit të standardit aktual grupet *mb, nd, ng, ngj: n(d)ez, n(d)aj, m(b)jell, n(j)gjall, dëgjoj/nigjoj, n(d)i(e)j, n(g)as* etj..
5. Pësojnë ndryshime të ndjeshme në fleksion (në trup a në mbaresa) në raport me standardin, një numër i madh foljesh me frekuencë të lartë në përdorim si: *kam/pasë, jam/kenë, dua/du, pi/pin, fle/flen, flas/fol, bëj/baj, boj*.
6. Një problem tjetër është ai i ë-së kryesisht në trup të foljes, e cila në një përlligje të paskajores në standard do të krijonte probleme drejtshkrimore si: *ë(a)nd(ë)rroj, ë(a)m(b)ëlsoj, ë(a)njt, m(ë)soj, p(ë)soj, pun(ë)soj, pik(ë)lloj, rr(ë)fej* etj.
7. Sistemi fontik/përkatësisht ai drejtshkrimor i standardizuar qysh prej Kongresit të Manastirit, pëson ndryshime thelbësore lidhur me pranimin e hundoreve dhe zanoreve të gjata dhe të shkurtra si dhe grafinë e tyre përkatëse. Këto ndryshime sjellin një pështjellim grafik, i cili tjetëron standardin e sotëm.
8. Shprehjet frazeologjike që mbështeten në përdorimin foljor, duke qenë të ngurosur, e ruajnë origjinën dialektore si: *I kalli frikën, më shtiu frikën, U korit daja kur foli me të, Mos e çik atë muhabet, Pse e nguc ..., i vetoi nëpër mend ..., Prej trishtimi nuk bëzan, U trand për një çast, U çart pa arsye... etj.*
9. Shtrirja e paskajores gege brenda standardit të sotëm do ta “tjetërsonte” vetë atë sepse do të deformonte edhe standardin edhe gegërishten e shkruar, pasi do t’i hiqte këtij varianti të drejtën natyrore për ta ruajtur të paprekur këtë perlë të gjuhës shqipe, e cila shërben si një veçanti themelore, që e dallon gegërishten nga toskërishtja.

Mirëpo, rishtimi i problemit të standardit nga pikëpamja e bazës dialektore në kushtet e sotme paraqet një sërë problemesh që lidhen me vetë gjeopolitikën e ndryshimet e mëdha demografike e shoqërore që kanë ndodhur. Veçanërisht dy dekadat e fundit me ndryshimet e mëdha gjeopolitike, me heqjen e perdes së hekurt të kufijve shqiptarët, kanë filluar të lëvizin lirisht në arteriet e kombit. Kjo lëvizje shoqërohet *ipso facto* me lëvizjen e gjuhës, e cila bashkë me përdoruesit e saj del nga enklavat territoriale për t’u ballafaquar në ‘tregun’ gjuhësor kombëtar. Nga ana tjetër, brenda kufirit politik të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi, ndryshimet politike e shoqërore janë shoqëruar me lëvizje demografike, të cilat kanë pasur si pasojë zhvendosje të popullsisve drejt qendrave urbane kryesisht metropoleve apo edhe në hapësirën bregdetare. Në këto kushte konceptet ‘të folme’, ‘dialekt’, etj. po humbin vlerën e tyre teorike klasike dhe gjuha shqipe, nën efektet e shoqërisë globale e të sipërmarrjes së lirë, po ballafaqohet me dukuri të reja siç janë; sociolektet apo të folme të grupimeve të ndryshme a një lloj ‘përzjerjeje idiolektore’ etj. Në një botim tjetër kam vënë në dukje se: “Ndryshimi gjeopolitik pas viteve ‘90 krijon mundësi të reja qarkullimi të njerëzve, bashkë me ta edhe të fjalëve, të cilat dalin nga enklavat, duke kapërcyer pengesat e dikurshme, që vinin nga kufijtë politikë. Brenda kufijve politikë lëvizja e lirë ka vënë në dyshim konceptet klasike të të folmeve dhe të dialekteve në të mirë të krijimit të sociolekteve

a të një “përzierjeje të folmesh” me prurje heterogjene. Gjuha standarde ka prirje të zgjerohet dhe të larmohet me prurje të rëndësishme dhe cilësore kryesisht nga dialekti gegë.”²¹

Në këtë këndvështrim duhen ndërmarrë studime që të trajtojnë shkencërisht çfarë po i ndodh gjuhës në këtë prag shekulli. Me fjalë të tjera, duhen kundruar me vëmendje çështje të ballafaqimit të standardit me këtë konfigurim të ri të shoqërisë shqiptare dhe të varieteteve që përdorin folësit. Studiuesi Gjovalin Shkurtaç me të drejtë thekson: “Dialektet dhe gjuha standarde, si variant i ngritur mbi bazën e një dialekti nuk janë dy ushtri kundërshtarë që ndeshen për jetë a vdekje dhe njëra shfaros tjetrën, por janë degëzime e bija të së njëjtës gjuhë, lindin dhe zhvillohen në të njëjtën bashkësi shoqërore ...”²²

Të gjitha gjasat po tregojnë përherë e më shumë se ky pragshekull është në dobi të shqiptarëve për sa i përket konceptit të njësismit si komb e si gjuhë. Ndarja e tyre në disa shtete pa kurrfarë lidhjeje organike, shpirtërore, gjuhësore, materiale, shoqërore doemos po shpinte deri dy dekada më parë në një ‘thyerje a krisje demografike e gjuhësore’ që, herëherës, shfaqte edhe shenja të konfliktit perceptiv gjuhësor deri në moskuptim a keqkuptim midis anëtarëve të bashkësisë shqipfolëse. Sot prirja globale integruese ndërkombëtare ka sjellë vetiu edhe prirjen integruese kombëtare. Në këto kushte shqiptarët nuk mund të kenë dy standarde gjuhësore e as nuk mund të nisin nga e para një të ri. Faktorët jashtëgjuhësorë shkojnë në të kundërt të këtyre prirjeve, ndaj nuk mund të kthehemi mbrapa për të ndërtuar një standard të ri në vend të këtij që është, pasi një nga kushtet e Bashkimit Evropian është që shtetet pjesëmarrëse brenda tij duhet të kenë gjuhë standarde të njësuara. Po cili është problemi i sotëm që shtrohet para standardit dhe gjithëgjuhës? Është pikërisht zgjerimi i këtij standardi drejt gjithëgjuhës që do të thotë se karakteri njësuës a njohës i idiomës gjuhësore duhet të zgjerohet drejt asaj që quhet gjuha shqipe. Kjo do të thotë se standardi duhet të pranojë natyrshëm për nevojat e veta prurje nga gjithëgjuha, kryesisht nga trevat jashtë kufirit politik të Shqipërisë. Nga ana tjetër, është e domosdoshme sot që të ndërtohen politika gjuhësore që mundësojnë shtrirjen e standardit në tërësinë e shqiptarëve brenda kombit. Pohimet në Kongresin e Drejtshkrimit se gjuha standarde ishte një realitet tashmë në tërë arealin shqipfolës, ashtu si dhe pohimi për natyrën e saj ‘mbidialektore’ ishin më tepër idealiste dhe me ngjyresa të një nacionalizmi ideologjik sesa një realitet gjuhësor. Vetë kushtet gjeopolitike as e kishin favorizuar dhe as mund ta favorizonin këtë gjë deri dy dekada më parë, para ndryshimeve të mëdha gjeopolitike. Prej këndeje del si detyrë kombëtare shtrirja dhe zgjerimi i këtij standardi drejt gjithëgjuhës, me qëllim që shqiptarët të arrijnë një kohezion më të shpejtë shpirtëror e gjuhësor, në mënyrë që ata të kenë një komunikim me frekuencë të lartë në të gjitha fushat e jetës politike, ekonomike, shoqërore, arsimore, edukative etj. Këtu duhet të synojë politika jonë arsimore, politika jonë e botimeve, politika jonë e mediave, që aktualisht po kthehen në faktorë kryesorë për njësimin kombëtar: zgjerimi i standardit nga pikëpamja e afrimit me gjithëgjuhën nga njëra anë, dhe shtrirja e tij në masën kombëtare të folësve, nga ana tjetër. Në këtë drejtim mësimi i standardit nuk mund të bëhet dhe nuk mund të realizohet jashtë vetëdijes për gjithëgjuhën, duke lënë mënjanë formimin e vetëdijes për ekzistencën e dialekteve, e ca më pak, vështrimin e tyre si të ish-in gjuhë tjetër. Lidhur me edukimin gjuhësor në shkollë T. de Mauro do të shprehej: “Ajo që është thelbësore është të mos u kërkojmë fëmijëve të flakin tutje si diçka të fajshme atë çka

²¹Sh. Rrokaj, Shqipja në epokën e globalizmit dhe identiteti i saj, botuar në Çështje të gjuhës shqipe, vëll. II, f. 67.

²²Gj. Shkurtaç, Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe, tiranë, 2003, f. 57.

ka qenë mënyra e tyre e parë e të folurit... Duhet të mbajmë parasysh këtë fakt; kur të na duhet t'ia mësojmë standardin (fëmijës, shën. ynë) le t'ia mësojmë pa iu dhënë shkopinj duarve. Në lëmë të gjuhës, shkopinj të bëjnë efektin e kundërt".²³ Natyrisht, shteti, shkolla, institucionet, mediet, shtëpitë botuese punojnë për ngulitjen e standardit, por ne jemi një shoqëri me standard gjuhësor të ri ende të pangulitur e të panjësuar. Kësisoj nuk mund të pretendohet se shqiptarët e krijuan standardin dhe ai duhet të mbetet një koine statike e dhënë njëherë e përgjithmonë. Sikundër vetë gjuha, brenda së cilës gjëllin, edhe standardi është një proces historik, dinamik në zhvillim; ndryshon e larmohet në përgjigje të kërkesave që ka shoqëria. Katër dekada prej Kongresit të Drejtshkrimit dhe vetëm dy dekada prej ndryshimeve të mëdha politiko-shoqërore janë shumë pak për të folur për një standard të ngulitur, të shtrirë e të njësuar në gjithë trevën shqipfolëse. Sikundër këshillon T. De Mauro²⁴, "një verifikim i kujdesshëm i disa përdorimeve të sotme të shqipes standarde mund të na ndihmojë të kuptojmë më mirë problemet dhe të gjejmë zgjidhjet më të mira të mundshme." Por ky proces duhet parë qetësisht dhe me tolerancë – thekson ai, larg egocentrizmit krahinorist a mendësive me frymëzim parashkencor e politik. Ai duhet parë me sytë drejt së ardhmes të kombit tonë dhe jo me kokën mbrapa për të zhbërë atë që u bë katër dekada më parë, sepse as gjuha as shqiptarët dhe as Shqipëria nuk janë më si katër dekada më parë.

²³T.de Mauro, Mbi gjuhën dhe edukimin gjuhësor, botuar në Dukuri të shqipes bashkëkohore prej L.Shamku-Shkreli, 5-8 tetor, 2005. f. 35.

²⁴ T. de Mauro, Disa konsiderata mbi politikën gjuhësore, vep. Cit. f. 43.

KUMTESA

**Dr. Elindë RAMADANI-DIBRA: LUIGJ GURAKUQI PËR PAVARËSINË DHE
ARSIMIN SHQIPTAR**

“Është pionier i qytetërimit përëndimor në Shqipëri, një nga shqiptarët e flaket që thithi me themele kulturën e Përëndimit dhe si njeriun që punoi më gjate e më shumë se kushdo tjetër për të mbjellur farën e saj në Shqipëri.”,
Fan Noli .

Në këtë 100 vjetor të Pavarësisë së Shqipërisë, është me vend që të kujtojmë dhe të risjellim ndër ne, kontributin e vyer të personaliteteve Shqiptare, që mundësuan me përkushtimin dhe guximin e tyre këtë ngjarje madhore në historinë e kombit tonë. Vitet e para të 1900-tës, sollën në Shqipëri një lëvizje të gjerë për liri e zhvillim kombëtar. Një sërë ngjarjesh dhe zhvillimesh i paraprinë ngjarjes madhore të Shqipërisë, 12 Nëntorit të vitit 1912. Me bindje mund të flitet për një Pavarësi pararendëse, atë të realizuar në shtypin e kohës, ndër veprat letrare, në tekstet shkollore, si dhe me miratimin e alfabetit¹ dhe hapjen e Normales së Elbasanit e të mjaft shkollave të tjera. Kjo lëvizje në bashkërendim me veprimtarinë diplomatike dhe me forcën e armëve të kryengritjeve të viteve 1910, 1911 dhe 1912, nën nxitjet “*dritë e diturisë përpara do na shpjerë*” si dhe *me pushkë e penë për mëmëdhenë*”, mundësuan plot një shekull më parë Pavarësinë e Shqipërisë.

*Lufta për gjuhën e shkollën shqipe nuk ishte thjeshtë një lëvizje kulturore. Ajo mori një karakter të theksuar politik e patriotik. Rilindësit shpallën me forcë se nuk mund të ketë Shqipëri pa shqiptarë, se nuk mund të ketë shqiptarë pa gjuhë shqipe, se nuk mund të ketë gjuhë shqipe pa shkronja shqipe e shkolla kombëtare, ku të mësohej shqipja.*⁴

Në këtë fazë të rëndësishme të lëvizjes sonë kombëtare historia thirri në skenë baballarët e mendjes, një brez të ri luftëtarësh e udhëheqësish, të cilët, me në krye Ismail Qemalin, realizuan idealet e rilindësve, ëndrrën e hershme të shqiptarëve Dhe ndër më të shquarit prej tyre, paraqitet personaliteti i Luigj Gurakuqit, si krijues, studiues, drejtues i arsimit, hartues tekstesh, e mbi të gjitha si mendje e ndritur e patriot i shquar që kontribuoi fuqishëm për lirinë e Shqipërisë. *Është cilësuar si:” ndër më të mëdhenjtë e atyre që mbyllën me sukses një etapë të historisë dhe të arsimit tonë kombëtar, Rilindjen, dhe të atyre që vunë gur themeli për etapën pasardhëse, Pavarësinë.*² Në propagandimin e traditave luftarake, patriotike e liridashëse të popullit tonë, Gurakuqi kishte një synim të madh: shqiptarët të njohin vlerën e vet, të mos hidhen në zjarr e të mos vriten për fitimin e të tjerëve e humbjen e vet, të njohin e të çmojnë vlerën e gjakut të tyre. Gurakuqi është organizator dhe figurë qëndrore e “*Kongresit të Manastirit*” dhe i “*Komisisë Letrare Shqipe*” në Shkodër, drejtori i parë i Shkollës Normale të Elbasanit, ministri i parë i Arsimit Shqiptar (1912), hartues tekstesh dhe librave ndihmës me qëllim zhvillimin e kulturës kombëtare ndër të cilët veçojmë në renditje:

Abetare për Msoitore Filltare t’Shqypniis, Libri i parë, Napoli, 1905.

Knimë t’para për Msoitorë Filltarë t’Shcypnis, Libri i dytë, Napoli, 1905.

Abetar i vogël shcyp mas Abevet t' Bashkimit e t' Stambollit, me tregime n't' dy dhialektet, Bukurect, 1906.

Vargenimi n' Gjuh Shcype me gni Fjalorth shcyp – frangisht n' marim, Napoli 1906.

Fjalorth Shcyp – Frangisht e Frangisht – Shcyp i fjalve t' reja, Napoli 1906.

Abetari i gjuhës shqipe, Moti i Parë, Athinë, 1912.

Këndimet e para për çunat, Mot i Dytë, Prej D.H, Athinë, 1912.

Këndimet e dyta për çunat, Mot i Tretë Prej D.H, Athinë, 1912.

Këndimet e treta për çunat, Mot i Katërtë, Prej D.H. Athinë, 1912.

Shtimi i abetarit shqip për çunat, Mot i Parë e i Dytë, Prej D.H., Athinë, 1912.

Shqipnia përpara Konferencës së Paqes, Ble i parë, Romë, 1919 dhe Ble i dytë, Shkodër, 1920. (Dokumente zyrtare të paraqitura nga Dërgata Shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris), përkthyer e përgatitur për botim në gjuhën shqipe nga Luigj Gurakuqi.

Përkushtimi në hartime tekstesh mësimore e në veçanti të abetareve, zhvillimi i një strategjie mësimore të bazuar në traditë por edhe në modelet perëndimore u bënë motoja e punës së Gurakuqit, për të cilin. "*Çështja e arsimit, ka randësi kryesore në rilindjen e kombit shqiptar, pse vetëm me një mësim të shëndoshë e me një arsim të vërtetë mund të ngjallet e mund të mkambet kombi ynë e mund të fitojë të drejtën me hymun në rradhën e popujve të qytetëruar*"³. Përkushtimi për arsimin, vizioni perëndimor e mbi të gjitha mbështetja në trashëgiminë kulturore të truallit ku u lind e ndihmuan së shumti Gurakuqin që të ndërtojë një koncept të drejtë mbi shkollën kombëtare shqiptare, duke arritur kështu të ndriçoj mendimin arsimor të Rilindjes. Me rastin e hapjes së shkollës së Elbasanit, drejtor së cilës u emërua Gurakuqi, në fjalën e përshëndetjes do të shprehej: "*Dita e sotme. Kjo ditë e bardhë dhe plot hare, që gshini sot mbi qytetin tonë, do të mbetet si një ditë e madhe, si një ditë e çqueme e e paharueme në histori të kombit tonë, do të qëndrojë si një e kreme e shenjtë e e përvojëtëshme, e cila do të lutet me nderim e brohori, babë mbas babe e djalë mbas djali, ndër kohnat e panumëruarshëme që do të vijjë e gjer në jetë të jetës*". Trashëgimia kulturore e popullit tonë, traditat kombëtare, zakonet, dokumentet e ndryshme shkrimore apo gojore që nga më të vjetrat e deri tek më e reja, vlerat që ato mbartin, u bënë shpesh herë objekt vëmendjeje i studimeve dhe i artikujve të Gurakuqit teksa paraqet mendim për to në disa artikuj, e veçanërisht në "*Përparimi i Shqiptarëve*". Gurakuqi është vlerësuar edhe si historiani i parë i traditës arsimore – kulturore shqiptare. "*Veprimtaria pedagogjike dhe arsimore e Luigj Gurakuqit, -shkruan Prof. Bedri Dedja-, shkëlqeu në vitin 1909-1912 e më pas, kur ai vuri në jetë me patriotizëm të flakët, me urtësi dhe me guxim politik, me një guxim të pashembullt shkencor, idealet e Rilindjes Kombëtare për arsimin.*"⁴

Ai njihte e vlerësonte ndihmesën e dhënë nga shkrimtarët e vjetër për kultivimin e gjuhës shqipe, zhvillimin e letërsisë e të kulturës sonë kombëtare, si: Buzukun, Budin, Bardhin, Bogdanin, njihte mirë krijimtarinë e ndihmesën e shkrimtarëve e veprimtarëve të shquar të lëvizjes kombëtare nga të gjitha trevat e Shqipërisë, nga arbreshët, nga kolonitë shqiptare në Evropë, të të gjithë shqiptarëve kudo që jetonin e vepronin. Vlerëson ndër shkrime dhe fjalime Naim Frashërin, Veqilharxhin, Mitkon, Abdyl e Sami Frashërin, Jani Vreton, etj.

Pati fati të njihej nga afër me botën arbëreshe me përpjekjet e mëdha të bëra nga arbëreshët për ruajtjen e mbajtjen gjallë të zakoneve, të traditave e të gjuhës amtare dhe njëkohësisht të kishte mësues ne kolegjin e Shën Mitër Koronës, Jeronim De Radën.⁵ Jeronin de Rada është për Gurakuqin "*sotëpërsot vjershëtari ynë më i madh*", dhe përulet me respekt të thellë ndaj këtij këngëtarit të "*naltë dhe të ambël*", ndaj "*Nestorit Arbëresh*". Gurakuqi vlerëson edhe punën e gjithë atyre që e ndoqën rrugën e këtij burri të madh, si Darën, Kamardën,

Skiroin, etj. Ndiqte me vëmendje të gjitha zhvillimet gjuhësore, letrare e kulturore dhe mbante lidhje të ngushta me personalitetet e shquara të kësaj fushe. Vlerësonte punën e imzot Pal. Doçit, abatisit të Mirditës, themeluesit të shoqërisë “Bashkimi”. Në *parathënien e veprës, “Milli e Hajdhia”*. Gurakuqi theksonte se imzot P. Doçi “*të gjithë jetën e vet ia ka falun Atdheut tue u munduar burrërisht të shpetojë atë nga të këqijat që e ndrydhin gjer më sot, ma parë me trimëri të gjyshërve, tash me dituri e me mendje krejt të kohës sone.*”⁶ I nisur nga këto frymëzime, përktheu në italisht këngën e parë të “Lahutës së Malcis”.

Tërë jetën s’ka rreshtur të kujdeset për të njohur e propaganduar traditat më të mira kulturore e historike të popullit tonë, për të nxjerrë në dritë çdo gjë të mirë që kishte trashëguar ky popull që nga lashtësia. Në këtë kuadër është me vlerë të theksojmë interesin që tregoi ai për gërmimet arkeologjike në Shqipëri dhe për botimin e “*Mesharit*” të Buzukut.

Duke vlerësuar shumë e propaganduar parreshtur traditat e shquara të popullit tonë, Gurakuqi iu shmang paraqitjes romantike dhe idealizuese të Shqipërisë nga disa paraardhës të tij. U përpoq të jepte një pamje realiste të Shqipërisë. Ai vuri në dukje të metat e bënte thirrje për t’i luftuar ato. Ndër këto të meta e zakone të këqija që e shqetësoi më shumë Gurakuqin, ishte gjakmarrja.

Gjakmarrjen e dënonte si akt të dëmshëm dhe si mjet për nxitjen e përçarjes në mes të popullit nga të huajt. Ai brengoset se shqiptarët “... *ndër vedi janë tue u vra/ E’n’gjak t’vllazve duert tuj la*”, se “*Me u kthye mbar’gjaqet s’na lanë./ Ndërmjet vllaznve idhnimi s’ pranë*”.

Gurakuqi nuk pajtohet me faktin se disa shqiptarë po rendnin pas fitimit, duke harruar edhe interesat atdhetare e duke u bërë vegël e të huajve. Prandaj i shqetësuar shkruan:

*“T’bijt e saj janë çoroditë,
Me fitue, por veç mendojnë,
E me u vra me shoqishojnë”.*

Këtu buron thirrja e tij e fuqishme plot duf shpirtëror:

“Uh! Ç’e zeza, o bijt e mi?

*Sa keq jeni tuj punue,
Lenie ma ket zakon t’zi,
Gjaqet vinë ma me i harrue”*

Godet e satirizon kulturën fallso të disa njerëzve, veçanërisht të disa të rinjve që, duke dalë nëpër Evropë, mendojnë se sjellin qytetërimin në Shqipëri, duke harruar gjuhën e zakonet e veta. Me forcë e frymë të thellë patriotike e shpreh këtë në poezinë “*T’falun Atdhetarit të Kosovës*”.

Pra ky burrë shteti , na paraqitet në plotësinë e tij edhe si poet, madje nga kritika është konsideruar edhe si pararendës për brezin brilant të letërsisë që do të lulëzonte në Shkodrën e viteve 20-30. Krijoi poezi dhe i krijuan poezi. Pazgjidhshmërisht lidhet shpirti i tij prej:

Atdhetari: teksa veçojmë krijimin e mësipërm si dhe “ Shqipja e burrit”, “ Dita 29 Tetor 1900”, “ Luftetari tue dekë”,

Mërgimtari; teksa ishte larg vendlindjes hedh në letër poezitë” Shpis sime”, “ Dallëndyshja u kthye”, “ Dëshirë”, “Tufë lulesh”,

Mësuesi: “Rrenacaku” , “Stinët e motmotit” “Mësimi”, “Mbarimi i vjetit të shkollës”, “ Fëmija prekës”etj.

Një tjetër kontribut shumë i rëndësishëm i Gurakuqit është “*Vargënimi n’gjuhë shqype*”, libër studimor i vyer teoriko- letrar, i cili u bë një ndihmesë e fuqishme për gjithë krijuesit

dhe studiuesit e letërsisë. Synimi për botimin e këtij libri ishte i qartë, zhvillimi i letërsisë shqipe e kryesisht poezisë, siç edhe nënvizon vetë autori në parathënien e veprës” *“Për me ba qi vjersha shqype të përparojë për ditë e ma tëpër e t’I përgjigjet, jo vetëm më mendimi e ide, por edhe me trajtë t’përyshtrime kërkimeve e nevojave t’mjeshtrisë u vuna e shkrova disa vremje e rregulla përmë masë t’përmbledhun t’vargjeve që janë si me thanë, vesha e stolija e vjershës, të cilat poi a ve sot përpara shkrintarëve tanë”*⁷.

Studioi dy dialektet e shqipes . Siç njëjthe gegërishten, bënte studime serioze për të njohur edhe toskërishten. Në kapitullin e dytë të *“Vargënimi n’gjuhë shqype”*, na bën me dije se *“Unë, ndonëse gegë, kam një andje të veçantë për toskërishten.”*⁸ Me modesti, thekson se meqë nuk është toskë, nuk ia rrit mendjen vetes për të pretenduar se e di mirë toskërishten. Megjithatë mendimet që shfaq për këtë dialekt, nuk janë aspak të pastuduara, por rrjedhim i vëzhgimeve të gjata e serioze: *“... fjalët e gjykimet e mija në këtë çështje rrjedhin prej kërkimesh e vremjesh t’gjata e t’kujdesshme”*⁹

Krahas gjithë kësaj veprimtarie, Gurakuqi ndiqte me vëmendje të veçantë punën dhe përpjekjet e kolegëve të tij në fushën e publicistikës, e ndër të tjera veçojmë, vlerësimet për revistën *“Albania”* dhe kryeredaktorin e saj Faik Konica. Nuk resht së theksuari se se të gjithë shqiptarët duhet të njohin vlerat e Konicës si lëronjësi i gjuhës letrare, si punëtor i palodhur për zgjimin e ndërgjegjjes kombëtare dhe si veprues në fushën politike. *“Ai, ka fitue një nderim të madh përta i përket lëvrimin të gjuhës sonë. Të gjithë duhet t’a admirojnë se këtë gjuhë e përdori rrokull sa e sa vjetësh për me zgjue në zemrat e shqiptarëve ndiesi kombëtare e dashuri për atdhe.”*¹⁰

E ndërsa vlerëson e çmon punën e bashkëkohësve, jo më kot vlerësimin hyrës të *“Vargënim N’ Gjuhë Shqype”*, Luigj Gurakuqi ia kushtoi Gjergj Fishtës, i cili *“... me vepra t’larta e t’shkëlqyeshme i fitoj nderë e famë t’pasosme zanave shqypitare.”*¹¹

Këngët e para të *“Lahutës së Malcisë”* së Fishtës menjëherë morën dhenë e çuan peshë zemrat e shqiptarëve, ndër ta edhe të Luigj Gurakuqit. Arti i Fishtës e magjeps. Ai është i mendimit se *“Hylli i Zanës Arbnore / Leu me Lahutën”* dhe i drejtohet Fishtës së *“Vjershënimin në ne, lulzim nëpër ty ka gjetun”*. Ashtu si në pyll, kur këndon bylbyli zogjtë e tjerë, në shenjë nderimi, përpara tij të gjithë zërin ulin, *“Edhe Shqypitarët ashtu: ç’atherë qi ushtima, E lahutës s’ ate nisi me tingllue, Shuen kangën t’gjithë e, t’sjellun kah Zadrime, Zun me ndigjue”*.

Fryma patriotike e kësaj dhe mbështetja në eposin shqiptar e rrëmben të tërin. *“Me Lahutën, vë në dukje Gurakuqi, – leu Hylli i Shqipënisë qi Knjazët tuten”*. Ka besim të patundur se vargu i *“Lahutës”* do t’i zgjojë shqiptarët nga gjumi e do t’i bashkojë:

*“tuej u mbledhun, t’shpejtë si era,
Si pranë Marash Ucit, Lekët e Hotit,
U mblodhën at hera”*.

Ai nuk është kundër kulturës së huaj, zakoneve e traditave të të tjerëve, qytetërimit evropian, por kërkon që kultura e qytetërimi evropian të merren me taban, në përputhje me zakonet e traditat tona: *“T’marrim prej tjerëve çka t’jen’ mirë për ne./ E t’ lam’ m’ njen an’ teprin”*.

Mbi bazën e këtij koncepti që kishte ai thekson se po të lëmë zakonet që kemi trashëguar, po të mohojmë prindërit tanë, atëherë *“Fisnik ma s’ jemi, s’ jemi ma shqiptarë”*.

Lufta e tij për propogandimin e afirmimin e traditave e zakoneve më të mira të popullit tonë ka synime të qarta patriotike, sociale e kulturore. Kultivimin e tyre e vlerësonte si element të rëndësishëm të formimit të ndërgjegjes kombëtare, si mjet të qytetërimit e të kulturës së popullit. Sigurimi i unitetit kombëtar të popullit tonë ishte ndër synimet themelore të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Si dhe rilindësit e tjerë edhe Gurakuqi e shihte këtë unitet, si unitet territorial, krahinor, unitet gjuhësor dhe unitet e mirëkuptim fetar. Luftoi për të bashkuar në një të tërë tokat e viset shqiptare. Për këtë ai iu përmbajt idesë: *“Shqipnia e shqiptarvet me kufijt që i ka falun zoti deri ku flitet gjuha e ambël e zogjvet të shqipes.”*¹² Njësinë e atdheut, bashkimin e kombësisë, lidhjet e gjakut e të gjuhës, mirëkuptimin fetar në mes besimeve të ndryshme, i quante si baza të sigurta të jetës kombëtare.

Gurakuqi, si drejtues dhe organizator i shkollës shqipe dhe arsimit kombëtar, si mësues dhe edukator, si pedagog dhe didakt i talentuar, i kushtoi shumë vëmendje, përpjekje dhe energji sigurimit të teksteve mësimore, hartimit dhe botimit të tyre. Kontributi i tij në këtë në këtë fushë të dijes që i një rëndësie të veçantë jo vetëm për sistemin arsimor por për gjithë zhvillimin kombëtar: *“Çështja e arsimit, theksonte Gurakuqi, ka randësi kryesore në rilindjen e kombit shqiptar, pse vetëm me një mësim të shëndoshë e me një arsim të vërtetë mund të ngjallet e mund të mkambet kombi ynë e mund të fitojë të drejtën me hymun në rradhën e popujve të qytetëruar.* Kontributi i tij në këtë fushë që gurë themeli për mendimin pedagogjik shqiptar. Në këtë drejtim e ndihmoi kultura e gjerë, formimi i shkencor e pedagogjik, njohja e gjuhëve të huaja dhe, mbi të gjitha, patriotizmi që u bë motivi që shoqëroi veprimtarinë së tij nëpërmjet një vullnetitë pashoq. Si autor dhe bashkautor, me punë origjinale, apo edhe me përshtatje, siç e bëmë me dije më sipër, Gurakuqi i dha shkollës shqipe tetë tekste mësimore, me një vëllim prej 732 faqesh. Gurakuqi na ka lënë platformën pedagogjike e shkencore më të përparuarën dhe më të arrirën e kohës së tij për hartimin e teksteve shkollore. Probleme të veçanta të saj i ka trajtuar në disa artikuj, nga të cilët duhen veçuar: *“Albania” e Shoqnija e “Bashkimit” - Themelimi i gjuhës letrare*, *“Gjuha e shkencave”*, si edhe në disa letra, posaçërisht në letërkëmbimin me Asdrenin.

Nga ana tjetër, njohjen e përvetësimin e traditave e zakoneve të popullit Gurakuqi do ta konsideronte si një nga detyrat më të mëdha të shkollës shqiptare, si një nga qëllimet e më të mëdha të sistemit arsimor për edukimin qytetar të të rinjve shqiptarë. Prandaj ai do të shkruante: *“Nji popull që nderon burrat e vet, nji popull që pavdekëson kujtimin e tyne, jo vetëm ndër faqet e histories, por edhe mbi rrasa e në monumenta, ai popull tregon se ka ndërgjegje, se ka ndiesi të holla, se nje miradijen e ka dëshir me u sjellun e me u drejtuem mbas shëmbullit të të Mëdhajvet të vet”*.¹⁶

KUMTESA

Fehmi ISMAJLI: HUAZIME TË SHQIPES NË FUSHËN E ARSIMIT - KORNIZA E KURRIKULËS DHE FJALORI I SAJ

Procesi i globalizimit, si proces botëror, ka ushtruar dhe vazhdon të ushtrojë ndikimin e vet të fuqishëm në të gjitha fushat e dijes dhe të jetës në tërë botën. Natyrisht, ky ndikim vjen nga shtetet më të mëdha, më të zhvilluara dhe më të fuqishme të botës në aspekte të ndryshme: teknologjike dhe ekonomike, ushtarake dhe politike, arsimore dhe shkencore, gjuhësore dhe kulturore, etj. Ky ndikim, me kohën, jo vetëm që nuk (do të) ndalet por as nuk (do të) dobësohet. Përkundrazi, ai vetëm sa do të rritet dhe zgjerohet, pothuaj në të gjitha fushat e dijes, të punës dhe të jetës. Ky ndikim (do të) ndihet edhe më shumë në vendet e vogla dhe (më) pak të zhvilluara. Ky dikim ndihet edhe në fushën e gjuhëve, me ndikimet që gjuhët mëdha janë duke ushtruar mbi gjuhët më të vogla. Por, megjithkëtë, ndikimet e këtilla nuk shkojnë në masën e plotë vetëm në një kahe, pra ky është proces i dykahshëm edhe pse me disproporcione të mëdha mes tyre. Gjuhët e ndryshme, numri i të cilave, si gjuhë të folura, arrin në 6000 sosh, duke bashkëjetuar me njëra-tjetrën, ndikojnë reciprokisht mbi njëra-tjetrën, edhe pse jo në të njejtën masë. Ato, sikur edhe njerëzit, kanë nevojë për njëra-tjetrën, që të ndihmohen, të plotësohen me fjalë a njësi gjuhësore të cilat u mungojnë dhe për të cilat ato kanë nevojë t'i kenë në përdorim. Prandaj, pikërisht nga kjo nevojë lind nevoja për huazimin²⁵ e fjalëve të huaja që një gjuhë bën nga një a më shumë gjuhë të tjera. Nga kjo praktikë nuk bën përjashtim as gjuha shqipe.

Marrëdhëniet gjuhësore mes gjuhëve të ndryshme, në të kaluarën më të largët, vareshin më shumë nga afria gjeografike mes gjuhëve të ndryshme, nga afria e familjeve të gjuhëve dhe nga komunikimi i drejtpërdrejtë mes njerëzve të gjuhëve të ndryshme. Në kohën e sotme, shumë dinamike dhe intensive, me zhvillime të mëdha tekniko-teknologjike, me qarkullime të mëdha të njerëzve, ideve, mallërave, etj., ato nuk varen më vetëm nga faktorët e sipërshtuar: koha e kompjuterit dhe e internetit, në njërin anë dhe procesi i globalizimit, në anën tjetër kanë bërë që ndikimi i gjuhëve “të mëdha” mbi gjuhët “e vogla”, thënë kushtimisht, të bëhet çdoherë e më i fuqishëm. Nevojat e njerëzve për lëvizje në këtë botë çdoherë e më të vogël, për arsye ose shkaqe të ndryshme (shkollim, karrierë, punë, biznes, etj.) janë (duke u) shtuar vazhdimisht, prandaj edhe nevoja për njohjen e gjuhëve të huaja për kontakte mes njerëzve bëhet gjithnjë e më e madhe.

Gjuhët, ashtu sikur edhe njerëzit ose shtetet, manifestojnë prirjen për dominim mbi gjuhët tjera. Ato bëjnë luftë²⁶ të përhershme mes vete për dominim të cilën nuk e shohim as ndejmë ne të gjithë: këtë mund ta bëjnë gjuhëtarët, e veçanërisht leksikologët / leksikografët

²⁵ Ky artikull është vazhdimësi e një artikulli që i kushtohet huazimit të fjalëve të gjuhës shqipe.

²⁶ Louis-Jean Calvet, «La guerre des langues et les politiques linguistiques», Paris 1987.

të cilët përcjelin lëvizjet e fjalëve nga gjuhë të tjera në gjuhën e caktuar. Në të vërtetë, çështja e huazimeve është temë e përhershme debatesh shkencore, studimesh dhe qasjesh të ndryshme. Natyrisht, edhe në këtë fushë ka mendime e kualifikime të ndryshme për këtë çështje. Kështu, edhe për kuptimin e termit *huazim* ka mospajtime mes studiuesve të ndryshëm të kësaj fushe, sikur edhe për atë se cilat fjalë dhe sipas cilit kriter duhet të quhen huazime ose fjalë të huaja e cilat jo. Dhe kështu lindin pyetjet: si duhet të quhen fjalët e huazuara të një gjuhe që futen në një gjuhë tjetër?²⁷ Deri kur fjalët e huazuara duhet të quhen të tilla? Kur bëhen pjesë e leksikut të gjuhës në të cilën futen (në përdorim)? Si fitohet ky “status” dhe në çfarë kushtesh?

Përpjekja e parë e rëndësishme për rregullimin ligjor të e arsimit parauniversitar në Kosovë u bë në vitin 2001 kur u hartua versioni i parë i Kornizës së Kurrikulit të Ri të Kosovës²⁸. Ai u rishikua pas shumë vitesh nga MASHT (në vitin 2011), u modifikua pjesërisht dhe kështu u hartua versioni i dytë dhe i fundit i këtij dokumenti i cili konsiderohet si “kushtetutë” e arsimit parauniversitar. Më vonë ky version, i modifikuar në përmbajtje dhe emër²⁹, u miratua në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe u bë dokument të obligueshëm juridik për MASHT-in dhe për të gjitha institucionet arsimore dhe administrative të Republikës së Kosovës.

Korniza e Kurrikulës ndahet në dy pjesë kryesore:

- e para përcakton Kornizën e Kurrikulës dhe bën fjalë për:
 - a) rolin, funksionin dhe strukturën e Kornizës së Kurrikulës,
 - b) kompetencat kryesore të të nxënit,
 - c) parimet e Kornizës së Kurrikulës,
 - d) Korniza e Kurrikulës sipas niveleve arsimore dhe shkallët e saj,
 - e) Fushat, lëndët dhe modulet mësimore,
 - f) Dokumentet e Kurrikulës dhe
 - g) Sistemi i vlerësimit të nxënësve
- e dyta përcakton zbatimin e Kornizës së Kurrikulës dhe bën fjalë për:
 - a) rolin e shkollës,
 - b) hartimin e materialeve të reja për mësimdhënie dhe nxënie dhe
 - c) zbatimin e Kornizës së Kurrikulës për arsimin parauniversitar.

Korniza e Kurrikulës përmban edhe një pjesë të veçantë – *Fjalorthin* - në të cilën përfshin 89 *konceptet* bazë³⁰, një pjesë e konsiderueshme e të cilave janë fjalë³¹ që nuk i

²⁷ Fjalë të huazuara, të marra nga një gjuhë dhënëse dhe të pranuar nga gjuha marrëse, pra të futura në përdorim.

²⁸ Dokumenti u përfundua në DASH, nga ekspertë vendorë dhe të jashtëm, por nuk u bë dokument me fuqi ligjore.

²⁹ Dokumenti mori emrin “*Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës*” (në tekstin e mëtrjëm – *Korniza e Kurrikulës*).

³⁰ Lista e plotë e Kurrikulës shënon 89 fjalë (koncepte), me kuptimet e tyre të përcaktuara në këtë dokument.

kemi pasur në përdorim në gjuhën shqipe më parë. Për të gjitha këto fjalë (të emërtuara si *koncepte*) janë dhënë *shpjegime*, pra është bërë një përkufizim përshtues i kuptimit të tyre në këtë dokument të rëndësishëm. Në disa raste, për to janë dhënë edhe *konceptet ekuivalente* për to, për të saktësuar kuptimet e tyre.

Këto koncepte të reja, të shënuara me një ose më tepër fjalë të huaja, do të jenë në fokusin e shqyrtimit tonë të mëtejshëm³². Kjo vlen edhe për fjalët e reja, të huazuara nga gjuhë të huaja, që janë përfshirë në listën e plotë të këtyre koncepteve dhe shpjegimeve të tyre.

Përveç fjalëve të huazuara, të përfshira në pjesën e Fjalorthit, ne kemi nxjerrë edhe fjalët e huazuara nga gjuhë të huaja, të përfshira në tërë tekstin e Kornizës së Kurrikulës. Natyrisht, fjalën e kemi për fjalët e reja (huazimet), të bëra gjatë viteve të pasluftës dhe të përfshira në këtë dokument. Edhe këtu janë përfshirë një numër i konsiderueshëm fjalësh të huazuara rishtas dhe të cilat nuk ishin në përdorim në fjalorin e shqipes të fushës së arsimit në Kosovë deri në fund të viteve të nëntëdhjeta. Për arsye praktike, fjalët e huazuara, të përfshira në Kornizën e Kurrikulës, do t'i shqyrtojmë bashkarisht, duke përgatitur një listë të përgjithshme dhe duke përdorur një qasje të njejtë për trajtimin e tyre.

Lista e zgjeruar³³ e fjalëve të ndryshme, të përdorura në Kornizën e Kurrikulës, përmbajnë kryesisht një fjalë të huaj, të huazuar nga gjuha e huaj (kryesisht nga gjuha angleze). Disa prej fjalëve të huazuara janë përdorur në një ose në më shumë se një fjalë, prandaj numri i tyre është më i vogël se ai i fjalëve në të cilat ato janë përdorur³⁴.

Struktura gramatikore e fjalëve të huazuara është e larmishme: numri më i madh i tyre, siç ndodhë zakonisht, janë emra të përgjithshëm, por në mesin e tyre ka edhe mbiemra.

Zëvendësimi i fjalëve të huazuara në një gjuhë, me fjalë semantikisht të barasvlershme të saj, është një çështje komplekse për dy arsye: e para - pasi kjo çështje nuk është thjesht një problem gjuhësor (leksikor) dhe e dyta - pasi është vështirë, pothuaj e pamundur që, përnjëherë, të gjenden zëvendësimet adekuate të gjitha fjalët e huazuara. Për këto arsye, në këtë rast nuk do të merremi me çështjen e zëvendësimit eventual të fjalëve të huazuara me fjalë shqipe, pasi ky do të jetë objekt i një shqyrtimi të mëvonshëm³⁵.

Në vazhdim, ja lista e gjerë e këtyre fjalëve, të përfshira në tekstin e Kornizës së Kurrikulës, në cilëndo nga pjesët e saj, të shënuara në trajtën e përdorur në të, në të cilën hyjnë edhe fjalët e huazuara³⁶, të shënuara me italik dhe të ndara nga grupet e fjalëve (fusnota 12).

³¹ Me termin fjalë do të nënkuptojmë fjalët e vetme ose grupet e fjalëve që janë përdorur në Kornizën e Kurrikulës.

³² Për arsye të vetëkuptueshme, ne nuk do të mirremi me konceptet e reja që shënohen me fjalë shqipe.

³³ Lista e zgjeruar përmban rreth 120 togfjalësh (formulime gjuhësore të ndryshme).

³⁴ Fjalët e huazuara do të shënohen vetëm një here, pra nuk do të përsëritën.

³⁵ Kjo do të bëhet në një artikull përmbledhës, pas artikujve kushtuar huazimeve të shqipes në fushën e arsimit.

³⁶ *Administrim, akreditim, alokim, aplikativ (aplikim, aplikues, aplikuar i), asistent, balancuar (i), CV (sivi / seve),*

| | |
|--|---|
| <p><i>Administrim i testit</i> <i>akreditim i programeve</i> aktivitet <i>ekstrakurrikular</i> aktivitet <i>kurrikular</i> aktivitet <i>mësimor sfidues</i> alfabetizim <i>digjital</i> alokim i kohës aplikim (<i>aplikues</i>) i programeve arsim <i>formal</i> arsim <i>informal</i> arsim <i>joformal</i> arsim <i>passekondar</i> jouniversitar bibliotekë <i>elektronike</i> <i>CV (si vi ose seve)</i> <i>digjitalizim</i> i shkollave <i>diversitet</i> kulturor <i>dizajnim</i> i programeve <i>dizajnuet</i> inovativ edukim i <i>balancuar</i> ekonomi <i>globale</i> elemente plotësuese <i>kurrikulare</i> <i>fasilitim</i> i punës në shkollë <i>figuracion</i> <i>fleksibilitet</i> i shkollës <i>fokusim</i> i mësimdhënies fushë e <i>aplikuar</i> fushë jashtëkurrikulare fushë <i>kurrikulare</i> <i>gjenerim</i> i programeve <i>infrastrukturë</i> shkollore</p> | <p><i>Kurrikulë</i> spirale <i>Kurrikulë</i> zgjedhore lëndë <i>aplikative</i> lëndë e <i>integruar</i> lëndë <i>opcionale</i> material <i>aplikativ</i> <i>menaxhim</i> i Kurrikulës <i>menaxhim</i> konstruktiv <i>menaxhues</i> i shkollës mendimtar <i>krektiv</i> menduarit (të) <i>krektiv</i> <i>mentor (mentorim)</i> mësim <i>digjital</i> mësim <i>efektiv</i> mësim <i>elektronik</i> mësim <i>holistik</i> mësim <i>inovativ</i> mësim <i>virtual</i> mësimdhënës <i>asistent</i> mësimdhënie e <i>balancuar</i> mësimdhënie <i>eficiente</i> mësimdhënie e <i>integruar</i> mësimdhënie <i>interaktive</i> mësimdhënie <i>koherente</i> mësimdhënie <i>proaktive</i> metodë e <i>aplikuar</i> metodë <i>interaktive</i> e mësimdhënies <i>mision</i> i shkollës <i>modalitet</i> i punës <i>modul</i> mësimor</p> |
|--|---|

digjital (digjitalizim), diversitet, dizajn (dizajnim, dizajnuet), eficient, efektiv, ekstrakurrikular, elektronik,
fasilitim, figuracion, fokusim, formal, formativ, gjenerim, global (globalizim), holistik, informal, informativ,
infrastrukturë, inovativ, integrim (i integruar), interaktiv, jashtëkurrikular, joformal, koherencë (koherent),
kompetencë, komunitet, konsistencë, konsolidim, konstruktivist, kontekstualizues, kreativ, kurrikular, Kurrikulë,
memorizues, menaxhim, (menaxhues), mentor (mentorim), mision, modalitet, modul, monitorim (monitorues),
mostër, nënsektor, normativ, objektiv, opcionale, operativ, passekondar, prioritetizim, proaktiv, procedim,
produktiv, prokurim, reflektim, reproduktiv, resurs, sektor, sfidë (sfidues), softver, staf, standardizuar (i), stres,
sumativ, teknologji, trajnim, transparencë (transparent), veb (ose web), virtual.

| | |
|---|--|
| integrim i Kurrikulës koherencë e programeve kompetencë digjitale kompetencë kryesore komponentë operative komunikim (komunikues) efektiv komunitet global konsistencë konsolidim i dijes kontribues produktiv Kornizë e Kurrikulës kurrikulë Kurrikulë bërthamë Kurrikulë e fshehur kurrikulë e integruar Kurrikulë efektive Kurrikulë formale Kurrikulë me bazë shkolle prokurim qasje interaktive qasje konstruktiviste realitet virtual reflektim pozitiv resurse njerëzore sektor i arsimit sfidë arsimore shëndet reprodutiv shkallë kryesore e Kurrikulës shkallë kurrikulare shkathtësi proaktive shkollë transparente sistem i Kurrikulës | monitorim i mësimit monitorues i procesit mostër e dijes nënsektor i arsimit nivel formal i arsimit normativ arsimor nxënie e integruar nxënie memorizuese nxënie sfiduese pakoja e Kurrikulës performancë e nxënësve personel menaxhues plan operativ politika të Kurrikulës prioritetizim i objektivave procedim efektiv program i balancuar programe ekstrakurrikulare softver arsimor staf menaxhues stres strukturë e Kurrikulës teknologji informative test i standardizuar trajnim i mësimdhënësve veb faqe veprim kontekstualizues vlerësim formativ vlerësim i standardizuar vlerësim sumativ zhvillim holistik |
|---|--|

Fjalët e huazuara, të përfshira në listën përfundimtare³⁷, janë pranuar në një trajtë të caktuar. Siç ndodhë në të shumtën e rasteve, këto fjalë janë futur në përdorim në gjuhën shqipe në trajtën fonetike të tyre të gjuhës nga e cila kanë ardhur (shumica absolute e tyre nga gjuha angleze). Me këtë rast, fjalët e huazuara kanë pësuar ndryshime të konsiderueshme morfologjike – kanë ndryshuar trajtën e tyre të origjinës duke iu përshtatur rregullave të gjuhës shqipe dhe duke ruajtur shqiptimin e tyre të gjuhës dhënëse.

Ndryshimet e bëra morfologjike të fjalëve të huazuara kanë të bëjnë me ndryshimet:

³⁷ Fjala është për listën përfundimtare të fjalëve të huazuara, të përfshira në Kornizën e Kurrikulës (fusnota 12)

KUMTESA

1. në fillimin (parashtesat) e fjalëve të huazuara, si: *jashtëkurrikular, joformal, nënsektor, passekondar*;
2. në fundin (prapashtesat) e fjalëve të huazuara, duke u përshtatur me ato të gjuhës shqipe, si psh., *administrim, aplikim, diversitet, dizajn, fasilitim, gjenerim, infrastrukturë, konsolidim, menaxhim, monitorim, transparencë*;
3. të shkronjave të përdorura në fjalët e huazuara, duke ruajtur shqiptimin e gjuhës dhënëse, si psh., *aplikant, asistent, elektronik, kreativ, proaktiv, sektor*;
4. me ndryshime të tjera që nuk i përmbahen formës fonetike as morfologjike të fjalëve të huazuara, si psh., *mision, resurs*.

Ndërkaq, në disa raste, fjalët e huazuara në trajtën e përshtatur, krahas ruajtjes së trajtës shqiptimore, kanë ruajtur edhe trajtën shkrimore të tyre të gjuhës së origjinës, si psh., *global, formal, informal, mentor, normativ, staf, stres³⁸ virtual, CV³⁹* (sivi, por edhe seve), *web* (ose *web*).

Fjalët e huazuara kanë “mbuluar” një pjesë të madhe të fushës së arsimit parauniversitar të Kosovës, duke plotësuar zbrazëtitë jo të pakëta të fjalorit ekzistues të shqipes në fillim të viteve 2000, duke përcaktuar një pjesë të fjalorit të ri që do të përdoret në këtë fushë dhe duke përkufizuar kuptimet e terminologjisë së re, të futur në përdorim gjatë kësaj periudhe kohore.

Fjalori i huazuar shënon reformat dhe zhvillimet e reja të gjitha niveleve arsimore parauniversitare në Kosovë dhe fushat e ngushta, aspektet e dimensionet e ndryshme të tyre: sistemin e ri arsimor, programet mësimore, planet mësimore, trajnimet e personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollave, etj); ndryshimet e shumta që janë bërë në këtë fushë me qëllim të përafrimit të sistemit tonë arsimor me ato të vendeve euroatlantike.

Huazimi i këtyre fjalëve, pothuaj që të gjitha nga gjuha angleze, në formën e huazuar, sipas rregullave fonetike të gjuhës së huaj nga e cila janë huazuar, gjatë përdorimit të tyre praktik në gjuhën shqipe, në formën gojore, por edhe në atë të shkruar, nuk ka paraqitur ndonjë vështirësi të veçantë. Kjo ka ndodhur pasi, pas luftës së fundit, gjuhët e huaja (sidomos gjuha angleze, por edhe gjuhët tjera të “mëdha”⁴⁰) tashmë kanë fituar një rëndësi më të madhe dhe një status juridik të ri⁴¹ (sidomos e para) dhe si të tilla janë duke u

³⁸ Fjalët staf dhe stres në gjuhën angleze kanë shkronjë të dyfishtë në fund të tyre (*staff, stress*).

³⁹ Kjo shkurtesë shkruhet si në gjuhën dhënëse (CV), por shqiptohet në dy mënyra (anglishtfolësit e shqiptojnë në

mënyrën e parë, kurse frëngjishtfolësit edhe në të dytën).

⁴⁰ Pas gjuhës angleze, për nga përdorimi i tyre në Kosovë renditen: gjuha frënge, gjuha gjermane dhe gjuha italiane

⁴¹ Sipas Kornizës së Kurrikulës gjuha angleze duhet të mësohet si lëndë e detyrueshme nga klasa e parë e shkollës

fillore, kurse gjuhët e dyta (gjuhët: frënge, gjermane, italiane, spanjolle, etj. duhet të mësohen si lëndë zgjedhore

përdorur çdoherë e më shumë nga popullata vendore, sidomos nga ajo e moshës së re (shkollore dhe universitare), por edhe nga personeli mësimdhënës, udhëheqës i institucioneve edukativo-arsimore dhe nga personeli administrativ i fushës së gjerë të arsimit.

Arsyeshmëria e huazimeve

Sikur çdo gjuhë edhe gjuha shqipe është gjuhë e gjallë, pra gjuhë e cila përdoret në jetën e përditshme, në formën gojore dhe me shkrim, prandaj zhvillohet dhe pasurohet vazhdimisht. Pasurimi i saj bëhet në mënyra të ndryshme, në mesin e të cilave edhe me huazimin⁴² e fjalëve të (gjuhëve të) huaja për të cilat, në një fazë të caktuar të zhvillimeve të caktuara, ndien nevojë t'i ketë në përdorim. Natyrisht, huazimi i fjalëve të huaja nga një gjuhë e caktuar ose në përgjithësi, në praktikë, duhet të mbështetet në nevojat reale leksikore të saj. Kjo, në praktikën e huazimeve, nuk ngjet gjithënjë, prandaj huazimet nuk dalin gjithënjë dhe tërësisht të nevojshme, prandaj edhe të arsyeshme. Kështu mendojmë edhe për huazimet e shqipes në fushë të arsimit të viteve dymijë të cilat janë objekt i shqyrtimit në këtë artikull. Sipas vlerësimeve tona, në kohën e pasluftës dhe në rrethanat e krijuara prej saj, duke u nisur nga nevojat reale për reformimin e tërë sistemit arsimor dhe të përmbajtjeve të tij, del nevoja për huazimin dhe futjen në përdorim (zyrtar) të një fjalori shtesë për të plotësuar këto nevoja leksikore të gjuhës shqipe të dhjetëvjetëshit të parë të këtij shekulli. Natyrisht, si rrjedhojë e kushteve dhe rrethanave të përgjithshme dhe të veçanta, një pjesë e rëndësishme e këtyre huazimeve na duket e arsyeshme, pasi fjalori i shqipes, semantikisht i barasvlershëm me këto huazime, nuk ishte në përdorim ose mungonte fare. Por, kështu nuk mund të thuhet për të gjitha huazimet e shqipes të kësaj periudhe kohore.

Përfundim

Sikur edhe në rastet e gjuhëve të tjera, huazimet e fjalëve të huaja nga gjuha shqipe, në kushtet dhe rrethanat e përgjithshme, gjatë viteve dymijë, mund të konsiderohen përgjithësisht të nevojshme, prandaj edhe të arsyeshme. Mirëpo, ky përfundim mund të jetë vetëm i pjesërishtëm pasi një pjesë e konsiderueshme e këtyre huazimeve, të fushës së arsimit, gjatë kësaj periudhe kohore, nuk mendojmë se ishin të nevojshme dhe, rrjedhimisht, edhe të arsyeshme. Një pjesë e këtyre të fundit janë futur në përdorim pa asnjë nevojë as arsye pasi kanë zëvendësuar fjalët përkatëse të shqipes (burimore ose të prejardhura) që deri atëherë ishin në përdorim në gjuhën shqipe në këtë fushë, në komunikimin e përditshëm gojor ose me shkrim, individual ose institucional. Pjesa tjetër e tyre, edhe pse për kohën kur janë huazuar mund të kenë qenë huazime të nevojshme, mendojmë që, si të tilla, nuk do të

(por të detyrueshme pasi të jenë zgjedhur nga nxënësit), nga klasa e gjashtë (shkolla e mesme e ulët).

⁴² Përveç përmes huazimeve fjalëve nga gjuhë të huaja, gjuha shqipe, edhe në këtë rast, mund të pasurojë leksikon

e vet edhe përmes neologjizmave ose përmes futjes në përdorim të fjalëve që i takojnë fondit të përgjithshëm të

leksikut të gjuhës shqipe

KUMTESA

qëndrojnë gjatë në përdorim, pasi edhe për to, të paktën për një pjesë të tyre, mund të gjenden fjalë të leksikut të shqipes, semantikisht të barasvlershme me to, edhe pse të papërdorura deri tani në jetën e përditshme dhe në kuptimet e fjalëve të huazuara, kurse të tjerat mund të bëhen pjesë e leksikut të gjuhës shqipe.

Recenzentë: Dr.Mehdi Halimi
Dr.Avdi Visoka

Dr. Shpresa HOXHA: PËRKTHIMI I PERFEKTIT TË TASHËM TË ANGLISHTES NË SHQIPEN

Përkthimi është i rëndësishëm jo vetëm në gjuhësi por edhe në të gjitha sferat tjera shoqërore. Ka shumë shkrime që kanë të bëjnë me përkthimin dhe kontrastivitetin si degë më e re gjuhësore, të shkruara nga autorë të ndryshëm në tërë botën, të cilët përkthimin e marrin si art letrar.

Sipas veprës së J.C. Catford “ A Linguistic Theory of Translation” (Teoria gjuhësore e përkthimit) , del se përkthimi është një veprim që ka karakter gjuhësor; proces i zëvendësimit të tekstit në një gjuhë të caktuar me tekstin tjetër. Përkitazi me këtë secila teori e përkthimit duhet të nxirret nga teoria gjuhësore – teoria e përgjithshme e përkthimit.⁴³

Etimologjia e fjalës përkthim rrjedh prej fjalës latine *translatio* (e cila vetë vjen nga fjalët *trans* dhe *fero*⁴⁴ që dmth. *trans* = tej, përtej, andej, matanë dhe *fero* = mbart një barrë.⁴⁵

Përkthimi gramatikor është ngushtë i lidhur me përkthimin leksikor, që është përkthim i përkufizuar leksikor, në të cilin fjalët e gjuhës burimore të një teksti zëvendësohen me ekuivalentin e fjalëve të gjuhës së shenjave, por pa zëvendësim gramatikor.

Andaj, analiza kontrastive është e vlershme për vijimin e mësimin të gjuhëve të huaja në përgjithësi dhe jo vetëm të atyre që janë të njohura në botë, por pa përjashtim. Njëkohësisht, është ndihmë pedagogjike për arsimtarin e gjuhës së huaj të bëjë dallimin në mes të ndryshimeve dhe ngjashmërive të dy gjuhëve të cilat ngandonjëherë çojnë edhe kah gabimet eventuale, sidomos kur një strukturë e njohur e gjuhës amtare paraqitet me disa struktura në gjuhën e huaj. Kështu përfundimet e analizës kontrasteve vërtetohen me analizën e gabimeve.⁴⁶

Lidhur me gjerësinë gjuhësore të analizës kontrasteve temat mund të jenë të ndryshme. Në të vërtetë mund të kufizohemi në një fushë të veçantë gramatikore dhe të bëjmë analizën konkrete kontrasteve midis dy gjuhëve: gjuhës A dhe gjuhës B. Në këtë punim jam kufizuar në analizën komparative të perfektit të tashëm të gjuhës angleze (Present Perfect Tense) në tekstin origjinal / romani “Oliver Twist” të Charles Dickens- it⁴⁷ dhe

⁴³ G. N. Leech, Meaning and the English Verb, 1980, 30.

⁴⁴ <http://en.wikipedia.org/wiki/Translation>

⁴⁵ Fjalor latinisht – shqip, Rilindja, Prishtinë 1980, 529, 180.

⁴⁶ Isa Zymeri, Kategoritë gramatikore të emrit në gjuhë shqipe dhe angleze, punim i magjistraturës, Prishtinë 1979, XIII.

⁴⁷ Charles Dickens, Oliver Twist, London 1966.

përkthimit të tij në gjuhën shqipe sipas tekstit të përkthyer nga S. Luarasi / romani “Oliver Tuisti”⁴⁸.

Qëllimi kryesor në punën e kësaj analize është shpjegimi kontrastiv i funksioneve të perfektit të tashëm të mënyrës dëftore, duke i krahasuar ato në të dy gjuhët: në anglishte dhe në shqipe në bazë të materialit të përbashkët konkret.

Perfekt i tashëm i gjuhës angleze Present Perfect Tense) Funksionet

Perfekt i tashëm i gjuhës angleze është një trajtë e veçantë e kohës së shkuar, e cila shpreh një veprim ose gjendje të një kohe të kaluar, mirëpo veprimi i shprehur përmban lidhje edhe me kohën e tashme, me fjalë të tjera pasojat vazhdojnë të jenë të pranishme edhe në momentin e ligjërit. Për këtë arsye kësaj kohe të shkuar i shtohet atributi i tashëm.

G.N. Leech thekson se gjuha angleze ka dy mënyra me anë të së cilave ndodhitë e shkuara mund të lidhen me prezentin me kuptim të perfektit: a) mund të përfshihet periudha kohore që ka filluar në të kaluarën por zgjat edhe në të tashmen; b) mund të përfshihet vetëm periudha kohore e shkuar pa arritur në të tashmen, mirëpo pasojat kanë mbetur edhe në të tashmen.

Ky autor vëren katër funksione kryesore të perfektit të tashëm të gjuhës angleze. Njëri përdoret me folje “të gjendjes” dhe tre të tjerët me “folje të ndodhive (të veprimeve)”.

We ve lived in London since last September.

Ne jetojmë në Londër që nga shtatori i vitit të kaluar.

Përkthimi fjalë për fjalë do të ishte kështu: Ne kemi jetuar në Londër që nga shtatori i kaluar. (që do të thotë se Londra është vendi ku jetojmë tani.)

Fjalja e sipërshënuar vijon nga e shkuara deri në momentin e tashëm, me mundësi që të kalojë edhe në kohën e ardhme.

Një funksion të tillë zakonisht e kryejnë foljet që tregojnë zgjaturi të kohës së gjendjes. Ja edhe një shembull:

We ve lived here all our lives, and mean to live here for many years to come.

Jetojmë këtu gjatë tërë jetës dhe mendojmë të jetojmë këtu edhe gjatë shumë viteve të ardhshme.

Përdorimi i perfektit të tashëm rregullisht mund të shoqërohet me një ndajfolje ose me një togfjalësh që tregojnë zgjaturi kohe si: this week, always, ever, recently, lately, yet, etj.

Have you ever been to America?

A keni qenë ndonjëherë në Amerikë?

Has the dustman called yet?

A ka thirrur pastruesi ende?

Perfekt i tashëm përdoret edhe si e shkuar e pacaktuar (Indefinite Past), zakonisht me disa folje që tregojnë gjendje të pacaktuara nga pikëpamja kohore:

He's a man who has experienced suffering.

⁴⁸ Çarlsls Dickens, Oliver Tuisti, (përkthyes: Skender Luarasi) Prishtinë 1961.

Ai është njeri që ka pësuar vuajtje.

Kur perfektit i tashëm nuk përfshin momentin e tashëm, atëherë anon kah e kryera e thjeshtë dhe ka mundësi zëvendësimi me të.

Në gjuhën angleze perfektit i tashëm ndonjëse ka funksione të veçanta të veta, prapëseprapë shpeshherë është i afërt me kohën e kryer të thjeshtë. Dallimi qëndron në atë se perfektit i tashëm tregon veprime të zgjatura, të përsëritura ose të pacaktuara në pikëpamje kohore të cilat në thelb kanë aspektin imperativ (të vijimësisë) ndërsa e kryera e thjeshtë e anglishtes tregon veprime që kanë përfunduar në të kaluarën dhe nuk kanë lidhje me të tashmen.

Funksionet e perfektit të gjuhës shqipe

Funksioni kryesor i perfektit të shqipes, dmth. i kohës së kryer, është që të shënojë një veprim ose gjendje që ka ndodhur në një kohë të shkuar, respektivisht para momentit të ligjëritimit ose të shkrimit:

Petriti ka mbaruar Fakultetin e mjekësisë në Tiranë.

Veprimi që shprehet me foljen ka mbaruar nuk është i lidhur me një kohë të caktuar, porse tregohet vetëm fakti se veprimi ka marrë fund në një kohë, në çfarëdo kohe para momentit të ligjëritimit.

Një funksion tjetër shumë karakteristik i perfektit të gjuhës shqipe është që të tregojë një veprim a gjendje të një kohe të shkuar, por që pasojat e atij veprimi vazhdojnë dhe janë të pranishme edhe në kohën e tashme, në momentin e të folurit.

Pushkët i kemi mbushur dhe jemi bërë gati për gjueti.

Veprimet që tregojnë dy foljet në perfekt janë kryer para momentit të ligjëritimit, dmth. në kohë të shkuar, mirëpo gjendja që ka pasuar në të kaluarën pas këtyre veprimeve vijon edhe në të tashmen dhe ka mundësi të vazhdojë edhe në të ardhmen; në rastin konkret kjo do të thotë se pushkët janë ende të mbushura, pra fishekët janë ende në pushkë. Folja e dytë tregon se gjuetarët janë bërë gati në të kaluarën, njëherazi kuptojmë se ata edhe tani – në të tashmen, janë të gatshëm për gjueti, gjendje kjo ende e pa përkufizuar.

Foljet e formës së kryer të mënyrës dëftore nganjëherë përdoren edhe me kuptimin e së ardhmes, kur folësi e paraqet veprimin si një të dhënë të kryer, veprim i cili ende nuk ka filluar:

Po e gjete librin që më ka humbur, ta kam falur (do ta fal).⁴⁹

Funksionet e perfektit të shqipes janë edhe disa syresh por këtu u paraqitën vetëm disa sosh.

Analiza e shembujve të perfektit të tashëm

Analizën kontrasteve të shembujve të perfektit të tashëm të gjuhës angleze e kam mbështetur në veprën origjinale të Charles Dickens – it “Oliver Twist”⁵⁰ dhe të gjuhës shqipe në tekstin e përkthyer nga S. Luarasi “Oliver Tuisti”.⁵¹

⁴⁹ Grup autorësh, Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, Tiranë, 1976, 269.

⁵⁰ Charles Dickens, Oliver Twist, London 1966.

KUMTESA

Përkthimi i romanit në fjalë nga gjuha angleze në gjuhën shqipe i është përshtatur natyrës së gjuhës shqipe. Ndonëse në shumicën e shembujve të marrë, të kohës së kryer të mënyrës dëftore (Indicative Mood), kohët përkojnë, hasim edhe në mospajtime të kohës, mënyrës, të aspektit, të diatezave etj.

Nga vjelja dhe analiza e shembujve vërehet se perfekti i tashëm i gjuhës angleze është përkthyer në të shumtën e rasteve me perfektin e shqipes, që dmth. se kjo kohë foljore në përgjithësi përkon në këto dy gjuhë, mirëpo në një numër të caktuar rastesh perfekti i anglishtes përkthehet përgjithësisht me kohë të tjera të shkuara të afërta të gjuhës shqipe: si me të kryerën e thjeshtë, me më se të kryerën, me të pakryerën, me të tashmen, me të ardhmen etj.

Gjatë analizës së shembujve të përkthyer të perfektit të tashëm të anglishtes në gjuhën shqipe është bërë ndarja në lloje. Së pari vijnë shembujt që përkojnë plotësisht, pastaj pasojnë shembujt që nuk përkojnë nga pikëpamja kohore e më në fund shembujt që nuk përkojnë nga pikëpamja e kategorive të tjera gramatikore, siç është diateza, mënyra etj.

Në mbështetje të analizës së hollësishme të shembujve të vjelë nga vepra në fjalë del se perfekti i anglishtes në 120 fjalitë është përkthyer me perfektin e shqipes 77 herë, përkatësisht 64,2%.

Ja disa shembuj të këtillë:

Lord bless her dear heart, when she has lived as long as I have sir. (OT, 46)

Zoti e ruajtë, të rronjë sa kam rrojtur unë, zotëni. (OT, 17)

The people who have been better off, and have paid rates for many years, are the first to sink when they come into the house. (OT, 69)

Ata njerëz që kanë qënë në gjëndje më të mirë, dhe kanë paguar taksa për shumë vjet, rrëzohen të parët kur vijnë në shtëpinë e punës. (OT, 41)

That time has not arrived; (OT, 315)

Ajo kohë s'ka ardhur. (OT, 299)

Supper has been announced, and young Oliver, who is all alone in the next room, will have begun to think. (OT, 375)

Na kanë lajmëruar se darka është gati, dhe Oliveri i vogël që po rri vetëm në odën tjetër, do të ketë nisur të mendojë. (OT, 361)

Murder has been done. (OT, 440)

Është bërë një vrasje. (OT, 432)

Perfekti i tashëm është përkthyer me një numër relativisht të madh shembujsh me aoristin e gjuhës shqipe. Kjo ndodh për arsye se funksionet e perfektit dhe të aoristit të shqipes janë të afërta dhe shpeshherë të këmbyeshme. Nga analiza e shembujve të nxjerrë nga vepra në fjalë më rezulton se nga 120 fjali me perfekt të anglishtes janë përkthyer 27 shembuj me aoristin e gjuhës shqipe, përkatësisht 22,5 %.

Shembuj:

“I have taken the measure of the to women that died last night, Mr. Bumble”. (OT, 69)

“Morra masën e dy gravet që vdiqën mbrendë, Mister Bumbël” (OT, 40)

“Here! I ve brought the boy.” (OT, 73)

“Ja! Ta solla djalin.” (OT, 45)

⁵¹ Ç. Dikens, Oliver Tuisti, (përkthyes: Skender Luarasi) Prishtinë 1961.

“He has brought me to this lonely place to murder me!” (OT, 207)

“Më solli te ky vend i shkretë që të më vrasë.” (OT, 184)

Perfekti prezent i anglishtes në romanin në fjalë është përkthyer me prezentin e shqipes më rrallë se me dy kohët e shënuara më lart. Më saktësisht kjo kohë e anglishtes nga 120 shembujt e vjelë, është përkthyer me kohën e tashme të shqipes 9 herë, respektivisht 7, 5 %.

Shembuj:

“You’ve known her long enough to trust her.” (OT, 191)

“E njihni prej mjaft kohësh, e mund t’i zini besë.” (OT, 166)

Tommy Chitling hasn’t won a point; (OT, 230)

Tomi Çitlingu nuk fiton as një pikë. (OT, 207)

Kjo kohë foljore e anglishtes është përkthyer me të tashmen e shqipes përgjithësisht atëherë, kur perfekti i anglishtes tregon një veprim që ka ndodhur në një kohë të shkuar, por që pasojat e tij vazhdojnë edhe në kohën e tashme, dmth. në momentin e ligjëritit.

Sipas dendurisë vjen në radhë përkthimi i perfektit të tashëm të anglishtes me pluskuamperfektin e shqipes. Nga numri i lartpërmendur perfekti i anglishtes është përkthyer 5 herë me më se të kryerën e shqipes, ose 4, 2%.

Shembuj:

He remembered to have seen the waggon, as they went out, toiling up the hill. (OT, 95)

I kujtohej se kish parë karrot tek dilnin jashtë qytetit, dhe ngjiteshin kodrës përpjetë. (OT, 69)

He asked as he resumed his seat: in the tone of a keeper who has tamed some wild animal. (OT, 348)

Pyeti, kur u kthye në vënd, me tonin e një roje që kishte zbutur ndonjë kafshë t’egër. (OT, 369)

Gjatë leximit me kujdes të “Oliver Twist” – it jam ndeshur me disa raste shumë të rralla të përkthimit të perfektit të anglishtes me kohë të tjera, në të vërtetë një shembull me imperfektin e shqipes dhe një tjetër me të ardhmen e përparme të gjuhës shqipe:

A polite and delicate evasion of the request, which shows the young lady to have been possessed of that natyral good breeding... (OT, 138)

Kjo shmangie e sjellëshme e delikate tregonte se vajza dallohej me edukatë të mirë natyrale... (OT, 128)

Which way have they taken? (OT, 441)

Ç’udhë do të kenë shkuar vallë? (OT, 434)

Sa u përket diatezave të perfektit të tashëm të anglishtes, vërehet se në shumicën e shembujve diatezat përkojnë, qoftë në raste kur koha ndryshon, qoftë në raste kur koha nuk ndryshon. Kjo do të thotë se diateza veprorë (Active Voice) në gjuhën angleze është përkthyer me diatezën veprorë të gjuhës shqipe, si dhe diateza pësore e anglishtes (Passive Voice) me diatezat pësore dhe vetvetore të shqipes. Nga gjithë shembujt e vjelë, nga kjo pikëpamje del se përkojnë më shumë se gjysma e rasteve.

Ja shembuj:

I have walked a long way. (OT, 100)

Kam bërë udhë të gjatë. (OT, 74)

I have not slept under a roof since I left the country. (OT, 189)

S'kam fjetur nënë strehë që kur ika nga vëndi im. (OT, 175)

Ndonëse në raste të rralla ndeshen edhe mospërputhshmëri të diatezave të njëjës gjuhë me tjetrën. Rastet më të shpeshta të tilla janë ato, në të cilat diateza pësore e anglishtes është përkthyer me diatezën veprorë të shqipes:

He has been hurt already, ... (OT, 122)

Edhe me kaqë ka pësuar mjaft, ... (OT, 94)

You've been brought up bad. (OT, 183)

Të kanë edukuar keq. (OT, 158)

Rastet e kundërta, kur diateza veprorë e anglishtes është përkthyer me diatezën pësore të shqipes, më së miri ilustrohen me shembujt që vijojnë:

I have tried hard for you, but all to no purpose. (OT, 198)

Jam përpjekur shumë, shumë për ty, por s'ja kam dalë mb'anë. (OT, 174)

As we have met today, we meet no more; (OT, 316)

Ashtu si jemi hasur sot nuk do të hasemi kurrë më; (OT, 301)

Shënim:

Ka raste të rralla kur perfektin i mënyrës dëftore të gjuhës angleze është përkthyer me perfektin e mënyrës habitore të gjuhës shqipe. Kjo ndodh zakonisht në periudha të zhdrejta, respektivisht në fjalë të pohuara nga të tjerët e të përsëritura nga folësi. P.sh.:

... and he has been a thorough paced little villain, all his life. (OT, 176)

... dhe paska qenë tërë jetën djalë dinak, i poshtër. (OT, 151)

Gjatë analizës së mëtejme, kam vërejtur edhe një rast të përkthimit të perfektit të mënyrës dëftore të anglishtes me pluskuamperfektin e mënyrës lidhore të shqipes. P.sh.

Which, never failing to revert to his kind friends, and the opinion they must long ago have formed of him, were sad indeed. (OT, 178)

Dhe këta mendime, që kurrë s'mungonin të ktheheshin te mqt' e tij të dashur dhe tek opinionin që duhej të kishin formuar për të, me të vërtetë qenë trishtuar. (OT, 154)

Përfundim

Në këtë punim janë shpjeguar ndaras funksionet e perfektit të tashëm të gjuhës angleze dhe perfektit të gjuhës shqipe. Gjatë vrojtimit të kësaj kohe vërehet se shumica e funksioneve të kësaj kohe, të këtyre dy gjuhëve puqen, por ka raste të mospajtimeve të tyre. Është bërë edhe analiza e hollësishme kontrasteve e shembujve të vjelë nga romani të perfektit të tashëm të anglishtes dhe të perfektit të shqipes. Edhe nga shembujt e analizuar mund të konstatohet se këto dy kohë në të shumtën e rasteve përkojnë në mes tyre, andaj një numër i vogël i shembujve është përkthyer me kohë të tjera të shkuara, si me të kryerën e thjeshtë, me më se të kryerën, me të pakryerën dhe me tashmen në raste të rralla.

Për të gjithë shembujt janë dhënë përqindjet e veçanta të sakta dhe numrat e faqeve të shembujve të veprës origjinale dhe të asaj të përkthyer.

P Ë R M B L E D H J E

Në këtë punim është paraqitur analiza kontrastive e perfektit të tashëm të gjuhës angleze në diatezën veprorë dhe përkthimi i tij në gjuhën shqipe, në bazë të shembujve të përkthyer të romanit "Oliver Twist" të Ç. Dikensit.

Në mënyrë të ndarë janë shpjeguar funksionet e perfektit të tashëm të gjuhës angleze dhe perfektit të gjuhës shqipe. Gjatë analizimit të kësaj kohe vërehet se shumica e funksioneve të kësaj kohe, të këtyre dy gjuhëve puqen, por ka edhe raste të mospajtimeve të tyre në përkthim dhe diateza gjithashtu. Disa shembuj janë përkthyer në shqipet me kohë të tjera të shkuara, si me të kryerën e thjeshtë, me më se të kryerën, me të pakryerën dhe me të tashmen në raste të rralla.

Për të gjitha rastet janë dhënë përqindjet e veçanta të sakta.

S U M M A R Y

In this paper is presented the contrastive analysis of Present Perfect Tense of English in Indicative Mood and its translation into Albanian, based on Charles Dickens's novel "Oliver Twist".

There are explained separately the functions of the Present Perfect Tense of English and the Perfect Tense of Albanian. During analyses of this tense it is noticed that most of the functions in both languages are close to each other, but there are also some disagreements in translation of these tenses and their voices too. Some examples are translated into Albanian with some other tenses of the Past Time, as with the Simple Past, Past Perfect, Imperfect and very rarely with Present Simple.

For all translated examples are given specific exact percentages.

Recenzentë:
Prof.dr. Vesel Nuhiu
Prof.dr. Latif Mulaku

KUMTESA

Alma KUÇAJ: E FOLMJA E QYTETIT TË KAVAJËS, HETIME RRETH NDRYSHORËVE SOCIOLOGUISTIKË TË GJINISË, MOSHËS E BESIMIT

Në vitet e fundit në gjuhësinë shqiptare janë shtuar studimet në rrafshin sociolinguistik, duke hulumtuar sjelljen e shtresave të ndryshme shoqërore ndaj gjuhës dhe veçori të ligjërimit të tyre.

Studimet e mëparshme dialektologjike, sigurisht, do të shërbejnë si bazë krahasimi me gjendjen e sotme të gjuhës, që do të jetë edhe pika e rëndësës në punimin tonë. Lidhur me të folmen e qytetit të Kavajës⁵² kemi vënë re dhe ndryshime midis folësve dhe “lëkundje” brenda të njëjtit subjekt e këto, në varësi të disa ndryshorëve sociolinguistikë siç janë ata të moshës, gjinisë dhe besimit. Pikërisht këta faktorë na orientuan në një studim të kahut sociolinguistik të së folmes.

Mosha është vështruar si një nga faktorët natyrorë të diferencimit dhe të diversitetit të sjelljes gjuhësore të individëve. Brenda një bashkësie shoqërore ekzistojnë dhe dallime midis brezave. Me këtë faktor të rëndësishëm sociolinguistik janë marrë studiues të huaj si Reichstein e Labov, si dhe studiues shqiptarë që kanë botuar një numër studimesh për dallimet midis brezave të folësve duke filluar nga disa trajtime të përgjithshme të marrëdhënieve dialekt - gjuhë letrare të bëra nga J. Gjinari e deri në disa hetime dhe rezultate më të qarta për këtë çështje në studimet për të folmet e Lezhës nga Gj. Shkurtaj dhe të qytetit të Elbasanit nga Xh. Gosturani. Nga studimet është vënë re se *“ligjërimi i bashkësive shoqërore etnikisht homogjene, paraqet variacione sipas brezave. Zakonisht të rinjtë flasin në mënyrë të tillë që dallohen nga të moshuarit, ndonjëherë edhe duke përdorur kode apo nënkode të tyre, të huaj për brezin më të moshuar...”*⁵³.

Këtë faktor e kemi parë gjithashtu të shtrirë dhe veprues në gjuhën e folësve të qytetit të Kavajës. Duke vijuar dhe duke u mbështetur edhe në studimin e bërë nga Mehmet Çeliku⁵⁴ dhe duke e ballafaquar atë me të folmen e sotme të qytetit të Kavajës, në një vështrim të përgjithshëm mund të themi se nuk kanë ndodhur shumë ndryshime këto dhjetëvjetëshat e fundit. Megjithatë, duke marrë parasysh karakterin gjithnjë inovues të gjuhës, si dhe një sërë faktorësh të tjerë që kanë ndikuar në gjuhë, jemi përpjekur të parashtrijmë më poshtë disa nga ndryshimet më kryesore në të folmen e Kavajës në aspektin fonetik, morfologjik, sintaksor dhe leksikor ndërmjet brezash të moshave të ndryshme. Duhet të theksojmë se,

⁵² Anketimet dhe intervistat janë realizuar në një periudhë 2-vjeçare për qytetarë kavajas të moshave 16-70 vjeç (fëmra dhe meshkuj) të besimeve të ndryshme.

⁵³ Shih: Gj. Shkurtaj, Sociolinguistika, Tiranë, 2003, f. 154.

⁵⁴ Shih: M. Çeliku, Të folmet e Kavajës, në “Dialektologjia shqiptare”, II, 1974, f. 133.

ndryshimet më të mëdha midis brezave i vëmë re më shumë në leksik, fonetikë, morfologji dhe më pak në sintaksë.

Shqyrtime rreth fonetikës

Ndërkohë që më parë⁵⁵ dëgjohej hundore zanorja /a/ kur labializohej, sot, kjo zanore e labializuar e ka zbehur hundorësinë e saj duke bërë që /ô/-ja të kalojë në një /o/ të pastër (jo të hundorëzuar). P.sh.: *shullâ*^o > *shullo*: ; e *ã*^o*ma* > e *o:ma apo, kôma* > *koma*; *ka thãn* > *ka tho:n* etj. Për këtë dukuri fonetike na shërbejnë si dëshmi edhe disa fjalë të urta të qytetit të Kavajës të paraqitura nga disa mbledhës të folklorit⁵⁶:

P.sh.: Ha hudhra *bāj* gajret/*Ha pras t'vij shnet*. (*bāj*>*boj*)

Ku kullote *mrãm*/Me një deg *thãn*. (*mrãm*>*mrom*; *thãn*>*thon*)

Nyja e dimnit, kãnga e verës. (*kãnga*>*konga*) etj.

Në këtë rast, mund të themi se ka një kalim progresiv të /â/-së në /o/ çka dëshmon qartë për një prirje drejt humbjes së hundorësisë së disa zanoreve në brezin e ri të folësve. Nisur nga kjo dukuri, marrim shkas të sjellim këtu një hipotezë se mbase me kalimin e viteve kjo /â/ e labializuar në /o/ mund të errësohet në /ë/, duke qenë se këtu ndikon shumë edhe gjuha e sotme standarde. Lidhur me këtë dukuri, edhe studiuesi Jorgji Gjinarri në një studim mbi historinë e dialekteve shprehet pikërisht kështu: “Reduktimi nga â në ë duhet të ketë kaluar nëpër disa faza, ka nisur me labializimin e â-së dhe pastaj, duke u theksuar gjithmonë e më shumë karakteri labial i saj, â-ja ka kaluar nëpër një o (një variant të o-së) dhe prej këtij në zanoren e reduktuar ë. Ka shumë të ngjarë që denazalizimi i â-së të jetë kryer në fazën o dhe pikërisht për shkak të ndërrimit të saj në o, sepse, për shkaqe të panjohura mirë, ndoshta sepse kur u formuan zanoret hundore nuk qëlloi o-ja në një pozitë të atillë që të shndërrohej në ô, shqipja në përgjithësi nuk ka zanore ô primare, të mirëfilltë...”⁵⁷. Duke marrë parasysh edhe këtë citim mund të mendojmë se me kalimin e kohës kjo /o/ e sotme mund të errësohet në /ë/.

Në brezin e mesëm dhe në atë të vjetër vëmë re se zanorja *ë* e patheksuar, para bashkëtingëllores *-ll*, në disa fjalë të caktuara shfaqet si *u*: *pullo:m, pullum* etj. në vend të *pëllëmbë, pëllumb* etj. Ndërkaq, në brezin e ri nuk vihet re kjo dukuri për fjalët e mësipërme, pasi ato realizohen në: *pëlllo:m; pëlllum* etj.

Ndërkohë, zanorja e patheksuar /u/ përpara bashkëtingëllores *-ll*, *-r* dëgjohej si /ë/: *kumëll, sqetëll, shpatëll, çakëll, petëll, ufëll, lepër, hekër* etj. Por, te brezi i ri i folësve ndeshen dhe raste të përdorimit të rregullt të kësaj zanoreje.

Grupi /vo/, që në Kavajë dëgjohej rregullisht, në ditët e sotme, në subjekte të ndryshme (sidomos nga brezi i ri) dëgjohej shpesh /va/. P.sh.: *vatër, i varfër, varreza* ndeshen shpesh, por përdoren ende edhe *voj, vorr* etj.

/o/-ja e patheksuar në rrokje nistore ruhet në të folmen e të rinjve (ndryshe nga brezi më i vjetër që bën kalimin /o/>/a/): *damote*>*domote*; *gamor*>*gomor*; *flarij*>*florij*; *aborr*>*oborr* etj. Kjo dukuri nuk është shmangur krejtësisht, pasi *patere, dallap* etj. përdoren sërish.

⁵⁵ Në monografinë e tij, M. Çeliku ka gjurmuar të folmen e Kavajës kryesisht në brezin e vjetër duke lënë mënjandë të folmen e brezit të ri dhe ndikimet e gjuhës letrare në breza të ndryshëm.

⁵⁶ Fjalë të urta dhe shprehje kavajase, dorëshkrim, mbledhur nga N. Rroli.

⁵⁷ Shih: J. Gjinarri, Për historinë e dialekteve në gjuhën shqipe, në “St. fil.”, 4, 1968.

Bashkëtingëllorja /h/ ruhet mirë në fillim të fjalës, si dhe në trup të saj. Këtu bëjnë përjashtim disa grupe të caktuara folësish, kryesisht të brezit të ri, të cilët kanë vështirësi të nyjëtojnë këtë tingull në pozicion nistor. P.sh. *do iki te alla*, në vend të *halla* etj. Në fund të fjalës, bashkëtingëllorja /h/ del /f/ në fjalë të tilla si: *shoh, njoh, gjynah* etj., përk. *shof, njof, gjynof* etj. Madje, në disa subjekte të veçanta, sidomos te më të moshuarit, vihet re edhe shtimi i saj në fillim të disa fjalëve që nisin me zanore: *haborr, havlli, hik*, etj. Ky shtim i kësaj bashkëtingëllorjeje ndeshet edhe në brezin e ri, kryesisht tek ata që janë rritur pranë gjyshërve të tyre dhe përpiqen t'i imitojnë ata.

Bashkëtingëllorja /k/ në subjekte të veçanta, kryesisht në brezin e vjetër, shfaqet dhe në variantin fonetik /q/: *maqi:n* (makinë), *qi:sh* (kishë) etj.

Bashkëtingëllorja /t/ kur ndiqet nga një sonante /l/ në disa fjalë të caktuara dëgjohet edhe si /k/. P.sh.: *atlete-aklete; tlyn-klyn* (për gjalpë). Ky variant fonetik ndeshet kryesisht në brezin e ri, sidomos te fëmijët, të cilët për lehtësi shqiptimi dhe për t'i thënë fjalët ashtu shkujdesur, vetëm duke ruajtur një strukturë të afërt të fjalëve që dëgjojnë, ngatërrojnë *t* me *k*.

Bashkëtingëllorja /dh/ në pozicione të ndryshme që zë në fjalë, ndeshet edhe si /ll/. P.sh.: *e bardhë- e ba:ll; dhëndri-llondri; shtatëdhjetë e tre -shtalltetre; e madhe-e molle; e verdhë-e ve:ll, dhomë-llo:m, dhëmbët-llo:mët, dhe-lle, dhallë-lla:ll; dhé-llé* etj. Kjo dukuri nuk përfshin të gjithë subjektet folës, pasi te të rinjtë kjo dukuri ndeshet rrallë. Në pozicion nistor, e kushtëzuar nga një rrethim i caktuar, bashkëtingëllorja /dh/ zëvendësohet nga buzore-dhëmborja /v/. P.sh.: fjala dhjamë ndeshet edhe *dhjo:m*, po edhe *vjo:m*.

Bashkëtingëllorja /sh/ përgjithësisht ruhet mirë. Ndërrimi i fonemave /sh/>/ç/, që më parë ka qenë më i dukshëm, sot nuk bëhet aq i plotë (në kuptimin që e ndeshim në trajtën /^tç/). P.sh.: formën foljore: *po e vriçin* (po e vritshin) sot e ndeshim në një trajtë të tillë të të folurit: *po e vriçin*, apo në pjesë të tjera të ligjëratës si, (pesmllit) *diç>di'ç*. Rastet e ndërrimit /sh/>/ç/ dallohen kryesisht në moshat mbi pesëdhjetë vjeç. P.sh.: *u çfaq; e lçonte* etj.

Grupet e bashkëtingëlloreve /mb/ dhe /nd/ në të tre brezat e folësve të Kavajës asimilohen në bashkëtingëlloret hundore përk. në *m* dhe *n*: *ma:j, mret, huna, mrapa, maroj, naloj, kanil* etj. në vend të: *mbaj, mbret, hunda, mbrapa, mbaroj, ndaloj, kandil* etj. Në disa fjalë të caktuara, si p.sh.: *Shkëmbi i Kavajës, komb, dallëndyshe* etj. ruhen këto grupe bashkëtingëlloresh nga brezi i ri.

Grupi /ng/ shqiptohet i rregullt nga moshat e reja dhe më pak në ato të rritura, pasi te këto të fundit ky grup asimilohet shpesh në një tingull okluziv hundor grykor η si te *ηec, ηul* etj. Te të rinjtë ndeshen shpesh fjalë të tilla me formë fonetike të rregullt: *ngas* (te brezi më i madh ηas), *ngadalë* (ηada:l:kada:l), *ngatërroj* (ηatroj), *ngushtoj* (ηushtoj), *ngrej* (ηe:j), *ngarkoj* (ηarkoj) etj.

Në qytet, grupi bashkëtingëllor /ngj/ në të shumtën e rasteve është asimiluar në /nj/ dhe nuk vihen re raste të asimilimit të tij në qiellzoren /j/. Megjithatë, në brezin e ri ndeshemi dhe me shqiptimin siç duhet të këtij grupi bashkëtingëllor: *ngjarje, kangjella, ngjyrë, ngjirem* etj., por *njesh, nja:l, o nja:ll* (është ngjallur), *njis shkallët, nju:j* etj. përdoren sërish.

Grupi /kj/ ndodh të zëvendësohet nga qiellzorja /q/ dhe anasjelltas. Këto ngatërrohen në subjekte të ndryshëm dhe konstatohet një farë lëkundjeje edhe brenda të njëjtit individ folës, më tepër i brezit të vjetër. P.sh.: për *kjo* përdorin *qo*, por për *ky* nuk e ndeshim variantin *qy*.

Morfologji

Po duke iu përmbajtur ndryshorit sociolinguistik të moshës, nga pikëpamja morfologjike, veçojmë gjininë e emrave, që i është afruar standardit (*shnetja* > *shneti*; *pylla* > *pylli*; *turpja* > *turpi* etj.) bashkë me formimin e shumësit. Për këtë të fundit, përveç rasteve të përdorimit të rregullt të tij, mund të themi se pas rënies së *ë-së* fundore, që po duket dhe në kohën e sotme, *a-ja* del si më konkrete për formimin e shumësit (*msusa*, *nxënsa*, *shofer* etj.).

Lidhur me formën rasore të vendores, në pozicione të caktuara sintaksore ajo gjen ende përdorim në qytetin e Kavajës. P.sh.: *i mbiu n'de:rt*, *m'ra barkut buka*, *i ra tavolinës n'çekiçt* etj. Megjithatë, në të folmen e brezit të ri zor se ndeshet *kjo* formë rasore e vendores.

Te folësit e brezit të vjetër ndeshen raste të përdorimit të formave *kena* dhe *jena* në vend të *kemi* e *jemi* :

P.sh.: *Kena babën qefeli*

kan njizet e nji pulluma

kunojn, s'pushojn

*mi deg qershi, lum si ti kumri*⁵⁸.

Por, sot ndeshemi dhe me formën e duhur të tyre (njëlloj si norma e njësuar). Përdoren rregullisht foljet *kemi* e *jemi* në brezin e ri dhe shumë më pak në atë të mesëm. Ndonjëherë ka dhe ngatërrim të vetës së parë shumë të këtyre foljeve me vetën e parë njëjës nga folës të brezit të mesëm dhe më tepër atij të vjetër: *Nigjo si t'themi un*.

Dallime më të shumta në gjuhë midis brezave ndeshim pikërisht në aspektin leksikor. Brezi i mesëm dhe i vjetër, në krahasim me brezin e ri, karakterizohen nga një mori fjalësh dhe shprehjesh, ndër të cilat një pjesë të madhe e zënë turqizmat, si dhe shprehje të tjera, që në brezin e ri ndeshen shumë rrallë e disa herë aspak. Kështu, brezi i vjetër i është kthyer terminologjisë fetare në shprehje të tilla të ngurtësuara, si *syfyr*, *akshom*, *iftar*, *selo:m*, *xhevap* etj. Por, edhe të rinjtë, nga ana e tyre, përdorin fjalë dhe shprehje të veçanta që i kemi ndeshur kryesisht në zhargonin e tyre nëpërmjet intervistave dhe anketimeve tona në qytetin e Kavajës. Ndër të tjera, vëmë re se në “fjalorin” e këtyre të rinjve kanë hyrë edhe shumë fjalë të huaja si: *ok*, *bye*, *sorry*, *thanks* etj.

Gjithashtu, fjalë të urta si: *de:r e zanot*, *shpi e nosihat*; *iqin hile*, *nji trimni*; *ku t'shko:j lata*, *t'shko:j sopata*; *di dhia*, *ç'ësh tagjia* etj. ndeshen shpesh në gojën e të mëdhenjve dhe shumë rrallë në brezin e ri, kryesisht tek ata të rinj, të cilët janë rritur pranë gjyshërve të tyre. Por, jo vetëm brezi i vjetër karakterizohet nga një lloj “bollëku” në fjalë apo shprehje të veçanta a specifike që zor se përdoren nga brezi më i ri. “*Me zhvillimin dhe përparimin e shoqërisë, të ekonomisë, të kulturës etj. është zhvilluar edhe leksiku, shumë fjalë janë vjetëruar e kanë*

⁵⁸ Marrë nga materiale të grumbulluara folklorike, A. Tafa.

dalë nga përdorimi, fjalë të reja kanë lindur e kanë hyrë në përdorim, kurse shumë fjalë kanë ndryshuar formën ose kuptimin"⁵⁹. Në këtë mënyrë, edhe të rinjtë kanë "fjalorin" e tyre, që hera-herës bëhet i pakuptueshëm për brezat më të rritur. P.sh. ka shprehje të tipit: *më është mbushur plot hard disku* (në kuptimin kam nxënë shumë), *flet si procesor i prishëm* (flet keq) etj., të cilat nuk kuptohen mirë nga brezi i vjetër për shkak të përdorimit të fjalëve nga fjalori i shkencës së informatikës që nuk ka qenë e njohur më parë për ta.

Të folmen e Kavajës e kemi hetuar edhe lidhur me ndryshorin sociolinguistik të gjinisë. Vëmë re se ka dallime midis femrave dhe meshkujve. Femrat e brezit të mesëm, në dallim nga meshkujt e po këtij brezi, janë shfaqur si më konservative në gjuhë⁶⁰.

Tipike për gjuhën e grave janë dhe frazeologjizmat mallkime që ato përdorin. Me denduri të madhe janë mallkimet të tipit: *T'ça:ft ujku zorrët! T'shtifsha n'dhe:!, T'plaçin sytë e ballit!, T'dalçin sytë kallup!, T'dalçin tomthat venit!, Lonç kokrrën e nomit!, T'kno:ft hoxha n'rronxet t'veshit!, Mos u bofsh!, T'u thafshin durët gjer n'rronxët!, U thafsh e u ngrifsh!, T'mo:rt Zoti hakun!, T'lonça Zotin!, T'mo:rt rrylën!, T'pre:ft dumullaja jarebi!, T'shpla:ft panuklla!* etj. që të meshkujt nuk ndeshen aspak.

Por, nuk mund të lemë pa përmendur dhe eufemizmat e tabutë që shoqërojnë besëtytnitë e ndryshme ku drejtohen gratë. Në të tilla raste ato përdorin fjalë të ndryshme si: "*syu bardh, syu zi, plaçin sy:t e kqi:*"; "*i pla:st syu keq, i pla:st syu ba:rdh*" për një fëmijë që mendohet se mund ta kenë marrë mësysh të tjerët. Për emërtimin *djall* përdoren eufemizmat: *ai që iu tra:sht hallka e zinxhirit apo tobja*. Përgjithësisht, femrat myslimane, kryesisht ato të moshës mbi dyzet vjeçe, kur dëgjojnë për një sëmundje si sëmundja e tokës, kancer, tumor, apo për djallin etj. ato thonë *tobestfkururulla*, emërtim ky që nga femrat ortodokse zëvendësohet me *larg o Zot*.

Lidhur me ndryshorin sociolinguistik të besimit, mund të shprehemi se pjesa më e madhe e popullsisë së qytetit të Kavajës përbëhet kryesisht nga banorë të besimit mysliman e më pak të atij ortodoks. Dallimet më kryesore midis tyre vërehen në aspektin leksikor, ku në veçanti spikatin shumë turqizma të myslimanët në krahasim me të krishterët (p.sh. shumë myslimanë përdorin fjalë të tilla si *melek* (në vend të *engjëll*), *selam* (në vend të *të fala*) etj. Shfaqin interes fjalët dhe shprehjet frazeologjike të folësit të besimit mysliman, që janë me bazë të huazimit turk (*u bo sebeb, s'e ve n'hesap* etj.), si dhe emërtimet disi të veçanta të emrave të farefisnisë (p.sh.: *ije* që përdoret nga myslimanët në vend të motrës së madhe ose për nënën apo gjyshen; *la:l* në vend të vëllait të madh etj.). Theksojmë se më shumë dallime në këtë aspekt shfaqen në brezin e vjetër dhe atë të mesëm e shumë më pak në atë të ri.

⁵⁹ Shih: J. Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2002, f. 22.

⁶⁰ Ndryshe paraqitet ky raport tek femrat dhe meshkujt e brezit të ri, ku femrat shfaqen më inovuese në gjuhë dhe shumë më pranë standardit sesa meshkujt.

KUMTESA

Zenun Rexhepi: SHKRIMI I LASHTË I ZATRIQIT NË KOSOVË DHE KULTURA DANUBIANE E PERIUdhËS NEOLITIKE

Përmbledhje (abstrakt)

Qenien njeri, si pasardhës i *homo sapiensit*, midis tjerash, e karakterizojnë: të menduarit, të folurit dhe shkrimi, përmes të cilit ruhen të arriturat e civilizimeve njerëzore deri në ditët tona.

Shkrimi është mënyrë e paraqitjes grafike, apo e regjistrimit të gjuhës.⁶¹ Shkenca e cila merret me studimin e lindjes së shkrimit, llojet, zhvillimin dhe emërtimet e tij, quhet gramatologji.

Shkrimi petrografik i Zatriqit, vendbanim i Komunës së Rahovecit, dhe *ai i Aqarevës*, i Komunës së Skenderajt, janë zbuluar para disa vjetësh. Informatat e para për zbulimin dhe karakteristikat e tyre i kanë në mediat kosovare i kanë publikuar: *Ilaz Thaqi* dhe *Berat Miftari*. Ata, në revistën e ilustruar mujore “*Albanica-Exklussive*”, nr. 63/2006 e cila botohet në Prishtinë, kanë publikuar artikullin me titull “*Shkrimi 5000 vjet i vjetër*”. Para se të botohej ai shkrim, *prof. dr. Emanuel Anati*, arkeolog nga Italia, me rastin e qëndrimit në Zatriq, në korrik 2006, kishte konfirmuar se *Shkrimi i Zatriqit* është i ngjashëm me shkrimin e zbuluar në Vinçë afër Beogradit dhe se i takon të ashtuquajturës *Kulturë danubiane*.

Në këtë kumtesë trajtohen ngjashmëritë dhe dallimet midis *Shkrimit të Zatriqit* dhe *Shkrimit të Vinçës*, disa shkrimeve të tjera petrografike në Evropë dhe Azi, si edhe vlera e tyre historike e kulturore.

Fjalët kyç: *Shkrimi i Zatriqit, Kosova, Shkrimi i Vinçës, Kultura danubiane, vizatimet e shpellave, petrograf-i, piktogramet, logogramet, ideogramet, figurat gjeometrike, shenjat.*

⁶¹ Dragan Barac - *Historia e përgjithshme e shkrimit, (Opšta istorija pisma)*, 2004, Beograd. Me sa di, ekziston vetëm libri i autorit - akad. Aleksandër Stipčević “*Historia e librit*”, “*Rilindja*” 1988, në të cilën janë dhënë pak informata përkitazi me historinë e shkrimeve; Artikulli “*Shkrimi 5000 vjet i vjetër*”, *Albanica - Exklussive*, nr. 63 / 2006, fq. 67-70; Në ditoren “*Ekspres*”, Prishtinë, dt. 17. 11. 2006, fq. 10.

HYRJE

Zatriqi është vendbanim i Komunës së Rahovecit (Dukagjin, Kosovë). Aty janë zbuluar *petrograme* që janë temë e kësaj kumtese. Ato, me gjasë, janë vërejtur edhe më herët, por në mungesë njohurish, nuk janë konsideruar si diçka me vlerë. Popullata vendësi po i quante “*Sharenica*”⁶² Kur dikush që i ka pa, do të ketë shfaqur mendimin se mund të jenë gjetje arkeologjike me vlerë, madje ndoshta me vlerë të madhe kulturore dhe historike, ishte kërkuar ndihma e profesor *Emanuel Amatit*, nga Italia.

Prof. dr. Emanuel Amati, është *arkeolog* italian, *petrograf*, specialist për shkrimet e lashta. Ai, pasi kishte vizituar vendin ku gjendeshin gjurmë të shkrimit në *Zatriq* e *Aqarevë*, kishte shfaqur mendimin se ishte fjala për *petrograme*, që janë të ngjashme me ato të zbuluara në *Vinçë*, në bregun e Danubit, afër Beogradit në fillim të shek. XX dhe se i takojnë të ashtuquajturës *Kulturë danubiane*, e cila është e lashtë *midis 5000-8000 vjet para erës së re*. Sipas njohurive shkencore të shek. XX, ajo është më e lashtë se *kultura egjiptiane*⁶³ dhe *ajo sumeriane*⁶⁴ e *Mesopotamisë*, që deri në fund të shek. XIX, konsideroheshin si kulturat e njohura më të lashta.

Profesori italian *Amati*, kishte shfaqur bindjen e thellë, se ishte fjala për zbulimin arkeologjike me të rëndësishëm në Kosovë dhe më gjerë, e cila ka vlera që maten me ato të zbulimeve të ngjashme në Evropë dhe Azi, prandaj ai ka një vend të rëndësishëm edhe në suaza të trashëgimisë kulturore evropiane e botërore.

I. SHFAQJA DHE ZHVILLIMI I VIZATIMEVE NË SHPELLA DHE I SHKRIMEVE TË PARA TË LASHTA

1. Vizatimet e kafshëve në shpellat e Evropës

Dihet se prej periudhës së akullnajave qeniet *humanoide* jetonin në shpella, të cilat u ofronin strehim e mbrojtje nga kafshët e egra dhe të ftohtit. Me kohë, në ato shpella ata vizatuan figura të thjeshta, e më vonë edhe mjaft pasqyruese dhe me ngjyra, sa mund të konsiderohen veprat e para të artit të njeriut në lashtësi. Për ato vizatime për nevoja praktike, ose edhe religjioze, janë shfaqur mendime të ndryshme të ekspertëve.

⁶² “*Sharenica*” (sllav. - *larëza, vizatime*). Në realitet fjala është për shkëmbin në faqen e sipërme të të cilit gjenden vizatime enigmatike, *petroglife*, siç quhen në *fushën e historisë së shkrimeve të lashta*.

⁶³ *Kultura egjiptiane* - e lashtë më se 3200 vjet p. e. së re (sipas M. E. “*Prosvete*”, Bgd., I, 1986, fq. 720).

⁶⁴ Po aty, vëll. III - *Sumerët*, njëri prej popujve më të lashtë, prejardhja e të cilit nuk dihet. Rreth 5000 vjet para erës së re është vendosur në jug të Mesopotamisë. Në mijëvjeçarët IV dhe III, zhvilloi një kulturë të lartë; Akad. Radivoje Pešić, *Vinçansko nismo*, Beograd, 1985.



Vizatime nga shpella Lascaux, Francë të lashta rreth 15.000 vjet.

Vizatime të tilla janë zbuluar në Francë, në Spanjë, etj. Para ca kohe, për një të tillë në rrethinë e Prizrenit, kanë njoftuar edhe mediat kasovare. Por, se a ka bërë kush hulumtime më të gjëra më vonë, nuk kam informacion.

2. Origjina e shkrimeve dhe logogrameve

Siç mund të konstatohet edhe në bazë të një pllake guri me shenja që shkojnë midis figurave, simboleve dhe një lloji të shkrimeve të para, shfaqjes së formave të para të shkrimit iu paraprijnë ato në formë figurash të shpezëve dhe të gjallesave⁶⁵ të tjera. Piktogramet dhe *petroglifet*, herë-herë janë quajtur edhe logograme⁶⁶, sepse ishin simbole me domethënie të një fjale, apo emri.


3. Format e para të shkrimeve

Shkrimet *kunjore* (kuneiforme), konsideroheshin si më të lashtat. Janë zbuluar në Lindje të afërt dhe të Mesme të Azisë (në Mesopotami e Iran, etj.). Vlerësohej se janë të lashtë 2500 - 3500 vjet para erës së re.

Derisa *hieroglifet* egjiptiane janë kombinim i *figurinave* dhe i një lloji shkronjash, format që mund të konsiderohen një lloj shkrimesh të realizuara nga shenja që mund të konsiderohen edhe shkronja, janë *Shkrimi Linaer A e B*, te regjionit të Mesdheut, ai *fenik* (Phoenicia), prej të cilave më vonë dalin shkrimet e ndryshme: ai etrusk, grek, latin, glagolica sllave etj.

⁶⁵ Shkrimi Luvitian, por edhe në hieroglifet egjiptase.

⁶⁶ Logogram (greq. *logos* - fjalë + *grafia*, ose *gram* - shkrim), pra të shkruarit e fjalëve me shenja (Mikel Ndreca, Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja, "Rilindja", Prishtinë, 1980).



Pos figurave të kafshëve, në Lascaux Cave, shpellë në Francë janë zbuluar edhe shenjat e mësipërme, çfarë hasen edhe në shkrimet e tjera të kulturës Danubiane.

II. SHKRIMI I ZATRIQIT, I AQAREVËS DHE AI I VINÇËS


Figurat dhe simbolet e zbuluara në Vinçë dhe në Zatriq, janë quajtur shkrimi i Vinçës dhe Shkrimi i Zatriqit. Sado që për shenjat e zbuluara në Vinçë, që konsiderohen shkronja dhe për to janë dhënë mendime se cila shenjë paraqet shkronjën përkatëse, ndoshta më e drejtë do të ishte që quheshin *simbole dhe shenja* të Vinçës dhe të Zatriqit, sepse ato janë më shumë figura dhe simbole se sa shkronja, siç janë shenjat e shkrimit *kuneiform* (kunjor), të *hieroglifëve* egjiptiane apo të *alfabetit Fenikas*, si më karakteristikët, edhe pse jo të vetmit.

1. Rëndësia e shkrimeve të Zatriqit e Aqarevës dhe të Vinçës

Prof dr. *Emanuel Amati*, arkeolog italian, thotë se “Njerëzit në kohë të lashta janë frymëzuar nga natyra dhe në këtë mënyrë e kanë mësuar njëri-tjetrin. Ata mësimet dhe njohuritë e tyre i kanë shënuar në gurë dhe kështu janë ruajtur deri në ditët tona. Shenjat duket se përmes atyre shenjave njerëzit pasqyronin principet e ekzistencës ose jetës, ekzistencën e shpirtit (perëndisë - fuqisë së shenjtë), që është aktive në proceset elementarë të natyrës, ... por organizimin social e religjioz të asaj shoqërie.”⁶⁷ “Dy janë ritualet, përshkrimet dhe nderimet që iu bëhen të vdekurve: Ritualit me nderime me gurë të mëdhenj pa shkrime dhe ritualet me përshkrime. Është shumë i rëndësishëm përshkrimi që haset në dy ekzemplarët e gurëve: yjet, bërthama, shenja të origjinës, lindja, pastrimi, brezi dhe kthimi në tokë, në bërthamën prej nga edhe kemi dalë... Në dy gurët qendrorë në Varrezat e fshatit *Aqarevë* të Komunës së Skënderajt, shenjat dhe simbolet iu referohen lutjeve.”⁶⁸

⁶⁷ *Albanica Exklussive*, nr. 63/2006, faq. 67.

⁶⁸ *Albanica - Exklussive*, po aty, fq. 68.



ideogram, simboli femrës, mashkullit dhe territorit, Zatriq

Ideogrami, simbol i femrës, i mashkullit dhe i territorit, Zatriq, 2006

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| A | | | | ⊥ | ⊂ |
| B | ⊠ | ⊠ | ≡ | ⊠ | |
| C | ✳ | ☀ | | | |
| D | + | × | ≠ | | |
| E | ⊥ | ≡ | ⊥ | | |
| F | ∨ | ∨ | ⊥ | | |
| G | Y | Y | ⊥ | | |
| H | ⊥ | | | | |

Tabela; Llojet grafemave,
Zatriq 2006

Aqarevë: Pikat që simbolizojnë energjinë në ceremoni e lutje

Tabela: Llojet e grafemave në shkrimin e Zatriq, 2006

*Shkrimi i Zariqit dhe i Aqarevës - Kosovë -
"Albanica - Exsklussive", Prishtinë, nr. 63/2006, fq. 68-70.*

Pllakat tartariane, tri sosh, janë zbuluar në qytetin Tartara në Rumani. Në to gjenden simbole që kanë shkaktuar kontraverza të mëdhe midis arkeologëve, sepse disa prej tyre konsiderojnë se simbolet në to paraqesin formën më të lashtë të shkrimit në botë.

Ato të Vinçës, pra edhe të Zatriqit, me gjasë janë më të afërta me ato që janë quajtur *Shkrimi Linar A* dhe *Linear B* të Kretës. Sipas rezultateve të studimeve njëzetvjeçare të akad.

KUMTESA

Radioje Peshiqit⁶⁹, të gjitha janë me origjinë pellazgjike të dy kulturave - të kulturës danubiane dhe të asaj mesdhetare. Tabela e Dispilios, është një *tabelë prej druri që përmbanë shenja të gdhendura (charagmata)*, e zbuluar gjatë gërmimeve që i bëri George Hourmouziadis në Dispilio të Greqisë dhe sipas karbonit-14 - daton rreth vitit 7300 p.e.r. (5260 BC). Ajo u zbulua në vitin 1993 në bregun e liqenit në një ishull artificial pranë fshatit modern të Dispilio, në liqenin e Kastorias në Prefekturën e Kosturit në Greqi.



*Simbole nga periudha e lashtë e Kulturës së Vinçës
(nga mileniumi i pestë para erës së re)*

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| a | b | c | d | e | f | g | h | i | j | k | l | m |
| | | | | | | | | | | | | |
| n | o | p | q | r | s | t | u | v | w | x | y | z |
| | | | | | | | | | | | | |
| A | B | C | D | E | F | G | H | I | J | K | L | M |
| | | | | | | | | | | | | |
| N | O | P | Q | R | S | T | U | V | W | X | Y | Z |
| | | | | | | | | | | | | |
| À | Ó | Û | ß | à | ó | û | . | . | : | < | > | |
| | | | | | | | | | | | | |

Pasqyrë e deshifrit (dekodimit) të shenjave të shkrimit të Vinçës

⁶⁹ Po aty, R. Peshiq, është thellë i bindur, se *shkrimi i Vinçës*, i *Lepenski Vir-it*, pranë Danubit, i *etruskëve* dhe ai *fenik*, (i cili me gjasë është më i ri se ata të Kulturës danubiane), nuk ka pothuaj kurrfarë dallimesh.

2. Ngjashmëritë dhe dallimet midis shkrimeve të lashta danubiane

Kur analizohen *grafemat - simbole ose shkronja*, nga tabelat e përpiluara me të tilla, të hasura në blloqe gurësh në vendbanimet *Zatriq* dhe *Aqarevë* të Kosovës, në *Tabletat Tartariane* (në Rumuni), në pasqyrat e shenjave të zbuluara në *Vinçë* (Serbi), shkronjat në *Sorin Paliga*, e gjetiu, hasim në disa sosh plotësisht të njëjta, apo të afërta.

1. *Shkrimi i Vinçës dhe ai i Zatriqit, apo i Aqarevës, kanë të njëjta*: shenjat në formë të numrit romak "III"; të shkronjës "V" "X" dhe "Y": nga një në formë trekëndëshi "Δ"; të shkronjës "V" me shtojca të ngjash-me me formën e çekanit në simbolin "X" të minatorëve; shenjën që paraqet rrezet e diellit, me një dallim se njëra e ka në mes një rreth të vogël, e tjetra më të madh; një në formë të rrotës së qerres; e kanë përbashkët edhe një grafemë në forme degëze me tre rrema etj.

2. Tabela me shenjat ose simbolet (*petroglifet*) nga *Zatriqi*, përmban gjithsej lloje 11 shenjash të përafërta: 3 shenja me nga dy variante, 3 raste nga tri variante, dhe tri raste me nga dy variante (gjithsej 33 shenja ose grafema);

3. Shkrimi i *Vinçës* ka në tabelën e parë 28 shenja, kurse në të dytën 39 grafema.

4. Piktura nga shpella *Lasskaus* në Francë ka 42 shenja;


5. Tableta e *Dispilios* ka gjithsej 48 grafema të padëshiruara.

6. Shkrimi i lashtë Iberian ka gjithsej 22 shenja, por në 7 raste për një shkronjë të dekoduar janë përdorur nga dy grafema njëra pranë tjetrës.

7. Alfabeti i lashtë Turk i periudhës klasike, me origjinë nga lokaliteti Turke nga Azia Qendrore ka 27 grafema që paraqesin tinguj ose rrokje të caktuara.

8. Tabela e grafemave të *abc-s* nga *Gimbutas* dhe *Sorin Palinga* kanë nga 26 shenja të veçanta për shkronjat prej *a - z* (të vogla të shkrimit); 27 për shkronjat *A - Z* (të mëdha të shtypit), si edhe për gjashtë zanoret (*A, O, U*), me pika të mbivendosura dhe 19 shenja (grafema), që mund të paraqesin numra, ose kanë domethënie tjetër.

Ndërkaq tabela me shenja e simbole, të cilën e ka përpiluar *Sorin Palinga* ka rreth 150 shenja dhe është më e pasura ndër shenjat dhe simbolet që i përkasin të ashtuquajturës *Kulturë Danubiane*.



*Hartë e thjeshtë e kulturave kryesore të mijëvjeçarit të 4 p. e. së re
“Kulturat e vjetra Evropiane”.*

III. P Ë R F U N D I M

Nga sa u tha më sipër, mund të konstatohet sa vijon:

1. Gjurmët e shkruara në formë vizatimesh, figurash dhe simbolesh, të zbuluara në Zatriq dhe Aqarevë - vendbanime të Kosovës, janë pa dyshim pjesë të pandashme të asaj që quhet Kulturë Danubiane. Kjo dëshmohet përmes ngjashmërisë së plotë disa formave të *ideogrameve* dhe *simboleve*, por edhe me afërsinë gjeografike.

2. *Kultura Danubiane*, sado që janë shfaqur dilema dhe dallime, ka gjasa të jetë kulturë më e lashtë se ajo e Egjiptit dhe shkrimi hieroglifëve, prandaj vlera e tyre i takon trashëgimisë së kulturës botërore.

3. Nuk është me vend, që vlerat e tyre, pra edhe për shkrimet e *Zatriqit* e të *Aqarevës*, të *Vinçës* dhe të shkrimeve të tjera në Evropë e Azi, të përvetësohen si kultura të kësaj apo të asaj popullate, sepse njohuritë e pakta për ato periudha nuk e bëjnë të mundshme të flitet për atë se cilat ishin grupet dhe popullatat të cilave iu përkisnin. Prandaj, duhet të flitet për vlera kulturore e historike të civilizimeve të njerëzimit, pa marrë parasysh se ku janë zbuluar.

Prishtinë, maj 2012.

Mr. Muhamet PEÇI¹: ARTI LETRAR DHE LEXUESI SI KATEGORI ESTETIKE

**¹Universiteti i Prishtinës
Fakulteti i Edukimit**

Bashkë me letërsinë ka lindur edhe nevoja për interpretimin e saj. Gjatë shekujve janë zhvilluar edhe metoda të ndryshme studimi, të cilat në qendër të tyre kanë pasur zhvillimin e një qasjeje të caktuar sa i përket interpretimit apo analizës së veprës letrare. Por nga ana tjetër nuk duhet harruar se, pavarësisht të gjithave, vepra letrare është një sistem kodesh gjuhësore, mesazhe këto që i dedikohen receptuesit, pra lexuesit. “Poetikat moderne të veprës së hapur mbështeten në parimin se ekziston një raport specifik midis veprës dhe lexuesit, të cilit, sipas këtij këndvështrimi, autori i ka dhënë të drejtën për ta interpretuar veprën në mënyrën e vet. Në një farë mënyre krijohen dy struktura artistike; njëra e lexuesit e tjetra, më e qëndrueshmja e autorit”.⁷⁰ Megjithatë e parë nga perspektiva e jashtme, vepra letrare ka vetëm një receptues, lexuesin, sepse në fund të fundit, autori në këtë rast mund të marrë pa frikë rolin e emituesit. Edhe nëse autori zgjedh të interpretojë veprën e tij, kjo nuk do të thotë që interpretimi i tij është i vetmi dhe më i sakti, këtë nuk e lejon vetë gjuha e veprës së tij, e cila pasuron dhe ndryshon pandërprerë kuptimin thjeshtë leksikologjik duke gjeneruar kuptime të reja nëpërmjet përplasjes dhe kondensimit të “shtresave” të saj. P.sh. gjatë analizës së njërës nga veprat e Gabriel Garsia Marquesit, “Gjeneralit nuk ka kush t’i shkruajë”, në shkollë, nxënësit gjelin luftarak të gjeneralit e interpretuan si simbol të popullit kolumbian. Ndërkohë që vetë nobelisti u shpreh mjaft i habitur nga ky fakt dhe përfundoi me fjalët “Të them të drejtën në disa raste gjatë shkrimit të kësaj vepre kam dashur t’ia heq kokën gjelit dhe ta fusja për t’u zier në tenxhere, por tani jam shumë i lumtur që nuk e paskam bërë.”

Duhet pasur parasysh se receptimi i veprës letrare varet nga shumë faktorë. Një ndër faktorët e parë është vetë receptuesi, pra lexuesi. “Sipas terminologjisë së teorisë së receptimit lexuesi ‘konkretizon’ veprën letrare, e cila nuk është më shumë se një seri pikash të zeza të radhitura në një faqe. Pa pjesëmarrjen e vazhdueshme dhe aktive nga ana e lexuesit vepra letrare nuk do të ekzistonte”.⁷¹

Mund të konsiderohet se ekzistojnë dy kategori receptuesish; e para është lexuesi i cili i qaset veprës letrare për përfitime estetike, pra kënaqësi shpirtërore, kjo kategori ka nënkategoritë e veta, por do të mjaftohemi me dy: lexuesi aktiv dhe ai pasiv dhe e dyta është lexuesi kritik, ky i fundit mund të quhet edhe profesional, sepse përgatitet profesionalisht për analizimin e veprave letrare.

⁷⁰ Floresha Dado, *Teoria e veprës letrare – Poetika*, SHBLU, Tiranë 2003, f. 49.

⁷¹ Terry Eagleton, *Hyrje në teorinë e letërsisë*, Camaj- Pipa, Shkodër 2005, f. 59.

Lexuesi aktiv, pavarësisht përgatitjes së tij teorike letrare, i qaset veprës më ndryshe se ai pasiv. Për shkak të traditës së tij të leximit, ky lexues receiptimin e veprës ka mundësi ta bëjë më të plotë. Kërkesat e tij ndaj veprës i kalojnë caqet e kënaqësisë estetike që të ofron ajo. Për të është më e thjeshtë të kalojë shtresimet kuptimore dhe të sprovohet në zërthimin e kodeve gjuhësore që ngërthehen në vepër. Ky lexues shkon përtej zhvillimit të ngjarjeve, përtej fateve të personazheve dhe mundohet të perceptojë atë çka e bën këtë vepër universale.

Lexuesi pasiv mjaftohet me kënaqësitë estetike që i përcjell vepra. Ajo çka i intereson këtij lexuesi është lidhja e bukur e fjalëve, rrjedha e ngjarjeve e fatet e personazheve. Kërkesat e tij ndaj veprës janë të thjeshta; ajo duhet të ngjallë tek ai një reaksion estetik dhe emocione, ky lexues kërkon për vete të kalojë një kohë të mirë leximi, të relaksohet gjatë leximit e me anë të këtij leximi të mos shkaktojë ndërlikime mendimesh e lodhje psikologjike.

Por kemi edhe një lexues i cili receiptimin e veprës, duke u nisur nga profesioni i tij, e bën në një mënyrë më të veçantë, kritikun e letërsisë. Duhet pasur parasysh se “Kritika letrare nuk është vetëm gjykim për vlerën e veprave të caktuara letrare dhe arsytimi i këtyre gjykimeve. Kritika letrare merret edhe me mënyrën e hyrjes në vlerat letrare dhe kështu luan rolin ndërmjetësues në mes veprës dhe lexuesit. Me analizën e veprave të caktuara, me gjykimet sintetike mbi autorë të caktuar, epoka e të tjera, që në kritikën letrare janë të pranishme shpesh, ajo takohet me historinë dhe teorinë e letërsisë”.⁷² Në një farë mënyre receiptimi i veprës nga lexuesi kritik është i një tjetër natyre, supozohet që ai duhet të jetë objektiv në atë që parashtron dhe të mbështetet në fakte shkencore. Megjithatë në letërsi qasja ndaj veprës shpeshherë mund të jetë sa objektive aq edhe subjektive. Këtë e tregojnë shembujt e shumtë të përplasjes së mendimeve midis shumë kritikëve sa i përket kritikave që mund të kenë bërë për një vepër të njëjtë. Madje ka mjaft raste kur edhe i njëjti kritik receiptimin e një vepre të njëjtë e ka bërë ndryshe kur e ka lexuar për herë të parë dhe ndryshe pasi e ka rilexuar atë.

Zhan – Pol Sartri perceptimin e veprës letrare e lidh me preferencat e lexuesit “meqenëse liritë e autorit dhe të lexuesit kërkojnë dhe emocionojnë nëpërmjet botës, ne mund të themi gjithashtu se është zgjedhja e autorit për një aspekt të caktuar të botës që vendos për lexuesin dhe reciprokisht duke zgjedhur lexuesin vendos për subjektin. Kështu të gjitha krijimet përmbajnë në vetvete fytyrën e lexuesit për të cilin janë destinuar”.⁷³ Sartri të jep të kuptosh se mënyra e receiptimit të veprës varet nga destinimi i saj për lexuesin, pra receiptimi i saj sa i përket kuptimit apo keqkuptimit të krijimit lidhet me rrethin e caktuar të lexuesve për të cilët ajo shkruhet dhe preferencat e këtij të fundit. Receiptimi i veprës letrare varet edhe nga mjaft faktorë të tjerë, intererferenca e të cilëve është e pashmangshme dhe me mjaft ndikim.

Vendi ku shkruhet një vepër letrare është njëri nga këta faktorë, i cili ndikon në receiptimin e asaj vepre. Vepra duke lindur brenda një grupi shoqëror të caktuar është mëse normale që së pari dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë t’i drejtohet grupit të organizuar shoqëror, prej të cilit ka dalë, ashtu siç është më se e natyrshme që ky i fundit receiptimin e kësaj vepre ta bëjë në mënyrë tjetër, qoftë kjo mënyrë e çuditshme, e veçantë apo e ndryshme nga receiptimi që mund t’i bëjë pjesa tjetër e lexuesve, për të cilët vepra në fjalë mund të

⁷² Milivoj Solar, *Hyrje në shkencën për letërsinë*, SHBLU, Tiranë 2001, f. 23.

⁷³ Zhan – Pol Sarti, *Ç’është letërsia*, Deas, Tiranë 1998, f. 54.

konsiderohej e huaj. “Të lexosh, të dëgjosh, të shikosh një vepër të huaj, kjo do të thotë të marrësh mbi vete rrezikun që të vihesh përballë me një ligjërim që nuk të drejtohet ty në radhë të parë; do të thotë të mbash parasysh mundësinë se do të të duhet t’u përgjigjesh pyetjeve që nuk të janë bërë deri atëherë dhe që, për më tepër, ndofta nuk kanë të bëjnë fare me ty... Prandaj tekstit të huaj shpesh i duhet afruar në një mënyrë të veçantë, e cila heraherës e përligj paraprakisht prejardhjen e largët dhe e përkufizon si të tillë”.⁷⁴ Shembuj të tillë kemi plot në letërsi. Vepra e një shpуре të tërë shkrimtarësh në Amerikën Latine u perceptuan nga lexuesit jashtë vendeve ku u shkruan këto vepra, në mënyrë krejt të kundërt nga perceptimi që iu bë këtyre krijimeve nga lexuesit brenda vendit apo rrethit shoqëror prej nga patën zanafillën këto vepra. Madje pikërisht në bazë të një reagimi të tillë receptiv kjo veprimtari veprash artistike mori edhe titullin paradoksal Realizëm magjik. Sepse ajo që një pjese të receptuesve i dukej mjaft reale, për pjesën tjetër kjo krijimtari nuk ishte gjë tjetër veçse ireale, imagjinative, magjike e mitologjike. Por jo vetëm autorët e Realizmit magjik, por edhe shumë të tjerë shkruan vepra të cilat u receptuan ndryshe brenda dhe ndryshe jashtë vendit të tyre nga lexuesit. Në Evropë një ndër rastet më të diskutuara është vepra “Procesi” e Franc Kafkës. Jo vetëm lexuesit e thjeshtë, por edhe kritikët kanë dhënë ide mjaft kontradiktore sa i përket interpretimit të saj. Milan Kundera me të drejtë shtron pyetjen; "si është e mundur që në Pragë romanet e Kafkës të ngatërrohen me jetën; dhe si është e mundur, prapë, që në Paris të njëjtat romane përcillen si shprehje hermetike e botës, ekskluzivisht subjektive të autorit?"⁷⁵

Faktor tjetër që ndikon në receptimin e veprës letrare është koha kur lexohet vepra. Përgjithësisht ka pasur studime dhe teori të shumta të cilat, përveç të tjerash, janë marrë edhe me ndikimin e kohës në leximin e veprës. A thua çdo moment leximi dhe interpretimi nënkupton një numër supozimesh për natyrën e kuptimit, të mirëkuptimit dhe komunikimit? Është e natyrshme që kuptimi të konceptohet si i tillë që del nga fjalët dhe shprehjet e tekstit që realizojnë *autonominë semantike*, por duke pasur parasysh natyrën e gjuhës sidomos asaj konotative, cila është garancia se domethënia që i ka dhënë autori veprës, të ketë të njëjtin kuptim gjatë leximit dhe të receptohet si e tillë? Vepra letrare pas daljes së saj nga pena e autorit bëhet aset publik dhe gjithashtu e ‘pavdekshme’, kjo i jep asaj mundësi të kalojë në duart e gjeneratave të tëra lexuesish. Sa mund të jenë mundësitë që receptimi i lexuesit të parë të veprës të jetë i pandryshueshëm nga receptimi që i bëjnë kësaj vepre lexuesit e mëpastajmë pas shumë e shumë vitesh apo shekujsh. Përgjithësisht shumica e teoricienëve këtë e shohin si të pamundur. Kjo lidhet jo vetëm me veprën në vetvete, por edhe me një sërë faktorësh të jashtëm siç janë: zhvillimet historike, shoqërore, politike, etj. Këta faktorë të jashtëm ndihmojnë të secili individ dhe në formimin e tij si karakter dhe si intelekt. Kur ky individ merr rolin e lexuesit, qoftë edhe në mënyrë të pandërgjegjshme ai i ndërlihd proceset e tij psikologjike, ndihmë në formimin e kësaj psikologjie kanë dhënë edhe faktorët e jashtëm, me veprën. “Interpretimi nuk është kurrë të kuptuarit e diçkaje që na paraqitet, pa pasur asnjë njohuri paraprake, ai bazohet në ato çka ne (gjithmonë) dimë - të parakuptuarit tonë, i cili nuk mund të ndahet nga qenia jonë. Nuk mund t’i shpëtohet rrethanës historike të të kuptuarit, sepse kjo është baza ontologjike e qenies tonë në botë”.⁷⁶

Duke pasur parasysh interpretimet e ndryshme që i janë bërë në kohë të ndryshme një vepre letrare, dilemat dhe pyetjet e pafundme sa i përket këtyre interpretimeve si;

⁷⁴ Yves Chevrel, *Letërsia e krahasuar*, Albin, Tiranë 2002, f. 16-17.

⁷⁵ Milan Kundera, *Arti i romanit*, Toena, Tiranë 2001, f. 118.

⁷⁶ Ann Jefferson & David Robey, *Teoria letrare moderne*, Albas, Tiranë 2004, f. 182.

autoritetin e kujt duam të pranojmë? Atë të lexuesve të parë, të lexuesve nëpër kohë, gjykimet e tashme teorike, etj, atëherë mund të vijmë në përfundimin se ndoshta vizioni i autorit për të ardhmen nuk është vërejtur nga lexuesit e kohës së tij, por pastaj a nuk mund të vijmë në të njëjtin përfundim edhe për lexuesit e tjerë?

Gadameri dilemave të tilla iu përgjigj me anë të argumenteve të tij, argumente këto, që në një mënyrë apo një tjetër u pranuan nga shumica e teoricienëve që u morën me teorinë e receptimit, natyrisht të shoqëruara me teoritë e tyre shitesë. Sipas tij “interpretimi i letërsisë së kaluar shtrihet në dialogun ndërmjet të kaluarës dhe të tashmes. Orvatja jonë për të kuptuar një vepër mund të varet nga pyetja, të cilën rrethimi ynë kulturor na lejon ta bëjmë. Në të njëjtën kohë ne përpiqemi të zbulojmë pyetjen që ngre vet vepra. Perspektiva jonë e tashme përfshin marrëdhëniet me të kaluarën, por në të njëjtën kohë e kaluara mund të rrokot vetëm përmes perspektivave të kufizuara të së tashmes”.⁷⁷

Perspektivat e receptimit të një teksti varen pashmangshmërisht dhe nga gjinia të cilës i përket ky tekst. Natyra e secilit tekst që përfaqësohet brenda një gjinie të caktuar, ka karakteristikat e veta dhe si e tillë secila nga këto gjini përmes tekstit që e përfaqëson jep mundësi të ndryshme për receptimin e këtij të fundit.

Le të marrim si shembull prozën, romanin. Duke pasur parasysh se struktura e romanit nisët nga rumbullakësimet e motiveve, nga lidhjet e këtyre motiveve për të formuar temën dhe duke mos harruar se në roman gjatë këtij procesi shpjegimet bëhen deri në detaje, mundësitë për të krijuar kuptime shumëfishe janë më të vogla se sa, bie fjala, p. sh. kur kemi të bëjmë me poezinë. Kjo nuk do të thotë se gjatë leximit të një romani nuk mund të kemi receptime të ndryshme, por për shkak të ndërtimit të romanit mundësitë janë më të vogla po të krahasohet me poezinë lirike. Por duke qenë se romani është vepër artistike dhe veçori e tij nuk është vetëm përdorimi i gjuhës, por përdorimi i gjuhës figurative, atëherë është e natyrshme që kjo gjuhë të vilet nga lexuesit në mënyra të ndryshme receptive. Kjo aftësi e bën këtë zhanër edhe më të çmuar. Pavarësisht ndërtimit të temave, zberthimit të motiveve, trajtimit të ideve, thurjes së intrigave, dhënies në tërësi deri në detajin më të vogël të çdo pjesë të tij përbërëse, ai ka përsëri aftësinë të na surprizojë në çdo receptim që i bëjmë gjatë leximeve, rileximeve, kohë pas kohe, vend pas vendi.

Veprat e shkruara në poezi lirike, janë të thurura në mënyrë të tillë që autori të identifikohet plotësisht me krijimin, pra autori e shkruan poezinë nga pozicioni i vetës së parë, *unë*, pozicion ky me të cilin jo vetëm artikullohet autori, por edhe me të cilin lexuesi identifikohet që në fillim të leximit. Receptimi i tekstit lirik, duke pasur parasysh se rrjedh nga një realitet shpirtëror, subjektiv dhe i drejtohet një bote subjektive siç është ajo e secilit lexues, bëhet gati i paparashikueshëm. Kjo ndodh sepse poezia lirike nuk realizohet mbi themelin e lidhjeve kuptimore të drejtpërdrejta, por duke përdorur kuptimet dhe sugjerimet që shtrihen me fuqinë e gjuhës. Dhe nëpërmjet lidhjeve asociative që krijojnë fjalët fitohen kuptime të cilat të lidhura me përvojat e lexuesit receptohen krejtësisht në mënyrë unike prej secilit receptues.

Nga ana tjetër drama pavarësisht se është vepër letrare nuk mund të shikohet në pozitë të njëjtë me poezinë dhe prozën. Megjithëse është letërsi, drama është e lidhur ngushtë me teatrin dhe shprehja e saj e plotë del vetëm kur ajo vendoset në skenë. Por edhe pse teksti i dramës shkruhet për t’iu kumtuar publikut, edhe pse ky tekst kërkon për interpretim

⁷⁷ Stefan Çapaliku, *Letërsia e interpretuar*, Arbri, Tiranë 1998, f. 81.

pjesëmarrjen e aktorëve dhe përgatitjen e skenës, kjo nuk do të thotë se teksti si i tillë nuk ka vlera.

Rol të veçantë në receptimin e veprave letrare në përgjithësi e të dramës në veçanti, ka parafytyrimi si aktivitet i brendshëm i lexuesit. Kur lexohet një dramë, ajo çka e bën atë më të realizueshme për t'u kuptuar është parafytyrimi. Parafytyrohet vendi ku zhvillohen ngjarjet, parafytyrohet mënyra se si duken personazhet, veprimet e tyre, mimika e tyre në çaste e situata të ndryshme etj., e në këtë mënyrë bashkë me thurjen e shthurjen e ngjarjeve arrihet receptimi i plotë i saj. Kur kjo vepër vihet në skenë, të gjitha këto parafytyrime humbin, sepse zëvendësohen më imazhe reale të interpretuara nga aktorët, por në të njëjtën kohë edhe receptimi ndaj veprës mund të ndryshojë. Por kjo nuk ndodh vetëm me dramën. Tashmë shumë nga veprat më të njohura botërore në prozë, por edhe epike, janë bërë filma, shumë prej tyre mjaft të suksesshëm, të tjerë dështime të plota. Natyrisht, receptimi ndaj veprës së shkruar dhe asaj të konvertuar në film nuk është i njëjtë. Këtë e bën të mundur vetë natyra e veprës së shkruar, përkundër natyrës së veprës filmike.

Nganjëherë është e pamundur të konkurrosh me fuqinë e pamatë e të mrekullueshme të shprehjes gjuhësore. Bie fjala, sa e sa herë është projektuar në film epi "Iliada", por pavarësisht teknologjisë dhe artit të aktorëve është e pamundur që filmi të përcjellë të njëjtat ndjesi estetike receptive që përcjell vetë epi i shkruar. Bukuria e Helenës është një nga themelet bazë të thurjes së ngjarjeve, por asnjë aktore sa do të papërsëritshme ta ketë bukurinë, asnjë bukuri nuk mund të krahasohet me bukurinë e dhënë përmes fjalëve të Homerit. Gjuha ka rrugët e saj për të ecur përpara. Teknika gjuhësore e Homerit e evoluar në stadet më të larta, ka gjetur një rrugë tërësisht origjinale dhe komplet të pamundur për t'u marrë nga kineastët e për t'u vendosur në film. Ai nuk zgjedh të përshkruajë bukurinë e Helenës, sepse kjo zgjedhje do ta banalizonte bukurinë e saj, ai zgjedh që me anë të gjuhës të përshkruajë reagimet e të tjerëve ndaj bukurisë së saj, madje edhe reagimet e vetë natyrës, kur Helena del mbi bedenat e Trojës, lufta në fushëbetejë ndalet, ushtarët ngelin të ngrirë nga bukuria rrëzëllitëse, zogjtë e pushojnë këngën e dielli ndalet për një çast që ta kundrojë. Prandaj sa i përket receptimit, mund të themi se filmi sjell vetëm një shkëndijë nga universi i veprës letrare dhe si i tillë emiton një pjesë shumë të vogël të saj.

Recensentë:

Prof.Dr. Liman Matoshi , profesor në Universitetin e Prishtinës – Fakulteti i Filologjisë.

Prof.asc.Dr. Qibrie Demiri-Frangu, profesoreshë në Universitetin e Prishtinës – Fakulteti i Filologjisë

KUMTESA

Rexhep OSMANI: *JUSTIN RROTA PËR DIALEKTET E SHQIPES*

1..Justin Rrota me mbrehtësi të një gjuhëtari të shquar kishte veneruar dallimet, që dilnin midis dialekteve të shqipes dhe varianteve letrare të saj. Studimin e tij për dallimet dialektore të gjuhës shqipe Rrota e botoi si shtesë në sintaksën e gjuhës shqipe më 1942. Kjo temë e shtruar, për dallimet dialektore të gjuhës shqipe, nuk ka lidhje me sintaksën, si nënsistem i gramatikës së shqipes, por ka të bëjë me dialektologjinë. Rrota në fillimi të këtij shqyrtimi theksonte, se shqipja ka dy dialekte: gegërishten dhe toskërishten dhe disa nëndialekte nga të cilat për gegërishten numëronte radhazi: nëndialektin e Kosovës, të Malësisë së Mbishkodrës, të Krajës, të qytetit të Shkodrës, të Mirditës, të Pukës, të Matit etj. Ndërsa në kuadër të dialektit të toskërishtes radhiste këto nëndialekte: çamërishten, labërishten, nëndialektet e shqiptarëve të Italisë dhe të Greqisë.

2. Ndryshimet dialektore në fushë të fonetikës

2.1. Ndryshimet dialektore, konstaton me të drejtë Rrota⁷⁸, janë më të theksuara në fonetikë, ndërsa në gramatikë dhe në leksik ato vijjnë e zvogëlohen dukshëm. Nga ndryshimet që dalin në fushë të fonetikës ai fillimisht përmend hundorësinë e zanoreve ku në gegërishte vëren zanoren a hundore, ndërsa në toskërishte kësaj i përgjigjet zanorja ë e theksuar, e cila natyrisht nuk është dhe nuk mund të jetë e hundorëzuar. Te zanoret e tjera hundorësia ekziston, por ajo është më pak e dallueshme. Të folmet e toskërishtes nuk kanë zanore hundore, por kanë vetëm zanore gojore.

2.2. Të folmet e gegërishtes, thotë Rrota⁷⁹, kanë edhe gjatësinë e zanoreve, d.m.th. kanë kundërvënie të theksuar mirë midis zanoreve të shkurtra dhe të zanoreve të gjata. Kjo në toskërishte nuk ndihet më. Kjo do të thotë se Rrota e dinte, që dikur edhe toskërishtja do t'i ketë pasur zanoret e gjata, por tani nuk i ka. Në eliminimin e kundërvënies midis zanoreve të shkurtra dhe të atyre të gjata, sikurse edhe në eliminimin e hundorësisë në të folmet e toskërishtes, një rol të rëndësishëm e ka luajtur greqishtja, e cila nuk i njeh këto fenomene gjuhësore.

⁷⁸ Justin Rrota, Sintaksi i shqipes, Shkodër, 2005, f.121

⁷⁹ Po ai, po aty, f. 122

2.3. Zanoren ë të patheksuar, e cila ndodhej para një bashkëtingëlloreje të zëshme të tipit n, nj, m, r, rr, l, ll toskët e shqiptojnë si ë, ndërkaq te gegët, thotë ky, del si zanore e, p.sh. *Nji shembell i shkelqyeshem*. Kjo është një karakteristikë ekskluzive e të folmes së Shkodrës me rrethinë, ku përfshihen edhe të folmet e tjera të gegërishtes veriperëndimore, por nuk del në të folmet e tjera të gjuhës shqipe. Prandaj si e këtu kjo dukuri gjuhësore nuk mund të konsiderohet si dallim konfrontues midis dy kryedialek-teve të shqipes, por është një fenomen i kufizuar dialektor, që del vetëm në të folmen e Shkodrës me rrethinë. Këtë asokohe Rota nuk e dinte, sepse nuk kishte të dhëna për to.

2.4. Një dallim tjetër ndërdialektor Rrota⁸⁰ e sheh edhe te grupet e tipit *va, vo* nga të cilët i pari ishte i toskërishtes dhe tjetri i gegërishtes, p.sh. *varri, vaji, vatra* të toskërishtes dhe *vorri, voji, votra* në të folmet e dialektit të gegërishtes. Këtë veçori dialektore do ta konstatojnë gjithnjë të gjithë historianët e shqipes dhe do ta paraqesin në veprat e tyre.

2.5. Zanoren y, thotë Rrota⁸¹, të folmet e toskërishtes e zbusin në i, siç bën edhe Mirdita. Kjo është pjesërisht e saktë, sepse kjo zanore alternohet (y>i) në toskërishten veriore, por jo edhe në labërishte e çamërishte. Madje në gegërishte ky ndryshim ndodh te të folmet e gegërishtes qendrore, që fillojnë me *Matin* e *Mirditën* e përfundojnë në rrethinën e *Shkupit*, duke përfshirë *Dibrën*, *Strugën*, *Gostivarin* dhe *Tetovën* me rrethina. Fenomeni është i përgjithshëm dhe ka përfshirë të gjitha fjalët që dikur dilnin me zanoren y.

2.6. Ndryshimi tjetër, që vërente pater Justini⁸², ka të bëjë me grupet e zanoreve të tipit *ue-ua*, të cilat janë të shpërndara në dialekte në mënyrë të saktë e precize. I pari del te të gjitha të folmet e dialektit të gegërishtes në sistemin emëror dhe në sistemin foljor, ndërsa i dyti në dialektin e toskërishtes. Rrota nuk e shënonte faktin, se diftongu i dikurshëm *ue*, që del në të folmet e gegërishtes dhe sot është si grup vokalik, nuk është ruajtur me konsekuencë në të folmet e dialektit të gegërishtes, por ka përfunduar në zanoren *u* (*këndue-këndu*:). Ndërkaq, grupin zanor *ie* të gegërishtes ai e gjente të jetë në toskërishte në diftong të mirëfilltë - *je*, p.sh. *diell-djell*. Në gropën e Shkodrës, thoshte Rrota, ky grup zanoresh është monoftonguar plotësisht.

2.7. Dialekti i gegërishtes, thotë Rrota⁸³, ka aftësi që të shqiptojë pa vëshirësi grupe të bashkëtingëlloreve edhe kur janë më tepër se dy sosh, ndërkaq toskërishtja në këto raste fut në funksion zanoren ë, si zanore mbështetëse, në shumicën e rasteve, kur dalin dy e më tepër bashkëtingëllore njera pas tjetrës, p.sh. *pleqësi, pleqëri, Shqipëri* etj. Madje dy fjalëzat: *qi* e *nji*, në toskërishte, thotë Rrota, dalin me ë (khs. *që* e *një*). Këto venerime të këtij gjuhëtari të shquar dalin plotësisht të mbështetura dhe të argumentuara bindshëm.

2.8. Një fenomen ekskluzivisht dialektor, që i takon vetëm të folmeve të dialektit të toskërishtes është rotacizmi* (shndërrimi i bashkëtingëllores *n* në bashkëtingëlloren *r* në

⁸⁰ Po ai, po aty

⁸¹ J. Rrota, *Sintaksi i shqipes*, Shkoder 2005, f. 122

⁸² Po ai, po aty

⁸³ Po ai, po aty, f. 123

* Ky fenomen e ka marrë emrin rotacizëm në bazë të emrit të shkronjës rrota, siç quhet shkronja r në alfabetin e greqishtes. Prej andej me këtë emër është përhapur në të gjitha gjuhët.

rastet, kur ka ndodhur midis dy zanoreve). Ky fenomen është shumë i vjetër dhe përfshin periudhën e hershme të zhvillimit të shqipes, madje edhe të mëmës së saj. Fenomen fonetik i rotacizmit ka përfunduar para ardhjes së sillavëve në Ballkan, pasi që në huazimet sillave të tipit *sanë* (khs. *seno*) nuk del fare, por ruhet e pandryshuar bashkëtingëllorja ndërzanore n. Disa prapashtesa, thotë Rrota⁸⁴, të foljeve në toskërishte dalin me rotacizëm, ndërsa në gegërishte përfundojnë me -m, p.sh. *shqyer-shqyem*, *sharë-shamë*, *lerë-lemë* etj. Në këto raste të folmet e gegërishtes në këto pozita do ta kenë pasur një bashkëtingëllore të tipit n, sepse vetëm ajo ka mundur të pësonte rotacizëm. Bashkëtingëllorja m kurrë nuk është rotacizuar.

2.9. Grupet e bashkëtingëlloreve *kl*, *gl*, konstatonte Rrota⁸⁵, kanë pasur reflektime të ndryshme në dialektet e gjuhës shqipe. Kështu edhe sot në të folmet e çamërishtes dhe në të folmet e arbëreshëve të Italisë mund të hetohet grupi i vjetër i bashkëtingëlloreve *kl*, *gl*, p.sh. *klumshtë*, *klaj*, *tue klenë*, *gluhë e glatë*, *i nglan s' ëmës* etj. Këto grupe bashkëtingëlloresh, vërente Rrota, në të folmet e toskërishtes janë zbutur në q, gj, p. sh. *qumshtë*, *qaj*, *tue qenë*, *gjuhë e gjatë*, *i ngjan së ëmës* etj. Të folmet e gegërishtes i kanë grupet k-j, g-j, p.sh. *kjaj*, *kjumshtë*, *tue kjenë*, *giuhë e giatë*, *i gian s' amës* etj. Duhet menjëherë të thuhet, se grupet *kj*, *gj* nuk janë karakteristike për të folmet e gegërishtes, por vetëm për grupin e kufizuar të të folmeve të gegërishtes veriperen-dimore, në të folmet e tjera të gegërishtes këto grupe kanë përfunduar në *k*, *g*, p.sh. *kushtë*, *kaj*, *tue kanë*, *guhë e gatë*, *i ngan së amës* etj.

2.10. Një ndryshim tjetër i radhës ka të bëjë me grupet e bashkëtingëlloreve *mb*, *nd*, *ng*, *ngj*, të cilat në të gjitha të folmet e toskërishtes ruhen shumë mirë, ndërsa në të folmet e gegërishtes ato janë asimiluar në bashkëtingëllore të thjeshta. Duhet të thuhet, megjithëkëtë, se në një numër të kufizuar të folmesh këto grupe ruhen të plota. Kemi pasur rast t'i ndëgjojmë në disa të folme të disa fshatrave në rrethinën e Mitrovicës, si bie fjala në Suhodoll. Nuk e dimë se a janë ruajtur këto grupe bashkëtingëlloresh në këtë të folme apo janë rikrijime të vonshme. Kjo mundësi e dytë na duket shumë më e mundshme. Kemi gjetur materiale dialektore që vërtetojnë, se edhe e folmja e Elbasanit, e cila në Komisinë Letrare të Shkodrës ishte ngritur në nivel të gjuhës standarde, nuk i ka ruajtur të plota grupet e bashkëtingëlloreve *mb*, *nd*, *ng*, *ngj*, por i ka asimiluar në bashkëtingëllore të thjeshta. Në rastet e këtylla në Komisinë Letrare të Shkodrës më 1916-18 janë marrë parasysht të folmet e toskërishtes, të cilat i ruajnë mirë këto grupe bashkëtingëlloresh.

2.11. Të folmet e toskërishtes gati regullisht i shurdhojnë bashkëtingëlloret fundore, kur ato dalin të zëshme. Edhe kur janë në trup të fjalës para një bashkëtingëllorese të pazëshme, bashkëtingëlloret e zëshme bëhen të pazëshme në të folmet e toskërishtes. Gegërishtja i ruan shumë mirë bashkëtingëlloret e zëshme në fund të fjalës, p.sh. *brez-bres*, *mend-ment*, *gardh-garth*, *plumb-plump*, *zog-zok*, *djeg-djek* etj. Te këta shembuj format e para me bashkëtingëllore të zëshme janë të gegërishtes, ndërsa ato me bashkëtingëllore të pazëshme të toskërishtes.

⁸⁴ J. Rrota, *Sintaksi i shqipes*, Shkodër 2005, f. 123

⁸⁵ J. Rrota, *Sintaksi i shqipes*, Shkodër 2005, f. 124

2.12. Rr-ja e fortë e gegërishtes, thotë Rrota⁸⁶, në toskërishte vjen e ligshhtë, me fjalë të tjera do të thotë se ajo nuk del si *rr*, por del si *r*, pasi që në të folmet toske është zhdukur kundërvënia midis bashkëtingëlloreve dridhëse rr-r. , p.sh. në toskërishte thuhet *kurizi, rushi, burnimi, rallë herë* etj., të cilat në gegërishte gjithnjë dalin si: *kurriz, rrushi, burrnimi, rrallë herë* etj., d.m.th. gjithnjë me rr të fortë. Kjo karakteristikë nuk vërehet fare në të folmet e dialektit të gegërishtes, të cilat kundërvënien midis këtyre dy bashkëtingëlloreve e ruajnë shumë mirë. Kjo veçori e të folmeve të gegërishtes ka gjetur vend edhe në normën aktuale të shqipes standarde.

2.13. Të folmet e toskërishtes, vëren Rrota⁸⁷, disa foljeve u vënë përpara një n p.sh. *nxënës-xënës, nzejmë-xejmë, ndarë-darë, nxjerrim-xerrim* etj. Duhet të thuhet se format, të cilat Rrota i paraqet si të gegërishtes, janë vetëm të të folmeve të gegërishtes veriperëndimore, ndërkaq në të gjitha të folmet e tjera të gegërishtes n-ja nistore e këtyre foljeve është plotësisht e rregullt. Kjo do të thotë se fenomeni gjuhësor, për të cilin bën fjalë Rrota, nuk është ndonjë veçori e përgjithshme, karakteristike për të dy dialektet e shqipes, por del si fenomen fonetik i kufizuar, që paraqitet vetëm në të folmen e gegërishtes veriperëndimore dhe jo në të folmet e tjera të gegërishtes dhe të toskërishtes, prandaj ky fenomen gjuhësor nuk përmendet në asnjërin nga studimet, që kanë bërë studiuesit shqiptarë dhe të huaj për ndryshimet midis dialekteve të shqipes..

3. Ndryshimet në fushë të morfologjisë

3.1. Në morfologji pater Justin Rrota⁸⁸, po ashtu heton një grumbull dallimesh të dialekteve të shqipes. Emrat, që e bëjnë shumësin me a (*lisa*), në toskërishte i marrin fjalët përcaktuese të gjinisë femërore, p.sh. *emrat e vjetra shqipe, lisat e thata, fiqat e njoma* etj., ndërsa në të folmet e gegërishtes emrat që në shumës marrin prapashtesën a konsiderohen si emra të gjinisë mashkullore, prandaj edhe përcaktorët i marrin në këtë gjini, p.sh. *emna të vjetër shqip, lisa të thatë, fiqa të njomë*.

3.2. Del i kundërt rasti i emrave, që e bëjnë shumësin me prapashtesën e, p.sh. *mendime, faje, burime*, të cilët në gegërishte konsiderohen si shumësa të gjinisë femërore, sepse edhe fjalët përcaktuese i marrin të kësaj gjinie, p.sh. *faje të randa, mendime të forta, burime të ftofta* etj. Në të folmet e toskërishtes fjalët përcaktuese mbesin në gjininë mashkullore edhe në numrin shumës, p.sh. *faje të rëndë, mendime të fortë, burime të ftohtë* etj. Ky konstatim i Rrorës⁸⁹ del plotësisht i mbështetur.

3.3. Emrat, që dalin në një togfjalësh, ku fjala e dytë është një emër në rrjedhore, në të folmet e toskërishtes dalin pa mbaresën rasore -t, ndërsa në gegërishte e marrin një mbaresë të këtyllë, p.sh. tosk. *lëkurë lope* - geg. *likurë lopet*, tosk. *hiqmu qafe* - geg. *hiqmu qafet*, tosk. *mish viçi* - geg. *mish viçit*. Edhe këtu format, që Rrota⁹⁰ i konsideron si të

⁸⁶ J. Rrota, *Sintaksi i shqipes*, Shkodër 2005, f. 125

⁸⁷ Po ai, po aty

⁸⁸ Po ai, po aty, f. 126

⁸⁹ J. Rrota, *Sintaksi i shqipes*, Shkodër 2005, f. 127

⁹⁰ Po ai, po aty, 126

gegërishtes, i përkasin vetëm së folmes së Shkodrës me rrethinë; të folmet e tjera të gegërishtes, si ato të gegërishtes verilindore, gegërishtes qendrore dhe ato të Shqipërisë së Mesme nuk e kanë këtë mbaresë rasore, prandaj kjo ka karakter të kufizuar dialektor dhe nuk është e gjithë gegërishtes dhe nuk mund të merret si element valid për dallimet dialektore të gjuhës shqipe.

3.4. Emrat mashkullorë, që mbarojnë me grup vokalik *ue/ua*, si: *përrua, krua, ftua* etj., kur të skajohen në të folmet e gegërishtes marrin një n p.sh. *prroni, kroni, ftoni* etj., ndërsa në të folmet e toskërishtes dalin pa këtë n, p.sh. *përroi, kroi, ftoi* etj. Edhe kjo veçori e gegërishtes nuk i përfshin të gjitha të folmet e dialektit të gegërishtes, por vetëm gegërishten veriperendimore, ndërkaq të folmet e gegërishtes jugore këto fjalë i kanë pa n, sikurse ato të toskërishtes.

3.5. Emrat në toskërishte, kur janë në rasën kallëzore, i shkurtojnë trajtat e tyre, p.sh. *djalnë* për *djalin*, *lisnë* për *lisin*, *burrnë* për *burrin* etj. Këso shkurtimesh, konstaton Rrota, i ndesh njeriu edhe në shkrimet e shkrimtarëve të vjetër shqiptarë të Buzuku, Budi e Bogdani. Sipas këtij konstatimi të Rrotës⁹¹ del se dikur të dy dialektet kanë pasur forma gjuhësore plotësisht të barabarta, por më vonë të folmet e gegërishtes kanë ndryshuar, d.m.th. i kanë zgjeruar format gjuhësore të tyre. Ky është një fenomen gjuhësor interesant që kërkon studime të mëtejme, sepse është e njohur që të folmet dialektore të gegërishtes gjithnjë dalin më inovuese, d.m.th. që i thjeshtojnë trajtat gjuhësore më tej (khs. p.sh. *lexuem-lexue-lexu, punuem-punue-punu* etj.).

3.6. Ndër emrat foljorë, thotë Rrota⁹², toskërishtja i përdor më shpesh ata që dalin me sufiksat *-je, -ja*, si p.sh. *ardhje, nisje, sjellje, thirrja, sjellja* etj. Këtu, siç mund të vërehet, nuk kemi të bëjmë me dy prapashtesa, por me një të vetme dhe kjo është prapashtesa *-je* ndërkaq *-ja* është varianti i shquar i së njëjtës fjalë dhe nuk mund të jetë prapashtesë tjetër. Emrat e këtyllë gegërishtja i përdor në dy-tri forma. Një herë i përdor si femërorë të thjeshtë, p.sh. *dala e gjasë, u ka ra sëmunda, ma e mirë ika se mbeta* (khs. *ikja-mbetja*).

3.7. Mbiemrat foljorë në të folmet e toskërishtes përveç nyjes së përparme nuk marrin sufiksën e, siç ndodh në të folmet e gegërishtes, p.sh. *vitin e kaluar, javën e kaluar*, ndërsa në gegërishte: *vitin e kaluem, por javën e kalueme*.

3.8. Përemrat pronorë i, e vet përdoren në gegërishte, ndërsa në toskërishte gjithnjë dalin i, e, të tij, i, e, të saj, p.sh. Mbretnesha me bijt e vet tani u ngjit në kështjellë; toskërisht: Mbretëresha me bijtë e saj u ngjit në kështjellë. Ky dallim dialektor ka qenë i mirëfilltë në kohën kur Rrota i bënte këto studime për dallimet dialektore të shqipes, mirëpo sot gjendja mund të ketë ndryshuar edhe në të folmet e veçanta të toskërishtes, sepse përemri i, e vet është normëzuar dhe duke u përdorur vazhdimisht në gjuhën letrare është përhapur edhe në të folmet e veçanta të toskërishtes.

⁹¹ Po ai, po aty

⁹² Po ai, po aty

3.9. Toskët përdorin dhanoren e tipit *neve, juve* edhe në vend të emërores *na, ju*, p.sh. *Neve shkojmë e vijmë pa frikë. Juve s'keni qenë dje në shkollë*. Format e këtilla dialektore të toskërishtes kishin depërtuar një kohë edhe në gjuhën letrare shqipe, mirëpo ishin qortuar si forma të gabueshme dhe tani dalin gjithnjë e më rrallë.

3.10. Trajtat e dëftorit *ky, kjo* në kallëzore *këtë, atë* toskërishtja i ka të këtillë edhe kur dalin vetë, por edhe kur shoqërojnë një emër, p.sh. *këtë libër atë punë*, ndërsa gegët e kanë *këtë punë, atë punë* etj. d.m.th. nuk theksohet rrokja fundore por ajo parafundore.

3.11. Një dallim tjetër del tek imperfekti (e pakryera) i foljeve, sepse toskërishtja e ka imperfektin asigmatik *punonja, punonje, punonte, punonjim, punonjit* dhe *punonjin* ndërsa në gegërishte e pakryera është gjithnjë sigmatike*, p.sh. *punojsha, punojshe, punonte, punojshim, punojshit* dhe *punojshin*. Trajtat e imperfektit të toskërishtes ndëgjohen edhe në të folmen e Malësisë së Mbishkodrës, thotë Rrota⁹³.

3.12..Aoristi (koha e kryer e thjeshtë) në vetën e tretë shumës te foljet që mbarojnë me l, ll, r, rr del i cinguar në mbaresën vetore të tij, p.sh. *u shaktrruan e u therrë* (khs. *u therrën*). Kjo dukuri, sipas mendimit tonë, nuk është e përgjithshme për toskërishten dhe nuk mund të quhet si karakteristikë e saj. Rrota⁹⁴ një trajtë të tillë e gjen te shkrimet e Fan Nolit, por kjo te ky autor dhe tek autorët e tjerë toskë nuk kanë një përhapje të gjerë si e këtillë. Sipas disa analizave, që kemi bërë, na del, se kjo formë foljore e së kryerës së thjeshtë del e plotë si në të gjitha të folmet e tjera të gjuhës shqipe, pra: *u therrën*.

3.13. Koha e ardhme e tashme ndryshon në të folmet e gegërishtes dhe të toskërishtes. Toskët e kanë gjithnjë të ardhmen me *do* plus lidhoren e tashme: *unë do të shkoj*, ndërkaq, gegët e kanë të ardhmen e formuar me foljen ndihmëse *kam, jam* në kohën e tashme dhe me paskajoren e foljes, *unë kam me shkue*. Edhe ky është një konstatim i mbështetur i Rrotës⁹⁵, të cilin do ta përfillin me konsekuencë të gjithë studiuesit e mëvonshëm, të cilët do të marrin për t' i trajtuar dallimet dialektore midis gegërishtes dhe toskërishtes.

3.15. Të folmet toske kanë edhe imperfektin e habitores, që mungon te gegët, unë *punuekështa, ti punuekështe, ai punuekësh, ne punuekëshim, ju punuekëshit* dhe ata *punuekëshin*. Një trajtë e këtillë e habitores, konstaton Rrota⁹⁶, gjindet në veprën e Pjetër Bogdanit. Kjo, sipas tij, vërtetonte se dikur edhe të folmet e gegërishtes e kishin pasur të rregullt një formë të këtillë gjuhësore, por e kishin humbur më vonë me kalimin e kohës dhe me largimin gjithnjë e më të madh nga trajtat gjuhësore të toskërishtes.

* Imperfkti sigmatik e ka marrë emrin sipas shenjës grafike s të alfabetit grek, e cila në këtë alfabet quhet sigma. Meqë s-ja dhe sh-ja janë shkronja të ngjashme, atëherë sigma quhet edhe sh-ja që del te këto forma foljore të imperfektit (kohës së pakryer).

⁹³ J. Rrota, *Sintaksi i shqipes*, Shkodër 2005, f. 128

⁹⁴ J. Rrota, *Sintaksi i shqipes*, Shkodër 2005, f. 128

⁹⁵ Po ai, po aty, f. 129

⁹⁶ Po ai, po aty

3.16. Tri vetat e para të foljeve, që mbarojnë me bashkëtingëllore në të tashmen e dëftores, të folmet e toskërishtes i përdorin pa mbaresa vetore, p.sh. unë *fal*, ti *fal*, ai *fal*, unë *nis*, ti *nis*, ai *nis* etj., ndërsa në gegërishte, sipas Rrotës⁹⁷, dalin me mbaresa vetore të tipit unë *fali*, ti *falë*, ai *falë*, unë *nisi*, ti *nisë*, ai *nisë* etj.

3.17. Gegët, thotë pater Justin Rrota⁹⁸, e përdorin infinitivin d.m.th. paskajoren tepër shpesh ndërsa toskët e zëvendësojnë foljen e mënyrës paskajore me atë të lidhores, p.sh. gegërisht: *Me dashtë na me thanë të vërtetën; Ti duhesh me shkue* etj., toskrisht: *Po të duam neve ta themi të vërtetën. Ti duhet të shkosh*. Edhe ky konstatim i Rrotës, si shumë të tjerë të paraqitur në këtë studim, del i saktë.

4. Dallimet në fushë të leksikut

1.Më pas Rrota⁹⁹ kërkonte dallimet dialektore në fushë të leksikut të të dy dialekteve të shqipes dhe renditte fjalët e tipit *agjëroj*, *arrij*, *ardhi*, *capi*, *çelur*, *ca*, e të tjera duke ua vënë përballë ato të gegërishtes të tipit *ninoj*, *andej*, *mrrij*, *erdhi*, *harushë*, *hapi*, *çil* etj. Kështu ai merr dhe trajton reth 85 fjalë, pjesë të ndryshme të ligjëratës, veçanërisht emra, mbiemra, folje e ndajfolje, por edhe pjesët e tjera të ligjëratës. Në dy copa të shkurtra leximi, njera marrë nga Fishta dhe tjetra nga Lumo Skendo.

Studimit të pater Justin Rrotë për dialektologjinë shqiptare nuk i kanë kushtuar ndonjë rëndësi as dialektologët në studimet e tyre individuale

Recenzentë:
Prof.dr Imri Badallaj
Prof.dr. Shezai Rrokaj

⁹⁷ Po ai, po aty

⁹⁸ J. Rrota, *Sintaksi i shqipes*, Shkodër 2005, f. 130

⁹⁹ Po ai, po aty

KUMTESA

Shpresa ISMAJLI: PARASHTESAT DHE PRAPASHTESAT E SHQIPES SË BUZUKUT DHE ASAJ TË SOTME

Vepra e Buzukut, si libri i parë i shqipes së shkruar, ndër të tjera shërben edhe si vepër krahasimi, mbështetja mbi të cilën i jep të drejtë studiuesit të pohojë që dukuri të caktuara gjuhësore të shqipes që i gjejmë në veprën e Buzukut dëshmojnë të paktën në shek. XVI. Kjo vepër është pasqyrë e një faze në rrugën e zhvillimit të shqipes, prej nga mund të ndiqet saktësisht historia e zhvillimit të saj.

Vepra “Meshari” ka rëndësi edhe për studimet në fushën e formimit të fjalëve, për mënyrat, tipat dhe formantet fjalëformuese të shqipes së kohës. Në këtë kumtesë do të flasim për parashtesat dhe prapashtesat që gjenden në shqipen e Buzukut, ballafaqimin dhe krahasimin e tyre me ato të shqipes së sotme, për nga numri, prodhimtaria apo gjallëria.

Ashtu si në shqipen e sotme, edhe në librin e Buzukut formantet parashtesore janë më të pakta në numër sesa formantet prapashtesore, të cilat edhe pse nuk janë aq të shumta, janë, veç kësaj, dhe më të dendura në përdorim sesa parashtesat.¹⁰⁰ Fjalët e prejardhura me parashtesa, në librin e Buzukut, vihen re kryesisht në fushën e mbiemrave dhe foljeve. Dihet që mjetet fjalëformues (parashtesat dhe prapashtesat) e te Buzuku janë relativisht të pakta, por ky fakt nuk do të thotë se kjo është gjendja e vërtetë e mjeteve fjalëformuese të shqipes së shek. XVI.¹⁰¹

Me parashtesën *a-*, në një fazë të caktuar të zhvillimit të gjuhës, janë formuar përemrat dëftorë, disa ndajfolje të vendit e të mënyrës, si: *aj, ata, i atillë, aty, andaj, ashtu, kështu(shtu)*, duke u dhënë kuptim deiktik të largësisë. Mirëpo në gjendjen e sotme të gjuhës *a-, kë-* e ndonjë tjetër nuk merren më si parashtesa.¹⁰²

Në gjuhën shqipe ka hyrë edhe parashtesa e huaj *a-*, e cila gjithnjë e më shumë po zëvendësohet me *jo-*.

Me parashtesën *ç-*, në librin që kemi objekt studimi e ndeshim foljen *çkushulloj*, si edhe mbiemrin e emëruar *të çkushulluomitë*. Kjo parashtesë mund të thuhet se sot del kryesisht si variant dialektor i *sh-së*, por në rastet kur parashtesa *ç-* ndiqet nga një zanore ose bashkëtingëllore sonante(*l, ll, r, rr, m, n, nj, j*) janë bërë normë trajtat me *ç-*.

Me parashtesën *çpër-*(sot *shpër-*), e gjejmë foljen *çpërthej*. Sot është mjaft prodhimtare, formon shumë folje dhe emra prejfoljorë.

Me *k(ë)-* gjemë foljen *këqyrë*, nga rrënjori *qyrë* (por haset edhe trajta *qyrë*). Po kështu gjejmë edhe fjalët: *kaqë, ky, këjo, kështu, këha, këndej, këtillë, (i tillë), këta, këtyre, kësaj, kështu*, etj, **por** edhe këto fjalë në gjendjen e sotme të gjuhës këto fjalë nuk merren më si formime parashtesore.

Me *kaca-* e hasim emrin *kacadre*, shtazë që i përngjan drenit.¹⁰³

¹⁰⁰ E. Hysa dhe L. Xoxa, *Vëzhgime për formimin e fjalëve te “Meshari” i Gjon Buzukut*, në Seminari për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqipe, 22/1, f. 236

¹⁰¹ Po aty

¹⁰² Thomai, J. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f. 147

¹⁰³ Po aty

Me *lë-* gjejmë disa folje, si: *lëkundunë* (khs. *për-kund, sh-kund*)¹⁰⁴; *lëpij* (*lyinjënë*) në ç'rast parashtesa bën dallim kuptimor të fjalës së formuar nga folja *pi*. Kjo parashtesë nuk është më prodhimtare.

Me *mbas-* gjejmë dy ndajfolje të kohës: *mbasandaj dhe mbaskëndaj*.

Me *m(ë)-/mb(ë)-* i gjemë foljet *mbukuroj dhe mplak*; *mbiemrat i mplakunë, i mbegatë dhe ndajfoljen mpari*.

Me *parashtesën n-* (kryesisht pa kurrfarë funksioni) gjemë 7mbiemra: *e ngënyjeme, e ngënyjeshime, i ndhezunë, i nveshunë, i nvrar, i nthellë, i nvrantëtë*; 18 folje: *nçili, nvrar, ngënej, nfshehunë, nkuqunë, ngjall, nfal, ndhezunë, nlidhunë, , nginjunë, nkrijuom, nxirr, nthej, nlem, nçuo, nveshunë, nflini, nkrijuom*; e 2 ndajfolje: *nçuom, nvrar*. Nuk vepron më.

Me *ndë-* e gjejmë fjalën *ndënatë-ja*.

Me *ndër-* ndajfoljen *ndërmjed*. Kjo parashtesë, sot, është mjaft prodhimtare në formimin e disa emrave, mbiemrave e foljeve.

Me *parashtesën pa-* në Mesharin e Buzukut na dalin 25 fjalë: *i pamort, i paplang, i pashtëpi, i papushim, i pabesë, i paçmuom, i padrejtë, i padenjë, i paditunë, i pafrujt, i pagojë, të pakrështena, i paligji, të pandigluom, i pafe, të pamasë, të pabujtunë, të palana, të pashërbëtoresë, e pakeqe, e pamartuome, të panierëz, të papërmortshime, të pashërbëtyrë, i panjohunë dhe vetëm një ndajfolje: padhimshim*. Edhe sot është shumë prodhimtare, pothuajse nga çdo pjesore mund të formohen mbiemra me *pa-*, më pak prodhimtare është në formimin e emrave dhe ndajfoljeve.

Me *për-* na dalin 17 folje: *përdredh, përglatunë, përfaronj, përkujdesunë, përbuz, përdaj, përlëvdoj, përzuna, përpjekunë, përgëzuj, përkatëno, përderdhi, përlëftoj, përtham, përpijtë, përze (me kuptimin pres, pranoj)*¹⁰⁵, *përzien, përgjigji, përvëluotë*; 14 ndajfolje: *përherë, përmaal, përfondi, përpara, përmbropa, përjashtëna, përbrenda, përndanë, përmënishim, përhirshim, përmbapa, përposh, përkaq, përsipër*, 6 mbiemra: *i përgjykuom, i përfaruam, e përdame, i përkatënuom, i përmëshirshim, të përvutë, i përgjegjunë, i përhirshim, dhe 2 parafjalë përmbi dhe përqaq*. Në gjuhën e sotme, parashtesa *për-* është bërë shumë produktive.

Me *pranë* te Buzuku e gjemë vetëm emrin *pranverë*, por edhe sot nuk është aktive, e gjejmë në 2 a 3 fjalë (*pranëvendosje, pranëvënie*).

Me *parashtesën sh-* gjejmë emrin *shkushullim*, antonimi i emrit *ngushëllim*; foljet *shkatërronjë dhe shkul*. Te Buzuku e hasim edhe fjalën *i shtëmanktë*, që ka si bazë fjalën *i majtë*. Në disa të folme të gegërishtes, kjo parashtesë të fjala *i shtëmanktët/ i shtëmajtë* me anë të sinkopës u thjeshtua në *sh-*, *i shmajtë*.¹⁰⁶ Parashtesa *sh* -sot është aktive, sidomos në formimin e foljeve me kuptim të përkundërt.

Me *shpër-* na del në folja *shpërblenë* (me), emër *shpërbles-i*, por edhe si mbiemër *i shpërblenë*. Sot është mjaft prodhimtare, në formimin e emrave prejfoljorë dhe foljeve.

Me *të-* formohen emrat: *tëlyen, tfurkthi, tambëlth* (fshikëza e vnerit) dhe ndajfolja *tepër(epër)*. Nuk është aktive në shqipen e sotme.

Me *tu-* (që mendohet të jetë variacion i *të*, me ndërrim të *ë-së* në *u* në pozicion para theksit¹⁰⁷) janë formuar ndajfoljet si *tumir dhe tuteq*. Sot nuk vepron më.

¹⁰⁴ Libri i cituar, f. 163

¹⁰⁵ Çabej, E. *Studime gjuhësore*, VI, Prishtinë, 1988, f. 82

¹⁰⁶ Mulaku, R. *Parashtesat dhe prapashtesat e gjuhës shqipe në shkrime të vjetra*, Prishtinë 1998, f.

66

¹⁰⁷ Libri i cituar, f. 183

Me *z-* foljet *zbardhunë, zdit, zbuloi, zgidhunë* dhe mbiemrat e emëruar të *zbardhunit* dhe të *zditunit*.

Me *x-* foljet *xveshunë dhe* mbiemrin *i xveshunë* (antonim me *i veshunë*). Nuk është më aktive.

Me *xh-* folja *xhverdhunë*. Në shqipen e sotme mjaft aktive është parashtesa *zh-*, me të cilën alternon *xh-*ja.

Prapashtesat, siç thamë, janë më të shumta në sasi, përdoren më dendur dhe janë më shumë produktive. Fjalët e prejardhura me prapashtesa, në librin e Buzukut, vihen re kryesisht në fushën e emrave dhe foljeve.

Me prapashtesën *-ac*, te Buzuku e gjejmë fjalën *butac-i*(, një lloj ene druri për të mbajtur ujin si ibrik¹⁰⁸). Kjo prapashtesë është pak prodhimtare.

Me prapashtesën *-cë*, del fjala *përparëse*.

Me *-ec, turmec* “trumcak”, siç duket i përfutur me metatezë *turm: trum*¹⁰⁹

Me prapashtesën *-uc, garuc*(lakuriq). Këto prapashtesa nuk janë më aktive.

Me *-an*, gjejmë fjalën *shtrigan*.

Me *-aj*, fjalët *kurraj, kujnaj, askujnaj*.

Me *-as, vendas*. Prapashtesat *-an* dhe *-as* janë prodhimtare edhe sot, ndërsa *-aj* ka mbetur joprodhimtare.

-ar/-tar. Me *-ar*, gjejmë 3 emra: *ortar, kurvar, letrar*; ndërsa me *-tar* 11: *kopshtar, tregtar, peshkëtar, pjesëtar, udhëtar, burgëtar, rogëtar, vistar, gojëtare, shtekëtar, ndihmëtar* dhe mbiemrin *leshëtar*. Edhe sot të dyja janë mjaft prodhimtare.

-atë. Te Buzuku e gjejmë vetëm fjalën *kafshatë*. Ndërsa në shqipen sot kemi një numër të madh fjalësh me këtë prapashtesë.

-es/-esë. Me prapashtesën *-es* gjemë emrin *shërbes*; ndërsa me *-esë*: *shëmbëllesë, ndijesë, pendesë*. Prapashtesa *-es* nuk është më e gjallë(sot përdoret *-ës*), ndërsa *-esë* është mjaft aktive dhe prodhimtare.

Me *-ë*, emrat *pasë* “pasuri” *masë dhe kullosë*. Me prapashtesën *-ë* dhe me nyjëzim, te Buzuku gjejmë 10 mbiemra *i shkretë, i afërë, i egërë, i errëtë, i fortë, i naltë, i ftoftë, i largë, i plotë, i shpeshë*. Prapashtesa *-ë* nuk është më prodhimtare, ndërsa njëkohësisht me nyjëzim bëhet prodhimtare.

Me *-(ë)r(ë)* dhe me paranyjëzim te Buzuku e gjejmë vetëm mbiemrin *i poshtërë*, sikurse edhe sot kjo prapashtesë nuk është joprodhimtare.

Me *-(ë)s*, kemi 24 emra: *hjekës, grabitës, ruajtës, ndjekës, bas, gjykatës, shëlbuos, shkruos, shkruos, forcuos, munduos, zotënuos, ordhënuos, kënduos, shpëtuos, shëlbuos, penduos, shpërblesi, duruos, ngushëlluos*. Edhe sot është shumë prodhimtare për të formuar emra të rinj.

Me *-i*, gjejmë 30 emra: *lavdi, dhëndëri, gjakësi, kusëri, ushtëri, famulli gjakësi, populli, njerëzi, bukurë, begatë, fërmi, dhunë, dëshmi, lakëmë, mrekuillë, miqëni, anëmiqi, djelmëni, gjendenë, kurvëni, fëlliqëni, regjëni, priftëri, vëllazëni, zotëni, pleqëni, shejtëni dhe shoqëni*; Kjo prapashtesë te Buzuku na del mjaft aktive, prodhimtaria e saj gjithnjë u zgjerua, është shumë produktive edhe sot.

-(ë)ni/-(ë)si. Me *-ëni* emrat: *fëlliqëni dhe gjendeni*, ndërsa me *-ësi* emri *malësi*

¹⁰⁸ Ashta, K. *Leksiku historik i gjuhës shqipe, I*, Shkodër, 2000

¹⁰⁹ Mulaku, R. *Prapashtesat dhe prapashtesat e gjuhës shqipe në shkrime të vjetra*, Prishtinë 1998, f.

-(ë)sinë, vetëm emri *qelbësinë*. *(-ë)ri* dhe *(-ë)si* dhe në shqipen sot janë shumë produktive, *(-ë)sinë* është më pak, ndërsa prapashtesa *-ni* del në një vetëm në një numër to kufizuar emrash.

Me prapashtesën *-icë*, gjejmë emrat *buollicë* dhe *shumicë*. Nuk vepron më.

-im/-imë. Në veprën që kemi objekt studimi, me *-im* kemi gjetur 13 fjalë: *durim, kushtim, mundim, nderim, ngushëllim, ngjënim, pushim, shkushullim, guvernim, ndërim, ngadhënjim, kushtime, i pabesim*; kurse me *-imë* 4: *vetëtimë, bubullimë, sokëllimë, vetëtimë dhe dhezëllimë*.

Me *-m(ë)* 3 emra: *pështymë, frymë* dhe *krizmë*. Prapashtesa *-im* është ndër prapashtesat më prodhimitare të shqipes, *-imë* sot nuk është më aktive, ndërsa prapashtesa *-më* nuk është më e gjallë.

Me parashtesën *-m* dhe me nyjëzim gjejmë 36 mbiemra në librin e Buzukut: *e amëshuome, e bekuome, e dëshëruome, të dhunuome, i endërruom, i endigluom, i endijyem, e faruome, e festuome, e glorifikueme, i gjykuom, i këmbyem, të kënduom, i majm, e mbapëme, i munduom, i nvarm, i gënjyem, e ngarkuome (me kuptimin me barrë¹¹⁰), të ngushulluome, i përfaruom, i pëlqyem, i publikuem, të penduome, e përdame, e përtërme, e pushuome, të qendruome, e rezuome, e sodme, i shtuom, e shekruome, i tepërm, i tukej, i vetëm*. Nuk është prodhimitare.

Me *-(i)sht* gjejmë 4 ndajfolje: *gërqiisht* (me metatezë nga Greqi), *letisht, xhudhish, ligjisht*.

Me *-shim(çim)* janë formuar 5 ndajfolje: *eçim, gëzuoshim, reshim, padhimshim* dhe *përhirshim*. Është mjaft prodhimitare dhe po gjallërohet gjithnjë e më shumë.

Me nyjëzim dhe prapashtesim *-shim* kemi 15 mbiemra: *i ditëshim, i ndriçim, i duruoshim, i dishim, e dhimshime, i dhunuoshim, i ngaeshim, i mëshiershim, e ngënjyeshime, i ndershim, i nevojsim, i rreshim, të shishim, të vëjyeshim, të zdiriçime*

Edhe kjo është ndër mënyrat më prodhimitare.

Me prapashtesën *-shti*, gjejmë emrin *madhështi*.

Me *-shkë*, mbiemri *e zeshkë* (*e zezë*>*zeshkë*, ku ka rënë *z*-ja në grupin e tri konsonantesh: *e zeshkë: e zeshkë*).¹¹¹ Nuk vepron më.

Me *-nik* një emër *pashnik* (perde, mbulesë). Nuk është më aktive.

Me *-o* gjejmë 37 folje: *u ambëltuom, afëroj, besonj, mbukuroj, dëshmonj, denjoni, dhunoni, dëshëron, forcon, feston, faron, formon, frujtonj, fluturon, gjmuom, idhënuo, lëfton, largon, lëvdvoj, lironi, mbaroi, mundoj, meritojmë, mjeko, ndimo, ordënuom, paguonjinë, provonjë, punoni, shumonj, shtegtoi, shenjtoi, trajtonj, vepëroi, vono, vizitove, vononjë*.

Prapashtesën *-o* në veprën e Buzukut e ndeshim edhe në variantet *-(ë)no* *zotënonj, turpëroj, regjënoj dhe shenjhtëroj* dhe *-(ë)zo: lulëzonetë* dhe *-to: ambëltuom, rangëtuom, tregëtuom*, të cilat kanë dalë gjatë zhvillimit të brendshëm të shqipes.

Prapashtesat *-o* është bërë shumë prodhimitare, ndërsa *-(ë)no* vepron më pak.

Me prapashtesën *-or(-uor)* në librin e Buzukut gjejmë *krahëruorë, kalor, kaluar, dasmor, zemëruour*.

Me *tor (-tuor)*: *gjator, punëtor, fajtuor, shërbëtore*. Në shqipen e sotme *-or* ka prodhimitari shumë të madhe, ndërsa *-tor* më pak.

¹¹⁰ Çabej, E. *Studime gjuhësore*, VI, Prishtinë, 1988, f. 216

¹¹¹ Mulaku, R. *Parashtesat dhe prapashtesat e gjuhës shqipe në shkrime të vjetra*, Prishtinë 1998, f.

Me *-të, kurrajtë, përhapëtë*. Me prapashtesën *-të* dhe me paranyjëzim janë formuar 8 mbiemra te Buzuku: *i artë, i errëtë, i shtëmankëtë, i unëtë, e drujtë, të shumëtë, të parëtë, i mëndafshhtë*.

Me *-ti, lodërti, tregëti, shkretëti, dhunëti*.

Me *-tyrë, shëmbëlltyrë, shërbëtyrë*.

Prapashtesa *-të* dhe me paranyjëzim është shumë prodhimtare, *-ti* dhe *-tyrë* nuk veprojnë më.

Me prapashtesën *-th*, janë formuar emrat *tambëlth* dhe *tfurkth*. Edhe kjo parashtesë është aktive në shqipen e sotme, formon emra me kuptim zvogëlimi a përkëdhelie.

Me *-(ë)z(ë)* janë formuar 8 fjalë: *vashëzat njomëzatë, grishëzë, duorzëtë, barkëzë, napëzë; mbiemri të vogjëlizëtë*; ndajfolja *pakëzë*. Edhe në shqipen e sotme është mjaft aktive.

Siç mund të shihet, në librin e parë shqip, parashtesat më prodhimtare janë *-për* (me 43 formime) dhe *-pa* (me 25) pastaj vijnë *n-* (7), *z-* (6), *m(ë)-* (5), *sh-*(4), *shpër-* (3), *mbas-* (2), *etj*. Disa nga këto parashtesa, gjatë zhvillimit të shqipes janë gjallëruar shumë e janë bërë shumë prodhimtare, disa kanë mbetur më pak produktive, e disa e kanë humbur krejtësisht prodhimtarinë dhe nuk janë më aktive në shqipen e sotme. Por, siç dihet, gjatë kësaj kohe, shqipja e zgjeri dhe shumëfishoi numrin e parashtesave, produktivitetin, përdorimin dhe funksionin e tyre. Po përmendim: *jo-, mos-, para-, prapa-, kundër-, sipër-, pas, nën-, mbi-, ndër-, ndaj-, prej-, bashkë-, pan-, tej-, sapo-, porsa-, prej-, lart-, poshtë-, sipër-, stër, ultra-, a-, anti-, super-, auto-, poli-, bio-, gjeo-, etj*.

Ndërsa nga prapashtesat më prodhimtarja në veprën e Buzukut është prapashtesa *-o* (37), pastaj *-i* (29), *-ës* (24), *-im* (13), *-tar* (11), *-(ë)z(ë)* (8), *-shim* (5), *-or(-uor)* (5), *-imë* (4), *-(ë)no* (4), *-tor (-tuor)* (4), *-isht* 4, *-ti* (4), *-më* (3), *-ar* (3), *-esë* (3), *-ë* (3), etj.

Në veprën e Buzukut, me prapashtesim dhe paranyjëzim së bashku, formohen një numër i madh mbiemrash. Kështu, me nyjëzim dhe prapashtesën *-m* janë formuar 35 mbiemra, nyjëzim dhe *-shim* 15, me nyjëzim dhe *-ë* kemi 10, me nyjëzim dhe *-të* kemi të formuar 8 mbiemra.

Gjuha shqipe gjatë shekujve të zhvillimit të saj, përveç që zgjeri kuptimet, funksionet dhe përdorimin e këtyre prapashtesave, u pasurua me shumë të tjera, e rrjedhimisht edhe me shumë formime të reja fjalësh. Po përmendim disa parashtesa që nuk gjenden te Buzuku: *-ak, -as, -al, -it, -iot, -ist, -ik, -ian, -ant, -anik, -ent, -esk, -oz, -ier, -je, -ishte, -iv, -urina, -aç, -ashkë, -ishte/-ishtë, -in(ë), -(ë)tirë, -ajë/-najë, -llëk, -izëm, -azh, -ual, -urë, -ush, -ushkë, -ikë, -içkë, -ko, -acak, -acuk, -lluq, -alec, -aman, -arash, -avec, etj*.

Recenzentë :
Prof.dr. Ragip Mulaku
Prof.dr. Shefikje Islamaj

KUMTESA

Dr. Mustafa IBRAHIMI¹: GJENDJA DHE PERSPEKTIVA E ETNOLINGUISTIKËS SHQIPTARE

¹Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe
Universiteti i Evropës Juglindore
Tetovë - Maqedoni

Punimi shqyrton marrëdhëniet e ndërsjellë të gjuhës në raport me kulturën e një etnosi, e njohur si etnolinguistikë, një shkencë e re ndërdisiplinore të gjuhësisë, e cila përmban njohuri gjuhësore, historike dhe kulturore të një populli. Edhe pse në botën shkencore ka arritur të zhvillohet dhe të sjell metoda dhe terma të reja, në kushtet e një shqipeje të pambrojtur si duhet nga institucionet dhe të izoluar për gjysmë shekulli, etnolinguistika shqiptare nuk arrijnë të paraqitet si disiplinë që sot e do koha dhe të arrijë t'i mbulojë gjerë dhe thellë problemet ndërdisiplinore gjuhësore që ka shqipja. Megjithatë në këtë punim do të jepet një pasqyrë e studimeve në raportin gjuhë dhe kultura e një etnosi, duke ndjekur me vëmendje veprimtarinë e dijetarëve shqiptarë, me botimet dhe shkrimet e shumta si prijës të prurjeve teorike e të dhënave kulturore, dialektologjike, folklorike, shoqërore etj., duke mundësuar që etnolinguistika si shkencë të degëzohet në disa fusha tematike të interesimit. Kjo mund të jetë një shtysë dhe nxitje për studiuesit e ardhshëm.

1. Përkufizimi për etnolinguistikën

Studimi i raportit gjuhë dhe kulture nuk ka përgjigje të shkurtë dhe të qartë. Termi kulture është aq i gjerë, sa që nuk ekziston një disiplinë e vetme që mund ta shpjegojë. Përkufizim më të saktë të këtij raporti mund të shihet tek etnolinguistika, megjithatë edhe ky term kërkon shpjegime të shumta, sepse etnolinguistika kështu e menduar, është shkencë interdisiplinore kurse metodologjia e saj është e ndërlikuar dhe përbëhet prej disa etapash dhe shumë fushash.

1.1 . Termi etnolinguistikë dhe pikëpamjet e saj

Etnolinguistika është një term i përdorur shpesh në studimet etnike, në disiplina të tilla si antropologji dhe linguistikë dhe komunikimit ndërkulturor, e cila merret me studimet e gjuhës në lidhje me studimin e grupeve etnike dhe kulturës së tyre. Etnolinguistika është një nder disiplinat me te reja gjuhësore, të zhvilluara kohëve të fundit; e pikërisht; në vija të përgjithshme, ajo mund të studiojë: *përshëndetjet, doket, zakonet, traditat, ritualet, magjitë, syri i keq, urimet, mallkimet, traditat dasmore, lindja, vdekja etj.* Ky raport midis gjuhës dhe

kulturës mund të jetë në kompetencat e gjuhësisë antropologjike, antropologjisë kulturore, sociogjuhësisë, psikologjisë sociale, kulturologjisë ose fushave tjera shkencore interdisiplinare.

Etnolinguistike zakonisht janë definuar si studime të gjuhëve në raport 1) me një shprehje e një kulture dhe 2) në lidhje me situatën e të folurit. Ndonjëherë ajo shihet si një etnolinguistikë e veçante sociolinguistike, por etnolinguistika për dallim nga sociolinguistika përcakton ndryshe, duke analizuar në veçanti të ashtuquajturat gjuhë primitive në lidhje kulturën e tyre, kurse sociolinguistika raportin e gjuhës me dukuritë shoqërore të popujve më të mëdha. Nga aspekti etimologjik, kjo disipline ka të bëjë me raportin midis etnosit dhe gjuhës. Për ta precizuar kemi të bëjmë me kulturën e atij etnosi, por jo duke u mbështetur në kulturën elite, por në kulturën popullore dhe tradicionale. Sipas kësaj raporti i vërtetë i etnolinguistikës është raporti midis gjuhës dhe kulturës popullore. (Bugarski 2005:25).

Prej ketu, objekt i etnolinguistikës do të jetë pikërisht raporti i gjuhës me kulturën popullore të saj, kurse qëllimi është i njëjtë si me disiplinat tjera, si folkloristika, leksikologjia, dialektologjia etj..

1.2. Shkollave të ndryshme për etnolinguistikën

Zhvillimi i etnolinguistikës mund të ndiqet nga shek. XVIII (J.G.Herder), Në shek. XIX (V.Humbolt, A.Afanasjev, F.I. Buslajev, A.A. Potebnja, gjatë tërë shek XX (F.Boas, E Sapir, V.V. Ivanov dhe V.N. Toporov. Kah fundi i shek. XX lindin shkollat e posaçme etnolinguistike: rusishtja dhe polonishtja.

Etnolinguistika, si lëndë interdisiplinare, nuk është kuptuar njësoj. Varësisht shkollave dhe shteteve ku është përdorur, hulumtimi është zhvilluar në fusha të ndryshme, duke prekur disiplina të shumta. Në traditën evropiane, traditë kjo që bazohej në studimet e Herderit dhe fon Humbolldit, peshja e studimeve etnolinguistika është mbështetur në raportin midis gjuhës amtare të një bashkësie dhe mentalitetit të saj se si ai e shikon botën.

Përkufizim më të saktë, etnolinguistika do të fitojë në SHBA, në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, hulumtuesit amerikanë të gjuhës, e në radhë të parë studiuesi Franz Boas, vërejtën se gjuhët e indianëve të Amerikës duhet studiuar me një metodë specifike dhe krejt tjetër nga ajo tradicionalja si për arsye se në ato gjuhë nuk ekziston dëshmi të shkruara për statet e tyre të mëhershme, ashtu edhe pse struktura e tyre e brendshme ndryshon qenësisht prej atyre indoevropiane.¹²⁹ Si rrjedhim i kësaj vërejtjeje lind mësimi të cilin disa e quajnë edhe **etnolinguistikë** që e plasoi nxënësi i Boasit, **Eduard Sapir**. Ky mendonte se gjuhën duhet shpjeguar në korniza të univerzumit të plotë njerëzor dhe sidomos të determinantëve kulturorë të ndonjë civilizimi.¹³⁰ Këtë teori e mbështet edhe bashkëpunëtori i tij **Benjamin Lee Whorf** i cili e plasoi hipotezën e quajtur Hipoteza Sapir-Whorf që thotë se gjuha qenësisht e përcakton botën e njeriut, kështu që univerzumi i njohur është i strukturuar sikurse gjuha me anë të të cilit ai njihet, pra ndryshe nga njëra gjuhë në tjetrën.¹³¹ Pa analizuar më tej saktësinë dhe vërtetësinë e këtyre hipotezave dhe atyre, të cilat i kundërshtuan këto, mund të konkludojmë se në shkollën amerikane të gjuhësisë, u shpreh

¹²⁹ Dubravsko Skiljan: "Kraj Lingvistike", Zagreb 1991, f.56-57

¹³⁰ D.Skiljan: "Pogled u Lingvistiku", SK Zagreb 1987, f. 75.

¹³¹ Po aty.

nevoja dhe domosdoshmëria për gërshetimin e këtyre dy drejtimeve, pra edhe e aplikimit të metodave të ndërsjella në hulumtimin e kulturave të ndryshme, me qëllim të kuptimit sa më të saktë të popujve të ndryshëm. Si rrjedhojë e kësaj, në hapësirën amerikane, ashtu si edhe në shtetet tjera etnolinguistika dallohej nga studimet antropologjike dhe etnografike të bashkësive vendase, siç janë p.sh. **taksonomia e bimëve, sëmundjet, terminologjia e farefisit, emrat e ngjyrave dhe tabutë gjuhësore.**

Pikëpamje të ngjashme, por megjithatë tjera kishte edhe linguistika etnografike apo kontekstuale angleze, përfaqësues kryesor të së cilës ishin antropologu **Bronislav Malinovski** dhe linguisti **John Firth**, të cilët hulumtuan ndikimin e kontekstit civilizues në gjuhë.¹³² Hap shumë të rëndësishëm në gërshetimin e aplikimit të metodave bëri antropologu i njohur francez **Claude Levi-Strauss**, i cili shfrytëzoi strukturalizimin e zbuluar nga linguistët në hulumtimet e mëtejshme të tij antropologjike, duke e përdorur atë sidomos **në studimin e miteve**, por edhe në lëmi të tjera si p.sh. në **analizimin e marrëdhënieve gjinore (fisnore)**. Pra, siç shihet, kjo metodë hulumtuuese ishte mjaft e popullarizuar edhe në Evropë, kështu që një teori të ngjashme e përpunoi edhe R. Mesinger dhe e quajti **"Fjalët dhe sendet"**¹³³ përkrahës të së cilës ishin edhe Norbert Jokli dhe nxënësi i tij Eqrem Çabej.¹³⁴

Në botën sllave, rrethi i studimeve etnolinguistike zgjerohet edhe më tej, tani më me termin etnolinguistikë kuptohet edhe raporti midis gjuhës dhe kulturës tradicionale, sidomos asaj shpirtërore, krijimtarisë popullore, e cila përfshinë mitologjinë dhe religjionin, besimet, rritet, folklorin dhe artin.¹³⁵ Kështu etnolinguistika ndërlihet me një numër të madh të fushave shkencore, nga etnologjia dhe *etnopsikologjia* deri te *dialektologjia*, *etimologjia* dhe *historia e gjuhës*. Mund të përfshihen edhe terminologji tjera popullore të profesioneve si dhe fushave tjera – të themi, **studimi i shprehjeve gjuhësore të subkulturave bashkëkohore dhe zhanreve paraletrare, tifozërisë sportive, kompozimet e reja të muzikës popullore e deri te nekrologjitë.** (Colović 2000 dhe libra tjera të tij)

2. Formulimi i problemit

2.1. Etnolinguistika shqiptare

Përdorimi i kësaj disipline gjuhësore, në hapësirat shqiptare u paraqit me shume vonesë në krahasim me shkollat tjera botërore dhe paraqitet në dekadën e fundit të shek.XX. Megjithatë, dijetarët shqiptarë kanë marrë role që lidhen jo vetëm me gjykimin e gjuhëtarit e etnolinguistit, por edhe me atë të etnologut. Si pasojë e një pune pasionante e të organizuar, është mbledhur *një lëndë e begatë eufemistike*. Eufemizmat janë trajtuar fillimisht nga mjeshtri i shqipes, Çabej, por pas viteve 90 u bënë objekt gjykimi i gjuhëtarëve e dashamirëve të gurrës popullore shqipe, si: *Pasqyrimi i eufemizmeve në letërsinë gojore dhe artistike* (Osmani-Pepa 1995-1996); *Etnolinguistika ne veprën e Çabejt* (Zhurga 2003); *Disa eufemizma të shqipes* (Çabej 1976:17); *Vëzhgim për emrat familjarë të shqiptarëve* (Shpuza:1998); *Sisteme e struktura, raporte* (Sejdiu 2002); Rreth normave të sjelljes

¹³² Po aty.

¹³³ Mark Tirta: Franc Nopça- studiuues i mirënjohur i etnokulturës shqiptare, *Kultura Popullore* 1-2,1993,Tiranë, f.155.

¹³⁴ E. Çabej, *Studime Gjuhësore I*, Parathënie f. VIII.

¹³⁵ Pasqyrë më të gjerë jep Tolstoj, N.I (1995). *Jezik slovenske kulture*. Niš: Prosveta, sidomos në titullin „*Etnolingvistika u krugu humanističkih disciplina*“, 31-46.

gjuhësore dhe kritereve të gojtarisë në folklorin e viseve të Veriut (Zhugra 2001); *Strukturat e këngëve të kreshnikëve, vlerat e antroponimeve në poemën "Lahuta e Malësisë"* (Shih më gjerë artikujt e Gj.Shkurtajt), etj. Punimet e tyre karakterizohen me përpjekjet që problemi etnolinguistik (qoftë leksikor aose frazeologjik) të shqyrtohet në kontekste tëndryshme folklorike, me çka rëndësi të veçantë u kushtohet pyetjeve etnologjike. Asnjë nga autorët nuk përdor metodën e krahasimit me kulturat tjera të afërt apo të largët, dhe as që u jep ndonjë rëndësi arealeve etnolinguistike.

Zhvillim më të madh në fushën e etnolinguistikës kemi në vitet e nëntëdhjeta, edhe pse nuk mund të themi se kemi studime të organizuara apo të flitet për një shkollë etnolinguistike shqipe. Gjatë kësaj periudhe në kombinim me metodat tjera gjuhësore, çasja etnolinguistike paraqitet në punimet e disa studiuesve si te Gjovalin Shkurtaj, Osmani, T.; Pepa, S., Nexhip Mërkuri, Zhugra, A., Shpuza J. etj.

Meqë në hapësirat shqiptare, ende nuk mund të flasim për ndonjë studim etnolinguistik, dhe meqë çdo autor ka qëndrim individual, në këtë punim do të sjell një pasqyre e studimeve të autorëve të ndryshëm shqiptar që kanë prek apo trajtuar tema nga fusha e etnolinguistikës.

2.2. Eqrem Çabej: Etnolinguistika dhe etimologjia

Perspektivën e saj të veçantë, etnolinguistika e gjen edhe në hulumtimet etimologjike. Nga ana tjetër etimologët rrallë e përdorin metodën etnolinguistike, ata para së gjithash këtë metodë e përdorin për të plotësuar qëndrimet e ndryshme etimologjike, si një lloji digresioni etnolinguistik ose fusnote. Raporti i etimologjisë ndaj etnolinguistikës, më tepër ka të bëjë me nevojën e etimologjisë për tu hapur në kontekst gjuhësor dhe jashtëgjuhësor. Një qëndrim të tillë shpreh edhe filologu shqiptar Eqrem Çabej, i cili në shkrimet e tij flet qartë, se: *"etnografia është e caktuar të thotë fjalën e vet në këtë çështje, por në anën tjetër është dëshmia autoritative e gjuhës, si një element vendimtar në përcaktimin e një kulture"*.

Babai i gjuhësisë shqiptare, përveç që konsiderohet si njëri ndër etimologët më të mëdhenj, Çabej mund të radhitet edhe në mesin e studiuesve të një orientimi etnolinguistik dhe këtë e dëshmojnë shumë fakte.

Eqrem Çabej hap perspektiva të reja për zhvillimin e etimologjisë dhe etnolinguistikës. *Dukuritë kulturore i vështron në sinkroni dhe në diakroni*, por edhe në raport krahasues me elementet ekzistuese te popujt dhe gjuhët e tjera, pra marrëdhëniet reciproke që mund të kushtëzonin njëra-tjetrën, për të arritur në këtë mënyrë të paraqesë strukturën e kulturës sonë në përgjithësi dhe përcaktimin e veçorive kulturore etnike.

Në mesin e punimeve të shumta të Eqrem Çabejt, janë të shumta ato që ndihmojnë në mënyrë të mirëfilltë dhe domethënëse shkencën e etnologjisë, siç janë punimet: *"Disa eufemizma të shqipes"*, *"Vendbanimi i hershëm i shqiptarëve në Gadishullin Ballkanik në dritën e gjuhës e të emrave të vendeve"*, *"Disa figura të besimeve popullore shqiptare"*, *"Disa aspekte të kulturës popullore shqiptare në vështrim gjuhësor"* si dhe *"Zakone dhe doke të shqiptarëve"*.

Por, mund të themi se përveç këtui, edhe një numër shumë më të madh punimesh e trajtesash gjejmë elemente që ndriçojnë edhe fenomene të ndryshme kulturore, siç është psh. *sqarimi i fjalëve të ndryshme në fjalorin etimologjik*, me ç'rast gjatë një analize të një fjale zbulohen shtresime të ndryshme kulturore apo qoftë ndoshta edhe vetëm një evolucion kulturor përbrenda një fenomeni dhe një emërtimi.

Me këtë rast do të veçoja disa prej punimeve të Eqrem Çabejt, të cilat bëjnë pjesë në mesin e atyre punimeve që i kontribuojnë interdisiplinës së quajtur etnolinguistikë. Të fillim nga punimi "**Disa aspekte të kulturës popullore shqiptare në vështrim gjuhësor**". Është ky një punim i mirëfilltë etnolinguistik meqë, me anë të analizimeve që i bën fjalëve të veçanta me të cilat emërohen dukuri të ndryshme kulturore si nga fusha shoqërore ashtu edhe nga ato materiale e shpirtërore, me anë të krahasimeve të atyre fjalëve edhe me gjuhë të tjera ballkanike, duke arritur deri te një shpjegim etimologjik, e madje edhe semantik të tyre (siç është psh. rasti me shpjegimin që i bën ai fjalës së përgjithshme të **banimit, banoj, banim, banesë, banorë**, të cilin e sheh si formim të ri prej popullores ban kasolle, stanarësh, të bana shm. *ndërtesa* si dhe fjalëve këpucë, tirq etj.), vërteton elementet e mirëfillta, elementet autentike shqiptare, me çka dëshmohet veçantia e kulturës shqiptare dhe përcaktohet vlera e saj në mesin e kulturave të tjera fqinje apo edhe më të largëta.

Në këtë punim vlera e Çabejt si etnolinguist më së miri shihet në shqyrtimin e zhvillimit të kulturës popullore shqiptare, nëpër proceset e brendshme dhe të jashtme. Duke analizuar raportin mes elementit trashëgim e elementit huazim dhe bashkëveprimet të tyre, Çabej plason tezën se me depërtimin e një huazimi në gjuhë, nuk don të thotë se kemi edhe depërtimin e sendit ose konceptit përkatës në fushën e kulturës materiale ose mendore. Si shembull për këtë mund të shërbej shpjegimi i fjalëve **gjq e gjykoj**, të cilat janë huazuar prej latinishtes *iudicium* e *iudicare*, por, ndërkaq fjalët *gjykim, gjykatë, gjykatës* dhe *gjyqtar* janë formimetë brendshme të gjuhës me pikënisje nga *gjq* e *gjykoj*.

Në këtë punim, autori u kushton rëndësi fjalëve të lashta me origjinë shqipe, për të dëshmuar autenticitetin kulturor shqiptar, por edhe aktivitetin ndikues të kulturës sonë në kultura fqinje. Këtë autencitet kulturor ai e vërteton edhe me analizën e emrave të banimeve nga aspekti semantik, gjuhësor dhe social, siç janë për shembull emrat **Gardhiq, Zgërdhesh, Fikas, Misras apo Kudhës, Lëkurës, Lopës, etj. pastaj Markat, Vugalat, Bularat, Vuthajt, Bogajt**, ku theksohet shumësi. Gjithashtu, me anë të fjalëve me origjinë shqipe jepen dëshmi jo vetëm të autenticitetit, por edhe të ndikimit në gjuhë dhe kulturë të popujve tjerë të Ballkanit, siç është rasti me fjalët *katund, çiflik, vatra* etj., nga kultura e banimit, pastaj *bathë, bishtajë, thjerr, përshesh, bacarak*, etj., nga kultura e ushqimit si dhe *shark, bërruc, flokata, fustan*, etj., nga kultura e veshjes.

Si punim të rëndësishëm, ta quajmë etnolinguistik, mund të numërojmë edhe "**Disa eufemizma të shqipes**", ku gjatë studimit të fjalëve, që ai i quan "pjesë të të folurit figurativ"¹³⁶ praktikisht studion edhe një element të rëndësishëm etnopsikologjik, pra atë të **tabuve**, të cilat janë prezente pothuaj në të gjitha kulturat dhe janë të lidhura me sfera të ndryshme të jetës. Kështu ai, duke theksuar aspektin etnologjik të eufemizmave dhe lidhjen e tyre me tabu, duke bërë krahasime me të njëjtat prani edhe të gjuhët dhe kulturat e tjera ballkanike dhe jashtballkanike, shqyrton ato që kanë të bëjnë me botën e kafshëve dhe insekteve. Gjatë të dhënave që i jep për eufemizmat, të cilat ekzistojnë në gjuhën tonë por edhe në shumë gjuhë të tjera evropiane, për kafshën *Nusja e lalës*, thua se arrin të bëjë një komparacion indoevropian me ç'rast të themi rekonstruktohet një relik i mendësisë së përbashkët indoevropiane.

Në vazhdim, në po të njëjtën mënyrë, trajtohen eufemizmat nga lëmi i demonologjisë si dhe e sëmundjeve, kurse si eufemizma karakteristikë shqiptare në të cilat zbulohet univer-

¹³⁶ E. Çabej. Disa aspekte të kulturës popullore shqiptare në vështrim gjuhësor, Studime Gjuhësore?, f.

sumi specifik i tyre, trajtohen ato eufemizma, që paraqiten, siç shprehet ai, në punë të vogla të jetës së përditshme (psh. procesi i të shuarit), për vezët, për lypset (dukuri sociale), për krypën si dhe eufemizmat nga sfera seksuale.

Gjovalin Shkurtaç : **etnolinguistika dhe folkloristika**

Edhe linguistika antropologjike mund të ndihmojë folkloristikën. Zakonisht hulumtimet në terren janë bazuar në pyetësorin e A. Plotnikova (1996), i cili tekstin folklorik e shqyrton vetëm nëse është ritual, magjik apo demonologjik. Këtu hulumtohen edhe aspekte të tjera të kulturës tradicionale (**meteorologjia Kombëtare, mjekësi, mjekësi veterinare, bindjet për kafshë**, etj) . Një nga studiuesit, i cili pjesën më të madhe të kohës ua ka kushtuar studimeve dukurive të gjuhës së sotme shqipe, së pari si dialektolog dhe si studiues i problemeve të kulturës së gjuhës, të sociolinguistikës dhe etnolinguistikës është prof. Gjovalin Shkurtaç. Në këta njëzet vjetët e fundit, është përkushtuar gati krejt problemeve të marrëdhënieve gjuhë-shoqëri, duke u pykëzuar thekshëm në dukuri të sociolinguistikës, etnografisë së të folurit të shqipes.. Duke marrë parasysh se etnolinguistika është shkencë, e cila merret, në mënyrë më të përgjithësuar, me studimin e kulturës së popujve, pra për objekt ka njeriun dhe univesumin e tij, atëherë është i kuptueshëm dhe madje shumë i arsyeshëm gërshetimi i interesave, i aplikimit të metodave dhe i mënyrës së trajtimit të këtyre objekteve mes shkencave të ndryshme shoqërore. Në veprën Onomastikë dhe etnolinguistikë, studiuesi Gjovalin Shkurtaç studion pikërisht këto çështje, në mesin e tyre: *Shqyrtime paraprake rreth etnonimisë shqiptare: bigëzimet Albania: Shqipëria, arbën/arbër-shqiptar; Gegëria, Toskëria; Emrat e njerëzve (antroponimet) dhe bigëzimi i tyre në forma zyrtare dhe jozyrtare; Shqyrtime sociolinguistike për emrat e faretfisnisë dhe emrat vetjakë të shqipes; Përsëritjet dhe urimet në gjuhën shqipe; Përditimi dhe lindja në sociotipin shqiptar; Vlera etnolinguistike të epikës heroike shqiptare, Pseudonimet në letrat shqipe etj.*

Mjaft me interes është studimi mbi bigëzimin e emërtimeve të etnonimit, si: Albani dhe Shqipëri, dhe variantet tjera nga popujt e ndryshëm Albaner, Albanci, Arnaut, Arvanit, Arbanash, duke theksuar se kjo dukuri nuk është vetëm për Shqipërinë dhe shqiptarët, por edhe për popuj të ndryshëm në botë. Me interes si etnonime janë edhe dy ndarjet e mëdha të shqiptarëve sipas dy arealëve dialektore kryesore gegëria dhe Toskëria.

Autori sjell edhe shumë studime dhe përpjekje për të paraqitur laramanin dhe veçoritë e formimit të emrave vetjakë, duke i studiuar emrat e vjetër vendas, emrat fetarë, historik etj. Një dukuri me interes për etnolinguistikën shqiptare përbën edhe sinonimia e emrave familjarë e faretfisnorë të përfutur nga trysnia shoqërore e kulturore. P.sh. për fjalën vjehërr, vjehrra, ndesh edhe sinonime tjera, si *nana e nuses, krushka (nga familja e djalit), nana e mirë (nga dhëndëri) etj.* Emërtimet e faretfisnisë dhe përgjithësisht të marrëdhënieve familjare, Shkurtaç i ka shqyrtuar gjerësisht si dukuri mjaft të rëndësishme shoqërore e etnokulturore.

Në përgjithësi në studimet e shumta etnolinguistike të prof. Gjovalin Shkurtaç, janë gërshetuar tema të ndryshme në raportin gjuhë, kulturë etnos që prekin periudha të ndryshme kohore, me të cilat karakterizohen rrymat e ndryshme në metodologji të punës, si me: historinë, me gjeografinë, me sociologjinë dhe gjuhësinë e përgjithshme apo linguistikën etj.

Nexhip Mërkuri : **etnolinguistika dhe leksikologjia**

Autori Nexhip Mërkuri ofron një studim të hollësishëm dhe të plotë i leksikut të bimësisë titulluar “*Kërkime etnolinguistike mbi emërtimet e bimësisë, zona e Dëshnicës Përmet*”. Ky studim që është me mjaft interes për gjuhësinë shqiptare dhe disiplinën e etnolinguistikës ngërthen një varg problemesh me interes të madh leksikologjik. Me mjaft sukses në këtë studim paraqitet sociolekti i kësaj zone që ndërtohet mbi bazën e një tipari kryesor kuptimor, që ka të bëjë me një pjesë të rrënjës, kërcellit, fletës, lules, frutit të bimës etj. Për të komunikuar sa më qartë e saktë, krijuesit anonim kanë përdorur emërtime të ndërtuara mbi bazën e dy tipareve që bien në sy (*thanë e kuqe me aromë, rrush serambel me supa*). Autori në materialin e mbledhur me leksikë të bimësisë dallon edhe motivimin semantiko-fjalëformues që haset në emërtime të prejardhura. Ai zgjedh emërtime si *mollçinë, kordele, thaniçkë*, si shënues i një bime tjetër e të ndryshme nga *mollë, hudhër, thanë*. Për të plotësuar nevojat e gjuhës në tërësi e për emërtimet e bimësisë ka shërbyer çdo tipar i veçantë tek bima, p.sh. sipas tipareve të ndryshme që kanë kërcelli, gjethet, lulet, frutat; pastaj sipas ngjyrës (*lule e verdhëe fushës, kumbull e verdhë kokërrmadhe*); disa nga emërtimet kanë zhvilluar një kuptim të figurshëm, ose me vlerë mbiemërore, p.sh. plep – 1.dru, 2. Fig. Që ka trup të drejtë e të gjatë.

Emërtimet e rralla që përdoren vetëm në këtë zonë, si *motrume, bar i mërzitur, ponik i gjatë, fendose, konjar, dokshor fik zorrëzgjatur, rrush farrëpak, rrush serampel me supa etj.* Në punim shqyrtohen edhe njësitë frazeologjike në të cilët si pjesëmarrëse janë edhe emërtimet e bimësisë, p.sh. *mbjell grurë e i djel egjër* për “del keq”, *veshur si kallëp misri* etj. Të gjithë këta, janë një pasuri me vlerë të rrallë për leksikun e gjuhës shqipe, që do ishin pasurim për fjalorë të ndryshëm, deri ai tek ai terminologjik.

3. Përfundime

Hulumtimet etnolinguistike, edhe më tutje janë të pjesshme. Etnolinguistika shqiptare nuk arriti të paraqitet si disiplinë që sot e do kohë dhe të arrijë t'i mbulojë gjerë e gjatë problemet gjuhësore që ka shqipja. Në institucionet tona diçka po botohet, por vështirë të gjejë vend pohimi se kjo disiplinë e ka kaluar pragun e rëndë të shqipes, pjesa më e madhe e tyre është para nesh. Me metodologjinë e saj të studimit sinkronik *shkak-pasojë*, hulumtimet e ardhshme duhet të fokusohen që me sukses t'u paraprijë proceseve e dukurive gjuhësore në vijim. Gjithsesi kjo parashtron nevojën për t'u njohur me hulumtimet më të reja nga fusha e etnolinguistikës në suaza botërore, dhe të shërbehemi me përvojën duke i vërejtur anët pozitive dhe negative të hulumtimeve të tilla.

Duhet të fillohet me hartimin e bibliografisë etnolinguistika shqiptare, si për nevojat tona ashtu edhe për bibliografinë ndërkombëtare. Gjithsesi do të hasen shumë vështirësi lidhur me natyrën e përmbajtjes, duke ditur se etnolinguistika në gjirin e vet përfshin shumë fusha heterogjene dhe difuze. Vallë do të përfshihen vetëm ato punime me përmbajtje të pastër etnolinguistika, apo edhe ato punime ku përmenden disa komponentë të tilla, duhet të merren njerëz profesional dhe institucione përkatëse.

Fillimi i vërtetë i etnolinguistikës shqiptare, në kuptimin e shkruar do të bëhet atëherë kur do të merren aktivitete linguistike, të mbahen konferencat shkencore nga fusha e

KUMTESA

etnolinguistikës, kur do fillojnë të paraqiten përmbledhjet e punimeve, monografitë, veprat sintetike, të botohen revistat dedikuar posaçërisht problematikës etnolinguistike etj.

Recenzentë :
Prof.dr. Hamit Xhaferi
Prof.dr. Vebi Bexheti

Prof. dr. Hamit XHAFERI¹: ÇËSHTJA E IDENTITETIT NË POEZINË E SOTME SHQIPE

¹Universiteti i Evropës
Juglindore – Tetovë, MAQEDONI
Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit
Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe

Letërsia bashkëkohore shqipe në kuadër të saj edhe poezia, që krijohet në Shqipëri, në Kosovë, tek shqiptarët në Maqedoni dhe Mal të Zi, ndër arbëreshët e Italisë dhe gjithandej në Diasporë, gjeografikisht është krijuar në mënyrë të veçantë dhe e shkëputur nga trangu letrar. Këtë shkëputje apo copëzim në të shkuarën jo aq të afërme e thelloi edhe më shumë ideologjizmi i fuqizuar në dy krahët e rëndësishëm, në Shqipëri dhe në trojet etnike shqiptare në ish Jugosllavi, duke e shtrënguar këtë letërsi të njëjtë komb dhe trung gjuhësor të shkruhet dhe krijohet në dy trajta të ndryshme stilistike, teorike dhe gjuhësore. Kur dihet mirëfilli se shumë kohë më parë, në veprat poetike të De Radës, të Asdrenit, të Mjedës dhe Nolit ka qenë i pranishëm një ekstrakt i tillë gjuhësor stilistik modern, kur gjithashtu edhe poezia e Lasgusht është një poezi e mirëfilltë dhe moderne. Ndonëse, për mua letërsia bashkëkohore nismën e saj e ka që nga viti 1912 e këtej. Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, letërsia shqipe do të rigjallërohet me anë të një nisme të re letrare që do të zgjasë deri në vitet e gjashtëdhjeta, kur në të vërtetë pa zhurmë dhe qetë nisin të esëllohen tiparet përmbajtësore letrare shqiptare, me shqetësime të mëdha, duke e duruar cenzurën e egër të monizmit.

Studimi i poezisë shqiptare nëpër kohë dhe veprimtaria poetike në përgjithësi, ka për bazë lulishten e muzës së poezisë, disa nga lulet më të bukura, sa të larmishme në ngjyresa dhe aroma, aq edhe shëmbëllyese në rrënjën që e kanë ushqyer: vetëdijen e brendshme poetike, kënaqësinë, shqetësimin, përzemërsinë dhe pezmin. Fati i disa poetëve tanë ka qenë zëmadv në historinë e letërsisë shqipe. Kritikët dhe studiuesit shqiptar u kanë kushtuar vëmendje të veçantë autorëve me vlera të mirëfillta letrare, sidomos disa prej poetve tanë disident dhe të anatemuar, të cilët gjatë kohëve në veprimtarinë e tyre kanë kaluar pazhurmë. Këta poetë brenda këtij njëqindvjetori përmes poezive kanë qëmduar si bleta me lule, vargje të bukura për të pasuruar sado pak vizionin e thesarit poetik të krijuar në kohë, duke kënduar me vetëdije e zë të ëmbël, ngadonjëherë me tone shpërthyes. Në këtë kumtesë përfaqësohen disa nga poetët me kuptimin e tyre më të gjerë, që janë shquar me traditën e pasur poetike. Një vend të rëndësishëm zë poezia e tyre, e cila lulëzimin më të theksuar e ka shënuar brenda periudhës njëqindvjeçare të formimit të shtetit shqiptar. Prej mjaft poezive të vëna në tryezë, kanë dalë vetiu në sipërfaqe ato që këndojnë me një tingëllim të sinqertë e prekëse vetëdijen e dyfishtë të shpresës e të zhgënjimit. Ideja fataliste mbi brishtësinë e asaj që është ngazëlllyese, e bukur, e pafajshme, është derdhur në vargje me një thjeshtësi sugjestive dhe me lirizëm të hollë. Në këto poezi janë dëgjuar e kënduar notat e dhembjes, trishtimit, që jehojnë herë me zë të dobët e të mekur, aty-këtu të thekshme si një kabanë që shoqëron në një procesion të gjatë ëndrrash dhe shpresash ngazëlllyese. Në këtë drejtim një mori poetësh bashkëkohorë krijojnë vëllime të ndryshme poetike, që e ndjekin metodologjinë krijuese e

cila nuk ka të bëjë me modernitetin. Gjatë krijimtarisë së tyre do të ndiqet parimi krijues i realizmit, bile ai i realizmit socialist. Në poezinë bashkëkohore shqipe është krejt e zakonshme të thuhet se nisma e mirëfilltë të jetë në vitet shtatëdhjeta, kur fillon procesi i kulmimit të vlerave artistike letrare të nisura më herët që nga Lufta e Dytë Botërore e më pas, ku paraqitet me një ngjyrim gjuhësor me pohime paraprake të brendshme, kur lirika moderne është më e hapur, ndërsa lidhja e poetit me lexuesin është më e lehtë. Fuqia e fjalës së bukur artistike është ngjyrosur me domethëniet dhe kuptimet e ndryshme. Këto janë poezi që, tek lexuesi zgjojnë prirje të logjikës dhe vetëdijes, që janë të fshehura diku thellë në qenien e tij. Pra, janë poezi të çliuara nga fjalët dhe shprehjet shungulluese. Në antologjitë e poezisë sonë shpesh gjejmë tablo poetike që fillon me hënën, yjet, burimet, lulet, fluturat, fërfëllëzën, dëborën, mallin për fshatin, për tymin e oxhakut... Të gjitha këto krijojnë sfondin poetik persiatës, ku lëviz vrtëdija e nostalgjisë dhe dashurisë...Këto poezi dallohen me notat filozofike, didaktike, që janë karakteristikë themelore e urtësisë sonë popullore. Në to zë vend të veçantë dashuria, nostalgjia, kurbeti, largimi, fërfëllima e një humori mendjehollë për të dalë nga situatat e vështira sentimentale. Të gjitha këto derdhen në vargje me një lirizëm të mptehtë, njësoj si me bukurinë e legjendës së bujshme shqiptare.

Marrë në përgjithësi tek disa poetë në Kosovë, poezia tematikisht është retrospektivë e qeniesimit të etnikumit shqiptar në këtë truall, duke u orvatur të ndriçojë lidhjen ndërmjet kuptimit të emrit dhe identitetit, duke e pozicionuar këtë marrëdhënie në fushëveprimin e letërisë bashkëkohore. Poezia mbështetet në konceptin esencial, në kuptimin e rëndësishëm të identitetit, në stabilizimin poetik të rrëfimit të shkurtër dhe në ndërtimin e pandërprerë të poezisë si pasqyrim. Nisma e këtij pasqyrimi gjendet në procesin e krijimeve poetike e veçanërisht në „kthimin kah gjuha poetike“. Shtrohet pyetja me cilën gjuhë poetike bëhet i autorizuar poeti shqiptar në krijimet e veta dhe si është bartur roli dhe mëkëmbja e identitetit të tij poetik. Përgjigjja është se vetë titujt poetikë e përflasin këtë të vërtetë, ngaqë modusi i rrëfimit gjuhësor del më i qartë, më i lexueshëm dhe më i shfaqur, gjatë rrjedhës së vetë procesit të krijimit. Konceptioni i gjuhës poetike si veprim dhe efekt është zhvilluar, pavarësisht njëri nga tjetri. Veprat poetike tek disa prej poetëve tanë sillnin një gjuhë tjetërfare, si për shembull te I. Kadare krijues i të gjitha llojeve dhe zhanreve letrare. Poezia e tij sublimon në vete përvojat më të avancuara poetike ku bashkëjetojnë prirja narrative dhe lehtësia e komunikimit me lexuesin, me vizionin intelektual e filozofik të poetit. A. Podrimja poet me një krijimtari të qëndrueshme dhe të përhershme, është përfaqësuesi më tipik i poezisë së sotme shqiptare. Në brendinë e poezisë së tij do të mbarsen, muzat shpirtëruese nga kohërat e mëparshme (epike dhe dramatike) të Kosovës. Kjo poezi bën fjalë për ndjenjën e ngrohtë dhe fisnike që të frymëzon me lirikën dedikuar njeriut kosovar dhe kohërave të trazuara. Ndërsa D. Agolli, është madhështi e pandryshueshme në poezi, njëri prej personaliteteve më dinamike e më kreative, i cili depërton në thellësinë e shpirtit të njeriut shqiptar, në enterierin e vetëdijes. Nuk ka shkruar vetëm poeti vargje, por edhe vargjet e tij e kanë shkruar poetin. A. Shkreli veçohet me kohë si poet popullor, që këndon krenarinë dhe fatin fatkeq të popullit duke ia qarë hallin në fatkeqësinë. Shqetësimet personale të tij bëhen polivalente dhe me vlerë kombëtare. B. Musliu qëndron në kreun e poezisë shqiptare moderne, e dalë në mes të viteve '60. Poezia e tij është hermetike po aq sa është edhe moderne. Tematikisht është retrospektivë e qeniesimit të etnikumit shqiptar në këtë truall. A. Islami një krijues produktiv i poezisë lirike dhe asaj me primesa epike. Është poet i shqetësimeve të mëdha, me vokacion të ndjenjës së thellë të dashurisë ndaj trollit, vendlindjes dhe mllefrit të së keqes. Din Mehmeti dallohet me lirikën e drejtpërdrejtë, me frymëzime, me

një “unë” të krijuesit që di të identifikohet me fatin e njerëzve të thjeshtë. Në rrëfimin lirik të unit të këtij poeti në të shumtën e rasteve do të inkuadrohet një shpirt i dramatizuar poetik. Eqrem Basha e të tjerë, tek të cilat vepra poetike ekziston si një abstrakt gjuhësor stilistik modern (**Letërsia me shembuj për klasën IV të shkollave të mesme, 1996, f. 11**). Në veprat e tyre ndizej një zjarr i brendshëm shpirtëror që për herë të parë fliste shqip me një petk të ri gjuhësor. Ndërsa në letërsinë bashkëkohore të artit modern, ishte M. Camaj ai që i hapi rrugë interpretimit të aktit foljor si mjet krijimtarie të subjektit të identitetit të shfaqur në çështjet etike-poetike letrare. Çështja e interaksionit të pragmatizmit, poezia kah mesi i viteve '60 dhe fillimi i viteve '70, pas krijimit të një klime pak a shumë liberale politike, tek një mori krijuesish që patën defiluar një dekadë më parë, në veprat e tyre poetike sillnin një gjuhë tjetërfare nga ajo që ishim mësuar të lexonim. Në këto vepra ndizej një zjarr i brendshëm shpirtëror që për herë të parë fliste shqip me një petk të ri gjuhësor. Tek këta krijues është bërë e domosdoshme rrjedha frytëdhënëse e procesit poetik, sidomos risia e ngjyrimit gjuhësor me premisa të brendshme stilistike dhe figurative, gjatë së cilës janë vërejtur një numër pikash të përbashkëta në qasjet e këtyre poetëve. Poetët për shembull, fillojnë të marrin fizionominë e çlirimit të shpirtit njerëzor dhe nisin të profilizohen llojet e ndryshme të artit të tyre poetik. Bie fjala në poezinë e B. Musliut, është zhvilluar faza e mendimit të tij poetik, në të cilën bëhet një sintezë në mes reales dhe imagjinare, në të cilën shihet dhe preket ajo që sugjerohet. Ne mendojmë se këta janë problemet gjuhësore dhe filozofike në përgjithësi që kanë ndikuar vetvetiu në çështjen e identitetit në poezinë shqipe në tërësi. Ndërsa në konceptonet e emrave dhe emërtimeve – në të cilat janë përfshirë kategoritë e lojës gjuhësore pa rregulla të forta, sepse këta kanë pasur vetëm rëndësi stabilizimi të përkohshëm – ngaqë janë treguar si themel i deklaruar ose jo, të qasjeve të shumta të teorive bashkëkohore letrare. Këtu fjalën e kemi tek dekonstrukcionet e ndryshme, te teoritë psikoanalitike ose të lindura dhe tek ato politike. Vërejmë se në disa prej krijimeve poetike ndeshim në një mënyrë disa prej teorive të përmendura, kuptohet në mënyrën e tyre specifike, ku është manifestuar problemi i lidhjes reciproke të emrave dhe identiteteve. Duke i hetuar në mënyrë të qartë pikat e përbashkëta gjatë gjithë qasjeve të përmendura, arrijmë në përfundimin se secili identitet poetik është një konstrukt diskurziv, i formësuar në të sotmen përmes gjuhës së stabilizuar e cila e përshkruan gjendjen e subjekteve të forta ose esenciale. Kjo do të thotë se subjektet janë fragmentuar dhe marrin pozicione subjektive plurale, kurse, identiteti kulturor (klasor, gjinor, politik, etnik...) ka qenë kaheerë apo përkohësisht i stabilizuar me „pikën e qepur“ t vargut poetik. Procesi i cili e ka mundësuar këtë përfundim të përkohshëm të rëndësisë së krijimtarisë poetike, duke qenë i lidhur me relacionet e forcës poetike-letrare dhe politikës kulturele. Kjo forcë kaheerë nuk ka qenë stabile ose statike, sepse çdoherë kanë dalë në rrafshet e ndryshme të përditshmërisë, poetë të rinj dhe produktiv të cilët me poezitë e tyre kanë ndikuar në krijimin e subjektit të identitetit. Vetë „forca e emërtimeve“, krijimit të subjektit ose përjashtimeve, i ka takuar bindjes politike, ndërsa mungesa e fuqisë krijuese është arsyetuar me „emërtimin“ e subjektit. Identiteti i poetit dhe poezisë së tij në shoqërinë shqiptare ka funksionuar në atë masë ashtu siç kanë funksionuar lojërat gjuhësore. Këtu nuk e kemi fjalën për të kritikuar ashpër pozitën ku ndodhemi sot, por për të interpretuar dhe për të argumentuar kompleksitetin e procesit tonë letrar gjatë një faze kur liria e individit ishte edhe më e paktë, ashtu si liria prej gaforreje të cilën e përmend Migjeni te poezia “Të lindet njeriu” (Migjeni, Vepra, Shtëpia Botuese N. Frashëri, 1989, f. 87).

Mendoj se individualitet e tilla letrare që prijnë me krijimet epiko-lirike me temën e atdheut, si Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Bilal Xhaferi, Fatos Arapi e tjerë, në kapërcyellin brenda një shekulli të shtetit shqiptar, kanë treguar kujdes të veçantë edhe ndaj formave të vjershërimit. Atdheu për këta është vetë: dhimbje dhe – varr! (Arapi F., Atdheu..., Në, pikëllimi i dritave, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1993, f. 76). Ndërsa një vistër emrash të poetëve dhe krijuesve të tjerë, siç janë: Adem Isrefi, Vebi Skenderi, Vath Koreshi, Xhevahir Spahiu, Bardhyl Londo, Mimoza Ahmeti dhe Visar Zhiti, lista e të cilëve Adriatik Kallullit sërish i duket e mangët, ky i fundit do të thotë se: përbëjnë kuota të qëndrueshme, sepse me veprat e tyre më të mira e realizojnë vetveten si krijues dhe e dëshmojnë letërsinë si tutje – tëhu atdheut, por edhe pasaportën dhe visat për të dalë jashtë kufijve, edhe në mjediset ballkanike, edhe në qendrat e metropoleve evropiane. Është një argument i fortë në mbrojtje të veprës së tyre që vëllezërit kosovarë dhe shqiptarët që jetojnë në trojet e veta në Maqedoni, Mal të Zi e gjetiu, madje edhe ata të diasporës, shkrimtarët që u përmendën dhe të tjerë, i kanë bërë të tyre me kohë, i kanë ndjekur në antologji dhe vepra të zgjedhura, u kanë kushtuar studime edhe monografi me analiza dhe interpretime që i qëndrojnë kohës (Kallulli A., Letërsia kalimtare dhe krijimtaria e qëndrueshme, f. 87). Tek e fundit, siç shprehet një poet dhe filozof njëherësh, Lasgushi ynë që s'e kuptuam dhe as e përkrahëm kur duhej: "... Të përmbysim vetëdijen kur na fton burim i jetës?! ... Të mendojmë kaq errët mu në mes të së vërtetës?!... Ta mjerojmë kuvendimin me kaq helm e kaq prishimë", s'kemi bërë gjë tjetër veçse kemi mjeruar veten tonë, kuvendin tonë, por letërsia është aty, e dëshmuar, e dokumentuar dhe e pohon vetveten kurdo që të jetë si e tillë (Kallulli A., Letërsia kalimtare dhe krijimtaria e qëndrueshme, f. 88). Kështu në disa raste Mjeda, por më shpesh Asdreni dhe Hilë Mosi, vazhdojnë të shfaqin preokupimin e atdhetarëve të mirë për vendlindjen, për politikën, larinë dhe identitetin (Dibra M., Soneti në letërsinë shqipe të viteve '30, f. 198).

R e z y m e

Çështja e identitetit në poezinë e sotme shqipe

Në poezinë bashkëkohore shqipe lirika e sotme është e hapur, ndërsa komunikimi i poetit me lexuesin kërkon një analizë më të thellë dhe interpretim specifik. Fuqia e fjalës së bukur e kesaj poezie ngjyroset me domethëniet dhe kuptimet e ndryshme figurative. Te disa poetë në Kosovë, poezia për nga tematika është retrospektivë e qenësimit të etnikumit shqiptar në rrethana të caktuara historike, me synimin për të ndriçuar lidhjen e identitetit me fushëveprimin e poezisë bashkëkohore. Kjo poezi mbështetet në konceptin esencial të kuptimit poetik aq të rëndësishëm për identitetin e një kombi. Nisma e këtij përqasimi gjendet në procesin e këtyre krijimeve dhe në „kthimin kah gjuha poetike“. Vetë titujt poetikë e përflasin këtë të vërtetë, ngaqë mënyra e ligjërimit gjuhësor del më i qartë, më i lexueshëm dhe më i shfaqur, gjatë rrjedhës së procesit të krijimit. Koncepti i gjuhës poetike si veprim dhe efekt është zhvilluar pavarësisht nga njëri tjetri, gjë që konstatohet edhe në veprat e disa poetëve, siç janë ato të: Kadaresë, Podrimjes, Agollit, Shkrelit, Musliut dhe të ndonjë tjetri, tek të cilët vërehet një fond i pasur gjuhësor, stilistik e modern.

Fjalë kyçe: identiteti, diskursi, kthimi ndaj gjuhës, loja gjuhësore, performanca, etika, politika, dekonstrukcioni, kritika psikoanalitike.

Recenzentë:
Dr. Akad. Ali Aliu
Prof. dr. Vebi Bexhet

Dr. Ismet OSMANI¹: SEMANTIKA E SHPREHJEVE FRAZELOGJIKE NË SHQIP DHE NË MAQEDONISHT

¹Fakulteti i filologjisë në Shkup
Katedra e gjuhës dhe letërsisë shqiptare - Shkup

ABSTRAKT

Gjuha si mënyrë e të shprehurit të realitetit i pasqyron gjërat që i ka emërtuar: natyrën, njeriun, jetën traditat, institucionet, teknikat si dhe mënyrat përmes të cilave percepton botën dhe njerëzit tjerë. Gjuha gjithsesi është 'pasqyra e një populli', ajo është prodhim i historisë dhe shprehje e një mjedisi dhe përvoja nga e cila rrjedh edhe vet ajo. Njeriu lind, jeton, vdes, hapëron, ha, pi, jep mendimin e vetë për ndonjë çështje; jeton në fshat ose në qytet, jeton në shtëpi me familjen, ose me miq, me kanakarë në shtëpi etj. Ky realitet pasqyrohet në fjalët të cilat janë shprehje e saj. Po ky realitet paraqet burim, mënyra të shprehjes të cilën kanë karakter objektiv ose subjektiv.

Frazeologjizmat në shqip dhe në maqedonisht për nga vëllimi dhe për nga vlerat e shumëfishta, përbëjnë një thesar të çmuar në kulturat kombëtare përkatëse. Në komunikimin e përditshëm frazeologjia dhe shprehjet popullore janë pjesë e pandashme e të shprehurit. Kontakti i përditshëm i frazeologjisë së gjuhës shqipe me atë maqedonase shërbeu si një nga shtysat që të ndalemi te kjo pasuri dhe ta sjellim në një rrafsh përfshirës, sepse kjo pasuri lidhet historikisht me shqipen dhe argumenton se shqipja qysh herët ka qenë gjuhë figurative dhe me mundësi shumë të mëdha jo vetëm emërtuese, por edhe shprehëse.

Marrëdhëniet semantike midis shprehjeve frazeologjike shprehen përmes **polisemisë, homonimisë, sinonimisë** dhe **antonimisë**.

*Polisemia, sinonimia dhe antonimia janë tipat themelor semantik të leksemave. Sipas D. Gortan-Premk(1997), këto bien në mekanizmat themelor, të cilët marrin pjesë në ndërtimin e sistemit leksikor. Për gjuhëtarët polisemia paraqet problem teorik në dallimin e polisemisë nga homonimia. D. Kristal vë në dukje *kriterin etimologjik*, me të cilin supozohet se homonimet janë krijuar nga fjalë të ndryshme formale. Rolin kryesor në zhvillimin e polisemisë së frazemave e ka aftësia e tyre në planin semantik dhe strukturor. Kështu, shembuj të tillë të frazeologjizmave ka edhe në FGJSH dhe në FGJM: **Ma mor kafshatën e gojës / му го зеде залаком од уста; ndan nga ushqimi / су делу од устата; gojë ka e gjuhë nuk ka** (është i qetë dhe fjalëpakë) / **уста има јазик нема**.*

Homonimia ngërthen në vete shprehjet frazeologjike të cilat janë identike për nga forma, por dallojnë në bazë të vlerës së tyre leksikore, prandaj ne duhet t'i kualifikojmë jo si forma të një frazeme, por si njësi të veçanta.

Sinonimia është një lloj relacioni semantik midis leksemave, të cilat pjesërisht ose plotësisht përputhen sipas rëndësisë. Në rrafshin formal ato nuk kanë pika të përbashkëta, por janë të ngjashme për nga kuptimi. Në planin funksional, sinonimet njësi frazeologjike shprehin aftësi për t'u zëvendësuar me shprehje tjetër. Sinonimet ndërgjuhësore janë të llojeve të ndryshme. Për shembull, njësia frazeologjike *Bën lojën struci* (dikush tenton të fshihet ose të shpëtojë nga ndonjë rrezik, duke u munduar më kot, ose duke menduar se po ia arrin qëllimit, ndërsa në maqedonisht themi *нојева работа / punë struci; dy atllarë në një hu nuk lidhen / два камена луги не мелат брашно; kam një (gurë në zemër) brengë të madhe / камен ми лежи на срце; për kohë të vështira / за зор заман*. Sipas strukturës, mund të përbëhen nga fjalë të njëjta (për shembull, nga mbiemri dhe emri, që po qe se përkthehen ndërrojnë vendet: në shqip vjen emri përpara, ndërsa në maqedonisht mbiemri, pastaj emri: rosë e egër / ; dokërr, trillim, gjerpur / новинарска патка.

Antonimet në të shumtën e rasteve paraqiten te frazemat foljore. Njësi frazeologjike të tilla janë: *Theu qafën / shpëtoi kokën / зуби глава – спасу глава; Është i fjalës – nuk është i fjalës / Го газу зборот – не го газу зборот; Pa ditën e bardhë – s'pa ditë të bardhë / Виде бел ден - не виде бел ден*.

Frazeologjizmat librore

Këto frazeologjizma paraqiten në formën e shkruar, përkatësisht i takojnë gjuhës së shkruar. Këto frazeologjizma dallojnë nga shprehjet tjera frazeologjike, ose nga frazeologjia e gjuhës së folur – frazeologjia bisedimore, e cila në të shumtën e rasteve mbështetet në metaforat natyrale, të cilat rrjedhin nga vëzhgimi i veçorive fizike dhe psikike të njeriut, të natyrës etj. Këtë lloj të frazeologjizmave e gjejmë në publicistikë – gazetari, histori në letërsinë artistike etj., dhe karakterizohet me një stil të matur libror.

Përdorimi i gjerë i tyre në jetë shoqërore, politike, kulturore, sportive dhe në tekstet tjera, të prezantuara në mjetet e informimit (të shtypit, dhe atyre elektronike – radios dhe televizionit), manifestohet në gjuhën e shkruar dhe në gjuhën e folur. Shprehjet e tilla frazeologjike i ndihmojnë autorit të ndonjë lajmi që sa më shpejt t'ia kumtojë dëgjuesit ose lexuesit. Të tilla janë: klima politike/политичка клима, и dorëzuan armët - го положија оружјето; *forcat e armatosura* - вооружени сили, *игра на судбината* etj.

Ndërkaq, frazeologjitë librore në gjuhën e letërsisë artistike paraqiten në formë më të zgjeruar se ajo standarde. Me përdorimin e figurave të ndryshme, siç janë metafora, krahasimi, rima etj., shkrimtari, kryesisht, në formën e dialogut shfrytëzon frazeologjizma dielaktor, zhargone dhe bisedore. Disa autorë vetë krijojnë: *Овде е јака авата, ама ни е слаба тавата*. Karakteri i tyre vërehet edhe midis gjuhëve të largëta gjenetiksht dhe gjeografiksht, siç janë, bie fjala shqipja dhe maqedonishtja, midis të cilave ka shumë paralele. Ato dëshmojnë për ndikim të faktorëve të njëjtë mbi modelet kulturore kombëtare.

Ndërkaq, nganjëherë midis frazeologjizmave shqipe dhe maqedonishte vërehen dallime, të cilat nuk zbatohen mbi ndryshimet sistemore. P. sh. shpeshherë togjeve shqipe

me strukturë emër + emër u korrespondojnë ndërtimet maqedonase mbiemër + emër, p.sh. *kali i Trojës / тројански коњ*.

Përputhja jo e plotë në përbërjen leksikore ka një interes të veçantë, sepse tregon karakteristika individuale kombëtare në suazën e frazeologjisë së përbashkët. Në hulumtime më të gjera kjo dukuri mund të ndihmojë të zbulohet burimi i ndikimit të huaj. Frazeologjizmat e mëposhtme, megjithëse kanë komponentë të ndryshme, padyshim janë ekuivalente: ***mollë e ndaluar*** – забрането јаблоко (fryt i ndaluar).

Megjithatë, një ndër kriteret themelore për të vlerësuar dy frazeologjizma si ekuivalente është përputhja semantike. Nëse ajo nuk zbatohet kemi të bëjmë vetëm me ekuivalencën e pjesshme. Kështu, për shembull, në FGJSSH lexoj midis rreshtave –mund të konstatohet diçka që është shkruar, ose kupton mendimet e fshehta për diçka që është shkruar, kurse ekuivalenti në maqedonisht ka të njëjtin kuptim читам меѓу редовите.

Nëse flasim për ndryshime në sferën e përdorimit, vlen të analizojmë togfjalëshin *tryezë e rrumbullakët*, i cili sipas FGJSSH ka dy kuptime: mbledhje ku marrin pjesë përfaqësues të palëve të ndryshme për të trajtuar ndonjë temë; 2. diskutim që organizohet zakonisht për të rrahur ndonjë temë nga një grup i caktuar. Edhe në gjuhën maqedonase kemi këtë shprehje *тркалезна маса, работна маса, зелена маса*. E para mund të përdoret për ndonjë temë politike, e dyta mund të përdoret në forma të, për punë dhe për ndonjë debat të zhvilluar, qoftë shkencor apo politik.

Shprehjet frazeologjike somatike në shqip dhe maqedonisht

Komponentë përbërëse e një numri të madh të shprehjeve frazeologjike janë pikërisht emërtimet e trupit të njeriut. Shprehjet e tilla quhen somatike ose somatizëm. Shprehjet frazeologjike somatike janë shprehje me domethënie të ndryshme, të cilat emërtojnë të ndonjë pjesë të trupit të njeriut. F. Çermak (1996), përveç termit somatik, paralelisht përdor edhe termin antropomorfe. Ky term është marrë nga filozofia dhe paraqet pikëpamjet, sipas të cilave objektet, dukuritë natyrore posedojnë karakteristika të njeriut.

Tema e frazeologjizmave somatik është e vjetër dhe është vështirë të gjendet gjuhë që nuk ka shprehje të tilla. Prandaj këto mund të konsiderohen edhe si pjesë më universale të gjuhës. Sipas R. Vajntraub (1975) frazeologjia somatike paraqet një shtresë prej 30% të përbërjes frazeologjike të çdo gjuhe. Trupi i njeriut është i njëjtë për të gjithë, prandaj pjesët e tij lënë shumë pak hapësirë për ndryshime gjuhësore. Megjithatë, Jelmslevi vë në dukje se një gjë fizike mund të pranojë përshkrime shumë të ndryshme semantike, varësisht nga civilizimi i dhënë.

Si komponentë përbërëse SHF, emërtimet e pjesëve të trupit të njeriut shfrytëzohen përmes funksionit dhe simbolikës së tyre: p.sh. hunda është shqisë për aromën, por me të, gjithashtu mund të vërehet edhe ndonjë rrezik etj., zemra është pjesë kryesore e trupit të njeriut, e cila mund të shihet edhe si simbol por edhe me ndjenjë domethënie më të gjerë: qendër e dashurisë, guximit, zemërgjërësisë etj. Kështu, emri ***kokë*** mund të paraqitet me shumë domethënie metaforike, si p.sh. jetë: ***peshku qelbet në kokë / рубама смрду од главата***; në situata kur vihemi para ndonjë rreziku për jetë shprehjet më të përdorura frazeologjike janë: ***mos luaj me kokën tënde / не узрај со со главата; e fut kokën në torbë (e vë jetën në rrezik) / ја става главата в торба***; inteligjencë, por edhe domethënie tjera të tipit: etj. Për të shtuar edhe diçka për karakteristikën e frazeologjisë vlen të përmendet, se midis frazeologjizmave të analizuara shqipe vetëm tri njësi kanë si gjymtyrë emërtime të

pjesës së trupit të njeriut – *thembra e Akilit (ахилова нетица), pjesa e pasme e këmbës; nga koka gjer në këmbë / од глава до нетицу; i shkoi (i ra) zemra te thembra / му слезе срцето во нетицу*. Ajo që bie në sy është përdorimi më shumë ose më pak i njësive frazeologjike lidhur me trupin njeriut. Lidhur me të F. Çermak (1996) vë në dukje faktorin rastësisë. Është e pamundshme të shpjegohet se, pse një pjesë e trupit të njeriut paraqitet në shumë shprehje frazeologjike.

Përveç karakteristikave themelore dhe universale të njësive frazeologjike (në kuptimin figurativ të fjalës), mund t'u shtohet edhe një karakteristikë tjetër, ajo e gjestit. Në literaturë, gjesti definohet si shoqërues i situatës së komunikimit ose mjet i posaçëm komunikimi, përkatësisht shenjë e posaçme. Në komunikimin me gojë, gjesti vetvetiu e shpreh, përkatësisht e bart mesazhin. Frazeologjizma të tipit të tillë janë: i ka ardhur në majë të hundës (*nuk mund të durojë më*) / дојдено му е неку глава; s'e di ku e ka kokën (*ka shumë punë*) / не знае кај му е главата.

Përfundime:

Më shumë se gjysma e frazeologjizmave librorë shqipe kanë një ekuivalencë tekstuale me maqedonishten, për dallim nga ato të ligjërimit bisedor që nuk kanë ndonjë përrudhje të madhe. Komponentë përbërëse e një numri të madh të shprehjeve frazeologjike janë pikërisht emërtimet e trupit të njeriut, përkatësisht somatike ose somatizëm. Tema e frazeologjizmave somatik është e vjetër dhe është vështirë të gjendet gjuhë që nuk ka shprehje të tilla. Prandaj këto mund të konsiderohen edhe si pjesë më universale të gjuhës.

RECENZENTË:
Prof. Dr. Asllan Hamiti
Prof. Dr. Avzi Mustafa

Prof.dr Vebi BEXHETI¹: ARBËRESHËT NË POEZINË E MARTIN CAMAJT¹UEJL, Tetovë (15.05.201)

Krijimtaria poetike e Martin Camajt që erdhi vonë tek lexuesi shqiptar, i takon një shtrirjeje të gjatë kohore. Fati i poetit që herët mbeti pa atdhe, ishte njëherit edhe fati i veprës letrare të tij. Historia e letërsisë shqiptare, atje ku frymonte më lirshëm, me kohë e kishte identifikuar taborin e shkrimtarëve desidentë, por e drejta për të folur realisht për veprat e tyre që mbeten gjatë kohë në ekzil politik, bashkë me krijuesit e vet, u përlij pas viteve të 90-ta, kur u hapën dyert e hekurta dhe këto vepra letrare u kthyen aty ku edhe e kishin vendin.

Martin Camaj, ky zë që vinte nga larg, shpeshherë ishte temë diskutimi mes gjeneratash, atyre që e kishin njohur si poet dhe intelektual të madh dhe atyre, të cilëve ky emër u silllej vërdallë si fantazmë. Lidhja e tij me atdheun u shkëput shumë herët, për të vazhduar në atdheun e dytë, Kosovën e robëruar, ku edhe e filloi rrugën krijuese e letrare për t'i dhënë lexuesit shqiptar të kësaj ane veprat e para, dy përmbledhjet poetike *Një fyell ndër male* dhe *Kanga e vërrinit*, që për kohën kur u botuan ishin dhurata më e çmueshme dhe e hapën rrugën e poezisë shqipe në Kosovë, të trasuar më parë nga Esad Mekuli.

Rruga jetësore e këtij shtegtari do të jetë e pandarë, nga ajo krijuese që karakterizohet me tri fazat poetike e që në vazhdimësi e ruajtën karakterin autokton të poezisë shqipe, të lidhur aq fuqishëm me truallin që e lindi, me jetën e njeriut shqiptar, me gëzimet dhe me vuajtjet e tij. Kjo poezi në asnjë moment nuk u bë e huaj për shqiptarin, as edhe në fazën e hermetizmit të saj, siç është bërë traditë të thuhej, ajo i kishte rrënjët në truallin që frymonte shqip dhe vazhdimisht lulëzonte dhe rritej për tu ngjitur në majat e artit të madh evropian. Vargu poetik i Camajt, edhe pse në faza të ndryshme dhe në mjedise me përvojë të gjatë në krijimtarinë letrare, evoluoi vazhdimisht duke fituar shtresime të reja kuptimore që buronin po nga e njëjta gjuhë me të cilën i kishte shkruar edhe veprat e para, ajo mbeti e pa lëkundur në misionin që kishte dhe njëkohësisht tërheqëse edhe për lexuesin e huaj.

Për veprën e Camajt kohëve të fundit është shkruar e shkruhet vazhdimisht sepse ajo ka nevojë për mendimin kritik shqiptar që i kishte munguar asaj për vite me radhë. Edhe ky poet si shumë të tjerë, nuk e la jashtë vargut të tij krijues as pjesën arbëreshe të trungut tonë të përbashkët. Ndoshta qëndrimi i tij në Itali si student në Romë, e më vonë edhe si studiues dhe afëria që pati me këtë pjesë të ndarë në rrethana krejt tjera historike nga ndarjet në hapësirat tjera shqiptare, e lidhi me jetën arbëreshe, me dinjitetin e tyre dhe krenarinë për ruajtjen e gjuhës dhe traditave tjera kombëtare e kulturore. Elementi arbëresh është i pranishëm në disa nga poezitë e Martin Camajt. Personalitetet si De Rada apo arbëreshët në përgjithësi, shpeshherë u bënë frymëzim për poezinë e sotme shqipe, ashtu si edhe poezia e arbëreshëve dhe autorët e tyre që merreshin me evokimin e kohërave të lavdisë kombëtare,

sidomos të kohës të *Motit të madh*, për vet identifikim kombëtar, ndërsa sot për afërinë e tyre me pjesën e këndeje detit, si çmallje e njëri tjetrit që i takonin një gjuhe e një gjaku.

Poezitë kushtuar jetës arbëreshe, sipas përmbledhjeve të botuara poetike, i takojnë fazës së dytë të krijimtarisë, kohës kur në këtë poezi vërejmë një kombinim të poetikës realiste me ate hermetike-moderniste. (Ymer Ciraku: f.37).Kësaj faze i takon edhe përmbledhja *Njeriu me vete dhe me tjerët*, në kuadër të së cilës përfshihen edhe poezitë: *Veshja arbëreshe* dhe *Pranvera në katundin arbresh*. Përmes kuptimit të thellë të fjalës dhe formës, tanimë të përsosur, që bashkë me mesazhin që nuk zbulohet lehtë dhe me metaforat shumëdimensionale që reflektojnë disa shtresime kuptimore, poeti e ndërtoi këtë poezi, që nga të tjerat e kësaj faze dallojnë për nga tema që e trajtojnë, por jo edhe nga thellësia kuptimore dhe gjuha që e përdor, kjo gjuhë e vetmjaftueshme dhe e zonja për të krijuar edhe poezi të përmasës së evropiane. Studiuesi Mateo Mandala konstaton se gjuha poetike e Camajt është njëkohësisht mjet dhe objekt i aktivitetit të tij të përditshëm, që do të thotë se ai brenda gjuhës së zakonshme e zbulon atë që kësaj poezie i jep domethënie më të thellë me shtresime shumëdimensionale e kuptimore.

Poezia *Veshja arbëreshe*, jo rastësisht e mban këtë titull. Si element identifikimi kombëtar, përveç gjuhës dhe vlerave tjera si pjesë e trashëgimisë kulturore, veshja arbëreshe, e veçmas ajo e grave që mbeti ashtu e gjallë edhe sot e që në vete bartë pjesë të historisë arbëreshe dhe identifikuese për poetin, si duket është e rrezikuar dhe e ka të vështirë t'i përballojë ndikimit të globalizmit të kohës, që në masë të madhe e rrezikon etnokulturën e popujve më të vegjël. Kjo vjershë përbëhet nga katër strofa dhe asnjëra nga ato nuk ka numër të njëjtë vargësh. Në strofën e parë që është ndërtuar me gjuhën e lirikës moderne por jo edhe aq të errët si gjuha poetike e fazës së tretë, ku lirika e poetit flet shpesh për ngjarjen, shkakun por që kohën e të cilave nuk thuhet asgjë (L. Topciu:(po aty f.79). Poeti duke i njohur këto vlera të mëdha dhe me karakter etnografik, siç është veshja tradicionale, me kohë kishte konstatuar, se kjo veshje që ruhet nëpër arka e që ishte bërë dikur nga vektaret duar-holla, është gjysmë e vdekur. Dasma e dikurshme arbëreshe kishte kuptim vetëm me këto veshje, konstaton poeti, sepse vetëm atëherë kjo veshje do ta kishte vlerën e mirëfilltë. Në kohën kur shkruhen këto vargje, pothuajse nuk jetojnë ato vektare. Zemra e nuses së dikurshme tanimë ngrihet në pikturë, petku i saj qëndron ashtu i grisur nga një dorëzi, natën e karnevalit. Shpresa se kjo vlerë material që bashkë me ato shpirtërore, siç janë edhe këngët arbëreshe do të mbijetojnë, është gjithmonë e gjallë. Stërnipja që erdhi nga larg i veshi teshat e gjyshes dhe që e luajti vallen te sheshi, tregon karakterin solemn në raste të rralla sepse, shprehet poeti: *N'ora dhetë veshja arbreshe / u zhgreh e ra para kambëve më të bukura / se t'gjyshes nuse pikturë / e kthye ndër arka keza e coha palë palë linja – erëmirë / e ngime me gji ma vashe*. Përmes këtyre vargjeve të strofës së fundit të poezisë, poeti edhe njëherë shpreh me keqardhje fillimin e fundit të kësaj tradite që e mbajtën gjallë shpirtin arbëresh.

Ashtu si zakonisht, te Camaj, fjala poetike e gdhendur aq mjeshtërisht, edhe në këtë poezi sa vjen e lexuesit i dhuron shpërthime të reja lirike. *Keza*, një lloj lidhëse që mbulon pjesën e mbrame të flokut të nuseve arbëreshe, *Coha*, *fustani* karakteristik që përdoret në një shtrirje të madhe ndër arbëreshët e Kalabrisë dhe Linja, lloj këmishe e bërë nga liri, janë pjesë të veshjes së grave arbëreshe, që për fat të keq duhet të kthehen sërish në arkat e vjetra e ashtu të rrinë të burgosura, duke pritur ndonjë moment të ri ceremonie. Fjalët që e ndërtojnë këtë varg na vijnë me fuqi magjike dhe ashtu lehtas depërtojnë në qenësinë e mesazhit thelbësor të poetit dhe në dëshirën e tij që arbëreshët, ashtu siç i mbijetuan shekujt, të vazhdojnë rezistencën për t'i mundur edhe kërcënimet e kohës më të re. Poezia mbaron

me dy vargjet më të fuqishme që kulmojnë efekte lirike duke prekur edhe çështje emocionale erotike, që në këtë rast s'kanë të bëjnë me pjesën historike dhe mbijetesën e arbëreshëve. Pjesa më intime e veshjes, Linja (këmisha), në këtë rast sikur i largohet karakterit etnografik të saj, duke anuar kah një vlerë tjetër ajo me ngjyrimet erotike, sepse është më e ngjeshur me trupin e vajzës se sa pjesët tjera që u përmendën. Kjo Linjë erëmirë, e ngirë me gjinjte e vashës siç shprehet poeti, gjithsesi e urren më tepër arkën, ku bashkë me Kezën e Cohën do të rrinë të paluara kushedi sa kohë. Edhe poezia *Pranvera në kantundin arbëresh* është përfshirë në përmbledhjen *Njeriu me vete e me tjerë*. Meqë ky vëllim përfshin poezi nga cikle të ndryshme vargjesh të pabotuara, radhitja sipas kohës e përmbajtjes që e pamundur, thotë autori me rastin e botimit (Lirka : f.33). Kjo poezi tristrofëshe na del jo e harmonizuar në vargje e rrokje. Në katundin arbëresh, sipas këtyre vargjeve poetike, edhe pranvera nuk vjen ashtu e zakonshme, edhe pse vargu i parë i poezisë fillon me fjalën lule. Këto lule nuk u ngjajnë atyre të Naimit, të *Bagëti e Bujqësisë*, ku secila e ka aromën e vetë, ngjyrën e vet dhe emrin e vet. Lulja e pranverës arbëreshe, rrënjët i ka lëshuar *plasave të gurëve*, të shkëmbit, prandaj edhe formën nuk e ka të zakonshme. Këto lule kurm *këputuna me qafë sa peni*, simbolizojnë jetën e vështirë arbëreshe të katundeve që u vendosën maje shkëmbi. Edhe në vargjet e kësaj poezie, mënyra e të shprehurit poetik përbëhet nga larmia e trajtave gjuhësore dhe tingullore. Poeti është i vetëdijshëm së pa to vargu nuk do të kumbojë bukur e mesazhi do jetë i cunguar. Nëse në poezinë, *Veshja arbëreshe*, Martin Camaj është i brengosur për zbehjen që çon kah humbja e vlerave materiale, këtu siç duke ai vuan bashkë me ato për jetën e vështirë të këtyre banorëve në vendet ku edhe pranvera është e shëmtuar e gratë e lodhura as që e zënë në gojë atë. Lulet e asaj pranvere, ashtu të njoma, sa kanë çelur, bëhen viktimë e barishteve të prillit të tërbuar. Kjo atmosferë përvëluese edhe në kohën më të bukur të vitit e mundon poetin, e detyron që të ikë ashtu i mllëfosur, pa e shijuar këtë stinë të natyrës së kësaj pjese të universit shqiptar: *Më kaluan ditët si n'andërr / me sy ndër lulet e hershme si humbshin / në barishtet e muejit prill të tërbuem*. Largimin e tij nga ky vend që me vështirësi i kishte ushqyer rrënjët e shkukur nga atdheu i të parëve, dhe ashtu i vrarë shpirtërisht, poeti e përshkruan në strofën dyvargshe të fundit: *U zgjova te dita e kthimit me një varg / fjalësh pa kuptim në dorë*.

Temën për jetën arbëreshe autori e trajtoi edhe në disa poezi të përmbledhjes *Lirika mes dy motive*, të botuara më 1967. Në këtë përmbledhje sipas autorit, janë përfshirë disa poezi shumë më të hershme. Poezitë kushtuar jetës së arbëreshëve dhe fatit të tyre gjithsesi janë krijime të periudhës pas shkuarjes së Camajt në Itali. Në poezinë: *Trashëgimi*, autori me një gjuhë të gdhendur poetike dhe me plot figura që janë karakteristika e stilit të tij, vazhdon ta përshkruajë jetën në katundin arbëresh, që ashtu i vetmuar është i ngulitur maje kodrës dhe sikur vëzhgon horizontin e largët. Përmes katundit, me emrin e të cilit edhe fillon strofa e parë, dheut që vëren me syrin e plakës qindvjeçare, që është vargu i parë i strofës së dytë, dhe dimri me ferrën e murrizit, sikur shkrihen në tërë strofën e fundit katërvargëshe që tingëllon kështu: *fjalët e gjuhës seme një / udhitimë e gjatë, e gjatë në kohë, / një ushtrimë e gjatë, e gjatë ndër veshë*. Sipas mesazhit poetik, gjuha e arbëreshëve do të flitet dhe dëgjohet edhe në të ardhmen, do të mbijetojë edhe më tej sepse u ruajt me sakrificat e mëdha. Metafora e tri fjollave të leshit të deles që u shkulën nga ferrat e murrizit të një dimri që krahasohen me tri fjalët që *la tezja arbëreshe*, më duket më e qëlluara e tërë kësaj poezie. Këto kombinime poetike të shprehjeve figurative siç janë; *dimri, murrizi, dhe delja*, që la tri fjolla leshi duke kaluar në ngushticën me ferrat e gjembat, që në këtë rast poeti i vë në shërbim të një krahasimi që vështirë mund ta hasësh diku tjetër në poezinë shqipe,

dëshmojnë aftësinë krijuese të Camajt për ta gjetur fjalën me fuqinë e saj magjepsë dhe me shumëkuptimësinë që përmban në thellësinë e vet e që në mënyrë të mrekullueshme ta përcjell mesazhin te lexuesi. Tri fjalët e plakës qindvjeçare arbëreshe që ishte nisur në rrugë pa kthim, ku do të pushonte në kodrinë, nën qiparisa, që i la trashëgim ishin: *udhëtimi, gjuha dhe ushtria e saj*, të ngjashme me tri fjalat e leshit të mbetura në ferrat e murrizit: *Dimën. Në ferrën e murrizit / la delja tri fjolla leshi. / Tri fjalë më la tezja arbëreshe / te dheu i eshtnave tanë.*

Në poezinë *Valle arbëreshe*, Camaj po me të njëjtën fuqi shprehëse, pa u larguar nga gjuha e figurave dhe metaforave poetike, ashtu si te veshja e tyre që e analizuar, i këndon vajzës arbëreshe kur ajo vallëzon. Edhe në këto vargje na paraqitet figura stilistike e krahasimit me delen. Ashtu si në shumë poezi të fazës së mëvonshme krijuese, kur fjala poetike ndërtonte një model të ri në rrafshim emocional e kuptimor, edhe në poezitë me temën që po i trajtojmë, nuk mungojnë prirjet moderne që bashkë me ato tradicionale tek lexuesi rrezatojnë emocione të fuqishme. Edhe në këtë poezi nuk mungon ligjërimi metaforik e simbolik. Në strofën e parë, lexuesi pa ndonjë vështirësi e sheh krahasimin mes deles e valltares arbëreshe, elegancën dhe nazet e saj që ashtu lehtas e lëmojnë tokën para se ta prekin, si delja që para se ta këput me dhëmb barin, e ngrohë me frymë: *Edhe kamba e vashezës /lemon tokën/ mandej i leshon ritmin.*

Poezia “Dimni i Jeronim de Radës”, i po kësaj përmbledhjeje edhe njëherë e dëshmon se personaliteti i De Radës dhe vepra e tij madhështore “Këngët e Milosaos” mbetën monument i përjetshëm jo vetëm ndër arbëreshë. Për këtë figurë që është ngritur në simbolin e jetës arbëreshe, e që reflekton në mbarë kulturën shqiptare, shkruan shumë poetë. Edhe Camaj që temë të preferuar i kishte arbëreshët dhe historinë e tyre, nuk e la jashtë vargjeve të poezisë së tij De Radën e madh. I inspiruar nga vargjet e bukura romantike të “Milosaos”, ky poet portretin e De Radës e shihte të pandarë nga kjo vepër. Vargu: *Ra bora ndë dejtj*, që poeti e nxori nga kënga VIII e “Milosaos”, që nuk është pjesë e poezisë kushtuar kësaj figure, tregon se çdo varg i romantikut tonë të madh, paraqet një botë të tërë frymëzimi.

Jorasatësisht Camaj këtë poezi e titulloi kësisoj, Dimri si stinë, si zakonisht nuk reflekton diçka të bukur e të këndshme që sjell hare e lumturi. Te poezia e Camajt kjo nuk ka rëndësi. Metafora e vargut poetik e Camajt nuk reflekton si zakonisht. Nëse në poezinë “Pranvera në katundin arbresh”, stina e pranverës karakterizohet me lulet jonormale, me “*qafë sa peni*”, nuk e simbolizon jetën e bukur me njerëz të lumtur, në poezinë kushtuar De Radës, edhe në momentin kur bora kishte rënë në deti, *Vashëzat bredhin vneshtave/ me llana jasht/.*

Në këto vargje vërehet një atmosferë më e këndshme, që është rezultat i shkëlqimit të figurës së De Radës dhe personazhit të Rinës, vajzës së varfër që di ç’është dashuria dhe si duhet dhuruar atë Milosaos.

Në strofën e dytë, De Rada na vjen i lodhur nga stina e vjeshtës dhe e verës që në këtë rast ato janë metaforë e jetës që atij i solli aq tragjedi familjare. Me gjuhën karakteristike plot me simbole e figura, Camaj në këtë rast autorin e “Milosaos”, jetën e vështirë të tij dhe lirikën e fuqishme që rrezatojnë vargjet e saj, i paraqet të pandarë. Ashtu si zakonisht edhe në këtë poezi, vargu i Martin Camajt nuk i zbulon detajet dhe rrjedhat e zhvillimit të ngjarjes. De Rada që tani “pushon ndër kufij mes territ dhe dritës” përballë dritares “ndër keshtëzat e saja” duke shijuar aromën e mollës dhe të verës së vjetër në dhomë, mund të mos jetojë fizikisht, sepse vargjet: *Shpirti yt endet ullishtave/ ndër kodrat e qeta e të bardha/ plot dritë e plot diell.*, si duket simbolizojnë ndarjen e tij nga kjo botë. Ai

tanimë pushon ndër kodrat e qeta e të bardha, në ambientin e kësaj natyre të bukur që edhe në stinë dimri janë plot dritë e diell.

Recenzentë:
Dr. Ali Aliu
Dr.Hamit Xhaferi

KUMTESA

Indira ÇIPA: KATALOGIZIMI I VEPRAVE PIANISTIKE TË KOMPOZITORËVE KOSOVAR-ASPEKTI TERCIAR

I Hyrje:

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte: I. Formimi i bazës së të dhënave për veprat pianistike të kompozitorëve kosovar dhe II Shqyrtimi analitik i parametrave muzikor të veprave pianistike të kompozitorëve Kosovare.

Detyrat e hulumtimit ishin ato informative dhe analitike

Korpusin empirik e përbëjnë 59 vepra pianistike të 17 kompozitorëve Kosovare: Mark Kaçinari (4 vepra), Vinçenc Gjini (2v.), Esat Rizvanolli (3v.), Akil Koci (1v.), Fahri Beqiri (5v.), Zeqirja Ballata (10v.), Rauf Dhomi (10v.), Rafet Rudi (6v.), Gjon Gjevelekaj (3v.), Bashkim Shehu (1v.), Mendi Menxhiqi (5v.), Valton Beqiri (1v.), Trimor Dhomi (3v.), Kreshnik Aličkaj (1v.), Dafina Zeqiri (2v.), Kushtrim Gashi (1v.), Drinor Zymberi (2v.)

Objekt i hulumtimit janë parametrat muzikor: forma, stili, formacioni interpretues, gjendja tonale, tempi dhe karakteri, metri, kohëzgjatja e veprave, notacioni.


Metoda e hulumtimit është kuantitative. Përpunimi i të dhënave është bërë me metodën deskriptive statistikore. Rezultatet e hulumtimit janë paraqitur me tabela dhe grafikone statistikore me të cilat është arritur efektiviteti i pasqyrimin.

Grumbullimi i mostrave ka përfunduar në qershor të vitit 2010.

II Gjetjet dhe distribuimi

Forma

Analiza e formës së veprave të analizuara ka rezultuar me 12 kategori: Forma ciklike (18 frekuenca), formë e lirë (14 f.), tripjesore (10 fr.), sonatë njëkohëshe (3 fr.), rondo (3 fr.), njëpjesore (2 fr.), dypjesore (2 fr.), këngë e vogël tripjesore (2 fr.), scherzo (2 fr.), këngë e lirë dypjesore kalimtare (1 fr.), formë e lirë e variacionit (1 fr.), marsh-këngë e madhe tripjesore (1 fr.).



Nga këto gjetje janë formuar dy

KUMTESA




nënkategori: fromat ciklike me 18 frekuenca dhe veprat me strukturë njëkohëshe me 41 frekuenca.

Në nënkategorinë e formave ciklike janë gjetur 7 variacione, 5 suita, 4 cikle dhe 2 sonata.

Stili

Interesi hulumtues në raport me stilin ishte i fokusuar në gjetjen e argumenteve që do të vërtetonin orjentimet stilistike të kompozitorëve Kosovar duke u bazuar në faktin se Kompozitorët kosovar përfaqësojnë shkolla të ndryshme të kompozimit dhe se në periudhat e zhvillimeve të stileve muzikore deri në shek.XX në Kosovë nuk është krijuar ndonjë vepër pianistike. Veprat e para pianistike nga kompozitorë Kosovarë gjejmë të jenë krijuar në gjysmën e dytë të shek. XX. Sëkëndejmi është kërkuar masa dhe vëllimi i tendencave krijuese në dy drejtime: kompenzimi i opusit krijues me vepra stilesh tradicionale dhe tendencat novatore.

Janë gjetur 11 kategori stilesh: stili



Teknikat kompozicionale si tendenca stilistike

bashkëkohor (19 frekuenca), neoklasicizëm (16 fr.), romantizëm i vonshëm (8 fr.), impresionizëm (3 fr.), klasicizëm (3 fr.), neoromantizëm (2 fr.), neoimpresionizëm (2 fr.), romantizëm (2 fr.), avangarde (2 fr.), postmodernizëm (1 fr.), neobarok (1 fr.).

Raproti i stileve tradicionale me stilet e reja novatore është 37 me 22 në favor të stileve tradicionale,


Në veprat e analizuar janë gjetur teknikat kompozicionale që paraqesin tendencat stilistike të kompozitorëve kosovar si: seriale, minimaliste, minimaliste seriale, aleatorika, aleatorika e kontrolluar, minimalizmi i synuar, multistilistika-bluz, minimalizmi repetitiv, puntualizmi. Kuantumi i tyre është minimal. Të gjitha teknikat-tendencat stilistike paraqiten me nga një frekuencë..

Formacioni interpretues

Analiza e formacionit interpretues ka dhënë rezultatet vijuese: solistike 51 fr, ose 86.44%, për katër duar 4 fr. ose 6.77%, për dy piano 2 fr. ose 3.38% dhe për piano e orkestër 2 fr. ose 3.38%.

Gjendja tonale

Në 59 veprat pianistike të analizuar janë gjetur 14 kategori. Në listën e kategorive të gjetura me frekuencë më të lartë prej 20 frekuencash prijnë veprat në tonalitete minore ose 33.89%. Pasojnë: 11 vepra atonale ose 18.64%, 8 vepra modale me ose 13.55%. Me tonalitete të lirë janë 5 vepra ose 8.47%, me tonalitete maxhore janë 4 vepra ose 6.77%.. Me nga 2 frekuenca ose me nga 3.38% janë veprat tonale dhe bimodale, ndërsa me nga një frekuencë ose shprehur në përqindje 1.69% janë veprat me tonalitete të zgjeruar, tonalitete të lirë të avancuar, heksakord atonal i toneve të plota, jotonale e lirë, pantatonikë, shkallë simetrike e toneve dhe semitoneve të njëpasnjëshme dhe dorike.




Tempi dhe karakteri

Tempi dhe karakteri, si një prej parametrave të rëndësishëm të përcaktimit estetik në veprat pianistike të kompozitorëve kosovar rezultoi me 4 kategori. Kësaj liste ranguese i prin kategoria e emërtuar me Karakteri i përshkruar & MM (masa metronimike) me një frekuencë prej 31 njësisish që përbëjnë 52.54%. Kategoria e ranguar si e dyta është Karakteri i përshkruar pa MM me 25 frekuenca ose 42.37%. Pason kategoria Pa shenime për karakterin

KUMTESA

&MM me 2 frekuenca ose 3.38%, ndërkaq e fundit në këtë rang paraqitet 1 vepër e katagorisë së emërtuar si E pacaktuar që përbën 1.69 % të korpusit empirik.

Pason paraqitja grafike:



Metri

Metri rezultoi me 8 kategori. Rezultatet janë paraqitur në tabelën që vijon:


| | Kategoria | frekuenca | % |
|---|---|-----------|--------|
| 1 | Konstant | 21 | 35.59% |
| 2 | I ndryshueshëm | 7 | 11.86% |
| 3 | Ndryshime frekuente | 21 | 35.59% |
| 4 | Ametrike | 2 | 3.38% |
| 5 | Ndryshueshmëri përmes MM | 3 | 5.08% |
| 6 | Ndryshueshmëri përmes karakterit përshkrues | 3 | 5.08% |
| 7 | Metriko ametrike | 1 | 1.69% |
| 8 | E panjohur | 1 | 1.69% |

Kohëzgjatja

| Kategoria | kohëzgjatja | frekuenca | % |
|-------------|-------------|-----------|--------|
| Grupi i I | 60-120 | 5 | 8.47% |
| Grupi i II | 120-210 | 13 | 22.03% |
| Grupi i III | 210-420 | 24 | 40.67% |
| Grupi i IV | 420-1040 | 17 | 28.81% |

Kohëzgjatja e veprave të analizuar është paraqitur në sekonda. Ndërsa llogaritja është bërë me formulën $NPNjM/min$ sipas MM, përkatësisht $NPNjM/shpejtësia$ mesatare e karakterit të përshkruar, përkatësisht modifikimet specifike të veprave të

veçanta. Është llogaritur NETO kohëzgjatja, dmth pa i përfshirë agogjikën dhe pushimet ndërmjet kohëve. Këtë përcaktim e kushtëzoi mungesa e formatit auditiv të shumicës së veprave në korpus empirik.



Notacioni

Analiza e notacionit rezultoi me 5 kategori: tradicional me 48 frkuenca që përbën 81.35 % të korpusit empirik. Notacioni Kryesisht tradicional paraqitet me 2 fr. ose 3.38%, MIX tradicional dhe bashkëkohor shenon 4 frekuenca ose 6.77%. Kryesisht bashkëkohor ka 2 fr. ose 3.38%, ndërsa ai Bashkëkohor ka 4 fr. ose 5.08%. Tabela vijuese pasqyron kronologjinë e përdorimit të notacionit bashkëkohor dhe marrëdhënien e kompozitorëve në raport me kategorinë e caktuar të notacionit.

| | Kompziotri | Viti i përdorimit | Nr i kategorisë | Frekuenca |
|----|-----------------|-------------------|-----------------|-----------|
| 1 | Zeqirja Ballata | 1967 | 2 | 1 |
| 2 | Zeqirja Ballata | 1967 | 3 | 1 |
| 3 | Zeqirja Ballata | 1969 | 3 | 1 |
| 4 | Rafet Rudi | 1993 | 2 | 1 |
| 5 | Zeqirja Ballata | 1999 | 4 | 1 |
| 6 | Zeqirja Ballata | 2001 | 5 | 1 |
| 7 | Mendi Menxhiqi | 2002 | 5 | 1 |
| 8 | Zeqirja Ballata | 2003 | 4 | 1 |
| 9 | Zeqirja Ballata | 2004 | 5 | 1 |
| 10 | Drinor Zymberi | 2006 | 3 | 1 |
| 11 | Drinor Zymberi | 2010 | 3 | 1 |

KUMTESA

Zeqirja Ballata ka treguar prirje të theksuar në raport me notacionin bashkëkohor me 7 vepra që përbëjnë 63.63% të veprave nga lista e kategorive të notacionit bashkëkohor.

| | Kompozitori | Frekuenca | % |
|---|--------------------|------------------|----------|
| 1 | Zeqirja Ballata | 7 | 63.63% |
| 2 | Drinor Zymberi | 2 | 18.18% |
| 3 | Rafet Rudi | 1 | 9.09% |
| 4 | Mendi Menxhiqi | 1 | 9.09% |

Konkluzion:

- Veprat pianistike të kompozitorëve kosovar në raport me aspektin struktural tregojnë afinitet të theksuar ndaj formave njëkohëshe
- Prirjet stilistike të kompozitorëve kosovar, megjith dominimin e stileve tradicionale dhe duke u bazuar në zhvillimet historike mund të konkludojmë se kompozitorët kosovar reflektojnë një përkushtim të konsiderueshëm ndaj stileve bashkëkohore dhe tendencave inovatore stilistike.
- Novatorizmi është shprehur edhe përmes aplikimit të notacionit (shenjave) bashkëkohor.
- Diversiteti i stileve dhe i tendencave stilistike inovative është refleksion i prejardhur nga shkollat e ndryshme artistike
- Ndikimi i elementeve të muzikës nacionale është i shprehur përmes metrit të ndryshueshëm, masave të përbëra, gjendjes tonale dhe tematizmit
- Hulumtimi ka arritur të krijojë një shumësi të konsiderueshme të të dhënave informative dhe analitike të vlefshme për studime të mëtejme në këtë fushë

Recenzentë:
Mr. Todor Svetiev
Mr. Vasilqo Pecakovski

Edmond MALAJ: FIGURA E SKËNDERBEUT NË NJË VEPRËN „TÜRCKENMACHT VON GOTT VERLACHT“ TË HUMANISTIT GJERMAN JOHANNES LASSENIUS

Veprat e historiografisë dhe të letërsisë gjermane, të cilat bëjnë fjalë për Skënderbeun janë të shumta, dhe të gjinive të ndryshme. Ato fillojnë me historiografinë humaniste, që në shekullin XVI, ku si bazë për to është *Historia de Vita e te Gestis Skanderbegi*” e cila u përkthye në gjermanisht nga Johannes Pinicianus, e vazhdojnë deri në shekullin e XXI, ku si vepër më të fundit mund të përmendim këtu “Skënderbeun” e historianit zviceran Oliver Jens Shmitt.



Frontespici i veprës “Türkenmacht von Gotte verlacht”, marrë nga vepra origjinale, pa nr. fq. (shih titullin e plotë më poshtë)

Përsa i përket letërsisë artistike, për Skënderbeun në letërsinë gjermane janë shkruar disa drama, por edhe romane dhe poema të gjata, dhe ndër to mund të përmendim dramën e Aufenbergut, me titull “Skanderbeg” 1844, romanin e Hildebrandit “Princi Skanderbeg” (Fürst Scanderbeg), 1824, apo eposin madh të Friedrich Krug von Nidda “Skanderbeg një poemë heroike në dhjetë këngë” (Skanderbeg. Heroisches Gedicht in zehn Gesängen) 1823/24.

Por unë në këtë kumtesë dua të ndalem në një vepër të historiografisë gjermane të gjysmës së dytë të shekullit të XVII.

Vepra që po prezantoj këtu sot është e autorit humanist Joahannes Lassen dhe ka Titullin “Pushteti i Turqve, i përqeshur nga vetë perëndia” (Türckenmacht von Gott verlacht).¹⁴⁶ Kjo vepër u shkrua në kushtet kur ushtritë osmane ishin bërë tashmë kërcënim edhe për vendet e Evropës qendrore. Osmanët në vitin 1661, pas një paqeje prej gati 50 vjetësh, ishin futur përsëri në Hungarinë veriperëndimore, dhe aty perandori gjerman dërgoi trupat e tij kundër tyre. Midis dy ushtrive pati beteja të shumta, të cilat e arritën kulmin e saj në të ashtuquajturën “Lufta kundër Turqve”, e viteve 1663/1664.¹⁴⁷ Dhe duke pasur parasysh këto ngjarje Johannes Lassenius publikoi veprën e tij, titullin e së cilës e përmendëm më lart. Kjo vepër është një përmbledhje e madhe e shumanshme informacionesh politike dhe historike që kishin të bënin më atë kohë dhe me problemin e kërcënimeve që vinin nga ana e ushtrisë osmane. Duke iu përshtatur brendësisë së veprës, Lassenius paraqet në frontespicin një figurë alegorike, një krijesë femërore në trup engjëlli të madh me krahë që i fryn borive të fitores dhe pas saj ndodhet dy ushtritë që luftojnë, ushtria e krishterë dhe ajo osmane, por që e krishtera paraqitet si fitimtare.

Vepra përbëhet nga 308 faqe dhe pjesët kryesore janë të ashtuquajturat lajmërimi, që janë letra fiktive, në të cilat autori shpreh mendimet e tij në lidhje me çështje të ndryshme të luftës kundër turqve dhe kërcënimet që ata po u sillnin vendeve të Evropës qendrore dhe perëndimore. Në fillim të veprës ka një paradhënie dhe pas saj përmenden personat, të cilëve Lassenius ua kushton veprën, të cilët janë nga shtresa e lartë e fisnikërisë së Nyrenbergut, të cilët iu gjenden Lasseniusit me ndihmë, ngaqë ia ishte i ardhur i ri në qytet.¹⁴⁸ Ndër figurat e shumta madhore të kohës dhe të kohërave të mëparshme që kishin fituar famë në luftën kundër Turqve, i paraqitet lexuesit edhe Gjergj Kastrioti (Skënderbeu) dhe sfondi shqiptar. Skënderbeu përshkruhet si një Luftëtar i lirisë dhe si një hero i krishterë. Si luftëtarë i lirisë Skënderbeu përshkruhet si një strateg i madh, që luftonte vazhdimisht kundër forcave pushtuese osmane.

Për të dhënat mbi Skënderbeun, Lassenius mbështetet kryesisht në Biografinë Skanderbegiane të humanistit shkodran Marin Barleti, dhe nga vepra të tjera që kishin si bazë veprën e Barletit, dhe rrjedha e ngjarjeve në lidhje me Skënderbeun ndjek

¹⁴⁶ Johannes Lassenius: Türcken Macht von Gott verlacht: Oder/ Kurtzes und wolgemeintes Bedenken/ über den itzt vor Augen schwebenden Türckischen Krieg/ darinnen nicht allein von nützlichen Mitteln/ denselben wol anzufangen/ und glücklich zu enden/ sondern auch von andern hierzu dienlichen Sachen gehandelt wird/ zusambt Beantwortung auf einige Einwürffe/ deren sich etzliche bißhero/ betreffende den jetzigen Krieg/ gebrauchen wollen. Darinn auch enthalten Eine kurtze Türckische GeschichtBeschreibung von deren Glauben/ Regiment/ Leben/ Kräfften/Stärke/ Landen und Einkommen. Sambt angehengten einigen nöhtigen Krieges=Frage/ deren sich ein Cavalier nützlich zu gebrauchen. In 29. Send=Schreiben. Nürnberg/ Gedruckt bey Michael Endrer/ A. 1661. Në vazhdim vepër e cituar si: Lassenius: Türcken Macht von Gott verlacht.

¹⁴⁷ *Österreichs Lexikon In Zwei Bänden*. Hrsg. v. Richard und Maria Bamberger, Ernst Bruckmüller, Karl Gutkas. Bd I: A-L. Wien 1995, f. 516.

¹⁴⁸ „In der Widmung wird Lassens Stellung als Neankömmling in Nürnberg deutlich („so ich bißhero als ein Ausländer/ in dero gesegneten und florisanten Respubliq“) und er bedankt sich bei den vier Widmungsempfängern, „Denen Hoch= und Wol=Edlen/ Gestrengen/ Fuersichtigen Hoch= und Wolweisen Herren/ Herrn Burckhard Loeffelholz von Colberg. Herrn Leonhard Grund =herrn/ des aeltern geheimen Raths/ vordersten Scholaechen und Kirchen=Pflegern. Herrn Georg Paulus Im Hof/ des innern geheimen Raths und Land=Pflegern. Herrn Andreas Georg Baumgaertner von Hollenstein/ des inneren geheimen und Kriegs=Raths“für die Unterstützung, die ihm zuteil wurde.“Lassenius: *Türcken Macht von Gott verlacht*. (Panimës faqeje).

kronologjinë e Barletit. Lassenius i fillon të dhënat e tij me rënien e Skënderbeut nga Sulltan Murati II, duke lënë historinë e fëmijërisë dhe rinisë së Heroit. Momenti i rënies së Skënderbeut është lufta që ushtritë osmane fillojnë kundër Hungarisë, dhe aty Skënderbeu gjen momentin për të braktisur këtë ushtri dhe për tu kthyer në atdhe, ku ia fillon luftës për çlirimin e vendit, duke nxjerrë jashtë pushtuesit turq.¹⁴⁹ Këtij momenti të çlirimit të vendit dhe të suksesit të Skënderbeut, autori Lassenius i vë një rëndësi të madhe, pasi sheh një shembull të shkëlqyer se si një prijës i vogël mund të mundë një ushtri të madhe më me shumë forca, dhe sigurisht duke i bazuar tek Barleti numrin e të rënëve tek pala turke e jep me shifra shumë më të mëdha nga të rënë të shqiptarë,¹⁵⁰ duke përdorur edhe një shprehje barletiane, si *“turqit u lanë në gjakun e tyre”*. Dhe tani duke marrë si shembull luftën e Skënderbeut ai bën konstatimin, se *“Gjermania është e madhe dhe fuqishme mjaftueshëm, që ti bëjë ballë armikut turk, dhe nuk i mungon asgjë përveçse bashkimit të sovranëve të krishterë”*¹⁵¹ dhe në lidhje me bashkimin e shpresuar ai përsëri merr si shembull bashkimin e princave shqiptarë rreth Skënderbeut, të cilët u bënë ballë edhe ushtrive osmane me mbi 100 mije vetë, duke i detyruar edhe jeniçerët e tmerrshëm që të iknin nga sytë këmbët, sepse jeniçerët, sipas Lasseniusit janë si ato zogjtë grabitqar, që vijnë me shpejtësi, por me një mbrojtje të organizuar mirë ata ia mbathin me një shpejtësi edhe më të madhe.¹⁵²

Luftën kundër turqve Lassenius e konsideron edhe si një luftë të shenjtë, sepse sipas tij, të krishterët luftojnë edhe për nderin dhe kurorën e Jezus Krishtit të tyre të kryqëzuar, dhe si rrjedhojë lufta e tyre është e drejtë.¹⁵³ Pra këtu kemi arritur në një moment tjetër të këndvështrimit të Lasseniusit në lidhje me Skënderbeun, pasi ai e konsideron heroin e shqiptarëve edhe si hero të Krishterë. Lassenius nuk dyshon aspak se *“Perëndia do të dalë dhe di ti prijë vetë popullit të tij, nëse ky popull – dhe këtu bëhet fjalë për gjermanët – to të fillojnë ti besojë dhe do të shkëputet nga jeta mëkatore dhe e shturur dhe zemëruese për Perëndinë, që kanë bërë deri më tani gjermanët.”*¹⁵⁴

Këtu kemi ardhur tani në një konstatim tjetër në lidhje me osmanët. Ata në kohërat e Lasseniusit konsideroheshin si një ndër tri plagët që Zoti ua dërgon popullin gjerman, si rrjedhojë e mosbesimit dhe mosrespektimit të urdhërimeve të tij. këto plagë ishin, *Murtaja, Karkalecat* dhe *Turqit*. Pra turqit konsideroheshin nga disa autorë dhe teologë të asaj kohe si *“Kamxhiku i Perëndisë”* për të krishterën e rrëzuar nga besimin.

¹⁴⁹ „eroberte wieder seines Vatters Erbland/ kombt mit List und Behendigkeit in seine Hauptstadt Crojam, treibt daraus die Türkische Besatzung.“¹⁴⁹ Er befreite auch die anderen Städte, die ihm als ihrem „Erb=Herrn“ zufielen. Mit ihm vereinigten sich auch andere Herren: „Und kamen ihm auch etliche Herrn zu Hülffe/ die halfen ihn den Türken aus seinem Lande treiben/ und thäten ihm Beystand“. *Po aty, f. 121.*

¹⁵⁰ „Wider diesen Scanderbeg schickte der Käyser Amurath/ fürs erste Ali Bassam, mit vierzig tausend Reutern/ welchen Scanderbeg begegnet mit fünf und zwanzig tausend/ überwand Ali Bassam und schlug ihn ab zwei und zwanzig tausend Mann.“ *Po aty.*

¹⁵¹ „Teutschland ist groß und mächtig genug/ ihm (dem türkischen Feind) zu widerstehen/ und mangelt an nichts/ als nur an Einigkeit/ als nur an Einigkeit/ der Christlichen Potentaten.“ *Po aty, fq. 117.*

¹⁵² „nur Raub-Vögel/ welche so bald sie ankommen/ so bald auch/ durch eine verständige angerichtete Gegenwehr können in die Flucht geschlagen werden.“ *Po aty.*

¹⁵³ „die Christen streiten vor die Ehr und Kron ihres gecreutzigten Jesu/ in einer rechtmässigen Sache/ welches allezeit daß besste im Kriege ist.“ *Po aty.*

¹⁵⁴ “Gott der Herr werde vor seinen Volck selber herziehen/ und ihnen ein Herz geben“wenn dieses Volk (die Deutschen) anfinge, auf Gott zu vertrauen und mit dem ärgerlichen und sündhaften Leben, „welches bißhero in Teutschland getrieben“, aufhörte.” *Po aty, f. 118.*

Dhe kjo përshtypje pra “turqit si kamxhiku i Perëndisë” haset edhe tek humanisti Lassenius.

Në lidhje me Gjermaninë dhe Skënderbeun si shembull të mirë, Lassenius thotë më tej se, “do të ishte një turp, nëse Gjermania nuk do të mund tu bënte ballë turqve, dhe këtu duhet të kihet parasysh Gjergj Kastrioti, prijësi i Epirit, të cilin e quajnë ndryshe edhe Skënderbe, i cili me një lavdi të madhe dhe me pak njerëz të vet, i bëri ballë Perandorisë Turke dhe, i detyroi ata më në fund që të bënin paqe”,¹⁵⁵ duke u shprehur më në fund, që këtë hero, pra Skënderbeun, e zgjodhi Perëndia, kundër perandorit turk Amurat, posaçërisht për mbrojtjen e të krishterëve të tij të mjerë.”¹⁵⁶ Dhe në këtë fjalë të fundit Lassenius bashkon të dy këndvështrimin mbi Skënderbeun, atë të Heroit çlirimtar dhe mbrojtës të njerëzve të tij, dhe të heroit të krishterë, të zgjuar dhe të mbështetur nga Perëndia në luftën kundër Osmanëve.

Dy fjalë mbi jetën dhe veprën e Johannes Lassenus

Pasi i hodhëm një vështrim figurës së Skënderbeut tek vepra e këtij autor, është me vend që të japim edhe disa të dhëna në lidhje me jetën dhe veprën e tij. Johannes Lassenius¹⁵⁷ është një figurë shumë e njohur e protestantizmit luteran ortodoks. Lista e veprave të tij arrin në 60 tituj, në gjuhën daneze, latine dhe gjermane, ndër të cilat bën pjesë edhe vepra për të cilën folëm më sipër. Pjesa më e madhe e veprave të tij u shtyp shpesh here deri në shekullin XIX.

Ai u lind më 26. 4. 1636 në Valdov (Hinterpommern), dhe i ati i tij ishte pastor. U shkollua në shumë shkolla duke filluar në vendlidje e duke vazhduar pastaj në Danzig, Stettin e më vonë në Universitetin e Rostokut, e më vonë pastaj duke frekuentuar leksione edhe në universitetet e Utrehtit, Leidenit, Orleansit dhe të Oksfordit, Tybingenit, etj. Në universitetin e Strasburgut mori titullin Magister, në universitetin e Graifswaldit mori licenciatin për teologji dhe po në atë universitet (në Greifswald) u promovua si Doktor i Teologjisë në vitin 1677.

Ai njihet edhe për udhëtimet e tij të studimeve që i bënte me fëmijët e patricëve për ti dërguar ata të vizitonin universitete dhe vende me shumë rëndësi për kulturën e kohës, si Itali, Francë, Irland, Angli, Spanjë, Portugali. Ka punuar për disa edhe në Bibliotekën Princërore të Berlinit. Në universitetin e Kopenhagenit ka dhënë mësim teologjinë në gjuhën latine. U caktu edhe si pastor kryesor në Kishën e shën Mhillit në Hamburg, por mbreti Kristian V nuk e lejoi të shkonte, dhe kështu ai qendroi në Kopenhagen, duke dhënë mësim në universitetin e këtij qyteti dhe duke punuar si pastor në bashkësinë e Shën Pjetrit në afërsi të Kopenhagenit. Johannes Lassenus qe martuar dy herë. Gruja e parë, e bija e një tregtari nga rostoku i vdiq dhe me të nuk pati fëmij, kurse

¹⁵⁵ “Es were ja eine Schande/ wann nicht Deutschland den Türcken sich widersetzen könnte/ wann man es nur rechtanfienge; da doch die einige Georgius Castriota, herzog in Epiro, den man sonsten Scanderbeg genennet/ sich mit grossen Ruhm/ allein mit wenig der Seinigen/ dem ganzen Türkischen Reich widersetzet/ und endlich den Türken gezwungen/ Friede zu begehren” Po aty.

¹⁵⁶ „Diesen Helden hat Gott absonderlich zu Schutz seiner armen Christenheit/ wider den Türkischen Kaiser Amureth erwecket.“ Po aty, f. 118-119.

¹⁵⁷ Të dhënat biografike: *Allgemeine Deutsche Biographie. Bd. 17. Hrsg. durch die Historische Commission bei der Königl. Akademie der Wissenschaften.* Leipzig: Duncker & Humboldt 1875, f. 788-790; *Neue Deutsche Biographie. Bd. 13.* Herausgegeben von der Historischen Kommission der Bayerischen Akademie der Wissenschaften. Berlin: Duncker&Humboldt 1953, f. 674.

me gruan e dytë, bijë e një tregtari nga Wilsteri, pati dy vajza. Johannes Lassenius vdiq më 29. 8. 1692 në Kopenhagen.

Recenzentë :
Prof. dr. Beatrix Muller-Kampel
Prof. dr. Ingrid Spork
Prof.dr. Karl Kaser

KUMTESA

**Ma. Anisa KOSTERI: PËRSHKRIM I FJALORËVE DIALEKTORË- KRAHINORË
TË SHQIPES VERIPERËNDIMORE (STUDIM MBI BARDHIN, GAZULLIN E
BENEDIKT DEMËN).**

Leksikografia dialektore është një degë e rëndësishme e gjuhësisë, e cila zhvillimin e saj e njeh vetëm vitet e fundit nga fjalorët e glosarët e ndryshëm që janë botuar. Në gjuhën shqipe ka në përdorim shumë fjalorë dialektorë, që mbartin lëndë leksikografike të pasur. Por duhet theksuar se dialektet po vijnë duke e zbehur rëndësinë e tyre, sepse po i kushtohet më tepër vëmendje prirjes dhe përvijimit drejt gjuhës letrare standarde, duke mënjanuar kështu ekzistencën e rëndësinë e dialektit bazë. Dijetari frëng Charl Nodie thoshte: “ *Ai njeri që nuk ka hulumtuar me kujdes dialektet dhe të folmet e gjuhës së vet, nuk njeh as gjysmën e saj*”.¹³² Kjo traditë e përvijuar tashmë prej shekujsh, zë fill me Fjalorin latinisht – shqip, botuar në vitin 1635 të Frang Bardhit, e cila zuri një vend themelor në leksikografinë shqiptare, ku do të shërbente si bazë për hartimin e fjalorëve të tjerë gjuhësorë.

Ky Fjalor që na ka mbetur prej tij, nuk është një fjalor i latinishtes klasike, sepse qëllimi i tij nuk ishte që të bënte një fjalor për leximin e veprave klasike. Si bazë për Fjalorin e Bardhit, u mor gjuha kishtare latine, sepse ishte e nevojshme, që të gjithë njerëzit që i shërbenin kishës, të dinin latinisht. Vetëm me gjuhët klasike mund të fitohej një kulturë e lartë.

Pashko Geci shprehet: “ *Ai e dinte mirë gjendjen e ulët kulturore të klerit shqiptar, që lexonte për ditë librin e meshës dhe lutjet e ndryshme, por nuk kuptonte gjë dhe për t’u ardhur në ndihmë këtyre hartoi të parin fjalor latin – shqip dhe për ta bërë më të lehtë e më të sigurtë përdorimin e tij nuk i ngarkoi fjalë me kuptime të ndryshme, por u mjaftua me kuptimin e tekstit të vjelë*.”¹³³

Në botimin e tij analitik për Frang Bardhin, Mustafa Kruja citon: “ *Në këtë vepër të përvutë shqiptare, kënduesi s’ka për të gjetun vetëm një listë alfabetike të thatë të fjalëve shqipe të Frangut të Bardhë (kund nja 2500), por diçka edhe më tepër, qi kam shpresë se mund t’i sjellë një dobi praktike studimit të gjuhës s’onë përgjithësisht*.”¹³⁴

Gjithashtu, ky studiues, është i mendimit se , pothuajse nga të gjitha fjalët e parashtruara në Fjalor, nuk ka ndonjë të mos përdoret në shqipen e sotme. Gjithsesi ky mendim mbetet relativ.

Autori, nga fakti se Fjalori do të dilte me pak faqe (80, siç e kishte parashikuar vetë ai), e ka fryrë duke marrë për bazë një Fjalor latinisht çfarëdo. Nga kjo rrjedhin listat e gjata me fjalë në in-, per-, pro-, -re, në kundërshtim me numrin e vogël të fjalëve me de-, ex-.¹³⁵

¹³² J.Gjinari, Gj.Shkurtaç, Dialektologjia, Ribotim, Tiranë, 2003.

¹³³ P.Geci, Frang Bardhi dhe « Fjalori » i tij latinisht – shqip, Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II, Tiranë, 1972, f.300.

¹³⁴ M.Kruja, Gjuha e Frang Bardhit dhe shqipja moderne, botimet « Çabej », Tiranë, 2007.

¹³⁵ M. Roque, Frang Bardhi dhe Fjalori i tij, Dijatarët francezë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Shkodër, 2005.

Përkatësisht, me *in-* kemi 173 fjalë, me *per-* 219, me *pro-* 141, *re-* 250, ndërsa me *de-* 49 dhe *ex-* 22 fjalë.

Një fakt tjetër, për të cilin mendohet se Bardhi ka ndërruar metodë, është se fjalëve latine u ka dhënë një korresponduese në italisht dhe glosave shqipe, korrespondueset në turqisht, gjë që të lë të kuptosh, se mos ka dashur të na pasqyrojë një Fjalor katërgjuhësh. Por, prania e turqishtes, mund të shpjgohet qartë se shqipja ka qendruar nën presionin turk gjatë, psh., *hodie* – *sod*, *Turcicè*, *bugiun* (B. f.31), *huc- cheha*, *turcicè*, *buraija*, (B. F. 32), *illicitum* – *malecuem*, *turcicè*, *haram* (B.f. 33) etj, etj., por dhënia e tyre në italisht, është më pak e qartë, duke menduar se shumë fjalë latine janë të njëjta me ato italiane, si psh *damnū* , *danno* – *dam*(B. f.17), *efurio*, *efurire* – *cham uu* (B. F. 23), *fabula*, *favola* – *perrala* (B. F. 24), *frumentū*, *frumento- grune* (B.f.28) etj, etj.

Sipas studiuesit Mario Roque, përgjegjëset e tyre në italisht kanë një dobi të veçantë, sepse shpjgojnë një fjalë të çuditshme latine, para se të jepet përkthimi në shqip¹³⁶, psh., *forceps*, *tanaglie* – *daena* (B. f. 27), *frixorium*, *padella- furtereia* (B. f.28), *fur*, *ladro* - *cuffaar* (B. f. 28), *hepar*, *fegato* – *mufchenij* (B. f. 31) etj, etj.

Puna leksikografike e këtij autori do vlerësohet, se është i pari ballafaqim i shqipes me një gjuhë të huaj, siç ishte latinishtja, së pari për vështirësitë si fjalor dygjuhësh, dhe, së dyti, ai nuk kishte me kë të konsultohej, sepse kishte shtatë vjet që kishte shkuar në Itali.

Një tjetër Fjalor me vlerë gjuhësore, që nuk ka qenë i njohur, është “Fjalorthi i ri” i Gazullit, ku së bashku me “Fjalorthin e ri, fjalë të rralla të përdoruna në Jug të Shqipnis”, Tiranë, 1941, (“Visaret e Kombit”, vëllim XII) të Pano Tases, janë të parët fjalorë krahinorë të ne.

Fjalori i gjuhës shqipe 1954 dhe ai i Benedikt Demës, i cili u botua për herë të parë në vitin 2005, u mbështetën bindshëm mbi Fjalorin e ri të Gazullit. Për shumë vite emri i Gazullit nuk u përmend, madje në shumë citime të gjuhëtarëve të mëdhenj, si: Xhuvani apo Çabej, shënohej vetëm “G”, “Fjalorth i ri”, ose “Shkodër 1941”.

Fjalësi i këtij “Fjalorthi” paraqet më së miri një hapësirë të së folmes së gegërishtes veriperëndimore, përkatësisht trevës së Malësisë së Madhe, Shkodra, Dukagjini, Lezha, por kemi edhe fjalë nga gegërishtja verilindore, si zonat e Pukës e gegërishtja qendrore, ku përfshihet Mirdita me zonat përkatëse.

“Fjalorthi i ri” i Gazullit, botuar më 1942, merr vlera duke qenë i pari fjalor krahinor i gegërishtes botuar deri më sot. Përfshin fjalë të rralla, disa nga ato edhe të padëguara në Veri të Shqipërisë, kryesisht pjesës veriperëndimore. Për hartimin e këtij Fjalori, mësohet se pati një letërkëmbim të ngushtë me Joklin dhe bashkëpunim të ndërsjellë të fjalorëve, sepse ndërkohë që Gazulli përfundonte Fjalorthin e tij, Jokli po përfundonte Fjalorin etimologjik të Shqipes. Gazulli ishte një erudit në kuptimin e plotë të fjalës, njohës i disa gjuhëve të huaja, të cilën e pasqyron qartë se shumë fjalëve në Fjalor u jep korresponduesen e tyre në latinisht, italisht, gjermanisht, greqisht dhe sllavisht. Vitet në të cilat u la në harresë emri dhe Fjalori i tij, shënojnë një errësirë të vetë personalitetit të Gazullit, i cili doli në dritë pak vite më parë, vetëm kur pau dritën e botimit dhe vlerësimit të tij si figurë e madhe gjuhësore.

Fjalësi i “Fjalorit” përmban 5000 lema. Sipas studiueses Shamku, kriteri sasior nuk ngre peshë, sepse ky është një fjalor i tipit shpjgues dhe përshkrues dhe e rëndësishme është metodologjia e hartimit, gjë të cilën Gazulli e ka pasqyruar në mënyrën më të përsosur.

¹³⁶ M. Roque, Frang Bardhi dhe Fjalori i tij, Dijatarët francezë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Shkodër, 2005.

Duke qenë njohës i mirë i gjuhëve të huaja dhe me një përgatitje të lartë filologjike klasike e moderne, në shumicën prej fjalëve, ai jep edhe korrespondueset e tyre në gjuhë të tjera, si italisht e latinisht, ose edhe gjermanisht e frëngjisht, kjo ndoshta për të treguar edhe etimologjinë e asaj fjale, si dhe kuptime shtesë psh. : **currel-i** – (Rr. M.M) – të gërryeme qi bâjnë në shkambij ujnât ; germ. Karrenfelder, it. scanalature (F.G. f.88). **qepore-ja** (dhè.PI) – enët e dheut i lyejnë me qepore për mos me kjasue; qepue; it. smalto, frang.emaille (F.G.f.91).

Një vend të rëndësishëm në Fjalor zënë njësitë frazeologjike me shpjegime përkatëse që u bënë autori. Larmia frazeologjike del tepër e pasur dhe interesante, e cila pasqyron më së miri mendësinë dhe psikologjinë e zonave malësore të gegërishtes veriperëndimore.

Në këtë vepër gjuhësore ka frazeologjizma, shpjegimi i të cilave jepet në shqip, por pjesa më e madhe e tyre shpjegohen drejtpërdrejtë me italishten, kjo sepse italishtja asokohe njihej mjaft mirë në nivelet intelektuale , fakt që tregon se Gazulli e kishte më të thjeshtë të jepte një shpjegim krahasues në gjuhë të huaj sesa në shqip.

ec me beh – vemende (F.G. f. 58). **me ra buzvet** me thye qafen prej ndonji shkambi (F.G.f.77). **me cbihi andrra** – m'u realizue (F.G. f. 81). **m'u falë me këndin** – m'u përshëndetë (F.G.f. 126) **me hjekë si Lekë Dukagjini** – me hjekë mundime të mdhaja (F.G. f. 176). **hutova burra** – ka hy tash vonë ndër malsina, gabue (F.G.f. 179). **me kjë me fjalë** - m'u gjet havale (F.G.f. 198) etj.

Një tjetër element me vlerë që ndeshim tek Fjalori i Gazullit, është se ai ka përfshirë edhe elemente etnolinguistike, të cilat pasqyrojnë, mendësinë, psikën, karakterin dhe kulturën shpirtërore dhe materiale të popullit shqiptar, sidomos atij në zonat më të skajshme veriore.

Të tilla janë pasazhet leksikore me shpjegimet e duhura:

gjâmue – me i bâ gjâmën të vdekunit me sjellje të caktueme: bashkohen burrnimi t'a mârrmën lajmin e dekës, graniya shkojnëme 'ta; nji grue do të mbajë zânin tue vajtue (vajore, vajtojcë). Burrat kundruell shpisë rreshtohen gna dy e bërtasin dy herë: mjeri ûn për ty, miku, vllau i im! etr.- mjeri ûn-oo, mjeri un-ê-ê!

N'oborr të shpis thrasin kështu katër herë në kambë. Britma do të përsëritet prej gjashtë here në dymbëdhetë herë a njizet' e katër herë, por për here t' parë: të hymën te i vdekuni thrasin prap dý herë, rrahin parzmat prej dhimbe e dahan njëni prej tjetrit tue rrethue vigun; mandej thrasin prap e dý herë vetmas nëkambë; mandej bijnë në gjûj. Në Pukë ndëjnë krahun me shplakë të dorës të apme përmbi të vdekunin e sa herë lohet vigu i ndaluem i rrugës. Në Dukagjin thrasin: kraj'i im: rrahen e gërvishten (përgjaken) në shêj dhimbe, e shum herë shkon gjaku rrëkajë tânzave të faqevet; kapin hundën me dorë tue lëshue nji zâ me shungullue toka. Grueja vetëm vajtohet, por gjinija (gjaku i saj) e vllaznija i bân edhe gjâmën tue thirrë përherë: vëllau i im!¹³⁷

bjerrun- (i,e) (M.M)adj. bjerrë (m'u) : me hî në jaz, m'u veshë në të zi. Jam i bjerrun; N.N âsht i bjerrun; germ. (im Trauer sein a traurig sein.) Në Malësi të Madhe nana vên në krye rubë të bardhë për djalë q ii ka dekë, e tjerët të zezë¹³⁸. (f. 64).

razog-u – (në Kanû të Lekës) - . Dukagjinsit kur pajtohen prej zotnije për punë i thonë: të due kulaçin e xët me djeth, në nade tri rrojët e ditës, as zogun nuk nuk t'a fal, as nuk t'a shes! Hakun t'a due grumbull! Zogu ishte pushimi me dy orë ditë, prandej kur zotnija e harronte thirrshin: ra zogu, flutëroi zogu! 1. Pushim, sa pushon zogu. 2. Haeja e kësaj kohe:

¹³⁷ N.Gazulli, Fjalori i Gazullit, Tiranë, 2005.

¹³⁸ Po aty

*zâmër – a (Kurbini): frz. Po e bâjmë një zog (pushim të shkurtën, sa pushon një zog). Me hângër zogun; me hangër n'e mbasdite; shms. Razogjt ish in koniqet qi i kishte detyrë i Mirditsi Derës Gjumarkejvet, kur ndonji kësi princash dilte me këqyrë gjendjen e popullit*¹³⁹(f. 344).

Gjeografikisht dhe gjuhësisht, Malësia e Madhe dhe Shkodra janë shumë afër njëra tjetrës, kështu që duhet theksuar se Gazulli nuk pasqyroi në Fjalor idiolekte malësorësh, por pasqyroi më së miri të folmen e gegërishtes veriperëndimore.

Duke marrë parasysh shtrirjen dialektore të fjalësit të Fjalorit, vërejmë se, përveç zonave të Malësisë së Madhe, janë përfshirë fjalë edhe nga Puka, Dukagjini, Mirdita, Ulqini, Malësia e Lezhës, Bregu i Bunës, por edhe Tirana (ku Gazulli ka përfshirë fjalë në rrethe).

Një tjetër çështje me interes për t'u trajtuar në Fjalorin e Gazullit, është se shumë fjalëve u jep sinonimen përkatëse në variantin dialektor të gegërishtes, por ka nga ato, të cilave ai u jep vetëm një shpjegim me fjalë. Kjo na lë të kuptojmë se Gazulli nuk gjente korrespondueset e lemave krahinore, për këtë arsye, ai jepte kuptimin e fjalës duke e shoqëruar me fjalë, psh.: **afërmendësh** – mos fol afërmendësh: mos fol nëpër të, dishka atypari, jo gjâ të njimendët-kjo punë është afërmendësh (G. F. 43). **akulltar-e** – njeri qi e ka menden akull, qi i peshon fjalët (G. F. 44). **ardhshëm** - njeri i ardhshë: qi i vjen punës, arsyes: i ndigjueshëm, i shoqnueshëm; punë e ardhshme, qi vjen për doresh, njeri i ardhshëm me kuvend: qi i vjen arsyes (G. F. 48). **balishan-e** – kush lë balishën (G. F. 53). **baltimë,t** – me hangër sa me hjekë baltimën e gojës: të keqt qi merr goja prej së pa ngrânmi; të baltimët (G. F. 53). **ballafaçkë** – të ramë të fyeshëm, e bjerrme me zhurmë; e muer e fitoi një ballafaçkë (G. F. 53). **bastarr-i** – kacafit-i, kësoll' e vogël sa me xânë një a dy vetë, ngrehëer me ruejtë bastanin, berret, etj (G. F. 56). **bucak-u** – ênë uji prej drûni, me çep a lëfyti si jebriku (G. F. 73). **cacë** – ka nisë fëmija me cacë (G. F. 79).

Këto fjalë të rralla që i vërejmë në këtë fjalor, janë fjalë që përdoren në ligjërimin popullor në zona të ndryshme të Veriut të Shqipërisë, të cilat dëshmojnë për një gurrë të çmuar leksikore të fondit shqip dhe na japin larminë e shumëkuptimësinë e përdorimit të fjalës shqipe me ngjyrimet e përftesa që vetëm një filolog si Nikollë Gazulli ka ditur t'i mbledhë e të na i pasqyrojë në këtë Fjalor, siç e quan ai.

Një tjetër misionar i gjuhës dhe i fjalës shqipe është edhe Benedikt Dema. Një tjetër leksikograf në lëmë të të shqipes, i cili edhe ky nuk u njoh bashkë me Fjalorin e tij, deri në vitin 2005, kur u botua nga shtëpia botuese Toena, na la një fjalor krahinor dhe një punë studimore të pasur gjuhësisht. “Fjalori i shqipes”, krahas me “Fjalorin enciklopedik”, janë dy prej veprave më të rëndësishme filologjike të At Benedikt Demës. “Fjalorit enciklopedik”, është i përgatitur në shtatë vëllime dhe ruhet në daktiloshkrim në Arkivin Qendror Shtetëror. Vetë kjo vepër është origjinale në llojin e vet.

Vepra e tij “Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe”, një punë mbledhëse 18 vjeçare, është një thesar më tepër në leksikologjinë e leksikografinë shqiptare, Ky Fjalor u përfundua në vitin 1966, me qëllimin për të dalë në shtyp, por nuk doli asnjëherë.

Siç thekson edhe vetë autori, ky Fjalor është një shtesë e fjalëve që i bëhet Fjalorit të gjuhës shqipe, 1954, duke përfshirë shumë fjalë që nuk përmenden, ose që kanë një kuptim të ndryshëm nga ai i pasqyruar në Fjalorin e '54.

¹³⁹ N.Gazulli, Fjalori i Gazullit, Tiranë, 2005.

Për hartimin e këtij Fjalori, ai u mbështet tek “Fjalori i Bashkimit”, 1908, “Fjalorthi i Gazullit” 1942, tek disa vepra të Fishtës e të Kanunit të Lekë Dukagjinit, duke mos lënë pa përmendur edhe punën e vyer studimore që ka mbledhur autori prej gojës së popullit. Fjalësi i këtij Fjalori pasqyron të folmen e gegërishtes veriperëndimore, zonën e Shkodrës e Malësisë së madhe me rethinat e saj.

Vend me rëndësi në këtë Fjalor zënë edhe neologjizmat, fjalë të krijuara nga vetë autori, të cilat i japin kësaj veprë një veçanti më vete.

Modestia e tij del qartas në fjalë të tilla:” *Pranimi ose mospranimi i tyne në Fjalorin e gjuhës sonë mvaret edhe këtu prej gjykimit të përbashkët të shkrintarve shkencatarë*”¹⁴⁰

Përfshihen rreth 284 neologjizma të krijuara nga vetë autori, kryesisht të sferës shkencore, fjalë që i përkasin sferës së bimëve, sferës së frymorëve, fushës së mjekësisë, fjalë që përfshijnë shpendë dhe lloje peshqish të ndryshëm.

Nuk duhen lënë pa përmendur edhe frazeologjizmat, të cilat e pasurojnë edhe më tepër gjuhësisht veprën e tij, por edhe japin një pasqyrë më të thelluar të dialektit veriperëndimor, përmes varianteve dialektore të përdorura. Dema nuk është se ka përdorur ndonjë shenjë përkatëse në ilustrimin e tyre, por i kemi gjetur në sajë të shpjegimeve që u ka bërë autori leksemave të veçanta. Vërehet mirëfilli se shumica prej tyre janë variante dialektore ose edhe frazeologjizma krahinore, të cilat zënë vend përdorimi vetëm në disa krahina të caktuara dhe vështirë t’i ndeshim të shpjeguar në Fjalorët e shqipes e sidomos në atë të Frazeologjizmave.

Ader-dra – *llafe, fjalë kote, pallavra, dokrra, shaka: Me qite (thye) adra: me ba llafe koti (kote)*, (D. f. 11). Tek Fjalori Frazeologjik nuk e gjejmë me të njëjtën trajtë si tek Dema, por kemi sinonimen e saj, **çan dokrra** (dikush) – *çan dërrasa* (dikush), ose mund të kemi edhe një tjetër frazeologjizëm sinonim me këtë, (thotë) **dokrra në hi** – *flet kot, as vetë nuk e di se ç’thotë, flet gjepura* (FFGjSh, f. 80).

Me i marre kuj anen – *me u largue prej kuj, me e shikjue jo me dashtni* (D. f. 13). Me të njëjtin kuptim që ka dhënë Dema nuk e ndeshim tek Fjalori i Frazeologjizmave (2006). Gjithashtu nuk e ndeshim as në Fjalorin e gjuhës shqipe, 1980.

Me qite kend manesh – *me e da prej tjerve* (per me folë veçmas etj) (D. f. 13). Ndajfolja **manesh** nënkupton më anash, krahinorizëm që përdoret në gegërishten veriperëndimore, zona e Malësisë së Madhe – 1. *Anash, mane, mënjane, njananë*, 2. *Veças të tjerëve, damas*, 3. *Mbanë*, 4. *Mënjane; larg syve të dikujt* (FGjSh, Mehmet Elezi, f.873). Në Fjalorin Frazeologjik të Jani Thomait nuk e ndeshim si të tillë, me të njëjtin kuptim, por takojmë në këtë formë, **e nxjerr në anë** – 1. *dikë a diçka. E shpëtoj nga një e keqe, e ndihmoj të kapërcejë vështirësitë*, 2. *diçka. E përfundoj, e çoj deri në fund, e kryej me sukses* (FFGjSh, f. 5).

Me ra manesh – *me ra perbri* (D. f. 13). Këtë frazeologjizëm nuk e ndeshim të shpjeguar në këto Fjalorë. Gjithashtu edhe Fjalori i gjuhës shqipe 1980, nuk e ka si fjalë, sepse kemi të bëjmë me një krahinorizëm të mirëfilltë të zonës veriperëndimore.

Me u çmekë së ngranuni, jam çmekë gazi – *me ba një veprim në tepri* (D. f. 41). E ndeshim tek Mehmet Elezi, **çmek/em** – *me u çmekë (prej ç + mekem), lodhem së ngrëni, më merret fryma. “ m’u çmekë së ngranëmi”* (Gazulli), (FGjSh, Mehmet Elezi, f. 314). Sipas Elezit, Dema e ka të huazuar nga Gazulli këtë frazeologjizëm.

Gjujzue – *me iu ulë kuj nder gjuj* (D. f. 80). Ndonëse si frazeologjizëm është tepër i përdorur në ligjërimin e përditshëm, nuk e gjejmë të përdorur në Fjalorët e përmendur. E

¹⁴⁰ B.Dema, Fjalor fjalësh të ralla të gjuhës shqipe, Tiranë, 2005.

ndeshim në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, 1980 në dy kuptime, **gjunjëzohem**- 1. *bie ose ulem në gjunjë para dikujt a diçkaje, përgjunjem* (FGjSh, 1980), 2. *përulem para forcës së dikujt, e pranoj veten të mposhtur, bie në gjunjë; kërkuj mëshirë; përgjunjem* (FGjSh, 1980).

Me hjekë mirë/keq – *me jetue mire / keq* (D. f. 86). Me të njëjtën formë nuk e ndeshim, por kemi sinonimen e saj tek J. Thomai, **bëj jetë**- *jetoj në kushte të mira, rroj mire* (FFGjSh, f. 212).

Me e hjekë me krye (gjindë): *me e pague një faj me jetë të vet a të gjindve të shpisë* (D. f. 86). Kemi sinonimin e saj te Fjalori Frazologjik, **i iku (shkoi) kryet** – *i iku (shkoi) koka dikujt* (FFGjSh, f. 262).

Kacanelë – marrë hov (D. f. 93). E kemi si të tillë, **merr hov** – *nis të zhvillohet a të veprojë me vrull, ngrihet e përparon më me forcë* (FFGjSh, f. 202).

Kushatisë – çue dam krejt (D. f. 114). Të njëjtin frazeologjizëm e kemi edhe tek J. Thomai, **e bën (e çon, e hedh) dëm** – 1. *e prish kot, nuk ia shfrytëzon vlerat, e harxhon kot, nuk e vë në punë, nuk e shfrytëzon*, 2. *e vret* (FFGjSh, f. 72). Vërejmë se Fjalori frazeologjik jep një kuptim të dytë të këtij frazeologjizmi, që nuk e ndeshim tek Dema.

Maraz – me u çue toka maraz (D. f. 129). Këtë frazeologjizëm nuk e ndeshim në këto Fjalorë. Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, 1980, e takojmë si fjalë të ligjërimit bisedor, por si frazeologjizëm nuk ekziston dhe kuptimi nuk na përkon me atë të Demës, **maraz-i** – 1. *ndjenjë munduese që lind nga dëshira e madhe për të pasur diçka që e ka dikush tjetër ose për t'ia kaluar dikujt, smirë, inat*, 2. *hidhërim, brengë* (FGjSh, f. 1058).

Siç vërehet të tre këta “të mëdhenj” të leksikografisë shqipe na lanë një trashëgimi të pasur gjuhësore, ku secili prej tyre është “i parë” në llojin e vet.

Fjalori i Bardhit përbën Fjalorin e parë të mirëfilltë dygjuhësh shqip – italisht, Gazulli na la Fjalorin e parë krahinor (të gegërishtes veriperëndimore), Dema, gjithashtu, i parë në llojin e vet, ku me punën e tij hulumtuese, na pasqyroj një shtesë fjalësh që nuk ekzistonin në Fjalorin e gjuhës shqipe të '54, ose që kishin një kuptim të ndryshëm nga ky Fjalor.

E përbashkëta e këtyre autorëve ishte se të tre dhanë një kontribut të vyer në lëmë të leksikografisë, duke na lënë tre fjalorë të mëdhenj, dhe më e rëndësishmja, vërejmë se në këta fjalorë, pasqyrohet e folmja geqe, përkatësisht zona e Zadrimës, Shkodrës dhe Malësisë së Madhe.

Recenzentë:
Prof. as. dr. Tefë Topalli
Prof. as. dr. Mimoza Prik

**Dr. Shykrane GËRMIZAJ¹: PËRBALLJA E SHQIPES ME ANGLISHTEN –
BEGATIM APO VARFËRIM**

¹Profesor i rregullt
Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze
Fakulteti i Filologjisë
Universiteti i Prishtinës

Abstrakt

Shqipja, duke qenë në kontakt të përditshëm me anglishten, si rrejdhojë e ndryshimeve shoqërore dhe ekonomike, por në radhë të parë ndryshimeve globale politike, në këto përballje po has në vështirësi natyrash të ndryshme në shumë rafshe. Para së gjithash këto lënë vrragë të thella në leksikun e shqipes, por nga to nuk kursehet as struktura e saj në të cilën pandalshëm po depërtojnë struktura të huaja që bien ndesh me natyrën e shqipes.

Përmes një analize të gjithanshme, autorja e këtij studimi mëton të hetojë dhe të paraqesë ndikimet pozitive dhe negative të kontakteve të anglishtes me shqipen, duke hedhur dritë mbi një varg faktorësh që ndikojnë në pasurimin, por edhe në degradimin e shqipes, që rezulton sa në lehtësimin e komunikimit nga njëra anë, po aq edhe në vështirësimin dhe pengimin e tij nga ana tjetër.

Fjalët kyçe: *anglishtja, kontaktet, komunikimi, ndikimi, shqipja.*

**CONFRONTATION OF ENGLISH AND ALBANIAN – ENRICHMENT OR
IMPOVERISHMENT**

Abstract

Being in day to day contact with English as the result of the social and economic, and above all the global political changes which affected our soils as well, Albanian encounters obstacles of diverse nature at various levels. These primarily leave deep traces in the lexis of Albanian. However, its structure is not spared either since foreign structures incompatible with the nature of the language penetrate into Albanian.

Through a comprehensive analysis, the author of the study attempts to investigate and present the positive and negative impact of the contacts of English and Albanian, shedding light on a number of interrelated factors that result in the enrichment of Albanian, as well as its impoverishment. In consequence, communication is facilitated on the one hand, and impeded on the other.

Key words: *Albanian, contacts, communication, English, influence.*

Kontaktet e shqipes me anglishten nuk janë të datës së vonë. Po bëhen plot dy shekuj që nga kohët e kontakteve të para të shqipes me gjuhën angleze dhe kulturën anglishtfolëse, fillimisht përmes udhëpërshkrimeve¹⁴¹ e ndonjë sprove në rrafshin gramatikor e leksikografik¹⁴², përballje këto të cilësuar si dinjitoze.¹⁴³

Që nga ajo kohë, shqipja, përkundër mungesës së kontakteve të drejtpërdrejta si rrjedhojë e largësisë gjeografike, ka vazhduar komunikimin e saj me këtë gjuhë rruzullore përmes fjalorëve, përmes përkthimeve, të shumtën e rasteve të teksteve letrare, duke përfshirë këtu edhe përkthimet nga gjuhë të ndërmjetme që kanë shërbyer si urë lidhëse për komunikim nga teksti burimor në anglishte deri te teksti i synuar në gjuhën shqipe. Si do që të jetë, duhet pranuar se këto kontakte megjithatë kanë qenë të kufizuara si nga vëllimi, ashtu edhe nga intensiteti.

Duke e kujtuar rrethanën se fjalorët e parë të mirëfilltë anglisht e shqip dhe shqip e anglisht u botuan vetëm në fillim të shekullit XX, megjithatë duhet nënvizuar faktin e pamohueshëm se vargu i gjatë i fjalorëve, tiparet dalluese të tyre që mundësojnë një periodizim të qartë të fjalorëve të përgjithshëm dygjuhësh të këtyre dy gjuhëve, dëshmojnë jo vetëm traditën e begatë të leksikografisë shqiptare, por edhe zhvillimin e pandërprerë të saj, dhe rrjedhimisht, edhe vazhdimësinë dhe përshkallëzimin e përballjes së gjuhës shqipe dhe asaj angleze.

Fjalorët e vegjël me format xhepi, me fjalës të kufizuara dhe me qëllime kryekëput praktike e karakterizuan gjysmën e parë të shekullit XX. Mesi i shekullit XX, përkatësisht botimi i fjalorëve të Stuart Mannit,¹⁴⁴ shënoi një kthesë të rëndësishme në praktikën leksikografike të fjalorëve dygjuhësh. Në fjalorët e Mannit jo vetëm se u vunë krah për krah shqipja dhe anglishtja, por njëkohësisht u vunë edhe themelet e një shkolle moderne të hartimit të fjalorëve dygjuhësh, me synimet që në ta të përmblihdeshin fjalët e fondit themelor të anglishtes në ‘gjuhën e sotme letrare shqipe’, siç shprehet autori, në kohën kur kjo ide, sa e guximshme aq edhe përparimtare, sikundër dihet, ende nuk ekzistonet në trojet tona.¹⁴⁵

Përfaqset e shqipes me anglishten përmes fjalorëve dygjuhësh shqip e anglisht vazhduan edhe në gjysmën e dytë të shekullit XX. Autorët e fjalorëve që u botuan në këtë periudhë në shumë aspekte i ndoqën shtigjet e rrahura mirë nga Manni, mirëpo vëllimi i fjalësit, tipi dhe qëllimet e fjalorëve mbetën të pandryshuar.¹⁴⁶

¹⁴¹ Hobhouse, J.C. (1813). A journey through Albania and other Provinces of Turkey in Europe and Asia, to Constantinople, during years 1809 and 1810. London

¹⁴² Leake, W. M. (1814). Researches in Greece. London

¹⁴³ Mansaku, S. (1996). Kontributi i studiuesve rumunë për historinë e gjuhës shqipe, në Kontribute të albanologëve të huaj për studimin e gjuhës shqipe, Studime shqiptare 5, Universiteti i Shkodrës, Shkodër

¹⁴⁴ Mann, S. (1948). An Historical Albanian – English Dictionary (1496-1938). London; (1957). An English – Albanian Dictionary. Cambridge University Press. London. Ribotim “Rilindja” Prishtinë, 1982.

¹⁴⁵ Gërmizaj, Sh. (2004). Stuart Manni – admirues i madh i shqipes dhe shqiptarëve. Prishtinë

¹⁴⁶ Gërmizaj, Sh. (2005). Fjalorët anglisht shqip e shqip anglisht – Arritje dhe sfida në Leksikografia shqiptare – Trashëgimi dhe perspektivë, ASHSH dhe ASHAK, Tiranë

Për shtimin dhe përshkallëzimin e kontakteve të shqipes dhe anglishtes në këtë periudhë me rëndësi është themelimi i Katedrës së Gjuhës dhe letërsisë Angleze nga njëra anë, dhe ofrimi i gjuhës angleze si gjuhë e huaj në shkollat tona, nga ana tjetër. Këta qenë dy faktorë vendimtarë shtytës që ndikuan në shtimin e interesimit, por edhe në përhapjen dhe shtrirjen dhe intensifikimin e kundërvënies së shqipes me anglishten, natyrisht jo aq përmes kontakteve të drejtpërdrejta sa përmes literaturës: teksteve shkollore, fjalorëve, ndonjë programi në radio dhe televizion, e të ngjashme.

Hapja e Shqipërisë ndaj botës në të nëntëdhjetat dhe krijimi i realitetit të ri në Kosovë në periudhën e paraluftës, e sidomos në atë të pasluftës, si dhe proceset gjithintegruese në shkallë rruzullore, me të cilat u kapluan edhe trojet tona, bënë që këto kontakte jo vetëm se të shtrihen në gjithë arealin gjuhësor të shqipes, por edhe ta arrijnë intensitetin kulmor. Në saje të ndryshimeve politike në vendin tonë, ndryshoi edhe statusi i gjuhës angleze. Nga një gjuhë e huaj, e cila në planet mësimore të shkollave tona fillore hyri në fund të të gjashtëdhjetave, arriti ta ketë statusin e gjuhës së dytë, pra, të gjuhën zyrtare të administratës ndërkombëtare, për të vazhduar funksionin e saj, sikurse edhe anë e mbanë rruzullit tokësor, si *lingua franca* e kohës sonë.

Periudha e administrimit ndërkombëtar në Kosovë, kontaktet e drejtpërdrejta të përditshme të anglishtes me shqipen, kërkesa e shtuar tej mase për përkthim të teksteve të shkruara dhe të folura, kuptohet të teksteve joletrare, padyshim ia dha shtysën vendimtare ndikimeve të gjuhës angleze në gjuhën shqipe. Përballja e gjuhës shqipe me gjuhën angleze, me një gjuhë me leksik kaq të pasur,¹⁴⁷ natyrisht nuk mund të zhvillohej pa pengesa natyrash të ndryshme, e as pa vështirësi; rrjedhimisht nuk mund të mos linte vrragë në sistemin gjuhësor të gjuhës sonë. Nëse e kujtojmë thënien e Jakobsonit se gjuhët dallojnë thelbësisht nga njëra tjetra nga ato (kuptime, shënimi im) që duhet të bartin, e jo çka mund të bartin,¹⁴⁸ është e qartë se shqipja u detyrua të bartte jo vetëm ato që duhej dhe mund të bartte, por edhe ato që nuk mund të bartte.

Nga ana tjetër, një rol jashtëzakonisht të madh në tërë këtë proces pati dhe ka zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, por edhe qëndrimi i folësve burimorë të shqipes në radhë të parë ndaj gjuhës shqipe, pastaj edhe ndaj gjuhëve të tjera. Qëndrimi i shkujdesur ndaj shqipes në përdorimet publike, qëndrimi gjithnjë e më pak konservativ, gjithnjë e më liberal, jo vetëm ndaj ndikimit të anglishtes, por edhe ndaj ndikimeve të gjuhëve të tjera në përgjithësi, bënë që shqipja të ndikohet në të gjitha rrafshet: në rrafshin drejtshkrimor dhe drejtshqiptimor, në atë leksikor e semantik, por edhe në rrafshin gramatikor.¹⁴⁹

¹⁴⁷ Në vitin 1965 konsiderohej se po të hartohej një fjalor i gjuhës angleze i cili do të përfshinte gjithë fjalët e leksikut të gjuhës angleze, ai do të përmbante rreth 650 000 fjalë. Më 20 qershor 2009 gjuha angleze e ka kaluar pragun e një milion fjalëve sipas Global Language Monitor

<http://www.languagemonitor.com/no-of-words/> data e qasjes 29 prill 2012.

Po atë vit S. Manni në Konferencën e parë të Studimeve Albanologjike në kumtesën e tij *Shqipja si gjuhë indoevropiane* pohonte se shqipja i kishte rreth 100 000 fjalë.

¹⁴⁸ Jakobson, R. (1959/2000). On Linguistic Aspects of Translation. Cituar sipas Munday, J. *Introducing Translation Studies, Theories and Applications*. Routledge. London & New York, 2005, f. 37

¹⁴⁹ Gërmizaj, Sh. (2008). Kontaktet e shqipes me anglishten – përparësitë dhe rreziqet, Seminari XXVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare

Si rrjedhojë e rrethanave që u zunë ngoje, periudha e përmendur u karakterizua me huazime të shumta, jo vetëm për realitetet jashtëgjuhësore që po depërtonin ose po krijoheshin, por edhe për realitetet jashtëgjuhësore ekzistuese për të cilat shqipja kishte emërtime të gurrës vendore. Në këtë vazhdë, krahas huazimeve të reja nga anglishtja, si prurje të reja, shumë huazime më të hershme që ishin shtresëzuar në leksikon e shqipes dalëngadalë u zëvendësuan me huazime të reja. Po të përmendim vetëm disa nga regjistri i gjatë i fjalëve të huazuara si **adresim, adresoj, akceptoj, akses, aprincipial, aset, atitudë, blu, eveniment, event, fans, ingranazh, inxhinier civil, kek, kurrikul, listim, listoj, obesitet, pozitë, pozicion, pub/ pab, resurs, rimbursim, rimbursoj, sillabus/syllabus, suportues, suportoj, surprizë, surprizoj, trajnim, trajnoj, trajner, workshop**, që i dëgjojmë dhe i lexojmë nga dita në ditë, kujtoj se mjaftojnë për ta ilustruar prodhimtarinë e dukurisë. Përveç këtyre, me huazimin e fjalëve nga gjuhët e tjera u formuan çiftet, por edhe vargjet, sinonimike (khs. p.sh. **vend pune: post, pozitë, pozicion; udhëheqës: menaxher, zyrtar i lartë, shef**, etj.). Nga ana tjetër, u formuan edhe çiftet barasvlerëse mashtruese, të cilat, ndonëse ngjasojnë nga forma, në gjuhën marrëse mund të kenë pësuar një rivlerësim semantik, prandaj nuk e bartin përmbajtjen semantike që e kanë në gjuhën dhënëse (khs. **actual: aktual; actually: aktualisht; accidental: aksidental; accidentally: aksidentalisht; honorary: honorar; physician: fizikan; termat: terms**). Vetëm atëherë kur vendosen këto fjalë në kontekst, del në pah vlera e tyre e vërtetë semantike, mirëpo këtë mund ta hetojnë vetëm dygjuhësorët, ndërkaq folësit burimorë të shqipes që nuk e zotërojnë anglishten nuk mund ta dinë këtë, andaj edhe i përdorin ashtu siç i hasin në gjuhën e folur dhe atë të shkruar, siç dëshmohet nga fjalitë që po i sjellim në vijim:

Actually he told me another story. (= në të vërtetë)

Aktualisht jemi duke i shqyrtuar dy çështje. (= tani, në këtë kohë)

The actual number of students in our department is... (= i vërtetë, real)

Regjistrimi i studentëve është çështje aktuale në universitet.

The enrollment of students is a current issue at the university.

Babai i tij është një fizikan që ende praktikon mjekësinë në Tbilisi. (= mjek)

His father is a physician who still practises medicine in Tbilisi.

Termt e marrëveshjes ishin caktuar nga...

The terms of agreement were... (= kushtet e marrëveshjes)¹⁵⁰

Me këto procese dita ditës po pasurohet shtresa e veçantë e leksikut të shqipes, ajo e ndërkombëtarizmave, gjë që është e natyrshme. Pas periudhave të përballjes me mungesën e fjalëve të barasvlerëse nga njëra anë, dhe qëndrimeve puriste ndaj ndërkombëtarizmave nga ana tjetër, prej çerekshekullit të fundit të shekullit XX e këndeje, vazhdimisht hetohet qëndrimi gjithnjë e më liberal ndaj ndërkombëtarizmave, mbase, mes tjerash, edhe si rrjedhojë e qëndrimit të ngjashëm të përdoruesve të gjuhës shqipe.

Në fjalorët dygjuhësh anglisht e shqip, për shkak të përpunimit të fjalëve mbi bazën e artikullit, kjo dukuri hetohet lehtë. Vende-vende, si pasojë e numrit të madh të ndërkombëtarizmave e profesionalizmave, si dhe fjalëve që i përkasin terminologjisë teknike e shkencore, krijohej përshtypja se bëhej fjalë për ndonjë fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja. Në këto kushte, në fjalorët e tillë, rrjedhimisht, mbetej fare pak vend për ilustrimin e përdorimit të fjalëve, për ilustrimin të lidhjeve të qëndrueshme e të paqëndrueshme në të

¹⁵⁰ Gërmizaj, Sh. (2005). Translation Theory in the Classroom. Prishtina

cilat hyn fjala përkatëse, për prezantimin e frazeologjisë, dhe çështje të ngjashme që lidhen me fjalorët dygjuhësh. Mirëpo, rrethanë vështirësuese paraqitej edhe shpërputhja mes kërkesës së tejtheksuar për fjalorë një dhe dygjuhësh nga njëra anë, dhe ofertës ekzistuese, nga ana tjetër.

Edhe pse në kapërcyellin e shekullit XX dhe XXI u botuan një numër fjalorësh me fjalës shumë më të gjerë se ato të periudhës së mëhershme që do të mund të cilësoheshin si fjalorë të mesëm, për shkak të numrit të madh të ndërkombëtarizmave, më saktësisht anglicizmave që përfshiheshin në fjalësinë e tyre, dalëngadalë u fshi kufiri mes fjalorëve të përgjithshëm, pra, jospecial, joterminologjikë, dhe atyre të fushave të veçanta të dijes. Në mungesë të fjalorëve shpjegues, që do të jipnin ndihmesë në gjetjen apo edhe krijimin e fjalëve të barsvlershme, ndodhi dhe po ndodh ajo që është e pashmangshme – depërtimi dhe përhapja e fjalëve të huazuara.

Në këtë periudhë, krahas krijimit të institucioneve dhe segmenteve të aparatit shtetëror, në shqipe u shfaqë edhe prirja e theksuar për krijimin dhe përdorimin e akronimeve për emërtimet përkatëse të plota. Një dukuri e tillë ishte sa e pritshme, po aq edhe e arsyeshme në këtë kohë kur vendi ynë përpiqej ta mbante hapin me zhvillimin e vrullshëm dhe hovin e krijimit të institucioneve në procesin e rindërtimit të shoqërisë dhe shtetndërtimit. Mirëpo, duhet të vihet në pah fakti se krijimi i akronimeve në diskursin e shkruar ishte në dorë të secilit tekstshkrues, artikullshkrues, përkthyes, apo redaktor gazete, ndërkaq në diskursin e folur ato krijoheshin nga përdoruesit e gjuhës shqipe, pra nga gjithë ne.

Nga ana tjetër duke e patur parasysh statusin dhe funksionin e anglishtes në këtë periudhë situata ndërlikohej edhe më shumë për faktin se krahas akronimeve të gurrës vendore përdoreheshin edhe akronimet e gurës së huaj. Edhe pse dihet mirëfilli se motivi parësor i krijimit të akronimeve është shkurtimi, pra ekonomizimi me hapësirë dhe kohë, dhe lehtësimi i transmetimit të informacionit, mungesa e emërtimeve të plota në mediet e shtypura, që nuk ishte dukuri e rallë,¹⁵¹ e mjegullonte kuptimin dhe e vështirësonte zbërthimin e kuptimit tërësor të tekstit në shkallë të konsiderueshme dhe, rrjedhimisht, e vështirësonte si transmetimin, ashtu edhe absorbimin e informacionit.

Pengesat në komunikim shfaqeshin dhe po shfaqen për shkak se nga krijimi i një akronimi deri te shtresëzimi i tij në leksikon e shqipes, pra identifikimi dhe përdorimi i saktë i tyre, merr një periudhë relativisht të gjatë kohore. Sa për ilustrim: DAQ, DME, DRAPSH, DRGJC, DRM, IPK, KM, QKSPZHC, ZAB, ZIE, ZL, ZP, ZPM, ZDNJ janë akronimet nga lista jo e plotë e njëres nga ministrinë tona. Duke qenë se ky proces fjalëformues doli të jetë tejet prodhimtar dhe i vrullshëm, dhe në mungesë të burimeve të referencës, përkatësisht një fjalori të akronimeve të gjuhës shqipe, komunikimi përmes gjuhës shqipe, sidomos përmes gjuhës së folur u vështirësua në masë të konsiderueshme për shkak të mjegullimit të kuptimit.¹⁵²

Duket sheshit se gjuha e folur, duke qenë më e hapur ndaj ndikimeve të jashtme, po kërruset në përballjen e saj me anglishten. Në këtë mes rol kyç ka edhe njohja e pamjaftueshme e gjuhës standarde shqipe dhe kujdesi i pamjaftueshëm i folësve burimorë të shqipes, gjë që pasqyrohet edhe në mediet elektronike ku hasen modele komunikimi që

¹⁵¹ Gërmizaj, Sh. (2003). Përdorimi i akronimeve në gjuhën shqipe, Kulturë Gjuhe 1, Prishtinë.

¹⁵² Gërmizaj, Sh. (2011). Akronimet në diskursin e folur dhe të shkruar: *AKTET*, Revistë e Institutit Alb-Shkenca, Tiranë – Prishtinë - Shkup, Vëll. IV nr. 4: 745-750.

KUMTESA

vështirë mund të cilësohen si komunikim publik. Për shkak të numrit të madh të huazimeve nga anglishtja (dhe ndonjë gjuhë tjetër), kalkeve, transfereve të kodit, dialektizmave dhe krahinarizmave, po promovohen modele të komunikimit joformal, që pastaj ndiqen dhe përvetësohen nga publiku. Atë që unë e çmoj brengosëse janë rastet kur folësit burimorë të shqipes komunikojnë në shqipe dhe pengesat në komunikim përpiqen t'i kapërcejnë përmes anglishtes. Ka raste kur edhe ia dalin.¹⁵³ Kjo për pasojë ka edhe përshkallëzimin e ndikimit të anglishtes, por edhe gjuhëve të tjera mbi shqipen.

Duke e përmbyllur këtë kumtesë kujtoj se përfundimi që buron nga hollësitë që u paraqitën këtu është se anglishtja nuk e varfëron, por e begaton shqipen. Mirëpo, ajo varfërohet nëse ne, folësit burimorë të shqipes, tregojmë kujdes të pamjaftueshëm ndaj gjuhës sonë. Duke e mbajtur një qëndrim tejet liberal ndaj ndikimeve të jashtme, shqipja do të begatohej, por në dëm të shqipes. Me qëndrimin tejet purist ndaj ndërkombëtarizmave, shqipja do të varfërohej, dhe kjo përsëri do t'i shkaktonte dëm shqipes.

Për ta mbajtur një qëndrim të baraspeshuar, pra as skajshmërisht liberal, e as skajshmërisht purist, kërkohen përpjekje të përbashkëta dhe ndihmesë e vazhdueshme institucionale dhe individuale nga gjithë ne: gjuhëtarët, institucionet arsimore, mediet, por edhe gjithë folësit burimorë të gjuhës shqipes. Mirëpo, krahas përpjekjeve tona janë të domosdoshme edhe burimet përkatëse të referencës: fjalorë njëgjuhësh dhe dygjuhësh, të përgjithshëm dhe të veçantë, të shtypur edhe elektronikë, me fjalës shumë më të pasur se ata ekzistues, në mënyrë që shqipja të vazhdojë komunikimin e saj me anglishten në mënyrë dinjitoze, ashtu siç i ka hije kësaj gjuhe të lashtë, që ajo të mbetet 'mahnitëse',¹⁵⁴ ashtu siç në vazhdimësi cilësohet nga studiuesit e huaj të shqipes.

Recenzentë:
Prof.dr. Abdullah Zymberi
Prof.dr. Ymri Badallaj

¹⁵³ Gërmizaj, Sh., (2011). Shqipja e shekullit XXI, Takimi i VI Vjetor I Institutit Alb-Shkenca, Prishtinë

¹⁵⁴ Joseph, B. (2009). Preface në Gërmizaj, Sh. Anglishtja dhe shqipja - Përjasje e kundërvënie, Prishtinë

Evis CELO¹(Ph.D), Lorenc DANAJ(Ph.D Candidate)²: MASMEDIA MODERNE – PUSHTETI I KOMUNIKIMIT . QENDRIME DHE OPINIONE TE NDRYSHME

¹University of Vlora “Ismail Qemali” Department of Foreign Languages
²Dean of Law & Justice Department

Abstract

Today's society with the rapid development of cinema, television, computer has managed to make a revolution of all the time. Cultures in the reality of globalization, still fail to accept each other un-conditionally. The fragility of communication today, is really due to a deep analysis of the process by which our life depends so much on social, familiar and human relationship. In media the information flux is valuable in some cases, but the most is useless. People and consumers of media, like others obviously can not pay attention to every message that comes their way. They might go insane if they tried. Which message are they listening to? Which do they believe? How do they choose? How does the proverb language affects in comprehending a problematic-conflictual situation or just social life?

As the society itself is, the media are an unstoppable flux and in the coming decade we need to reflect too many changes, but two are vivid: a) In linguistic field b) In social field. In our thesis we have treated some basic point which are the fund of all the procedure.

Media and their power in which it is shown that their most important duty is not only to inform the public, but even in the influential and the convenience of the interest where media is centered to be situated. The media are serving like channels for the information expand and exchange.

Audiences and attitudes. Audience is not a passive follower of media, on the contrary it is dynamic in this process of massive communication. The editors determine what public likes and within certain limits defines the type of the material he wants.

Hyrje

Komunikimi është sot ceshtja më e rëndësishme e shekullit të XXI. Komunikimi është ai që lidh dhe ndan njerëz dhe popuj .Përmes tij ,shënohen pakte dhe vjen paqja.Po përmes tij ,nga moskuptimi lindin luftëra që marrin jetë njerëzish .Shoqëria e sotme me zhvillimin e vullshëm të knmasë,televizionit,kompjuterit,ka arritur të bëjnë revolucion të të gjitha kohërave në komunikim.Përsëri ,edhe pse barrierat e distancës ranë,komunikimi vazhdon të jetë problematik.Kulturat në realitetin e globalizmit ,nuk arrijnë ende të pranojnë pa kushte njëra-tjetrën.Brishtësia e komunikimit sot ,është vërtet shkak për një analizë të thellë të këtij procesi prej të cilit varet kaq shumë jeta jonë në marrëdhëniet shoqërore,familjare dhe njerëzore.Në mediat e përditshme fluksi i informacionit në disa raste është i vlefshëm,por pjesa më e madhe është e papërdorshme.Njerëzit dhe konsumatorët e medias,dukshëm nuk mund ti kushtojnë vëmendje të vecantë cdo mesazhi që ata marrin. Kështu të dalin pyetjet .

Cilin mesazh duhet të dëgjojnë? Cilin duhet të besojnë? Si ta zgjedhin? Sa ndikon gjuha proverbiale në kuptimin e një situatë problemore-konfliktuale apo thjesht jetesore-sociale? Sic është shoqëria në vetvete edhe mediat janë në një fluks të pandalshëm dhe në dekadat e ardhshme ne duhet të reflektojmë shumë ndryshime, por dy janë më të prekshmet : **a)** në rrafshin gjuhësor **b)** në rrafshin social

1.2. Mediat dhe shoqëria.

Mediat janë problematike në raport me shërbimin që kryejnë, por ato kanë problematikë edhe në realitetin e ri global. Sipas Wolton-it: “Qysh nga vitet 1950, mediat masive kanë luajtur tri role kryesore nga pikëpamja e kohezionit: një rol, së pari politik, të lidhur me rindëritimin e shteteve-kombe pas luftës, një rol shoqëror të kohezionit, për të zbutur goditjen e të gjitha shndërrimeve shoqërore dhe një rol kulturor për të menazhuar multikulturalizmin e shoqërive tona. Individualizmi që na rrethon nuk mund të mos mbështetet në një minimum kohezioni shoqëror e kulturor. Shoqëria e informacionit u përgjigjet rrjeteve botërore të informacionit, shoqëria e komunikimit bashkëjetesës në gjirin e shteteve-kombe” (Wolton, 2009:115)

Në analizën që ai i bën medias masive dhe asaj individuale, ai del në konkluzionin se, komunikimi ka një sfidë përpara, për të, nuk kanë rëndësi kanalet, por sfidat, dhe se ai tashmë ndodhet mes kontradiktave gati të harruara : kontradiktave politike. Mediat, detyrimisht në atë çfarë prodhojnë e përcjellin, nuk i ndan dot nga interesat e politikës, prandaj, në analizën e arsyeve të imazhit që gëzojnë shqiptarët sot në mediat italiane, nuk mund të mos “hetohet” dhe argumenti i lidhjes media-politikë.

”Janë mediat ato që duhet të menaxhojnë identitetet e shumta të individëve të lidhur njëkohësisht me shoqërinë e masës, individualizmin, komunitarizmin, identitetin kombëtar, Evropën dhe botën.” (Wolton 2009:111) Në rendin e ri botëror të një shoqërie multikulturore, mediat marrin një rol të ri akoma më të fuqishëm dhe që sigurisht, duhet të jetë në sinkron me vlerat e bashkëjetesës mes popujve dhe ky duhet të kthehet në misionin e ri të mediave në kohët moderne. Roli i saj në krijimin e modeleve pozitive të bashkëjetesës dhe qytetarisë njerëzore është një kontribut i nevojshëm dhe i domosdoshëm për edukimin e shoqërisë. Nëse mjaftohet vetëm me informimin, atëherë fuqia e saj është e paplotë, pasi mungon misioni i këtij informimi : edukimi i shoqërisë në një botë modern, ku kufijtë bien e bëhen çdo ditë e më të papërfillshëm, dritarja e saj e lajmit duhet të përçojë anekënd Botës, lajmin e madh se qytetërimi ka arritur stadin final: komunikimin dhe përmes tij, bashkëjetesën.

Derisa kjo ditë të vijë, media do të vazhdojë lidhjen dhe raportet e saj me shoqërinë, por duhet t’i paraprijë ditës që komunikimi harmonik të jetë mënyra, sesi njerëzit e këtij planeti me kultura, gjuhë dhe histori të ndryshme, të pranojnë njëri-tjetrin duke lënë pas, dallimet dhe duke gjetur atë që i bashkon : të qenit qytetarë të Botës.

1.3. Teoritë që kanë në fokus mediat

Sipas modelit të autorit Lasuellit: *“...të identifikosh dhënësin do të thotë të analizosh vepruesit(autorët, producentët e masmedias apo grupe interesi), që janë në burim të komunikimit si dhe mekanizmat e prodhimit të informacionit kolektiv.T’i përgjigjesh pyetjes së dytë (Çfarë ?) do të thotë të thotë të analizosh mesazhin, pra përmbajtjen e transmetuar përmes një mediumi, cilido qoftë ai. Kur pyetet (Si?) i referohemi transmetimit të mesazhit, mediumit që i bën të mundur këtë transmetim dhe kanalit të tij.Përcaktimi i marrësve (Kujt?)në fushë të komunikimit masiv do të hapë fushën e analizës së destinuesve, të audiencës...analiza e efekteve (Çfarë efekti?) përcakton një*

fushtë të gjerë të analizave psikosociologjike” (Meunier, J. Peraya, D. Hyrje në teoritë e komunikimit QSSHE 2009:37). Modeli i Lasuellit i quajtur ndryshe nga Proulx dhe “**modeli teorik i komunikimit**” konsiderohet “**si sproma e parë e ‘mediologjisë së përgjithshme’**” (Meunier, J. Peraya, D. Hyrje në teoritë e komunikimit QSSHE 2009:38).

Klasifikimi i Lasuellit shihet si një model përshkrues e taksonomik, por ai ndihmon në klasifikimin e vrojtimeve mbi komunikimin dhe mediat. Studiuesit ndalen në aspektin makro të medias, pra në raportin e saj me shoqërinë. Media e influencon shoqërinë me informacionet dhe mesazhet që i përcjell asaj. Pikërisht këtu, futet dhe aspekti i dytë që ka të bëjë me përdoruesit e medias, qofshin grupe ose dhe individë, duke krijuar një tjetër raport, atë të medias dhe audiencës. Teoritë që lidhen me strukturën, fokusohen tek shenjat dhe simbolet që përdoren në mesazhin e medias. Teoritë që lidhen me shoqërinë dhe kulturën fokusohen tek funksionet e masmedias në shoqëri, shpërndarjen e informacionit dhe ndikimin e tij, opinionin publik dhe pushtetin. Kurse teoritë në lidhje me audiencën, merren me efektin e masmedias tek individë, tek komunitetet e audiencës dhe në përdorimin e masmedias nga audienca. Sipas studiuesve të massmedia-s, John C Merrill, John Lee dhe Eduarts Jay Friedlander “komunikuesit e masmedia-s dhe audienca janë në një lidhje të përbashkët simbiotike me njëri-tjetrin.” (Merrill, J. Lee, J. dhe Friedlander, E. Modern MassMedia, Harper&Row 1990:24). Pikërisht këtu, qëndron shpjegimi i perceptimit të imazhit që media ngre me informacionin që përcjell dhe audienca merr prej saj atë që ajo pret, duke e lënë veten të ndikohet prej saj. Ja pse, opinionin mediatik i imazhit negativ të shqiptarëve në ekran apo në median e shkruar, nxit kureshtje të audiencës dhe shton në radhët e saj perceptimin që artikulon media, pa harruar të vërtetën brenda saj që përbën thjesht lajmin e radhës .

Pesë traditat në teoritë e masmedias janë: tradita semiotike që fokusohet në mënyrën sesi mediat prodhojnë shenja që audienca i kupton dhe ndikohet prej tyre.

Tradita sociokulturore na çon në thënien e McLuhan “The medium is the message.” (McLuhan, M. Instrumentat e komunikimit, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit 2004:13).

McLuhan e përshkruan përmbajtjen e mediumit si një copë mishi që ushqehet nga fakti se krime të tilla i serviren publikut në shtëpi për t’u konsumuar gjatë darkës. Dhe të mendosh më pas, që imazhi të jetë thjesht shija e mirë apo e keqe e këtij ushqimi. Ja pse audienca krijon për të huajin një imazh jo të drejtë, sepse në rastin kur në ekran shfaqet krimi, publiku ndyshon qëndrim edhe pse s’ka lidhje me historinë. Njerëzit kanë prirjen të ndikohen nga media dhe besojnë se atë që media e quan të rëndësishme , ajo është me të vërtetë e rëndësishme. Pra imazhi i të huajit, kërkon dashamirësinë e dy partnerëve: medias dhe audiencës. E kur të dyja këto kushtëzojnë njëra –tjetrën , del pothuajse i njëjti produkti : imazh i mirë ose i keq. Përparësitë mediatike ndikojnë edhe mbi sjelljet e njerëzve, çka do të thotë se media dhe teknologjia e re janë jo vetëm informuese, por dhe drejtojnë opinionin dhe sjelljet e tij.¹⁵⁵

Tradita të tjera janë ato sociopsikologjike, kibernetike dhe kritike. Për tërë këtë lidhje duhet analizuar audienca e masmediave dhe varësia e saj prej tyre.

1.4. Tipologjitë e audiencës

¹⁵⁵ (Merrill, J. Lee, J. dhe Friedlander, E. Modern MassMedia, Harper&Ro= 1990:90).

Audienca

Qysh në Antikitët, prejardhja e konceptit lidhet me një grup fizik njerëzish, në një vend, për të njëjtin qëllim, për të parë tragjedinë ose lojëra sportive. Në antikitet kishte tri lloj publikësh: politik, kulturor, sportiv. Pra, koncepti për audiencën nuk ka ndryshuar shumë, mbetet po ajo shumësi njerëzish për të cilët krijohen mesazhe dhe prodhohen produkte mediatiqe. “*Procesi i komunikimit masiv është i formalizuar, i institucionalizuar dhe impersonal. Ai konstiston në mesazhin e dërguar përmes disa formave të teknologjisë në një numër të madh njerëzish ose në audiencë masive. Teknologjia është gjithmonë e përfshirë në komunikimin e masës, nuk ka më ndarje informacioni fytyrë më fytyrë. Mesazhet i komunikohen masës së audiencës përmes një shumëllojshmërie formash: faqet e printuara, radioja, televizioni, filma në ekran, reklamat, posterat e mëdha dhe bluzat me reklamime.*” (Merrill, J. Lee, J. dhe Friedlander, E. Modern MassMedia, Harper&Row 1990:7). Sipas studiuesve të “mediologjisë” Merrill, Lee dhe Friedlander audiencia është një përzierje individësh të ndryshëm në kohë të ndryshme. Po sipas studiuesve amerikanë audiencia duhet përfytyruar në formë hinke, ku pjesa më e gjerë i përkon audiencës më të madhe, pra publikut të rrjeteve kombëtare televizive, ndërsa pjesët e tjera u përkohjnë grupeve të tjera të publikut të shtypit të shkruar, të atij profesionist e deri te komunikimi impersonal.

Klasifikimi Në themel të çdo audience është individualja. Sepse është individ që sheh TV-në, blen gazetën apo lexon librin. Mesazhet e mediave, edhe pse merren në mënyrë individuale, krijojnë atë që quhet opinion publik, ose e thënë ndryshe, konsensus të përhershëm ose të përkohshëm mes individësh të ndryshëm. Audiencia përfshin masat, publikun, grupet, organizatat apo edhe individët. Ka disa klasifikime që i bëhen audiencës. Sipas Merrill, Lee dhe Friedlander audiencia klasifikohet sipas tipeve, natyrës apo tipologjisë së qëndrimeve.

“Tipi i parë: *audience e përgjithshme, publiku. Është shumë e gjerë dhe jashtëzakonisht komplekse. Një masë kompakte gjithëpërfshirëse edhe e pjesëve anonime, edhe e masës heterogjene, edhe e masës së lëvizshme, edhe e masës individuale.*” (Merrill, J. Lee, J. dhe Friedlander, E. Modern MassMedia, Harper&Row 1990:43).

Në tipin e dytë të audiencës po këta studiues flasin për një audiencë më të vogël dhe më homogjene. “*Ky lloj publiku është më pak anonim. Quhet audiencë e specializuar.*” (Merrill, J...1990:43). Studiuesit e mediologjisë amerikane e klasifikojnë audiencën dhe pjesëtarët e saj duke u bazuar edhe te qëndrimet e tyre bazë siç janë vlerat, interesat dhe filozofia e tyre për jetën. “*Qëkur masmedia vendosi të ketë sa më shumë qëllime mbi personin me interesa të ngjashëm dhe qëndrime të ngjashme, gazetarët si komunikues të masës, dëshirojnë të izolojnë segmentet bazë të audiencës së përgjithshme publike. Kemi kështu një shembull të tipologjisë së qëndrimeve:*

qëndrimi i paorientuar, qëndrimi pragmatik, qëndrimi intelektual.” (Merrill, J. Lee, J. dhe Friedlander, E. Modern MassMedia, Harper&Row 1990:44).

Qëndrime të ndryshme

Le t’i analizojmë me radhë këto qëndrime.

Qëndrimi i paorientuar ka të bëjë me audiencën e sipërfaqshme, që nuk hyn në thellësi të lajmit, mbetet te koka e lajmit, nuk i pëlqen të lexojë informacionin në mënyrë kritike, por e merr siç e jep një media e caktuar. “*Kanë qëndrime negative kundrejt informacioneve, nuk mbajnë qëndrime serioze edhe kur janë informacione me vlerë ndërkombëtare.*” (Merrill, J. Lee, J. dhe Friedlander, E. Modern MassMedia, Harper&Roë 1990:45).

Qëndrimi pragmatik- një prej qëndrimeve kryesore të gazetarisë amerikane. Në këtë rast masa e komunikuesve është shumë e vëmendshme ndaj informacionit. Ja si i përcaktojnë studiuesit amerikanë këtë lloj audience: *“Pjesëtarë të saj janë shumë socialë dhe janë të interesuar të dinë sesi shkojnë punët në komunitete dhe në botë. Ata janë pjesëmarrës socialë. Ata japin kohën dhe energjinë e tyre në aktivitetet e komunitetit. Kanë hobi udhëtimet, bashkëbisedimet, argumentimet, pëlqejnë makinat dhe të ndërtojnë shtëpi. Ata lexojnë gazetatat, revistat, blejnë disqe dhe dëgjojnë radion.”* (Merrill, J. Lee, J. dhe Friedlander, E. *Modern MassMedia*, Harper&Row 1990:46).

Qëndrimi i tretë i takon audiencës intelektuale.

“Qëndrimet intelektuale përfshijnë segmentet më inteligjente të audiencës masë, por ata nuk janë domosdoshmërisht më ‘inteligjentët’ e gjithë shoqërisë, por ata mbajnë qëndrime inteligjente. Ata mund të mos kenë lidhje me çështjen, mund të mos dinë filozofinë dhe problematikën e çështjes, por ata janë të orientuar konceptualisht. Ata pyesin ‘Pse?’ dhe nuk yesin vetëm ‘Çfarë?’ dhe ata i marrin gjërat seriozisht. Pjesëtarët e audiencës intelektuale janë të përfshirë nga ideja e ekzistencës humane ,goditjeve që të jep ajo.” (Merrill, J... 1990:46).

Pritja e publikut

Audienca nuk është një ndjekëse pasive e medias, përkundrazi ajo është dinamike në këtë proces të komunikimit masiv. Editorët përcaktojnë se çfarë pëlqen publiku dhe brenda disa kufijve përcakton dhe llojin e materialit që ai kërkon. Nëse audienca nuk kënaqet nga shërbimi i ofruar nga një media e caktuar, ajo zhgënjehet dhe e gjen veten në një tjetër rival të medias. Kështu ekonomia e tregut bën që editorët jo vetëm të interesohen për shijet e publikut, por dhe t’i përmbushin ato cilësisht, ndryshe zhgënjimi i audiencës është rrënim ekonomik për ta.

1.5. Axhenda dhe publiku

Axhenda e medias dhe axhenda e publikut. Sipas studiuesve Maxwell McCombs dhe Donald ShaË (1977), disa raste studimore mund të merren si mbështetëse të idesë se mediat piren nga tregu për të shpërndarë lajmin dhe programuar zbatimin. Axhenda e medias duket se i paraprin axhendës së publikut . Axhenda e medias merret si shkaku, ndërsa ajo e publikut si pasojë. Ata flasin për **“agenda seter”** dhe **“agenda setting”**: **“Njërëzit mësojnë çfarë të mësojnë dhe të mendojnë rreth mesazheve që ata marrin. Media është një strukturë madhore e botës sonë dhe në një mënyrë madhore na dikton interesat tona të përditshme... Çfarë ju përket juve, na përket dhe neve. Kjo është ‘agenda setting’”** (Merrill, J. Lee, J. dhe Friedlander, E. *Modern MassMedia*, Harper&RoË 1990:90). Një grup i ngushtë njerëzish që konsiderohen ndryshe edhe elitë mediatike pranë politikës dhe dialogut të saj , ndjekin ngjarjet dhe veçojnë si më të rëndësishme njërin prej tyre dhe më pas të tjerët e marrin dhe e përpunojnë, pra, nis më pas efekti mediatik.

Po cila është **“agenda seter”**? Të quajtur ndryshe “gardianët e gardhit” përcaktuesit e axhendës janë ata që selekcionojnë informacionin që duhet të “konsumojë ” audienca dhe që ndalojnë atë lloj informacioni që s’duhet të kalojë te publiku. *“Ata sigurojnë dhe vendosin format bazë që duhet t’i përkasin publikut. Janë ata që vendosin axhendën sociale duke na treguar së çfarë të konsiderohet e rëndësishme duke u nisur nga fakti i seleksionimit se cila nga çështjet apo ngjarjet duhet të ekspozohet. Në një farë mënyre janë gardianët e interesit të publikut. Atyre mund t’u jepet famë, pasuri duke e fokusuar vëmendjen në njerëz të caktuar. Me pak fjalë, ata kanë fjalën e parë dhe të fundit në të gjitha diskutet publike”* (Merrill, J...1990:27-28). Këta janë përcaktuesit e axhendës dhe qysh aty, nis historia pse një

vrasës në Itali apo Greqi përpara krimit që s’duhet të ketë atdhe, menjëherë mediat i gjejnë kombësinë duke trumbetuar me të madhe faktin e të qenit shqiptar. E kjo, ndodh vetëm kur flitet për të huajin, pasi nuk kemi dëgjuar të flitet për kombësi a shtetësi kur kriminelin është vendas italian apo grek.

Atëherë lind pyetja : Pse u intereson origjina e një kriminelin, atyre që bëjnë axhendën e mediave në rastin shqiptar? Pra edhe këtu duhet parë e analizuar pasoja e imazhit negativ që është krijuar nga mediat e huaja për shqiptarët. Duket se janë më tepër një grumbull interesash të ndryshme që bëhen gjithnjë e më shumë përcaktues në krijimin e lajmeve që duhen transmetuar.

Funksionet e massmedia-s

Deri në fillim të viteve ‘90 çdo artikull rreth teorisë së rëndësisë së attributeve, theksonte faktin se mediat nuk janë fort të suksesshme për të na treguar çfarë të mendojmë, por kanë një sukses të habitshëm për të na treguar mbi çfarë të mendojmë. Përmes inkuadrimit. Po sipas studiuesve amerikanë media ka tri funksione kryesore që në fud i japin masmedia-s rolin si përcaktuese e axhendës së audiencës dhe “rojtare gardhi” në përcjelljen e informacionit për publikun e saj.

“1. Massmedia ndjek, eliminon dhe bashkërendon informacionin faktik.

2. Përballja e publikut me kuptueshmërinë e mesazhit.

3. Të zbavitë publikun.

Këto shpesh u referohen tri gjërave: -lajmeve, analizave, zbavitjes” (Merrill, J...1990:28).

Ja pse lidhjen mes audiencës dhe komunikuesve të masmedia-s Merrill, Lee dhe Friedlander e konsiderojnë si simbiotike pra, në bashkëjetesë me njëra-tjetrën.

ROLI

I

MASMEDIAS

Flitet për globalizëm dhe multikulturalizëm. Nëse popujt merren vesh e bashkëjetojnë me njëri-tjetrin, nëse njerëzit ndihen mirë në këtë bashkëjetesë, shumë shpejt s’do të kemi nevojë për imazh, se ai do të jetë thjesht pasqyrim i atij realiteti ku komunikimi paraprin një botë pakufij dhe të qytetëruar. Por për sa kohë ka interesa të forta politike dhe ekonomike, do të ketë dhe imazhe pozitive apo negative, sipas axhendave që janë dhe përfituese të asaj që percepton publiku. Po sipas kësaj qasjeje të perspektivës së veprimit social “kuptimi i medias ndryshon vazhdimisht” teksa qasjet e audiencës ndryshojnë.

Nëse publikun italian do ta konsiderojmë grup, kjo do të thotë se ata kanë një përcaktim masiv për shqiptarët dhe negativja që mbizotëron, është pjesë e kulturës së tyre për ta parë tjetrin si të huaj e të pabarabartë me të. Mënyrat sesi reagojmë ndaj medias, lidhen me ndërveprimet sociale. Ndërveprimi njerëzor është pjesë e jetës sonë të përditshme dhe nëse një lajm i keq për shqiptarët dëgjohet duke pirë një kafe, duke luajtur apo në makinë, kjo sigurisht bëhet objekt diskutimesh dhe nxit efekte negative në përshtatje me stereotipin e shqiptarit që tashmë dihet se është i padrejtë dhe negativ. Si konkluzion massmedia ka një rol që mund të jetë pozitiv kur i qëndron kodit të saj etik, por dhe negativ kur i largohet apo e shkel këtë kod. Ja si cilësohen efektet e massmedia-s në veprën e studiuesve amerikanë “Massmedia”:

“Efektet pozitive: 1. Mesazhet e medias e mbajnë publikun në kontakt me vlerat shoqërore të popullatës. Ato kanë në vetvete masivizimin ose socializimin e efekteve. 2. Mesazhet e medias përforcojnë vlerat shoqërore. Media shërben si mekanizëm i kontrollit për të mbajtur në marrëdhënie drejtimin thelbësor të shoqërisë. 3. Media ka efekte ndihmëse për plotësimin e dëshirave të papërbushura, shpresave, pengesave dhe ndjenjave negative.” 4. Media ndihmon në shoqërizimin e masës përmes edukimit duke vendosur në peshore gjërat e

mjerueshme dhe të papritura, normat sociale dhe pritshmëritë. Mesazhet e medias zmadhojnë sistemin e besimit dhe prodhojnë vlera qartësie të ideve në të cilat vlerat zhvillohen, përforcohen dhe ndyshojnë” (Merrill, J...1990:83).

KONKLUZIONE

Duke njohur dhe analizuar rolin pozitiv të medias, arrihet një vlerësim më i plotë i ndikimit që ajo ka në perceptimin pozitiv dhe i fuqisë së saj për të krijuar vlera dhe besime të tjera konkretisht, krijimin e imazheve pozitive për të huajin. Por perceptimi i medias së huaj në praktikë duket se më shumë përputhet me efektet negative të saj kur flasim për imazhin e shqiptarëve në to.

“1. Mesazhet e medias janë shpesh të manipuluar, të depersonalizuara dhe shumë herë të vendosura në mënyrë sensacionale për të goditur pjesëtarët e audiencës.

2. Media shkakton një ndikim narkotizues duke e bërë audiencës psikologjikisht dhe mendërisht të fjetur.

3. Media korrupton shoqërinë duke e mësuar atë me frymën materialiste dhe frymën brutale e në mënyrë intesive edhe sjellje të tjera antishoqërore.

4. Mesazhet e massmedia-s krijojnë steriotipe duke krijuar katalogë për njerëzit, veprimet, institucionet dhe idetë në mënyrë sipërfaqësore” (Merrill, J...1990:83).

Ajo që duhet theksuar është se nuk duhet kërkuar faji te media, pasi ato janë thjesht mjete, por te “ruajtësit e gardhit” ose axhenda e atyre që i kanë këto media. Që këtu nis shpjegimi i imazhit steriotip të shqiptarit si “negativ”. Në këtë epokë të teknologjive të reja mediat mund të shihen edhe në rolin e tyre neutral. Ato shkaktojnë konformitetin social veçanërisht në fushën e tregtisë ku njerëzit e shohin veten e tyre si konsumatorë.

“Mesazhet e medias kanë pak ose aspak efekt mbi njerëzit realitetet sociale të të cilëve janë bashkëkohorë, por mund të alternojnë sjellje të asaj pjese të audiencës që është e varur nga mesazhet e massmedia-s. Mediat shkaktojnë efekte që lidhen me natyrën e masës dhe jo me mesazhet që ato dërgojnë. Mesazhet krijojnë objektiva për njerëzit dhe përmirësim të personalitetit” (Merrill, J...1990:83).

Parë në efektet e tyre sipas këtyre këndvështrimeve ajo që mbështet hipotezën e këtij punimi është pikëpamja kritike mbi komunikuesit e mediave, hartuesit e axhendës mediatike që mban brenda argumentin e steriotipit negativ për shqiptarin që mbizotëron në median e huaj pas viteve '90. *“Mesazhet e massmedia-s krijojnë steriotipe duke krijuar katalogë për njerëzit, veprimet, institucionet dhe idetë në mënyrë sipërfaqësore” (Merrill, J...1990:83).*

E “katalogu” shqiptar duket se vazhdon të mbetet ekzotik dhe i paplotë në vërtetësinë e këtij perceptimi.

Recenzentë:
Prof.dr. Gjovalin Shkurtaç
Prof.asoc.dr. Thoma Dhima

KUMTESA

Msc. Edlira CERKEZI¹: TIPARE DHE VECORI TE DRAMËS SË DRITËRO AGOLLIT. (KËNDVËSHTRIM TË DRAMAVE “FYTYRA E DYTË” DHE “MOSHA E BARDHË”)

¹Universteti "Ismail Qemali", Vlorë

Veprimtaria e gjithanshme e Dritëro Agollit I ngjason një peme fytdhënëse të nërguar me kujdesin e pemëtarit i cili duke ia krasitur degët në stinë e mote, ka kujdesin që shartimi të mos prekë në trung dhe rrënjë, në mënyrë që petalet të nxjerrin frytet që qëndrojnë në të gjithë kohët. Po shqiptarët kanë c'të ruajnë : kanë jovetëm legjendat për Skënderbeun dhe letërsinë e mahnitshme gojore, por edhe emra të ndritur dhe personalitete të mendimit njerëzor, si Dritëro Agolli. Një kontribut të vëçantë në fushën e dramaturgjisë shqiptare ka dhënë edhe Dritëro Agolli. Drama satirike “Fytyra e dytë.(1963) e njërit prej krijuesve më të njohur të letërsisë bashkëkohore shqiptare, e poetit dhe prozatorit të frytshëm Ditëro Agolli është një nga tekstet dramatike që në strukturën e saj letrare e dramatike, relativisht komplekse ka vënë para sprovash e dilemash kritikën letrare teatrore të kohës lidhur me përkatësinë e saj zhanrore. Derisa në tekstin “Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist nuk përkufizohet qartazi përkatësi e këtille dhe ky tekst dramatik përkufizohet në frymën e komedisë dhe provohet të identifkohet burimi i komizmit të kësaj komedie(Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist fq 377), në historinë e teatrit shqiptar ky tekst shënjohe fillimisht si “dramë –satirië”, që , po ashtu trajtohet në frymën e komedisë, ku thuhet : “*Në këtë vepër, që ka në themel një ngjyrim të komedisë, për herë të parë vihet në tehun e kritikës, botëkptimi i burokratit.(Historia e teatrit shqiptar)*

Duke lënë mënjanë përkatësinë e saj zhanrore, ky tekst dramatik i afrohet më shumë dramës satirike, e shkruar më pak me frymën e komikes e më shumë me frymën e seriozes, është një nga tekstet dramatike që në strukturën e konfliktit të vet, tematizon një fushë tematike interesante për kohën, të guximshme. Vë në shënjestrën e ritorikës së saj fenomene e procese morale, politike e shoqërore me peshë.

Përpara se të ndahemi në dy aspëkte problematike të strukturës së konfliktit dramatik të kësaj drame satirike, do të vëmë theksin në strukturën e personazhit përkatësisht të kryepersonazhit të kësaj drame satirike Bektash Shkoza, rreth të cilit lëviz boshti tematik i dramës, është projektuar si prototip i burokratit, i njeriut në thelb konservator e patriarkal, karrierist dhe në një masë më të madhe edhe një shenjë e një orientimi shoqëror joproduktiv. Bektash Shkoza është projektuar në tri fusha dhe ambiente të marrëdhënive të tij; në familje, në vendin e punës dhe në abjentin shoqëror, në dinamikën e marrëdhënive shoqërore.

KUMTESA

Në të tri rrafshet, konstante e sjelljes dhe e personalitetit të tij është manipulimi dhe hipokrizia jo vetëm sociale e psikologjike, por edhe morale. Bektashi, si familjar dhe si prind, është arrogant dhe agresiv kur frustohet dhe mbi të gjitha manipulues edhe me familjen edhe me te bijën, me fatin e saj, të cilën e fut në një kurth të llojit të vet kur ia server kryenxhinierit perspektiv , Muhametit. Bektashi është po ashtu burokrat i shkathët, i cili terrorizon kolegët e tij të punës prej Andresë deri tek Kosta për t' I ushqyer makinacionet e tij lidhur me idene e autoritetit, njeri I cili i zvogëlon çështjet e mëdha me interes dhe zmadhon çështjet minore. Bektashi kultivon lidhjet e tij me njerëzit e pushtetit qëndror me nivele të larta ministrore dhe injoron njerëzit e vegjël me status të zakoshëm shoqëror. Duke e projektuar ne këto tri rrafshet të dinamikës së tij familjare, shoqërore dhe politike, Agolli e ndërton sipas një logjike të një gradacioni të matur artistic kryepersonazhin e dramës së tij satirike, ka manifestuar personalitetin kompleks në thelb të dyfishtë të cilit graduaisht i hiqet maska familjare, shoqërore dhe politike.

Kryepersonazh i kësaj dramë satirike në thelb ndërtohet mbi kontaditën e fenomenales dhe esenciales, mbi kontraditën e veprimit dhe të delariit, kontradita ëto që spalosen gradualisht e artistikisht bindshëm dhe si të tilla e ndërtojnë portretin kompleks te burokratit, por edhe njeriut që hiqet si përparimtar, I cili uanë paragjykimesh, njeriu I cili u mban ligjërata të tjerëve për parimet dhe rregullat, e ishte ftur edhe të bijën e vetë në një grackë, grackën e fejesës, e cila me gjithë skandalizimin e të atit del.

Bektashi nga njeriu i parimit, zbret ne nivelin e agresivitetit dhe hakmarrjes, duke keqpërdhur pozicionin e tij shoqëror dhe, “rivalin “ e dhëndrrit të tij, Aleksin , të dashurin e së bijës,, e transferon në Bregas dhe bashkë me dhëndrrin e tij “zyrtar”, Muhametin bojkoton punën dhe angazhimin e këtij inxhinjeri të zellshëm të ekipit I cili lufton për shmangien e rreziqeve nga shembja e ndërtesës.

Në fillim të interpretimit të kësaj drame satirike kam shtruar çështjen e dy aspekteve problematike të strukturës së konfliktit dramatik

Së pari: Konflikti I këtij teksti ndërtohet mbi logjikën e asaj që quhet kontraditë joantagoniste, që për shkak të kritikës së fshikullimit të tipit të burokratit, konsiderohet si përparësi e kësaj drame satirike. Kryepersonazhi, si product I moralit të kësaj shoqërie, bëhet objekt i kritikës, po prej kësaj shoqërie e moralit të saj, prej mekanizmave socio-politike që e krijojnë. Pra demaskimi i tipit të burokratit, të karierristit, të njeriut konservator, është bërë prej parimit të një kritike të ndjeshme , të mooderuar, një kritikë e cila kryepersonazhin dhe dukuritë që shënjojnë me të i nxjerr si dukuri aksidentale.

Së dyti:Aspekti tjetër problematik i kësaj drame satirike ka të bëjë me fundin e kryepersonazhit, fund I cili rezulton i profilizuar,qoftë si qëndrim nga ana e vet kryepersonazhit, qoftë si qëndrim i njerëzve me të cilët realizon dinamikën e tij sociale.

Bektashi: Ke të drejtë: Pse të ndodhte kështu bre Andrea? Me punën më vajti ters, me cupën më vajti ters! Hajde me thuaj ti, pse të ndodhte kështu?

Dhembja, pendesa, shqetësimi që ndjen kryepersonazhi , edhe nëse mund të kuptohen si një kthesë morale e psikologjike, nuk artikulojnë fuqishëm sistemin e motivacionit, mbi të cilin ndërtohet qëndrimi final i kryepersonazhit. Dritëro Agolli, mbi të gjitha, në këtë dramë satirike shquhet për strukturën gjuhësore stilistike, me anë të së cilës artikulon personazhet e tij. Mbi të gjitha gjuha e personazhit është një gjuhë e motivuar, një gjuhë që megjithëse ndërtohet, në të shumtën, mb tipin e ligjërimit politik e ideologjik, të burokratit i cili manovron me frazat dhe formulat e kohës, funksionon në të gjitha rrafshet e saj. Në të vërtetë, besoj se autori, duke ndërtuar një strukturë të këtillë të ligjërimit te kryepersonazhit të tij, ironizon e parodizon ligjërimit e burokratit të kohës i cili manipulon, në situatë të ndryshme të komunikimit edhe në rrafsh gjuhe.

Drama “Mosha e bardhe”

Sapo mbaron së lexuari rrëfimin dramatiko-lirik “Mosha e bardhë” e Dritëro Agollit, ndeshesh përnjëherësh me atë thjeshtësinë e vërtetësisë, të cilin ky autor e ka thuar në cdo vepër të tij. Duke qenë vëzhgues i hollë i jetës që na rrethon, ai e paraqet realitetin në një tjetër dinamikë të re. Një grup studentësh përgatiten të festojnë mbarimin e studimeve universitare, S’ka asnjë ceremoni të jashtëzakonshme. Emrat e tyre na skaliten në mendje menjëherë. Tek drama “Mosha e bardhë” autoti rreh probleme të mprehta shoqërore përmes marrëdhënive të gjalla e komplekse të personazheve. Këto probleme tingëllojnë reale të vërteta, sepse ngjarjet e figurat artistike autori i zhvesh krejtësisht nga retorika e deklamacionit e nga qëndrimi melodramatic, psh pas një shakaje plot kripë autori krijon skena të forta dramatike dhe pas momentesh të acaruar, nuk nguron të provokojë gazin më të cmendur.

Tek drama “Mosha e bardhë” e Dritëro Agollit, jeta paraqitet në mënyrë komplekse dhe njëkësisht shumë optimiste. Të bëjnë përshtypje sidomos ato skena dhe tablo ku marrëdhëniet më të acaruar të personazheve zgjidhen me natyrshmërinë më të madhe. Kështu për shembull, në filim të dramës ku heronjtë tanë mblidhen për të festuar ndarjen, nuk ndodh që “ndarja” të mbyllet me përqaftime sic na është bërë zakontë shohim ,po me lindjen e një konflikti të ri u shfaqen disa koncepte të ndryshme për jetën.

Bota shpirtërore e heronjve të dramës “Mosha e bardhë” i ka themelet në realitetin e ri shoqëror dhe është e lidhur ngushtë me interesat të gjëra e të përparuar etike –shoqërore. Dritëro Agolli zbulon tek secili personazh tipare esenciale të jetës së njerëzve të tjerë që na rrethojnë. Por ai nuk i zbulon personazhet njëherësh ,por me zhvillimin e veprimit dramaturgjik, kërkon dhe gjen tipare të reja të karakterit, që e ngrej në deri në shkallën e përgjithësimit artistik psh figura e Ritës është një figurë që pasurohet e formohet paseshtur si karakter njerëzor. Në një monolog të saj del mirë në pah bota e trazuar e trishtimi dhe ndjenja e dashurisë së fyer. Megjithatë ajo nuk tërhiqet

“Kantierin , - thoë Rita në një vend,- mund ta ndërtsh brenda një dite, pr njeriun nuk mund ta ndërtosh brenda një dite”

Pra lihet të kuptohet që Ritës do t’i duhet paskëtaj një luftë e mëtejshme dhe më e gjatë. Cdo iluzion tjetër do të ketë vlerën ideo- artistike të dramës. E vecanta e dramës është jo vetëm pasqyrimi me besnikëri i realitetit shoqëror,por në të njëjtën kohë i bën këtë realiteti një vlerësim aktiv të gjithanshëm.

Dritëro Agolli ,krahas paraqitjes së fenomeneve dhe problemeve që kanë të bëjnë me daljen e rinisë në jetë, përcakton edhe qëndrimin e tij aktiv, ku përmes një gjuhe plot ngjyra e zhdërvjelltësi, kritika e dramaturgut kalon deri në satirë. Duke mbajtur një qëndrim aktiv ndaj

KUMTESA

shfaqjeve të ndryshme të fenomeneve në realitetin tonë shqëror, Dritëro Agolli arrin edhe në disa konkuzione të cilat shërbejnë si një përgjithësim filozofik i këtij realiteti. Por problemet e shumta që shtrohen e pengojnë deri diku autorin të bëjë diferencime e të përcaktojë qëndrime të caktuara ideo-emocionale ndaj tyre. Detajet dhe hollësitë i shërbejnë tipizimit të personazheve ndikojnë edhe në unitetin e saj të përgjithshëm ideo-estetik. Ngjarjet e besueshme ,faktet e vërteta, personazhet jetësorë dhe konfliktet e mprehta shoqërore, vendosen në truallin e dramës me thjeshtësi e intesitet të vazhdueshëm që kurdoherë ndjellin dhjetra kujtime e asosacione dhe ,nga ana tjetër, të gëzojnë e frymëzojnë parreshtur.

Recenzentë:
Prof.dr. Bardhosh Gace
Prof. dr. Nexhip Merkuri

Dr. Gladiola DURMISHI (ELEZI)¹: MJEDISI SHOQËROR KU NDODH KOMUNIKIMI DHE KULTURA GJUHËSORE E INDIVIDIT, SPECIFIKUES TË NJË KOMUNIKIMI TË NDËRSJELLTË NË SHOQËRI

¹Departamenti Gjuhë-Letërsi
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Çfarë do të thotë të komunikosh?

Të komunikosh do të thotë :

- Të japësh një mesazh dhe ta kthesh atë
- Të zgjedhësh një kod dhe ta përdorësh atë për kodifikimin dhe dekodifikimin e mesazhit
- Të mbash në gjendje pune kanalet e komunikacionit
- Të interpretosh përmbajtjen e komunikacionit sipas kontekstit

Të njohësh dhe të zbatosh rregullat e komunikacionit kur të gjithë këta elemente janë të pranishëm se pohohet se komunikimi ynë është plotësuar dhe se personat në komunikime e kryejnë atë për një qëllim të caktuar. Qenia njerëzore nuk mund të përfytyrohet jashtë komunikimit. Komunikimi shihet si një përpjekje e njeriut për të bashkëjtuar me përvojën e tij. Komunikimi është një proces që mundëson krijimin e klimës së mirëkuptimit midis dy ose më shumë personave. Për të qenë të komunikueshëm s'mjaftojnë vetëm disa udhëzime, por ajo çka duhet për t'u mësuar rreth dërgimit dhe marrjes së personazheve, është të kuptuarit e asaj që ndodh kur komunikojnë si dhe aftësia për t'iu përshtatur komunikimit.

Individët që bëjnë pjesë në një shoqëri apo në një bashkësi të madhe apo të vogël, e zhvilluar apo primitive shkëmbejnë komunikime me njëri-tjetrin, pra mjedisi shoqëror është vendi ku kryhet komunikimi. Gjithçka që ndodh në praninë e dy personave konsiderohet komunikime¹. Me gjithçka komunikohet, gjithçka në mënyrë të pashmangshme komunikon diçka. Komunikimi plotëson nevojën e anëtarëve të një grupi. Për mjedisin shoqëror komunikimi ka si qëllim të transmetojë një pasuri të një lloji të veçantë që është kultura². Gjatë një komunikimi një informacion merr fill nga një burim , kthehet në sinjale me anë të një përcjellësi dhe pengesa të kanalit arrin tek marrësi. Pra që të vendoset një proces normal komunikimi nevojiten këta elementë³.

TRANSMETUESI

DHËNËSI → SINJALI → MARRËSI

E thënë ndryshe njeriu kur komunikon e ka shumë të qartë qëllimin e asaj që do të thotë dhe do të arrijë, e do të pres si kundërsjellje nga marrësi. Për të komunikuar është e domosdoshme që të jenë dy pjesëmarrës në dialog, dy bashkëbisedues. Secili prej tyre duhet të ketë një bagazh njohje. Çdo rast komunikimi lidhet me një hapësirë e vend të caktuar, dmth çdo akt komunikimi ndodh në një kontekst të dhënë. Në kontekst mund të përfshihen elementët më të imët që lidhen me realitetin e komunikimeve të veçanta. Këtu vinë dhe bashkohen konteksti apo sekuenca verbale, prozodia, lëvizjet e trupit, shprehjet e fytyrës. Është konteksti ai që përshkon si një fill i padurueshëm realizimin e çdo situatë komunikative.

Komunikimi është i rëndësishëm në jetë sepse ai e dallon njeriun nga qeniet e tjera. Jetojmë në universin e komunikimeve. Secili prej nesh gjendet i përfshirë në një rrjetë të dendur sistemesh komunikimi, pasi në jetën tonë të përditshme jemi të rrethuar nga një sasi e pafundme shenjash të cilat na transmetojnë informacione. Disa prej këtyre janë psh (tingulli i ziles në mëngjes na tregon se është ora për t'u ngritur. Jemi në rrugë, afrohemi në një kryqëzim dhe nqs semafori ka ndezur dritën e kuqe duhet të ndalojmë, nqs është ndezur drita jeshile rruga është e lirë) e shumë shembuj të tjerë që na transmetojnë informacion.

Komunikimi me gojë dhe komunikimi me shkrim

Komunikimi me gojë është kur marrësi është afër dhe i pranishëm. Gjatë bashkëbisedimit kontakti është i drejtpërdrejtë sepse dhënësi dhe marrësi ndodhen në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Bashkëbisedohet gjallërisht. Rolet e dhënësit dhe të marrësit këmbehen. Mundësitë e komunikimit janë të shumta, me fjalë, me gjeste, me intonacion, duke kombinuar në të njëjtën kohë komunikimin me fjalë dhe atë me gjeste dhe anasjelltas.

Komunikimi me shkrime: dhënësi dhe marrësi nuk janë afër, as të pranishëm. Gjatë komunikimit, kontakti nuk është drejtpërsëdrejt, sepse dhënësi dhe marrësi nuk janë në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Komunikimi realizohet me shkëmbime letrash. Mundësitë e komunikimit janë të kufizuara vetëm në fjalë. Përdoren mjete gjuhësore (fjalë dhe shprehje) që përshkruajnë me saktësi situatën. Jepen me saktësi të dhënat për dy faktorët e komunikimit dhënësit dhe marrësit. Saktësohet dhe vendi dhe koha e komunikimit. Këto dy lloje komunikimesh si me shkrime edhe me gojë lidhen me situatë të ndryshme të shprehuri e në mesazhe të posaçme.

Komunikimi gjuhësor dhe jogjuhësor.

Komunikimi realizohet nëpërmjet përdorimit të fjalëve pra nëpërmjet komunikimit gjuhësor. Por është provuar se marrëdhëniet nëpërmjet njerëzve realizohen edhe nëpërmjet komunikimit jogjuhësor. Komunikimi jogjuhësor nënkupton komunikimin me anë të gjesteve, të veprimeve, të treguesve, të sinjaleve dhe të shenjave. Treguesit janë dukuri të rastit që tregojnë diçka, por që nuk i drejtohen kurrë dikujt. Sinjalet janë rezultate, një marrëveshje. Ato u drejtohen njerëzve të njohur ose të panjohur dhe përdoren për t'u marrë vesh. Shenjat janë veprimet, figurat, vizatimet që përdoren për të treguar diçka. Simbolet janë shenja të caktuara që përdoren në mënyrë konvencionale për të treguar një element, një madhësi të caktuar, një njësi matje.

Komunikimi verbal dhe joverbal

Komunikimi verbal përfshin atë që thuhet nëpërmjet fjalëve. Ndërsa komunikimi joverbal përfshin një dimension më të gjerë, ai përfshin të gjitha format e tjera të komunikimit që në përdorimin për të përcjellë mesazhe, përveç fjalëve. Shpesh kur komunikojmë me dikë ne reagojmë ndaj asaj që nuk është thënë me fjalë por është thënë me mënyra të tjera. Keqkuptimet mund të shmangen apo sqarohen nëqoftëse përpiqemi të kuptojmë më mirë mesazhet joverbale që dëgjojmë apo marrim. Fusha e komunikimit joverbal është zgjeruar së tepërmi dekadat e fundit. Ajo gjen aplikimet e veta në biznes, media, marrëdhënie ndërpersonale, në edukime, pra në çdo fushë që përfshin dinamikat ndërpersonale dhe ato grupe. Komunikimi joverbal ndodh jo vetëm së jashtmi nëpërmjet njerëzve por edhe së brendshmi, personi i komunikon diçka vetes edhe nëpërmjet njerëzve, por edhe së brendshmi, personi i komunikon diçka vetes edhe nëpërmjet komunikimit joverbal. Komunikimi joverbal përfshin disa kategori.

Fytyra në komunikim:

Sinjalet që prodhon dhe shpërndan fytyra janë të shumtë. Përmes fytyrës ne marrim një informacion të shpejtë, të pasur jo vetëm për ndjenjat dhe emocionet, por herë pas here edhe për mendime që tjetri "bluante në kokë". Vetëm për pak sekonda mund të dallosh habinë, frikën, zemërimin, neverinë, turpin, pëlqimin apo mos pëlqimin. Ndjenja si këto, fytyra i shpreh dukshëm.

Sytë

Në komunikimin përmes syve, lëvizjeve të tyre, shkëmbimit të shikimeve, mund të japin dhe marrin mesazhe. Sytë e hapin ose e mbyllin komunikimin, e ndezin ose e fikin atë. Jo më kot sytë janë cilësuar si dritare të shpirtit. Përmes tyre bëhet i mundur "leximi" i ndjenjave nga më të ndryshmet. Edhe sytë ashtu si fytyra në tërësi mesazhet që ata përcjellin për ndjenjat dhe gjendjen emocionale, për mendimet dhe qëndrimet tona kanë gjetur pasqyrime në shumë fjalë dhe shprehje të popullit p.sh.: (syqeshur, symirë, syxixë, sypatrembur, sypafjetur). Nga këto fjalë dinamika e kontakteve me sy dhe e lëvizjeve të syve i jep komunikimit joverbal një kolorit të pasur.

Lëvizja e trupit: mënyra e pozimit ose e qëndrimit të tij shprehin ndjenja dhe përcjellin mesazhe të ndryshme që përforcojnë komunikimin joverbal.

Distanca në komunikime.

Ekzistojnë shumë lloje distancash si distanca intime, distancë personale, distancë sociale, distancë publike. Të gjitha këto distanca variojnë në kultura të ndryshme (psh njerëzit në Shqipëri tentojnë të mbajnë një distancë të vogël fizike me njëri-tjetrin. Ndërsa në Europën Veriore njerëzit preferojnë të mbajnë një distancë më të madhe fizike. Distanca fizike varet dhe nga lloji i marrëdhënieve që ne kemi. Komunikimi vokal mund të përcjellë mesazhe të ndryshme mbi nuancat emocionale. Ngadalësia apo shpejtësia në të folur, volumi i ulët apo i lartë i zërit, toni i zërit (hundore, grykore), pauzat bëjnë pjesë në këtë kategori. Një ndër elementet që ndërhyjnë në komunikime është edhe ambjenti fizik me të cilin njerëzit takohen. Nuk është e njëjta gjë të komunikosh në një dhomë të ngrohtë e të

rehatshme ku ke mundësi t'i shohësh të gjithë anëtarët e grupit , apo të komunikosh në një dhomë ku ambjenti nuk është i përshtatshëm. Pra, edhe lloji i hapësirës dhe ambjenti ku zhvillohet komunikimi ka rëndësinë e vet. Është fakti që përmes shprehive që përmendëm më sipër siç janë shprehjet e fytyrës dhe sidomos syve, përmes gjesteve dhe lëvizjeve të trupit, përmes pamjes fizike, takimeve dhe distancës me të tjerët, përmes vokalizimeve të ndryshme si psherëtima, të qeshura, e qara, britma, në përgjithësi përmes anës joverbale të sjelljes, ne marrim shpeshherë informacion më të plotë, më të saktë me të cilin komunikojmë.

Komunikimi në aspektin verbal

Për sa i përket komunikimit në aspektin verbal është një nga cilësitë më të shquara të qenies njerëzore që e dallon rrënjësisht njeriun nga kafsha. Zotërimi i rregullave në komunikime e lehtëson shumë komunikimin , në të kundërt komunikimi do të ishte i pashtjelluar. Në komunikime ka shumë rëndësi psikolinguistika, gramatika, sintaksa ose semantika.

Psikolinguistika na ndihmon të kuptojmë aspektin psikologjik të teknikave gjuhësore, për konvektimin e tingujve në simbole që kanë kuptime dhe që mund të përdoren për të komunikuar me të tjerët. Gramatika na ndihmon të njohim sistemin e rregullave gjuhësore në komunikime , që përdoret pafundësisht për të krijuar dhe kuptuar fjalitë e pafundme , na mëson rregullat për tingujt dhe fonemat , për strukturën dhe rendin e fjalëve në fjali dhe për kuptimin e gjuhës ose për ndërtimin e fjalëve me kuptime. Pa rregulla të tillë fjali ynë gjuhësor sado i pasur që të jetë , do të mbetej formal, një stoli pa funksion që nuk mund t'i shërbejë komunikimit. Kur fjalitë dhe frazat ndërtohen drejt nga pikëpamja gjuhësore, komunikimi jo vetëm që është i rrjedhshëm pa pengime dhe bllokime, por edhe ndonjë fjalë e vështirë do të kuptohet lehtë.

Natyra e komunikimit verbal nëpërmjet gjuhës së folur mund të kthjellohet edhe më mirë nëse mbajnë parasysh jo vetëm aspektin psikolinguistik e shoqëror të të folurit, por edhe anatomo-fiziologjike të tij. Ky aspekt përfshin mekanizma anatomo-fiziologjike të të folurit siç janë:

-Aparati i frymëmarrjes që përbëhet nga diafragmat , mushkëritë, muskujt e gjoksit, bronket dhe gypi i frymëmarrjes. Ky aparat ka si funksion krijimin e rrymave të ajrit që kalojnë nëpër laringun e zërit.

-Aparati zanore ose i prodhimit të zërit që përbëhet nga laringu që është vazhdimi i gypit të frymëmarrjes.

-Aparati i artikulimit apo nyjzimit të zërit përbëhet nga zgavra e gojës dhe e hundës. Këto lloje komunikimesh verbale dhe joverbale takohen në formë të pastër, por më shpesh në formë të përzier si shoqërues , plotësues dhe përforcues të njëri-tjetrit.

-Komunikimi si dukuri universal dhe llojet e komunikimit në shoqëri. Komunikimi është një dukuri universale që e takojmë në natyrë dhe në shoqëri. Në natyrë kemi komunikime amorfe, midis objekteve dhe dukurive fizike pa jetë, por që jeta jonë pa to nuk mund të përfytyrohet. Ky lloj komunikimi na shërben edhe për t'u orientuar. Kemi edhe komunikime midis mjedisit natyrorë dhe gjallesave, midis bimëve dhe kafshëve, brenda llojit dhe midis llojit, midis natyrës dhe njeriut. Në shoqëri kemi komunikime vetjake me veten dhe brenda vetes, brenda personit apo unit, kemi edhe komunikimet ndërvetjake me një , dy , ose më shumë persona që nuk përbëjnë grupe, komunikime grupole në një grup dhe brenda grupit, me shoqata dhe organizata të ndryshme dhe të tjera komunikime të kësaj natyre që i

përkasin komunikimit njerëzor ose shoqëror. Kemi komunikime sipas vendit, në vende të hapura, brenda shtëpisë, qendrës së punës.

Sipas largësisë, kemi komunikime në largësi dhe në afërsi, komunikime intime , kokë më kokë, me shtërngime duarsh, puthje dhe përqafile.

Sipas shkallës së njohjes dhe të afrimit

Sipas shtresave apo grupimeve shoqërore. Sipas seksit, grupmohës, nivelit arsimor e kulturor, profesionit, humorit dhe gjendjes shpirtërore. Pikëpamjet e disa studiuesve për komunikimin sipas EKOS (V. Eco)⁴ kemi procese komunikimi, atëherë kur një burim dhënës prodhon mesazhe që kalojnë tek një marrës nëpërmjet një kanali. Sipas studiuesit De Mauro kuptimi i përgjithshëm i një mesazhi është pikërisht ajo që një përdorues i kodit tregon saktësisht , nëpërmjet një sinjali të përdorur në një çast të dhënies⁵. Në kuadrin e psikologjisë disa kërkues e përdorin termin komunikime vetëm e vetëm për ato raste, kur një subjekt ka si objektiv të saktë t'i përcjellë informacione të mirëcaktuara dikujt (një marrësi) tjetër⁶.

Kur fillojmë të komunikojmë

Komunikimi fillon që në momentin e ngjizjes. Kur fëmijët lindin edhe pse nuk janë të aftë të zotërojnë gjuhën ata marrin dhe japin mesazhe nga prindërit e tyre në disa mënyra. Në lindje vokalizimet dhe të shprehurat janë në formën e të qarit. Në moshën dy vjeçare foshnjat prodhojnë tinguj që përmbajnë shumë prej tingujve të gjuhës. Në moshën 4-5 muajsh foshnja prodhon më shumë tinguj dhe i vargon ato bashkë që të prodhojnë gugotje. Nga mosha 6 muajsh fëmija fillon prodhon gradualisht vetëm tinguj që përmban në gjuhën që ai degëzonte. Në moshën 6 muajsh deri në 1 vjeç fëmijët përfshihen në një model të foluri që tingëllon si një bisedim i të rriturve. Nga mosha 1 vjeç, fëmija shqipton fjalën e parë. Kjo fjalë shoqërohet me objekte, njerëz ose me veprime specifike. Në moshën 2 vjeç fëmijët përdorin kombinime dyfjalëshe që reflektojnë fillimin e gjuhës së vërtetë. Më pas kur fëmija rritet dhe hyn në arsimin fillor atëherë ai e realizon më mirë komunikimin, sepse ai mëson të shkruajë dhe të dijë kuptimet e fjalëve. Ai komunikon me mësuesin për shumë biseda që i interesojnë atij. Në veprimtarinë e shkollës mësuesit duhet të komunikojnë me nxënësit në atë mënyrë që nxënësit të krijojnë një afrimitet me mësuesin , të vendosin një marrëdhënie miqësie në klasë. Mësuesi me një nivel të lartë komunikimi e stimulon nxënësin hap pas hapi. Ndërsa një mësues me komunikim të dobët nuk do ta motivonte nxënësin të komunikojë.

Komunikimi me adoleshentët rivalitet dhe shpërthim

Ky është një çast delikat i lidhjeve shqiptare, sepse bëhet fjalë për një moshë ku shpërthen një tjetër njeri brenda familjes së dikurshme. Interesat fokusohen , adoleshenti fillon të shfaqë dëshira, sjellje të çaktuara, ide, qëndrime shpesh të kundërta nga ato të prindërve, çka shpie në konflikte. Me kalimin e viteve është vënë re një zbutje e autoritetit prindëror mbi reflektimin e moshës së adoleshentit. Sot gjithnjë e më rrallë, detyrohen vajzat të martohen me dikë që nuk e duan. Edhe djemtë nuk detyrohen të ndjekin shembullin e babait.

Komunikimi prind – të rinj shoqëri dhe takte

Ky është momenti më i pëlqyer nga familjet shqiptare. Nënati mezi presin të kenë si shoqe vajzat e rritura, baballarët po ashtu me djemtë. Tashmë fëmijët janë pranuar si të rritur dhe si shokë. Gjithnjë dhe më shumë vihen re elemente të bashkëpunimit , këshillimit të ndërsjelltë, diskutimit mes prindërve e fëmijëve të rritur. Faktorët që ndikojnë në komunikimin prind – fëmijë , të çdo moshe qofshin ata , janë të shumtë,

përveçse statusit ekonomik të familjes dhe autoritarizmit në marrëdhënie, janë edhe elemente si statusi social, shëndetësor dhe formimi psikologjik e arsimor, numri i fëmijëve, përvoja traumatike familjare të cilat ndikojnë në raportin prind-fëmijë dhe në atë të brezave të ndryshëm në familje në përgjithësi.

Komunikimi në familjet shqiptare

“I vogli nuk duhet të flasë para të madhit”. Na takon që shprehje si kjo të dëgjojmë edhe sot. Duket sikur normat e komunikimit mes shqiptarëve nuk e kanë humbur brishtësinë. “Dëgjoji këshillat e prindërve dhe gjyshërve se kanë jetuar dyfishin tënd”. Rrregulla të tilla për mënyrën se si duhet komunikuar, pasqyrojnë në veten e tyre një lloj tipik komunikimi. Shpesh njerëzit që i thonë janë të së njëjtës moshë që kanë prindërit dhe gjyshërit ose të mëdhenjtë që përmendëm në këto fjalë të cilëve duhet t’u përulemi. Nuk ka rëndësi të ulesh e të rendisësh shprehje që sot i bëjnë të mëdhenjtë të ruajnë piedestalin e paprekur të autoritetit. E rëndësishme është të nxjerrësh në pah nëse ka apo jo ndryshime në komunikimin brenda familjes krahasuar me familjet ku kanë jetuar të mëdhenjtë e sotëm, të cilët dikur kanë qenë të vegjël e një familje.

Komunikimi është një domosdoshmëri që buron nga natyra e shoqërisë njerëzore, nga nevoja për të organizuar prodhimin dhe gjithë veprimtarinë shoqërore : komunikimi gjuhësor është një akt i ndërlikuar, sepse të komunikosh, të hysh në marrëdhënie me të tjerët do të thotë t’u transmetosh diçka atyre. Komunikimi gjuhësor ka një përmbajtje, një qëllim, një pikësynim të caktuar. Meqënëse gjuha trashëgohet nga një brez në tjetrin, ajo bën të mundur komunikimin joverbal brenda një brezi të shoqërisë , por edhe midis brezave të periudhave të ndryshme. Me fjalë të tjera gjuha përcjell nga një brez në tjetrin thesaret e dijeve të kulturës kombëtare e botërore. Sa më e zhvilluar të jetë një gjuhë aq më mirë realizohet organizimi i veprimtarisë shoqërore.

Komunikimi midis dy personave si një nga format e komunikimit njerëzor

Format e komunikimit human janë të shumta. Brenda tij zhvillohet komunikimi në të gjithë komponentët e tij. Format më të spikatura janë : komunikimi midis dy personave si formë e parë dhe themelore e komunikimit human , më e përhapura dhe që takohet më shpesh. Komunikimi ekipor ose në grupet e vegjël me marrëdhëniet komplekse brenda grupit , sipas llojit, veçantive dhe nivelit të grupit, sipas detyrës në grupe dhe formës organizative. Komunikimi publik, me publikun dhe në mjedise publike, me karakteristikat e folësit si persona e personalitetit dhe e figurës së tij , autoriteti, karakteri dhe temperamentit i tij, ana pamore, ajo verbale dhe joverbale e tij, stili dhe teknikat e transmetimit të mesazhit. Komunikimi në mas, media pengesë e mjeteve të kulturës dhe të propagandës, pengesë e radios, televizionit, shtypit, liderit dhe filmit me veçoritë e ndikimit dhe të efektit të këtyre mjeteve në masën e njerëzve. Komunikimi institucional brenda institucioneve zyrtare dhe organizative të ndryshme, sipas hierarkisë së përgjegjësive, nga lart-poshtë dhe nga poshtë-lart. Komunikimi midis dy personave kushdo qofshin këta (miq apo të dashuruar, të martuar apo prindër dhe fëmijë, qytetarë të zakonshëm, të njohur dhe të panjohur, apo zyrtarë të rangjeve të ndryshme) është një formë komunikimi që karakterizohet nga disa veçori : konteksti shoqëror. Sado i rastësishëm ose intim të jetë komunikimi midis dy personave ai nuk mund të përfytyrohet jashtë mjedisit shoqëror ku zhvillohet drejtpërdrejtë ose jodrejtpërdrejtë çdo çift personash në komunikime , ndikohet nga mikromjedisi dhe sidomos dhe rregullat e shoqërisë. Pra e ka një kontekst shoqëror. Ky kontekst mund të jetë i theksuar saqë komunikimi midis dy personave duket si një sistem shoqëror me dy persona.

Normat

Sidoqoftë çifti i personave në komunikim, në mënyrë të vetëdijshme apo të pavetëdijshme, i përmbahen disa kërkesa me cilësitë e normës. Në të kundërt komunikimi i tyre do të ishte i pamundur i nivelit të ulët ose mund të ketë pamje kaotike. Të një rëndësie të veçantë janë normat etike që normalizojnë sjelljen e personave në komunikime që e afrojnë atë pranë sjelljes së kulturuar qytetare që rregullojnë marrëdhëniet midis shokëve, miqve dhe të dashurve, që ndihmojnë zhvillimin e komunikimit dhe e ruajnë atë nga sjelljet agresive. Sidoqoftë, normat humanitare ku pranohen nga personat në komunikime, nuk e lënë komunikimin të dalë jashtë kontrollit. Brenda një komunikimi personat mund të jenë në role të ndryshme. Modelet e komunikimit sipas roleve janë të shumtë dhe të shumëllojshëm. Komunikime prind-fëmijë, mësues – nxënës, mjek-pacient, shok-shoqe, i dashur – e dashur, burrë-grua. Por brenda një modeli rolet e personave në komunikime mund të ndryshojnë ose mund të këmbehen. Kështu psh komunikimi i një pedagogu me studentin mund të jetë shumë i ndryshëm nga komunikimi i një pedagogu tjetër me të njëjtin student. Që komunikimi të jetë i një çilësie të lartë kërkohet që marrëdhëniet midis personave të rregullohen nga ata vetë dhe me pëlqimin e tyre, komunikimi të zhvillohet jo aq sipas rregullave apo kërkesave të imponuara nga pozita superior, nga të tjerët, nga forcat e zakonit apo traditës por kryesisht mbi bazën e marrëveshjeve të arritura nga palët. Që komunikimi të jetë cilësor kërkohet që personat të futen në komunikime me karakteristikat e tyre vetjake, me rolin e tyre të vërtetë që buron natyrshëm nga personaliteti i tyre pa qenë nevoja të dyzohen, të hiqen dhe të shtiren apo të jenë fals.

Si ka evoluar komunikimi në shoqërinë shqiptare?

Të marrësh përsipër analizën e evoluimit të komunikimit brenda shoqërisë shqiptare, do të thotë të kesh marrë parasysh gjithashtu edhe vështirësitë që i dalin përpara një pune të tillë. Gjuha dhe komunikimi janë dy elemente që ngjizen organikisht në jetën e një shoqërie dhe një kulture të caktuar, madje thuajse gjithmonë, është fusha e një populli që e bën atë të jetë i veçantë duke krijuar më pas veçanësi në tiparet, traditën dhe sigurisht edhe në evoluimin e asaj shoqërie. Kështu duket e natyrshme të pranojmë se, nëse një shoqëri apo kulturë evoluon me kalimin e kohës, atëherë bashkë me të ka evoluar dhe gjuha e saj, komunikimi, llojet, cilësia dhe karakteristikat e këtij komunikimi, gjatë ndërveprimit mes anëtarëve të kësaj shoqërie. Gjuha është përmbajtja e kulturës së një shoqërie dhe mes tyre ekziston një lidhje: kultura e shoqërisë ndihmon në evoluimin e gjuhës dhe gjuha në vetvete ndikon dhe favorizon zhvillimin e jetës së anëtarëve brenda kësaj shoqërie. Komunikimi brenda një shoqërie fillon brenda familjes, vijon me atë mes personave të një moshe, të një profesioni, të të njëjtave interesa.

Komunikimi në grupet sociale në Shqipëri

Komunikimet brenda grupit dhe mes grupeve të ndryshme sociale në Shqipëri ndërmjetësohen nga kanale komunikimi të ndryshme që kanë evoluar me kalimin e kohës, veç kësaj ka ndryshuar edhe vetë natyra dhe shumëllojshmëria e grupeve që krijohen. Strukturimi i themeltë i shoqërisë shqiptare ka ndërlikuar komunikimin mes anëtarëve të kësaj shoqërie. Dhe kur flasim në kontekstin e bashkëpunimit mes grupeve drejt një produktiviteti sa më efikas, atëherë ndjehet frika për paragjykimet e dyanshme në palët ndërvepruese. Paragjykimet e mëdha ishin ato që lidheshin me shtresën e familjeve të të burgosurve politikë. Komunikimi me anëtarët e kësaj shtrese shihej me sy kritik. Ata përbuzeshin, injoroheshin, izoloheshin nga jeta shoqërore. Ndërkohë edhe në komunikimin mes partisë dhe anëtarëve të saj kishte nënshtrime. Komunikimet mes grupeve në shoqëri ishin të mirëpërcaktuara dhe nëse vihej re një devijim kjo sillte pasoja jo të vogla. Një

element tipik i komunikimit në grupet sociale në Shqipëri është mosrespektimi i rradhës së të folurit, secili dëshiron të flasë vetë, sa më shumë që të mundet, me zë të lartë dhe ton ndikues. Është gjithnjë njëri që do të arrijë të vendoset në pozicionin e liderit, i cili pretendon të respektohet për çdo gjë dhe nga kushdo, të japë urdhra, të kërkojë të vendosë dhe të kërkojë që vendimet e tij të zbatohen pa diskutim. Kjo vlen si për grupet e vogla dhe për grupet e mëdha. Ende ka gjurmë të diskriminimit që e pengojnë komunikimin e lirshëm brenda grupit, por në përgjithësi anëtarët e një grupi kanë më shumë tipare të përbashkëta sesa të kundërta, çka e rrit kohezivitetin e tij.

Përfundime

Komunikimi tek njeriu është mjaft intensiv, kompleks dhe i llojllojshëm. Ai edhe për nga shpeshësia tejkalon komunikimin shprehimisht të kafshëve. Ai është përcjellës i përhershëm i aktivitetit të njeriut. Pothuaj në të gjitha format e sjelljes së njeriut është i përfshirë. Kur nuk komunikim me njerëzit e tjerë, njeriu i drejtohet vetvetes, komunikim me veten. Komunikimi tek njeriu është mjaft i zhvilluar, i ngritur dhe kompleks. Ai mbështetet edhe në shenja që janë vetëm sinjale, por para së gjithash mbështetet në simbole. Simbolet që njeriu i shfrytëzon në komunikimin e vet janë mjaft të shumta dhe të ngritura në sisteme komplekse. Komunikimi realizohet me anë të mjeteve të ndryshme. Për njeriun është karakteristik komunikimi me fjalë. Por nuk realizohet vetëm me fjalë por edhe me figura, skema dhe shenja të ndryshme arbitrare. Lloji rëndësishëm i komunikimit të njeriut është komunikimi joverbal me anë të llojeve të ndryshme të lëvizjeve si dhe me anë të pozitës në hapësirë.

Gjuha dhe komunikimi janë dy elemente që ngjizen organikisht në jetën e një shoqërie dhe një kulture të caktuar, madje thuajse gjithmonë, është fusha e një populli që e bën atë të jetë i veçantë duke krijuar më pas veçanësi në tiparet, traditën dhe sigurisht edhe në evoluimin e asaj shoqërie. Kështu duket e natyrshme të pranojmë se, nëse një shoqëri apo kulturë evoluon me kalimin e kohës atëherë bashkë me të ka evoluar dhe gjuha e saj, komunikimi, llojet, cilësia dhe karakteristikat e këtij komunikimi, gjatë ndërveprimit mes anëtarëve të kësaj shoqërie. Gjuha është përmbajtja e kulturës së një shoqërie dhe mes tyre ekziston një lidhje: kultura e shoqërisë ndihmon në evoluimin e gjuhës dhe gjuha në vetvete ndikon dhe favorizon zhvillimin e jetës së anëtarëve brenda saj. Psikolinguistika na ndihmon të kuptojmë aspektin psikologjik të teknikave gjuhësore, për konvertimin e tingujve në simbole që kanë kuptime dhe që mund të përdoren për të komunikuar me të tjerët. Gramatika na ndihmon të njohim sistemin e rregullave gjuhësore në komunikime, që përdoret pafundësisht për të krijuar dhe kuptuar fjalitë e pafundme, na mëson rregullat për tingujt dhe fonemat, për strukturën dhe rendin e fjalëve në fjali dhe për kuptimin e gjuhës ose për ndërtimin e fjalëve me kuptime. Pa rregulla të tilla fjali ynë gjuhësor sado i pasur që të jetë, do të mbetej formal, një stoli pa funksion që nuk mund t'i shërbejë komunikimit.

Kudo dhe kurdoherë jemi në komunikim. Komunikojmë me veten, me të tjerët dhe me botën. Komunikojmë me të njohur dhe të panjohur, në grupe dhe organizata të ndryshme, me shtetin dhe institucionet e tij, në masa të mëdha njerëzish ose me publikun e gjerë. Pra komunikojmë dhe komunikojmë pareshtur. Ne me të tjerët por edhe të tjerët me ne. Merret me mend që në këtë komunikim të ndërsjelltë jo çdo gjë mund të eci mirë. Ka dhe do të ketë probleme, ndërlikime apo situata të ndërlikuara që e vështirësojnë procesin apo aktin e komunikimit. Që vështirësitë në komunikim të kapërcehen, që komunikimi të zhvillohet

KONFERENCA VJETORE E SHKENCËS 'JAVA E SHKENCËS 2012

normalisht dhe të ndihmojë për arritjen e objektivave të dëshiruara, është e interesuar çdo qenie njerëzore e arsyeshme.

Recenentë :
Prof. dr. Gjovalin Shkurtaj
Prof. asoc. Dr.Thoma Dhima

KUMTESA

Vjosa OSMANI: KOHEZIONI LEKSIKOR NË ROMANET E ISMAIL KADARESË

Hyrje

Teksti letrar dhe gjuha në veprat e Kadaresë ka gjetur një trajtim studimor, monografik për aspekte të veçanta apo të përgjithshme në këtë drejtim.

Megjithatë, edhe pse Kadareja shquhet për stilin e vet në përdorimin e mjeteve të ndryshme gjuhësore, apo për një arkitekturë interesante të tekstit, deri më tani nuk është bërë asnjë studim i plotë dhe i mirëfilltë që del jashtë kufijve të fjalisë për veprën e këtij autori. Prandaj, ky punim është një përpjekje për të trajtuar pikërisht mënyrën se si ndërtohen gjuhësisht tekstet e tij, apo si realizohet lidhja leksikore midis njësive gjuhësore. Thënë më saktësisht, korpusin e hulumtimit tonë e përbën studimi i lidhjes kohezive leksikore në tekstet e Kadaresë.

1. Kohezioni leksikor

Kohezioni leksikor ka të bëjë me zgjedhjen e përdorimin e mjeteve të ndryshme gjuhësore, semantikisht të afërta, të cilat i lidhin ose i bëjnë bashkë pjesët e tekstit. Ky tip i kohezionit nuk merret me lidhje gramatikore, as semantike, por me lidhjet e bazuara në fjalët e përdorura. Arrihet me përzgjedhje të fjalorit, duke përdorur njësi semantikisht të afërta.¹

Kohezioni leksikor mund të realizohet nëpërmjet: dyfishimit dhe kolokimit.

Dyfishimi, i cili mund të jetë disa llojesh, përfshin:

- përsëritjen e njësisë së njëjtë leksikore (*qyteti-qyteti, kështjella-kështjella etj.*)
- sinonimet (*djall-shejtan, fëmijë-kalama, shoh-shikoj- vështroj etj.*)
- antonimet (*i madh - i vogël, atje-këtu, dritë- errësirë etj.*)
- hiponiminë (ushtri-ushtar)
- metoniminë (*Ismail Kadare-“Kështjella” etj.*)

Tekstet e Kadaresë shquhen për zgjedhjen e përdorimin e këtyre mjeteve gjuhësore, të cilat i japin ligjërit karakter të figurshëm e shprehësi të lartë, por edhe ndihmojnë për ndërtimin e një arkitekture interesante të tekstit. Së këndejmi, nëpërmjet përzgjedhjes së fjalorit, përdorimit të njësive semantikisht të afërta a të kundërta, krijohet një përshtypje dhe arrihet një efekt i caktuar tek lexuesi.

Prandaj, është me interes të shihet se si shfrytëzohen këto mjete gjuhësore për të arritur një qëllim të tillë.

1.1 Përsëritja është një nga tipat e kohezionit leksikor e cila ka të bëjë me përsëritjen e elementeve që kanë të njëjtin referim në tekst. Ky mjet koheziv është më tipik për ligjërimin gojor, meqenëse në këtë lloj ligjërimi të folurit është më spontan dhe mundësia për t'ju shmangur përsëritjes së shpeshtë të të njëjtit element është shumë më e vogël.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se përsëritja nuk haset edhe në tekstet e shkruara, madje, në letërsi është një nga llojet kohezive më të shpeshta. Përmes përsëritjes së shpeshtë të elementeve që kanë të njëjtin referim në tekst, theksohet mendimi, tërhiqet vëmendja e lexuesit dhe në këtë mënyrë arrihet një efekt i caktuar tek ai.

Derisa zëvendësimi, sidomos ai me elipsë paraqet dinamizimin, gjallërinë e veprimeve, përsëritjet e ndalin rrëfimin, e frenojnë atë në dobi të përshkrimit.

P.sh.:

Dy të tjerët vështronin dritaret. Në dritare dolën Nazua bashkë me nusen.

(“Kronikë në gur”, fq. 199)

Ndërtimet e tilla, me përsëritje të shpeshtë të elementeve të njëjta, shfrytëzohen shpesh për të pasqyruar situata të tendosura, por edhe për të tërhequr vëmendjen e lexuesit, e në këtë mënyrë t'i imponohet qëndrimi për një ngjarje, fenomen apo dukuri të caktuar.

P.sh.:

- *Një krah njeriu.*
- *Krahu i pilotit.*
- *Krahu i englezit. Vetëm krahu i kishte mbetur.*
- *Dora që hodhi bombën.*
- *Ah qen!*

- *I shkreti englez!*

- *Korba, mbyllni sytë!*

Aqif Kashahu e tundte vazhdimisht krahun e këputur që ta shikonin të gjithë. Krahu e kishte dorën të hapur.

- *Paska një unazë.*

- *Shikoni një unazë në gisht.*

- *Oh unazë. Unazë në gisht.*

(“Kronikë në gur”, fq. 100)

1.2 Sinonimet janë fjalë me ndërtime të ndryshme, por me kuptim të njëjtë apo të afërt. Në tekstet letrare sinonimia u jep teksteve ngjyrimë emocionuese, pasqyron anë të ndryshme, saktëson përshkrimin, por edhe pasuron leksikun.

Në ndërtimin tërësor të tekstit këto mjete gjuhësore kanë rol të rëndësishëm për realizimin e kohezionit leksikor. Përdoren kryesisht për të shmangur përsëritjen e shpeshtë të fjalëve të njëjta, të cilat krijojnë përshtypje të pakëndshme në tekst.

Këto mjete kohezive mund të jenë: *të plota* dhe *kontekstore*.

Çiftet sinonimike të plota, të cilat formohen kryesisht me fjalë të huaja, apo me fjalë të dialekteve dhe të gjuhës standarde, janë shumë të shpeshta në tekstet e Kadaresë.

P.sh.:

Ishte ditë pazari. Nga të gjitha drejtimet fshatarët po dyndeshin drejt sheshit të tregut.

(“Kronikë në gur”, fq. 21)

Këto çifte sinonimike përdoren për të karakterizuar gjuhën e personazheve, për të pasqyruar atmosferën, rrethanat, apo mjedisin në të cilin zhvillohet ngjarja.

Ndër sinonimet e shpeshta janë edhe ato që dallojnë nga nuanca kuptimore.

P.sh.:

- *Po aeroplanin a do ta **shohim** ? – pyeta*

- *Do ta **shikojmë**, - tha gjyshja. - E kanë vënë në mes të dhomës së madhe....*

- *Po nga afër a do ta **shoh**?*

- *Edhe nga afër do ta **shohësh**, vetëm mos bëj budallallëqe. Mos ngrit gjë me dorë.*

***Vështrova** duart. Ato ishin të hutuara më keq se unë. I futa në xhepa.*

(“Kronikë në gur”, fq. 95)

Në këtë rast shohim se si mjete kohezive përdoren njësitë: *shoh*, *shikoj* dhe *vështroj*, të cilat janë të afërta nga kuptimi, por që nuk përputhen në të gjithë përbërësit e tyre kuptimor. Këto njësi dallohen nga nuanca kuptimore, meqenëse njëra nga to shpreh një nuancë, kurse njësia tjetër shpreh një nuancë tjetër kuptimore.

Sinonimia realizohet edhe nëpërmjet fjalëve e njëjësive frazeologjike.

P.sh.:

*Ju nuk i **kuptoni** këto gjëra, se jeni akoma të vegjël, - tha Isai – Mos pyetni më mirë.*

*Ata seç thanë midis tyre në gjuhë të huaj. Gjithmonë kështu bënë që në të mos **merrnim vesh** çfarë flisnin*

(“Kronikë në gur” fq. 43)

Për të ndërtuar raporte të tilla përdoren shpesh edhe sinonimet kontekstore. Këto çifte sinonimike nuk janë të këmbyeshme në çdo kontekst, meqenëse nuk përputhen në të gjithë përbërësit e tyre kuptimorë, prandaj dalin si sinonime vetëm në kontekste të caktuara.

P.sh.

- *Vetëm **krahu** i kishte mbetur.*

- ***Dora** që hodhi bombën.*

(“Kronikë në gur”, fq. 100)

1.3 Antonimet janë mjete kohezive, të cilat po ashtu kanë të bëjnë me raportet kuptimore midis njëjësive leksikore. Mirëpo, ndryshe nga sinonimet të cilat dy ose më shumë forma lidhen me të njëjtin kuptim, antonimet janë fjalë me forma dhe kuptime të ndryshme.

Fjalët antonime përdoren në ligjërime e në stile të ndryshme, e sidomos në letërsinë artistike. Si mjete të fuqishme shprehjeje, këto mjete kohezive i hasim në role të ndryshme leksikore. Përmes këtyre njëjësive shkrimtarët ndërtojnë antiteza, duke i dhënë shprehjes forcë e qartësi dhe duke e bërë ligjërimin më të fuqishëm.

Antonimet mund të jenë: *të plota dhe kontekstore.*

Në tekstet e Kadaresë, ndër më të shpeshtat janë antonimet e plota.

P.sh.:

*Partizani ishte **atje**. Të gjithë ishin **këtu**.*

(“Kronikë në gur”, fq. 174)

KUMTESA

Nga këtë rast shohim se çiftet antonimike janë të plota, meqenëse kundërvihen plotësisht në të gjithë përbërësit e tyre.

Përveç fjalëve me kuptime plotësisht të kundërta, si mjete kohezive përdoren edhe çifte fjalësh kundërvënira e të cilave bëhet vetëm brenda kontekstit.

P.sh.:

Qetësia është e gënjeshtërt. **Luftën** e kemi në prak.

(“Kështjella”, fq 35)

Çiftet e këtilla antonimike krijojnë kundërvënira kuptimesh të figurshme vetëm brenda kontekstit, ndërsa jashtë kontekstit nuk arrijnë një gjë të tillë.

Lidhja antonimike realizohet edhe nëpërmjet fjalëve e njëjësive frazeologjike.

P.sh.:

*Ai mendoi se ndoshta i kishte ardhur koha që te kalonte dite me te qeta në shtëpinë e tij. Jo, se ishte **i shkuar nga mosha**. Ai ishte akoma **i ri** dhe i fortë ...*

(“Kështjella”, fq. 12)

Raportet antonimike me fjalë të formuara me parashtesa me kuptim të kundërt: *mos-*, *pa-*, *jo-*, kundër- etj, janë po ashtu të shpeshta.

P.sh.:

*Qyteti ynë ishte **i okupuar**. Kjo do të thotë se në këtë qytet kishte ushtarë të huaj. Këtë unë e dija, por ajo që më mundonte ishte tjetër gjë. Unë nuk e kuptoja dot se si mund të jetë një qytet **i paokupuar**.*

(“Kronikë në gur”, fq. 25)

***Gëzimi** ishte rreth e rrotull tij, mjaftonte që të zgjaste duart për ta prekur, megjithatë diçka e pengonte të vendoste një kontakt me të. Ç’ke kështu i tha vetës.*

*Asgjë, mendoi pas pak. Dhe papritur, për një grimë ju duk se e kapi shkakun e **mosgëzimit**.*

(“Pashallëqet e mëdha”, fq. 27)

Dihet se kundërvënira me këto parashtesa është më e dobët, prandaj shfrytëzohet vetëm në situata të caktuara, në rastet kur dëshirohet të zbutet toni i ligjëritimit.

1.4 Metonimia është po ashtu një nga tipat për realizimin e kohezionit e cila ka të bëjë me raportet kuptimore midis njëjësive leksikore. Ky tip koheziv nënkupton shmangie nga emërtimi i drejtpërdrejtë apo i rëndomtë, me ç’rast në vend të një fjale që ka një kuptim të caktuar përdoret një fjalë tjetër, gjegjësisht një kuptim tjetër.

Lëvizja kuptimore me metonimi bëhet duke u mbështetur në raporte të caktuara logjike. Pra, kuptimi i fjalës së dytë duhet të ketë lidhje logjike me kuptimin e fjalës së parë. Ky tip i kohezionit përdoret mjaft shpesh në tekstet letrare, kryesisht kur dëshirohet të thuhet diçka jo në mënyrë të zakonshme, por në mënyrë më të fuqishme, më ndikuese dhe më tërheqëse.

P.sh.:

- *Ku e di ti se unë kam raki?*

- *Që ke raki nuk jam i sigurtë, por, që ke pirë, duket sheshit- tha jeniçeri...*

*Kur Sadedinit iu duk se u futën në hije, ai i zgjati shishen të posanjohurit. Jeniçeri vështroi njëherë rreth e rrotull dhe, pasi i ktheu shpinën rrugës, curi **shishen** në gojë.*

(“Kështjella”, fq. 42)

Në rastin e mësipërm shihet se kemi shmangie nga emërtimi i drejtpërdrejtë, meqenëse në fjalinë e dytë përdoret fjala që emërton mbajtësen në vend se të përdorej fjala që emërton përmbajtjen.

1.5 Hiponimia është lloj i kohezionit leksikor, e cila nënkupton përfshirjen e një termi të veçantë në një term më të përgjithshëm. Me fjalë të tjera, konceptet më të përgjithshme, që i referohen një klase më të madhe apo më gjithëpërfshirëse, përfshijnë brenda vetes konceptet më të veçanta.

P.sh.:

*Në mbrëmje **ushtria** nuk kishte mbërritur akoma krejt. **Ushtarët** vazhdonin të arrinin njëri pas tjetrit.*

(“Kështjella”, fq.6)

Këto njësi janë më të veçanta, dhe si të tilla kanë disa tipare më specifike, tipare këto që nuk janë të përbashkëta për të gjitha njësitë. Prandaj, ato përdoren për të dhënë një shkallë më të lartë informacioni.

1.6 Kolokimet janë mjete kohezive, të cilat krijojnë relacione leksiko-semantike midis njësisve leksikore. Marrëdhënia që krijohet përmes kolokimeve është “*jo e drejtpërdrejtë, më e vështirë për t’u definuar dhe mbështetet në asociacionet që krijohen në mendjen e lexuesit.*”¹ Kjo do të thotë se për interpretimin e tyre është i nevojshëm inventari i njohurive dhe i përvojave që kemi fituar nga jeta për një fushë të caktuar. Prandaj, sa më shumë që kemi njohuri për ato fusha, aq më lehtë e kemi t’i definojmë marrëdhëniet në mes të njësisve gjuhësore.

P.sh.:

*Në **kampin** e tyre ka rënë qetësia. **Ushtarët** gjithë ditën vijnë vërdallë ose merren me rregullimin e kampit.*

(“Kështjella”, fq. 91)

KUMTESA

Ma. Arjeta CUKA¹: VËZHGIME MBI ZHVILLIMIN NË KOHË TË EMËRTIMEVE TË NJERËZVE SIPAS VEPRIMTARIVE QË KRYEJNË

¹ Gazetare pranë Televizionit Publik Shqiptar
Pedagoge e jashtme pranë Universitetit "Vitrina"

Gjuha dhe veçanërisht leksiku janë të lidhura drejtpërdrejt me veprimtarinë njerëzore në të gjitha sferat e jetës. Çdo anë e jetës politike, ekonomike, shoqërore e kulturore të një vendi gjen pasqyrimin e saj në gjuhë. Nga ana tjetër, çdo ndryshimi në zhvillimin e këtyre faktorëve në jetën e një populli i përgjigjet pasqyrimi në gjuhë nëpërmjet leksikut. Emërtimet e personave sipas veprimtarisë që kryejnë, si një shtresë e leksikut, kanë veçorinë të gjenden më shumë se çdo anë tjetër e gjuhës në zhvillim dhe nën ndikimin e vazhdueshëm të faktorëve jashtëgjuhësorë.

Zhvillimet ekonomiko – shoqërore e kulturore të vendit kanë shtruar vazhdimisht para gjuhës kërkesën për zgjerimin e pasurimin e leksikut dhe kanë përcaktuar nga kjo pikëpamje gjendjen e këtij shtresimi në prerje të ndryshme sinkronike. Në përputhje me këtë gjendje, në nivelin e këtyre emërtimeve mund të bënim një klasifikim të gjendjeve të tyre në tri periudha kryesore :

1. Periudha deri në vitin 1912 (d.m.th. periudha para shpalljes së Pavarësisë).
2. Periudha nga vitet 1912 – 1950 (d.m.th. periudha e zhvillimit pas shpalljes së Pavarësisë deri në periudhën e viteve të para të çlirimit të vendit).
3. Periudha e zhvillimit të vendit nga vitet 50 deri në ditët e sotme (d.m.th. periudha pas Çlirimit të vendit).

Për trajtimin e këtij problemi është vjelur lëndë nga fjalorë të ndryshëm, si: *"Fjalor Latinisht – Shqip"* i F. Bardhit ¹⁵⁶, *"Fjalor Shqip – Greqisht"* i K. Kristoforidhit ¹⁵⁷, *"Fjalor i gjuhës shqipe"* 1954 ¹⁵⁸, *"Fjalor i shqipes së sotme"* ¹⁵⁹.

A. Periudha deri në vitin 1912.

Në fazën e parë deri në vitet 1912 emërtimet lidheshin kryesisht me fushën e bujqësisë. Po kështu ato kishin të bënin me fenë apo sfera të ngushta të ekonomisë. Tek autorët e vjetër (kemi parasysh veprat e autorëve tanë të vjetër; Buzuku, Matrënga, Budi, Bogdani etj., kryesisht fjalorin e Bardhit) gjenden krahas emrave të tjerë edhe emra konkretë që shënojnë njeriun sipas profesionit a punës që kryen, të prejardhur nga:

¹⁵⁶ F. Bardhi, "Fjalor latinisht – shqip, 1635", Prishtinë, 1983.

¹⁵⁷ K. Kristoforidhi, "Fjalor greqisht – shqip", Prishtinë, 1977.

¹⁵⁸ "Fjalor i gjuhës shqipe", Tiranë, 1954.

¹⁵⁹ "Fjalor i shqipes së sotme", Tiranë 2002

KUMTESA

- a. tema emërore me prapashtesën *-tar*, si *gojëtar* (avokat), *peshkëtar* (Buzuku); *lodërtar* (muzikant), *rrogëtar* (mercenar), *ndihmëtar*, *fëdigëtar*, *sqimatar* (Budi); *furrëtar*, *banjëtar* (punëtorë në banjë), *vjershëtar*, *fjalëtar*, *pajëtar* (Bardhi); *landëtar* (marangoz), *detar*, *luftëtar*, *kankëtar* (Bogdani) etj.
- b. tema emërore me prapashtesën *-tor*: *gjatuor* (Buzuku); *ushtëtuer*, *harkëtuer* (Bardhi).
- c. tema foljore me prapashtesën *-ës*: *udhënues*, *pagëtorës*, *ruojtës*, *mallkues*, *krijues*, *ndjekës*, *përgjues*, *dijës*, *perrallës*, etj.

Në këtë mënyrë, kushtet ekonomiko – shoqërore të kësaj periudhe kanë ndikuar në zhvillimin e këtyre emërtimeve që lidheshin me seksin mashkull. Kjo kishte të bënte me kushtet shoqërore të vështira, të cilat kushtëzonin pabarazinë shoqërore ndërmjet burrit dhe gruas dhe nuk lejonin pjesëmarrjen aktive të kësaj të fundit në jetën e vendit. Kjo është edhe arsyeja pse emërtimet e para që gjejmë për gratë kanë të bëjnë me punën e saj brenda sferave të ngushta të jetës familjare dhe lidhen me raste gëzimi ose hidhërimi për të cilat merrte ndonjë shpërblim. Mund të përmendim: *amvisë*, *akçeshë*, *tajë*, *ustë* etj. Në përgjithësi emrat e grave sipas veprimtarisë janë dhënë në të njëjtën çerdhe me emrat e gjinisë mashkullore, vetëm në raste të veçanta, kur veprimtaria ka qenë specifike për gruan ose kur këto emërtime kishin veçori të dukshme në fjalëformim, si p.sh. me prapashtesën *-esh* si p.sh. *bareshë* etj.

Fjalorët e periudhës para shpalljes së Pavarsisë kanë një numër të vogël të emërtimeve të grave sipas veprimtarisë që kanë ushtruar. Kjo do të thotë se këto emërtime edhe kur kanë ekzistuar nuk janë pasqyruar në fjalorët e kësaj periudhe.

Emërtimet e personave sipas veprimtarisë që kryejnë, në periudhën para shpalljes së Pavarsisë janë prekur edhe nga huazimet e gjuhëve në kontakt, veçanërisht nga turqishtja. Fjalët nga turqishtja nisin të hyjnë në gjuhën shqipe që nga shekulli XV.

Pushtimi, i cili zgjati deri më 1912, la gjurmët e tij edhe në gjuhë.

Shumësia e këtyre emërtimeve nga gjuha turke bën që t'i klasifikojmë ato në disa grupe:

1. Emërtime të huaja (turke) dhe hibride, që lidhen me fushat e veprimtarive të grave, si p.sh. *tajë*, *ustë*, *terzeshë* (rrobaqepëse), *jatreshë* (mjeke), *akçeshë*, *bareshë*, *çobaneshë* etj.

2. Emëtimet që lidhen me fushën e veprimtarisë së burrave.

Këto emërtime i kemi klasifikuar sipas këtyre fushave.

- a. Shërbime në ekonomi: *bakall*, *bakërxi*, *barolakçi*, *bazërgjani*, *bazhdar*, *buçukçi*, *bakall*, *çerekçi* (zanatçi), *çertexhi* (shitës endacak), *dyfekçi* (armëpunues), *dyqanxhi*, *ekmexhi* (bukëshitës), *ekmixhanë*, *halif* (zëvendës), *kallajxhi*, *kazanxhi*, *kokullar* (shitës endacak), *kujumxhi* (punues ari), *marangoz* (zdrucktitar), *matrapaz* (shitblerës endacak), *simçi* (furrëtar), *teneqexhi*, *ustabash* (kryemjeshtër) etj.
- b. Shërbime shoqërore: *ahengxhi*, *akshibash*, *arçicë*, *allaxhakli* (huadhënës), *arabaxhi* (karrocier), *arzuhallxhi* (lutjeshkrues), *bajraktar* (flamurtar), *bejtar*, *bejtexhi*, *berber*, *bojaxhi*, *borizan*, *bozaxhi*, *ciribash* (kryeplak), *çirçi* (bujk), *çirak* (ndihmës), *dollibash* (kryegjetësi), *beksi* (rojtar), *dynjaxhi* (mbarshtrues), *exhraxhi* (barnator), *fajdexhi*, *gajdexhi*, *hamall*, *hyzmetqar* (shërbëtor), *jorganxhi*, *karakoll* (rojë), *kollxhi* (rojë), *koxhabash* (kryeplak), *kumarxhi*, *llokmaxhi*, *mejhanxhi* (pijeshitës), *nallban* (mbathtar), *odaxhi*, *portier*, *pajtar* (mjek), *qahaja* (mbarështues), *xhabaxhi*, *sahatçi* (orëndreqës), *samarxhi*, *sanxhaktar* (flamurtar), *sazexhi* (muzikant), *shahit* (dëshmitar), *tajë*, *tellall*, *tertipçi* (rregullues), *terxhuman* (përkthyes), *xherah* (kirurg) etj.

- c. Shërbime shtetërore: *aga, amir* (epror), *aze* (këshilltar), *bedel* (zëvendësues), *bej/beg, beshaiş* (zyrtar), *efendi, kadi* (gjyqtar), *kahreman* (krajli), *hajmekam* (prefekt), *myhendës* (inxhinier), *padishah* (monark), *pasha, safir* (ambasador), spahi, taksidar (tagrambledhës), *tefterdar* (drejtor), *timarli, vali* (qevirtar), *vezir* etj.
- d. Shërbime ushtarake: *akënxhi, allaj* (kalorës), *allajbeg* (komandant spahish), *bashibozuk* (mercenar), *bylykbash* (oficeri i P.O.), *çahadar* (ushtar i gatshëm), *jeniçer, jyzhash* (kryeqindës), *zabit* (oficer).
- e. Shërbime fetare: *bektashi, dervish, hoxhë, muhamed* (pejkamer), *vajr* (hoxhë dijetar) etj.
- f. Shërbime familjare: *amanetçi, argat* (mëditës), *bahçevan* (kopshtar), *bostanxhi* etj.
- g. Shërbime vetjake: *avxhi* (gjuetar).

Duhet shënuar se disa nga këto emërtime të burimit turk janë asimiluar plotësisht nga shqipja dhe janë bërë pronë e saj, si p.sh. *mjeshër, karrocier* etj.

Me kalimin e viteve emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë që kryenin (kemi parasysh vitet afër shpalljes së Pavarësisë) kishin filluar të përhapeshin dhe zinin një vend të mirë në fondin themelor të leksikut.

Në "*Fjalori i gjuhës shqipe*"¹⁶⁰ i hartuar nga K. Kristoforidhi në vitet 70 – 80 të shekullit XIX, që pasqyron në mënyrë shkencore pasurinë leksikore të shqipes, ka gati njëqind emërtime të tilla. Shumica e emërtimeve të njerëzve sipas veprimtarisë që kryejnë në këtë periudhë, që gjenden në fjalorin e Kristoforidhit, si: *gjobar, kamatar, kandilier, kokmexhi, kutrovoxi, shegert, terezi* etj., kanë lidhje me fushën e zejtarisë, tregtisë, të shërbimit komunal dhe janë pasqyrë e marrëdhënieve feudale dhe nivelit të ulët të forcave prodhuese që sundonin në vend.

B. Periudha ndërmjet shpalljes së Pavarësisë dhe Çlirimit të vendit

Shpallja e Pavarësisë dhe krijimi i shtetit të pavarur shqiptar solli ndryshime të rëndësishme jo vetëm në jetën shoqërore e kulturore, por edhe në zgjerimin dhe pasurimin e leksikut (si rrjedhojë e nevojës për emërtime të reja).

Në fjalorët e ndryshëm të botuar në këtë periudhë janë pasqyruar emërtime të tilla. Përmendim këtu: Fjalorin e Kordinanjos dhe atë të S. Manit (1948), të cilët kanë një numër të madh emërtime në krahasim me atë të K. Kristoforidhit. Por kjo nuk do të thotë se u pasqyruan plotësisht. Nuk gjenden emërtime të tilla të cilat haseshin në dokumentet e kohës, si: *piktor, korrektues, centralist, korrier, arkivist, kopist, gazetashitës* etj.

Një vend të madh në këto fjalorë zënë variantet fonetiko – dialektikore, si: *mandeshë/mëndeshë, gjëzar (gjizar), gjikatës (gjykatës), bukëpjekës* etj.¹⁶¹

Duket se një pjesë e mirë e fjalëve që emërtojnë njeriun sipas veprimtarisë në gjuhën letrare është marrë nga ligjërimi popullor. Të tilla janë fjalë me prapashtesën *-ore / -tore*, të cilat emërtojnë njeriun (më fort gjininë femërore) sipas punës që bën: *furkatore, endatore* etj; *-tar*, me këtë prapashtesë emërtohen njerëzit sipas punës që bëjnë në bujqësi e në blektori: *gardhtar, mbjelltar, mbushtar, fushëtar, maltar, mjaltar* etj.

Edhe në këtë periudhë leksiku kryesisht lidhet me fushën e bujqësisë, e cila ishte fusha kryesore e ekonomisë në vend.

¹⁶⁰ K. Kristoforidhi, "*Fjalori shqip-greqisht*", Prishtinë 1977.

¹⁶¹ V. Miklani "*Vëzhgime mbi emërtimet e njerëzve sipas profesionit*" në "*Studime mbi leksikun ...1*" Tiranë, 1972".

Megjithatë, vitet e Paraçlirimit mbeten vite të vështira me kushte të rënda ekonomiko – shoqërore. Vazhdonin të ekzistonin marrëdhëniet e vjetra në proceset e punës, si rrjedhim pjesëmarrja e njerëzve në to mbetet e ngushtë.

Ekonomia ngushtohet në degë të caktuara. Kjo është edhe arsyeja pse emërtimet e njerëzve sipas veprimtarive janë të kufizuara në degë të industrisë, të kulturës, të jetës artistike dhe asaj shoqërore në përgjithësi.

C. Periudha e Pasçlirimit.

Në periudhën e Pasçlirimit numri i emërtimeve të njerëzve sipas veprimtarisë që kryejnë u rrit ndjeshëm, duke pasqyruar në këtë mënyrë edhe ndryshimet në jetën e vendit, të cilat erdhën me zhvillimin e fushave të ndryshme të ekonomisë dhe shoqërisë, si: industria, transporti, telekomunikacioni, shkenca, tregtia, elektronika, arti, sektori i shërbimeve njerëzore etj. Në këtë mënyrë, nga fjalori i K. Kristoforidhit me 100 emërtime të tilla vijmë në Fjalorin e sotëm të shqipes, i cili përmban më shumë se 1500 emërtime njerëzish sipas veprimtarisë që kryejnë.

Në këtë periudhë emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë përbëjnë një shtresë të gjallë e mjaft aktive në përdorim të leksikut të shqipes, i cili pasurohet e zhvillohet vazhdimisht. Natyrisht, arsyeja e këtij zhvillimi duhet lidhur me gjallërimin e jetës ekonomiko – shoqërore të vendit.

Zhvillimet e reja sociale dhe ekonomike shtruan para gjuhës kërkesa të reja, të cilat leksiku i përmbushi me zhvillimin e shumë kategorive semantiko – leksikore, me pasurimin me fjalë të reja etj.

Kjo shtresë e leksikut vazhdon të pasurohet në ditët tona me ritme të shpejta si rrjedhim edhe i zhvillimit të vrullshëm të teknologjisë.

I. **Emërtimet në rrafshin e faktorëve brendagjuhësore.**

Kushtet brendagjuhësore që kanë ndikuar në zhvillimin e kësaj shtrese të leksikut, lidhen me historikun e zhvillimit të gjuhës shqipe dhe formimin e kristalizimit të gjuhës letrare kombëtare.

Historikisht emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë që kryejnë kanë shkuar përkrah zhvillimit të dialekteve të shqipes. Kështu hasen *gjikatës- gjykatës, gjëzar- gjizar* etj. Madje edhe brenda të njëjtit dilekt (norma letrare) nuk ka qenë e njësuar.

Për pasqyrimin e këtyre emërtimeve në përputhje me zhvillimin e gjuhës na dëshmojnë trajtat dialektore të shkrimeve dhe fjalorëve të këtyre viteve. Këtë pamje e plotëson vëzhgimi i emërtimeve të pasqyruara në veprën leksikografike “*Fjalor i gjuhës shqipe*” i vitit 1954 ku zënë një vend të madh variantet fonetiko – dialektore (*senkser, ngjizar, dhënar, shkrirës, druar, mandeshë, dylmer* etj).

Njësimi i gjuhës bëri që emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë si shtresë e leksikut të zgjerohej në krahasim me të kaluarën, duke përfshirë të gjitha sferat e veprimtarisë njerëzore (shtetërore, politike, shoqërore e kulturore) në të gjithë truallin e shqipes.

Ndikimin e fuqishëm të faktorëve brendagjuhësorë e shohim të pasqyruar në një varg anësh të zhvillimit të emërtimeve të veprimtarisë njerëzore si në rrafshin e formës, ashtu edhe në atë të përmbajtjes.

Siç e përmendëm më sipër, ndërsa në periudhën para kristalizimit përfundimtar të gjuhës letrare (standarde) shqipe vëreheshin emërtime në formën e varianteve fonetike, në periudhën e gjuhës letrare (standarde) takojmë vetëm format e njësuara. Në kohën e sotme, sidomos në gjuhën e shkruar përdoren vetëm format e njësuara të këtyre emërtimeve.

Lëvizjet e vullshme gjuhësore për nxjerrjen prej gjuhe të turqizimave, si edhe fjalëve të huaja nga gjuhë të tjera e fillur qysh nga Rilindasit, preku në masë të madhe edhe një pjesë të emërtimeve në fjalë, të cilat u zëvendësuan me gjegjëset shqipe, të ndërtuara me brumin e shqipes dhe me mjetet fjalëformuese të saj ose me fjalë ekzistuese, të cilat u aktivizuan në gjuhën e folur e të shkruar, si: *rojtar* për *bekçi*, *kopshtar* për *bahçevan*, *bukëpjekës* për *furrxhi*, *bujk* për *buqar*, *vjedhës* për *cub*, *çelsabërës* për *axhustator*, *ndihmës* për *çirak*, *bari* për *çoban*, *flamurtar* për *bajraktar*, *mësues* për *dhaskal*, *ëmbëltor* për *pastiçier*, *barnator* (*farmacist*) për *spicer*, *tregtar* për *grosist*, *orëndreqës* për *sahatçi*, *birësues* për *adoptues*, *veprimtar* për *aktivist* etj.

Nga ana tjetër gjallërimi, aktivizimi dhe prodhueshmëri e lartë e disa prapashtesave shqipe, si - *tar*, - *atar*, - *ës*, - *or* e ndonjë siparashtesë, çoi në zëvendësimin e disa prapashtesave të huaja, sidomos të atyre turke – *xhi*, - *çi*, duke iu dhënë këtyre emërtimeve fizionomi të plotë shqipe si: *furratar* për *furrxhi*, *sharrëtar* për *sharrxhi*, *fshesar* për *fshesaxhi*, *samarpunues* për *nallban*, *bakërpunues* për *bakërxhi*.

Në ditët e sotme vihet re aty – këtu përpjekja e individëve të veçantë për zëvendësimin e emërtimeve të huaja të kësaj shtrese me fjalë shqipe, siç mund të takohen në publicistikë ose në ndonjë vepër leksikografike (fjalor) si: *kuvendor* për *parlamentar*, *amvisues* për *menaxher*, *barnator* për *farmacist*, *ëmbëltor* për *pastiçier* e ndonjë tjetër.

Një dukuri interesante, që vihet re në shfaqjen e këtyre emërtimeve të ardhura në gjuhën shqipe nga gjuhët e huaja, është se në disa prej tyre vihen re ndryshime në format strukturore, të përfutuara gjatë futjes së tyre në gjuhën shqipe, duke iu përshtatur ligjësive të gjuhës shqipe nga pikëpamja fonetiko - morfologjike¹⁶², siç mund të sjellim si shembuj: *bankier* (nga *bankiere*), *karrocier* (nga *karrocierë*), ku shihet rënia e fundores së huaj –*e*, *biolog* (nga *biologo*), *aksionist* (nga *aksionista*), *kamionist* (nga *kamionista*), ku shihen rëniet e fundoreve të huaja –*a*, –*e* etj.

Tek një pjesë vihet re karakteri i theksuar hibrid me futjen e temave të huaja (sidomos të fjalëve ndërkombëtare) në rrethin e mjeteve fjalëformuese shqipe, duke krijuar kështu forma dysore si: *administrator* dhe *administrues*, *eksperimentator* dhe *eksperimentues*, *menaxher* dhe *menaxhues*, *armator* dhe *armatues* etj. Lidhur me këtë dukuri do të përmendim idenë e prof. M. Samarës se “*shqipërimi i pjesshëm i fjalës së huaj e fut huazimin brenda sistemit të gjuhës dhe e bën atë më të kuptueshëm, më të kapshëm. Këto shqipërime bëhen në harmoni me natyrën e shqipes dhe pasqyrojnë në gjuhë prirjen që ka ajo për të ruajtur të pastër strukturën e vet fjalëformuese*”.¹⁶³

Recenzentë:
Prof.dr. Gjovalin Shkurtaj
Prof.dr. Agron Duro

¹⁶² K. Jorgaqi, “*Mbi integrimin leksiko – semantik të italeanizmave në shqipën standardë*”, sf/1 – 2, 1998.

¹⁶³ M. Samara, “*Formimi i gjuhës letrare...*”, Tiranë 1981, FQ. 119 – 120.

KUMTESA

**Dr. Elvira LUMI¹: DEKONSTRUKSIONI I HISTORISË DHE I PUSHTETIT NË
PROZËN E ISMAIL KADARESË**

¹Universiteti "Aleksandër Xhuvani"
Elbasan

Abstrakt: Kaosi ndërmjet historisë dhe pushtetit janë objekt interpretimi narrativ në veprën e Kadaresë. Me gjuhën e një kodi simbolik dhe metaforik, autori bën kritikën dhe diferencën midis historisë dhe pushtetit politik. Historia shfaqet si një konflikt midis pushtetit dhe shoqërisë, midis ideologjisë dhe hierarkisë absolute të pushtetit, midis iluzionit si ëndërr utopike e një realiteti historik të tjetërsuar dhe kaosit social.

Kur flasim për dekonstrukcionin i referohemi teorisë së Jacques Derridas¹⁶⁴, e cila lidhet me kuptimin e veprave artistike dhe me elemente të strukturës së ndërtimit narrativ, elemente që ndërtohen mbi diferenca semantike dhe prej një lënde të marrë nga një traditë e dhënë kulturore. Në çdo rast veprat artistike nuk janë krijuar ex nihilo, por burimi, mënyra e trajtimit, struktura narrative, shkalla e pranisë së lëndës historike dhe asaj imagjinare janë të diskutueshme.

Fjalë kyçe: dekonstrukcion, strukture, histori, utopi politike

Hyrje: Dekonstruksioni i historisë dhe i pushtetit në artin e Kadaresë lidhet me artifakte që përbëjnë strukturën e veprave artistike, ku fikcioni ka elemente të romantizmit, realizmit dhe surrealizmit dhe temat që shtjellohen janë historia shqiptare, politika, mitologjia, etniciteti, gjakmarra, semiautobiografia.

Historia shqiptare shfaqet si një 'Viti i mbrapshtë' ku fati i popullit shqiptar është poetizuar si një histori tragjike, e viktimizuar dhe me probleme të mbetura pezull.

Shqiptarët duke e vendosur kahun e historisë "midis Perëndimit dhe Lindjes"¹⁶⁵ jetuan me këtë simbiozë për shekuj me rradhë. Është kjo dilemë tragjike që gjithmonë ka ngritur pyetjen se nga do shkonte Shqipëria në kohën që Perandoria Osmane po jepte shpirt. Viti 1913 e përgjysmoi Shqipërinë dhe shqiptarët e paguan dyzimin e tyre me 'vitin e mbrapshtë'. Vendosja e Shqipërisë në kampin e Lindjes pas 1944 ishte një tjetër histori e errët në jetën shqiptare, që do të bëhet objekt i veprave kadareane. Identiteti evropian i shqiptarëve është një temë që Kadareja do ta trajtojë si një sprovë në kohën e Demokracisë.

164 Derrida, J. [1967] (1978) *Of Grammatology*, trans. by Gayatri Chakravorty Spivak. Baltimore and London: Johns Hopkins University Press : Deconstructionism është një teori filozofike e kritikës letrare dhe artistike. Ajo ka qenë përshkruar si "një tendencë për të shkatërruar ose për të zbrëthyer dhe për të analizuar tekste ekzistuese që kanë të bëjnë me kuptimin si dhe individualizimin."

¹⁶⁵ Çabej, E., "Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes", MÇM, Tiranë, 1994.

Letërsia e Kadaresë është një evidencë faktesh të hollësishme të historisë së luftës që fillon me ‘Gjeneralin e ushtrisë së vdekur’ dhe pason nga një univers letrar ku përshkruhet historia e mardhënieve ruso-shqiptare (‘Dimri i madh’), kinezo-shqiptare (‘Koncert në fund të dimrit’) dhe histori –pushtet politik (‘Kështjella’, ‘Piramida’, ‘Përbindëshi’, ‘Kronikë në gur’). Paradokset historike dhe politike kushtëzonin izolimin e shqiptarëve nga Perëndimi. Liria e mendimit mungonte për shkak të diktaturës së egër, dhe shpresa se shqiptarët do të jetonin qytetërimin evropian ishte mërguar si një mendim në egzil i autorit. Disa simbole dhe alegori shkrimtari i shpërben me ftohtësi për qëllime artistike narrative. Kadare e pasqyron historinë në shtrirjen e saj vertikale, si një truall për të ngritur një problem nga koha e sotme si: ç’natyrë ka pushteti dhe cila është struktura politike e tij. Kur flet për të kaluarën, shkrimtari mban një qëndrim kritik ndaj saj dhe e sheh si një risemantizim mitik duke e vlerësuar nga një pikvështrim i drejtë filozofik dhe universal. Kur flet për bashkëkohësinë, shkrimtari e përshkruan utopike, të zymtë, të tjetërsuar ku sundojnë metamorfoza politike dhe e ardhmja mbetet një enigmë në trajtën e ankthit dhe të frikës ndaj vdekjes së intelektualit dhe krimit e luftës për pushtet.

Diktatura në veprën e Kadaresë shfaqet një sistem politik ku sundon paranoja dhe terrori, ku individi shkrihet me kolektiven dhe humbet identitetin e tij human. Në kushtet e një lufte të egër për pushtet historia zbulohet si një kaos ku faji është kolektiv dhe ku falsifikohet gjithçka. Në këtë kaos bien një e nga një të gjitha kategoritë sociale si: artistët, ekonomistët, inxhineierët, historianët, ushtarakët fshatarë e punëtorë. Historia dhe pushteti plotësojnë njëra-tjetrën dhe i japin arsye shkrimtarit të anlizojë objektivisht dhe nga pozitat e një prespektive të re siç është liria e interpretimit të historisë dhe shpërbërja me gjuhën e narratives së një sistemi utopik siç është diktatura komuniste.

Romani ‘Përbindëshi’ është një model i dekonstruksionit të historisë dhe pushtetit politik. Rrefimi antik i ‘kalit të Trojës’ shkatërrohet dhe transformohet nëpërmjet figurës së Konstruktorit i cili shkrin në një figurën e kalit antik me furgonin e prishur për të realizuar arketipin e përbindëshit ideologjik të Lindjes komuniste. Gjuha e këtij romani përbën një risi moderne përse i përket strukturës narrative dhe diferencave semantike. Do të referohemi hermeneutikës së Hajdegerit në kalimin e kohëve mitike në ato moderne dhe në simbolikën metaforike të historisë së ngatërruar politikisht. ‘Përbindëshi’ qëndron midis realitetit dhe ëndërrës, midis të përkohshmes dhe të përjetshmes. Kali që ngriti Konstruktori në bashkëkohësi është në thelb një simbol- makinë me trupin në mitet antike dhe me kokën e shndërruar në përbindësh ideologjik që vepron me të njejtin qëllim si dikur, manipulimin e njerëzve. Te ‘Përbindëshi’ historia rimerret përmes arketipit mitik, ndërsa pushteti politik përmes simbolikës ideologjike, çka bën të mundur depërtimin në realitetin totalitarist të arketipave dhe simboleve të përjetshme të dinakut, projektuesit të dredhisë, por tashmë një makinë e prishur për muze, por që megjithatë shkakton luftë dhe shkatërrim vlerash humane. Funkcioni risjellës i mjetit shkatërrues paralajmëron rrezikun për praninë e një dredhie politike që buron nga një risi teknologjike, por nëpërmjet pushtetit si një enigmë intrigash dhe krimesh që egzistojnë në kohët moderne. Sindroma e Kalit të Trojës fshihet në figurën e Konstruktorit të makinës totalitare. Përpjekja për të goditur shtetin është tragjike dhe groteske, pasi është me pasoja shkatërruese por dhe qesharake duke qenë krejt e pamundur në kushtet e totalitarizmit.

Transgresioni moral dhe kodi legal, që me sa duket është i përzier për të mbajtur rregullat e shoqërisë, na kujtojnë se krimi jo gjithmonë ka qenë me ne¹⁶⁶ por i institucionalizuar.

Ismail Kadare është një vazhdues i veprës së George Orwell¹⁶⁷ jo nga pikpamja e një paralajmërimi të thjeshtë profetik mbi rrezikun e totalitarizmit¹⁶⁸, por, gjuha poetike ofron një padi penale dhe civile me natyrë publike. Vepra artistike e këtij shkrimtari të madh shqiptar, është një akuzë e rëndë në adresë të utopisë totalitare qeverisëse dhe primitivitetit të shoqërisë¹⁶⁹ që Kadare, me sa duket e ka një barrë të rëndë prove krijuese. Shoqëria është e kontrolluar me dorë të hekurt nga partia në pushtet dhe udhëhiqet nga një diktator nga më të egrit në Ballkan dhe nga makineria e rëndë shtetërore e tij.

Shteti, në veprën artistike të Ismail Kadesë, është mbërthyer nga metamorfoza politike¹⁷⁰ dhe psiko-patologjike, si: korrupsioni i gjakut me natyrë feudale të shtetit¹⁷¹, terrori makabër ndaj njerëzve të thjeshtë dhe lufta e klasave, gjuetia e intelektualëve, tëhuajtëzimi i identitetit, tjetërsimi i mendimit të një 'elite politike', hierarkia midis të privilegjuarve, kontrolli i policisë dhe korruptimi i organeve të drejtësisë, falsifikimi i së vërtetës dhe manipulimi i opinionit publik, burokratizimi dhe ideologjizimi ekstrem i shoqërisë, sterilizimi i jetës morale, shpirtërore dhe gjuhësore, tabutë-gjinore mbi 'seksin e engjëjve' dhe inçesti i egër politik që buron nga absolutizmi i një autoriteti sundues diktatorial, paradokse dhe absurde psiko-patologjike të cilat, rrjedhin nga një term i vetëm- **utopi politike**¹⁷².

Ismail Kadare është shkrimtari që shkruan mbi bashkëkohësinë në kapërcim të kufirit nga utopia politike drejt identitetit European të shqiptarëve. Është ky vizion¹⁷³ universal i Kadesë që meriton të quhet shkrimtari i së drejtës. Ai parashtron në veprën e vet, në formën e një projekcioni poetik, artifakte për të diskutuar, rreth subjektit në fjalë: -Kush janë shqiptarët realisht, dhe çfarë na lidh ne me Europën?!

Gjithmonë ka një 'Altro-s' në të gjitha gjërat. Guximi për të shpresuar¹⁷⁴ se rreziku, dhuna dhe vdekja mund të parandalohen për të mirën publike dhe personale është një kauzë për të cilën Kadareja shkruan veprat artistike.

Amerikanët Steven H. Gifis dhe Wright Mill e kanë quajtur 'public use'¹⁷⁵ - 'imagjinatën sociologjike', e cila është aftësia që mundëson të shohë dhe të vlerësojë origjinën e të gjitha paradokseve historike dhe utopinë e një sërë kategorish humane në raportin e tyre reciprok, të rrethit shoqëror së cilës i përkasin. Me terma të tjerë, vepra artistike e Kadesë, buron nga 'nga biografia dhe historia', në kushtet e mbijetesës në Diktaturë.

Në romanet 'Përbindëshi'¹⁷⁶, 'Dimri i madh'¹⁷⁷, 'Muzgu i perëndive të stepave'¹⁷⁸, 'Prilli i thyer', 'Vajza e Agamemnonit', 'Darka e gabuar', 'Piramida', etj, utopia politike paraqitet si

¹⁶⁶ McLaughlin, Muncie, J., Hughes G, 'Criminological Perspectives', G B, 2007.

¹⁶⁷ Orwell, G. '1984', Tiranë, 2005.

¹⁶⁸ Arendt, H. 'The Origins of Totalitarianism', 1951.

¹⁶⁹ Mijatovich, Ch, "Paleologus. C-The last... (1448-1453)", USA. LCCC No. 67-29129.

¹⁷⁰ Hardie, Ph. 'Metamorphosis, Metaphor and allegory in Latin Epics', USA, 1999.

¹⁷¹ Gifis H.S, 'Law Dictionary', NY, 2003.

¹⁷² More, Th, 'Utopia', 1516: utopi- një sistem socio-politiko-legal jo realist, ideal, një sistem i pamundur të realizohet, në letërsi është gjuha e fikcionit.

¹⁷³ Rrella, F, 'Metamorfosi-Immagimi del pensiero', Milano, 1984.

¹⁷⁴ Obama, B, 'Audacity of Hope', USA, 2008.

¹⁷⁵ Gifis, H. Steven, 'Law Dictionary', USA, 2003.

¹⁷⁶ Kadare, I, "Përbindëshi", Tiranë, 2005

një paradigmë historike, ku gjutia humane është e sofistikuar dhe një genocid fizik dhe mendor. Hierarkia e pushtetit është absolute. Në kushte diktature shteti nuk funksionon si ligj i së Drejtës që siguron transparencë, liri personale dhe publike, por një praktikë të gabuar sundimi politik. E Drejta është mohuar, ose tjetërsuar. Liria e fjalës përjashtohet si e drejtë themelore Kushtetuese dhe shtypet me terror nga Diktatura komuniste. Shteti nuk ka ligje funksionale, ai ka vetëm një rregull të fortë: sundim klanor-fisnor (kinship), bindje e verbër në mendime dhe veprime, ndaj një autoriteti absurd dhe të egër siç është Diktatori.

Kadare shkruan: ‘Tirani tjetërshej. Ne e ndienim se si çdo ditë tërhiqeshim fatalisht në mekanizmin e fajit të përbashkët. Duhej të flisnim, të akuzonim, të hidhnim baltë, në fillim mbi vete, pastaj mbi të tjerët... Dhe litari i fajit të ndërsjelltë, vijonte ti lidhte të gjithë.’¹⁷⁹ Skematizmi dhe imitimi banal shkatërronin artin si mimes: ‘I pari u kthye Lladoshnikovi, si gjithmonë skematikisht i qeshur, stalinist, me punët që i kishte në rregull, sipas gjendjes optimiste të gjërave në gjithë Bashkimin e madh Sovjetik. Në fytyrën e tij të gjerë... kishte një lloj solemniteti të mitingjeve, një lloj mallëngjimi nga takimet me ..heroinat plaka të Punës Socialiste, një partishmëri të qeshur dhe zyrtarizëm të përmbajtur, ashtu siç që ..ngjyra bezhë e padesysë së tij’..kur thoshte ‘vot tak tavarishi’¹⁸⁰, do të mendoje se kishte fytyrën e një modeli që kishte dalë nga udhëzimet e Kryesisë së Bashkimit të Shkrimtarëve Sovjetikë’.

‘Terrori i kuq’ ushqen skenat e fikcionit prej nga burojnë dramat e një tragjedi-komedie ku, ‘masat milionëshe’ të egzaltuara gajasen dhe tmerrohen njeherazi në ferrin Dantesk, ku shfaqet një botë shtypëse, kurthesh, dredhish e maskash karikatureske politike. Gjestet e përditshme përfundojnë në tragjedinë antike, tiparet e njohura të shqisave deformohen në ngërdheshje karikatureske, instiktet të ndrydhura dhe të shtypura ku buron një ‘skizofreni nacioni’¹⁸¹. Qiejt tragjikë të Ballkanit mbulohen me ‘mjergull’ nga ish-Perandoritë që krijojnë njolla të murrme ku së largu mezi shihet një arratisje pulbardhe dhe fluturimi të legjendës¹⁸² dhe ku shkëlqen metafora e ftohtë e ‘Shkabës’ së Kadaresë¹⁸³. Vepra e Kadaresë është një libër orësh¹⁸⁴ ku koha ka ngrirë dhe historia paraqitet në kaos.

Utopia politike, në veprën poetike të Kadaresë, prezantohet një ‘Përbindësh,’ që endet si fantazma shekspiriane dhe demonizon popullatën me dhunë e terror, duke paralajmërar një shkretëtirë ekonomike. Stuhia e dunave të stepës¹⁸⁵ duket e vdekur por me trauma humane. Izolimi i vendit nga fqinjët dhe bota, në kufinj me tela me gjemba, e largoi shoqërinë shqiptare nga Europa. Kush guxonte, dhe këta ishin te rinj që fshehurazi mundoheshin të lidheshin me vale radioje apo stacione televizive, akuzoheshin si tradhëtarë të vendit dhe armiq të rrezikshëm që përfundonin të vvarë, në burgje ose me trauma psiko-patologjike, në çmendinë¹⁸⁶.

¹⁷⁷ Kadare. I, Dimri i madh’, Tiranë, 1971.

¹⁷⁸ Kadare. I, ‘Muzgu i perëndive të stepave’, Tiranë, 1981.

¹⁷⁹ Kadare. I, ‘Vajza e Agamemnonit’, Tiranë, 2003.

¹⁸⁰ (rusisht): kështu pra shokë.

¹⁸¹ Mouse. Angry, ‘State of the Nation’, Daily Kos, 2010.

¹⁸² Kadare. I, ‘Spiritus’, Onufri, 1996.

¹⁸³ Kadare. I, ‘Shkaba’, Onufri, 1996.

¹⁸⁴ ‘Buzuku dhe Gjuha e tij’, Tiranë, 2005.

¹⁸⁵ Kadare. I, Muzgu I perëndive të stepës’, Tiranë, 1980.

¹⁸⁶ Foucault. M, ‘Historia e Marrëzisë’, Tiranë, 2003.

Shoqëria manipulohet me qëllim të caktuar, duke 'e bindur' atë me ideologjinë e gjuhës, sikur jetonte një 'parajsë', por në thelb artificiale dhe kriminale¹⁸⁷. Absurdi dhe paradokset ishin natyrë e tjetërsimit të shtetit. Hierarkia politike bënte 'agjitacion-propogandë' dhe censuronte njëherazi kundërshtarët e vet politikë, duke përjashtuar njëherazi dialogun publik dhe kompromisin me 'të deklasuarit'. E Vërteta mohohej me qëllim. Gjyqet ishin formale, të paligjshme dhe arbitrare. Oponenca publike¹⁸⁸ dhe avokatia nuk ekzistonin. Vendimet gjyqësore ishin ekstremisht absurde, me varje dhe pushkatim.¹⁸⁹ Gjykata kishte formën e një 'kulle-piramidë' hermetike, ku informacioni dhe vendimet ishin të tjetërsuar. Dokumentacioni i ndëshkimit mbahej i fshehur nga publiku. Kadare shkruan 'Kullë':-aktet, marrëveshjet e fshehta, korrespondenca me konsuj të huaj, akordet me qeveritë shqiptare, me republikën e parë, me republikën e dytë, me mbretërinë, akordet me guvernatorët apo komandantët e trupave pushtuese, turq, serbë, austriakë. Aktet ishin në disa gjuhë, shumica në shqipen e vjetër." Gjithçka ishte 'top sekret'. E gjithë shoqëria shqiptare jetonte një butafori të diktatorit-Zeus¹⁹⁰ dhe një çmenduri qesharake¹⁹¹ ku fryma e pëshpërimita e frikës diktonte jetën si në një ishull, në zemër të Europës.

Sipas Kadaresë, është 'makina monstroze shtetërore' që krijon probleme tepër të ngatërruara, kryesisht ekonomike¹⁹², duke na sjellë në vemendje legjendën e shqiptonjës, që ushqehet me plagët e veta, si profesioni më i vjetër i njeriut, në gjueti me plumbin. Kjo për shqiptarin, në ligjet kanonike quhet 'taksa e gjakut'¹⁹³ që buron nga ligji mbi tokën¹⁹⁴. Në kohën e komunizmit, diktatura politike e filloi sundimin në formën e një ligji agrar me natyrë 'Shtetëzim', 'Shpronësim', 'Konfiskim'. Në paqyrën e llogarisë, me një saktësi të çuditshme ishën bërë krahasime nga taksat e gjakut, gjatë katër vjetëve të fundit, krahasuar me të ardhurat e misrit, të bagëtisë, të shitjes së tokave, të minierave e të përqindjeve nga fajdetë, dhe përfundimet ishin çmendurore. Bashkë me përcudnimin e gjithçkaje, po përcudnoheshin dhe gurët e themelit të jetës morale në Kanun, si 'besa', 'gjakmarrja', 'miku', 'nderi' të cilat janë vlerat më të mëdha e sublime për shqiptarin. Me kalimin e viteve këto vlera ishin tjetërsuar njësoj si Tirani, duke u shndërruar dalngadalë në një makinë çnjerëzore, duke u katandisur në dukje 'një sipërmarrje kapitaliste fitimesh'. (IK. "Prilli i thyer")

Për shtetin totalitar, shoqëria humane dhe individit në veçanti, shihej si 'mall konsumi' me të cilin mund të bëjë tregëti si në kohën e skllavopronarisë së largët. Vlera dhe çmimi i jetës së çdo shqiptari, sipas konceptit 'stalinist' nuk ishte më shumë se '5 astra'¹⁹⁵. Shteti nuk qeveriste, por sundonte me dorë të hekurt.

Vetëm 'Rafshi' që janë malësitë shqiptare të cilat përbëjnë 'gjysmën e mbretërisë', jetojnë me fantazmën e Kanunit. Kanuni, është një e Drejtë për shqiptarin, para së cilit ligjet e Hamurabit, apo ç'janë andej më tutje, ngajnë 'lodra fëmijësh' (IK). Shteti është total, Kanuni është total. Ato qëndrojnë si dy blloqe bazë, ballë njëri-tjetrit, që mbajnë dhe lëkundin

¹⁸⁷ Elezi, I., Hysi, I., 'Politika Kriminale' T, 2006.

¹⁸⁸ Rama, E., Term i tij.

¹⁸⁹ Kadare, I., 'Ikja e Shtërgut', Onufri, 2000.

¹⁹⁰ Kadare, I., 'Stinë e mërziutshme në Olymp', T, 2002.

¹⁹¹ Kadar, I., 'Çështje të marrëzisë', Tiranë, 2009.

¹⁹² Kadare, I., 'Prilli i thyer', Tiranë, 1981.

¹⁹³ po aty.

¹⁹⁴ Meçani, D., 'Pronësia mbi tokën', Tiranë.

¹⁹⁵ Kadare, I., 'Dimri i madh', Tiranë, 1977.

kolonat ekonomike dhe morale që peshojnë, aq herë sa njeri i largohet tjetrit..Kanuni është kushtetua vetqeverisëse e popullit, në kushtet e mungesës së shtetit¹⁹⁶ normal.

Shkrimtari Kadare dëshmon¹⁹⁷ ‘Gjaku i shqiptarit si mall’. Ku mund të zbulojë një ‘bankë-gjaku’ kaq të pastër?’.

Janë me qindra e me mijëra jetë të pafajshme që kanë rënë në ‘morsën’ shypëse të makinës së rëndë, përbinndëshe ‘shtet’.Janë zhdukur dhe eliminuar qindra dhe mijëra njerëz vetëm për ‘një fjalë’, për ‘një muzikë të huaj’, për ‘një besim’, për ‘një libër dekadent’, për ‘një pikturë ndryshe’, për ‘një shfaqje të huaj’, për një shteg të lirë udhëtimi në vise të largëta, për një rilindje nga gjumi letragjik i vdekjes.

Kadare pohon:Kjo është pamja e vërtetë e gjërave!-..Pleqtë rënkojnë e psherëitjnë!-Eh botë ëndërr!...Ngritja e të vdekurve.-Allah, ç’tmerre ka këtu...Kaosi: toka e qielli të përzier bashkë..Projekte jetësh me zanafillë femërore.Me zanafilla mashkullore..Ëndrrat erotike...Krizat ekonomike, zhvleftësimet e monedhave, renta e çifligjeve, bankat, falimentimet, komplotet.Grushtet e shtetit, të shtypura që në vezë.Intrigat shtetërore.Deliret...ëndrrat osmane...ëndrrat e popujve...ëndrrat fetare...ëndrrat e pushtetit. Jo ringjallje e një të vdekuri, por e një kombi të tërë.

‘Viti i mbrapshtë’¹⁹⁸ i 1913 kur Europa ndahu kufijtë e Ballkanit, e shndërruan Gadishullin antik në ‘Fuçi baroti’ që shpërthen në prag të çdo Luftë Botërore.

Kadare pohon : ‘Një vashë e re, e shtrirë në një tyreze operacioni.Rrotull saj kirurgët me maska në fytyrë, me thika e gërshërë në duar.Poshtë qe shkruar : ‘Shqipëria në tryezën e bisedimeve të Fuqive të Mëdha në Londër’¹⁹⁹.

Shqipëria por, dhe Ballkani²⁰⁰ vuajnë ankthin dhe frikën e një arene lufte të nxehtë, të ftohtë dhe të përgjakshme, ku ndeshen etnitë dhe gjuhët e nacioneve me egërsi barbare²⁰¹. Diktatori Hoxha e betonizoi të gjithë Shqipërinë me bunkerë dhe tela me gjemba.Tirania tij nuk mund të krahasohet me askënd. Diktatori ka sindromën e sulmit të armikut fantazmë në Shqipëri dhe të një ‘shoku klinik’ ndaj shoqërisë.Kufijtë me fqinjët janë piramida të rrezikshme dhe të pakalueshme. Në çdo shtëpi përndiqej në mënyrë absurde.

‘Çdo shtëpi veç tymit, shkruan Kadare, ka Kuvendimin e vet: drurit megjithëse me rrënjët nën tokë, me të dalë nga dheu, s’dihej ç’i ndodhte.O i binte rrufeja, o sëpata, o rrëzohej vetvetiu’.²⁰²

Për stilistin e gjuhës²⁰³ Ismail Kadare, gjithmonë ka një ndryshim në tragjedinë ‘Hamlet’. Shkrimtari i thyen ligjet e rrëfimit me metafora që shkëlqejnë, megjithëse vepra dhe vetë Kadare nuk i shpetoi censurës dhe ndeshkimit.

‘Ftesë në studio’²⁰⁴, ‘Spiritus’, ‘Kronikë në gur’, ‘Çështje të marrëzisë’, ‘Darka e gabuar’ etj, është një ofertë që shkrimtari i bën lexuesit të kërkojë burimin e së ashtuquajturës ‘çoroditje universale’²⁰⁵. Njeriu ballafaqohet me djallin. E urren me forcën e shpirtit por, e ka

¹⁹⁶ Ymamoto.K ‘Struktura etike e Kanunit’,USA,2005,

¹⁹⁷ Kadare.I, ‘Spiritus’, Onufri,1996.

¹⁹⁸ Kadare.I, ‘Viti i mbrapshtë’, Tiranë, 1985.

¹⁹⁹ Po aty.

²⁰⁰ Kadare.I, Simiç.P,...”Ballkani i Jugut’, Onufri, 2005.

²⁰¹ Xhafaj.F, ‘Deballkanizimi i Ballkanit’, T, 2007.

²⁰² Kadare.I, ‘Çështje të marrëzisë’, Onufri, 2003.

²⁰³ Sadiku.I, ‘Kadareja ky stilist i madh’,Tiranë,2000.

²⁰⁴ Kadare.I, ‘Ftesë në studio’, T, 1990.

²⁰⁵ Buçpapaj.S, ‘Art që ngre krye kundër çeroditjes universale’.’Trebesiana’,T,1998.

frikë prej terrorit që përhapte. Të shkruaje në kohën e Diktatorit, ishte si të përktheje rrezikun²⁰⁶ e vetë Diktaturës në zemrën e saj, natyrën e egër prej 'kafshe', të përktheje konfuzionin e trurit që buronte nga manipulimi e së vërtetës. Diskursi kadarean e zhvendos kështu analizën në qendër të trillimit, si një informacion shkencor fikcional, me qëllim të vërtetojë tezën e tij, mbi natyrën flijuese të shqiptarit.

Kadare në veprat e veta na shfaqet shkrimtar i së Drejtës. Proza e Kadareane përfaqëson një praktikë të veçantë krijuese. Veprën artistike të Kadaresë e quajmë arti i demokracisë, sepse krijohet nga një autortet i pavarur²⁰⁷, të cilin e shqetëson siguria publike, të drejtat dhe liritë e individit, natyra e shtetit totalitar, raporti i tij me traditën, rendin dhe gjykatat. Shkrimtari shkruan me gjuhën e një avokati dhe shkrimtari gjykatës që mund ta zbulosh sipas natyrës së një 'common law'²⁰⁸.

Kadare e zbulon 'bishën-shtet' në trurin e vet, e cila sundon mbi flasitetin, deformin, gabimin, kalbjen, abuzimin, rrezikun e jetës së individit, ndërhyrjen deri në ëndrrën, për të shkatërruar identitetin e shqiptarit që është në kërkim të Europës²⁰⁹.

Historia zbulohet kështu si një parodi tragjik-komike e një shteti Donkishotesk me individin, që burojnë nga 'kapitali'²¹⁰ dhe shndërrimi i të gjitha vlerave²¹¹ shqiptare me gjuhën e përndjekjes dhe seleksionimit.

Qyteti dhe dashuria e Kadaresë për vendin dhe shqiptarët është pa reklama²¹². Ai e sheh historinë si një fushë konfliktesh, ku pushteti fshihet pas nacionalizmit shqiptar²¹³. Teksti artikistik i Kadaresë është një apel mbi 'Criminal Correspondence'²¹⁴ të shtetit totalitar.

Janë kufijtë ideologjikë dhe konfliktet historike ato që nga Perandoritë e deri te izolimi me fqinjët, që i shfaqin shqiptarët të duken në sytë e të tjerëve si një 'tribu zulush'²¹⁵, të zhytur në kaosin e jetës së vet. Por, nuk pushtohet as nuk robërohet kurrë një popull, pa u mbytur, pa u shojtur më parë letërsia, artet, shkenca, kultura e tij²¹⁶ pohon Lasgush Poradeci.

Është Kadare, dhe vepra e tij që na dëshmon se ne jemi një popull që jemi rritur²¹⁷ në krah të popujve më të vjetër të Europës dhe, përtej çdo kufiri, meritojmë padysim të thyejmë të gjitha kufijtë fizikë dhe moralë, për të vërtetuar indentitetin se kush jemi, nga vijnë dhe ku duam të shkojmë?

Përfundim: Është bërë një kërkim i papërfytyrueshëm nga guximi i çdo shqiptari për të ndryshuar natyrën e pushtetit dhe për të ndrruar kahun e historisë.

Vepra e Kadaresë është një dëshmi, që me krimin nuk duhet bërë kompromis. Kolapsi i kësaj nyje të ngatërruar i ka rrënjët në konfliktet historike dhe natyrën e pushteteve .

²⁰⁶ Shvarc.R. Përkthyes i literatures gjermane.

²⁰⁷ Lumi.E, 'Kadare shkrimtar i së Drejtës'. Tiranë, 2009.

²⁰⁸ Smith & Hogan, 'Criminal Law', UK,1983.

²⁰⁹ Lumi.E, 'Metamorfozat...', Tiranë, 2006.

²¹⁰ Marks.K, 'Kapitali', Tiranë, 1980.

²¹¹ Nietzsche.F, 'Shndërrimi i të gjitha vlerave në tragjedi', Tiranë,2002.

²¹² Kadare.I, 'Qyteti pa reklama', Tiranë, 1964.

²¹³ Clayer.N, 'Në fillimet e nacionalizmit shqiptar', T,2009.

²¹⁴ Warner.M, 'The Letters of the Republic', USA,1990.

²¹⁵ Konica.F, 'Katër përralla nga Zullulandi', Albania, 1898-1899.

²¹⁶ Poradeci.L, Intervistë, Pogradec,1987.

²¹⁷ Encyclopaedia Britannica', Vol 8, 1768. (Knowledge in Depth)

KUMTESA

Është besimi tek e ardhmja që si një memorije hyjnore u bën thirrje njerëzve : ‘Urbis²¹⁸ and Orbit’.

Emancipimi qytetar i shqiptarëve është një nevojë ‘emergjente’ që lidhet me reformat në të gjitha fushat politike, veçanërisht në fushën e së drejtës, dhe në prespektivën e vërtetë të shqiptarëve për të hyrë, të nderuar, në familjen Europiane.Ky emancipim na vjen nëpërmjet veprës së Ismail Kadaresë.

.Recenzentë :
Dr. Ilir Yzeiri
Dr.Meli Shopi

Sindorela DOLI – KRYEZIU: SHQIPJA STANDARDE DHE PËRDORIMI I SAJ NË KOSOVË

Kjo kumtesë do të trajtojë çështjen e raporteve të sotme midis shqipes standarde dhe shqipes së folur në Kosovë. Këtë vit mbushen plot 40 vjet që nga standardizimi i saj në Kongresin e Drejtshkrimit, mbajtur në Tiranë, më 1972. Pra motivi për përzgjedhjen e kësaj teme është gjendja jo e kënaqshme e përdorimit të standardit të shqipes këtu në Kosovë.

Në këtë kumtesë do të hulumtojmë problemet me të cilat janë ballafaquar folësit gegë (si nga trajta e shkruar ashtu edhe në të folur), posaçërisht në Kosovë, të cilat kanë paraqitur vështirësi të përvetësimit të standardit, prandaj do t'i paraqesim të gjitha vëzhgimet si probleme të mundshme që e ngadalësojnë përvetësimin e standardit.

Në zbatimin e normës së standardit të gjuhës shqipe, ka një mori rregullash si drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi që mund të jenë problematike në të folurën dhe më pak në të shkruarën e shqipes së unisuar në Kosovë.

Drejtshqiptimi duhet të paraqitet si pjesë e kulturës së të folurit, të cilat kanë vlerë edhe sidomos në të folurën formale që mund të rritet krahas fjalës së shqiptuar drejtë të paraqitura në shoqëri, në shkolla, medie, konferenca të ndryshme, debate, në paraqitjet skenike sidomos në teatro, etj.

Meqë po merremi me problemet që dalin nga shqipja standarde e folur në Kosovë, të cilat kanë lidhje të ngushtë me kushtet shoqërore të folësve, dihet fakti se në Kosovën e paraluftës së 1999, kemi pasur regjimin e pushtetit serb. Po ashtu, nëse i kthehemi edhe Luftës së Dytë botërore pas 1945, në Kosovë ka mbizotëruar analfabetizmi, me një numër mjaft të vogël shkollash të gjuhës shqipe, ku më shumë rëndësi iu është dhënë gjuhës serbokroatishte në krahasim me gjuhën amtare shqipe. Gjuha shqipe e ka pasur të kufizuar përdorimin, është folur brenda familjes, farefisit dhe në ato pak shkolla që kanë qenë. Ndërsa, gjuha serbishte si gjuhë e prestigjit të asaj kohe, ka ndikuar në leksikun e shqipes së folësve gegë, sidomos në sintaksë, morfologji po edhe në fonetikë.

Faktor tjetër është edhe ikja e shqiptarëve jashtë atdheut për arsye politike, të cilët kanë qenë të izoluar prej shtetit amë. Prandaj, edhe historia e zhvillimit të shqipes standarde është e lidhur ngushtë nga ndikimi i faktorëve shoqëror të cilët kanë ndikuar dukshëm në shqiptimin e drejtë të shqipes së unisuar.

Por, pas mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit 1972, është futur me shumë kombëtarizim dhe patriotizëm zbatimi në mënyrë të fuqishme ndaj shqipes standarde, gjë që dominon edhe sot, me përjashtim të grupeve të caktuara që kalojnë në ekstremizëm.

Trajtën e folur në Kosovë, duhet shikuar cilat shtresa shoqërore e kanë të folurën më të përafërt me gjuhën standarde. Këto shtresa gjuhësore sipas varieteteve të tyre mund të ndahen tek gjinia, mosha, statusi shoqëror, arsimimi etj. Po t'i vërejmë në medie të ndryshme kosovare, do të shohim se aty do të nxirren në pah e folura e shtresave të ndryshme, që

konkretisht, pa dashje njeriu vetëm në të dëgjuarit e tyre do t'i selektojë në nivele të ndryshme arsimore. Këto shtresa dallojnë për nga niveli i përdoruesve të varieteteve të ndryshme ekzistuese në Kosovë, si dhe variacionit gjuhësor që shfaqet në të folur të individëve nën ndikimin e faktorëve të tillë shoqërorë e psikologjikë, po që gjithmonë bazohet niveli i shkollimit të këtyre vernakularëve.

Duke dashur që të shikojmë realitetin e saktë të përdorimit të standardit në Kosovë, kemi bërë dy lloj anketimesh/pyetësorë me studentë të drejtimit Gjuhë dhe letërsi shqipe të Fakultetit të Edukimit, në disa qytete të Kosovës.

1. Problemet fonetike dhe fonologjike

Tek njëra nga pjesa e pyetësorit ishte edhe shkrimi i drejtë për ditët e javës. Ku gabim janë shkruar sidomos dita e hënë, e enjte, e shtunë dhe e diela. Karakteristika e gabimeve në mes qytetesh ishin këto ditë: ditën e hënë- një përqindje e lartë e gabimeve në të shkruar ishin qytetet e komunave të Prishtinës, Gjilanit, Gjakovës, e Prizrenit e më pak në Pejë (është e shkruar e hëne- me /e/ në fund); dita e enjte është shënuar gabim gati prej të gjitha komunave, me përjashtime të një përqindjeje shumë të vogël (është shënuar e enjete me/ë/ në mes me tinguj të shtuar ose epentezë, ose ejte, e paraqitur si shpërngjashmim ose disimilim) ; dita e shtunë është shënuar gabim në një përqindje të lartë gati nga të gjithë të anketuarit e qytetit të Pejës (e paraqitur me tinguj të shtuar, ose protezë); kurse dita e diel, është shënuar gabim në një përqindje të lartë nga të anketuarit e qytetit të Gjakovës si: e dille (kjo është dukuri e cila është marrë nga sllavishtja paraguhorja /ll/, ku është interesant fakti, se kjo dukuri gjendet në zonën ku kemi një bilinguizëm modern sllavo-shqiptar), e diellë (/ë/ e shtuar pa vend) , ose në disa komuna si e djelë. Edhe në të folurën joformale, po edhe në atë formale e herë- herë në medie, e dëgjojmë shumë të përhapur metatezën apo vendkëmbimin e vendeve të dy tingujve në fjalë. Të përhapur dhe mjaft karakteristike e kanë sidomos qytetet: Gjakova dhe Theranda. P.sh. “Frabrikat nuk punojnë më”, fabrikat>frabrikat –metateza e /r/ (në Gjakovë), si dhe “ E përshëndesmi këtë rast”, përshëndesim>përshëndesmi – metateza e /i/ (në Therandë, apo ish Suharekë). Po ashtu, edhe theksi zë vend me rëndësi në të folurën e arealëve në Kosovë dhe në shqipen standarde. Në të folmen e dialektit gegë, zanoret e patheksuara jo vetëm që kanë prirje të tkurren , po shpesh ndodhë që edhe te bien, si. P.sh. përrállë>prá:ll, shtëpi>shpi, shtëllúngë>shllú:ng, shembujt tregojnë se mosshqiptimi i [ë]-së fundore është karakteristikë e të folmes së gegërishtes për dallim nga shqipja standarde. Karakteristikë tjetër e theksit është se në çfarë pozite bie theksi në fjalët shumërrokëshe. Në gjuhën shqipe i kemi të paraqitura në pozitën fundore (ku theksi bie në rrokjen e parë nga fundi i fjalës që ndryshe quhen oksitone, p.sh. njerí, qirí, babá, etj). Mirëpo, nga shqipja standarde dhe shqipja e folur në Kosovë, ka dallim në zbatimin e këtyre pozitave të paraqitura në rrokje. P.sh. kur u përmend pozita fundore oksitone si: njerí- në Kosovë theksohet njëri, qirí -qíri , babá – bába, etj. Pra, janë të theksuara sipas pozitës parafundore ose paroksite. Kemi rastin edhe në gjuhën formale, konkretisht në mediat tona në RTK, ku konferencieri i lajmeve në vend se ta shqiptojë fjalën veriú i Kosovës, ai e thotë vériu i Kosovës, e shumë raste të këtilla me rastin e shqiptimit të drejtë të tingujve.

Anketimi i radhës kishte pyetjen “A më lehtë e flisni standardin apo e shkruani?” Nga 150 të anketuarit, pjesa dërrmuese përafro 98% u përgjigjen që më lehtë shkruajnë në gjuhën standarde, ndërsa një numër i vogël i të anketuarve u përgjigjen, më lehtë e flasin shqipen standarde.

Ndërkaq, kur jemi te e shkruara, 40 % shkruajnë drejtë, me gabime tolerante. Kur i kemi futur ta lexojnë dhe ta komentojnë atë që e kanë shkruar, na bie në sy menjëherë një "harresë" e shqipes standarde, nëse mund të shprehemi kështu. Pra, në komunikimin e zakonshëm nuk flitet shqipja standarde, pothuajse të gjithë e përdorin gjuhën joformale, konkretisht gegërishten.

Anketimi përpos që iu është bërë në mënyrë të shkruar, prej shumicës së studentëve është kërkuar që edhe ta lexojnë në mënyrë që të shohim drejt shqiptimin e asaj që e kanë shkruar, konkretisht në shqiptimin e tingujve ku kemi rastin e paraqitjes së dukurive fonetike. Ndërsa, tek gjuha formale, pasi iu tërhoqëm vërejtjen, kemi ndeshur në probleme të shumta. Mes tyre më të shfaqura i kishin këto të përbashkëta:

1. Në komunikimin joformal përdorej pothuajse komplet gegërishtja;
2. Pjesa që mundahej të fliste shqipen standarde (edhe pse me shumë probleme) kishte një situatë paksa sociolinguistike që dalloheshin nga ngritja apo formimi që e kishin të krijuar përmes arsimimit më të përkushtuar, konkretisht përmes leximit. Ose, ishin studentë që kishin qëndruar më shumë në viset e Shqipërisë, ose tjetra, që kishin lidhje familjare me qytetet e Shqipërisë (së mesme e asaj të jugut);
3. Kur flisnin në shqipen standarde, problemet dalloheshin fare qartë. Një kosovar që e flite sipas rregullave të shqipes standarde kuptohet lehtë, sepse fjalët e tij janë të shkurtra, ka gabime në sistemin fonetik., leksikor, morfologjik dhe sintaksor, si dhe flet shumë ngadalë. Po ashtu, ka përzierje mes formave dialektore, të kombinimit sipas sistemit gjuhësor të gjuhës sllave, pra fillojnë me frazat gabim. Kësaj i shtohet edhe problemi psikologjik, pasi që mundohet në mënyrë korrekte të flasë shqipen standarde e njëkohësisht i kupton edhe gabimet e veta gjersa e flet standardin. Kjo gjë i bën edhe më të ngathët në përdorimin e shqipes standarde.

2. Problemet morfologjike

Në rastin e shqipes së folur në Kosovë, pothuajse ka gabime te shumta morfologjike si në të folur, ashtu edhe në të shkruar, kur mundohen ta flasin standardin dhe aty pasojnë ndryshimet e paraqitura sidomos tek emrat, ku i vihen dhe ku nuk i vihet –ë- fundore, ku si pasojë ndryshon veta, numri dhe koha, si dhe kuptimi.

Kemi raste p.sh.

- "kritikë", e shkruajnë dhe e flasin pa –ë- fundore, që konkretisht nga –kritikë- që është emër, na del mbiemër -kritik-.
- ka qenë në gusht (për një ngjarje të cilën e shkruan një studente R. S.), po që e shkruan gabimisht "ka qen në gusht". Në radhë të parë ndryshon kuptimi i fjalës, në vend të foljes " ka qenë", na del fjala "qen" që është emër.
- ose përemri pronor "saj", e shkruajnë "sajë", pra nga përemri na del emër.
- përemri "atë", e shënojnë pa –ë- fundore, dhe del emër "At", pra prift.
- tek ndajfolja "fare", e shkruajnë më –ë- fundore "farë", që del se është emër.
- kur parafjalës "me", e shkruajnë me –ë- fundore –më-, ku del trajtë e shkurtër e përemrit vetor, ose shkallë e mbiemrit. - lidhëzën "megjithëkëtë" e shkruajnë si dhe e shqiptojnë pa –ë- fundore "megjithëkët".
- lidhëzën "duke qenë se", e shkruajnë pa –ë- fundore "duke qen se", pra i humbet kuptimi.
- Pjesëza " qe", e shkruajnë me –ë- fundore, që del lidhëza "që".

Të gjitha këto sa u thanë më lartë, janë me përqindje që paraqesin dukuritë morfologjike në të shkruar, po që ekzistojnë më shumë edhe në të folur.

2.1. Përdorim i gabueshëm në fushën e emrave

Kemi shkelje të normës në fushën e emrave në rastin e rasave të emrit, të shumësit të emrit, të gjinisë etj. Në rastin e rasave të emrit kemi këto lloj gabimesh, p.sh. parafjala në shpesh na del në rasën emërore në vend të rasës kallëzore. E hasim në këtë formë: “Dje në ora 12 u mbajt...”, është dashur të thuhet “ Dje në orën 12 u mbajt...”. Nuk e bëjnë dallimin në të shkruar të fjalës plak me plakë, p.sh. ne mediet tona “ ...u gjet e vdekur një plakë...”, ku doli që kishte të bënte me një plak, pra të gjinisë mashkullore. Hkelje tjetër të rasave të emrit kemi rastin e rasës dhanore, ku gabimisht përdoret emri me parafjalën te. P.sh. “... kërkoi që t’i kalojë kërkesa te Qeveria”, në vend të “...kërkoi që t’i kalojë kërkesa Qeverisë”.

2.2. Përdorim i gabueshëm në fushën e mbiemrave

Kemi shkelje të normës drejtshkrimore tek mbiemrat që i përcaktojnë emrat e gjinisë mashkullore, që në shumës e ndërrojnë gjininë, apo si i quajmë ndryshe emrat ambigjenë, të cilët në shumës i hasim po në formën e gjinisë mashkullore. Kjo mund të shihet nga shembulli: “Njerëzit me karaktere të ndryshëm...”, në vend: “Njerëzit me karaktere të ndryshme...”, etj.

2.3. Përdorim i gabueshëm në fushën e përemrave

Edhe në këtë fushë kemi shkelje të normës, sidomos te trajtat e shkurtëra të përemrit vetorë. Si p.sh. “ Do t’iu them juve këtu që...” në vend të “ Do t’ju them juve këtu...” (trajta t’iu them –ka të bëjë me veten e tretë të numrit shumës, e jo me kuptimin logjik për njerëzit që janë prezent aty, me veten e dytë të numrit shumës, pra t’ju them juve këtu)”. Po ashtu përemri pyetës cka përdoret pa kuptim në vend të përemrit lidhor që, si në të trajtën e folur ashtu edhe në të folur, p.sh. “ Atë cka dua të them është se...”, në vend të “Atë që dua të them është se...”. Kemi rastet e gabuara të përdorimit të nyjës së përparme përpara përemrave pronorë të vetës së parë dhe të dytë njëjës dhe shumës, si p.sh. “Vota e jonë shkoi huq”, në vend të “ Vota jonë shkoi huq” etj. Kemi shkelje të normës edhe të përemrave pronorë, si p.sh. “Më tregoi shoqja e juaj që keni provim sot”, në vend të “ Më tregoi shoqja juaj që keni provim sot”, pra s’ka nevojë për nyje të përparme“. “ Ardhmëria e Kosovës tonë varet nga rinia jonë”, në vend të “ Ardhmëria e Kosovës sonë varet nga rinia jonë”, etj.

2.4. Përdorim i gabueshëm në fushën e parafjalëve

Po ashtu shkelje të normës drejtshkrimore kemi te parafjalët *në* dhe *nën*, ku zakonisht këto të dyja i përziejnë në mes tyre edhe me parashtesën para. P.sh. “ Shkollën e ndërtuam nën ditët e para të shtatorit” (marrë nga RTV21 nga një politikan 2010), kuptimin logjik të saj e kishin për parashtesën para, që kryesisht tregon tipar për një kohë më të hershme, është dashur të jetë “ Shkollën e ndërtuam para ditëve të para të shtatorit”, ose “Kënetat e dikurshme u shndërruan nën fusha pjellore”, në vend të “Kënetat e dikurshme u shndërruan në fusha pjellore”, etj.

2.5. Përdorim i gabueshëm në fushën e nyjave

Shkeljet e normës drejtshkrimore i kemi gjithsesi edhe në fushën e nyjave. Shumë raste si në trajtën e shkruar po edhe më shumë në trajtën e folur e kemi te nyjat e përparme të dhe së. P.sh. “ 5 vjetori i vdekjes të dr. Ibrahim Rugovës”, në vend të “ 5 vjetori i vdekjes së dr. Ibrahim Rugovës”, “Kosova është zhvilluar përmes të cilës...”, në vend të “ Kosova është zhvilluar përmes së cilës...”,

2.6. Përdorim i gabueshëm në fushën e foljeve

Problemi më i madh në trajtën e shkruar, po sidomos në trajtën e folur në Kosovë, e hasim në fushën e foljeve. Shkelje të normës kemi shënuar në përdorimin e vetës së tretë të lidhores në vend të vetës së tretë njëjës të së kryerës së thjeshtë dëftore, p.sh. “Ajo mendojë njëjtë”, në vend të “Ajo mendoj njëjtë”. Po ashtu, veta e parë njëjës e mënyrës dëftore të kohës së tashme shkruhet pa ë-, p.sh. “Unë po mësojë vazhdimisht...”, në vend të “Unë po mësoj vazhdimisht...” (këtë nuk e hasim në trajtën e folur), “Të uroj shumë fat”, në vend të “Të uroj shumë fat”. Kemi raste të shumta të foljeve në vetën e tretë njëjës të lidhores, të cilat shkruhen pa mbaresën ë fundore po edhe shqiptohen gabim, kjo është shkelja më e shumtë në fushën e foljeve. P.sh. “Ajo nuk ka mundur të flas me nënën”, në vend të “Ajo nuk ka mundur të flasë me nënën”, “Nuk ka mundur ta regjistroj fakultetin”, në vend të “Nuk ka mundur ta regjistrojë fakultetin”.

Ose shkelje tjetër në trajtën e folur kemi përzirjen e vetës së parë me të tretën, p.sh. “Po e përdori...”, në vend të “Po e përdor”. Një prej shkeljeve më të shpeshta ku është dallimi në mes të gegërishtes dhe gjuhës standarde është ai i përdorimit të pjesores së shkurtër në vend të pjesores së zgjeruar. P.sh. “Ajo i ka përmend disa fakte që...”, në vend të “Ajo i ka përmendur disa fakte...”

2.7. Përdorim i gabueshëm në formimin e numrit shumës

Kemi po ashtu raste të shkeljes së normës në formimin e numrit shumës te emrat, mbiemrat, të cilët e formojnë shumësinë me ë, zakonisht shkruhen pa ë, po edhe shqiptohen po njëjtë, pa ë-. Kjo shkelje shfaqet si dukuri e shpeshtë. P.sh. “të menduarit opozitar”, në vend të “Të menduarit opozitarë”. Kemi rastet ku shumësit të emrave ia shtojnë shquarsinë pa nevojë, p.sh. “Bleva disa kilogramë molla”, në vend të “Bleva disa kilogramë mollë”. Po ashtu kemi shkelje tek ë-ja e shumësit edhe në emrat që shënojnë frymorë, p.sh. “Kriminelat janë ende të lirë”, në vend të “Kriminelët janë ende të lirë”. Kemi rastin edhe te qiellzorëzimi i bashkëtingulloreve fundore i k në q. P.sh. “Shtëpinë e kishte ndërtuar me blloka”, në vend të “Shtëpinë e kishte ndërtuar me blloqe”, “Kishte shitur dru me denga”, në vend të “Kishte shitur drunj me dengje”, etj.

3. Shkaqet sintaksore

Një problem serioz për normën drejtshkrimore janë problemet e karakterit sintaksor. Askush nuk po shqetësohet për një mori fjalësh apo shprehjesh që kanë hyrë tashmë në leksikon tonë, përkundër natyrës së shqipes standarde, shqipes së folur të mëhershme, madje edhe nga gjuhëtarët ose nga ata që e quajnë vetën të tillë. Në fushën e sintaksës e vërejmë shpesh përdorimin e emrit prejfoljor me parafjalë në vend të formës së foljes në formën e përcjellores. Kjo është bërë një dukuri e shpeshtë në shqipen e shkruar po edhe në të folurën. P.sh. “Ata theksuan se janë në kërkim të një rroge më të mirë...”, në vend të “Ata theksuan se janë duke kërkuar një rrogë më të mirë...”

-Shkolla që janë të thirrura ta mbrojnë shqipen tonë... (në mediat tona), në vend se të thonë “shkollat që janë kompetente ta mbrojnë shqipen tonë”;

-Më vie keq (në vend se “më vjen keq”);

-Me kaq po e përmbylim këtë emision lajmesh (drejtuesit e lajmeve), kjo të jep të kuptosh se me kaq s’do të ketë më lajme, u përmbyll;

-Të konsulltohet literatura, (s’ka se si konsultohet literatura, se për t’u konsultuar duhet të jenë dy individë apo dy bashkëfolës);

KUMTESA

- Konsultojë mjekun (kur pacienti ka nevojë për mjekun, dhe logjika është që ky të konsultohet nga mjeku, e jo ky ta konsultojë mjekun që vet është në nevojë);
- Mbledhja mbahet në 10 ora (është përkthim direkt nga sllavishtja, ku duhet thënë “ mbledhja mbahet në orën 10”);
- Në një makinë, pesë persona janë plagosur rëndë pas një aksidenti...– në vend se të: Në një makinë, pesë persona janë plagosur rëndë në një aksident, etj;
- Të shpejtohet dhe të përshpejtohet çështja...(marrë nga RTK me 23 shkurt 2011)- mjafton të jetë njëra nga këto shprehjet, të cilat kanë të njëjtin kuptim;
- Ka risi të reja- (po ashtu marrë nga një reklamë nga RTK “Nota brilante”)- mjafton njëra nga këto fjalët, sepse kanë të njëjtin kuptim)
- Risja më e re (Reklamë nga mediat tona)- vet fjala risi e ka kuptimin e re, pra edhe këtu s’ka vend për të dy fjalët të së njëjtit kuptim, etj.
- Kemi studentë me kualitet dhe cilësi të lartë (nga fjalimi i njërit prej panelistëve të ftuar në “Javën e Shkencës 2012”)

Një gjë duhet ta kemi të qartë se sintaksa është bazamenti i gjuhës. Gjuhëtari M.Samara shprehet me të drejtë, ku thotë: “ Detyrë e studentit, mësuesit, gjuhëtarit, gazetarit, shkrimtarit, shtetarit dhe e çdo qytetari shqiptar është ta dojë gjuhën letrare, ta mësojë e përvetësojë normën e saj të përpiqet të lëvrojë e zhvillojë më tej atë, ta pasurojë dhe të zgjerojë frymëmarrjen e saj, ta ruajë e ta mbrojë, sepse ajo është dhe mbetet vetëqenia e tij, burim, frymëzim dhe krenari kombëtare për secilindo”.

Gjuha duhet të vendosë marrëdhënie edhe midis brezave të ndryshëm, duhet të transmetojë idetë nga një brez në tjetrin, të sigurojë kështu trashëgiminë. Për këtë arsye, ajo duhet të ruajë njëjtësinë e normës drejtshkrimore, përndryshe, pas tre ose katërqind vjetësh, këto radhë që po shkruhen sot këtu, do të mund të lexohen vetëm nga filologët e specializuar.

Recenzentë:
Dr.sc. Mazllom Kumnova
Prof.dr. Hasan Mujaj

Prof. asc. dr. Begzad BALIU¹: GJENDJA E TOPONIMISË NË BALLKAN

(The status of the toponymy in the Balkans)

¹Universiteti i Prishtinës
Fakulteti i Edukimit

Summary

The Balkan region represents with its history and linguistics (which is one of its most important components) a great and manifold richness of the South-Eastern Europe. Before studying its microstructure it is the problem of the inventory of toponymy and its consequences which is represented by its very name: the Illyrian Peninsula, the Hellenic Peninsula, Rumelia, the Balkan Peninsula, South-Eastern Europe, and recently a new tendency for its separation by calling a part of it the Western Balkan, where the Albanian ethno-linguistic and cultural realm is a part. The space included in our research is characterized by a rich and deep cultural and linguistic tradition: the pre-Indo-European heritage (the Pelazgians), the Indo-European families heritage (the Hellene, the Illyrians, the Thracian, the Slavs), a rich stratification of cultures appeared more than anywhere in the “pelasgian” toponymy of Illyrians, Greeks, Romans, Sases, Albanians, Slavic (mainly Serbian and Bulgarian), Roma, Turkish, etc., as well as a common linguistic realm called more than once with the syntagma Balkanic Linguistics. Today in the world it is very rare to find such numerous and deep cultural stratifications within one unique geographical integral such as in the Balkan. It is very difficult to find such a small space which has accepted and radiated such a rich culture in Europe, Asia and elsewhere. Toponymy has marked deep and rich traces in this radiation. It reflects the most secure signs of the historical developments not only for the Balkan realm, but also for the linguistic, historic and cultural realm of Europe and Asia. But in the Balkans, as nowhere else, toponymy more than once has been the sign of recycling the old myths and new ethnic conflicts. As if the rich and sometimes dark heritage for what regards the descent was not enough, the Balkan toponymy in the recent centuries continues to be convoluted with contemporary strata of myths.

Referenc: Toponymy, Balkans, Illyrians, Greeks, Romans, Sases, Albanians, Slavic, Roma, Balkanic Linguistics.

HYRJE

Ballkani, si me historinë ashtu edhe me gjuhësinë (që është njëra prej përbërëseve të saj më të rëndësishme) paraqet një pasuri të madhe dhe shumështrësore të Europës Juglindore. Më parë sesa mikrostrukturat e tij, problemin e inventarizimit të toponimisë dhe rrjedhëve të saj, në këtë proviniençë të Europës, e paraqet vetë emri i tij: Gadishulli Ilirik, Gadishulli Helenik, Rumelia, Gadishulli Ballkanik, Europa Juglindore dhe tash së fundi një tendencë e re për ndarjen e tij: Ballkani Perëndimor.

Hapësirën e përfshirë në studimin tonë e karakterizon një traditë e pasur dhe e thellë kulturore e gjuhësore: trashëgimia paraindoeuropiane (Pellazgët), trashëgimia e familjeve indoeuropiane (Helenët, Ilirët, Trakët, Sllavët) dhe joindoeuropiane (Turqit); një shtresim i pasur kulturash të shfaqura më shumë se askund, në toponiminë: pellazge, ilire, greke, romake, sase, shqiptare, sllave (kryesisht serbe e bullgare), arumune, turke etj., por edhe një areal gjuhësor i përbashkët, i konstatuar jo njëherë me sintagmën gjuhësi ballkanike.

Sot, janë të rralla në botë shtresimet kaq të shumta e të thella kulturore brenda një tërësie gjeografike, sikur i gjejmë në Ballkan. Zor të gjendet një hapësirë kaq e vogël, e cila ka pranuar dhe ka rrezatuar një kulturë kaq të pasur në Europë, në Azi e më tej. Në këtë rrezatim, toponimia ka shënuar gjurmë të thella dhe të pasura. Ajo reflekton shenjat më të sigurt të zhvillimeve historike jo vetëm në arealin e Ballkanit, por edhe në arealin gjuhësor, historik e kulturor të Europës e të Azisë. Është e kuptueshme prandaj, pse ka shumë kohë që studimi i onomastikës, përkatësisht i toponimisë, paraqet një prej problemeve të shpeshta dhe shumë interesante në rrethet shkencore ballkanike dhe europiane. Ajo është bërë fushë e kërkimeve të shkollave dhe e drejtimeve më bashkëkohore të kohës; Ajo është bërë sinonim i kërkimeve historike, gjuhësore, kulturore dhe madje të vetë prejardhjes së një populli a të një tjetri në Ballkan; Ajo është bërë mjet i caktimit të kufijve të përshtirjes historike të popujve në këtë rajon në shekujt më të errët të historisë.

Por, në Ballkan si ndoshta askund tjetër, toponimia jo njëherë ka qenë shenjë e riciklimit të miteve të vjetra dhe e konflikteve të reja nacionale. Sikur të mos mjaftonte trashëgimia sa e pasur po kaq e errët, sa i përket prejardhjes, toponimia e Ballkanit disa herë, shekujt e fundit vazhdon të mbështillet me shtresa mitesh bashkëkohore.

GJENDJA E TOPONIMISË NË GREQI

Gjatë fundit të shekullit XIX dhe gjysmës së parë të shekullit XX Greqia shfrytëzoi situatën politike dhe diplomatike të kohës, jo vetëm për të përzënë popullatën jogreke, por edhe për të ndryshuar trashëgiminë e saj me elemente kulturore e historike të provinencës greke. Nuk ka dyshim se ndryshimet janë të mëdha, të shumta dhe të ndryshme, por kujtesa popullore, trashëgimia kulturore dhe historike i ka ruajtur dhe duke mos qenë këto ndryshime të largëta, vazhdon t'i ruajë të freskëta në përditshmërinë e tij, pavarësisht nëse jeton në ato vendbanime apo jo.

Prej kujtesës historike të popullatës shqiptare të dëbuar nga Çamëria dhe prej asaj të mbetur në vendbanimet e të parëve të tyre, arvanitase, nuk duhet të jesh etimolog për të kuptuar origjinën shqipe të toponimisë së krahinës së Çamërisë dhe asaj të shpërndarë në gjithë hapësirën e shtetit të sotëm grek, e cila është ndryshuar me emra të rinj të fjalësit grek me metoda administrative.

Një njollë më vete në toponiminë e Greqisë paraqet standardizimi i saj në veri të këtij vendi. Fjala është për toponiminë sllave të zonës së Maqedonisë së Egjeut, për të cilën studiuesit maqedonas ngulin këmbë se është e tëra e proveniencës së gjuhës, historisë dhe trashëgimisë së tyre. Në këtë zonë studiuesit e onomastikës kanë identifikuar rreth 3000 ojkonime, mikrotoponime e oronime të ndryshme, disa prej të cilave mund të identifikohen edhe nga etimologët popullor, por që të gjitha sot janë standardizuar si emra të rinj të gjuhës dhe semantikës greke. (Симовски1978).

GJENDJA E TOPNIMISË NË SERBI

Duke u mbështetur në mitet e romantizmit kombëtar dhe në mitet e kohëve të reja, qeveria serbe ka krijuar një hartë të re dhe të paqëndrueshme të arealit shqiptar nën Jugosllavi. Kështu, duke u mbështetur në mitet e vjetra serbe, pushteti i jugosllav ka krijuar një sistem emërtimesh me paradigme Luftën e Kosovës (1939): *Devet Jugoviq, Kosovo Polje, Orloviq, Obiliq, Llazarevë, Dushanovë* etj., ndërsa duke u mbështetur në paradigmen historike të saj ka krijuar një sistem tjetër, të riemërtimit të vendbanimeve të Kosovës: *Ferizaj: Uroshevac, Hani i Elezit: Gjeneral Janković, Fusha e Kosovës: Kosovo Polje, Kaličan* (në emër të gjeneralit serb Kaliçanin), etj.

Përpykja e dështuar shtetërore

Pas Luftës së Dytë Botërore është bërë përpjekje që ndonjë element përmbajtësor i toponimisë së kësaj ane ose të ruhet ose të rikthehet në gjendjen e mëparshme, por pa bërë ndryshime të rëndësishme. Ndryshime nën ndikimin e lëvizjeve të fuqishme kulturore, shkencore dhe politike të shqiptarëve do të fillojnë të bëhen vetëm në fillim të viteve '70. Atë kohë qenë bërë disa përmirësime dhe përparime të dukshme në hartën toponimike të Kosovës dhe jo vetëm të saj. Amandamentet e miratuara në Kushtetutën e Jugosllavisë nga Qeveria e saj më 1971 (shih, Zbornik, 1984), lejonin për një përdorim më të saktë të toponimeve dhe sidomos për një përdorim në shkrim dhe shqiptim të mundshëm të tyre edhe në gjuhët e kombësive, për të cilat janë të merituar edhe përpjekjet e studiuesve shqiptarë në Kosovë (shih, *Onomastika e Kosovës*, 1979).

Duke u mbështetur në rezolutat e njohura ndërkombëtarisht, sidomos ato të viteve 1967 dhe 1973, në ish-Jugosllavi, që nga viti 1977 filloi procedura e formimit të Komisionit për Standardizimin e Toponimisë, të cilin duhej ta përbënin: Komisioni Federativ (si institucion koordinues i Qeverisë Federale dhe pa ingerenca të theksuara e me ndikim mbi politikën e standardizimit të toponimisë së republikave dhe krahinave jugosllave), dhe komisionet republikane e krahinore. Sipas udhëzimeve të sjella nga organet më të larta shtetërore, prej makrotoponimeve, mezotoponimeve dhe mikrotoponimeve, vlerësimi duhet t'i nënshtroheshin vetëm emrat e lokaliteteve – mikrotoponimet, ndërsa emrat e lagjeve vetëm duhej të standardizoheshin. Parimet ishin të përgjithshme, por edhe të detajuara: nuk kishte rëndësi prejardhja etimologjike e toponimit; secili toponim duhej shikuar dhe studiuar në mënyrë interdisiplinare nga gjuhëtarë, gjeografë, hartografë, historianë etj., kërkimet në terren dhe arkiva duheshin bërë në mënyrë paralele; duheshin marrë parasysh të gjitha trajtat e shkrimit dhe të shqiptimit, pavarësisht a ishin ato gjuhë zyrtare apo të minoriteteve dhe duhej dhënë përparësi gjendjes më të përshtatshme për të gjithë; duhej të caktohej kategoria e toponimit etj. Pritej që rezultatet e standardizimit të toponimisë edhe në arealin e banuar me shqiptarë të përfundonin me sukses (Petrica 1987: 4; Gosl 1988: 81-95).

Nga të gjitha komisionet, siç dihet, që formuar vetëm Komisioni për Maqedoninë, vendimet politike dhe aspak shkencore të të cilit, siç dihet do të rrënojnë toponiminë e prejardhjes dhe shqiptimit në gjuhën shqipe. Në të vërtetë, më parë sesa të standardizonte toponiminë shumështrësore dhe shumëgjuhësore të Maqedonisë, ai Komision që bërë laborator i sprovave të politikës kulturore, shkencore dhe administrative serbe nga Beogradi.

GJENDJA E TOPONIMISË NË MAQEDONISË

Standardizimi i toponimisë në ish-Jugosllavi dhe prova e parë në Maqedoni

Përpjekjet e para për formimin e komisioneve republikane dhe krahinore për standardizimin e emërvendeve në Jugosllavi lidhen me Maqedoninë. Prej projekteve komisionit maqedonas, prej qëllimeve të tij dhe prej rezultateve të para të tij, pavarësisht prej udhëzimeve dukshëm më të arsyeshme nga Komisioni Federativ, nuk është vështirë të kuptohet se koncepti i tyre ishte nxjerrë nga laboratorit i vjetër i Beogradit, me qëllim të mënjanimin të toponimisë tradicionale bilinge në trojet etnike shqiptare brenda Maqedonisë. Gjithashtu kjo sjellje e Komisionit të administratës maqedone ishte vetëm një sinjal paraprak për rezultatet që duhej të priteshin edhe në pjesën tjetër të toponimisë së arealit shqiptar në ish-Jugosllavi (Kosovë, Serbi dhe Mal të Zi).

Sipas projektit të Komisionit Republikan të Maqedonisë, vendimet e të cilit shpejt do të bëhen të ligjshme dhe të referueshme jo vetëm në administratën e përditshme, por edhe në tekstet shkollore, toponimet shumëgjuhëshe në Maqedoni duhet të shkruheshin, duhet të shqiptoheshin dhe duhet të përdroreshin vetëm në gjuhën, përkatësisht, në trajtën e gjuhës maqedonase, si: *Shkup*: Skopje, *Tetovë*: Tetovo, *Ohër*: Ohrid, *Kërçovë*: Kiçevo, *Dibër*: Debar, *Manastir*: Bitola etj. Nëse këto vendime merreshin dhe imponoheshin dhunshëm për qytetet më të mëdha të vendit, për qytetet ku historikisht popullsia shumicë ishte popullsia shqiptare, sot mund të merret me mend se çfarë vendimesh janë marrë apo do të merren më vonë për hidroniminë, oroniminë, dhe mikrotoponimet e tjera anësore për opinionin, por të thella dhe shumë të rëndësishme për historinë e gjuhës dhe të vendit (*Gjendja*: 1987; *Balio*: 1997, 2004).

GJENDJA E TOPONIMISË NË SHQIPËRI

Standardizimi gjatë sistemit komunist

Pas Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri janë bërë ndryshime të mbështetura kryesisht në natyrën e zhvillimeve politike dhe ideologjike të kohës. Sot nuk mund të përjashtohet ndonjë emërtim i ri i karakterit të trashëgimisë së antikitetit, si: *Drilon* (Voloçekë) burim në afërsi të Pogradecit; apo nga tradita historike, si: *Bajram Curri* (Kolgecaj), i cili në esencë është me paradigme politikë të brendshme dhe të jashtme (Bajram Curri ishte likuiduar nga qeveria e Ahmet Zogut, paraadhësit politikë të Enver Hoxhës, ndërsa me vendosjen e emrit të tij në kufi me Kosovën, politika e kohës donte të tregonte përkujdesje anësore të shtetit shqiptar ndaj shqiptarëve të mbetur jashtë kufijve të Shqipërisë), dhe të paradigmes ideologjike: *Qyteti Stalin*, *Fshati i Ri*, *Përparim*, *Fitore* etj.

Ndryshimet toponomastike në Shqipëri përgjithësisht kanë karakter të standardizuar, por nuk mund të thuhet se janë përcjellë nga një indiferentizëm nacional e gjuhësor, pavarësisht nga vija politike dhe ideologjike që i ka udhëhequr.

Në këtë rrjedhë mund të thuhet se janë ndryshuar toponimet, oronimet, hidronimet etj., pa përjashtuar krahina të veçanta dhe pa përjashtuar besime, shtresa sociale, kulturore e historike etj., duke ju përmbajtur disa paradigmeve që në vija të trasha do të mund të ndaheshin në: *Toponimet me përmbajtje fetare*; *Toponimet me përmbajtje zbuluese*; *Toponime me prejardhje feudale, pra të padëshireshme për sistemin politik të kohës*;

Toponime të ndryshuara me paradigme ideologjike të kohës; Toponime të standardizuara thjesht me qëllim lehtësues të përdorimit etj.

Sot në Shqipëri nuk ka ndonjë përpjekje zyrtare apo e nxitur nga institucione shkencore dhe joqeveritare, për të ndryshuar toponiminë e vendit, por kjo nuk do të thotë se shqetësimet mungojnë për gjendjen e përgjithshme të saj. Si duket shqetësimet e mëdha të dala nga ndryshimi i dhunshëm i antroponimisë shqiptare nga qeveria greke, si kusht për të marrë vizat greke, si dhe një lëvizje mjaft e çoroditur e emërtimit të posalindurve shqiptarë, problemin e standardizimit të emërvendeve të Shqipërisë postkomunsite e ka hedhur në plan të dytë. Pavarësisht nga kjo, në faqe shtypi dhe sidomos në faqe interneti diskutime të gjera janë bërë edhe për problemin e emërvendeve me prejardhje të huaj, dhe madje jo vetë të tyre, në Shqipëri.

Recensues
Profesor dr. Shefki Sejdiu
Profesor asc. dr. Zenun Gjocaj.

KUMTESA

Asllan HAMITI: DIGLOSA NË MAQEDONI DHE PROBLEMI I PËRDORIMIT ZYRTAR TË GJUHËS SHQIPE

¹Universiteti i Shkupit

Shqiptarët e Maqedonisë përgjithësisht njohin dhe përdorin *varietetin territorial* të shqipes (në familje, në komunikimin joformal ndërmjet tyre, në mjedisin shoqëror, në komunikim me telefon e internet), *shqipen standarde* (në shkollë, në komunikimin formal, në mjetet e informimit publik) si dhe *maqedonishten standarde* (në jetën publike, në veprimtarinë shoqërore) si gjuhë zyrtare në gjithë territorin e shtetit.

Për shkak të shumëgjuhësisë (multilinguizmit) shpeshherë ndodhin përzjerje kodesh, situatë në të cilën asnjë gjuhë e përdorur vetëm, nuk do të ishte e mjaftueshme.²¹⁹ Për të arritur efektin e duhur, folësit përziejnë dy gjuhët me njëra-tjetrën në një lloj kokteji gjuhësor – pak fjalë nga shqipja e pak fjalë nga maqedonishtja, pastaj kthehen tek e para me disa fjalë më shumë (me huazime), me shprehje nyjëtimore të shqipes kur flasin maqedonisht, sidomos në theksimin e fjalëve; me një morfologji e sintaksë të ndërmjetme (herë sipas natyrës së shqipes e herë sipas asaj të maqedonishtes).

Dukuria e përzjerjes së kodeve hetohet jo vetëm në bisedat e përditshme të masës së gjerë popullore, por edhe në gjuhën e të arsimuarve, si në ligjërimin e personave publikë, ashtu edhe në përkthimet dhe interpretimet e shumta që bëhen te ne nga maqedonishtja në shqip. Përkthimet lëngojnë sidomos në zëvendësimin e formave rasore të shqipes me forma analitike: parafjalë + emër, meqë maqedonishtja nuk ka lakim emrash.

Sidoqoftë dukuritë e tilla janë me interes e për gjuhët në kontakt dhe ndikimin ndërgjuhësor e përgjithësisht për sociolinguistikën. Por, në këtë kumtim vëmendjen tonë do ta përqendrojmë në problemet praktike që janë pasojë e përdorimit të maqedonishtes si gjuhë zyrtare në gjithë territorin e Maqedonisë, pra si “gjuhë e lartë” dhe të shqipes si “gjuhë e ulët”.

Si është rregulluar me dispozitat ligjore përdorimi i gjuhëve në Maqedoni?

E drejta e përdorimit të gjuhëve të bashkësive në Republikën e Maqedonisë rregullohet me Kushtetutë dhe me disa ligje. Pas një debati shumëvjeçar, në qershor të vitit 2008, Kuvendi solli një Ligj të përgjithshëm për përdorimin e gjuhës të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Maqedoni dhe në njësitë e pushtetit vendor. Në periudhën prej vitit 1992 deri në vitin 2006 janë sjellë 30 amendamente.²²⁰ Amendamenti më i rëndësishëm ku rregullohet përdorimi i gjuhëve është amendamenti V dedikuar përdorimit të gjuhëve, i cili thotë:

“Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saja ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

Gjuhë tjetër që flasin së paku 20% e qytetarëve, gjithashtu, është gjuhë zyrtare me alfabetin e saj. Edhe pse popullatë me mbi 20% në Maqedoni janë vetëm shqiptarët,

²¹⁹ R. A. Hudson, *Sociolinguistika*, Kumanovë, 2007, f. 52.

²²⁰ Amendamentet paraqesin formën përmes së cilës kryhen ndryshime të caktuara dhe plotësime të Kushtetutës. Numri më i madh i amendamenteve janë sjellë në vitin 2001 si rezultat i arritjes së Marrëveshjes kornizë dhe obligimeve që dolën prej saj.

hartuesit e ligjeve qëllimisht iu kanë shmangur emërtimit gjuhë shqipe, duke përdorur shprehjen perifrastike “gjuha që e flasin mbi 20% e qytetarëve”.

Tani, dokumentet personale të qytetarëve shqiptarë (letërnjoftimi, pasaporta) jepen në maqedonisht e anglisht, me kërkesën e palës edhe në shqip. Por, shqipja kufizohet në përdorim, përkatësisht maqedonishtja ka shtrirje të përgjithshme, ndërsa shqipja mund të përdoret vetëm në institucionet e pushtetit vendor ku ka mbi 20% shqiptarë. Kjo në zbatimin praktik do të thotë se në ato bashki ku shqiptarët nuk arrijnë 20% nuk e gëzojnë të drejtën që me organet bashkiake të komunikojnë në gjuhën shqipe. Fjala vjen, në qytetin e Shkupit, përveç maqedonishtes si e domosdoshme, vetëm në komunën e Çairit lejohet përdorimi publik i shqipes në institucionet e pushtetit vendor, në mbishkrime rrugësh, firmash etj. Nga ana tjetër, maqedonishtja mbrohet me ligj, me gjoba të parapara prej 2500 deri më 3 000 euro për thyerjen e normave të saja, ndërsa shqipja nuk mbrohet me ligj e as që ndëshkohet shkelja e normave.

Padrejtësi në zgjedhjet dhe në format e tjera të deklarimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve

Në ç’gjuhë shkruhet fletëvotimi? Fletëvotimi shkruhet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik. Në komunat ku së paku 20% e qytetarëve flasin shqip, fletëvotimet shtypen në maqedonisht e në shqip.

Me këto dispozita nuk u mundësohet shqiptarëve të deklarohen në gjuhën amtare në ata vendbanime ku përqindja e tyre në numrin e përgjithshëm të banorëve sipas përkatësisë etnike nuk arrijnë 20 për qindëshin. Për shembull, fletëvotimi për zgjedhjet parlamentare në komunën e Strugës, do të shkruhet maqedonisht e shqip, por në komunat fqinje të Ohrit dhe Vevçanit vetëm në gjuhën maqedonase edhe pse në këto vendbanime numri i shqiptarëve mund të arrijë në 19%.

Si është rregulluar përdorimi i gjuhëve në pushtetin vendor?²²¹

Rregulli kryesor – në komunat dhe qytetin e Shkupit, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

Gjuhë tjetër zyrtare – gjuhë zyrtare në komunat dhe qytetin e Shkupit, krahas gjuhës maqedonase me alfabetin e saj cirilik, është edhe gjuha dhe alfabeti të cilën e përdorin së paku 20% e banorëve të asaj komune.

²²¹ Vetadministrimi lokal është mënyrë e organizimit të pushtetit në nivel lokal. Në vetadministrimin lokal, pushtetin e realizojnë qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet të zgjedhurve të tyre. Me anë të së drejtës për vetadministrim lokal, qytetarëve u mundësohet pjesëmarrje në vendimmarrje për çështje në interes të tyre lokal. Në këtë mënyrë, te qytetarët krijohet ndjenjë e afërsisë me pushtetin.

Tek ne, vetadministrimi lokal është i organizuar me komuna të cilat paraqesin bashkësi të banorëve të një rajoni të caktuar territorial. Vetadministrimi lokal në Republikën e Maqedonisë është i organizuar në komuna dhe qytetin e Shkupit si njësi e posaçme e vetadministrimit lokal. Një ndër specifikat e vetadministrimit lokal është mekanizmi juridik për miratimin e dispozitave të cilat kanë të bëjnë me kulturën, përdorimin e gjuhëve dhe alfabeteve të cilat i flasin më pak se 20% e qytetarëve në atë komunë, dhe për përcaktimin e përdorimit të stemës dhe flamurit të komunës.

Përdorimi i gjuhëve të bashkësive të tjera – për përdorimin e gjuhëve dhe alfabeve në të cilat flasin më pak se 20% e banorëve të asaj komune, vendos Këshilli i komunës, respektivisht Këshilli i qytetit të Shkupit.

Edhe në pushtetin vendor lindin probleme të zbatimit praktik të gjuhëve: p.sh. Në cilat gjuhë duhet të shënohen tabelat rrugore në komunën e Gazi Babës në Shkup? Në cilat gjuhë duhet të shënohet tabela para Urës së Gurit në Shkup? Së pari duhet shkruar gjuha e bashkësisë gjuhësore shumicë në atë vend apo maqedonishtja?

Kufizimi territorial i përdorimit të shqipes lidhet drejtpërdrejt edhe me kufizimin e përdorimit të simboleve kombëtare jomaqedonase. Nëse një kolonë dasmorësh nisët nga skaji verior dhe duhet të arrijë në pjesën jugore të Shkupit me flamurin kombëtar shqiptar nga Haraçina (bashki me 99% shqiptarë) për krushqi në Saraj (bashki me mbi 20% shqiptarë) duhet të kalojë nëpër komunën e Gazi Babës, Qendrës e Karposhit (bashki me më pak se 20% shqiptarë) a duhet të valojë flamuri gjatë gjithë rrugëtimit vajtje – ardhje, apo kur krushqit në vendbanimet me më pak se 20% shqiptarë flamuri duhet futur brenda në makinë?

Ky përdorim i kufizuar territorial i shqipes: jo në gjithë Maqedoninë, por vetëm në bashki të caktuara të quajtura edhe si “komuna shqiptare” apo “maqedonase” ose “rome” (komuna e qytetit të Shkupit e quajtur Shuto Orizare) bën që të kemi zhvendosje popullore nga një vendbanim me përkatësi etnike heterogjene në vende me përkatësi homogjene. P.sh. Manastiri pothuajse mbeti pa shqiptarë, ndërsa zëri i shqiptarëve po shurdhohet edhe në Ohër. Shqiptarët e Shkupit parapëlqejnë të jetojnë në komunën shqiptare të Çairit, në Tetovë, Gostivar etj.

Këtë getuizim e segregacion etnik të dëmshëm e me pasoja të paparashikueshme, përveç faktorëve të tjerë, po e ndihmon lejimi apo ndalesa për përdorim të gjuhëve të bashkësive që kushtëzohet drejtpërdrejt me përqindjen etnike të popullsisë. Pikërisht nga mosbesimi i ndërsjellë dhe droja e përqindjes së popullatës sipas përkatësisë etnike, veçmas e raportit maqedonas - shqiptarë, nuk u përfundua dhe dështoi regjistrimi i sivjetmë i popullsisë, familjeve, banesave dhe pronave në Maqedoni.

Kufizime në përdorimin e shqipes në arsim

Arsimi fillor dhe i mesëm është bërë i domosdoshëm për të gjithë banorët e Maqedonisë. E drejta e shkollimit në gjuhën amtare për bashkësitë etnike joshumicë në komunat me mbi 20% jomaqedonas jetësohet më me pak vështirësi, por probleme ka në vendet ku numri i shqiptarëve është i vogël. Edhe sot e kësaj dite ka shqipfolës që në arsimin fillor e të mesëm detyrohen të mësojnë në maqedonisht. Rastin më të ri të këtillë e patëm në fshatin Jabollçishtë të Velesit. Një kohë të gjatë, para 2001 edhe dokumentet pedagogjike (ditari, librezat, dëftesat e nxënësve, përfshirë edhe plankonspektet) duhej të shkruheshin vetëm në maqedonisht, ndërsa tani në dy gjuhë: maqedonisht e shqip.

Në cilat universitete në Maqedoni mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe?

Në arsimin universitar mësimi zhvillohet në maqedonisht. Në institucionet private të arsimit sipëror mësimi mund të zhvillohet edhe në gjuhët e bashkësive që nuk janë shumicë në Maqedoni ose në gjuhët botërore. Shqip ligjërohet në Universitetin Shtetëror të

Tetovës dhe në Universitetin e Evropës Juglindore. Në Universitetin “Shën Cirili e Metodi” në Shkup mësimi mbahet në gjuhën maqedonase, përveç në Fakultetin e Mësuesisë dhe pjesërisht në Katedrën e Gjuhës e të Letërsisë Shqiptare.

Problemet:

Kolegët tanë të dy universiteteve të Tetovës administratën e kanë në shqip, ndërsa ne të Shkupit vetëm në maqedonisht. Po e tregojmë një shembull tipik me të cilin përballemi shumë shpesh. Sipas rregullores së Universitetit të Shkupit, përfshirë edhe rregulloren e Fakultetit të Filologjisë, pjesë e së cilës është Katedra e Shqipes, punimet e magjistraturës, masterit e doktoratit shkruhen e mbrohen në maqedonisht ose në njërën nga gjuhët botërore (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, rusisht), por kursesi shqip. Pra, kandidati detyrimisht punimin duhet ta dorëzojë në maqedonisht, referati të shkruhet në maqedonisht. Edhe në rastet kur tema lidhet ngushtë me gjuhën, letërsinë apo kulturën shqiptare, komisioni recensuese dhe të gjithë të pranishmit në sallë janë shqiptarë, ne detyrohemi procedurën e mbrojtjes dhe bisedën me kandidatin ta zhvillojmë në maqedonisht.

Propozim për ngritjen e statusit të shqipes si gjuhë zyrtare në gjithë Maqedoninë:

Në këtë paraqitje përmendëm disa nga kufizimet juridike të përdorimit të shqipes në Maqedoni, përkatësisht lejimin për përdorim vetëm në institucionet e pushtetit vendor ku ka mbi 20% shqiptarë dhe mospërdorimit të saj në shumë institucione shtetërore, me disa shembuj konkretë për problemet e zbatimit praktik të saj, duke nxjerrë si përfundim nevojën për ngritjen e statusit të shqipes si gjuhë zyrtare në gjithë territorin e Maqedonisë, krahas maqedonishtes, në tërë shtetin.

Gjuha luan rol të dyfishtë. Nga njëra anë homogjenizon, respektivisht shërben si kanal për komunikim ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve. Nga ana tjetër, diversifikon, respektivisht ndan qytetarë sipas vijës etnike, kulturore dhe politike.

Dihet se nëse një gjuhë nuk praktikohet, ajo gradualisht do të tkurret, të ndikohet saqë ekziston rreziku i zhdukjes së saj. Përdorimi i gjuhës, në veçanti përdorimi i drejtë si gjuhë zyrtare, nuk paraqet vetëm të drejtë, por edhe obligim për të gjitha subjektet.

Modele të përdorimit zyrtar të dy e më tepër gjuhëve gjejmë në disa shtete shumetnike e shumëgjuhësore.

Pra, në Kushtetutën e Maqedonisë mund të përcaktohet shkurt e qartë se: gjuhë zyrtare në Maqedoni janë maqedonishtja dhe shqipja. Në Kosovë,²²² bie fjala, ku vetëm 4% janë serbë, gjuhë zyrtare në tërë shtetin janë shqipja dhe serbishtja. Ndërsa afër 1/3 e popullatës në Maqedoni flasin shqip, pra afro 30% janë shqiptarë.²²³

Avancimi i statusit të shqipes në përdorim zyrtar nga një gjuhë e dytë vetëm në institucionet e pushtetit vendor ku ka mbi 20% shqiptarë në gjuhë zyrtare shtetërore nuk do të shkojë në dëm të askujt, por është në të mirën e të gjithë qytetarëve të këtij vendi.

²²² Sipas të dhënave statistikore të fundit, në Kosovë 92% janë shqiptarë, 4% serbë, 2% boshnjakë dhe goranë, 1% turq dhe 1% romë.

²²³ Sipas regjistrimit të vitit 2002, në Maqedoni 66% janë maqedonas, 22.7% shqiptarë, 4% turq, 2.2% romë, 2.1% serbë dhe 2.4% të tjerë.

Recenzentë :
Dr. Haki Ymeri
Dr.Zeqirja Neziri

KUMTESA

Mr. Marjela PROGNI – PEÇI¹: KRIJIMTARIA POPULLORE NË LETËRSINË SHQIPE (PROZA E MITRUSH KUTELIT)

**¹Universiteti i Prishtinës
Fakulteti i Filologjisë**

Mitrush Kuteli është një nga autorët më të dalluar i cili spikat në letërsinë shqiptare. Ai në shkrimet e tij paraqet jetën e shqiptarit të shenjëzuar në mjedisin e tij autokton e jashtë trojeve të tij, duke vënë në shënjestër kodet, traditën, jetën sociale e ekonomike, brengat e hallet, botën shpirtërore e fizike, pa harruar ndjenjat, kontradiktat mes këtyre të fundit, zgjedhjet e zgjidhjet e mundshme e të pamundshme. Përmes shfrytëzimit të letërsisë dhe mundësive që jep ajo ky shkrimtar ka arritur të dalë shpesh herë nga perspektivat e rrëfimit të tij duke u kthyer në retrospektivë e duke trajtuar shumë çështje të tjera, të cilat paraqesin njeriun përtej realitetit të kohës kur zhvillohen ngjarjet e rrëfimit bazë, madje duke shkuar deri në kohën e Skënderbeut, duke paraqitur në këtë mënyrë me anë të prozave të tij shtresime të tjera kuptimore mbi tekstin fillestar. Kuteli me shkrimet e tij dëshmoi se kishte dashuri të madhe jo vetëm për artin e shkruar letrar, por edhe për krijimtarinë popullore shqiptare, të cilës i kushtoi vëmendje të veçantë duke u përpjekur që ta mblidhte e ta botonte. Madje ai shkoi edhe një hap më tutje, duke përzgjedhur një pjesë të kësaj krijimtarie, për ta përdorur më vonë si bazë për disa nga tregimet e tij më të bukura, të cilat u botuan nën përmbledhjen e titulluar “Tregime të moçme shqiptare”.

Që në titull shenjëzohet dhe përcaktohet statusi i këtyre prozave. Pra titulli përveçse si paratekst funksionon edhe si metatekst. Tregohet që tekstet e paraqitura janë të moçme sa i përket ekzistencës së tyre në kohë, pra që janë të huazuara dhe të risjella nga autori dhe si të tilla, megjithatë, duke pasur parasysh se në krijimtarinë popullore kanë ekzistuar si këngë e si rrjedhojë në vargje, tashmë ato sillen para lexuesit në një formë të re, atë të prozës. Në këtë vepër janë përfshirë “përpunimet në prozë të tridhjetë e pesë balladave dhe rapsodive shqipe tue fillue prej balladës së murimit, asaj të Konstantinit të vogël, Halil Gajrisë e deri te kangët legjendare mbi Gjergj Elez Alinë, Mujën e Halilin, Skënderbeun etj. Dhe “çdonjëra nga këto është një perlë më vete marrë nga qerthujt e folklorit tonë të Veriut dhe të arbëreshëve”. Përpunimet janë ba me një kujdes e mjeshtëri të duhun. Ka në këtë vëllim tregime që të emocionojnë, që të rrëmbejnë me fuqinë e fjalës, që të lënë një përshtypje të thellë për forcën e tregimit e për mjetet artistike, që në shumë raste janë krijime të vetë autorit”.²²⁴

Duke pasur parasysh veprimtarinë e gjerë letraro-artistike të Kutelit, vetë autori është marrë me ndarjen dhe kategorizimit e prozave të tij, duke i quajtur rrëfime tekstet që i marrin temat e tyre nga realiteti jetësor dhe duke i cilësuar si rrëfenja tekstet që kanë në bazë të tyre krijimtarinë popullore gojore.

Shpeshherë është vënë në diskutim autorësia e këtyre teksteve, për shkak se në bazë të krijimit të tyre kanë qëndruar tekste me autorë anonimë të krijimtarisë popullore. Por, në fund të fundit, a ekziston ndonjë tekst i pastër origjinal? Sipas Bahtinit “ligjërimi ndesh ligjërimin e tjetrit nëpër të gjitha rrugët që çojnë drejt objektit dhe s’kanë si të mos hyjnë në bashkëveprim të gjallë dhe të shpeshtë. Nga kjo ai përjashton vetëm mitikun e vetmitarin Adam, i cili duke iu qasur një bote të virgjër dhe ende të pashprehur, mund ta shmangte me

²²⁴ Mitrush Kuteli, *Ago Jakupi e rrëfime të tjera*, EBSHRSS, Prishtinë 1968, f. 9.

të vërtetë riorganizimin e tillë të ndërsjellë”.²²⁵ Në këtë mënyrë shtrohet teoria i intertekstit prej Bahtinit. Interteksti si term është përdorur për herë të parë nga Julia Kristeva. Interteksti ose ndërtekstshmëria ka të bëjë me praninë e një ose më shumë teksteve në një tekst tjetër. Kjo prani mund të nënkuptohet si rimarrje e një teksti dhe vendosja e tij në një tekst të ri, rimarrja e ideve, temave, motiveve, stilit, por të tilla konsiderohen edhe përmendjet, aluzionet, ndikimet, përputhshmëritë, huazimet, imitimi etj., pra intertekstuale quhet çdo lidhje midis dy teksteve, e cila në një mënyrë apo në një tjetër përçon referenca të çfarëdollojshme nga një apo më shumë tekste tek tjetri. Lidhjet referenciale të tekstit të parë me të dytin e kështu më radhë, kur ato janë të qëllimshme, përdoren për të arritur një synim të caktuar të autorit, i cili i rifunksionalizon këto gjetje në tekstin e ri, por në shumë raste ndodh që intertekstualiteti të aplikohet në mënyrë të pavetëdijshme nga autori dhe kjo të zbulohet nga lexuesi apo kritiku/analisti i veprës “Duke pohuar se interteksti është para së gjithash një pasojë leximi, duket sikur i lëmë dorë të lirë lexuesit: jo vetëm që i takon atij të pikasë dhe të njohë intertekstin, por dhe aftësia dhe kujtesa e tij bëhen kritere të vetme të cilat lejojnë për të pohuar praninë e tij. Pra është intertekstuale çdo gjurmë që unë e shquaj si të tillë, qoftë kjo një citim i hapur apo një vegim i turbullt”.²²⁶ Në fund të fundit siç kanë rënë dakord shumica e teoricienëve, nuk ka tekst pa intertekst.

Në rastin e Kutelit shihet se interteksti në prozat e tij është i vetëdijshëm. Tekstet e këngëve popullore zgjidhen që të jenë hipotekste të teksteve të reja të shkruara nga autori. Por hipertekstet megjithëse ruajnë shumë veçori e karakteristika të teksteve mbi të cilat janë ndërtuar, të hipoteksteve, nuk ndjekin domosdoshmërisht në mënyrë besnike çdo të dhënë që ato paraqesin. Autori ndjek parimin e tij krijues, zhvillon procesin e tij të shkrimit, duke i dhënë liri vetes që bashkë me ritregimin të krijojë. Këtë e shpreh në mënyra të ndryshme, duke filluar që me paraqitjen në prozë të kësaj krijimtarije, zgjedhjen dhe funksionalizimin e gjuhës, ligjërimit e mjeteve artistiko-letrare që i kanë hije këtyre prozave, duke pasur parasysh statusin e tyre në versionin fillestar, e duke vazhduar me përzgjedhjen e teksteve që do ritregohen dhe natyrisht, me përzgjedhjen e motiveve që do të trajtohen apo që nuk do të trajtohen brenda këtyre teksteve, duke shtuar e hequr, e në këtë mënyrë duke fasaduar tregimet në bazë të kërkesave e qëllimeve që i ka vënë vetvetes.

Mitrush Kuteli, në veprën “Tregime të moçme shqiptare” trajton, me mjeshtëri, tema që kanë të bëjnë përgjithësisht me realitetin e botës shqiptare e në veçanti asaj të malësisë. Vetë vendosja në hapësirë e këtyre rrëfimeve të intrigon në vetvete, sepse me anë të kësaj përzgjedhjeje ai i shenjëzon këto hapësira dhe si të tilla ato izoloohen nga pjesa tjetër sa i përket mënyrës së jetesës, botës së tyre shpirtërore, asaj psikologjike, traditave e zakoneve, etj. Veprat përmbajnë në vete dy skajshmëri - mitin dhe realitetin, të cilat jo vetëm që nuk e përjashtojnë njëra - tjetrën, por bashkekzistojnë si të ishin një. Në shumë faqe të këtij libri është gdhendur një copë nga realiteti i shqiptar, ashtu siç është trajtuar në shumë të tjera bota e tij kulturore e shpirtërore.

Vlen të shihet me interes për shembull mënyra se si autori e paraqet botën subjektive të personazheve. Në shumë rrëfime pjesë e personazheve bëhen orët dhe zanat. “Zana, figurë qendrore e besimeve popullore, zë një vend të veçantë në eposin legjendar mesjetar të Shqiptarëve, madje merrte pjesë gjallërisht në veprimet e heronjve të këtij eposi. Vend qendror zë edhe në disa balada mesjetare, në legjenda mitike: atë e ndeshim dendur në gjini

²²⁵ Kujtim Shala, *Kujtesa e tekstit*, Buzuku, Prishtinë 2003, f. 15.

²²⁶ Nathalie Piegay-Gros, *Poetika e intertekstualitetit*, Parnas, Prishtinë 2011, f. 27.

të ndryshme të krijimeve folklorike. Kjo figurë na ka ardhur e plotë, natyrisht dhe e sinkretizuar me qenie të tjera mitike, me dukuri të ndryshme të besimeve, në kulte të vendeve të shenjta, përmes ritesh të veçanta”.²²⁷ Zanat pavarësisht rolit të tyre në mitologjinë shqiptare, në këto tregime marrin të tjera dimensione, të cilat dalin përtej mitologjisë. Prandaj, nëse orët apo zanat bëhen pjesë e tregimeve, ato nuk përdoren vetëm me funksionin e një elementi fantazie, por si një manifestim i realitetit të njerëzve, të cilët besojnë dhe kanë pasur eksperiencë “të vërteta” me këto qenie, këto karaktere nuk përdoren si spekulim, por bëhet përpjekje që të na shfaqet një botë e parë me sy të tjerë. Duke të lënë përshtypjen se bota në të cilën ekzistojnë ato personazhe ekziston me të vërtetë dhe një këndvështrim i tillë është i saktë. Duke pasur për bazë të prozave të tij trashëgiminë popullore të përcjellë brez pas brezi, Kuteli nuk huazon thjeshtë një pjesë të krijimtarisë orale me tiparet që ajo përcjell, por besimet e besëtytnitë dhe një botë të tërë të pasur subjektive që zë një vend të palëkundshëm në ndërdijen e shqiptarit malësor edhe sot. Edhe pse të moçme, temat dhe idetë që përcjellin tregimet e tij paralelizohen vetvetiu me shumë aspekte të botës së brendshme sa të ngurtë aq edhe të trazuar të malësorit. Duke njohur thellë shpirtin e malësorit dhe mënyrën e kodet e tij të jetës, arrihet të pozicionohet në mënyrë mjaft të natyrsme e në të njëjtën kohë edhe të harmonishme, roli që luajnë këto elemente fantastike në jetën e maleve. Por për këtë nuk shfrytëzohet vetëm mentaliteti malësor, por edhe hapësira e përshtatshme gjeografike, natyra e egër, terreni i thyer e gati mistik i maleve hijerënda, i lumenjve, përrenjve e luadheve që shtrihen nëpër shkrepë. Këto bëhen një me karakterin malësor, karakter ky që kërkon po ashtu një qenie, e cila i dikton fatin e trazon shpirtin. Shpirti i malësorit, ky i fundit i rritur mes bukurive të paana natyrore, por të egra e të rrezikshme, vetvetiu i personifikon këto bukuri në shtatin e bardhë, të hijshëm, rrethuar me aureolë drite të artë, të orëve e zanave, që me kënaqësi lahen natën në ujërat e akullta të puseve, e mrizojnë ëndshëm ditën nën hijet e pemëve shekullore, por që nga ana tjetër shitojnë me një shikim, profetizojnë kobshëm e që ndjekin me dashuri e xhelozë të pamatë shënjestrat e tyre. Kjo mënyrë e realizimit të tekstit është serioze, sepse përpriqet ta shfaqë realitetin e një ose disa pikëvështrimeve që tashmë ekzistojnë. Këto tregime kanë një lloj realizmi, por të ndryshëm nga realiteti që shumica e kulturës sonë përjeton tani. Ato nuk janë spekulative dhe nuk na çojnë përmes eksperimentesh. E thonë historinë e vet nga perspektiva e njerëzve që kanë jetuar dhe jetojnë në botën tonë dhe përjetojnë një realitet tjetër nga ai që ne e quajmë objektiv. Këto tregime mund të duken fantastike dhe magjike për një pjesë të lexuesit, por për një pjesë tjetër mund të përcjellin realitet të qartë e të pakundërshtueshëm. Kjo ndodh sepse perceptioni i një personi apo një grupi të veçantë mbi realitetin mund të ndryshojë prej atij të një personi apo grupi tjetër. P. sh një tekst i dhënë mund të ketë mjaft lidhje me realitetin e një vendi dhe njerëzve që jetojnë në atë vend prej të cilit janë vjelë materialet që përbëjnë tekstin, prandaj receptimi i këtij teksti nga lexuesi që e njeh këtë realitet nuk do të jetë i njëjtë me receptimin që i bëhet të njëjtë tekst, nga një lexues që nuk njeh asnjë nga elementet kulturore dhe shpirtërore të atij vendi dhe popullit të cilit i është referuar libri, prandaj mund t’i duket imagjinar dhe i pavërtetë. Pra receptimi i tekstit si realitet diktohet nga njohuritë e thella që ka lexuesi, në rastin tonë, për botën e brendshme shpirtërore të malësorit, për misteret dhe besëtytnitë e kësaj bote dhe për besimin gati infantil në këto qenie, i cili paradoksalizohet me karakterin e fortë e të patrembur, të ndërtuar shtigjeve e thepave për shekuj e shekuj me radhë. Në tekstet e mësipërme, shpesh,

²²⁷ Mark Tirta, *Mitologjia ndër shqiptarë*, Akademia e shkencave të Shqipërisë, Tiranë 2004. f. 112-113.

kombinohen faktorët e jashtëm të ekzistencës njerëzore me ata të brendshmit, është një shkrimje mes realitetit shkencor fizik dhe realitetit njerëzor psikologjik. Përfshihen aspekte të ekzistencës njerëzore siç janë p.sh. mendimet, emocionet dhe imagjinata. Përmes këtyre përdorimeve, autori mund të jetë më i përpiktë për të dhënë secilën shkallë të realitetit njerëzor. Ndoshta mund të jetë e vështirë të dallohen këto tekste nga realizmi fikcional konvencional, sepse siç shihet intrigat, personazhet dhe tregimtari i fikSIONIT konvencional nuk janë me të vërtetë reale. Megjithatë, këto tregime tentojnë ta trajtojnë realitetin si krejtësisht fluid dhe kanë personazhe që e pranojnë këtë si normale.

Këto tekste janë të karakterizuara nga dy konflikte, por të para nga perspektiva koherente autonome: e para është e bazuar nën një shikim racional të realitetit, tjetra është e bazuar nën pranimin e të jashtëzakonshmes si pjesë e botës së përditshmërisë. Prandaj koncepti thelbësor i tyre në letërsi është këmbëngulja në bashkekzistencën midis fantastikes dhe reales. Por natyrisht që natyra reale e tekstit, përkundër përdorimit të fantastikes, duhet të shihet si imitim. Tregimet e lartpërmendura janë tekste autoriale dhe origjinale. Ato janë krijuar nga pena e autorit, ashtu siç janë zgjedhur nga autori temat, motivet, personazhet e situatat.

Kuteli i risjell në mënyrën e tij krejt origjinale një sërë tekstesh e këngësh popullore që kanë qarkulluar në trevat shqiptare, por nga ana tjetër paraqitet edhe trajtimi sa më i saktë i mendësisë që ekziston akoma në disa zona, përveç realitetit, pasqyrohet nga mendësia dhe bota fantastike e malësorëve edhe irealiteti që jeton brenda ndërgjegjes së këtyre njerëzve, sepse mendësia e kësaj bote, në fund të fundit, nuk konsiston vetëm në realitetin e saj, por po aq ngushtë ajo është e lidhur edhe me irealitetin e saj. Kjo duket paradoksale, por irealiteti që konsiston në ato treva është një gjë aq reale, sa mund të ngatërrohet lehtë me atë që nënkuptohet me fjalën realitet. Ajo çfarë përcjellin këto tekste është se realiteti nuk ezaurohet me dukuritë e jashtme, por ai ekziston në ndërgjegjen e njerëzve dhe në transmetimin e këtij realiteti nga ata vetë.

Në tregimet e Kutelit nuk jepet koha kur ndodhin ngjarjet. Kjo e çliron lexuesin nga konvencat e përcaktimit kohor, duke i dhënë atij mundësi që këto ngjarje t'i përshtatë në secilën kohë që parapëlqen, sipas parafytyrimit që ai krijon. Të lexuara nga perspektiva e sotme, përsëri shumica e lexuesve, që njohin traditat, kulturën dhe botën shpirtërore shqiptare, do të arrinin të kuptonin natyrën e teksteve. Kjo ndodh sepse akoma në zonat e thella të malësisë vazhdon të ekzistojë e njëjta filozofi jete, i njëjti mentalitet, të njëjtat këndvështrime, veçse tani disa pjesë të tyre janë bartur copa - copa edhe në terrene të tjera së bashku me familjet malësore që janë bartur nëpër fshatrat fushore e në qytete. P. sh. shumë amvisa nuk i shkundin natën mbulesat e tavolinave, për shkak se thërrimet e bukës mund t'u bien mbi kokë orëve, të cilat si pasojë mund të lëshojnë ndonjë mallkim. Ka njerëz që edhe sot e kësaj dite nuk i thërrasin në emër orët e zanat, por kur bie fjala për to i emërojnë me epitelin të *mirat*, nga frika e respekti supersticioz që ushqejmë për to etj. Por edhe kur mbeturinat e fundit të këtij realiteti subjektiv të zduken nën presionin e civilizimit, e në fund të ngelin veç tekstet që i kujtojnë, përsëri këto të fundit nuk do të transmetojnë vetëm një letërsi të bukur narrative, por do të përfaqësojnë flakën që është djegur në shpirtin e shqiptarit, realitetin që veç ai ka mundur ta shohë e ta prekë.

Recensentë:

Prof.Dr. Nuhi Rexhepi, profesor në Universitetin e Prishtinës – Fakulteti i Filologjisë.

Prof.Dr. Sali Bashota, profesor në Universitetin e Prishtinës – Fakulteti i Filologjisë.

KUMTESA

**Ma. Rozeta BICI¹: METAPHORIZATION OF THE TERMS DENOTING HUMAN
BODY PARTS IN ENGLISH LANGUAGE**

¹ALEKSANDER XHUVANI UNIVERSITY
HUMAN SCIENCE FACULTY
ENGLISH –GERMAN LANGUAGES DEPARTMENT
ELBASAN, ALBANIA

At present, metaphor has been considered as a figure of speech and it has always been treated as such in the field of literature. But not always it is an analysis object in the field of literature, but as well in the field of linguistics. As a result, the article will treat linguistic metaphor, as well as, it will investigate one of the sciences that analyzes it better, semantics and its kinds. Later on the article will shed light on the ways of English lexicon enrichment through the horizontal and vertical enrichment, where polisemy appears as one of the best sources of it. The other section of the article will treat metaphor expressed by human body parts names. As well, it is emphasized the application of human body parts metaphorization in a class and the effects it has in the process of teaching.

First, it is of academic interest the paper starts with the definition of the term metaphor in the contexts it is encountered. Thus, metaphor is defined as “a figure of speech in which a noun or a descriptive word is transferred in another object or action different or analogues to it, that is applied in literary meaning; a unit of which, a metaphorical expression”²²⁸. Apart from this, metaphor and metaphorization are applied in linguistic context, being labeled as linguistic metaphor. Thus, studied by historical linguistics, it is defined as “a semantic change, based on similarity, e.g. Similarity in the form or function between the original concept that manes a word and the concept addressed named by this word.”²²⁹


Since from the definition done to metaphor, it is noticed that the science which plays an important role in the understanding of linguistic metaphor is semantics. As a result, semantics and its kinds give its nuances of understanding to metaphor. Therefore, Structural Semantics, Generative Semantics, and Cognitive Semantics are the sciences which will be

²²⁸ <http://www.oed.com/view/Entry/117328?redirectedFrom=metaphor#eid>

²²⁹ <http://en.wikipedia.org/wiki/Metaphor>

treated below as it follows, giving a short summary about the object of each of these sciences and an analysis of the linguistic metaphor.

Semantics is the science of meaning. It is “a wide substance within the general study of language. Semantics understanding is basic for the study and learning of language (how the users of language learn a sense of meaning, as a speaker, listener or reader) and the transformation of language (the way meaning changes with the time). It is very important that language is understood in the social contexts, considering that they influence meaning, and the understanding of the variants of English and the effects of style. Therefore, it is one of the most fundamental concepts in linguistics.”²³⁰ It is noticed from the definition the importance of semantics role in the division of the variants of English despite it is about social, temporal, personal or regional variations. The below picture shows the division of variants of English on basis of use model.



Temporal Variation has to do with the changes time has made to language, sorting out the different processes. They are classified into short-term and long-term ones. Whereas Regional Variations has to do with the changes language encounters from the use of people based on the region where they live (Intranational Regional Variations). Social Variations are related to the use language has in the society, depending on the profession, stratification, culture, age, ethnicity, education etc. Personal Variation includes the selection of different

²³⁰ <http://www.teachit.co.uk/armoore/lang/semantics.htm>

words and structures from different individuals. This is in dependence to being unique, related to the transformation of individuals in their memory, personality, intelligence, social background, personal experience.²³¹

All these aforementioned are object of study in semantics and the different types of semantics like structural semantics; generative and cognitive semantics play a considerable role in the understanding of metaphorization. Structural semantics is “the study of the connections between terms’ meanings in a sentence, and how meaning can be created by different elements.”²³² The same thing happens even with the naming terms of human body parts. Thus, for example the word *head* depending on the situations can be used in different contexts:

“ *Head*

1. The upper part of the human body that stands on the neck or the front part of animals’ body, round, long where the brain, mouth, eyes, ears, nose, hair are located.
2. The front part of animals’ body part cooked as a dish.
3. A unit to count cattle, people etc.
4. fig. This part of human body used as the center of thinking, brain and its abilities to judge; mind and reason; person as a bearer of ideas and different points of view.
5. The person’s life (as a valuable thing)
6. Fig. Leader of a country, organization, or in a workplace; with high mental abilities.
7. The part used to plant potatoes or garlic.
8. The upper or front part of a thing of apparatus that is usually the main part and that is round.
9. The first part, the beginning of a row of things, the first row, the beginning of a group that moves; the beginning of a river
10. fig. the main part that makes the essential of something; chapter etc.”²³³

Generative and cognitive semantics are opposition to each other being elaborated by different groups of linguists. Generative semantics is related to the “deep structures that are identified by semantic representation”²³⁴ whereas Cognitive semantics “is part of the cognitive linguistic movement, and its main tenets are: grammar is a conceptualization, conceptual structure is included and motivated by the use, the ability of language use based on the general cognitive sources and not on a special language module.”²³⁵ Based on the definitions and evaluations of the last two types of semantics which play an important role in the understanding of metaphor, metaphorization of human body parts naming passes in relation to the grammatical structures as well as in relation to the abilities to use language and its cognitive sources.

²³¹ David Crystal (2002). ‘The Cambridge Encyclopedia of the English Language’. Cambridge University Press

²³² http://infotoute.com/info/Structural_semantics

²³³ <http://www.fjalori.shkenca.org/>

²³⁴ <http://www2.let.uu.nl/uil-ots/lexicon/zoek.pl?lemma=Semantic+representation&lemmacode=217>

²³⁵ http://en.wikipedia.org/wiki/Cognitive_semantics

Metaphorization of human body parts names leads to the enrichment of the lexicon with different terms and words which are used in different contexts enrich the lexicon and knowing of the meanings of different words. The two types of lexicon enrichment in English language are: Horizontal Enrichment differently called lexicon enrichment and is realized through word formation and Vertical Enrichment related to polisemy.

Thus, horizontal enrichment, or lexical one, which is related to the word formation is the most noticed form of semantic structures. According to David Crystal, when we speak about word formation or semantic structures, then we refer to the relation of the meanings' nets which link the lexemes together. As a result, when we speak about semantic structures and lexical enrichment then we should bear in mind all the possible meaning links of a word. There are included here even the terms that name the human body parts. The below example of the word *eye* I will illustrate the aforementioned theory bringing at the limelight that only one word can generate many other words in relation to the meaning or word formation:

“**Eye:** each of a pair of globular organs of sight in the head of humans and

vertebrate animals:

Eyebrow: the line of hairs above each of the two human eyes

Eyelid: one of the pieces of covering skin which can move down and close each of the eyes

Eyeball: the whole of the eye including the part inside the head which forms

a

more or less round ball.”²³⁶

Whereas when we refer to polisemy as another way of lexicon enrichment, then we should bear in mind which effects or features of the word we are concentrating on. Thus, polisemy is “the phenomenon when a single word has two or more meanings, despite the way it is defined meaning in a certain context.”²³⁷ Multi-meaning words lead as well to the enrichment of the lexicon on basis of contexts. Consequently, if we refer to an illustrative example with terms naming human body parts in English language, we would notice as it follows with the word *blood*.

“**Blood – 1.** The red liquid that circulates in the arteries and veins of humans and other vertebrate animals, carrying oxygen to and carbon dioxide from the tissues of the body: *drops of blood* an internal bodily fluid in invertebrates which performs a

²³⁶ David Crystal (2002). ‘The Cambridge Encyclopedia of the English Language’. Cambridge University Press, 2001

²³⁷ Gergely Peth, Department of German Linguistics, University of Debrecen, Hungary “What is Polysemy?– A Survey of Current Research and Results”

similar function to blood in humans and other vertebrates. (bloods) blood samples or tests: *his bloods were normal a nurse was out on the corridor taking bloods from the patients*

2. Violence involving bloodshed: *a commando operation full of blood and danger*
3. Fiery or passionate temperament: *a ritual that fires up his blood*
4. [with modifier] family background; descent or lineage: *she must have Irish blood in her [count noun] a person of specified descent: a mixed blood [count noun] US informal a fellow black person: any blood who opted out was ostracized*
5. [count noun] dated a fashionable and dashing young man: *a group of young bloods*²³⁸

Polisemy is realized in different ways and means. The ways of polisemy realization are: meaning broadening, meaning narrowing and meaning carrying. Whereas, the means of polisemy realization are the different figures of speech, such as: metaphor, metonymy, synecdoche, hyperbole, litotes, analogy etc. English language is very rich of multi-meaning words, as a result, the realization of lexicon enrichment through polisemy focusing on meaning broadening, meaning narrowing or meaning carrying. Whereas the implementation of the word or the human body part naming term in the role of a figure of speech give the other nuance to the term. An illustrative example can be noticed with the word **finger**.

“Finger: each of the four slender jointed parts attached to either hand (or five, if the thumb is included)

be all fingers and thumbs: *British informal* be clumsy or awkward in one's actions. **get (or pull) one's finger out:** *British informal* cease prevaricating and start to act.

get one's fingers burned/burnt (or burn one's fingers): (especially in a financial context) suffer unpleasant consequences as a result of one's actions, discouraging one from trying a similar action again.

give someone the finger: *North American informal* make a gesture with the middle finger raised as an obscene sign of contempt.

have a finger in every pie: be involved in a large and varied number of activities or enterprises.

have a finger in the pie: be involved in a matter, especially in an annoyingly interfering way.

have (or keep) one's finger on the pulse: be aware of all the latest news or developments: *he keeps his finger on the pulse of world music*

lay a finger on someone: touch someone, especially with the intention of harming them.

put the finger on: *informal* inform against (someone) to the authorities.

put something on the long finger: *Irish* postpone consideration of something; put something off: *don't put retirement planning on the long finger*

put one's finger on something: identify something exactly: *he cannot put his finger on what has gone wrong*

snap (or click) one's fingers: make a sharp clicking sound by bending the last joint of the middle finger against the thumb and suddenly releasing it, typically in order to attract attention in a peremptory way or to accompany the beat of music.²³⁹

²³⁸ <http://oxforddictionaries.com/definition/blood?q=blood>

But what is the implementation of metaphor composed by the human body parts' naming in an English class? Metaphors bring a memorable organizational and convenient model of the vocabulary to be learned. The aims of the implementation of metaphorization of human body parts naming are: the enlargement of the students' vocabulary, the improvement of chunks of words knowledge, English language use in a creative way and develops students' autonomy.²⁴⁰

Human body parts metaphorization is related to the body as a source domain from which there derive metaphors related to machines and computers where expressions like *computer brain* can be encountered, communities, communication and nations. For example the *hand* can be used in a metonymic way related to all the physical actions of the body, *heart* related to feelings, *head* related to thinking and *eyes* related to watching. As well, *hand* can be unrelated even simply to the action of American presidents in front of their people to show consideration towards them.²⁴¹ The latest is related to the body parts naming metaphorization, bringing to the limelight even the social factor that influences the understanding of these naming.

The next group has to do with the metaphors that have the body as an object, to which they refer and are grouped metaphors that refer to illnesses for example: *foot soldiers* is the name of an illness or infection of feet that at the beginning was faced at the soldiers and metaphors referring to the process and structure of the brain.²⁴²

Simultaneously, thinking that the pupils have encountered the term *metaphor* only in the literature context, it remains an important point teaching them linguistic metaphor composed by human body part names. But which are some of the methods and approaches of them? Different methodologist have highlighted that a good way is making students work independently, asking them to research about linguistic metaphor composed of the human body parts names or draw a poster related to them. The first step is that students draw a scheme of the human body where they put different organs and the second step is that they consult the dictionary of English language and search for metaphors composed of human body parts names and write them in posters and put them next to the organs. Whereas, another method is to ask students to brainstorm as many words related to the lexical field of human body parts. After this, the teacher understands how much the students know the first meaning of the words and then asks them to include these words in metaphorical structures. Furthermore, the students can be asked to write a story implementing language in a creative way.²⁴³ Some of the activities used can be: quizzes, flashcards, listening, linking human body parts with their definitions and the meanings of the metaphors, games, and another activity named Speller, Learn, Test, where students are controlled about the understanding of human body parts names.²⁴⁴

²³⁹ <http://oxforddictionaries.com/definition/finger?q=finger>

²⁴⁰ <http://www.teachingenglish.org.uk/articles/exploring-metaphors-classroom#0>

²⁴¹ Juliana Goschler, *Embodiment and Body Metaphors*, 2005

²⁴² *Ibidem*.

²⁴³ <http://www.teachingenglish.org.uk/articles/exploring-metaphors-classroom#0>

²⁴⁴ <http://quizlet.com/1884743/metaphors-body-parts-ii-flash-cards/>

To conclude, it needs to be stressed that metaphor is not only a figure of speech but as well a means of linguistics and the students should be aware of this. Apart from this, metaphorization as a phenomenon can be composed of different terms including those naming human body parts. Context as well as the variants of English are the main factors which influence the use of English language, and for more, the well-knowing of the first meaning and literary meaning is of interest because this plays an important role in the widening of the lexicon of foreign languages. Teaching field is included in this study as one of the fields that can be influenced by terminology, thus methods and approaches are recommended to be used to make students use language in a creative way after their understanding. The study can be a help for teachers and students of this field to further on continue that even in comparison to another foreign language.

Recenzentë :
Prof. dr. Gjovalin Shkurtaj
Dr. Meli Shopi

KUMTESA

Prof.ass.dr. SHKËLQIM MILLAKU¹: PËRFSHIRJA DHE ZHVILLIMI HISTORIK I KONCEPTVE GJENERATIVE NË GJUHËSINË (SHQIPTARE)

¹Universiteti i Prizrenit, Fakulteti i Edukimit, Prizren

Përfshirja e koncepteve (gramatikore) gjeneruese në studimet e gjuhësisë shqiptare “mund të” mundësojnë njohjen dhe zhvillimin e thellë dhe të saktë të fenomeneve gjuhësore si nga parimet fonetike, morfologjike dhe strukturës sintaksore.

Andaj, gramatika (gjuhësia) gjenerative si drejtim bashkëkohorë ka lindur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në mesin e viteve '50 të shekullit XX. Themeluesi i rrymës në fjalë është gjuhëtari amerikan Zellig Harris, i cili gjuhësinë (gramatikën) e kishte menduar se mund të studiohet në aspektin matematikor, logjik, gjenerues etj. Ky studiuës hapi një rrugë të re në studimin e morfologjisë gjenerative. Mirëpo, studiuësi në fjalë, me ligjëratat e tij frytdhënëse, për studentët ishin motivuese, sepse paraqitja e drejtimit në fjalë ishte i ri, me interes, por edhe i pastudiuar. Studimet gjenerative i vazhduan shumë studiuës të zellshëm (...), mirëpo studenti i Zellig-it, ide-marrëse dhe ide-dhënësi Noam Chomsky në vitin 1957, botoi librin “**Syntactic Structure**”, i cili libër, bëri hapin e parë objektiv në fushën e gjuhësisë gjenerative. Kjo rrymë (gjenerativizmi) është një qasje tjetër nga ajo deskriptive (*Librin në fjalë e kam përkthyer në gjuhën shqipe, për të cilën do të flas përgjithësisht për përbërjen, rolin dhe rëndësinë e saj*).

Noam Chomsky në vitin 1957, botoi librin “**Syntactic Structure**”, i cili libër, bëri hapin e parë objektiv në fushën e gjuhësisë gjenerative. Kjo rrymë (gjenerativizmi) është një qasje tjetër nga ajo deskriptive. Figurat apo studiuësit kryesor të deskriptivizmin ishin: **Saussuri** dhe **Trubeckoi**, të cilët kanë lënë gjurmët e tyre në fushën e gjuhësisë përshkruese, por edhe për metodologjinë e gjuhësisë. Mirëpo, ata kishin si objekt përshkrimin e gjuhësisë në aspektin e sinkronisë “normative dhe jonormativ”. Koncepti i shumë përfolur i Bloomfieldit, është sfiduar nga i pari i gjuhësisë gjenerative, me vetëdije të përgjithshme gjuhësore, më një ndërtim dhe një koncept filozofik, logjik apo psikologjik, gjenerativ, transformativ etj. Një libër (Syntactic Structure) thelbësor për gjuhësinë gjenerative dhe transformuese. Nga ky tekst studimor mund të themi se kemi prerje të reja, të drejtimeve apo gërshetimeve të tyre gjuhësore nga rryma e strukturalizmit në atë të gjenerativizmit. Drejtimi i strukturalizmit i erdhi fundi me idetë e studentëve, të studiuësve dhe profesorëve të fushës strukturale. Një nga studiuësit e ri ide-marrësi dhe ide-dhënësi është Noam Chomsky, një studiuës zinxhiror dhe i zellshëm, i cili botoi librin e parë në vitin 1957 me titull **Syntactic Structures**. Ky botim i dha një risi drejtimit (gjenerativ) me inertes të veçantë dhe si model për gjuhësinë gjenerative në përgjithësi, por në veçanti për gjuhësinë gjenerative anglo-amerikane. Gjuhësia gjenerative dhe transformative me themelvënësin e saj N. Chomsky-in, e përfshinë kuptimin në analiza dhe studime gjuhësore, në aspektin normative, matematikor, logjik, filozofik, gjenerues dhe transformues, që janë studiuar kryesisht në fushën e “gramatikës” sintaksës dhe morfologjisë. Libri “Syntactic Structures” i Noam Chomsky-it, është dritarja e

parë objektive e këtij drejtimi të ri. Në parathënien e librit autori, citon: “Gjatë gjithë periudhës se këtij hulumtimi kam pasur fatin shumë të mirë që shpesh kam diskutuar gjatë me Zellig Harris, mirëpo sugjerimet e shumta dhe idetë e tij janë përfshirë në tekstin e mëposhtëm dhe në hulumtimin mbi të cilat jam bazuar unë. Andaj, nuk do të bëjë përpjekje për t’i treguar ato si referenca të posaçme”. Nga ky citat mund të nënkuptohet se autori është vazhdues i drejtimin paraprak dhe ideator i gjenerativizmit. Autori i ka studiuar dhe përshkruar studimet e studiuesve Zellig Harris, Çarlz Hoketi, Bernard Bloku etj., duke i filluar se studiuar nga fonema, morfema, fjala dhe deri në fjali.

Libri “Strukturat sintaksore” është e përbërë prej disa kapitujve (pavarësia gramatikore, teoria e gjuhësisë, struktura e sintagmës, transformimet në anglisht, sintaksa dhe semantika, përmbledhja, shtojca etj.), të cilat argumentojnë për një teori të re të fushës se gjuhësisë gjenerative dhe transformuese.

Kapitulli i parë fillon me një hyrje të shkurtër që përmbledhë studimin ideor të hulumtuar nga fusha e fonetikës, morfologjisë dhe sintaksës (gramatikës) në përgjithësi, me një drejtim të ri dhe metodë të re studimore.

Në kapitullin e dytë, autori ofron një studim për një gramatikë të pavarur, i cili për gjitha gjuhët ekzistuese mund të konsiderohet si boshti kryesor i studimit të teorisë se gjenerativizmit. Në këtë kapitull paraqiten disa fjali që nuk janë normative, por për folësin e anglishtes mund të kuptohen si modele apo forma. Në këtë kapitull “The independence of grammar – Pavarësia gramatikore” paraqitën tri vlerësime për shprehje të lira dhe të logjikshme gramatikore, kuptimore të strukturës morfo-sintaksore. Nga këto vlerësime të dhënë përmes disa shembujve, saktësohen se mund apo jo të jenë të kuptueshme nga kushtet e paraqitura gramatikore.

Një kapitull pasues është “An elementary linguistic theory – Teoria elementare (fillestare) e gjuhësisë” e cila paraqet disa shembuj përmes simboleve alfabetike dhe disa diagrame. Nga ky kapitull kemi dritaren e parë të gjuhësisë gjenerative.

Nga tri modelet e studiuar dhe paraqitura nga kreu i dytë janë udhërrëfyes për t’i shprehur fenomenet gjuhësore përmes simboleve dhe diagrameve.

Kapitulli në vazhdim është një dritare e re e studiuar, sepse teoria e gjenerativizmit paraqitet në konceptin e krijimit të një modelit të ri, përmes diagrameve, simboleve etj. Në këtë kapitull fillon studimi filozofik, logjik (psikologjik) dhe gjenerues. Kapitulli në fjalë ofron zhvillimin dhe mbrojtjen e gjuhës përmes alfabetit dhe simboleve. Vazhdimi i studimit paraqet strukturën e sintagmave, të cilat si për sintagmën emërore, foljore, mbiemërore etj., mund të konsiderohet si boshti i studimit, sepse përmes analizave, studimeve gjeneruese të fjalive të thjeshta, dëshmohet për risimtarinë e gjuhësisë dhe pikërisht për gjuhën angleze, mirëpo ekziston edhe një model për gjitha gjuhët e botës.

Kapitulli i katër dhe i pestë janë objekti gjenerues i librit në fjalë. Nga gjithë studimi që është bërë, dihet fakti se, gjithë shembujt janë të gjeneruar dhe studiuar në gjuhën angleze, por edhe nga simbolet e gjuhës në fjalë.

Gramatika gjenerative – transformuese mbështetet mbi transformimet (rregullat T) për të krijuar pjesën më të madhe të fjalive të pranueshme gramatike në të gjitha gjuhët.

Në kapitullin e pestë kemi dy lloj rregullash të tilla: transformimet e detyruara (affix hopping), përmes se cilës gjenerohet forma e rregullt e fjalive dhe transformimet me zgjedhje (opcionale), të cilat kryejnë funksion për kthimin e fjalive pohore në mohore dhe pyetëse.



Gjuhësia gjenerative, objektivisht themelet i ka nga ky libër, mirëpo nuk kanë munguar idetë dhe studimet të studiuesve të ndryshëm si Z. Harris “**From phonem to morpheme**” (Nga fonema deri të morfema, 1955); N. Chomsky “**Sistems of syntactic analysis**” (Analiza e sistemit sintaksor, 1953); C. F. Hockett “**A formal statement of morphemic analysis**” (1947) dhe studime të tjera që i paraprinë studimit (**Struktura sintaksore 1957** të N. Chomsky-it. Për me gjerësisht për korpusin dhe rëndësinë e gjuhësisë gjenerative flitet në kapitullin e gjashtë. Një studim i veçantë është bërë në kapitullin e shtatë, i cili deri në atë kohë nuk ishte studiuar.

Kapitulli “Some transformations in English – Disa transformime të anglishtes”, i cili kapitull hap edhe një dritare apo studim të ri me interes të veçantë për gjuhësinë gjenerative - transformuese. Libri “Strukturat Sintaksore” ka një model të veçantë të studimit. Studimi është bërë në fushën semantike, morfo-sintaksore dhe deri në një studim të thellë të logjikshëm gjenerative dhe transformuese. Këndvështrimi gjenerativ në këtë libër që është udhërrëfyes për gjuhësinë gjenerative anglo-amerikane dhe model për çdo gjuhë tjetër që ka standardin, e cila mund të studiohet dhe të analizohet nga aspekti gjenerative dhe transformues.

Libri vazhdon me kapituj tjerë që përshkruan rregullat gjyhësore, kuptimore dhe të pavarura. Studimet e analizuar nga morfema deri të fjalitë e përbëra është boshti i kapitullit “Sintaksa dhe semantika”. Nga gjithë ky kontribut i dhënë për gjuhësinë anglo-amerikane, të fushës gjenerative dhe transformuese meritë të veçantë i takon frymëzuesve të gërshetimeve ideore të strukturalizmit.

Nga këto themele, metoda, rregulla si gjenerative ashtu edhe transformuese janë ndërtuar dhe studiuar shumë tekste nga studiuesit e ndryshëm, nga gjuhët e ndryshme. Gjuhësia gjenerative lehtëson kuptueshmërinë nga morfema dhe deri të fjali e përbërë. Nga kjo rrugë studimore mund të fitohet renditje e drejtë nga semantika deri të funksioni i drejtë fjalëve dhe fjalive në koncept sintaksor.

Në vazhdim të studimit do t’i paraqesim fillimisht disa kompozita, të cilat mund të analizohen përmes simboleve dhe koncepteve gjenerative. Kështu, për kompozitat **emërore**, **mbiemërore**, **foljore** dhe **ndajfoljore** do t’i gjenerojmë nga dy apo më shumë shembuj, të cilët deri me tani nuk janë studiuar sa kanë merituar. Mirëpo, për t’i paraqitur nga ky këndvështrim do t’i analizojmë emrat e përbërë **kryeqytet** dhe **bregdet**, të cilët mund të gjenerohen në këtë përbërje:



Si në figurën e parë dhe të dytën kemi kompozitën e ndërtuar emër + emër, të cilat kanë dhënë emër. Mirëpo, në figurën e dytë, ndërtimi i kompozitës është **emër + emër = emër** i përbërë (**breg + det**), ku pjesa e parë ka këtë kuptim: “që është pjesë rrip toke që kufizon në anë një rrjedhë uji, një det, një liqen etj. Anë toke që ndodhet buzë një sipërfaqeje uji²⁴⁵”, pastaj + **emri** det-i që në fjalorin shpjegues ka këtë shpjegim “hapësirë shumë e madhe më ujë të kripur që zakonisht është e rrethuar me tokë jo nga të gjitha anët dhe që qëndron disi e veçuar, pjesa më e madhe e rruzullit tokësor, e mbuluar me ujë të kripur”²⁴⁶.

Bashkimi e këtyre dy emrave ka dhënë respektivisht një emër më kuptim të ri **bregdet-as**, „rrip toke anës detit breg deti, krahina që shtrihet gjatë bregut të detit”. Formula e ndërtimit të kësaj kompozitë është **em + em = em.p**.

Një tip tjetër kompozitë + ndajshitesë kemi ndeshur gjatë studimit si: **bashkohës, zëvendës, kryengritje (ngre kryet)**, shembulli i fundit në fjalë gjenerohet si:




Fig.3

Në figurën 3 kemi kompozitë + ndajshitesë për të cilën dihet fakti se janë formuar emra të ndryshëm nga një përbërje t tillë si në figurën numër tre (një apo dy), apo si nga shembujt **zëvendës, kryengritje** e ndonjë tjetër. Gjenerimi i kompozitës zëvendës, e cila **rrjedhë** prej **zë-** si **folje** (emër) + **-vend** si emër + prapashtesa **-ës**, të cilat kanë dhënë një fjalë të re me kuptim të ri, në këtë rast kompozitë të përbërë.

Andaj, edhe kompozita emërore kryengritje është formuar nga një **emër + folje + prapashtesën -je, (kryengritje)**, vendin kryesor e zënë ndërtimi frazeologjik foljor **folje + emër** me parashtesën **-je**, por në këtë rast e kemi gjeneruar si model i mundshëm gjenerues. Në të vërtetë, këtu kemi të bëjmë me një shprehje frazeologjike, tema e së cilës përbëhet nga dy fjalë më kuptim të plotë dhe një prapashtesë, të cilat respektivisht formojnë një fjalë të re dhe të përbërë (**krye + ngrit -je = kryengritje**).

Një model i tillë mund të paraqitet edhe për fjalët e përbëra foljore, ndajfoljore, mbiemërore etj. Mirëpo, përveç paraqitjes së fjalëve në koncept gjenerativ ky model studimi është i mundur edhe për fjalitë e thjeshta dhe të përbëra. Në konceptin historik studimi morfologjik i paraqitur nga Z. Harris, i cili kishte menduar në vitet '50 se kjo fushë gjuhësore mund të studiohet edhe në këtë këndvështrim gjenerativ, mirëpo Chomsky vazhdoi sugjerimet e mësuesit të tij, por ai në një parim më të gjerë në atë fonemë – sintaksë. Andaj, gjuhësia gjenerative shqiptare mund të studiohet dhe analizohet, studiohet në këndvështrimin gjenerativ. Në vazhdim do t'i analizojmë edhe ndonjë fjalë të përbërë mbiemërore si **emër + emër = mbiemër**. Këtu mund të krijojmë mundësin për ta dalluar funksionin e kontrastit, i cili përmes analizave gjenerative ofron koncepte të reja. Andaj, fjalët e përbëra janë të ndërtuara nga dy apo më shumë fjalë kuptimplote dhe si kategori të tyre gramatikore mund të kenë pjesët e ndryshuara dhe të pandryshuara të ligjëratave. Në këtë rast paraqesim kategorinë mbiemërore si **krye + peshk = kryepeshk; krye + tul = kryetul (mb.); krye + tullë = kryetullë (mb.); krye + zi = kryezi (mb.); lule – lule = mb.** e ndonjë tjetër.

²⁴⁵ Fjalori elektornik shpjegues **FESH 1.0**.

²⁴⁶ Po aty, në **F.E.SH**.

Në fjalët e përbëra emërore ka shumë grupe të pasura, mirëpo këtu po i theksojmë disa prej tyre nga emrat e njerëzve, **të veglave të punës, profesionit** etj., ku gjymtyra e dytë është temë e një emri vepruesi, si **bregdet** (breg det) em; **bregdetas (breg detas)** em.; **kryeministri (krye ministër)** em.; **vendbanim (vend banim); vendburim; pikëpamje (pikë pamje)** etj.

Emrat me kuptim të ndryshëm që janë formuar me ndihmën e zanores lidhëse **a**, si **zanafillë, dashamirë, bjerrafat** e ndonjë tjetër, të cilit, janë një grup i vogël krijimesh të vjetra popullore, mirëpo, me anë të kësaj lidhëse nuk janë shumë prodhimtare.

Një nëntip tjetër **emër + mbiemër** që ka dhënë emër si **bisht + i gjatë = bishtgjatë, bisht + i madh = bishtmadh; bisht + i kuq = bishtkuq; kokë + e madhe = kokëmadhe; kokë + vogël = kokëvogël, krye + i lartë = kryelarti** etj.

Nëntip tjetër që është prodhimtar, nga **emër + emër = emër** si **krye + vendi = kryevendi; krye + oxhaku** e ndonjë tjetër.

Në këtë studim paraqitem dy mundësi:

a. Historikun e gjenerativizmit, i cili ka lindur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo rrymë bëri hapin e parë të kalimit nga strukturalizmi në gjenerativizëm. Andaj, autorët e cituar me lartë janë plotësisht themelues të gjuhësisë gjenerative. Por, a janë idedhënës dhe themelues edhe të gjenerativizmit shqiptar? Kjo pyetje le të mbetet e hapur për dashamirësit e gjuhësisë shqiptare se janë apo nuk janë themelues.

b. Në vazhdim kemi paraqitur disa fjalë të përbëra, të cilat mund i kemi gjeneruar në diagramit. Ky lloj studimi mund të bëhet edhe për fjalë përgjithësi, fjali (të thjeshta apo të përbëra).

Nëse, ky koncept studimi do të respektohet në tekste të ndryshme shkollore, atëherë studentëve dhe nxënësve do t'u lehtësohet rruga për ta mësuar e njëzuar si duhet.

Recenzentë:
Prof.dr. Asllan Hamiti
Prof. dr. Ismat Osmani

KUMTESA

Dr. Tonin ÇOBANI: NJË FILL I ESESË SOCIOLOGJIKE SHQIPTARE

Duke studiuar eseistikën shqiptare në rrafshin diakronik, më ka tërhequr vëmendjen një karakteristikë thelbësore dhe permanente e saj: eseja shqiptare qysh në nisje ka trajtuar problemet sociologjike. Kështu, qysh nga eseja e parë, “Shqypnia dhe shqyptarët” (Pashko Vasa, 1879) e deri te eseja më e debatuar e kohëve të fundit, “Identiteti evropian i shqiptarëve” (Ismail Kadare, 2006), pavarësisht se i referohen në mënyrë të dukshme fakteve historike, në esencë trajtojnë gjerësisht bashkëjetesën sociale të një komuniteti ballkanik të përvijuar qysh nga kohët e hershme.

Në mënyrë të veçantë, sociologjia shqiptare ka kthyer në argumente faktike realitetin gjuhësor e etnokulturor shqiptar më tepër se atë historik. Madje, ajo ka ndriçuar në këtë mënyrë edhe ato pika të errëta historike apo ato konkluzione të shtrembëruara prej historianëve për shkak të mangësive dokumentare të historisë. Ndoshta për këtë arsye sociologjia shqiptare gjeti vetën e vet në formën e esesë dhe u zhvillua së bashku me të. Edhe Branko Merxhani, që mbahet prej studiuesve të sotëm si themelues i sociologjisë shqiptare, nuk la ndonjë tekst (libër) sociologjie, por vetëm disa shkrime publicistike ose eseistike, në mes të të cilëve edhe një cikël esesh sociologjike, “Neoshqiptarizma”, të cilat u botuan në gazeta e revista të ndryshme të viteve ‘20-’30...

1. Hyrje

Në literaturën evropiane eseja vjen si gjini letrare e ndërmjetme në gjuhën e gjallë popullore: përkundrejt latinishtes, si gjuhë diturore e kohës, Montenji esetë e veta i realizoi në frëngjisht dhe Bekoni në anglisht, sado që të gjithë veprën tjetër, të dy këta themelues të eseistikes, e kanë në latinisht. Prandaj edhe ne **eseistikë shqiptare do të konsiderojmë vetëm tekstet në gjuhën shqipe.**

Gjithashtu, nisur nga kuptimësia e fjalës ese (që në gjuhën shqipe do të thotë sprovë, tentativë, eksperiment), **eseistikë shqiptare kemi konsideruar ato tekste në gjuhën shqipe që kanë tentuar të promovojnë problematikë shqiptare,** e cila lidhet domosdoshmërisht me rrethanat social-kulturore të kohës kur ato ese u shkruan dhe u publikuan. Në këtë rast kemi vërejtur se argumentet e këtyre teksteve kanë qenë etnokulturorë dhe social-historikë, ndërsa reaksioni ndaj tyre ka pretenduar të jetë historiko-shkencor, por që në shumë raste ka përfunduar në pseudohistori e aspak shkencë.

Sa për ilustrim: në një paragraf të eseve të Montenjit përmendet Skënderbeu ynë kur ia fali ndëshkimin një ushtari të vet, pikërisht pse ai u tregua i guximshëm edhe përballë eprorit të vet.²⁴⁷ Asnjë historian shqiptar apo i huaj nuk ka kërkuar të verifikojë historikisht këtë rast, sepse Montenji nuk ka dëshmuar historinë e Skënderbeut në esetë e veta, por thjesht ka shpalosur vlerësimin e kurajës individuale nga një figurë e mirënjohur

²⁴⁷ Ymer Jaka, “Skënderbeu në letërsinë frënge”, Prishtinë, 1990, f.42.

historike, si ishte Skënderbeu. Ndërsa tek eseja e Pashko Vasës “Shqypnia e shqyphtarët”, ku pohohet se populli shqiptar e njeh veten me emrin *shqiptar* qyshkur Pirua i Epirit u quajt shqiponjë e luftëtarët e tij - krahët e shqiponjës, ka ndodhur ndryshe. Të gjithë studiuesit e institucioneve tona shkencore kanë preferuar ta paraqesin atë dëshmi si jo shkencore, duke e konsideruar veprën fundamentale të Rilindjes sonë Kombëtare (pra, esenë “Shqypnia e shqyphtarët”) jo si ese, por thjeshtë si një studim historiko-romantik të tejkaluar në kohë. Sipas tyre, shkenca historike ka bërë përpara me teza e fakte, që argumentuekan edhe sot e kësaj dite se Epiri është “djepi i helenizmit”, madje jo vetëm Epiri i vjetër, por edhe Epiri i Ri, që vinte deri mbi Shkumbin, duke i lënë shqyphtarët, kështu, endacakë pa truall, si shkruante aso kohe Jani Vreto: “*pa histori, pa letërsi, pa asnjë përparim dhe pa vetëqenie kombëtare*”²⁴⁸. I solla këta dy shembuj për të kthyer vëmendjen seriozisht te eseja sociale me problematikë shqiptare, sepse deri vonë në studimet tona të Pasluftës së Dytë Botërore nuk ka qenë pranuar as eseja si gjini specifike letrare, as sociologjia si shkencë e mirëfilltë. Në raste të tilla pasojat na çojnë aty ku nuk do të donim të ishim.

2. Diakronia

Tani më lejoni të paraqes këndvështrimin tim mbi eseistikën shqipatre, nisur nga sa parashtrova më lart:

Eseja e parë, “**Shqypnia dhe shqyphtarët**” e Pashko Vasës, botuar në Alfabetaren e Stambollit (Konstantinopojë, 1879), ka gjithsej 36 faqe.²⁴⁹ Pashko Vasa është më i pari që kuptoi se jo vetëm opinioni evropian duhet kthjelluar për çështjen shqiptare, por edhe vetë shqyphtarët kanë nevojë të mësojnë për veten e tyre: nga vijnë, prej cilave fise rrjedhin, prej cilës etni? E konsiderojmë ese sociologjike, sepse në variantin frëngjisht, shkruar prej vetë Pashko Vasës dhe botuar po në të njëjtin vit si libër më vete me rreth 114 faqe²⁵⁰, cilësohet, *studim historik e kritikë*, ndërsa disa studiues e kanë klasifikuar si artikull historiko-publicistik (Vehbi Bala) dhe histori e letrarizuar (Sabri Hamiti).

Njëzet vjet më vonë **Sami Frashëri** boton esenë e tij të famshme: “**Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet**” (Bukuresht, 1899) me një dimension të ri: ardhmërinë ose parashtrimin e organizimit të shtetit të ardhshëm të shqyptarëve, duke parashikuar sistemin e qeverisjes, kryeqytetin, universitetin etj. Edhe klasifikimi i këtij libri, si ese e gjatë sociologjike, është përcaktuar nga të njëjtat kritere që kemi ndjekur për esenë e Pashko Vasës. Edhe studiues të tjerë i kanë përvijuar këto dy vepra, por ne, duke i klasifikuar si ese, duam të argumentojmë edhe një pikëvështrim tjetër, objektin

²⁴⁸ Për më tepër shih: Jani Vreto, “Apologjia kundër artikullit “Epiri, djepi i helenizmit, Shqipëria!!!”, Stamboll, 1878. (Cituar nga Jani Vreto, “Apologjia”, përkthye prej greqishtes nga Niko Çani, f.181, në Jani Vreto, “Vepra të zgjedhura”, Tiranë, 1973, f.175-229).

²⁴⁹ Ismail Kadareja ka deklaruar në një intervistë: “Në letërsinë shqipe, trajtat e para të saj (të esesë) janë shfaqur në shkrimtarët e mesjetës së vonshme, **Frang Bardhi** e **Pjetër Bogdani**. Më pas ishin **Konica** me **Nolin**, e pas tyre shkrimtarët e viteve ‘30, si **Kuteli**, **Çabej**, **Krist Maloki** e të tjerë, që e lëvruan gjininë.” <http://gazeta-shqip.com/ndryshe/71b135689323a42e0255ae5319fdb4d4.html> (21 nëntor 2011).

²⁵⁰ Nga frëngjishtja që përkthyer e botuar: anglisht, gjermanisht, turqisht e greqisht, dhe më vonë edhe në arabisht e italisht.

sociologjik: shqiptarizmën²⁵¹, që do të mbizotërojë eseistikën shqiptare si tipar esencial deri në ditë e sotme.

Dhjetë-njëmbëdhjetë vjet më vonë, **Gjergj Fishta** boton në Shkodër broshurën “**Shqiptarët dhe të drejtat e tyre**” (1921), ku shtron problemin e kufijve kulturor të shqiptarëve: “Prandaj, - shkruan Fishta, - s'ka si mohohet se të gjithë ata që flasin shqip janë të kombësisë shqiptare; dhe se për këtë arsye shteti shqiptar do të shtrihet gjeografikisht deri ku përfshin gjuha shqipe”. Në artikullin e tij, “Gjergj Fishta sociolog?”, Lekë Sokoli shkruan “se Fishta ka arsye të cilësohet edhe si një ndër pararendësit e sociologjisë shqiptare, në mos sociolog”.²⁵²

Në vitet '20-'30 një sociolog i mirëfilltë si **Branko Merxhani** pretendon të krijojë atë mendësi të munguar shqiptare, të cilën ai e quan **Neoshqiptarizëm** (shqiptarizma – tradicionalja - që do rinovuar: neo, e reja) duke botuar një sërë esesh në shtypin e kohës, fillimisht në gazetën “Demokratia” të Gjirokastrës e më pas në revistat prestigjioze, “Përpjekja Shqiptare” dhe “Neoshqiptarizma”, themeluar prej tij. Ai promovon esenë sociale dhe filozofike, duke cituar autorë evropianë, të traditës dhe bashkëkohorë, në kontekstin e nevojave imediate për emancipimin e mendimit intelektual shqiptar. Prof. Hamid Beqja shkruan:

Në frymën e kësaj neoshqiptarizme dhe të kërkesave të saj (Branko Merxhani) merret me analizën e lëmijëve të ndryshme të jetës shoqërore, para së gjithash social-ekonomike. Polemizon me tezat marksiste, të materializmit historik. Kritikon përparësinë që ato i japin faktorit ekonomik. E argumenton pikëpamjen e vet historikisht e aktualisht (në shembullin e Rasisë bolshevike). Bolshevizmin e quan të papërshtatshëm për Shqipërinë. Këtej edhe shkrimi i tij sugjestiv “Pse nuk jam marksist?”. Padyshim shkak për ftohjen e marrëdhënieve të tija me qarqet “e majta” të kohës²⁵³.

Po në këto vite, me një ton ironik **Faik Konica** boton esenë e tij të famshme “**Shqipëria si m'u duk**” (1929). Konica përvijon vërejtjet realiste të Pashko Vasës, duke kapërcyer “patriotizmin romantik” të Sami Frashrit dhe, deri diku, duke iu shmangur këndvështrimit kritik të Gjergj Fishtës ndaj Evropës: apelon për një shtet të vërtetë shqiptar, sipas modelit evropianoperëndimor, ndryshe edhe prej “neoshqiptarizmës” së Merxhanit.²⁵⁴

²⁵¹ Madje në Stamboll është formuar “Shoqëria e të shtypurit me shkronja shqip”, e cila ka dalë me abetaren e vet, me një program kulturor dhe me të përkohshmet “Drita” e “Dituria”.

²⁵² Lekë Sokoli: “Fishta ka trajtuar një problematikë e cila është, gjithsesi, në fokus të sociologjisë bashkëkohore: të sociologjisë religjioze, të kulturës, artit e komunikimit, të moralit e të edukimit, të sociologjisë së familjes (kompleksi i marrëdhënieve familjare, martesë, familja, divorci etj.). Pra mund të pohojmë se ai ka vendosur një gur themeli në godinën sociologjike shqiptare.” (www.dardania.de/vb/upload/shoëthread.php?t=17710 (29 tetor 2011).

²⁵³ Branko Merxhani, Tirana Observer. 30 maj, 2007, f. 11

²⁵⁴ Kujtojmë këtu se Faik Konica e boton esenë e parë në turqisht “Shqipëria dhe turqit”(1895) dhe më 1896-7 nxjerr gazetën “Albania” ku boton thujtë në çdo numër esetë e veta kryesisht në gjuhën shqipe dhe krijimtarinë e vet letrare po në shqip.

Eqrem Çabej është një autor tjetër serioz, që në fund të viteve '30, pra dhjetë vjet më pas se Konica, boton esenë e tij të famshme **“Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes”**²⁵⁵ (1938-39). Më vonë ky autor do të argumentojë me studimet e veta gjuhësore vazhdimësinë iliro-shqiptare, duke provuar shkencërisht atë tezë që në eseistikën shqiptare esencialisht ishte shtruar për zgjidhje qysh nga Pashko Vasa.

Në vazhden e kësaj fryme duhet parë edhe **Fan Noli** me **“Gjergj Kastrioti Skënderbeu, kryezot i Arbërisë (1405-1468)”**, botuar në Boston 1950. E konsiderojmë ese këtë veper për dy arsye. E para, sepse Noli nuk përktheu në gjuhën shqipe (dhe për shqiptarët) tekstin e vet të doktoraturës (botuar në anglisht, 1947), por përvijoi, si shprehet në parathënie, tekstin e **“Historisë së Skënderbeut”** botuar po prej tij më 1921²⁵⁶, që tashmë është klasifikuar si histori e letrarizuar ose sprovë letrare, pra ese; dhe, e dyta, sepse kjo veper udhëhoqi mendimin intelektual shqiptar për më tepër se një gjysmë shekulli, duke e kthyer Skënderbeun në një figurë kombëtare institucionale dhe pikë reference për shtetin ideologjik shqiptar të Pasluftës së Dytë Botërore. Noli e kishte parashikuar këtë qëllim, d.m.th., që e kaluara e lavdishme t'i shërbejë kohëve moderne²⁵⁷, por jo deri në ekstrem, si u përdor gjatë periudhë së monizmit, për të justifikuar diktaturën ideologjike. Ndoshta, nga ky keqpërdorim, ka edhe sot e kësaj dite diskurse pa fund, disa prej të cilëve duke përgojuar mbarë e prapësht Skënderbeun dhe epokën e tij.

Një veper tjetër, që, duke u trajtuar si ese e gjatë, fiton shumë më tepër se në të gjitha përqsjet e mundshme, është **“Vepra e Bogdanit”** (Prishtinë, 1982 dhe Tiranë, 1991) e **Ibrahim Rugovës** (1955-2005), e cila u parapri dhe u shoqërua nga cikli i eseve për Bogdanin: **“Një kryeveper e letërsisë shqiptare ose Çeta e profetëve – e Pjetër Bogadnit”**²⁵⁸ **“Qiriri i ndezur para tre shekujsh”**²⁵⁹ dhe **“Historia shqiptare në veprën e Pjetër Bogdanit”**²⁶⁰

²⁵⁵ Në fakt me këtë titull ka dalë si libër më vete në vitin 1994, ndërsa, kur u botua së pari në revistën **“Hylli i Dritës”** në Shkodër, **“Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindje”** është nëntitull i studimit **“Për gjenezën e literaturës shqipe”**.

²⁵⁶Varianti i parë **“Historia e Skënderbeut (Gjergj Kastriotit), Mbretit të Shqipërisë, 1412-1468”**, Boston, 1921; i dyti **“Historia e Skënderbeut, Kryezotit të Arbërisë (1405-1468)”**, Boston, Massachusetts, 1950) dhe, i tretë, një studim shkencor në anglisht: **“George Castrioti Scanderbeg (1405-1468)”** by Bishop Fan Stylian Noli, PhD, International Universities Press, New York, 1947), që është teza e tij e doktoraturës.

²⁵⁷ Shih kushtimin e veprës ... kryetrimave që çlirovan atdheun. Fan.S.Noli, *Vepra* 4, f.485.

²⁵⁸ Fjala, Prishtinë, 1981, nr.3, f.1,7,8.

²⁵⁹ Zëri i rinisë, Prishtinë, 21 dhjetor 1985, nr 1135, fq.22-23.

²⁶⁰ Jeta e Re, Prishtinë, 1989, nr.9, fq.1249. (**“diçka si ese,- e quan Rugova këtë shkrim,- sepse i falet pak a shumë mendimit të ngjyrosur me ndjenjë”**) (Ibrahim Rugova, **“Kode të shkrimit letrar”**, mblodhi Munish Hyseni, Shtëpia Botuese **“Faik Konica, Prishtinë, 2009, f.32).**

të Ibrahim Rugovës. “Vepra e Bogdanit” (1982) dhe cikli i eseve, krahas kompetencës shkencore që ngërthejnë në vetvete, kanë edhe një frymë të përgjithshme, e cila të fokuson te dimensionin kulturor i shqiptarizmit. Por jo vetëm kaq. Shembulli i orientimit perëndimor i Rugovës merr nismë nga një tekst thellësisht religjioz i një prelati të lartë të Kishës Katolike Shqiptare me veprimtari të shquar patriotike në Shkodër, Tivar, Shkup, Prishtinë e Prizren, dhe ndriçohet me atë tolerancë që na rikthen maksimumin e Pashko Vasës “Feja e shqiptarit është shqiptaria”. Sa për ta theksuar një reagim tjetër në lidhje me kohën kur u publikua: vepra e Rugovës u ribotua në Tiranë vetëm në fillim të viteve ’90, ndërsa edhe sot e kësaj dite provokon kundërshti të heshtura. Ajo shpesh herë anashkalohet si referencë apo edhe gjykohet me paramendim për vlerat e saj në raport me kohën kur u shkrua dhe sot.

Ismail Kadareja është një tjetër personalitet i letrave shqipe që trajtoi gjerësisht dhe me sukses esenë, sado që shumë vonë ai i cilësoi ato ese. Përmbledhjen e parë me ese “Linja të largëta”(1970) e quajti shënime udhëtime, pastaj “Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe”, që u botua një herë si parathënie

e më pas si libër më vete, e quajti, trajtesë etj. e deri te esetë më të fundit që i quajti sprovë (“**Identitet evropian i shqiptarëve**” (2006, 62 f.) dhe sprovë letrare “**Mosmarrëveshje mbi raportet e Shqipërisë me vetveten**” (2010). Janë pikërisht këta dy të fundit, që morëm për të përvijuar atë devizë të eseistikes shqiptare që lidhet me Shqipërinë e shqiptarët. Dhe është esea e Kadaresë për identitetin evropian të shqiptarëve, e cila, pikërisht për këtë arsye ngjalli një polemikë të gjatë në median dhe botimet e kohës në Shqipëri, Kosovë dhe diasporë, që na dëshmon se këndvështrimi sociologjik i “Shqiptarizmit” është edhe sot e kësaj dite objekti më relevant i eseistikës shqiptare.

3. Përfundime

I rreshtova esetë e mësipërme, sepse qysh në titull kanë diçka të përbashkët që përvijohet nga Pashko Vasa deri te Ismail Kadareja. Kjo e përbashkët është çështja e shoqërisë shqiptare në kohë të ndryshme: kur kishte shqiptarë, por nuk kishte Shqipëri (Pashko Vasa), kur Shqipëria ishte një ëndërr dhe shteti shqiptar nuk ekzistonte as si projekt (Sami Frashri), kur bëhej Shqipëria, por nuk kishte ende kufijtë e saj (Gjergj Fishta), kur sajohej më në fund një shtet shqiptar dhe shndërrohet në monarki anadollake (Faik Konica), kur hiret e mbretit nuk i mbulon dot kaosi i mentaliteteve (Branko Merxhani), kur shqiptarët mbeten në kërkim të gjenezës së tyre (Eqrem Çabej), kur rikërkohet modeli i Heroit Kombëtar si shpëtim (Fan Noli), kur ideologjia e vetme sunduese shpërfill vlerat kulturore (Ibrahim Rugova), kur shteti pretendohet si kombi, por kombit shqiptar i mungon identiteti mes shtetesh e kombesh të familjes së vet (Ismail Kadare).

Në kontekstin e arsytimit tonë të gjitha këto nuk janë studime të mirëfillta historike-shkencore. Madje, duke përjashtuar Fan S. Nolit, asnjëri prej autorëve nuk ka qenë mirëfilli

KUMTESA

historian. Pavarësisht kësaj, të gjithë marrin argumente historike ose, më saktë, argumentojnë me të dhëna historike. Kaq do të mjaftonte t'i klasifikonim ese sociologjike apo historiko-sociologjike. Por, si e cekëm edhe më sipër, në shumë prej tyre kemi të gërshetuar esenë shkencore, esenë sociale, esenë filozofike etj. Aty mbizotëron teksti argumentues, por nuk mungon teksti poetik sepse, me ndonjë përjashtim të rrallë (Sami Frashri), autorët kanë kultivuar krahas eseistikës edhe poezinë ose anaçjelltas.

Por përkujdesja e tyre e përbashkët më e dukshme është vëmendja për gjuhën e shkruar shqipe. Pavarësisht se deri vonë pas Luftës së Dytë Botërore gjuha shqipe nuk u kodifikua në tekste universitare a rregulla drejtshkrimore të konsoliduara, në eseistikë, më tepër se në të gjitha gjinitë e tjera letrare, bëhen përpjekje për një gjuhë të saktë dhe të qartë, gjë që do të thoshim se aty ka nismat e veta gjuha letrare kombëtare. Në pjesën më të madhe, autorët që përmendëm më sipër kanë hartuar alfabetet ose kanë marrë pjesë në diskutimet për alfabetin e gjuhës shqipe (P. Vasa, S. Frashëri, Gj. Fishta, F. Konica), kanë hartuar gramatikat e gjuhës shqipe (P. Vasa, S. Frashëri, E. Çabej)) apo kanë ndikuar në gjuhën shqipe me një autoritet të fuqishëm individual (veçanërisht: Gj. Fishta, F. Konica, F. Noli, dhe I. Kadareja) apo kanë kontribuar në mënyrë të posaçme në terminologjinë shkencore (Samiu – në përgjithësi, Merxhani - në sociologji, Konica, Rugova - në kritikë letrare, Noli - në histori e muzikë, Çabej – në gjuhësi) etj.

Të gjithë kanë mbrojtur çështjen kombëtare në rrethana të ndryshme kohore, por, çfarë është më e rëndësishme, të gjithë, duke filluar nga Pashko Vasa kanë ngjallur reagime brenda e jashtë vendit: Gj. Fishta, F. Konica dhe B. Merxhani për një gjysmë shekulli u shpallen të papranueshëm, së bashku me shumë emra të tjerë eseistësh që edhe u dënuan fizikisht, si Anton Arapi, Lazer Shantoja, Tajar Zavalani, Mit'hat Frashri, Mustafa Kruja, Krist Maloki e sa e sa të tjerë. Sot eseistika shqiptare po afirmon emra të ri, shumë prej të cilëve edhe sociologë të vërtetë.

Recensentë :

1. Dr. Lekë Sokoli, Universiteti "Marin Barleti", Tiranë
2. Prof.dr. Tefë Topalli, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Mr. Zahrie KAPLLANAJ: PALIMPSESTI NË VEPRËN *DRANJA TË MARTIN CAMAJT*

Punimi *Palimpsesti dhe Dranja e Martin Camajt*, gërsheton në vete dy problematika: palimpsestin si dukuri teorike, si pikë shikimi, dhe veprën *Dranja*, madrigal për frymorin e papërsosun.

Palimpsesti e ka zanafillën në shkrimet një mbi një, në tekstet e para të shkruara në lëkura kafshësh e pergamena. Mënyra e shkrimit bëhet shkak që të rikontekstualizohet ky term, tash për të shenjuar një mënyrë leximi dhe një poetikë krijimi. Atë mënyrë leximi, e cila merret me komunikimin mes teksteve, me komunikimin mes kulturave, me rikontekstualizimin e elementeve, formave të vjetra, në tekste të reja.

Komunikimi i veprave, mes përbërësish të ndryshëm është i përhershëm dhe i shumëllojshëm. Teoricienët e pranojnë relativitetin ndërkomunikues. Disa tekste kanë përqindje më të madhe rimarrjesh, sesa të tjerat.

Komunikimi në mes teksteve është dukuri shumë e vjetër, madje që prej se ekziston letërsia, por dukuria e emërimit me emrin palimpsest është e vonë. Teoritë formaliste dhe strukturaliste, ofrojnë zanafillën e afrimit drejt palimpsestit, por edhe lindjen dhe funksionimin e tij. Ekziston një lidhje e largët që teoria palimpsestuale ka me konceptet gjuhësore të Sosyrit. Kurse, brenda fenomenit, së pari, duke trajtuar parimin dialogjik mes teksteve, e sidomos brenda një teksti, hyn Bahtini. Praninë e padiskutueshme të inertekestualitetit në secilin tekst, e shpall Kristeva, e cila dëshmon se *s'ka tekst pa intertekst*, lidhjen palimpsestuale me atë postmoderne e dëshmon Linda Haçion, deri të studimi i shkrirë për palimpsestet nga francezi Zherar Zhenet. Zheneti njeh pesë lloje të lidhjeve ndërtektuale: Intertekestualitetin, Paratekstualitetin, Metatekstualitetin, Arkitekstualitetin dhe Hipertekestualitetin. Zheneti pranon, po ashtu, relativitetin e masës së komunikimit mes teksteve që mund të jetë më e madhe ose më e vogël. Po ashtu e pranon edhe komunikimin mes diskurseve, motiveve, metrikës, stilit etj.

Janë tekstet vetë që dëshmojnë palimpsestualitetin e tyre, ndërlidhjen e tyre me të tjerat. Ishte Meshari i Xhon Buzukut, me nivelin e tij të lartë krijues, që e shtyri Camajn, gjuhëtar e krijues, të besonte se para tij kishte pasur tekste të tjera në gjuhën shqipe. Prandaj edhe u vu në kërkim të tyre.

Martin Camaj mahnitet me zbulimin e palimpsesteve. Aty mëson se teksti i ri e ruan të vjetrin si hije, si frymë. I vjetri frymon me të riun, i riu e ka bazament të vjetrin. Si të tillë funksionojnë bashkë. Çëmton palimpsestualitetin dhe është i bindur se palimpsesti i letërsisë shqipe e ka nënshtrat, kë tjetër veç letërsisë popullore, veç mendësisë shqiptare. Pastaj trajtoi teorinë e ndërlidhjes së letërsisë me jetën. *Jo gjithë jeta është burim poezie* (titulli i parathënies së vëllimit të tij të fundit *Palimpsest*), ku dëshmon se kujtesa jetësore hyn në secilin art, duke dëshmuar se ai është ndër ata krijues që nuk i gjuan kujtimet, por do të mbajë mend. Kjo dëshmi tregon se Camaj, palimpsestin e konsideron si lidhje, jo veç mes teksteve, por edhe përtej tyre, me vetë jetën.

Teorinë e zbaton në praktikë, pothuajse në pjesën më të madhe të krijimtarisë së tij, sidomos te kryevepra e tij *Dranja*, e cila është një palimpsest me shumë shtresa, por që shtresë kryesore e ka artin e kulturën shqiptare me tërë arsenalin e tyre. Teoria e krijimit palimpsestual aplikohet plotësisht te ky krijim, i cili në tërësinë e tij, dëshmon përfundimisht se ka një mënyrë të veçantë ndërtimi letrar.

Titulli, nëntitulli e parafjala (elementet paratekstuale) i paraprijnë veprës, duke i ofruar shenjat e para të leximit, kuptimit dhe deshfrimit. Të tri këto elemente të para krijojnë habi dhe kureshtje te lexuesi.

Dranja është emërtim i objektit të veprës që përfaqëson, një objekt, *persona poetica*¹ për autorin, e konsideron Arshi Pipa (studiues mjaft serioz i këtij libri), realizohet në bazë të një gërshetimi funksionesh, për t'u shndërruar ngadalë në figurë që reflekton shumë kuptime, madje së fundi (kemi parasysh, sidomos, pjesën e tretë të librit *Fryma e ngujueme në asht*) edhe rrashtë-palimpsest, në të cilën gjejnë vend e mund të lexohen shtresa të ndryshme ndërtimi e përfaqësimi.

Dranja është emërtim femre. Emër shumë i shpeshtë në trevat veriore të Shqipërisë. Kjo ka qenë shtysë, me siguri që autori e zgjedh këtë emër, pasi që libri ka lidhje të shumta me Shqipërinë veriore, si krahinë ku ndodhin ngjarjet, pastaj në gjuhë, kulturë, mentalitet etj.

Emërtimi Dranja, ka në rrënjë emrin e lules, e cila llogaritet më e bukura ndër lule: Drande-drandafile-trëndafil, mbretëreshë e luleve. Ky emër është një trajtë dialektike e emrit *Drande (Drandafile)*¹. Do të thotë në gjenezë, titulli, po ashtu edhe objekti-personazh (breshka), bart një emër estetik. Këtë nivel estetik, në njëfarë mënyre, e inkuadron në tekst, aq sa lulet bartin funksionin e tyre estetik në arte e letërsi: traditë e njohur kjo. Po ashtu, në këtë rast, është emërtim femre që i ofron këtij emërtimi edhe një përkatësi të dytë, e tekstit, një lloj subtiliteti, ndjeshmërie, me funksion përkushtimi gjatë gjithë shtrirjes së tij.

Çuditërisht ky emër me një bagazh estetik e kulturor edhe jashtë vetë librit të caktuar, paradoksalisht i vendoset një objekti shumë të çuditshëm: jo një njeriu, por një frymori, që për nga natyra rri në kufi të llojit, është *frymor i ndërmjëmë mes sisorëve dhe atyre që pjellin ve*, sepse ka karakteristika nga të dy llojet-breshkës.

Kuptimi që ka emri në planin jashtëletrar, edhe femëror, edhe artistik e estetik, dhe kombinimi me një frymor “të papërsosun” siç e konsideron Camaj breshkën, është i pazakonshëm, çka e bën lexuesin, që në takimin e parë të hamendësohet e të kuptojë që ka përpara një kombinim të veçantë, brenda një libri të veçantë.

Kur dalim te nëntitulli, *Madrigale për frymorin e papërsosun* kemi hapur disa faqe të palimpsestualitetit. Te ky nëntitull, peritekst, lexojmë e gjejmë edhe funksion metatekstualiteti, madje edhe arkitekstualiteti.

Metatekst, sepse nëntitulli tenton të jetë përcaktues teorik, sugjeron zhanrin dhe përcakton tekstin, dhe arkitekst, sepse libri me anë të këtij nëntitulli vetëpërcaktohet me një lloj shumë të veçantë siç është madrigali (nënllloj i lirikës erotike në Mesjetë). Për habi të lexuesit, pasi ta ketë kaluar këtë pjesë e të ketë hapur faqen e parë për lexim, madrigalin e parë, sheh se teksti është shkruar në prozë, jo në varg siç ai e priste, sepse ia sugjeronte këtë nëntitulli. Nuk ka përcaktim (strikt) metrik të vargjeve, madje s'ka vargje fare, as refren siç e kërkonte madrigali, por fjali të gjata që formojnë tërësi të ndryshme, të cilat në fakt janë proza poetike, emërtohen secila me titullin e vet, madje-madje përveç gërshetimit mes vete, brenda veprës, duke formuar kështu një tërësi, mund të lexohen e të funksionojnë edhe si të veçanta.

Për të dalë në parafjalë, e cila e shpjegon arsyen e zgjedhjes së breshkës për objekt

letrar dhe trajtën e librit, që lidhet ngushtë, njëjtëzohet me figuracionin, me palimpsestin.

Madrigali, vjen i përgjysmuar në këtë libër. Merr pjesë përgjysmë dhe lexohet përgjysmë si arkitekt-kujtesë zhanrore, duke fituar një mbulojë tjetër, që autori nuk e sheh të arsyeshme ta deklarojë në këtë paratekst-prozën poetike.

Thyerja është goxha e madhe, prej vargut forma rrafshohet, zgjerohet në fjali të gjata, duke i ikur saktësisë poetike të formës. Kjo ndodh krejt për një qëllim: për të shënuar risi, për t'iu kundërvënë *trajtave tjera letrare, përdorë deri sot në gjuhën shqipe, siç shprehet vetë Camaj*. Ky përcaktimi i fundit i qëllimit me destinim letërsinë në gjuhën shqipe, e lokalizon terrenin, duke e përcaktuar kërkimin e veçantisë brenda territorit të kërkuar, jo më larg.

Del se në këtë rast kemi një rrjet kombinimesh. Kombinim formash së pari: poezi e prozë (format eternele të letërsisë) e së dyti llojesh: madrigal e prozë poetike.

Madrigali, pra është nënshtrësë e prozës poetike, karakteristikat e të dy llojeve, të cilat mund të shihen e të ndihen gjatë leximit, shumë të ndërlydhura, por kurrë të diferencuara tamam.

E bashkimi i tyre arrihet përmes një gjetjeje shumë interesante, e cila, në njëfarë mënyre shënon kthesë në historinë e letërsisë shqipe: përmes breshkës, *"frymorit të papërsosun"*, që fut frymën deheroike në letërsinë shqipe, në një letërsi të mbushur plot me heronj, heroizma e heroizim.

Pse breshka?

Në lexim e sipër, mundësisht të ngadalshëm, do pasë parasysh se trajta e jashtme, historia e një breshke dhe e rrashtës së saj (don me thanë pjesa aksiomatike), do lidhë me nënkuptime simbolike; me fjalë tjera, me zbërthimin e përmbajtjes së mbrendshme apo të teoremës. Me randësi për autorin ashtë fjala e bukur poetike, sidomos në librin Dranja, ku bahen përpjekje që gjuha t'i përshtatet çdo situatë.

Ky paragraf synon dhe arrin disa funksione: së pari, duke qenë i vetëdijshëm krijuesi me veçantinë e krijimit që ka shkruar, ia ka frikën lexuesit, prandaj edhe i drejtohet, me një mirësjellje të shtuar: "mundësisht" thotë, duke kërkuar prej tij që t'i përmbahet leximit të ngadalshëm. Kjo këshillë, e cila jepet më shumë si sugjerim, për të qenë/për të tingëlluar sa më e zbutur të ngjall që në start ndjenjën e enigmës, të së veçantës: pse u dashka të lexohet ky libër ngadalë. Kjo njëkohësisht rrit kureshtjen e lexuesit. Së dyti, autori vetë i përcakton dy trajta të krijimit së tij: trajta e jashtme dhe e brendshme, të cilat nuk kanë lidhje me zhanrin tash, por me objektin poetik: breshkën. Duhet ta themi, se është breshka: gjysmë sisorë, gjysmë gjitarë, ose ndryshe: gjysmë grua, gjysmë breshkë që ka lidhje patjetër me formën: gjysmë poezi gjysmë prozë, ose gjysmë madrigal, gjysmë prozë poetike. Ky është kombinimi i madh dysor, që krijon lidhje çiftore në shumë anë, lidhje të pazakonshme, por që kanë efekt të shtuar në libër.

Trajtë të jashtme quan historinë e breshkës dhe të rrashtës së saj. Ta nxit kureshtjen fjala histori, e cila në parim nuk i shkon aspak këtij tip teksti, i cili, si formë shkrimi është krejt ndryshe nga shkrimet me bazë historike, argumentuese, po ashtu nuk ka as ndonjë fabul strikte. Megjithatë, si të gjitha elementet, te ky tekst edhe fjala "histori" kuptohet figurshëm, jo në plan të parë. Është histori e llojit të veçantë, madje, jo vetëm e breshkës, por edhe e rrashtës së saj. Do të thotë rrashta dhe pjesa mishtore hyjnë në bashkëveprim për të realizuar atë që Camaj e quan pjesë "aksiomatike", e cila si e tillë realizon jo simbolin, por simbolikën.

Lexuesi (që duhet jetë lexues model), te libri, duhet të lexojë dy trajta sipas Camajt.

Kjo është një anë e monedhës “trajtë”, e cila ekziston për të njohur pjesën e brendshme-esencialen, që Camaj me një term matematikor e emëron “teoremë”. Kemi prapë edhe një dysi tjetër këtu. Tamam palimpsest, ku pjesa e emërme e mbulon të brendshmen, e kjo e brendshmjia është kryesorja, sepse shënon kujtesën, atë që mbetet, frymën do të thoshte Camaj.

Merret vesh që ky tekst është një sprovë për përsosjen e mjeshtërisë së krijuesit (pa harruar funksionin e Camajt prej gjuhëtari) në fushë të gjuhës, që duket se është një ndër preokupimet kryesore të këtij krijuesi, por edhe një ndër arritjet kryesore. E kjo arritje e tij lidhet pashkëputshëm me Dranjen.

Me randësi për autorin ashtë fjala e bukur poetike, sidomos në librin Dranja, ku bahen përpjekje që gjuha t'i përshtatet çdo situatë.

Ky për Camajn është qëllimi i qëllimeve në nismë të shkrimit, si dhe rezultati i rezultateve: kryevlera pasi e ka shkruar.

Ana arkitekstuale plotësohet me komunikimin e zhanreve në Dranja: madrigal e prozë poetike, të cilat gërshetohen plotësisht, ashtu siç gërshetohen shtresat në palimpsest, e shkojnë në favor të formës së zgjedhur të bashkimit të çifteve të vecanta: prozë e poezi, grua-breshkë, breshkë-gjarpër etj.

Përderisa Paratekstualiteti e Arkritekstualiteti aplikohen tërësisht, e në këtë kontekst edhe mund të identifikohen tërësisht te kjo vepër, nuk është njësoj për tri llojet e tjera. Intertekstualiteti, i cili si lloj kërkon komunikim tekstesh të caktuara, shfaqet vetëm në madrigalin Në mitologjinë popullore, ku dëshmohet lidhja me mitin shqiptar për krijimin e breshkës dhe përrallën për Pulën e dreqit, ku, në këtë rast, Dranja është Teksti, e miti e përralla Intertekstet. Mënyra e përdorimit të tyre është rimarrje në nivel rrëfyes edhe njëherë për të përforcuar rrënjët e Dranjes, duke i shtuar asaj një nënshtresë simbolike të shprehësisë.

Kur lexohen madrigalet e librit Dranja, me kujdes, duke identifikuar të gjitha elementet ndërtuese të tyre, e ne i shtrojmë vetes detyrën e të hulumtuarit të shtresave intertekstuale, në të gjitha nivelet, shohim se ky libër ka shumë material për të na dhënë.

Dranja është sintezë e shumë karaktersitikeve, të cilat rrjedhin nga burime te ndryshme. Në të shumtën e rasteve e kemi të vështirë të flasim për burime e referenca të sakta, por e kemi shumë të lehtë të konkludojmë se elemente të njohura, të rikontesktualizuara identifikojmë gjithandej. Po ashtu, pa ndonjë hezitim mund të vijmë në përfundim, se Camaj te Dranja, ka qenë shumë i vetëdijshëm për rimarrjet, ashtu sikurse ka qenë i vetëdijshëm për mënyrën dhe qëllimin e riparaqtijes së tyre në një tekst të ri. Këtë e ka bërë gjatë gjithë kohës dhe me sukses.

Komunikimin më të dukshëm dhe më të gjerë Dranja e mban me oralitetin shqiptar, me kulturën e artin shqiptar, madje jo vetëm me letërsinë, por i zgjeron raportet edhe me fusha të ndryshme.

Pra, nënshtresa kryesore që i rri “poshtë” tekstit të ri, të cilën shtresa e re e ruan si kujtesë, është letërsia popullore dhe kultura shqiptare në përgjithësi. Ato marrin pjesë te ky libër në forma të ndryshme dhe shtrihet e shpërndahet nëpër elemente të ndryshme të ndërtimit të pjesëve.

Pas dy madrigaleve të para: *Si doli emni prej gurit* dhe *Skotë me troje të veta*, radhitet madrigali *Në mitologjinë popullore*, ku hapet një faqe komunikimi me mitologjinë shqiptare, për të mbushur një pjesë të rëndësishme të figurës së breshkës-Dranje. Duke iu bashkangjitur kjo pjesë, në njëfarë mënyre, breshka-Dranje i fut rrënjët më thellë. Na ngjan

ky proces me bimën, e cila sa më thellë që i fut rrënjët në tokë, pjesa sipërfaqësore e trungut të saj bëhet më e fortë dhe më frytdhënëse. Marrëdhënia me mitologjinë është një përforsim i saj, që përgatitet për funksionin e ri.

Sipas këtij madrigali, breshka fiton dy-tre kuptime në mitologjinë popullore. Kështu fillon madrigali që tregon historinë për metamorfozën dhe krijimin e breshkës:

Në mitologjinë popullore Dranja ka nam të keq. Në një përrallë ajo na del pula e dreqit, me shtrigën kaluer mbi shpinë. Dikund tjetër tregohet se ajo kur e pau të huejin tue ardhë për mik me bujtë, hoqi vorbën me mish prej zjarmit për të mos e ngranë me atë.

Natën i erdhi u, u que dhe e hangri mishin vetëm dhe Perëndia për ndëshkim ia ngjiti vegshin në shpinë. Në mëngjes e zuni turpi, dhe shi për këtë tashti sa e sheh një të huej, marrohet e ngrëh kokën nën rashë¹.

Shihet se Camaj, në këta dy paragrafë iu referohet dy burimeve, natyrisht për të fut në lojë dy përcaktime njëherësh për breshkën: së pari lidhet me përrallën ku breshka del “pula e dreqit, më shtrigën kaluer mbi shpinë”, përrallë që njihet në letërsinë tonë orale, e së dyti me një burim tjetër, që ndryshe nga i pari nuk e përcakton. Në këtë rast mjaftohet vetëm me një lloj përcaktimi “të papërcaktuar”: “dikund tjetër”, pa i dhënë shumë rëndësi dhe vazhdon me pjesën tjetër që është më interesantja, ku e ritregon me një ton normal rrëfimi historinë mitike të gruas, e cila, duke fshehur ushqimin nga mysafiri, theu kodin e mikpritjes, prandaj u shndërrua në breshkë dhe prandaj e karakterizon ndjenja e turpit. Titulli i madrigalit *Në mitologjinë popullore* përcakton, në njëfarë mënyre burimin e kësaj historie.

Duke i sjellë në jetë edhe njëherë këto histori mitike, Camaj e pajis Dranjen e re me “namin e keq” të vjetër, së pari për të “institucionalizuar” papërsosmërinë e saj (në këtë rast në plan moral), së dyti për t’i dhënë karakter mitik-zgjdhje palimpsestuale, dhe së treti për ta përforsuar karakterin deheroik që synon teksti me anë të breshkës.

Dranja ofron shumë rikonteksualizim temash, motivesh, situatash, trajtash gjuhësore e stilistike, duke shënuar kështu një komunikim të llojit të veçantë me krejt një folklor e traditë shqiptare, që mban si nënshtresën kryesore, pa lejuar mundësi ndjekie linjash komunikimi mes një numri të caktuar dy a më shumë tekstesh.

Dranja është një rrjetë komunikuese në shumë forma, jo veç me folklorin e traditën shqiptare, të cilën lidhje e dëshmon në mënyrë metatekstuale, sidomos në pjesën e tretë, *Fryma e ngujueme në asht*, por edhe me mitologji të hershme pagane shqiptare e evropiane, edhe me kulturën e shkruar shqiptare e përtej saj.

Camaj është nga ata studiues, i cili e sheh komunikimin e tekstit edhe me jetën e kujtimet, jo vetëm me librat a krijimet letrare, prandaj edhe përkatësia zoologjike e breshkës, si kombinim llojesh krijon nënshtresë, e në fund të fundit edhe vetë jeta e autorit, i cili nuk dëshiron të harrojë, por ta përjetësojë atë në letërsi, në art.

Camaj e sheh të rëndësishme lidhjen e artit me burimet e jetës. Ai që e arrin këtë, sipas tij, ka gjetur fillin e të krijuarit, esencën e shkrimit, prandaj Dranja është alteregoja e krijuesit, korrespondentja, simboli i vendlinjes, i kulturës, i traditës, i jetës së thjeshtë, i jetës deheroike e i letërsisë deheroike, i magësive, i dashurisë, i artit dhe i letërsisë.

Si përfundim, vepra Dranja –madrigale për frymorin e papërsosun, është vepër letrare e rëndësishme për letërsinë shqipe. Ajo relativizon praninë e zhanreve brenda saj dhe krijohet mbi poetikën e palimpsestit, prosede i njohur që në zanafillë të letërsisë, e që kohëve të fundit gjeti vend në tekstet moderne e postmoderne.

Recensentë:
Prof. Dr. Agim Vinca
Prof. Dr. Liman Matoshi

KUMTESA

**Ma. Ermira YMERAJ¹, Ma. ROVENA VATA²: LETËRSIA DHE IDENTITETI -
NDËRTIMI LETRAR I MITEVE IDENTITARE KOMBËTARE,
DEKONSTRUKTIVIZMI LETRAR MODERN.**

¹QSA Tiranë

²QSA Tiranë

Letërsia, publicistika, polemika, tekstet shkollore të Rilindjes sonë kombëtare kanë krijuar rrafshin e shenjave të identitetit tonë kombëtar. Pavarësisht qendrimeve, letërsia flet me gjuhën e vet, e historia me të sajën, individit është i lirë të dokumentojë njerën dhe të vërtetojë apo të shijojë tjetrën për të kuptuar funksionin e tyre. Shekulli i 18-të, i cilësuar shpesh padrejtësisht si shekulli i krizës, shfaqet me një pararilindje të vërtetë letrare, apo me një “*rilindje të parë*” letrare dhe kulturore në botën arbëreshe - sipas burimeve dhe vlerësimeve të reja të studiuesve M. Mandalà e F. Altimari; por edhe me një shkëlqim të shkurtër iluminist në fenomenin e Voskopojës. Kjo është koha kur Zef Skiroi (prosenior), arkipeshkv i Durrësit dhe vikar i gjithë Arbënit (“*Jofifi Schirò, arçbifscupu i Dursfit e Vicari Apostolicu ndæ Arbënit, viti 1767*”), përdor gjuhën shqipe jo për të kthyer në shqip tekstet latine, por për t’iu drejtuar Selisë së Shenjtë në mënyrë zyrtare bashkë me përkthimin latinisht¹; është koha e kolegjeve italo-shqiptare ku përgatiteshin klerikë e dijetarë; koha kur alfabetet, fjalorët, gramatikat, shkollat, edukimi, shtypshkronjat, akademitë dhe shkrimi u bënë një mit.

Letërsia e romantizmit, prej fillimeve deri kur u përmbyll, krijoi dhe ajo mitet e veta, më shumë se çdo periudhë tjetër: mitin e “*motit të madh*” dhe të kryeheroit të saj; mitin e lavdisë së dikurshme të “*dheut të Arbërit*”; mitin e prejardhjes dhe të lashtësisë; mitin e gjuhës shqipe dhe të virtyteve shqiptare, duke përfshirë dhe mitin e Perëndimit¹. Për gati një shekull me radhë në këtë letërsi miti i eposesë, i gojëdhënës kombëtare, sundoi zhvillimin e letërsisë shqipe, në të gjitha mjediset ku u zhvillua, prej kangjeljeve të “*Rapsodi e një poemi arbëresh*” e “*Istori e Skënderbeut*”, deri tek eposi “*Lahuta e Malcís*”.

Të gjitha këto mite të romantizmit shqiptar kishin një frymë të përbashkët: etnocentrizmin. Ndërsa ideologjitë dhe letërsitë e vendeve fqinje, prireshin drejt ekspansionit dhe mitit të epërsisë gjenetike si popuj të zgjedhur, letërsia romantike shqiptare nuk krijoi komplekse dhe as psikoza të tilla përdalluese. Krijimi i miteve dhe demonëve është një dukuri që i ka shoqëruar përjetësisht letërsitë, prej periudhës homerike gjer në kohën e sotme; prej *titanëve* të Greqisë së vjetër deri te krijimi i *mitemave* bashkëkohore të epokës së multimedias.

E shfaqur në fillimet e kryehershme të veta si letërsi e shkruar në një gjuhë perandorake e liturgjike, **siç** ishte latinishtja, ajo nuk ndryshonte prej letërsive humaniste europiane, si letërsi heronjsh dhe bëmash heroike. Miti i Gjergj Kastriotit u përhap në Europë e në Azi përmes kësaj letërsie, duke e bërë të njohur botën shqiptare prej Islandës në thellësitë

kontinentale aziatike¹. Në rrafshin e mendësisë kulturologjike të një populli, përpjekjet e krijuesve të ndryshëm, të shumtë a të pakët, për çmitizimin e një figure me përmasë kombëtare, që ruan edhe sot, në kohën e globalizmit shenjat e identitetit kombëtar, ndodh të jenë me efekt të kundërt. Duke bërë përpjekje të çmitizohen mite, kulte e shenja identifikuese kombëtare, atyre u shtohet një përmasë e re e shtrirjes në atë që quhet identitet kombëtar, sado që tani në një formë të re mitizimi. Le të quhet një forme e re e kulturës me përmasa globale, të krijimit të mitit. Prandaj, edhe debatet e kësaj natyre, si ato pas librit të Oliver Schmid, por edhe ato në mes të Kadaresë dhe Qosjes, duhen marrë me rezervë, së paku në planin e trajtesave për sociologjinë e kulturës.

Pavarësisht qendrimeve letërsia flet me gjuhën e vet, e historia me të sajën, individi është i lirë të dokumentojë njëren dhe ta vertetojë e të shijojë tjetrën kështu të kuptojë funksionin e saj. Miti i Skënderbeut është një konstrukt historik i ndërtuar në një kohë të caktuar dhe në një kontekst të caktuar lufrash dhe urrejtjesh nacionale, ai është një mit i rimarrë i rikonstruktuar mëse një herë. Ai është konstruktuar së pari si mit në emër të krishtërimit, kur u mbiquajt "kalorës i krishtërimit", kurse dy tre shekuj më vonë u rimorr në emër të nacionalizmit.

Në një periudhë të mëvonshme, bashkë me hapat e parë të letërsisë në gjuhën shqipe dhe gati për dy shekuj e gjysmë me radhë, u krijuan e u shfaqën mite të reja, si miti i gjuhës amtare, miti i vendlindjes, miti i botës shqiptare ("*që s'është dashunit botës së sanë*"), që herë-herë shkon deri në prekjen e një vetëdije etnocentriste, sidomos tek Pjetër Bogdani dhe "*Çeta e profetëve*", ku një pjesë e lëndës teozofike albanizohet (cikli i *Sibilave* dhe disa poezi me motive biblike-ungjillore zhvendosen në një tjetër "*tokë të shenjtë*" prej asaj të Biblës: nuk ka në to Sion, Palestinë, Nazaret apo Galile, sepse ndodhitë zhvendosen në Pashtrik, në Zadrimë, në Prizren, në Shkup, në Has e në Shkodër. Në përmbyllje të kësaj tradite letrare nuk mungoi dhe "*malli i stampësë*", miti i Gutenbergut, miti i librit, i ndriçimit të mendjes njerëzore. Gjergj Fishta do të mbete për më se një shekull personaliteti më i spikatur i kulturës letrare shqipe, duke u çmuar si klasiku më i dalluar i kësaj letërsie. Ai ndërtoi një univers letrar, një Olimp Shqiptar, me qenie mitike e reale, duke ndërtuar kontraste të fuqishme dhe dramatike të letërsisë; madje më dramatikët në letërsinë shqipe. Aty ndeshim diskutet më glorifikuese, por edhe diskutet më sarkastik, që bëhen përmes ironisë së hollë, ku autori godet pamëshirë pseudoatdhetarin. Përmes veprës së vet të larmishme, autori donte të theksonte një aspekt të rëndësishëm për shqiptarët; një identiteti kolektiv, që endet si karakteristikë e përhershme e veprës së tij.

Shekulli i modernizmit, në gjysmën e tij të parë, që më i kursyer në krijim mitesh. Por të paktën dy prej tyre mund të veçohen: miti i idesë dhe miti i qytetërimit, më së shumti i mbivendosur ndaj mitit të Perëndimit. Por nuk mungoi në të njëjtën kohë dhe një demonizim agresiv i Europës, sidomos i Fuqive të Mëdha ("*shtatë krajlive*"), që përcaktuan fatin historik të shqiptarëve në rregullimin e tyre shtetëror në Ballkanin e asaj kohe. Vargjet e Fishtës në këngën e njohur "*Te ura e Rzhanicës*" të poemës "*Lahutës së Malcis*":

*"Un Shqiptar e ata janë shkje, /ne na danë një gjak e 'i fe; /n'mëni t'sho'shoqit kemi lè:
/kemë ndërmet një qiellë e 'i dhè!*

e tejkalojnë urrejtjen mitologjike ("*shtatqind vjet do t't'i djeg kullat*") të eposit legjendar shqiptar dhe atë shkallë demonizimi që gjendej brenda tij për tjetrin, palën e dytë në bëma e konflikt¹.

Megjithëse në vështrimin teorik-estetik të studiuesve të njohur të kohës “*çdo përpjekje për të ringjallur mendimin mitologjik brenda artit të realizmit socialist kishte për të qenë në kundërshtim me synimet njohëse të kësaj metode*”¹, letërsia shqipe e realizmit socialist në tërësinë e vet mund të lexohet dhe si një letërsi mitologjike. “*Një hero i kohës sonë*”, titulli i romanit të njohur të M. Lermontovit, mund të shërbente për të shenjuar qartë synimin e teknokracisë madhështuese dhe njëherësh djallëzuese të letërsisë së realizmit socialist në përgjithësi.

Një vështrim prapavajtes ndaj letërsisë së realizmit socialist në Shqipëri mund të ishte më i verifikueshëm shkencërisht duke iu referuar miteve dhe demonëve që ajo ka krijuar, sesa përmes shqyrtimeve të disa raporteve të mirënjohura në mënyrën e vlerësimit të saj, si letërsia dhe liria, letërsia dhe shteti, letërsia dhe ideologjia, letërsia dhe revolucioni, letërsia dhe tendenca. Por zhvillimet që Shqipëria paskomuniste përjetoi pas viteve '90-të, sëbashku me lejimin e fesë, në Shqipëri, nxiti edhe debatin mbi rishikimin e shumë figurave historike të cilat komunizmi i kishte trajtuar më parë sipas interesit të tij. Kështu figura që nga ajo e Pjetër Bogdanit e deri te Haxhi Qamili u transformuan dhe morën dimensione të reja.

Personi më i zëshëm në rrokatën e miteve në Shqipërinë pas-komuniste ka qenë vërtë Kadareja. Euforia kadarejane ka ngritur në piedestale edhe më të mëdha figurën e priftërijeve katolikë, të cilët Kadareja i sheh si lidhësit e Shqipërisë me Evropën nëpërmjet “...veprave të tyre dygjuhëshe” (të botuara) në kryeqendrat kulturore evropiane. Priftërijtë katolikë që shkruan me gërma latine, Kadareja i trajton si lidhësit dhe ambasadorët e Shqipërisë me Evropën. Letërsia e realizmit socialist në njëfarë mënyre u rikthye në traditën romantike të krijimit të miteve të veta, pjesërisht të pangjashme me ato të traditës dhe pjesërisht vijime të shmangura të atyre tradicionale. Gjëja e parë që duhej bërë për t'ua shtruar udhën këtyre miteve ishte demonizimi i traditës, më saktë i asaj pjese të traditës që përbënte fillimet e modernitetit të saj. Demonizimit, përveç Konicës, Fishtës dhe Koliqit, nuk i shpëtoi as poeti arbëresh G. Schirò.

Tentimi më i rëndësishëm i letërsisë së realizmit socialist që krijimi i një miti të njeriut të ri. Ky tentim e largoi shumë letërsinë prej njeriut si individ, prej subjektit; duke çuar në një ikonografizëm sundues dhe në një kodifikim tërësor të karaktereve. “*Njeriu i ri socialist*”, është një nga projektet më kontradiktore që njeh historia politike e njerëzimit për ta modular, përshtatur, kontrolluar, kodifikuar dhe programuar subjektin dhe progresin shoqëror në funksion të interesave të paracaktuara¹. Miti i njeriut të ri është pjesë e një gjedheje të njohur paradigmatiske, si: “ideologji socialiste”, “rend socialist”, “familje socialiste”, “art socialist”, “realizëm socialist”, “shoqëri socialiste”, “moral socialist”.

Në kushtet e ndarjes nga bota, krijimi i njeriut të ri mori trajtën e një mitologjie etnike. Miti i njeriut të ri u kthye në një qëllim themelor të letërsisë së realizmit socialist, deri në atë shkallë sa, edhe kur ai mungonte ose nuk gjendej nga kritika, shpikëj si “*hero pozitiv*” edhe diçka jonjerëzore, mjafton të plotësohej kushti i mitologjisë së realizmit socialist: një qytet, një kantier apo dhe një “*kështjellë që përbën heroin pozitiv*” (rasti i romanit “*Kështjella*”). Animizimi i qytetit, antropomorfizimi i *habitat*-it, kthimi i mjedisit në personazh, duket se nuk që një shpikje e studiuesve të realizmit socialist, sidomos e atyre që u kujdesën për të marrë në mbrojtje vepra ku heroi pozitiv mungonte. Në disa prej veprave të I. Kadaresë, duke përfshirë romanin “*Kronikë në gur*”, në botimet në gjuhë të huaja, qyteti është karakterizuar si personash¹. Dështimi i mitit të njeriut të ri dhe për konsekuencë dehumanizimi i botës njerëzore është ndoshta dështimi më i madh i kësaj letërsie. Pyetja se

cili është njeriu që gjendet brenda kësaj letërsie, njeriu si e vetmja qenie me vetëdije receptimi estetik, është një prej pyetjeve më të vështira për t'u gjetur një përgjigje vlerësuese. Si një pyetje e papërgjigjshme, ajo do të qendrojë gjithnjë para gjysmë shekulli letërsi zyrtare të zhvilluar në Shqipërinë shtetërore dhe do të mjaftojë për të kujtuar e rikujtuar përgjegjësitë e protagonistëve të saj. Kushtëzimi i rreptë i letërsisë prej sistemit politik dhe ideologjisë shtetërore u përpunua edhe teorikisht, deri në atë shkallë sa të konkludohet se ka një lidhje parimore midis artit dhe politikës, se *“politikanit i duhet artisti si ajri, si buka, siç i duhet këmbës së djathtë e majta”*¹. Kjo filozofi nuk mund të kishte përfundim tjetër, veç dehumanizimit të letërsisë.

Në letërsinë e realizmit socialist ka gjithfarë mitesh të tjera, që nuk kanë ndonjë lidhje me tradita të mëparshme apo me ndonjë poetikë a manifest zhvillimesh të tjera letrare brenda dhe jashtë vendit¹. Antologji nga më të pasurat mund të bëheshin duke përzgjedhur poezitë e pafundme të realizmit socialist shqiptar kushtuar së ardhmes, kantierit, repartit, kolektivit, kazmës e pushkës, malit e kështjellës¹, piramidës e kufirit, pranverës e diellit.

Sido që teorikisht konsiderohej se *“mendimi mitologjik është i kapërcyer për artin e realizmit socialist”*¹, letërsia shqipe e gjysmës së dytë të shekullit të kaluar ka marrë dhe mjaft mite prej letërsisë gojore tradicionale: mitin e ringjalljes, të rikthimit, të rinjohjes, të flijimit. Një shumicë veprash të I. Kadaresë, por edhe të disa shkrimtarëve të tjerë, janë mburjtur me këtë lëndë¹. Jo më pak e pasur është kjo letërsi me demonë gjithfarësh, sidomos të krijuar prej asaj vetë. Letërsia e romantizmit demonizoi *“qenin turk”*, por pa arritur deri tek demonizimi i fqinjëve, që u shfaq në periudhën shtetërore, sidomos me *“Lahutën e Malcis”*, ku shqiptarë e sllavë janë të lindur *“n’mëni t’sho’shojt”*. Letërsia e realizmit socialist, si letërsi e kontradiktave dhe e antagonizmit, përveç demonizimeve tradicionale, krijoi Europën e demonizuar, Perëndimin e demonizuar, superfuqitë armike, një botë të tërë tërësisht të demonizuar, që gjithnjë ndërton projekte antishqiptare bashkë me mbështetësit e tij brenda: diversantë, agjentë, të deklasuar, të ndikuar prej dekadencës borgjeze. Demonizimi i tjetrit, i shtetit fqinj, i Perëndimit, ka lënë gjurmën e vet edhe në vepra që zor se do të mund të quheshin pastërtisht të realizmit socialist, po të kërkohej prania e njëkohshme e të pesë kanoneve të njohura të tij, siç mund të veçoheshin romani i B. Xhaferit *“Krustakraus”* / *“Ra Berati”*, apo në një skaj të kundërt: *“Mekami, melodi turke”* e Kasem Trebeshinës. Në të dy romanet historia shihet prej një kundërvështrimi ndaj atij që e kishte vështruar letërsia e realizmit socialist: në të parin prej humbjes e jo prej fitores dhe në të dytin me një përmbysje të statusit të kryeheroit, mitit të Gjergj Kastriotit. Por në të dy këto vepra gjenden gjithaq të pranishme demonizimi i Perëndimit (gjegjësisht i Venetikut), i tradhtisë, pabesisë së fqinjëve. Realitetin parësor të kryeqytetit shqiptar dhe shkalla e demonizimit të njeriut të luftës që jeton në mjedisin e një familjeje të deklasuar bën pjesë në teknologjinë e farkimit të armiqve, tipike e letërsisë së realizmit socialist. *“Tregtari i skeleteve”* (Prishtinë 2006) hyn në simetri si një kundërvepër ndaj veprës me *“Gjeneralin e ushtrisë së vdekur”*; *“Mekami, melodi turke”* (Prishtinë 1994) i kundërtqendron romanit *“Kështjella”*, ndërsa *“Kukudhi”* (1993) parodizon *“Kush e solli Doruntinën”*¹. Sipas relatorëve të kohës, nëpërmjet novelës *“Dikush më buzëqeshte”* autori donte të zhvleftësonte fëmijërinë joheroike të autorit të romanit *“Kronikë në gur”*¹. Ermira Velo tek *“Para agimit”*, Sherif Abeceja tek *“Arka e djallit”*, si dhe shumica e personazheve të romanit *“Vdekja më vjen prej syve të tillë”*, mund të shërbenin si shembullzime të tjera të demonizimit të shkrimtarit prej shkrimtarit, të *“prototipit”* prej *“tipit letrar”*, një dukuri parimore e realizmit socialist.

Mitet e letërsisë së realizmit socialist, megjithëse premtuese e një realizmi të padyshmitë të përforcuar me optimizmin romantik, e bënë atë një letërsi ideocentriste dhe e larguan krejt prej traditave më të mira të realizmit antropocentrist.

Recenzentë:
Prof. dr. Hamit Xhaferi
Prof. dr. Vebi Bexheti

Prof.dr.bahtijar KRYEZIU¹: FJALË E TERMA TË HUAJ NË FUSHËN E ARSIMIT

¹Fakulteti i Edukimit
Prishtinë

"Me e përmbajtun gjuhën të thjeshtë e të dlirtë nuk asht një rregull arti për njerinë e diçëm e të qytetnuem, por asht një nevojë e një detyrë që rrjedh nga ndjenja e naltë e fisnike e kombsis"

Prof. Aleksandër Xhuvani

Çështja e përdorimit të fjalëve të huaja dhe e leksikut terminologjik e profesional në fushën e arsimit, është çështje që duhet të shtrohet për diskutim në institucionet arsimore e shkencore të vendit, në sesione e konferenca shkencore të filologëve, pedagogëve, juristëve e pse jo edhe të ekspertëve të mjekësisë, ekonomisë, informatikës, teknikës etj. Sigurisht se kërkesa bëhet edhe më e ngutshme sot, në ditët tona, kur gjuha shqipe është hapur, madje më tepër se që do të duhej, përballë gjuhëve të huaja. Kjo shpirtgjerësi, thënë më së buti kështu, shprehet sidomos ndaj anglishtes e ndër emigrantët tanë edhe karshi gjermanishtes, frëngjishtes etj., ndërkaq tek emigrantët nga Shqipëria, sidomos ndaj italishtes e greqishtes, prej të cilave gjuhë shqipja edhe më herët ka marrë e do të marrë edhe në të ardhmen, fjalë që nuk i ka, por jo edhe fjalë që merren për "pasurimin" e saj, në të vërtetë, për të treguar kinse një dije e kulturë më të lartë tonën, e ne do të thoshim, për të shprehur atë shkallë snobizmi që sot na ka mbërthyer më shumë se kurrë më parë.

Shumë fjalëterma të fushës së informatikës, të financave, të ekonomisë së tregut, të biznesit, të arteve moderne, po edhe të shkencave shoqërore-humanitare etj., që sot kanë marrë zhvillim të veçantë, vijnë në shqipe bashkë me konceptet që shprehin dhe mbushin zbrazëtitë e leksikut. Pa dyshim se këto kanë vlerën e tyre pasuruese, e bëjnë gjuhën më funksionale, po kur huazimet e tilla, shprehje të huaja a kalke nga më të ndryshmet që mund t'i ndeshim, pushtojnë pa farë kandari edhe fushën e arsimit, kur këto përfshijnë shkollën shqipe, vendin ku edhe duhet të herren si egjra nga gruri i bukës, atëherë shqetësimi ynë duhet të jetë edhe më i madh. Këtu dhe ndoshta gjen vendin më të mirë mendimi i një gjuhëtarit tonë, kur gjendjen e tashme të shqipes e përshkruan me fjalët: *"Në këto shtjella të mëdha gjuhësh e civilizimesh, me mbisundim të elementit anglo-amerikan, gjuha shqipe e përdorur mishmash, me frymë (model) e me fjalor të huaj, rrezikohet të bëhet edhe kjo si kanadishtja, gjuhë me gramatikë angleze e me fjalor amerikan, apo si anglishtja e përkthyer në gjuhën shqipe"*¹.

Për një gjendje të këtillë aspak të lakmueshme të shqipes, faktorët janë të shumtë, si: procesi i globalizimit, që nënkupton shkrirjen e kufijve midis vendeve, kombësive e kulturave, pra edhe të gjuhës; zhvillimi marramendës i teknologjisë: interneti, telefonia celulare, programi satelitor etj., por, mbi të gjitha kujtojmë se qëndron pakujdesia dhe papërgjegjësia jonë ndaj kësaj vlere të shenjtë. Jo vetëm në fjalësin e nxënësve e të studentëve, por edhe te mësimdhënësit tanë e gati edhe në të gjitha shkrimet me përmbajtje pedagogjike-metodike ose edhe legjislative në fushën e arsimit, nuk mbeten pa u përdorur fjalëtermat: *kurrikulë, silabus apo sillabus e syllabus, modul, portofolio, evaluim, ECTS, CV-i (Sivi), thirrje, draft, departament, po edhe prorektor, prodekan, spostim, distribuim, menaxhim, workshop etj.; si dhe shprehjet – togfjalëshat: aktivitet nxemës, in-servis e pri-servis etj*¹.

Ç'është e vërteta, ne dhe një herë tjetër e kemi rrahur këtë problem, duke marr në syzim këto fjalë e shprehje fjalësh. Atëbotë patëm shpresën se bile ndonjëra nga këto kopile do t'ia lëshojë vendin bijave të shqipes, për të cilat fjalë e shprehje shqipja ka përgjegjëset e veta, por kjo nuk po ndodh me ne dhe me gjuhën tonë.

Shih për këtë arsye e me qëllim të një ndihmese sado modeste në këtë rrafsh, edhe i shtruum vetes për detyrë, të vëmë në spikamë edhe disa fjalëterma të tjerë të huaj, nga të cilët shqipja po vuan e do të dërgjet edhe më shumë në ditët e ardhme, po qe se ne bëjmë sehir ndaj tyre e nuk ndërmarim gjë.

Kësaj liste fjalësh, këtë radhë, po i shtojmë edhe një numër syresh, të cilat, jo vetëm që po u zënë vendin fjalëve shqipe, por nga disa mësimdhënës e shkrime, janë bërë përditshmëri dhe shumë të pëlqyeshme. Cili nga ne, bie fjala, nuk dëgjon në një orë mësimi, ose nuk ndesh në një shkrim, studim a akt zyrtar të shkollave a të universiteteve tona, të drejtorive komunale të arsimit a të MASHT-it edhe fjalët: *abstrakt, akcent, aplikim (i metodave...), aproksimativ, artikulum, auditiv, azhurnim, bord, definicion, deskriptiv, detaj (mësimi...), draft projekt, ekuivalencë, ekzemplar, eveniment, fokusim, frekuencë (frekuentoj një kurs), fusnotë, gjeneratë, ibid, inkluziv, investigim, konkluzion, konsulent, kualitet (kualitativ, kualitativisht), kuantitet, mediator (i programit), memorie (memorizoj, memorizim, i.e memorizuar), nostrifikim, op. cit, opozicion, permanent (mësim permanent), staf, supervisor (i programit), survejim, survejoj, i.e survejuar, survejues, tekstual, tekstualisht, verbal, verbalisht etj., etj.*

Me pak kujdes e përgjegjësi profesionale po edhe ndjeshmëri kombëtare, borxh yni ky, si dje, ashtu dhe sot e nesër, pa farë vështirësie këto fjalë e gjedhe fjalësh të huaja, mund të hidhen jashtë përdorimi, ngase për to shqipja ka fjalët e saj, plotësisht me të njëjtin kuptim, më të njohura, të përpikta e të qarta për folësit e shqipes, një pjesë e të cilave janë botuar në librat “*Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj*” (1998); te *Fjalori për “Pastërtinë e gjuhës shqipe”* (botuar po në vitin 1998) nga Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë etj.

Në qoftë se edhe para sa e sa vitesh, shkrimtarë e patriotë tanë, si: Gjon Buzuku me shokë, disa autorë arbëreshë të Italisë (Nikollë Keta, Engjëll Moshi e Jeronim de Rada); arbëreshë të Greqisë (Panajot Kupitari e Anastas Kullorioti) si dhe autorë të tjerë të shekullit XVIII dhe të fundshekullit XIX e të fillimit të atij XX, duke përfshirë ndër këta të fundit edhe Kristoforidhin, vëllezërit Frashëri, Luigj Gurakuqin, Aleksandër Xhuvanin, Mati Llogarecin

e ndonjë tjetër¹, patën ndjenjën e përgjegjesisë ndaj pastërtisë dhe pasurisë së gjuhës, përse atëherë ne sot të përdorim, p.sh., fjalën e huaj *abstrakt*, në gati çdo hyrje studimi, kur në vend të saj mund të përdorim fjalët *parathënie* ose *përmbledhje* (*parathënie* libri, doktorate, diplome etj.).

Përse në vend të fjalës *akcent* (të frëngjishtes), të mos e përdorim fjalën *theks* (*theks* i fjalës, *theks* logjik, *theks* i zanores etj.), ashtu siç do të duhej të zëvendësohej edhe një çerdhe fjalësh të huazuara nga gjuhët neolatine: *aplikoj*, *aplikim*, (*i*, *e*) *aplikuar* - me përgjegjëset: *zbatoj* (një metodë, teknikë të re në mësim; *zbatimi* i metodës së aksionit; gjuhësi *e* *zbatuar* etj.)*

Edhe mbiemri *aproximativ* apo ndajfolja *aproximativisht* (të huazuara nga frëngjishtja), mund të zëvendësohen plotësisht me fjalët shqipe: (*i*, *e*) *përafërt*; *përafërsisht*, *afërsisht*, *me afërsi* etj. P.sh.: shumë *e përafërt* matematikore, *përafërsisht* mirë e zgjidhi detyrën etj.

Ngjashëm me këta terma, mund të zëvendësohen edhe termat e gjuhësisë: *artikuloj*, *artikulum*, (*i*, *e*) *artikular* (me temë të huazuar nga gjuhët neolatine), me fjalët: *nyjëtoj*, *nyjëtim*, (*i*, *e*) *nyjëtuar* (*nyjëtoj* zanoret, *nyjëtim* i fjalës, *tinguj të nyjëtuar*, etj.).

Po kështu, në vend të fjalës *auditiv* (me prejardhje nga italishtja), mund të përdoret fjala shqipe *dëgjimor*, sikurse edhe fjalët *azhurnim* e (*i*, *e*) *azhurnuar* (të frëngjishtes), që mund të zëvendësohen lehtë me fjalët: *përditësim*, *i përditësuar* etj.

Gjithashtu, pse të themi *bordi* i shkollës, *bordi* i fakultetit, *bordi* i universitetit, *bordi* i këtij apo i atij, në vend të fjalës *këshill*: *këshill* shkolle, *këshill* fakulteti, *këshill* universiteti ose edhe *komision* etj. Është huazim i futur në shqipe viteve të fundit nga anglishtja dhe nuk ka fituar statusin e një fjale ndërkombëtare që të përdoret më dendur se fjala *këshill*.

Kështu do të thoshim edhe për fjalët *definicion* (hyrë në shqipe nga italishtja), e cila mund dhe duhet të zëvendësohet me fjalën e proveniencës shqipe *përkufizim* (*përkufizim* i *fjalisë*, *jep një përkufizim* etj.); mbiemri *deskriptiv* (ardhur nga gjuhët neolatine) që ka përgjegjësen e tij *përshkrues*; *detaj*, *detajoj*, (*i,e*) *detajuar* (çerdhe fjalësh me temë të huazuar nga frëngjishtja), të cilat zëvendësohen: *detaj* – me *hollësi*, kurse dy të tjerat me *përimtoj*, (*i,e*) *përimtuar* (e shpjegoi mësimin në *hollësi*, *përimtimi* i detyrave etj.).

Po a s'është më mirë që edhe në vend të fjalëtermave: *ekuivalencë* (e gjuhëve neolatine) dhe *ekzemplar* e *eveniment* (të frëngjishtes), të përdoren me fjalët shqipe: për të parën fjala *barasvlerësim*, për të dytën *kopje* dhe për të tretën *ngjarje*, si të shembujt: gjej *barasvlerën* e numrit...; “Meshari” është *kopje* e rrallë; kjo *ngjarje* historike ka ndodhur më... etj.)

Me fjalë shqipe duhet zëvendësuar edhe fjalët: *frequencë* (e gjuhëve neolatine), *fusnotë* (e anglishtes), *gjeneratë* (e gjuhëve neolatine), *si dhe fokusim*, *ibidem*, me shkurtesat *ib.*, *ibid.*, *inkluziv*, *investigim* (të latinishtes) e ndonjë fjalë tjetër si këto. Andaj, në vend të fjalës *fokusim*, *fokusoj*, mund të përdoren përgjegjëset shqipe: *vatërzim*, *vatërzoj*, përkatësisht *përqendrim*, *përqendroj* – kur përdoren me kuptim të figurshëm (*vatra* e thjerrzës, *përqendro*, *do të përqendrohëm* te ky mësim etj.), kurse për *frequencë* - fjalën *denduri*, për *gjeneratë* – fjalën *brez*, për *fusnotë* është mirë të përdoret kompozita shqipe *fundfaqe*, siç po

përdoret kohëve të fundit, sidomos në librat e botuar në Shqipëri; për *ibid – po aty, në faqen e njëjtë* të një libri; për *inkluziv – gjithëpërfshirës, gjithëpërfshirje* (mësim *gjithëpërfshirës*), ndërkaq termi *investigim* të zëvendësohet me përgjegjësen tonë *hulumtim, gjurmim* për një studim etj.

Sikurse fjalëtermat *konkluzion, kualitet e kuantitet* (të gjuhëve neolatine) që zëvendësohen me fjalët shqipe *përfundim, cilësi, sasi* (*përfundimi* i një studimi, mësim *cilësor*, nga ana *sasiore* ishte mirë etj.), ashtu duhet të zëvendësohen edhe fjalët e huaja: *mediator* (i programit - me shqip *ndërmjetësues i programit, arbitër*), *memorie* (*memorizoj, memorizim, (i,e) memorizuar* – fjalë me prejardhje nga latinishtja), që në gjuhën tonë kanë përgjegjëset: *kujtesë, kujtime, i kujtesuar* etj., p.sh.: ka *kujtesë* të mirë; botoi *kujtimet* e veta); *nostrifikim* (fjalë e latinishtes) që hëpërhë po përdoret më shumë se fjala shqipe *rinjohje, parifikim*, apo edhe *barasvlerësim* (*rinjohje, barasvlerësim* i një diplome, i një doktorate etj.).

Edhe fjalëtermat a togfjalëshat e huaj të poshtëshënuar, mund të zëvendësohen me fjalëterma shqip. Kështu, bie fjala, nuk ka asgjë të keqe, përkundrazi do të duhej që op. cit (nga latinishtja *opera citato*), të zëvendësohet me *vepra e cituar, opozicion, permanent*, (fjalë neolatine) - me *kundërvënie* (në gjuhësi: *kundërvënie* fonologjike), përkatësisht me *i përherëshëm, i pandërprerë* (mësim *permanent* – mësim i *përherëshëm, i pandërprerë*); *supervizor* (e latinishtes) - me *mbikëqyrës* (*mbikëqyrës* i programit, *mbikëqyrës* i mësimi praktik etj.); *perfeksionim*-i (fjalë nga latinishtja) - me *përsosje, përkryerje* (*perfeksionim* profesional - *përsosje* profesionale); *survejm, survejoj, (i, e) survejuar, survejues* (çerdhe fjalësh me temë të huazuar nga frëngjishtja) – me *mbikëqyrje, i,e mbikëqyrur* (*mbikëqyrje* e mësimi...); *tekstual, tekstualisht* (me temë nga gjuhët neolatine) – zëvendësohen me *i fjalëpërfjalshëm* (citim (përkthim) *fjalë për fjalë, i fjalëpërfjalshëm*); ashtu sikurse edhe *verbal, verbalisht* (me temë po nga gjuhët neolatine) që duhet të zëvendësohen me fjalët *gojor, gojarisht* (e shpjegoi mësimin *gojarisht*).

Nuk e kemi fjalën këtu për farë harrje të skajshme a purizëm të tepruar, por për ato fjalë e shprehje të huaja të cilat nuk i kanë përfshirë fjalorët njëgjuhësorë të gjuhës shqipe, e të cilat, po nuk i përdorëm shqip, vetëm sa e lodhin gjuhën tonë, e bëjnë atë të dalë rodit të shqipes së Naimit, të shqipes së Konicës, të shqipes së Kadaresë dhe të shqipes së popullit, siç ka thënë dikush tjetër edhe para meje.

Në përmbyllje të këtij shtrimi të shkurtër, do të shtonim edhe këtë se, risitë tekniko-shkencore dhe ato nga jeta shoqërore në përgjithësi, padyshim se kanë nxitur dhe nxisin nevojën e krijimit të fjalëve e të shprehjeve të reja në gjuhë, qoftë me futjen e pastaj përhapjen e tyre, qoftë me kalkimin, apo qoftë edhe me krijimin e vetëdijshëm të termave që shfrytëzojnë pasurinë e mjeteve leksikore – karakteristikë për një gjuhë, ama me masë e terezi, siç do të thoshte Gjergj Fishta, sepse huazimet kanë anën e mirë – pasurojnë gjuhën, por kanë edhe anën e keqe, ngase jo gjithçka e huaj i duhet shqipes.

Në këtë hulli është edhe qëndrimi i akademik Rexhep Qosjes, i cili, duke paraqitur opinionet e tij për pasurimin e gjuhës letrare, shkruan se “*krijimi i fjalëve të reja, ringjallja e disa fjalëve plaka, përdorimi i krahinorizmave, zgjerimi a ndryshimi a, më në fund, saktësimi i kuptimit të disa fjalëve të marrëveshjes së përditshme*”¹ janë bazë e mirë për një gjuhë të pastër e të pasur shqipe.

KUMTESA

**Mr. Luljeta ADILI-ÇELIKU¹, Mr. JEHONA RUSHIDI- REXHEPI²:
ANTONIMIA TE KADAREJA**

¹ Universiteti i Evropës Juglindore- Tetovë

² Universiteti i Evropës Juglindore - Tetovë

Hyrja

Kadareja, si vizionar që është, e ka marrë përsipër pasurimin dhe pastrimin e gjuhës shqipe. Duke u nisur si nga nevojat leksikore ashtu edhe nga nevojat stilistike dhe estetike, ai krijon fjalë të reja gati me gjithë parashtesat dhe prapashtesat e gjuhës shqipe, gjithmonë duke i bazuar prurjet e tij në rregullat e brendshme të fjalëformimit të shqipes, pa dëmtuar strukturën morfologjike dhe leksikore të saj. Kjo është një arsye jo e vogël për tu përcaktuar për studimin dhe sqarimin e antonimeve neologjizma, gjegjësisht për të marrë objekt studimi fjalët e krijuara me parashtesat **kundër-** / **anti-**, **mos-** dhe **pa-**, pra antonimet që krijon ai.

Bazuar në konstatimin e studiuesit, Ibrahim Goçi për antoniminë, themi se antonimia është fenomen leksiko-semantik që lidhet me shumë faktorë gjuhësorë e jashtëgjuhësorë. Ndonëse Kadareja iu përmbahet rregullave gramatikore në krijimin e fjalëve të reja, krijimet e tij antonimike janë të ndikuar nga faktorët jashtëgjuhësorë, pra janë krijime momentale, kontekstuale. Është e tepërt të thuhet se Kadareja i parapëlqen parashtesat e mohimit, ngaqë e tërë vepra e tij përshkohet nga njerëz apo sende që bartin kuptimin e mohimit. Dihet se personazhet e Kadaresë janë personazhe që në një mënyrë ose tjetër kanë mbi vete vulën e mohut. Është një bekim për Kadarenë ajo që gjuha shqipe ka disa parashtesa mohimi dhe Kadareja fare lehtë mund të zgjedhë atë që i përgjigjet fjalës së re. Prandaj Kadareja përdor shumicën e parashtesave për të krijuar antonime neologjizma, p.sh *çgaforrizim* me parashtesën *ç-*, *shprij*s me *sh-*, *zhkomplot* me *zh-*, *antigjeografi* me *anti-*, *kundërdiell* (*i,e*) me *kundër-*, *parrokshëm* (*i,e*) me *pa-*, *mosdashuri* me *mos-*, *johyjni* me *jo-*.

Pavarësisht nga kjo, punimi nuk do të ndalet në parashtrimin e antonimeve neologjizma me të gjitha parashtesat, për të vetmen arsye pasi disa nga ato tashmë janë të studiuar dhe të sqaruara. Konkretisht, siç u theksua më lartë punimi do të ndalet në ato që nuk janë hasur të sqaruara, [d.m.th.](#) fjalët e krijuara me parashtesat **kundër-** / **anti-**, **mos-** dhe **pa-**.

Duke u nisur nga klasifikimi i antonimeve sipas përbërjes së tyre, në antonime të së njëjtës rrënjë dhe në antonime me rrënjë të ndryshme, llojin e fundit nuk e gjejmë te Kadareja. Nuk gjenden antonime-neologjizma që plotësisht e kundërshtojnë fjalën me fjalë tjetër, por gjenden vetëm antonime- neologjizma me parashtesim.

1. Neologjizmat antonime me parashtesën kundër-

Sa i përket parashtesës **kundër-**, kjo parashtesë i vjen ndoresh shkrimtarit kur është fjala për të krijuar emra ose mbiemra që shprehin kuptimin e kundër semantik me fjalën nga e cila vjen njësia leksikore e re e krijuar, pra i vjen në dorë për të krijuar antonime. Kjo parashtesë për nga burimi është nga parafjala *kundër-* / Enver Hysa, faqe 64/. Në Fjalorin Gjuhës Shqipe, ky element konsiderohet si pjesë e parë e njërive leksikore të përbëra, që u përgjigjet nga kuptimi fjalëve *kundër* e *kundrejt*, pra nuk merret si parafjalë siç e trajtojmë ne në këtë punim. Bashkohet me tema të parme, emra ose mbiemra si p.sh. *kundërgreqi* (vend i cili i ka tiparet dhe veçoritë e kundërta me Greqinë; fig. një Greqi e kthyer me kokë poshtë); *kundërhero* (ai që ka një karakter a veprimtari të kundërt me atë të heroit; fig. njeri që të zgjon ndjenja përbuzjeje, njeri pa vlerë të mirëfillta); *kundërkinez* (ai që ka tiparet e kundërta me një kinez; ai që vepron dhe vepron kundër politikës kineze, në kohën e marrëdhënieve të ngushta shqiptaro-kineze); *kundërmaksimë* (e kundërta e parimeve të cilave njeriu iu përmbahet në jetë; e kundërta e një rregulle që njihet dhe ndiqet nga të gjithë; e kundërta e një mendimi udhëheqës); *kundëroman* (roman që nuk i ngjet fare një romani; vepër letrare që s'mund të shkruhet); *kundërsjellje* (e kundërta e sjelljes; sjellje e kundërt me atë si vepron njeriu në jetë, në shoqëri e në shkollë; qëndrim në marrëdhënie me të tjerët ose kundrejt detyrave e në rrethana të caktuara në kundërshtim me atë që zakonisht merret si qëndrim i drejtë); *kundërura* (kjo njësi leksikore nuk është krijuar të shprehë kuptimin kundërt të fjalës urë, por shpreh në mënyrë stilistike një ngrehë të ngjashme me një urë por që nuk kryen funksionin e saj); *kundërdiellt* (*i,e*) (që i nuk i ka tiparet e diellit; që është i flohtë dhe i errët; që nuk është i kësaj jete); *kundërprindëror* (diçka që është e kundërt me atë që u përket prindërve; tipar ose veti të kundërt me ata që janë dallues për prindërit; diçka ose dikush që drejtohet kundër prindërve të vet apo prindërve të dikujt tjetri); *kundërkohshëm* (*i,e*) (që nuk është i kohës, që ecën në kundërshtim me kohën; që nuk iu përmbahet dhe nuk e ndjek rrjedhjen normale të kohës, por që ecën në kah të kundërt me të). Në tabelën në vazhdim jepen shembuj për modelet krijimit të neologjizmave antonime me *kundër-*, të klasifikuara sipas kategorisë leksiko-gramatikore të cilat paraqiten si rrënjë.

kundër- + një emër = emër

Kundërgreqi

Kundërkinez

Kundërmaksimë

kundëroman

kundërsjellje

kundërura

kundër- + mbiemër = mbiemër

i,e kundërdiellt

i,e kundërprindëror

i,e kundërkohshme

Tabela 1. Neologjizmat antonime me parashtesën kundër-

Parashtesa *kundër-*, megjithëse e re dhe nuk gjendet si mjet fjalëformues në gjuhën popullore, ka potencial të madh krijimi, sidomos fjalë të ligjërimit libror. Meqë zakonisht shkrimtari shpreh gjendje, mendime dhe veprime të zakonshme, sa herë që do të shprehë mendimin, veprimin ose gjendjen e kundërt, ai i kërkon ndihmë kësaj parashtese. Dihet se Kadareja është shkrimtari i kundërshtive. Ndodh që personazhet e tij në të vërtetë të jenë kundërpersonazhe dhe cila fjalë do t'i përshkruante më mirë veprat apo mosveprat e tyre?

2. Neologjizmat- antonime me parashtesën anti-

Një ndër qëllimet kryesor gjatë krijimit të fjalëve të reja të Kadareja është pastrimi dhe pasurimi i gjuhës, mirëpo, të neologjizmat e tij gjendet edhe parashtesa e huaj anti- e cila, sipas studiuesve të gjuhës, duhet të lidhet kryesisht në termat ndërkombëtarë, tema e të cilave nuk gjenden në gjuhën shqipe të pavarura. Kadareja e përdor me ngjyrimet **stilistikore-emocionale** krahas përgjigjes së saj në shqip **kundër-**, ai ua shton këtë parashtesë edhe emrave të përveçëm, pra emrave shqip. p.sh.: *antikrisht, antigjergj, antibuzëqeshje, antifestiv, antijetë, antijugosllavizëm, antimodë, antinënëterezist, antinjeri, antiolimp, antipartenon, antireklamë, antishekspir, antiurë, antivështrim, antivjeshtë* etj. Meqenëse për shumicën nga këta neologjizma tashmë ka sqarime, duket më se e tepërt që në këtë punim sërish t'i jepet hapësirë sqarimit të tyre. Në tabelën 2 vazhdim jepen shembuj për modelet krijimit të neologjizmave antonime me *anti-*, të klasifikuara sipas kategorisë leksiko-gramatikore të cilat paraqiten si rrënjë.

anti- + emër = anti- + emër= neologjizmi

neologjizmi

| | |
|-------------------|--------------|
| Antibuzëqeshje | Antiolimp |
| Antijetë | Antipartenon |
| Antireklamë | |
| Antijugosllavizëm | Antishekspir |
| Antimodë | Antiurë |
| Antinënëterezist | Antvështrim |
| Antinjeri | Antivjeshtë |
| Antigjergj | Antikrisht |

Tabela 2. Neologjizmat antonime me parashtesën *anti-*

3. Neologjizmat-antonime me parashtesën pa-

Parashtesa *pa-* përputhet fonetikisht me para-fjalën *pa*. Përdorimi i këtij elementi si parashtesë është relativisht i ri dhe ka marrë një përhapje gjithsesi jo të vogël, sidomos vitet e fundit. Nga pikëpamje semantike njësitë e reja leksikore që krijohen me këtë element tregojnë mungesën e asaj që shënon tema fjalëformuese ose e përjashtojnë atë. Te Kadareja këtë element e gjejmë të përdorur te fjalët: *pagjumë* (mungesë gjumi a fjetjeje; gjendje e njeriut që nuk ka fjetur fare a që nuk është ngopur me gjumë); *padëmtueshëm(i,e)* (që nuk mund të dëmtohet, që nuk mund të priset); *pafutshëm (i,e)* (që nuk mund të futet dhe të zërë vend); *pathithshëm-me (i,e)* (që është i tillë që nuk mund të thithet); *parrënjë(i,e)* (që nuk ka rrënjë; që nuk i dihen rrënjët; i pabazë); *pasy (i,e)* (që nuk ka sy ngaqë i janë nxjerrë përdhunshëm, që i mungon njëri ose të dy sytë); *paburrërisht* (jo me guxim por si frikacakët, ashtu si nuk u ngjan burrave).

KUMTESA

Në tabelën në vazhdim jepen shembuj për modelet krijimit të neologjizmave antonime me *pa-*, të klasifikuara sipas kategorisë leksiko-gramatikore të cilat janë rrënjë.

| | | | |
|------------------|------------------------------|-------------------------------|------------------------|
| pa + emër | pa- + mbiemër | pa-+një emër = mbiemër | pa -+ ndajfolje |
| <i>Pagjumë</i> | <i>padëmtueshëm(i,e)</i> | <i>parrënjë(i,e)</i> | <i>Paburrërish</i> |
| | <i>pafutshëm (i,e)</i> | <i>pasy (i,e)</i> | |
| | <i>pathithsh/ëm-me (i,e)</i> | | |

Tabela 3. Neologjizmat antonime me parashtesën *pa-*

4. Neologjizmat-antonime me parashtesën *mos-*

Nga pikëpamja semantike parashtesa *mos-* është sinonim me parashtesë *pa-*. Ky element shërben për të kundërshtuar a mohuar veprimin a gjendjen e shprehur nga folja, për të mohuar një emër apo një mbiemër, por ky nuk është një mohim i një shkalle shumë të lartë, p.sh. *mosdashuri*, që ka kuptimin : mungesë ndjenjash të fuqishme dhe të thella për dikë; nuk është urrejtje, por thjesht mungese dashurie; *mosdashje*), *mosdashuri* nuk është *urrejtje*, *mosgëzim*: mungesë e plotë gëzimi; ndjenjë që nuk është as gëzim e as hidhërim, vetëm mungesë gëzimi), *mosgëzim* nuk ka kuptimin e *hidhërimit*. Nga fjalët që do të renditim më poshtë do të merret vesh se Kadareja këtë parashtesë e ka bashkuar kryesisht me tema fjalëformuese të brumit të shqipës, më së shumti tema emërore ose tema emërore prejfoljore dhe më rrallë me ndonjë mbiemër.

P.sh. *mosdukja* (mungesë e dukjes së diçkaje, humbje për një kohë te gjatë e dikujt a e diçkaje); *mosepsh* (mungesë e plotë epshi, mungesë e dëshirës për kënaqësi trupore; ftohtësi seksuale); *mosgjë* (mungesë absolute e gjithçkaje; gjendja kur s'ka asgjë; zbrazëti e plotë; hiç absolut); *mosgjuhë* (një gjuhë që nuk mund të jetë; gjuhë e përçudnuar, gjuha e zhdukjes); *mosjetë* (mosqenia në jetë, mungesa e të qenit në jetë e dikujt a e diçkaje; mosjetesë, mosrrojtje); *moskrim* (krim që nuk është, një krim i paqenë, diçka që merret si krim pa qenë në të vërtetë i tillë; pafajësi); *mosmendje* (mungesa e arsyes; çmendje e padëmshme dhe e bukur); *mosvarësi* (mungesë e plotë e varësisë; mungesë kushtëzimi nga rrethanat; pavarësi); *mossy* (sy që nuk kanë tiparet ose pamjen e syve normalë; sy të frikshëm); *mosshkak* (mungesa e shkakut, një shkak që në të vërtetë nuk është shkak, një shkak i paqenë); *mosdurim* (mungesë durimi ose aftësie për të duruar apo për të përballuar vështirësitë, shqetësimet, vuajtjet, fatkeqësitë; Kadareja e përdor në vend të fjalës intolerancë); *mosfolje* (mungesa e foljes; paaftësia për të folur a për të thënë diçka; heshtje, memecëri); *mosgëzim* (mungesë e plotë gëzimi; ndjenjë që nuk është as gëzim e as hidhërim, vetëm mungesë gëzimi); *moskapërcim* (mungesa e kapërcimit, paaftësia për të kapërcyer diçka, qoftë pengesë apo jo); *moskufizim* (mungesë e plotë kufizimi, mospasje kufijsh; liri e plotë veprimi ose mendimi); *mosndodhje* (mungesa e të qenët diku, mosqenie në një vend të caktuar); *mosparje* (mungesë e plotë e të parit; paaftësi shikimi; verbëri); *mospërkim* (

mungesë përkimi apo përputhjeje; mungesë pjekjeje a takimi); *mospërligje* (mungesë përlligjeje, paaftësia për të përlligjur dikë a diçka); *mosshpjegim* (mungesë shpjegimi, gjendje me kushte të tilla ku nuk bëhet a nuk ka shpjegim); *mosshtirje* (mungesë shtirjeje, të qenët pa shtirje; çiltërsi); *moszbulim* (mungesë e plotë zbulimi; të qenët i mbuluar a i fshehtë); *moszhbërje* (mungesë zhbërjeje, mosprishje *mosnatyrsh/ëm-me (i, e)* (që nuk bëhet e nuk është sipas rregullsive ose ligjeve të natyrës); *mosrroksh/ëm-me (i, e)* (që nuk mund të rroket a të kapet me dorë; që nuk mund të kapet dot nga shqisat ose nga përfytyrimi; që është i vështirë për t'u zbërthyer a për t'u rrokur; i pakapshëm). Në tabelën në vazhdim jepen shembuj për modelet krijimit të neologjizmave antonime me *kundër-*, të klasifikuara sipas kategorisë leksiko-gramatikore të cilat janë rrënjë.

| mos- + emra të parme | mos- + temë emërore prejfoljore | mos + një mbiemër i nyjshëm |
|-----------------------------|--|------------------------------------|
| <i>Mosdashuri</i> | <i>Mosdurim</i> | <i>mosnatyrsh/ëm-me (i, e)</i> |
| <i>mosdukja</i> | <i>Mosfolje</i> | <i>mosrroksh/ëm-me (i, e)</i> |
| <i>Mosepsh</i> | <i>Mosgëzim</i> | |
| <i>Mosgjë</i> | <i>Moskapërcim</i> | |
| <i>Mosgjuhë</i> | <i>Moskufizim</i> | |
| <i>Mosjetë</i> | <i>moszhbërje</i> | |
| <i>Moskrim</i> | <i>Mosndodhje</i> | |
| <i>Mosmendje</i> | <i>Mosparje</i> | |
| <i>Mosshkak</i> | <i>Mospërligje</i> | |
| <i>Mosvarësi</i> | <i>Mosshpjegim</i> | |
| <i>Mossy</i> | <i>Mosshtirje</i> | |
| | <i>Moszbulim</i> | |

Tabela 4. Neologjizmat antonime me parashtesën *mos-*

Përfundimi

Të flitet për antonimet e Kadaresë si për një proces që ka përfunduar është e pamundur duke pasur parasysh se letërsia e tij është një proces që është në vazhdim e sipër. Antonimet e Kadaresë janë njëri nga segmentet e shumta karakteristike të krijimtarisë së tij. Kadare krijon antonime dhe njëkohësisht shton e fondin neologjizmave të tij. Është autor prej të cilit lexuesi pret shumëçka të lexojë dhe kuptohet në këtë drejtim i hapet shumë punë edhe studiuesve të letërsisë së tij. Mbetet të shihet se në ç' masë antonimet e Kadaresë do të përfshihen në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, të shihet se çfarë dimensionesh do të arrijnë ato, çfarë funksione do të kryejnë. Punimi në veçanti u ndal te analiza e kuptimeve që merr fjala e re e krijuar nga lidhja mes një parashtese dhe një kategorie gramatikore. Gjithashtu, në tabela janë paraqitur neologjizmat antonime të ndara në bazë asaj se me cilën parashtesë janë krijuar dhe se çfarë është fituar gjatë krijimit të tyre.

KUMTESA

Është e qartë se të krijuarit e antonimeve ngushtë lidhet, gjegjësisht i referohet aftësisë së tij për të krijuar neologjizma. Në këtë drejtim, të shpresojmë se ky punim do të jetë shtytje që në të ardhmen të analizohen se çfarë njësisish leksikore përveç antonimeve përfshihen në neologjizmat e tij.

Recenzentë :
Dr. Avzi Mustafa
Dr. Mustafa Ibrahim

Prof. dr. Zeqirja NEZIRI: STUDIMET BUZUKJANE NË PRAGSHEKULLIN E DYTË TË PAVARËSISË KOMBËTARE: BASHKËKOHËSITË E MESHARIT

Hyrje

Në kontekst të leximit të veprës së shkruar të një autori që është aktualizuar nga Umberto Eko në studimin e tij *Eco lupus* historiografia letrare shqiptare disponon me të dhëna se libri i Buzukut gjatë gjithë historisë së jetesës së tij gati pesëshekullore vazhdimisht ka tërhequr vëmendjen e lexuesve dhe studiuesve dhe gjithmonë ka qenë në epiqendër të interesimit shkencor. Me ndërprerje deri më 1910 përmendet disa herë. Ka qenë në heshtje dhe askush nuk e ka përmendur deri më 1743. Përsëri tërhiqet në harresë deri më 1853, kur e përmend Zef Krispi dhe, prapë harrohet deri te Pal Skiroi, më 1910 kur gjallërisht nisë të jetojë dhe të frymojë midis studiuesve.

Në kontekst të bashkëkohësisë dhe të jetesës së *Mesharit*, nga koha e bërjes publike dhe e pranisë së tij në mjedisin e lexuesve historiografia e tekstologjisë shqiptare mund të flasë për pesë bashkëkohësi, të cilat, në kohë, janë të shpërndara dhe shtrihen në tri periudha të gjata historike.

- (1) për një *bashkëkohësi të mjegulluar (të heshtur)* deri në vitin 1743;
- (2) për një *bashkëkohësi dritëdhënëse* deri në vitin 1910;
- (3) për një *bashkëkohësi rrezatuese* deri në vitin 1929;
- (4) për një *bashkëkohësi frytdhënëse (vlerësuese)* deri në fund të shekullit të 20 – të; dhe
- (5) për një *bashkëkohësi sfiduese*, e cila i përket fillimit të shekullit XXI.

Të gjitha këto udhëtime të jetës së *Mesharit* nëpër periudha të ndryshme e të gjata të këtij gjysmëmijëvjeçari shenjojnë udhët nëpër të cilat kanë shkelur dhe kanë ecur lexuesit e rëndomtë e kureshtarë dhe studiuesit e përkushtuar të *Mesharit*. Secila prej këtyre bashkëkohësive ka karakteristikat e veta dhe secila bart me vete njohuri shumë të vlefshme dhe jashtëzakonisht të rëndësishme për shkencën shqiptare.

(1) Bashkëkohësia e mjegulluar

Bashkëkohësia e mjegulluar i përket kohës së të qenmes së heshtur, të mjegulluar dhe të tërthortë të *Mesharit*, është koha e jetesës së tij në heshtje dhe të mbyllur brenda një numri shumë të kufizuar lexuesish të klerit katolik shqiptar. Dijmë se në shekujt vijues, deri më 1743, nuk përmendet askund dhe prej askujt. Janë të heshtur të gjithë pasuesit e Buzukut, në shekullin e tij dhe në atë vijues, duke nisur nga Lekë Matranga e Pjetër Budi, si të një brezi më të afërt, pastaj duke vazhduar me Marin Bicin e Pjetër Mazrekun, Frang Bardhin e Pjetër Bogdanin si të një brezi të dytë, paksa më të largët.

Përkundër tyre, aty janë anëshkrimet mbi *Meshar*, për të cilat mund të dyshohet në i kanë bërë nxënësit e Kolegjit të Propagandës Fide në Romë, apo janë të priftërinjve për të

cilët bën fjalë profesor Shuteriqi. Sidoqoftë, ato flasin për një jetë të gjallë dhe për praninë e tij midis lexuesve, të paktën për një gjysmë shekulli menjëherë pas botimit.

Është e megjulluar edhe çështja e vendosjes së *Mesharit* në Bibliotekën e Propagandës Fide (1622), që i përshkruhet Marin Biciti (Shuteriqi, 1979: 74 – 75), ku e gjeti Gjon Nikollë Kazazi. Por dihet se në shekullin XVIII në Bibliotekën e Kolegjit Urban, ku e gjeti Pal Skiroi, e pat vendosur Stefan Borxha (Ismajli, R. 1988: 26).

Ekzistojnë mendime se mund të jetë vendosur para se të shkruante Budi, më 1618 dhe 1621, por edhe para vitit 1610, ose edhe para vitit 1568 (Shuteriqi, 1979: 58 – 59). Por është e vërtetë se pas vitit 1570 libri “mbeti jashtë përdorimit si ‘një manual i vjetëruar’ (*Meshari* 1, 1988: 24) dhe se binte ndesh me frymën e vendimeve” të mëpastajme kishtarë (Bulo, 2005: 10).

Gjurmë, të alfabetit të tij, pa u përmendur askund, përkundër strehimit në Romë flasin se ai ka qenë në përdorim nga pasardhësit për dy – tre shekuj në vijim. Sepse te të gjithë këta krijues në shekujt vijues përvijohen dhe në veprat e tyre janë të pranishme po ai vullnet i çeliktë i Gjon Buzukut për ta ndërtuar dhe ngritur gjuhën shqipe në gjuhë kombëtare; përbartet po ai shqetësim dhe zell për lëvrimin e gjuhës shqipe; nënvizohen po ato nevoja të ngutshme e të domosdoshme të botimit të librave në këtë gjuhë; përtheksohet po ajo dashuri e zjarrtë e Gjon Buzukut për arsimimin e popullit shqiptar; përvijohet po ajo forcë morale dhe po ai angazhim për ngritjen e vetëdijes kombëtare me shkolla në gjuhën kombëtare; e përshkrojnë po ato ndjenja të dhimbshme për gjendjen e mjeruar ekonomike dhe politike të popullit shqiptar dhe për gjendjen e përkeqësuar të gjuhës shqipe.

Pjetër Bogdani, më 1665 përmend një libër me titullin *Ungjijtë në gjuhën shqipe*. Nuk dihet në është fjala për *Mesharin* e Gjon Buzukut, apo për ndonjë libër tjetër që është zhdukur në harresën e kohës, si gramatika e ungjijtë të tij Ndre Bogdanit.

Deri te Gjon Nikollë Kazazi më 1743 shohim se *Meshari* i Gjon Buzukut është i gjallë, është i pranishëm midis klerikëve shqiptarë. Shumë nga fjalëpaket e *Pasthënies* së tij i gjejmë të thëna, në një mënyrë ose në një tjetër, te të gjithë pasuesit. Mos është fjala këtu për një jetë të fshehtë të *Mesharit*, të mbyllur në sekretin e kohës, brenda mjedisit të një numri të vogël klerikësh, apo bëhet fjalë për një program të pashkruar që përcillet për disa shekuj radhazi. Si duket bashkarisht të dyja janë të pranishme. Për dy shekuj në vijim askund nuk përmendet as titulli i librit, as emri i autorit, por pasojat e tij janë të dukshme dhe i takojmë kudo, gjurmë të tyre ndeshim në të gjitha veprat e pasardhësve Budit, Biciti, Mazrekut, Bardhit, Bogdanit.

(2) *Bashkëkohësia dritdhënëse*

Bashkëkohësia dritdhënëse do të përfshinte periudhën prej kur për *Mesharin* flitet si për një libër që ekzistonte dikund, por që nuk e kishin në dorë ta preknin e ta lexonin – do të shprehet Lasgush Poradeci për *Çetën* e Bogdanit. Për të flitej për aq sa ofronte informacioni dhe kopjimi i Gjon Nikollë Kazazit. Studiuesit e përmendin të qenmen e tij, por askund nuk di më shumë se ajo letër e Kazazit dhe ajo pjesë e fragmentit të bekimit të unazës dhe të kurorës, pra të faqes 26 e në vazhdim, si një dëshmi për ekzistencën e shkrimit të shqipes që nga gjysma e dytë e shekullit XVI. Por ai që i dha krah, rëndësi historike dhe u bë prijatar i studimeve buzukjane është *Gjon Nikollë Kazazi*.

Giorgio Guzzetta (1678/82 – 1746/56), rektor i parë i Seminarit të Palermos, mendohet se në librat e tij e ka përdorur alfabetin e Buzukut (Shuteriqi, 2005: 274). **Pal Mario Parrino** (1721 – 1765) e përmend “në një libër që i mbeti pa botuar” (Shuteriqi, 2005: 262).

Midis atyre që në veprat e tyre dëshmojnë se e kanë pasur në dorë dhe e kanë shfrytëzuar këtë pjesë të *Mesharit* të Buzukut, përmendet edhe **Nikollë Keta** (1743 – 1803), (Shuteriqi, 2005: 309; Sedaj, 1988: 38). Edhe **Zef Krispiti** i përshkruhet merita ta ketë shfrytëzuar këtë informacion më 1853, me rastin e hartimit të librit të tij *Memorie storiche* (Shuteriqi, 2005: 113).

Libri i Buzukut, pas përmendjes së Kazazit, për opinionin shkencor një kohë të gjatë, mbetet në harresë. Informacioni për të do të qarkullojë në formë të mangët deri në vitin 1910, kur Pal Skiroi bën kopjimin e parë (Sedaj, 1988: 38).

(3) Bashkëkohësia rrezatuese

Bashkëkohësia rrezatuese e Mesharit nis me vitin 1910, me përpjekjen e Pal Skiroit, por ndërmarrja e tij u përmyll vetëm brenda atij interesimi dashamirës shkencor, në dashim edhe politik propagandistik sa kishte nevojë 'punëdhënësi'.

Pal Skiroi e rizbuloi për të dytën herë ose e riaktualizoi në qarqet shkencore duke bërë studimin dhe interpretimin e parë të tekstit. Puna e tij pati jehonë të madhe në mjediset shqiptare dhe do t'i vejë në lëvizje forcat intelektuale të fillimit të shekullit XX. Studimi i parë mbi të, si dihet, u bë nga vetë Pal Skiroi, por si i plotë nuk u botua kurrë (Sedaj, 1988: 39 – 40).

Në këtë kohë, më 1910, jepen shkrimet e para nëpër gazetën e atëherëshme shqiptare dhe flitet si për një zbulim epokal, shkruante Faik Konica në gazetën „*Dielli*” të Bostonit (nr. 5, 18 mars 1910). Lajmi jepet edhe në gazetën „*Tomori*” të Elbasanit (nr. 12, 30 qershor 1910).

(4) Bashkëkohësia frytdhënëse

Prap heshtet për një çerek shekulli. Vetëm pas krijimit të shtetit shqiptar *Meshari* i Buzukut, në udhëtimin e tij të gjatë historik u desht të aktualizohet për herë të tretë nga **Justin Rrota**, i cili më 1929 bëri fotografitë e para dhe, në këtë mënyrë, *Meshari* nisi jetën e tij të vërtetë shkencore. *Bashkëkohësia frytdhënëse e Mesharit* nis në vitet e tridhjeta dhe vazhdon deri në vitet e '60 – ta të shekullit XX, kur kurorëzohet me botimin e tetë studimeve monografike nga studiues të mëdhenj të kulturës shqiptare (gjashtë vendës dhe dy të huaj): Norbert Jokli (1930) dhe Mario Roku (1932); Justin Rrota (1930, 1938, 1941, 1958), Eqrem Çabej (1955, 1958) e Selman Riza (1961), Namik Ressuli (1958) e Martin Camaj (1956, 1960) dhe Kolë Ashta (1964 – 1967).

Studimet e para mbi *Mesharin* janë të viteve 1930 – 1932, të dy prijtarëve më të mëdhenj të albanologjisë së midis dy luftërave botërore: austriakut **Norbert Jokël** dhe francezit **Mario Roques**, si dhe i albanologut të njohur shqiptar **Justin Rrota**. Pas tyre vijojnë studime të tjera, si në fushën e gjuhësisë, po ashtu edhe në atë të kulturologjisë. Studimet e para monografike dhe botimet komplete vijnë nga fillimi i gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë.

Namik Ressuli është i pari, i cili arriti në Romë ta botojë *Mesharin* më 1958. Ai *Mesharin* e përgatitur në riprodhim dhe transkriptim (1 – 381), e shoqëroi me një parathënie (V – XIX), me aparat kritik (383 – 388) dhe përmbajtje të teksteve të përkthyer latine (389 – 406).

Pas tij, më 1960, po në Romë, **Martin Camaj**, do ta botojë monografinë e parë, në të cilën do të trajtohen probleme kryesisht gjuhësore të librit të Buzukut. Rexhep Ismajli, duke përshkruar përmbajtjen e këtij studimi të rëndësishëm thotë se libri i Camajt: “përveç Hyrjes, Bibliografisë e Indeksit të fjalëve, kap këtë problematikë: ortografinë, zanorjen hundore,

aspekte të gjuhës së Buzukut dhe ndikime të huaja në gjuhën e Buzukut” (Ismajli, R., 1995: 116).

Më në fund, më 1968, pas dhjetë vjetë pritjeje për botim, dietari më i madh shqiptar, profesor ***Eqrem Çabej***, arrin ta kurorëzojë projektin e punës së tij disavjeçare me botimin e librit të Buzukut në dy vëllime. Libri përcillet me një hyrje shteruese, ku gjerësisht dhe me përgjegjësi të madhe shkencore sheshohen e shoshiten probleme të jetëshkrimit të autorit dhe të jetesës së librit. Të gjitha këto shoqërohen me një studim të thukët gjuhësor, sidomos për fonetikën e Buzukut. Në të trajtohen këto çështje:

Botimi i Tiranës dhe ribotimi i Prishtinës i përgatitur nga profesor Eqrem Çabej, i përcjellë me një hyrje dhe i shoqëruar me të gjitha kërkesat më të avancuara shkencore që janë të nevojshme për botime të kësaj natyre (fotokopjim, transliterim, tejskrim dhe shënime përcjellëse shpjeguese) do të shërbejë për studiuesit e ardhshëm si model shembullor për metodën e punës, mënyrën e përgatitjes së lëndës për lexim dhe për mënyrën e prezantimit e të afirmimit të tij para lexuesit dhe studiuesit të sotëm specialistik e të thjeshtë.

Në këtë kohë, mbi librin e Buzukut, në Shqipëri, krahas Eqrem Çabejit punojnë edhe dy studiues të shquar të albanistikës: Selman Riza (1961) dhe Kolë Ashta (1964), si dhe më parë Injac Zamputi, Mahir Domi dhe Dhimitër Shuteriqi. Punimet e dy të parëve do të botohen në revistat e atëhershme shkencore, kurse si tërësi më vete dritën e botimit do ta shohin shumë vjet më vonë. Punimet e ***Selman Rizës***, ribotohen pas vdekjes së autorit, më 2002 dhe 2004 në Prishtinë dhe në Tiranë. Kurse punimet e ***Kolë Ashtës*** mbi fjalorin e Buzukut, të përcjella me shënime për personalitetin, historinë dhe teknikën e librit të botuara si vëllim më vete, me një vonesë shumë të madhe, do të ribotohen në vitin 1996, në tre vëllime. Ndërkaq punimet e Mahir Domit e të Dhimitër Shuteriqit do të bëhen pjesë përbërëse e *Historisë së letërsisë shqipe I* (1959). Kurse ato të Justin Rrotës (të kësaj periudhe) dhe të Injac Zamputit do të mbesin të shpëradara nëpër revistat shkencore.

Bashkë me këta emra të mëdhenj të shkencës albanistike me Buzukun do të merren brezi tjetër i studiuesve (shqiptarë e të huaj), si Shaban Demiraj, Osman Myderrizi, Idriz Ajeti, Wilfried Fiedleri, Jorgo Bullo, Tomor Osmani, Rexhep Ismajli, Engjëll Sedaj, Emil Lafe, Latif Mulaku, Bahri Beci, Imri Badallaj, Mahmud Hysa, Enver Hysa, Seit Mansaku, Abdullah Zyberi, Shefkije Islamaj, Ethem Likaj, Sabri Hamiti, Abdullah Karjagdiu, Koleç Topalli, Isa Bajçinca dhe shumë të tjerë.

Në vitin 2004, studiuesi i zellshëm ***Wilfried Fiedler***, nën kujdesin e Akademisë së Shkencave të Kosovës do të arrijë ta botojë studimin e shkëlqyer, deri tash më të thelluar dhe më të vëllimshëm (812 faqesh) gjuhësor, në fushën e sistemit foljor të *Mesharit* të Gjon Buzukut. Me të nisin edhe studimet e thukta e shteruese filologjike të gjuhës së autorëve të Pararilindjes Kombëtare.

Në vitin më 2005, në Tiranë Akademia e Shkencave të Shqipërisë (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë) botoi një vëllim antologjik 450 faqesh të studimeve më reprezentative të albanologëve të huaj dhe vendës, nga fillimet e deri më 2005. Aty janë përfshirë, duke përshkruar përmbajtjen e këtij libri antologjik, studimet më të rëndësishme (të plota ose të përzgjedhura, sipas vlerësimit të redaksisë) mbi *Mesharin* e Gjon Buzukut të botuara brenda shekullit XX.

(5) Bashkëkohësia intriguese

Ribotimi i *Mesharit* të Gjon Buzukut në vitin 1988, në Prishtinë shënon nismën e fazës së pestë të jetesës së tij, të cilën do ta quajmë *bashkëkohësi intriguese*. Tanimë ky libër

bëhet pronë e studiuesve të të gjitha niveleve dhe fushave shkencore. Interesimi për të vazhdon të rritet e të përhapet në vitet vijuese të fundshekullit të njëzetë dhe të fillimshekullit XXI, me çka edhe promovohet një hap i ri i perceptimit, i njohjes, i ndriçimit dhe i vlerësimit të traditës së largët kulturore kombëtare, midis të cilave *Meshari* zë kryet e vendit.

Në 440 – vjetorin e botimit, në vitin 1995 do të organizohen konferenca shkencore në Ulqin (19 – 20 maj) dhe në Tiranë (30 – 31 gusht); kurse në 450 – vjetorin e botimit, në vitin 2005 konferenca të këtilla do të organizohen në disa qendra kulturore dhe shkencore albanistike, si në: Prishtinë (17 mars 2005), Tetovë (19 mars 2005), Ulqin (27 dhe 28 maj 2005), Munihi (14 – 15 tetor 2005), Zagreb (18 tetor 2005) dhe Tiranë (18 nëntor 2005).

Nuk guxojmë të lëmë pa përmendur edhe përpjekjen e jashtëzakonshme të Institutit Gethe të Universitetit të Frankfurtit, i cili u përkujdes ta bëjë radhitjen kompjuterike të *Mesharit* sipas botimit të Resselit dhe të Çabejit. Duket se realizimi ka përfunduar në vitin 2003. Me këtë realizim kompjuterik, nis një epokë e re për *Mesharin* – epoka kompjuteristike. Me këtë veprimtari elektronike, megjithë mangësitë e natyrës teknike – gjuhësore, është bërë një punë jashtëzakonisht e madhe ndihmëse për studiuesit. Në këtë mënyrë është lehtësuar puna e tyre për t'u thelluar në studimin edhe të rrafshëve të tjera të këtij monumenti shumë të rëndësishëm të kulturës së shkruar shqiptare.

Përfundim

Jo rastësisht kopjet e para të *Mesharit* të Gjon Buzukut bëhen vetëm pas krijimit të shtetit shqiptar dhe jo pa qëllim, deri në këtë kohë, ai vetëm do të përmendet si një libër i rrallë, i grisur nga vjetërsia. Pra, deri në vitin 1929, kur Justin Rrota, u pajis me dokumentacionin e nevojshëm nga shteti shqiptar, *Meshari* i Gjon Buzukut bënte jetën e tij të një guri të mbuluar nga harresa historike, ndriçimi i të cilit nuk dilte jashtë mureve të dhomës ku rrinte i mbyllur. Pas këtij viti shkëlqimi i rrezatimit të dritës së tij doli nga dhoma ku ruhej si diçka e shenjtë u përhap dhe përfshiu tërë botën. Me të, shqiptarët i dëshmonin botës së qytetëruar se kështu jepnin pjesën e ndihmesë së tyre për ndërtimin e kulturës dhe qytetërimit botëror.

Përkrah përpjekjeve të palodhshme disashekullore të studiuesve (shqiptarë e të huaj) *Meshari* i Gjon Buzukut qëndron krenar, i paluhatur, i grisur (nga koha), i sakatuar (në shtypshkronjë), por dritëdhënës dhe udhërrëfyes. Ai sogjeton si shkëmbmali i palëkundur para stihive të kohërave, i patundur dhe i paluhatur para spicave e ndërskamcave të dashakëqinjve dhe i patrandur para shkatërrimtarëve të të gjitha llojeve. Rri e vështron, pret në heshtje studiuesit e rinj, nuk tërhiqet dhe nuk luhetet të dorëzohet para sfidave të kohës moderne. Pret studiuesit e brezit të internetit, i intrigon ata nga maja e piramidës së kulturës kombëtare shqiptare, por prej atje vigjilon pasardhësit. Pret prej tyre ta kthejnë vështrimin prapa, të shikojnë drejt përpjekjeve të njëjta pesëgjyshi shumë të lashtë dhe të krenohen me të e ta fuqizojnë rrezatimin e dritës së tij.

Recenzentë:
Prof. dr. Vebi Bexheti
Dr. Hamit Xhaferi

KUMTESA

Dr. Hasan MUJAJ: KOMUNIKIMI NDËRKULTUROR SI PROCES INTEGRIMI

Me gjithë arritjet e mëdha që janë shënuar deri më sot në studimet shqiptare të dijeve të ndryshme, hulumtimet shkencore në teorinë e komunikimit sikundër kanë mbetur në periferi të interesimit të dijetarëve të ndryshëm.

Fakti se teoria e komunikimit në studimet perëndimore ka shënuar shkallë të lartë zhvillimi, shtrton mbëhinë (nevojën) e kultivimit të kësaj dijeje edhe në gjuhësinë dhe në kulturën shqiptare.

Komunikimi është ndërveprim social. Ai është kompleks dhe si i tillë përmbledh në vete një spektër të gjerë konstituentësh, të cilët u përkasin shkencave të ndryshme gjuhësore dhe jogjuhësore.

Komunikimi është veprim intensional dhe social i partnerëve folës me anë shenjash gjuhësore ose jogjuhësore, të cilat vihen në funksion kontekstualiteti dhe tekstualiteti për të sajuar komunikim të mirëfilltë. Ai është i lidhur me situatën, zhvillohet si veprim social dhe vihet në funksion të sendërtimit të një synimi; ai është ndërkëmbim ose bartje e informacionit.

Sa i gjerë është nocioni i komunikimit dëshmon edhe shumësia e dijeve që merren me këtë veprim social si p.sh. etnografia e komunikimit, që ndjek komunikimin e grupeve sociale në vendet njëgjuhësore dhe shumëgjuhësore; indeksikaliteti i komunikimit ndiqet nga shumë disiplina dhe subdisiplina shkencore si p.sh. nga stilistika, pragmatika linguistike, semiotika, hermenautika, linguistika interkulturore, gjuhësia e tekstit, sociolinguistika, psikolinguistika, retorika etj. Së këndejmi procesi i komunikimit do parë në dritën e integruar të këtyre shkencave.

Në ndërtimin e tekstit pragmatik të komunikimit duhet të mbahen parasysh faktorët gjuhësorë dhe jogjuhësorë, prania e të cilëve është me rëndësi për komunikimin ndërkulturor dhe ndëretnik.

Nga kjo pikëpamje komunikimi duhet të kundrohet edhe nga këndi i linguistikës kontrastive. Është me interes të trajtohet edhe niveli sociokulturor i komunikimit brenda institucioneve të ndryshme shtetërore, i cili, sidomos në Kosovë, ende është i ulët, i varfër dhe në shpërpjesëtim me kriteret shkencore të komunikimit.

Kultura e komunikimit duhet të ngrihet shumë më lart. Ajo përfshin një varg përbërësish, të cilët duhet të mbahen parasysh në komunikimin gojor dhe shkrimor.

Në procesin e komunikimit gojor, në shumë raste, madje edhe në institucionet më të larta shtetërore, nga zyrtarët më të lartë, mund të vihet re komunikim jashtë standardit gjuhësor-shkencor e kulturor;

komunikim varietetesh në ndikimin e treguesve diatopikë dhe diastratikë tek dallohen: nyjëtimi rajonal i tingujve dhe i fjalëve si rrjedhojë e mosnjohjes së kritereve fonetike-fonologjike, e mosnjohjes së ortoepisë dhe pozicionit që marrin organet artikulimit të tingujve gjuhësorë në aparatën e të folurit, mungesa e kulturës politolinguistike në debate të ndryshme në medie dhe në raste të tjera, ngarendja pas termash të huaj pa e ditur mirë domethënien e tyre, përdorimi i gabueshëm i semantikës së fjalëve si p.sh. ndërtimet “**po kyçem në diskutim, u kyç në debat**” etj. që vërshojnë mediet dhe diskutimet publike në Kosovë, prozodia e gabueshme në lloje të

2

ndryshme komunikimesh, varfëria stilistike dhe leksikore, mungesa e kognicionit etj., të meta këto të mëdha, që e zvetënojnë tekstin e komunikimit ndërkulturor dhe sociokulturor. Në vitet e 70-80-ta lindi teoria sociologjike e komunikimit nga dietari Niklas Luhmann, i cili thekson: “Der Mensch kann nicht kommunizieren; nur die Kommunikation kann kommunizieren.” D.m.th. së pari kognicioni për fenomenin për të pasur bazën e veprimit komunikativ për ndërtimin e tekstit të komunikimit.

Komunikimi do parë nga dy aspekte:

1. nga aspekti ndërveprues i pjesëmarrësve të këtij procesi nga i cili varet edhe mënyra e zhvillimit të komunikimit: kureshtja kognitive, kreativiteti, sfera e interesimit, tema, qëllimi etj. dhe

2. nga aspekti shkencor i ndërtimit të tekstit të komunikimit, ndërtimi i të cilit është mjaft kompleks; komunikimi paraqet një sistem shenjash. Me terminologjinë e Sosyrit do të mund të thuhet **shenjues dhe të shenjuar** të strukturuar nga koherenca dhe kongruenca tekstore ose, me terminologjinë e Çomskit, **kompetencë dhe performancë** për të krijuar një ndërveprim social që quhet komunikim.

Aspekti shkencor i komunikimit kap edhe përbërës të tjerë me interes për sendërtimin funksional të komunikimit. Një nga këta përbërës është edhe dinamika e komunikimit, e cila zbatohet përmes anës fonike të leksemave. Kështu në rrafshin e fonostilistikës dinamika e komunikimit ngrihet përmes **asonancës, aliteracionit, rimës, anaforës** etj.

Një shtysë tjetër e dinamikës së komunikimit është edhe topika e njëjësive gjuhësore. Se me cilën fjalë do ta fillojë komunikimin folësi, varet nga situata, zhvillimi i komunikimit, gjendja afektive e partnerëve etj. Nga stilistika gjuhësore, nga sintaksostilistika, është e ditur se edhe **inversioni dhe paralelizmi** janë shtysa nxitëse të dinamikës së komunikimit. Fjala me domethënie më të madhe për autorin vihet në fillim të njësisë gjuhësore pasi fillimi i fjalisë është shumë më i spikatur sesa mesi.

Rëndësi të madhe në procesin e komunikimit ka zgjedhja e mjeteve gjuhësore në përputhje me situatën dhe me temën e bisedës. Akribia kognitive dijesh të ndryshme gjuhësore dhe jogjuhësore ofron mundësi më të gjera zgjedhjeje të mjeteve gjuhësore për të shprehur mendimin. Edhe pragmalinguistika luan rol të rëndësishëm në këtë pikëpamje. Situata e komunikimit është një nga faktorët e rëndësishëm eksternë të këtij ndërveprimi.

Në veprimin e komunikimit është me interes që dëgjuesi jo vetëm të kuptojë të shprehurën e partnerit folës, porse të zbulojë edhe synimin parësor të bashkëfolësit, d.m.th. ta hetojë edhe të

pashprehurën, por të menduarën, të nënkuptuarën. Kjo, gjatë komunikimit, mund të nënkuptohet nga dy tregues kryesorë:

1. përmes zbërthimit konotativ të së shprehurës dhe

2. me anë të indeksikalitetit joverbal që nënkupton “gjuhën” e trupit (gjer. Körpersprache). Në çdo komunikim duhet të shihen intensionin dhe ekstensionin, si dy faktorë përbërës të komunikimit.

Studiuesi Peter Ernst me të drejtë komunikimin e trajton të lidhur ngushtë me stilin. Ai shkruan: “Stil ist ein Phänomen der Kommunikation, ist Ziel, Resultat und Element kommunikativen Handelns.” 1)

Stili është mjet i zbatimit të komunikimit. Ky mjet mbështetet në dy parime kryesore:

3

1. **seleksionimi** dhe

2. **kombinimi**. Këto parime themelore, tok me përbërës të tjerë, duhet të mbahen parasysh përherë me qëllim të realizimit të komunikimit pragmatik, andaj komunikimi duhet të ndiqet edhe nga stilistika, të cilën Charl Bali 2) e futi në linguistikë si dije që heton intensionin afektiv të komunikimit.

Interes hulumtimi paraqesin edhe disa deiktikë të komunikimit si p.sh. intonacioni, koherenca tekstore, kohezioni, përsëritja funksionale, sociofonetika, metaforika, paralelizmi, inversioni, sinonimia, aspekti fonostilistik i komunikimit, pasuria leksikore, shprehësia e stilit, komunikimi si shprehje e kulturës, polisemia etj.

Nga ky kënd vështrimi, studimi i këtyre treguesve është me rëndësi të veçantë për veprimtarinë gjuhësore siç e quante Charl Bali të folurit.

Është meritë e Sosyrit që fonetikës i dha dimension të ri: atë e quajti “shkencë e të folurit” 3) për të cilin emërtim ai kishte përdorur shprehjen “linguistikë e të folurit”. Nga kjo pikëpamje Bali e vëzhgoi termin “intonacion” si element të domosdoshëm të realizimit të të folurit dhe si tërësi vlerash të variantit të folur të gjuhës. Ai e vuri re drejt dallimin midis nyjëtimit dhe intonacionit-këtyre dy treguesve të realizimit të komunikimit. Nyjëtimi, që mund të jetë dialektor, patologjik etj., dëfton folësin, por jo përmbajtjen e të folurit, bartës i së cilës është intonacioni.

Gjuha është pjesë përbërëse e kulturës, andaj faktorët relevantë të komunikimit i përkasin kulturës. Studimi i simbiozës specifike gjuhë-kulturë, në hulumtimet e gjermanistikës, solli konstituimin e një subdisipline të re që u quajt linguistikë interkulturore, por edhe komunikim interkulturore.

Komunikimi duhet të vështrohet në bashkërendim me kulturën. Helmut Glyk vë re se gjuha dhe komunikimi janë pjesë të kulturës.

Komunikimi ndërkulturore është degë e linguistikës interkulturore. Ai nuk duhet të jetë vetëm interesim i studiuesve, por edhe i politikës së institucioneve shtetërore. Gjuha e pakicave nacionale duhet të përligjet edhe në përdorimin zyrtar duke krijuar mundësi më të favorshme integrimi. Madje, për këtë qëllim, në shumë shtete si p. sh. në Kanada, Belgjikë, Francë etj. janë themeluar komisione të veçanta në kuadër të ministrive, të cilave u vihet si detyrë që të merren me planifikimin gjuhësor dhe me komunikimin ndërkulturore, komunikim ky që, sipas të dhënave empirike, është një variant i linguistikës kontrastive.

Hulumtimi i komunikimit ndërkulturore është me shumë interes edhe për mënjanimin e konflikteve të ndryshme brendaetnike dhe ndëretnike.

Me të drejtë është thënë se terminologjia dhe përdorimi funksional i saj, në komunikimin publik-zyrtar, janë aq të rëndësishme për oratorin sa edhe busulla për drejtuesin e anijes. Filozofi i njohur Mishel Fuko 4) ka theksuar se mendimi në semiotikë është strategji e gjuhës: denotacion dhe konotacion.

Komunikimi është mjet efikas edhe për pajtueshmëri dhe zhvillim. Ai është veprim kompleks, i cili do hulumtim dijesh të ndryshme; ai është sendërtim i të folurit, përbërës të të cilit, sipas studiuesit P. Guberina 5) , janë: mjetet leksikore, situata, konteksti, aspekti psikologjik i të folurit, motivi i folësit, vlera e njësive gjuhësore, reaksioni i oratorit dhe afektiviteti etj.

4

Kohën e fundit është ngritur interesimi për studimin e anës vizuale të komunikimit si p.sh. paraqitja në medie, TV, reklama, portrete liderësh etj. madje për këtë komponent të komunikimit u krijua një nëndisiplinë shkencore e quajtur teoria e komunikimit vizual.

Komunikimi është formë e veçantë sjelljeje. Ai nuk gjendet vetëm në mjetet gjuhësore, porse ndiqet edhe nga deiktikët jogjuhësorë: qëndrimi i trupit, mimika, veshja, lëvizjet e duarve, shikimi, lëvizja e syve, pjesëmarrësit në komunikim, mosha, gjinia, statusi social, koha, vendi, tema, stili, zgjedhja e fjalëve, varieteti, sociofonetika, heshtja, përsëritja etj. që studiuesit gjermanë i quajnë “shenja shtuese” (zusatzliche Zeichen).

Teoria e komunikimit në Kosovë

Komunikimi në nivel shteti është përfaqësim i shtetit, i vendit, i kulturës, i vlerave kombëtare etj. Ai duhet të ngrihet shumë më lart, të zhvillohet, të pasurohet dhe të përmirësohet në gjithë përbërësit e tij dhe në të gjitha sferat e përdorimit zyrtar dhe privat.

Në Kosovë zhvillohet një komunikim i thukët interkulturor për integrimin e pakicave në fusha të ndryshme të jetës, të arsimit, të kulturës etj. Shqiptarët nuk i pengon gjuha e tjetrit. As kultura. As historia. Edhe pse shumicë në Kosovë, ata i mësojnë dhe i flasin edhe gjuhët e të tjerëve si një nga format më konkrete të përafrimit dhe të ndërkomunikimit midis nacionalitetesh të ndryshme si tregues të respektimit të ndërsjellë dhe të bashkëpunimit interkulturor.

Në praktikën komunikative të Kosovës kultivohet komunikimi ndërkulturor. Kështu p.sh. studentët e minoritetit boshnjak të Fakultetit të Shkencave Aplikative në Pejë, me kërkesën e tyre, e mësojnë gjuhën shqipe si lëndë të obligueshme tri orë në javë dhe janë të integruar me kolegët e tyre shqiptarë. Ata flasin, lexojnë dhe shkruajnë në gjuhën shqipe ashtu sikundër edhe shqiptarët komunikojnë në gjuhën boshnjake, turke etj. Duke e ditur gjuhën shqipe, të rinjtë e minoritetit boshnjak marrin pjesë edhe në manifestime të ndryshme kulturore, sportive etj. me të rinjtë shqiptarë. Ky konstatim vlen edhe për nacionalitetin turk, por jo edhe për minoritetin serb, i cili, duke vepruar sipas diktatit politik të Beogradit, me disa përjashtime, refuzon komunikimin dhe integrimin në institucionet e Kosovës.

Refuzimi i komunikimit për t'i zgjidhur problemet me dialog shpeshherë në shumë vende ka sjellë konflikte dhe madje luftëra ndëretnike si në rastin e Kosovës. Shqiptarët vite të tëra kërkuan komunikim pragmatik dhe konstruktiv me Beogradin zyrtar për të zgjidhur statusin

politik të Kosovës, por politika serbe u përcaktua për "komunikim" dhune, të cilin e ndjek edhe sot, sidomos në pjesën veriore të Kosovës.

Mund të thuhet se teorisë së komunikimit në Kosovë nuk i kushtohet vëmendje e duhur në institucionet shtetërore, andaj, te pjesa dërrmuese e oratorëve, vihet re deficit i madh leksikor, gjuhësor, gramatikor, stilistik, semantik, sociolinguistik, sociokulturor, pragmalinguistik etj. Ky deficit i kompetencës komunikative është i pranishëm në instancat më të larta shtetërore të vendit.

Ja disa shembuj të komunikimit të shtetarëve përpara medieve dhe opinionit të gjerë: "Ne sot po i **dhomë** kuptim të ri..." (për japim), "debati ka fillu...", me pohu; asht dashtë me kundërshtu..., asht bo ni punë..., do të jem i shkurtër (kalk nga serbishtja), u kërkoke..., çka bojne ata... etj. Te pjesa më e madhe e zyrtarëve të institucioneve të larta shtetërore mund të dëgjohet nyjëtimi i tingujve, rrokjeve e fjalëve në shpërpjesëtim me kriteret drejtshqiptimore dhe nën ndikimin diatopik e diastratik të përdorimit të gjuhës. Kështu e-ja në pozicionin midis dy konsonanteve

5

hundore **m-n**, nga shtysat dialektore, del me ngjyrim nazaliteti p.sh. dokumente, argumente, instrumente etj.

Shkrija e togjeve zanore: **ue, ua, ie, ye** në sistemin emëror e foljor në rastet kur duhet të ruhen të plota p.sh. dilli, m'susi, ka mendu, në dur, asht thy etj. Nyjëtsimi në nyjëtim i afrikateve dhe i palataleve: **ç, xh: q, gj** etj.

Përdorimi i trajtave të këtylla dialektore në gjuhën standarde është një tregues i komunikimit rajonal dhe i kulturës së pamjaftueshme gjuhësore që e zbrit kompetencën komunikative nga pikëpamja e komponentit linguistik.

Për arsyet e sipërshtuara dhe në interesin e zhvillimit të kulturës së komunikimit, mendojmë se institucionet kompetente shtetërore duhet të ndërmarrin masa përmirësuese në këtë pikëpamje si p.sh. futja e lëndës: Teoria e komunikimit në programet shkollore etj.

Recenzentë :
Prof. dr. Adem Hajdaraj
Prof. as. dr. Xheladin Zymeraj

KUMTESA

Doc. Dr. Valbona TOSKA: MOHIMI SI KOMPONENT SEMANTIK (DHE PRAGMATIK)

Në këtë kumtesë do të përpiqemi të përcaktojmë vendin e mohimit në strukturën e tekstit, si dhe të ofrojmë interpretimin e tij varësisht nga konteksti semantik dhe pragmatik.

Edhe pse mohimi shqyrtohet shpesh edhe nga aspektet e filozofisë dhe të logjikës, në këtë qasje ajo që ka ndonjë lidhje me këto disiplina shkencore mund të jetë vetëm hamendja çfarë në fakt mohojmë – a e mohojmë vërtetësinë (përshtatshmërinë e faktetve) e një gjendjeje të caktuar të gjërave (angl. *state of affairs*), përkatësisht a e mohojmë ekzistimin e asaj gjendjeje ose, e mohojmë vërtetësinë/përshtatshmërinë e porosisë gjuhësore që e pasqyron atë gjendje. Me fjalë të tjera, mbi çdo porosi tonën gjuhësore ne „lexojmë” edhe elementin ‘pohoj se...’, ‘them se ...’, ‘e di se ...’ ‘mendoj se...’, ‘dua të ...’, ‘nuk dua të...’ etj. Në rastin tonë rëndësi ka porosia gjuhësore.

Në rrafshin gjuhësor **treguesit e mohimit**: 1. mund të paraqiten në **nivelin sintaksor** të strukturës së fjalisë dhe 2. të jenë **morfologjikë**, zakonisht parashtesat *pa-*, *mos-*, *ç-*, *sh-*, *zh-*, *jo-*, *a-*, *i(n)-* etj¹. Mohimi gjithashtu mund të shprehet edhe me fjalë që në kuptimin e tyre leksikor përmbajnë mohim **pa pasur ndonjë tregues formal** (*i verbër, refuzon*).

Në qendër të vëmendjes në këtë artikull janë ndërtimet me tregues sintaksorë të mohimit, përkatësisht ndërtimet, në të cilat mohimi i aneksohet drejtpërdrejt dhe në mënyrë eksplicite kallëzuesit. Në këtë pozitë, mohimi ndikon drejtpërdrejt në karakterin e porosisë. Modeli i analizës së bërë mbështetet në studimin e Z. Toplinjskës mbi mohimin (Z. Toplinjska 2009). Kështu, identifikohen fjali të ndërtuara nga **kallëzues të rangut të parë** (kallëzues, argumentët e të cilëve kanë referentë pjesë nga bota materiale ose kallëzues të cilët entitetëve të caktuar u japin cilësi të caktuara: *Artani bleu shtëpi* ose *Ajo vajzë është e mirë*), **të rangut të dytë** (kallëzues që i pasqyrojnë gjendjet mentale të njerëzve dhe si argumentë lidhin pikërisht njerëzit dhe brendinë e gjykimeve, ndjenjave... të tyre: *Artani planifikon të shkojë në det*) dhe **të rangut të tretë** (kallëzues që pasqyrojnë mekanizmat/mënyrat e mendimit tonë për botën, rrjedhën e konkluzave tona dhe, kështu pranojnë vetëm argumentë propozicionalë; në sipërfaqe të tekstit më shpesh paraqiten si lidhëza, rallë si folje ose si nominalizime: *Nuk erdha sepse djali ishte i sëmurë* ~ *Sëmundja e djalit ishte shkak që nuk erdha*).

Konkretisht do të përqëndrohemi vetëm te kallëzuesit e rangut të parë, në mënyrë që të arrijmë t'i ilustrojmë disa nga funksionet e mohimit.

Në gjuhën shqipe mjetet më të zakonshme të mohimit që gjithmonë qëndrojnë para foljes-kallëzues janë pjesëzat mohuese **nuk** dhe **s**. Në këtë pozicion qëndron edhe pjesëza **mos**, kurse pjesëzat **as** dhe **pa**, përveç pozicionit para kallëzuesit, mund të qëndrojnë edhe para gjymtyrëve të tjera.

Mohimi në fjali me kallëzues të rangut të parë

Në diskurs mohimi zakonisht është një reagim ndaj asaj që e kuptojmë më herët ose nga bashkëbiseduesi ose nga ndonjë burim tjetër. Ai ka të bëjë me informatën për atë që (nuk) ka ndodhur në botën reale ose me informatën për atë që – sipas dëshirës, paramendimit, prognozës së bartësit të porosisë – nuk do të ishte dashur të ndodhë në botën virtuale.

Mohimi nuk paraqet thjesht një kundërvënie të fjalisë pohore, pra nuk bëhet fjalë vetëm për praninë e elementit të mohimit. Ky raport është shumë më i komplikuar, varet nga konteksti verbal dhe situativ dhe prandaj nuk lejon të formulohen rregulla të përgjithshme. Në parim, mohimi përveç kategori semantike është edhe kategori pragmatike. Rrjedhimisht, duhet të jemi të vetëdijshëm se për përdorimin e fjalive mohore nevojiten kushte të posaçme kontekstuale.

Që në fillim duhet të themi se parafrazimi i një thënie në logjikë dallon nga ai në gjuhësi. Përderisa parafraza ‘*nuk është e vërtetë se ...*’ pa elementin e modalitetit është korrekte për pohimet shkecore (*një plus një nuk bëjnë tre – ‘nuk është e vërtetë se një plus një bëjnë tre*’), po kjo parafrazë nuk mjafton për të pasqyruar mohimin në diskursin e përditshëm, e natyrshëm. Për të parafrazuar p.sh. ndonjë supozim tonin do të duhet të përfshijmë edhe kallëzuesinë e nënkuptuar. Kështu parafraza e fjalisë *Ai si duket nuk ka arritur në kohë* do të kishte qenë ‘*Si duket nuk është e vërtetë se ai ka arritur në kohë*’.

Kur me kallëzuesin përshkruajmë ndonjë cilësi/vlerësim, përkatësisht kur kemi kallëzues emëror treguesi formal i mohimit vendoset para këpujës. Ka dallim të rëndësishëm semantik mes ndërtimeve me kallëzues që si pjesë emërore kanë një mbiemër dhe ndërtimeve, në të cilat mohimi gjendet në strukturën morfologjike të kallëzuesit: *Artani nuk është simpatik kundrejt Artani është josimpatik*. Zakonisht kallëzuesi i mohuar shpreh një intensitet më të fortë të cilësisë përkatëse edhe pse kjo nuk mund të merret si rregull, krh. *Nuk është e mundur ~ Është e pamundur* (Xh. Gosturani 1976: 38).

Derisa te fjalitë e ndërtuara me kallëzues të rangut të parë elementi virtual (i nënkuptuar) që i shtohet mohimit zakonisht interpretohet si “e di se (nuk është e vërtetë...)”, ose “pohoj se (nuk është e vërtetë...)”, te disa kallëzues që emërtojnë veti psikike të njerëzve, si *i mirë, i mençur* etj., ose qëndrimin emocional të folësit për njerëzit e tjerë si *i këndshëm, i padurueshëm* etj. është më e drejtë që parafraza ‘e di se ...’, të zëvendësohet ‘me mendoj se...’.

Në ndërtimet, në të cilat brendia e fjalisë mohohet edhe duke mohuar komponentë të veçantë të strukturës së saj, krahas treguesit sintaksor që gjendet para kallëzuesit, paraqiten edhe tregues morfologjikë, përkatësisht fjalë që përmbajnë mohim në kuptimin e tyre gramatikor. Më e zakonshme është që mohimi i këtyre elementeve të veçanta, apo theksimi ekspresiv i tyre të bëhet me përemra (*askush, asnjë, asgjë...*) dhe ndajfolje (*asnjëherë, askund...*) ku mohimi i komponentëve të caktuar tërheq mohimin e fjalisë si tërësi: *Askush*

nga studentët nuk e lexon shtypin. Asnjëherë nuk kam qenë në Shkodër. Në këto raste kemi mohim të elementeve të veçanta: referent dhe fragment hapësiror (vend). Mohimi madje mund të paraqitet në më shumë pozicione sintaksore *Askush nuk tha asnjë fjalë asnjëherë*. Një situatë pak më të komplikuar në raport me mohimin kemi te përemrat si *të gjithë, çdokush...*: *Jo të gjithë nuk dëgjonin*. Në këtë rast sikur kemi të bëjmë me ndonjë reagim ndaj ndonjë vërejtje të dhënë më parë prej dikujt tjetër.

Me disa struktura të mohimit emërtohet ajo që sipas folësit paraqet informatë të vërtetë si zëvendësim, alternativë për atë që mohohet: *Artani nuk e pastron oborrin, vetëm e ujit barin*. Parafrazimi i kësaj fjalie do të kishte qenë: 'Nuk është e vërtetë se *p*, e vërtetë *q*'.

Mohimi i porosive për botën virtuale në fakt paraqet mohim të argumentëve të kallëzuesve virtualë të rangut të dytë. Këta kallëzues janë joverbalë, nuk janë të ekspozuar në tekst. Këtu argument i parë, pikënisja është njeriu, mendimet, deklaratat, vlerësimet e të cilit paraqesin brendinë e argumentit të dytë i cili është propozicional. Kështu p.sh. fjalinë *Nuk do ta jap librin*, varësisht nga konteksti i përdorimit do ta interpretojmë (*Vendosa se*) *nuk do ta...*, (*Mendoj se*) *nuk do ta...*

Në disa fjali të mohimit, folësi mund të shprehë distancë nga porosia, në kuptim të asaj se nuk do të marrë përgjegjësi për vërtetësinë e asaj që thuhet (porosinë e ka dëgjuar nga dikush tjetër ose porosia është produkt i dedukcionit mbi bazë të fakteve të njohura): *Ata nuk qenkan mbledhur për të diskutuar* apo informatën e marrë ta vlerësojë si pak të mundshme, të befashmë, të habitet, ta ironizojë: *Ai nuk qenka banor i Shkupit?!*. Në rastin e parë interpretimi i mohimit bëhet me parafrazimet: '*Nuk di nëse është e vërtetë se...*', si dhe '*Nuk jam i sigurt nëse...*', '*Më duket se...*', '*Kam dëgjuar se...*', kurse në rastin e dytë '*Nuk më besohet se është e vërtetë se*', si dhe '*Më befason...*', '*Nuk besoj se është e mundur...*' etj.

Mohimi në strukturat që hapin mundësinë e paraqitjes së dyshimit për sigurinë e realizimit të ndonjë veprimi mund të parafrazohet si '*X supozon se nuk është e vërtetë/nuk do të bëhet e vërtetë p*': *Ajo nuk do të arrijë në kohë, Megjithatë nesër nuk do të shkoj në Tetovë*.

Në fjalitë ku ka tregues gramatikorë të modalitetit deontik (mënyra dëshirore dhe urdhërore) faktori pragmatik luan rol të rëndësishëm. Këtu elementi i ngërthyer në parafrazimin/interpretimin e strukturave të mohimit do të kishte qenë folja *dua*, përkatësisht *nuk dua* – 'nuk dua të bëhet e vërtetë...'. Konteksti mund të lejojë që kjo parafrazë të lexohet edhe si 'ndaloj, anulohet, nuk lejohet...': *Mos pafsh ditë të keqe! Mos qoftë! Mos fol! Mos të të shoh më këtu! Mos kini merak!* Siç shihet me këto struktura mund të shprehen urime, mallkime, urdhëra, qortime, kërcënime, paralajmërime, këshilla, lutje, kërkesa etj.

Në dialogun e drejtpërdrejtë treguesit e mohimit janë shpesh të paparashikueshëm, shumë pragmatikë dhe të motivuar emocionalisht: *Do të vijnë? Vetëm po të vdes unë!*

Siç shihet variacionet e interpretimit të mohimit varen nga konteksti semantik dhe pragmatik. Në fund dua të them se qëllimi i parashtrimit të çështjes së mohimit nga aspekti semantik i interpretimit të tekstit është vetëm të prezantojë një model të mundshëm të qasjes.

KUMTESA

**Dr. Meli SHOPI¹, Dr.RUDINA MITA¹: HAFIZ ALI KORÇA, PERSONALITET I
ARSIMIT, KULTURËS E GJUHËS SHQIPE**

¹Universiteti "A.Xhuvani" Elbasan

Për një shpirt të madh profetik, fluturimi i tij në hapësirë s'është gjë e pamundur, sepse ato (shpirtërat profetikë) zhvishen prej gjendjes njerëzore, shpirtërisht dhe engjullisht fluturojnë më shpejt se vetëtimja. Pa përjashtim gjithë profetët kështu janë.¹

Fjalë dhe ide këto të njeriut të Zotit, njeriut të mendjeve të ndritura, fisnike e plot kulturë, patriotit Hafiz Ali Korça. Të shkruash për figura të tilla historike, patriotike, me vlera kulturore, gjuhësore e shumë të rralla publicistike etj., nuk është e lehtë, sidomos për atë që kanë qenë apo përfaqësojë. Ajo që shërbeu për të si shembull, për të qenë dikushi në jetë është marrja model e jetesës, veprimtarisë, sjelljes, etikës dhe e veprave të njerëzve të shquar të kombit, rruga e të cilëve ka qenë dhe mbetet ndriçuese për zhvillimin e progresin human.

I lënë në harresë nga diktatura, ajo u mundua t'i mënjanonte këto vlera të rralla e të vyera të traditës shqiptare, nga rrethi intelektual zyrtar. Por koha dhe e vërteta nuk i la të mos dilnin në dritë, të merrnin përmasa gjigande e të vendoseshin në radhën e atyre që sot brezat i kanë studiuar dhe i kanë përjetësuar. Puna dhe përpjekja e intelektualëve shqiptarë, sidomos pas viteve '90 për të nxjerrë në pah këto vlera të pazbuluara, përbën një angazhim qytetar e kulturor. Ato vijnë para lexuesit si autorë të veprave filozofike, teologjike, gramatikore e përkthime, bashkë me veprimtarinë e tyre në të gjitha fushat.

I tillë ishte edhe Hafiz Ali Korça. Ai vinte nga një mjedis tipik patriotik, fetar, kulturor, korçar. Veprimtaria e tij: kulturë, fe dhe publicistikë etj., ishte si e të gjithë atyre që ndoqën rrugën për t'iu përkushtuar popullit, interesave dhe çështjeve kombëtare. Çdo fjalë e dalë nga goja e tij apo e shkruar nga dora e palodhur do të gjente mbështetjen dhe besimin e të gjitha shtresave shoqërore të asaj kohe. Ky lider ishte padyshim një oqean i madh i mendimeve fisnike dhe përparimtare, të cilat na ndjekin në vargjet e çdo krijimi. Shkrimet e Hafiz Aliut përbëjnë një moment tranzitor nga Rilindja në letërsinë e Pavarësisë ku tiparet e saj janë më të spikatura, edhe pse veprimtaria e tij, sikur kufizohet gjatë gjysmës së parë të shek.XX(1900-1944). Ai do të radhitej në vazhden e atyre mendjendriturve që do të quheshin **-rilindas-** si një letrar e patriot për çështjen kombëtare, me vargjet:

... O mëmëz -o halle- madhe, ç'gjëmë e zezë të ka zënë,
Bijt' e tu s'mentohen fare rrugëvet të kanë lënë,
Të pamëshirçmit s'të shohin nuk kujdesen për ty fare,
Të kanë lënë të shkretë, zhveshur, e pa ngrënë...

ose

... Qani vëllezër Kosovën qani!
Për gjëmëzezën ca ditë zi mbani
.....
Qani Kosovën dhe Çamërinë

Se i këmbëjnë si bagëtinë!

Në shkrimet e Hafiz Ali Korçës do të spikatin dukshëm idetë e qarta, interesat kombëtare për vendin e atdheun e tij. Edhe pse një fetar mysliman, në radhë të parë do të ishte një atdhetar me domosdoshmërinë e kuptimit të qartë të raporteve komb dhe fe. *“Gjithë sahabet ishin fetarë të sakët. Secili prej syresh atdhetar m’i flakët!”*¹Në veprën *“Shtatë ëndërrat e Shqipërisë”* ai do të përshkruante rrugën e luftës së shqiptarëve për liri, luftë së cilës ai i qe përkushtuar totalisht. Ai e shihte me dhimbje copëzimin e Shqipërisë. Midis të tjerave ai do të shprehet:

“Ata që mendonin të ardhmen derthnin lot gjaku e iu dridhej buza kur kujtonin copëtimin e paracaktuar...”

“Atdhetarët e çmueshëm duke vënë vdekjen në syt, themeluan shoqërinë e fshehtë “Ittihat ve Tereki”, (“Bashkim e Përparim”) më 1908 në Manastir.

Jo vetëm shkrimet, por edhe marrja pjesë në krye të çetës devollite në vitin e parë të shek.XX, do të qëndrojnë në mes të bashkëluftëtarëve me parrullën në dorë: *“Shqipëri A Vdekje”*.

Në shkrimet e tij, sidomos ato publicistike, pasqyrohej drejtpërsëdrejti njohja dhe kompetenca e tij jo vetëm në fushën e politikës dhe të së drejtës, por edhe si historian, psikolog, etj. Tematikës së tij të larmishme i duhen shtuar edhe motivet e idetë domethënëse si: atdhedashuria, drejtësia njerëzore, humanizmi, tezat shkencore, kujdesi i tij i vazhdueshëm për të mbrojtur interesat e islamit botëror etj. Tema qendrore në disa shkrime të tij ishte edhe gjuha shqipe, një nga problemet më të mëdha të kohës. Ai do të shkruante:

“Nuk duhet të mbushim gjuhën tonë engjullore me gjemba e me ferra se nuk i qërojmë dotë më vonë.”

Domethënia e kësaj ideje kuptohet më së miri. Ruajtja e gjuhës nga ndikimet e gjuhëve të tjera, lufta dhe përpjekja për ta mbajtur të pastër, patjetër që do të ishte pjesë e punës së Hafiz Ali Korçës, si mësues i gjuhës shqipe. Ai do të jepte mësimet falas në shkollën shqipe të djemve në Korçë, etj.

Hafiz Ali Korça shkruan një shqipe të pastër, shumë afër normës së sotme në të gjitha planet ku herë-herë ndihet edhe atmosfera e të folmeve të Korçës, vendlindjes së tij.¹Duke qenë ndër pedagogët e parë të Mësonjëtores, organizues i komisionit *“Përparimi”* për pastrimin e gjuhës shqipe nga fjalët e huaja, Hafiz Ali Korça mori shkas të botonte *“Shtatë ëndërrat e Shqipërisë”*.Me intelektualizmin e tij në shërbim të njerëzve dhe të kombit ai do të japë ndihmesën e tij në ato fusha ku politika do të ishte e pafuqishme ta pengonte: në kultivimin e njerëzve dhe botës shpirtërore të tyre, me vlerat e mirëfillta kulturore e kombëtare. Arma me të cilën do të luftonte ishte arsimimi, kultura, përkthimi dhe intelekti.Me mbarimin e shkollës do të ishte një njohës i mirë i gjuhës turke, perse, arabe dhe frënge. Pjesëmarrja në pesë Kongrese do të shfaqë edhe një herë potencialin e tij intelektual:

- në Kongresin e Manastirit në përpjekje për një abetare unike;
- në Kongresin e Dibrës në përpjekje për një Shqipëri etnike;
- në Kongresin e Elbasanit gjuha shqipe nisi të merrte udhë, etj.

Deputetë të asaj kohe, bashkëkohës të H.A.Korçës kanë treguar se ai ishte një njeri i nderuar dhe kishin dashur ta dënonin me vdekje, sepse përhapte farën e gjuhës shqipe.Megjithatë vazhdoi punën dhe veprimtarinë e vet pa kurrfarë tronditjeje e luhatjeje, duke shkruar edhe abetaren me gërma latine. Këtë abetare e botoi po atë vit. Në të paraqitej së pari një pasqyrë abeice me gërmat e shoqërisë së shkronjave e pas saj një pasqyrë abeice e ndërtuar tërësisht prej shkronjash latine. Kurse në faqen 24 të saj një pasqyrë

tjetër, ku krahas gërmave të atyre dy pasqyrave, shënohen edhe shenjat përgjegjëse greqisht e osmanisht. Të 23 faqet e tjera, abetarja i ka të mbushura me shkrime të ndryshme mësimdhënëse.

Fletorja “Aksisada” ndër të tjera shkruante:

“Shkrimtari me famë, z.Hafiz Ali Korça, i cili me shkrimet e bukura letrare po na zbukuronte herë pas here shtyllat e fletores sonë, meqë ishte anëtar e përhapës i shkronjave latine, u dënua me vdekje nga gjyqi politik i Stambollit...”ose

...Të dërguarin Hafiz Alinë që ish mësonjës n'idadie të këtushme e pushuan nga puna se qe anëtar i shkronjave shqipe. Me gjithë që imami s'ishte dhe aqë kamës s'e prishi fare zemërën, mund të themi se u kënaq q'e nxuarë nga puna.

Hafëz Aliu ka përgatitur një tok libra dhe tani shpejt po i shtyp...¹

Konceptet përparuese mbi gjuhën shqipe, vlerën dhe funksionet e saj do të gjejnë pasqyrim në punën për Gramatikën¹, në fushën e përkthimit¹ dhe në krijimin e poezive.¹

Duke qenë një vazhdues i denjë i rrugës së Fishtës dhe të Naimit, i papajtueshëm me kompromiset apo politikat e kohës do të shkruajë vazhdimisht në shtypin që dilte në atë periudhë e, sidomos në gazetën “Korça”, në mbrojtje të abece-së dhe të çështjes kombëtare në tërësi. Jo vetëm kaq, por përmes këtyre shkrimeve e vjershave, tregohet përkushtimi ndaj studimit të gjuhës shqipe, rolit dhe vlerave të saj. Ndihet gjithashtu, shqetësimi i njeriut të nderuar për shqiptarët, shkollimin e tyre, por sidomos në gjuhën amtare. Veçoritë e shkrimeve të Hafizit i përgjigjen stadi të zhvillimit të gjuhës e të letërsisë shqipe të asaj periudhe, kur punoi e veproi. I vëmendshëm në fushën e ortografisë, respekton rregullat deri atëherë të pranuar përballë problemeve të asaj kohe. Fjalori i pasur dhe figurat letrare me burim nga goja e popullit i japin bukuri të veçantë poezisë dhe prozës së tij.

*“Njeriu vetëm me gjuhë të tij mund të vejë përpara...
me gjuhë të huaja kjo s'mund të bëhet kurrë...”¹*

Se në tërësinë e këtyre problemeve që kërkonte koha, ai nuk do të mëngojë pa shpjeguar:

“Po s'mësuam mjeshtëria, po s'ditëm si bëhet baruti, si bëhet pushka, si bëhet topi m'i qeruar e m'i shpejtë që ta hedhin plumbin e gjylen më larg se prej armëve të armiqve, si bëhet anija e zjarrtë e luftës, me se do të mbrojmë mëmëdhenë? Dhe tërë këto mjeshtëri s'mund të përvetësoheshin pa qenë të ditur.” Pra, në veprimtarinë e tij shkrimore, artikuj të ndryshëm me tema politike apo dhe me tema të ndryshme gjuhësore, në krijime apo përkthime të tij, ne shohim njohësin e mirë të gjuhës shqipe, kërkuesin dhe çmuesin e kësaj vlere të pavdekshme për kombin Qysh në atë kohë Hafiz Aliu do të diskutojë për problemin e ashtuquajtur vendore e shquar, p.sh. “...këta si përhapen nëpër botë...” ose “po futen nëpër shpirtat e myslimanëve... (Veprime të nxehta..Zani i naltë, nr.7, Maj 1924.)

Në një artikull të Danish Bebeziqit për kushtet e formimit të personalitetit të Hafiz Ali Korçës, do të shkëputim një nga thëniet e Safet Butkës në formën e kujtimeve personale të tij për Ali Korçën, kur citon një ndër porositë: “*Djem mos u bëni kodoshët e mëmës suaj, duke futur fjalë të huaja në gjuhën tonë*”, porosi kjo që u shfaq dhe shkoi shumë përpara gjatë gjithë veprimtarisë, i cili ishte purist, afries i dialekteve dhe përdorues i formës më të përshtatshme për shprehjen e mendimit shqip, si dhe luftëtarë për shkrimin e gjuhës shqipe në gërmat më të përshtatshme për të, pra në gërma latine.¹

Në mënyrë filozofike e artistike ai do të përcjellë te shqiptarët:

...Edhe ne e dimë se Shqipëria ka nevojë të madhe për dritë; por dimë edhe që Drita duhet të jetë thjeshtë shqipëtare dhe aspak osmane, arabe, elling, serbe, bulgare, austriake

dhe italiane. Po të zemë t'i ndritim Shqipërisë me ato dritëra jallane që na kanë dhënë të huajtë, atëherë nuk duhet të bëjmë gjë tjetër, veçse do të andakosemi një orë e më parë.¹

Si mësimdhënës në Mësonjëtorën e parë shqipe në Korçë, nuk kishte mundësi të mos shfaqte vlerat e tij si metodist, arsimdashës e pedagog. Gjatë gjithë kësaj periudhe luftime e përpjekjeje, veprimtarie intensive në disa fusha e drejtime si ajo e politikës, publicistikës, arsimit e kulturës do të njohë përveçse arritjeve, do të njohë edhe rënien e dënimit e tejskajshme, deri në dënimin me vdekje. Por presionit për dënimin me vdekje H.A.Korça do t'i përgjigjet:

“Hajde të themi se unë u vrava, a pandehni ju se kjo ide do të vdiste. Unë kam lënë me mijëra nxënës, të cilët këtë ide kanë për ta ndjekur. Por duhet të dini mirë, se edhe sikur të vdisnja, eshtrat e mija deri në kijamet: Ah, Shqipëri! Ah, Shqipëri! kanë për të thirrur.”¹

Në kohën e rënies së suksesit të medreseve, sipas Hafiz Ali Korçës, arsyeja kryesore ishte metoda e gabuar e mësimdhënies së gjuhës arabe. Dhe jo vetëm në këtë fushë, por edhe në shkrimet e tjera shoqërore, shkencore të këtyre shkollave.

Prandaj, me rënien e këtyre medreseve nuk po binte vetëm Perandoria e myslimanëve, por edhe qytetërimi islam bashkë me fenë. Siç thekson edhe vetë H.A.Korça, *feja mbahet vetëm me dituri. Dituria sjell zotësi, ndërsa injoranca sjell robëri.*

Si intelektual, si vlerësues i dijeve, mendimet e tij prej pedagogu, në lidhje me metodat e mësimdhënies, do të jenë sa të rëndësishme, por edhe bashkëkohore. Duke qenë anëtar i Komisionit të Gjuhës, në kohën e pushtimit nga AustroHungaria, bashkë me Ndre Mjedën dhe disa figura të tjera ia shpalo këto mendime popullit të Shkodrës, ku ai gjen mbështetje të plotë. Midis metodave që ai do të zgjedhë, atë që ka të bëjë me mësimin e gjuhës, të cilën nënat ia mësojnë fëmijëve të vegjël, kur ata pyesin: *“Çfarë është kjo?”*. Pra, fëmijët e vegjël mësimin e gjuhës nuk e fillojnë nga gramatika, por nga praktika e mësimi i fjalëve. *“Gjuha pjell gramatikën e jo gramatika gjuhën”*-thekson ai. Lufta dhe përpjekja për ta çuar përpara shkollën me reformat do t'ia prisnin ëndrrën në mes, sepse shteti i atëhershëm nuk ia vuri veshin. Në vend të kësaj ëndrre realizohet ëndrra ose makthi komunist, për të cilin H.A.Korça kishte shkruar edhe më parë në librin *“Bolshevizma a çkatërrimi i Njerëzimit”*.

Duke mbyllur me këto rreshta për veprën e tij themi se kemi bërë shumë pak. Ishte dhe do të mbetet një nga njerëzit më të ditur që kishte Shqipëria në shekullin e kaluar. Ai me fjalën e mençur, karakterin e jashtëzakonshëm fitoi respektin më të madh jo vetëm te besimtarët myslimanë, por të të gjithë shqiptarëve brenda e jashtë kufijve të Shqipërisë, Kosovë, Maqedoni e gjetkë.

Recenzentë :
Prof.dr. Tomor Plangarica
Dr.Zhulieta Daja

Mirlinda KRIFCA-BEQIRI: QUO VADIS, LETËRSI ? (POSTMODERNIA DHE PAS SAJ...)

Hyrje

Ekzistojnë një mori përkufizimesh në lidhje me atë se çfarë paraqet postmodernia / postmodernizmi, aq më tepër meqë, përkufizimet e tilla pretendojnë të shënojnë, jo vetëm veçori të letërsisë dhe artit, por njëherit edhe ta përshkruajnë epokën në të cilën jetojmë.

Sipas Linda Haçion "iniciativën e re kulturore, siç duket, duhet ta quajmë *postmodernia*" (Hucheon, 1995: 8). Duke filluar nga vitet '90, ky nocion filloi të fitojë shtrirje shumë më të gjerë dhe për të të diskutohet jo vetëm në studimet teorike letrare.

Nocioni *postmodern* është nocion i papërshtatshëm, madje në aspektin semantik është paradoksal dhe i pamundur (Muhiç, 1988: 56), ashtu siç është paradoksal edhe nocioni *modern*, meqë ky nocion nuk paraqet karakteristikat e një epoke të caktuar, por paraqitet diçka që është e re, që është në modë. Po e njëjta gjë ndodh edhe me nocionin *postmodern* / *postmodernizëm*, ku huti shkakton sidomos prefiksi "*post*", që shënon diçka që lidhet me të ardhmen.

Është e pamundur të përcaktohet saktësisht koha e paraqitjes së postmodernies, edhe pse ajo lidhet me emra të njohur si: Borhes, Nobakov, Beket etj. Në kërkim të rrënjëve të postmodernies / postmodernizmit si fenomen, kategoria "*postmodern*" shumë është kthyer pas. Sipas U. Eko-s: "...në fillim dukej se u përshtatej disa shkrimtarëve e artistëve që kanë shkruar gjatë njëzet vjetëve të fundit, pastaj ca e nga ca shkoi deri andej nga fillimi i shekullit, pastaj edhe më tej, dhe marshimi vazhdon, e prite kur të arrijë kategoria e postmodernes deri te Homeri" (Eko, 472).

Është e njohur se çdo lëvizje e re letrare i kundërvihet lëvizjes paraprake, gjegjësisht mëton ta deformojë ideogramin e saj, duke e konsideruar atë si të vjetëruar dhe të harxhuar dhe mundohet të ngrejë një ideogram të ri, që do t'ju përgjigjet kërkesave të kohës së re.

Në esenë "*Letërsia e shterimit*" të Xh. Bart-it, që konsiderohet si manifest i postmodernies, autori shprehet "*Shkrimtari im ideal post-modern nuk irriton e nuk përbuz as prindërit e vet të Nëntëqintës e as gjyshërit e vet të Tetëqintës. E ka bluajtur mirë modernizmin por nuk e mban në kurriz si ndonjë barrë. . .*" (Eko, 474).

Historia e nocionit: lindja e postmodernies

Pavarësisht se shumë studiues e përdorin nocionin *postmodern*, akoma nuk dihet saktësisht se kush e përdori atë për herë të parë. Xhon Watkins Çepmen e përdori këtë nocion në vitin 1870, për të shënuar artin figurativ, që i pasvjen impresionizmit.

Volfgang Velsh (Welsch, 1993: 11), lindjen e këtij nocioni e lidh me vitin 1917 dhe me Rudolf Panvic, i cili në veprën “*Kritikë kulturës evropiane*”, me këtë nocion shenjon nihilizmin e shoqërisë bashkëkohore. Velsh gjithashtu përmend se këtë nocion e ka përdorë më 1934 edhe Frederik de Oniz, për të shenjuar një periudhë të shkurtër të zhvillimit të poezisë spanjole dhe latinoamerikane, që gjendet mes dy periudhave të modernies, gjegjësisht periudhën 1905-1914.

D. Zomervel, nga ana tjetër, në vëllimin e gjashtë të veprës enciklopedike “*Studimi i historisë*” propozon që me këtë nocion të shenjohej periudha prej 1875 e këtej. Pra, mes këtyre përdorimeve të para të nocionit *postmodern* nuk ka asnjë lidhshmëri.

Pavarësisht se kush do të duhej të konsiderohet si farkues i këtij nocioni, fakt është se ai askujt nuk i pëlqen. “*Post*”, sipas Riçard Kostalanec (Richard Kostalantz), “*është prefiks travijal, edhe sot por edhe historikisht marrë, meqë lëvizjet e mëdha definohej nëpërmjet të nocioneve vetanake, e jo nëpërmjet të lidhjes së tyre me diçka tjetër. . .*”. (Kostalanetz, 1982: 38).

Për Xhon Bart-in (John Barth) nocioni është “*I pashijshëm, i zbehtë, epigonik, më pak i përshtatshëm për shenjimin e një drejtimi të ri të fortë, qoftë edhe vetëm interesant në artin e vjetër të rrëfimit, . . .*” (Barth, 1980: 66). Por, pavarësisht se nocioni askujt nuk i pëlqen, ai ka përdorim dukshëm më të dendur se alternativat tjera të propozuara, si “*mbiproza*” ose “*proza post - bashkëkohore*”.

Fillet e postmodernies lidhet me vetëdijesimin teorik se janë harxhuar dominantat e vjetra teorike dhe janë zëvendësuar me dominantat e reja. Risia e tyre nuk lidhet gjithmonë me inovacionin. Kështu, p.sh. karnevalizmi ka qenë shumë i shprehur në mesjetë; citatshmëria është mjaft prezente te dadaistët; ironia te romantikët; konstruktivizmi te modernia, por të gjitha këto paraqiten si dominantat poetike në epokën e re postmoderne.

Edhe nocioni *modern* është një nocion problematik dhe për të është shkruar se: “*Në përdorim historik shpesh përdoret (në kundërshti me përdorimin e vjetër dhe atë mesjetar) për të*

shenjuar kohën që vjen pas Mesjetës” (Oxford, 1989). Nocioni *postmodern /postmodernizëm*,

kuptohet, është akoma më problematik dhe më paradoksal. Zh F. Liotar e përshkruan si *Paradoks të të ardhmes (post) dhe të të kaluarës (modo)*.

“*Krejt Owens (Craig Owens) ka shkruar se gjendja postmoderne është paraqitur në çastin kur kemi kuptuar se kultura jonë nuk është as homogjene e as monolite, siç është besuar më parë. . . Idetë për një subjekt universal të vetëm, për natyrshmërinë e formacioneve shoqërore dhe kulturore e kanë humbur rëndësinë e tyre si metanarracione të mëdha, të cilat e ushqenin kulturën humaniste të modernës*” (Djuriç, 2006:1).

Në vitet `50 dhe `60 ky nocion fillon të gjejë përdorim gjithnjë e më të dendur, kurse në vitet `70 filluan të paraqiten studimet e rëndësishme teorike mbi postmodernizmin në kulturë, si ato të Ihab Hasan-it. Viojnë pastaj studime tjera, si “*Gjendja postmoderne*” e Zhan Fransoa Liotar, sipas së cilit filozofia e postmodernizmit mundëson që bota të vrojtohet si diçka partikulare dhe shumë heterogjene. Liotar u shqua si luftëtar i heterogjenitetit, i dallimeve, hibriditetit, fragmentarizmit në të gjitha sferat dhe diskursjet jetësore. Ai, në

mënyrë energjike, i sulmoi metodat universale në filozofi, në estetikë ose në teorinë e shoqërisë. Diskutimet e tij për gjendjen postmoderne paraqesin një tërmet në zhvillimin e mendimit perëndimor.

Linda Haçon, pranon mendimin e Piter Blejk-ut shprehur në librin e tij *“Forma ndjek fiaskon”* (1977), sipas së cilit postmodernizmi është rezultat i rishqyrtimeve që vetë autorët modernë i bënë modernizmit. Mjaft teoreticientë e përcaktojnë postmodernizmin si gjendje të botës post - iluministe, post - humaniste, post - frojdiste.

Julia Kristeva mendon se postmoderniteti paraqitet në *“çaste të krizës”*, kur diçka po rrënohet, por kur edhe paraqiten burime të reja. Linda Haçon (Haçon, 1996), bën dallim mes nocionit postmodernizëm dhe postmodernia dhe shprehet se nocioni postmodernizëm ka kuptim më të ngushtë se nocioni postmodernie dhe shënjon fazën e parë të kohës, në të cilën jetojmë.

Mihail Epshtejn (1998: 31), mendon se arti bashkëkohor gjakon pas teorisë, kështu që nga faza e fundit e modernies, e veçmas në fazën e postmodernies, krijuesit gjithnjë e më shumë e kanë shtypur sferën vetanake të artit letrar dhe pushtetin autorial e kanë zëvendësuar më atë të kritikut.

Për dallim nga J. Habermans, sipas së cilit postmodernia paraqet kthim prapa, sipas Liotar-it postmodernia nuk është lëvizje e kthimit *“Came back”*, por është proces i *“ana”*: analizës, anamnezës, analogjisë, anamorfozës që e elaboron *“harresën fillestare”*.

Brajan Mekhejl (Brian Mc Hale, 2007: 197), si edhe te drejtimit tjera, ashtu edhe te postmodernizmi dallon më tepër konstrukcione të tij, prej të cilave asnjëri nuk është më pak *“i vërtetë”* ose *“fiktiv”* në raport me tjerët, meqë të gjithë së bashku janë përfundimisht fiksiione.

Karakteristikat e postmodernies / postmodernizmit

Lindja e postmodernies/postmodernizmit, fundja si edhe lindja e drejttimeve paraprake letrare, është ngushtë e lidhur me rrethanat aktuale shoqërore, gjegjësisht me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë, sidomos të shkencave të informatikës, të cilat arritën deri në një shkallë të lartë të përsosjes që të ofrojnë pasqyrë të tillë të realitetit që, në të vërtetë, duket më real se sa që është vet realiteti, pra paraqitet dukuria e simulacionit, të cilës i kushton kujdes shumë të madh Zhan Bodrijar (Bodrijar, 2001), njëri nga studiuesit më të njohur amerikan të postmodernies.

Varësisht prej hapësirave ku paraqitet, postmodernia, si edhe drejtimit tjera, ka dallime dhe specificitete të veta, sado që në fazën e postmodernies, komunikimi masovik ka bërë që këto dallime të zbutem. Fakt është se paraqitja e postmodernizmit, varet edhe nga stadi i zhvillimit të kodit modernistik. Në pjesën më të madhe të këtyre letërsivë, postmodernizmi paraqitet në vitet 70 - 80 të shek. XX. Në vendet e ish bllokut socialist, paraqitja e postmodernizmit është e lidhur me periudhën e rënies së sistemit komunist. Prandaj, në raste me të shpeshta, në letërsitë e këtyre popujve, dominojnë tema traumatike.

Sipas Živan Filippi, ndoshta karakteristika më e rëndësishme e postmodernies, që është e përbashkët edhe për letërsinë modernie, është kritika e saj radikale artit mimetik dhe gjakimi për risi në përmbajtje dhe në formë. Ashtu si arti modern që shpesh është kthyer dhe i ka parodizuar modelet mitologjike dhe letrare, arti postmodern po të njëjtën gjë e bën me modernien. *“Te postmodernistët fortë është kristalizuar vetëdija se është e pamundur që në tekstin prozaik ose atë poetik të vendosen sende dhe njerëz nga jeta reale, për dallim prej modernistëve, në radhë të parë Xhojsit, të cilët, edhe pse kritik ndaj realizmit tradicional dhe*

papërshatshmërive të tij, akoma besonin në transkribilitetin e tekstit letrar. Për postmodernistët bota përreth është e pamundur të imitohet, vetëmse sërish të krijohet. Andaj ata krijimin e vet verbal e konsiderojnë si shtesë të realitetit, e jo si paraqitje e tij. Poesis-i në tekstin postmodern e zëvendëson mimesis-in e pararendësve të tyre” (Filippi, 1985: 10).

Në natyrën e modernies, autoriteti i veprës artistike, kërkesa që ajo të paraqesë një lloj vizioni autentik të botës, bazohet në univerzalitetin. Sistemi përëndimor i rrëfimit pranonte vetëm një vision –vizionin e subjektit konstitutiv mashkullor, si të vetmin. Kurse veprat postmoderne mohojnë stabilitetin e pozitës së sundimitarit. Kristeva dhe Bart kanë gjykuar se edhe avangarda moderne, me vendosjen e heterogjenitetit, mungesës së kontinuitetit, shumëzëshmërisë, e destabilizon subjektin e rrëfimit. Sipas M. Epshtejn, postmodernizmi në kuptim më të ngushtë të fjalës, shënon avangardën artistike dhe kulturore të disa dekadave të fundit - shkrimin inovativ dhe artin që karakterizohet me fragmentalitet, ironi, intertekstualitet, mosrespektim të kufijve zhanror dhe autorefleksivitet.

Nëse nisemi nga parimi se postmodernia shenjon një formacion stilistikor, atëherë si edhe formacionet tjera ka karakter historik. Në Amerikë, ky nocion lidhet me fenomenet e viteve `50-ta, kur u zhvilluan diskutimet e para rreth postmodernies / postmodernizmit, diskutime këto që, në fillim, kanë pasur një konotacion negativ, meqë janë nisur nga bindja se letërsia që paraqitet pas Jejsit, Eliotit, Xhojsit, karakterizohet me një mungesë të inovacionit. Në Evropë, diskutimet e para rreth postmodernies lidhen me fenomenet e viteve `70 dhe, gjithashtu, kanë qenë të përcjellura me rezerve. Sipas L. Haçion ajo që është karakteristike për veprat postmoderniste, është se ato janë dy herë të koduara dhe gjenden diku mes faktit dhe fiksionit (Graham, 2000: 188).

Dallimet mes modernies dhe postmodernies janë të dukshme. Këto dallime vërehen fillimisht në besimin që kanë në lidhje me përfytyrimin e botës si dhe për nga mënyra si e kuptojnë vendin dhe rolin që luan subjekti në këto dy tipe të letërsisë. Modernia dhe postmodernia dallojnë edhe përnga “*gjatësia*” e narracionit, ashtu siç dallojnë edhe përnga qëndrimi që kanë ndaj historisë: “*Kur periudha e kaluar letrare që njohur si modernizëm, atëbotë, siç kemi parë në kapitujt e mëparshëm, koncepti mbi veprën si objekt i mbyllur, i vetëmjaftueshëm, autonom, i cili unitetin e vet e krijon nga ndërlidhja formale e pjesëve të saj, në postmodernizëm edhe është rivendosur, edhe është rrënuar. . . Postmodernia vetëdijshëm është art “brenda arkivit” (Foucault 1977), kurse ky arkiv është historik dhe letrar” (Haçion, 2004: 12).*

Ku pas posmodernies?

Edhe përkundër tendencës që postmodernizmi të paraqesë një sistem plotpërfshirës, megjithatë në fund të shek. XX, në Danimarkë, paraqitet një lëvizje e re në fushën e kinematografisë që, megjithatë, ushtroi ndikim të madh. Kjo lëvizje është e njohur me emrin ***Dogma 95***.

Dogma u zyrtarizua në 1995 në Kopenhagë. Manifesti i saj përbëhet prej 10 pikëve. *Dogma* është e orientuar kundër revolucionit teknologjik dhe përdorimit të të arriturave teknologjike në film. Natyrisht, ky kthim pas paraqet një reaktion të natyrshëm dhe të pritur për ta shpëtuar artin filmik nga rreziku për të marrë formën e artit dixhital.

Shkëputja më e dukshme e *Dogmës* nga teoria postmoderne filmike vërehet në ato pika të manifestit, që proklamojnë shfrytëzimin e skenarit natyror, që i ndalon përjashtimet

kohore dhe hapësinore dhe veprimet e pavërteta. Për dallim nga kinoteka postmoderne, *Dogma* dëshiron që inspirimin ta marrë vetëm nga jeta, nga realiteti. Qëllimi kryesor i kësaj lëvizjeje është që e vërteta e pazbukuar, konteksti jetësor, me të mirat dhe të këqijat e veta, të shprehet në film.

Ky reaktion ndaj zhvillimit të teknologjisë filmike, paraqet kthim në fillimet filmike. Ky kthim në rrënjët, paraqet një lloj metafore për kthimin e artit në sistemin e dikurshëm të vlerave.

Një lëvizje tjetër artistike, e ngjashme me *Dogmën* është, lëvizja që u paraqit në Angli, në fushën e letërsisë. *Puritanë të rinj britanikë* mundohen që, nëpërmjet të afirmimit të të vërtetës dhe moralitetit si postulate kryesore të prozës, t'ia kthejnë letërsisë dinjitetin, të cilin, sipas tyre, ajo dekadave të fundit e kishte humbur. *Puritanët e rinj britanikë* paraqesin një lëvizje të re letrare që ka për qëllim të bëjë apel për kthim në narracionin klasik.

Ithtarët e kësaj lëvizjeje janë adhurues, në radhë të parë, të prozës. Ata janë kundër veprimeve, që mbështeten në zërin e narratorit dhe në komentet autoriale; i kushtojnë kujdes kohës lineare, prandaj janë kundër analepsës, prolepsës dhe stukturës temporale të dyfishtë. Respektojnë thjeshtësinë gramatikore dhe janë kundër interpunkcionit të komplikuar. Duke pranuar mendimin se veprat e botuara janë dokumente historike, ata parapëlqejnë që ngjarjet në veprat e tyre të vendosen në kohën e tashme dhe që vendet dhe sendet që emërtohen të jenë të vërteta. Tekstet e tyre karakterizohen më një realitet të dukshëm etik.

Ky kanun estetik, që për shumëçka e kemi të njohur edhe nga drejtimet e mëparme (si nga shkolla realiste apo natyraliste), nuk pretendon që shprehjen letrare ta bëjë më inovative. Bindja se jeta duhet të paraqesë marterialin e vetëm ndërtimor të artit, konstruksioni metonimik gjuhësor dhe leksiku i rëndomtë, pa ndonjë nëntekst të theksuar, kompozicioni linear si dhe fokusimi në çështjet etike, paraqet një lloj instistimi në modelin e realizmit kritik, që beson se nëpërmjet të letërsisë, gjegjësisht artit, do të ofrohen mundësi për veprime humane.

Puritanët e rinj dëshirojnë ta bindin opinionin publik se letërsisë duhet t'i kthehet ana e saj enigmatike, mistike, por jo nëpërmjet të formave hermetike të letërsisë (post) moderniste.

Në tekstin e tyre përmbledhës "*Përshëndetini të gjithë Puritanët e rinj*", autorët themelues të kësaj lëvizjeje, respektojnë normat e përcaktuara në manifestin e tyre. Shumica prej tyre zgjedhin *ich* (iç) formën dhe narratorin, që është pjesëmarrës në ngjarjet. Insistimi i tyre në përdorimin e konstruksioneve të thjeshta sintaksore, me një leksik, në të cilin gjejmë edhe zhargone dhe shprehje vulgare, është në shërbim të pasqyrimin të përditshmërisë provinciale ose urbane.

Për dallim prej *Dogmës* që ka një jetë më të gjatë, dalja në skenë e *Puritanëve të rinj* është e mëvonshme, prandaj edhe është vështirë të parashihet jetëgjatësia e kësaj lëvizjeje.

A. Dunderin lëvizjet e tilla, si *Dogma* dhe *Puritanët e rinj*, i konsideron si *Opcione të hu*

manizmit esencial, që karakterizohen me një *ide të madhe*. Ai është i mendimit se emërtimi i kësaj faze të re artistike si *Opcioni i humanizmit esencial*, është i përshtatshëm, për të paraqitur atë që M. Epshtejn (Epstejn, 1998) e quan *Sentimentalizëm të ri*.

M. Epshtejn shprehet: "*Në përgjithësi, nëse mendojmë për mundësitë e emërtimit të kohës së re, që vjen pas postmodernizmit, atëherë duhet veçmas ta veçojmë rëndësinë e prefiksit trans. Dukuritë e tilla të fundit dhe nocionet e kohës së re (Modernity) siç janë e*

vërteta dhe objektiviteti, shpirti dhe subjektiviteti, utopia dhe ideologjia, krijimi i parë dhe origjinaliteti, sinqeriteti dhe sentimentaliteti, tani rilindin, por si trans - subjektivitet, trans - idealizëm, trans - utopizëm, trans - origjinalitet, trans – sentimentalitet. . .” (Epstejn, 1988: 139 – 140).

Përfundim

Pavarësisht se si të emërtohet kjo lëvizje e re, e paraqitur nëpërmjet të *Dogmës* ose *Puritanëve*, fakt është se po paraqitet një tendencë e re artistike dhe letrare, që ju kundërvihet postulateve dhe praktikës postmoderniste. Lëvizjet e tilla, insistojnë në etikën, të vërtetën, në humanizmin universal dhe besojnë në funksionin shoqëror të artit, në përgjithësi. Pra, edhe përkundër tendencies që postmodernia/ postmodernizmi me heterogjenitetin e saj, të paraqesë një sistem plotpërfshirës, megjithatë tendencat e reja në fushën e artit, sikur dëshmojnë se koha e postmodernizmit po kalon dhe vendin e tij gradualisht po pëpiqen ta zënë lëvizje të tjera, akoma të reja dhe jo mjaft të përhapura dhe të dëshmuara.

Recenzentë ;
Prof.dr Zeqirja Neziri
Prof.dr. Avzi Mustafa

**Ma. Aida URUÇI: VËSHTRIM KRAHASUES NË GJUHËN E AUTORËVE:
CAMAJ, KOLIQUI E PIPA. (NË RRAFSHIN FJALËFORMUES)**

Camaj, Koliqi e Pipa këta kolosë të mëdhenj të letrave shqipe, megjithëse jetën e veprimtarinë e tyre krijuese letrare e gjuhësore e kaluan në dhe të huaj, gjuhën, e në veçanti gegërishten e ruajtën mjaft mirë, madje e përpunuan dhe sollën risi në disa ndërtime. Ata dhanë një kontribut jo vetëm si shkrimtarë me krijimtarinë e tyre letrare, por edhe si gjuhëtar. Vlen të theksojmë rolin që luajti E. Koliqi në përhapjen dhe zhvillimin e gjuhës, të letërsisë dhe kulturës shqiptare në kohën kur ishte ministër i Arsimit. Camaj arriti të kryente disa studime me vlera gjuhësore, madje ai ishte edhe autor gramatike. Kurse Pipa hodhi mjaft ide për një shqipe të njësuar. Të tre këta shkrimtarë të pajisur me një kulturë të gjërë dhe aftësi gjuhëkrijuese, u përpoqën në mënyrë të vetëdijshme të zbulonin mes shkrimeve të tyre pasurinë e begatinë e shqipes. Ata arritën ta pasurojnë atë me fjalë, shprehje e thënie të reja të nxjerra nga thesaret e gjuhës popullore ose të krijuara nga ata vetë sipas modeleve të shqipes. Gjuha që përdori E. Koliqi dhe A. Pipa në veprat e tyre është një gjuhë kryesisht e zonës së Shkodrës, ndërsa Camaj bëri përpjekje për një kodifikim në lëmin e drejtshkrimit e të gramatikës. Gjuha e tij është gegërishtja letrare.¹ Në këtë punim jemi ndalur në gjuhën e këtyre autorëve e pikërisht në disa veçori fjalëformuese. Jemi përqendruar në:

- Studimin i krijimit të fjalëve të reja që u përkasin tipave të ndryshëm fjalëformues.
- Gjallërimin e disa fjalëve dialektore, të cilat mund të përfshihen në leksikon aktiv të gjuhës së sotme shqipe.

Në fushën e fjalëformimit këta autorë i dhanë përparësi dy mënyrave: prejardhjes dhe kompozimit. Në fjalët që po analizojmë jo të gjitha janë krijime të autorëve, ndonjëra prej tyre ndeshet edhe në autorë të tjerë paraardhës, bashkëkohës ose që i përkasin ligjërimin krahinor. Ndajshitesat më të përdorurat nga këto tre shkrimtarë janë: parashtesa për-, prapashtesat –shëm e –isht.

1. Parashtesa për- u ngjitet *emrave, mbiemrave, ndajfoljeve e foljeve*, duke u dhënë kuptime të ndryshme.¹ Ndajshitesa për- gjatë ndërtimit të mbiemrave u jep fjalëve kuptim të forcuar e ndonjëherë krahasues, por ka mbetur pak prodhimtare.¹ Kjo mënyrë fjalëformimi gjen pasqyrim më tepër në letërsinë artistike, dukuri që është vënë re tek të tre këta shkrimtarë, por me një zhvillim më të dukshëm tek Camaj. Kështu kemi fjalët e prejardhura: *e përfrigueshme, e përndalun, e përलगun, e përdhunshme, i përngeshëm, i përmoçëm, i përnotun, i përलगshhtë* (tek Camaj); *e përvuajtun, e përmbrendshme, e përdredhun* (tek Koliqi); *e përvojuntun, e përhapur* (tek Pipa) etj. Camaj duke shfrytëzuar lemën foljore *ndal* ka arritur të formojë ndërtimet: *e përndalun* (mbiemër): (...*Fuqi e përndalun*...M. Camaj, Buelli, f. 154), dhe *përndal* (folje): (...*Nika u përndal e s'i tha atij s'i binte ma ndërmend qysh ku ajo s'kishte vu kambë në atë vend*...Pishtarët e natës, f. 38). Në FGJSSH (1980) kemi të paraqitur një larmi formash të ndërtuara nga folja ndal, por ky ndërtim nuk del i pasqyruar.¹ (...*stuhija e përmbrendëshme vinte tue e shtrive përherë e ma furin e vet*...E.

Koliqi, Shija e bukës mbrume, f. 31); (...*bukën e zezë e gjellën e përvujtun / idhnimi s'na helmon...* A. Pipa, Lundërtarë, f. 15).

Me këtë parashtesë janë formuar **folje** zakonisht nga *tema foljore e emrore* (më pak). Kjo parashtesë u paravijet **temave foljore** e u jep *foljeve* të krijuara një kuptim intensiv e në mjaft raste ngjyrimë të reja kuptimore.¹ Në këtë grup do të veçojmë përpjekjen e Camajt për të dhënë forma të reja, duke shfrytëzuar mjetet fjalëformuese të shqipes, si p.sh.: **përkënaq**, **përvështirësoj** të cilat nuk i kemi të pasqyruara në Fjalorin e Gazullit, Fjalorin e '54, Fjalorin e "Bashkimit" e FGJSSH (1980) e (2006)¹. (...*Përkënaqesha në vete jo aq sa qitsha në letër vargje mbas vargjesh, po sepse ato mbëshin nga ndiesi që ushqesha për Djellën...*M. Camaj, Djella, f. 91); (...*shqarri atypëraty, përvështirësohej prej tymit...*Pishtarët e natës, f. 77). Ndërsa tek Koliqi kemi ndërtimet: **përbuz**, **përpjij** etj., tek Pipa: **përfal**, **përhidhet**, **përdridhet** etj. lema që i ndeshim të përdorura në gjuhën letrare. Pipa në mjaft raste përpjijet që fjalëve t'u japë ngarkesa emocionale, ai arrin të përdorë pranë njëra-tjetrës fjalë me të njëjtën ndajshitesë, si: *përhidheshin e përdridheshin* me vlerë përforcuese. (...*e gjetht e mjerë përhidheshin / shtremnoheshin, përdridheshin...*A. Pipa, Lundërtarë, f. 15); (...*qi përbuz qumshtin e Nanës...*E. Koliqi, Gjurmat e stinëve, f. 28).

Si tip fjalëformues më vete parashtesimi nuk është karakteristikë për ndajfoljet.¹ Në disa raste kemi vënë re ndajfolje të formuara zakonisht nga *tema ndajfoljore*. Këtu duam të veçojmë përpjekjet e Camajt e Pipës për dhënien e ndërtime të reja, ku vetë Camaj shfrytëzon ndajshitesën për- për dhënien e ndërtimeve të tilla, kurse tek Pipa kemi përdorimin e mënyrës së përzier (*parashtesim e prapashtesim* njëkohësisht), por nga tema emërore. Tek Camaj kemi ndajfoljet: **përngadalë**, **përngeshëm** të cilat nuk i kemi të pasqyruara në Fjalorët e marrë për krahasim. **përngadalë** (...*kisha një copë akulli në kurm që duhej shkri përngadalë para flakadanit...*M. Camaj, Djella, f. 105). Ndërtimin *përngeshëm* e kemi të përdorur nga Camaj edhe si ndajfolje edhe si mbiemër, p.sh.: **përngeshëm** (...*në kohë të lirë e shtrinte kuvendin përngeshëm...*Djella, f. 89); (...*Jera e dinte se përralla janë ato, por ua kishte lakmi treguesve të përngeshëm e pa të keq të cilët përkënaqeshin të shtireshin ma fëmijë se fëmijët...*Rungaja në mars, f. 168). Pipa përpjijet të ndërtojë ndajfolje nga tema emërore, si p.sh.: **përvajshëm**, **përmallshëm**, **përmortshëm** etj. (...*kori përmortshëm shungulloi...* A.Pipa, Burgu, f. 157). Në FGJSSH (1980) e (2006) kemi të përdorur vetëm trajtën mbiemërore *i përmortshëm*, kurse ndërtimi ndajfoljor nuk del i dhënë. (...*përmallshëm sonte mbramja e majit ulet...* A.Pipa, Burgu, f. 29). Tek Koliqi na pasqyrohet me trajtën mbiemërore: (...*me e lanë të kuptohet keq heshtja e përmallshme e tij...*E.Koliqi, Hija e maleve, f. 115). Kjo mënyrë fjalëformimi është pak prodhimtare në krijimtarinë e Koliqi, atë e gjejmë të përdorur në disa lema që gjenden të pasqyruara edhe në standard, si: **përbrenda**, **përmbra** etj.

2. Prapashtesa –shëm. Me këtë prapashtesë janë formuar prej emrash, foljesh e ndajfoljesh mbiemra, që tregojnë një cilësi të rrjedhur nga të pajisurit me një gjë ose me një veti. Gegërishtja përveç mbiemrave ka edhe ndajfolje me këtë prapashtesë, që tregojnë një gjendje a një mënyrë.¹ Kjo mënyrë fjalëformimi po zhvillohet gjerësisht në gjuhën e sotme letrare.¹ Në krijimet e Camajt, Koliqit e Pipës të bie në sy prirja për t'iu afruar standardit duke përdorë më tepër ndërtimet me ndajshitesën –shëm si ndajfolje se sa si mbiemra. Si p.sh. te Camaj: **kujtueshëm**, **bindshëm**, **dëshirueshëm**, **mpishëm**, **preshëm**, **marrshëm** etj., tek Koliqi: **theksueshëm**, **lëmueshëm**, **lirueshëm**, **gëzueshëm**, **durueshëm**, **andshëm**, **ngatrrueshëm** etj., tek Pipa: **idhshëm**, **ankueshëm**, **trembshëm**, **erandshëm**, **hovshëm**, **potershëm**, **ankueshëm** etj.

Gjatë krahasimit me Fjalorin e 2006-ës kemi vënë re se në çerdhen fjalëformuese të këtyre fjalëve, aty pasqyrohen mbiemrat përkatës e jo ndajfoljet, si p.sh.: kujtueshëm – i kujtueshëm (në FGJSSH, 2006), dëshirueshëm – i dëshirueshëm (në FGJSSH, 2006), mistershëm – i mistershëm (në FGJSSH, 2006) etj., e në raste të tjera përmban ndajfoljet me të njëjtin kuptim, por të formuara me prapashtesa të tjera, si: ngathshëm–ngathtësisht (në FGJSSH, 2006), mpishëm – mpitas (FGJSSH, 2006), preshëm – prepas (FGJSSH,2006) etj., disa prej këtyre ndërtimeve mund të jenë përpjekje të autorëve për dhënie e formave të reja pasi ato nuk gjenden të pasqyruara në fjalorë. Ndajfoljet *dëshirueshëm*, *mistershëm*, *kujtueshëm* etj. kanë gjeçjësjet e tyre mbiemërore në FGJSSH (2006): i dëshirueshëm, i mistershëm, i lakueshëm. (...*përnjimend e qita cekën me e rrahë magjypin, së paku atë, ndonëse edhe të tre tjerët pritin pritin dëshirueshëm në kambë t'ua kallëzoja...*M. Camaj, Pishtarët e natës, f. 51); (...*kur lakueshëm shigjetojnë / fushat e qiellit...*A. Pipa, Libri i burgut, f. 164). Ndajfolja **idhshëm** del e përdorur në krijimtarinë e Camajt e të Pipës, por në gjuhën letrare kemi ndërtimet me ndajshitesën –as, –az: *idhtas, idhtazi*: (...*ashtu gjarpni i rrek pa grat / tambël për me nxjerrë / në gjijt e Ledjes vashë / deri sa helmi idhshëm / i kulloi nëpër dhambë...*M. Camaj, Legjenda. f. 186); (...*brofi ajo idhshëm si e shkelun n'gisht...*A. Pipa, Rusha, f. 56). Në FGJSSH, 2006, f. 1115, kemi përdorimin vetëm të ndajfoljes *turbullt*: në mënyrë të turbullt. Ndajfoljet: *lëmueshëm*, *përpishëm* gjenden të përdorura në kontekste të ndryshme tek Camaj e Koliqi, me forma të tilla ato s'na pasqyrohen në FGJSSH (1980) e (2006): **lëmueshëm** (...*Gjuri kishte shti ndër ara ujin që e sillte prej amës së lumit; edhe ky e trazonte me krismën e vet, edhepse rridhte lëmueshëm, tue gurgullue nëpër rranjët e misrit...*M. Camaj, Rrungaja në mars, f. 181); (...*krehjes së flokëve të shkurtë, të ujdisun lëmueshëm e përpishëm...*E. Koliqi, Tregtar flamujsh, f. 68). Në FGJSSH (1980) e (2006) kemi disa ndërtime si: *lëmoj* (folje), *lëmim* (emër), *i,e lëmuar* (mbiemër), *lëmuar* (ndajfolje). **përpishëm** (...*terri i territ me zemër në mur / hajnisht gëlltitej përpishëm...*M. Camaj, Djella, f. 119). Në FGJSSH (1980) e (2006) nuk e kemi trajtën ndajfoljore përpishëm, por kemi përdorimin *foljor*: *përpij*. **nynyrueshëm** (...*heshtuen të tanë posa e kapi fjalën një plak: fliste nynyrueshëm, ftohtas, e një cope, pa modulacion zani...*M. Camaj, Rrungoja në mars, f. 208). Ndërtimi me ndajshitesën –shëm nuk e del e përdorur në fjalorët e marrë për krahasim, prandaj përdorimi i saj plotëson çerdhen paradigmatiche.¹

3. Prapashtesa –(i)sht është prapashtesa ndajfoljore më prodhimtare në shqipen e sotme letrare. Ajo lidhet kryesisht me tema jo të parme që mbarojnë më –i, duke dalë kështu prapashtesa –sht.¹ “Një tip të pasur e prodhimtar përbëjnë në gjuhën e sotme shqipe ndajfoljet me prapashtesën –isht. Në letërsinë artistike përdoren më të përgjithshmet, të tjerat përdoren për qëllime stilistike.”¹ Camaj me anë të kësaj ndajshitesë ka dhënë lemat: *mirësisht, letrarisht, shpirtnisht, fuqimisht, qetsisht, rastësisht, hajnisht* etj., tek Koliqi kemi ndërtimet: *ngulmënisht, mjerisht, guximtarisht, çuditënisht, njerzisht, lirisht, bukurisht, mrekullisht, dashunisht* etj., e më pak përdorim tek Pipa: *mrekullisht, lumnisht* etj. Gjatë vjeljes së leksemave kemi vënë re që ndajshitesa –isht na rezulton më e larmishme tek Koliqi, në krahasim me Camajn e më pak te Pipa. Nga lema *ngulm* Koliqi ka ndërtuar ndajfoljen *ngulmënisht*, ndërsa në krijimtarinë e Camajt e gjejmë me ndajshitesën –as: *ngulmas*, vihet re prirja e Camajt për të qenë sa më pranë standardit. “...*ishte ngulmënisht i vendosur...*E. Koliqi, Shija e bukës mbrûme, f. 121 (...*tue i vrojtë ti ngulmas kishe ndie afshin...*Palimpsest, f. 201). Ndajfolja *mrekullisht* gjendet e përdorur tek Koliqi e tek Pipa, kurse tek Camaj ajo del me formën: *mrekullim*. (...*edhe ato lule pa erë qi ndrisin mrekullisht n'at perde...*E. Koliqi, Shija e bukës mbrûme, f. 113); (...*vrente të birin, ndryshe / të bukur*

mrekullisht...A. Pipa, Libri i burgut, f. 105). Pipa këtë ndajfolje e ka përdorë për të treguar shkallën sipërore të mbiemrit. “...*Po atë ngjyrë e kam zbulue vjet ma vonë në një pikturë impresioniste të pjesës së dytë të shekullit të kaluem dhe, për mrekullim tim, më ra mall për Ndërsanë...*Djella, f. 127”. Ndajfolja **bukurisht** gjendet e përdorur që tek fjalori i “Bashkimit” (f. 55) e ajo është risjellë në krijimet e Koliqit. (...*nji burrë i pashëm, me mustakë bukurisht të përdreshun...*E. Koliqi, Shija e bukës mbrûme, f. 111). **letrarisht** (...*don të bindish letrarisht gjithë ata që s’i kanë mendt tua...*M. Camaj, Kandili i argjandit, f. 87). Në Fjalorin e ’54, ’80 e të 2006 kemi të dhënë trajtën mbiemrore **letrar**, ndërsa ndajfoljen: **letrarisht** nuk e kemi të pasqyruar e mund të jetë përpjekje e autorit për një zgjerim të çerdhes fjalëformuese. Në FGJSSH (2006) kemi të pasqyruar trajtat ndajfoljore: **lumtësisht** e **lumturisht**, kurse tek Pipa shfaqet me trajtën: **lumnisht**: (...**Lumnisht!** *Se ktu n’kët anë / ku burri ka / nji torbë e nji gjylpanë...*A. Pipa, Libri i borgut, f. 136).

Camaj, Koliqi e Pipa janë treguar dorëmbarë edhe në përdorimin e kompozitave. Veprat e tyre janë të pasura me kompozita emërore, mbiemërore, foljore e ndajfoljore të përdorura ose të krijuara mjeshtërisht prej tyre. Ja disa prej tyre: **sy-zbrazët**, **buzëshpërvjelun**, **krahthatë**, **mrekullibamëse**, **fatlumësi**, **fshehësiplotë**, **marrfrymja**, **mbamendja**, **mirakandas** etj. (tek Camaj); **miradije**, **zemërzhuritur**, **kureshtngacmues**, **orpemë**, **mirëndiellës**, **fatlumsisht**, **mrekullbase**, **harrimsjellse**, **fatbardhësue**, **erëlëshuese** etj. (tek Koliqi); **miradishëm**, **fatshkretue**, **zemërplasët**, **krelartë**, **belzhdërvjelltë**, **hundërthym**, **orzezë**, **hareplotë**, **syzhgjetues**, **krahshpërvjeluna**, **sqepshqiponja** etj. (tek Pipa). Le të shohim disa ndërtime duke i vënë re sipas strukturave të përdorura. Tipi **emër+mbiemër** është mjaft prodhimtar në formimin e mbiemrave, në formimin e emrave është tepër i kufizuar.¹ Një dukuri e tillë është vënë re edhe tek të tre shkrimtarët, por s’përrjashtojmë edhe ndërtimet emërore të përdorura nga ata. Duke shfrytëzuar lemën **sy** Camaj e Pipa kanë dhënë kompozitat: **sy-zbrazët**, **syzhgjetues**. Në Fjalorin e ’54 e FGJSSH (2006) kemi mjaft ndërtime me emrin **sy**, si: **sykaltër**, **sykeq**, **syshkruar** etj., janë 47 ndërtime mbiemërore, por këto dy kompozita s’janë të pasqyruara. (...*dhe kur kalojnë ato përmes dheut të shthurun, pa prita e me erë të ngrime ndër degë, sy-zbrazët e pa mallin që kishte Dranja vetë për largësina të fshehta...*M. Camaj, Dranja, f. 62); (...*ju çerdhe shkabash qi na bani burra / krenarë e t’rreptë e syzhgjetues si shkabat...*A. Pipa, Libri i burgut, f. 119). Në ndërtimin e kompozitave: **buzëshpërvjelun**, **ballëshpërvjelun** (Camaj) e **krahshpërvjelun** (tek Pipa), autorët kanë marrë si element të parë emra që tregojnë pjesë të trupit, ndërsa mbiemrin e kanë të përbashkët si p.sh.: (...*Mbi sukë qëndronte në kambë një pelë. Hingëllonte buzëshpërvjelun e kërcente rrëmbyeshëm përpjetë a thue dashkej me u kapë në qiell...*M. Camaj, Shkundullima, f. 149); (...*kjo ishte një tip vajze e hollë, buzëmprehtë, ballëshpërvjelun e tepër të gjanë për fytyrën që kishte...*M. Camaj, Djella, f. 115); (...*e ndër vneshtat mbi shpat / krahshpërvjeluna vasha faqequqe...*A. Pipa, Libri i burgut, f. 165). Shfrytëzimi i leksikut popullor nga të tre këta shkrimtarë duket mjaft qartë tek përdorimi i leksemës **krahthatë**. Kjo kompozitë del e përdorur që tek Epika Legjendare.¹ (...*bariu krah-thatë te ura e zjarmit lodhet / nërmend / për dhitë damtare përjashta...*M. Camaj, Njeriu me vete e me tjerë, f. 182). Koliqi dhe Pipa e kanë përdorë këtë kompozitë si një emër, ndryshe nga Camaj. (...*Jorgji, trashigimtar i virtyteve e i meritave të rralla patriotike të krahëthatit...*E. Koliqi, Shija e bukës mbrume, f. 56); (...*por erdh fashizmi qi për lau Europën / e fati ynë i zi / atij ndër t’parët ktu ja fali copën / mbi krahthatën Shqipni...*A. Pipa, Libri i burgut, f. 53). Tek të tre këta autorë kemi ndërtimin e kompozitave me emrin **fat**: **fatkeq**, **fatzezi** (Camaj), **fatbardhë**, **fatlum** (Koliqi), **fatzezë** e **fatshkretue** (Pipa), por veçojmë leksemën **fatshkretue** të Pipës (emër + pjesore),

ndërtim i cili në FGJSSH (1980), f. 485, del me trajtën fatshkretë (emër +mbiemër). (...*Ku na len, ah, mue fatzezën, / tande motër fatshkretue...*A. Pipa, Libri i burgut, f. 21). Në FGJSSH (2006) kemi fjalën **orë** të përdorur në mitologji si figurë e besimeve popullore shqiptare ku kemi shembujt: *orët e bardha, orët e liga, ora e njeriut, ora e shtëpisë etj.*, ndërtimet: *orpreme* (Koliqi), *orzezë* (Pipa) janë të pasqyruara në FGJSSH (1980), kurse kompozita: *ora-gjarpën* (emër+emër) (te Camaj) nuk del e pasqyruar, çka vërteton përpjekjen e shkrimtarit për ndërtimin e formave të reja duke shfrytëzuar leksemat e shqipes. (...*i a vejshin vendlindjes orpreme fajin e vuetjeve...*E. Koliqi, Shija e bukës mbrume, f. 61); (...*me lanë qi nata e shtypjes ma orzezë / mbi dhe të dyndë hije...* A. Pipa, Libri i burgut, f. 54); **ora-gjarpën** (...*E ujë kurr nuk piu \ Sall tambël gjiu grueje n'gjumë. \ Ora-gjarpën s'pui kurr ujë!*..M. Camaj, Legjenda, f. 186). Në bazë të strukturës: **emër + emër prej foljor vepruesi** tek Camaj kemi kompozitën: *mrekullibamëse*, tek Koliqi: *mrekullbase*, ndërsa tek Pipa kemi ndryshim strukture: *mrekullplotë*. Në FGJSSH (2006) kemi të dhënë vetëm fjalët e prejardhura: *mrekulloj* (folje), *i mrekulluar* (mbiemër), *mrekullisht e mrekullueshëm* (ndajfolje), ndërsa në FGJSSH (1980), f. 1177 del trajta e standardit: *mrekullibërës*. (...*diçka si hajmali mrekullibamëse që shpërthente edhe detin...* M. Camaj, Pishtarët e natës, f. 42); (...*i cili pa qenë në zotnim vërtytesh mrekullbase...*E Koliqi, Shija e bukës mbrume, f. 109); (...*E nji prrallë / mrekullplotë për atë tregojnë...* A. Pipa, Rusha, f. 58). Në grupin **emër + ndajfolje**, duam të veçojmë kompozitat: *fshehësiplotë* të Camajt, *heshtim – plotë* të Koliqit të cilat nuk janë të pasqyruara në Fjalorët e marrë për krahasim, ndërsa kompozita *hareplotë* e Pipës del e dhënë. **fshehësiplotë** (...*të marrin me mend se qenësit fshehësiplotë ndër Gurra mund të ishin vetëm Zana e Orë ...*Pishtarët e natës, f. 33). Camaj ka arritë të shfrytëzojë lemat *fshehësi* dhe *plotë* që janë të pasqyruara në FGJSSH (2006), për ndërtimin e trajtës mbiemrore *fshehësiplotë*. (...*ndër hymne hareplote / tue e përkundun lehtë...*A. Pipa, Libri i burgut, f. 106).

Në grupin e fjalëve të përbëra, me interes janë disa ndajfolje të formuara sipas tipit kompozim + ndajshitesim ku bashkimi i dy temave ose fjalëve shoqërohet edhe me një prapashtesë¹. Prapashtesa më e parapëlqyer e Martin Camajt në këto kompozita është –as (ndjellakeqas, prishakandas, gazakeqas etj.), kurse tek Pipa ndeshim pak ndërtime me ndajshitesën shëm-. Mbi bazën e lemës *mirë* (të përbashkët) kemi kompozitat: *mirakandas, miradishëm*. (...kundronte **mirakandas** gjakimin e pashëm të nobelistit...M. Camaj, Rrathë, f. 115); (...simbas **mirakandes** së vet...Rrongoja në mars, f. 165). Ndërsa në FGJSSH kemi trajtën emërore *mirakandje*, trajtë që del e përdorur edhe tek Koliqi, ndërsa kompozitat me prapashtesën –as, -es nuk dalin të dhëna. **miradishëm** (...*At'herë dhe gjaku i juej jo kot ai birret, / dëshmorë të t'gjitha kohnave. Dhe tye / te pyrgu yt, aty, o fatos i kombit, / miradishëm ta ngren ai përmendoren...* A. Pipa, Libri i burgut, f. 20).

Gjatë një analize të shkurtër bërë gjuhës së shkrimtarëve: Camaj, Koliqi e Pipa vërejmë që këta autorë u përpoqën të sjellin ndërtime të reja duke shfrytëzuar mjetet fjalëformuese të shqipes.

Tek Camaj vihet re denduria e ndërtimit të mbiemrave e ndajfoljeve me parashtesën për-. Në krijimet e tij ai bëri një hap për të qenë sa më afër gjuhës standarde, dukuri të cilën nuk e vëmë re tek Koliqi e Pipa. Në krijimtarinë e Koliqit të bie në sy pasqyrimi i ndërtimeve ndajfoljore me ndajshitesën –isht. Koliqi nuk ishte i prirur të përdorë me fanatizëm të folmen e vendlindjes, por të zgjedhë ato forma që sipas autorit ishin më të pranueshme dhe më të përgjithshme. Pipa në veprat e tij parapëlqen trajtat dialektore, por një gjuhë më të zbutur. Camaj, Koliqi e Pipa arritën të shfrytëzonin ato mjete fjalëformuese të shqipes të cilat mund

KUMTESA

të kenë qenë jashtë shqipes standarde, duke u përpjekë të përfshihen në leksikun e mbarë shqipes. Këta shkrimtarë shquhen edhe në ndërtimin e shumtë të kompozitave (sidomos mbiemërore) duke shfrytëzuar leksemat e përbashkëta të shqipes.

Veçori e gjuhës tek të tre këta shkrimtarë paraqet interes, sepse ato shkruan një shqipe larg standardit, duke parapëlqyer më shumë trajtat e përbashkëta dialektore.

Recenzentë:
Prof.dr.Tomor Osmani
Prof.dr.Mimoza Priku

Dr. Mirela (MITA) SINANI¹: VËSHTRIM FILOSOFIK PËR GJUHËN SHQIPE. RRETH MËNYRËS SE SI NORMA GJUHËSORE E TË SHKRUAJTURIT MUND TË NDIKOJË NË HUMBJEN E KUPTIMIT TË FJALËS. (RASTI: NGA FILOSOFIA- DITURIA TEK FILOZOFIA)

¹Universiteti i Tiranës

1. Probleme të formësimit të dijes

Vite më parë, kur punoja për redaktimin e Fjalorit të Filosofisë të përgatitur nga Prof. Akademik Ekrem Myrtezai, sintezë e një pune të mundimshme rreth 25 vjeçare, ndesha në një problem, që për mua si studiuese e filosofisë, ishte shqetësues. Mbi ballinën e librit shkruhej shqip *Fjalor i Filozofisë*. Të gjithë studiuesit e filosofisë, por edhe studiuesit e degëve të tjera të dijes, e fillojnë punën duke u prezantuar me fushën e dijes, me atë *çfarë* studion dega përkatëse. Në rastet kur fusha e dijes emërtohet sipas termit origjinal shkencor, shpjegimi etimologjik i termit është hapi i parë që na qartëson. Në këtë rast, është mbajtur termi origjinal, por është ndryshuar në shkrim nga *sofia* në *zofia*. Pasoja është e drejtpërdrejtë. Krijohet një mospërputhje mes seriozitetit të punës shkencore që përmban fjalori, dijes mijërvjeçare të grumbulluar aty, që pretendon saktësi, dhe mënyrës si prezantohet kjo dije në ballinë me një formë të gabuar. Kjo ndodh pikërisht me emërtimin e filosofisë, e cila historikisht është pema e madhe e dijes prej nga, më pas, u shkëputën dhe u pavarësuan format e veçanta të dijeve shkencore. Krijohet një paradoks. Ne pretendojmë dhe shkencërisht pranohet se gjuha shqipe është një nga gjuhët më të vjetra, ndërsa nga ana tjetër, emrin e kërkimit të dijes që na vjen nga lashtësia, e shkruajmë të shtrembëruar(!).

Lindin të paktën dy probleme të njohjes:

-A mundet një gjuhë të pretendojë se i përket një kulture tepër të lashtë, që do të thotë se është lëvruar për mijëra vjet, e të mos respektojë kriteret e saktësisë së kuptimit të fjalëve?

-A është ky gabim një gabim që e mbart vetë gjuha shqipe, apo është një gabim i prejardhur nga puna njerëzore? Si studiues kemi të drejtë ta shtrijmë dyshimin 360° duke renditur shkaqe që nga ato që thjesht karakterizojnë procesin e sendërtimit të çdo njohjeje njerëzore siç është niveli jo i plotë i dij^{es} deri tek shkaqe më të thella të ndikimeve gjeopolitike dhe poshtëruese raciste në fushën e gjuhës shqipe, kur dihet se gjuha është dija që përmban lëngun limfatik të shtyllës kurrizore të një kombi. Shqiptarëve u është dashur të mbijetojnë. Gjuhës shqipe po ashtu.

Në këtë mënyrë vijmë **te problemi i mënyrës si formësohet dija dhe i kriterëve që duhen respektuar** për një dije shkencore, jo sipërfaqësore, të përkohshme, doxa -një opinion.

Ne kemi ndryshuar tashmë mënyrën e jetesës, sisteme të të menduarit e të të vepruarit. Këto ndryshime duhet të ndodhnin edhe në mënyrën e formësimit të dijeve. Vërejmë se ende, 20 vjet pas hapjes ndaj gjithë dijes botërore, në shumë studime e diskutime shkencore vazhdojnë të ruhen e të përdoren koncepte të trashëguara nga shkollat lindore, të njëanshme dhe shpesh të ideologjizuara të tilla si ndarja objekt-subjekt njohjeje, prioritet i

realitetit objektiv, pasqyrim i saktë i realitetit, pasqyrim me vërtetësi, përputhje me realitetin, etj. Shumë studime ndërtohen me skemat e konceptimit objektiv materialist dialektik, trashëgimi e dijes socialiste të burokratizuar. Shumë botime janë vetëm tërësi citimesh, megjithëse e drejta e autorit e ndalon rreptësisht këtë. Të tjera “studime” ndërtohen sipas metodës që studiuesi anglez Collingood e quan metoda e “prerje-qepjeve”- vetëm parashtrajnë koncepte dhe teori të përpunuara nga autorë të ndryshëm, pa asnjë parashtrim vetjak të studiuesit, për çështjen në fjalë, pa asnjë pozicionim ose kritikë,- copy-paste të autorëve të ndryshëm, gjithashtu e dënueshme. Botime të tilla jo të pakta, implikojnë drejtpërdrejt probleme të etikës dhe të saktësisë së dijes. Shkencëtarët përkatës të fushës, mbajtësit e titujve, nuk mund të bëjnë indiferentin, as të hiqen sikur kjo nuk ndodh. Të tilla botime i gjejmë që nga ato me mbështetje të Akademisë së Shkencave deri te shpërthimi i botimeve universitare, ku mjaftojnë nja dy vjet për të “lindur” shkencën dhe ku përvetësimet e punës së brezave të tërë të studiuesve janë të zakonshme. Me këtë lloj “shkence” kemi prodhuar dhe prodhojmë aq shumë shkencëtarë sa konkurrojmë vendet më të zhvilluara. Por nëse duhet të shkojmë në BE, duhet të fillojmë të zbatojmë edhe ligjet që mbrojnë të drejtat e autorit, edhe standartet e ndërtimit të dijes shkencore.

Filosofët janë shqetësuar gjithnjë për mënyrën si ndërtohet dija. Prej këtej ky shqetësim u bë pjesë edhe e punës kërkuese në shkencat e veçanta. Filosofët kanë këmbëngulur prej shekujsh se një dije mban vulën e vërtetësisë atëherë kur ajo karakterizohet nga qartësia, plotësia, mungesa e kontradiktave të brendshme, dhe verifikueshmëria e vazhdueshme në praktikë.

2. Kuptimësia gjuhësore dhe rishikimi i normës gjuhësore

Nga ky këndvështrim filosofik, lind pyetja: Përse disa norma ose rregulla, të vendosura në një kohë të caktuar, që sjellin pasoja mjegulluese dhe keqkuptime, në kthjelltësinë dhe saktësinë e gjuhës shqipe, duhet të na imponohen për tërë jetën? Formalizmi dhe paaftësia janë ato që e kanë vrarë kuptimin e vërtetë të fjalës Filozofi dhe e kanë fshirë ekzistencën e Dashurisë për Dije. Mënyra si shkruhet në shqip me “z” çon në një rrënjë “zoo” që e trupëzuar në fjalë na jep përfundimin *dashuri për... kafshë(!)*. Vallë, këtë kanë dashur studiuesit tanë, shkencëtarë të gjuhës shqipe, kur kanë vendosur që kjo fjalë, megjithëse e huaj, t’i nënshtrohet një rregulli që është ndërtuar për fjalë shqip?

Për cilindo që flet një gjuhë, po ashtu për gjuhën shqipe është thelbësisht e rëndësishme të dimë mirë *Çfarë flasim e themi*. U ndala tek fjala Filozofi si fillesa e dijes. Çështja është më e gjerë se kaq. Përmes shtrimit të këtij problemi synoj **një rishikim të normës gjuhësore**, jo nën këndvështrimin e ngritur në tryezat e dialogëve të mbrapshtë që duan të mbivlerësojnë njerin dhe të fajësojnë tjetrin dialekt, -debate qartazi të nxitura artificialisht, pjesë e strategjive për të shpikur kundërshti themelore veri-jug, që çojnë në ndarje. Për ata që kanë ngritur këto çështje, rikujtoj se dialekti toskë është dialekt vetëm i një pjese të Jugut të Shqipërisë, pavarësisht se është marrë si bazë për krijimin e gjuhës letrare të njehsuar. Edhe në jug ka larmi dialektesh dhe pasuri gjuhësore që kapërcejnë caqet e gjuhës së njehsuar e që shprehen aq fuqishëm në këngët, shprehjet popullore dhe kudo në format e artit të fjalës me thekset e veçanta dialektore të Labërisë, Bregdetit, Myzeqesë, Beratit, Korçës, etj.

Problemi shtrohet **nga pikëpamja e kuptimësisë gjuhësore**, jo e dialektit të zgjedhur për t’u ngritur në normë. Logjika kërkon para së gjithash, të respektohet realiteti i gjallë, i cili i ka dhënë jetë fjalës. Të respektohet realiteti i gjallë, që shprehet në përmbajtjen e fjalës, pastaj të shprehim zotësinë në ndërtimin e rregullave që fiksojnë kuptimësinë brenda

formateve të caktuara tingullore, që nuk e lenë përmbajtjen të rrëshqasë drejt shumëkuptimisë. Mungesa e ndonjë rregulli fiks, pranimi i shmangieve, mund të mos jetë mangësi gjuhësore, përkundrazi epërsi, sepse le të hapur shtegun për të zbuluar burimin origjinal të fjalës, për të kuptuar tërë përthyerjet që e njejta fjalë merr gjatë kalimit nga një luginë në tjetrën deri sa një “a” transformohet në “o”, “e”, “ë” (oj mam’, oj mome, moj mëmë, moj nan’, mi none, me nëne, moj nënë). Si studiuese e filosofisë, respektoj specifikat e kërkimit gjuhësor. Si studiuese e filosofisë mbaj këndvështrimin filosofik që lidhet me problemin “a” të çdo gjuhe- kuptimi i mbartur në fjalë, përcimi i dijes. Kuptimi vjen përmes gjithë fjalës, por fjala përbëhet nga tinguj dhe këta varen nga shqiptimet dhe lakimet që merr gjuha. Pylli përbëhet nga një shumicë pemësh. Nëse priten pemët, një, dy... dhjetë pemë të mbetura janë vetëm “ca pemë”, nuk janë më “pyll”.

Çështja është që tingujt dhe rrokjet themelore që mbartin kuptimin rrënjë të fjalës, duhet të mbeten të paprekura. Në çdo gjuhë të zhvilluar ka përjashtime nga rregulli. Problemi është sa janë të argumentuara rregullat dhe përjashtimet, **çfarë baze kanë ato**. A duhet vrarë fjala, kuptimi, për hir të një rregulli apriori? Në rastin e fjalës Filozofi, rregulli shqip është zbatuar tek rrënja e një fjale nga një gjuhë e lashtë, duke e çnatyruar nga *kërkim i dijes* në kërkim i “zo...fisë”. Për më tepër që vetë gjuha shqipe pranon që edhe mes dy zanoreve të shqiptohet “s”. A duhet flakur tej thesari i gjuhës së gjallë, pse kështu kanë vendosur dikur disa gjuhëtarë ?

3 Gjuha si përmasë ekzistenciale e njeriut. Fenomeni i pastrimit të gjuhës shqipe nga huazimet dhe pasojat e tij

Rëndom gjuhën e konsiderojmë mjet komunikues i pazëvendësueshëm. Nga pikëpamja filozofike ky trajtim mekanik e sipërfaqësor, është thellësisht vстарar. Një mjet mund të lihet mënjane dhe të rimerrret sa herë je në nevojë. Gjuha është e pandashme nga kontinuiteti (vazhdimësia) jetësor ekzistencial njerëzor. Bergsoni përmes filosofisë së intuitës e pa gjuhën të paaftë të shprehë kohën e kulluar që rrjedh brenda njeriut, pa e kufizuar, burgosur, vrarë dhe shtrirë në hapësirë nëpërmjet fjalëve. Sartri si ekzistencialist zbuloi një tjetër pamje të gjuhës. Konceptet, fjalët e gjuhës me përcaktimet e tyre na fusin në një botë të mirërregulluar dhe na fshehin ekzistencën reale të njeriut, që kapet vetëm papritmas si një revelacion (zbulesë).

Në linjën ekzistenciale të mendimit shtoj se nëse njeriu ekziston dhe kjo ekzistencë çelet, hapet, gjuha është përmasa e çeljes ekzistenciale të njeriut. Gjuha është mënyra (theksoj-jo mjeti) e shprehjes së brendësisë njerëzore, shtrati ku ndjenjat, emocionet, pasionet fiksohen në bashkime tingujsh kuptimorë-fjalë dhe hapsinohen, duke u bërë të njohura edhe për të tjerët. Si mbartëse të kuptimeve thellësisht ekzistenciale për njeriun, fjalët e gjuhës përcaktojnë raportet njohëse që vendos njeriu me botën rretheqark. Nga bazimi në këto përcaktime varet edhe saktësia e njohjes sonë.

Një tendencë e vërejtur në gjuhësinë shqipe është ajo për ta orientuar shqiptimin e shumë fjalëve sipas gjuhëve perëndimore: frëngjisht, anglisht. Si mund të pretendojmë lashtësi të gjuhës sonë, kur heqim lidhjet me elementët më të vjetër gjuhësorë, për t’i zëvendësuar me shqiptime nga gjuhë relativisht më të reja? Kjo tendencë erdhi si pasojë e përpjekjes për ta pastruar gjuhën shqipe nga huazimet. Ndërsa pastrimi nga huazimet osmane ishte më i lehtë, puna ishte shumë më e vështirë me huazimet nga ndikimet e krishterimit përmes gjuhëve latine dhe greke. Këtu, bashkëjetesa shkonte në mijëra vjetë.

Ndodhën dy dukuri të gabuara:

Së pari, u flakën mjaft fjalë si huazime latine dhe greke, të cilat me mundësitë e zgjeruara që ekzistojnë sot për verifikimin e dijeve duhet të rishikohen.

Së dyti, mjaft fjalëve të tharmit shqip, u është ndryshuar shqiptimi për të hequr gjoja ndikimin ortodoks dhe u është dhënë një shqiptim i huazuar nga gjuhë perëndimore, psh., gjuha frënge.

Veprimi i parë ka shpronësuar mjaft fjalë origjinale shqipe dhe ua ka falur gjuhëve latine dhe greke, duke e mbushur plot thesare të vyera shportën e fqinjëve. Veprimi i dytë ka shpronësuar një numër edhe më të madh fjalësh, duke u ndryshuar atyre qoftë edhe një tingull në shqiptim, -fjala ka humbur origjinën dhe kuptimin themelor të saj. Për ta kuptuar sot një fjalë, dikur krejt shqipe, duhet t'u drejtohem për shpjegim gjuhëve perëndimore.

Ka patur një trysni për pastrimin e gjuhës shqipe prej ndikimeve ortodokse. Kemi të drejtë të mendojmë se ka patur një konkurrencë të fshehtë mes fuqive me interesa të drejtpërdrejta në trojet shqiptare. Gjuhës shqipe iu la vetëm një shteg i hapur: Ajo mund të marrë fjalë hua prej gjuhëve perëndimore, më të reja, mjaft që të mos akuzohet se është nën ndikim latin ose ortodoks. Në këtë mënyrë, copëtimi i dikurshëm i trojeve shqiptare, u shoqërua fatkeqësisht, jo vetëm me copëtim gjuhësor në favor të gjuhëve gjitane latine e greke, por sidomos me një sakatim të gjuhës shqipe: këtë radhë prej paditurisë së gjuhëtarëve shoqëruar me pamjaftueshmërinë e dokumentave që provonin autenticitetin e fjalëve shqipe.

Ndodhi ajo dukuri që filosofi Xhan Batista Viko që në shekullin XVII e quante “falsitet i burimeve” ose “ngatërrim skolastik i kombeve”, sipas së cilës nëse dy popuj kanë ide ose institucione të ngjashme, patjetër njëri e ka mësuar nga tjetri. Kulturat sunduese janë ato që u imponojnë popujve në takim me to, institucionet e veta. Popujt e tjerë shihen si të paafte intelektualisht dhe pa forcë krijuese që të mund të zbulojnë dhe krijojnë vetë, pa i marrë prej të tjerëve. Për rrjedhojë në fushën e gjuhësisë, prej këtij gabimi, pohohet rrjedha huazuese njëkahëshe prej kulturave më të fuqishme dhe mohohet rrjedha në kah të kundërt nga popujt e tjerë drejt gjuhëve të kulturave sunduese. Ky qëndrim ndaj gjuhës shqipe fsheh në thelb edhe pikëpamje raciste antihistorike, që dallimet në institucionet sociale (mes tyre edhe gjuha) janë rrjedhojë jo e përvojave historike, por rrjedhojë e veçorive të lindura të racave më superiore, në këtë rast raca greke dhe ajo romake.

Për ta qartësuar çfarë mund të ketë ndodhur me gjuhën shqipe, çfarë përmasash mund të ketë shpronësimi i fjalëve nga shqipja, le të shohim çfarë mund të përftojme nga një dëshmi e dhënë nga filosofi i shquar italian, Benedeto Kroçe. 110 vjet më parë, duke folur për kuptimësinë e fjalës, ai përmend një nga mënyrat e fjalëformimit të përdorur gjerësisht që periudhat më të hershme, mënyrën onomatopeike: Emërtimi i sendeve, dukurive, objekteve sipas zhurmës ose tingullit që lëshojnë. Kroçe përmend se kjo metodë ka marrë edhe emrin teoria e “uau-uau”, sipas tingujve që lëshonte kafsha, e cila pikërisht në greqishten e vjetër u emërtua sipas qarjes. Bëhej fjalë për një kafshë besnike të njeriut, *qeni*. Në latinisht *cane*. Gjuhësia shqipe fjalën “*qen*” e shpjegon si fjalë me origjinë latine: *cane*. Historikisht mbetet që ilirët, kafshën shtëpiake e patën lënë pa emër, derisa u shpik gjuha latine, ose meqë gjuha latine ishte gjuhë kulture, paskan dashur ta nderojnë mikun besnik, dhe kanë marrë fjalën prej Romës duke e pagëzuar *cane*. Po ta shohim me kujdes, fjala latine *cane* nuk ka asnjë lidhje me ndonjë grup tingujsh që përbëjnë të qarën- sipas shpjegimit të dijetarëve të lashtë që përmend Kroçe (në gjuhët perëndimore uau-uau) . Ne në gjuhën shqip themi “*qan*”, në një formë më të hershme që ekziston edhe te arbëreshët e Italisë “*kjan*”; duke rënë “*j*” vjen *kan*, *cane*. Mbështetur te dijetarët e lashtë, kafsha që bën *uau-uau* pra, *kjan*; emri i saj është “*që qan*”, “*që kjan*”, në latinisht: *kan-cane*. Në gjuhën shqipe fjala e latuar gjatë të folurës

del me zanoren “e”, “*gen*”. Nga ana tjetër, mbështetur krejtësisht drejtpërdrejt në mënyrën e të qarit të kafshës, tingujt e saj në shqip janë *ham-ham*. Këtej me *h* të fortë dhe me ndryshim të *m* në *n*, fjala del *kan*. Mirëpo në gjuhët latine qeni bën uau-uau dhe jo ham-ham. Për rrjedhojë teoria në përfundim duhej të quhej “teoria e ham-ham-it”, që të justifikonte emrin *kane* (*cane*). Që t’i vemë krye punës, saktë, origjina e fjalës *gen* nuk është gjuha latine. Qeni qan, është shqip! Edhe kur leh *ham-ham*, kjo është në shqip. Sikur të ishte kërkuar me kujdes dija, dhe kjo është detyra e shkencëtarëve, nuk do t’i bëhej dhuratë kjo fjalë kaq e bukur dhe kuptimplote në shqip një gjuhe të huaj.

4-Bazimi i çështjes. Filozofia për kuptimësinë e fjalëve

Në fillim të shekullit të 20-të një varg filozofësh çelën shtigje të reja mendimi: Detyrë e filozofisë nuk është të bëjë zbulime, por *qartësime*, pra *të merret me kuptime*. Ky studim është në këtë rrjedhë. Filozofi Gilbert Ril tërhoqte vëmendjen se në jetën e përditshme ne përdorim me statusin e shprehjeve të sakta mjaft “shprehje që gënjëjnë sistematikisht”. Nën këtë këndvështrim edhe fjala filozofi siç e përdorim të shkruar sipas normës së sotme gjuhësore shqipe, a nuk është një fjalë që gënjën, sepse nuk çon te burimi i dijes, kërshëria për *me dit*’, dashuria për **dije**, por largon nga ai drejt **zo**...?

Analiza filozofike synon të parandalojë shprehjet e pasakta shkencore, duke kontrolluar qartësinë dhe kuptimshmërinë logjike të fjalës.

Falë të dhënave që na përmend Benedeto Kroçe, ne kemi të qartë kuptimësinë logjike të fjalës “qen” dhe kemi të drejtë t’ia kthejmë meritën për origjinën e fjalës gjuhës shqipe dhe popullit që e ka folur këtë gjuhë.

Filozofi anglez Mur e shikonte si detyrë të filozofit të analizojë gjuhën për ta qartësuar gjuhën e zakonshme dhe për t’ia nënshtruar gjuhën provës së logjikës në kuptimin e saj. Në të njëjtën vijë mendimi është edhe ideja e Vitgenshtejnit, që më 1919 se “çfarëdo që *mund* të thuhet, *mund* të thuhet me saktësi”.

Synimi i këtij punimi është të tregojë pikërisht se ne duhet t’i themi fjalët shqip, saktë duke ia nënshtruar logjikës kuptimin e tyre.

Në përfundim mund të themi se:

1- Është tezë e padiskutueshme shkencore se gjuha shqipe është gjuhë indo-europiane. Për rrjedhojë, në *rrafshin gjeografik*, ka një rrjedhë hapsinore prej Azisë drejt trojeve ku aktualisht flitet prej shqiptarëve që nga lugina e Preshevës, Medvegja, Bujanovci, Mitrovica, Shkupi, Ulqini e deri në Artë apo në fshatrat rreth Athinës. Gjithashtu, *gjeografikisht*, ne jemi fqinjë me atë truall ku në lashtësi lindën Shkollat e para Filozofike, që do të thotë se *natyrshëm* kemi patur shkëmbime kulturore me kulturën më të zhvilluar të lashtësisë dhe shkëmbime kulturore të orientuara në këtë drejtim që nga thellësitë e historisë. Për këtë arsye janë të natyrshme edhe fjalë të prejardhura prej brumit të gjuhës së lashtë greke dhe s’ka arsye pse të ushqejmë qendrimet fobike.

2- Në *rrafshin gjuhësor*: Shkencëtarët mbështesin tezën e vazhdimësisë iliro-shqiptare e, për rrjedhojë edhe të gjuhës shqipe nga ilirishtja. Bëhet fjalë për një lashtësi të paktën 2500 vjeçare. Për rrjedhojë, gjuha ilire me dialektet e saj është bashkëkohëse me gjuhën e lashtë në të cilën u lëvrua filozofia që prej kohës së Thalesit, Heraklitit, Sokratit, Platonit, Aristotelit, gjuhë të cilën nuk duhet ta ngatërrojmë me gjuhën artificiale helene (nga vjen greqishtja e sotme) të krijuar nga rektorët nëpër katedrat universitare duke filluar nga periudha e Aleksandrit e më pas në periudhën bizantine. Si një gjuhë e lashtë, ilirishtja jonë mund të ketë marrë, por edhe mund t’i ketë dhënë gjuhës që ishte gjuha e diturisë. Gjuha shqipe sot i mban gjurmët e periudhës politeiste, pagane, që është shumë më e vjetër sesa

periudha monoteiste gjatë së cilës u konsolidua gjuha greke apo ajo latine. Pretendimet e studiuesve tanë për një numër të madh fjalësh të huazuara nga greqishtja nën ndikimin e ortodoksisë, po ashtu edhe për një numër të madh fjalësh të huazuara nga latinishtja nën ndikimin e fesë katolike vihen në pikëpyetje. Sigurisht ndikime ka, por nën këtë dritë, ndoshta nuk janë të atyre përmasave. Faktet historike dëshmojnë se në fushën e besimit shqiptarët kanë ruajtur zakonet e tyre pagane shumë më fuqishëm dhe i kanë ushtruar paralelisht me besimet monoteiste edhe pasi këto u fuqizuan institucionalisht dhe u kthyen në besime sunduese. Për rrjedhojë, nuk gjej asnjë arsye që shqiptarët të flaknin më lehtë fjalët e gjuhës, sesa zakonet pagane. Përkundrazi, historia dëshmon në favor të qendrueshmërisë gjuhësore në raport me atë zakonore. Popujt, në këtë mes edhe populli shqiptar, kanë ndryshuar shumë mënyra jetese, sjelljesh, deri bindje fetare e perëndi, por kanë ruajtur gjuhën.

Gjithashtu, në *rrafshin gjuhësor*, në gjuhën shqipe, si studiuese e filosofisë identifikoj fjalë bazë me një origjinë dhjetëra mijëra vjeçare, që nga periudhat më primitive të shoqërisë njerëzore. Këto fjalë, ngado që të kenë ardhur, kanë lenë gjurmë në konstituimin shpirtëror të gjuhës shqipe, të mendësisë shqipe, të urtësisë, të mënyrës së kuptimit të botës. Rilindasi ynë i madh Jeronim De Rada, i cilësuar nga bashkëkohësit europianë Homeri i dytë, vërente shumë kohë para se shqiptarët të organizoheshin për çështjen e kombit të tyre, se grekët i kanë emërtuar perënditë përmes fjalëve shqip. Nuk do të ishte çudi sikur edhe arti i lashtë ose filozofia të kenë pirë ujë në një burim me gjuhën shqipe. Duke iu rikthyer shembullit të fjalës filozofi.

3-*Në rrafshin historik*: Pushtuesit dhe fetë e kanë konsideruar gjuhën shqipe gjuhë të mallkuar si gjuhë pagane. Pavarësisht pengesave dhe ndalesave, pavarësisht traumave historike të eksodeve masive të popullsisë drejt gadishullit Apenin, gjuha shqipe me dy dialektet bazë të saj, brenda dhe jashtë territorit të shtetit shqiptar, nuk ka thyerje aq të thella sa vërehen në dialektet e popujve të tjerë që e bëjnë të pamundur komunikimin e njerëzve nga krahina të ndryshme pa ndërmjetësinë e gjuhës së njehsuar. Këtej mund të ngremë hipotezën se dy dialektet e sotme nuk janë dy farë prej nga është ushqyer dhe rritur gjuha e sotme shqipe, përkundrazi ka mundësi të ketë ekzistuar një gjuhë e njehsuar (në mënyrën e saj të lashtë) shumë kohë përpara krijimit të gjuhëve të kulturave të mëdha greke e latine. Prej kësaj është e njëjta gjuhë e frytëzuar në dy mënyra të ndryshme shqiptimi, sipas përshtatjeve, afrimeve dhe largimeve me kultura të ndryshme. Përsa i përket rastit të fjalës Filozofi, të paktën, që me krijimin e shtetit të pavarur shqiptar dhe hapjen e shkollave shqipe fjala është folur dhe shkruar “filoSofi” dhe “filoSofët”;

4-*Në rrafshin praktik*: Gjuha e folur shqipe ka një diapazon të tingujve mjaft të gjerë që na jep mundësi të shqiptojmë saktë edhe fjalë të lashta si fjalët “sofia”, “sofistët”, madje edhe “filozofia” në gjuhët e huaja. Është shumë saktë kur shqiptojmë “filozofia”, ndërsa është tmerr kuptimi që merr fjala për një “z” e çnatyruar në *Zoo...fi?* Me “zo...finë” gjuhëtarët tanë na kanë kthyer në 1913, atëherë kur të huajt talleshin se shqiptarët kishin bisht! Gabim i vockël fare i pafajshëm?!...

Rilindasit na dhanë edhe një fjalë të re që përkon me fjalën e lashtë-Dit Uria, uria për me dit’: Kjo është filoSofia. Mbetet të zgjidhni ose kopshtin e dijes, ose kopshtin zoologjik!

Rikthimi në kërkimin e gjuhës shqipe duhet t’i japë fund epokës së servilizmit ndaj kulturave të tjera dhe të shkencës servile të politikave të huaja. Ne kemi nevojë të njohim veten tonë, gjuhën tonë. Rikthimi i pasurisë së çmuar gjuhësore popullit që e flet këtë gjuhë është detyrim për cilindo studiues të gjuhës. Është detyrë e veçantë vetëdijësimi për

KONFERENCA VJETORE E SHKENCËS 'JAVA E SHKENCËS 2012

pavarësimin e gjuhës këtë 100 vjetor të shtetit të pavarur shqiptar. Gjuha ka nevojë të dalë në dritën e diellit. Dija ka nevojë të vihet mbi themele të forta. Kur ta kryejmë këtë, ndoshta një qiell i ri do të hapet për dijen. Ndoshta edhe filozofia e lashtë do na thotë ndonjë fjalë shqip!

Recenzentë:

Prof.dr. Gjergj Sinani
Prof.dr Gjergji Pendavinji

KUMTESA

Abdullah ZYMBERI: PRURJE TË REJA LEKSIKORE NGA DISA TË FOLME POPULLORE

Të folmet popullore janë mburojë e të ruajturit të fjalësit të një gjuhe e edhe të shqipes në këtë rasë. Gjuha e shkruar e shqipes filloi të zhvillohet, veçmas pas Kongresit të Manastirit, duke e lënë mbanë gjuhën popullore. Mirëpo, për fat të mirë, të folmet popullore u zhvilluan vetvetiu, sepse ato kishin filluar së zhvilluari për disa shekuj më parë. Ato nuk ishin vetëm ruajtëse e fjalësit të shqipes, por edhe e zhvillimit dhe e pasurimit të tij nëpër rrymë motesh. Me fjalë të tjera, ato nuk ishin vetëm konservime të këtyre fjalësi, por edhe risime të tij. Në të folmet popullore ruhet fjalësi me brumë të shqipes, por për fat të keq kjo shtresë e tij u la atje, pikërisht në gjirin e popullit për të mos u prekur prej dorës së leksikografëve tanë gati gjatë gjithë jetës së tij. Në këtë dhjetëvjetëshin e fundit është punuar diçka rreth kësaj çështjeje me rëndësi të dorës së parë, mirëpo sa duhet-jo dhe jo se jo. Detyrë parësore dhe e përhershme e leksikografëve, e gjuhëtarëve, e mësuesve të shkollës dhe e çdo intelektualit tjetër është që të qëmtojë fjalë të gurrave popullore dhe t'i zditë në të gjitha mjetet e informacionit, për t'u bërë pastaj pronë e secilit njeri. Kjo do të ishte barra kryesore e të gjithë dashamirësve të gjuhës.

Për të mos e lodhur dëgjuesin, për shkaqe kohe, do t'i marrim nëpër duar disa fjalë gurrash popullore, të cilat s'e kanë parë dritën e botimit asnjëherë dhe, mendojmë ne, janë me burim të shqipes. Të folmet popullore kanë krijuar dhe nuk kanë reshtur së krijuari gjatë gjithë zhvillimit njerëzor këtë thesar të çmuar, sepse me të e ka jetuar jetën, e ka zhvilluar vetveten, prandaj është turp prej nesh që të mos e mbledhim atë përditë, nga dita në ditë.

Kështu, në të folmen e Krajës janë krijuar kompozitat mbiemërore – **menezi-menezë** – për fjalët me burim të huaj **xheloz- xheloze**. Domethënë atij ose asaj që i shkon mendja te e zeza, te e keqja. E në të folmen e Kojës së Kuçit u kanë krijuar (për janë krijuar) kompozitat mbiemërore – **hijezi** (për baksuz) dhe **hijemirë** (për i mbarë).

Në të folmen e Grudës, pikërisht në fshatin Kodër e Budanit, kem ndeshur edhe në dy kompozita mbiemërore – **hjekakeq dhe hjekazi** – për njeriun që heq keq, që vuan. Boll hjekakeq ite Shabi. Po edhe ata i:n (për- ishin) hjekazi.

Në Përshevcë të Tetovës tendës së rrushit i thuhet – **shtrethe-** (kjo- mbase nga shtroj), ndërsa në Ostrec të Manastirit- shtrethja emërton raftin e enëve.

Në rrethet e Malishevës kemi ndeshur në foljen – **krenon- krenojnë-** për më dalin, më qesin deri në krye – mielli, drutë, mishi etj., si: Nashta na krenon deri n'fun mielli? E numërojmë fjalë me burim të shqipes, sepse do lidhur kryet te rrënjori – krye. Në rrethet e Pejës m'përsipjetin sënët per sivjet.

Në të folmen e Struzhës na ka rënë rasi të dëgjojmë fjalën – **rrashtoj** dhe joveprorri- **rrashtohet-** për- thyej-çmpreh tehun e sëpatës. Për mendimin tonë kryet kësaj fjale do lidhur te rrënjori – **asht**. Gjithandej rron edhe mbiemri i, e rrashtuët- për – i çprehtë. Te Fjalori i

Gjuhës Shqipe rron kokrrësh sinonimi me burim – sllav- **topit-** për çmpreh. Ja se ç'bën shqiptari, e lë në ballë të Fjalorit të tij fjalën me burim të huaj- topit-, ndërsa të gjuhës së vet e lë jashtë tij. E ç'i thonë kësaj? Asgjë tjetër vetëm - ironi kohe. Me rrënjorin – asht- do të lidhnim edhe femërorin – rrashtë – për sakësi. Besa në Korishë të Prizrenit gjëllin edhe sinonimi tjetër me gurrë të shqipes- **shytoj** (kjo e dalë nga një shut e prej një më të vjetre-çut). Pastaj po në Korishë rron edhe sinonimi tjetër – humon- (kjo nga –humb)Ja, kjo të bind se të folmet popullore e kanë ruajtur, por njëherazi edhe e kanë zhvilluar fjalësin me burim të shqipes nëpër rrjedhë motesh. Gjuha e shkruar në këtë drejtim ka ngecur mbrapa, shumë mbrapa, veçmas pas Luftës së Dytë Botërore, sepse ajo u mbush me fjalë të burimit të huaj.

Për fjalën prindër (kjo nga latinishtja – parens-parentis) në Planejë të Hasit të Prizrenit rron fjala me burim të shqipes – amt (për amët) kjo e dalë nga rrënjori i shqipes – amë – dhe jo- ëmë. Fjala – amë- emërton edhe:

Ama e fëmijës (nëna)

Ama e viçit

Ama e kërtoles (patates) –Kojë e Kuçit.

Ama e bletës (Brisk-Ljare)

Anatomi – uterus.

Ama e drinit (e lumit) për shtrat lumi- rrethet e Pejës.

Ama e tokës (për- tokë kryesore e një shtëpie) – Malishevë.

Burim i pusit në arë. Anamali.

Në të folmen e Rekës së Keqe (pikërisht në fshatin – Babaj i Bokës) kemi

ndeshur në fjalën – fjetak-e si mb. por edhe të emëruar – fjetak-i-u si sinonim të fjalëve – anas, rrënjës, vendës, e cila, pa ndërzyje, e shtaton anën sinonimike me gurrë të shqipes të këtyre fjalëve.

Vetëm për fjalën – bigë- (kjo nga baza –bi- e latinishtes) në të folmet popullore rrojnë tri e më shumë sinonime me gurrë të shqipes, si: Në Ivajë të Kaçanikut – gresë – (e dalë nga ngreh, tërheq),kalli- në Nerez të Shkupit, fyllë (bigë e tokmes) në Muzhevinë të Istogut.

Në fshatin Kobi të Prizrenit për fjalën e burimit sllav – sajë-rron fjala me burim të shqipes – zhag-i(u).

Në fshatin Kodër e Budanit të Tuzit kemi ndeshur në fjalën – shkjekë – për skaj toke, por edhe skaj dhome, e cila për mendimin tonë, e ka peshën e vet në këto fushëveprime. Për mjetet bartëse të punës nëpër vise malësie në rrethet e Pejës përdoren dy fjalë të burimit sllav – smuk –dhe –vllakë.Për këto të dyja Korisha e Prizrenit i ka me burim të shqipes – për smuk – tokme, ndërkaq për –vllakë-zhags.

Në Kojë të Kuçit për mënyrën e të ecurit – tërthuer gjithandej rron sinonimi tjetër shqip – brinjet. Po eci brinjet.

Për fjalën tirë në krejt Opojën rron sinonimi – ftonë.

Në rrethet e Rahovecit për fjalën cektësirë të lumit rron sinonimi me gurrë të shqipes – shterrinë (kjo nga rrënjori shter e edhe më tej prej –ter), mirëpo prapashtesa –inë- ka burim të huaj.

Për foljen – vorroj-varros- në Ljare të Krajës përdoret folja – rmonj- me rmue (kjo dalë nga rrëmoj). Gjëllin gjithandej edhe mbiemri – i,e rmuem për i,e varrosur, i,e vorruem- e.

Për fjalën –kryqëzohet bima zakonisht misri pranë misrit në ara të mbjella në Korishë të Prizrenit rron fjala me burim të shqipes – përfaret, përfarë (me u) e edhe mbiemri

i,e përfarun për – i, e kryqëzuar dhe emri përfarje (të përfarun) për –kryqëzim. Kjo fjalë i ka pjesët përbërëse të saj me burim të shqipes , pra e ka rrënjorin e shqipes -farë + parashtesën e shqipes – për.

Rrethet e Pejës dhe të Istogut fjalën – anoj- e përdorin me formën –njanoj- me këto kuptime:

Konkreti – njanon njëra anë e barrës së ngarkuar në kalë a gomar. Pa këqyr bre dja:l, se po i njanon ana e dja:tht kalit!

Njanon edhe njëra anë e qerres së ngarkuar me bar, tallë, dru etj.

Fig. Anoj për dikë. Ti po njanon per Hajdinin. Po këqyrëm hollë e hollë më

e drejtë është të thuhet – njanoj, se anoj, sepse në njëren anë anohet dhe jo në të dyja anët.

Neve na thotë mendja se edhe folja – mënjanoj – do zbërthyer në : më+nj+anë.

Në të folmen e Hotit gjëllin folja –mendjemadhohem- me u medjemadhua për rris mendjen. Po ç'ite mendjemadhua Le:k Lucaj.Pason edhe mbiemri –i,e mendjemadhuam- e. për – i,e rritur mendjeje. Kjo folje e ka peshën e vet për fushën e kompozimit, sepse, siç dihet, kjo fushë është bukur e varfër në shqipet, mirëpo pa u këqyruar e hallakatur mirë e mirë të folmet popullore s'mund të biem përfundime me saktësi të prerë.

Në të folmen e Opojës rron fjala – fille – me këto dy kuptime:

Fije bari.

Me kuptim të fig. për –ilaka- Nesimin e kam fille (për e kam timin-ilaka).

Në Hot, Triesh, Kojë e Grudë për fije bari e kanë si mashkullor një fill- disa fij- fijt.

Po në të folmen e Opojës rron folja – me ngallmue- ngallmoj- (për shtie për dikë) e edhe mbiemri përbuzës –ngallmefç- për –shties, që, sipas mendimit tonë, të dyja këto fjalë janë me burim të shqipes, sepse do mbështetur te rrënjori – kall.

Në katundet e Vërrinit të Prizrenit, në Vërmicë të Prizrenit dhe në krejt Opojën ka përdorim të dendur –folja – me live:r (liveri) edhe joveprori – me u liverë- liverem) për – leckos, zheloj-os dhe leckosem.Pastaj edhe emri – livere –për leckë-zhele e edhe – mb. i, e liverët (për – i,e leckosur), po edhe mbiemri – përbuzës – liverç- live:rç, ndërsa Vërmica – liversh- live:rsh. U ka krijuar atje edhe –ndajf. –livere-livere. E kish bâ: kmishën livere- livere.Në këtë çerdhe fjalësh do përfshirë edhe fol. me shkalaverë - për shkatërroj tërësisht dikë. Kqyr se po t'shkalaveri!Pastaj pasojnë edhe – i,e shkalaverët si mbiemër dhe shkalaverç si mbiemër përbuzës. Emrin livere e kemi ndeshur edhe te -Scutari- për – rroba veshjeje. Ka të ngjarë që kësaj çerdheje fjalësh do lidhur kryet te rrënjori – var-lëvar.

Fjalorit të Gjuhës Shqipe i mungojnë mbiemrat përbuzës. Për mendimin tonë kjo është një varfëri e tij, sepse disa të folme popullore janë mjaft të pasura me kësi mbiemrash, qesin krye këtu Vërmica e Prizrenit, Opoja duke kaluar nëpër Tetovë e gjer në Dibër. Ja disa shembuj mbiemrash përbuzës : nxifç (i nxirë), thifç (i thinjur)

Thafç e tha:fç (për thatanik-e), hupç (Vërmica –hupsh) (për humbës në lojëra e edhe në tregti, stërpikç –stërpi:kç (ai a ajo që stërpiket), largofç- largo:fç (ai a ajo që largohet nga loja), tjerrç-tje:rç (stërhollues fjalësh), nrofoç-nro:fç (ai a ajo që i ndërron fjalët) , fruthç-fru:thç (për ngucje ai a ajo që e ka fruthin).

Në Blacë të Krajës rron fjala – thellojë- (për- thellinë uji në Liqenin e Shkodrës dhe përgjithësisht në ujë).

Po përmendim këtu se në Hot, Grudë, Triesh dhe në Kojë të Kuçit kanë përdorim të dendur disa trajta të vjetra përemërore, si: Përemri vetor i vetës së parë njëjës –unë- përdoret me formën – vet, p.sh: Hajde te vet (për eja te unë). Pastaj edhe përemri i pacaktuar – tjetër- del me nyjën e përmarme – i ,si: Tash jam i tjetër. Në të folmet e atyre viseve ka përdorim të

KUMTESA

dendur edhe emri i gjinisë asnjane – t'pamujshimit- për- të fikëtit. Lekën e kite mudua t'pamaujshimit. Atje përdoren edhe mbiemrat dëftorë – i kshtusëm+ i kshtuzëm (për i këtillë) dhe i ashtusëm-i ashtuzëm për i atillë. Edhe folja – me capllua-caplloj – për-narth për së tepërmi- ka përdorim në të follmet e viseve të parapërmendura. Ka nar:rtth e ka capllua. Ato të folme kanë sajuar edhe plot eufemizma dhe shprehje eufemistike, të cilat i duhen historisë së shqipes, si: aj i lell(dh)it (për miun). Ajo e pu:ls (veja) dhe asosh s'pulah (për – vezët). Aj i lleut (për- urithin). Aj i biget (për djallin). Kâbbrapshti dhe i pakryqi (për djallin)etj. Në Korishë të Prizrenit kemi ndeshur në ndajf. zheleve:sh me kuptimin dal pa përgatitur, kur të më thërrasë dikush. Hajt se po dal zheleve:sh, pa i ndërruar petkat.

Recenzentë:
Prof.dr. Hasan Mujaj
Prof.dr. Adem Hajdaraj

Xhafer BEQIRAJ: SINTAGMA PARAFJALORE

Në teorinë sintaksore tradicionale të shqipes, togfjalëshi është njëra nga njësitë themelore e sintaksës. Koncepti gjuhësor "togfjalësh" hyri në gramatikën e shqipes nga ruseshtja në shekullin e kaluar dhe gramatika jonë vazhdon të operojë me të edhe sot e kësaj dite. Koncepti i togfjalëshit në shqipë është hartuar së pari nga S. Floqi, i cili këtë koncept e mori nga gramatika e ruseshtes. Kësaj teorie i janë bërë disa kritika nga disa gjuhëtarë, të cilët kanë vënë në pah mangësitë e saj.

Së pari, do vënë në dukje se ç'thonë gramatikat tona për togfjalëshin? Për këtë koncept thuhet: "Togfjalësh quhet njësia strukturore e formuar nga bashkimi i dy a më shumë fjalëve të plotkuptimshme në raporte të caktuara kuptimore dhe gramatikore midis tyre"¹. Në bazë të përkufizimit del se togfjalëshi ndërtohet nga dy gjymtyrë; gjymtyra kryesore (bosht) dhe gjymtyra përcaktuese, e cila përcakton gjymtyrën kryesore, dmth. ai ndërtohet patjetër nga dy gjymtyrë. Këta klasifikohen sipas fjalës bosht, në togfjalësha emërorë, foljorë, mbiemërorë, numërorë, përemërorë, ndajfoljorë, p.sh.: **djalë** i mirë, i **shtyrë** në moshë, **secili** nga ne, **tri** vajza, **shikoj** filmin, **mjaft** mirë; **u ula** me shokët; **u takuam** me fshatarët, **lexon** me lehtësi, **pres** me brisk, **bisedova** me pleqtë... etj. Struktura e të cilëve del emër + mbiemër, mbiemër + emër me parafjalë, përemër + përemër me parafjalë, numëror + emër, folje + emër, folje + emër me parafjalë, ndajfolje + ndajfolje.

Disa gjuhëtarë i kanë kushtuar vëmendje dhe kanë dhënë mendimet e tyre për teorinë e togfjalëshit. Njëri prej tyre është prof. Rami Memushaj, i cili jep një vështrim kritik për togfjalëshin (Hyrje në gjuhësi, 2002) që ndër të tjera thotë: "Togfjalëshi përbën në të vërtetë një nga mundësitë e realizimit të sintagmës dhe jo një njësi sintaksore të veçantë"². Kurse te sintagma vëren një njësi sintaksore me një strukturë hierarkike me madhësi të papërcaktuar dmth. një sintagmë mund të ngërthejë në vetvete disa sintagma më të vogla dhe në anën tjetër, vetë ajo mund të marrë pjesë në një sintagmë tjetër më të madhe. Sipas tij, sintagma del njësi strukturore, por edhe njësi kuptimore dhe shpesh intonacionore. Qëndrim të njëjtë me prof. R. Memushajn, lidhur me togfjalëshin, ka edhe J. Mita.

Jemi të mendimit, natyrisht duke u mbështetur në teorinë e gjenerativizmit se teoria e togfjalëshit, së pari, nuk është gjithëpërfirëse, sepse brendapërbrenda kësaj teorie nuk përfshihen të gjitha strukturat që dalin gjatë analizës sintaksore të fjalisë. Së dyti, ajo çalon edhe në anën funksionale. Gjithëpërfshirjen dhe anën funksionale të këtyre strukturave në fjali e sjell teoria e sintagmës (gjenerativizmi), e cila, ndryshe nga teoria e togfjalëshit, bën një përshkrim më të saktë gjuhësor.

Grupet e fjalëve: *pres me thikë, biseduan me studentë, u ulëm me shoqet, shkoj pas saj, mësoj me atë* etj. gramatika tradicionale i quan togfjalësha foljorë (me strukturë - folje + emër me parafjalë dhe folje+ përemër me parafjalë). Shtrohet pyetja: ç'do të thonë shprehjet

‘emër me parafjalë’, përemër me parafjalë? Ç’njësi sintaksore janë këto? Këtyre pyetjeve do t’u japim përgjigje në vijim.

Në gramatikat tradicionale shqipe, teoria e togfjalëshit lë jashtë strukturave të saj parafjalën dhe sipas kësaj teorie, ajo nuk mund të jetë gjymtyrë drejtuese e togfjalëshit. Në qoftë se shikojmë klasifikimin e togfjalëshave, do të shohim se për ndërtimet parafjalore nuk thuhet asgjë. Kjo lloj strukture sintaksore anashkalohet. Gramatikat shkollore gjatë analizës sintaksore i lënë parafjalët jashtë vështrimit, për shkak se ato i konsiderojnë vetëm fjalë shërbyese. Për të argumentuar këtë që thamë, do të marrim disa shembuj nga tekste të ndryshme shkollore për të vënë në dukje një dukuri të tillë, p.sh.: *Policia u gjend menjëherë në vendin e ngjarjes*; Do të ngrihemi **me natë**; **Në malin e Dajtit** ka shumë vende të bukura; Gjithë djemuria shkallonte **pas kësaj çupe**; Ha **nga kjo gjellë**; Vjollca habitej **me të vëllanë**; Atë s’e lidh asgjë **me mua**; Ata punonin **për bukën e gojës**; E kapi **për krahu**;³; *Mësuesi i vizatimit pikturoi këtë tablo të madhe në fshatin e tij*;⁴; *Në mbrëmjen e së premtes kampi i tyre u gjallërua papritur*;⁵, etj.

Grupet e fjalëve të shkëputura nga shembujt më lart: *në vendin e ngjarjes, në malin e Dajtit, pas kësaj çupe, nga kjo gjellë, për mua etj.* gramatika tradicionale i quan emra me parafjalë dhe përemra me parafjalë, pra gjymtyrë përcaktuese të emrit bërthamë të togfjalëshit. Kurse te disa gramatika shkollore, këto grupe fjalësh quhen grupe emërore⁶. Në të vërtetë, a janë këto grupe emërore? Po parafjala që u paraprin këtyre grupe fjalësh, ç’funsione kryen? Përgjigje të saktë këtyre pyetjeve u jep gjenerativizmi.

Gramatika gjenerative argumenton bindshëm se parafjala është kokë e sintagmës dhe cakton rasë, p.sh. **nga mali** (em.), **për shkak të përtacisë**(gjin.), **në saje të angazhimit** (gjin.) **nën ujë** (kall.), **me shokun** (kall.), **mbi bjeshkë** (kall.), **buzë lumit**(rrjedh.), **larg atdheut** (rrjedh.), , etj. Secila nga këto parafjalë kërkojnë një rasë, p.sh. parafjala *nga* kërkon që emri të jetë në rasën emërore, parafjala *për shkak të* kërkon një emër të rasës gjinore e kështu me radhë, dmth. parafjalët në grupet e fjalëve të lartshënuara janë koka të sintagmave dhe sintagmat e tilla quhen sintagma parafjalore.

Në fjalinë *Këngët më të bukura janë thurur për nënën* thuhet se **për nënën** është kundrinor i zhdrejtë. Ana funksionale është e saktë, sepse këto grupe fjalësh dalin në funksion të gjymtyrës së fjalisë, por ana strukturore jo. Pastaj nga shembujt e fjalive më lart shkëpusim grupet e fjalëve: **në fshatin e tij, në mbrëmjen e së premtes** për të cilat disa gramatika shkollore thonë se janë grupe emërore në funksion të rrethanorit të vendit dhe rrethanorit të kohës. Për mendimin tonë, grupet e fjalëve **në fshatin e tij** dhe **në mbrëmjen e së premtes** janë sintagma parafjalore (SP) në funksione rrethano-re. Ose te *Gramatika e gjuhës shqipe 2* (ASHSH, Tiranë, 2002) kemi shkëputur këtë fjali - *Kur rifilloi nga puna, çdo gjë në uzinë ishte rregulluar për bukuri*⁷. Sipas analizës gramatikore tradicionale themi se **nga puna** është emër me parafjalë në funksion të kundrinorit të zhdrejtë në rasën emërore. Për mendimin tonë dhe duke u mbështetur në gramatikën gjenerative, ky grup fjalësh është një sintagmë parafjalore, sepse kokë leksikore e këtij grupi është parafjala **nga**. Nëse e heqim parafjalën **nga** që i paraprin emrit, e cila i cakton atij rol tematik, atëherë do të kemi një fjali me një kuptim tjetër –

Kur rifilloi puna, çdo gjë në uzinë ishte rregulluar për bukuri. Në shembullin e dytë, emri *punë* na shfaqet në funksion të kryefjalës, kurse në shembullin e parë, sintagma parafjalore **nga puna** del në funksion të kundrinorit të zhdrejtë. Pra, është parafjala ajo që i jep një funksion tjetër sintaksor emrit. Thënë në gjuhën e gjenerativizmit (përveç foljes)

edhe parafjalët caktojnë rasë (për këtë, shih R.Memushaj, 2008: 172; Josif Mita, 2005: 90). Prandaj, themi se koka leksikore e sintagmës parafjalore **nga puna** është parafjala **nga** që e shndërron kryefjalën në kundrinor të zhdrejtë në rasën emërore.

Për të kuptuar drejt sintagmën me të cilën operon gjuhësia gjenerative duhet njohur edhe konceptet e tjera gjuhësore mjaft me rëndësi: *valencën* dhe *rolet tematike*, të cilat na ndihmojnë në analizën e sintagmave. Valencë kanë foljet, emrat e mbiemrat, të cilët caktojnë edhe *role tematike*⁸ (edhe parafjalët caktojnë role tematike, por nuk kanë valencë)⁹. Praktikisht, në shembujt e mëposhtëm do të vëmë në dukje emrat dhe mbiemrat (si koka të sintagmave) në korrelacion sintaksor me sintagmat parafjalore, si p.sh.:

a) sintagmat emërore: *ecja nëpër pyll, mbyllja në shtëpi, vrapimi me kalë, shkuarja në vende të huaja, kositja me kosë, thumbimi me fjalë, fluturimi me aeroplan, ikja nga rreziku, punimi me dorë, luftimi kundër armikut, kuvendimi me mikun, ndeja në shtëpi, pushimi në det, gjuajtja nga larg, veshja në dimër, shkollimi për fëmijët tanë, e ardhmja për popullin shqiptar, bredhja nëpër male, përndjekja nga armiku i përbetuar, banimi nëpër shtëpi të huaja, veprimi me urtësi, korrja me drapër nëpër ara, hulumtimi pa arsye, sundimi nga armiku, përmendja nga të fikëtit* etj.

b) sintagmat mbiemërore: *i lodhur nga puna, i molisur nga sëmundja, i logjikshëm në të menduar, i shtyrë në moshë, i ardhur prej Anadrinit, i lodhur nga shëndeti, i përmendur për shkencë, i matur në fjalë, i etur për dije, i shkëputur nga bota reale, i shkelur nga armiku, i shkruar me laps të thjeshtë, i përshtatshëm për punët tona, i arritur me shumë mundime, i sigurt për arritje të reja*, etj.

Në dy grupet e sintagmave të lartshënuara del përbërës i tyre sintagma parafjalore, e cila është kategori sintaksore¹⁰ e një sintagme më të madhe, p.sh.: a) *nëpër pyll, në shtëpi, me kalë, në vende të huaja...*, b) *nga puna, nga sëmundja, për shkencë, në moshë, prej Anadrinit* etj. Vihet në dukje qartazi se rolet tematike sintagmave parafjalore ua caktojnë emrat dhe mbiemrat. Në grupin e parë (a) kemi sintagmën emërore, sepse koka e këtyre sintagmave është emri, kurse në grupin e dytë (b) kemi sintagmën mbiemërore dhe kokë e këtyre sintagmave del mbiemri. Emri dhe mbiemri janë në funksion të kokës së sintagmës dhe këto dy klasa fjalësh kërkojnë plotësimin e valencës. Këtë plotësim valencash e bëjnë sintagmat parafjalore, të cilat së bashku ndërtojnë sintagmën emërore dhe mbiemërore në shembujt e marrë më lart.

Më poshtë po vëmë në dukje skemën e pemës së sintagmës parafjalore dhe mbiemërore sipas rregullës X-bar me tri nivele projektimi¹¹.

SP¹² SM¹³

| | | | | | | | |
|-----------|----|----------------|-------------------|--|----------------|--------|----------|
| Spec | P' | Spec | M' | | | | |
| | | P ⁰ | SE | | M ⁰ | SP | |
| pikërisht | | para | derës së shtëpisë | | aq | i etur | për dije |

KUMTESA

Pra, kokë e sintagmës parafjalore del parafjala *para* + *grupi emëror* (SE), kurse të sintagma mbiemërore, kokë e saj del mbiemri *i etur* + *grupi parafjalor* (SP). Ndërsa *pikërisht* dhe *aq* janë specifikues në dy skemat e strukturës së sintagmave.

Në vitin 1987 në Liepzig të Gjermanisë u botua libri “Albanische Grammatik” nga autorët gjermanë Oda Buchholz dhe Wilfried Fiedler. Kjo vepër është e shkruar me një shkathtësi të veçantë, e cila ngërthen në vete një material shumë të pasur, të gjithanshëm dhe e shoqëruar me një analizë të thelluar. Këtu operohet me konceptin *grup parafjalor*, koncept i afërt me sintagmën parafjalore. Ndër të tjera, shtjellohet edhe struktura dhe funksioni i grupit parafjalor.

Këta autorë gjermanë, te kapitulli për parafjalën, përveç të tjerash thonë: “Grupi parafjalor mund të marrë shumë funksione sintaksore... Si kundrinë, grupi parafjalor kushtëzohet prej valencës, rekcionit dhe kuptimit të foljes drejtuese...”¹³. Ata e ilustronjë këtë dukuri duke bërë krahasime në mes të shqipes dhe gjermanishtes, p.sh. në fjalinë shq. *Ai flet për probleme gjuhësore – gjerm. Er spricht über sprachliche Probleme*¹⁴. Në këta shembuj, sintagma parafjalore plotëson valencën e foljes¹⁵, e cila është në funksion të gjymtyrës së dytë, kundrinorit të zhdrejtë në rasën kallëzore.

Krahas funksionit të grupit parafjalor, ata shpjegojnë edhe strukturën e saj:

GP

PARAFJ. GE

Grupi parafjalor, në skemën¹⁶ në fjalë, ndërtohet **nga parafjala + grupi emëror**. Nga kjo skemë del se grupi emëror mund të jetë një fjalë e vetme ose dy a më shumë fjalë, të cilave u paraprin një parafjalë që i cakton rasë emrit, përmerit a grupit emëror (gjerm. Nominalgruppe) dhe së bashku ndërtojnë grupin parafjalor që del gjymtyrë e fjalisë në funksione të ndryshme sintaksore. Mirëpo, gramatika jonë nuk e përvetësoi as këtë koncept, por vazhdoi dhe vazhdon ta konsiderojë grupin parafjalor (pra, sintagmën parafjalore) si *emër me parafjalë*. Shprehje, e cila nuk jep një adekuaci¹⁷ përshkruese të qartë në analizën sintaksore.

Në të përfunduar të kësaj kumtese shprehim mendimin tonë se gramatika jonë ka nevojë për koncepte të reja gjuhësore bashkëkohore dhe konceptet e vjetra duhet t’ua lëshojnë vendin dalëngadalë të reja, dhe shqipja, ashtu si gjuhët e tjera simotra, të ecë drejtë përparimit dhe rritës së saj.

Recenzentë:
Prof. dr. Abdullah Zymeri
Prof. dr. Hasan Muja

Dr. Irena GJONI¹: NDËRTIMI I ARKETIPIT TË MITIT PËR PËRBINDËSHAT DRAGOI DHE KUÇEDRA NË BREGDETIN E JONIT SHQIPTAR

¹Departamenti: Letërsi shqipe
Universiteti i Tiranës Filiali i Sarandës

Përmbledhje

Objekti i këtij studimi është ndërtimi hipotetik i arketipit të mitit për përbindëshat Dragoi dhe Kuçedra në Bregdetin e Jonit shqiptar. Mbështetur në rekonstruimin e teksteve të shenjta e të fragmenteve të tyre, të cilët flasin për ndeshjen (*agon*) kozmike midis Dragoit (Indra) dhe Kuçedrës, është e mundshme të rekonstruohet legjenda e Bregdetit Jonian.

Në ballafaqimin e attributeve të Kuçedrës me Dragoin në studimet etnologjike shqiptare, duke i bërë jehonë pozitivizmit historik dhe sidomos teorisë e bartjes e të huazimit të motiveve, bëhen përpjekje që këto dy figura mitike në koordinatën vertikale historike të paraqiten sikur njëra ndjek tjetrën, domethënë Dragoi ndjek Kuçedrën dhe kështu krijohet përfytyrimi sikur kemi të bëjmë me një figurë mitike, por të paraqitur me dy emra dhe që i përkasin dy periudhave historike: Kuçedrën e një periudhe më të lashtë e ka zëvendësuar Dragoi i një periudhe më të vonë. Duke ballafaquar Alojz Shmausin, Albert Lordin e studiuesit rus, përqafohet pikëpamja se këtu kemi të bëjmë me një hyjni të një rendi më të ri, që asgjëson një hyjni të një rendi më të vjetër.

Rekonstruimin e panteonit mitik të Bregdetit Jonian mbështetur në gjurmët e hulumtimeve simiotiko-filologjike e semiologjiko-etimologjike (të Lambercit e Çabejt) dhe etnologjiko-filologjike (hermeneutike të Papelekës), mund të sjellë supozimin se në legjendën mitike të Dragoit Jonian, bëhet fjalë për heronjtë kryesorë të dramës kozmike mitike nga miti protoilir, pra edhe protoshqiptar, ku *Dragoi* e ka zëvendësuar alopersonazhin – (vetëtimsjellësin, vetëtimëmbajtësin), ndërkaq *Kuçedra* (si sunduese e botës nëntokësore), botën mitike të pranverës së përhershme. Në të vërtetë Dragoi dhe Kuçedra janë të vetmit perëndi parashqiptare e protoilire.

Për të mbërritur në përfundimin se këtu nuk kemi të bëjmë me shtresëzime të attributeve të këtyre përbindshave nëpër periudha të ndryshme historike, por me dy hyjni, të cilat pikëtakohen, ndeshen në qiell, në një zonë të ndërmjetme midis diellit e tokës. Dhe në këtë pikë arrijnë vertikalisht nga drejtime të kundërta: Kuçedra nga nëntoka, kurse Dragoi nga Qielli.

Dragoi

↓

Toka

↑

Kuçedra

Sipas kësaj kuptojmë se të dy këto qenie ktonike kanë bashkëjetuar, nuk kanë jetuar në periudha të ndryshme historike, njëra pas tjetrës dhe i përkasin të njëjtës periudhë historike.

Fjalët çelës: përbindësh, Dragua, Kuçedër, ndërtimi i arketipit, Bregdeti i Jonit.

NDËRTIMI I ARKETIPIT TË MITIT PËR PËRBINDËSHAT DRAGOI DHE KUÇEDRA NË BREGDETIN E JONIT SHQIPTAR

Hyrje

Një nga sfidat e etnologëve sot, është ndërtimihipotetik i arketipave duke u nisur nga ato mbetje mitike që kanë mbërritur përmes mbijetojave deri në ditët e sotme. Objekti i këtij studimi është ndërtimi hipotetik i arketipit të mitit për përbindëshat Dragoi dhe Kuçedra në Bregdetin e Jonit shqiptar. Mbështetur në rekonstruimin e teksteve të shenjta e të fragmenteve të tyre, të cilët flasin për ndeshjen (*agon*) kozmike midis Dragoit dhe Kuçedrës është e mundshme të rekonstruohet legjenda e Bregdetit Jonian. Miti i mbytjes së Kuçedrës dhe i lirimt të ujërave konsiderohet se ka të bëjë me pjesën e vitit kur mungon uji dhe kur udha e Diellit është lart, pra, rreth kthyerjes së diellit në verë.

Rekonstruimin e panteonit mitik të Bregdetit Jonian mbështetur në gjurmët e hulumtimeve simiotiko-filologjike e semiologjiko-etimologjike (të Lambercit e Çabejt) dhe etnologjiko-filologjike (hermeneutike të Papelekës) mund të sjellë supozimin se në legjendën mitike të Dragoit Jonian bëhet fjalë për heronjtë kryesorë të dramës kozmike mitike nga miti protoilir, pra edhe protoshqiptar, ku *Dragoi* e ka zëvendësuar alopersonazhin – (vetëtimsjellësin, vetëtimëmbajtësin), ndërkaq *Kuçedra* (si sunduese e botës nëntokësore), botën mitike të pranverës së përhershme. Në të vërtetë Dragoi dhe Kuçedra janë të vetmit perëndi parashqiptarë e parailirë. Marrëdhëniet e tyre mund të ndërtohen pjesërisht. Kështu, në rrafshin protoshqiptar fitojmë këtë skemë të dramës mitike kozmike: Dragoi e mbyt/ndjek/mund Kuçedrën me vetëtimën/bubullimën.¹

Kuçedra dhe Dragoi në traditën e Bregdetit të Jonit

Në mitologjinë e Bregdetit të Jonit shqiptar, e vjetër sa dhe vetë shqiptarët në këto troje e hapësira, ekziston një përbindësh me shumë kokë, me trup gjarpri që nxjerr zjarr nga goja e qëquhet Himera. Herë shfaqet me kokë luani, ngërdheshur para sulmit, me bishtin e tij të një gjarpri që në shtrirje kap nga brirët një dhi. Himera është një lloj Kuçedre në mitologjinë e Bregdetit të Jonit. Kjo kafshë e përbindshme shfaqet kur dikton viktimën e pastaj zhduket. Mendohet se jeton në malet Akrokeraune ose të Vetëtimave. Himera është kafshë e steresë që “viktimat e saj” i godet me “flakët e gjata”, që i ngjajnë një gjarpri të zjarrtë.

Me Himerën lidhet një ndër dukuritë specifike metereologjike e më mbresëlënëse të Krahinës së Bregdetit që quhet Sifoni, ose Stih. Ai, në kuptimin popullor, është i shtrirë nga retë mbi malet Akrokeraune e deri në det. Zbriste po nga reja lart e futej në det. Thithte ujë prej tij, përpinte anijet, shkulte ullinjte. Populli mendon se kaq fuqi ka sifoni, sa nxjerr ullirin nga toka në Palasë dhe e shpie në Vuno. Po ta prisnin, nuk bënte dëm, ndaj bënin çdo lutje e kryenin disa rite për ta “prerë”. Dhe të gjitha e kishin burimin te Himera.

Edhe karakteristikat gjeografike të trevës rreth vendbanimit të Himarës japin pamjen e një përbindëshi. Sipas karakteristikave të saj Kuçedra, në vija globale, përfytyrohet si hyjni e nëntokës, sepse jeton nëpër shpella e ujëra nëntokësorë. Nga ana tjetër, ajo shkakton

breshrin, erërat e fuqishme, thatërsirën me çka i ndalë shirat, që bijnë “nga qielli”. Me këto attribute lidhet me qiellin dhe fiton atributet e qiellit.

Përkundrejt kësaj Himere – Kuçedër, ekziston një Dragoi. Veprimet e Dragoit lidhen me jetën e njerëzve në tokë. Ai kështu na del si një hyjni mirëbërës, i cili kujdeset për organizimin e jetës në tokë, në rastet kur kjo pengohet nga forcat destruktive, siç është kuçedra, të cilën e ka armik të përbetuar. Ja si i përshkruan Mark Tirta këto attribute të Dragoit: “Përdorimi i rrufesë si armë në duar të dragoit tregon se këtu kemi të bëjmë me hyjni të qiellit, pra me një kryehyjni, siç ndodhte në kohën e lashtë dhe te grekët, trakët, sllavët, perianët etj. Edhe Zeusi, Jupiteri, Peruni dhe të tjera, në ndeshjet e tyre përdorin rrufenë, parmendën. Përdorimi i parmendës (plorit a zgjedhës së saj) së pavëdyer (të panëmur) si armë nga dragoi është tepër domethënës si atribut i hyjnisë së bujqësisë. Kau ka një rol të madh si dragua. Ai, sipas besimeve popullore, në asnjë rast nuk fluturon, po bërlyket, gërryen tokën me brirë e me to lufton.”¹

Në këtë kontekst, shumë e njohur është në Bregdetin e Jonit legjenda e mëposhtme: “Në një vend të Kaonisë, Perëndia Diell goditi me rrufe demin (ose kaun) dhe nga plaga e tij filloi të rrjedhë gjak, i cili duke rënë në tokë, çuditërisht u jepte jetë luleve, bimëve, pemëve dhe çdo gjëje të gjallë. Armiku i Diellit dërgoi gjarprin i cili filloi të pijë gjakun e kaut pa e lënë atë të bjerë në tokë. Dhe atëherë, pemët dhe lulet filluan të thahen. Dielli u zemërua, u prek shumë dhe u mbyll të vajtonte në shpellën e tij qiellore. Nga lotët e shumtë që derdhi nuk po ngrohte dot tokën dhe atëherë toka u mbulua nga akulli. Gjarpri, i trembur, u fut nën tokë dhe nuk e pinte më gjakun e kaut i cili vijoi të rrjedhë pak nga pak. Pemët e bimët filluan ta pinë, por me kursim e në heshtje dimërore. Sidoqoftë, gjatë kohës që gjarpri flinte, ato krijuan rezervat e jetës, aq sa të shpëtonin kur të zgjohej gjarpri”¹.

Edhe Dragoi në luftë me Kuçedrën përdor vetëtimën, e cila është atribut i qiellit. Dragoi, siç e thamë më lart, është qenie ktonike qiellore dhe, si i tillë është i lidhur me tokën, përkatësisht me bujqësinë, që nënkupton se është në shërbim të njerëzimit që merret me bujqësi¹.

Ndërtimi i arketipit të mitit për përbindëshat Dragoi dhe Kuçedra

Lufta kundër Kuçedrës ose substituteve të tjera të saj paraqet luftën jetësore të të mirës me të keqen, dritës dhe errësirës, të forcave të kozmosit kundër forcave të kaosit. Mbytja e Kuçedrës nga Dragoi është njëri prej motiveve më të lashta dhe më të përhapura botërore. Në Bregdetin e Jonit, në kohë shiu dhe vetëtimash e shkretimash, thuhet se lufton Dragoi me Kuçedrën e bregdetasit nuk i lenë gratë të dalin jashtë derës së shtëpisë, sepse thonë se i shkojnë në ndihmë Kuçedrës. Burrat vetë dalin të gjithë jashtë dhe thonë: “O Zot ndihmoje Dragoi tonë!”

Me legjendën për personalizimin e mitit mund të supozohet se këtu kemi disa fragmente të një teksti ritual, të mitit, i cili përgjatë shekujve ka fituar veshjen kishtare, nën të cilën qëndron rrëfimi mitik (*pagan*, ama parailire e parashqiptare) i ndeshjes midis Vetëtimsjellësit – qiellorit dhe kundërshtarit të tij si sundues i botës nëntokësore, botës mitike të pranverës së përherëshme, ose nëse e përmbysim amën mitike (ekofeministike) të ndeshjes së të ashtuquajturit përbindësh me kundërshtarin e tij. Meqë është fjala për një legjendë mitike fragmentare, ku si heronj themelorë kemi Dragoi dhe Kuçedrën, të cilët në rrafshin protoshqiptar e protoilir (në të a.q. interpretim "panteonik") figurojnë si vetëtimmbajtës Dragoi dhe *formëgjarpri* Kuçedra, është e nevojshme të theksohet se nuk

është fjala për aspektin e hyjnive të së mirës dhe së keqes, sepse në religjionet natyrore, botëkuptimi i ndeshjes kozmike me të cilën lirohet uji pjellor prej botës nëntokësore të Kuçedrës, si botë mitike e pranverës së përherëshme, të dy hyjnitë përmbajnë attribute edhe të hyjnisë dobisjellëse edhe të hyjnisë rreziksjellëse. Domethënë nuk ka indicie që protoilirët dhe protoshqiptarët kanë pasur botëkuptim dualist për hyjninë e të mirës dhe të keqes. Përveç kësaj, të a.q. përbindësja në vetvete shkrijnë dualizmin hyjnor-demonik,¹

Fitorja e Dragoit kundër qenies së mbinatyrshme çon drejt ‘zhdukjes’ së mungesës – rrjedhjes së ujit, lumenjve, përtëritjes së rendit, i cili është i njëkohshëm me kthimin e forcave të plleshmërisë, vendosjes së rendit një herë të vendosur pas daljes në skenë të kaosit. Kjo duket edhe te legjenda e mëposhtme e gjarprit të Bisticës: “Në zonën e Delvinës, në lashtësi ishte një gjarpër i madh, i cili ishte bërë tmerri i zonës. Ai jo vetëm kishte zënë burimet, por edhe hante çdo gjë që i dilte përpara. Tentativat për ta vlarë gjarprin kishin dështuar, por u kërkua mençuria e një plaku. Plaku ngarkoi një gomar me eshkë dhe qymyr dhe kur përbindëshi ishte në gjumë, plaku e vuri gomarin në vendin ku flinte gjarpri dhe ndezi eshkën e ngarkuar në gomar. Gjarpri pasi e pikasi gomarin, e hëngri me gjithë ngarkesë. Eshka vazhdonte të digjej dhe bashkë me të edhe gjarpri. Meqë nuk i duronte dot dhimbjet, i kërkoi ndihmë perëndisë së detit dhe Bisticës. I tha: “Ku je, o nëna ime Bisticë dhe ti motra det!” Bistrica nxorri tetëmbëdhjetë burimet e “Syrit të kaltër”, por nuk i mjaftonin gjarprit. Ai e kuptoi gabimin dhe thirri: “Ku je, o nëna ime det dhe ti o motra ime Bisticë!” Deti erdhi deri në Finiq, por nuk arriti dot më lart e ta shuante zjarrin e brendshëm të gjarprit. Që të shpëtonte nga dhembjet, gjarpri lëvizi me shpejtësi në shpatin e malit mbi Delvinë. Nga rruga e lëvizjes së gjarprit mbinë dy radhë lisash paralel për kilometra të tërë faqe malit, që nga vendasit është quajtur e quhet “Rruga e gjarprit”. Aty sot gjendet një dukuri komplekse natyrore me origjinë gjeologjike në të dy anët e së cilës kanë mbirë lisat. Me kockat e gjarprit, - përfundon legjenda, – u ngrit Manastiri i Mesopotamit”.¹

Kalimi nga errësira drejt dritës nganjëherë shpjegohet edhe si pasojë e disfatës së përbindëshit që ka gëlltitur Diellin. Që këtu del se “heroizmi i trimit vendoset në epiqendër të ndryshimeve ciklike sezonale, duke i transformuar përfytyrimet e mëparshme për vdekjen dhe lindjen e hyjnive të natyrës, që e thamë më lart. Në vendin e hyjnzimit të kohës natyrore, përmes ciklizmit dhe përputhjes së fazave të botëve të ndryshme, çon jo vetëm në mbytjen e Kuçedrës dhe i lirimit prej saj i burimeve të ujit, por e pllenon tokën (lavrimi simbolik, hierogamia). Mundja e Kuçedrës dhe lirimi i ujrave shenjon fuqinë prodhuese të metalit, me çka njeriu ngritet mbi qeniet tokësore, bile edhe mbi stuhitë dhe bëhet krijues i fatit të tij ekzistencial. Përfytyrimet e tokës, të cilat gjithmonë kanë qenë personifikim i hyjnisë femërore, kurse qielli i hyjnisë mashkullore, tani ndryshohen dhe arrihet tek hierogamia midis hyjnisë së parë dhe trimit”.¹

Paraqitja e religjioneve monotoiste atributet e Dragoit që vret Kuçedrën i veshen shenjtoreve të ndryshëm, të cilët luajnë rol të rëndësishëm për forcimin e besimit. Në krishtenizëm këto attribute i vishen shën Gjergjit e shën Ilisë. Pra për shqiptarët Shën Gjergji ishte Dragua, ndërsa Shën Ilinë e përfytyronin të hipur në një kalë të bardhë në qiell prej nga lëshon rrufe në qiell. Ndërkaq në islamizëm atributet e Dragoit i vishen Sari Salltikut, një shenjtë bektashian i shekullit XIII.¹ Kjo edhe është faza e personalizimit të qenieve mitike, të cilat nga një përfytyrim i përgjithshëm për to në vetëdijen e njerëzve konkretizohen me një emër të jetës reale – shpjegon Qemal Haxhihasani, që njëkohësisht shënon edhe fazën e kalimit “nga bota e përgjithshme e mitologjisë në atë të njerëzve të shoqërizuar e të

personalizuar. Kemi këtu momentin e parë të lidhjeve të individit si person me bashkësinë e tij epike, por edhe me universin e tij shoqëror e kozmogonik”¹.

Qemal Haxhihasani duke i mëshuar kësaj çështjeje, por në një kontekst tjetër, në kontekstin e saktësimit historik të figurës së Gjergj Elez Alisë, ecurinë diakronike të formimit të kozmosit mitik etnokulturor shqiptar e dallon tri periudha:

- (a) në periudhën e parë bën pjesë lufta e Dragoit me Kuçedrën: “dragojtë luftojnë kundër këtyre përbindëshave me parmenda /.../, fakt që flet për praktikimin e kulteve bujqësore në popullin tonë që në kohërat më të lashta”;
- (b) “Në periudhën e dytë, janë figurat e kozmosit mitologjik shqiptar ato që i shndërrojnë heronjtë nga barinj të thjeshtë në kreshnikë legjendarë, në luftëtarë të guximshëm, të vendosur dhe të pamposhtur për të mbrojtur vendin, të drejtat, jetën dinjitoze, kulturën, doket e tyre tradicionale”;
- (c) “Në periudhë e tretë këta elemente jo vetëm që do të marrin zhvillim të mëtejshëm, por edhe do të shkrihen në mënyrë të pandarë në një të vetme organike, në një kozmos etnokulturor veçues, në vjetërsi normash të sjelljes së anëtarëve të fisit që do të dallojnë heroin e epikës sonë heroike tradicionale prej atij të popujve të tjerë”¹.

Sipas tij Kuçedra përfaqëson të përgjithshmen, kurse Dragoi të veçantën, personalen. Gjithnjë në këtë drejtim ai pranon evoluimin e kësaj figure, por këtë e shpjegon në një rrugë tjetër me anë të individualizimit, personalizimit. Prandaj, sipas kësaj, Kuçedra do t’i përkiste periudhës më të hershme, asaj politeiste, kurse Dragoi një periudhe më të re, në prag ose përgjatë periudhës së formimit, konstituimit e të konsolidimit të besimeve monoteiste. Mirëpo, meqë i përkitkan dy periudhave të ndryshme, atëherë nuk gjen shpjegim nevoja e ndeshjes së tyre. Sikur të mos kishin bashkëjetuar, atëherë as nuk do të kishte nevojë të ndeshen dhe sikur të kishin jetuar në periudha të ndryshme pse u ndeshën, kur nuk e kanë mbërrirë njëri – tjetrin?

Në këtë mënyrë shpjegohet procesi i kalimit të perceptimeve mitologjike, të një periudhe shumë të hershme në një periudhë më të re. Mitin e mbytyjes së Kuçedrës dhe të lirimimit të ujërave për nevojat e njerëzimit, krishterimi, si e pamë, do ta zëvendësojë me shenjtore të kalendarit të besimit të krishterë¹, me njërin prej shenjtorëve më të rëndësishëm të tij shën Gjergjin që është shumë I përhapur në krahinën e Bregdetit të Jonit, ndërkaq figurën e Kuçedrës do ta zëvendësojë me gjarprin, që është simbol i djallit. Ndaj edhe kishat do të stolisen me ikona të fytyrës së shën Gjergjit, i paraqitur si kalorës (edhe kjo është atribut i Dragoit – mendon Haxhihasani¹) që e vret Kuçedrën, alias djallin.

Pikëpamje të ndryshme mbi kohën e ekzistencës së Kuçedrës e Dragoit

Në ballafaqimin e attributeve të Kuçedrës me Dragoin në studimet etnologjike shqiptare, duke i bërë jehonë pozitivizmit historik dhe sidomos teorisë së bartjes e të huazimit të motiveve bëhen përpjekje që, këto dy figura mitike në koordinatën vertikale historike të paraqiten sikur ndjekin njëra – tjetrën, domethënë Dragoi ndjek Kuçedrën dhe kështu krijohet përfytyrimi sikur kemi të bëjmë me një figurë mitike, por të paraqitur me dy emra dhe që i përkasin dy periudhave historike: Kuçedra e një periudhe më të lashtë e ka zëvendësuar Dragoi i një periudhe më të vonë. Duke ballafaquar Alojz Shmausin, Albert Lordin e studiuesit rus përqafohet pikëpamja se “këtu kemi të bëjmë me një hyjni të një rendi më të ri, që asgjëson një hyjni të një rendi më të vjetër”¹.

KUMTESA

Harrohet me këtë rast një karakteristikë e veçantë dhe dalluese e të dy këtyre qenieve mitike. Atributet e tyre të kundërta ndihmojnë të përvijojmë pikëpamjen tonë, se nuk përfaqësojnë një hyjni të vetme në dy periudha të ndryshme historike (pasuese të njera – tjetrës), po janë hyjni të të njëjtës periudhë dhe me attribute të kundërta: njera përfaqëson hyjnitë nëntokësore (Kuçedra), ndërkaq tjetri hyjnitë qiellore (Dragoi). Po përmendim faktorët qenësorë dallues midis tyre:

- (1) Kuçedra është demon i nëntokës dhe duke tentuar të shoqërizohet me jetën tokësore ushtron dhunën në familje e në mjedis shoqëror, në bashkësi (pavarësisht se në disa përralla “zbutet” e mëshirohet), shkatërron bimësinë dhe jetën tokësore.
- (2) Dragoi, ndërkaq, është hyjni solar, që zbrret nga qielli në tokë për t’i mbrojtur tokësorët nga dhuna dhe shkatërrimet e Kuçedrës.

Sipas kësaj del se këtu nuk kemi të bëjmë me shtresëzime të attributeve të këtyre përbindshave nëpër periudha të ndryshme historike, por me dy hyjni, të cilat takohen, ndeshen në qiell, në një zonë të ndërmjetme midis diellit e tokës. Dhe në këtë pikë arrijnë vertikalisht nga drejtime të kundërta: Kuçedra nga nëntoka, kurse Dragoi nga Qielli.

Dragoi



Toka



Kuçedra

Si përfundim, nga gjithë kjo kuptojmë se të dy këto qenie ktonike kanë bashkëjetuar, nuk kanë jetuar në periudha të ndryshme historike, njera pas tjetrës dhe i përkasin të njëjtës periudhë historike. Pikëpamja evolucioniste e kundërshtuar nga pikëpamja antropologjike në studimet e sotme mitologjike botërore dhe jo vetëm në to, është lëshuar dhe dalë nga përdorimi.

Recenzentë :
Prof.dr. Miaser Dibra
Prof.dr.Zeqirja Neziri

Aida BADO(DOKTORANTE): SJELLJA GJUHËSORE E FOLËSVE SHQIPTAR PAS '90-S

Në këtë kumtesë do të përpiqemi të dallojmë sjelljen gjuhësore të folësve shqiptar pas 1990-s, pra do të përcaktojmë rrugët ose mënyrat që janë ndjekur, këto dhjetëvjeçarët e fundit, për të pasuruar leksikun ekzistues me njësi të reja¹.

Me anë të metodës së krahasimit është bërë krahasimi i dy fjalorëve botuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, përkatësisht, “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, 1980” dhe “Fjalori i gjuhës shqipe, 2006”. Nga ky krahasim është nxjerrë korpusi i fjalëve të cilat ndodhen vetëm në fjalorin e vitit 2006, i cili do shërbejë edhe si burim për studimin tonë.

Është e njohur aftësia e folësve për të krijuar fjalë të reja, duke u nisur nga fjalët e njohura. Shembullin më të mirë të zbatimit të kësaj teorie na e japin shkrimtarët. Në prozën e sotme shqipe, sidomos në atë të Ismail Kadarese, janë vënë re njësi të reja leksikore të krijuara falë mjeteve fjalëformuese që gjuha shqipe ofron.¹ Këto fjalë, shpeshherë, bëhen pjesë jo vetëm e gjuhës së letërsisë, por edhe e leksikut të përgjithshëm.

“Kalimi i një fjale të re në sistemin leksikor të mbarë shqipes kushtëzohet në radhë të parë nga nevojat e sistemit dhe nga vlerat që merr fjala brenda këtij sistemi”.¹

Në këtë pikë lind pyetja: Cilat janë rrugët ose mënyrat e pasurimit të leksikut që kanë ndjekur shqiptarët këto dhjetëvjeçarët e fundit?

Nga vëzhgimet e bëra del se, këto dhjetëvjeçarët e fundit, janë përdorur këto rrugë¹: formimi i tyre sipas mënyrës morfologjike dhe huazimi i tyre nga gjuhët fqinje.

Formimi i njësive leksikore sipas mënyrës morfologjike

Kur flasim për formime fjalësh sipas mënyrës morfologjike, kemi parasysh mënyrat e tipat e fjalëformimit të parashtruara në gramatika të ndryshme të gjuhës shqipe. Ne jemi mbështetur tek renditja që jep “Gramatika e gjuhës shqipe” I (2002, fq 60).

Do të merren në shqyrtim edhe rastet kur tema e përdorur për formimin e fjalëve të reja nuk është me burim nga gjuha shqipe, apo edhe kur mjetet e përdorura nuk janë me burim nga gjuha shqipe. Rasti i parë tregon se fjala e huaj është ngulitur në sajë të përdorimit të saj si temë fjalëformuese, duke zgjeruar çerdhen e saj me mjetet e shqipes. Rasti i dytë tregon se huazimi i mjeteve të huaja është bërë bashkë me fjalën e huaj dhe në disa rrethana i është ngjitur edhe temës shqipe.

Formime me prejardhje

a. Formime me parashtesë. Parashtesat e përdorura më së shumti këto 20-30 vitet e fundit janë:

- anti-, pa-, de-, ç-, in-, mos-, a-, s-, sh-

- pas-, para-
- nën-, mbi- ndër-, për-
- stër-, tej-, super-¹
- ri-
- jashtë-, vetë-, gjysmë-, drejt-¹
- foto-, mikro-

Këto parashtesa, për lehtësi studimi, i kemi grupuar në 7 grupe parashtesash.

Grupi i parë i parashtesave përfshin parashtesat që shënojnë kuptime, të cilat u kundërvihen temave fjalëformuese përkatëse, si: pa-, ç-, mos-, s-, sh- anti-, de-, in-, a-. Nga këto parashtesa, përdorim më të madh ka parashtesa ç-. Me këtë parashtesë, e cila paraqitet mjaft prodhimtare, janë formuar mbiemra dhe folje. Numrin më të madh të formimeve me këtë parashtesë e zënë mbiemrat: në f. pol¹. i *çintegruar*; në f. usht¹. i *çminuar*; në f. fiz.¹ i *çmagnetizuar*; në fusha të tjera i *çlidhur*, i *çmaterializuar*, i *çideologjizuar*, i *çmagjepsur*, i *çmbushur*, i *çmësuar*, i *çmekur*, i *çmprehur etj.* Në të gjitha rastet parashtesa ç- u ngjitet mbiemrave të formuar nga nyjëzimi i pjesores. Veç mbiemrave, sikurse thamë, kemi edhe foljet. Në këtë rast janë formuar folje kryesisht nga foljet: *çmiqësoj*, *çideologjizoj*, *çngec*, *çngul etj.*

Vihet re një përdorim më i shpeshtë i parashtesës së huaj **anti-**. në raport me atë kundër. Kështu kemi, në f. drejt¹., *antikrim*, *antikontrabandë*; në f.usht. *antigaz*; në fusha të tjera *antivlerë*.

Një përdorim të gjerë ka edhe parashtesa **pa-**. Ajo është përdorur, përgjithësisht, në këto fusha: në f. libr.¹kemi i *pakondicionuar*; në f. biol¹. kemi i *paasimilueshëm*, i *papërvetueshëm*; në f. gjuh.¹kemi i *paanalizueshëm*; në f. pol. kemi i *parevokueshëm*; në fusha të tjera kemi *pabarazi*, i *pacivilizuar etj.* Nga shembujt e dhënë vihet re se, kjo parashtesë i është ngjitur, më së shumti, mbiemrave të formuar me prapashtesën –shëm dhe mbiemrave të formuara nga nyjëzimi i pjesores.

Parashtesa e huaj **de-** përdoret paralelisht me parashtesën e shqipes **sh-**. Ka raste ku në të njëjtën temë fjalëformuese të jenë përdorur, përkatësisht, këto dy parashtesa sinonimike. Kjo ka ndodhur, përgjithësisht tek fjalët e krijuara nga tema të huaja (të huazuara): i *dekurajuar*: i *shkurajuar* (nga kurajë- guxim), por kemi edhe i *deformuar*: i *shformuar*. Kjo dëshmon përpjekjen për të zëvendësuar parashtesat e huaja me ato të shqipes. Ka raste kur zëvendësimi i parashtesës de- me parashtesën sh- nuk është i mundur, por ajo po zëvendësohet mjaft mirë me parashtesën pa- p.sh. i *degazuar* (i *pagazuar*)¹, i *decentralizuar* (i *pacentralizuar*). Fjalët me këto parashtesa janë folje e mbiemra: *shkredh* (*kredh*), i *shkredhur* (i *kredhur*), i *deformuar* (i *formuar*), i *deshifruar* (i *shifruar*), i *decentralizuar* (i *centralizuar*). Edhe në këto raste tema mbiemërore më prodhimtare, është ajo me nyjëzimin e pjesores.

Parashtesat **in-**, **mos-**, **a-** dhe **s-**. Këto janë parashtesat që dalin me përdorim më të paktë nga parashtesat e këtij grupi. Më prodhimtarja prej tyre është parashtesa mos-: *mosrespektim*, *mosukses*, *mosvlerësim*, *mosveprues*. Parashtesa in- përdoret më shumë në ligjërimin libror dhe i paravihet kryesisht emrave me temë të huaj: f. libr. *independencë*, *independent*, *intolerancë*. Parashtesa a- është gjetur e përdorur vetëm në një rast, në fushën e arsimit i *atestuar*. Në këtë rast ajo nuk ka kuptim mohues, por duket sikur fjalës i jep një kuptim intensiv.

Grupi i dytë përmban parashtesa që janë në antonimi me njëra-tjetrën: **pas-** dhe **para-**. Këto parashtesa janë gjetur të përdorura më së shumti në fushën e arsimit: i *parastudiuar*,

parauniversitar, edhe në fushën e drejtësisë: *i paraburgosur, paszgjedhor*, por edhe në fusha të tjera: *pararini, pararinor*. Ato i paravihen mbiemrave të nyjshëm a të panyjshëm dhe tregojnë që tipari i dhënë i përket një kohe më të hershme a më të vonë sesa tipari i shënuar nga tema fjalëformuese.

Grupi i tretë përbëhet nga parashtesa me prejardhje parafjalore: **nën-, mbi-, ndër-, për-**. Nga këto parashtesa, përdorim më të gjera ka parashtesa për-. Nga ana leksiko-gramatikore, fjalët e termat me këto parashtesa janë kryesisht mbiemra të nyjshëm e të panyjshëm dhe folje. Këto parashtesa janë shfrytëzuar më shumë në leksikon libror dhe në fushën e mjekësisë: *i përdatur, përbyk, i përdjegur, përdhëmb, i përfolur, përfush, përkap, i përndjekur, i mbiçmuar, mbikalor, mbilodhem, mbipasnesër, mbipeshë, i mbiquajtur, i nënçmuar, nëndërgjegje, ndëretnike, ndërkal, mbidozë etj.* Parashtesa **mbi-** në dy raste del në sinonimi me parashtesën stër- dhe tjetër-: mbilodhem për stërlodhem; mbipasnesër për tjetërpasnesër. Në të gjitha rastet parashtesat nën- dhe mbi- dalin antonimike.

Grupi i katërt përmban parashtesa që shprehin ngjyrimë të zmadhimit a të teprisë: **stër-, tej dhe super-**. Prej tyre më të përdorurat janë parashtesat **tej-** dhe **stër-**. Fusha e përdorimit të tyre është e gjerë: *tejnësër, tejpardje, tejparvjet, tejpasnesër, tejzgjat, tejndot, i tejzgjatur, i stërmundimshëm, stërngop, i stërmunduar, stërkeq, i stërlodhur, supermarket, superstradë (këto dy fjalët e fundit janë huazime)*. Parashtesa **tej-** nuk shpreh vetëm ngjyrimë të zmadhimit a të teprisë, në disa fjalë ajo tregon që tipari i veprimit i përket një kohe më të vonë sesa tipari i shënuar nga tema fjalëformuese: *tejnësër për pasnesër; tejpardje për tjetërpardje, tejparvjet për tjetërpavjet; tejpasnesër për tjetërpasnesër*. Nga ana leksiko-gramatikore, fjalët dhe terma me këtë parashtesë janë mbiemra, ndajfolje dhe folje.

Parashtesa **super-** hetohet tek disa emra të huazuara: *superstradë, supermarket etj.*

Grupi i pestë ka në përbërje parashtesën **ri-**. Kjo parashtesë është shfrytëzuar në fjalësin e fushës së ndërtimit, së bujqësisë, fushës së emërtimeve me burim libror, fushës së ekonomisë etj. P.sh. *rikonstruktioj, rimbjell, rishtrukturoj*, por kemi edhe *rimartohem, rijetoj*. Kjo parashtesë u paravijet vetëm foljeve. Me anë të kësaj parashtese folja emërton një veprim që kryhet sërish, por në ndonjë rast shpreh edhe ndonjë ngjyrim tjetër kuptimor: *rijetoj*... sjell ndërmend ngjarje të së kaluarës; *rishtrukturoj*: e bëj sërish diçka duke ia ndryshuar strukturën.

Grupi i gjashtë përmban siparashtesat me burim nga gjuha shqipe: **jashtë-, vetë-, gjysmë-, drejt-**. Nga këto siparashtesa, përdorim më të gjerë ka siparashtesa **vetë-**. Siparashtesat e tjera kanë një përdorim më të pakët. Kjo ndoshta ka të bëjë me faktin se këto siparashtesa nuk kanë gjegjëse të tyre të huaj, sikurse ka siparashtesa **vetë-**. Shpeshherë, rritja e numrit të përdorimit të një tipi parashtese me burim nga gjuha shqipe, ka të bëjë me zëvendësimin e gjegjëses së saj të huaj me parashtesën përkatëse shqipe. Disa nga fushat ku janë përdorur më së shumti këto parashtesa janë: f. libr. *vetëdeklaror, vetëdemaskohem, vetëfajësohem, vetëdorëzohem etj*; f. ek. ¹ *vetëfinancohem*, f. tek. ¹ *vetëkurdiset, vetëkomandohet*; f. bot. ¹ *vetëpërhapje*; në fusha të tjera *gjysmëburrë; gjysmëditë; gjysmëdremite; gjysmënatë; gjysmëzot; i jashtënatyrshëm*.

Grupi i shtatë përmban siparashtesat me burim të huaj: **foto-, mikro-**. Këto siparashtesa kanë një përdorim relativisht të dendur në fusha të ndryshme të dijes. Siparashtesa me përdorim më të gjerë është siparashtesa **foto-**, pasi fusha ku ajo përdoret, fusha e fotografisë, këto vitet e fundit ka pësuar zhvillimin më të madh.

1.1 Pasurimi i leksikut të gjuhës shqipe nëpërmjet huazimit

KUMTESA

Në këtë çështje do të mundohemi t'i grupojmë këto huazime, sipas disa kriterëve të përcaktuar nga Jani Thomai në librin "Leksikologjia e gjuhës shqipe" i vitit 2002 dhe sipas një kriteri të ri dalë nga analiza jonë.

Fjala e huaj ka hyrë këto 20-30 vitet e fundit në gjuhën shqipe në këto raste:

a. Kur **ka qenë një term ndërkombëtar**. Huazime të tilla termash janë vënë re në këto fusha:

-Fusha e mjekësisë: *aids (sëmundje, sida), adrenalinë (lëndë e nxjerrë nga gjëndra nënveshkore), fizioterapi (mjekim me anë ushqimesh, me masazhe etj.), neuron (njësi e sistemit nervor), stres (brendë që vjen nga trysnia trupore), skaner (aparaturë mjekësore) etj.*

-Fusha e ekonomisë: *bankomat (aparaturë për të tërhequr para), euro (njësi monetare), kesh (para në dorë), klientelë (tërësia e klientëve), tender (paraqitje propozim) etj.*

-Fusha e fesë: *rabin (predikues i fesë izraelite), shiit (besimtar mysliman) etj.*

-Fusha e kuzhinës: *picë (gjellë), kek (ëmbëlsirë) etj.*

-Fusha e teknologjisë (elektronikës): *disketë, faks, celular, kompjuter, kompaktdisk, maus, printer etj.*

-Fusha e arsimit: *master (gradë që merret pas mbarimit të shkollës pasuniversitare), test (grup pyetjesh) etj.*

b. Kur **e ka kërkuar një stil i caktuar i gjuhës**. Në rastin tonë huazime të tilla i përkasin këtyre fushave:

- Fusha e emërtimeve me burim libror: *abonim (pajtoj), absorboj (përthith), aprovues (miratues), i avancuar (i përparuar), ekzekutor (vrasës), entitet (qenie), evaziv (i paqartë) etj.*

- Fusha e politikës: *abrogoj (shfuqizoj), i bojkotuar, i decentralizuar, i ratifikuar etj.*

c. Kur **ka lindur një profesion i ri**. Zhvillimi ekonomik, kulturor e teknologjik përkon edhe me lindjen e mjeshtërive të reja. Për këtë arsye, vendet më pak të zhvilluara kanë zhvilluar më vonë disa mjeshtëri në krahasim me vendet e tjera. E njëjta gjë ka ndodhur me Shqipërinë. Me orientimin e ekonomisë shqiptare drejt ekonomisë së tregut dhe me zhvillimet e reja të teknologjisë e kulturës, u bë e nevojshme që sektori i profesioneve të pasurohet me mjeshtëri që vendet e tjera më të zhvilluara ekonomisht tashmë i kishin, prandaj veç përvojës, në disa raste, morëm edhe emërtimin e profesionit: *biznesmen (ai që merret me biznes), kambist (ai që merret me kambizëm), masazhit (ai që bën masazh), opinionist (ai që jep në shtyp e televizion gjykime e vlerësime për çështje të ndryshme shoqërore), menazhues (ai që menazhon punën dhe prodhimin e një ndërmarrjeje etj.); analist (publicist që merret me analizën e ngjarjeve e të situatave politike etj.; sipas mendimit të analistëve) etj.*

d. Kur **ka sjellë ndonjë nuancë kuptimi më të përpiktë e të veçantë**: *ekstradoj (kriminelin) d.m.th. "ia dorëzoj dikë shtetit ku akuzohet për krim", kurse dorëzoj (kriminelin) është tjetër gjë; kamikaz d.m.th. "ai që vetëvritet (zakonisht me eksploziv), duke vrarë edhe të tjerët përreth", kurse vetëvrasës ka një kuptim tjetër, pasi nuk përfshin në kuptim edhe vrasjen e njerëzve të tjerë; trafikoj (tregtoj) d.m.th. "tregtoj në mënyrë të paligjshme mallra të ndaluara..", kurse tregtoj nënkupton mënyrën e ligjshme të veprimtarisë.*

Përfundime

Nga kjo analizë e fjalëve të reja me të cilat është pasuruar gjuha shqipe këto dhjetëvjeçarët e fundit, mund të dilet në këto përfundime:

-Ndër fjalët e reja me të cilat është pasuruar gjuha shqipe këto 20-30 vitet e fundit, nga ana leksiko-gramatikore, mbizotërojnë emrat (që janë kryesisht terma) mbiemrat, foljet dhe në fund ndajfoljet. Këtë gjë vërteton edhe pasqyra e mëposhtme e nxjerrë nga të dhënat e korpusit tonë:

| | |
|---------------------|--------------|
| Pjesët e ligjëratës | gjithsej |
| Emra | ≈ 2600 fjalë |
| Mbiemra | ≈ 1759 fjalë |
| Folje | ≈ 632 fjalë |
| Ndajfolje | ≈ 278 fjalë |

Këtu del qartë se nga ≈ 5260 fjalë gjithsej, 2600 ose rreth 50% janë emra, rreth 33% janë mbiemra, rreth 12% janë folje dhe vetëm 5% janë ndajfolje.

-Hyrja e fjalëve të huaja në leksikun e shqipes, siç dihet, ka bërë që bashkë me fjalët e huazuar dhe kuptimin e tyre të përdoren edhe elementet që përbëjnë strukturën e tyre. Me fjalë të tjera është e mundur të veçohet parashtesa nga fjala me të cilën bashkohet. *“Kjo bëhet e mundur sepse parashtesa nuk është e kufizuar në një fjalë të vetme; ndërsa nga ana tjetër edhe fjala pa parashtesën nuk është e izoluar, po ka përdorim të mëvetësishëm”*.¹ Meqenëse huazimi i fjalëve nga gjuhë të huaj, është një dukuri e pashmangshme dhe në disa raste edhe e domosdoshme edhe ndajshitesat e huaja duken si të pashmangshme. Këto vitet e fundit, nga të dhënat e fjalorthit, duket se kanë ndodhur dy fenomene:

- Ndajshitesat e huaja po zëvendësohen me ato shqipe
- Po hyjnë ndajshitesa të reja, p.sh. parashtesa de- (me kuptimin e parashtesës sh- dhe pa-), siparashtesa foto- etj.

Recenzentë :
Prof.dr.Shezai Rrokaj
Prof.as.dr. Aljula Jubani

KUMTESA

Sejdi M.GASHI¹: RRUGA E FORMIMIT TË SHQIPES LETRARE NË KOSOVË

¹Instituti Albanologjik i Prishtinës

Proceset e planifikimit gjuhësor të shqipes janë të hershme dhe komplekse, megjithatë, hapat më vendimtarë drejt standardizimit janë bërë pas Luftës së Dytë Botërore, kohë kur çështja në tërësi mori vull. Në këtë aspekt rrethanat e Kosovës ishin të ndryshme nga ato në Shqipëri, për shkak të historisë dhe të gjendjes së trashëguar, po edhe në raport me qëllimet e përgjithshme. Në Kosovë, nga viti 1952, u punua në të dy drejtimet e planifikimit të gjuhës: në drejtim të zgjidhjes së korpusit dhe në drejtim të planifikimit të statusit të shqipes. Si pika më rëndësi duhet veçuar tri mbledhjet e mbajtura në Prishtinë më 1952, më 1957 dhe më 1963.

Në mbledhjen e 1952 u morën vendime të rëndësishme për zgjedhjen e kodit gjuhësor, mbështetur në atë që quhej "varianti gegë i shqipes letrare", pra një gegërishte përgjithësuese duke shmangur këtu atë që quhej vetëm si shkodranishte, me ç'rast u kërkua edhe hartimi i gramatikave dhe fjalorëve. Por, më 1957, ka pasur tendencë për të shkuar mbrapa drejt një varianti të mundshëm, por të refuzuar më 1952, të kosovarishtes, me argumentin për heqje nga përdormi të shumë ë-ve të panevojshme.

Tani sikur po nxirrnin krye tendencat e qarqeve serbe që synonin diferencimin e gjuhës shqipe (*shqiptarski*) për kosovarët dhe shqiptarët e ish-Jugosllavisë dhe (Albanski) për shqiptarët e Shqipërisë, çka ndikonte në rritjen e ndjenjës së kërcënimit të identitetit. Në vitin 1966, intelektualët shqiptarë ngulnin këmbë që tërë energjinë ta përudhnin drejt rritjes së ndjenjës së identitetit, gjithnjë duke e kërkuar komunikimin e mohuar deri atëherë me Shqipërinë. (Ismajli, 2003:24-25). Klima e krijuar në ato vite, pas dekadave të shtypjes së egër solli nevojën për afrime gjuhësore dhe kështu natyrshëm lindi slogani „një popull- një gjuhë letrare”, i formuluar nga Ali Hadri. Më 1968, në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës u braktis praktika e standardizimit që po ndiqej më parë. Tani përmes gjuhës po theksohej identiteti dhe dallimi nga të tjerët në Jugosllavi (Ismajli, 2003:28). Konsulta Gjuhësore e Prishtinës vërtetësisht i dha fund zhvillimit paralel të dy gjuhëve të shkrimit ku edhe Kongresi i Drejtshkrimit katër vjet më vonë në Tiranë, vetëm e vërtetonte këtë gjendje të krijuar. (Ismajli, 2003:94). Pas Kongresit të drejtshkrimit, në opinion, përgjithësisht është manifestuar vullneti i madh për të përdorur shqipen e njësuar letrare, në Kosovë madje përtej të gjitha pritjeve.

Puna për normëzimin e shqipes në Kosovë nuk ishte e lehtë pasi që përfundimi i Luftës së Dytë Botërore dhe vendosja e pushtetit komunist në Kosovë dhe në trojet shqiptare në Maqedoni dhe Mal të Zi, do të jenë kohë sfiduese në rrugën e standardizimit të saj. Deri

atëherë Kosova dhe shqiptarët që kishin mbetur jashtë kufijve të Shqipërisë, kur diskutohej për çështje të gjuhës letrare, thuajse ishin harruar fare.

Në Kosovë prej vitit (1960-1990)

Rruga që u ndoq deri në vitin (1972), ishte një rrugë e vështirë, por që kishte vetëm një qëllim, krijimin e një standardi gjuhësor të përbashkët, çka do të thoshte; krijim i një identiteti gjithëkombëtar që si përfundim do ta sillte vetëm bashkimin. Këto ide u bënë edhe më të shpeshta veçmas kur shqiptarët e Kosovës, por edhe të trojeve të tjera në ish-Jugosllavi, filluan të interesoheshin në mënyrë më shkencore dhe më serioze për standardizimin e gjuhës së tyre. Për këtë qëllim, pas vitit 1945, u organizuan disa aktivitete shkencore në të cilat u trajtuan probleme të drejtshkrimit, por edhe të gjuhës standarde në përgjithësi. Megjithatë, ngjarja më e rëndësishme mbetet organizimi i Konsultës Gjuhësore të Prishtinës, nga Instituti Albanologjik dhe Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, e cila u mbajt më 27-28 prill 1968. Në këtë Konsultë, morën pjesë përfaqësues nga të gjitha trojet etnike shqiptare të ish-Jugosllavisë, të udhëhequr nga parimi “një komb – një gjuhë letrare. (Munishi,2007:28).

Diskutimet lidhur me gjuhën e përbashkët në rrafshin politik kanë qenë të pranishme edhe më herët, mirëpo pas Konsultës Gjuhësore të Prishtinës, ku u mor vendimi për përdorimin e një gjuhe të shkruar të përbashkët letrare, ky vendim gjeti mbështetje të fuqishme edhe nga politikanët shqiptarë të Kosovës. Këta të fundit e shfrytëzuan rastin për t’i dhënë një shtysë përpjekjeve për afrimin ndërshqiptar. Këtë e dëshmoi pritja që u bëri klasa e pushtetarëve shqiptarë, pjesëmarrësve të Konsultës ani pse në qarqet partiake kishte të atillë që Konsultën e kishin cilësuar si nacionaliste. Kjo çështje do të bëhej e rëndësishme veçmas në vjeshtën e atij viti, pas demonstratave të studentëve, ku drejtues të instancave të larta në Kosovë kishin planifikuar që çdo tubim shkencor apo kulturor ta shpallnin si nacionalist. Mirëpo, miratimi i përmendur më lartë nga Fadil Hoxha kishte shërbyer si argument për mbrojtje dhe vlerësimi i Konsultës si nacionaliste mbeti nën hije. (Ismajli, 2003:38).

Duke parë hapat pozitiv që po bëheshin në Kosovë, sidomos pas Konsultës Gjuhësore, Akademia e Shkencave e Serbisë, përkatësisht grupi i ekspertëve të saj, hartoi një dokument të quajtur Memorandum, më 1986. Sipas këtij memorandum, unifikimi i gjuhës shqipe dhe të emrit kombëtar shqiptar, shihej si i papranueshëm dhe i dëmshëm për çështjen serbe për shkak se, sipas tyre manifestuaka ide për bashkimin e shqiptarëve.

Por, në Kosovë, gjërat u zhvilluan ndryshe. Një sistem shkollor me shkolla fillore dhe të mesme në gjuhën shqipe u vendos vetëm më 1941, pas rënies së Jugosllavisë, gjatë sundimit Italian. Në atë shtet të Jugosllavisë, shqipja nuk ishte gjuhë që kishte status të lakmueshëm, kishte status zyrtar vetëm brenda Krahinës së Kosovës dhe vetëm krahas me serbishten. Politika gjuhësore në Jugosllavi ishte politikë e dirigjuar dhe në ato rrethana statusi i shqipes varej nga qëndrimi shtetëror ndaj pakicës kombëtare dhe nga raportet midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë. (Ismajli, 2003:89), së këndejmi, gjuhëtarët kosovarë u morën në radhë të parë me statusin e shqipes në raport me gjuhët tjera të Jugosllavisë e jo me raportet përbrenda gjuhës. Prandaj, ata shpeshherë qenë të detyruar t’i pranojnë zgjidhjet e propozuara nga kolegët e tyre në Shqipëri si zgjidhje të vetat. (Ismajli, 1989:94).

Ndërkaq, qëndrimi i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve për shqipen, në *Memorandumin* e saj të vitit 1986, u bë frymëzues i politikës së Milosheviqit dhe programit nacional serb, gjë që ngushtoi dukshëm rrethin për veprim nga intelektualët shqiptarë. Jo

vetëm kaq, por edhe dhuna fizike dhe psikike mbi shqiptarët nga aparati shtetëror e i dhunshëm serb, detyroi elitën politike shqiptare, që më 7 shtator të vitit 1990, të shpallë Kushtetutën e Kaçanikut, për të vazhduar më tej më 2 korrikun, shpalljen e Kosovës shtet të pavarur. Në bazë të kësaj Kushtetute (Kaçanik,1990, neni 10, pika 10), gjuhës shqipe i jepej ky status: „**Në shkollat fillore, të mesme, të larta e fakultete, respektivisht në paralelet e tyre sigurohen kushtet për mësimin në gjuhën amtare, respektivisht në gjuhën shqipe, serbokroate dhe turke, në pajtim me ligjin. Në rajonet ku jetojnë romët, varësisht nga kushtet, sigurohet mësimi fillor edhe në gjuhën rome**”. (Kushtetuta e Kaçanikut, 7 shtator, 1990, neni 10, : 10)

Apeli i studentëve për Konsultën e Prishtinës

Në prag të organizimit të Konsultës së Prishtinës, ishte bërë një apel nga ana e studentëve shqiptarë në adresë të kësaj konsulte, që me rastin e diskutimeve për shqipen në Kosovë, të ndiqej rruga e Tiranës zyrtare. Një gjë të tillë e potencon edhe profesor Rexhep Ismajli i cili hedh në dritë faktin se ka pasur një apel nga ana e studentëve, në të cilin kërkohet që të pranohej Projekti i Drejtshkrimit (1967) i Tiranës. (Ismajli, 1998:182) Profesor, Ismajli më tutje shton se “në një atmosferë të përgjithshme *pro* Projektit nuk duket që ky apel i studentëve të ketë qenë vendimtar pasi që ishte më parë disponimi i përgjithshëm i shqiptarëve në atë kohë që shkonte në favor të mbështetjes për gjuhën letrare”. Në fakt, për shqiptarët që jetonin në trojet e okupuara njësimi i gjuhës shihej si një mjet i fuqishëm i bashkimit kombëtar, i cili synohej të arrihej. (Ismajli, 2003:45) pasi që organizmi i Konsultës Gjuhësore ishte edhe prodhim i rrethanave të reja politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore që ishin krijuar në Kosovë pas demaskimit të politikës antishqiptare të Aleksandar Rankoviçit në Plenumin e Brionëve (1966).

Prandaj, pranimi i gjuhës letrare në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës nga populli shqiptar në Jugosllavi ishte rrjedhojë logjike për atë kohë, pasi siç ka theksuar me të drejtë edhe dijetari i njohur Jannet Byron :“**vendimet e shqiptarëve të Jugosllavisë motivoheshin me parë nga aspekte shoqërore se sa gjuhësore**”.

-Nga e tëra që u tha më lart, mund të konstatojmë se planifikimi i shqipes në Shqipëri dhe në trojet shqiptare në ish-Jugosllavi, deri në fazën e fundit pati rrugë të ndryshme pasi që siç ka theksuar R. Ismajli, deri sa në Shqipëri po zhvillohej “lufta në gjuhë”, në Kosovë zhvillohej “lufta për gjuhë”. (Ismajli, 2003:29).

- Puna në përzgjedhjen, kodifikimin dhe elaborimin e normës u bë kryesisht prej autoriteteve gjuhësore nga Shqipëria e edhe Projekti i Drejtshkrimit (1967) u përfundua pas punës së gjuhëtarëve nga Shqipëria, por, miratimi i tyre nga shqiptarët e ish-Jugosllavisë ishte fund e krye një akt i shprehjes së përkatësisë kombëtare. Këtu shihet qartë se pesha e nacionalizmit po matedej përmes gjuhës.

Në fund të kësaj kumtese dëshiroj të jep këtë përfundim:

-Unifikimi i gjuhës shqipe çoi në përfrimin e bashkimit kombëtar. Kjo tregoi se ne, nuk ishim një popull që me dëshirë jemi ndarë nga njëri –tjetri. Nuk ishim dy shtete sepse ishim një komb me një gjuhë të përbashkët, i ndarë padrejtësisht nga fuqitë e mëdha të Evropës.

Dhe fare në fund po sjell këtu dy mendime, njëri i sociologut të gjuhës Karl Deutsch dhe i dyti i veprimtarit të njohur të çështjes shqiptare, patriotit Jusuf Gërvalla.

I pari (Deutsch) thotë:„*Duhet të mbahet mend, sido që të jetë se elementet e tjera të rëndësishme të kombësisë, si institucionet politike dhe edukative, letërsia, territori, lëvizjet*

KUMTESA

nacionaliste, madje shpesh edhe shtetet sovrane dhe zonat doganore, të gjitha janë ngushtësisht të ndërlidhura me faktorin gjuhësor”.

Ndërsa patrioti Jusuf Gërvalla, gjatë një interviste në Tiranë, në mes tjerash thotë: „*Duke pasur parasysh se nëpër çfarë kohërash ka kaluar populli shqiptar ,, mjaft kemi që sot flasim shqip”.*

Prandaj, unë, gjuhën shqipe këtu e shoh themeltare të krijimit të identitetit dhe formimit të shtetit shqiptar, me theks të veçantë themeltare të krijimit të shtetit të Kosovës.

Recenzentë :
Prof.dr.Ragip Mulaku
Prof.dr. Qemal Murati

**Dr. Sadik IDRIZI¹: UTICAJ ALBANSKOG JEZIKA NA GOVOR I NARODNU
POEZIJU GORE**

¹Edukacijski fakultet Univerziteta u Prizrenu
Departman na bosanskom jeziku

Apstrakt:

Kontakti goranskog govora sa albanskim jezikom su viševjekovni. Uticaj albanskog jezika na govor Gore nije dovoljno proučen, kao što nije proučen ni obrnuti proces. Normalno je da su ti uticaji veći u mjestima koja se nalaze na rubnim dijelovima prema albanskim naseljima. Posebno jak uticaj albanskog jezika prisutan je u dijelu Gore u Albaniji gdje dolazi do čestih međusobnih kontakata i porodičnih veza (ženidbe, udadbe). U kosovskom dijelu Gore pozajmica iz albanskog jezika u leksici ima veoma malo, ali je uticaj u fonetici, sintaksi i frazeologiji znatniji.

Ključne riječi: govor Gore, albanski jezik, bilingvizam, interferencija, leksika, kalkovi.

UVOD

Balkanski jezici pokazuju mnogo paralelnih osobina u fonetici, morfologiji, sintaksi i leksici. Zbog stalnog kretanja stanovništva Gore i čestih kontakata sa govornicima iz drugih, neslavenskih jezika, goranski govor je bio izložen stalnim uticajima gotovo svih balkanskih jezika. Na vrlo bogato i izražajno egzistiranje i stvaranje lingvistilema u usmenom narodnom stvaralaštvu Gore direktan uticaj ima interlingvalni položaj Gore, ali i polilingvalna naobrazba apsolutne većine stanovnika Gore, te lociranje govora Gore na tri lingvistički različita lokaliteta: na Kosovu, u Albaniji i u Makedoniji.

Do propasti Otomanske Turske 1912. godine Gora je bila geografska i duhovna cjelina, a nakon toga našla se na mjestu gdje se uspostavljala granica između Albanije i Srbije. Londonskim mirom kojim je izvršena podjela teritorija, potvrđena Bukureštanskim dogovorom 1913. godine, devet goranskih sela pripalo je Albaniji. Konačna podjela je uslijedila marta 1923. godine kada je definitivno uspostavljena granica između Albanije i Kraljevine SHS. Ovom podjelom najveći dio Gore pripao je Kraljevini Jugoslaviji (21 selo), a manji dio Albaniji (9 sela). Albaniji su pripala goranska naselja: Šišteec, Borje, Zapod, Pakiša, Orgosta, Crnjeljevo, Košarišta, Orešek i Očiklje.

Tada je uvedena administracija kao i nastava u školama na albanskom jeziku. Škole na albanskom jeziku su otvorene najprije u Šišteecu 1924. godine, zatim u Zapodu 1927. i u Borju 1928. godine. Goranski govor je u albanskom dijelu Gore sačuvan u svim selima,

mada je pretrpio pro- mjene kako u leksici tako i u strukturi. Jedino je selo Orčikle na granici da izgubi svoj dosadašnji jezik i da se u potpunosti albanizira.

DISKUSIJA

U fonetici goranskog govora došlo je do određenih promjena koje su nastale pod uticajem albanskog jezika. Na ove pojave su u svojim radovima ukazivali pojedini istraživači govora Gore.

Prisutnost *a* (ë) u goranskom govoru, u kojem su poluglasnici vokalizovani, ukazuje na kontakt sa arumunskim, ali i albanskim govorima. Božidar Vidoeski smatra da je redukcija vokala, prije svega *a*, najčešće u kontaktu sa nazalima, mogla nastati pod uticajem arumunskih ili albanskih govora (Vidoeski:1998).

I „zatamnjanje“ vokala *a* Koneski objašnjava sličnim pojavama u albanskim i arumunskim dijalektima (Koneski:1966). Pojam „zatamnjanje“ koji koristi Koneski odnosi se na redukciju i zatvaranje vokala. U kontaktu sa nazalima u mnogim slučajevima *a* je prešlo u *a* (ë). To se dogodilo kako u domaćim tako i u riječima stranog porijekla. Glagol *znəm, znajem* – *né znəm, né znajem* koristi se u ovom obliku gotovo na cijelom prostoru Gore. Oblik *né znam, né znajem* je poznat na ograničenom prostoru i vjerovatno je inovacija.

Momci spijet, majčice, ka *jagəncə* (Dokle, 437).

Ge zatemne jena temna *məglə*,
niz *məglata* jeno belo pile, (Hasani, 264).

Uspostavljanje konsonanta *dz* (*x*) u govoru Gore, također, bi moglo biti podstaknuto arumunskim ili albanskim uticajem.

Najveći dio autora *l/l < lj* u slavenskim govorima objašnjava uticajem albanskog jezika (Ivić: 1991). Ivić ističe da je „u mnogim govorima duž albanske granice, crnogorskog, metohijskog i prizrenskog tipa, kao i kod sandžačkih Muslimana, poremećen odnos između *l* i *lj*, ali bez potpunog gubljenja distinkcije ovih fonema“ (Ivić:1991).

Goranski govor i poezija Gore poznaje tročlani i dvočlani sistem pokaznih zamjenica. Tročlani sistem je prisutan u višim selima, dok dvočlani sistem poznaju niža sela. Tročlani sistem (*óvja, ója, ón-ja*) poznaju viša sela Gore kao i sela u Makedoniji (Urvič i Jelovjane), te viša sela u Al- baniji (Borje, Šišteec, Orešek i Crnjeljevo). Dvočlani sistem (*óvja, tója*) poznaju niža sela Gore kao i niža sela u Albaniji (Zapod, Pakiša, Orgosta, Košarišta i Orčikle). Tročlani sistem poznaju obližnji makedonski i neki granični srpski govori. Dvočlani sistem poznaje i albanski jezik.

U goranskom govoru i u narodnoj poeziji Gore normalno je da atribut stoji ispred imenice koju određuje. Ali nije rijetko da atribut dođe iza imenice, odnosno da se nađe u postpoziciji. Ovakvo mjesto atributa je čak obavezno ako je atribut prisvojna zamjenica. Mjesto atributa iza imenice osobina je romanskih jezika. Ta osobina je karakteristična i za albanski jezik.

Nesumnjivo je da je ona u goranskom govoru nastala kao rezultat kontakata sa pomenutim neslavenskim jezicima, svakako i albanskog.

U goranskom govoru u upotrebi je nekoliko riječi iz albanskog jezika: *besa* („zadata riječ“), *nusa*¹ (alb < *nysa* – „nevjesta“) mada je u češćoj upotrebi riječ *mlanesta* (*mlada nevesta*), *kənaç* (< *kənaq* – „zadovoljiti“), *baljoš* („pjegav čovjek“), *bojđakesto* („boje krvi“), *çupa* („šuta“, „ovca bez rogova“), *grika* („uvala“), *đūša* („tašta“, „punica“), *krupa* (< alb. *kripë* – sol, u goranskom govoru sa značenjem prejesti se, presoliti stoku), *ljaljo* („otac“, ograničeno na neka naselja) i još poneka riječ.

Prema albanskom modelu su nastali pojedini frazeološki kalkovi u goranskom govoru:

na glava ot devet godine = „në krye të nëntë vjetëve“;
nemalje ljep duša da vrtet = „nuk kishin bukë të mbanin shpirtin“;
nemaj strah = „mos ki frikë“;
usta/ruka da ti çafte = „të lumë goja/dorë“;
me tera srce = „po m'qet zemra“, „më shkon barku, kam kolit“;
sum teška: „jam e rëndë, „jam me barrë, shtatzënë“;
besa da vrzeme = „besën me lidhë“;
ima tvrda glava (tvrdoglav) = „e ka kokën e fortë“;
koljko se učini sahat = „sa u bë orë“.

U narodnoj poeziji iz kosovskog dijela Gore uticaj albanskog jezika je neznatan. U upotrebi je tek nekoliko leksema:

Zimbiljo nuse ubava (Hasani, 43).

mije *besa*, Omer, će vrzeme,
 tvrda *bese*, Omer, arnautska, (Hasani, 163).

U zbirkama pjesama i narodnih priča koje je Nazif Dokle sakupljao u albanskom dijelu Gore, a koje su nastale nakon uvođenja albanske uprave, uticaj je izraženiji:

Pet *puntora* prajet bunar (Dokle, 123), (alb. < *puntor* – „radnik“).

Mu ispuca mintan *bojđaklija* (Dokle, 188),
 (alb. < *bojëgjak* – „crven“, „boje krvi“).

Dalj *filore*, naša dejko, *tetvjeçare*
tetvjeçare, naša dejko, elj *unike*?! (Dokle, 299).
 (alb. < *filore* – „osnovna škola“; *tetvjeçare* – „osmoljetka“; *unike* – „srednja škola“).

Naše horo kraj ne ima,
 ke će vljeze i *suljmuje*, (Dokle, 439), (alb. < *sulm* – „napad“).

Naša država *lirija* ni dala. (Dokle, 440), (alb. < *liria* – „sloboda“).

Ja som *roja*, more, ot planina (Dokle, 446), (alb. < *roja* – „straža“).

I ja gi sakam muškarci da mi bidet *vendosur* (alb. „odlučan“), Ama *krahasim* (alb. „u poređenju“) so drugete, a me *kuptuješ*? (alb. „shvataš“). Veljet se *prmirualo* (alb. „popravilo“), (Orešek). Mije ot Šišteec i Borje *pondruše* (alb. „drugacije“) zborime. (Zapod). Mu pišaf *se* dejka negova ide po loši putoj. (Dokle, Priče).

Navedeni primjeri ukazuju na prilagođavanje albanskih riječi morfološkom sistemu goranskog govora. U glagolu *kuptuješ* (alb. < *kuptoj* – „razumijeti“, „shvatiti“) nastavak -*uješ* je goranski nastavak za drugo lice jednine prezenta. U glagolu *prmirualo* (alb. < *përmirsoj* – „popraviti“, „poboljšati“) nastavak -*ualo* je nastavak glagolskog priloga radnog za srednji rod, dok je u riječi *pondruše* (alb. < *ndryshe* – „drukčije“) -*po* prefiks za komparativ priloga. Sličnih primjera ima mnogo, jer je albanski jezik ovdje prisutan u svakodnevnoj komunikaciji izvan porodice u svim javnim i državnim institucijama.

I u manjem broju toponima i patronima primijetan je uticaj albanskog jezika:

Toponimi: *Árber* (Orčuša), *Bériša* (Dikance), *Gurél'* češma, *Gúrel'*, *Džónoec*, *Džerávišća* (Res- telica), *Đinóf* potok (Kruševo), *Gúra* (Zlipotok), *Kiša*, *Pišec* (Borje), *Kiša*, *La Dámes*, *Maj vores*, *Nən aras*, *Más krei* (Orčikle).

Patronimi: *Beriša*, *Krasnići*, *Ljura*, *Paljoš* (Brod), *Paškovci* (Gornja Rapča), *Nelja*, *Kojčin*, *Kru- ezi*, *Šalja*, *Šok* (Globočica), *Brenoli*, *Sopi* (Kruševo), *Ukovci* (Kukaljane, Bačka), *Bardovci* (Leš- tane), *Páljinci* (Borje), *Gaši*, *Krasnići* (Orčikle), *Kaljimačići* (Orgosta), *Bibinci* (Orešek), *Kras- níčovci*, *Šlaku*, *Mataj* (Zapod), *Tuševci* (Urvič) i drugi.

U albanskom dijelu Gore goranski govor u odnosu na državni i administrativni jezik (albanski) ima poziciju „kasnog bilingvizma“, jer učenje albanskog jezika ovdje počinje tek od šeste-sedme godine, tj. polaskom djece u školu.

U ovom dijelu Gore gotovo jedan vijek egzistira posebno interesantna jezička realnost. Naime, tamo je albanski jezik prisutan u administraciji, školstvu i cjelokupnom društvanom životu, dok goranski („naški“) služi za privatnu komunikaciju. To je navelo Shefqeta Hoxhu da dođe do zaključka da se u „bilingvnoj zoni Gore govori albanski jezik i jedan slavenski dijalekt sa nejasno određenim statusom, koji se može približiti makedonskom, odnosno bugarskom“ (Hoxha:2007). Međutim, bilingvizam je ovdje nastao kao rezultat specifičnih okolnosti nastalih nakon 1923. godine, kada je uspostavljena sadašnja politička granica, i kada je ovaj dio Gore potpao pod jurisdikciju albanske države, kada je albanski jezik postao službeni i kada su otvorene škole na ovom jeziku. Prije toga je retko ko znao govoriti albanski jezik (Dokle:2009). O tome najbolje svjedoči kazivanje Ilijaza Šahinija iz Borja, učenika prve generacije škole u Borju otvorene 1928. godine: „Nismo znali niti jednu albansku riječ. Učitelj nas je učio albanski jezik isto kao što majka uči dijete kada počinje govoriti. Najprije nas je učio kako se na albanskom imenuju dijelovi tijela. Uhvati uho i kaže ovo je uho, a onda ovo je nos, ovo su usta, ovo su oči i tako redom. I pored toga što je dobro poznao slavenski, nikada nam nije govorio slavenski. Tako smo, iz dana u dan, učili novi jezik“ (Elmaz Dokle:2010).

ZAKLJUČAK

Mnogobrojni oblici, riječi i kalkovi porijeklom iz albanskog jezika koji se javljaju u govoru i narodnoj poeziji Gore svjedoče o intenzivnom odnosu između ovih jezika. To potvrđuje ispravnost stanovišta koje, pri objašnjavanju fonoloških i gramatičkih pojava, daje značajno mjesto međujezičkom kontaktu u balkanskoj jezičkoj sredini.

Nesumnjivo je da su grčki, arumunski i kasnije turski jezik ostavili najviše tragova u modeliranju balkanske leksike. Što se tiče govora Gore i narodne poezije Gore, pored pomenutih jezika, treba posebno istaći i uticaj albanskog jezika sa kojim se veoma često dolazilo u kontakt. Uticaj albanskog jezika na govor Gore i obrnuti procesi nisu u dovoljnoj mjeri proučeni, mada su se mnoge riječi, a naročito kalkovi preuzeti iz albanskog jezika, odomaćili u govoru Gore i ponekad predstavljaju bukvalni prijevod.

Recenzenti:

Prof. dr. Ahmet Kasumović, Univerzitet u Tuzli (BiH)

Prof. dr. Azra Verlašević, Univerzitet u Tuzli (BiH)

Summary

[Sadik Idrizi]

INFLUENCE OF THE ALBANIAN LANGUAGE ON THE SPEECH AND FOLK POETRY OF GORA

Balkan languages show a lot of parallel features in phonetics, morphology, syntax and vocabulary. Due to the population movement, the Gorani dialect was always exposed to the influence of almost all Balkan languages.

Contacts of Gorani dialect with Albanian language are long for centuries. Influence of Albanian language to Gora dialect is not well researched, and vice versa. It is normal that these influences are bigger in the places allocated at the boundary towards the Albanian settlements. The influence of the Albanian language is especially stronger in Gora part which is under the administration of Albania for almost a century and where the interpersonal and family contacts are more frequent.

KUMTESA

Dr.Xheladin ZYMBERAJ¹: PËR NJË EKOLOGJIZIM TË VARIANTIT TË FOLUR DHE TË SHKRUAR TË GJUHËS STANDARDE

¹Fakulteti i Edukimit

Gjuha është një mjet komunikimi. Njerëzit jetojnë e bashkëveprojnë në një mjedis shoqëror. Kështu, ajo nuk duhet shikuar vetëm në raport me përdoruesin, por edhe si modalitet veprimi. Deivid Crystal, një linguist i njohur anglez thotë se bota është një mozaik vizionesh, të cilat shprehen përmes gjuhës.

Realizimi konkret i gjuhës është akti i të folurit. Në mjedisin ku jetojnë, njerëzit përveç raporteve të tjera kanë edhe kontakte verbale. Kështu të folurit është edhe si sinjal i identitetit shoqëror. Ashtu si gjuhët e tjera, shqipja përmban disa njësi gjuhësore që pasqyrojnë karakteristikat e folësit e të dëgjuarit dhe marrëdhënive midis tyre.

Gjuhëtari i mprehtë, Prof. Xhevat LLoshi ndër të tjera thekson: "Gjuha është veprimtari shoqërore dhe një ndryshim në gjuhë është për t'i thënë botës se duhet të ndyshojë¹. Ne mendojmë se në rrjedhën e gjuhës, njësia dhe ndryshueshmëria janë gjeneratorë që vënë në lëvizje zhvillimin e hovshëm të saj. Përballë këtij zhvillimi është e natyrshme dhe e nevojshme njohja e rregullave që drejtojnë veprimtarinë gjuhësore.

Gjuhësia moderne dhe kushtet e reja shoqërore kërkojnë që gjuha të shihet e të studiohet edhe në raport me shoqërinë, me përdoruesin, me antropologjinë, me proceset psikike, me bazat neurologjike në raport me përdorimin e mjeteve kompjuterike etj.

Përveç të tjerash edhe në fushën e komunikimit kërkohet një vetëdije më e lartë në përdorimin e gjuhës së folur dhe asaj të shkruar. Gjuha standarde duhet parë, jo vetëm në raport me përdoruesin, por edhe me mjedisin gjuhësor shoqëror. Me t'u zbuluar një send, nga cilado fushë qoftë, ai kërkon një emërtim të ri. Prandaj është e nevojshme që në nivelin e ASHAK të formohet një komision për hartimin e termave të rinj. Pas lufte, bashkë me disa kolegë kemi mbajtur seminare nëpër shkolla të viseve të ndryshme të Kosovës, gjatë asaj kohe kam vënë re se, sidomos në zonat e thella, nxënësit e atyre viseve nuk e zotërojnë në nivel të kënaqshëm gjuhën standarde. Kodi i tyre gjuhësor është më i kufizuar në krahasim me moshatarët e tyre në zonat e tjera. Për këtë prapambetje gjuhësore nuk janë fajtorë vetëm nxënësit. Kjo lidhet edhe me kontekste të tjera shoqërore, pra me ngritjen profesionale dhe gjuhësore të arsimtarëve. Ka mjaft tregues të tjerë që sinjalizojnë MASHT-in për të organizuar seminare me arsimtarët jo vetëm në fushën e metodologjisë së avancuar të mësimdhënies, por edhe të atillë që trajtojnë problemet e gjuhës standarde.

Kur normat gjuhësore nuk njihen si duhet, atëherë bëhen edhe shkelje të tyre. Kështu, shkeljet gjuhësore vihen re te administrata, te shtypi, te mediet etj.

Në ofiqaritë tona , nga mosnjohja e nivelit të duhur të gjuhës, bëhen regjistrime të gabueshme të emrave vetjakë.

Së këndejmi vjen edhe shtypa për një ekologjizim, një ngritje e vetëdijes së përdoruesit të gjuhës në një shkallë më të lartë. Në të mirë të kësaj çështjeje kaq të rëndësishme flet edhe Prof. Xhevat Lloshi:

``Ekologjia gjuhësore`` e mbështetur në studime serioze pragmatike do të jepte ndihmesë të vlefshme për të përmirësuar atmosferën serioze të vendit¹.

Të folurit e drejtë është edhe një sinjal i mirë i identitetit shoqëror. Edhe në gjuhën e shkruar ka norma që duhen zbatuar dhe respektuar. Njësitë gjuhësore vargëzohen ashtu siç e kërkon natyra e gjuhës. Nga përdorimi vend e pa vend i tyre bëhen edhe shkelje të gjuhës standarde.

Shkelje të tilla vihen re edhe në sferën e ekonomisë, të administrimit, të biznesit, , të arsimit etj.

Në fushën e arsimit ndeshim gabime që u përkasin degëve të ndryshme gjuhësore: Fonetikës, Morfologjisë, Sintaksës, leksikut etj.

Në fonetikë ka shkelje të drejtshqiptimit, te përdorimi i theksit, te grupet e zanoreve, të cilat nuk shqiptohen të plota; mosruajtja e zanores ë të patheksuar në pozicionin në fillim të fjalës dhe në atë fundor. Mosshqiptimi i j-së ndërzanore *paqja* (paqa), *anija* (ania) etj.

Shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në trup të fjalës. Ka shkelje edhe te grafia e shqipes standarde. E rëndësishme për grafinë e një gjuhe është leximi i njëvlershëm i diagramave¹. Shkelje të tjera ndeshim edhe te modifikimet e tingujve, sidomos në ligjërimin kuvendor. Nga mosnjohja në shkallë të duhur e prozodisë, shpesh, njësitë suprasegmentare ngatërrohen me dukuritë kryesore prozodike.

Në morfologji ka shkelje te struktura e fjalës, te shumësi i emrave, te përdorimi i trajtave të shkurtra të përemrave vetorë, te përdorimi i pronorëve, te shkrimi i datave. Gabimisht kemi edhe krijimin e një rase gjinore pa mbaresë. Shpesh bëhet ngatërrimi i vetës së parë të lidhores me vetën e tretë. Përdoren gabimisht trajtat e fjalëve në pjesore e në paskajore.

Në sintaksë vihen re shkelje në ndërtime sintaksore. Prof Emil Lafe me kompetencë të thellë gjuhësore thekson: Dhunimi i strukturës sintaksore sjell shpërfytyrimin e gjuhës¹. Gabimet sintaksore vihen re kryesisht te format kryesore të lidhjeve sintaksore, sidomos te përshtatja e drejtimit; te bashkërregullimi i trajtave mënyrore të foljeve kallëzues, te përdorimi i gjymtyrëve të dyta.

Raportet sintaksore në disa raste mund të gjejnë shprehje në topikën a rendin e fjalëve e të gjymtyrëve , herë – herë edhe fjalive¹. Nëse nuk jemi të kujdesshëm në këtë drejtim, çrregullojmë kohezionin dhe koherencën sintaksore.

Ka shkelje edhe te paravendosja e prapavendosja e një gjymtyre a fjalie ndaj gjymtyrës a fjalisë së cilës i referohet rendi i gjymtyrëve në fjali dhe i fjalive në periudhë. Pra, duhet një kujdes i shtuar në këtë drejtim, sepse mbi faktet gjuhësore ushtrojnë veprimin e tyre edhe dukuritë shoqërore. Kështu, zhvillimi kulturor i një populli sjell edhe pasurimin e mjeteve sintaksore të gjuhës së tij , rritjen e fuqisë shprehëse të saj¹. Prandaj mbetet i përgjithmonshëm konstatimi i Prof. Idriz Ajetit se në veprimtarinë e kulturës së gjuhës nuk mund të ketë sukses po nuk u edukua dashuria për gjuhën amtare , ndjenja e përgjegjësisë dhe qëndrimi i ndërgjegjshëm ndaj saj.

Standardizimi , sipas Prof. Shezai Rrokajt, është një proces i vazhdueshëm dhe në këtë mënyrë nuk mund të ketë as pikënisje të caktuara , as pikëndërprerje e as pikëmbështetje , sepse si gjuha dhe faktorët jashtëgjuhësorë janë në lëvizje të pandërprerë¹

Mendoj se një fushë virgjër për studiuesit dhe kërkimtarët e zellshëm është fusha e leksikut të shqipes, e cila në vazhdimësi do t'i shërbejë gjuhës standarde si një burim i pashterrshëm i fjalëve të truallit të saj. Do të përmend vetëm një shembull: në zonat e thella të Shqipërisë së Veriut për konceptin *bukël* kemi 35 sinonime. Në Australi ekziston një fis që për ngjyrën e kuqe ka 15 fjalë, d.m.th. e kuqja perceptohet në 15 mënyra.

Në Kosovë tash , të thuash , kemi kryqëzim kulturash, vlime zhvillimesh, për pasojë kemi një vërshim të rrëmyeshëm fjalësh të huaja në lemenjtë e ndryshëm të jetës sonë shoqërore. Këtyre duhet vënë pritë duke i zëvendësuar me ato të leksikut të shqipes.

Nga ana tjetër, njerëzit e profesioneve të ndryshme në të folurit e përditshëm nuk i përmbahen gjuhës standarde, duke shkelur atë dhe duke iu kundërvënë rregullave të saj. Lëkundje të standardit kemi edhe kur njerëzit bashkëkuvendojnë edhe në ato raste norma gjuhësore nuk ruhet plotësisht. Ndonëse ligjërimet e ndryshme në gjuhë nuk kanë kufi të prerë midis tyre, shkeljet gjuhësore janë më shumë të pranishme te ligjërimi i thjeshtë.

Përfundim

Gjuha nuk është vetëm transmetues i emocioneve njerëzore, ajo transmeton edhe vlera sociale, etike, shpirtërore dhe ekologjike.

Shqipja standarde sot si varietet i përzgjedhur, i kodifikuar, funksional dhe i pranuar, përdoret funksionalisht në administratë, në gjykata, në arsim e në institucione të tjera shtetërore dhe si e tillë shërben si gjuhë kombëtare, si forcë unifikuese për shtetin dhe si simbol i shtetit përkundrejtë shteteve të tjera.

Ndaj, kujdesi dhe përsosja e mëtejme e gjuhës standarde kërkon një angazhim dhe përkujdesje më të madhe të të gjitha institucioneve tona.

Recenzentë :
Prof.dr. Hasan Mujaj
Prof.dr. Adem Hajdaraj

KUMTESA

**Dr. Teuta KAFEXHOLLI: PËR MITRUSH KUTELIN DHE KONSTATIMET E TIJ
PËR KËNGËT FOLKLORIKE**

Abstrakt:

Në këtë kumtesë me temë “Për Mitrush Kutelin dhe konstatimet e tij për këngët folklorike” bëhet fjalë për disa segmente të jetës së tij dhe për kontributin e madh që dha si për mbledhjen e folklorit ashtu edhe për studimin e këngëve lirike. Posaçërisht zgjon interesim studimi i tij i hershëm që në vitin 1933 kur boton studimin e tij të rrallë dhe të vlesfshëm me titull “Vendet e largimit në këngët popullore shqiptare”. Theksohet se këngët popullore shqipe përbëjnë një lëndë dokumentare me rëndësi të veçantë për studimin e kohës së kaluar. Studentët shqiptarë të jashtëm dhe pikërisht ata që vazhdojnë degën e letërsisë, mund t'i bëjnë një shërbim të madh kombit duke marrë teza magjistrature ose doktorate nga fusha virgjine e folklorit shqiptar. Ky mendim vizionar për kohën dhe hapësirën, është jo vetëm i mirëpritur por edhe me sugjerime të përhershëm aktuale.

Dhimitër Pasko, i njohur përjetësisht në letërsinë shqipe si Mitrush Kuteli, rrjedh nga një familje shqiptare, shpërngulur në Mokër, pastaj në qytetin e Pogradecit (nga Çamëria, qytet i Artës) në fillim të shekullit XIX. Babai i Kuteli, Pandi Pasko ka qenë i pari që ka përhapur libra shqip në Pogradec. Qe i kapluar nga flaka e patriotizmit në kontakt me patriotët e kohës në Rumani, sidomos me Nikolla Naçon. Në Pogradec ndërron profesionin e muratorit dhe bojaxhiut dhe hap librarinë e parë me libra shqip më 1908. U quajt edhe „Pandi shqiptari“. Qe burgosur, ndjekur e përndjekur nga regjimet e kohës aq sa përfundon në zjarrin e shtëpisë së djegur më 1943, për çka poeti Kuteli do të shkruajë „Poemin e Shëndaumit. Në shtëpinë e tyre vinin luftëtarë të kohës. Dervish Hima, Mihail Grameno, Avdyl Ypi, Thimi Gërmenji, Pasa Pema, Vasil Tamara, Telemak Gërmenji, Menduh Zavalani etj. Këta dy të fundit i dënojnë xhon turqit me vdekje duke i mbytur në thellësitë e liqenit.

Krijimtaria e Mitrush Kutelit përbëhet nga shumë fusha veprimi. Ai njihet si prozator me tregime e romane, si studiues (kritik), përkthyes duke na lënë vepra klasike me përkthime të mrekullueshme, gazetar e publicist, veprimtar për çështje kombëtare me gazetatat e revistat “Bota letrare”, “Shqipëria e re” etj., si njëri nga themeluesit e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, si kryetar i studentëve shqiptar në Rumani, folklorist e poet, por edhe si ekonomist i shpikatur.

Si folklorist botoi “Këngë e britma nga qytet i djegur”, “Vendet e largimit në këngët popullore shqipe” (studim), “Proverba popullore shqiptare” (rumanisht), një përmbledhje me 140 këngë popullore, ”Tregime të moçme shqiptare”, “Xinxifilua” dhe përralla të tjera, një tekst për folkloristikën për shkollat e larta të Tiranës etj.

Folklori ka qenë ushqimi shpirtëror i përhershëm kur Mitrush Kuteli ndodhej në mërgim. Atje kish mbledhur folklor midis shqiptarëve të mërguar. Këtë veprimtari e ka vazhduar kur është kthyer në Shqipëri.

“Këngë e britma nga qyteti i djegur” është vepër me lëndë filklorike këngësh popullore mbledhur në Pogradec. Këto këngë i ka pajisur me shënime të duhura biografike të njerëzve që ia kishin dhënë këngët. Kjo është një nga përmbledhjet e para folklorike me kritere shkencore. Pastaj ka mbledhur tetëdhjetë përralla dhe 140 këngë popullore, të cilat, mjerisht i kanë mbetur të pabotuara. Në vitet 1928-1933 ka botuar në “Shqipëria e re” një varg komentesh mbi folklorin shqiptar, sidomos mbi këngët historike.

Kuteli boton gjithashtu një përmbledhje të fjalëve të urta shqipe titulluar “Proverba albaneze” duke njoftuar një regjion tjetër gjuhësor me kulturën shpirtërore shqiptare. Nga ky autor kemi në vitin 1962 librin “Xinxifilua” me përralla; pastaj “Tregime të moçme shqiptare” me balada e këngë kreshnike të ritreguara në prozë, në vitin 1965, pikërisht kur shkruan kërkesën për leje pune.

Le të hyjmë tani në botën e këngës e të krijimtarisë folklorike të Mitrush Kutelit për të parë sa vlerat e kësaj kulture shpirtërore, aq edhe rolin dokumentar, siç thotë vetë Kuteli për këngët historike në një studim të tij që më 1933.

Se, me sa përkushtim, i qaset ai trashëgimisë popullore të popullit, duket qartësisht e bindshëm po të përmendim edhe një burim tjetër të veprës së tij, një qëndrim i shprehur në “Sulm e lot”:

“...Dikur në një qytet të math, në dimrin e rëndë të vitit tridhjetë e shtatë ... ky mall m’u pat ndezur aq fort në shpirt sa jam mbyllur në shtëpi brenda një muaj e një javë, të lëçit libra shqip me vetë-veten. Asohere Fjalori i Kristoforidhit, Bleta e Mitkos, Valët e detit të Dines, kanë mbetur ditë e natë të hapura në tryezë e në shtrat dhe të leçitura e të rileçitura ças për ças- si prifti ungjitë”. Peshën e këtij qëndrimi e shton pozitivisht edhe fjala e Mitrush Kutelit për rolin e vdekjen e një shkrimtari apo një kombi (shtoi T. K.) me këto rreshta: “Mua më duket se vdekja e një shkrimtari si shkrimtar, fillon atëherë kur pushon të flasë me vetë veten në gjuhën e tij. Nis atëherë përleshja e shprehjeve dhe veshja e mendimeve me petka të huaja – ose me petka balashe – të cilat, ay vetë, i errësuar nga pikëpamja e gjuhës, s’ka se si t’i dallojë se janë të huajat”.

Për këtë fakt krijues të M.Kutelit, një studiues i spikatur si Aurel Plasari, me të drejtë thotë: “...Të përcaktojmë qysh në krye se dy mësues të mëdhenj pati M.Kuteli: krijimtarinë gojore të popullit dhe tekstet religjioze kishtare. Nëpër këtë shkollë të dyfishtë, gati të pashmangshme për kohën, kaluan edhe shumë bashkëkohës kulte të Kutelit, por asnjëri syresh Kutel nuk u bë (A.Plasari, “Mitrush Kuteli midis të gjallëve dhe të vdekurve”, Tiranë, Apollonia, 1995, f.100). Kjo na e shton e përforcon bindjen se folklori si krijimtari artistike i freskon, i zbukuron, i përplotëson të gjitha shkrimet e shumta të Kutelit. Po në mënyrë të veçantë Kuteli folklorist spikatet në veprat e përmendura më lart siç janë: “Këngë e britma nga qyteti i djegur”, “Vendet e largimit në këngët popullore shqipe” e komente të tjera botuar në “Shqipëria e re” të Konstancës që më 1933 dhe vepra të tjera të Kutelit.

Duhet te theksojmë se “Këngë e britma nga qyteti i djegur” është e para vepër folklorike moderne, por s’është thënë si e pse M.Kutelit i takon ky nder në folkloristikën shqiptare. Nga shfletimi e studimi i veprës totale të M.Kutelit mësojmë se ky shkrimtar, ky ekonomist, në Rumani, ka ndjek një kurs për folklor. Ky do të jetë shkaku që ai pat qëndrim shkencor ndaj lëndës folklorike. Ai ka shkruar edhe një tekst për studentët e shkollave të larta për folklor që mjerisht ka humbur.

Dhjetë vjet para se të botonte “Këngë e britma nga qyteti i djegur”, Mitrush Kuteli studioi gjeografinë e këngës shqipe në punimin titulluar “Vendet e largimit në këngët popullore shqipe “. Ky punim duhet konsideruar i pari në historinë e folkloristikës shqiptare që prek zemërgjërësinë e këngës shqipe si dhe përhapjen gjeografike të saj.

Le të ndalemi pakëz te ky punim për të theksuar disa vlera që i ka vërejtur Kuteli. Ja një mendim që më ka befasuar:

“...Këngët popullore shqipe përbëjnë një lëndë dokumentare me rëndësi të veçantë, për studimin e kohës së kaluar. Studentët shqiptarë të jashtëm, dhe pikërisht ata që vazhdojnë degën e letërsisë, mund t’i bëjnë një shërbim të madh kombit duke zgjedhur si tema për licenca ose doktorata fushën virgjine të folklorit shqiptar.”

Vini re fjalën “studentë të jashtëm”. Le të koncentrohemi, le ta thellojmë pak të menduarit tonë “të jashtëm”. Është viti 1933. Ata që bënin shkollimin e lartë ishin jashtë shtetit shqiptar dhe folkloristi ynë apelon, këshillon në rolin e mentorit, të merren për objekte studimi ato lëmi e fusha që janë të paprekura siç është, apo siç ka qenë folklori ynë. Është koha e mbretërisë së Zogut. Mitrush Kuteli na këshillon të bëhen licenca e doktorata që në vitin 1933. Në gjithë Shqipërinë ahëre nuk kish ende asnjë fakultet, qoftë nga shkencat filologjike apo nga ato të shkencave ekzakte. Tingëllojnë në mënyrë profetike fjalët e Kutelit para se të hapet Universiteti i Tiranës më 1957. Na gëzon largpamësia apo vizioni i M.Kutelit. Ai e ka dhënë këtë mendim vizionar në një kohë kur çështjet gjuhësore dhe çështjet e kulturës sonë të shekullit të kaluar i kanë bërë më shumë të huajt se sa studiuesit tanë. Dhe kjo jo pse kanë munguar vlerat tona folklorike, por pse kanë munguar studiuesit nga gjiri ynë. Shikuar nga ky aspekt shkrimi studimor i Kutelit mbetet sa vizionar aq edhe sinjifikativ, sa i qëlluar aq edhe aktual dhe na gëzon ky fakt, siç na gëzojnë edhe shkrimet e tij qofshin nga sfera ekonomike apo ajo artistike. Le të theksojmë me këtë rast se fjala e dytë e titullit “... e largimit” është përdorur në kuptimin e shtrirjes gjeografike të këngës shqipe nëpër botë siç sqaron edhe N. Jorgaqi .

Mitrush Kuteli e shpreh këtë mendim sugjestiv kur ishte vetëm 26 vjeçar dhe mendimi i tij mbetet aktual dhe vlen si leksion për të gjithë ata që i kanë në dorë përcaktimet e tezave të mr. e dr.

Për këtë punim e për këtë temë, kanë shkruar disa studiues por të gjithë e kanë lënë anash çështjen thelbësore apo esencën që e theksuam më lart. Fjalën e kam për mendimin e Kutelit në fund të punimit të tij. Të gjithë këta ose s’e kanë ditur ose e kanë anashkaluar punimin “Vendet e largimit në këngët popullore shqiptare “ shkruar nga M.Kuteli,1933.

Në këtë studim të botuar para gati 80 vjetësh, Kuteli ka shfaqur mendime dhe ka nxjerr konstatime me interes shkencor. Ai na del njohës i shkëlqyeshëm jo vetëm i poezisë shqiptare por edhe i asaj ballkanike. Ai na sjell shembuj që dëshmojnë shtrirjen gjeografike të këngës popullore shqiptare, duke thënë se perandoria e këngës sonë është tepër e gjerë “ajo shtrihet që nga Spanja e gjer në Brusë e ndofta edhe më tej, që nga Krimeja e gjer në Abisini”. Kështu dëshmohet se kënga shqipe pushton me toponiminë e saj tri kontinentet me këngët më të hershme, kurse me ato më të vonshme edhe dy kontinentet tjera, pra Amerikën dhe Australinë.

Duke qenë njohës i mirë i folklorit dhe këngëve tona popullore, ai rendit një varg emrash: Spanja, Italia, Venetiku, ose Venetia, Karadaku, Rumelia, Vidini, Plevna, Edreneja, Vllahia, Ardeli, Mallakovi, Krimi, Vullaka, Abisinia etj. Ky varg emrash shtohet po t’i radhisim edhe viset e Greqisë: Athinë, Misalongji, Morea, si edhe viset legjendare: Janina, Preveza, Korfuzi, Suli, Hormova apo "Hercegovinë gjithë male"etj. Veç këtyre në këngët

KUMTESA

popullore shqipe kujtohen kombe të huaja me të cilët shqiptari pat ardhur në marrëdhënie si Frëngu ose Francezi, Inglizi ose Englezi, Taliani, Nemci, Magjari, Bosnjëria, Shqahu ose Piperlliu, Turku, Tartari, Greku, Vllahu, Moskovi, Arapi, Habeshi etj.

Dua të ndalem edhe në dy momente me rëndësi të këtij studimi. Mitrush Kuteli me metodën krahasimtare hyn në botën e këngës rumune, greke e “shqahe”. Ai ka qenë njohës edhe i gjuhëve të këtyre këngëve ballkanike por edhe i vet folklorit rumun, sllav e grek. Për këngën shqahe ai thotë se legjenda bëhet përrallë; te ajo greke kënga del e ngarkuar me artificializëm dhe me ide të mbjella. Kënga rumune ose rumuni nuk këndon përveç se malet, grykat, fushat dhe lumenjtë e tij. Inspiracioni është pasiv, sepse rumuni njeh këto kombe kur i erdhën në vatrën e tij dhe jo sepse u ka shkelur ai tokën.

Pse kënga popullore shqiptare del, sipas M.Kutelit, më e avansuar, pyet Kuteli dhe përgjigjet vet: “Pa fjalë se shkaku i dukshëm është se në kohën e kaluar shqiptari ka rrahur shumë dendur rrugët e mërgimit. Po ky fenomen nuk është veçse një efekt. Shkaqet e vërteta mund t’i përmbledhim në tri grupe kryesore:

1) shkaqe politike, 2) shkaqe shoqërore dhe 3) shkaqe ekonomike.

Duke zbatuar metodën krahasimtare, ai konstaton se kënga popullore shqiptare është “lulja e egër e muzës shqiptare”.

Nga këto shkaqe që i përmendëm më lart, muza popullore shqiptare pushton kontinentet me këngët si më poshtë:

a)

Ka vojtë fjala te Dovleti:/Ne at Bruzë e ba gazepi :/ U vra Isuf Pula vetë i tretë.

b)

Një të enjëte nga qindia/ ndë Misir u zu nizaja/ se iu rrethua kalaja./Ndë Misir e ndë Vullakë...

c)

Sevastopull anë deti,/ia vuri synë dovleti/.../...Lëfton Englez e Francezi/ i gjori Moskovë sa ndezi...

ç)

Mbeçë ore shokë mbeçe/ përtej urën e Qabesë...

d)

Del Sulltan Aziz nga varri,/... ta muar të shkretën Tunë/ Tun’ e pashtë Rumelisë/lanet paç bej i Vllahisë,/iu bëre jatak Ruisë/muar gjysmën e Anadollisë/mbeti pellgu i Shqipërisë,/do t’ia falnjë Italisë!

dh)

Plevn e shkretë male-male,/mos e shkretë pse s’u fale/Osman pasha i kalove/... treqind mijë rusër vrave.

e)

Njeh ushtartë shqyphtarë t’rri/ç’po shëtisin n’Rumeli/nër shkretin’ a rrin ka dy/ ç’m ‘ka marrë malli, o shtëpi.

ë)

Ç’ka Veziri që m’vret mue/ke m’ka’ çue e kam nigjue./Nrenermore more i kam shkue/e me Grekt unë kam luftue:/dy-tri herë un’ jam plague/me heqima jam mjekue/ e ylfen s’ma ka pague...

f)

Koha po vjen, o rob i xanë/prej asaj të zezës Spanjë/a një fjalë a një të re/për Ag-Omerin s’o ke?

g)

Ti,more Foto Xhavella,/se ç'na bëre me kapella/se ç'u prem' e se ç'u vramë./Sul' e shkretë ku e lamë?/Ali Pashajt ia dhamë,-/nat' e ditë rrim' e qajmë/Fati ndë Korfuz na hodhi,/zumë dorë te Moskovi,/me Moskovë lidh kuvendin/të vem' e të marrim vendin./Vem' e vdesim ndë dhe tënë./Atje tek patëm thënë./Vdesim me yfek në dorë,/si dhendurë me kurorë.

gj)

Krishterimi i Shqipërisë/ shumë i lutet Perëndisë/për mbretinë e Rosisë./ ... Lëfton për krishterim/Për ne që jemi jetim...

h)

...Dy-tri herë un jam plague/me heqima jam mjekue/e ylefen s'm'ke pague.

i)

Unë jam Rexhep-çollaku/ia thoni vetë vezirit/gjersa mos m'ipetë haku/S'dal gjallë prej Misirit./Në Misir thirri çollaku,/Ku jeni ju shqipëtarë?/Gjer në brez na mbuloi gjaku/ylefen s'e lam' pa marrë./S'e di pasha, s'e di veziri/mua më thonë çollaku i ngratë!/ S'e qes komën ka Misiri,/ pa marr' ylefen me shpatë.

f)

Hajde o mike te miku,/prapa shtëpisë te fiku,/leshverdha,si Venedike./ Lumëmadhja ku je/më je mbyll në prede,/synë Venedik ma ke.

k)

Haj nuse të lozimë./ S'kam para të ble shami./ Unë t'ap një Benetik./Haj nuse të lozimë.

l)

Vajta të ndahet kësmei,/po kësmei tim ç'e gjete./ Po mori thellë Frangjinë,/ Trieshtën e Italinë...

ll)

Rri o zonjë me shëndet/lerm'të vete ndë sefer,/muhamudije të të sjell./ Muhamudije s'i dua/rri o bej, këtu me mua./ Rri o zot, këtu të rrimë.../ Dua një sërë florinj,/pa të t'ap ballëtë tim./Mos o moj, oji , moj oji,!/ Mos më dërgo në Vllahi/ Se jam djalë mituri,/... Un të fola me shaka/ të të njoh, a ke sevda?.

m)

Misir, i shkretë Misir,/ti më mban atje tim bir,/ u djegsh, o Arabistan,/ burrën tim atje ma mban./ Vullak' e shkreta Vullakë,/ ti u bëfsh frëngjill e flakë!/ç'faj të kanë bërë gratë/ Që u le jorganët thatë!/Përditë nga një mandatë,/ grat e veja tym e flakë,/e shkretove kaqë shrëpi/të djegshin, të bëfshin hi.../O Stamboll, more i shkretë!/rëntë zjarri e të djegtë!/Po të djegtë anëmbanë,/se na mban burratë tanë/karafil, e manxhuranë.

Të tilla vargje janë të shumtë në këngët popullore shqipe, thotë Kuteli dhe vërtet këto shembuj na dëshmojnë dokumentaritetin e studimit të Kutelit. Këto shembuj të mrekullueshëm edhe me vlerën e tyre si dokument, si monument artistik e si testament i mërgimtarëve tanë që kanë kaluar rininë ose kanë tretur jetën në viset që përmend Kuteli në punimin "Vendet e largimit në këngët popullore shqipe".

Para se të përfundoj për punimin që e pata objekt vrojtimi, dua të përmend edhe diçka për një fytyrë historike, apo personazh kënge që vetë Kuteli e ka renditur nën numrin 9 ose shkronjën g, pra për Foto Xhavellën e kënduar në këngët tona.

Se këngët mund të shërbejnë herë herë edhe si dokument,siç na e pohon sa herë M.Kuteli, na flet edhe një studim tjetër burimor.

Ja ç'thuhet aty:

KUMTESA

“...Në një këngë popullore botuar në Francë thuhet se te... Suli i dëgjuar, Suli i famshëm, shikojmë të luftojnë edhe fëmijët e vegjët, gratë dhe vajzat. Gruaja e Foto Xhavellës lufton me shpatë në dorë, me foshnjën në njërin krah e me armën në tjetrin si dhe përparësen e ka plot me fishekë”.

Le të përfundojmë pra rreth punimit “Vendet e largimit në këngët popullore shqipe” të M.Kutelit:

1. Është studimi i parë shkencor në gjithë folkloristikën tonë që prek dhe analizon me akribi shkencore çështjet e këngës popullore shqiptare në relacionet historike e toponimike si shtrirje gjeografike nëpër kontinente.

Mund të shtohet edhe mendimi i I.Kadaresë, i cili 70 vjet më vonë iu qas kësaj teme. Ja konstatimi i Kadaresë:

“Gjeografia e këngës popullore shqiptare, shtrirja e saj e jashtme, tregojnë, në fund të fundit, përmasat e gjëra të brendshme të popullit tonë. Këto përmasa shpirtërore ia krijoji atij vetë historia. Gjatë luftës për egzistencë me tri nga perandoritë më të fuqishme të kohëravë: romaken, bizantinën, dhe otomanën, populli ynë krijoi, veç të tjerave edhe një “perandori të katërt”, perandorinë e tij poetike, e cila nuk ka cenuar kurrë kërrkënd, përkundrazi ka qenë përherë në tërësinë e saj, një kumt miqësie për popujt e tjerë”.

2. Nga studimet e tjera të tij del se Kuteli nuk është as epigon i qendrave të huaja e të mëdha të kulturës as edhe i mbyllur në izolacion njënacional, por e dëgjon me kujdes porosinë e estetit e studiuesit gjerman i rrymës letrare “Shturm und Drag” në “Zërin e popujve në këngë” të J.G.Herderit bashkë me idenë humanitare të përvetësuar aq rrënjësisht të Kutelit, idenë popuj krah popujsh e jo popuj mbi popuj, që e thekson qëllimisht në testament edhe në Kujtesa shkruar nga vetë Kuteli.

Rezencentë:
Prof. Dr. Enver Mehmeti
Prof. Dr. Mirlinda Krifca-Beqiri

Shpresa DORDA (Doktorante): DREJTIMET KRYESORE TË HUAZIMEVE TË SOTME NË GJUHËN SHQIPE

Objektstudimi i këtij artikulli është gjuha e sotme shqipe përballë futjes së fjalëve të huaja të panevojshme. Ky është një shqetësim jo i ri, por i hershëm sa vetë gjuha dhe sot ka marrë përmasa të mëdha dhe pa arsye të vlefshme. Për këtë temë kam studiuar çfarë është shkruar deri tani, kam vëzhguar dy gazeta të ditëve të sotme dhe të disa viteve të kaluara duke parë sa janë fjalët e huaja të përdorura, nëse janë shtuar apo pakësuar numri i huazimeve të panevojshme. Për këtë jam bazuar në Gazetën “*Shqip*” 25 qershor 2006, Gazetën “*Shqip*” 25 qershor 2011, Gazetën “*Tema*” 18-25 qershor 2000, Gazetën “*Tema*” 23 qershor 2000, si bëhet emërtimi i mjedisëve publikedhe ajo çfarë kam dëgjuar çdo ditë në radio, TV dhe bisedat e përditshme.

Në këtë kumtesë do të trajtoj çështje të tilla:

- Si është gjendja e gjuhës shqipe sot
- Pse janë futur kaq shumë fjalë të huaja
- Cilat janë rrugët e futjes
- Cfarë mund të bëjmë për ta zvogëluar këtë fenomen.

Vitet e fundit vihet re një gjymtim i gjuhës sonë për shkak të dyndjes së madhe të fjalëve të huaja të panevojshme dhe ndërtimet sintaksore e morfologjike që nuk i shkojnë përshtat gjuhës shqipe. Sot mund ta themi me siguri se ajo që flasim apo dëgjojmë nuk është gjuhë shqipe, por një gjuhë e bukur shqipe që ka ekzistuar dikur, e përzier me një lum fjalësh e elementesh të gjuhëve të huaja. Flas me siguri për këtë përzierje, pasi mjaft njerëz shprehin shqetësimin se nuk kuptojnë fjalë që dëgjojnë në radio a TV apo i lexojnë nëpër gazeta a revista.

Sipas një studimi që kam bërë në gazetën “*Shqip*” dhe gazetën “*Tema*” më dalin këto përfundime:

| Emertimi i gazetës | Numri i faqeve | Fjale te huaja | Nr mesatar i fjaleve te huaja per cdo faqe |
|--------------------|----------------|----------------|--|
| Tema 2000 | 20 | 198 | 10 |
| Tema 2011 | 20 | 180 | 9 |
| Shqip 2006 | 48 | 379 | 8 |
| Shqip 2011 | 31 | 296 | 9 |

Pra, lexuesi shqiptar lexon afërsisht 9 fjalë të huaja për çdo faqe gazete. Edhe pse, nuk shikohet ndonjë shtim apo pakësim i mirëfilltë i numrit të huazimeve të panevojshme

nga gazeta e ditëve tona dhe edisa viteve më parë. Ky numër i madh duhet të na shqetësojë. Por shqetësimi është akoma dhe më i madh kur ne jemi të vetëdijshëm se gazetatat janë ndër të vetmet materiale të shkruara që më së shumti lexohen. Kështu që duke u lexuar vazhdimisht ato bëhen padashur në mënyrë të pavetëdijshme pjesë e leksikut. Kjo ndodh pasi lexuesi rrallë i shikon me sy kritik huazimet, por i merr si të mirëqëna dhe si risi që duhen përvetësuar.

Fjalët e huaja të panevojshme kanë hyrë përveç mjeteve të informimit masiv siç janë gazetatat, radiot, televizionet edhe në emërtimet e mjediseve publike. Për këtë mjafton t'u hedhim një sy rrugëve të Tiranës ku vetëm në njërin anë të rrugës "Abdyl Frashëri" nga 54 mjedise, 36 janë të emërtuara në gjuhë të huaj, 12 të emërtuar në gjuhë të huaj e në gjuhën shqipe dhe vetëm 6 janë të emërtuara në gjuhën shqipe.

Masa e gjerë e shqipfolësve mendoj se nuk e di ku është problemi, thjesht ai apo ajo kur dëgjon një emision në radio, shikon një debat në television, lexon gazetën dhe një pjesë të mirë të fjalëve nuk i kupton, atëherë mendon se nuk ka aq nivel kulturor sa për të kuptuar se për çfarë flitet apo gjuha është zhvilluar aq shumë dhe ai/ajo ka mbetur mbrapa në kohë.

Atëherë lindin pyetjet: Pse duhet të ndjehemi të pasigurtë në atë që kuptojmë nga të lexuarit apo dëgjuarit në gjuhën shqipe? Duke qenë shqiptarë, duke jetuar në vendin tonë, pse duhet të mësojmë disa gjuhë të huaja për të arritur një komunikim të saktë me bashkëkombasit tanë?

Sot jetojmë në një botë të lirë ku secili ka të drejtë të thotë atë që mendon, por askush nuk ka të drejtë të shpërftyrojë gjuhën që është pasuri e të gjithëve, vetëm se ka zënë një pozicion publik ku fjalën e tij apo të saj janë të detyruar ta dëgjojnë një masë e madhe njerëzish dhe i përdor ato (fjalët e huaja), ndoshta duke hamendësuar se është i kohës a modern.

Gjendja e gjuhës shqipe është shqetësuese sot me këtë shumësi fjalësh të huaja të futura pa kriter përgjithësisht nga njerëzit e medias, politikanët, përkthyesit e papërgjegjshëm apo të pa kualifikuar mirë etj. Sa mund të themi me siguri se shumë njerëz janë familjarizuar aq shumë me to sa nuk arrijtë të kuptojnë se cila është fjalë e huaj dhe cila shqipe, e ku sipas vëzhgimeve të mia bëjnë pjesë një përqindje e madhe e njerëzve.

Duke menduar se si mund të jetë gjuha jonë në të ardhmen, nëse futja e fjalëve të huaja të panevojshme do të vazhdojë me këtë ritëm dhe nuk do të punohet fort për ta mbrojtur atë, mund të presim më të keqen, humbjen e saj.

Është e vertetë që gjuha shqipe ka nevojë të përdorë çdo ditë e më shumë fjalë të reja, por këto fjalë nuk duhen marrë vend e pa vend si të na pëlqejë, por duhen parë me vëmendje nëse kjo fjalë që po përdorim e pasuron gjuhën tonë apo e dëmton atë. Akoma më shumë sot ku të gjithë shoqërinë e ka përfshirë globalizmi duhet të punojmë për ta ruajtur dhe pasuruar gjuhën tonë, që të mos humbasë. Pra, ne duhet të marrim fjalë të huaja që plotësojnë vendet bosh në gjuhën shqipe, por gjithmonë duke i përshtatur me strukturën e gjuhës dhe nuk duhet të pranojmë fjalë të huaja për të cilët ka zgjedhje në shqip.

Hyrja në gjuhën shqipe e fjalëve të huaja të panevojshme tashmë është një fakt i pakundërshtueshëm, por përveç se të parashtrij problemin po jap disa mënyra zgjidhjeje: Të gjithë e kemi cilësuar median si pushteti i katërt pasi ka një fuqi të madhe ndikuese. Këtë gjë e kemi të vërtetuar, meqënëse një nga rrugët e hyrjes apo përhapjes në masë të gjërë të huazimeve është media. Duke qenë një fuqi kaq e madhe ndikuese, mund ta përdorim si një mënyrë për të dhënë informacion se si duhet ta flasim e shkruajmë gjuhën tonë saktë, qartë, pastër dhe bukur. Kjo mund të realizohet duke transmetuar një emision televiziv apo

radiofonik për çështje të përditshme të gjuhës dhe thelbësore, për ta ruajtur atë sa më mirë dhe për ta përshtatur me kërkesat e kohës në mënyrë të drejtë pa e deformuar.

Po ashtu nëpër gazeta mund t'i kushtohet një artikull i veçantë një herë në javë, ku gjuhëtarët të shkruajnë se si është mënyra më e mirë për ta përdorur gjuhën shqipe, te japin disa rregulla drejtshkrimore dhe të tregojnë cilat fjalë që ne po dëgjojmë e flasim sot janë të huaja dhe si mund t'i zëvendësojmë ato. Mund të bëhet një punë e tillë si një fjalorth me fjalë të huazuara të panevojshme dhe gjegjësen e tyre në gjuhën shqipe, siç bëhet tek revista "Gjuha jonë". Por mendoj se ndikimi që ka ky fjalorth tek lexuesit do të jetë më i madh në një gazetë të përditshme se sa tek revista "Gjuha jonë", pasi gazetatat e përditshme kanë një numër më të madh lexuesish. Ky lloj fjalorthi mund t'u shërbejë dhe vetë gazetarëve apo redaktorëve për të shkruar në mënyrë të saktë e të kuptueshme për shqipfolësit e të gjitha niveleve arsimore duke ngulitur normën gjuhësore tek një masë e gjerë që lexojnë shkrimet e tyre.

Gjithashtu mund të bëhen trajnime të shpeshta të mësuesve të cilët japin mësim gjuhën shqipe në arsimin parauniversitar, pasi ata janë të parët dhe më kryesorët që japin njohuritë e sakta të gjuhës shqipe dhe të ngulitjes sa më mirë të saj. Por edhe mësuesit e profiëve të tjera pasi edhe ata janë në kontakt të vazhdueshëm me nxënësit.

Një vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet përkthyesve dhe librat që ata përkthejnë. Përkthyesi nuk duhet të dijë shumë mirë vetëm gjuhën e huaj, gjuhën në të cilën është shkruar libri që do përkthejë, por duhet të ketë dhe njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe, të pasurisë së leksikut, të ndërtimeve morfologjike e sintaksore, të frazeologjisë dhe njohuri të mira të rregullave drejtshkrimore dhe jo të shruajë atë që përkthen si t'i vijë për mbarë.

Subjekteve të ndryshme private para se t'u jepet liçenca për të filluar një aktivitet, duhet t'u kërkohet rreptësisht që gjuha e cila do përdoret të jetë gjuha shqipe dhe emërtimi i aktivitetit të jetë shkruar në gjuhën shqipe.

E rëndësishme dhe e domosdoshme është ngritja e institucioneve shtetërore për të mbrojtur gjuhën dhe marrjen e masave ndëshkuese ndaj atyre personave që nuk e përdorin drejt atë sipas rregullave.

Secili nga ne e ka për detyrë ta përvetësojë e ta përdorë drejt gjuhën standarde dhe të japë kontributin e tij modest për ta mbrojtur dhe zhvilluar më tej atë. Mbi të gjithë këtë përgjegjësi duhet ta ndiejnë punonjësit e medias dhe personat që kanë zë publik. Mendoj se një njeri mund ta quajë veten i plotësuar intelektualisht duke njohur, folur dhe shkruar bukur gjuhën e tij.

Gjithashtu të gjithë duhet të shfrytëzojmë burimet e pashtershme të fjalëve që gjenden në gjuhën popullore dhe të hedhim një gur në kështjellën e lashtë e të bukur të gjuhës shqipe, duke e pasuruar dhe pastruar, për ta bërë sa më të kohës, funksionale e t'i përgjigjet kërkesave të sotme.

Pra, e rëndësishme është që të punojmë së bashku për të njëjtin qëllim, të ruajmë gjuhën shqipe standarde nga fjalët e huaja të panevojshme dhe ndërtimet sintaksore e morfologjike që nuk i shkojnë përshtat gjuhës sonë dhe kur përdoren ndjehen vërtet të huaja

KUMTESA

Prof. Ukë OSMANAJ: PESHA DHE RËNDËSIA E GJUHËS NË INSTITUCIONE

Hyrje

Dhjetëvjetëshi i fundit që përkon me çlirimin e Kosovës solli me vete ndryshime të mëdha në të gjitha fushat e jetës . Këto ndryshime jo vetëm për Kosovën por për të gjitha trojet shqiptare nuk u përcollën dot pa vështirësi dhe sfida ndër më të ndryshmet. Përpjekjet, vuajtjet, heroizmi dhe guximi rezultuan me çlirimin e vendit – ardhjen e lirisë të shumë pritur. Dekada e fundit e shek. XX dhe fillimi i shekullit XXI do të mbetën të shkruara me shkronja të arta në historinë tonë më të re – për shtetin e Kosovës” Nuk është për t’u vajtuar vdekja derisa fitohet pavdekshmëria”. citoj të ketë thënë një dijetar. Pavdeksinë, sinonim të lirisë, tanimë Kosova e ka. Nuk ka dyshim kjo është epoka më e ndritëshme e shtetit më të ri të Evropës. Kosova tani është shtet sovran, demokratik dhe i pavarur.

Do ishte iluzion të mendonim se liria i solli të gjitha. Liria është parakusht jetik për arritje dhe ndryshime të mëdha në sferat e jetës së një kombi .Pikërisht për këtë shteti duhet të jetë i përgjegjshëm dhe në lartësinë e duhur të funksionimit tij. Në të kundërtën mosfunksionimi mirëfilltë i një vendit i përcjellur me veprime devijante ;si korrupsion, pabarazi ligjore, zhvillim të ulët ekonomik, arsimim jo cilësor, diskriminim të të drejtave të njeriut, pa barazi gjinore për pasojë do ketë që : shpresat, synimet,optimizmi dhe të gjitha ato që lidhen me shtetin të mos jenë në hap me kohën, të shndërroheshin në zhgenjim dhe pesimizëm. Këtë porosi ua përcollën politikanëve tanë miqtë tanë ndërkombëtar që ndihmuan në ardhjen e lirisë dh pavarësisë së Kosovës duke iu sugjeruar se “liria (nënkupto: shteti është po aq i vështirë të bëhet sikurse edhe fitorja e luftës. Këtë e dëshmuan katërcipisht edhe ngjarjet e viteve të fundit në të dyja shtetet shqiptare. Në Shqipëri, pa mohuar arritjet e shkëlqyera që janë bërë dy dekadat e fundit që cilësohen si shembje e një sisremi komunist totalitar dhe shtypës dhe arritja e demokracisë. Megjithë progresin e pa kontestueshëm që ka bërë Shqipëria ajo ende përballet me shumë vështirësi dhe sfida që bëhen pengesë serioze për integrimin e saj në BE. Ndërsa për Kosovën këto probleme bëhen edhe më të ndjeshme dhe më vështirë të realizuara për këto arsye:

E para – Kosova historikisht e pushtuar nuk pati eksperiencën e duhur që në nismë të shtetësisë të merrej me sforcimin e shtetit ligjor dhe demokracisë, përkundër angazhimeve të pareshtura.

E dyta – Në një periudhë të caktuar, madje edhe sot, në vendim-marrje të rëndësishme shteti ynë është në vartësi dhe i “kushtëzuar” nga faktori ndërkombëtar. Kosova nuk e ka sovranitetin në gjithë territorin e saj (kujtojmë pjesën veriore të Mitrovicës). Papunësia, pa perspektiva për të rinjt, zhvillimi i ultë ekonomik, arsimimi jo cilësor, korrupsioni e dukuri të

tjera devijante janë tregues se në cilat pista shteti duhet të ecë për të qenë pjesë e familjes evropiane.

Roli i institucioneve në hapjen e perspectives

Në kontekstin e përrhyerjeve historike të ndodhura në fillimin e mileniumit të tretë, roli i shtetit për funksionimin e tij duke i plotësuar standardet evropiane të shkruara në Kushtetutën e BE nuk ka alternativë tjetër. Shtrohet pyetja ku është aktualisht roli i shtetit – institucioneve në përmbushjen e këtyre parametrave. Me zhvillimin ekonomik, të drejtat e njeriut ,prodhimin bujqësor dhe ruajtjen e mjedisit iu takon të mirren ekspertët e fushave përkatëse. Ndërsa ky artikull në fokusi do ketë ate: sesa është i përgjegjshëm shteti dhe institucionet përkatëse për ruajtjen, kultivimin dhe pasurimin e gjuhës dhe kulturës si pjesë më vitale për një komb dhe popull. Fokusimi im (besoj jo vetëm imi) në këtë temë nuk është i rastësishëm por është tejet aktual për kohën në të cilën jetojmë.Fatkeqësisht gjuha shqipe e përdorur sot po mbytet çdo ditë e më shumë me fjalë të huaja të panevojshme që po ia prishin bukurinë. Ndikimi i gjuhëve të huja ka prekur leksikun, terminologjinë, semantikën, morfo-sintaksën duke e rrezikuar në thelbin e saj gjuhën standard shqipe si pasuria më e madhe e kombit tonë.Ruajtja me çdo çmim e gjuhës, kulturës dhe traditës së kombit duhet të jetë në vazhdimësi në vëmendjen dhe prioritet mbi të gjithë prioritetet për shtetin. Ky detyrim shtetëror nuk është aktual vetëm sot, përkundrazi gjuha jonë në vazhdimësi ka pësuar tronditje dhe e rrezikuar nga mospërfillës dhe armiq të ndryshëm ,megjithatë ajo mbijetoi me stoicizëm dhe asnjëherë nuk u përul duke ruajtur të qenurit e saj si gjuha më e vjetër indoevropiane. Në vazhden e globalizmit, këtij fenomeni të botës bashkëkohore, ku gjuha, kultura dhe tradita e një kombi të vogël mund të rrezikohen deri në maksimum, shteti duhet të jetë në lartësitë e përgjegjësive në ruajtjen dhe mbrojtjen e këtyre vlerave kombëtare.Kjo mund të arrihet qoftë edhe me masa ligjore në qoftë se dikush shpërfill me këtë element kombëtar. Sepse siç pati thënë rilindësi ynë Filip Shiroka: ***“Kurrë nuk kemi të drejtë të quhemi komb i qytetëruar, sado që të mësojmë gjuhë të huaja, sepse kombi nuk qytetërohet vetëm me mësimin e gjuhëve të huaja, por me mësimin e gjuhës së vet”*** Ky mendim mbetet tepër aktual edhe në ditët e sotme. Në emër të globalizmit gjuha jonë është mbërthyer nga një vërshim i përdorimit të fjalëve të huaja, huazimeve pa asnjë kriter, përktihimeve nga jo profesionistët dhe injorim të gjuhës së pasur shqipe.Në qoftë se nuk e parandalojmë këtë fenomen të përçudnuar, në perspektivë rrezikojmë jo vetëm gjuhën dhe kulturën por edhe identitetin tonë kombëtar.Kjo çfarë u tha më lart nuk do duhej të na përjashtonte si komb në mospranimin e globalizmit si fenomen, por ai përqaftim duhet të merret deri në kufirin e moscenimit të gjuhës,kulturës dhe integritetit tonë kombëtar. Shikuar në aspektin gjuhësor kemi edhe shenjat e para të këtij kërcënimi. Gjuha shqipe në folësin e saj sot përdor aqë fjalë të huaja sa që po të vazhdohet me këtë trend dhe ritem mund të ndodh që një ditë të varfërohet aqë shumë sa që brezi ynë do përdor një gjuhë bastarde që asnjëri me arsye dhe ndjenjë kombëtare nuk do ta dëshironte. Fjalë të huaja të futura në leksikun e shqipes pa asnjë kriter po thuhet janë bërë standard dhe janë aq më bollek sa që për një shqipfolës të devotshëm (të devotshëm duhet të jemi të gjithë) krijojnë një neveri dhe ankth të papërshtueshëm. Shtrohet pyetja është apo s’është e arsyeshme të ndodhë kjo ? Përgjigja është shumë e thjeshtë: jo,jo dhe jo. Fatmirësisht gjuha shqipe është aqë e pasur nga ama e vet sa që nuk ka nevojë të mbjellim fjalë dhe shprehje të huaja në të. Mjafton vetëm t’i ruajmë ato, t’i fusim në veprim dhe t’i kthejmë në pëdorim fjalë të gurrës së

popullit të cilat për teke të dikujt janë hequr nga e folmja e shqipes duke u zëvendësuar pamëshirshëm me fjalë të huaja.

Për madhësinë e gjuhës shqipe gjuhëtari Holger Petersen thotë:

“Gjuha Shqipe është i vetmi mjet i ndriçimit dhe i përparimit moral. Ajo është një gjuhë e fuqishme dhe e bukur që duhet të jetë krenaria e folësve të saj dhe një mjet i shenjtë për zhvillimin kulturor dhe intelektual të kombit të vjetër shqiptar.” Se është kështu nuk ka asnjë dyshim por sa e respektojmë këtë kjo është e diskutueshme dhe meriton një analizë më të hollësishme.

Përdorimi i gjuhës në Institucionet tona

Personalisht mendoj se në aspektin e përdorimit të gjuhës secili individ është institucion në vete. Përdorimi me kompetencë i gjuhës është përgjegjësi e vetë individit dhe jo i gjithë institucionit. Ky është detyrim kombëtar dhe profesional i gjithësecilit. Shmangia nga ky detyrim dhe përgjegjësi zbeh dhe ul prestigjin e intelektualit dhe përdoruesit të fjalës shqipe. Jo rastësisht e them këtë sepse është bërë “modë” të thuhet nga goja e vetë intelektualëve të fushave të shkencave natyrore dhe fushave tjera jo gjuhësore dhe humanitare se: “Unë nuk qëndroj mirë me drejtshkrimin dhe përdorimin drejt të gjuhës meqenëse jam i kësaj apo asaj fushe jo gjuhësore. Ky është një absurd i llojit të vet. E them këtë me plotë përgjegjësi sepse në qoftë se shkohet sipas kësaj llogjike rezulton se shqip drejt duhet të shkruajnë vetëm ata që studiojnë gjuhët. Hipotetikisht kjo do thoshte se drejt dhe pa gabime të flisnin më pak se 40% e një populli. Një gjë e këtillë nuk guxon të ndodhë në vendet më të fuqishme e botës si: SHBA, Gjermani, Francë, Angli, Itali, Spanjë etj. *“Gjuha është një institucion mbi të gjitha institucionet”* citojmë të ketë thënë gjuhëtari e filosofi Heidegger. Dhe nuk ka dyshim sepse puna dhe fushëveprimi i secilit institucion fillon nga të shkruarit dhe të folurit. Të gjitha veprimtaritë e institucioneve të pasqyruara në të gjitha format e tyre bëhen përmes akteve me shkrim apo në formë gojore, përmes debateve, takimeve qoftë brenda apo jashtë institucionit, konferencave të ndryshme, kongreseve etj. Të gjitha këto formulime me qëllim informacioni dhe pasqyrimi të fushëveprimtarisë së institucionit përkatës detyrimisht duhet të artikulohej me gjuhë të rrjedhëshme, drejtshkrim, me formulime të sakta, pa ngarkesa me fjalë jo të njëjtë kuptim si: suportoj dhe mbështes, kualitet dhe cilësi, avantazh dhe epërsi, influence dhe ndikim etj. të cilat janë marrë nga gjuhë të huaja

Përkthimi nga gjuhët e huaja është pjesë përbërëse e secilit institucion. Përkthimet bëhen kryesisht nga gjuha angleze por edhe nga gjuhë tjera të huaja. Ky është fakt i pakontestueshëm por i cili kërkon njohës të mirë të gjuhëve të huaja dhe kjo nuk bën asesi të mohohet. Por në mungesë të njohjes solide të gjuhës shqipe na dalin shpesh përkthime të nivelit jo të kënaqshëm, madje shpesh ndodh që në saje të përkthimeve të dobëta të ndeshim në paqartësi dhe gabime të theksuara. *Përkthyes i mirë është vetëm ai i cili zotëron shkëlqyeshëm gjuhën e vet.* Është për t'u përsëritur nisma e katedrave të gjuhëve të huaja në UP ku në studimet master e kanë bërë profilizimin enkas për studimin e përkthimit. Aftësimi i përkthyesve nga gjuhët e huaja ishte nevojë e domosdoshme.

Cila është gjuha në institucionet tona?

Mediet

Kosova duhet të mburret sot për numrin e madh të medieeve. Ajo ka një televizion publik, RTK-ën dhe radio publike, RK ,si dhe katër TV private të nivelit shtetëror dhe shumë kanale televizive dhe radio lokale. Kemi një numër të konsiderueshëm të gazetave të përditshme të cilat shkruajnë dhe informojnë për më të rejtat në globin tokësor. Shikuar në aspektin sasior kjo është një arritje e jashtëzakonshme kur kemi parasysh se para luftës kemi pasur vetëm dy sosh RTP dhe RP si dhe vetëm një gazetë të përditshme. Megjithatë në aspektin cilësor niveli i tyre lë për të dëshiruar, pa mohuar faktin se në të gjitha këto kanale TV kemi gazetarë dhe profesionistë të shkëlqyeshëm. E njëjta gjë vlen të thuhet edhe për gazetatat e përditshme. Ajo që duhet theksuar më këtë rast është se mediet, të shkruarat dhe elektronike luajnë rol të pazëvendësueshëm në aspektin gjuhësor meqë janë në kontakt të përditshëm dhe me të gjitha shtresat e popullit.

Institucionet e ndryshme

Nuk duhet humbur shumë kohë për të pasur një pasqyrë të qartë se cili është përdorimi i gjuhës në institucionet tona. Mjafton t'u hedhësh një shikim shkresave të ndryshme të afishuara në vendet e shpalljeve, mureve, agjencioneve turistike të udhëtimit, guidave të ndryshme turistike, reklamave nëpër qytet , njoftimeve, lajmërimeve, për të parë me sa gabime janë të përshtuara ato. Autori i këtij shkrimi mbi katedrën e një drejtori të një shkolle të mesme kishte hasur që shtatë ditët e javës në orarin e kujdestarisë së mësimdhënësve vetëm dy sosh ishin të shkruara drejt. Për keqardhje por i vërtetë është fakti se një numër i madh i njerëzve nuk i shkruajnë drejt dhe pa gabime ditët e javës. Në shumicën e rasteve këto i gjejmë nëpër shkollat tona, aty ku fitohet baza e drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit. Gjendja nuk është aspak më e mirë edhe në institucionet tjera të larta. Sa për ilustrim do marr disa shembuj sesi shkruhet në disa institucone tona. Një zyrtar i një Ministrie në një Njoftim për kolegët e tij shkruan..."Koleg te nderuar iu njoftoi se me datete gjith...etj Shkronjat në kursiv janë të shkruara gabimisht. Në dhjetë fjalë kemi gjashtë gabime, pot të vazhdonte shkrimi më gjat do llogaritnim çdo të tretën fjalë me gabim. Ose një shkrim tjetër ..."Hartimi i Strategjis" ... "për nderë të 100 vjetorit të Pavarësis së Shqipëris"..."ASH shprehi gatishmërin"..."të pakënaqur me ecurin"..."për të marr masat..."vizituam edhe Ministrin e Arsimit" (është fjala për Ministrinë dhe jo Ministrin) ..."z/Beni na njoftoj" ..."Ministria e Ekonomis"

Në të folurit e përditshëm shumësi i foljeve kam dhe jam në të tashmen e dëftores po thuajse është bërë standard përdorimi gabim kena dhe jena, madje edhe nga vetë profesorët e të gjitha niveleve të arsimit. Kam ndesh jo rrallë kur mësimdhënës të arsimit parauniversitar t'i shkruajnë emrat e lëndëve : fizik, matematik ose në vend të përvojë e punës (provojë e punës) etj. Procesverbalet e mbledhjeve në Librat e klasës , nëpër shkolla , raportet e ndryshme, njoftimet, dhe rubrka të ndryshme në institucionet e AMU dhe AML janë nën çdo nivel jo vetëm për për gabimet drejtshkrimor por edhe në sajimet morfo- sintaksor me plot defekte.

Arsimi i lartë

Është për keqardhje por pjesa dërmuese e studentëve tanë kanë zbrastësira të dukshme për t'u shprehur me shkrim por edhe me gojë si rezultat i nivelit jo të kënaqshëm nga shkolla fillore dhe e mesme. E them me përgjegjësi të plotë se në një ese të një student të UP por edhe të Kolegjeve private 70% është e hartuar me gabime jo vetëm gjuhësore. Çdo koment këtyre shembujve do ishte i tepërt.²⁶¹

²⁶¹ Kjo kumtesë është refleksion individual imi, ashtu siç i shoh aktualisht rrjedhat jo të favorshme

Përfundim

Institucionet janë përgjegjëse në përdorimin drejt dhe me korrektesë të gjuhës së shtetit – gjuhën shqipe. Shpërfillja dhe keqpërdorimi duhet të sanksionohet me Ligj. Sot jetojmë në një botë të lirë ku secili ka të drejt të thotë atë që mendon, por askush nuk ka të drejt të shpërftyrojë gjuhën që është pasuri e të gjithëve vetëm se ka zënë një pozicion publik ku fjalën e tij apo të saj janë të detyruar ta dëgjojnë një masë e madhe njerëzish dhe ndoshta për arsye vetjake, për t'u mos u kuptuar qartë, kur i jep përgjigje ndonjë pyetje të pakëndshme për të apo për t'u treguar i kohës a modern përdor një numër të madh fjalësh të huaja.

Institucionet e Kosovës të prirë nga Instituti Albanologjik –dega e studimeve gjuhësore Departamenti i gjuhës dhe Letërsisë në UP dhe simotrat e tyre në Shqipëri dhe Maqedoni dhe trojet tjera shqiptare sa më parë duhet të bashkërendojnë përpjekjet angazhimin e gjithë potencialit shkencor profesional në këtë fushë në ruajtjen ,fuqizimin në aspektin evoluimit, të pasurimit të gjuhës shqipe si vlerë kombëtare.

Recenzentë: Prof.dr.Abdullah Zymeri
Prof.dr. Hasan Muja

në ruajtjen dhe kultivimin e gjuhës sonë të bukur shqipe, megjithkëtë i bindur në përkushtimin e shtetit dhe institucioneve përgjegjëse në marrjen e masave në prandlimin dhe fuqizimin e këtyre vlerave kombëtare.

KUMTESA

Naim BERISHA¹: KOMPJUTERI (INTERNETI), PËRPARËSITË DHE PASOJAT PËR SHQIPEN

¹Instituti Albanologjik i Prishtinës

Fillimi i shekullit të ri në Kosovë solli ndryshime të mëdha, ndryshime të cilat u manifestuan në shumë fusha të jetës por edhe në gjuhë. Këto ndryshime, pos të tjerash, janë pasojë e ndryshimeve që kanë përfshirë edhe popuj të tjerë të Evropës dhe të Botës; zhvillimi i hovshëm i teknologjisë informative, rritja e nevojës për marrëdhënie tregtare e ekonomike, nevoja e bashkëpunimit ndërkombëtar në shumë fusha , e shumë faktorë të tjerë. Në këtë kontekst të ri të krijuar duhet pasur parasysh ndikimin e anglishtes si gjuhë globale, ndikim ky që shfaqet pothuajse në të gjitha gjuhët e botës.

Një faktor me peshë të madhe në zgjerimin e këtij ndikimi e kanë luajtur dhe po luajnë kompjuteri dhe interneti. Edhe pse në Kosovë përdorimi i interneti nuk ka kohë të gjatë në përdorim, përhapja dhe ndikimi i tij rrodhi shumë shpejt, sa që u kthye në domosdoshmëri pa u kuptuar mirë nga ne.

Sipas rezultateve të projektit *Web Characterization* të OCLC-së 4 të realizuar në vitin 2002, deri 72% e përmbajtjeve tekstore në sajte janë në gjuhën angleze, 7% në gjuhën gjermane, 6% në gjuhën japoneze, 3% në spanjishte e 3% në frëngjishte dhe 9% në të gjitha gjuhët e tjera të globit¹. Kur i kemi parasysh këto shifra, tash pas 10 vjetësh, me plot gojë mund të themi se anglishtja është gjuha e internetit.

Përdorimi i internetit është një mundësi e mirë komunikimi, shërben si burim i rëndësishëm i informacionit, ta krijon mundësinë e qasjes në shumë të dhëna në mbarë botën, të jep mundësi të krijosh lidhje me njerëz të vendeve të ndryshme etj. Me gjithë përparësitë që na krijon përdorimi i internetit, ndikimi i tij në gjuhë është i madh dhe po shtohet dita ditës. Në këtë kontekst, mund të thuhet se është krijuar një “komunitet” i veçantë i përdoruesve të internetit, të cilët me ose pa vetëdije kanë krijuar një “zhargon” të vetin, që funksionon jashtë normës së shqipes.

Problemet që shfaqen me “shqipen e internetit” kanë qenë temë diskutimi e studime edhe te studiues të tjerë të shqipes.

Anila Çepani shprehet kështu, **citoj**: Kjo pakujdesi mendoj se vjen nga dy arsye kryesore: e para, sepse përdoruesit e shqipes në internet jo vetëm që janë të shumtë, por u përkasin kategorive dhe shtresave të ndryshme shoqërore, ndërsa pjesa më e madhe e tyre nuk kanë kulturë të nevojshme gjuhësore; e dyta është mungesa e kohës së nevojshme për të shkruar saktë, sepse përgjigjja duhet të jetë më e shpejtë¹.

Përderisa teknologjia ka përparuar mjaft dhe mundësitë e komunikimit janë më të shumta dhe shumë më të shpejta, në komunikimin e përditshëm vërehet një prirje e çuditshme e të nxituarit, pse gjithë ky ngut në komunikim? Kësaj pyetje duhet t'ia shtojmë edhe dy pyetje tjera : a mos vallë kemi më pak kohë tash?, apo jemi bërë më përtacë?

Këtyre pyetjeve ua shtojmë edhe disa pyetje të cilat i ngre **Gladiola Bendaj, citoj:** Nëse gjithë kjo fugë është një trend bashkëkohor i paevitueshëm, mos vallë rilindasit ishin “demodé” dhe “mirupafshim”, “tungjatjeta”, “faleminderit” e “dakord” janë fjalë shumë të gjata e të shkuara kohe?!¹

Përdorimi i gjuhës në mënyrë të shkujdesur është bërë njëfarë mode në vete dhe mund ta gjejmë nëpër forume të ndryshme të internetit. Kur themi përdorimi i shkujdesur i gjuhës, vetvetiu nënkuptohet se gabimet do të jenë të shumta dhe të natyrave të ndryshme. Ndër gabimet që bëhet më së shpeshti dhe në shumicën e rasteve me vetëdije është **zëvendësimi i ë-së me “e”, apo heqje e sajë nga përdorimi.** Shembujt e zëvendësimit të ë-së dhe zhdukjes së saj janë të shumtë si:

Definitivisht une mendoj se pergjegjes jan vet botuesit shqipetar qe ne shumicen e botimeve te tyre shkruajn fjale qe nuk kan te bejn me gjuhen shqipe.

Fjalja është marrë në origjinal në një nga forumet shqiptare në internet, ku temë diskutimi ishte “**A po deformohet gjuha shqipe**”, shihet qartë se diskutuesit aty flasin për problemin e deformimit të shqipes, e vetë i kontribuojnë këtij deformimi.

Edhe për përdorimin e shkronjës **ç** ka një prirje të përdorimit më të lehtë se **alt - 135**, në vend të sajë shkruhet **c**, e në disa raste edhe **cc**. Shembuj për këtë ka shumë, si **diccka, ose diccka, cfare** etj. Kur jemi te përdorimi i shkronjës “**ç**” duhet përmendur se në shumë raste kjo zëvendësohet me “**q**” qiellzore. Zëvendësimi i saj me qiellzoren “**q**”, mendoj se është më i dëmshëm se zëvendësimi i saj i mundshëm me një “**e**” apo “**cc**” si pasojë e shpejtësisë apo pakujdesisë. Kjo tregon se ata “shqipshkrues të internetit”, të cilët e bëjnë një zëvendësim të tillë nuk e kanë idenë se ku qëndron dallimi.

Mospërdorimi i apostrofit përbën një problem më vete. Të paktë janë “shqipshkruesit e internetit” që e përdorin apostrofin në shërbimet e tyre. Shembuj të mospërdorimit të apostrofit ka shumë si në rastet:

ska rendesi, skam koh, Çpun po ban etj. Mospërdorimi i apostrofit shkakton ngatërresa në kuptim të trajtat e shkurtra të përemrave, punonjësit e administratës në shumicën e rasteve këto trajta i shkruajnë pa apostrof.

Vende të ndryshme të botës, shumicën e këtyre problemeve (të cilat po i quaj “teknike”), i kanë zgjidhur me krijimin dhe prodhimin e tasteve përkatëse, ku janë të përfshira të gjitha shkronjat dhe simbolet e alfabetëve të tyre. Kjo duhet të zgjidhet edhe me shqipen në të ardhmen.

Problem më vete në komunikimin në internet është edhe përdorimi i disa fjalëve të huaja. Në kontekste të ndryshme të fjalive, ato dalin si mundësi më e lehtë e shkrimit pasi janë më të shkurtra, dhe shkrimi bëhet më shpejt. Kjo ndodh sidomos nëpër chat-e të ndryshme. Më të shpeshtat janë : **ok, no, crazy, go, donload, je king, be njeri** etj.

Jo në të gjitha rastet përdorimi i fjalëve të huaja është nevojë e përdorimit më të shpejtë. Ka raste kur të rinjtë të ndikuar nga përdorimi i tyre nëpër mediet lokale, ato i marrin apo i kopjojnë si një “**modë e të shprehurit**”, pa e ditur në të vërtetë se çfarë kuptimi kanë.

Të ndikuar nga përdorimi i internetit, të rinjtë kanë krijuar një “**gjuhë të internetit**”, e cila na del me veçanti të shumta. Gjuha e përdorur në internet po perceptohet gjithnjë e më tepër si një hibrid midis gjuhës së folur dhe asaj të shkruar¹. Ajo është shumë praktike për të bërë dialog në internet, sepse përdoren vetëm dy ose disa shkronja, shpeshherë të kombinuara me numra, për të shprehur një mendim me përmbajtje të pasur dhe për t'u marrë vesh mirë me njëri-tjetrin¹.

Sot, kur e jetojmë të ashtuquajturën epokë të rrjeteve sociale, si: **Facebook, Twitter, Myspace, Mesenger etj**, është formuar një pritje interesante e shkrimit me sa më shumë shkurtesa të ndryshme, të përziera me numra e simbole për shprehjen e emocionit.

Shembujt janë të shumtë, p.sh: **flm** (faleminderit), **sps** (s'ka përse), **çka ka 3** (çfarë ka të re), **Iherë** (njëherë), **mpuq** (më puth), **vër8** (vërtetë), **3gim** (tregim), **2shim** (dyshim), **7zënë** (shtatzënë) e shumë e shumë shembuj të tjerë.

Duke qenë të ndikuar fort dhe në vazhdimësi nga anglishtja, të rinjtë e kanë zgjedhur një metodë imitimi në komunikim, në disa raste i kanë krijuar shkurtesat në shqip, si ato që i përmendëm, e në disa raste të tjera i përdorin të gatshme nga anglishtja për të treguar zotësi dhe njohuri të anglishtes si “**modë e kohës**”.

Këto shkurtesa përdoren si formula të përziera, si p.sh: **B4 për (before) --- më përpara, 2DA për (today) – sot, L8R për (later) – më vonë, K2 (këtu)**.

Në krijimin e shumë shkurtesave ka ndikuar edhe përdorimi i celularit. Duke mos mjaftuar numri i shkronjave në dispozicion për përdoruesit e celularit, u krijuan një numër i madh i shkurtesave, si: **prsh** (pershendetje), **flm** (faleminderit) **sps, mpuq** etj.

Për dallim nga “**shqipja e internetit**”, “**shqipja e administratës**”, këto vitet e fundit është ndihmuar nga programet kompjuterike në gjuhën shqipe. Programet e sotme kompjuterike të gjuhës shqipe janë një ndihmë shumë e madhe për përdoruesit e kompjuterit, duke u mundësuar atyre njohuri dhe përforsim të standardit të shqipes. Programet kompjuterike të punuara nga “**Qendra për Edukim dhe Përparim**”, si: **Fjalori elektronik shpjegues, AS tastiera shqip, Drejtshkrimori, Office 2010 shqip, Windows 7 shqip** etj, i kanë krijuar mundësitë që gabimet dhe deformimet gjuhësore të pakësohen dukshëm.

Megjithëse këto programe kanë disa mangësi në përdorim, duke i pasur parasysh rrethanat në të cilat po zhvillohet jeta, ato janë njëra prej arritjeve më të rëndësishme në jetën shkencore dhe arsimore shqiptare. Përfituesit e drejtpërdrejt nga këto programe janë punonjësit e administratës në radhë të parë, por edhe njerëzit e profileve të ndryshme akademike.

Me gjithë përparësitë dhe ndihmën që na ofrojnë këto programe kompjuterike, duke pasur parasysh mangësitë që kanë, përdorimi i tyre nga njerëzit që nuk e njohin sadopak standardin mund të ndikojnë në formimin e një “varshmërie ndaj kompjuterit”. Me këtë rrezikohet që standardi dhe normat gjuhësore në përgjithësi të mbesin si diçka “abstrakte”.

Gjuha e internetit ka disa karakteristika interesante që duhet të studiohen, karakteri i saj spontan dhe përdorimi i shkujdesur kanë krijuar edhe një material ndryshe nga ai i gjuhës standarde, material i cili mund të reflektohet me pasoja të mëdha për shqipen.

Në fund them se nëse nuk përpiqemi sadopak ta përmirësojmë gjendjen e përdorimit të gjuhës së sotme, “**ne**” të cilët nuk e njohim mirë përdorimin e “**formulave**

KUMTESA

alfanumerike të internetit”, mund të jemi të përjashtuar nga komunikimi virtual shumë shpejt!.

Recenzentë:
Prof.dr.Shekije Islamaj
Prof.dr. Ragip Mulaku

Denis HIMCI¹ (PHD Student): PËRFYTYRIMI I SHQIPËRISË NË POEZINË E SOTME TË ARBËRESHËVE TË ITALISË

¹Universiteti "A. Xhuvani", Elbasan
Fakulteti i Shkencave Humane
Departamenti i Gjuhës Italiane

Artikull

Arbëri dhe arbëreshë. Shqipëria dhe shqiptarët. Sa vite e shekuj, kalime farëzash njëri pas tjetrit në dhe të huaj. Ngulime shqiptarësh kudo. Por a kanë humbur vallë lidhjen me vendin e tyre, atdheun e lashtë, gjuhën, kulturën dhe ëndrrat?!...Jo pa qëllim e filluam artikullin tonë me këtë fragment ku në vazhdimësi do të jenë vetë shqiptarët me veprimtarinë, aktivitetin e tyre dhe prodhimtarinë krijuese të tyre në ngulimet ku ato janë vendosur.

"Të rralla janë në botë diasporat që, për shumë shekuj, edhe pas shpërnguljes në dhe të huaj, ruajnë me ngulm gjuhën, kulturën, traditat dhe dashurinë për mëmëdheun e tyre të lashtë, siç janë ngulimet arbëreshe të Italisë. Dhe jo vetëm i ruajnë, por dhe i punojnë pa pushim për t'i shtuar, duke nxjerrë breza të tërë veprimtarësh që janë shquar për lëvrimin e gjuhës së vet amtare dhe i kanë dhënë letërsisë, kulturës e shkencës shqiptare një numër të mirë veprash me merita të shënuara" – pohon prof. Gj.Shkurtaj në studimin e tij: *Poezia e sotme arbëreshe*¹.

E gjithë letërsia e sotme arbëreshe është një përpjekje gati masive e shkrimtarëve për ta afruar krijimtarinë e tyre me atë të dheut mëmë, me gjuhën që përdorin sot kudo shkrimtarët shqiptarë.

Letërsia e sotme arbëreshe është kryesisht një vjershë me temë shoqërore. Ajo ndjek traditën më të mirë të lirikës së Serembes. Motivët e saj i përfiton jeta e katundit, por tashmë jo e një katundi të vetmuar. Aty shprehet shqetësimi për gjendjen e rëndë të arbëreshit, që ndihet përjetësisht i huaj e larg atdheut të parë, por që është edhe krenar për atdheun e të parëve, për origjinën shqiptare. Duhet të themi me gojën plot se këtë cilësi të arbëreshëve nuk e zbeh dot asnjë mjegullim që mund të vijë nga sa flitet e shkruhet ndonjëherë për Shqipërinë e shqiptarët, apo nga sa mund të kenë pësuar e kryer në Itali e gjetkë mërgimtarët më të rinj shqiptarë, të përplasur andej-këndej nga valët e eksodeve masive të viteve '90. Poezia arbëreshe është një poezi e lëvruar, ashtu si edhe gurra e saj ushqyese, kënga popullore, I mëshon fakti se gjaku i arbrit, sado i shprishur nuk birret, nuk bëhet ujë, as në botën e sotme moderne e aq të trazuar. Sigurisht, që në kohën e sotme arbëreshe nuk mund të mos tregojë më e ndjeshme ndaj aktualitetit bashkëkohor, sesa ndaj së kaluarës. Kjo nuk do të thotë se ajo nuk merret më me të shkuarën. Historinë ajo e njeh, e përfill dukshëm dhe e parakupton

apo e nënkupton në indin e saj, nxjerr tërthorazi edhe mësimë , por frymëzimin e merr nga koha e vet, nga jeta arbëreshe e përditshme. Ajo është shprehje poetike e asaj që ndodh çdo ditë në ato ngulime: sprova për të mbijetuar dhe për të mbetur pa arbëreshë. Kjo sprovë nuk shkon as fjollë as pa probleme e pa shqetësime, prandaj edhe nervi i poetëve më të mirë arbëreshë mëton të zbulojë pikërisht këtë plan shoqëror dhe njëherazi intim, të hedhë dritë në botën shpirtërore të mbarë një etnie që rron në diasporë, por edhe të çdo individi si qeliza e saj.

Shqipëria e moçme dhe ajo e sotmja për arbëreshët ka qenë dhe mbetet kurdoherë si “Meka” për besimtarët e Islamit, prandaj edhe ka zënë kurdoherë vendin qëndror. Mëmëdheu i tyre i lashtë është jo vetëm ai që lanë pas gjyshërit e tyre, por edhe ai që ata e morën me vete në zemër e në mendje, të cilin (pikërisht sipas zemrës dhe shpirtit të tyre) do ta krijonin edhe në dhë të huaj. Këtë përfytyrim ata e mbajtën gjithnjë gjallë nëpërmjet folklorit, po edhe nëpërmjet poezisë së lëvruar të djeshme e të sotme.

Atdheu stërgjyshor njihet atje me emrin e moçëm *Arbëri* dhe banorët e saj quheshin asokohe *arbëreshë*. Kështu e quajnë veten deri më sot mërgimtarët në tërë Italinë e Jugut e në Siçili. *Arbëria* mbeti për ta përgjithmonë vendi nga lind dielli, ku janë trojet e të parëve, ku lufta dhe fitoi lavdinë e përjetshme heroit i madh, Skënderbeu, “*teku fjitet gjuha jonë e gjindja jonë gjallësina*”. Padyshim, në vizionin tradicional të arbëreshëve të Italisë, Shqipëria është më i bukur vend i dheut. Ky parashtrim poetik i Arbërisë, duke qëndruar në kufi të historisë e të legjendës do të shtegtonte nëpër kohë nëpërmjet folklorit e traditës arbëreshe. Në Arbëri, poetët arbëreshë i vendosën ngjarjet dhe konfliktet e veprave të tyre. Atje morën edhe heronjtë e tyre. Por, në poezinë e Rilindjes arbëreshe të De Radës, Darës, Serembes e Santorit vizioni i Shqipërisë ishte krejt i sajuar mbi imagjinatën dhe intuitën artistike, sepse asnjëri prej tyre, sa qenë gjallë, nuk patën mundësi ta vizitonin Shqipërinë. Ata vijuan të jepnin në vjershërinë e tyre një *Arbëri* të tipit tradicional, sipas gjedhëve të gojëdhënës e të folklorit popullor. Gjithçka, pothuajse u montua te “*Moti i Madh*” e te *bëmat zulmëmëdha të kryetrimt të Arbërisë të asaj kohe*.¹ Me kohë, sa më shumë mot kalonte, aq më i nevojshëm bëhej një përditësim i përfytyrimit arbëresh me realitetin konkret të Shqipërisë më të re dhe më të ndryshme sesa Arbëria e dikurshme. Nga poetët traditës një hap të parë e pat bërë vetëm Zef Serembja, i cili e la mënjanë *Arbërinë e Motit të Madh* dhe synoi të fliste për Shqipërinë e kohën. Aty konceptimi romantik ia lë vendin një përfytyrimi më afër të së vërtetës. Në hullinë e Serembes u përpoq të ecte poezia arbëreshe e fundshekullit të kaluar dhe ajo e fillimit të shek. XX, ndonëse ajo nuk pati ato figura madhore si më parë. Kjo duket po të kundrojmë poezinë e poetëve të tillë, si: A. Ribeku, Kozma Serembes, F. Krispi Glloviono, Salvatore Braile, Oracio Kaporelli, etj. Por nuk mund të thuhet se u arrit që të jepej ashtu siç ishte fizionomia dhe situatë e atdheut të tyre të dikurshëm. Në fund atë as ata nuk e kishin parë ndonjëherë, porse së paku kishin një njohje më të mirë nga sa shkruhej për të në qarqet italiane e më gjerë. Rrethanat e vështira të kohës i mbajtën arbëreshët larg nga Shqipëria, madje shpesh krijuan edhe situata të ndërlikuara.

*“Politika antishqiptare e disa rretheve të borgjezisë italiane, demagogjia dhe manovrat djallëzore të fashizmit përfuan një klimë të flohtë, për të mos thënë mbytëse edhe për letërsinë arbëreshe.”*¹

Për dhjetëra vjet do të bënte që zëri i poetëve arbëreshë do t’i humbiste tonet madhore. Vendin e letërsisë së madhe e zuri përsëri folklori arbëresh, në pritje të një rizgjimi të ri.

Bashkësive arbëreshe, ashtu si mbarë Jugut të Italisë, mjaft të varfër, do t’u duhej të përballonin problemet jetike të papunësisë e të mungesave të shumta të *Pasluftës*. Letërsisë

arbëreshe iu deshën me se tridhjetë vjet që të mblidhte forcat e të riniste udhën e vet e të luante rolin që i takonte. Shprehja e saj kryesore përsëri do të ishte *vjershëria*, tashmë me një identitet të qartë e të papërcaktuar. Baza e saj do të mbetej edhe më tej përfytyrimi i Shqipërisë, si atdheu i lashtë. Më 1946 Dushko Vetmo përuroi prurjet e reja të poezisë arbëreshe me përmbledhjen "*Bubuqe t'egra*", e cila çelej me vjershën e famshme "Atdheut" në të cilën, nëpërmjet një apostrofe të fuqishme, Shqipëria merr përmasat e një përkushtimi shpirtëror të të gjithë qenies arbëreshe:

*"Për ty na o mëmë po dhurojmë,
Per ty te lufta nder, lule, madhëri,
Kërkojmë, o mëmë e dashur Shqipëri,
E prapë për ty çdo ditë rrojme!!*

Jo vetëm te Dushko Vetmo, po edhe te shumica e poetëve të tjerë arbëreshë që erdhën pas tij, nis të evokohet shpesh e me shpesh atdheu i lashtë, Shqipëria. Madje edhe te LLuka Pevrone, Vincenzo Borreshio, Karmell Kundreva etj., dotë vijojë për mjaft kohë po ai përfytyrim i përtërirë i traditës së Rilindjes, por njëkohësisht edhe do të gjallërohet dhe do të shihet nga këndvështrime të reja. Tipike është këtu poezia e LLuka Perrones, një poet lirik shumë interesant, i cili përfaqëson ata poetë arbëreshë që shkruan për Shqipërinë e re, por pa pasur rastin ta njihnin atë drejtpërsëdrejti. Përfytyrimin e saj Perrone, Borreshio etj., e nxorën nga kujtesa legjendare e popullit, nga përfytyrimi tradicional arbëresh. Shqipëria përfytyrohet si një mëmë e lashtë, e dashur dhe madhështore, që nuk i ka harruar asnjëherë bijtë e saj të mërguar. Edhe bijtë e saj, arbëreshët, nga ana e tyre, sipas Perrones, megjithëse nuk e kanë parë kurrë Shqipërinë, e ndiejnë thellë dashurinë për të dhe e kanë gjithnjë në zemër e në mendje.

Arbëria e moçme apo Shqipëria e sotme në përfytyrimin e Lluca Perrones merr paraqitje nga më të larmishmet, të gjitha prekëse e mbreslënëse: ajo herë paraqitet si një dru i lashtë që kurrë nuk thahet, por qëndron gjithnjë i bletë, herë si një vend me diell, me vasha e trima, me lule e zogj, herë si toka ku rron i gjallë kujtimi i pasosur i Skënderbeut. Midis të tjerave në vjershën: "*Moj mëma Arbëri*", ku ai thotë: "*një burbuqe u çel, në horizontin ka Arbëria*". Vëmë re se autori, megjithëse atdheu i të parëve vijon të jetë i mbuluar me një tis idilik, me nota malli e trishtimi, prapë e ndien se Shqipëria e sotme ndryshon nga ajo e dikurshme dhe kjo hedh dritë e optimizëm në poezinë e tij. Përfytyrimi i Shqipërisë në poezinë arbëreshe do të vijë duke evoluar e ndryshuar. Veçanërisht, rrethana e re, e krijuar në vitet '70 e më pas, jo pak arbëreshë do të vinin në Shqipëri apo në Kosovë, herë si turistë, herë si kursantë, në kuadrin e kurseve apo seminareve të gjuhës shqipe e kulturës shqiptare. Por do t'i shohim edhe si pjesëmarrës në veprimtari letrare apo të ftuar nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Edhe poetë, studiues e grupe artistike arbëreshe e kosovare në ato vite, pothuajse, rregullisht do të shkonin nëpër ngulimet arbëreshe të Italisë. Kështu, Shqipëria dhe takimi me shqiptarët u kthye nga një ëndërr në një të vërtetë të gjallë, nga një dëshirë e zjarrtë në një mundësi të hapët e me përspektiva e më të gjera. Të gjitha këto nuk mund të mos sillnin edhe një situatë të re në poezinë arbëreshe. Ardha në mëmëdheun e lashtë të *Vorea Ujkos*, *Del Gandies*, *Kondrevës*, *Zef Skiro Majit*, *Zef Skiro Modikës*, *pastaj edhe e Paskal Rendës*, *Kate Cukaros*, *Matilde Ferraros* etj., shkaktoi frymëzime e shprehje origjinale të mallit të ri. Ata shkruan vjersha për qytetet e Shqipërisë, për Sarandën, Tiranën, Shkodrën, Krujën, për njerëzit, të cilët i gjetën aty dhe u miqësuan me ta menjëherë, për bukuritë e natyrës shqiptare, por edhe për poetët e shkrimtarët shqiptarë që ishin të njohur në Shqipëri e në Kosovë. Kemi kështu, një shkëmbim marrëdhëniesh miqësore të poetëve

arbëreshë me krijues si: Dritëro Agollin, Nasho Jorgaqin, ashtu siç kemi dhe vjersha po aq të bukura të këtyre poetëve, edhe për diasporën arbëreshe. Kështu vjersha “*Dëshira*” (1984) e Paskal Rendës:

“Kam dëshirë/ Të shtrëngoj duar të lodhura./

Kam dëshirë/ Të shoh sy plot shpresë./

Kam dëshirë/ Të uth një flamur gurgull me djerësë./

Kam dëshirë/ Të dëgjoj si e këndojnë lirinë zogjtë shqipëtarë./

.....Kam dëshirë/ Të përqafoj një vëlla./

Kam dëshirë të përqafoj dhjetë.....njëqind

Njëmijë... tre miliona vëllezër shqiptarë.”

Vjersha të tilla, ku Shqipëria, qytetet dhe katundet shqiptare, varrezat e dëshmorëve apo fermat bujqësore e blegtorale që kanë vizituar poetët arbëreshë, bashkë me imazhin e vashës shqiptare që ndërthuret me vashën tradicionale arbëresho-shqiptare, janë të dendura në vëllimet e poetëve arbëreshë të viteve '70 e këtej. Citojmë disa prej tyre, si: “*Këngë arbëreshe*”, “*Burimi*” të Vorea Ujkos, “*Shpirti i arbërit rrom*” të Karmell Kondrevës, “*Përtej malit prapa kodrës*” të Xhuzepe Skiro Maxhios, “*Zemër arbëreshe*” të Zef del Gandios, “*Segmenti*” të Zef Skiro di Modikës, “*Shtegu*” të Paskal Rendës etj. E gjithë kjo krijimtari politike që ka në qendër temën: *Shqipëria dhe shqiptarët përbën një si udhëtim kolektiv të poezisë arbëreshe në atdheun e origjinës*. Me këto pika takime, si të themi, merr fund një nga dilemat e kësaj letërsie shekullore që ishte gjithmonë në kërkim të rrënjëve të veta. Atë që e krijuan me imagjinatë, atdheun e tyre të lashtë, arbëreshët tashti edhe mund ta shihnin, mund ta kundronin nga afër dhe, kështu mund të bënin një përditësim e përtëritjeje të asaj çka trashëgonin vetëm si kujtim nga gojëdhënat, me atë që ishte realisht. Natyrisht, edhe mund të merrnin me vete në kthim një grusht dhe, siç e shpreh bukur poezia: “*Mall për Shqipërinë*” e K. Kondrevës.

“Kur shkova në Shqipëri/ një grusht me dhe mblodha rrugës/ dhe me shpejtësi/ e futa në xhep/ me një mall të thellë/ që s'ka pend' as vizatim/ për të bërë një përshkrim”.

Poetët arbëreshë që kanë vizituar Shqipërinë në këta dhjetëvjetarët e fundit, natyrisht nuk kanë të gjithë të njëjtin formim apo të njëjtat bindje për jetën. Megjithatë ata kanë një emërues të përbashkët ideoemocional: mallin e zjarrtë dhe dashurinë për Shqipërinë, etjen e madhe për ta parë, njohur e gëzuar atë nga afër, dëshirën për t'i kënduar e për të hyrë në dialog me të. Takimi i drejtpërdrejtë me Shqipërinë bëri që edhe përfytyrimi i saj të mos mbetej më i vagëlluar e mbi apostrofime të përgjithshme legjendaro-mitike, por të vijë nga një takim ballësor e nga njohje të shumanshme me vendin dhe me njerëzit e Shqipërisë. Kjo ka sjellë që tashmë atdheu të pasqyrohet në përmasa reale e të jepet portreti i tij i gjallë. Poezia e sotme arbëreshe me temën e Shqipërisë mbështetet kryesisht në përshtypjet, emocionet, përjetimet dhe situatat e gjalla që krijohen nga ky rikthim magjik i bijëve “*shkapurdhjarë*” në vendin prej nga kanë mërguar të parët e tyre. Poetët që vizitojnë Shqipërinë janë intelektualë të kohës, priftërinj, mësues, gazetarë, mjekë, ruajtës të rendit etj., por ata janë edhe fshatarë arbëreshë tradicionalë, sepse janë ushqyer me atë traditë shekullore, prandaj ata shkrihen në një, kur është fjala për të rrëfyer për Shqipërinë.

“Poezia për Shqipërinë, ka në thelb motivin e katundit, si një atdhe në miniaturë, shtrirë në kufijtë e gjuhës e të jetës zakonore, por që duke iu drejtuar tashti atdheut, rritet në përmasa të mëdha dhe fiton brendi më të thellë e mundësi përgjithësimesh historike e shoqërore”¹.

Motiv më I përhapur është ai i mbresave dhe i gjendjes shpirtërore që pasqyron ndjesitë e forta të takimeve e përjetimeve në Shqipëri. Arbëreshi në vendin e të parëve sikur bëhet përsëri fëmijë, i duket sikur prek gjirin e mëmës apo siç thotë Di Maxhio:

“Biri I lashtë kthehet te nëna gjithnjë e re, ulet në prehërin e saj, lëkundet në djepin e shekujve, nën këngën e kujtimeve dhe I sjell nënës karafilin e zemrës.”

Për Vorea Ujkon ardhja në Shqipëri është *“Kthimi I birit Shkapërdhjarë te vatra e vjetër”* Ai ka ecur 500 vjet në gjurmët e stërgjyshërve, me këngë arbëreshe në buzë dhe, më në fund, e ka gjetur burimin, *“dheun e lisave e të erërave ku e ndien veten si “vëlla i fshatarëve dhe i punëtorëve”.* Kaloi koha e pulëbardhave në det, -thotë Vorea Ujko. Tani në vend të pulëbardhave vijnë vetë arbëreshët në Shqipëri dhe shqiptarët nga Shqipëria në ngulimet arbëreshe.

Del Gandio, një nga ata që ka ardhur më shpesh, po edhe që i ka kënduar me aq pasion Shqipërisë, ka gjithnjë në buzë lutjen *“Më fto Shqipëri”* dhe ardhjen e tij këtu e quan si *“lajmëtar dashurie”* të të gjithë atyre që janë shpërndarë nëpër botë.

Zef Skiro di Modika, gjithashtu, i prekur thellë nga sa ka gjetur në Shqipëri shkruan:

“Njëmijë këngë të pakënduara...më kanë plasur në kraharor për ty o tokë e dashur”.

Poetët arbëreshë i drejtohen Shqipërisë si gjësë më të shtrenjtë: mëmë, diell, vater, truall i papërsëritshëm, tokë e shenjtë, burim ku zë fill jeta dhe historia e tyre.

Vlerat e poezisë së sotme arbëreshe janë të dukshme, sidomos në penat e disa prej poetëve më të shquar, të cilët kalojnë më tej se përshtypjet nga vizitat në Shqipëri dhe mëtojnë të depërtojnë më thellë, të kapin një hapësirë sa më të gjerë, të kahjeve dhe të rrjedhave të jetës së sotme shqiptare. Ata e shohin Shqipërinë si një realitet ku e shkuara dhe e sotmja përbëjnë një binom të pandashëm e një vijim logjik. Siç thotë V. Ujko *“e shkuara, e sotmja, e ardhmja bashkohen me emrin e lavdisë”* *“Çerdhja”*. Në një rast tjetër ai shprehet:

“Koloviten ullinj mbi herojt’ e varrosur e unë dëgjoj fanfarat e Shqipërisë së re” *“Era e historisë”*.

Edhe më shkoqur e thotë këtë ide në vargjet:

“nga toka tërë e vjetër doli vrulli tërë i ri” *“Butrinti”*.

Del Gandio, ndërsa flet për Shqipërinë e sotme, i vjen vetvetiu në mendje e kaluara e lavdishme e saj dhe i bashkon të dyja këto pamje në një vision të vetëm:

*“O Shqipëri se njëherë ti qe
Mbrojtëse e Evropës dhe lavdia,
Kështu të shoh dhe sot”*

“O Shqipëri”.

Zef Skiro Maji, i gëzuar për bukurinë e vendit të të parëve, po edhe entuziast për rrjedhat e mbara të ecurisë që shihte në ato vite në Shqipëri, e ndien veten si biri që kërkon shpatën e etërve për t’u radhitur në luftë krahas vëllezërve shqiptarë:

“Shpatën e etërve më jep/ që edhe unë/

Me të dy duart të të mbroj, sepse unë arbëreshi/ të dua të begatshme/

Të lumtur të dua/ midis kombeve krenare/

E me krenari për ty jem/ mëmëdheu i lashtë.

“Udhëtimi iparë”

Duket e çuditshme, por është një ndjesi aq e natyrshme, që disa nga poetët arbëreshë i përjetojnë aq thellë takimet e situatat në Shqipëri, saqë janë gati të bëjnë çfarëdo sakrifice për atdheun e tyre të dikurshëm.

“Për ty Shqipëri jap edhe jetën” V. Ujko

KUMTESA

kurse Del Gandio me të njëjtën gjë, por në një formë tjetër:

Dhe unë biri yt, për ty dua të vdes”

Edhe një nga poetët më të rinj Anxhelo Matrango nga Firmoza thotë:

“Tani mund të vdisja që e pashë Shqipërinë”

Përfytyrimi më i saktë dhe më i përditësuar i Shqipërisë e ka forcuar mjaft identitetin e poezisë së sotme arbëreshe. Shqipëria është tashmë si një shprehje e re e thelbit të përbashkësisë etnike, po edhe ka krijuar mundësi të reja për ta përcjellë në atdhe mesazhin e dashurisë, të besimit dhe të mallit të bijëve të munguar për tokën mëmë, për ato që e lanë stërgjyshërit, por që nuk e harruan dhe nuk duan ta harrojnë kurrë as stërnipat.

Recenzentë :
Dr. Elvira Lumi
Dr. Meli Shopi

SHKENCAT TEKNIKE

KUMTESA

Agni DIKA, nebi CAKA, Adnan MAXHUNI, Avni REXHEPI, Kadri SYLEJMANI, Haxhi LAJQI¹: PRINCIPET BAZIKE PËR SINTETIZIMIN E TË FOLURIT PËRMES KOMPJUTERIT TË TEKSTEVE TË SHKRUARA NË GJUHËN SHQIPE

¹Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Universiteti i Prishtinës

Abstrakti

Me sintezimin e të folurit nënkuptohet procesi i gjenerimit artificial të të folurit nga tekstet e shkruara. Përpyekjet për gjenerimin artificial të të folurit janë shumë të hershme, gjë që ndërlidhet me mundësitë e përdorimit të tij për qëllime të ndryshme. Gjenerimi në fjalë ka një rëndësi të veçantë për njerëzit e hendikepuar në të pamur, për përdorim në lojrat e ndryshme për fëmijë, në gjenerimin e numrave në mesazhet e ndryshme telefonike, si dhe në shumë raste tjera të jetës së përditshme. Procesi i konvertimit të tekstit të shkruar në të folur, në punime të ndryshme shkurt njihet si TTS (nga Text-To-Speech).

Ky punim ka për qëllim prezentimin e principeve bazë mbi të cilët do të mbështetet algoritmi për gjenerimin e të folurit nga tekstet e shkruara në gjuhën shqipe²⁶². Aktualisht, për disa gjuhë të mëdha botërore ekzistojnë zgjidhje për konvertimin e teksteve në të folur. Kurse për gjuhën shqipe ekzistojnë punime përmes të cilave janë prezentuar ide për zgjidhje të këtij problemi, pa dhënë një zgjidhje finale. Përdorimi i platformave ekzistuese në internet për gjuhë të tjera, në bazë të hulumtimeve tona, nuk japin rezultate të kënaqshme edhe për gjuhën shqipe. Një përafrim më i dukshëm vërehet nëse si gjuhë bazë merret gjuha italiane. Derisa kuptueshmëria e fjalëve plotësonë një lloj pragu minimal, natyraliteti është shumë larg të të folurit shqip. Konvertimi i numrave është diç më i natyrshëm. Edhe versioni i cili ofrohet në kuadër të Google Translate, është me qartësi të kufizuar dhe jonatyror. Kjo është si rezultat i asaj se gjuhët i kanë specifikat e tyre dhe përputhet me konstatimin që haset në punime të ndryshme se për secilën gjuhë (apo së paku për secilën familje gjuhësh) duhet gjetur zgjidhje të veçantë.

Shumica e zgjidhjeve për gjuhë të ndryshme bazohen në metodën e bashkimit të segmenteve akustike (zanore), të ruajtura paraprakisht në një bazë të dhënash. Si segmente akustike mund të merren fjalët, rrokjet, grupe shkronjash, shkronja, etj. Pastaj, përmes

²⁶² Ky punim ndërlidhet me projektin shkencor “Konvertimi automatik në të folur i teksteve të shkruara në gjuhën shqipe”, që financohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës.

softuerit përkatës, në bazë të tekstit të shkruar, bashkohen segmentet akustike në një fajll akustik të vetëm, gjë që rezulton në gjenerimin e të folurit për tekstin e dhënë. Problemi kryesor këtu qëndron te bashkimi i këtyre “copëzave” akustike, sepse me bashkimin e thjeshtë të tyre paraqiten diskontinuitete të natyrave të ndryshme, të cilat e bëjnë të folurit jonatyror.

1. Hyrje

Gjenerimi artificial i të folurit, në radhë të parë ndërlidhet me personat e hendikepuar, qoftë me ata që nuk shohin, por edhe me personat që kanë pengesa në të folur. Por, gjenerimi në fjalë mund të shfrytëzohet edhe gjatë gjenerimit të mesazheve të ndryshme, ose edhe në lojra fëmijësh.

Cilësia e konvertimit të tekstit në të folur matet me dy parametra kryesor: kuptueshmërinë dhe natyralitetin. Kuptueshmëria ka të bëjë me qartësinë e të folurit që dëgjohet, ndërsa natyraliteti - me ngjashmërinë e të folurit të gjeneruar artificialisht me të folurit e zakonshëm [3].

Për shumë gjuhë të mëdha botërore ekzistojnë zgjidhje që sigurojnë gjenerimin e të folurit nga tekstet e shkruara në ato gjuhë. Por, për gjuhën shqipe ende nuk ekziston një zgjidhje complete.

Në bazë të studimeve të ndryshme, për shkak të specifikave që kanë gjuhët e ndryshme, është konkluduar se për çdo gjuhë duhet të dizajnohet një algoritëm i veçantë për sintetizim të të folurit.

Nga literatura dhe punimet e publikuara shihet se, për sintezën e të folurit nga teksti i shkruar përdoren tri metoda kryesore: *sinteza formant*, *sinteza përmes vargëzimit* dhe *sinteza atrikulese*. Secila nga teknologjitë ka përparësitë dhe të metat e veta [3]. Metoda më e përdorur deri më tani, nga shumica e autorëve, është *metoda e sintezës përmes vargëzimit* (agl. concatenative synthesis).

Përdorimi i metodës së vargëzimit konsiston në ruajtjen e segmenteve të caktuara të tekstit si segmente akustike. Nga këto segmente (copëza) akustike, përmes bashkimit me ndihmën e një algoritmi të veçantë, gjenerohen fjalët, fjalitë dhe teksti në përgjithësi. Segmentet që duhet të incizohen paraprakisht dhe të ruhen si fajlla akustik elementarë në një bazë me të dhëna, mund të jenë të ndryshme, si: fjalë, rrokje, grupe shkronjash, etj.

E gjithë përpjekja për arritjen e cilësisë së kënaqshme të gjenerimit përqendrohet në bashkimin e segmenteve akustike, ashtu që të folurit e gjeneruar të jetë sa më natyral.

Konvertimi i numrave të shkruar në numra që shqiptohen është një tjetër sfidë gjatë gjenerimit të të folurit nga teksti i shkruar dhe duhet të jetë pjesë integrale e algoritmit të përgjithshëm, ngase numrat gati gjithmonë paraqiten si pjesë e teksteve të shkruara.


2. Gjuha shqipe dhe sinteza e të folurit nga tekstet e shkruara

Gjatë dizajnit të sistemit për konvertim të tekstit të shkruar në të folur duhet pasur parasysh karakteristikat e gjuhës për të cilën do të punojë sistemi. Specifikat e gjuhës përkatëse kanë rëndësi dhe kërkojnë përgjigje konkrete që mund të dallojnë nga gjuhët tjera. Gjuha shqipe bënë pjesë në familjen e gjuhëve indoeuropiane. Në pemën e kësaj familjeje, gjuha shqipe paraqitet me një degë të veçantë, e që në disa elemente rrjedhin edhe nga vet trungu i familjes [2]. Alfabeti i gjuhës shqipe përbëhet nga 36 shkronja të bazuara në alfabetin latin. Këto shkronja u përkasin 36 fonemave të gjuhës së folur shqipe. Prej tyre 29

janë bashktingëllore dhe 7 janë zanore. Në grupin e bashkëtingëlloreve, 9 janë dysymbolëshe-bigrane (dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh, zh). Për t'i ikur leximit të gabuar të tyre, ato duhet të gjenerojnë tingull të veçantë. Një gjë e tillë duhet të parashihet në algoritmin (dhe më pas aplikacionet) për sintezën e të folurit. Vetia e gjuhës shqipe, e leximit të çdo shkronje në një mënyrë unike (të vetme), pa marrë parasysh pozitën se ku ndodhet paraqet një element të rëndësishëm lehtësues gjatë sintezës së të folurit artificial.

Fjalori i gjuhës shqipe përmbanë më tepër se 40 000 fjalëve. Duke pasur parasysh edhe trajtat e fjalëve bazë, gjatë shkruarjes së teksteve numri i tyre kalon një milion variacione fjalësh. Për këtë arsye, incizimi i fajllave akustik të të gjitha fjalëve dhe trajtave të tyre dhe pastaj bashkimi i tyre në fjali, është praktikisht një gjë e pamundur.

Mirëpo, sikur edhe te gjuhët e tjera, jo të gjitha fjalët përdoren me shpeshtësi (frekuencë) të



njejtë. Një numër relativisht i vogël i fjalëve përbëjnë pjesën më të madhe të teksteve dhe të të folurit të përditshëm. Në bazë të një statistike [1], janë fituar rezultatet e fjalëve që përdoren më shpeshë në gjuhën shqipe (shih figurën 1).

Figura 1. Frekuenca e 40 fjalëve më të përdorura të gjuhës shqipe

Kjo statistikë ka një rëndësi të veçantë gjatë dizajnit të sistemit TTS (Text-To-Speech) për gjuhën shqipe. Rëndësia kryesore qëndron në faktin që këto fjalë mund të incizohen si segmente të

veçanta akustike dhe më pas të përdoren për gjenerim të fjalive të ndryshme. Në këtë mënyrë zvogëlohet nevoja për bashkimin e segmenteve më të shkurtëra akustike, gjë që do ta dëmtonte cilësinë e fjalëve të gjeneruara. Natyrisht, rritja e cilësisë për fjalët më të shpeshta ka ndikim të madh në cilësinë e gjithmbarshme të tekstit, sepse pesha e tyre në tekst është e madhe. Nëse numri i këtyre fjalëve rritet, atëherë rritet edhe cilësia e konvertimit të tekstit të shkruar në të folur. Mirëpo, numri shumë i madh i fjalëve bënë që baza e të dhënave me segmente akustike të rritet, me ç'rast edhe shpejtësia e aplikacionit ulet. Në bazë të testeve të para, mund të themi se numri prej disa qindra fjalëve më të përdorura është një madhësi optimale për dizajnimin e sistemit për konvertim [1].

Fjalët tjera që nuk përfshihen në këtë grup (në grupin e fjalëve më të përdorura) formohen me bashkimin e segmenteve më të vogla akustike: dyshkronjësheve dhe shkronjave të veçanta.

Numri i përgjithshëm i dyshkronjësheve është 1296. Nga ky grup mund të përjashtohen disa nga dyshkronjështet që nuk përdoren, kështu që numri real i dyshkronjësheve është pak më tepër se njëmijë. Si segmente akustike duhet të ruhen edhe 36 shkronjat e alfabetit.

Këto tri grupe segmentesh akustike (fjalët, dyshkronjështet dhe shkronjat), përkatësisht fajllat akustik përkatës e paraqesin bazën me të dhëna e cila mund të shfrytëzohet për konvertimin e teksteve të shkruara në të folur.

3. Algoritmi i përgjithshëm për konvertimin e tekstit në të folur

Principi bazë i dizajnit të algoritmit për konvertimin e teksteve të shkruara në të folur qëndron në krahasimin dhe gjetjen e fjalëve të tekstit me fjalët nga baza e të dhënave me segmentet akustike. Nëse fjala gjendet në grupin e fjalëve të ruajtura si fajlla akustik, atëherë segmenti i tillë akustik merret dhe bëhet pjesë e fajllit akustik për gjenerim të të folurit [4].

```

përsërite
{
  për secilën fjalë
  nëse fjala është në databazë
    gjenero të folurit
  nëse jo
  {
    për secilën dyshkronjësh
    nëse dyshkronjëshi është në databazë
      gjenero të folurit
    nëse jo
    {
      për secilën shkronjë
      gjenero të folurit
    }
  }
}
deri në fundin e tekstit

```

Figura 2. Algoritmi për konvertim të tekstit në të folur

Nëse fjala nga teksti i shkruar nuk është ruajtur si segment i veçant, atëherë ajo ndahet në dyshkronjëshe. Pastaj, bëhet kërkimi i këtyre dyshkronjëshave në bazën e segmenteve akustike përkatëse. Duke i bashkuar këto segmente akustike fitohet fjala e caktuar (shih figurën 2).

Incizimi i segmenteve akustike paraqet një çështje në vete. Ai duhet të bëhet në studio profesionale me kushte dhe pajisje të veçanta akustike, me qëllim të eliminimit të zhurmave. Pastaj prej tyre priten valët akustike të fjalëve, dyshkronjësheve dhe shkronjave [3]. Prerja nga teksti i lexuar është shumë më cilësore se sa incizimi i fjalëve, dyshkronjësheve dhe shkronjave veç e veç, gjë që do të rezultonte në të ashtuquajturin lexim robotik.




Figura 3. Pamja e valëve akustike (shkronja e, përkatësisht numri 60)

Gjatë prerjes dhe ruajtjes së këtyre segmenteve akustike duhet përshtatur parametrat

e fajllit (kohëzgjatjen, amplitudën dhe frekuencën), në mënyrë që pas ngjitjes së “copëzave” të minimizohen diskontinuitetet apo problemet tjera që do ta ulin kuptueshmërinë dhe natyralitetin e të folurit të gjeneruar (shih figurën 3).

4. Konvertimi i numrave në zë

Një prej problemeve të veçanta që paraqitet gjatë konvertimit të teksteve në të folur, është trajtimi i vlerave numerike, të cilat mund të përfshihen në tekste të ndryshme. Për të mundësuar sintetizimin e vlerave numerike, paraprakisht mund të bëhet normalizimi i vlerave numerike në vlerat përkatëse tekstuale të shifrave, e pastaj sintetizimi i të folurit bëhet në mënyrë standarde si për tekstet e zakonshme.

Shndërrimi i vlerave numerike në fjalët përkatëse për secilën prej shifrave numerike, fillon me analizen e shifrave të veçanta të numrave të dhënë. Në gjuhën shqipe, sikurse edhe në shumicën e gjuhëve të tjera, për shifrën e njëjtë fjalët përsëriten, por merret parasyshë peshë e shifrës varësisht prej pozitës që ka. Përveç njëzet shifrave të para, të cilat janë unike, vlerat tjera më të mëdha, përmbajnë emërtimin/fjalën e njëjtë me numrat themelor prej 0 deri në 9, por atyre u shtohen prapashtesat përkatëse të shumëfishave, si qindëshe, mijëshe, milionëshe, etj. Pra, numri bazë, si një, dy, etj., përcillet me shumëfishin përkatës, si: njëqind, një-mijë, dy-qind, dy-mijë, e kështu me radhë.

Një prej elementeve me rëndësi dhe që e karakterizon gjuhën shqipe, është nevoja për përdorimin e lidhëses “e” ndërmjet vlerave përkatëse të shumëfisheve. Pra, zakonisht thuhet, p.sh.: *njëqind e pesëdhjete e katër*. Vërehet se lidhësja “e” qëndron ndërmjet shifrave të veçanta për peshat e caktuara të vlerave numerike.

Në gjuhën shqipe, shumica e numrave theksohen njësoj, pa marrë parasysh nëse ajo paraqet vit, vlerë numerike, vlerë monetare apo ndonjë dimension tjetër. Një përparësi e madhe është fakti që për “konvertimin” e numrave në fjalë përdoret një numër jo i madh fjalësh (shih figurën 4). Pra, numri i fjalave akustik është i vogël.

| Vlera numerike | Fjala/Leximi | Vlera numerike | Fjala/Leximi |
|----------------|-------------------|-------------------|----------------|
| 1 | Një | 30 | Tri-dhjetë |
| 2 | Dy | 40 | Katër-dhjetë |
| 3 | Tre | 50 | Pesë-dhjetë |
| 4 | Katër | 60 | Gjashtë-dhjetë |
| 5 | Pesë | 70 | Shtatë-dhjetë |
| 6 | Gjashtë | 80 | Tetë-dhjetë |
| 7 | Shtatë | 90 | Nëntë-dhjetë |
| 8 | Tetë | 100 | Një - qind |
| 9 | Nëntë | 1000 | Një - mijë |
| 10 | Dhjetë | 1,000,000 | Një – milion |
| 11 | Njëmbëdhjetë | 1,000,000,000 | Një – miliardë |
| 12 | Dymbëdhjetë | 1,000,000,000,000 | Një – bilion |
| 13 | Trembëdhjetë | ... | ... |
| 14 | Katërmëdhjetë | | |
| 15 | Pesëmbëdhjetë | | |
| 16 | Gjashhtëmbëdhjetë | | |
| 17 | Shtatëmbëdhjetë | | |
| 18 | Tetëmbëdhjetë | | |
| 19 | Nëntëmbëdhjetë | | |
| 20 | Njëzet | | |

Figura 4. Fondi i fjalëve për shndërrim të numrave në fjalë

Prej këtu mund të konstatohet se fondi i fjalëve të veçanta që përdoren për vlerat numerike është i kufizuar. Për vlerat prej 11 deri në 20 përdoren fjalë të veçanta, gjë që e lehtëson sintetizimin. Gjatë konvertimit në tekst të vlerave numerike, analiza bëhet për treshet e veçanta brenda tyre. P.sh, nëse bëhet fjalë për numrin: 123123, do të kemi përsëritjen: “Njëqind e njëzet e tre” – mijë, e “Njëqind e njëzet e tre”. Kjo gjë e mundëson

që analizën e vlerave numerike ta bëjmë në nivel të tresheve të shifrave, për pozitat përkatëse të shumëfisheve.

```

Për çdo numër
{
  nëse numri negativ
    shtoja parashtesën "minus"
  Përsërit
  {
    ndaji "treshet" nga vlera numerike
    {
      - Deri      999  - treshja e parë
      - Deri      999999  - treshja e dytë + "mijë"
      - Deri      999999999  - treshja e tretë + "milion"
      - Mbi      9999999999  - shifrat tjera + "miliardë"
    }
  }
  bëje shndërrimin në tekst
}
Shkruaj tesktin përkatës

```

Figura 5. Pjesa e algoritmit për shndërrimin e vlerës numerike në tekst të zakonshëm

Në figurën 5 është paraqitur një pjesë e algoritmit për analizimin e vlerave numerike dhe shndërrimin e tyre në tekst. Pas kësaj, teksti i fituar konvertohet në të folur duke e shfrytëzuar sistemin standard për sintetizimin e të folurit nga tekstet e shkruara shqipe.

Përfundim

Shndërrimi i teksteve të shkruara në të folur mbetet edhe më tutje një fushë me shumë interes. Gjuha shqipe ende nuk është e përfshirë në bashkësinë e gjuhëve për të cilat ka një zgjidhje përfundimtare lidhur me këtë çështje. Ne jemi angazhuar në gjetjen e një modeli sipas të cilit do të mund të bëhej shndërrimi i teksteve të shkruara në gjuhën shqipe, në të folur. Duke i përcjellur edhe studimet për gjuhët tjera, jemi duke e përpunuar idenë e sintezës së të folurit me bashkimin e fajllave akustik të segmenteve tekstuale, të cilët ruhen në një bazë të dhënash.

Problemi kryesor që paraqitet gjatë sintetizimit është ai i bashkimit të segmenteve akustike, në procesin e gjenerimit të fjalëve. Nga algoritmi i dhënë më sipër shihet se si segmente akustike janë një numër i caktuar fjalësh (ato që paraqiten më së shpeshti në tekstet e gjuhës shqipe), pastaj dyshkronjëshet (difonet) dhe të gjitha shkronjat e alfabetit. Kurse, problemi i shndërrimit të numrave në zë lehtë zgjidhet duke i shndërruar së pari numrat në tekste të zakonshëm dhe pastaj, tekstet e fituara konvertohen në zë duke e shfrytëzuar procedurën e zakonshme që përdoret për tekstet tjera.

*Recensentë:
Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Prof. Asoc. Dr. Lule Ahmedi*

Msc. Arlinda ALIMEHAJ¹: NDIKIMI I RENDITJES FAZORE TË KTHIMEVE MAJTAS (LEAD/LAG) NË NIVELIN E SHËRBIMIT TË KRYQËZIMEVE TË ARTERIES "LIDHJA E PEJËS" NË PRISHTINË

¹Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Universiteti i Prishtinës

ABSTRAKT

Përveç opsioneve themelore të definuara në controllerët e trafikut, gjatë punës së dirigjimit të kryqëzimeve të sinjalizuara, në rritjen e progresionit të koordinimit, në rrethana të caktuara, rrol të rëndësishëm luan edhe radhitja fazore e kthimeve majtas të rrugës kryesore si dhe atyre dytësore në raport me qarkullimet përkatëse drejtë. Në këtë punim, është bërë analiza e efektit të ndryshimit të sekuencave të kthimeve majtas për katër kryqëzimet e formës T përbërëse të arteries së lartëpërmendur në përmasën kualitative të koordinimit-progresioni e cila drejtpërdrejt rezulton në nivelin e shërbimit. Me ndryshimet e sekuencave : leading (udheqës) dhe lagging (pasues), janë analizuar efektet në nivelin e shërbimit të kryqëzimeve dhe poashtu janë sjellur rezultatet krahasimtare me ndihmën e softëare-it Synchrono.

Fjalët kyçe: Unaze, barrierë, kthim majtas udhëheqës, kthim majtas pauses, fazë e mbojtur, fazë e mbrojtur/lejuar, nivel i shërbimit, valë e gjelbër.

1. HYRJE

Gjerësia e valës progressive paraqet qëllimin themelor në procesin e përpilimit e planeve të koordinimit të sinjaleve ndicuese të kryqëzimeve të trafikut. Sa më e gjerë që të jetë vala progresive nënkuptohet se grup më i madh automjetetsh mund të përshkrijnë kryqëzimet kryqëzimet pa ndalesa nëpër ta. Me zhvillimin e renditjes së kthimeve majtas në baza ditore, sot në botë, arrihet funksionalitet dhe fleksibilitet më i madh i operimit të sinjaleve ndicuese të trafikut. Përveç parametrave të përgjithshëm të sinjalizimit kohëzgjatja e ciklit dhe kohëzgjatja e fazave, rrol të rëndësishëm në aritjen e valës progressive kur ajo është e dëshiruara luan renditja fazore dhe vecanërisht e kthimeve majtas dhe drejtimeve drejt të

rrugës kryesore-të koordinuar. Renditja e kthimeve majtas e njohur në literature si leading (udhëheqës) dhe (lagging) nënkuptohet në raport me qarkullimet fqinjë drejt në kryqëzim (fig.1). Në këtë punim është prezentuar gjerësia e valës së gjelbërt si përmasë kualitative e nivelit të shërbimit të të gjitha kryqëzimeve përbërëse të arteries.

2. RENDITJET E KTHIMEVE MAJTAS

Renditja udhëheqje (lead) e kthimeve majtas në unazë nënkupton se ajo fillon para qarkullimeve drejt të kahjes së kundërt.

Renditja passim (lag) e kthimeve majtas fillon pas qarkullimeve drejt të kahjes së kundërt.

Renditja (udhëheqje-udhëheqje) lead-lead nënkupton se të dy kthimet majtas të kahjeve të kundërta fillojnë përnjëherësh dhe atë para qarkullimeve drejt të kahjeve të kundërta përkatëse.

Në renditjen udhëheqje-pasim (lead-lag) një palë e qarkullimeve të kthimeve majtas udhëheq para atyre drejt ndërsa pala tjetër e kthimeve majtas pason qarkullimet drejt të kahjeve të kundërta përkatëse.

Në renditjen pasim-udhëheqje (lag-leading) që ka kuptim të kundërt simetrik me atë lead-lag, qarkullimet e kthimeve majtas i pasojnë qarkullimet e kahjes së kundërt ndërsa pala tjetër udhëheq qarkullimet drejt të kahjes së kundërt.

Në renditjen passim-pasim (lag-lag) qarkullimet e kthimeve majtas të të dy kahjeve të ndryshme i pasojnë qarkullimet drejt të kahjeve të kundërta përkatëse.




Fig.1 Renditjet fazore të kthimeve majtas

Njihen edhe forma tjera të renditjes fazore që mundësohen përmes kontrollereve të sofistikuar të trafikut që praktikohen sot nëpër botë, por përmendja e rëndësisë së këtyre të lartpërmendurve përmbush nevojën për kuartësim qëllimi të punimit.

3. ANALIZË E MUNDËSIVE TË RENDITJES NË ARTERIEN “LIDHJA E PEJËS” DHE APLIKIMI I SOFTWARE-IT SYNCHRO

Arteria rrugore “Lidhja e Pejës” (fig.2) që ka në përbërje katër kryqëzime të sinjalizuara ka gjatësi prej 2,348 km që janë të rregulluar përmes formës së kontrolimit me kjo fikse që nënkupton se rregullimi i kohëzgjatjeve të fazave rregullohet përmes të dhënave fikse të

regjistruara për kërkesa trafikut. Shqyrtimin e rëndësisë së ndryshimit të renditjes së kthimeve majtas në këtë punim është bërë duke u bazuar me formën e sofistikuar të kontrollimit të njohur si semi-actuated²⁶³, ku rregullimi fazor bëhet në bazë të kërkesave të regjistruara në trafik përmes detektorëve të akteve të vendosur nëpër shiritë dhe atë të vendosur vetëm nëpër shiritët e kthimeve majtas dhe të rrugëve dytësore. Në rrugën kryesore ku edhe është qëllimi të vëhet koordinimi nuk vendosen detektorë pasi që ajo në mënyrë standard gëzon përparësinë e qarkullimit, pra e drejta e qarkullimit qëndron në mënyrë të vazhdueshme në të dy kahjet e rrugës kryesore –pjesë e magjstrales M9, dhe e drejta e qarkullimit në të (drita e kuqe) mund të ndërpritet vetëm aktivizimin e thirrjeve të kontrollerëve nga kërkesa e automjeteve në drejtimet dytësore. Intersection distancat në mes kryqëzimeve janë:

kryqëzimet '1- '2~398 m; kryqëzimet '2 dhe '3 ~1485 m; dhe kryqëzimet '3 dhe '4 ~465 m.




Fig.2 Pamje gjeometrike e arteries "Lidhja e Pejës"

Meqenëse kryqëzimet janë të formës T atëherë shqyrtimi i renditjes thjeshtohet përshkak të mungesës së kthimeve majtas një njërin kah të cdo kryqëzimi, megjithatë mbetet të analizohen renditja e atyre kthimeve majtas në raport me qarkullimet drejt të afërta. Arteria e lartpërmendur njihet për numrin e aksidenteve të parreshtura të trafikut që kanë ndodhur nëpër kryqëzime. Për këtë arsye mbizotëron kriteri siguri në zjgjedhjen e mënyrës së mbrojtur, lejuar apo mbrojtur+lejuar të kthimeve majtas. Mënyra e rregullimit të kthimeve majtas është propozuar të jetë e mbrojtur në të gjitha kryqëzimeve, cka do të thotë se brenda fazës së kthimeve majtas nuk ka qarkullime drejt nga kahja e kundërt dhe elimimon mundësinë e konflikteve të automjeteve në kryqëzime. Software-i synchro i cili mundeson analiza mikrosimulative të trafikut nëpër kryqëzime, është aplikuar në këtë punim për vlerësimin e efektit të ndryshimeve të kthimeve majtas në gjerësinë e valës së gjelbërt të arteries për të dy drejtimet lindje dhe perëndim. Në punim drejtimi i njohur në synchro (EB) nënkupton drejtimin kah lindja që në punim i referohet drejtimit Prishtinë-Fushë Kosovë, dhe ai (WB) kah perëndimi paraqet drejtimin Fushë Kosovë-Prishtinë. Definimi i kthimeve majtas bëhet vërehet në diagramin hapësirë- kohë (fig. 3). Ndryshimet e renditjes së kthimeve majtas janë bërë për secilin kryqëzim në arterie dhe në fund është fituar rezultati gjerësisë së valës për drejtim të arteries që mundësohet të shiqohet edhe në diagram të

²⁶³ Forma e kontrollimit semi-actuated (kontrollimi me gjysmë-veprim) propozon ndërrimin e inetrvaleve në sinjalet ndricuese për qarkullime të ndryshme në bazë të detektorëve të vendosur në akse dhe vetëm nëpër drejtimet dytësore,nën supozimin se e drejta e qarkullimit ruhet në drejtimin kryesor të koordinuar. Në qoftë se në ndonjë rast nuk regjistrohet kërkesë trafiku nëpër drejtimet dytësore, e drejta kalon në qarkullimet e automjeteve në rrugën kryesore

gjerësive (fig 3).




Fig. 3. Diagrami fazor dhe diagrami hapësirë-kohë i valëve të gjelbërta

REZULTATE DHE KONKLUDIME

Janë analizuar dymbëdhjetë kombinime na bazë të mundësisë kombinatorike: për dy lloje (lead dhe lag) $4!/2=4*3*2/2=12$. Për secilin kombinim në vecanti janë fituar rezultatet e gjerësisë së valës së gjelbërt dhe atë për segmente të vecanta në mes të kryqëzimeve të vecanta por edhe ato rezultuese- të arterieve si baraspeshë e këtyre të parave, të cilat janë dhënë në tabelën e mëposhtme (tabela nr.1).

| Tabela.1. Rezultatet e gjerësisë së valës së gjelbërt (s) | | | | | | | | | | |
|---|---------|---------|---------|---------|---------|---------|-----|-----|--|-----|
| Gjerësia e valës së gjelbërt për segmente (s) | | | | | | | | | Gjerësia e valës së gjelbërt për arterie (s) | |
| Kryqëzimet | '1 | | '2 | | '3 | | '4 | | | |
| Kombinimi/Drejtimi | L- P | P- L | L- P | P- L | L- P | P- L | L-P | P-L | L-P | P-L |
| 1 (xxxx) | 31 | 27 | 34 | 37 | 46 | 44 | 46 | 44 | 31 | 17 |
| 2 (xxx-) | 31 | 27 | 34 | 37 | 43 | 56 | 43 | 56 | 31 | 17 |
| 3 (xx--) | 31 | 27 | 34 | 48 | 43 | 54 | 43 | 54 | 31 | 17 |
| 4 (x- - -) | 31 | 43 | 34 | 41 | 43 | 54 | 43 | 54 | 31 | 23 |
| 5 (- - - -) | 31 | 46 | 34 | 41 | 43 | 54 | 43 | 54 | 31 | 40 |
| 6 (---x) | 31 | 46 | 34 | 41 | 46 | 50 | 46 | 50 | 31 | 36 |
| 7 (--xx) | 31 | 46 | 22 | 41 | 41 | 52 | 41 | 52 | 22 | 36 |
| 8 (-xxx) | 31 | 34 | 22 | 50 | 41 | 52 | 41 | 52 | 22 | 34 |
| 9 (x-x-) | 18 | 46 | 22 | 41 | 38 | 54 | 38 | 54 | 14 | 40 |
| 10 (-x-x) | 18 | 46 | 22 | 54 | 41 | 54 | 41 | 54 | 14 | 44 |
| 11 (x—x) | 20 | 30 | 22 | 35 | 41 | 54 | 41 | 54 | 8 | 28 |
| 12 (-xx-) | 20 | 39 | 22 | 54 | 30 | 44 | 38 | 44 | 13 | 27 |

*L-P është shënuar drejtimi Lindje-Perëndim (Prishtinë-F.Kosovë),

P-L është shënuar drejtim Perëndim-Lindje (F.Kosovë-Prishtinë),

Në kolonën e kombinimeve janë shënuar llojet e kthimeve me shenjë (x)-renditje udhëheqëse dhe shenjë (-) renditje pasuese. Poashtu janë shënuar me ngjyrë të gjelbërt

kryqëzimet që në kombinim kanë renditje udhëheqëse të kthimeve majtas.

Sic vërehet nga tabela e më sipërme, madhësitë e gjerësive të valëve të gjelbërta, si të segmenteve të vecanta e poashtu edhe ato të arterieve ndikohen nga përcaktimet sequenciale të kthimeve majtas në kryqëzimet e para '1 dhe '2, përderisa kryqëzimet '3 dhe 4 nuk tregojnë ndonjë efekt të dukshëm, pasi që përbëjnë kthime majtas me vëllime më të ulëta të trafikut.

Në bazë të rezultateve tabelare të nxjerrura më lartë mund të nxirret konkludimi lidhur me arrijtjen e nivelit më të lartë të valës së gjelbërt për kombinime të ndryshme:

- Gjerësitë e valëve të gjelbërta të arteries rezultojnë të jenë të shkrurtëra në drejtimin P-L si rezultat i gjerësive të valëve në segmentin e parë në tri kombinimet e para ku kthimet majtas udhëheqin. Pra vala e automjeteve e nisur nga drejtimi P-L zvogëlohet në 17 sekondasi pasojë e ballafaqimit me kthimet majtas që 'privilegjohe' në kryqëzimin '1.

-Shembulli më i dobët i nivelit të shërbimit sipas gjerësisë së valës së gjelbërt është ai në kombinimin 11 (8 sekonda në drejtimin L-P dhe 28 sekonda në drejtimin P-L) dhe në kombinimin 12 (13 sekonda në drejtimin L-P dhe 27 sekonda në drejtimin P-L) Në kombinimin 11 kthimet majtas udhëheqin vetëm në kryqëzimin e parë dhe të fundit dhe sipas të gjitha gjasave, në brendi të arteries nuk arrijnë të shërbehen në tërësi dhe me këtë rast pësojnë valët e automjeteve të drejtimit të koordinuar.

Poashtu, edhe në kombinimin 12 kthimet majtas udhëheqin në mes të arteries (në kryqëzimet '2 dhe '3) ndërsa në kryqëzimet dalëse '1 dhe '4 pasojnë, ashtu që rezultojnë në zvogëlim të valës së gjelbërt të arteries.

-Kombinimi 5 në të cilin është zgjedhur tretman i njejtë kthimeve majtas në të gjitha kryqëzimet, më renditje fazore pasuese të kthimeve majsta ka ofruar, megjasë nivelin më të mirë sipas parametrin të gjerësisë së valës së gjelbërt (31 sekonda dhe 40 sekonda për drejtimet L-P përkatësisht P-L).

Recensentë:

Dr. sc. Xhevat Perjuci, prof.

Dr. sc. Nijazi Ibrahim, prof.

KUMTESA

Dr. Ermira Qosja & Floriand Beshku: INOVACIONI DHE SIPËRMARRJA, VËSHTIRËSI DHE SFIDA NË SHQIPËRI

Hyrje

Sipërmarrjet sot kudo në botë ndodhen përballë sfidave të shumta. Ruajtja e avantazheve konkurruese për një kohë relativisht të gjatë prej tyre është bërë gjithnjë e më e vështirë, mungesa e burimeve dhe globalizimi, zhvillimi i shpejtë i teknologjisë në përgjithësi dhe i teknologjisë së informacionit në veçanti, ka transformuar tërësisht qasjet menaxhuese të bizneseve dhe për më tepër i ka dhënë përparësi menaxhimit të ndryshimit, risive dhe inovacionit. Në këtë punim jemi përpjekur që duke analizuar trendet evropiane në inovacion, si dhe duke shfrytëzuar burime zyrtare të Shqipërisë si dhe një sërë raportesh të agjensive prestigjioze të paraqesim vështirësitë dhe sfidat e sipërmarrjes shqiptare në këtë drejtim.

I. Përkufizimi i inovacionit dhe indeksi i matjes së tij

Inovacioni sipas Schumpeter (Fagerberg, Mowery, Nelson, 2005) është një nga faktorët kyç për mbijetesën e organizatave në periudhën afatgjatë. Sipas tij inovacioni mund të klasifikohet në pesë tipe: futja e një produkti të ri, futja e një mënyre të re prodhimi në industri, hapja e një tregu të ri, përdorimi i burimeve të reja në proceset e prodhimit dhe ndryshimi në organizimin e sipërmarrjeve apo dhe vetë industrive. Për inovacionin gjenden një numër i madh përkufizimesh, që kanë mjaft pika të përbashkta, por që nga viti 2005 në Manualin e Oslos (OECD, 2005), është standartizuar përkufizimi i inovacionit si në vijim: *Një inovacion është zhvillimi i një produkti apo shërbimi të ri, i një metode të re prodhimi, një përmirësim i ndjeshëm i një metode të re marketingu,*




Fig.1. Indeksi i inovacionit (Komisioni Evropian, 2012).

një metode të re organizative në praktikat e biznesit, organizimi i vendit të punës apo dhe i marrëdhënieve me jashtë". Gjithashtu në Manualin e Oslos propozohet një klasifikim i përshkallëzuar i risive në inovacion, të cilat mund të jenë: risi për kompaninë, risi për tregun apo risi për të gjithë botën. Inovacioni sot shikohet në dimensione më të gjera, ai lind i nxitur prej mjedisit të jashtëm, zhvillohet brenda sipërmarrjes dhe jep efektin e tij në të gjithë ekonominë dhe mirëqënien e vendit. Në publikimin e fundit të Komisionit Europian në lidhje me inovacionin "Innovation Union Scoreboard" (shkurt 2012), inovacioni është analizuar gjatë dhe është matur përmes një indeksi, që përcaktohet nga tre indikatorë kryesorë që përfshijnë tetë dimensione të inovacionit, ku këta të fundit përbëhen nga nën-indikatorë të tjerë (fig.1).

1. **Mundësuesit** – janë nxitësit kryesorë të performancës në inovacion, zhvillohen jashtë sipërmarrjeve dhe ndahen në tre dimensione të cilat janë: *burimet njerëzore*, nënkuptuar si dimensiononi që vlerëson aftësitë dhe nivelin e forcës punëtore; *sistemet e kërkimit*, nënkuptuar si dimensiononi që vlerëson nivelin e punës shkencore dhe *mbështetja financiare*, nënkuptuar si dimensiononi që vlerëson mbështetjen e qeverisë në kërkime dhe aktivitete innovative.

2. **Aktiviteti i organizatës** – vlerëson përpjekjet e vetë sipërmarrjeve për të zhvilluar inovacionin dhe përmban tre dimensione: *investimet e firmës*, nënkuptuar si dimensiononi që i referohet investimeve në R&D (kërkim-zhvillim) dhe jo vetëm, që sipërmarrja kryen për të gjeneruar inovacionin; *bashkëpunime*, nënkuptuar si dimensiononi që vlerëson përpjekjet për bashkëpunim mes firmave të ndryshme apo me sektorin publik dhe *asete intelektuale*, nënkuptuar si dimensiononi që mat format e ndryshme të së drejtës së pronësisë intelektuale të gjeneruara prej procesit të inovacionit.

3. **Output-_i** – mat efektet e aktivitetit të inovacionit të sipërmarrjeve duke e parë në dy dimensione: *inovatorët*, vlerëson numrin e sipërmarrjeve që kanë futur inovacione në treg apo në organizatën e tyre dhe *efektet ekonomike*, nënkuptuar si dimensiononi që vlerëson suksesin ekonomik të inovacionit në punësim, eksport dhe shitje si pasojë e aktivitetit të inovacionit.

Kur mundësuesit janë aktivë (niveli i arsimimit i lartë, botimet shkencore dhe numri i studentëve të diplomuar jashtë i lartë apo në rritje, mbështetje financiare nga ana e qeverisë) krijohen kushtet e përshtashme që çojnë në zhvillimin e inovacionit brenda sipërmarrjeve. Më pas janë vetë sipërmarrjet që gjenerojnë inovacionin nëpërmjet shpenzime për R&D dhe jo R&D, bashkëpunime në sektorin publik dhe me sipërmarrje të tjera, si dhe mbrojtja me patenta. Më tej vijnë rezultatet (output-_i) që pasqyrohen fillimisht në rritjen e numrit të sipërmarrjeve që fusin produkte, shërbime, strukturë dhe marketing inovativ dhe së dyti në aspektin ekonomik duke rritur punësimin e punëtorëve të dijes, eksportuar produkte të teknologjisë së mesme dhe të lartë, eksportuar shërbime të dijes dhe duke rritur të ardhurat si pasojë e nxjerrjes jashtë (shitjes) të licencave dhe teknologjive inovative.

II. Performanca në inovacion e vendeve europiane

Bazuar në indeksin kompleks të inovacionit, është vlerësuar për vendet e BE-së dhe 7 vende të tjera, performanca në inovacion, (fig.2) dhe është bërë klasifikimi i tyre në 4 grupe: *inovatorët lider*, *inovatorët ndjekës*, *inovatorët e moderuar* dhe *inovatorët modestë* (KE, 2012; fq.4)





Fig.2. Performanca në inovacion

Vendet lider në inovacion (fig. 3) (Komisioni Europian, 2012; fq3) kanë një shpërndarje të drejtë dhe të gjerë të tetë dimensioneve kryesore, dmth kanë pikë të fortë kërkimin shkencor kombëtar dhe sistemet e inovacionit me një rol të rëndësishëm në aktivitetin e biznesit dhe një bashkëpunim shumë të mirë privat-publik; shumë prej tyre performojnë shumë mirë në indikatorët që lidhen me aktivitetin e firmave; gjithashtu të gjitha këto vende karakterizohen nga komercializimi i njohurive teknologjike, që demonstron nga treguesit e licencës dhe të ardhurat nga jashtë prej licencave. Vendet me shkallë më të ulët inovacioni, kanë raport të pabalancuar në tetë dimensionet psh. inovatorët modestë kanë një zhvillim mesatar të burimeve njëzëzore, por janë mbrapa në sistemet e kërkimit apo bashkëpunime.

Fig.3. Grupet e shteteve: Performanca e inovacionit sipas dimensioneve.

III. Inovacioni në Shqipëri, vështirësi dhe sfida

Inovacioni i sipërmarjeve është një dukuri që zyrtarisht ka filluar të trajtohet vonë në Shqipëri. Në raportin e Komisionit Europian mbi inovacionin Shqipëria mungon, si në pasqyrat që i referohen vendeve europiane ashtu edhe tek ato që nuk janë pjesë e BE-së si: Maqedonia, Serbia, Turqia etj, për shkak të mungesës së të dhënave në këtë drejtim dhe për më tepër dhe kur këto të dhëna ekzistojnë, ato nuk janë grumbulluar sipas standarteve ndërkombëtare (OECD, Eurostat apo UNESCO). I vetmi raport që i jep mundësinë Shqipërisë të krahasohet me shtetet e tjera në inovacion është “Global Competitiveness Report”, por në këtë raport indikatorët e marrë parasysh janë vetëm pesë krahasuar me 27 të



“Innovation Union Scoreboard”.

Aktualisht, referuar “Global Competitiveness Report”, Shqipëria ka përmirësuar konkurueshmërinë ekonomike të saj duke avancuar nga vendi i 96-të në vitin 2010, në të 78-in në 2012, nga 142 vende të marra në shqyrtim; si dhe ka përmirësuar klimën ndaj biznesit dhe lehtësuar procedurat e hapjes së tyre, sipas raportit të Bankës Botërore “Doing Business” renditja për Shqipërinë ka lëvizur nga vendi i 136 në 2008, në të 82-in në 2012, nga 183 vende. Nëse sot në Shqipëri është më lehtë krahasuar me katër vite më parë për të hapur biznes ato sërish vazhdojnë të performojnë dobët në inovacion, për shkak dhe të strukturës sektoriale të bizneseve, veçanrisht të SME ku rreth 70% e tyre (INSTAT 2011) i përkasin tregtisë dhe shërbimeve të tilla si hoteleri, kafe e restorante si dhe bizneseve në fundin e zinxhirit të prodhimit (façon). Struktura e eksporteve është gjithashtu tregues i inovacionit të dobët, sepse sipas Bankës së Shqipërisë, ajo është e tillë që në masën 85% mbizotërohet nga industritë e bazuara intensivisht në burimet natyrore dhe punën e pakualifikuar (minerale, produkte agro – ushqimore, veshmbathje, lëkurë, këpucë, etj), por dhe me disavantazhin e produktivitetit më të ulët në Ballkanin perëndimor.

Varësia e plotë nga teknologjia e huaj që hyn në Shqipëri përmes IHD dhe struktura e importit ku zëri makineri dhe pajisje është i dyti, e rendisin të 42/142 vendeve (Global Competitiveness Report) që duhet parë si një avantazh për inovacionin. Por, kapaciteti teknologjik i bizneseve shqiptare për të avancuar brenda tyre në teknologji është shumë i ulët, numri i patentave është më i ulët se në të gjitha vendet e rajonit (në vitin 2005 ka patur vetëm pesë aplikime për patentë kombëtare). Teknologjia e informacionit ka rritje të shpejtë tek individët dhe familjarët, por për bizneset mbeten prapa në nivel rajonal, sipas INSTAT në vitin 2011, 23 % e SME-ve përdorin kompjuterin në biznes, 16% e tyre përdorin internetin dhe vetëm 5 % e përdorin për shit-blerje.

Buxheti vjetor për R&D është rreth 0.37 % e GDP-së në 2012, më i ulët nga të gjitha vendet e tjera europiane, për më tepër kapaciteti e kompetenca e limituar për të menaxhuar kërkimin bazë dhe të aplikuar, bëjnë që të jemi shumë larg standardeve europiane, e për rrjedhojë kjo vështirëson kooperimin dhe pjesëmarrjen në programet evropiane dhe ndërkombëtare dhe disavantazhon inovacionin. Shqipëria gjithashtu mbetet akoma mbrapa vendeve të tjera europiane në stabilizimin e politikave proaktive për të suportuar ngritjen e kapaciteteve për ndërmarrjet, veçanrisht SME-ve.

Përballë sfidave të zhvillimit ekonomik, por dhe atyre të integritit, qeveria shqiptare ka ndërmarrë hartimin e një sërë strategjish që në thelbin e tyre synojnë krijimin e “mundësuesve” aktivë, si më poshtë vijon :

A. Burime njerëzore dhe sisteme kërkimi

Liberalizimi i Arsimit të Lartë, ka bërë që aktualisht, në vend të ketë 13 Institucione Publike të Arsimit të Lartë dhe 46 Institucione Private të Arsimit të Lartë, për rrjedhojë numri i studentëve nga viti akademik 2006-2007, në vitin 2010 – 2011, në të tre ciklet e studimit bachelor, master dhe doktoraturë është rritur 56 % (nga 86.178 në 134.877 studentë) dhe për të njëjtën periudhë, po me 56 % është rritur dhe trupa akademike (INSTAT dhe MASH, 2012).

Programi “Brain Gain”, një inisiativë e UNDP me Qeverinë shqiptare, që shënon si datën e nisjes shtatorin e 2006, ka bërë të mundur kthimin e shkencëtarëve dhe të diplomuarve ekselentë nga universitetet më të mira botës. Të dhënat tregojnë për punësimin e 78 personave në sektorin publik dhe privat. Gjithashtu, “Fondi i ekselencës” i mbështetur në një vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave të vitit 2007, përcaktonte përdorimin

fillimisht të 100 milionë lekë /vit dhe më pas 200 milionë lekë (50 % e fondit për bursa studimi për studentët e shkëlqyer që fitojnë të drejtën e studimit në një nga 15 universitetet më të mira të botës dhe 50 % për incentivimin e kërkimit shkencor nga shkencëtarët shqiptarë. Për vitet 2008 – 2011, janë akorduar 63 bursa studimi për bachelor, master dhe doktoraturë.

Reformimi i Akademisë së Shkencave dhe i instituteve të kërkimit shkencor, duke i organizuar në përputhje me vendet evropiane ku arsimiti i lartë dhe kërkimi shkencor integrohen së bashku dhe në këtë kuadër krijimi i disa agjensive dhe qendrave të transferimit të teknologjisë, është një reformë tjetër me kah inovacionin

B. Mbështetje financiare dhe hartimi i strategjisë së inovacionit dhe teknologjisë së biznesit

Strategjia kombëtare e inovacionit 2011 – 2015, ka si objektivi rritjen e buxhetit të R&D në nivel kombëtar në 2015 në 0.6 % të GDP-së, duke krijuar *fondin e inovacionit*; që synon t'u ofrojë kompanive mbështetje të drejtpërdrejtë, në rritjen e kapacitetit dhe përmirësimin e produktivitetit. Gjithashtu, do të ofrohen *shërbime mbështetëse* të inovacionit të biznesit që synojnë përmirësimin e kulturës dhe të aftësive të tyre menaxhim dhe teknologji si dhe do të realizohet *zhvillimi i infrastrukturës së biznesit* që synon ngritjen e strukturës që do të mbështesë shfaqjen e kompanive të reja inovative. Ndërkohë, projektet e cluster-ave synojnë ndërveprim dhe bashkëpunim ndërmjet sektorëve të biznesit, universiteteve dhe shoqatave të biznesit për nxitjen e zhvillimit dhe punësimit

IV. Konkluzione dhe rekomandime

Shqipëria, tashmë ka ndërtuar strukturën ligjore dhe institucionale, si dhe ka bërë reformat e duhura në mbështetje të inovacionit.

Reformat në arsim, përfshirë strategjinë e arsimit të lartë e kërkimit shkencor, mbështesin inovacionin në dy drejtime: së pari, për zhvillimin e R&D në nivel kombëtar (jashtë bizneseve) dhe së dyti, u ofrojnë bizneseve njerëz me kualifikim të lartë;

Struktura e biznesit shqiptar, ku 99.8% janë SME nuk është kufizim për inovacionin.

Sipërmarrjet, qoftë të mëdha apo SME, duhet të orientohen në afatgjatë në aktivitete inovative;

Sipërmarrjet, duhet të shfrytëzojnë të gjitha programet e qeverisë dhe të BE (cluster-at dhe inkubacionit të bizneseve), si dhe heqjen e TVSH për importet e makinerive të teknologjisë së lartë për t'u orientuar drejt aktiviteteve inovative

Sipërmarrjet duhet të ndryshojnë kulturën brenda tyre, duke synuar zhvillimin dhe trajnimin e fuqisë punëtore, strukturat fleksibile dhe mentalitetin e hapur. Gjithashtu, duhet të krijojnë buxhetet R&D brenda organizatave, sepse strategjitë dhe mundësitë japin efekt në se bizneset reflektojnë brenda tyre.

*Recensentë:
Dr. Edlira Gjuraj (Tukaj)
Prof. Dr. Luçjeta Minxhozi*

KUMTESA

Hazbije SAHITI, Linda GRAPCI-KOTORI, Agim GASHI, Kemajl BISLIMI, Fetah HALILI¹: DIZAJNIMI I BIOREKATORIT PËR PRODHIM KONTINUAL BIOLOGJIK TË HIDROGJENIT

¹Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore

Abstrakti

Prodhimi biologjik i hidrogjenit, si një burim alternativ i energjisë është bërë objekt i hulumtimit të shumë hulumtuesve. Në lidhje me këtë, punimi aktual ka të bëjë me dizajnimin e një bioraktori me përmasa të mëdha laboratorike (25 l) për prodhim kontinual të hidrogjenit nëpërmjet procesit të fermentimit. Si kulturë bakteriale është përdorur lym i fundërruar që përdoret për fermentim të metanit nga pajisjet për pastrimin e ujërave të zeza urbane, ndërkaq si substrat është përdorur një medium minimal sintetik.

Parametrat të cilët janë matur gjatë punës hulumtuese janë: sasia e gazit, sasia e hidrogjenit. Eksperimenti ka zgjatur për 12 ditë me radhë pa ndërprerje. Prodhimi i gazit ka filluar pas 48 ore të kultivimit të mikroorganizmave, pas tri ditësh janë prodhuar 400 ml gaz dhe nga kjo sasi hidrogjeni ka participuar në vëllim prej 2.5%. Në ditën e 12 të eksperimentit prodhimi i gazit është ndërprerë prandaj është ndërprerë edhe puna e bioreaktorit.

Bazuar në rezultatet e këtij hulumtimi, mund të konkludohet se prodhimi kontinual i biologjik i hidrogjenit përmes procesit të fermentimit është i mundur edhe në pajisje laboratorike me përmasa të mëdha.

Fjalët kyçe : Hidrogjeni, pajisje kontinuale, kulture bakteriale

Hyrje

Hulumtimi është bërë në institutin e Mekanikës së Fluideve në kuadër të Universitetit Friedrich Alexander në Nurnberg të Gjermanisë.

Hulumtimi është një përpjekje drejt industrializimit të procesit për prodhim biologjik të hidrogjenit. Popullariteti i hidrogjenit si burim i energjisë ka rezultuar si pasojë e krizës energjetike gjatë viteve 1970. Në atë kohë është menduar se hidrogjeni do të jetë burim energjetik i së ardhmes, por me rënien e çmimit të naftës bie edhe interesimi për hidrogjenin (Benemann J. 1996).

Me ngritjen e nivelit të CO₂ në atmosferë të shkaktuar me djegien e bartësve fosil të energjisë, përsëri gjatë viteve '90 riaktualizohet interesimi për përdorim të hidrogjenit si lëndë djegëse (Smith G.D., 1992).

Prodhimi biologjik i hidrogjenit si një proces i përshtatshëm për ambientin ka tërhequr vëmendjen e shumë hulumtuesve. Hidrogjeni mund të prodhohet me ndihmën e mikroorganizmave të ndryshëm dhe përmes proceseve të ndryshme; qoftë përmes proceseve të varur nga drita (fotoproceseve) apo edhe nga proceset fermentative.

Proceset e fermentimit janë më të përshtatshme për prodhim industrial të hidrogjenit për disa arsye:

- Është e mundur të prodhohet ditë dhe natë pa ndriçim

KUMTESA

- Produktet e fotosintezës mund të shfrytëzohen si substrat
- Si substrate mund të përdoren mbeturinat e ndryshme industriale dhe ato të agrikulturës (Tanisho S. 1987).

Prodhimi i hidrogjenit me rrugë fermentative me llojin *Enterobacter aerogenes* E 82005 është hulumtuar nga Tanisho dhe bashkëpunëtorët dhe rezultatet kanë treguar se sasia e hidrogjenit e prodhuar ka qenë 1 mol H₂ për 1 mol të glukozës (Tanisho S. 1987)

Ndërkaq Blackwood raportoi për sasinë e hidrogjenit prej 0.72 mol H₂ për molekulë të konvertimit të glukozës nga lloje të ndryshme të *E. Colit*.

Duke pasur parasysh këto fakte, qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë që të konstruktohet një pajisje për prodhim biologjik kontinual të hidrogjenit me anë të proceseve të fermentimit.

Materiali dhe metodat

Si kulturë bakteriale për prodhim të hidrogjenit është shfrytëzuar lym i fundërruar për fermentim të metanit, i marrë nga pajisjet për pastrimin e ujërave të zeza urbane në Erlangen.

Për inokulum është marre 4% e vëllimit të gjithëmbarsëm të bioreaktorit. Menjëherë pasi që është marre kultura bakteriale është bërë kultivimi i tyre në bioreaktor i cili paraprakisht është mbushur me substrat ushqyes (24 l).

Kultivimi i mikroorganizmave ka zgjatur 48 orë, 15 orët e para është bërë ajrosja e biomasës në reaktor, ndërkaq gjatë kohës së kultivimit vlera e pH ka qenë 7.

Ajrosja e biomasës është bërë me qëllim të shkatërrimit të baktereve metanogjike të cilat janë të ndjeshme ndaj prezencës së oksigjenit.

Pas përfundimit të kultivimit të mikroorganizmave është lëshuar në funksion pompa peristaltike që ka vënë në lëvizje substratin ushqyes nga rezervari në drejtim të reaktorit.

Si substrat është përdorur një medium minimal sintetik me përbërje si në tabelën e dhënë.

| Lloji i substancës kimike | Sasia |
|---------------------------------------|----------------|
| Glukoze | 5 gr / l |
| K ₂ HPO ₄ | 7 gr / l |
| KH ₂ PO ₄ | 5 gr / l |
| NaCl | 2.5 gr / l |
| MgSO ₄ * 7H ₂ O | 1 gr / l |
| FeSO ₄ | 0.0022 gr / l |
| CuSO ₄ | 0.00044 gr / l |
| MnSO ₄ | 0.0014 gr / l |

Meqenëse gjatë zbërthimit të glukozës nga ana e baktereve vjen deri te krijimi i acideve organike të cilat do të mund të ndikojnë në ndërrimin e shpejtë të vlerave të pH, atëherë për ti amortizuar këto ndërrime është dashur që në medium të shtohet edhe një sasi e buferëve.

Provat janë bërë në pH 6 dhe temperaturë 45 – 50 °C. Sasia e gazit të prodhuar gjatë eksperimentit është matur duke bërë grumbullimin e tij në të ashtuquajtur gazometër, ndërsa sasia e hidrogjenit në përzjerje të gazit të prodhuar është matur me ndihmën e cilindrave të

qelqit të mbushur me indikator, me të cilët sasia e hidrogjenit është lexuar në përqindje.

Dizajnimi i pajisjes kontinuele për prodhim biologjik të hidrogjenit

Një nga detyrat e para të hulumtimit ka qenë dizajnimi dhe vënia në funksion e pajisjes kontinuele për prodhim biologjik të hidrogjenit (fig. 1).




Fig. 1 Skema e paisjes për prodhimin kontinual të hidrogjenit

1-Bioreaktori, 2-Izolimi termik, 3-Nxemesi elektrik, 4-Pompa recikluese, 5-Matesi i sasise se lengut, 6-pH Matesi, 7-Elektroda per detektimin e pH, 8-Baloni per mbledhjen e gazit, 9-Vendi per mbushjen e reaktorit, 10-Rezervoari me medium, 11-Pompa peristaltike, 12-Rezervoari per hudhjen e mediumit te shfrytëzuar, 13-Vendi per zbrazjen e reaktorit, 14-Ena me solucion te NaOH, 15-Pompa dozuese

Ekzistojnë disa tipe të kulturave kontinuele, por aplikim më të gjerë në industri ka kultura kontinuele e tipit hemostat që është përdorur edhe me rastin e hulumtimit tonë. Gjatë dizajnit, madhësia e bioreaktorit ka diktuar përzgjedhjen e pjesëve përcjellëse të pajisjes në përgjithësi. Vëllimi i reaktorit në hulumtimin tonë ka qenë 25 l, dhe ka qenë i ndërtuar nga çeliku i fisnikëruar.

Rezervari i ushqimit mund të jetë nga plastika ose ndonjë material tjetër jokorrodues, por që vëllimi i tij nuk duhet të tejkaloj shumë herë vëllimin e reaktorit, sepse gjatë operimit disa ditësh mund të bëhet kontaminimi me bakte të tjera që gjenden në ambientin për rreth, gjë që do të shkaktoje shpenzimin e materieve ushqyese pa hyrë brenda në reaktor.

Në rezervar të ushqimit është paraparë vendi për dalje të ushqimit në të cilën vendoset gypi i cili përmes pompës do ta dërgoj ushqimin në bioreaktor. Gypat të cilët e përcjellin ushqimin nga rezervari në reaktor preferohet të jenë gypa të silikonit sepse kanë një rezistencë të mirë kimike.

Vëllimi i lëngut në reaktor duhet të jetë konstant, dhe kjo është rregulluar me rënie të lirë përmes një dalje anash në pjesën e sipërme të reaktorit. Për kontrollin e kushteve që mbizotërojnë në brendi të reaktorit janë vendosur një pH-metër dhe termometri. Për të penguar fundërrimin e biomasës është përdorur një pompë recikluese, që ka vene në lëvizje biomasën brenda reaktorit. Për të mirëmbajtur vlerat e pH, pajisjes i është shtuar një enë e mbushur me NaOH e cila ka pasur një pompë dozuese që ka vënë në lëvizje solucionin në momente të caktuara.

Rezultatet e hulumtimit

Duhet theksuar se pajisja për prodhim biologjik të hidrogjenit ka operuar për më se 280 orë. Rezultatet e këtij hulumtimi janë dhënë në forme të grafikoneve në figurat 2 dhe 3.




Fig. 2 Sasia e gazit e prodhuar në varësi nga koha




Fig. 3 Sasia e hidrogjenit të prodhuar në varësi nga koha

Siç shihet nga figura 2 prodhimi i gazit ka filluar pas 48 orëve dhe prodhim maksimal është arritur pas 96 orëve, prodhimi i gazit ka përfunduar pas 280 orëve me çka është ndërprerë puna e bioreaktorit. Në këtë përzieje të gazit të prodhuar ka pasur edhe hidrogjen, dhe ai ka participuar në sasi të vogël me rrethë 2- 3% . Në figurën 3 është dhënë sasia e hidrogjenit e shprehur në mililitra, dhe nga figura shihet se prodhimi maksimal i hidrogjenit është arritur pas 160 orëve, prodhimi është ndërprerë pas 280 orëve.

Në figurën 4 është dhënë varshmëria e prodhimit të hidrogjenit ndaj vlerave të pH. Nga figura shihet se sasi të më të larta të prodhimit të hidrogjenit janë arritur në vlera 5.72 dhe 6.05 të pH.




Fig. 4 Varshmëria ndërmjet vlerave të pH dhe sasisë së prodhuar të hidrogjenit

Diskutimi

Një nga aspektet më të komplikuar dhe më të rëndësishme të bioteknologjisë dhe mikrobiologjisë industriale është transferimi i procesit nga pajisjet me përmasa të vogla laboratorike në pajisje komerciale me përmasa të mëdha e cila procedurë quhet proces i ngritjes. Kjo ka rëndësi sepse rrallë ndodh që proceset mikrobiale të zhvillohen njësoj në fermentor të mëdhenj sikurse që zhvillohen në pajisje të vogla laboratorike. Procedura e transferimit të një procesi nga fermentori laboratorik në fermentor komercial kalon nëpër këto etapa :

1. Etapa e parë – përfshin eksperimentet të cilat japin indikacionet e para se procesi me interes komercial është i mundshëm. Eksperimentet realizohen në enë të vogla laboratorike.
2. Etapa e dytë – eksperimentet realizohen në fermentor me madhësi prej 5 deri në 10 litra, në të cilin rast bëhen përpjekjet e para të procesit të ngritjes.
3. Etapa e tretë – hulumtimet bëhen në fermentor të mëdhenj (300 deri 3000 l) të ashtuquajtur pilot fermentor. Në këto pajisje kushtet e zhvillimit të procesit pothuajse iu afrohen plotësisht kushteve që ekzistojnë në fermentor komercial.
4. Etapa e katërt – procesi kalon në fermentor komercial me përmasa 10000 deri në 50000 l.

Nga kjo shihet se hulumtimi ynë gjendet në mes të etapës së dyte dhe të trete. Gjatë hulumtimit tonë janë bërë eksperimentet e para me të cilat është vërtetuar mundësia e prodhimit biologjik të hidrogjenit në reaktor me përmasa të mëdha, në mënyrë që në të ardhmen procesi i prodhimit biologjik të hidrogjenit të mund të komercializohet.

Procesi i prodhimit të hidrogjenit është shumë kompleks dhe varet prej shumë faktorëve, një prej tyre është edhe vlera e pH. Shikuar nga ky aspekt rezultatet tona përputhen me rezultatet e Kumar N. dhe Das D. (1999). Autorët në fjalë konstatuan se prodhimi maksimal i hidrogjenit është arritur në vlerat e pH 6, kjo tregon se kushtet acidike janë të favorshme për prodhim të hidrogjenit. Prodhimin e hidrogjenit në kushte të kontrolluara të vlerave të pH e kanë hulumtuar edhe Tanisho S. , Suzuki Y. dhe Wakao N.(1980), të cilët konstatuan se

vlerë e përshtatshme për kultivim të mikroorganizmave është pH 7, kurse hidrogjeni është prodhuar në pH 5.

Përzgjedhja e kulturës bakteriale është po ashtu e rëndësishme për prodhim biologjik të hidrogjenit. Prodhimtaria e hidrogjenit nga ujërat e zeza të fabrikës së sheqerit nga ana e mikroflorës anaerobe në kulture kontinuale të tipit hemostat është hulumtuar nga ana e Ueno Y. , Otosuka S. dhe Morimoto M. (1996). Rezultatet e hulumtimit treguan se hidrogjeni mund të prodhohet nga kultura e përzier bakteriale e ujërave të zeza, kulturë e tillë bakteriale është përdorur edhe në hulumtimin tonë.

Përfundimet

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte që të vërtetohet mundësia e prodhimit biologjik të hidrogjenit në kulturë kontinuale, me përmasa të mëdha laboratorike duke përdorur si substrat glukozën në përqindje të vogël kurse për inokulum përzierjen bakteriale të paidentifikuar. Në bazë të rezultateve të fituara të këtij hulumtimi mund të përfundojmë si vijon:

- hidrogjeni mund të prodhohet në mënyre kontinuale për disa ditë me radhë në fermentor me vëllim të madh.
- Është konstatuar se lymi i pajisjeve për pastrimin e ujërave të zeza mund të shfrytëzohet si kulturë bakteriale pas ajrosjes disa orëshe.
- Si medium për procese të fermentimit mund të shfrytëzohen materiet organike siç janë karbohidratet, edhe atë në përqindje të vogël.
- Është konstatuar se vlerat e pH 5,5 – 6 janë vlera optimale për prodhim të hidrogjenit.

Që ky proces të komercializohet, dhe që procesi të gjej zbatim edhe në praktik, duhet që në të ardhmen puna të fokusohet në optimizimin e parametrave që ndikojnë në prodhimin e hidrogjenit.

*Recensentë:
Prof. Dr. Idriz Vehapi
Prof. Dr. Selim Jusufi*

Muhamet AVDYLI, Prof. Asoc. dr. Tamara LUARASI: NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI PËRDORIMIN E TEKNOLOGJIVE TË GPS DHE TË SENSORËVE NË MENAXHIMIN E NJË BIZNESI TRANSPORTI

Përmbledhje:

Artikulli do të ketë një karakter përshkrues të qëllimit, metodologjisë, si dhe të teknologjive që do të përdoren në një studim në nivel doktore. Studimi do të marrë përsipër përdorimin e teknologjive moderne në krijimin e një sistemi menaxhues të aktivitetit të një biznesi transporti në lidhje me përdorimin e automjeteve të tij. Esenca e studimit është krijimi i një sistemi informacioni rreth një grupi automjeteve dhe përdorimi i tij për kontrollin, planifikimin, dhe rritjen e efikasitetit të përdorimit të tyre. Ky sistem informacioni mundësohet nga sistemet satelitore ekzistues GPS, bashkëpunimi i tyre me sensorë të vendosur në automjet dhe shfrytëzimi i këtij informacioni me metoda bashkëkohore programimi.

Hyrje

Sistemi i Pozicionimit Global (GPS) është një sistem i bazuar në përshkrimin satelitor të hapësirës që siguron informacione të ndryshme që mund të përdoren sipas interesave specifike të bizneseve ose institucioneve të ndryshme. Informacionet e marra nga GPS me ndihmën e marrësve specialë bëhet e mundur me teknologjitë moderne hardware dhe software të rezervohen në Servera të caktuar ku këto informacione do të përpunohen dhe përdoren për qëllimet konkrete të studimit. Teknologjia nga pikëpamja e hardware-it përfshin marrësin GPS, sensorë të ndryshëm që vendosen në automjete me konfigurime specifike të tyre për të mbledhur atë lloj informacioni për të cilin jemi të interesuar si dhe paisje të tjera që do të bëjnë të mundur transmetimin e këtij informacioni në një Server. Nga ana tjetër ky transmetim kërkon ndërhyrjen e një software-i që do të realizonte komunikimin e Serverit me paisje të tilla si marrësi GPS dhe sensorët si dhe interpretimin e informacionit që do të kalonte nga sensori në një bazë të dhënash në Server. Në rastin konkret të këtij studimi, gjithë kjo teknologji do të përdorej për një menaxhim më të mirë të aktivitetit të transportit nga pikëpamja e përdorimit më me efikasitet të automjeteve, duke e lidhur këtë efikasitet me përdorimin e rrugës më të përshtatshme (nga pikëpamja e kostos), shfrytëzimit racional të kohës së punës dhe elementëve të tjerë që të gjithë bashkë do të ngrinin rendimentin dhe efikasitetin të një biznesi transporti.

-Shtrimi i Problemit: Studimi merr shtypë nga një situatë e zakonshme dhe që është

KUMTESA

menaxhimi jo i mirë e me metoda tashmë të vjetëruara të bizneseve të transportit. Mangësitë mund të përmblihen në mungesë menaxhimi të: Orëve të punës të automjetit, shpenzimet e lëvizjeve të automjetit, shpenzimet e derivative, shpenzimet e sigurimeve të automjetit, shpenzimet e komunikimit me drejtuesin e automjetit. Është e kuptueshme që pasja në dorë e një informacioni që azhurnohet në çdo moment rreth automjetit do të rriste kontrollin, efikasitetin e punës, sigurinë e automjetit dhe vënjen e tij në kushte komunikimi të vazhdueshëm me drejtuesit e aktivitetit. Përdorimi i teknologjive moderne si në aspektin e hardware-it dhe atë të software-it do ta bënin të mundur një gjë tillë.

Do të konsideronim burim referimi për këtë studim eksperiencia të ngjajshme në fusha të ndryshme që përdorin sistemin e pozicionimit global (GPS). Zbatimi i GPS po përhapet edhe në pajisje si telefonia mobile dhe rrjedhimisht njohja e vet sistemit dhe pajisjeve që përdor ky sistem është parësor për të ardhmen. Ka shumë lloje pajisjesh që luajnë rolin e sensorëve, software-sh që realizojnë komunikimin në rrjeta të tipeve të ndryshme duke përfshirë wireless-ët.

-Si punon sistemi satelitor GPS në bashkëpunim me marrësin

Sistemi i Pozicionimit Global (GPS) është një konstelacion i përbërë nga 27 satelitë, 24 në përdorim dhe 3 në gatishmëri, i vendosur në orbitë në distancë afro 20020 km mbi sipërfaqen e tokës, nga 4 satelite në secilën prej 6 orbitave, ku këndi i inklinacionit (pjerhtësia orbitale) në mes të këtyre rrafshëve është 55 shkallë fig1.

Satelitët lëvizin në trajektoren e tyre me shpejtësi 11,000 km/h. Furnizimi kryesor apo primar elektrik është me energji diellore por në rast të eklipseve (zënies së diellit) ata mund të përdorin bateritë e brendshme.

Të 24 satelitët aktivë në orbitë rrotullohen rreth Tokës dy here brenda 24 orëve, duke përmbushur kështu një cikël të plotë.




fig.1

Koordinatat e GPS bazohen në Sistemin Gjeodezik Botëror të vitit 1984 që përbëhet nga vijat në gjerësi dhe gjatësi gjeometrike.(GPS Basic Jean-Mariu Zoog 2002)

Për të caktuar pozicionin në tokë (dy dimensional) nevojiten që së paku tre satelitë të shikojnë në objektin e caktuar statik apo mobil dhe për pozicionin tre dimensional nevojiten së paku 4 satelitë të diktojnë objektin.


Se pari duhet thënë që nëpërmjet sistemit GPS dhe marrësit GPS mund të përcaktohet distanca nga sateliti në një marrës GPS. Largësia në mes të satelitit dhe marrësit llogaritet në bazë të kohës së kaluar prej momentit të dërgimit të sinjalit nga satelitët deri në momentin e pranimit të sinjalit nga marrësi. Pra, këto llogaritje bëhen duke aplikuar apo përdorur dy orë, njera në satelit dhe tjetra në marrës (antenë)të GPS-it.

Në kohë të caktuar sateliti fillon të transmetojë një sinjal të gjatë digjital të quajtur pseudo kodi.

Aparati marrës në anën tjetër në të njëjtën kohë fillon me transmetimin e kodit të njëjtë. Për të arritur në satelit, ai do të vonohet për një kohë të caktuar. Zgjatja e kësaj vonese është kohëzgjatja e udhëtimit të sinjalit nga i cili mund të matet distanca. Mbase dihet shpejtësia e dritës mund të matim distancën me saktësi të madhe. Kushti që kjo të bëhet si duhet është që orët në marrësin GPS dhe satelitë të jenë të sinkronizuara. Satelitët janë të pajisur me orë atomike ndërsa marrësit me orë kuartz të cilët rregullohen (kolaudohen) periodikisht, mbasi dihet që ora kuartz nuk punon me të njëjtën saktësi si ora atomike.


Për të evituar gabimet në matjen e distancës vazhdimisht kontrollohet ora e marrësit duke e sinkronizuar me orën e satelitëve.

Intervali kohor i nevojshëm që sinjali të arrijë nga sateliti në marrës përcaktohet duke lexuar orën nga sateliti i GPS në momentin e dërgimit të sinjalit dhe orën tjetër në momentin e arrijtes së sinjalit të marrësit GPS fig 2.



Duke shumëzuar këtë interval kohor me shpejtësinë e dritës që është (300.000. km/s) e fitojmë largësinë apo distancën e kërkuar: $L=c \cdot t$

Duke qënë në gjendje të llogarisim distancën e një marrësi GPS nga një satelit dhe duke e patur këtë mundësi për të paktën 4 satelitë bëhet e mundur të gjendet pozicioni i një objekti (tre dimensional). Në fakt janë 4 të panjohura, të cilat janë 3 koordinatat e objektit në sistemin karteziqan fig 3 dhe pasaktësia e llogaritjes së distancave që vjen si rezultat i diferencës në kohë në mes të orës satelitore dhe orës së shfrytëzuesit. Kjo është arsyeja që na duhen 4 satelitë diktues të një objekti për të realizuar një system ekuacionesh me 4 të panjohura dhe 4 ekuacione. Secili nga ekuacionet do të shprehë distancën midis satelitit dhe marrësit GPS. fig.3



-Roli i marresit GPS

Përveç përcaktimit të saktë të pozicionit GPS marrësi përcakton edhe të dhëna të tjera të rëndësishme siç janë: shpejtësia e lëvizjes, drejtimi i lëvizjes, koha reale e lëvizjes, gjatësia e shtegut që duhet të kalohet. Kjo varet nga sensorët që ndodhen në të si dhe konfigurimi i tyre që do të jetë një pjesë e rëndësishme.

-Programimi dhe krijimi i nje ambienti pune për programimin

Një element i rëndësishëm i punës është dërgimi i informacionit nga marrësi GPS në një bazë të dhënash në një server. Nëse marrësi GPS është i diktuar nga satelitët e sistemit satelitor GPS atëherë pozicioni i saktë i një objekti dhe informacionet tjera merren në kohën reale. Përndryshe nëse marrësi GPS nuk i “shikon” satelitët, ndërsa është realizuar lidhja nëpërmes shërbimeve komunikuese atëherë të dhënat në lidhje me pozicionin dhe të dhënat e tjera mund të merren nëpërmes ‘logut’ (kujtesës së brendshme të pajisjes GPS e cila në vartësi nga lloji i pajisjes mund të mbajë mendë deri 12000 km e fundit të rrugës së përshkruar të objektit). Kjo lloj përcjelljeje e informacionit quhet ndryshe edhe përcjellje GPS pasive e objektit i cili është në lëvizje ose ka qënë në lëvizje. Në këtë rast nuk mundemi të kemi transmetim të të dhënave në kohë reale, por antena e cila është vendosur në GPS marrës e ushqen me të dhëna siç janë pozicioni, shpejtësia, etj kujtesën e brendshme (logun) e marrësit GPS që më vonë do të mund të lexohet.

Përcjellja dhe marrja e të dhënave nga GPS marrësi në aspektin lëvizës bëhet në tri mënyra:

- GPS Përcjellja automatike bëhet atëherë kur e kemi të programuar GPS marrësin ashtu që në intervale të caktuara kohore (psh. çdo orë, 4 herë në 24 orë etj) të shpërndaj informacione.
- GPS Përcjellja sipas thirrjes nga një qendër kontrolli apo nga interneti e cila bëhet sipas nevojës dhe kërkesave.
- GPS Përcjellje pasive e cila i mundëson qendrës kontrolluese apo shfrytëzuesit që ndërkohë të marrë të dhëna të ruajtura dhe të kuptojë në bazë të tyre pozicionin, drejtimin, shpejtësinë etj.

Transmetimi i Informacionit nga paisjet e vogla në Server do të kërkonte instalimin e programeve specifike në paisjet e vogla që vendosen në automjete, ekzekutimi i të cilave efektin dërgimin e informacionit të mbledhur në destinacion (Server).

Këto programe fillimisht do të duhej të realizoheshin jashtë paisjeve të vogla e më pas të instaloheshin atje. Mund të punohet fillimisht me një emulator të një paisje të vogël dhe për këtë ndihmohemi nga platforma që u përgjigjen teknologjive të reja të programimit. Një e tillë është platforma ose sistemi Android. Android është një sistem operativ për paisjet e lëvizshme të tilla si smartphone-et dhe kompjuterat tablet. Kjo platformë është zhvilluar nga “Open Handset Alliance” e udhëhequr nga Google. Aplikimet në këtë sistem janë kryesisht në Java e cila ofron klasa të posaçme për programimin në paisjet e vogla. Android është një sistem operativ “open source” bazuar në Linux dhe me mundësi integrimi të fuqishme me baza të dhënash.

Me interes në rastin tonë do të ishte përdorimi i GPS dhe hartat e Google (Google Maps) në Android.

Për komoditetin e punës tonë përdorim Eclipse si IDE dhe sistemi Android do të integrohet në Eclipse. Më poshtë po paraqesim hapat që ndërmarim për të realizuar këtë ambient pune:

- Ngarkojmë Eclipse (në kemi ngarkuar eclipse-jee-helios-SR2-win32-x86_64.zip)
- Ngarkojmë Java JDK në kemi ngarkuar JDK6 Update 6: (<http://java.sun.com/javase/downloads/widget/jdk6.jsp>) Zgjidhni Windows x64

- Ngarkojmë Android SDK (<http://developer.android.com/sdk/index.htm>)
- Ngarkojmë ADT (Android Development Tools: 1) Zgjedhim Windows
- Instalojmë Java SDK: për këtë së pari duhet të kemi instaluar JDK
- Instalojmë Eclipsin.
- Instalojmë Android SDK. Më poshtë paraqiten disa hapa për këtë proces
 - Shqyrtojmë në se kompjuteri plotëson kërkesat që ky system kërkon.
 - Instalohet paketa startuese se mund të jetë njëra prej: [android-sdk_r16-windows.zip](#) dhe [installer_r16-windows.exe](#) (rekomandohet)
 - Instalohen ADT Plugin për Eclipsin, Hapet Eclipsi dhe zgjidhet Help > Install New Software...
 - Klikojmë Add, në skajin lart-djathtas.
 - Në dialogun Add Repository që çfaqet shtypni "ADT Plugin" për Name dhe URL <https://dl-ssl.google.com/android/eclipse/> Location, klikoni OK.
 - Në dialogun Available Software zgjedhim checkbox pas Developer Tools dhe klikojmë Next.
 - Në dritaren që vijon, shohim listen e tool-seve që ngarkohen. Klikojmë Next.
 - Lexojmë dhe pranojmë kërkesën e licenzës, kliko Finish dhe rishikojmë Eclipsin.
- Bëjmë modifikimet e përshtatëshme në PATH-in e sistemit:
 - ... \Program Files (x86)\Android\android-sdk\platform-tools;
 - ... \Program Files (x86)\Android\android-sdk\tools

Konfigurojmë ADT Plugin.

Pasi ADT është ngarkuar në mënyrë të suksesëshme si më sipër, hapi tjetër është modifikimi i preferencave në Eclipse për tu lidhur me direktorinë e Android SDK, Zgjedhim Window > Preferences), zgjedhim Android nga paneli i majtë.

Një aplikim i thjeshtë për të testuar se çdo gjë funksionon:

1. Hapim Eclipsin
2. Zgjedhim File > New > Project.
3. Zgjedhim Android > Android Project, dhe klikojmë Next.
4. Zgjedhim përmbajtjen e projektit:
 - Shtypim një *Emër Projekti*. Ky do të jetë emri i folderit ku projekti krijohet.
 - Nën Contents, zgjedhim Create new project in workspace. Zgjedhim një workspace për projektin.
 - Nën Target, zgjedhim Android target për tu përdorur si një Build Target i projektit. Build Target specifikon se cilën platformë Android duam për të ndërtuar aplikimin.
 - Nën Properties, plotësojmë gjithë fushat e nevojshme.
 - Shtypim një *Emer Aplikimi* të lexueshëm e cila do të afishohet në emulatorin e paisjes Android.
 - Shtypim një *Emer Pakete*. Ku është emri i paketës ku vendoset gjithë kodi i aplikimit.
 - Zgjedhim *Create Activity* që na lejon të fusim një emër për klasën kryesore Activity.
 - Shtypim *Min SDK Version*. Ky është një numer i plotë që paraqet nivelin minimal API të kërkuar për të ekzekutuar në mënyrë të përshtatëshme aplikimin. Duke futur këtë numer automatikisht shtohet atributi [<uses-sdk>](#) në file-in AndroidManifest.
5. Krijojmë një emulator që do tju duhet për ta ekzekutuar aplikimin:
 - Në nivel komande japim komandën: `android list targets` që na nevojitet për të zgjedhur

KUMTESA

paisjen ku do të bëjet ekzekutimi (Deployment Target). Ju do të shihni një liste target-esh të Android psh: Id: 1, Name: Android 1.1, Type: platform, API level: 2, Skins: HVGA (default), HVGA-L, HVGA-P, QVGA-L, QVGA-P
Id: 2, Name: Android 1.5, Type: platform, API level: 3, Skins: HVGA (default), HVGA-L, HVGA-P, QVGA-L, QVGA-P

Gjejmë atë target që përputhet me platformën Android nën të cilën ekzekutojmë aplikimin.

- Krijojmë një emulator paisje duke përdorur targetin e zgjedhur. Ekzekutojmë komandën.
android create avd --name <emri i paisjes suaj> --target <targetID>
- Më pas pyetemi për të krijuar një profile hardware-i të personalizuar, si fillim shtypim return (përgjigja apriori është jo) dhe Paisja AVD është gati.

6. Klikojmë Finish.

7. Ekzekutojmë aplikimin: zgjedhim Run > Run (ose Run > Debug) nga menuja kryesore e Eclipsit. ADT plugin automatikisht krijon një konfigurim të ekzekutimit për projektin.

Konkluzione:

Ky studim pretendon të sjellë rezultate konkrete në këto aspekte të menaxhimit të një kompanie ose biznesi transporti.

- Shpejtësinë e shërbimeve
- Shkallë më të lartë të organizimit të punës
- Sigurinë e bartjes mallrave dhe saktësinë e shpërndarjes
- Disiplinën e punës

Përveç kësaj rezultati i studimit do të ndryshonte metodën e punës së biznesit. Ajo do të udhëhiqej tani nga një desktop kompjuteri, do krijohej një menaxhim modern dhe bashkëkohor. Sigurisht i gjithë procesi do të kërkonte organizimin e një sistemi të tërë kompjuterash, të lidhur në një rrjet dhe ky rrjet do të kishte një ose disa servera ku do të vendosej një bazë të dhënash. Edhe ky aspekt do të përbënte një pjesë të studimit, d.m.th analiza e problemit e kushteve teknike dhe ambientit të punës që ky modernizim do të kërkonte. Pra qëllimi i studimit sjell me vete dhe aspekte të tjera të cilat janë pjesë e kësaj ndërmarjeje dhe në fund të fundit sjellin një progres në mënyrën e menaxhimit dhe punës në një biznes.

*Recensentë:
Prof. asocuar dr. Naim Braha
Dr.sc. Astrit Rexhepi*

Naser SAHITI, Sabit GASHI, Skënder ISUFI: POTENCIALI I KOSOVËS PËR HULUMTIME SHKENCORE DHE ZHVILLIMORE NË FUSHËN E ENERGJISË

Abstrakti

Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike në Kosovë mund të arrihet duke shfrytëzuar në mënyrë racionale kapacitetet ekzistuese gjeneruese si dhe, paralelisht, duke bërë ngritjen e kapaciteteve të reja të bazuar në teknologji moderne. Ngritja e kapaciteteve të reja të cilat sigurojnë një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit energjetik dhe në pajtim me normat evropiane në lidhje me çështjet mjedisore, mund të arrihet vetëm nëse paraprkishtë ekzistojnë studime të mirëfillta shkencore dhe zhvillimore në këtë fushë. Hulumtimi i nevojave dhe potencialit për hulumtime shkencore dhe zhvillimore të Kosovës në fushën e energjisë janë në fokus të punimit në fjalë i cili është realizuar në kuadër të projektit WEB-INCO.NET të përkrahur nga fondet e BE-së. Në punim është vlerësuar gjithashtu niveli i integritimit në fushën evropiane të hulumtimeve si dhe është vlerësuar përputhja e prioriteteve të vendit tonë me prioritetet e vendeve të rajonit.

1. Sistemi i shkencës dhe teknologjisë në fushën e Energjisë në Kosovë

Me futjen e punës hulumtuese në kuadër të prioriteteve qeveritare, viteve të fundit është shënuar një progres i kufizuar në drejtim të krijimit të një sistemi të qëndrueshëm të hulumtimeve shkencore dhe zhvillimore. Këshilli Kombëtar i Shkencës (KSSH) i themeluar në vitin 2007, ka hartuar draftin e Programit Kombëtar të Shkencës (PKSH) i cili është aprovuar nga Parlamenti në vitin 2010. Hulumtimi në fushën e Energjisë është identifikuar si një nga prioritetet kryesore të programit. Megjithatë, sa i përket punës hulumtuese dhe kërkimore, edhe më tej ekzistojnë një mori barrierash të cilat pengojnë zhvillimin e aktiviteteve hulumtuese në bazë të prioriteteve tashmë të definuara. Edhe pse Qeveria fillimisht kishte ndarë një buxhet prej 1 Milion € për financimin e projekteve nga 6 fushat prioritare, të identifikuara në PKSH, për shkak të zhvendosjeve buxhetore vetëm 0.4 Milion janë investuar për financimin e projekteve hulumtuese. Në anën tjetër, pjesëmarrja në Programin e Kornizës Evropiane të Hulumtuese (FP7) ka shënuar një ngritje të lehtë sa i përket aplikimeve por edhe më tej është shumë e kufizuar sa i përket projekteve të financuara. Në lidhje me kontributin e institucioneve vendore për përkrahjen e projekteve hulumtuese mund të konstatohet që janë përkrahur disa projekte të vogla hulumtuese me karakter zhvillimor të cilat kanë për qëllim primar zhvillimin e sektorit të energjisë. Në përgjithësi, puna shkencore edhe më tutje në masë të madhe është e bazuar në iniciativa individuale, me financim vetjak dhe me një ndërlidhje fare të vogël me aktivitetet ekonomike.

Gjendja e përgjithshme në sektorin e energjisë

Korniza institucionale dhe ligjore

Institucionet bazike për menaxhimin e sektorit të Energjisë në Kosovë janë Ministria e Zhvillimit Ekonomik (më herët Ministria e Energjisë dhe Minierave) dhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Një pjesë e përgjegjësive sa i përket këtij sektori i takon edhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Infrastrukturës. Një mori dokumentesh ligjore të draftuara dhe që implementohen nga këto institucione synojnë rregullimin e sektorit të Energjisë dhe të ofrojnë bazën e nevojshme ligjore për planifikimin e aktiviteteve strategjike në këtë fushë. Disa nga ligjet si dhe dokumentet strategjike e programore kryesore të aprovuara gjer më tani janë: Ligji për Energjinë, Ligji për Energjinë Elektrike, Ligji për Rregullatorin e Energjisë, Ligji për Eficiencën e Energjisë, Ligji për Ngrohjen, Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2009-2018, Plani i Kosovës për Eficiencë të Energjisë 2010-2018 dhe Strategjia e Ngrohjes së Kosovës 2011-2018

Gjendja aktuale në lidhje me furnizimin me energji

Përfundime të rëndësishme në lidhje me adresimin e problemeve dhe sfidave të sektorit të Energjisë në Kosovë mund të nxirren në bazë të analizës së pjesëmarrjes sektoriale në konsumin e energjisë.

Siç është prezantuar në fig. 1 sektori me konsum më të lartë të energjisë është sektori i amvisërisë. Në anën tjetër konsumi e energjisë elektrike përbën 30% të tërë energjisë së konsumuar në këtë sektor. Kjo nënkupton që zvogëlimi i konsumit të energjisë elektrike në këtë sektor do të ndikonte në përmirësimin substancial të furnizimit përgjithshëm me energji. Kjo mund të arrihet nëpërmjet adresimit të humbjeve komerciale siç janë keqpërdorimi i energjisë elektrike dhe mospagimi i energjisë së shpenzuar. Adresimi adekuat i humbjeve të tilla do të kontribuonte dukshëm në zvogëlimin e konsumit. Një tjetër çështje që duhet trajtuar është përdorimi i gjerë i energjisë elektrike për nevoja të ngrohjes. Analizat tregojnë që rreth 50 % e energjisë elektrike të konsumuar nga amvisëritë, shpenzohet për nevoja të ngrohjes. Përveç kësaj, nga figura 1 shihet që 50 % të konsumit total të energjisë e përbën konsumi në sektorin e amvisëritë dhe atë të shërbimeve. Në anën tjetër rreth 66 % e energjisë totale të konsumuar në këta sektor, shpenzohet për nevoja të ngrohjes.




Fig. 1 Shpërndarja e konsumit të energjisë nëpër sektorë në vitin 2010

Shkalla e lartë e konsumit të energjisë në sektorin amvisërisë dhe atë të shërbimeve tregon potencialin e madh për racionalizimin e shfrytëzimit të energjisë në ndërtesat rezidenciale (ndërtesat e banimit) dhe ato të shërbimeve publike. Bazuar në një fakt të tillë, Qeveria dhe

donatorët (në rend të parë Komisioni Evropian) janë duke financuar një mori projektsh me qëllim të përmirësimit të efikasitetit të energjisë sidomos në ndërtesat e sektorit publik. Përmirësimi i efikasitetit të këtij lloji të ndërtesave është një nga rekomandimet kryesore në Direktivën e Shërbimeve Energjetike të BE-së.

Elementet e politikës hulumtuese në fushën e Energjisë

Bazat e politikës hulumtuese në Kosovë janë dhënë në Ligjin për Veprimtarinë Kërkimore Shkencore, Strategjinë për Zhvillimin e Arsimit të Lartë 2005-2015 dhe Programin Kombëtar të Shkencës (PKSH)

Institucioni kryesor për krijimin dhe implementimin e politikave të përgjithshme hulumtuese në Kosovë është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë respektivisht Departamenti i Shkencës dhe Teknologjisë në kuadër të kësaj Ministrie. Një përparim i dukshëm në drejtim të identifikimit të nevojave të vendit për aktivitete hulumtuese është arritur me themelimin e Këshillit Kombëtar të Shkencës (KKS) në vitin 2007. Në programin e vet, të hartuar në vitin 2010, KKS ka identifikuar 6 fusha prioritare në të cilat ka nevojë të përqendrohen aktivitetet kërkimore. Në këtë kuadër Burimet natyrore, Energjia dhe Mjedisi janë radhitur si prioritet i parë. Përveç kësaj në PKSH është prezantuar edhe plani përkatës i realizimit si dhe planifikimin afatmesëm i nevojave buxhetore.

Infrastruktura dhe kompetencat kryesore në fushën e Energjisë

Infrastruktura e hulumtimeve në fushën e energjisë në Kosovë përbëhet nga institucionet publike dhe private. Institucionet publike përgjegjëse për hartimin e politikave dhe financimin e aktiviteteve hulumtuese dhe zhvillimore janë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik

Institucioni publik kryesor i cili zhvillon aktivitete hulumtuese në fushën e Energjisë është Universiteti i Prishtinës, përkatësisht fakultetet vijuese: Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike dhe Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë

Institucionet private të involvuara në hulumtime në fushën Energjisë janë: Instituti INKOS, Instituti Riinvest dhe Universiteti Amerikan-AUK

Në lidhje me kompetencat që posedojnë institucionet hulumtuese në Kosovës, duhet potencuar që pas vitit 1990 Kosova i ka pësuar ndryshime masive institucionale të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejtë në sektorin e kërkimeve dhe inovacioneve. Ndryshimet e tilla kanë rezultuar në humbjen e disa kompetencave që kanë qenë të ndërlidhura me aktivitetet e përbashkëta hulumtuese dhe zhvillimore me vendeve të rajonit. Por, në anën tjetër, rritja e madhe e bashkëpunimit të institucioneve arsimore me institucionet përkatëse të vendeve tjera (në rend të parë nga BE-ja), mobiliteti i shtuar i shkencëtarëve të rinj në dekadën fundit si dhe implementimi i një mori projektsh zhvillimore, kanë rezultuar në fitimin e përvojave të caktuara edhe në fushën e energjisë. Si rezultat i zhvillimeve të tilla, kompetencat kryesore të cilat Kosova i disponon në fushën e Energjisë ndërlidhen me **Teknologjinë e gjenerimit të energjisë elektrike, Burimet e ripërtërishme të energjisë, Efikasitetin e energjisë, Resurset energjetike si dhe me Prodhimtarinë e kombinuar të energjisë.**

SWOT analiza

| | |
|---|--|
| Përparësitë: <ul style="list-style-type: none"> • Korniza ligjore solide për arsimin e lartë dhe shkencën • Korniza ligjore për fushën e energjisë pothuajse e plotësuar • Programi Kombëtar i Shkencës i aprovuar | Mundësitë: <ul style="list-style-type: none"> • Implementimi i planit kombëtar të shkencës • Implementimi i strategjive dhe programeve energjetike • Pjesëmarrja aktive në projektet hulumtuese të BE-së |
| Dobësitë: <ul style="list-style-type: none"> • Buxheti i pamjaftueshëm • Ndërlidhja e dobët e aktiviteteve shkencore me ekonominë <ul style="list-style-type: none"> • Përvoja e kufizuar në menaxhimin e projekteve | Rreziqet: <ul style="list-style-type: none"> • Shkurtime buxhetore dhe rialokimet e buxhetit • Koordinimi i dobët institucional në lidhje me aktivitetet hulumtuese |

Prioritetet hulumtuese në fushën e Energjisë

Prioritete hulumtuese dhe zhvillimore në fushën e Energjisë duhet të jenë në funksion të përkrahjes së aktiviteteve që ndërlidhen me realizimin e prioriteteve të identifikuara në strategjinë e energjisë si dhe në vijë me kornizën hulumtuese të ofruar nga BE-ja në kuadër të FP7, Tempusit, projektit HERD etj. Prandaj, bazuar në këtë qasje, prioritetet hulumtuese të Kosovës duhet të jenë në fushat siç janë:

- Sigurimi i furnizimit me energji,
- Gjenerimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme,
- Përdorimi i burimeve të ripërtërishme në transport, ngrohje dhe ftohje,
- Aplikimi i teknologjisë për kapjen dhe ruajtjen e CO₂,
- Përdorimi i rrjetave inteligjente të energjisë,
- Eficienca e energjisë dhe ruajtja e energjisë termike.

Integrimi i Kosovës në zonën evropiane të hulumtimeve në fushën e Energjisë

Integrimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor në zonën evropiane të hulumtimeve (ZEH) konsiderohet të jetë me rëndësi vendimtare për politikën hulumtuese si të regjionit ashtu edhe të Unionin Evropian. Si partner i bashkëpunimit internacional, entitetet hulumtuese të Kosovës kanë mundësinë e aplikimit për projekte hulumtuese në kuadër të kornizës FP7. Në lidhje me këtë, Kosova ka organizuar disa sesione informuese dhe ka nominuar personin kontaktues për FP7. Në përgjithësi programet e mobilitetit nga BE-ja të fokusuar në arsimin e lartë dhe në hulumtim kanë kontribuar në rritjen e mobilitetit të shkencëtarëve. Mobiliteti i shkencëtarëve në vitin 2011 është përmirësuar dukshëm edhe nëpërmjet implementimit të PKSH.

Mirëpo, përkundër progresit të shënuar kohën e fundit në fushën e hulumtimeve dhe inovacionit, nuk mund të thuhet se është arritur përmirësim substancial sa i përket integritimit të Kosovës në ZEH.

Përputhshmëria e prioriteteve të Kosovës me prioritetet e vendeve tjera të rajonit Një nga qëllimet e punimit në fjalë ka qenë edhe vlerësimi i përputhshmërisë së prioriteteve të Kosovës me prioritetet e vendeve tjera të Ballkanit Perëndimor si dhe vlerësimi i mundësive të pjesëmarrjes në projekte të përbashkëta hulumtuese në fushën e Energjisë. Në dy takimet e përfaqësuesve të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor pjesëmarrëse në projektin WEB-INCO.NET që u mbajtën në margjina të Konferencës së dytë Evropiane për Energjinë (E2C) në Maastricht më 17 dhe 18 Prill të vitit 2012, u identifikuan prioritetet e përbashkëta që do të mund të përkraheshin nga BE-ja në kudër të FP7. Prioritetet e tilla të cilat përputhen mjaft mirë me prioritetet e Kosovës janë:

- Menaxhimi i integruar i rrjedhave të lumenjve
- Prodhimi i biogazit nga mbeturinat
- Gjenerata e dytë e bio-karburanteve
- Lidhja e hidrocentraleve të vogla në rrjet, integrimi në sistem, operimi dhe kontrolli
- Pompat gjeotermale në ndërtesat energji-efiçiente
- Ndërtesat me neto zero-konsum të energjisë

Përfundimet

Analiza aktuale e aktiviteteve hulumtuese dhe zhvillimore në fushën e Energjisë në Kosovë, dëshmon që përkundër një progresi të kufizuar që është shënuar viteve të fundit, ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm hulumtues kërkon një përkushtim të vazhdueshëm dhe shumë të koordinuar të institucioneve vendimmarrëse. Në rend të parë kërkohet një qasje strategjike që tejkalon politikat ditore dhe që garanton një vazhdimësi të ndërtimit të infrastrukturës së nevojshme hulumtuese dhe zhvillimore. Nga SWOT analiza e prezantuar mund të përfundohet që si pikënisje e ndërtimit të sistemit modern hulumtues, nevojitet fillimi i implementimit të PKSHE nëpërmjet planifikimeve përkatëse buxhetore. Në punim është treguar gjithashtu që përkundër kompetencave të caktuara të institucioneve vendore për hulumtime në fushën e energjisë, mungesa e projekteve të përbashkëta rajonale dhe evropiane paraqet një pengesë serioze për integrimin e mirëfilltë të Kosovës në zonën evropiane të hulumtimeve. Prandaj, një rëndësi e veçantë kërkohet ti kushtohet përmbytjes së aplikacioneve për përkrahje në FP7 sidomos në aspektin e cilësisë së tyre. Përvoja e vendeve të rajonit dëshmon që përkrahja financiare simbolike e aplikacioneve të tilla do të mund të ishte vendimtare për arritjen e qëllimit të dëshiruar.

*Recensentë:
Prof. dr. Xhemajl Fejzullahu
Prof. dr. Januz Bunjaku*

KUMTESA

Prof. asoc. Naim HASANI¹ Dr. Makfire SADIKU²: UJËPËRSHKUESHMËRIA E ARGJILËS RANORE

¹FNA(UP)
²FSHMN(UP)

Për kontrollimin e koeficientit të filtrimit është marrë materiali i argjilëranore 0/2 i cili është në përbërje 75% rërë me 25% argjilë dhe është hulumtuar në katër Kampion. Ndërtimi i kampionit provë sipas studiesit Horst(1997) duhet të bëhet në anën e lakores së lagur të Proktorit ku kampionët provues përgatiten me aparaturën e proktorit, ngjeshën në dy shtresa me diametër 10 cm e lartësi 3 cm. Sasia optimale e ujit është 14% për të cilën kemi një peshë vëllimore 1,78g/cm³, ndërsa për dendësinë 98% në anën e krahut të lakores së lagur është për lagështi 17% të përzierjes mineralit me një peshë vëllimore 1,75 g/cm³. Kampionet provë janë përgatitur me lagështi mesatare 18,5%. Para fillimit të provës bëhet pastrimi i aparaturave prej ajri, gjithashtu përpara enës së ujit është vendosur aparaturë për largimin e fluskave prej ujit të cilat mund të formohen përgjatë rrjedhjes nëpër gypëzime për në kampion. Kampioni i punuar me aparaturën e Proktorit vendoset në aparaturën e filtrimit. Në skajin e poshtëm është instaluar gypi që sjell ujin të cilit i është larguar ajri. Përmes gypit, hyn uji nëpër gurin filtrues i cili para se të ndërtohet është mbajtur në ujë për largimin e ajrit, në mes gurit filtrues dhe kampionit është vendosur letra filtruese dhe një tjetër është vendosur edhe sipër kampionit nën gurin e dytë filtrues. Në këtë formë është provuar mbrojtja prej erozionit e grimcave të imëta në hyrje dhe dalja në kampion prej ujit nën shtypje, i cili është mbështjellë hermetikisht me gomë. Për sigurimin e përcjelljes së kompaktësisë brenda në komorën provuese futet ujë me ngjyrë. Ky sistem i kontrollimit të filtrimit është hermetikisht i mbyllur nga i cili nuk kemi humbje uji apo avullim.




Fig. 1: Grafiku i koeficientit të filtrimit k në provën nr.1

Përgatitja e kampionëve me aparaturën proktorit me goditje, në dy shtresa është ngjeshur materiali i përzierjes së rërës dhe bentonitit për shqyrtim, mirëpo është e kuptueshme se ka

mbetur ajër nëpër pore të tyre i cili nuk mund të largohet gjatë këtij procesi. Për matjen e ujit i cili filtrohet prej kampionit shërben ena prej qelqi në formë gypëzimi me diametër 4mm, sasia filtruese lexohet në vijat e shënuara me saktësi për $0,02 \text{ cm}^3$ ujë. Në kampion uji filtrohet nga poshtë- lart nën shtypje hidrostatike. Leximi i vlerave të filtrimit bëhet rregullisht në periodë kohore 24 orë dhe pastaj i shtohet ujë i pastruar (pa ajër) në enën furnizuese deri në vijën e shënuar në të. Me kujdes bëhet kontrolli i gypëzimeve të furnizimit me ujë që të mos vjen deri te ndonjë kontakt me jashtë. Paraqitja e ngjyrës së kaltër në këtë rast ose e flluskave të ajrit janë elemente treguese se nuk është duke u zhvilluar prova pa ndikim. Paraqitja grafike e vlerave të koeficientit të filtrimit prej llogaritjes në tabelë janë bërë për vlerësim dhe përcjellje më të lehtë. Në abshisë kemi periodën kohore të zhvillimit të procesit provues, ndërsa në ordinatë janë vlerat e koeficientit të filtrimit të llogaritura për temperaturë të njëjtë. Gjatë vlerësimit të rezultateve për koeficientin e filtrimit në grupin e parë të provave shihet në diagram (figurën 1) se në fillim kemi vlera të cilat sillen përafërsisht prej $5,1 \cdot 10^{-11} \text{ m/s}$, e të cilat janë më të lartat, mirëpo me vazhdimin e procesit provues kemi ulje dhe stabilizim të lëvizjes së këtyre vlerave të filtrimit. Pas 100 h të zhvillimit të procesit provues si shihet te diagrami i provës së filtrimit vlerat sillen në mes $2,5 - 1 \cdot 10^{-11} \text{ m/s}$.




Fig. 2: Grafiku i temperaturës së ujit gjatë zhvillimit të provës

Kjo mund të kuptohet që procesi i ngopjes së mineralit fillon që me futjen e kampionit nën shtypjen e ujit me gradient hidraulik $i=30$ dhe kjo ngopje shkon duke ndikuar në bymimin e brendshëm të molekulave të argjilës bentonit, të cilat njëkohësisht ngushtojnë poret ekzistuese dhe e ngadalësojnë filtrimin e gjithëmbarshtëm të mineralit. Temperatura është faktor i cili mund të ndikoj në vlerat e rezultateve dhe për këtë arsye është matur vazhdimisht pas çdo leximi të rrjedhjes së filtrimit në ujin pran provës dhe janë paraqitur grafikisht në fig. 2. Si shihet temperatura e ujit gjatë procesit të provës është shumë më e lartë se 10°C , e kjo ndikon në koeficientin e filtrimit. Ndërsa, nga temperatura e ujit është llogaritur koeficienti β i cili është paraqitur me tabelë grafike në fig. 3, vlerat e të cilit sillen në mes 0,71 dhe 0,77.




Fig. 3: Parametri korrigjues i temperaturës β

Pas 42 ditë prove kemi një periudë relativisht konstante të filtrimit e cila është vazhdimisht nën vlerën $3 \cdot 10^{-11}$ m/s e cila na jep një permitivitet prej $1 \cdot 10^{-09}$ s⁻¹ që plotëson kushtin e filtrimit për mbrojtje të ambientit nga ndotjet e automjeteve prej $1,7 \cdot 10^{-07}$ s⁻¹




Fig. 4: Koefficienti i filtrimit k në provën nr. 2

Kampioni i katërt në orët e para ka një koefficient filtrimi $1 \cdot 10^{-10}$ m/s , i cili zvogëlohet në fillim më shpejt dhe pas ~72 orëve të zhvillimit të provës koefficienti i filtrimit zvogëlohet në $2,2 \cdot 10^{-11}$ m/s.




Fig. 5: Koeficienti i filtrimit k në provën nr. 3

Edhe studiuesi Heyer në studimin “Die Durchlässigkeit mineralischer Dichtungsstoffe unter besonderer Berücksichtigung des Sättigungsvorgang” pran UTM [1] i arsyeton vlerat e larta të filtrimit në fillim të provës.





Fig. 6: Koeficienti i filtrimit k në provën nr. 4

Kontrollimi i kampionit 15664 në fig. 6 tregon një filtrim të vogël që nga fillimi dhe si edhe kampioni i më hershëm i plotëson kërkesat si përzjerje për material mbrojtës.

Përmbledhja Për përcaktimin e koeficientit të filtrimit si për dherat e lidhura ashtu edhe për ato të pa lidhura aplikohet ligji i Darcy-t. Duhet pasur kujdes në largimin e ajrit nga poret si dhe ngopjen e përzjerjes së mineralit. Kampionet janë ndërtuar me aparaturën e proktoirit në laborator dhe me komorën tri aksiale, është përcaktuar koeficienti i filtrimit k , i cili ka vlerat nga $1 \cdot 10^{-10}$ m/s deri $2 \cdot 10^{-11}$ m/s. Edhe përzjerja e mineralit të shkruftë me lagështi natyrore e kontrolluar në komorën tri aksiale pas një fillimi me rrjedhje $\sim 9 \cdot 10^{-7}$ m/s zvogëlohet pas konsolidimit me kalim të kohës deri $\sim 8 \cdot 10^{-12}$ m/s. Filtrimi nëpër kampionin e shqyrtuar zhvillohet pa ndikime nga jashtë, kjo përzjerje e mineralit bentonit + rërë ka një vlerë të ulët filtrimi e cila është nën kufirin e lejuar. Ndryshimi i gradientit tregon një stabilitet të uljes së ujë përshkueshmërisë gjatë procesit të hulumtimit (Figura 7). Filtrimi nëpër kampionin e shqyrtuar zhvillohet pa ndikime nga jashtë, kjo përzjerje e mineralit bentonit + rërë në përbërje 1:3 ka një vlerë të ulët filtrimi e cila është nën kufirin e lejuar. Këto argjilat ranore të hulumtuara në kushte laboratorike me qëllim të aplikimit të tyre në mbrojtjen e ujerave nga ndotjet na japin rezultate të lakmueshme në gradientë të ndryshme hidraulike.



Dr. Sc. Bashkim BAXHAKU, Msc Hajredin TYTYRI¹: MËNYRAT ME EFIKASE TE ZVOGËLIMIT TE NDOTËSEVE PREJ EMISIONIT TE GAZRAVE DALËS NE REGJIONIN E PRISHTINËS

¹Fakulteti i inxhinierisë mekanike, Universiteti I Prishtinës

Abstrakt

Mjetet motorike përveç mirëqenës që ofrojnë dhe rolin e pashmangshëm në transportin e të mirave materiale, të udhëtareve dhe ngarkesave të veçanta në shoqërinë moderne ka edhe, në shikim të parë, anën negative që nuk vërehet. Domethënë, sipas hulumtimeve të pavarura që janë krye në tërë botën është ardhur në përfundim të vetëm se sektori i transportit paraqet burimin më të madh të ashtuquajturat ndotëseve konvencional (CO , C_xH_y , NO_x , CO_2). Duke shikuar trendin e zhvillimit të industrisë të automjeteve si dhe industrializimin e shpejt të shteteve të pazhvilluara është e pritshme rritja e mëtejshme e emisionit të ndotëseve nga ana e sektorit të transportit.

Duke shikuar pasqyrën complete të rritjes të numrit të mjeteve motorike, në Republikën e Kosovës, që në vitin 2010 e ka kalua numrin prej 380000 të mjeteve motorike të regjistruara, prej të cilave mbi 31% i takon kryeqendrës Prishtinës me moshën mesatare të tyre mbi 16 vjet. Në punim janë dhënë pasqyra e karakteristikave më të rëndësishme të parkut të automjeteve të Republikës së Kosovës - Prishtinës. Duke pasur parasysh rrënjat e përditshme në komunikacion në mjediset urbane, si dhe faktin që motorët me benzinë janë përgjegjës për shumicën e emisionit të CO , ndërsa motorët me naftë për emisionin e NO_x , duhet të përkushtohemi në mënyrë të posaçme emisionit të ndotëseve dhe të definojnë masat dhe mënyrat për zvogëlimin e tyre. Mënyra me efikase në zvogëlimin të emisionit të ndotëseve, e aplikueshme në rrethanat tona, është përdorimi i lëndës djegëse alternative dhe automjeteve hibrid.

Fjalët kyçe: Ekologjia, transporti, mjedisi urban, lëndët alternative, automjetet hibride

1. Hyrja

Lidhja e parë në mes mjeteve motorike dhe ndotjes të rrethit njerëzor në mjediset urbane është vendosur në vitet e 50 të shekullit të kaluar kur hulumtuesit vijnë të konkluzioni që transporti ishte fajtori kryesor për qiellin e mbushur me retë prej tymi mbi *Los Angeles, California, USA*. Këtij konkluzioni i ka ndihmuar mjaft fakti që më zhvillimin e industrisë pas luftës së dytë botërore është rritur në mënyrë karakteristike numri i përgjithshëm i mjeteve motorike. Faktori i dytë dhe më siguri më i rëndësishëm në krijimin e lidhjes të automjeteve motorike dhe ndotjes të mjedisit njerëzor është burimi i energjisë për ngasjen e automjeteve motorike, d.m.th. lënda djegëse. Me rritjen e

KUMTESA

vazhdueshme të numrit të mjeteve motorike, sasisë së lëndës djegëse e harxhuar dhe numrave të kilometrave të kaluar emitohet emisioni i rëndësishëm i ndotëseve prej të cilëve janë ma më rëndësi: monoksidi i karbonit CO, hidrokarburet e padjegur C_xH_y , bashkëdyzimet organike te avullueshme jo metanike NMVOC, oksidet e azotit NO_x , grimcat dhe dyoksidi i karbonit CO_2 .

Ne Prishtinë situata ka ndryshua pas luftës së fundit në Kosovë, ku përveç termoelektraneve të Kosovës nuk kemi me industri që do të merr pjesë në ndotjen e mjedisit në regjionin e Prishtinës. Në kohën e fundit si ndotës mund të definohen automjetet motorike, sistemi i nxehtësie së qytetit si dhe termoelektrana e Kosovës. Duke anashkaluar termoelektrana si dhe sistemin e nxehtësie në vazhdim të punimit janë prezantua rezultatet me të cilët definohet pasqyra ekologjike në regjionit të Prishtinës për vitin 2009 si dhe mundësia e zvogëlimit të ndotjes në mjediset urbane.

2. Analiza e emisionit të ndotëseve sipas burimit dhe kategorive të mjeteve motorike

Për nga burim i krijimit të ndotësit në atmosferë ndarja do të mund të kryhet në sektorin e transportit, industrisë, instalimeve të fuqisë, përdorimit komercial etj..

Sipas figurës 1, që paraqet analizën e komponentëve ndotëse siç janë CO, NO_x , C_xH_y dhe CO_2 sipas burimit të krijimit, është evidente se në botë si burim kryesor i ndotjes konsiderohet sektori i transportit me 89 % CO, 44% C_xH_y , 52% NO_x dhe 29% CO_2 nga emisioni i tërësishëm i të gjithë burimeve.




Fig. 1. Emisioni i komponentëve ndotës sipas burimit të ndotjes [1]

Zbërthimi i mëtuqjeshëm i sektorit të transportit sipas llojit të mjeteve motorike, siç është treguar në figurën 2, tregon se përdorimi i mjeteve motorike për udhëtarë, në radhë të parë në mjediset urbane dhe në relacionet e shkurta i kontribuon pjesës me të madhe të emisionit të komponentëve ndotëse CO (91%), C_xH_y (77%) dhe CO_2 (53%), ndërsa mjetet motorike të transportit kanë pjesëmarrjen më të madhe në emisionin e NO_x (56,5%). Emisioni i mbetur bie në motoçikleta si kategori e mjeteve motorike që në kohën e fundit është duke u popullarizua, dhe të cilës deri me tash shumë pak i është kushtua vëmendja.




Fig. 2. Emisioni i komponentëve të ndotjes sipas kategorive të automjeteve

3. Treguesit për vlerësimin e emisionit të materive ndotëse ne të ardhmen

Mjeti motorik për shkak të fleksibilitetit të vetë paraqet mjetin më të popullarizuar për transportin individual të personave, të mjeteve materiale për konsum të përgjithshëm, ngarkesave speciale etj.. Për popullaritetin e mjeteve motorike tregon rritja e numrit të mjeteve motorike të regjistruara në Evropë për periudhën prej vitit 1990 deri në vitin 2010 dhe supozimet për rritjen e tyre deri në vitin 2030. Deri sa në vitin 1990 janë regjistruar 182.67 milion mjete motorike në përfundim të vitit 2000 rritja e numrit të automjeteve të regjistruara ishte 226.869 milion.

Me urbanizimin në rritje dhe zgjerimin gjeografik të hapësirave të banuara në Evropë, pastaj me përmirësimin e infrastrukturës dhe zhvillimin e ekonomisë mjetet motorike si mjet për transport të udhëtareve dhe të mirave materiale të çfarëdo forme me fleksibilitetin e vetë e zë vendin e parë në sektorin e transportit të përgjithshëm (me 70% të transportit të tërësishëm të kryer).

Kjo rritje e mjeteve motorike në çdo aspekt do të kontribuoj dhe rritjes evidente të emisionit të komponentëve ndotëse. Studimet e kryera nga OECD-i, me projektin MOVE (Motor Vehicle Emissions) vërtetojnë mundësin e arritjes të efekteve pozitive nga aspekti i emisionit të komponentëve ndotëse nga gazrat dalës të mjeteve motorike me ndihmën e dy skenarëve prej të cilëve njëri parashikon aplikimin e masave më të rrepta dhe më të gjëra të kontrollit të emisionit të ndotëseve dhe masat që do të bien deri të zvogëlimi i harxhimit të lëndës djegëse nga fosilet. Skenari i dytë bazohet në kontrollin dhe para gjithash në zvogëlimin e madhësisë së rritjes të transportit prej 3% në vlerën reale që mund të realizohet prej 2%.

4. Gjendja në regjionin e Prishtinës dhe në republikën e Kosovës

Republika e Kosovës si një shtet i ri ende nuk ka në tërësi institucionet e organizuara të cilat në mënyrë unike do të përcjellin të gjitha ngjarjet e lidhura me transportin që zhvillohet me ndihmën e komunikacionit rrugor, parimisht mendohet në emisionin e komponentëve ndotëse në nivelin e tërë shtetit. Sipas shënimeve të cilat janë udhëhequr deri në vitin 2009 numri i veturave të regjistruar në Republikën e Kosovës ishte 380552 automjete.




Fig. 3. a) pjesëmarrja procentuale e automjeteve të regjioneve të Kosovës, b) struktura e automjeteve në regjionin e Prishtinës sipas kategorive të automjeteve

Në figurën 3a. është treguar pjesëmarrja procentuale e automjeteve të regjioneve të Kosovës në numrin e tërësishëm të automjeteve në vitin 2009. Në figurën 3b është treguar struktura e automjeteve në regjionin e Prishtinës sipas kategorive të automjeteve. Nga figura 3a del se nga numri i përgjithshëm i automjeteve të regjistruara në Kosovë në vitin 2009, 31.18% prej tyre janë të regjistruara në regjionin e Prishtinës, ku në këtë regjion kemi numrin më të madhe të automjeteve të regjistruara më të reja se pesë vite dhe më të vjetra se 15 vite, që regjionin e Prishtinës e bënë regjionin më reprezentativ për analizë më të hollësishme se regjionet tjera.

Në bazë të të dhënave, [2] në regjionin e Prishtinës automjetet më të reja se pesë vite përbëjnë 7.49% të numrit të përgjithshëm të numrit të automjeteve të regjistruara, ndërsa 77.36% e automjeteve të regjistruara janë më të vjetra se 10 vite. Pjesëmarrje e automjeteve më të vjetra se 15 vite është 66.82% e numrit të përgjithshëm të automjeteve të regjistruara, fig. 3c.

Nga numri i përgjithshëm i automjeteve të regjistruara 83.23% e përbëjnë automjetet e udhëtarëve, ndërsa automjetet transportuese marrin pjesë me 13.36%, për derisa pjesën tjetër e plotëson autobusët, motoçikletat, traktorët dhe automjetet tjera për këtë regjion.

5. Llogaritja e emisionit të materieve ndotëse nga gazrat dalës në regjionin e Prishtinës

Në bazë të analizës së gjendjes së parkut të automjeteve për regjionin e Prishtinës, si dhe verifikimin e vlefshmërisë së rezultateve të llogaritura (me mostrat e qëllimshme), në vazhdim do të analizohen materiet ndotëse duke shfrytëzuar programin llogaritës COPRET IV.

Për kryerjen e procedurës së llogaritjes me programin COPERT IV na nevojiten edhe të dhënat për numrin e kilometrave të kaluar, llojin e rrugës, shpejtësinë mesatare të lëvizjes si dhe sasia e përgjithshme të harxhuar e lëndës djegëse. Për shkak të mosekzistimit të disa prej këtyre të dhënave, është bërë vlerësimi dhe krahasimi i tyre me vendet e regjionit [8,9].

Nëse krahasohen sasia e importuar e lëndës djegëse me atë të llogaritur me program diferenca maksimale që na paraqitet është 3.6% që paraqet vlerë të pranueshme sipas [1].

Llogaritja është krye edhe për versionin 1 (Prishtina 1) ku do të ndryshonte vetëm gjendja e parkut të automjeteve, parametrat tjerë mbasin të njëjtë në programin llogaritës , ku automjetet e udhëtareve me benzinë dhe dizel konvencional deri në EURO 1 kanë kalua në kategorinë EURO 2 (Supozimi se automjetet e vjetra janë qitë jashtë përdorimit dhe janë zëvendësua me automjete me te reja të importuara në Kosovë – 12911 automjete të udhëtarëve me benzinë me vëllimin < 1400 para EURO 1 janë zëvendësua me 12911 automjete EURO 2 me benzinë me vëllimin < 1400, si dhe 15686 automjete të udhëtareve me motor dizel me vëllim < 2000 konvencional zëvendësohen me 15686 automjete dizel me vëllim < 2000 me EURO 2).

6. Analiza krahasuese e emisionit të materieve ndotëse dhe CO₂

Përcaktimi i emisionit të materieve ndotëse të veçanta prej gazrave dalës të automjeteve motorike të komunikacionit rrugor të cilat lirohen në rrethinën (ambientin) ku jetojmë do të kishte qenë i mangët po mos të bënim krahasimin e emisioneve me vendet e regjionit dhe me vendet në të cilat tradicionalisht ekziston vetëdije e larte ekologjike. Për këtë arsye në punim është bërë krahasimi i emisionit të koeficienteve të materieve ndotëse nga automjetet motorike CO, C_xH_y, NO_x dhe CO₂ si gazë që ndikojnë në efektin sërë me rezultatet e përshtatshme të vendeve të regjionit si dhe vendeve të OECD-Evropë. Shënimet për krahasim janë mare nga [4], [7], [8] dhe [9].

Me qëllim të krahasimit të koeficienteve të emisionit të materieve ndotëse të veçanta nga gazrat dalës të automjeteve të komunikacionit rrugor, janë krahasua rezultatet për regjionin e Prishtinës (gjendja fillestare dhe versioni 1), vendet e OECD – EU, Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës për vitin 2005 si dhe Serbisë për vitin 2009. Krahasimi është bërë në sasinë e emituar të një automjeti për një kilometër të rrugës.

Emisioni i dyoksidit të karbonit (CO₂) si gazë i efektit sërë edhe pas aplikimit të ripërtëritjes të parkut të automjeteve mbetet mbi vlerat e OECD – EU. Arsyeja qëndron në strukturën mjaft të vjetër të parkut të automjeteve dhe kualitet i dyshimtë i lëndës djegëse. Gjendja e monoksidit të karbonit (CO) me aplikimin e ripërtëritjes të parkut të automjeteve i për afrohet vlerave të OECD – EU. Emisioni i suboksideve të azotit (NO_x) edhe pas aplikimit të ripërtëritjes të parkut të automjeteve mbetet mbi vlerat e OECD – EU. Emisioni i hidrokarbureve (C_xH_y) pas aplikimit të ripërtëritjes të parkut të automjeteve zvogëlohet nën vlerat e OECD – EU.

KUMTESA




Fig. 4. Emisioni i materieve ndotëse të veçanta nga gazrat dalës

6. Masat potenciale për zvogëlimin e emisionit të ndotëseve

Që të mund të definohen masat të cilat do të kontribuojnë zvogëlimin e emisionit të ndotëseve nga ana e sektorit të transportit, duhet të vërehen parametrat në të cilët mund të veprohohet. Përveç mundësisë së udhëheqjes me transportin në kuptimin e kufizimit të shfrytëzimit të kategorive të veçanta të mjeteve motorike në pjesën e ngushtë të qendrës së qytetit dhe në përgjithësi me organizim më të mirë, ekzistojnë edhe potencialet tekniko – teknologjike aplikimi i të cilëve do të mundëson reduktimin e dukshëm të emisionit të ndotëseve. Si parametër kontrolli që mundësojnë përcaktimin e masave për reduktimin e emisionit të ndotëseve në këtë vend do të theksojmë:

- emisioni i gazrave dalës
- përbërja e lëndës djegëse
- emisioni i avullimit
- përmirësimi i efikasitetit të shfrytëzimit të lëndës djegëse
- shfrytëzimi i lëndës djegëse alternative
- udhëheqja me transportin

Me veprime të paramenduara në disa parametra kontrollues me futjen e rregullativës më të ashpër ligjore nga aspekti i ndotëseve, ose me masa ekonomike stimuluese tentohet që të zvogëlohet ndotja e mjedisit jetësor të njeriut.

Në Republikën e Kosovës si hapi i parë në pengimin e ndotjes të mjedisit jetësor të njeriut nga ana e mjeteve motorike duhet të pasqyrohet në ashpërsimin e vazhdueshëm të rregullativave ligjore. Ekzistojnë iniciativat nga ana e përfaqësuesve të prodhuesve të automjeteve që të kufizohet vjetërsia e automjetit që importohen. Kjo masë ligjore nga ana e autorit mund të shikohet si zgjidhje kalimtare deri te aplikimi i homologimit unikë të

automjeteve dhe pjesëve rezerve në bazë të standardeve ndërkombëtare dhe të rregullativave. Që të mund të përcillen ngjarjet rreth parkut të automjeteve në tërë Republikën e Kosovës dhe të zgjidhen problemet e vërejtur, vetvetiu paraqitet nevoja për subjektin i cili do të ishte në gjendje të përcjell ngjarjet në fushën e sektorit të transportit në përgjithësi në Republikën e Kosovës por edhe në tërë botën, dhe të propozoj ligjdhënëseve masat përkatëse që do të kontribuojnë në përmirësimin e pamjes ekologjike të sektorit të transportit si dhe mundësinë konkurruese të transportueseve vendas në Evropë dhe botë.

Për shkak të numrit të madh të inovacioneve teknike dhe teknologjike në fushën e industrisë të automjeteve në vitet e fundit paraqitet edukimi permanent të kuadrit ekzistues por edhe atij të ardhshëm në fushën e transportit që do të paraqet bazën për përmirësime nga aspekti i zgjidhjes së problemit të mbrojtjes të mjedisit jetësor të njeriut si dhe sektorit të transportit në përgjithësi.

Përveç “ripërtëritjes” të parkut të automjeteve, që së pari pasqyrohet në shfrytëzimin e teknologjive të reja të sistemit të injektimit të lëndës djegëse si te motorët dizel por edhe te ata me benzinë dhe përpunimit shtesë të gazrave dalës në tubat dalëse të motorit, aktivitetet e mëtutjeshme në zvogëlimin e emisionit të ndotëseve duhet të drejtohen në shfrytëzimin e lëndëve djegëse konvencionale me kualitet më të lart si dhe lëndës djegëse alternative. Është e sigurt se CNG (Compressed Natural Gas) sot paraqet lëndën djegëse alternative më të rëndësishme me të cilin mundësohet realizimi i emisionit të ndotëseve mjaft me i ulët, në rend të parë të NOx dhe grimcave.

Duke pasur parasysh situatën momentale ekonomike sigurisht që nuk pritet “ripërtëritja” të parkut të automjeteve në një interval të shkurt kohor si dhe përdorimi i lëndës djegëse alternative. Për këtë është e nevojshme të punohet në mënyrë paralele në ma tepër drejtime që ndihmojnë përmirësimin e pasqyrës ekologjike të mjediseve urbane.

Si shembull këtu do të përmenden stacionet e monitorimit, të cilat në mënyrë të vazhdueshme duhet të përcjellin ndotjen në pikat karakteristike të qytetit. Ato japin rezultatet e emisionit të grimcave, dhe te komponentëve tjera ndotëse, ndihmojnë si të vlerësimi i pasqyrës globale të ndotjes në mjediset urbane si dhe me rregullimin e rrjedhës së transportit sipas drejtimeve përkatëse.

Është e sigurt se vetëm me aktivitete të vazhdueshme në të gjitha drejtimet e cekura mund të arrihen rezultatet e dëshiruara në kontrollin dhe zvogëlimin e emisionit të ndotëseve në mjediset urbane.

Përfundimi

Problemi i ndotjes të mjediseve urbane prej mjeteve motorike paraqet njërin prej problemeve ma më rëndësi me të cilin ballafaqohet bota bashkëkohore. Duke pasur parasysh pozitën gjeografike të qytetit të Prishtinës dhe vendosjen e tij në afërsi të termoelektraneve të Kosovës, parkun e automjeteve me vjetërsi mesatare mbi 18 vite, problemit të ndotjes duhet kushtuar vëmendje e rëndësishme. Analiza e ndotjes nga mjetet motorike në qytetin e Prishtinës për vitin 2009 ka treguar se niveli i ndotjes momentale është në nivelin e ndotjes mesatare të vendet e OECD – Evropa para 7 viteve.

Në punim është dhënë analiza e gjendjes së tashme të ndotjes së mjedisit nga ana e mjeteve motorike, si në botë ashtu edhe te ne në Regjionin e Prishtinës. Në bazë të trendëve të veçantë për numrin e automjeteve, numrin e km të kaluar, kontrollit të emisionit të disa ndotëseve etj., janë dhënë vlerësimet e pasqyrës ekologjike në botë nga mjetet motorike. Në

KUMTESA

bazë të kësaj analize mund të përfundohet:

- ne emisionin e komponentëve ndotëse transporti rrugor e ka vendin udhëheqës
- ne botë po punohet në mënyrë intensive në zvogëlimin e emisionit të ndotëseve të automjeteve rrugore me ndihmën e zgjidhjeve teknike, rregullativës ligjore, masave ekonomike dhe aftësimin e pjesëmarrëseve në transportin rrugor
- gjendja e parkut të automjeteve ne regjionin e Prishtinës si ne Republikën e Kosovës është mjaft e keqe që ka për pasojë dhe pasqyrën ekologjike mjaft të keqe. Ne raport me pjesën e zhvilluar të botës ekziston në çdo aspekt një vonesë mbi 8 vjet.
- ne Republikën e Kosovës nuk ekziston ofrim i organizuar ose i rregulluar te përmirësimit te pasqyrës ekologjike te automjeteve rrugore, por krejt gati i është lenë stihisë.
- për zvogëlimin e emisionit te komponentëve ndotëse nga automjetet duhet te punohet nga njëra anë në:
 - rritja e efikasitetit me shfrytëzimin e lëndës djegëse alternative
 - shfrytëzimi i lëndëve djegëse alternative si për ngasjen e automjeteve të transportit publik ashtu edhe për mjetet motorike të udhëtarëve, me sigurimin e infrastrukturës përkatëse
 - futja e llojeve alternative te transportit (“më të pastër”), në radhë të parë të transporti i udhëtarëve në mjediset urbane,
 - përcjellja e përhershme e emisionit të ndotëseve në vendet karakteristike në mjediset urbane me cakun e përcaktimit të masave rregulluese etj..

Është e sigurt se vetëm me aktivitete të vazhdueshme në të gjitha drejtimet e cekura mund të arrihen rezultatet e dëshiruara në kontrollin dhe zvogëlimin e emisionit të ndotëseve në mjediset urbane.

Recensentë:

*Dr.sc. Hestet Cakolli prof.
Dr.sc. Naser Lajqi prof.asc.*

Kadri SYLEJMANI¹ dhe Lule AHMEDI¹: NJË PROPOZIM PËR NJË SISTEM PËR PLANIFIKIMIN E UDHËTIMEVE TURISTIKE GRUPORE ME TIPARE REAKTIVE I AVANCUAR ME ANALIZËN E RRJETAVE SOCIALE

¹Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

Abstrakti. Aktivitetet turistike kryesisht bëhen në formë grupore, me që rast turistët janë nën shoqërinë e të afërmeve apo shokëve të tyre. Përgatitja manuale e planit të vizitave për të vizituar disa pika të interesit në një rajon apo qytet, të cilat plotësojnë preferencat individuale të anëtarëve të grupit, është një detyrë komplekse. Për më shumë, pas përgatitjes së itinerarit të udhëtimit, i njëjti mund të bëhet i papërdorshëm për shkak të ngjarjeve të ndryshme që mund të ndodhin (p.sh. ndryshimi i motit, vonesat në trafik etj.). Në këtë punim prezantojmë një propozim për një sistem inovativ, i cili do të mundësoj parashikimin e kënaqësisë së turistit me pikat e interesit që do të vizitohen, planifikimin e udhëtimit turistik shumëditësh për një grup të turistëve, si dhe trajtimin e disa ngjarjeve reaktive që mund të ndodhin gjatë periudhës së udhëtimit. Për më shumë, në kuadër të këtij punimi paraqitet zhvillimi konceptual i sistemit.

Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Bregu i Diellit p.n., 10000, Prishtinë, Kosovë.

Hyrje

Gjatë fazës përgatitore (para udhëtimit), kryesisht, turistët merren me aktivitete planifikuese në lidhje me vizitat që do t'i bëjnë në vendin turistik të zgjedhur. Edhe pse, me ndihmën e veglave të ndryshme "online", turistët mund të bëjnë disa nga përgatitjet e tyre (siç janë p.sh. rezervimi i akomodimit, blerja e biletave për udhëtim, apo blerja e biletave hyrëse për të vizituar Pika të Interesit (PI) të zgjedhura në bazë të preferencave të tyre), akoma, është e vështirë që të sigurohen informata të detajuara në lidhje me PI-të, të cilat do të plotësonin

preferencat tyre. Andaj, në ditët e sotme, në mënyrë që të përkrahen turistet për të planifikuar udhëtimin e tyre turistik, janë zhvilluar sisteme të ndryshme [1] për këtë qëllim. Problemi i tillë i planifikimit mund të ndahen në dy nën probleme: procesi i parashikimit të interesit të turistit në lidhje me PI-të e caktuara, si dhe procesi i gjetjes së rrugës optimale për të vizituar PI-të e preferuara duke ju përmbajtur disa kushteve të përcaktuara nga turisti. Në pjesën vijuese paraqiten disa sisteme që ndërlidhen me fushën në fjalë.

Sistemi City Trip Planner [2] mundëson planifikimin e itinerarit të udhëtimit në bazë të preferencave personale të turistit. Ky sistem mundëson parashikimin e interesit të turistëve duke marrë për bazë tipin dhe kategorinë PI-së, si dhe ekzistenca e mundësisë shtesë që përmes përcaktimit të fjalëve kyçe nga turisti, të parashikohet interesi i tij në lidhje me PI-të e caktuara. Parashikim përmes fjalëve kyçe bazohet në modelin vektorëve hapësinor [3]. Sistemi i prezantuar në [4] koncentrohet me shumë në tipare të avancuara të gjenerimit dhe adaptimit të itinerarit, e më pak në modulën për parashikim të interesit të turistëve. Për më shumë, Kurata në [8] përqendrohet në vetitë interaktive të sistemit duke ju mundësuar turistëve që në mënyrë interaktive të përgatis planin e udhëtimit. Parashikimi i interesit të turistit për PI-të bëhet përmes një funksioni të thjeshtë që përdor një shumë të kategorive me pesha të caktuara. Kategoritë e mundshme janë: popullariteti, edukimi, arti, natyra dhe dëfrimi/zbavitja.

Në kohët e fundi, në [7] është paraqitur një sistem rekomandues për restorante i bazuar në analizën e rrjetave sociale. Autorët sugjerojnë përdorimin e analizës së rrjetave sociale, duke përfshirë profilin dhe preferencat e turistit, për të përmirësuar performancën e sistemeve rekomanduese. Eksperimentet e bëra në rrjetat sociale në internet, tregojnë një tendencë që shokët do të zgjedhin të njëjtat meny në restorante dhe do të japin vlerësime të ngjashme. Një sistem tjetër rekomandues [8] propozon reprezentimin e relacioneve të bashkëveprimit përmes rrjetave sociale, si dhe përdorimin e disa matësve të analizës së rrjetave sociale, për të analizuar bashkëveprimin në mes të përdoruesve dhe për të optimizuar shkëmbimin e informatave në sistemet e tilla.

Në njohuritë me të thella të autorëve, asnjë nga sistemet ekzistuese nuk trajton planifikimin grupor të turneut, ku secili turist do t'i shprehte preferencat e tij personale. Për më shumë, marraja për bazë e ngjarjeve reaktive (p.sh. ndryshimi i motit, tollovitë në trafik, mbyllja e PI-ve etj.), të cilat do të mund të ndikonin në itinerarin paraprakisht të krijuar, nuk trajtohet nga ndonjë sistem i tanishëm planifikues për turizëm.

Rezultatet e arritura në [7, 8], si dhe ekzistenca teorive, mirë të definuara, për llogaritjen e një numri të matësve që karakterizohen nga analizuesit e rrjetave sociale, na motivojnë që të krijojmë një metodë të re për parashikimin e interesit të turistëve, dhe më pastaj ta përdorim të njëjtën për planifikim e udhëtimit grupor të turistëve. Në këtë mënyrë, analiza e rrjetave sociale do të duhej të përmirësonte kualitetin itinerarin e udhëtimit për një grup të turistëve.

Objektivat e sistemit

Le të që një grup prej n turistëve që viziton rajonin (apo qytetin) A për një udhëtime prej r turneve. Rajoni i vizituar A ka m PI, të cilat turistët do të mund t'i vizitonin gjatë qëndrimit të tyre. Secila PI ka një varg të n vlerave S_{ij} , ku secila prej tyre mund të marrë vlerën prej 0

deri në 100 për të përcaktuar nivelin e interesit të turistit me pikën e caktuar. Gjatë periudhës së udhëtimit, mund të ndodhin një numër i k ngjarjeve, të cilat mund ta bëjnë itinerarin, paraprakisht të përgatitur, të pa përdorshëm.

Në mënyrë që të epet një shpjegim më i thuktë në lidhje me objektivat e sistemit të propozuar, le të supozojmë një shembull të thjeshtë të një udhëtimi me detajet si në vijim: $n=3$, $m=5$, S_{ij} ($i=1... n$, $j=1... m$), $r=1$, $k=1$. Vlerat e faktorëve të kënaqësisë S_{ij} , atributet e PI-ve dhe distancat e udhëtimit në mes të pikave janë paraqitur në tabelat 1, 2 dhe 3.

Tabela 1 Vlerat e faktorëve të Tabela 2 Atributet e PI-ve

| PI | Latituda | Longituda | Kohëzgjatja e visitës | Koha e hapjëse | Koha e mbylljes |
|-----------------|----------|-----------|-----------------------|----------------|-----------------|
| P ₁ | 90 | 10 | 30 | 0 | 120 |
| P ₂ | 80 | 70 | 15 | 30 | 120 |
| P ₃ | 00 | 70 | 20 | 20 | 105 |
| P ₄ | | | | | |
| P ₅ | | | | | |
| P _{SE} | | | | | |

Tabela 3 Koha e udhëtimit në mes të pikave të interesit (në

minuta)

Koha e hapjes dh e fillimit dhe atë
përfundimit të turr zuar në kohën prej
330 minutave (5 o isin dy itinerare të
ndryshme, duke tentuar që të plotësojnë sa më shumë preferencat e anëtarëve të grupit.
Itinerari i parë i përgatitur parasheh vizitimin, sipas sekuencës, të pikave P₁P₃P₄, ndërsa
itinerari i dytë përmban pikat P₁P₃P₅. Kënaqësia e përgjithshme e turistëve nëse përdorin
itinerarin e parë do të jetë 410, ndërsa nëse përdorin itinerarin e dytë do të jetë 450. Duke
analizuar të dy itineraret e krijuara, turistët vërejnë se deri të pika 3, të dy itineraret janë të
ngjashme, duke ndryshuar vetëm në pikën e fundit (itinerari 1 ka pikën 4, ndërsa itinerari 2
ka pikën 5). Si rrjedhojë turistët, vendosin të shkojnë së bashku deri të pika 3 dhe më pastaj
ndahen në dy grupe. Grupi i parë përbëhet prej turistëve 1 dhe 3, të cilët vizitojnë pikën 4,
ndërsa turisti i dytë shkon i vetmuar për të vizituar pikën 5. Në këtë mënyrë kënaqësia e
përgjithshme e turistëve rritet në 510.

Le të supozojmë që pas vizitimit të pikës P₁, turistët informohen që pika P₃ është mbyllur
për vizita të turistëve gjatë periudhës së tyre të udhëtimit. Në këtë situatë, turistët kanë
mundësinë që të vizitojnë pikën P₂, e cila është në afërsi të pikës P₃, dhe më pastaj të
vazhdojnë me itinerarin paraprakisht të përcaktuar.

Llogaritjet manuale në këtë shembull janë triviale, mirëpo nëse shqyrtohen raste të tjera më
të komplikuar të udhëtimeve turistike (p.sh. turne shumëditësh, ekzistenca e më shumë se
100 PI-ve, më shumë se 5 turistë), llogaritjet bëhen mjaft komplekse me që numri i
kombinimeve rritet në mënyrë eksponenciale. Si rrjedhojë, objektiv i këtij sistemi është

krijimi i një itinerarit të udhëtimit për një turne shumëditor për një grup të turistëve. Për të shtuar, ngjarjet reaktive, të cilat mund të bëjnë planin paraprak të papërdorshëm do të adresohen për mes krijimit të një algoritmi që do të reagoj në kohë reale. Në mënyrë që të parashikohet se do të jetë i kënaqur një turist i caktuar nëse viziton një pikë të caktuar, profilet individuale të anëtarëve të grupit turistik do të analizohen përmes përdorimit të analizës së rrjetave sociale.

Zhvillimi konceptual

Krijimi i prototipit të sistemit do bëhet në tërësinë e tij i ri, duke krijuar çdo njësi të tij që nga fillimi. Megjithatë, planifikohet të përdoren, aty ku është e mundur, vegla ekzistuese për njësitë periferike të sistemit. Figura 1 ilustron arkitekturën e sistemit të paraparë, dhe më pastaj komponentët e tij përshkruhen shkurtimisht.




Figura 1 Arkitektura e sistemit të propozuar

Të dhënat hyrëse

Sistemi do të ketë në hyrje të dhënat vijuese:

- *Detajet e udhëtimit* (p.sh. data e fillimit, numri i ditëve, numri i turistëve, lokacioni i fillimit të udhëtimit etj.)
- *PI-të* që janë dispozicion për t'u vizituar në një rajon apo qytet të caktuar. Atributet e një pike të interesit përfshijnë tipin (p.sh. arkeologji, arkitekture, art klasik etj.), kategorinë (p.sh. monument, kështjellë, park etj.), koordinatat, çmimi i biletës hyrëse, kohëzgjatja e vizitës, orari i punës, etj. Në mënyrë që të testohet funksionimi i prototipit të sistemit, një listë prej rreth 150 PI-ve, që gjenden në territorin e Kosovës, do të përdoret.
- *Profili social* përshinë të dhënat nga turistët dhe "Revjuesët" (të cilët ose janë persona profesional në përcaktimin e tipareve të PI-ve ose turist të mëhershëm). Këto të dhëna do të mblidhen nga rrjetet sociale siç janë Facebook, Tweeter etj. Aplikacione përkatëse për rrjetat e veçanta sociale do të krijohen me qëllim që të mblidhen të dhënat siç janë mosha, gjinia, vendi i banimit dhe profesioni.
- *Faktorët e kënaqësisë* të përcaktuar nga Revjuesët për PI-të që janë në dispozicion për t'u

vizituar në rajoni apo qytetin ku zhvillohet udhëtimi.

Parashikimi i interesit të turistëve

Një metodë e bazuar në analizën e rrjetave sociale do të zhvillohet për parashikimin/estimimin e interesit të turistëve. Me tutje, metoda do të avancohet që të mundësoj gjenerimin e nën grupeve të turistëve, gjë që do të ndikoj në shpejtimin e procesit të planifikimit të itinerarit të udhëtimit dhe në ngritjen e përgjithshme të kënaqësisë së turistëve. Performanca e metodës do të analizohet duke përdorur matës të ndryshëm nga analiza e rrjetave sociale, siç janë klikat (cliques), nën komponentët (sub-components), qendërsia (centrality) apo eigen vector. Në bazë të analizës së bërë, do të krijohet një algoritëm që do të mundësoj parashikimin sa më adekuat të interesit të turistëve duke përfshirë matësit e përmendur.

Algoritmi për krijimin e itinerarit të udhëtimit

Për të arritur një përgjigje në kohë reale për gjenerimin e itinerarit të udhëtimit, nevojitet që të aplikohet një metodë kërkuese efikase. Problemi i ashtuquajtur "Multi Constrained Team Orienteering Problem with Time Windows (MCTOPTW)" [9] mund të për të modeluar problemin e planifikimit të udhëtimit për një turist të vetëm. Ky problem do të zgjerohet në problemin MC *Multiple* TOPTW (MCMTOPTW), në mënyrë që të mund të modelohet problemi për rrugë të shumëfishta gjatë turneut njëditor. Parashihet që të aplikohet metoda kërkuese Taboo Search për të hulumtuar hapësirën kërkuese të zgjidhjeve të mundshme. Operatorët që konsiderohen të përdoren për të hulumtuar fqinjësinë e zgjidhjes aktuale janë: *Shkëmbje* (një pikë në itinerar me një pikë jashtë itinerari), *Inserto* (një pikë të re në itinerar) dhe *Bëjë Rotacion* (me disa pika të zgjedhura rastësisht në itinerar).

Menaxhimi i udhëtimit / Simulimi i ngjarjeve reaktive

Përderisa turistët do të jenë në fazën e realizimit të udhëtimit të tyre, itinerari paraprakisht i përgatitur mund të bëhet i papërdorshëm (në pjesë të caktuara të tij) si rezultat i ngjarjeve të ndryshme që mund të ndodhin. Andaj, fizibiliteti i itinerarit të përgatitur do të vëzhgohet nga një njësi qendrore, që do të bëjë sistemin të reagoj në raste të ndodhjeve të ngjarjeve të caktuara. Ngjarjet mund të iniciohen nga vet turistët (p.sh. kërkesë për një pauze apo një turist i ri i bashkëngjitet grupit) apo nga njësi simulative e ngjarjeve (p.sh. ndryshimi i motit, mundësi për të vizituar pika të reja, ngjarje jo të rregullta, tollovi në trafik etj.). Për më shumë, njësi qendrore do të ketë detyrën e realizimit të komunikimit në mes të moduleve të ndryshme të sistemit, duke përfshijë këtu edhe informatat mbi kontekstin e turistëve (lokacioni, koha dhe numri i turistëve).

Rezultatet e pritura

Në këtë punim, në të cilin, në formë të propozimit, paraqitem zhvillimin konceptual të sistemit, dallojmë katër kontribute kryesore shkencore, si në vijim: (1) algoritmi për planifikimin itinerarit për udhëtim grupor me tipare reaktive, (2) implementimi i prototipit, (3) simulatori i ngjarjeve reaktive dhe (4) metoda për parashikimin e interesit të turistëve.

Për më shumë, pas përfundimit të punës së paraparë, do të paraqesim konceptet teorike për të zgjedhur problemin në fjalë, duke përfshirë edhe reprezentimin matematikore të tij. Demonstrimi i tipareve reaktive dhe atyre grupore të sistemit të paraparë, do të bëhet përmes kryerjes së eksperimenteve me të dhënat testuese të cilat do të krijohen për këtë qëllim.

Recensentët:

KUMTESA

*Prof. Dr. Agni Dika dhe
Prof. asc. Dr. Blerim Rexha*

**Rrahim MAKSUTI¹, Hamit MEHMETI², Mursel RAMA¹, Malush MJAKU³:
ANIZOTROPIA E VETIVE MEKANIKE E ÇELIKUT TË PETËZUAR NË TË
NXEHTË**

¹Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë, Universiteti i Prishtinës

²UBT-Universiteti për Biznes dhe Teknologji

³Ministria e arsimit e shkencës dhe teknologjisë

ABSTRAKTI

Çeliku i petëzuar në të nxehtë si rrjedhojë e historikut të prodhimit, përkatësisht përpunimit shfaq anizotropi të vetive mekanike, d.m.th., shfaq veti të ndryshme mekanike në drejtime të ndryshme dhe sjellja, përkatësisht qëndresa e këtillë e çelikut të petëzuar në të nxehtë ushtron ndikim përcaktues në cilësinë e produkteve që prodhohen nga ky çelik. Prandaj, vetitë mekanike të çelikut të petëzuar në të nxehtë duhet njohur paraprakisht, përkatësisht para përdorimit si lëndë e parë për prodhimin e produkteve të ndryshme.

Në këtë punim është shqyrtuar anizotropia e vetive mekanike e çelikut të petëzuar në të nxehtë (S355 EN 10025:2004) dhe të mbështjellë në lëmsha (bobina), që përdoren për prodhimin e gypave të salduar, nëpërmjet përcaktimit eksperimental të vetive mekanike dhe analizës metalografike.

Fjalët çelës: anizotropia, vetitë mekanike, çeliku.

1. HYRJE

Petëzimi është metodë e përpunimit plastik të metaleve, që realizohet me ndihmën e cilindrave petëzues të cilët rrotullohen me kahje të kundërt me ç' rast lënda e parë tërhiqet në hapsirën midis cilindrave petëzues dhe deformohet duke u holluar, duke u zgjeruar dhe duke u zgjatur /1,2/, figura 1.




Fig. 1. Skema e petëzimit

Gjatë përfundimit të produkteve të formës petashuqe me petëzim, përveç ndryshimit të formës dhe të përmasave ndryshojnë edhe vetitë fiziko-mekanike si rrjedhojë e ndryshimit të mikrostrukturës /2/, figura 2.




Fig.2. Ndryshimi i vetive mekanike gjatë petëzimit

Deformimi gjatë procesit të petëzimit shkakton ndryshim të konsiderueshëm të mikrostrukturës si në pikëpamje të madhësisë së kokrrizave kristalore poshtu edhe në pikëpamje të orientimit të tyre në drejtime të caktuara, varësisht nga kahu dhe intensiteti i deformimit, figura 3.




Fig.3. Orientimi i mikrostrukturës gjatë petëzimit në të nxehtë

Orientimi i privilegjuar i mikrostrukturës njihet me termin teksturë e deformimit /3,4,5 /, ndërsa në rastin konkret quhet teksturë e petëzimit.

Si rrjedhojë e orientimit të këtyllë të mikrostrukturës (teksturës së petëzimit) vjen deri te:

- ndryshimi i vetive mekanike,
- ndryshimi i vetive optike,
- ndryshimi i vetive magnetike,
- ndryshimi i vetive termike,
- ndryshimi i vetive elektrike,
- ndryshimi i qëndrësës ndaj korrozionit, etj.

Dukuria e shfaqjes së vetive të ndryshme në drejtime të ndryshme njihet me termin anizotropi.

Anizotropia rrjedh nga fjalët greke: *aniso*, që do të thotë i ndryshim (diferencë) dh *tropos*, që do të thotë drejtim, pra veti të ndryshme në drejtime të ndryshme /6/. Koncepti i anizotropisë është mjaft i rëndësishëm, sepse pasqyron vetitë e materialit, përkatësisht detalit në varësi të drejtimit.

Vlen të theskohet se përveç se në raste të rralla që mund të shfaqë efekt dobipurrës, anizotropia e vetive mekanike gjithmonë shfaq efekt keqbërës. Ndonëse mënjanimi i plotë i saj është tejet i vështirë, duhet përcjellur dhe analizuar intensitetin e shfaqjes së ndikimit keqbërës të anizotropisë së vetive mekanike.

Te produktet e petëzuara në të nxehtë dhe në të ftohtë vjen deri te shfaqja e anizotropisë së vetive mekanike, përkatësisht shfaqja e vetive të ndryshme mekanike në drejtime të ndryshme.

Duke e pasur parasysh këtë, në punim shqyrtohet anizotropia e vetive mekanike të llamarinës së petëzuar që përdoret për prodhimin e gypave.

2. PJESA EKSPERIMENTALE

2.1. Materiali

KUMTESA

Në këtë punim shqyrtohet efekti i anizotropisë së vetive mekanike të çelikut të petëzuar në të nxehtë, S355 EN 10027:2003, që përdoret si lëndë e parë për prodhimin e gypave të salduar me tegel spiral dhe gjatësor. Ky çelik është i prodhuar në formë të shiritit me petëzim në të nxehtë (SHPN) dhe i mbështjellë në lëmsha (bobina-coils), figura 4.




Fig.4. Shiriti i çelikut i petëzuar në të nxehtë (SHPN)

Përbërja kimike dhe vetitë mekanike të çelikut S355 të prodhuar në formë shiriti me petëzim në të nxehtë SHPN, sipas Çertifikatës së prodhuesit (nr.00371), prezantohen në tabelën 1, përkatësisht 2.

Tab.1. Përbërja kimike e çelikut S355

| Çeliku | Përbërja kimike | | | | | | |
|--------|-----------------|------|------|-------|-------|-------|------|
| | C | Mn | Si | P | S | Al | Cu |
| S355 | % | | | | | | |
| | 0.17 | 1.28 | 0.08 | 0.021 | 0.021 | 0.047 | 0.09 |

Tab.2. Vetitë mekanike të çelikut S355

| Çeliku | Vetitë mekanike | | | | |
|--------|-----------------|-----|-------|------|------------|
| | Re | Rm | Re/Rm | A | Kv (-20°C) |
| S355 | MPa | | | 0.75 | % |
| | 403 | 537 | 23.3 | | 61 |

2.2. Provat

Me qëllim të përcjelljes së anizotropisë së vetive mekanike të shiritit të petëzuar në të nxehtë (SHNP) janë realizuar këto prova:

2.2.1. Prova në tërheqje

2.2.1.1. Përcaktimi i kufirit të rrjedhshmërisë (Re),

2.2.1.2. Përcaktimi i qëndrueshmërisë maksimale (Rm),

2.2.1.3. Përcaktimi i raportit (Re/Rm),

2.2.1.4. Përcaktimi i zgjatimit relativ (A),

2.2.2. Prova e viskozitetit dinamik (Kv)

2.2.3. Matja e fortësisë (HV30/15).

Për realizimin e këtyre provave janë marrë mostrat nga shiriti i petëzuar në të nxehtë, sipas skemës së dhënë në figurën 5.




Fig.5. Skema e marrjes së mostrave për prova

3. REZULTATET DHE DISKUTIMI

Prova në tërheqje është realizuar në makinën universale për prova, MOHR-FEDERHAFF-LOSENHAUSEN dhe rezultatet e fituara prezantohen në tabelën 3.

Tab.3. Rezultatet e provës në tërheqje

| Nr. i provës | Prova në tërheqje | | | | | | | |
|-----------------------|-------------------------|------------|-------------|--------------|-------------------------|------------|-------------|--------------|
| | Drejtimi transversal -T | | | | Drejtimi longitudinal-L | | | |
| | Re | Rm | A | Re/Rm | Re | Rm | A | Re/Rm |
| | MPa | | % | | MPa | | % | |
| 1. | 442 | 540 | 26.2 | 0.818 | 418 | 531 | 32.6 | 0.787 |
| 2. | 405 | 517 | 29.2 | 0.783 | 368 | 509 | 33.6 | 0.722 |
| 3. | 430 | 540 | 25.6 | 0.796 | 401 | 520 | 31.2 | 0.771 |
| Vlera mesatare | 426 | 532 | 27.0 | 0.799 | 396 | 520 | 32.4 | 0.760 |

Prova e viskozitetit dinamik (Kv) është realizuar në lavjerrësin e Charpy-it, MOHR-FEDERHAFF-LOSENHAUSEN, në temperaturën (-20°C) dhe rezultatet e fituara prezantohen në tabelën 4.

Tab.4. Rezultatet e provës së viskozitetit dinamik (Kv)

| Nr. i provës | Prova e viskozitetit dinamik (Kv) | | | | | | | |
|-------------------|-----------------------------------|------|------|------|-------------------------|-----|-----|-----|
| | T= -20°C | | | | | | | |
| | Drejtimi tangjencial -T | | | | Drejtimi longitudinal-L | | | |
| | Kv1 | Kv2 | Kv3 | Kv | Kv1 | Kv2 | Kv3 | Kv |
| J/cm ² | | | | | | | | |
| 1. | 45.5 | 45.1 | 45.1 | 45.2 | 143 | 186 | 158 | 162 |
| 2. | 58.2 | 58.4 | 57.8 | 58.1 | 186 | 151 | 180 | 172 |

KUMTESA

| | | | | | | | | |
|-----------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|------------|------------|------------|------------|
| 3. | 52.1 | 54.4 | 55.3 | 53.9 | 166 | 157 | 168 | 164 |
| Vlera mesatare | 51.9 | 52.6 | 52.7 | 52.4 | 165 | 165 | 169 | 166 |

Matja e fortësisë (HV30/15) është realizuar në tre drejtime (transverzal-T, longitudinal-L dhe në shtresën sipërfaqësore-S) sipas skemës së dhënë në figurën 6.




Fig.6. Pozicionet e matjes së fortësisë (HV30/15)

Rezultatet e matjes së fortësisë (HV30/15) prezantohen në tabelën 5.

Tab.5. Rezultatet e matjes së fortësisë (HV30/15)

| Nr. i provës | Fortësia HV 30/15 | | | | | | | | | | | | | | |
|-----------------------|------------------------|----|----|----|----|-------------------------|----|----|----|----|-------------------------|----|----|----|----|
| | Drejtimi transversal-T | | | | | Drejtimi longitudinal-L | | | | | Shtresa sipërfaqësore-S | | | | |
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 1. | 16 | 18 | 16 | 18 | 18 | 17 | 16 | 17 | 18 | 17 | 18 | 18 | 17 | 18 | 17 |
| | 8 | 5 | 8 | 5 | 7 | 8 | 8 | 8 | 5 | 8 | 7 | 5 | 8 | 5 | 8 |
| 2. | 17 | 17 | 17 | 18 | 18 | 17 | 16 | 16 | 16 | 17 | 18 | 18 | 18 | 18 | 18 |
| | 7 | 5 | 0 | 5 | 7 | 7 | 7 | 5 | 7 | 7 | 5 | 8 | 7 | 6 | 5 |
| 3. | 17 | 17 | 18 | 18 | 18 | 17 | 16 | 16 | 17 | 16 | 18 | 17 | 18 | 18 | 18 |
| | 8 | 7 | 6 | 5 | 1 | 7 | 8 | 6 | 7 | 8 | 5 | 8 | 5 | 8 | 5 |
| Vlera mesatare | 17 | 17 | 17 | 18 | 18 | 17 | 16 | 17 | 17 | 17 | 18 | 18 | 18 | 18 | 18 |
| | 4 | 9 | 5 | 5 | 5 | 7 | 8 | 0 | 6 | 4 | 6 | 4 | 3 | 6 | 3 |
| | 180 | | | | | 173 | | | | | 184 | | | | |

Vlera mesatare e kufirit të rrjedhshmerisë në drejtimin transversal ($R_e=426\text{MPa}$) është më e madhe se vlera mesatare e kufirit të rrjedhshmerisë në drejtimin longitudinal ($R_e=396\text{MPa}$), për 7.57%, ndërsa qëndrueshmëria maksimale në drejtimin transversal ($R_m=532\text{MPa}$) poashtu është më e madhe se qëndrueshmëria maksimale në drejtimin longitudinal ($R_m=520\text{MPa}$), për 2,30%. Viskoziteti dinamik në drejtimin transversal ($K_v=52.4\text{J/cm}^2$) është më i vogël se viskoziteti dinamik në drejtimin longitudinal ($K_v=166\text{J/cm}^2$), për 3.16 herë dhe ky është dallimi më i madh që shfaqet te shiritat e e petëzuar në të nxehtë (SHPN) dhe gjithsesi duhet të merret parasysh gjatë përdorimit të SHNP si gjysmëprodukt, gjegjësisht lëndë e parë për prodhimin e produkteve të gatshme në përgjithësi dhe për prodhimin e gypave të salduar në veçanti.

4. PËRFUNDIMI

Në bazë të shqyrtimit të literaturës nga fusha përkatëse dhe në bazë të rezultateve eksperimentale mund të konkludohet:

Anizotropia e vetive mekanike të SHPN është e theksuar dukshëm si në aspektin e rezistencës ndaj deformimit (R_e , R_m , R_e/R_m , H) poashtu edhe në aspektin e aftësisë për

deformim (A).

Anizotropia e viskozitetit dinamik (K_v) të SHPN shfaq efekt më të theksuar ashtu që viskoziteti dinamik në drejtimin longitudinal-L është afro 3x më i madh se viskoziteti dinamik në drejtimin transversal-T. Ky është dallimi më i madh që shfaqet ndërmjet këtyre dy drejtimeve të SHPN dhe gjithsesi duhet marrë parasysh gjatë përdorimit të SHPN për prodhimin e gypave të salduar.

Recensentë:

Prof. Dr. Milajete Shala-Mehmeti

Prof. Dr. Edmond Hajrizi

KUMTESA

Msc. Vehbi NEZIRI¹: ROLI I TEKNOLOGJISË NË E-DEMOKRACI – RASTI I KOSOVËS

¹Agjencia Kosovare e Pronës

Përmbledhje

Në vitet e fundit Kosova pati një rënie të dukshme të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset politike në përgjithësi, e në procesin zgjedhor në veçanti. Nisur nga kjo, shihet se nevojitet një veprim i përnjëhershëm në drejtim të gjetjes së mënyrave të reja të motivimit të qytetarëve për të marrë pjesë dhe për të pasur rol në këto procese. Përhapja e shpejtë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit-TIK në Kosovën e pasluftës mund të shërbejë si bazë e mirë për zhvillimin e e-demokracisë e me theks të veçantë të procesit zgjedhor. Se si, sa dhe në cilën fazë të sistemit zgjedhor përdoret o do të mund të përdorej TIK-u në promovimin e demokracisë me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të qytetarit është qëllim i këtij punimi. Në punim po ashtu diskutohet edhe roli i TIK-ut në proceset zgjedhore demokratike dhe njëkohësisht jepen rekomandimet praktike të lehtësimit dhe të përmirësimit të këtyre proceseve.

Fjalë çelës: teknologjia e informacionit, e-demokracia, procesi demokratik, proces zgjedhor, proces politik

1. Hyrja

Zhvillimi i hovshëm shkencës dhe teknologjisë, sidomos ky i dhjetëvjetëshit të fundit, vendeve demokratike ua ka lehtësuar proceset e komunikimit me qytetarët e tyre. Sot në vendet demokratike marrëdhënia në mes qytetarëve dhe qeverive ka ndryshuar dukshëm dhe, kjo kryesisht për shkak të rolit në rritje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimeve. Tashmë, mund të thuhet se, teknologjia ka ndikim të madh në jetën politike, si mjet i cili ndihmon dhe bën transparent veprimtarinë e përditshme politike. Shumë vende janë në rrugën e ndërtimit dhe të praktikimit të sistemeve demokratike, megjithëse rruga drejt demokracisë, qoftë asaj klasike qoftë asaj elektronike, është e mundimshme dhe e vështirë. Vështirësive u kontribuon dhe përcaktimi i drejtë se çka është dhe çka përfaqëson demokracia e vërtetë? Pjesëmarrja dhe gatishmëria, janë parakusht shumë i rëndësishëm i ndërtimit të sistemit demokratik. Prandaj angazhimi i qytetarëve me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë aktive në jetën publike përmirëson dukshëm rolin dhe rëndësinë e

demokracisë. Punimi karakterizohet me elemente shumëdimensionale duke trajtuar fuqinë dhe rolin e teknologjisë në demokraci. E gjithë rëndësia dhe roli që ka teknologjia, e bën atë një faktor të rëndësishëm në sistemin demokratik në përgjithësi e veçanti në sistemin zgjedhor i cili merret si procesi kryesor i demokracisë. Procesit zgjedhor si proces tejet kompleks dhe gjithëpërfshirës i cili ka ndikim të madh në përcaktimin e fatit të vendit dhe në çështjet për të cilat zhvillohet, sot në shumicën e vendeve demokratike zhvillohet saktë, shpejtë dhe si duhet mu falë teknologjisë e cila i përcakton mekanizmat për organizimin, mbikëqyrjen dhe zhvillimin e procesit zgjedhor saktë e pa hile. Një ndër motivet kryesore të këtij punimi është që të identifikohen faktorët kyç që garantojnë zbatimin e suksesshëm të projekteve të e-demokracisë. Teknologjitë e reja dhe komunikimi në praktikë janë jashtëzakonisht të dobishëm për qeveritë, në promovimin e transparencës së aktiviteteve, nxitjen e interesit të publikut për atë që ndodh në parlamentet lokale dhe nacionale dhe përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse.

2. Gjendja Aktuale

E-demokracia përshkruhet si përdorimi i gjerë i TIK-ut për të rritur angazhimin e qytetarëve në proceset demokratike [[HYPERLINK \l "Mil10" 1](#)]. Zhvillimi i modeleve të ndryshme të e-demokracisë është përfitues për të gjitha palët e interesuara. Së pari, për qytetarët, pasi ata mund të shprehin dhe të shkëmbejnë pikëpamjet e tyre për rritjen e ndërveprimit, duke e bërë komunikimin sa më shumë horizontal. Së dyti, për partitë politike, sepse e-demokracia kontribuon në uljen e deficitit demokratik dhe, në rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset politike. Së treti, për qeveritë, pasi ato zbatojnë transparencën dhe llogaridhënien në çështjet publike me aplikimin e modelit të qeverisë së hapur me të dhëna të hapura dhe kanale të hapura të komunikimit 2]. Sot edhe vendet e vogla, me popullatë si Kosova, mbështetin demokracitë e tyre në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimeve. Vlen të përmendet Estonia, e cila me një angazhim të madh në e-demokraci është bërë shembull i Bashkimit Evropian dhe, prej të cilës kuadri profesional i qeverisë së Kosovës ka përfutur shumë. Institucionet demokratike në Estoni si në shumë shtete të reja, ishin të brishta dhe besimi në qeverisje ishte tejet i ultë. Mirëpo, pas pranimit të saj në BE dhe NATO, Estonia u përqendrua në përmirësimin e pjesëmarrjes si dhe nxitjen e reflektimit nga qytetarët. Ndër problemet kryesore me të cilat u ballafaqua Estonia ishte brishtësia e strukturave të shoqërisë civile, pjesëmarrja e ulët e votuesve dhe reputacioni i ulët i partive politike [[HYPERLINK \l "Mic07" 3](#)]. Për të kapërcyer këto pengesa, parlamenti estonez krijoi *Konceptin e Zhvillimit të Shoqërisë Civile* me qëllimin e vetëm që të krijohen dhe të promovohen strategji të përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes politike nëpërmjet përdorimit të TIK-ut. Estonia u bë vendi i parë për mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme përmes internetit të bazuara ligjërisht, me pilot projektin e zgjedhjeve komunale në vitin 2005. Sistemi elektronik i votimit përballoi testin real dhe u shpall një sukses nga zyrtarët e zgjedhjeve të Estonisë 4]. Ky sistem i votimit tashmë është përdorur në disa palë zgjedhje dhe është treguar mjaft efikas, sidomos në rritjen e pjesëmarrjes së votuesve. Për këtë tregojnë edhe statistikat nga faqja zyrtare e *Komitetit Zgjedhor Kombëtar Estonian*, ku në zgjedhjet lokale të mbajtura në vitin 2005, përmes interneti kanë votuar vetëm 9,317 votues ose më pak se 0.9% e votuesve me të drejtë vote, kurse në zgjedhjet parlamentare të mbajtura në vitin 2011, përmes interneti kanë votuar 140,764 votues ose rreth 15.4% [[HYPERLINK \l "Vab12" 5](#)]. Edhe vendet me popullatë më të madhe se Kosova, e me një zhvillim më të madh nuk kanë një traditë të madhe në e-demokraci. Marrim rastin e Italisë, e cila ka filluar të

eksperimentojë në e-demokraci tek në vitin 2003. Megjithatë, ajo ka një koleksion të fuqishëm të projekteve në përgjithësi, si dhe një përqendrim jashtëzakonisht të lartë të aktiviteteve të orientuara drejt diskutimeve specifike. Në nivel kombëtar, Italia ka një organizëm të posaçëm të qeverisë të quajtur CNIPA (Qendra Kombëtare e Administratës Publike dhe Informatikës) 3] roli i të cilit është stimulimi, mbështetja dhe promovimi i përdorimit të TIK-ut brenda organeve publike. Në Itali, si në shumicën e demokracive perëndimore, çështjet kryesore me të cilat përballet komuniteti politik janë mungesa e interesit dhe publiku gjithnjë e më i painformuar. Për sa i përket e-demokracisë, Italia ka një ndarje digjitale të theksuar në mes veriut dhe jugut, ku pjesa jugore ka një mungesë të depërtimit të TIK-ut derisa në veri ai ka depërtuar në të gjitha poret e jetës. Përkundër këtyre pengesave, ka shembuj të ndritshëm që tregojnë se si e-demokracia lokale është duke u zbatuar në Itali. Në Komunën Argenta, një qytet i vogël në Emilia-Romagna, ka krijuar një hapësirë në internet, ku qytetarët për ngjarje të rëndësishme marrin pjesë aktive duke bërë propozime ose peticione me anë të formularëve të posaçëm ose nëpërmes dhomës së diskutimit online. Projekti bazohet në letërnjoftimin (kartën e identitetit), me veçori të kartelës smart, për identifikim të saktë të përdoruesit.

3. Roli i teknologjisë në e-demokraci

Qëllimi kryesor i e-demokracisë është rritja e transparencës së proceseve politike dhe demokratike me përfitim nga përdorimi i TIK-ut dhe duke e sjell informacionin: për dhe tek qytetarët. Ekzistojnë dy lloje më të theksuara të iniciativave për transparencë. Lloji i parë thjesht siguron një burim qendror të informacionit në lidhje me qeverinë dhe aktivitetet të cilat i zhvillon ajo. Lloji i dytë i iniciativës së e-demokracisë, e cila punon për të rritur transparencën dhe, për t'i bërë sa më masive aktivitetet e qeverisë është përdorimi i TIK-ut e sidomos i *ueb teknologjive*. Kjo mënyrë shpeshherë paraqet informacionin e zgjedhur për qytetarin duke i paraqitur atij atë që ai dëshiron. Lloji i dytë i e-demokracisë promovon pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin qeverisës. Tek lloji i dytë ekzistojnë tri nën ndarje të mëdha. Lloji i parë është procesi i drejtpërdrejtë i votimit e që u lejon qytetarëve të votojnë online ose përmes votimit elektronik [[HYPERLINK \l "Veh11" 6](#)]7]. I dyti, dhe deri tani më i zakonshmi është *reagimi i qytetarëve* ose *e-konsultimi*. Qytetarët përveç që marrin informacionet duhet që të krijojnë edhe një mendim dhe atë ta përcjellin tek qeveria, p.sh duke plotësuar pyetësorët e ndryshëm online për nivele të ndryshme të qeverisjes. Lloji i tretë u ofron qytetarëve mundësi të pjesëmarrjes aktive në proceset politike dhe është relacion i bazuar në partneritet, në të cilin qytetarët angazhohen aktivisht në procesin e vendimmarrjes. P.sh duke dhënë reagimin për alokimin e buxhetit, duke dhënë propozime për nene të caktuara të ligjeve, iniciativa të ndryshme online e kështu me radhë. Figura 2 jep pamjen vizuale të këtyre tri llojeve të e-demokracisë - ndërtimit të kapaciteteve të demokracisë. Një proverb i vjetër kinez thotë “*Më thuaj, unë do të harroj, Më trego, dhe unë do të kujtohem, Më përfshij, dhe unë do të të kuptoj*”, prandaj është me rëndësi që shqetësimet e qytetarëve të thuhet (informimi), të tregohen (konsultimi) dhe të përfshihen(participimi).




Figura 2: Objektivat e e-demokracisë

Sipas rekomandimit të Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare të BE [[HYPERLINK \l "Cou09" 8](#)], e-demokracia përfshin e-parlamentin, e-legjislacionin, e-drejtësinë, e-ndërmjetësimin, e-mjedisin, e-takimin, e-votimin, e-konsultimin, e-pjesëmarrjen, e-peticionin, e-iniciativën, e-fushatën, e-anketën etj. Akti më i lartë i Kosovës, Kushtetuta e saj, në Nenin 3, Pika 1 e përcakton Kosovën shtet demokratik i cili qeveriset në mënyrë demokratike 9]. Republika e Kosovës është duke e përafuar dukshëm legjislacionin e saj me atë të Bashkimit Evropian duke e mbështetur zhvillimin e mirëfilltë të demokracisë. Për vendosjen e standardeve dhe shërbimeve të teknologjisë, Departamenti i e-Qeverisjes dhe Proceseve Administrative ka hartuar strategjinë për e-qeverisje 2009-2015 dhe planin e veprimit [[HYPERLINK \l "Qev12" 10](#)]. Po ashtu janë miratuar ligjet që trajtojnë sigurinë e të dhënave personale dhe ligji për shërbimet e shoqërisë informative 11]. Kosova ka një demokraci të tërthortë parlamentare, me disa instrumente të tjera të demokracisë së drejtpërdrejtë. Kjo do të thotë se ligjet nuk bëhen nga njerëzit, por nga përfaqësuesit e zgjedhur, nga organet parlamentare. Prandaj është shumë e rëndësishme që këto organe të rrisin pjesëmarrjen e qytetarëve, ku qytetarët do të mund të merrnin pjesë aktive për të diskutuar rreth projekt ligjeve dhe rreth gjërave të tjera me rëndësi, të cilat diskutohen në organet parlamentare. Portali qeveritar, ueb faqja e Kuvendit të Kosovës, ueb faqet e kuvendeve komunale dhe ueb faqet e ministrive japin informacione për disa nga aktivitetet e tyre, por jo gjithëherë janë të përditësuara me informacione rreth aktiviteteve të fundit. Kur dihet që popullata e Kosovës ka një moshë të re dhe kjo rini është potencial i përdorimit të teknologjisë, atëherë institucionet duhet që të mundësojnë komunikim aktiv të qytetarëve me institucionin e tyre duke mundësuar qasjen përmes teknologjive dhe platformave të ndryshme. Komunikimi duhet të jetë dy-kahesh, Figura 3, ku qytetari do të komunikojë me politikëbërësit dhe anasjelltas.




Figura 3: Qytetarët dhe e-institucionet

Për të rritur transparencën e cila ndikon drejtpërdrejt në demokraci, puna dhe aktivitetet e institucioneve duhet që të pasqyrohet në medime të ndryshme a në ueb sajtet e tyre si p.sh duke publikuar vendimet, aktivitetet dhe transkriptet audio vizuale të takimeve që kanë të bëjnë me jetën e qytetarëve. Që qytetarët të mund të krijojnë një mendim për një projekt të caktuar, është më rendësi që të krijohen e-debate ku qytetarët do të mund të komunikonin me politikëbërësit dhe të njoftoheshin me hollësisht ose edhe të krijohen pyetësorë online përmes të cilëve qytetarët do jepnin vërejtjet dhe sugjerimet e tyre. Ajo çka është më e rëndësishmja në tërë procesin e demokracisë është marrja e një vendimi. Në mënyrë që qytetarët të japin mendimin dhe vendimin e tyre është e nevojshme që të ekzistojnë sisteme të votimit elektronik, por duke u ruajtur fshehtësia dhe identiteti i votuesit. Një model i arkitekturës së votimit elektronik është dhënë në [[HYPERLINK \l "Veh11" 6](#)] dhe mbi këtë model do të mund të ndërtohej modeli i marrjes dhe dhënies së mendimit nga ana e qytetarit.

4. Përfundim

Teknologjitë e reja kanë rol jashtëzakonisht të dobishëm për qeveritë dhe administratën publike në promovimin e transparencës së aktiviteteve të tyre, duke stimuluar dhe rritur interesin e publikut për atë që ndodh dhe duke ofruar mekanizmat për të ndjekur dhe për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes. Nuk ka dyshim se pjesëmarrja qytetare në politikëbërje sjell përfitime të shumta, jo vetëm për qytetarët si përfitues të drejtpërdrejtë, por, edhe në përmirësimin e marrëdhënieve qeveri-qytetar. Prandaj, TIK-u mund të kontribuojë në informimin e mirë të qytetarit rreth çështjeve publike dhe të lehtësojë në masë të madhe debatin dhe marrëdhëniet në mes qytetarëve dhe të zgjedhurve të tyre. Prodhimi i kartave biometrike të identitetit është njëri ndër hapet që duhet të ndërmarrin institucionet, në mënyrë që qytetarët të mund të kenë qasje në sa më shumë sektorë të e-participimit si në e-referendume, e-votime etj. Për zbatimin e shumicës së sektorëve të e-demokracisë nuk nevojitet ndonjë nivel i lartë i financimit sepse në shumicën e institucioneve ekziston infrastruktura teknike sidomos për fazën e informimit, por nevojitet përditësimi i informacioneve.

Recensentë
Dr. tech. Blerim REXHA
Mr. Ali CAKA

KUMTESA

**Msc. Xhemajl MEHMETI¹, Dr.sc. Naser LAJQI², Mr.sc. Shpetim LAJQI²:
ZHVILLIMI I MODELIT TË FUNKSIONIMIT TË MIRËMBAJTJES SË
AUTOMJETEVE QË NGASEN NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

¹Universiteti për Biznes dhe Teknologji

²Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

Qëllimi i punimi është krijimi i modelit të organizimit të funksionimit të mirëmbajtjes së automjeteve që ngasen në Republikën e Kosovës, e cili do të ndikon në rritjen e kapacitetit punues të tyre dhe rritjen e efikasitetit të tyre. Pra objektivi është që të bëhet një model i ri i mirëmbajtjes së automjeteve i bazuar në kushtet klimatike, nivelin e ndotjes së ambientit, kushtet infrastrukturore, shpejtësinë mesatar të ngasjes së automjeteve, etj. Gjithashtu do të paraqitet vjetërsi e automjeteve që ngasen në Republikën e Kosovës, gjendja aktuale e ndërrimit të filtrave vajit, ajrit dhe lëndës djegëse si dhe do të jepen rekomandime për kohën e ndërrimit të tyre në funksion të një jetëgjatësi më të madhe të sistemeve të automjetit.

Modeli i paraqitur në këtë punim mund të përdoret nga ngasësit automjeteve dhe nga kompanitë që merren me mirëmbajtjen e automjeteve në Republikën e Kosovës.

Fjalët kyçe: mirëmbajtja, automjet, ndërrimi i filtrave, ndotje e ambientit.

1. HYRJE

Të gjitha elementet e automjetit, lidhjet e tyre dhe tërësitë funksionale, kanë për detyrë që ta kryejnë misionin e dhënë. Aftësia e sistemit për ta realizuar funksionin e kërkuar karakterizohet me gjendjen e tij në punë. Gjendja në prishje tregon gjendjen e paaftësisë së sistemit që në mënyrën e lartë përmendur ta kryen funksionin e dhënë. Për dëshmi të kësaj, mirëmbajtja ka për detyrë që ta ndalojë apo shtyj gjendjen në “dështim”. Nëse megjithatë kjo gjendje është paraqitur, atëherë mirëmbajtja duhet të sigurojë kthimin e sistemit nga gjendja “*në prishje*” në gjendje “*punë*”. [1]

1.1. Gjendja aktuale e automjeteve në Kosovë

Është fakt i njohur se në Kosovë deri në vitin 1999 numri i automjeteve ka qenë shumë i kufizuar. Brenda 10 viteve të fundit ky numër është rritur me ritëm të shpejtë dhe është mbi 20 herë më i lartë se sa para 10 viteve, ku numri total i automjeteve të regjistruar në vitin 2009 arrin në 419241 automjete. Raporti banor - automjet në Kosovë është 5 banorë për një automjet, por tendencat janë drejt zvogëlimit të këtij raporti.






Fig. 1.1 Automjetet e prodhuesve të ndryshëm që shfrytëzohen në Kosovë, që janë regjistruar në vitin 2009 [1]

Nga fig. 1.1 mund shihet se automjetet e prodhuara në Gjermani përbëjnë shumicën e automjeteve të cilat janë në Kosovë, kjo përqindje është më e lartë se 75 %.

Nga aspekti i klasifikimit, vendin kryesor e zënë veturat me 91 %, kamionët me 8% dhe autobusët me 1% (fig. 1.3). Në bazë të vitit të prodhimit, 88 % të automjeteve janë të prodhuara para vitit 2000 dhe 12% janë prodhuar pas vitit 2000.



që s.



1.3 Automjetet sipas klasifikimit të tyre [1]




Fig. 1.4. Automjetet sipas vitit të prodhimit [1]

Në bazë të fig. 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, mund të nxirret përfundimi se në Kosovë mbizotërojnë veturat me lëndë djegëse benzinë dhe automjetet e prodhuar para vitit 2000.

2. Intervali i ndërrimit të filtrave

Jetëgjatësia e motorit varet nga vajrat cilësore gjegjësisht nga efikasiteti i sistemit të lubrifikimit të motorit dhe nga përdorimi i lëndëve djegëse cilësore. Në tabela 2.1. janë paraqitur intervalet e mirëmbajtjes sipas rekomandimeve të prodhuesit Land Rover për kushte normale të eksploatimit dhe për kushte eksploatuese të Kosovës.

Nga tabela 2.1 shihet se intervali i rekomanduar i ndërrimit të filtrave dhe vajit në Kosovë është pesë herë më

Tab. 2.1. Rekomandimet e ndërrimit të filtrave dhe vajit të prodhuesit Land Rover [2]

| | Për kushte normale | Për kushtet e Kosovës |
|---------------------------|--------------------|-----------------------|
| Filtri i ajrit | 24.000 km | 5000 km |
| Filtri i benzinës | 24.000 km | 5000 km |
| Filtri i vajit të motorit | 24.000 km | 5000 km |
| Vaji i motorit | 24.000 km | 5000 km |

Një numër i madh i faktorëve ndikojnë në zvogëlimin e intervalit të ndërrimit të filtrave dhe vajit, siç janë: cilësia e dobët e vajit, lëndës djegëse, lëngjeve teknike, infrastrukturës jo të mirë rrugore në Kosovë si dhe ndotja e ambientit (pluhurit) e cila është 3 deri në 10 herë më e lartë se sa ajo e lejuar me normat ndërkombëtare. Në një studim të Institutit për Shëndetësi Publike të Kosovës për ndotjen e ajrit të bërë në vitin 2009, rezulton se ndotja e ajrit nga grimcat e suspenduara ka raste kur e kalon 18 herë vlerën maksimale të lejuar me dispozitat ligjore. [1]

Rekomandimet e prodhuesit që mirëmbajtja duhet të realizohet pas çdo 5000 km, bazohen nëse automjeti shfrytëzohet në këto kushte eksploatauese: ngasje në intervale të shpeshta dhe të shkurta, ngasje në ambiente të ndotura, motori punon në shumicën e kohës me numër të vogël të rrotullimeve (hapin bosh), ndryshimet klimatike në intervalet e temperaturave prej -25°C deri 25°C dhe ndalje të shpeshta. [5]

Kur dihet fakti se automjeti punon shumë orë dhe kalon pak kilometra, ka shumë rëndësi që të bëhet ndërrimi i vajit të motorit, filtrit të vajit dhe filtrit të ajrit. Çka do të thotë se motori punon 60 min dhe rruga e kaluar e automjetit është 5 deri 15 km (sipas një studim rezulton se shpejtësia mesatare e vozitjes në Prishtinë është 15 km/h) [1] e cila është shumë më e vogël se te shtetet perëndimore. Për shembull në Gjermani nëse automjeti punon 60 min rruga e kaluar me automjet do të jetë minimum 60 km deri në 100 km. Kushtet e ngasjes së automjetit në Kosovë ndryshojnë jashtë zakonisht nga kushtet e ngasjes në shtetet perëndimore, prandaj prodhuesit rekomandojnë se këto kushte eksploatauese janë kushte të rënda (ekstreme).

Ndërsa intervali i rekomanduar i ndërrimit të filtrit të lëndës djegëse është për shkak të cilësisë së dobët të lëndës djegëse në Kosovë dhe fakti se ngasësit e automjeteve vozisin me sasi minimale të lëndës djegëse në rezervar.

Kur sasia e lëndës djegëse është minimale në rezervar, hapësira mbi nivelin e lëndës djegëse është e mbushur me ajër. Dihet se ajri përbën një sasi të vogël të avullit (lagështisë) dhe kjo lagështi e ajrit tenton të kondensohet brenda rezervarit të lëndës djegëse, sidomos gjatë temperaturave të ulëta. Sasi e kondensuar e ujit mund të shkakton korrozion në pjesët metalike të rezervarit si dhe të përzihet me lëndën djegëse në rezervar duke shkaktuar zvogëlimin e efikasitetit dhe të jetëgjatësisë së sistemit të ushqimit me lëndë djegëse. Nëse mbahet rezervari i lëndës djegëse i mbushur përplot, do të ketë më pakë ajër në rezervar, prandaj ka më pakë mundësi që të kondensohet lagështia e ajrit. Kjo është një arsye e mirë që të mos vozitet kur matësi i nivelit të lëndës djegëse tregon se në rezervar ka pak lëndë djegëse. Një arsye tjetër që të mbahet i mbushur rezervari është që korrozioni i formuar nga lagështia e ajrit tenton të zhvendoset poshtë rezervarit të lëndës djegëse duke e formuar një shtresë të sedimentuar. Kështu që sedimentimi i formuar në fund të rezervarit dhe papastërtitë tjera mund të mos thithen nga pompa nëse do të ketë sasi të mjaftueshme të lëndës djegëse, por nëse niveli i lëndës djegëse do të jetë shumë i ulët, furnizimi i motorit do të bëhet nga fundi i rezervarit dhe lënda djegëse e përzier me papastërtitë shkakton zvogëlimin e performancave të elementeve të sistemit të ushqimit më lëndë djegëse, bllokimin e filtrit, bllokim të gypave, prishje të injektorëve, etj. Disa rezervarë kanë një filtër që parandalon këto papastërti që të hynë në motor, por nëse vazhdimisht vozitet me rezervar të zbrazët filtri mund të bllokohet. [6]

3. Ndikimi i filtrave në jetë gjatësinë e motorit

Shumica e ekspertëve të automjeteve janë të mendimit se pjesët të cilat kanë ndikimin më të madh në jetëgjatësinë e motorit janë filterat, pra me një ndërrim të rregullt të filtrave do të mundësohet një jetëgjatësi më e madhe e motorit me shpenzime të vogla. [3] Ajri i kontaminuar dhe pluhuri janë shumë abraziv (gërryes) dhe në shumicën e rasteve janë shkaktarë kryesor të konsumit të elementeve në motor.

Në bazë të studimeve është konstatuar se 80% të prishjeve të motorit janë shkaktuar nga konsumi. Në mënyrë që të zvogëlohet konsumi i motorit është e nevojshme që të bëhen përmirësime në sistemin e filtrimit. [3]

Në vazhdim është paraqitur përqindja e ndërrimit të filtrave për disa automjete gjatë

periudhës janar-tetor 2010. [4]

Për të gjitha automjetet

Tabela. 3.1. Ndërrimi i filtrave gjatë periudhës janar-tetor të vitit 2010 për të gjitha automjetet. [4]

| Filtrat | Numri | % | Numri | % |
|----------------|-------|------|-------|-----|
| Ajrit | 9260 | 34 | 9260 | 43 |
| Vajit | 12382 | 45 | 12382 | 57 |
| Lëndës djegëse | 5584 | 21 | | |
| Gjithsej | 27226 | 100% | 21642 | 100 |





Fig. 3.1. Ndërrimi i filtrave të automjetve në qendrat e mirëmbajtjes Reforma, Prosche Prishtina, dhe LTG

Automjete e VW

Tabela. 3.2. Ndërrimi i filtrave gjatë periudhës janar-tetor të vitit 2010 për automjet e VW [4]

| Filtrat | Numri | % | Numri | % |
|----------------|-------|-----|-------|-----|
| Ajrit | 2485 | 37 | 2485 | 41 |
| Vajit | 3572 | 53 | 3572 | 59 |
| Lëndës djegëse | 681 | 10 | | |
| Gjithsej | 6738 | 100 | 6057 | 100 |





Fig. 3.2 Në përgjithësi për automjetet VW

Automjetet e Mercedesit

Tabela. 3.3. Ndërrimi i filtrave gjatë periudhës janar-tetor të vitit 2010 për automjete Mercedes [4]

| Filtrat | Numri | % | Numri | % |
|----------------|-------|-----|-------|-----|
| Ajrit | 632 | 35 | 632 | 47 |
| Vajit | 700 | 39 | 700 | 53 |
| Lëndës djegëse | 455 | 26 | | |
| Gjithsej | 1787 | 100 | 1332 | 100 |




Fig. 3.3. Ndërrimi i filtrave të automjeteve Mercedes

Automjete e Audisë

Tabela. 3.4. Ndërrimi i filtrave gjatë periudhës janar-tetor të vitit 2010 për automjete Audi [4]

| Filtrat | Numri | % | Numri | % |
|----------------|-------|-----|-------|-----|
| Ajrit | 508 | 33 | 508 | 45 |
| Vajit | 631 | 42 | 631 | 55 |
| Lëndës djegëse | 384 | 25 | | |
| Gjithsej | 1523 | 100 | 1139 | 100 |





Fig. 3.4. Ndërrimi i filtrave të automjeteve Audi

Për automjetet tjera

Tabela. 3.5. Ndërrimi i filtrave gjatë periudhës janar-tetor të vitit 2010 për automjete tjera [4]

| Filtrat | Numri | % | Numri | % |
|----------------|-------|-----|-------|-----|
| Ajrit | 4060 | 32 | 4060 | 43 |
| Vajit | 5479 | 44 | 5479 | 57 |
| Lëndës djegëse | 2994 | 24 | | |
| Gjithsej | 12533 | 100 | 9539 | 100 |






Fig.3.5. Ndërrimi i filtrave të automjeteve tjera

Siç vërehet nga tabelat dhe diagramet e mësipërm, ndërrimit i filtrave nuk është realizuar në mënyrë të rregullt, gjegjësisht sipas rekomandimeve të prodhuesve.

Nëse analizohen ndërrimi i filtrave të ajrit dhe vajit vërehet se te të gjitha automjetet e kemi një ndërrim afërsisht të njëjtë (me një diferencë $\pm 5\%$), ku filtrat e vajit kanë një përqindje prej 55 % dhe të ajrit prej 45%. Prandaj mund të konstatohet se është shqetësues fakt sa i përket ndërrimit të filtrave, ku mund të vërehet se filtrat e ajrit kanë një zëvendësim më të vogël se sa filtrat e vajit, ndërsa duke u bazuar në rekomandimet e prodhuesve filtri i ajrit do të duhej të ishte zëvendësuar në kohë të njëjtë me filtrin e vajit ose më shpesh se sa filtri i vajit. Kjo bazohet në faktin se pjesa që është ekspozuar më së shpeshti pluhurit dhe papastërtive është pikërisht filtri i ajrit. Njëri ndër faktorët kryesor të cilin e shkakton ndotja e vajit dhe zvogëlimin e performansave të filtrit të vajit është pluhuri, pra sa më shpesh që të zëvendësohet filtri i ajrit do të kemi një jetë gjatësi më të lartë të vajit dhe filtrit të vajit.

Si që shihet nga tabelat dhe diagramet filtri i lëndës djegëse ka një përqindje të ndërrimit më të ultë se sa filtrat e ajrit dhe vajit, ky ndryshim do të ishte i justifikueshëm nëse cilësia e lëndës djegëse do të ishte e lartë (sipas standardeve). Por siç dihet cilësia e lëndës djegëse në Kosovë konsiderohet se nuk i plotëson standardet dhe ngasësit e automjeteve ngasin me sasi minimale të lëndës djegëse në rezervar, prandaj duke u bazuar në këto fakte konstatojmë se ky ndërrim është jo i rregullt dhe nuk përputhet me rekomandimet e prodhuesve.

PËRFUNDIM

Bazuar në analizën e të dhënave për intervalet e ndërrimit të filtrave dhe vajit të automjeteve që ngasen në Republikën e Kosovë, konstatohet se:

Intervali i rekomanduar i ndërrimit të filtrave dhe vajit në Kosovë është pesë herë më i vogël se sa ai i rekomanduar nga prodhuesi për ngasje në kushte normale. Ky zvogëlim i intervalit të ndërrimit të filtrave është bazuar në rekomandimet e prodhuesve, të cilët i japin për kushte e rënda punuese.

Nga analiza e të dhënave mund të vërehet një ndërrim jo i njëjtë i filtrave të ajrit, vajit dhe lëndës djegëse, ku shihet se filtrat e vajit kanë një ndërrim më të shpeshtë krahasuar me filtrat e ajrit dhe lëndës djegëse. Pra vërehet se filtrat e ajrit kanë një zëvendësim më të vogël krahasuar me filtrat e vajit, prandaj kur bazohemi në rekomandimet e prodhuesve, filtri i ajrit duhet të zëvendësohet njëkohësisht me filtrin e vajit ose më shpesh se sa filtri i vajit.

Gjithashtu shihet se filtri i lëndës djegëse ka një përqindje të ndërrimit më të ultë krahasuar me filtrat e ajrit dhe vajit. Ky ndryshim do të ishte i justifikueshëm nëse cilësia e lëndës djegëse do të ishte e lartë (sipas standardeve). Por siç dihet kualiteti i lëndës djegëse në

Kosovë konsiderohet se nuk i plotëson standardet dhe ngasësit e automjeteve ngasin me sasi minimale të lëndës djegëse në rezervar. Konstatohet se ky ndërrim është jo i rregullt dhe nuk përputhet me rekomandimet e prodhuesve.

*Recensentë:
Dr.sc.Muzafer Shala, prof.
Dr.sc.Petrit Shala, prof.*

KUMTESA

SHKENCAT HISTORIKE

KUMTESA

**Msc. Sokol GJEVORI¹, Msc. Lira GJEVORI¹: RAJONI I ELBASANIT GJATE
INVAZIONIT SERB.**

¹Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani"

Shpallja e pavarësisë që u finalizua me ngritjen e flamurit më 25 nëntor 1912 në Elbasan u realizua në rrethana tepër të vështira kur ushtria serbe po përparonte me shpejtësi të rrufeshme e po i afrohej Elbasanit. Ky akt u ndërmor me qëllim që autoritetet serbe të viheshin përpara faktit të kryer. Ky eveniment do të pasohej më pas më 27 nëntor, në të cilën do të shpallte pavarësinë edhe Peqini e krahina të tjera të Shqipërisë. Kongresi i Vlorës i zhvilloi punimet nga data 28 nëntor deri më 7 dhjetor 1912, dhe qeveria e dalur nga ky kongres kishte në përbërje të saj dhe patriotë elbasanas si: Lef Nosin si ministër i Postë-Telegrafeve, Luigj Gurakuqin si shkronjës i parë, Shefqet Daiun si shkronjës i dytë, Ahmet Daklin si këshilltar në ministrinë e financave. Kryetari i Beladijes (bashkisë) i asaj kohe në Elbasan zoti Alush Saraçi në bashkëpunim me patriotin e shquar elbasanas Aqif pashë Biçakçiun mbante korespondencë të rregullt me Ismail Qemalin, i cili uronte të gjithë popullin e Elbasanit për shpalljen e aktit madhor dhe i rekomandonte patriotëve të trevës të mbanin rendin dhe qetësinë. Rreziku që i kanosej qytetit të Elbasanit nga pushtimi serb në këtë kohë, nxiti autoritetet e qytetit të lajmëronin Ismail Qemalin, i cili në emër të Qeverisë së Përkohëshme ndërveproi duke i telegrafuar gjeneralit serb Metoviç, duke i thënë se: "...kemi informacion se tani fuqitë ushtarake që komandoni ju po marshojnë dhe kanë vendosur të pushtojnë Elbasanin. Në parim, shkruante ai nuk është e drejtë të pushtohen tokat shqiptare...kjo do të thotë të dhunosh një vend të pavarur, që nuk është në luftë me Serbinë, prandaj protestoj për këtë veprim dhe lutemi të hiqni dorë..."²⁶⁴ Ismail Qemali e udhëzonte Prefekturën e Elbasanit për mënyrën se si të vepronte me forcat serbe të cilat kërcënonin pushtimin e trevës. Autoritetet e qytetit të Elbasanit, të cilëve pushtuesit serbë u kishin dhënë ultimatum të dorëzonin qytetin, Ismail Qemali i porosiste ti përgjigjeshin komandës serbe se nuk ishte e drejtë "të vazhdonte armiqësia e qeverisë serbe, kundër Shqipërisë që s'kishte provokuar ndonjë farë armiqësie me qeverinë në fjalë"²⁶⁵. Në një telegram të kohës, që i dërgohej prefekturës së Elbasanit nga nënprefekti i Peqinit Dervish Bej Biçakçiu vihet re se gjendja ishte e vështirë dhe populli i Elbasanit dhe i Peqinit ishin të shqetësuar e në panik nga lajmet e këqia që ishin përhapur nga çdo anë. Krahas ndihmës që Dervish Beu i kërkonte Prefekturës së Elbasanit ai i bënte thirrje, Aqif Pashës, Shefqet Beut, Emin Haxhiademit, Hysen Hastopallit dhe kryetarit të bashkisë Alush Saraçit për ruajtjen e gjakftohtësisë.²⁶⁶ Populli i Peqinit në këtë kohë nëpërmjet një telegrami dërguar ushtrisë pushtuese serbe kërkonte: "në emër të popullsisë myslimane të qytetit tonë, që është një qytet i Shqipërisë, ju lutemi mos ta shkeli ushtria fitimtare e serbisë, duke respektuar kështu independencën tonë"²⁶⁷. Aqif Pasha në këtë kohë ka njoftuar edhe Konsullatat Italiane dhe Austriake në Durrës, mbi pushtimin e tokave shqiptare nga serbët nga ku i kërkonte të ndërhynin për të ndaluar veprimet e tyre. Shkëmbime telegrafike ka pasur edhe me mjaft qytete të tjera si Lushnja, Kavaja, Berati, Ohri, të cilat

²⁶⁴ AME, F 3, D 1, v 1912, fq 2.

²⁶⁵ Histori e Shqipërisë, vëllimi i II, Tiranë: Mihal Duri, 1965, fq 360.

²⁶⁶ Nosi, Lef, Dokumente Historike 1912-1918, Tiranë: 2007, fq 55.

²⁶⁷ AQSH, F. 71, D. 1, Dok. Nr. 8115, kopje e përkthyer nga turqishtja.

KUMTESA

interesoheshin për gjëndjen dhe për masat që duhej të merrnin. Qeveria e përkohshme i bënte thirrje qytetarëve të vendit që të mos luftonin kundër ushtrisë serbe pasi e drejta e tyre do të zgjidhej vetëm midis dy qeverive përkatëse. Pavarësisht nga kjo forcat serbe e pushtuan Elbasanin për një periudhë 9 muaj dhe 16 ditë nga data 23.6.1912 deri në 11 prill 1913, me premtimin se vinin miqësisht e provizorisht, por zotimi i tyre nuk u mbajt kurrë. Okupacioni solli shumë dëme, jo vetëm në qytet por edhe në fshatrat përreth. Të gjitha godinat qeveritare u okupuan nga ushtarët serbë, flamuri kombëtar u ul, u plaçkitën dhe u shkatërruan zyrat qeveritare administrative, gjygsore, të cilat u mbyllën dhe nuk funksiononin më. Forcat serbe filluan të nxitnin urrejtjen e vëllavrasjen midis elbasanasve ortodoksë e atyre myslimanë, për ti përçarë e për ta patur më të lehtë nënshtrimin e tyre. Pas shpalljes së pavarësisë, gjatë viteve 1912-1913 në këtë trevë është bërë një luftë e ashpër dhe e vazhdueshme jo vetëm ndaj forcave osmane që vazhdonin të qëndronin aty, por veçanërisht në drejtim të ushtrisë dhe forcave serbe. Serbët gjatë viteve 1912-1913 e shtrinë sundimin e tyre edhe në krahina të tjera të Elbasanit. Sipas një njoftimi drejtuar qeverisë nga N/prefektura e Gramshit ku parashtrohej problemi emergjent i dorëzimit apo jo të kësaj N/prefekturë me afrimit e forcave serbe rreth 2 orë larg saj.²⁶⁸ Mjaft patriotë të zonave të Dumres, Grykëshit, kodrave të Pazhokut, të Shalsit, e të Gjyralës i pritën pushtuesit me pushkë në dorë. Mjaft çeta që vepruan në trevën e Elbasanit gjatë periudhës dhjetor të 1912-1913 goditnin herë pas here trupat serbe duke i shkaktuar dëme të mëdha në aspektin ushtarak duke i detyruar të largoheshin. Një kontribut të madh në luftë kundër pushtuesit ka dhënë çeta e zonës së Belshit të cilët i shkaktuan mjaft dëme forcave serbe në Pazhok. Edhe populli i Peqinit e priti pushtuesin serb me pushkë. Çeta e Ramazan Canit me rreth 30-40 vetë, nën drejtimin e patriotit Adem Gjinishi, konfrontohej herë pas here me forcat serbe dhe ato turke në zonën e Peqinit. Forcat serbe si pasojë e dëmeve të mëdha të shkaktuara nga këto forca kundërpërgjigjeshin duke përdorur forma të ndryshme dhune si: arrestime, vrasje, djegie shtëpish e katundesh, grabitje ushqimesh dhe kafshësh etj. Përmendim një ndër masakrat më të mëdha në trevën e Elbasanit të ndërmarrë në fshatin Xherije të zonës së Dumresë, ku rreth 35 djem i vranë e i therën me bajonetë. Zonat e Shtatit e Shtërmenit, Vërçës, Labinotit, Belshit u detyruan të viheshin në gjendje alarmi nga përplasia me trupat serbe, e cila u bë në dhjetor të 1912 në fshatin Shtërmen ku u vranë 16 ushtarë serbë. Gjatë luftimeve aty vritet edhe korrieri i Elbasanit që mbante lidhje me Vlorën Abdyl Haxhimusai.²⁶⁹ Raste të përdorimit të dhunës u ndërmorën nga këto forca edhe në drejtim të misionarisë amerikane me përfaqësues në qytetin e Elbasanit zotin Erikson, i cili në këtë kohë bëri përpjekje për të realizuar ngritjen e një kolegji amerikan në Krastë dhe të një shkolle bujqësore në këtë qytet. Për këtë iniciativë patrioti elbasanas Lef Nosi mori përsipër që me anë të një telegrami të njoftoj edhe Ismail Qemalin. Por si pasojë e situatës së vështirë, ëndrra e tij nuk u realizua, pasi shovinistët serbë e arrestuan dhe e burgosën.²⁷⁰ I detyruar të largohej në vitin 1913, për tu rikthyer në 1919 përsëri në Shqipëri me synim ngritjen e një qendër spitalore në Elbasan. Me cilësinë e prefektit, Aqif Pasha dha kontributin e tij duke evituar masakrat e vrasjet që shovinistët serbë me në krye kolonel Haxhiç u munduan të kurdisnin fill mbas shpalljes të pavarësisë në Elbasan.

Pas prillit të vitit 1913 me largimin e trupave serbe nga qyteti ekzistonte një lloj dypushteti, ai i qeverisë së Vlorës dhe pushtetit ushtarak osman. Gjatë kësaj kohe qyteti i Elbasanit ishte pothuajse tërësisht i zbrazët. Serbët u zëvendësuan nga një shumicë oficerësh turq, të cilët nuk kishin harruar kryenaltësinë e tyre të parë dhe vazhdonin të silleshin si zot shtëpie.²⁷¹ Rendi dhe siguria publike gjatë kësaj kohe linin shumë për të dëshiruar për arsye të: ekzistencës së vjedhjeve të shumta, çrregullimeve të ndryshme, problemeve ekonomike, dëmeve njerëzore e materiale të shkaktuara nga pushtuesit serbë, përhapja e sëmundjeve infektive, si dhe problemet administrative ekzistuese. Në një thirrje drejtuar përfaqësuesve më të lartë të disa kazave, Aqif Pasha me cilësinë e kryetarit të qeverisë provizore të Elbasanit shprehej: “Ushtria serbe u nis për në Strugë dhe kësajsoj Prefektura e Elbasanit u

²⁶⁸ AQSH, F. Prefektura e Elbasanit, D. 4/1, viti 1913, fq 101.

²⁶⁹ Elbasani Enciklopedi, Elbasan: Sejko 2003, fq 362.

²⁷⁰ Ne Panteon drejt Panteonit 2000, Elbasani-Enciklopedi, vëll 1 Elbasan: Silver 2000, fq 136.

²⁷¹ AQSH, F. 32, D. 57, (sipas një letre dërguar Lef Nosit nga Elbasani, dt 25 prill 1913) fq 20,

zbraz. Deri sa të bahet organizimi nga ana e qeverisë provizore të Shqipërisë me qëllim që të ruhet qetësia dhe të rregullojë punët, këtu -theksonte ai- provizorisht u formua një komision qeveritar nacional dhe në emër të parësis filloj nga puna. Jeni të lutur edhe ju zotërinj të zgjidhni nga paria e popullit njerëz të përshtatshëm dhe të formoni provizorisht një komision qeveritar nacional, rëndësia e formimit të tij është emergjente sidomos në këto kohëra ku ruajtja e qetësisë është një nevojë e domosdoshmëri. Lutemi përpikuni në një mënyrë të jashtëzakonshme që të mbahet nën kontroll vendi për ndonjë ngjarje që mundet të prishi sigurimin publik.²⁷² Një pjesë e mirë e financës u përdor nga Këshilli administrativ për të përmirësuar gjëndjen e vështirë gjatë viteve 1913-1914 në këtë prefekturë. Konkretisht më poshtë po rendisim disa nga vendimet e marra jo vetëm brenda qytetit por edhe për N/prefekturat, krahinat dhe për katundet e ndryshme të kësaj prefekturë. Vendim i datës 4 maj 1913²⁷³ për të ndihmuar ata që u janë shkatërruar shtëpitë nga serbët e grekët. Për këtë u morën masa për përgatitjen e një liste mbi të gjitha dëmet e ndryshme të bëra nga ushtarët serbë në të gjithë prefekturën. Kjo listë iu dërgua edhe Ministrisë së Punëve të Brëndshme për informacion por edhe për ti kërkuar ndihma financiare për ti ardhur në ndihmë këtyre njerëzve fatkeq. U morën masa për dërgimin e ndihmave në ushqime dhe në para për meremetimin e dëmeve të shkaktuara nga serbët në fshatin Shtëpanj.

Prefektura e Elbasanit nëpërmjet një telegrami të dërguar nga popullsia e këtij katundi informohej për djegien e këtij katundi, dëmet e shumta që i ishin bërë nga ushtarët serbë dhe për djegien e të dhjetave. Ndihi nga kjo prefekturë por edhe nga Qeveria e Përkohshme iu dhanë edhe 11 katundeve të Starovës që kishin pësuar dëme të shumta nga ushtarët serbë.²⁷⁴ Ndihi financiare iu dhanë edhe banorëve të katundit të Stërblevës për ndërtimin e shtëpive të tyre të djegura nga serbët. Shpenzime të tjera u bënë në drejtim të ndihmave për të vobektit, për emigrantët e ardhur në këtë prefekturë, për pagesën e shpenzimeve të gjindarmërisë, për marrjen me qera të zyrave e godinave të ndryshme, për meremetimin e godinave qeveritare, për strehimin e disa familjeve të cilët kishin qënë të detyruar të largoheshin nga shtëpijat e veta pas caktimit të kufijve dhe ku tokat e tyre kishin mbetur nën administrimin serb duke i strehuar në Starovë dhe duke i dhënë ndihma në ushqime etj. Gjithashtu u morën masa për ngritjen e një komisioni, i cili caktoi edhe ndihmat për të ardhurit nga Dibra. Problem tjetër i kësaj periudhe ishte edhe fakti se mbas ikjes së ushtarëve serbë më prill të 1913 nga Elbasani, një pjesë e tyre për shkaqe shëndetësore ishin të detyruar të qëndronin për kurim në spitalin e qytetit. Madje shumë prej tyre u larguan nga Berati dhe u vendosën në Elbasan. Gjendja e këtyre të sëmurëve ishte e mjerueshme dhe kushtet e spitalit ushtarak otoman ku ato kuroheshin ishin të këqija. Pjesa më e madhe e tyre mjekohesh dhe ushqehesh nga mjekë serb.

Duke parë gjendjen e vështirë të tyre, ushqimi, mjekimi, apo varrosja e atyre që vdisnin dhe pamundësinë e shpenzimeve (të ardhurat e pakta) nga bashkia e qytetit, të sëmurët u morën përsipër nga shteti i sapoformuar shqiptar për humanizëm. Me aprovimin e Ministrisë së Punëve të Brëndshme u vendos marrja e 11.500 grosh nga arka e financës së shtetit shqiptar.²⁷⁵ Populli i trevës së Elbasanit ka kontribuar në mbrojtje të çështjes kombëtare duke dhënë ndihmesën e tij në mirëpritjen e dibranëve të shpërngulur me dhunë nga trojet e tyre. Në shtator të 1913 shpërtheu kryengritja e Dibrës, si pasojë e padrejtësive që u bënë në caktimin e kufijve, të vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve të Londrës, masave të egra shtypëse të autoriteteve serbe ndaj popullsisë shqiptare. Mizoritë e masakrat e serbëve në drejtim të fshatrave e të njerëzve të atyre zonave ishin të mëdha aq sa rreth 120 fshatra u dogjën e u rrafshuan, e rreth 40000 shqiptarë u detyruan të largoheshin²⁷⁶. Numri i të larguarve ishte në disa mijë vetë. Gjatë këtij viti qyteti i Elbasanit dhe trevat e tij dhanë një ndihmesë të madhe për të strehuar e mirëpritur dibranët e shpërngulur nga shtëpitë e tyre për shkak të mizorive e masakrave serbe.

²⁷² Prefektura e Elbasanit, F. 71, d. 90 viti 1913, fq 1.

²⁷³ AQSH, Prefektura e Elbasanit, F. 271, D. 3, viti 1913, fq 4

²⁷⁴ Po aty, fq 34.

²⁷⁵ Po aty, fq 14.

²⁷⁶ Vlora, Eqrem bej, vep e përmend..., fq 24.

KUMTESA

Në një korrespondencë nga Elbasani pasqyrohet situata e vështirë në të cilën ndodheshin të larguarit dibranë nga masakrat e serbëve, ku pjesa më e madhe e të larguarve ishin pleq, gra e fëmijë të pa strehë. Vetëm në Elbasan u strehuan rreth 4000 vetë.²⁷⁷ U ngrit një komision i posaçëm për këtë problem, që grumbulloi dhe dha ndihma për të ardhurit. Qeveria e Vlorës mori masa për të ndihmuar pushtetin lokal në Elbasan, për dibranët, duke i dhënë ndihma në ushqime, veshmbathje dhe në para.²⁷⁸ Sipas korrespondencës së Ismail Qemalit drejtuar Aqif Pashës në këtë kohë e njoftonte se: Irfan Beut iu dorëzuan dyqind napolonat që dha Austria dhe një mijë e dyqind frangat, vlerë e pesëdhjetë liravet që na dha komisioni anglez për dibranët.²⁷⁹ Midis kryengritësve dibranë dhe prefektit të Elbasanit Aqif Pashës gjatë vitit 1913 ka patur një telekëmbim të pasur, duke e mbajtur këtë të fundit në djeni mbi rrjedhën e ngjarjeve dhe duke i kërkuar ndihmë në armë dhe municione.²⁸⁰ Fillimisht Aqif Pasha do të mbante një qëndrim të rezervuar në ndihmë të dibranëve, kjo jo nga mungesa e dëshirës për ti ndihmuar, por për të mos kompromentuar asnjanshinë e qeverisë së Vlorës. Synimi i tij ishte për ti ndihmuar kryengritësit dibranë, në dërgimin e pushkëve e municioneve sa më shpejt duke hedhur idenë e mbledhjes dhe blerjes së tyre nga vetë populli, duke mos i lënë vëllezërit e tyre në mëshirën e fatit por, njëkohësisht duke mos implikuar drejtpërdrejtë qeverinë e Vlorës. Aqif Pasha ruante gjatë kësaj kohe një telekëmbim të fshehtë me Ismail Qemalin, ku e informonte këtë të fundit mbi sukseset e kryengritësve, por gjithashtu duke siguruar ndihma për to. Ai përpigje që të ndërmjetësonte me Ismail Qemalin me qëllim që qeveria e Vlorës të dilte në përkrahje të kryengritësve të Dibrës. Ja ç'shkruante ai: “Shkëlqësia juaj vallë ç’ mendon? Për të mos dështuar ky marshim burror i këtyre heronjve dhe që të mos e humbasim këtë pjesë të çmuar të atdheut tonë vallë a është e mundur të përgatiten armë nga ndonjë anë e të sillen? Si urdhëroni zotëria juaj?”²⁸¹ Në dokumentet e kohës nuk vërejmë një përgjigje të menjëhershme nga qeveria e Vlorës. Kjo lë shkak të mendohet se ajo në veprimtarinë e saj politike ka treguar maturi kundër çdo veprimi apo preteksti, që kërkohet nga serbët për më shumë territore në kurriz të shqiptarëve. Kjo prefekturë për t’i ardhur në ndihmë popullsisë së krahinave të ndryshme të vendit mori masa për të dërguar ushtarë, oficer artilerie e armatime për të mbrojtur këto krahina nga sulmet, plaçkitjet dhe masakrat e serbëve. Gjithashtu për ti ardhur në ndihmë Dibrës iu kërkua ndihmë qeverisë për dërgimin e dy ose tre doktorëve, pasi popullsia nuk mund ti përdorte ilaçet. Në të njëjtën kohë nga popullsia e kësaj treve u dërguan disa telegrame dhe nota proteste për mizoritë e aktet ç’ njerzore të ndërmarra nga serbët. Vetë Aqif Pasha iu drejtua me një thirrje popullit anglez nëpërmjet gazetës “Morning Post” (Posta e Mëngjesit), për të ndihmuar këtë popullsi që të shqyrtoheshin faktet e tyre, duke u mirëpritur nga komitetet e pavarura të hetimit që ato të ktheheshin të sigurtë në shtëpitë e tyre dhe t’u kthehej pasuria.²⁸² Edhe Aubrey Herberti në 8.10.1913 i shkruante Aqif Pashës “jam në pritje të informatave tuaja mbi numrin e fshatrave të shkatërruara nga serbët dhe për numrin e refugjatëve.”²⁸³ Nga burimet e kohës njoftohemi se Aqif Pasha së bashku me patriotin tjetër Grigor Cilka, e kanë njoftuar gjërë e gjatë zotin Herbert për situatën e vështirë në të cilën gjendej Elbasani pas shpërnguljes së kësaj popullsie nga shtëpijat e tyre me dhunë, duke i kërkuar ndihmë urgjente për këto njerëz. Brënda një kohe të shkurtër Aubrey Herbert do ti përgjigjej Prefektit të Elbasanit: “Nuk mund t’ju tregoj se si u pikëllova kur mora njoftimin tuaj mbi barbaritë serbe. Këtë raport unë e kam dërguar për publikim në shtypin britanik. Kam besim se ky vend është duke arritur një vlerësim të vërtetë për karakterin serb, besoj se nuk do të jetë shumë vonë nga pikëpamja e shqiptarëve”. Gjithashtu zoti Herbert për të lehtësuar disi dhimbjen që kishte pllakosur në këtë prefekturë, dërgoi 246 ndihma të grumbulluara nga ana e tij, duke premtuar

²⁷⁷ Gazeta, Liri e Shqipërisë, Sofje, nr 86, viti 1913, fq 2.

²⁷⁸ Gazeta, Liri e Shqipërisë, Sofje, 20 nëntor 1913.

²⁷⁹ AQSH, F. 71, D. 4. Dok. Nr. 12031, viti 1913, kopje, përkthim nga turqishtja

²⁸⁰ AQSH, F. 70, D. 273, Qeveria e Përkohshme..., viti 1913, fq 193-216.

²⁸¹ Po aty.

²⁸² AQSH, F. 68, D. 30, viti 1913, fq 2.

²⁸³ AQSH, F. Aqif Biçaku, D. 5, fq 44, viti 1913.

se do të bënte të pamundurën për të dërguar edhe të tjera ndihma.²⁸⁴ Solidariteti ndërkombëtar në mbështetje të çështjes shqiptare dhe në mbrojtje të këtyre shqiptarëve të terrorizuar dhe të shpërngulur me dhunë nga trojet e tyre etnike nuk ka munguar. Edhe gazeta më e madhe e botës “The Times” e Londrës dha ndihmesën e saj morale duke ndihmuar çështjen shqiptare, duke dërguar në Shqipëri gazetarin Bucher, i njohur në të gjithë botën në atë kohë. Detyra e tij mbasi do të vizitonte disa nga qytetet më të rëndësishme të Shqipërisë duke përfshirë edhe Elbasanin, do të pasqyronte në shtypin ndërkombëtar, realisht situatën e vështirë në të cilën gjendej kjo popullsi e shpërngulur. Në udhëtimin e tij në këto qytete ai u shoqërua edhe nga një nga sekretarët e Dhomës së Lordëve zotin Gomez.²⁸⁵ Telegram iu dërgua edhe Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit në të cilin i kërkon të ndihmohen muhaxhirët e shumtë të grumbulluar në Elbasan. Në procesverbalin e seancës së njëzetë të mbledhjeve të këtij komisioni u vendos dhënia e një përgjigje duke njoftuar se “gjatë udhëtimin të tij të afërt nëpër Shqipëri, ai do ta studioj shumë seriozisht propozimin tuaj”.²⁸⁶ Nota proteste Aqif Pasha i ka dërguar edhe Admiralit Cecil Burney, Komandant i forcave ushtarake ndërkombëtare në Shkodër, të cilit i kërkonte ndihmë për të ndikuar në ndalimin e masakrave të grekëve në jug lindje të vendit, dhe atyre serbe në Dibër.²⁸⁷ Një muaj më vonë Aqif Pasha i shkruante këtij admiralit, duke e falenderuar për ndërhyrjen e bërë nga ana e tij, për tërheqjen e grekëve nga 40 fshatrat e Starovës të njohur si Gorra. Po në këtë letër ai i kërkon gjithashtu ndihmë edhe për ndërmarrjen e një veprimi tjetër por tashmë për të ndaluar pushtimin e territoreve të tjera nga serbët.²⁸⁸ Edhe dibranët e ardhur në këtë qytet mbas sistemimit të tyre iu drejtuan me nota proteste Fuqive të Mëdha si autoritetit anglez të Konferencës së Ambasadorëve në Londër zotit Eduart Grei dhe filoshqiptarit të njohur anglez Aubrey Herbert.²⁸⁹ Vlen për tu theksuar se këto nota proteste të dibranëve mbajnë nënshkrimin e patriotit të shquar elbasanas Aqif pashë Biçakçiu. Për të ndihmuar këto refugjatë të ardhur nga Dibra kanë kontribuar, Konsulli i Austrisë në Tiranë, i cili i kërkonte në mënyrë konfidenciale Aqif Pashës për ta njoftuar për numrin e të plagosurve dhe të sëmurëve, duke i parashtruar mundësinë e sigurimit sa më shpejt të një vendi të përshtatshëm për një spital 50 krevatësh të dhuruar nga Kryqi i Kuq Austriak.²⁹⁰ Edhe konsulli Italian në Durrës Dolfini i cili në 2 dhjetor të 1913 i shkruante Aqif Pashës se: “Kam nderin tju sjell në Elbasan një mision mjeksor italian, i përbërë nga dy mjek kirurg dhe katër infermier. Misioni do të jetë i pranishëm aty për tre ose katër javët e ardhshme. Puna e tyre do të konsistojë në shërimin dhe përkujdesjen shëndetësore të refugjatëve dibranë. Kam besimin e plotë në mikëpritjen që do ti bëhet këtij misioni nga ana juaj. Këto mjekë mbasi u vendosën në Elbasan dhe u njohën me situatën e vështirë në të cilën gjendeshin këto refugjatë, dërguan shkrimet e tyre në Kryqin e Kuq të Austrisë dhe Italisë për të kërkuar ndihmë për këto qindra dhe mijra njerëz që po vuanin nga barbarizmat e serbëve.²⁹¹ Edhe shtypi i kohës i ka bërë jehonë të madhe kryengritjes së Dibrës apo organizimit të shqiptarëve në luftë të përbashkët kundër serbëve dhe grekëve, duke i bërë thirrje mbarë popullit shqiptarë: “ të lidhin besën e të bashkohen të gjithë, se vetëm bashkimi bën fuqinë”.²⁹² Në përfundim theksojmë se populli i qytetit të Elbasani dhe i rrethinave të tij ka kontribuar në mbajtjen dhe mirëpritjen e vëllezërve të tyre dibranë, jo vetëm moralisht, duke i ushqyer dhe strehuar por duke i mbështetur ata me ndihma financiare, armë dhe municione, në luftën për të mbrojtur të drejtat e tyre, kundër vendimeve të padrejta të Konferencës së Ambasadorëve së Londrës.

Recenzentë:
Prof.as. dr. Kujtim Bevapi

²⁸⁴ Po aty, fq 39-40.

²⁸⁵ Gazeta “Përlindja e Shqipërisë”, Vlorë 30/12.10.13.

²⁸⁶ Arben Puto, “ Çështja shqiptare në Aktet Ndërkombëtare të Periudhës së Imperializmit, vëll II, Tiranë 1987, fq 463.

²⁸⁷ AQSH, F. Aqif Biçaku, D. 6, fq 6, datë 12.09.1913.

²⁸⁸ AQSH, F. Aqif Biçaku, D. 6, fq 8, datë 12.10.1913.

²⁸⁹ Gazeta, Liri e Shqipërisë, Sofje, nr 86, 20 nëntor 1913, fq 2.

²⁹⁰ AQSH, F. 68, D.5 fq 110, datë 4.10.1913.

²⁹¹ AQSH, F. Aqif Biçakçiu, D. 5, dt 2 dhjetor 1913, origjinal nga frengjishtja

²⁹² Gazeta, Liri e Shqipërisë, Sofje, nr 94, viti 1913, fq 4.

**Dr. Rudina MITA, Prof. DR. Hysen KORDHA: VËSHTRIM MBI PROGRAMIN POLITIK TË
“PARTISË DEMOKRATE”**

Programi i “Partisë Demokrate,, përbëhet nga gjashtë faqe të daktilografuara ku renditen njëri pas tjetrit, në mënyrë suksesive 49 nene të ndara në sythe apo kapituj sipas fushave të veprimtarisë ekonomiko – shoqërore. Në fund ai nuk ka as firmë, as vulë, siç paraqiten programet e partive të ndryshme të asaj kohe. Kjo dukuri nuk duhet larguar nga vëmendja. Pse të mos këtë firmë e vulë? Të jetë vallë projekt i formuluar nga një individ dhe po ta pranojmë këtë version, gjë që nuk është pa bazë, detyrohemi të themi se ideator dhe formulues i tij ka qenë Hoxha Kadri Prishtina. Le ta shtyjme arsyetimin më tej. Përderisa u gjet në fondin e tij, pra të Hoxha Kadriut, nuk ka pse të mos na shtyjë që të mendojmë e të pranojmë se ai ka qenë autori që e ka hartuar këtë program. Edhe fakti që origjinali i programit është në gjuhën turke, gjuhë aq e përdorur në të gjithë dokumentacionin e Hoxha Kadriut është një tjetër dukuri që shërben si argument e provë për të mbështetur idenë e autorësisë dhe të prejardhjes së këtij programi, nga dora e këtij personaliteti politik – historik të asaj periudhe, roli i të cilit gjithsesi ishte i dorës së parë dhe i njohur në opinionin politik e shoqëror dhe në sferat e qarqet e larta shtetërore. Këtë ai e dinte. Dinte edhe se fjala e mendimi i tij vlerësohej e dëgjohej me shumë kujdes, sidomos nga forcat përparimtare e demokratike, ndaj ai nuk mund të rrinte pa e dhënë mendimin e tij në ato momente kur vendi dhe populli kishin nevojë për një gjë të tillë.

Prandaj, nuk ka arsye të kërkohet gjetkë prejardhja e autorësia e programit në fjalë. Por edhe në qoftë se për një moment pranojmë sikur ta këtë hartuar dikush tjetër, gjë që me siguri do të kishte firmën e tij apo të tyre (nëse do të ishin disa), dhe të pranojmë e të mendojmë se ia dërguan Hoxha Kadriut, si jurist kompetent e erudit në fushën e drejtësisë e të jurisprudencës, për ta shqyrtuar me syrin e specialistit kompetent dhe për ta bërë rregullimet eventuale e të nevojshme, ky do të kishte bërë vërejtjet e veta mbi këtë program apo do të pasqyronte vërejtjet e mendimet e tij në ndonjë dokument tjetër, gjë që nuk rezulton gjëkund deri tani. A nuk është edhe ky version një tjetër argument e dëshmi në të mirë të sqarimit të prejardhjes së këtij dokumenti pra, që sidoqoftë lejon të pranosh autorësinë e Hoxha Kadriut?!

Tani le të kalojmë në pasqyrimin e përmbajtjes së programit dhe në analizën e tij sado të shkurtër.

Struktura dhe përmbajtja e Programit të “Partisë Demokrate,,

Në pikëpamjen strukturore ka këto sythe: shkaku dhe qëllimi i formimit (të Partisë –R.M., H.K.) (neni 1 dhe 2): Nyjet Themelore (nenet 3 – 5), Fuqia Ligjvuese (nenet 6 – 16), Punët e Mbrendëshme (nenet 17 – 25), Punët e Drejtësisë (neni 26), Politika e Përjashtme (nenet 27, 28), Arsimi (nenet 29 – 36), punët e Ekonomisë (nenet 37 – 44), Vakufet dhe Shoqnit fetare (nenet 45 – 49).

Qysh në nenin e parë, duke parashtruar shkaqet dhe qëllimin e formimit të “Partisë Demokrate,, në program pohohet se ajo synon “*për me renjue* (trënjosë – R.M., H.K.) *ndërmjet gjithë shqiptarëve,*

prej çdo fejet që të jenë, një bashkim të vërtetë kombëtar e politik e me këtë bashkim mundohet për mvehtësinë, zhvillimin e përparimin e Shqypnise,,²⁹³

Duke zhvilluar e sqaruar më tej idenë rreth qëllimeve të “Partisë Demokratë,, programi thekson se ajo do të punonte për *“me shpëtue Shtetin prej shkatërrimit dhe popullin prej çdo vuejtjeje e dani (dami – R.M., H.K.), tue i dhanë fund çdo vepre ambicioze e shkeljeje,,*

Në program theksohet prerazi se ndër qëllimet themelore të punës së Partisë do të ishte vendosja e shtetit ligjor dhe institucionalizimi i të drejtave e detyrave të shtetasve. Këtë proces politik ajo e konsideronte të domosdoshëm dhe si një moment kthese në jetën politike të Shtetit Shqiptar. Madje, në këtë drejtim shprehej se do të hapte një periudhë të re në jetën dhe praktikën shtetërore e shoqërore shqiptare. Prej qëllimeve rranjore (themelore – R.M., H.K.), të “Partisë Demokratë,, – thuhej në program – asht të hapi një periudhë ligjore (nënvizimi ynë –R.M., H.K.) të premë e me themelue një konstitucion të pëlqyeshëm e të caktuem edhe me i veçue fuqitë qeveritare nga çdo ndikim të çdo fuqie të përjashtme që të jetë e paligjshme,,.

Pra, është fjala për ndarjen e pushteteve, të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe përcaktimin e të drejtave, të detyrave e kompetencave të secilit, duke mënjeluar edhe ndërhyrjet e jashtme në veprimtarinë e tyre. Koncepte të tilla për kohën kur parashtrohen, kuptohet ishin mjaft të përparuara. Pohojmë kështu, sepse aso kohe në Shqipëri vepronin ligjet e trashëguara nga koha e pushtimit osman, ende nuk ishin hartuar ligjet e reja të Shtetit të saporiformuar Shqiptar.

Në sythin nyje themelore, i cili përbëhet prej tre nenesh, trajtohen qëndrimi i Partisë ndaj feve dhe synimet, rrugët e mjetet për përparimin e popullit e të Kombit. Njihte lirinë e besimeve fetare, shteti garantonte e mbronte lirinë e ndërgjegjes e të bindjeve fetare të shtetasve dhe barazinë e besimeve fetare. *“Të gjitha fetë e njoftuna në Shqypnie do të jenë të lira e do të ruhen nga çdo trazim (intervent) – nënvizonte programi – Tue mos hy në të drejtat të feve të tjera, çdo Shqiptar veçanërisht ose bashkërisht, do mund të shërbejë për dobina të fesë së vet e të ndërtesave (institut), shkencore e fetare. Tue mos i dhanë shkas lëvizjeve që damtojnë njisien kombëtare (unitetin kombëtar – R.M., H.K.) për të gjithë fetë në Shqypnie,,* “Partia Demokratë,, konsideronte *“për krim më të madh dhe për tradhtie kundra Atdheut çdo nisme (inisiative) për me prishë bashkimin kombëtar tue bamun për vegël njanën prej fevet të ndodhuna,,.*

Mbështetur në nevojat e Kombit, në aftësinë e zotësinë e shqiptarëve dhe në nevojat e shekullit të XX – të, Partia do të punonte për përparimin e përtëritjen e vendit dhe të popullit, madje, sikurse vihej në dukje në program, ajo kishte *“qëllim të posaçëm që të qesi (nxjerrë –R.M., H.K.) në dritë një përtrim (texhedyt). Këtë do t'a arrinte “tue i ruejt zakonet e bukura e të pëlqyeshme kombëtare, tuj forcue qëndrimin dhe vullnetin dhe tuj sigurue nisjen vetjake,,* (inisiativë personale, iniciativën e lirë – R.M., H.K.)

Në sythin me titull *Fuqija Ligjvuese* shtjellohen konceptet e parimet e Partisë për organizimin, ndërtimin, funksionimin e pushtetit legjislativ, të drejtat e detyrat e tij, mënyrën e zgjedhjes së deputetëve të Parlamentit apo Këshillit Kombëtar, siç quhej atëherë, për hartimin e miratimin e ligjit themelor të shtetit, Kushtetutës, etj.

Mund të konstatohet lehtësisht se: “Partia Demokratë,, për problemet e ndërtimit e funksionimit të pushteteve në Shqipëri kishte përqafuar konceptet moderne të kohës. Parlamentin e konceptonte si institucion përfaqësues e sovran, shprehës të vullnetit të popullit, organin më të lartë të administratës shtetërore, i cili duke mbajtur e shprehur sovranitetin e popullit do të ishte njëherazi edhe kontrolluesi i punës së gjithë fuqisë ekzekutive dhe do të garantonte mbrojtjen e të drejtave të përgjithshme të shtetasve.

“Fuqija Ligjvuese – thekson programi – e cila asht njana prej tri fuqivet të Shtetit, do të përfaqësohet nga ana e nji Këshilli të Kombit (parlament). Detyra e Këshillit të Kombit do të caktohet me ligjën Themelore,, (Konstitucionale) – (Kushtetutën –R.M., H.K.).

Duke parashtruar pikëpamjen e Partisë për të drejtat, detyrat dhe funksionimin e parlamentit, në program theksohet: *“Këshilli i Kombit asht kontrolluesi i fuqies ekzekutuese dhe ruejtësi i të drejtave të*

²⁹³ Po aty. Më poshtë, gjithë pjesët brenda thonjzave kanë të njejtin burim.

përgjithëshme. Prandaj ka të drejtë të pyesi e të kërkojë shkoqitje prej Kabinetit (Këshillit Ministrues) ose prej njanit ministër, përmbi rrjedhimin e punëve e për veprat e kryeme. Për pyetje e kërkim shkoqitjeve nuk ka nevojë për vendim të shumicës. Programi shkoqit në detaje mjaft të drejta e detyra të Parlamentit. Vëmendje i kushton rasteve të organizimit të anketave.

Ai përcakton qartë se, kur dhe kush kish të drejtë të kërkonte anketën parlamentare, mënyrën e organizimit, të drejtat e komisionit parlamentar, detyrimin dhe zbatimin rigoroz të të gjitha kërkesave të ligjit për këtë çështje.

“E bamja e hetimeve ligjore (enchete parlementaire), për ndonjë çështje mund të ngajë kurë të kërkohet së paku prej gjysës të Këshillit të Kombit. Kjo kërkesë në qoftë se pranohet prej Këshillit të Kombit, atëher komisioni i emnuem për të bamen e hetimeve ka të drejtë të marrin dije të plotë dhe të shofin çdo akt të zyrës që dëshirojnë. Po pa leje të Ministrit të gjegjëshëm nuk mund të shifen aktet qi i përkasin të mëshfunave politike e ushtrijake,..”

Është me mjaft interes të gjykohet dhe vlerësohet për kohën koncepti për mënyrën e organizimit të zgjedhjeve të deputetëve të Këshillit Kombëtar, ku i jep përparësi elementeve që garantonin, shprehnin rrugën dhe mjetet demokratike, lirinë e plotë të të zgjedhurit e të zgjedhjes, mënjanimin e arbitrariteteve, zbatimin e vullnetit të votës së lirë të popullit, mënjanimin e ndëshkimit e ndërhyrjeve. *“Të zgjedhunit e deputetit asht një e drejtë dhe detyrë e shenjtë për çdo bashkëatdhetar,..”* – theksonte programi – *Prandaj sikurse gjithësejci asht i detyruem të zgjedhi deputet, çdo shqiptar mundet me u zgjedhë deputet në çdo njanën krahinë të Shqipënisë,..* Dhe më tej vazhdohej: *“Zgjedhja e deputetvet do të bahet me një liri të plotë, tue qenë larg çdo përzimje. Do të ndalohet rrepsisht e bamja e influencës e nënpunësve të shtetit tek zgjedhësat. Ata nënpunsa qi do të përdorin influencën e tyre në zgjedhje të deputetëve, do të hiqen nga puna dhe do të ndëshkohen me ndëshkime të ndryshme,..”*

Rëndësi të veçantë i kushtohet mënyrës së përcaktimit të formës së shtetit dhe miratimit të ligjit themelor të tij, Kushtetutës. “Partia Demokrate, mbronte pikëpamjen në këto probleme themelore të jetës politike e shtetërore të Shtetit Shqiptar të zgjidheshin me rrugë demokratike, nëpërmjet mbledhjes së Asamblesë Kushtetuese ku çdo nënprefekturë do të çonte si përfaqësues të saj dy delegatë, të cilët do të zgjidheshin *“prej atyne që i dinë nevojat e Kombit e të këtij shekulli,..”* – thuhej në programin në fjalë. Me t'u mbledhur Asambleja Kushtetuese, Parlamenti do të shpërndahej dhe do të bëheshin zgjedhje të reja.

Pas përcaktimit të formës së shtetit dhe miratimit të Kushtetutës, Asambleja Kushtetuese do të shpërndahej duke ia lënë vendin Parlamentit të ri, i cili do të dilte nga zgjedhjet e reja.

Në sythin: *Punët e Mbrendëshme*, programi përcakton konceptet e Partisë për rregullimin e funksionimin administrativ të Shtetit shqiptar dhe për ndarjen territoriale administrative të tij. *“Shqypnija – vinte në dukje programi – do të ndahet në Prefektura e Nënprefektura, të mbramet do të jenë të lidhura në të parat dhe këto (është fjala për prefekturat –R.M., H.K.) me Ministrinë e Punëve të Mbrendëshme, e cila do të përpiqet për përmbajtjen e njisies së vendit. Por disa nënprefektura do të organizohen simbas zakoneve të tyre të herëshme tue u marrë parasysh gjindja e veçante dhe ndryshimi që kanë me të tjerat,..”*

Ndërtimin e administratës së re të shtetit e shikonte të lidhur ngushtë me veçoritë e krahinave, dukuri që vështrohej doemos në favor të interesave të zgjidhjes së problemeve e të detyrave që kërkonin banorët. Veç prefekturave e nënprefekturave vlerësohej posaçërisht edhe organizimi i krahinave (komuneve – R.M., H. K.), të cilin e konsideronin si *“themeli i organizimeve të administratës,..”* dhe që duhej shtrirë me kujdes *“në çdo anë të Shqypnisë,..”* Në këtë proces duheshin marrë parasysh veçoritë krahinore, traditat, zakonet, lidhjet fisnore e krahinore si kushte për krijimin e një administrate efikase. Këto parime dhe faktorë historikë, psikologjikë, shoqërorë, gjeografikë, etnografikë sugjerohej të vlerësoheshin për krijimin e çdo krahinë, veçmas për ato të malësive. *“Nër vende ku përdoren ligjet e malësinave (Kanuni i Lekë Dukagjinit ose Xhibali), - theksonte programi, - krahinat do të krijohen tue marrë parasysh lidhmia dhe e shkuemja qi kanë fiset njana me tjetrën,..”* Në krye të krahinës do të ishte një krahinar dhe një pleqësi e zgjedhur. Gjithashtu në administratën e krahinës do të vendosej një sekretar, një tagrambledhës, disa xhandarë e roje pyjesh. Gjithë personeli i administratës së komunës varej nga pleqësia e zgjedhur. Krahinat kishin një farë pavarësie në çështje

KUMTESA

të caktuara financiare, financa, arsim etj. Ato përfaqësonin pushtetin lokal dhe ishin përgjegjëse për miradministrimin e çështjeve financiare, të drejtësisë, arsimore. “Krahinat – theksonte programi,- numërohen si pjesë shoqërore të pamvarshme, tue randue çfarëdo dobie a dami mbi shpindë të tyne,.. Prefekturat do të njiheshin si “një pjesë e veçume për vedi dhe do të ketë mvehtësien në punë botore, të bulqësies, n’arsim sipas të ardhunave të saj,.. Për mbarëvajtjen e punëve dhe sanksionimin e të drejtave e detyrave të nënpunësve të administratës shtetërore lokale në prefektura, nënprefektura etj. “do të hartohet një ligj i posaçëm,, ku do të përcaktohet mënyra e të ndarit e të formimit të prefekturave e të nënprefekturave, mbi të zgjedhmen e këshillave administrative e mbi detyrat e këshilltarëve administrative ,..

Rëndësi të madhe i kushtonte “Partia Demokrate,, zgjedhjes të nëpunësve të administratës shtetërore. Kriter bazë do të ishte aftësia, zotësia e nëpunësit. Për këtë arsye në program nënvizohet posaçërisht ideja se “veç kushteve të shërbimit që do të shpjegoheshin në ligjin themelor – (Kushtetutën –R. M., H.K.), për nënpunësit që do të kishte kushte të tjera dhe besimi (fetar –R. M., H.K.) nuk do të merrej parasysh. Vetëm do të shikohesh zotësia e aftësia e nënpunësit qi duhet të ketë mbas vendit e njësis ku emëroheshin,.. Duke vlerësuar këtë moment të rëndësishëm, parashikohej që sipas “rregullave të drejta e të arsyeshme do të hartohet një ligj e posaçme qi të tregojë mënyrën e zgjedhjes e të emërimit të nënpunësve, rritjen (kualifikimin –R. M., H. K.) dhe qitmen në pushim, detyrat dhe gradat e përgjegjësies së tyne,.. Çdo nëpunës i administratës shtetërore, i drejtësisë dhe ushtarakët duhet të ishte i depolitizuar e i departizuar dhe t’i shërbente me paanësi popullit. Për këtë çështje programi shprehej direkt, qartë dhe prerazi. Madje, ndaj atyre që nuk merrnin parasysh këtë orientim, parashikoheshin sanksione. “E papërzemja e nënpunësve n’ato të drejta qi i përkasin popullit meqenë se asht për dobie e shpëtim të Atdheut, gjith nëpunësat e administratës të drejtësisë e të disiplinës ushtarët e oficerët do të lehen jashtë rrejedhjeve (partijave) të politikave. Do të bahet një ligjë e posaçme për punë të ndëshkimit të atyne nënpunësave të qeverisë që hynë në ndonjë partie ose një shoqnie tjetër,..

Në sythin “Punët e Drejtësisë,, parashtroheshin synimet e Partisë për këtë fushë të rëndësishme të jetës e të veprimtarisë politike e shtetërore. Thelbin e synimeve e përbënte krijimi i legjislacionit të ri të Shtetit Shqiptar, të bazuar në nevojat e zhvillimit politik – social, të shoqërisë shqiptare dhe të mbështetur në të drejtën zakonore kombëtare. Qëllimi themelor i legjislacionit ishte mbrojtja e nderit, frymës kombëtare, sigurimi e garantimi i jetës dhe i pasurisë së pronës të qytetarëve dhe mbrojtja e të drejtave. “Partija – thuhet në program – ka – dalë – ka – dalë tue përmirësue e ngren (heqë –R. M., H. K.) gjithnjë ligjet që janë në përdorim, do të mundohet të shestojnë (krijojë –R. M., H. K.) e të vejë në zbatim ligje qytetnore (civile) e ndëshkimore (penale), si mbas gojzhanës dhe venomeve kombtare e mbas nevojave të klimës. Fundi i qëllimit në shestim (krijimit –R. M., H. K.) të ligjeve të përmirësueme ka me qenë të rrejtuenit e shpirtit të nderës e të zotnimit dhe të sigurimit e të nxjerrmes së drejtës në shesh,..

Principet e ndërtimit e të funksionimit të Shtetit Shqiptar, Partia Demokrate i kishte parime të frymëzuara nga përvoja e shteteve më të zhvilluara të kohës, por që merrnin parasysh psikologjinë, traditën dhe zakonet e, sidomos, doket e të drejtën zakonore shqiptare, si dhe nevojat e popullit shqiptar. Në thelb ato përbënin një zgjidhje origjinale, me veçori specifike dhe me natyrë e frymë demokratike, sepse, siç konstatohet, ato synonin të vendosnin shtetin ligjor, shtetin e së drejtës, shtetin që mbronte e garantonte liritë politike e të drejtat demokratike të qytetarëve të vet, që siguronte pasurinë e tyre. Shtet që siguronte rendin e qetësinë, drejtësinë e zbatimit të ligjit para të cilit të gjithë duhet të ishin të barabartë. Për kohën koncepte të tilla ishin mjaft të avancuara dhe zbatim i tyre presupozonte vendosjen e rendit demokratik në Shqipëri, pra, shënonte një hap të madh në zhvillimin politik – social të shoqërisë shqiptare. Kjo përbënte një ndër kërkesat themelore të lëvizjes politike që nisi në Shqipëri menjëherë pas Kongresit të Lushnjës, i cili shënoi një moment kthese në historinë e Shqipërisë. Këtë, siç theksuam më lart, e kuptoi Hoxha Kadri Prishtina. Dhe jo vetëm e kuptoi, por me intuitën e personalitetit, të politikanit e burrit të shtetit, të përkushtuar fateve të Atdheut e të popullit të vet dha ndihmesën e tij për përcaktimin e nevojave e të drejtëve të reja të zhvillimeve që duhet të merrte procesi historiko – politik në Shqipëri. Kështu shpjegohet hartimi i këtij programi politik të

Partisë Demokratike, i cili përvijon një drejtim të ri, një proces politiko – shoqëror me përbajtje e synime demokratike, që i hapte rrugën zhvillimit të kapitalizmit dhe mënjanimin të mbeturinave të feudalizmit që ende ekzistonin e vepronin në jetën e Shqipërisë në ato vite.

Vështruar e vlerësuar në këtë rrafsh programi që shqyrtojmë shënon dhe përfaqëson një platformë politike për forcat demokratike e përparimtare antif feudale dhe për tërë lëvizjen politiko – shoqërore që përploq për vendosjen e rendit demokratik në Shqipëri. Këtij synimi i shërbente edhe programi i “Partisë Demokratike,,. Gjykuar në këto rrafsh dhe në synimet e misionin, ai i bënte një shërbim shumë të madh vendit, popullit dhe Atdheut, sepse i jepte përgjigje pyetjes se si duhej ndërtuar shteti, ç` rrugë duhej ndjekur për forcimin e fuqizimin e tij, ç` pamje dhe ç` përbajtje duhet të kishin institucionet dhe veprimtaria shtetërore etj. Prandaj, kjo është arsyeja që na detyron të pohojmë se më këtë program Hoxha Kadri Prishtina i bënte një shërbim të madh gjithë lëvizjes demokratike shqiptare që nisi më 1920.

Le të vazhdojmë më tej me parashtrimin dhe analizën e programit.

Vëmendja e “Partisë Demokratike,, do të përqendrohej edhe në fushën e politikës së jashtme, si një ndër fushat me prioritare të veprimtarisë shtetërore. Koncepti i Partisë për këtë fushë mbante parasysht dhe mbronte interesat kombëtare dhe shtetërore. *“Qëllimi themelor i politikës së përjashtme – thuhet në program-asht me u mundue për naltësimin e shvillimit të Shqyptarit në Ballkan për t`a ba një element përparimtar,,. Këtë synim të lartë e të shenjtë Partia do ta arrinte pa “Shkelë e drejta asnjë mbretinje e kombi,, pra duke i respektuar shtetet dhe kombet fqinje. “Për me sigurie e fitue mëmvetësiën kombtare e besimin e përjashtem Partija do të përploq me themelue një mardhënie të mirë me shtete qi kemi të bajmë (t`interesuem) dhe si mbas dobinave të nalta me disa mbretinje do të zgjidhet një udhë e fuqieshme besimtare,,.*

Parimet e politikës së jashtme ishin parime të marrëdhënies miqësore e të fqinjësisë së mirë me shtetet fqinje, të respektit reciprok, të barazisë e të mosdërhyrjes në punët e brendshme, mirëkuptimit mes shteteve e popujve të ndryshëm. Shqipëria, Shtet i pavarur dhe sovran me politikën e saj të jashtme, të bëhej faktor i rëndësishëm në marrëdhëniet ndërballkanike, pa bërë asnjë lëshim në dëm të interesave kombëtare dhe shtetërore.

Parimet e politikës së jashtme udhëhiqeshin nga mbrojtja e interesave kombëtare. Përderisa, siç theksuam më lart, qëllimi themelor i politikës së jashtme ishte përpjekja për lartësimin e zhvillimit të shqiptarit në Ballkan, për ta bërë atë një element përparimtar, duke respektuar të drejtat e kombeve e të shteteve të tjera “Partia Demokratike,, angazhohej të përforconte më tej tiparet kombëtare të politikës së jashtme të Shtetit Shqiptar dhe u jepte mesazhe miqësie e fqinjësie të mirë, shteteve e kombeve të tjera të gadishullit dhe u përgjigjej drejtpërsëdrejti atyre qarqeve antishqiptare që ende udhëhiqeshin nga psikoza e naciona-lizmave e shovinizmave në dëm të Shqipërisë e shqiptarëve, madje, edhe të atyre klikave reaksionare antikombëtare, të cilat në një mënyrë a tjetër flirtonin me armiq të shekullorë të Kombit tonë.

Këto koncepte ishin zhvillim i mëtejshëm i ideve të rilindësve për bashkëpunim e miqësi e fqinjësi të mirë midis popujve të Ballkanit. Kjo politikë ishte në shërbim të zhvillimit e të konsolidimit të Shtetit të saporiformuar shqiptar dhe lejonte gjithë forcat politike e sociale të vendit t`i përkushtoheshin zgjidhjes së problemeve të brendshme. Kjo ishte edhe kërkesë e tyre. Prandaj, mund të themi se, gjykuar nga peshorja e historisë, programi i “Partisë Demokratike,, u përgjigjej detyrave historike të atij momenti që kalonte Shqipëria asokohe dhe zgjidhjen e tyre e përcaktonte me mjete, rrugë e mënyra demokratike.

Ndër fushat ku programi ndalej me detaje dhe jepte hollësi për mënyrën e organizimit ishte fusha e arsimit, për të cilin, nga sa shihet në program Partia kishte koncepte mjaft të përparura dhe e vlerësonte atë si sektorin e përgatitjes së bazave të zhvillimit politik e të përparimit ekonomik – shoqëror të vendit. Sistemi arsimor ishte i plotë, i gjerë, me shtrirje në tërë vendin etj. Arsimi *“filluor do të jetë i doemosshëm,,*, pohohej në program dhe në vartësi nga ky parim Partia zotohej të plotësonte këtë nevojë, duke hapur shkollat fillore në qendra të krahinave, në fshatra (2000) banorësh apo në mes të fshatrave të tjera, që i kishin shtëpiat të përhapura. Madje, për realizimin e detyrimit shkollor në ciklin fillor Partia parashikonte që: *“në vende ku do të shifëj nevojë do të hapeshin edhe nga një*

KUMTESA

instituto,, (shpije nrxanësash – fjala është për konvikte –R.M., H.K.). Ky parim i masivizimit të arsimit fillor njëherazi ishte edhe me përmbajtje të thellë demokratike, sepse siç shihet, Partia kërkonte që në këtë kategori shkollë duhet të përfshiheshin detyrimisht gjithë fëmijët pavarësisht nga gjendja ekonomike, hapësira gjeografike apo pengesa dhe vështirësi të çfarëdo natyre qofshin. Mësimi fillor ishte falas dhe shpenzimet për përballimin e tij mbaheshin nga shteti. Pas fillores arsimit vazhdonte më tej në shkollat “*qëndrore-të mesme – tre vjetëshe, siç cilësohen në programin e Partisë, - Këto shkolla këto shkolla numërohen në rradhën e mësimëve fillore*,, - theksonte programi, - mbaheshin nga shteti, nxënësve nuk u merrej taksë dhe pjesëmarrja në to nuk ishte e detyrueshme. Pas shtimit, zgjerimit dhe përhapjes së mësimin në rrjetin e shkollave fillore në tërë vendin dhe në përputhje me nevojat për “*arsimin mendues të brezit të ri me mësim të dyta e të nalta do të hapen shkolla gjimnazije (universitete) e të nalta*,,.

Këtu është fjala për dy kategori shkollash. Vështro me kujdes pohimin: mësim të dyta e të nalta. Bëhet dallimi, ndahen nga njëra – tjetra shkollat e mesme apo gjimnazet nga shkollat e larta. Mësimet në të dy këto kategori shkollash “*do të jenë me pagim*,, vihet në dukje në programin e “Partisë Demokratike,,. Gjimnazet dhe Universiteti “*mvaren drejt për së drejti prej Ministrisë së Arsimit e punët arsimore kanë me u rregullue e organizue mbas ligjave e rregullave të posaçme*,, – vazhdonte programi.

Recenzentë:
Prof.dr. Roland Gjini
Prof. as. dr Hysejn Shabanaj

MSc. Ilir SALLATA: NAKO SPIRU NË PLENUMIN II TË BERATIT 23-27 NËNTOR 1944

Ndërhyrja e Partisë Komuniste Jugosllave në Shqipëri kishte filluar që me themelimin e Partisë Komuniste Shqiptare, nga dy të deleguarit Miladin Popoviçi dhe Dushan Mugosha. Ata kishin vepruar jo si këshilltarë por si drejtues të partisë dhe kishin zgjedhur për të mbajtur pranë Enver Hoxhën, që iu ishte nënshtruar plotësisht.

Velimir Stojnić u dërgua nga udhëheqja e PKJ kur po afronte çlirimi i Shqipërisë dhe i gjithë Ballkanit, me detyrën që të siguronin vazhdimësinë e kësaj hegjemonie në kushtet e reja. Tashmë marrëdhëniet do të ishin jo vetëm partiake ilegale, por edhe shtetërore zyrtare.²⁹⁴ Stojnić me detyrën e shefit të misionit ushtarak jugosllav, pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, erdhi në Shqipëri me një analizë të situatës ndërkombëtare dhe të perspektivave pas fitores së afërt mbi agresorët nazistë, me një analizë të veprimtarisë së PKSHP dhe detyrat që shtroheshin.²⁹⁵

Në një situatë të tensionuar u realizua Plenumi II i KQ të PKSHP që u mbajt më 23 deri më 27 nëntor 1944 në Berat.²⁹⁶ Plenumi u thirr nga udhëheqja e PKSHP me në krye Enver Hoxhën, për të analizuar veprimtarinë e deriatëherëshme të PKSHP dhe për të parashtruar detyrat në situatat e reja që po krijoheshin me çlirimin e plotë të vendit. Aty u mbajtën tri raporte: “Mbi situatën politike” nga Sejfulla Malëshova (raport i cili është zhdukur); “Vija politike e PKSHP” e mbajtur Enver Hoxha dhe raporti i tretë “Vija organizative”, nga Koçi Xoxe.

Të gjithë pjesmarrësit, që vinin nga sektorë të ndryshëm, morën pjesë aktive në diskutime dhe haptazi kritikuan dhe shfaqën mendime në bazë të përvojës së tyre.

Në rradhë të parë diskutantët kritikuan faktin se udhëheqja e partisë ishte monopolizuar nga “klika” Miladin-Dushan-Enver dhe se Byroja dhe Komiteti Qendror nuk kishin funksionuar si organe të udhëheqjes kolektive të partisë, madje as që ishin mbledhur.²⁹⁷

U kritikua politika sektare lidhur me Frontin Antifashist, me qëndrimet e padrejta ndaj Ballit Kombëtar dhe nacionalistëve antifashistë si Abaz Kupi, Muharrem Bajraktari, vëllezërit Kryeziu dhe shumë të tjerë. U dënua rreptë tendenca terroriste, pushkatimet e padrejta të njerëzve që nuk e meritonin, madje të antifashistëve e komunistëve.²⁹⁸ Sejfulla Malëshova theksoi se, PKSHP po kthehej në një parti me karakter terrorist. Për gabimet e vërtetuara disa nga diskutantët bënë përgjegjës në rradhë të parë Enver Hoxhën. Nga ana tjetër Enver Hoxha pranoi gabimet, likuidimin e figurave nacionaliste dhe komuniste, dobësitë në funksionimin e forumeve të partisë, ndikimin e madh të Dushan Mugoshës, etj.²⁹⁹

Nako Spiru ka qenë një nga diskutantët kryesor në Plenumin II të Beratit.³⁰⁰ Zgjuarsia dhe kultura, por sidomos patriotizmi dhe humanizmi e kishin ndihmuar Nakon të konstatonte sëmundjet e rënda të

²⁹⁴ Kujtime verbale dhënë autorit nga Liri Belishova, datë 5 korrik 2011

²⁹⁵ Po aty

²⁹⁶ *Historia e Popullit Shqiptar*, Grup autorësh, v 4, Tiranë; Toena, 2008, f.121

²⁹⁷ Kujtime verbale dhënë autorit nga L. Belishova, datë 5 korrik 2011

²⁹⁸ Po aty

²⁹⁹ *Historia e Popullit Shqiptar*, v 4, vepër e cituar, f.122

³⁰⁰ Reginald Hibert, *Fitorja e Hidhur*, Tiranë: Sh.b Lidhjes së Shkrimtarëve, 1993, f.335

PKSH, e ti kritikonte rreptë ato. Sipas Liri Belishovës kritikant dhe synimet e Nako Spirut dhe Sejfulla Malëshovës ishin të drejta dhe jo në të njëjtat shina, apo me të njëjtat synime me ato të jugosllavëve e të Koçi Xoxes, kështu që nuk mund të akuzohen si bashkëpunetorë të tyre. “*Këtë, e vërtetoi historia*”.

301

Ai i takon asaj pjese të elitës së re politike që nuk nguroi t’i shprehte pikpamjet edhe kur ato binin ndesh me të tjerët, veçanërisht me pikpamjet e emisarëve jugosllavë, që qëndronin pranë PKSH. Kështu, Nako i shkruajti Miladin Popoviçit se “përpiqej t’i tërhiqte të gjithë nga hunda”. Për këtë ai u etiketua si njeri që “vuante nga sëmundja e pakënaqësisë”, kurse Miladini u detyrua të pohojë se duhej pasur kujdes prej tij “se pastaj del me fakte në dorë”.³⁰²

Nako Spiru theksoi se Komiteti Qëndror u zgjodh nga Miladin Popoviçi, i cili synonte ta komandonte vetë atë, se KQ nuk kishte funksionuar si duhej dhe kjo frymëzohej nga Miladini, i mbështetur nga Enver Hoxha. Sipas Nakos ishte një vijë në PKSH e drejtuar nga ky i fundit, që të mos bëheshin mbledhje e të mos sheshoheshin problemet. Në diskutimet e veta Nako ngarkonte me përgjegjësi Miladinin, që “*mund të ndërronte edhe dy Komitete Qëndrore në ditë po të qe nevoja*”³⁰³ Nako Spiru u dallua si një nga elementët më aktivë që kërkuan të përpunojnë në forume dhe jo në kulisa vijën e partisë, larg sektarizmit e terrorizmit. Ai shtroi nevojën e një udhëheqje kolegjiale në parti dhe për forcimin e rolit aktiv të çdo anëtarit e forumit, nevojën e përpunimit të një politike më realiste, duke llogaritur të gjithë aleatët e mundshëm për çlirim.³⁰⁴

Nga diskutimet u vlerësua se PKSH ishte udhëhequr nga Miladini, me krah të djathtë Enverin. Sejfulla Malëshova e karakterizoi Enver Hoxhën si shëmbëlltyrën e të gjitha gabimeve gjatë luftës, si tipin që krijoi klika.³⁰⁵

Nga ana tjetër rezultoi se Miladini e ka vlerësuar Nakon si një njeri tepër të zgjuar dhe shumë frytdhënës, por më pas kishte ndërruar mendje kur kishte vërejtur prirjet e Nakos, të cilat binin ndesh me politikën e tij.

Këtë fakt e evidenton dhe historiania ruse Nina Smirnova. Sipas saj Nako Spiru ishte njeri i punës dhe i përgatitur ideo-politikisht, por e pengonte mbështetja jugosllave.³⁰⁶

Më tej Nako Spiru analizonte punën dhe dobësitë e Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar pas daljes së Ballit Kombëtar, duke u ndalur në gabimet që kishte bërë PKSH në qëndrimin ndaj tij. Puna e dobët e saj çoi në bashkimin me BK të shumë elementëve, që nuk ishin të ndërgjegjshëm për rrugën që duhej të ndiqnin. Ai tërhiqte vëmendjen lidhur me shprehjen “bolshevizmi i partisë”, kur sipas tij përpara qëndronte detyra e çlirimit. Në Panarit thuhej se partia po bëhej bolshevike, për këtë duhej bërë autokritikë. Nako goditi parullën “O me ne, o kundër nesh”; kështu “futej përçarja në popull”. Në këto kushte partia në vend që ta bashkonte popullin, e përçante atë.

Nako Spiru nuk ishte dakort me vrasjet e kundërshtarëve, duke dënua rëndë vrasjet politike. Dyshonte për vrasjen e Zaho Kokës dhe kundërshtoi atentatin ndaj Bari Omarit. Ai akuzoi se, këto akte ishin kryer nën ndikimin e jugosllavëve, duke iu referuar drejtpërdrejt Enver Hoxhës si fajtor për vrasjen e Mustafa Gjinishit.³⁰⁷

Gjithashtu Nako nuk ishte për popullarizimin e emrave të veçantë si p.sh. të Enver Hoxhës, por për popullarizimin e LANÇ. “*Deri dje as që kish dale ndonje emer. Sot edhe në një listë gjellësh do të gjesh emrin e Enverit. Në një gazetë është shkruar se faktori kryesor në luftë është Enveri; gje që s’thuhet as për Marks-in e Lenin-in*” – do të shprehej ai në diskutim.³⁰⁸

³⁰¹ Kujtime verbale dhënë autorit nga L. Belishova, datë 5 korrik 2011

³⁰² Lefter Nasi, *Aspekte nga jeta dhe veprimtaria e Nako Spirut në vitet 1943-1947*, Studime Historike, Tiranë: 1998, Nr. 1,2, f.205

³⁰³ Ndreçi Plasari, Luan Malltezi, *Politika antikombetare e Enver Hoxhës*, Tiranë: Eurorilindja, f.70

³⁰⁴ L. Nasi, “Aspekte nga jeta dhe veprimtaria e Nako Spirut në vitet 1943-1947”, vepër e cituar f.206

³⁰⁵ N. Plasari, L. Malltezi, *Politika antikombetare e Enver Hoxhës*, vepër e cituar, f.76

³⁰⁶ Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë shek.XX*, Tiranë: Ideart, 2004, f.317

³⁰⁷ Uran Butka, *Lufta civile në Shqipëri 1943-1944*, Tiranë: Drier, 2006, f.128,131,137

³⁰⁸ U. Butka, *Lufta civile në Shqipëri 1943-1944*, vepër e cituar, f.123

Gjatë diskutimeve Nako Spiru dhe Sejfulla Malëshova nuk u bashkuan me idenë e Koçi Xoxes se, vija sektare e PKSHE godiste fshatarët dhe punëtorët. Kjo sepse Koçi Xoxe kishte deklaruar se rradhët e PKSHE ishin mbushur me intelektualë, bejlerë e mikroborgjezë. Nako Spiru si një njeri intelektual gjithëpërfshirës e kundërshtoi një mendim të tillë.

Pandi Kristo vlerësoi në këtë plenum figurën dhe punën e Nako Spirut në krye të Rinisë Antifashiste e në Parti. Sipas tij puna e Nakos ishte për tu lavdëruar në hartimin e rezolucioneve të mbledhjeve të ndryshme; se ai kishte ndikuar mjaft në edukimin dhe rritjen e nivelit të rinisë e kuadrove dhe ishte kurajoz dhe i guximshëm, duke i thënë hapur dhe kujtudo kritikën. Pandi Kristo e shikonte Nakon si një potencial i mundshëm për drejtimin e partisë. Si rrjedhojë, sipas tij, kjo mund të kishte frikësuar shokët e udhëheqjes, se mos Nako mund t'u zinte vendin. Ai cilesonte se, Nako nuk ka qenë i preferuar i jugosllavëve dhe si rrjedhojë nuk pa pasur mbështetjen e duhur.³⁰⁹

Alqi Kondi e mbështeti Nakon, kur u diskutua për rininë. Ai theksonte se, Nako ishte kujdesur për ngritjen e rinisë në luftë duke treguar kështu një interesim për kuadrot, si rrjedhojë, sipas tij, puna e Nakos kishte dhënë mjaft rezultate.³¹⁰

Sipas Kico Ngjelës, nga Kongresi i Rinisë deri në ato momente kishte patur mjaft suksese. Organizata e Rinisë përfshinte afro 10 mijë anëtarë dhe nga organizata e Rinisë Antifashiste kishin dalë kuadro me vlerë.³¹¹

Nako Spirun e kritikuan disa diskutante, për një punë të veçantë të organizatës së Rinisë Antifashiste, që kishte tendenca të mënjanohej nga partia. Sejfulla Malëshova e shpjegonte këtë me faktin, që e tillë ishte krijuar klima në parti, se gabimi nuk duhej kërkuar në udhëheqjen e rinisë por tek vetë prirja sektare e partisë. Sipas Sejfullait, kur s'kishte unitet në Byro, s'ka se si të kishte unitet në parti.³¹²

Duke analizuar këto materiale shprehim mendimin se këto kritika ndaj Nakos lidhen me disa tendenca të udhëheqjes së PKSHE: -Kuadrot me prirje konservatore, nuk kuptonin nevojat e egzigjencat e rinisë, donin ta kishin atë nën disiplinën e kontrollin e rreptë të partisë. Kurse Nako, kërkonte që organizata e rinisë të mos kishte një vartësi të rreptë burokratike nga forumet e organizatat e partisë, që të merreshin parasysh veçantitë dhe kërkesat e moshave të reja. Për organizimin dhe mobilizimin e rinisë të zhvilloheshin jo vetëm mbledhje por dhe aktivitete sportive, grupe teatrale, rrethe letrare, etj. - Në udhëheqjen e Nakos rinia ishte mjaft aktive, e kjo ngjallte një farë xhelozie për figurën e tij shumëdimensionale.³¹³

Edhe Enver Hoxha gjatë diskutimeve shprehu mendimin e tij mbi Nako Spirun, mendim të cilin e kishte krijuar dhe nga bisedimet e mëparshme me Miladinin. Sipas tij, Nako ishte i zgjuar, por se donte të punonte independent, të dilte vetë e të tjerët ti linte në hije.³¹⁴ Kuptohet që dhe Enver Hoxha, duke mbështetur mendimet e Miladin Popoviçit, nuk do shprehej mirë për Nakon.

Plenumi miratoi diskutimet dhe tezat për gabimet e PKSHE, por këto materiale Enver Hoxha i mbylli në kasafortë, ato nuk u punuan as në aktivet e partisë e as në organizatat bazë duke i vënë një njollë të zezë.³¹⁵

Në fund të kësaj analize do të dëshiroja të citoja një portretizim, që Nako Spiru i ka bërë Enver Hoxhës. Ky dokument serviret si një pjesë e letrës që Nako Spiru i dërgonte udhëheqjes së PKJ në nëntor ose dhjetor 1944. Por Liri Belishova, shfaq mendimin që kjo nuk është letër që Nako ia dërgonte Titos, pasi një intelektual si Nako Spiru nuk mund t'i shkruante një partie tjetër në një fletë blloku dhe me korigjime. Ajo duhet të jetë një fletë e shkëputur nga ditari që ai mbante dhe u mor nga organet e sigurimit bashkë me dokumenta të tjera, natën e vdekjes së tij tragjike.

³⁰⁹ N. Plasari, L. Malltezi, *Politika antikombëtare e Enver Hoxhës*, vepër e cituar, f.100

³¹⁰ Po aty, f.110

³¹¹ Po aty, f.76

³¹² Po aty, f.76

³¹³ Kujtime verbale dhënë autorit nga L. Belishova, datë 5 korrik 2011

³¹⁴ N. Plasari, L. Malltezi, *Politika antikombëtare e Enver Hoxhës*, vepër e cituar, f.159

³¹⁵ Kujtime verbale dhënë autorit nga L. Belishova, datë 5 korrik 2011

KUMTESA

Megjithatë rëndësi ka mprehtësia dhe largpamësia e Nako Spirut në portretizimin e Enver Hoxhës, që në fillimet e pushtetit të tij diktatorial, që e mbajti Shqipërinë të mbërthyer për afër gjysmë shekulli. “Ndjek Tashkon me sy mbyllur. Me ardhjen e Miladinit e Dushanit, me formimin e Partisë u bë anëtar i Komitetit Qëndror të përkohshëm, ndjek me sy mbyllur Miladinin, i cili, pak nga pak përqëndron përgjegjësitë në duart e tij. Në Konferencën e Partisë u zgjodh Sekretar i Përgjithshëm i Komitetit Qëndror. U shqua zakonisht si njeri që shkëlqeu në luftën kundër fraksionistëve. Kjo është pjesa gratis. Më tepër ka gërthitur në këtë fushë se ka punuar. S’ka bërë asgjë nga vetja, zbatues pa perspektivë i Miladinit.

Inteligjencë (zgjuarsi) mediokër. Në shkollë, jashtë shtetit dhe si profesor, gjithashtu medioker. Gjatë gjithë kësaj kohe (para krijimit të Partisë), jetë jo shumë te rregullt. Në Parti sektar. Tani do t’i bëjnë lajka. Krijoi klikë rreth vetes. Do të jetë i parë në çdo gjë dhe t’i marrë të gjithë me shqelma. Të tjerët do t’i shohë fare të vegjël. Asnjë cilësi prej udhëheqësi. Frenon çdo inisiativë. Rrjedh nga një familje pronarësh të vegjël. Në kohët e fundit kushte jo shumë të mira ekonomike.

Në popull nuk është i njohur; ku është i njohur nuk gëzon reputacion. Partia po e popullarizon me të gjitha forcat. Vetëm kështu ka filluar të bëhet i njohur. Por populli nuk është shumë i bindur për aftësitë e tij.”³¹⁶

Recenzentë ; Prof dr. Fatmira Rama
Prof.ass. dr. Kseonala Sotirofski

³¹⁶ N. Plasari, L. Malltezi, *Politika antikombëtare e Enver Hoxhës*, vepër e cituar, f.331

Mr.sc. Memli KRASNIQI: RAPORTI POLITIK I GJERGJ QIRIAZIT MBI VILAJETIN E MANASTIRIT

Përmbajtja e shkurtër: Autori i këtij raporti politik, Gjergj Qiriazhi, pas veprimtarisë së tij të njohur në fushën e arsimit kombëtar shqiptar si dhe në luftën e tij për futjen e gjuhës shqipe në institucionet fetare, është dalluar edhe për një aktivitet të shtuar politik, në përpjekje për të informuar qarqet ndërkombëtare nga shqiptarët dhe për shqiptarët. Në këtë frymë është edhe ky raport i tij, në të cilën ai do të paraqiste situatën e vërtetë etnike, kulturore dhe politike të Vilajetit të Manastirit ose si quhej ndryshe provinca e “Maqedonisë”.

Fjalët kyçe: Gjergj Qiriazhi, Shoqëria Biblike Britanike, Vilajeti i Manastirit, Cecil Harris Noel Buxton, Maqedone, Perandorisë Osmane, Serbia, Vllahët etj.

Gjergj Qiriazhi, i cili që nga vdekja e Gjerasimit (1894) ishte përfaqësues i Shoqërisë Biblike Britanike dhe Amerikane në Vilajetin e Manastirit, pas veprimtarisë fetare dhe kombëtare, një kontribut të madh ka dhënë edhe në informimin e opinionit të huaj protestant me rrethanat dhe kushtet e vërteta, nën të cilat jetonin popujt e robëruar në Vilajetin e Manastirit. Kështu në një vizitë të tillë informative, ishin edhe anglezët Cecil Harris dhe Noel Buxton, të cilët në vitin 1899 qëndruan dy ditë në Manastir, ku biseduan me konsullin e Serbisë, Greqisë dhe me agjentin e Bullgarisë. Ata po ashtu u takuan edhe me Valiun, me të cilin diskutuan çështjen e dëbimit nga Dibra të Cilkos, shpëtimtarit të biblave, me ç'rast vali u shpreh i keqardhur, duke deklaruar se në të ardhmën raste të tilla nuk do të përsëriten. Porse, natyrisht më detajisht mbi të gjitha ngjarjet në këtë vilajet, ata u informuan nga Gjergj Qiriazhi.³¹⁷

Në letrën e titulluar “Some news of Monastiry Vilayet”, Qiriazhi jep një përshkrim të detajizuar të raporteve etnike në provincën “Maqedone” të Perandorisë Osmane. Bullgarët, thoshte ai, ishin shumë mirë të organizuar, duke zgjedhur me zgjuarsi njerëz të aftë dhe mirë të organizuar në të gjitha qytetet bullgare, njëkohësisht mbledhnin edhe të holla, të nevojshme për arritjen e objektivave të tyre kombëtare. Në të njëjtën mënyrë vepronin edhe në Vilajetin e Manastirit.

Mirë të organizuar ishin edhe grekët, të cilët po kështu kishin aspirata në provincën “Maqedone” të Perandorisë Osmane, ndaj edhe kishin mbledhur fonde financiare në Greqi dhe jashtë saj. Bile, thoshte Qiriazhi, grekët kishin mundur të kthejnë një numër të madh fshatrash Ekzahrste në gjirin e Patriarkanës së Stambollit. Në arritjen e këtij qëllimi, ndihmesë të madhe kishte dhënë edhe qeveria osmane, e cila në veprimtarinë e bullgarëve shihte një rrezik potencial për integritetin e saj territorial. Ngase, nuk duhet harruar se Sulltani ishte mbrojtës i besimtarëve ortodoksë, pushtet të cilën e ushtronte me ndërmjetësim të Patrikanës së Stambollit, kurse ekzarhistët kishin mbështetjen e Rusisë Cariste.

Serbët, si palë po ashtu e interesuar në këtë vilajet, kishin përforcuar aktivitetin e tyre dhe ndonëse ishin në konflikt të përhershëm me bullgarët, kishin ndërruar strategji duke u afruar me ta, bashkim ky, që kishte rrezikuar seriozisht interesat e qeverisë së Stambollit.

³¹⁷ AIH, Vj-7-2-246 (HHStA, PA, A, No. 69)

KUMTESA

Vllahët,banorë e lashtë të “Maqedonisë”,ishin në marrëdhënie miqësore me serbët dhe bullgarët,dhe në armiqësi me grekët.Deri në këtë kohë,thoshte Qiriaz,i,ata kishin besuar se vetëm me veprimtari kulturore,duke hapur shkolla dhe kisha kombëtare,do të siguronin të drejtat e tyre.Porse ishin zhgënjyer shumë,andaj edhe ata kishin filluar të krijonin çeta të armatosura ,si një nga metodat më të preferuara të diplomacisë Evropiane,për t’i shfrytëzuar si mjet presioni ndaj “Portës së Lartë”. Shpresat e tyre i kishin në Rumaninë,e cila edhe nuk mundte por edhe nuk dëshironte të prishte marrëdhëniet me Stambollin.Në kushte të tilla të pavolitshme për ta,udhëheqësit vllahë shpresonin në ndihmën Italiane,e cila po t’i mbështeste ,ky komb edhe mund të ishte shpëtuar nga asimilimi.³¹⁸

Shqiptarët,së paku deri më 1905,nuk kishin një lëvizje të organizuar ushtarake,jo pse nuk kishin atdhedashuri,por shpjegonte Qiriaz,i,ata nuk kishin mbështetjen që gëzonin popujt e tjerë të “Maqedonisë”në shtetet e tyre amë si : Bullgari,Serbi dhe Greqi,por edhe në fuqitë politike të kohës.Natyrisht,vazhdonte rilindasi ynë,të gjitha këto kombe nuk do të kishin arritur asgjë ,po të mos kishin përkrahjen e fuqishme të ndonjë shteti të fuqishëm,dhe shtrrohet pyetja:Pasi shqiptarët kishin mbetur pa mbështetje,a është e drejtë që të humbin vendin dhe gjuhën e tyre?A nuk është e drejtë që edhe ata si të gjithë popujt e botës të kërkojnë liri,dhe mundësi të barabarta për të zhvilluar kulturën dhe qytetërimin me elemente karakteristike shqiptare.

Për më tepër nuk ishin vetëm grekët,bullgarët dhe serbët që mendojnë dhe punojnë për vendin e tyre,ndërsa shqiptarët të vdisnin për interesa të huaja,jo më.Edhe ata pas kalimit të pengesave fillestare,kanë filluar të vetëdijesohen,se kjo tokë u takon atyre,dhe sa ata kanë të drejtë që për të edhe të sakrifikohen.Ata tani më e kishin të qartë se nga Turqia nuk do të kishin asnjë ndihmë,edhe pse ata kishin derdhur gjakun e tyre për Perandorinë.Për më keq ,qeveria në Stamboll,u lejonte të gjitha kombeve të cilat edhe pse punonin për fundin e saj ,edukimin në gjuhën e tyre kombëtare,me përjashtim të shqiptarëve.³¹⁹

Ishte kjo një politikë thellësisht e gabuar dhe me pasoja si për shqiptarët ashtu edhe për vetë qeveritarët osmanë,të cilët po të kishin vepruar në drejtim të emancipimit dhe zhvillimit të viseve shqiptare,ajo do të kishte vazhduar të kishte mbështetjen e tyre.Mjerisht,në fillim të shekullit XX ishte shumë e evidente edhe për shqiptarët se reformat në “Maqedoni”nuk ishin rezultative,andaj shpëtimi edhe i tyre ishte në luftën e armatosur.

Nga i gjithë ky raport i Gjergj Qiriazit ne mund të nxjerrim tri përfundime të rëndësishme.E para nga kjo është rëndësia që kishte informimi i opinionit të huaj publikë nga vetë shqiptarët,pra jo nga burimet serbe,bullgare e greke,të cilat si palë e interesuar për të trashëguar Perandorinë Osmane,pretendonin hapësira të banuara me shumicë nga shqiptarët.Rrjedhimisht për të ligjësuar këto kërkesa të tyre,ata dezinformonin opinionin ndërkombëtarë me gjysmë të vërteta dhe faktografi historike të bazuara në mitologji dhe të dhëna statistikore të rrejshme.E dyta që rrjedhë nga ky raport është edhe njohuria se qarqet vendimmarrëse Evropiane në përcaktimin e fatit të metejshëm të kësaj pjese të Ballkanit,si pikë orientuese nuk kishin përbërjen etnike të këtyre vendbanimeve,por fatkeqësisht elementin historik.Kështu provinca që ata quanin “Maqedoni”përfshinte vendbanime me shqiptarë,bullgarë dhe grekë,gjë do të thoshte se ajo hapësirë gjeografike do t’i takonte atij që do të dëshmonte më mirë dhe më bindshëm lidhshmërinë e saj historike me shtetet mesjetare serbe,bullgare ose lidhshmërinë e Aleksandrit të Madh me kulturën helene.Pra,nga ky botëkuptim i gabuar i historisë,popujt shtetet e të cilëve në lashtësi nuk ishin shtrirë edhe në këto hapësira,dënoheshin duke u lënë që ata të përfshiheshin në kufijtë e shteteve me të cilët nuk kishin përkatësi të nejtë etnike e religjioze.Një fat i tillë do t’i priste në provincën “Maqedone”,shqiptarët dhe vllahët,të cilët edhe pse në numër të madh jetonin aty,më vonë duke marrë elementin religjioz ortodoksë do t’i nënshtroheshin bullgarizimit,serbizimit dhe greqizimit.Përfundimi i tretë i këtij raporti qe edhe kuptimi se edhe atëherë,pra në kohën kur të gjithë thirreshin në qytetërimin përparimtarë Evropian,në realitet e vërteta dhe e drejta nuk ishte në anën e të shtypurit dhe të robëruarit,por në anën e atij që arrinte në opinionin publik të krijonte figurën e viktimitës,pra ashtu siç bënin shtetet ballkanike,dhe që njëkohësisht kishte

³¹⁸ AIH,A-39,fl.1

³¹⁹ Po aty,fl.2

forcën për të imponuar zgjidhjen vetanake. Prandaj, shumë shpejt pas këtij raporti, Gjergj Qiriazhi i vetëdijshëm për një nevojë të një lufte të organizuar kombëtare kundër Perandorisë Osmane, do të ishte një nga anëtarët e shoqërisë së fshehur të Manastirit komitetit "Për Lirinë e Shqipërisë", e cila do të formonte edhe çetën e Çerçiz Topullit,³²⁰ duke u dëshmuar të gjithëve kështu, se shqiptarët nuk ishin vetëm numër që do të asimilohej nga fqinjët ose duke marrë si bazë përkatësinë e tij religjioze islame do të shpërngulej në pjesën që do të mbetej nga Perandoria Osmane, por ata janë një komb që pretendon të jetojë i lirë. Frytet e një veprimtarie të tillë që pranimi që iu bë kombësisë shqiptare nga ana e Portës së Lartë pas revolucionit gjonturk të vitit 1908.

Summary

The author of this political report, George Qiriazhi, is known not only for his activity in the field of Albanian national education and the struggle for the introduction of the Albanian language in religious institutions, but also is distinguished for a heightened political activity in an effort to inform international circles from Albanians and for Albanians. So, in this spirit is also this report, in which he would present the real situation in the Vilayet of Monastery or province of "Macedonia" how it was called.

Recenzentë :
Prof.dr. Shkelzen Raça
Prof.dr. Fadil Greiçevci

³²⁰ Hysni Myzyri, Shkollat e Para Kombëtare, Tiranë 1973, 247.

KUMTESA

Mr.sc. Arbër SALIHU: DEMONSTRATAT E VITIT 1981 NË KOSOVË NË KONTEKSTIN E ZHVILLIMEVE TË BRENSHME TË ISH- JUGOSLLAVISË

Demonstratat që shpërthyen në Kosovë, në pranverën e vitit 1981, paraqesin momentin kur gjërat politike në Kosovë dhe në Jugosllavi do të ndryshonin përgjithmonë kahjen e tyre. Këto demonstrata, ku në fillim u përfshinë studentët e Universitetit të Prishtinës e shumë shpejt pastaj do të inkuadroheshin edhe punëtorët dhe masat e gjëra të qytetarëve shqiptarë, patën efekte që u reflektuan në mënyra të ndryshme në mbarë Jugosllavinë. Kështu demonstratat e viti 1981 shënojnë fillimin e një faze të re historike, shumë dramatike. Fazë kjo ku gjërat do të përshkallzonin deri në suprimimin e autonomisë së Kosovës por dhe në fillimin e rrënimit përfundimtar të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Rethanat në të cilat shpërthyen këto demonstrate ishin mjaft komplekse. Për shtetin jugosllav përgjithësisht ishte krijuar përshtypja si e një “parajse” të barzisë nacionale dhe zhvillimit të suksesshëm ekonomik. Këtë e faforizonte pozita e saj ndërkombëtare, amortizuese, në mes Lindjes dhe Perëndimit, dhe përfitimet që sillte ajo situatë³²¹. Një kontribut të rëndësishëm për imazhin e saj pozitiv luajti edhe udhëheqësi i saj karizmatik J.B. Titos, me politikën e tija balancuese. Por, shteti jugosllav, që në pamje të parë dukej shumë stabil e i qetë, në të vërtetë ballafaqohej me probleme të ndryshme shumë serioze. Imazhi i tij pozitiv ishte vetëm njëra anë e medaljes. Në qarqet ndërkombëtare kishte shqetësime për të ardhmen e Jugosllavisë. Këto shqetësime kishin filluar të shfaqeshin madje qysh gjatë viteve 70-ta të shekullit XX-të. Pytja që shtrohej ishte se çka do të ndodhte me Jugosllavinë pas vdekjes së Titos³²². Arsyet për këtë shqetësim ishin problemet që shfaqeshin apo që supozoheshin se do të mund të shfaqeshin nga veprimet nacionaliste, separatiste, dezintegruese, brenda saj por, dhe nga kalkulimet e marrëdhënieve ndërkombëtare. Fati i ardhmërisë së Jugosllavisë parashikohej shumë i zymët në vlerësimet që i bëheshin asaj në shumë skenar të ndryshëm, të mundshëm.

Problemet e shtetit jugosllav kishin filluar të shfaqeshin qysh gjatë viteve '60. Në thelb të tërë kësaj ishin antagonizmat dhe përplasjet në mes dy rrymave që ekzistonin brenda partisë komuniste të Jugosllavisë. Në njërin anë ishte rryma liberale, idhtarë e decentralizimit më të madh të sistemit qeverisës dhe ekonomisë jugosllave, kurse në anën tjetër ishte rryma unitariste, simpatizuese e centralizimit. Grupin e parë e përfaqësonin republikat më të zhvilluara siç ishin Sllovenia e Kroacia, që kërkonin ndryshime dhe një pavarësi më të madhe institucionale e ekonomike nga qendra. Kurse, grupin tjetër unitarist e përfaqësonte Serbia, që synim kryesor kishte ruajtjen e sistemit centralist të qeverisjes. Megjithatë, sado që kjo dukej si luftë e ideve dhe koncepteve qeverisëse, në esencë ishte luftë për dominim brenda federatës. Shumë qartë shihej që Serbia duke e mbrojtur centralizmin mendohej t'i ruante interesat e veta dhe t'i realizonte qëllimet hegjemoniste ndaj njësive tjera federale. Por, kësaj i kundërvihej koncepti slloven e kroat i decentralizimit që shfaqte mospajtimin me ritmet e

³²¹ Enver Hasani, Vetëvendosja, Integriteti territorial dhe stabiliteti ndërkombëtar : Rasti i Jugosllavisë, Prishtinë, 2010, fq.154

³²² Yugoslavia: An Intelligence Appraisal (In Response to NSSM 129), 27 July 1971, shiko: http://www.dni.gov/68C316DC-38CE-4608-B7AC-ECBC13779302/FinalDownload/DownloadId-F1BC22180243B622FA138735FAB8DFB0/68C316DC-38CE-4608-B7AC-ECBC13779302/mic/PDF_GIF_declass_support/yugoslavia/Pub24_An_Intel_Appraisal_27-Jul-1971.pdf ; Fejton: Dosja sekrete e CIA-së për Kosovën, “Koha Ditore” Prishtinë 15.01.2005, fq 6; 21.01.2005 fq.6; 27.01.2005 fq.6

KUMTESA

deriatëhershme të zhvillimit dhe mënyrën parazitare të qeverisjes së shtetit³²³. Duke mbrojtur decentralizimin ato mbronin interes e veta dhe i shmangeshin ndikimit serb. Në këtë mes nuk duhet përjashtuar edhe luftën për pushtet që realizohej brenda udhëheqësisë partiake e shtetëror jugosllave³²⁴.

Krahu politik brenda Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë që përfaqësonte idenë e ndryshimeve përkrahej nga Tito dhe një grup i bashkëpunëtorëve të tij si Eduard Kardeli, që konsiderohej edhe kreatori i sistemit të vetëqeverisjes jugosllave. Ky grup arriti që të imponoj mendimet e veta. Sistemi i vetëqeverisjes, që u sanksionuar me ligjet federative, bazohej në bartjen e pushtetit tek "baza" domethënë tek fabrikat apo organizatat themelore të punës së bashkuar dhe komunat. Kjo siguronte një formë më të lirë të qeverisjes dhe konkurrencës, në sferën e ekonomisë³²⁵. Njëkohësisht me këtë, shumë kompetenca barteshin tek republikat dhe krahinat federative duke fuqizuar rolin e tyre.

Por, kjo alarmoi grupin tjetër që përfaqësohej nga Aleksandër Rankoviçi, komunisti serb, bashkëpunëtor i vjetër i Titos që në atë kohë mbante poste të rëndësishme si atë të sekretarit të Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, ministrit të punëve të brendshme por dhe atë të nënkryetarit të RSFJ-së. Ai dhe politikanët që kryesisht vinin nga dega e Lidhjesë Komuniste të Serbisë, të përkrahur dhe nga qarqet akademike e të tjera serbe, shfaqën hapur reagimet e tyre ndaj këtyre ndryshimeve. Qëndrimi refuzues i Rankoviçit dhe përkrahësve të tij i la të kuptonte Titos se ai nuk mund ta kontrollonte më krahun ekstremist serb brenda partisë. Për ta shmangur rrezikun që i kërcnohej pozitës së tij dhe balancit në mes të njësive federative, si kusht i domosdoshëm i funksionimit të shtetit, ai vendosi të ndërmarrë masa të shpejta ndaj këtij grupi.

Në Plenumin e IV të Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, që u mbajt në korrik të vitit 1966, në Ishujt e Brionëve, Aleksandër Rankoviçi dhe bashkëpunëtorët e tij u akuzuan për keqpërdorim të pozitës së tyre. Ata fajsoheshin dhe konsideroheshin përgjegjës për atë se kishin tentuar të fusnin nën kontroll dhe përgjim njerëzit e thjeshtë por edhe nivelet më të larta udhëheqëse politike, duke përfshirë edhe vet J.B. Titon. Si rrjedhojë ish udhëheqësi i UDB-së famkeqe u detyrua të jepte dorëheqje dhe të largohej nga të gjitha funksionet e tija partiake e shtetërore.

Largimi i Aleksandër Rankoviçit dhe i forcave ekstremiste serbe ishte një lajm i mirë për popullsinë shqiptare të Jugosllavisë dhe për të gjithë ata që ishin shtypur dhe maltretuar pamëshirshëm nga sigurimi i fshehtë shtetëror, UDB-ja. Por, në anën tjetër kjo kishte acaruar në maksimum forcat ekstremiste serbe tek të cilat po grumbullohej një inat revanshist që nuk guxonte të shfaqej hapur, por jepte sinjale se priste rastin e vet për hakmarrje. Dobrica Qosiq, një nga eksponentët e nacionalizmit ekstrem serb i shkruante Titos në atë kohë "mos e ngucni Rankoviçin, ose kjo do të kuptohet si goditje mbi tërë Serbinë"³²⁶

Megjithatë përpjekjet për decentralizim vazhduan edhe më tutje. Një fazë e re që njihej si decentralizimi i natyrës burokratike filloi pas vitit 1966³²⁷. Kjo në radhë të parë lidhej me ekonominë por, gjithsesi se prekte edhe sferën e politikës. Duke u përpjekur që në këtë fushatë të përfshinin sa më shumë kundërshtar të frymës centraliste vet Tito kishte interes që në këtë kohë të përkrahte avancimin e të drejtave të popullsisë shqiptare në Kosovë. Në këtë mënyrë mund të zgjeronte rrethin e përkrahësve të tij në luftën për mbajtjen e balanceve politike.

Në rrethanat e krijuara përfituan edhe udhëheqësit politik kosovar që shfrytëzuan rastin të denonconin padrejtësitë dhe keqtrajtimet e ndryshme që u ishin bërë shqiptarëve gjatë dekadave të kaluara. Ata kërkonin edhe avancimin kushtetues të të drejtave të popullit shqiptar por edhe të statusit të Krahinës së Kosovës.

³²³ Enver Hasani, Vetëvendosja ... vep. e cit. fq.146

³²⁴ Mehmet Kraja, Identiteti kosovar, Prishtinë, 2011, fq.141

³²⁵ Ana Lalaj, Kosova rrugë e gjatë drejt vetëvendosjes (1948-1981), Tiranë,2000, fq.136-137

³²⁶ Kovanje Antijugoslovenske zavere, Knjiga 1, (Uredila I priredila:Sonja Biserko),Beograd 2006, fq,85

³²⁷ Enver Hasani, Vetëvendosja, Integriteti...vep. e cit. fq.146

Riorganizimi shtetëror i RSFj-së ishte kërkesë që dëgjohej gjithnjë e më shumë në forume të ndryshme partiake por edhe në nivelet tjera profesionale. Ndryshimet kushtetuese që filluan të proklamoheshin në kuadër të projektit "Ndërrimet dhe shtesat kushtetuese" ndodhën në tri faza gjatë viteve 1967, 1968 dhe 1971. Këto ndryshime u përqendruan në amandamentimin e kushtetutës që ishte në fuqi. Amandamente e miratuara ndryshuan në një masë të konsiderueshme marrëdhëniet midis nivelit qendror federative dhe njësisë të saja. Në këtë kontekst ndryshoi edhe pozita e krahinave autonome duke zgjeruar të drejtat, përgjegjësitë dhe detyrat e tyre. Kjo ishte një arritur e rëndësishme edhe për Kosovën. Por, kjo nuk duhet kuptuar si një dhuratë e gatshme për Kosovën, në radhë të parë ishte meritë e angazhimeve të popullit shqiptar që u artikulua edhe në kërkesat e saja në demonstratat e vitit 1968. Kërkesa kryesore e shqiptarëve që u dëgjua në atë kohë ishte "Kosova Republikë". Por, udhëheqja komuniste jugosllave nuk ishte e gatshme që të bënte lëshime të tilla. Megjithatë, Kosova arriti të fitonte disa të drejta shumë të rëndësishme që afirmonin pozitën e saj të përgjithëshme. Në atë kohë u lejua përdorimi i lirë i flamurit kombëtar shqiptar, u hap Universiteti i Prishtinës si dhe u përmirsua pozita kushtetuese që i hapi rrugën edhe ndryshimeve tjera që do të sanksionoheshin në Kushtetutën e Jugosllavisë, të vitit 1974.

Krahas kërkesës për decentralizim në nivelin federative u përcollën edhe kërkesat për avancimin e çështjeve kombëtare. Këto u potencuan më së shumti në Kosovë dhe në Kroaci. Në njësitë tjera federale çështja kombëtare ishte rregulluar në një masë të kënaqëshme në formë të ndryshme. Gjersa në Kosovë u bënë disa lëshime me të cilat shteti mendonte se do t'i qetsonte shqiptarët, në Kroaci gjërat shkolin më ndryshe. Grupet intelektuale por edhe politikanët e rinjë kroatë e shikonon si shumë të rrezikshme idenë e jugosllavizmit. Ideja e përdorimit të gjuhës serbo-kroate si një fillësë e krijimit të një kombi jugosllav ishte shumë shqetsuese për ta. Elita intelektuale kroate këtë gjë e shikonte si një përpjekje hegjemoniste serbe për ta serbizar gjuhën kroatë. Ajo doli hapur me thirrjet që i dretonte bashkëkombasve të vet që ta refuzonin gjuhën serbo-kroate dhe alfabetin cirilik dhe të aplikonin vetëm gjuhën kroatë. Por, një kërkesë të tillë shumë shpejt i u përgjegj pala serbe që kërkoi nga serbët që jetonin në Kroaci të bënin të kundërtën, të përdornin domosdo alfabetin cirilik. Çështja e gjuhës ishte vetëm njëra nga akuzat dhe kundërakuzat që shpërthyen në atë kohë në mes të serbëve dhe kroatëve. Fryma kombëtare që po rishfaqej më vullshëm në këtë kohë në Kroaci u konkretizua me lëvizjen masive (Masovni pokret) që ndryshe njihet edhe si Pranvera Kroate e vitit 1971. Kësaj lëvizjeje ju bashkangjiten edhe udhëheqësit e rinjë komunist kroat Savka Dabçević Kuçar dhe Miko Tripalo, por rolin kryesor e luante organizata "Matica Hrvatska". Kjo organizatë e intelektualëve kroatë që ishte themeluar qysh në shekullin XIX ishte riaktivizuar sërish në vitin 1967. Gjendja po acarohet shumë dhe shkrimet e ndryshme që plasoheshin në shtypin dhe pamfletet e kohës nxitën çështje të ndjeshme për diskutim si ajo se kujt i takonte Kroacia dhe Bosna e Hercegovina. Gjërat shkuan deri aty sa "Matica Hrvatska" u deklarua publikisht se ishte për shkëputjen e Kroacisë nga Jugosllavia. Me të njëjtën gjuhë u përgjigjën edhe serbët që kërkuan autonomi të një pjese të territoreve ku jetonin serbët e Kroacisë. Në këtë mënyrë po ringjallehin ambicjet e vjetra që kishin ekzistuar më parë. Në këtë situatë ndërhyri Tito duke bërë përpjekje që përmes bisedave me udhëheqësit kroat ta qetsonte situatën dhe ta zgjidhte problemin. Po, kjo nuk pati sukses. Kërkesa për shkëputje që u dëgjua në këtë kohë nga kroatët alarmoj jo vetëm udhëheqësinë jugosllav. Vet udhëheqësi sovjetik, Leonid Brezhnjev, kishte propozuar një ndërhyrje ushtarake për ta zgjidhur këtë çështje, por Tito e kundërshtoi. Si duket në mendjen e udhëheqësit jugosllav ishte ngulitur thellë frika e rrezikut që ai e shikonte nga Bashkimi Sovjetik, qysh nga koha e Informbyros por edhe nga intervenimi ushtarak i BRSS-së në Çekosllovakia, në vitin 1968. Kështu ai vendosi të ndërhyj vet, mori vendim që ta shtypte lëvizjen nacionaliste kroate duke i shkarkuar edhe udhëheqësit partiak në Kroaci. Ndër masat tjera që Tito ndërmoi në këtë kohë, për të shmangur ambicjet gllabruese serbe e kroate ndaj Bosnes dhe Hercegovinës, ishte edhe njohja e kombit musliman boshnjak.

Në kuadër të kësaj politike balancuese duhet parë edhe rrjedhojën e ndryshimeve të reja kushtetuese që rezultuan me hartimin dhe miratimin e Kushtetutës së re jugosllave, në vitin 1974.

KUMTESA

Kushtetutë kjo që avancoi dhe afirmoi akoma më shumë edhe të drejtën e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Kjo kushtetutë siguronte pjesëmarrjen e Kosovës në të gjitha organet federative dhe e njëjtte atë si njësi konstituive të federatës. Ajo i mundësonte dhe i garantonte edhe Kosovës ta kishte kushtetutën e vet për dallim nga më herët që kishte vetëm Ligjin Kushtetues.

Por, sado që këto avancime ishin të rëndësishme, shqiptarët kishin kërkesa edhe më të mëdha. Republika e Kosovës ishte synim parësor dhe shumë legjitim për të realizuar të drejtat e tyre. Megjithatë, kjo kërkesë e parashtruar edhe më herët, madje edhe në kanalet zyrtare drejtuar vet Titos, nga një delegacioni kosovar, nuk gjeti përkrahjen. Në këtë mënyrë thuajse u mbyllën rrugët për adresimin e kësaj çështje në mënyrë legale.

Udhëheqja politike e Kosovës megjithatë u mundua që ta shfrytëzonte hapsirën e krijuar duke u përqendruar në ngritjen dhe konsolidimin e institucioneve autonome, në avancimin e arsimit dhe ekonomisë. Por, kjo nuk mjaftonte sepse Kosova prap se prap mbetej pjesa më e prapambetur në ish-Jugosllavi. Ekonomia akoma mbeti në nivele të ulëta të zhvillimit dhe po krijohej një hendek në mes të Kosovës dhe njërive tjera federale.

Kjo kishte nxitur grupet ilegale shqiptare që të ishin edhe më këmbëngulë në kërkesën për realizimin e plotë të drejtave të shqiptarëve duke u angazhuar fillimisht për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Në këtë kërkesë më të zëshmit ishin organizata “Lëvizja Revolucionare e Bashkimit të Shqiptarëve” e udhëhequr nga Adem Demaçi dhe “Fronti i Kuq Popullor” që drejtohej nga Jusuf Gërvalla. Në programet e këtyre organizatave qëllim parësor ishte bashkimi me Shqipërinë, duke përdorur të gjitha mjetet e mundëshme, qoftë duke përdorur edhe kryengritjen e armatosur³²⁸.

Por, Kushtetuta e vitit 1974 kishte lënë të pakënaqur edhe serbët. Madje nacionalist serb si Dobrica Qosiq e të tjerë, ishin shprehur hapur kundër të drejtave që u garantoheshin Kosovës dhe shqiptarëve me këtë kushtetutë. Kurse qarqe ekstreme nacionaliste të përfaqësuar nga Dragosllav Markoviç, Millosh Miniç, Petar Stamboliç etj. në vitin 1977 kishin hartuar të ashtuquajturin “Librin e kaltër” që shqyrtonet Kushtetutën e vitit 1974, sidomos pjesën që kishte të bëjë me pozitën e krahinave të Vojvodinës dhe Kosovës. Aty ngritej edhe çështja e rishikimit të Kushtetutës, menjëherë pas vdekjes së Titos.

Dhe më të vërtet, vdekja e J.B.Titos në vitin 1980 ishte moment që forcat nacionaliste serbe e shfrytëzuan si shansë për të rishikuar pozitën e tyre dhe për të rritur ndikimin në tërë shtetin. Qarqet politike e intelektuale serbe filluan të rishfaqnin ambicjet e tyre unitariste. Ato mezi prisni që të ju krijohej rasti për të marr masa ndaj shqiptarëve³²⁹. Për të shfaqur hakmarrjen e tyre ndaj procesit të decentralizimit të Jugosllavisë dhe ndaj vendimeve të Kushtetutës së vitit 1974. Ndoshta pikërisht duke e kuptuar këtë qëllim të udhëheqësisë serbe të asj kohe, lideri komunist i Kosovës, Mahmut Bakalli, kishte shfaqur hezitimet e veta për demonstratat e vitit 1981 dhe vite më vonë kishte ngritur çështjen e mungesës së planit B, nga lëvizja shqiptare e kohës.

Ngjarjet e vitit 1981 ishin shpërthim që edhe mund të ishte pritur, ndoshta jo mu në këtë kohë dhe në këtë mënyrë, por herët a vonë diçka e ngjashme do të ndodhte. Nëse jo në Kosovë atëherë diku tjetër në Jugosllavi gjithsesi. Por, Kosova ishte më e predispozuar për një gjë të tillë.

Egërsia me të cilën u trajtuan demonstratat e viti 1981 në Kosovë, sidomos nga ana e Serbisë, ishin prelude i asaj çka do të ndodhte në këtë krahinë por edhe në mbarë federatën jugosllave në dekadat në vazhdim.

Recenzentë :
Prof.dr Fehmi Rexhepi
Prof. dr. Isa Bicaq

³²⁸ Historia e Popullit Shqiptar IV, Tiranë , 2009, fq.384

³²⁹ Julie a. Mertus, Kosova how myths and truths started a war, University of California Press, Berkeley, Los Angeles,
London, 1999 fq.35

Mr. sc Klodian GJONI¹: EKZISTENCA DHE FUNKSIONIMI I QYTETËRIMIT ANTIK NE KAONI

¹Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Sarandë

Përmbledhje

Objekti i këtij studimi është historia e egzistencës dhe e funksionimit të qytetërimit antik në Kaoni me tipologjinë origjinale, me dhënie, me marrjet dhe me ndikimet e tij. Këtë trevë që ka qenë e banuar qysh në shekullin XII p. l. K., e përmend për herë të parë Homeri te “Odisea”. Jeta urbane e kësaj krahine nuk është ndërprerë për mbi 2500 vjet duke evidentuar një pasuri të konsiderueshme të trashëgimisë kulturore shqiptare.

Synohet të studiohen qytetet dhe qytetërimi antik në Kaoni, të hulumtohet mbi mënyrën se si e paraqitin njerëzit veten e tyre dhe marrëdhëniet me botën ku jetonin. Të zbërthehet dhe të analizohet një qytetërim antik, duke bërë kërkime mbi funksionin që ai kryen në shoqërinë dhe qytetet antike, në të cilat ai është shfaqur.

Përmes metodës induktive, sheshtohen teori dhe mendime të ndryshme të autorëve e studiuesve që nga antikiteti e deri ata modernë.

Konsiderohet e pamundur për t’u ngjitur deri tek origjina primare. Megjithatë, prirja është të shkoj sa më në thellësi të mugëtirave të kohërave, gjithmonë përmes hulumtimeve dhe analizave pluridisiplinare.

1. Në këtë studim akumulohen prurjet e deritanishme në lidhje me qytetet dhe qytetërimin antik në Kaoni, me ambicien afirmative për të bërë përgjithësime dhe për të nxjerrë deduksione që lënë mbresë, jo vetëm tek lexuesit e thjeshtë, por edhe tek studiuesit e trashëgimisë kulturore dhe arkeologjike.

2. Janë përcaktuar ç’është dhe si nisi ky qytetërim dhe këto qytete sipas këndvështrimeve të ndryshme në ide, në kohë e në hapësirë duke u përpjekur përmes hulumtimeve të pasqyroj dhe të evidentoj ato më interesantet, natyrisht mbi këndvështrimin tim.

3. Është zbërthyer dhe analizuar zhvillimi i qyteteve, duke bërë kërkime mbi lidhjet midis tyre dhe formës së evoluimit të tyre, që për çdo qytet të zbulohet mënyra e zhvillimit dhe lidhjet e tyre me njëri – tjetrin.

4. Është bërë kërkimi dhe përcaktimi i një modeli referimi, duke filluar nga vendosja e një numri shembujsh ose konkretizimesh të qytetërimeve të ndryshme. Ndërsa rrjedha e kërkimit ka ecur përmes përafrimeve të njëpasnjëshme.

Për të arritur më pas në një mendim-sintezë, në përfundimin se si qytetërimi antik në Kaoni e bart kulturën e kësaj zone, dëshminë autoktone për qytetërimin, kulturën, ekonominë dhe zhvillimin politik të tyre që kanë karakterizuar gjithë historinë e trashëgimisë kulturore shqiptare.

Fjalët çelës: qytetërim antik, Kaoni, trashëgimi kulturore, autokton, shqiptare.

HYRJE

Shumë historianë, filozofë, arkeologë, etnologë, gjuhëtarë, dramaturgë, muzikologë kanë folur e shkruar për qytetërimin antik në Kaoni. Përqëndrimi i tyre më interesant ka qenë në hershmërinë e krijimit, vazhdimësinë e lulëzimit të tyre.

Territori kaon, nga eksplorimi që i është bërë, është një thesar i rrallë i historisë sonë kombëtare. Jeta urbane e kësaj krahine nuk është ndërprerë për mbi 2500 vjet duke evidentuar një pasuri të konsiderueshme të trashëgimisë kulturore shqiptare.

Janë evidentuar gjurmë të lashtësisë në mbi 300 vendbanime si: qytete, qyteza, kështjella, kala, mure fortifikues, banesa, ura, ujësjellësa, tuma etj..

Shumë qytete e qyteza në Kaoni kanë lulëzuar njëkohësisht, të tjera ia kanë lënë vendin njëra - tjetrës. Disa kanë pasur jetëgjatësi njëzet a tridhjetë shekujloze, të tjerë jo më shumë se shtatë - tetë shekujloze. Disa i kanë ruajtur mirë gjurmët e ekzistencës së tyre, disa janë braktisur e rrafshuar në vite nga banorët përreth.

Kaonia dallohet për njëkohësinë e saj me antikitetin ilir e helen. Historia shqiptare krenohet kur argumenton se Butrinti është një Trojë në miniaturë, kur thotë se Foinike, qendra kryesore e Kaonisë u bë kryeqyteti i një shteti të fuqishëm të Epirit, kur thekson se Saranda e sotme ka historinë portuale këtu e 2500 vjet më parë.

VENDNDODHJA E KAONËVE

Toponimi Kaoni përfshinte e shtrihej nga brigjet e detit Jon në perëndim e deri në Vjosë në lindje dhe me një shtrirje gjatësore veri-jug nga Akrokeraunet deri në lumin Thyamis (Kallama) që e ndante nga Thesprotia.³³⁰

Hershmëria e përmendjes së kaonëve nis qysh me Homerin në veprën e tij “Odiseu”, kur thotë: “Në Kimerë, përkundrejt Korkyrës, rron një popull trim, i pamposhtur, luftarak”.³³¹ Më tej përmend kimerët: “...nga Perëndimi, kur rrugët i mbulojnë hijet e natës,/ arritëm ndër kufijtë e oqeanit,/ ku truall e banesa kanë kimerët./ Jeton ky popull krejt mbuluar me mjergull/ edhe me re, pëlhurë që kurrë s'e çan/ të thuash një rreze dielli.”³³²

Kaonët përmenden për herë të parë prej Hekateut, dijetar grek i fundit të shek. VI p. l. K. dhe fillimit të shek. V p. l. K. në librin e tij *Udhëtim rreth botës*.³³³ I përmend edhe Pseudo – Skylaksi, bashkëkohës i Hekateut. Ai shprehet: “Pas ilirëve vijnë kaonët, pas Kaonisë vjen fisi i Thesprotëve”. Pseudo Skilaksi thotë se “kaonët, thesprotët dhe molosët banonin në fshatra d.m.th. një familje e madhe patriarkale ose një grup familjesh të tilla të një vëllazërie”. Përsëri ai thotë: “Pas ilirëve vijnë kaonët. Kaonia ka limane të mira, lundrimi anës Kaonisë mban gjysmë dite. Kaonët jetonin nëpër katunde (kata-komas).³³⁴ Ky pohim edhe po të merret në kuptimin që në atë kohë nuk kishim qytete, përsëri do të thotë se ata e kishin kapërcyer fazën e jetës endacake pas bagëtive dhe kishin kaluar në jetën sendentare, duke u ngulur në qendra banimi. Por ky proces nuk duhet të ketë ndodhur në të gjithë territorin e Kaonisë në të njëjtën kohë. Pas tyre kaonët i përmend Tuqiditi në fund të shek. V para Krishtit, si aleatë të spartanëve e të ambrakasve kundër Athinës.³³⁵ Kaoninë e përmendin edhe dijetarët të tjerë antikë si: Skymni shek. III p. l. K, Straboni shek. I p. l. K.

Sipas Plinit shek I p. l. K. (*Natyral History*, Libri IV, 4) emri Kaoni vinte nga kaonët e bregdetit të Akrokerauneve, ku ndodheshin fortesat Himairai dhe poshtë saj ndodheshin burimi i ujit hyjnor dhe Meandria.

³³⁰ Dhimosten Budina, *Disa rezultate të gjurmimeve në vendbanimet e lashta ilire të Kaonisë: Konferenca II e Studimeve Albanologjike II*, Tiranë 1972, f. 322- 323

³³¹ Homeri “Odisea” bot V 1960 f. 166.

³³² Homeri, *Odisea*, Onufri, Tiranë 2006: Kënga XI. v.15, f.188 (përkthimi në shqip P. Gjeçit).

³³³ N. Hammond, *Epirus*, Oxford 1967, f. 458.

³³⁴ Selim Islami etj., *Iliria dhe ilirët tek autorët antikë*, Tiranë 1965, f. 36.

³³⁵ Tucidade, *Le storie I*, Torino 1982, f. 396-401.

Me emrin Kaonë u pagëzuan banorët e kësaj zone. Edhe sot në majën e kalasë së Himarës, një majë shkëmbi quhet *Maja e Kaonisë*. Ka qenë vend vullkanik. Virgjili, poeti antik romak, i përmend në kohën e vet malet e Akrokeraunëve (të Vetëtimave), duke i cilësuar si “thithës të rrufeve”. Straboni në veprën e tij “Gjeografika” shkruan: “I ngrohtë dhe frytdhënës është ky vend, se është plot me ullishta e me vreshta”.

Stefan Bizantini është i fundit që e përmend krahinën e Bregdetit të Jonit me emrin Kaonia, në fjalorin e madh gjeografik *Mbi qytetet dhe popujt*, të bërë në vitet 528 – 548.

KAONËT SI NJË NGA FISET KRYESORE TË EPIRIT

Në shekujt e parë të mijëvjeçarit të fundit para Kr., ishin formuar bashkësi fisnore dhe në përgjithësi ato kishin zënë vend në trojet e tyre historike. Nga burimet historiko-epigrafike rezulton se fisi i Kaonëve u bë pjesë përbërëse e Epirit të lashtë. Kaonia zinte pjesën veriperëndimore të tij dhe përbëhej nga 17 fise, ku tre prej tyre përmenden me dy emra: Antigone – Argjirinë, Foinate – Kaonë, Omfale - Ofylë. Që prej autorëve të mësipërm e deri te Straboni, si fise të Epirit përgjatë brigjeve të Jonit përmenden kaonët, thesprotët dhe kasiopët.³³⁶ Ndërsa Pukëvili kur shprehet për Epirin, citon: “Të gjithë këta janë të një kombësie, vendas dhe madje stërnipër të një populli fillestar të lashtë autokton që sipas historianëve të antikitetit, rronte në këtë vend të Evropës para grekëve”.

Kaonët si në shtrirjen gjeografike dhe në kontributin që kanë dhënë në fuqizimin e shtetit të Epirit kanë qenë më kryesorët. Kaonia si fis tepër i rëndësishëm për shtrirjen gjeografike dhe si model i një organizimi të brendshëm të veçantë, përmendet shpesh nga historianët të antikitetit. Herë përmendet për ekonominë, herë për strategjinë mbrojtëse, herë për trimërinë, për rolin tregëtar në shumë porte të Mesdheut, herë për rolin ndihmues ndaj trevave kur ato rrezikonin. “Ky fis i madh i Epirit ka pasur një organizëm federativ të Kaonëve. Ishte një ndërtim politik-shoqëror e me familjen ishte ndërtimi i shoqërisë patriarkale.”³³⁷

Autorët e vjetër grekë vënë në dukje se kaonët “qeverisin pa mbretër” që do të thotë se ata nuk e njihnin pushtetin e mbretit, po qeveriseshin nga dy funksionarë të zgjedhur që quheshin prostatë. Kështu në vitin 430 para Kr. sipas Tukididit në krye të tyre “ishin prostatë për një vit Foti e Nikonidhi, që rridhnin nga fisi i parë”³³⁸ d.m.th. nga familjet e larta të fisit që kryesonte koinonin. Me kalimin e kohës forma e qeverisjes u reformua, veçse jo drejt përqendrimit të pushtetit në sa më pak duar, siç mund të pritej, po duke rritur shkallën e demokracisë. Sundimi i përbashkët i dy personave dhe ndërrimi i tyre në krye të çdo viti tregon për një regjim qeverisjeje mjaft të përparuar të kaonët, qeverisje që mund të krahasohet me regjimin republikan të Romës, ku në krye të shtetit qëndronin dy konsuj.³³⁹

Në gjysmën e dytë të shekullit V para Kr. kaonët, thesprotët e molosët merrnin pjesë në ngjarje të tilla politike të historisë së botës së Mesdheut, siç ishte Lufta e Peloponezitetit. Tukididi në vitin e tretë të luftës së Peloponezitetit shkruan: “Në gjirin e Ambrakisë, komandanti Spartan mori edhe një përforcim nga barbarët. Këta ishin në radhë të parë Kaonët, një popull që nuk sundohej nga mbretër dhe që dërguan 1000 burra nën komandën e dy prej fisnikëve të tyre.”³⁴⁰

Skylaki kur flet për Ilirinë sqaron: “Fqinjë me gjithë këta në viset e brendshme janë atintanët, sipas Oriksisë dhe Kaonisë gjer në Dodonë...” Në këto vise janë malet Keraune (Epir) dhe aty afër është një ishull i vogël që quhet “Sason”.³⁴¹ Ndërsa Plini ka saktësuar: “Epiri i marrë në përgjithësi fillon në malet Keraune. Ai përfshin në fillim kaonët prej nga vjen dhe Kaoni, thesprotët...molosët, ku

³³⁶ Strabon *Geography*, Book 7 f. 5-8 (N. Hammond, *Epirus*, f. 458-460).

³³⁷ Aristidh Kola “Arvanitasit dhe prejardhja greke” Tiranë 2002 f. 144.

³³⁸ Tukididi “Le storie”, Torino 1982 Libro II f. 80.

³³⁹ H. Ceka, N. Ceka “Mbi zhvillimin e shtetit të ilirët” ndodhet tek “Ilirët dhe gjenezja e shqiptarëve” bot. 1998 f. 42.

³⁴⁰ W. M. Lik “Udhëtimi në Shqipërinë e Vezirëve” Tiranë 2008 f. 228-229.

³⁴¹ Skilaksi “Lundrimi” “Ilirët dhe Iliria te autorët antikë” v.1965, f. 36.

ndodhet tempulli i Dodonës, i përmendur për orakullin e tij, mali Talar me njëqind burimet që gurgullojnë në këmbët e tij.³⁴²

Për vërtetësinë historike të Kaonisë dëshmon me theksimet e tij Straboni, ku shprehet: “Theopompi thotë se fiset e Epirit janë katërmbëdhjetë, më të dëgjuara janë kaonët dhe mollosët. Kaonët, thesprotët e pas këtyre me radhë kasiopët... banojnë në anëdetjen që nga malet Keraune deri tek Gjiri i Ambrakisë... dhe më tej një tjetër liman, i quajtur Onhezmi. Kundrejt të cilit ndodhet bregu perëndimor i Korkyrës...”³⁴³

Sipas poetit të famshëm Virgjili në veprën “Gjeorgjikat” “Lisat qenë pasuri e mbretit të Kaonëve”. Edhe në librin III të poemës “Eneida”, Virgjili përmend mbretërinë kaone nga e cila i ra një pjesë Helenit pas vdekjes së Neoptolemit që këto fise i quajti Kaoni, legjendë që përmendet nga Pompei Trogu.

ZHVILLIMI I QYTETEVE ANTIKE SI DHE QYTEZAT RRETH TYRE NË KAONI

Në historinë shumëshekullore të ekzistencës së fisit Kaon është pasqyruar denjësisht dhe qytetërimi autokton antik. Ky qytetërim është i lidhur ngushtësisht me ekzistencën e një numri të madh të qyteteve e qytezave në gjithë territorin ku shtrihet Kaonia. Shumë vendbanime kanë lindur, të tjerë janë zhdukur, kanë lulëzuar për shumë shekuj, a janë venitur për pak kohë. Kaonia ka pasë qytete të rëndësishme ku përmendim: Butrintin, Foiniken, Onhezmin, Antigonenë, Çukën e Ajtoit, Sopotin, Himarën, Panormin, Orikumin, Kardhiqin, Amantian e të tjerë. Janë kryeqendrat më të mëdha të Kaonisë, që me vendndodhjen e tyre, historinë, organizimin, zhvillimin, kordinimin mes trevave të banuara dhe kontributin që kanë dhënë në mbrojtjen e vendit, zhvillimin ekonomik dhe në zgjerim të besimit e të kulturës brenda qytetit a qytezës, por dhe më tej, kanë lënë gjurmë të pashlyeshme.

Kur flasim për qytete e qyteza në Kaoni, ne kemi parasysh jo çfarëdo fortifikimi të banuar me mure, por vetëm ato qendra, të cilat, pavarësisht nga sipërfaqja që zenë, shprehin praninë e një bashkësie të organizuar qytetare me funksione ekonomike dhe marrëdhënie sociale tipike urbane, me mënyrë të re jetese, me një organizim të veçantë politiko – administrativ etj.. Vendbanime me tipare të tilla urbane nuk kanë qenë të pakta në Kaoni. Gërmimet arkeologjike kanë nxjerrë në dritë në shumë prej këtyre qyteteve godina shoqërore dhe kulti, banesa, vepra të artit monumental dhe të vogël, objekte të ndryshme të përdorimit të përgjithshëm si dhe një tok mbishkrimesh të rëndësishme që i paraqesin këto vendbanime qendra të zhvilluara tregtare, politike, administrative dhe kulturore. Duke pranuar një urbanizim në përgjithësi intensiv të trevës kaone përpara pushtimit romak, duhet thënë se ky urbanizim nuk u zhvillua me një ritëm të barabartë dhe nuk pati të njëjtën shtrirje kudo. Në Kaoni ai u zhvillua më herët dhe përfshiu dhe zonat e brendshme të tij. Ky proces urbanizimi, i shkallëzuar në kohë dhe në hapësirë, është pa dyshim shprehje e një zhvillimi të barabartë social, ekonomik e politik të qyteteve e qytezave antike kaone.

Fakti që në Kaoni kishte zhvillime të qendrave urbane, bile të rëndësishme që në gjysmën e parë të shekullit I p.l.K. siç ishte Butrinti, Foinike, Himara apo Meandra, le të kuptohet se zanafilla e tyre duhet kërkuar më përpara, meqënëse qyteti nuk është fenomen që shfaqet menjëherë në formën e tij të përmbaruar, por është produkt i një procesi zhvillimi të gjatë historik. Për këtë janë shprehur si arkeologët shqiptarë dhe ata të huaj.

Këto qytete lidheshin me rrugë të rëndësishme të komunikacionit tregëtar. Këtu ekzistonin dhe premisat ekonomike për zhvillimin e jetës urbane. Këto marrëdhënie tregtare pasqyrojnë një zgjerim të mëtejshëm të prodhimit lokal të mallrave si dhe stabilizimin e shtresave të reja sociale gjatë antikitetit në Kaoni. Në varret e kësaj periudhe janë gjetur artikuj të importit grek dhe enë lokale gri me forma tipike të qeramikes greke si: kanthares, kylikse, kotone etj.. Prodhimet vendase në Foinike, Buthrot apo Antigone organizuan shtresat e reja të zejtarëve e të tregtarëve që do të përbënin në vazhdimësi edhe komponentët kryesorë socialë të qyteteve kaone. Në këtë periudhë historike, e cila

³⁴² Plini “Historia e Natyrës” libri IV f. 195.

³⁴³ Straboni V C f 158.

karakterizohet nga konflikte të brendshme e të jashtme u bënë jo vetëm qendra të rëndësishme politike, por dhe më të mbrojturat e krahinës. Në rrethanat e krijuara këto qendra u shndërruan në pika tërheqëse të shtresave të ndryshme të popullsisë së shpërndarë të fshatrave përreth tyre. Duke u vendosur pranë këtyre vendbanimeve, këto shtresa produktive hyn në marrëdhënie të reja prodhimi me aristokracinë lokale dhe në bazë të këtyre raporteve ata organizuan dhe ekonominë. U krijuan kështu kushte të favorshme për zhvillimin e një komuniteti të qëndrueshëm prodhuesish dhe konsumatorësh me interesa të përbashkëta ekonomike e politike. Lindi kështu bashkësia qytetare.

Në zhvillimin e qyteteve kaone dallojmë tri etapat kryesore:

1. Etapa e lindjes dhe formimit të tyre (shek. V- fundi shek. IV p.l.K.)
2. Etapa e intensifikimit dhe e lulëzimit të tyre më të madh (fundi i shek. IV – gjysma e shek. II p.l.K.)
3. Etapa e zhvillimit të qyteteve dhe rrethanat e krijuara pas pushtimit romak (shek. I p.l.K. – shek. III pas K.)³⁴⁴

PIKAT ARKEOLOGJIKE TË QYTETËRIMIT KAON

Kaonia ishte zona më e pasur në materiale. Mbi 300 pika arkeologjike qysh prej paleolitit me vendbanimin prehistorik të Shpellës së Kërçmoit, Xarrës, tumat e Bajkajt e deri në periudhat e vonëta japin mundësinë për të njohur qytetërimin antik në Kaoni. Vendbanimi i Badhrës ngrihet në një kodër me pozitë zotëruese në Bregdetin Jon. Materiali arkeologjik paraqet një nga fazat më të hershme të ngritjes së vendbanimeve të fortifikuara të epokës së bronzit të vonë 1500-1200 para Kr..

Të kësaj periudhe janë rathët e Qiroflekasit, midis fshatrave Vergo e Senicë, si dhe vendbanimi i Shqevit në veri të fshatit Tatzat, Gjashnjari pranë Lukovës që dëshmojnë se konceptimi i jetës është zhvilluar brenda fortifikimit si një vendbanim fisnor. Foinike (Finiqi), Onhezmi, Metoqi e Çuka zotëronin zonat pjellore të lumenjve Kalasë e Bisticë. Fushën e begatë të rrjedhës së poshtme të Pavllës dhe liqenin e Butrintit i zotëronte qyteti antik i Butrintit, Kalivoi e Çuka e Ajtoit. Mbi bazën e këtyre vendbanimeve të fortifikuara të kohës së hekurit u ndërtuan dhe qytetet antike Malçani me Paleomanastron e Ripësin, të cilët zotëronin një territor mbi luginën e sipërme të lumit Pavlla, që kontrollonte krahas luginës dhe rrugët që lidhnin Kaoninë me Thesprotinë. Bregdeti Jonian përfshihej në qytezën e Himarës, Sopotit, Karosit e Kalasë së Dhoknës (Qafa e Pazarit). Karakterin blegtoral të këtij territori e shpreh niveli kulturor e arkitekturor i qytezave. Një nivel i lartë ekonomik, arkitekturor e kulturor është zbuluar dhe në territorin e Antigonesë, në luginën pjellore të Drinos. Krahas qyteteve të Antigonesë e Melanit janë edhe qytetet e Leklit, Labovës e Selosë që kontrollonin rrugët që kalonin në këtë luginë dhe lidhnin Kaoninë me Molosinë. Ndërsa Kardhiqi që dyshohet të jetë qyteti antik i Fanotës kontrollonte rrugët që lidhnin pjesën e brendshme të Labërisë me Gjirokastrën, Janinën e Korkyrën nëpërmjet Qafës së Skërficës dhe luginës së lumit Belicë (lugina e Lumit të Bardhë). Orikumi e Amantia zotëronin zonën bregdetare të Adriatikut dhe rrugët e brendshme për lidhjen e zonës veriore me atë jugore. Ndërsa Himera-Himara ishte kryeqendra e Bregdetit, nëpër të cilën kalonte rruga që vinte nga Brindizi – Aulona – Akrokeraunia – Llogora – Foinike – Buthrot – Pelod – Nikopojë.

Monedhat e gjetura në gërmimet arkeologjike në këtë territor flasin për një qendër të madhe zejtare, bujqësore dhe tregëtare, e lidhur me zonat mesdhetare dhe perëndimore. Vlen të përmendet një përcaktim i Ciceronit se “Ilimani që shërbente për të lidhur Finiqin me Korkyrën quhej Onhezmi. Kjo ishte pikë tranziti midis Ilirisë dhe Italisë”. Për këtë ka shkruar dhe Straboni e Ptolemeu si një qendër e banuar gjatë shek. IV para Kr.. Në krye të të gjithë qyteteve qëndronte Foinike me muret imponante të rrethimit që mbronin një sipërfaqe prej 70 ha. Edhe vetë Buthroti (Butrinti) për një kohë bënte pjesë në sistemin shtetëror të kaonëve. Vartësinë e Buthrotit nga kaonët e vërtetojnë gjetja në gërmime e një tog mbishkrimesh që mbajnë emrat e kryetarëve të kaonëve. Disa ndër to flasin për faljen e lirisë nga ana e pronarëve skllëvërve të tyre, të përmendur një për një me emër. Këto

³⁴⁴ Frano Prendi “Urbanizimi I Ilirisë së Jugut” tek “Kuvendi I studimeve ilire” 15-20 shtator 1972, f. 109, 110, 112.

KUMTESA

dokumente mbishkrimore vërtetojnë njëkohësisht se zhvillimi ekonomik që mori Kaonia në shek. V para Kr. e këtij, i detyrohej në radhë të parë përdorimit me shumicë të skllëvërve në prodhim.³⁴⁵

Pra si përfundim, qytetërimi antik në Kaoni e bart kulturën e kësaj zone, dëshminë autoktone për qytetërimin, kulturën, ekonominë dhe zhvillimin politik të tyre që kanë karakterizuar gjithë historinë e trashëgimisë kulturore shqiptare.

Recensues:

Prof. Dr. Lorenc Bejko Universiteti i Tiranës
Prof. Dr. Abaz Mullai, Universiteti i Gjirokastrës

³⁴⁵ Hasan Ceka “Në kërkim të historisë ilire” bot. V 1998 f. 286-288.

Ma.sc.Shefqet DINAJ: VENDIMET E KONFERENCËS SË AMBASADORËVE NË LONDËR PËR COPËTIMIN E SHQIPËRISË DHE NJOHJEN E SHTETIT TË CUNGUAR SHQIPTAR

Konteksti historiko-shoqëror para Konferencës së Londrës

Pas përfundimit me sukses të negociatave për krijimin e një Shqipërie të vetëqeverisur në suazën e Perandorisë Otomane, Ismail Qemali u nis nga Vlora për në Stamboll që të ndikonte në zbatimin e përpikt të kushteve të marrëveshjes.

Në udhëtim e sipër, në Porto Rose, Ismail Qemali u takua me të birin e Krajl Nikollës, Princin Mirko, i cili e përkrahu Ismail Qemalin që të bëhet sundimtar i Shqipërisë së Jugut, me kushtqë të heq dorë nga Shqipëria e Veriut. Kjo ishte një aspiratë e kamotshme e malazezëve dhe serbëve. Malazezët dëshironin që t'i zgjeronin territoret e shtetit të tyre në dëm të tokave shqiptare, ndërsa serbët dëshironin të kishin dalje në Detin Adriatik.

Një ofertë të tillë të Princit Mirko të Malit të Zi, e refuzoi kategorikisht Ismail Qemali, i cili e vazhdoi rrugën për në Stamboll.

Posa arriti në Stamboll, diplomati shqiptar Ismail Qemali e vërejti situatën e cila ishte mjaft e pavolitshme për Shqipërinë, prandaj me mendjemprehtësi gjykoj se nuk duhej të merrte pjesë në Kabinetin e Qamil Pashës.

Meqë më parë Ismail Qemali ishte deklaruar se në rast të shpërthimit të ndonjë lufte e cila ishte në prag të shpërthimit, Shqipëria do të qëndronte në pozitë neutrale, ai vendosi që t'i telegrafojë klubeve shqiptare kudo që gjendeshin në Evropë, që të dërgojnë delegat në Vlorë, të shpallin pavarësinë e Shqipërisë që njëherë e përgjithmonë të shkëputen nga zgjedha e huaj otomane, të jenë të pavarur.

Prej Stambollit Ismail Qemali arriti në Bukuresht, ku u takua me krerët e kolonisë shqiptare të cilët i emëruan 15 delegatë për ta shoqëruar Ismail Qemalin në Vlorë. Pas Bukureshtit, vend ndalja e dytë ishte Budapesti, ku takohet me qeveritarët austriak, kontët Andrassy dhe Berchtold.³⁴⁶ Aty u bisedua gjërë e gjatë, mendimet e të cilëve u aprovuan nga austriakët. Si shenjë ndihme për delegacionin shqiptar, ata ia siguruan një anije për të lundruar deri në Vlorë ku do të mbahej kuvendi.

Meqë porti i Vlorësishte bllokuar nga flota greke, anija austriake me delegacionin shqiptar të kryesuar nga Ismail Qemali u ndodh në portin e Durrësit. Aty mbretëronte konfuzion i madh. Në njërën anë ishte perandoria otomane, në anën tjetër ushtria serbe po afrohej gjithnjë e më tepër duke djegur e vrrarë shqiptarët e pafajshëm të Kosovës. Propaganda greke e kishte bërë të veten, andaj edhe populli ishte i hutuar dhe i frikësuar me veprimet që po ndodhnin dhe atë që do të ndodhë së shpejti.

“Por çetat e patriotëve e kuptuan randësin historike të iniciativës së Ismail Qemajlit dhe u nisën me grupin e krerëve nacinalistë për në Vlorë. Atje kishin mbërrijë 83 delegatë nga të gjitha krahinat shqiptare tue kapërcye vështirësi të shumta nga shkaku i luftës që zjente në të katër anët.³⁴⁷

Më 28 nëntor të vitit 1912, në ballkonin e Bashkisë paraqitet Ismail Qemali, i cili kishte në dorë flamurin me shkabën e zezë dy krenare. Ai u prit me entuziazëm të paparë deri atëherë nga një turmë e madhe njerëzish që qëndronin pran kësaj ndërtese.

³⁴⁶ Tajar Zavalani, , Histori e Shqipnis, Phoenix, Tiranë 1998, p.224

³⁴⁷ Ibid, p.224

KUMTESA

Tekstin e shpalljes së pavarësisë e botoi më vonë Lef Nosi, i cili përbëhej prej katër rreshtave në alfabetin e turqishtes së vjetër dhe nënshkrimin delegatëve që dinin të shkruanin shqip, një delegat kishte nënshkruar me shkronja turqishte. Data e dokumentit është dhënë në dy shifra: 1912 sipas kalendarit gregorian dhe 1328 sipas kalendarit arab.

Teksti i deklaratës së shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë është formuluar kështu:

“Pas fjalëvet që tha Z. Kryetari Ismail Kemal Beu, me të cilat tregoi rrezikun e madh në të cilën ndodhet sot Shqipëria, të gjithë delegatët me një za venduan që Shqipëria më sot të bahet me vehte, e lirë e mosvarme”.³⁴⁸

Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, pas 445 vjetësh të nënshtrimit të Shqipërisë nga ordhitë otomane, formohet qeveria e parë shqiptare me Ismail Qemalin se Kryetar; Nikoll Kaçorin si Nënkyetar dhe një këshill i ministrave i përbërë nga: Myfit Libohova, Ministër i Punëve të Jashtme; Mehmet Pashë Dërralla, i Luftës; Petër Poga, i Drejtësisë; Luigj Gurakuqi, i Arsimit; Abdi Toptani, i Financave; Pandeli Cale, i Bujqësisë; Lef Nosi, i Post telegrafëve.³⁴⁹

Në burimet tjera historike, Myfit Libohova- na del si ministër e Punëve të Brendshme, e jo i Punëve të Jashtme si te autori Tajar Zavalani. Po ashtu, aty nuk përmendet fare edhe zotëriu Mithat Frashëri, i biri i patriotit kombëtar Abdyl Frashëri, i cili ishte mandatuar nga Gjakova me krahinat përreth saj që t'i përfaqësonte në Kuvendin e Madh të Vlorës, e i cili ishte zgjedhur Ministër i Punëve Botore, ndërsa Ismail Qemali mbajti edhe portofolin e ministrit të Punëve të Jashtme.³⁵⁰

Meqë nëse tokat shqiptare po invadoheshin nga të tria anët nga ushtritë e huaja, qeveria e re duhej që sa më parë të ndërmerre masa për mbrojtjen e tokave të saj dhe t'i njoftonte Fuqitë e Mëdha për veprimin e bërë. Po ashtu ishte e nevojshme që të kishte njohje nga fuqitë evropiane për shtetin e ri të sapo krijuar.

Qeveria e re shqiptare i njoftoi me telegram fuqitë e mëdha se kombi shqiptar e kishte marrë më në fund fatin e tij në duart e veta si shtet i pavarur dhe neutral.

Në muajin mars të vitit 1913, nga Evropa na vjen një kandidat i quajtur Ferdinand de Bourbon, Duc de Montpensier për t'u vënë në krye të shtetit shqiptar.

Ai arriti të depërtoi bllokadën greke në skelën e Vlorës me vaporin e tij privat dhe me flamurin britanik në shtizë.

Ismail Qemali si kryetar i qeverisë nuk dëshironte në atë kohë të bëhej kryetari i shtetit dhe në njëfarë mënyre shfaqti ambicie për aristoklatin francez që të jetë në shërbim të çështjes kombëtare.

Dihej se po përgatitej Konferenca e Londrës në të cilën do të lozej fati i Shqipërisë, u formua një delegacion i përbërë nga Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi dhe Isa Boletini për të udhëhequr me vaporin e Duc de Montpensierit për në kryeqytetet e Evropës.

Delegacioni shqiptar fillimisht arriti në Romë, e pastaj në Vjenë, i cili u prit mirë ndërsa në Francë nuk u prit mirë. Shtypi francez u shpreh hapur kundër pavarësisë së Shqipërisë.

Përkundër Francës, në Londër kishte përkrahës të vlefshëm të çështjes sonë kombëtare si koloneli Aubrey Herbert dhe Miss Edith Durham, të cilët kishin përgatitë sheshin, duke krijuar simpati dashamirëse në favor të Shqipërisë në mes të opinionit e deri diku edhe tek zyrtarët dhe qeveritarët britanik.

Isa Boletini kishte shkuar në Londër me kostume shqiptare si Tirq të Zi me gajtan dhe Qeleshe të Bardhë në kokë gjë që paraqiti një pamje imponuese dhe me plot dinjitet. Kjo gjë për shumë qeveritar dhe të tjerë anglez krijoi një përshtypje të mirë dhe ndikoi mjaft pozitivisht në forcimin e rrymës së favorshme që kishin krijuar orvatjet e palodhshme të miqve të Shqipërisë.³⁵¹

³⁴⁸ Ibid, p.224

³⁴⁹ Ibid, p.224

³⁵⁰ Historia e popullit Shqiptar III, , Akademia w Shkencave të Shqipërisë, Tiranë 2007, p.18

³⁵¹ Tajar Zavalani, op.cit., p.225

Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe Shqiptarët-Qëndrimi i Fuqive të Mëdha ndaj Shqipërisë

Misioni i parë diplomatik i qeverisë së Vlorës ishte kërkesa e dërguar Fuqive të Mëdha dhe shteteve fqinjë ballkanike për njohjen e pavarësisë së Shqipërisë. Mirëpo kjo nuk gjeti jehonë në asnjërin nga gjashtë fuqitë evropiane. Të gjitha qeveritë e Evropës e lanë në heshtje çështjen e shtetit të sapoformuar shqiptar dhe përçapjen e Qeverisë së Përkohshme. Këtu bën përjashtim Porta e Lartë, e cila u përgjigj drejt për së drejti për të kundërshtuar shkëputjen e Shqipërisë nga Perandoria Otomane.³⁵²

Meqë qeveria turke nuk ishte në gjendje të përballoi dhe të rezistoi Luftës Ballkanike e cila kishte filluar dy muaj më parë, u detyrua të nënshkruaj armëpushim më 3 dhjetor 1912.

Shqipëria tanimë u bë mollë sherri në diplomacinë e kohës. Shtetet ballkanike këmbëngulnin kategorikisht se të gjitha tokat e Perandorisë Otomane në Gadishullin Ballkanik do t'u takonin atyre me pretekst se kishin dalë fitues ndaj Turqisë. Qëllimet ekspansioniste dhe hegjemoniste të tyre shkonin aq lartë sa që nuk donin të dinë se ekziston një komb shqiptar, i cili duhej të gëzonte pavarësinë në emër të parimit të kombësive. Më brutal në këtë çështje ishte shtypi grek i cili shkruante: "Asht një gja e pa mundun me lejue Shqiptarët barbar të jetojnë të pamvarun në djepin e qytetnimit grek".³⁵³

Diplomacia evropiane ishte e interesuar dhe mjaft e preokupuar për çështjen shqiptare. Ajo ishte e ndarë në dy grupime të fuqishme si Austro-Hungaria dhe Italia të cilat e përbënin "Aleancën Trepalëshe" dhe Rusia nga "Antanta Kordiale". Këto dy grupime kishin interesa kontradiktore. Austro-Hungaria dhe Italia nuk ishin ende të përcaktuara qartë për një Shqipëri të pavarur apo autonome, por me një shtrirje territoriale të mjaftueshme që të mund të ekzistonte si shtet më vete (Shqipëria "Viable").

Këto të dyja ishin të interesuara t'iu pamundësohej zgjerimi i territoreve dhe i shteteve sllave drejt Ballkanit Perëndimor, si dhe mundësia e krijimit të një "urë lidhëse" drejt detit Egje. Po ashtu edhe Italia i shikonte prioritetet e saj ndaj shtetit shqiptar. Ajo e shikonte në perspektiv, si "bregun e pestë" ("quinta sponda"), si pjesë e domosdoshme të Perandorisë së saj koloniale, krijimi i së cilës tanimë ishte bërë ideja fikse e klasës sunduese të Italisë.

Në kundërshtim me shtetet e Aleancës Trepalëshe qëndronte fortë Rusia Cariste e cila kishte planet e saj. Ajo synonte shtrirjen e influencës së saj në Ballkan. Mënyrë e përshtatshme për këtë ishte krijimi dhe zmadhimi i shteteve të reja sllave.³⁵⁴

Qëndrimi i shteteve fqinjë ndaj Shqipërisë

Në Ballkan ishte formuar një aleancë në mes të Serbisë, Greqisë dhe Malit të Zi. Këta aleatë ishin të interesuar dhe të vendosur për të pushtuar të gjitha tokat shqiptare, gjë që ishte në kundërshtim të plotë me krijimin e shtetit shqiptar.

Qeveria greke ishte mjaft e zëshme në fushatën propagandistike brenda dhe jashtë Greqisë. Ajo kërkonte krahinat e Shqipërisë së Jugut të banuara historikisht me popullsi shqiptare. Popullin shqiptar e quante "barbar", ndërsa territoret shqiptare i quante "djep të qytetnimit grek". Këto ishin teza të kalbura të shovenistëve grekë të cilat nuk ndihmonin në arritjen e paqes, por në de stabilizimin e Ballkanit.

Qeveria serbe ishte e pangopshme ndaj territoreve shqiptare. Ajo kërkonte gjithë trevën e Kosovës. Nuk u ngop me kaq, kërkoi tokat shqiptare që sot gjenden në Maqedoni dhe vise të tjera të Shqipërisë së Veriut.³⁵⁵

³⁵² Arben Puto, Pavarësia e Shqipërisë në Tryezat e Diplomacisë, WESO, Tiranë 2008, p.38

³⁵³ Tajar Zavalani, op.cit., p.225

³⁵⁴ Arben Puto, op.cit., p.38

³⁵⁵ Historia e popullit Shqiptar III, op.cit., p.215

Serbët aspironin të shtrijnë territoret e tyre në Durrës, qëllimi kryesor i tyre ishte të kenë dalje në Detin Adriatik dhe të kenë një skele detare. “Mbasi Durrësi nuk mund të futej në kallëpin e Serbisë së Vjetër (Stara Serbia), qeveria e Belgradit vuri përpara argumenta ekonomike, tue thanë se kishte nevojë me eksportue derrat përmes detit për të shpëtue nga monopoli tregtar i Austro-Hungarisë”.³⁵⁶ Kjo ishte vetëm një farsë fallco e qeverisë serbe.

Mali i Zi dëshironte t'i shtinte në dorë ato territore të cilat nuk kishte arritur t'i merrte në vitin 1878, si Hotin, Grudën, Plavën, Gusinë. Kësaj radhe shkoi edhe më larg me ambicie. Kralj Nikolla e kërkoi Shkodrën. Argumenti i tij për këtë ishte i pabazë dhe qesharak. Ai thoshte se në Shkodër qenë varrosë paraardhësit e tij. “Kjo ishte një rrenë me bisht mbase dihet mirëfilli se familja Petroviç kishte ardhur prej Hercegovine”.³⁵⁷

Konferenca e Ambasadorëve

Lufta e Parë Ballkanike nxori mjaft probleme për diplomacinë botërore. Për të shqyrtuar këto probleme politike që nxorën ngjarjet e Ballkanit, gjashtë Fuqitë e Mëdha (Anglia, Franca, Gjermania, Austro-Hungaria, Rusia dhe Italia) u morën vesh për të mbajtur në Londër një konferencë në nivel ambasadorësh.

“E ardhmja e Shqipërisë u diskutua në Konferencën e ambasadorëve të mbledhur në ngut në Londër në dhjetor 1912. Konferenca e cila u kryesua nga ministri i jashtëm britanik Eduard Grej (Edward Grey), diskutoi tri çështje kryesore: statusin ndërkombëtar të Shqipërisë; organizimin e një shteti të ri shqiptar; si dhe vendosjen e kufijve të pranuar ndërkombëtarisht”.³⁵⁸

Statusi ndërkombëtar i Shqipërisë

Çështja shqiptare u mor në shqyrtim që në seancën e parë të Konferencës së Ambasadorëve në Londër më 17 dhjetor 1912. Kjo ndodhi për shkak të ngatërimit keqas të kontradiktave të Fuqive të Mëdha e bashkë me to edhe lakmitë e fqinjëve, e jo nga kujdesi i diplomacisë evropiane për të zgjidhur të vetmen çështje kombëtare që mbetej pezull në Ballkan në fillim të shek.XX.³⁵⁹

Eduard Grej në cilësinë e kryetarit të Konferencës, më 20 dhjetor e dha komunikatën për shtyp me sa vijon: “Ambasadorët u rekomanduan qeverive të tyre, dhe këto e pranuan, parimin e autonomisë shqiptare, si dhe propozimin për t'i garantuar Serbisë një dalje tregtare në Adriatik. Të gjashtë qeveritë ranë dakord për këto dy pika.”³⁶⁰

Rreth statusit të Shqipërisë Ambasadorët vendosën që në këtë mbledhje “të krijohej” një Shqipëri “autonome, e aftë për të jetuar”, “nën sovranitetin apo suzerenitetin e Sulltanit”.³⁶¹

“Lidhur me statusin e Shqipërisë, në mbledhjen e parë të Konferencës së Londrës u prek edhe një çështje tjetër, e cila në komunikatën e 20 dhjetorit nuk është pasqyruar fare. Është fjala për statusin e Shqipërisë në raport jo me Turqinë, por me fuqitë evropiane. Raportet e ambasadorëve janë unanime kur thonë se ditën e parë të punimeve Konferenca vendosi që Shqipëria autonome të vihej “nën garancinë dhe kontrollin e Fuqive” dhe të ishte “neutrale”.³⁶²

Organizimi i brendshëm i Shqipërisë

Temë preokupimi e Ambasadorëve në Londër rreth çështjes shqiptare ishte organizimi i brendshëm i Shqipërisë. Në seancën e parë të Konferencës së Ambasadorëve, atëherë kur u vendos që Shqipëria të

³⁵⁶ Tajar Zavalani, op.cit, p.226

³⁵⁷ Ibid, p.226

³⁵⁸ Miranada Vickers, Shqiptarët një histori moderne, Bota Shqiptare, Tiranë 2008, p.115

³⁵⁹ Arben Puto, op.cit., p.43

³⁶⁰ British documents of the origins of the war (1818-1914), vol.IX part II, d.nr.403, pp.302-303

³⁶¹ Arben Puto, op.cit., p.44

³⁶² Ibid, p.47

ishte me vete, autonome (edhe ose në kuadrin e Perandorisë Turke), ambasadorët e panë të nevojshëm që të mendonin për ngritjen e administratës së re shtetërore.³⁶³

Konferenca vendosi që të jetë mospërfillëse ndaj çdo veprimi që do të ndërmernte struktura udhëheqëse shqiptare e krijuar pas shpalljes së pavarësisë më 28 nëntor 1912. “Kështu ajo ngarkoi Austro-Hungarinë e Italinë, si një lëshim për “interesat e tyre të posaçme” në Shqipëri, që të hartonin dhe ti paraqitnin një projekt më të hollësishëm të organizimit të shtetit shqiptar”.³⁶⁴

Austro-Hungaria dhe Italia e hartuan projektin për një Shqipëri autonome, kur e paraqitën në Konferencë në maj të vitit 1913 ambasadorët e tyre u shprehën për pavarësinë e plotë të Shqipërisë.

Ky ndryshim diplomatik ndodhi për faktin e thjeshtë se ndryshoi situata në teren. Përkundër rezistencës së fortë të ushtrisë turke të udhëhequr nga kryekomandanti i sapoemëruar Shefqet Pasha, ushtritë ballkanike, ishin shumë më superiore, pushtuan njërin pas tjetrit qendrat e rezistencës osmane: më 6 mars grekët hynë në Janinë.³⁶⁵

Në veri malazetët hynë në Shkodër, prandaj Vjena dhe Roma e panë se ishte e pamundur të qeveriste në këto rrethana mbi tokat shqiptare Perandoria Otomane. Prandaj Austro-Hungaria dhe Italia paraqitën një projekt të ri për pavarësinë e plotë të Shqipërisë.

“Në prill qeveria e Enver beut vendosi të rihapte konferencën e paqes. Këtë herë bisedimet vazhduan vaj dhe më 30 maj 1913, u nënshkrua Traktati i Londrës sipas të cilit Turqia përjashtojë përfundimisht nga Evropa. Sulltani mundi të ruaj vetëm Konstadinopojën dhe një rrip tokësor nga Enosi në detin Egje deri në Midia në detin e Zi. Pjesa tjetër e territoreve iu dorëzua vendeve ballkanike. Natyrisht Shqipëria nuk ishte pjesë e këtyre territoreve pasi pavarësia e saj ishte njohur nga fuqitë e mëdha.”³⁶⁶

Sipas Georges Castellan, pasi që grekët hynë në Janinë më 6 mars 1913, bullgarët e gjeneralit Ivanov morën Edrenën, pas betejës së përgjakshme të Bulait dhe malazetët hynë në veri, respektivisht në Shkodër nga fundi i prillit, Shefqet pasha u detyrua të përulej. Konferenca e Londrës (30 maj 1913) i imponoi Perandorisë Osmane të lëshonte të gjitha territoret në Ballkan, në përfundim të vijës Midia në Detin e Zi, Enos në Detin Egje, e kësaj i shtihet edhe humbja e Kretës, që i kalonte Greqisë. Fuqive u lihej detyrë të rregullonin statusin e Shqipërisë dhe të ishujve të Detit Egje. Shefqet Pasha, patriot i Bashkimit dhe progresit, e pagoi me jetën e tij nënshkrimin e kësaj tërheqjeje të re: më 11 qershor, ai u vra në rrugë, ndërkohë që po përgatitej një grusht shteti.³⁶⁷

Sipas projektit të ri që sollën në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, Austro-Hungaria dhe Italia, Konferenca e Ambasadorëve vendosi më 29 korrik 1913, që Shqipëria të bëhej shtet i pavarur, asnjans dhe nën garancinë e Fuqive të Mëdha.³⁶⁸ Ky shtet do të mbikëqyrej nga përfaqësuesit e gjashtë Fuqive të Mëdha dhe nga një përfaqësues nga Shqipëria. Ky kontroll do të vazhdonte për 10 vjet dhe në rast nevojë edhe më gjatë. Në krye të shtetit shqiptar do të vihej një princ i cili do të caktohej brenda 6 muajve nga Fuqitë e Mëdha gjë që u bë me emërimin e princ Vilhem Vidit në vitin 1914, por që nuk qëndroi gjatë në pushtet.

Organizimi dhe drejtimi i xhandarmërisë do t'u besohej oficerëve të huaj. 29 korriku i vitit 1913 edhe pse jo në nivelin e dëshirueshëm për shqiptarët, përbën aktin kryesor ndërkombëtar mbi pavarësinë e Shqipërisë, me të cilën Fuqitë e Mëdha e njohën shtetin e ri shqiptar.

Vendosja e kufijve të pranuar ndërkombëtar

“Aspekti i tretë i çështjes shqiptare në Konferencën e Londrës ka qenë caktimi i kufijve midis Shqipërisë dhe shteteve fqinjë”.³⁶⁹

³⁶³ Ibid, p.48

³⁶⁴ Historia e Popullit Shqiptar, op.cit., p.20

³⁶⁵ Georges Castellan, Historia e Ballkanit, Çabej, Tiranë 1991, p.394

³⁶⁶ Ferdinand Schevil, Ballkani- Historia dhe qytetërimi, Uegen, Tiranë 2002, p.286

³⁶⁷ Georges Castellan, op.cit., p.394

³⁶⁸ Historia e Popullit Shqiptar, op.cit., p217

³⁶⁹ Arben Puto, op.cit., p.48

KUMTESA

Që në mbledhjen e parë të Konferencës së Ambasadorëve, më 17 dhjetor 1912 u vendos që Shqipëria autonome do të kufizohet në veri me Malin e Zi dhe në jug me Greqinë. Serbia u përjashtua nga mundësia që të ketë dalje në Detin Adriatik. Mirëpo Serbia do të kishte mundësi që të kishte një dalje tregtare në det nëpërmjet një skele shqiptare “të lirë dhe të neutralizuar”.³⁷⁰

Kjo pikë e marrëveshjes praktikisht nuk do të jetë e zbatueshme prandaj mbeti vetëm në letër.

Në ditët e më pastajme të mbledhjes filloi acarimi i situatës në mes të ambasadorëve për caktimin e kriteve që do të shërbenin si bazë për caktimin e kufijve. Më të zëshmit ishin ambasadori i Austro-Hungarisë dhe ai i Rusisë të cilët kishin pikëpamje kontradiktore. Ambasadori i Austro-Hungarisë paraqiti pikëpamjen e qeverisë së tij se “asnjë territor i banuar krejtësisht nga shqiptarët nuk duhej të shkëputej nga Shqipëria e ardhshme autonome”.³⁷¹

Sipas kësaj shihet qartë se Vjena ishte gati të bënte lëshime të territoreve shqiptare aty ku kishte ndonjë grup etnik të kombësive tjera.

Përkundër kësaj ambasadori i Rusisë nuk u kënaq me kaq. Ai thirrej në fitoren e aleatëve ballkanikë ndaj Perandorisë Osmane, prandaj kërkonte maksimumin për shtetet sllave. Cari rus përpiquej ta kufizonte rolin e Konferencës së Ambasadorëve në caktimin e kufijve në mes të Shqipërisë dhe shteteve fqinje. Prandaj Benkendorfi deklaroi aty për aty se kjo ishte një “ndërhyrje në bisedimet që po zhvilloheshin midis Malit të Zi dhe Turqisë” për kufirin verior.³⁷²

Edhe Qeveria e Vlorës dërgoi në Londër një delegacion, i cili në fillim të janarit 1913 i paraqiti konferencës një memorandum me anë të cilit kërkohet që brenda shtetit të Shqipërisë të përfshiheshin të gjitha viset më popullsi shqiptare.

Projekti austro-hungarez përfshinte një pjesë të mirë të trojeve shqiptare, ndër të cilat edhe Pejën, Gjakovën, Prizrenin, Dibrën, Ohrin etj., por linte jashtë Prishtinën, Mitrovicën, Ferizajn, Gjilanin, Kumanovën, Tetovën, Gostivarin, etj.³⁷³

“Projekti rus parashikonte një copëtim të madh të tokave shqiptare. Sipas tij vija kufitare në veri dhe në lindje të Shqipërisë do të ishte lumi i Drinit dhe Drini i Zi, kurse në jug linte jashtë Shqipërisë Korçën, Delvinën, Sarandën, Çamërinë etj.”³⁷⁴

“Ambasadori anglez Eduard Grej doli hapur kundër lakmisë sllave, por Rusia nguli këmbë që Shkodra ose Gjakova t’u jepej sllavëve, megjithëse Gjakova, një qytet me dy-tre mijë shtëpi nuk kishte më tepër se njëqind familje serbe dhe asnjë fshat serb përreth”.³⁷⁵

“Situata rreth Gjakovës ndryshoi në pjesën e dytë të marsit, kur Fuqitë e Mëdha gjithnjë e më shumë bënë presion mbi Serbinë e Malin e Zi, duke u bërë të ditur atyre se Shkodra në asnjë mënyrë nuk mund t’i jepej Malit të Zi. Në këto rrethana Serbia përpiquej që të zgjidhte sa më parë çështjen Gjakovës dhe të rrethinës së saj. Pashiqi gjithnjë e më shpesh theksonte se zvarritja e problemit të Gjakovës e komplikonte çështjen e Shkodrës”.³⁷⁶

Më në fund Beogradi e kuptoi se duhet të respektohet vendimi i Fuqive të Mëdha që Shkodra t’i mbetej Shqipërisë. Lidhur me këtë Petri I i shkruante mbretit Nikolla se “ne atëherë duhet t’i nënshtrohemi kërkesës së Fuqive të Mëdha dhe të çojmë duart rreth mbrojtjes së Shkodrës, ashtu siç kemi qenë të detyruar të heqim dorë nga dalja në Detin Adriatik”.³⁷⁷

Kral Nikolla, i pikëlluar, i dërgoi Carit të Rusisë një mesazh personal ku i thoshte: “Zemra e madhe sllave e madhnis Tuej do të jetë krenue me triumfet e ushtarve të mij, por duket se Madhnija e juej

³⁷⁰ Ibid, p.49

³⁷¹ Raportet e Mensendorff-it dt.17.12. e 18.12.1912, OUA, përkatësisht nr. 4944

³⁷² Ibid,

³⁷³ Historia e Popullit Shqiptar, vep.cit., p.216

³⁷⁴ Ibid, 216

³⁷⁵ Edith Durham, Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët, Tiranë 1990, p.319

³⁷⁶ Jusuf Bajraktari, Gjakova me rrethinë në fund të shek.XIX dhe fillim të shek.XX (1878-1912), Prishtinë 1998, p.301

³⁷⁷ Milovan Sekuliq, Kosovo od 1912-1918 godine, Tezë doctorate e mbrojtur në Prishtinë më 1980, p.199

duhet të marri vendime, të cilat kanë kundër interesave ma të shenjta të vendit tem. Madhniya e juej ka nënshkrue një marrëveshje qi len Shkodrën brenda kufijve të Shqipnis”³⁷⁸

Pas shqyrtimit të kufirit verior dhe verilindor, më në fund, më 22 mars 1913, Konferenca e Ambasadorëve në Londër vendosi të copëtonte rëndë trojet shqiptare duke shkëputur nga Shqipëria gjithë Kosovën dhe vise të tjera shqiptare, si Tetovën, Dibërën, Gostivarin, Kërçovën, Strugën etj., të cilat duhej të kalonin nga zgjedha osmane në zgjedhën e re serbe-malazeze.³⁷⁹

U deshtë të bëhen diskutime të gjata deri më 11 gusht 1913 kur Konferenca e Ambasadorëve vendosi për kufirin jugor e juglindor të Shqipërisë. “Sipas këtij vendimi, Korça përfshihet brenda Shqipërisë dhe në bregdet kufiri do të dilte në Kepin Stillo, përballë Korfuzit. Në këtë mënyrë pjesa më e madhe e Çamërisë dhe vise të tjera shqiptare në jug mbeteshin jashtë kufijve të Shqipërisë. Po kështu mbetej i papërcaktuar fati i Gjirokastrës. Për këtë do të vendosej gjatë përcaktimit në vend të vijës së kufirit, që do të bëhet nga dy komisione ndërkombëtare që krijoj Konferenca, njëri për kufijtë e Shqipërisë me Malin e zi e Serbinë, dhe tjetri për kufirin me Greqinë.”³⁸⁰

Rezime

Konferenca e Ambasadorëve u mbajt në Londër në vitet 1912-1913. Siç u pa nga materia e shtjelluar, Konferenca e Ambasadorëve nuk përfilli as parimin e kombësisë dhe as interesat kombëtare të popullit shqiptar por plotësoi në vija të përgjithshme pretendimet shoviniste të agresorëve ballkanikë: grekë, serbë, malazezë, etj.

Shembull shumë i mirë për këtë është qëndrimi kundërshtues i Rusisë ndaj Shkodrës e cila ishte ende e rrethuar nga trupat malazeze e që mbështeteshin diplomatikisht nga Rusia cariste.

Po ashtu Britania dhe Gjermania mbanin qëndrim indiferent për fatet e trojeve të Shqipërisë veriore. Kjo më së miri kuptohet nga letra e shkruar ambasadorit britanik në San Peterburg nga zëvendës sekretari i përhershëm i shtetit për punë të jashtme Sir Artur Nikolson (Arthur Nicolson)³⁸¹:

*“Jam plotësisht dakord me ju kur thonë se çështja e Shkodrës do të bëhet problematike. Po të flasim hapur, logjikisht nuk ka dyshim se ajo i përket Shqipërisë, por Rusia këmbëngul së tepërmi që ajo (Shkodra) t’i jepet Malit të Zi dhe ne duhet ta mbështesim në këtë pikë. Sipas mendimit tim për këtë çështje, po të shprehem me egoizëm, për ne do të jetë më mirë të rrimë indiferent për çështjen se kush do të jetë zotëruesi i Shkodrës, por ajo është e një rëndësie të madhe, kështu që ne na duhet të mbajmë një qëndrim që në asnjë mënyrë të mos dobësojë apo të prishë mirëkuptimin tonë me Rusinë.”*³⁸²

Austria ishte plotësisht e bindur se Shkodra duhet t’i takojë Shqipërisë, por, duke dëshiruar që mos të vjen deri te dështimi i Konferencës së Ambasadorëve për shkak të kundërshtisë së fortë ruse dhe indiferencës së Britanisë dhe Gjermanisë, u detyrua të bëj mjaftë lëshime derisa më në fund Rusia ra dakord që Shkodra të përfshihej në Shqipëri.

Austria mendonte se edhe qyteti i Gjakovës duhet t’i takoi Shqipërisë, mirëpo këtë e kundërshtinë e fortë Rusia. Populli rus e urrente Austrinë dhe kërkonte të solidarizohej me si vëllezërit ortodoks sllav serb. Sipas tyre Gjakova duhet t’i takojë Serbisë, një absurd. Për javë të tëra paqja e Evropës varej nga fati i Gjakovës, një qytet i vogël tregtar i Kosovës e i banuar kryesisht me shqiptar.³⁸³

Me vendimet e padrejta që u ndërmorën në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, brenda kufijve të shtetit shqiptar u përfshi vetëm afërsisht gjysma e trojeve dhe e popullsisë shqiptare (rreth 28 mijë km² me një popullsi prej 740 mijë banorë), kurse gjysma tjetër mbeti jashtë kufijve shtetëror dhe u shkëput në mënyrë arbitrare nga trugu i atdheut, si Kosova, Çamëria dhe territore tjera nën Serbinë dhe malin e Zi.

³⁷⁸ Emile Solai, Les documents secrets publies par les Bolsheviks, p.69

³⁷⁹ Historia e Popullit Shqiptar, op.cit., p.216

³⁸⁰ Ibid, p.216

³⁸¹ Miranda Vickers, op.cit., p.117

³⁸² Richard Crampton, The hollow Détente, Anglo-German Realitions in the Balkans 1911-1914, London 1979, p.83

³⁸³ Joan Kontos, Red Cross Black Eagle, A Biography of Albanian-American School, New York 1981, p.5

KUMTESA

Qeveria kombëtare e Vlorës dhe populli shqiptar në përgjithësi mbanin shpresa në vendimet pozitive që do t'i ndërmerre Konferenca e Londrës. Mirëpo ndodhi e kundërta, ata u zhgënjyen nga këto vendime andaj organizuan mitingje e manifestime proteste. Vet kryetari i qeverisë Ismail Qemali, së bashku me Luigj Gurakuqin dhe Isa Boletinin ndërmorën një udhëtim në Romë, Vjenë, në Paris dhe në Londër për të mbrojtur të drejtat kombëtare të popullit shqiptar.

Me gjithë të padrejtat dhe copëtimi i trojeve shqiptare që u bë në këtë konferencë, vendimi i 29 korrikut të vitit 1913 përbën aktin kryesor ndërkombëtar mbi pavarësinë e Shqipërisë, me të cilën Fuqitë e Mëdha e njohën shtetin e ri shqiptar, i cili i përgjysmuar në territor dhe popull u përball me një sërë vështirësish ekonomike e kulturore.

Recenzenë:
Prof.dr. Jahja Drançolli
Prof. dr. Ibrahim Gashi

Mirela LAZIMI : LËVIZJA KULTURORE SHQIPTARE NË VITET E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT - SHOQËRIA E TË SHTYPURIT SHKRONJA SHQIP

➤ HYRJE

Shek. XIX shënoi për popullin shqiptar një epokë të re, atë të Rilindjes. Kjo epokë përshkohet nga lëvizje kombëtare, që çuan në çlirimin popullit shqiptar nga zgjedha e osmane dhe në formimin e shtetit të pavarura. Shqipëria që në fundin e shek. XVIII dhe në fillimin e shek. XIX, nisi të zhvillohej nga pikëpamja ekonomiko-shoqërore e politike në po ato drejtime si edhe fqinjët e saj ballkanikë. Vështirësitë e ritmet e ngadalshme të këtij zhvillimi të Shqipërisë, të diktuar nga kushtet e rënda e të ndërlikuara, nuk e penguan shoqërinë shqiptare që në fillim të shek. XIX të kishte, krahas ndryshimeve, edhe mjaft gjëra të përbashkëta me shtetet fqinje, të krijonte premisat që çuan në konsolidimin e shqiptarëve si komb, në ngritjen e mëtejshme të ndërgjegjes kombëtare dhe në zhvillimin e lëvizjes kombëtare.³⁸⁴

Lëvizja Kombëtare Shqiptare ka pasur si objektiv çlirimin e trevave shqiptare dhe ribashkimin e tyre në një shtet të vetëm kombëtar, me emrin Shqipëri. Ideologët e saj kanë qenë të vetëdijshëm për rrezikun e copëtimit të trevave shqiptare midis fqinjëve, prandaj kanë përdorur si levë, jo vetëm luftën politike, diplomatike dhe ushtarake, por ajo u shfaq, në të njëjtën kohë, edhe me zhvillimin e vullshëm të mendimit politik, filozofik e shoqëror, si edhe të veprimtarisë publicistike, letrare e shkencore.

Rilindasit ndërmorën një revolucion kulturor nëpërmjet themelimit të shoqërive kombëtare dhe sponsorizimin e programeve politike e kulturore për arsimin dhe zhvillimin. Disa prej këtyre shoqërive u krijuan në Shqipëri në fshehtësi, kurse shumica ishin përqëndruar ndër shqiptarët në mërgim. Qëllimi i përbashkët i këtyre shoqërive patriotike ishte nxitja e përdorimit të gjuhës shqipe dhe, përmes saj, zgjimi i ndërgjegjes kombëtare dhe forcimi i lidhjeve të unitetit midis shqiptarëve.³⁸⁵ Zgjimi i ndërgjegjes kombëtare nënkuptonte nevojën e përdorimit të shqipes në të gjitha fushat e jetës, sidomos në shkrim e në shkollim në gjuhën shqipe, të ndaluar nga Porta.³⁸⁶

Nga viti 1858-1875 dalin në skenën politike e kulturore Vaso Pasha, Kristoforidhi, Hoxhë Hasan Tahsini, Jani Vreto, vellezerit Frashëri, të cilët bënë përpjekje për formimin e një alfabeti të përbashkët të gjuhës shqipe dhe të shoqërive kulturore.³⁸⁷ Penat e kulturuar të këtyre viteve mendonin se emancipimi kulturor dhe politik i shqiptarëve kishte nevojë për një kulturë militante, kombëtare nga forma, patriotike nga ndjenjat, iluministe nga përmbajtja. Laicizmi i ndërgjegjes politike kombëtare dhe mendimi iluminist në fushën e kulturës janë gjithashtu tipare dalluese të ideologjisë, të cilën ata e zbatuan jo vetëm me shkrimet individuale, por edhe me institucione të organizuara.³⁸⁸ Një e tillë ishte Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip.

Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip (1879 – 1891), shoqëri patriotike, kulturore, arsimore e themeluar me nismën e “Komitetit Qëndror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare”. Platforma e kësaj Shoqërie, në krye të së cilës u zgjodh Sami Frashëri, u përcaktua në statutin e saj themeltar (kanonizimën).³⁸⁹

³⁸⁴ *Historia e Popullit Shqiptar, vëll. II*, botimet Toena 2002, f. 17

³⁸⁵ Edwin E. Jacques, *Shqiptarët, vëll. I*, Stamboll, Turqi, botimet Kartë e Pendë, 1996, f. 419

³⁸⁶ Elsie Robert, *Histori e Letërsisë Shqiptare*, Tirane – Peje, Dukagjini, 1997, f. 162

³⁸⁷ *Historia e popullit shqiptar, vëll. II*, Prishtinë, 1969, f. 117 – 120.

³⁸⁸ Frashëri, Kristo, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, Tirane, Toena, 1997, f. 423

³⁸⁹ *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2009, f. 2509 – 2510

KUMTESA

Kjo ishte shoqëria e parë e organizuar për përhapjen e arsimit e të kulturës në gjuhën shqipe. Fakti që kjo Shoqëri u formua prej rilindasve shqiptarë të të tri besimeve fetare, apo prej shqiptarëve të krahinave të ndryshme, nuk tregon vetëm karakterin politik, por themelore ishte, që ndërgjegja kombëtare shqiptare të forcohej sic e porosiste më vonë Pashko Vasa “Mos shikoni kisha e xhamia, feja e shqiptarit asht shqiptaria”.³⁹⁰

Vlerësimet e mësipërme janë rezultat i burimeve të dokumentuara, kusht i rëndësishëm për një punim shkencor. Revolucioni kulturor dhe kontrinuti i shoqërive kombëtare në përgjithësi, apo i Shoqërise së të Shtypurit Shkronja Shqip në vecanti, gjatë viteve 1879 – 1891, nuk mund të merren të shkëputura nga veprimtaria e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Prandaj kur bëhet fjalë për bibliografi shkencore kushtuar Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, i bashkangjitet dhe lëvizja kulturore e viteve 1879 – 1891.

Hapat e para të saj, bibliografia shkencore kushtuar lëvizjes kulturore shqiptare dhe Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, i hodhi dy dekada më vonë. Merita për këtë i takon konsullit erudit austriak, Theodor Ippen,³⁹¹ i cili, pasi shfrytëzoi dy sfera burimore të rëndësishme – dokumentacionin diplomatik austro-hungarez dhe kujtimet e aktivistëve të organizatës patriotike – dha, në trajtën e një sinteze të shkurtër kushtuar historisë së brendshme të Shqipërisë gjatë shek. XIX, një vlerësim interesant për lëvizjen kulturore shqiptare dhe Lidhjen Shqiptare të Prizrenit.

Ndër autorët e huaj, i pari që i kushtoi një punim monografik Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe lëvizjes kulturore shqiptare ishte historiani serb Jovan Haxhivasiljevic, i cili për të shkruar veprën e tij “Arbanaska Liga” (Lidhja Shqiptare, botuar në serbisht 1909) u mbështet në dy fusha burimore armiqësore për shqiptarët – raportet tendecioze të konsullit serb të Prizrenit dhe tregimet gojore të serbëve të Kosovës. Me të tilla materiale, Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe lëvizja kulturore shqiptare nuk mund të pikturohej ndryshe veçse me ngjyra të zeza.³⁹²

Në periudhën midis dy luftrave botërore, trajtimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe lëvizjes kulturore shqiptare u bë nga historiografia shqiptare, e cila, për shkak se ishte në fillimet e saj, u mbështet jo në burime dokumentare rigorozë, por në traditën popullore shqiptare. Më vonë ajo u përfshi në hulumtime dokumentare dhe analiza shkencore.

Kthesa drejt kërkesave të metodologjisë shkencore ndodhi pas Luftes së Dytë Botërore. Një nga punimet e para të historiografisë shqiptare kushtuar Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe lëvizjes kulturore shqiptare është trajtesa e shkurtër e Kristo Frashërit botuar në v. 1956.

Sintezën më të plotë rreth lëvizjes ideologjike shqiptare në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e dha prof. A. Uci në referatin “Lidhja Shqiptare e Prizrenit si faktor kulturor në Rilindjen Kombëtare”, sipas të cilit ishte pikërisht Lidhja ajo që zgjoi dhe vuri në lëvizje forcat e kombit edhe në fushën e kulturës.³⁹³

Prof. Zija Xholi, në kumtesën e tij “Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare në v. 30’ të shek. XIX” vuri në dukje zhvillimin e një kulture të re shqiptare, mbartësja dhe lajmëtarja e një ideali të ri politik.³⁹⁴

Prof. Dhimitër Shuteriqi në kumtesën e tij “Mbi letërsinë shqipe në vitet e Lidhjes Shqiptare” pohon: “ajo që ka rëndësi të vihet në pah është se uniteti i letërsisë shqipe të Rilindjes e dha provën e tij në vitet e Lidhjes së Prizrenit, kur shkrimtarët patriotë shqiptarë të të gjitha krahinave dhe mërgimeve u bashkuan për një qëllim – mbrojtja e integritetit të atdheut dhe interesave kombëtare të popullit shqiptar”.³⁹⁵

Krahas referateve dhe kumtesave, tematika mbi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe lëvizjen kulturore shqiptare do të gjejë shtrirje edhe në monografi, artikuj, botime, përmbledhje studimesh historike apo dhe në tekste të ndryshme.

³⁹⁰ Studime Historike me karakter shkencor dhe recensione veprash, Tiranë 2006, f. 26

³⁹¹ Frashëri, Kristo, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, vëll. I, Tiranë 1989, f. 16

³⁹² Po aty, fq. 20

³⁹³ Frashëri, Kristo, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, veper e cituar, f. 53

³⁹⁴ Po aty, f. 53

³⁹⁵ Po aty, f. 53 – 54

➤ **Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip – Veprimtaria**

Veprimtaria patriotike e klubeve dhe shoqërive atdhedashëse ka pasur si synim që të ruajë gjuhën, kulturën dhe traditën shqiptare. Kërkesat për gjuhën dhe kulturën shqiptare ishin pjesë përbërëse e programit kombëtar të Lidhjes së Prizrenit. Në të kërkohej njohja zyrtare e gjuhës shqipe, përdorimi i saj në administratën dhe në shkollat e Shqipërisë si dhe përdorimi i një pjese të të ardhurave të vendit për zhvillimin e arsimit.³⁹⁶

Inisiativën për këtë e mori Komiteti i Stambollit, i cili krijoi një komision të veçantë për të zgjidhur dy detyra të ngutshme dhe të rëndësishme: caktimin e një alfabeti të përbashkët për shqiptarët dhe formimin e një shoqërie qëndrore kulturore. Meqënëse deri atëherë për shkrimin e shqipes përdorehin alfabetet e ndryshme, në vitet e Lidhjes rifilluan përpjekjet e nisura qysh më parë për t'a njësuar alfabetin e gjuhës shqipe. Në fillim të vitit 1879, përpara komisionit të krijuar u paraqitën katër projektalfabete. Pas shumë diskutimesh, komisioni miratoi alfabetin e propozuar nga Sami Frashëri. Ky alfabet i njohur me emrin alfabeti i Stambollit, bazohej në alfabetin latin dhe ishte ndërtuar mbi parimin fonetik, për çdo tingull një shkronjë.³⁹⁷

Ky alfabet ishte i pari i vendosur kolegjisht. Nuk kaluan as dy-tre muaj pas caktimit të alfabetit të Stambollit dhe me të u botua në Stamboll "Alfabetarja e gjuhës shqipe" me 136 faqe. Në faqet e para të saj jepet alfabeti i ri dhe mënyra e përdorimit të tij. Alfabetarja shërbeu për të mësuar shkrimin e leximin e shqipes dhe për të përhapur idetë kombëtare e demokratike të Rilindjes.

Në The Turkish Language Reform, nga Geoffrey Lewis, Alfabeti i Stambollit paska ndikuar, tërthorazi, edhe në reformat që përfshinë çdo aspekt të turqishtes, në fillim të shekullit XX, me synim europianizimin e saj. Lewis përmend, pa e specifikuar me emrin e vet si Alfabet i Stambollit, alfabetin me 36 shkronja "latine dhe greke" që sipas tij Sami Frashëri dhe vëllai i tij Abdyl Frashëri kishin krijuar, për gjuhën e tyre amtare, shqipen – një gjuhë, thotë ai, së cilës alfabeti arab i rrinte po aq keq për shtat sa edhe turqishtes.

Për shqiptarët myslimanë gati gjysmë shekulli më parë, adoptimi i shkronjave latine ishte njëkohësisht edhe një hap i guximshëm përpara, drejt laicizimit të kulturës dhe, për pasojë, edhe të jetës sociale. Në një kuptim, mund të thuhet se shqiptarët e Shoqërisë së Stambollit, e cila operonte në një mjedis kulturor osman, u treguan turqve se **ishte e mundshme** që një gjuhë të fillonte të shkruhej me një alfabet të sajuar posaçërisht për të, ose të krijuar në epruvetë.³⁹⁸

Krahas punës për njësimin e alfabetit dhe për përgatitjen e alfabetares vazhdonin edhe përpjekjet për të formuar një shoqëri kulturore kombëtare. Patriotët shqiptarë organizuan në Stamboll një konferencë më 12 tetor 1879. Në të përfaqësoheshin shqiptarët e të tri besimeve fetare dhe të krahinave të ndryshme të vendit. Kjo konferencë themeloi shoqërinë kulturore shqiptare me emrin "Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip", ose shkurtimisht Shoqëria e Stambollit dhe miratoi statusin e saj. Kryetar u zgjodh Sami Frashëri.³⁹⁹

Drejtuesit e kësaj shoqërie morën nga Porta e Lartë lejen për botimin e një organi, me të cilën zë fill botimi i gazetave në gjuhën shqipe. Numri i parë i revistës, që fillimisht u quajt Drita, por në numrin e saj të tretë u quajt Dituria, doli në gusht 1884. Por vetëm pak kohë më pas, nxjerrja e kësaj reviste në Stamboll u pezullua; për rrjedhojë, që nga viti 1885, ajo filloi të botohet në Bukuresht.⁴⁰⁰

"Shoqëria e Stambollit" hartoi e miratoi statutin e saj, kanonizmën, shkruar nga Jani Vreto. Kjo kanonizmë, e shtypur në një shtypshkronjë të Stambollit, fliste për detyrat e Shoqërisë për zhvillimin me sukses të veprimtarisë arsimore e kulturore. Se sa rëndësi i japin themeluesit e Shoqërisë kësaj veprimtarie, del nga këto fjalë të thirrjes së kanonizmës: "Gjithësa kompe janë të ndriturë dhe të

³⁹⁶ *Histori e Shqiperise dhe e shqiptareve*, Prizren 2001, f. 131

³⁹⁷ Buda, Aleks, *Shkrime Historike*, Tirane, 8 Nentori, 1986, f. 142 – 143

³⁹⁸ Oxford University Press, 1999, f. 32

³⁹⁹ Edwin E. Jacques, *Shqiptarët*, veper e cituar, f. 423

⁴⁰⁰ dr. Bozborra, Nuray, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*, Dituria 2002, f. 197

qytetëruarë prej shkronjash ndë gjuhët e veta. Cdo komp që nuk ka shkruarë gjuhën e vet, dhe s'ka shkronja ndë gjuhë të vet është ndë t'errëtë".⁴⁰¹

➤ Karakteri politik i Shoqërisë

Përpyqjet për arsimin e kulturën kombëtare u gërshetuan me luftën politike dhe i shërbyen luftës së Lidhjes për mbrojtjen nga copëtimi dhe për çlirimin kombëtar. Arsimi dhe kultura ndikonin në rritjen e vetëdijes kombëtare, për bashkimin dhe mobilizimin e popullit në luftën e udhëhequr nga Lidhja e Prizrenit. Përveç kësaj, arsimi e kultura kombëtare do të ndihmonin për ta bërë të njohur kombin shqiptar përpara opinionit të huaj publik e diplomatik dhe për të mbrojtur të drejtat e tij, aq më tepër kur atij i mohoheshin qëllimisht historia e kultura e deri edhe ekzistenca e tij.

Ndonëse Shoqëria e Stambollit nuk varej drejtpërdrejt nga Lidhja e Prizrenit, qëllimet i kishte të përbashkëta me të. Edhe pse kishin synime të qarta politike, për të përgatitur çlirimin e atdheut nga robëria dhe mbrojtjen e tij nga copëtimi, ajo paraqitej si shoqëri kulturore, gjë që pasqyrohej edhe në programin e statutin e saj. Kjo bëhej për të shfrytëzuar mjetet legale në të mirë të lëvizjes shqiptare dhe për të shmangur çdo pengesë që mund të nxirrej, nën presionin e qeverisë osmane, nga organet qeveritare të vendit ku vepronte.

Në një shikim të përgjithshëm, botimet e krerëve të Shoqërisë jo vetëm që u shumëfishuan, por mbi të gjitha morën karakter politik – historik, në të cilat mbronin çështjen e popullit shqiptar, të drejtën e tij për të rrojtur i lirë dhe i pavarur.⁴⁰²

Aktivitetet e ndryshme artistike e argëtuese, si edhe përhapja e mësimin shqip, ndihmuan si për bashkimin e shqiptarëve, ashtu edhe për ngritjen e tyre politike e kulturore.

Rrethanat e vështira, që po kalonte vendi ynë në vitet para dhe gjatë Lidhjes së Prizrenit, tronditën ndërgjegjen e kombit. Por, shqiptarët nuk ishin në gjendje të përpunonin strategji dhe taktika në këto momente kaq delikate. Këto dalin nga pena dhe mendja e mendimtarëve dhe ideologëve të kombit. Situatat kërkonin luftëtarë, por ato kërkonin edhe mendimtarë që t'i frymëzonin, t'i organizonin dhe t'i drejtonin.⁴⁰³ Këto mendimtarë ishin drejtuesit e Shoqërisë së Stambollit. Atyre u ra barra e rëndë për të argumentuar teorikisht të drejtën e kombit shqiptar për pavarësi dhe për të formuar ndërgjegjen kombëtare tek populli shqiptar.

Nuk ka vepër të Sami Frashërit, Pashko Vasës, Jani Vretos të shkruar në shqip që të mos ketë një tingull të theksuar politik. Shkrimet publicistike dhe traktatet politike të këtyre patriotëve trajtojnë po atë temë që frymëzuan protestat e memorandumet e kësaj periudhe – njohjen e shqiptarëve në arenën ndërkombëtare si një komb formuar plotësisht dhe miratimin e të drejtës së tyre supreme për të pasur shtetin kombëtar në kufijtë e tyre etnikë.⁴⁰⁴

➤ PËRFUNDIM

Gjatë vitit 1880, Porta e Lartë ndërhyri me ashpërsi dhe me kërcënime për të ndaluar veprimtarinë e Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqip. Në të njëjtën kohë edhe përfaqësues turkomanë e grekomanë, të institucioneve klerikale islamike e ortodokse, ndërmorën një fushatë të egër kundër veprimtarëve të lëvizjes kulturore shqiptare. Në këto rrethana Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip nuk pati mundësi ta zhvillonte veprimtarinë e saj kulturore brenda Perandorisë Osmane dhe ca më pak në Shqipëri. Madje ajo u detyrua të kalonte në ilegalitet.⁴⁰⁵ E gjithë veprimtaria e Shoqërisë ndihmoi në bashkimin e mëtejshëm të shqiptarëve.

Komiteti Organizativ i Stambollit dhe Shoqëria Kulturore kishin arritur të ushtronin një ndikim të madh jo vetëm në aktivitetin politik, por edhe në atë kulturor-letrar, në të gjitha shoqëritë dhe kolonitë e tjera shqiptare, të cilat u formuan në Bukuresht, Kajro, Sofje etj.

⁴⁰¹ Studime Historike me karakter shkencor dhe recensione veprash, veper e cituar, fq. 26

⁴⁰² Kleyer, Nathalie, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, fq. 304

⁴⁰³ Xholi, Zija, *Mendimtarë të Rilindjes Kombëtare*, 8 Nëntori 1987, f. 9 – 10

⁴⁰⁴ *Historia e Popullit Shqiptar, vëll. II*, veper e cituar, f. 208

⁴⁰⁵ Po aty, f. 212 – 213

Në gjirin e Shoqërisë së Stambollit bashkëpunuan ngushtësisht myslimanë të mëdhenj si vëllezërit Frashëri, katolikë të shquar, si Pashko Vasë Shkodrani e ortodoksë të mësuar e atdhetarë si Jani Vreto: ishte pra model i bashkëpunimit ndërmjet feve në shërbim të Atdheut.

Një fenomen i tillë ishte i rrallë në historinë e popujve të tjerë, sepse shqiptarët, të cilët u takonin tri besimeve të ndryshme, vepronin bashkarisht për një ideal.

Rasti i "Alfabetares së gjuhësë Shqip", ose Abetares së Stambollit është unikal në jetën mbi 150-vjeçare të abetareve shqipe, në këndvështrimin e lidhjes së ngushtë me kushtet historiko - shoqërore dhe të botimit; të rolit që luajti për njësimin e alfabetit të përbashkët të gjuhës shqipe; në hedhjen e themeleve të tekstologjisë shqiptare, të frymës atdhetare që ngjalli. "Alfabetarja..." padyshim, ndikoi fuqishëm në tekstet e mëvonshme e veçanërisht në abetaret. Nga kjo u mor modeli që në hyrje të disa teksteve të vihej një pasqyrë krahasuese e alfabetit shqip me alfabetet e tjera si turqisht, greqisht, frëngjisht, italisht, bullgarisht, për të ndihmuar dhe lehtësuar edhe ata që njihnin qofte edhe njëërën nga këto gjuhë. Kundër ABC-së së "Shoqërisë së Stambollit" u sulën në një front të përbashkët armiqësor që nga oborri osman, Patrikana e Fanarit dhe Papati i Romës, carizmi rus, qeveritë frënge, greke, serbe, etj.

Komiteti i Stambollit me detyrën kryesore hartimin e platformës ideologjike, politike dhe kulturore të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit nga njëra anë, Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip me synimin e saj të nxiste zhvillimin e kulturës në gjuhën shqipe dhe ta vinte atë në shërbim të çështjes së çlirimit kombëtar nga Turqia, nga ana tjetër, nuk i dhanë mundësi letërsisë shqiptare të zhvillohej ashtu si dhe letërsia europiane e fundit të shek. XIX. Në kohën kur vendi ynë rrezikohej nga çoptimi i tërësisë territoriale dhe kur shkolla dhe gjuha shqipe ishte zëvendësuar me shkollën dhe gjuhën turke, greke e latine, letërsia e kësaj kohe nuk mund të përshkohej nga muza apo nga frymëzimi lirik e stilistik.

Në fund, Shqipëria e shek. XX nuk mund të kuptohet aspak pa kuptuar periudhën e Rilindjes dhe kulturën e saj.

Recenzentë:

Prof.dr. Petrika Thëngjilli

Prof.aso. Kseonela Sotirofski

KUMTESA

Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA: PAVARËSIA E SHQIPËRISË, PIKË REFERIMI PËR VEPRIMTARINË ILEGALE NË KOSOVË (1945-1990)

Që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit në botën shqiptare ekzistonte një program kombëtar i ruajtjes së tërësisë tokësore të atdheut dhe i bashkimit kombëtar, mbi bazën e të cilit ishin hartuar gjithë programet e Lëvizjes Kombëtare në vijim. Ky qëllim programor i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare mbeti i pandryshuar në thelb, sepse buronte nga e drejta legjitime dhe e natyrshme e tyre për të qenë të barabartë me popujt tjerë.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë (1912), problemi i Kosovës dhe i viseve të tjera të banuara nga shqiptarët në ish-Jugosllavi, jo vetëm që nuk u zgjidh, por përkundrazi, atyre iu mohua çdo e drejtë për të vetëvendosur, si rrugën e vetme për zgjidhjen përfundimtare të problemit kombëtar.

Pas aneksimit të Kosovës, për popullin shqiptar filloi një etapë e errët, një kalvar i vërtetë. Filluan përsëri masakrat masive mbi popullatën e pafajshme, dhe likuidoheshin patriotët dhe intelektualët e paktë. Edhe pse ishte pushtuar, Kosova trajtohej vazhdimisht si zonë e rrezikshme dhe e pa sigurt për shkak se banohej me një popullsi jo sllave. Me këtë gjendje të imponuar, ku “liria” dhe “barazia” e popullit shqiptar ishin shndërruar në robëri nga një pakicë kombëtare- serbët dhe malazezët, kuptohet se populli liridashës nuk ishte i kënaqur. Meqë shqiptarët e Kosovës përgjatë tërë kufirit me shtetin amë, edhe zyrtarisht ishin shpallur si element i pabesueshëm, për këtë arsye edhe ndiqeshin, burgoseshin, torturoheshin, detyroheshin të shpërnguleshin, madje edhe vriteshin dhe askush nuk merrej në përgjegjësi. Fundja të gjitha masakrat, që iu bënë shqiptarëve, ishin të zyrtarizuara nga organet shtetërore, që si bazë u shërbenin “Naçërtania” e Garashaninit, Elaboratet e I. Andriqit, I. Vukotiqit, Elaboratet I e II të Vasa Çubrilloviqit. Të cilat vazhduan të zbatohen me përpikëri deri më 1999.

Veprimtarin politike-kombëtare ilegale të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, që nga viti 1945-1990, e kam ndarë në pesë faza të zhvillimit:

Faza e parë, përfshinë periudhën 1944-1948, e cila përkufizohej kryesisht me veprimtarinë e LNDSH-së. Si e tillë kjo lëvizje kishte karakter politik- ushtarak, dhe ishte e përcaktuar për luftë të armatosur kundër robërisë së re jugosllave dhe formimit të një shteti shqiptar me territoret e veta. Kishte një politik nacionale e demokratike pro-perëndimore, dhe kryesisht udhëhiqej nga patriot dhe intelektual të shquar si Ymer Berisha, Halim Spahiu, Selman Riza, Gjon Serreqi e shumë të tjerë.

Menjëherë pas prishjes së marrëdhënieve me Shqipërinë, në vitin 1948, fillon faza e dytë e organizimit ilegal. Në emër të politikës së gabuar të IB-së, në burg bien intelektualët më të mirë të popullit shqiptar, duke u akuzuar se po mbanin anën e politikës së shtetit shqiptar dhe të politikës ruse. Kjo nuk ishte asgjë tjetër pos një shkas që sa më shumë shqiptarë intelektualë të futeshin në burgjet jugosllave dhe të akuzoheshin si elementë armiqësorë. Deri më 1948 lidhjet ideologjike ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë e kishin lënë çështjen e Kosovës jashtë rendit të ditës. Mirëpo, pas prishjes së marrëdhënieve midis Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik, me përkrahjen e Stalinit shtypi shqiptar do t'i kushtojë një vëmendje më të shtuar persekutimit dhe padrejtësive të shumta që u bëheshin shqiptarëve në Jugosllavinë titiste. Në këtë kthesë të madhe politike në Jugosllavi shqiptarët menduan se ishte momenti i

përshtatshëm që edhe një herë të ngrinin zërin për padrejtësitë që iu bënë më 1945 (në Kuvendin e Prizrenit). Filluan dhe shtuan intensitetin e formimit të grupeve e organizatave ilegale në Kosovë që kishin për qëllim demaskimin e politikës okupuese jugosllave dhe shkëputjen e trojeve shqiptare për t'iu bashkuar Shqipërisë. Grupet dhe organizatat që u formuan gjatë asaj periudhe mbi të gjitha kishin karakter kombëtar, por për qëllime të tjera politike, ishin pro-komuniste. Dhe, mu për këtë arsye gjatë proceseve gjyqësore të organizuara pas zbulimit të tyre u quajtën “grupe informbyroistë”.

Faza e tretë, përfshinte vitet 1953-1968. Brenda këtyre viteve organizimet ilegale ishin të llojllojshme duke filluar nga vazhdimësia e LNDSH-së, e deri me formimin e organizatave të ndryshme ilegale që gjithashtu kishin karakter çlirimtar por me koncepte të reja politike e kombëtare. Mbas krijimit të rrethanave të reja në Kosovë, mbas një stabilizimi kushtimisht relativ të pushtetit të ri në Kosovë, mbas përshtatjes së një pjese të shqiptarëve me këto rrethana të reja, këto grupe ilegale e kishin orientuar një pjesë të madhe të veprimit në bindjen e popullit se lufta kundër pushtetit jugosllav, megjithatë, ishte i vetmi mjet dhe e vetmja rrugë e lirisë.

Në këtë periudhë edhe pse ishte konsoliduar deri diku LNDSH-ja, më 1957 u formuan dhe vepruan si: Organizata ilegale e atdhetarit Metush Krasniqi me emrin simbolik **“Partia revolucionare për Bashkimin e Tokave Shqiptare me shtetin amë”**. Në qershor të të njëjtit vit, Metush Krasniqi para anëtarëve të vet kishte paraqiti Programin e punës dhe projektin (skicën) e statutit të Partisë, ku pos angazhimeve të tjera, ai si kusht themelor e parimor kishte paraqitur rendësin e lirisë, por mbi të gjitha atë të bashkimit kombëtar me shtetin amë, duke përdorur të gjitha mjetet dhe metodat. Në këtë drejtim kishte hartuar planin për propagandimin e idesë për bashkimin me Shqipërinë. Ndërsa, më 1963 formohet një organizatë tjetër me emrin “Lëvizja revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve”, e udhëhequr nga Adem Demaqi. I cili më vonë në bashkëpunim me inteligjencën kosovare hartuan Statutin dhe Programin e saj. Statuti i saj kishte përmbledhur në dhjetë nene e tërë objektivin dhe qëllimin e organizatës. Në nenin e parë të saj theksohej se: “Qëllimi i parë dhe i fundit i Lëvizjes sonë është sigurimi i të drejtës për Vetëvendosje deri në shkëputje për viset e banuese në shumicë prej shqiptarëve që gjinden ende nën administrimin e Jugosllavisë, domethënë qëllimi i parë dhe i fundit i Lëvizjes sonë asht- Çlirimi i krahinave, të aneksuara prej Jugosllavisë dhe bashkimi i këtyre krahinave me nënën e vet- Shqipërisë”.

Veç këtyre në Kosovë dhe në trojet tjera shqiptare nën ish-Jugosllavi do të formohen dhe do të vepronin edhe disa grupime më të vogla ilegale-politike që për qëllim parësorë do të kenë bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare.

Nga viti 1968-1981, fillon faza e katërtë e organizimeve ilegale, të cilat do të artikulojnë koncepte të reja politike e kombëtare. Gjatë kësaj periudhe, shqiptarët që kishin shkuar në përëndim për të punuar për një kothere bukë, edhe atje nuk qëndruan duarkryq, në këtë kohë u formuan shumë parti që mbanin lidhje me ilegalen që vepronte në Kosovë.

Deri në vitin 1968, ndonëse të gjitha grupimet politike ilegale kishin si synim çlirimin e Kosovës me viset tjera shqiptare dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë, pa hequr dorë nga ky qëllim, do të angazhohen edhe për jetësimin e opsionit të Republikës, të përfshirë këtu në Kosovë dhe viset tjera shqiptare nën ish-Jugosllavi dhe kjo do të jetë shkalla e parë për realizimin e bashkimit kombëtar.

Mbas demonstratave të vitit 1968, shumë atdhetar e intelektual rënë në burg. Por, gjatë viteve të 70-80, ilegalja e Kosovës përsëri u këndell dhe mori veten. Gjatë kësaj periudhe u formuan organizata të reja që po ashtu u angazhonin dhe luftonin për lirinë e tokave shqiptare nën ish-Jugosllavi. Në këtë kohë u organizua dhe veproi organizata ilegale “Grupi Revolucionar i Kosovës” që më vonë u shndërrua në “Organizatë Marksiste- Leniniste të Kosovës”. GRK programin e tij e ndërtonte mbi bazë të çlirimit kombëtar dhe të bashkimit të atdheut të copëtuar padrejtësisht. Ky përkufizim i programit përjashtonte çdo mundësi cilësimi të tij si ekstremist, majtist a reaksionar.

Më 1968, në Kosovë nga ilegalja shqiptare u organizuan edhe demonstratat studentore që kërkuan forma të reja të organizimit ilegal, kërkuan unifikimin e organizatave dhe grupeve ilegale për të ndërtuar një platformë politike të veprimit, duke shtruar nevojën që programet politike të ilegales të përshtatën kohës dhe proceseve politike që u zhvillonin në rajon e më gjerë.

Në shtetet evropiane ilegalja shqiptare në diasporë luajti një rol të madh dhe të rëndësishëm për përhapjen e idesë së çlirimit dhe të bashkimit kombëtar. Gjatë asaj kohe ajo kishte organizuar demonstratat dhe demarshe para ambasadave jugosllave, duke ushtruar presion lidhur me gjendjen e rëndë në Kosovë.

Ndërsa vitet 1981-1990, përfshihen në fazën e katërt të ilegales në Kosovë, dhe mund të thuhet se ishte njëra nga fazat më të bujshme kur do të formohen grupe e organizata ilegale, me ngjyrimet e ndryshme ideologjike, të cilat i kishte ofruar koha. Ndërsa sa i përket vlerësimit se të gjitha organizatat dhe grupet ilegale që vepronin në Kosovë në këtë periudhë kanë pasur orientime marksiste-leniniste, duhet të kihet parasysh rrethanat konkrete të kohës si dhe fakti se në Shqipëri sundonte një regjim i tillë. Andaj, këtyre organizatave në Kosovë u nevojitej një mbështetje e natyrshme në një aleat të qëndrueshëm e të pranueshëm. Sigurisht që po të mos kishin orientim majtist ato do të rrezikonin për të mbetur pa përkrahjen e Shqipërisë së asaj kohe.

Ndërsa faza e pestë e lëvizjes ilegale në Kosovë fillon në vitet e kthesës më të madhe historike me 1981 dhe përfundon në fillim të viteve të '90, në kohën kur zë fill formimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo edhe është faza më e rëndësishme e saj: është përmbyllje kulminante e një lëvizjeje të gjatë ilegale në Kosovë dhe në trojet tjera shqiptare të ish- Jugosllavisë. Demonstratat e vitit 1981 ishin një kushtim i madh për popullin shqiptar dhe atë ndërkombëtar.

Është karakteristik e kësaj etape se në këtë kohë organizimi i ilegales kishte pësuar ndryshime të mëdha. Grupe të vogla që vepronin ilegalisht pas demonstratave studentore të '81 filluan të bashkohen dhe të formonin organizata më të mëdha po që kryesisht vepronin në interes të zhvillimit të Kosovës dhe të krijimit të kushteve të reja, qoftë në ngritjen e pozitës kushtetuese të saj, qoftë për përmbushjen e idealit të ilegales- për bashkim kombëtar. Organizatat ilegale që vepruan në këtë periudhë, që të gjitha mund të thuhet se punonin në bazë të Programeve politike dhe kishin Statutet e tyre, që synimet e tyre ishin thjesht të karakterit kombëtar dhe qëllimi suprem ishte mëvetësia e Kosovës dhe bashkimi me Shqipërinë.

Dhe krejt në fund, mund të themi se të gjitha organizatat ilegale atdhetare që nga viti 1945-1990, angazhoheshin për një Shqipëri të bashkuar në hapësirën e saj historike e etnike, të një shteti sovran, të lirë e demokratike, të përcaktuar sipas vullnetit të qytetarëve, në të cilin do të jetonin të lirë, të barabartë e në mirëqenie gjithë qytetarët, pa dallim feje, kombësie, gjuhe, krahine apo çfarëdo përkatësie tjetër qofshin.

Recenzentë:
Prof.dr. Izber Hoti
MA. Teuta Shala – Peli

KUMTESA

Dr. Etleva LALA: MBRETËRIA E ARBËRISË DHE SHQIPTARËT

Shekulli XIV është konsideruar si shekulli kur katoliçizmi arriti kulmin në territoret arbërore.⁴⁰⁶ E në fakt, një gjë e tillë mund të indentifikohet lehtësisht nga përhapja e urdhërave monastikë (benediktinët) dhe mendikanë (franceskanët dhe dominikanët), si dhe nga kishat e manastiret e shumta katolike që zunë vend në të gjithë territorin e Shqipërisë së sotme politike e më gjërë. Katoliçizmi arriti shtrirjen më të madhe në këto territore, por gjithashtu edhe intensitetin më të madh gjë që vihet re edhe nga dokumentacioni i dëndur me Selinë e Shenjtë. E gjithë kjo ndodhi në sajë të kushteve politike pro-katolike që u krijuan nga riafirmimi i *Regnum Albaniae* gjatë këtij shekulli, jo vetëm nga Selia e Shenjtë dhe forcat perëndimore, por edhe nga vetë shqiptarët.

Në librin e tij *The King's Two Bodies* Kantorowicz argumenton,⁴⁰⁷ që posti i mbretit është i përbërë nga trupi fizik dhe trupi politik, e ndërsa i pari mund të vdesë e të shuhet, i dyti është i përjetshëm. Nëse ndjekim këtë logjikë politike edhe për *Regnum Albaniae*⁴⁰⁸ që ishte një mbretëri perëndimore nga mënyra se si ishte krijuar në vitin 1272, duhet të pranojmë që edhe *Regnum Albaniae* ishte e përjetshme, pavarësisht nëse kishte apo nuk kishte mbretër e pasardhës të mbretit që do të merrnin fronin mbretëror. Duhet të ketë qenë pikërisht kjo logjikë politike që ka përligjur vendimin e Selisë së Shenjtë për t'iu adresuar fisnikëve të kësaj mbretërie gjatë shekullit XIV në korrespondencën e saj. Qëllimi është sigurisht politik: Selia e Shenjtë dëshironte të fuqizojë një mbretëri "fantazmë" për ta pasur si bazë në brigjet juglindore të Detit Adriatik, në mënyrë që të përligjte përpjekjet për t'u shtrirë në Ballkan.

Është tashmë i njohur fakti që Mbretëria e Arbërisë u shpall zyrtarisht si formacion politik më 21 shkurt të vitit 1272, nga Karli I Anzhu,⁴⁰⁹ i cili e kishte projektuar dhe ndërtuar atë si bërthamë

⁴⁰⁶ Millan Šufflay, 'Die Kirchengestaltung im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchzone im katholischen Damm', në *Illyrisch-albanische Forschungen* 2 vëll. (Munich dhe Leipzig: Verlag von Duncken and Humlot, 1916), 188-282.

⁴⁰⁷ Ernst H. Kantorowicz, *The King's Two Bodies: A Study in Medieval Political Theology* (N.J.: Princeton University Press, 1997).

⁴⁰⁸ Disa nga studiuesit më në zë që janë marrë me Mbretërinë e Arbërisë janë Émile Léonard, *Les Angevins de Naples* (Paris, 1954); G. del Giudice, *La famiglia di re Manfredi* (Napoli 1880); Francesco Carabellese, *Carlo d'Angio nei rapporti politici e commerciali con Venezia e l'Oriente* (Bari, 1911); Gennaro Maria Monti, *Nuovi Studi Angioini* (Trani, 1937); po ai, "La dominazione napoletana in Albania - Carlo I, d'Angio, primo re degli Albanesi në *Rivista d'Albania* I (1940); po ai, "Ricerche sul Dominio Angioino in Albania," në *Studi Albanesi*, vol. V-VI (Roma, 1935-1936); Alain Ducellier, *La façade maritime de l'Albanie au moyen âge* (Selanik, 1981), f. 230-323; J. Boucart, *L'Albanie et les Albanais* (Paris, 1921); Pëllumb Xhufi, "Shqiptarët përballë Anzhuinëve (1267-1285)" *Studime Historike* XLI/1 (1987): 199-222. Andreas Kiesewetter, "I principi di Taranto e la Grecia (1294-1373/83)", *Archivio Storico Pugliese* LIV, fasc. I-IV (janar-dhjetor 2001).

⁴⁰⁹ Sipas Donald Nicol si dhe G. M. Montit, ishin "ipeshkvët, kontët, baronët, ushtarët dhe qytetarët" shqiptarë ata që e zgjodhën dhe e pranuan Karlin I Anzhu si mbretin e tyre. Si rrjedhim Karli u premtoi që do t'i mbronte ata nga armiqët e tyre dhe do të respektonte privilegjet e vjetra që u ishin dhënë nga perandorët Bizantinë në të kaluarën. Shih: Donald Nicol, *The Despotate of Epiros 1267-1479: A Contribution to the History of Greece in the Middle Ages* (Londër, New York, New Rochelle, Melbourne, Sydney: Cambridge University Press, 1984), 15; G. M. Monti, *Mezzogiorno d'Italia nel medioevo: Studi Storici* (Bari: Laterza, 1930), 80. Për më shumë në lidhje me

e një perandorie të madhe ballkanike. Fisnikët shqiptarë qenë të pakënaqur me këtë strukturë politike që në fillimet e saj, sepse pritshëmëria e tyre për autonomi dhe superioritet në skenën politike nuk u mor parasysh në drejtimin e kësaj mbretërie. Karli I Anzhu u përpoq t'i mbante nën kontroll vendasit me anë të masave të dhunshme, e kjo çoi në përkeqësimin e marrëdhënieve të tij me vendasit.⁴¹⁰ Fisnikët shqiptarë si Pal Gropa e Gjin Muzaka, zotër përkatësisht të zonës së Dibrës dhe asaj të Beratit, si dhe Blinishtët, Skurajt, Jonimët etj., jo vetëm që iu kundërvunë Karlit I Anzhu, por edhe gjithë formacionit politik *Regnum Albaniae*, të cilin mesa duket e konsideruan si pjesë e administratës shtypëse të Anzhuinëve. Pas kësaj, Mbretëria (anzhuine) e Arbërit u reduktua në kështjellat bregdetare të Durrësit, Vlorës e Kaninës.⁴¹¹ Megjithatë, me vdekjen e Karlit I Anzhu, filloi të ndryshonte edhe qendrimi që kishin fisnikët vendas ndaj Mbretërisë së Arbërit.

Në vitet '90 të shekullit të 13-të, fisnikët vendas filluan t'i rimarrin në konsideratë ndihmat që mund t'u ofronin anzhuinët për neutralizimin e tensioneve me fqinjët sulmues: serbët dhe bizantinët. Duke qenë të sulmuar nga mbreti serb Stefan Uroshi II Milutin, që kishte ardhur deri në vijën Mat-Ohër, në shtator të vitit 1304, bashkësia qytetare e Durrësit dhe krerët shqiptarë nga familjet Matranga, Arianiti, Skura, Blinishti, Zenebishti, Shpata etj., njohën për kryezot princin Filip të Tarentit, djalin e mbretit Karl I Anzhu, i cili nuk pretendoi kurrë të quante veten mbret, si pasardhës i Karlit I Anzhu, por përdori vetëm titullin zot i mbretërisë së Arbërisë (*Dominus Regni Albaniae*).⁴¹² Ai i ndihmoi shqiptarët në luftë kundër serbëve pushtues. Megjithatë kur erdhi koha për të vendosur pushtet real në Durrës, edhe në këtë fazë të mëvonshme të Mbretërisë e Arbërit, anzhuinët e Napolit u konsideruan si armiq nga fisnikëria vendase. Kjo duhet të ketë qenë arsyeja se përse në vitin 1311 anzhuinët e Napolit arritën deri aty sa të mendonin t'i shkëmbenin zotërimet e tyre në Shqipëri me Sicilinë,⁴¹³ por titullari i kësaj të fundit, Frederiku i Aragonës, pasi mori vesh që në Durrës dhe në "mbretërinë e Arbërisë është e vështirë të vendosësh pushtet real nga jashtë, nuk e pranoi ofertën e Anzhuinëve, megjithëse e dinte që këto territore "ishin shumë të pasura e bujare".⁴¹⁴

Ngjarjet morën një zhvillim të ri në dekadën e dytë të shek. XIV dhe pikërisht me daljen në skenën politike ballkanike të Selisë së Shenjtë. Selia e Shenjtë nuk kishte pasur asnjë kontakt me Mbretërinë e Arbërit gjatë kohës që Karl I Anzhu ishte gjallë, të paktën jo në bazë të dokumenteve të

Karlin I Anzhu, e dinastinë e tij, në përgjithsi si një ndër studimet më të fundit e më të plota ia vlen të konsultohet: Andreas Kiesewetter, *Die Anfänge der Regierung König Karls II. Von Anjou (1278-1295): das Königreich Neapel, die Grafschaft Provence und der Mittelmeerraum zu Ausgang des 13. Jahrhunderts*, Historische Studien, vëll. 451 (Husum: Matthiesen, 1999).

⁴¹⁰ "Privilegji" i Karlit I, për Pal Gropën më datë 18 maj 1273 shënon një moment qëndror në marrëdhëniet shqiptaro-anzhuine. Sipas këtij privilegji, Pal Gropa duhet të kënaqej me ca fshatra në veri të Ohrit, fshatra këto që nuk përfshihen as në interesat imediate të anzhuinëve dhe as të serbëve, gjë që tregoi se anzhuinët nuk kishin ndërmend të mbanin anën e shqiptarëve as kur interesat e këtyre të fundit prekeshin nga serbët. P. Xhufi, *Shqiptarët...*f. 212. Kur flet për marrëdhëniet e Stefan Dragutinit, mbretit të Serbëve në vitet 1276-1282, Jireček thotë që ai u qëndroi besnik lidhjeve të të atit me Karlin e I Anzhuin, dhe se lojrat e Michaelit me unionin e kishave nuk çudisnin asnjë njeri më, ngaqë papa Martin IV, u kishte hapur rrugë traktativave me perandorin grek. Konstantin Jireček, *Geschichte der Serben*, 320.

⁴¹¹ Shih Monti, *Ricerche*, 565-568; po ai, *La Dominazione*, 50-58; Xhufi, *Shqiptarët*, 199-222; Ducellier, *La Façade*, 230.

⁴¹² Kiesewetter, *I principi*, 69.

⁴¹³ Projekt i 28 prillit të vitit 1311, shih: H. Finke, *Acta Aragonensia. Quellen zur deutschen, französischen, spanischen, zur Kirchen- und Kulturgeschichte aus der diplomatischen Korrespondenz Jaymes II. (1291-1327)*, (Berlin-Lipsia 1908), vëll. II, f. 704-705, nr. 443. Shih gjithashtu: D. Abulafia, "The Aragonese Kingdom (sic!) of Albania. An Angevin Project of 1311-1316," në *Mediterranean Historical Review X (Intercultural Contacts in the Medieval Mediterranean. Studies in Honour of D. Jacoby)* (Londër, 1955), 1-13. Arsyeja kryesore në fakt ishte që anzhuinët të merrnin me çdo kusht ishullin e Sicilisë, që ishte në duart e Frederikut të Aragonës. Shih Norman Housley, *The Italian Crusades: The Papal-Angevin Alliance and the Crusades against Christian Lay Powers*, 1254-1343 (Oxford: Clarendon Press, 1986), 96-97. Shih gjithashtu G. M. Monti, "L'Albania e la Guerra di Sicilia: trattative diplomatiche," *Nuovi studi angioini*.

⁴¹⁴ Ibid.

shkruara të regjistruara në regjistrat e Kancelarisë Apostolike. Kjo mungesë dokumentesh mund të sugjeronte edhe një lloj mosnjohje apo mospranim të Mbretërisë së Shenjtë nga Selia e Shenjtë gjatë kësaj periudhe të parë të ekzistencës së Mbretërisë së Shenjtë. Arsyet pse papati nuk e kishte njohur atë si formacion politik nuk na janë treguar asgjëkundi në mënyrë eksplicite. papati nuk e kishte njohur atë si formacion politik. Arsyet nuk na janë treguar asgjëkundi në mënyrë eksplicite. Në vitin 1317 fillon një korrespondencë e dendur midis Selisë së Shenjtë dhe fisnikëve të Mbretërisë së Arbërit, dhe termi *Regnum Albaniae* fillon të shfaqet rregullisht në kancelarinë papnore. Që nga viti 1272, kur kishte filluar të ekzistonte "Mbretëria e Arbërit", dokumenti i parë papnor që e përmend atë vjen nga viti 1317. Ky dokumenti i parë, kur fillon të përdoret termi *Regnum Albaniae* (Mbretëri e Arbrit) në kancelarinë papnore, është një dokument i veçantë dhe vjen pikërisht nga 10 maji i vitit 1317. Në të papa Gjoni XXII kërkon që Guljelm Montegrano, ipeshkvi i Kunavisë, në kryepeshkvinë e Durrësit, në mbretërinë e Arbërisë të paraqitet në Avinjon.⁴¹⁵

Megjithatë kjo përmendje nuk është as *lapsus* dhe as rastësi. Muk mund të konsiderohet *lapsus* apo rastësi një dokument i tillë, sepse papati ishte pushteti qendror, dhe po ta krahasojmë me kohën në të cilën jetojmë do të ishte sikur Këshilli i Bashkimit Evropian t'i drejtohej me emër një shteti që nuk ekziston. Megjithatë që papati ishte i ndërgjegjshëm për një adresim të tillë, këtë e vërteton vargu i dokumenteve papnore që ndjekin këtë të parë.

Pas kësaj bule, vijon një numër i konsiderueshëm bulash papnore që datojnë nga viti 1317 deri në vitin 1320, në të cilat përmendet pothuajse gjithmonë *Regnum Albaniae*. Përsa i përket kontekstit të këtyre bulave, duhet thënë që të gjitha ato, direkt apo indirekt kanë lidhje me një kryengritje që po përgatitet kundër mbretërisë serbe, e cila po u shkakton shumë vuajtje katolikëve të territoreve që mbretërit serbë kanë pushtuar dhe sidomos shqiptarëve katolikë. Dashje pa dashje, në të gjitha këto bula vihet re një figurë shumë e rëndësishme, por fare e pastudiuar shqiptare e kësaj periudhe: Ndreu, ipeshkvi i Krujës. Analizën e këtyre dokumentave do ta fillojmë me këtë figurë, sepse bula e dytë që regjistrohet pas asaj të mësipërme flet pikërisht për dëbimin e Ndreut më 17 shtator të vitit 1317 nga posti i tij si ipeshkv i Krujës.⁴¹⁶ Është pikërisht Uroshi (1282-1321) mbreti serb, ai që e detyron Ndreun, ipeshkvin e Krujës të largohet nga posti i tij, sepse i martuar me Simonën në vitin 1299, vajzën e perandorit bizantin Andronikut II-të,⁴¹⁷ ai kërkon që të bëjë politikën bizantine, megjithëse është rritur nga një nënë katolike siç ishte Helena e Francës dhe bashkë me të kishte themeluar dhe ndihmuar shumë manastire katolike në veri të Shqipërisë dhe në Mal të Zi.⁴¹⁸ Rëndësia që kanë lidhjet martesore, del qartë menjëherë kur vëmë përballë vëllanë e Uroshit, Stefan Dragutin i cili ishte martuar me Katerinën, vajzën e Stefanit V-të, mbretit të Hungarisë, dhe motrën e Ladislaut IV-të, trashëgimtarit të fronit të Hungarisë, dhe ndiqte rigorozisht politikën e perëndimit.⁴¹⁹

Në vitin 1319 do të ndeshemi me shumë bula papnore në të cilat adresohet *Regnum Albaniae*, dhe të gjitha këto bula janë në kontekstin e një kryqëzate. Më 17 qershor të vitit 1319, papa Gjoni XXII-të, fillon përpilimin e një plani për kryqëzatë kundër mbretit Serb. Në fakt përpilimi i këtij plani kishte filluar kur Filipi, princi i Tarentit,⁴²⁰ i kishte parashtruar atij, gjendjen e keqe të katolikëve shqiptarë nën sundimin e mbretërve serbë, dhe i kërkonte papës që t'i mbronte ata me ndihmën e një koalicioni.⁴²¹ Papa i kthen përgjigje Filipit më 12 maj të vitit 1319⁴²² duke e siguruar që është i

⁴¹⁵ ASV, *Reg. Aven. 2*, fol. 183 dhe *Reg. Vat. 63*, fol. 363v.

⁴¹⁶ Kjo letër gjendet në ASV, *Reg. Aven. 8* fol. 70 ep. 96 dhe *Reg. Vat. 67*, fol. 26, ep. 96.

⁴¹⁷ Jirecek, *Geschichte der Serben I* (Gotha: Friedrich Andreas Perthes A.-G. 1911), 347-348.

⁴¹⁸ Jirecek, *Geschichte der Serben I*, 348.

⁴¹⁹ Ibid.

⁴²⁰ Filipi, princi i Tarentit (1294-1331) ishte biri i katërt i Karlit II, mbretit të Sicilisë. Ishte martuar me Tamara Duka Domnenën, vajzën e Nikeforit, dhespotit the Romanias (Bizantit), dhe morit titullin princ i Akaiës në vitin 1304. Për shkak të një martese të dytë me Katerinën, vajzën e Karl de Valois, u bë trashëgimtar potencial i fronit perandorak të Konstantinopojës në vitin 1312, dhe pas kësaj filloi pretendimet për titullin e perandorit.

⁴²¹ Letra e Filipit nuk ekziston më, por këtë informacion e marrim vesh nga përgjigja që papa Gjoni XXII i jep atij në letrën e regjistruar në ASV, *Reg. Vat. 109*, fol. 162v, ep. 671. Kjo letër përmendet edhe në *Acta Albaniae I*, no. 648, si dhe nga *Theiner, Monumenta Hungariae I*, 830, n. 1263.

gatshëm për çfarëdo lloj iniciative, dhe të tillë ishin edhe Karli I-rë Roberti, mbreti i Hungarisë (1308-1342), si dhe Mladeni II-të, bani i Kroacisë dhe Bosnjës.⁴²³

Më 17 qershor të vitit 1319 papa Gjoni XXII u dërgon letra Muzakajve.⁴²⁴ Mentul Muzakës, kontit të Këlcyrës, Ndre Muzakës, marshallit të mbretërisë së Arbërit (*regni Albaniae marescalco*), Theodor Muzakës, *protosevastor*-it të mbretërisë së Arbërit, të cilët i kishin pronat e tyre në jug të Shqipërisë së sotme; princërve të Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut.⁴²⁵ Guljelm Blinishtit, *protosevaston*, Guljelm Aranitit, *protholegatu*ro, Kalgjon (*Calojohanni*) Blinishtit, Pal Matrangës dhe baronëve të tjerë të mbretërisë së Arbërit (*ceterisque baronibus regni Albaniae*), si dhe Ladislavit, kontit të Arbërit,⁴²⁶ duke i vënë në dijeni që ai ishte i informuar se ata po vuanin nën tiraninë e rëndë të mbretit të Serbisë (*sub gravi tyrannide illius regis perfidi Rascie nedum scismatici et religionis christiane totaliter inimici*),⁴²⁷ dhe duke i nxitur që t'i bëjnë rezistencë, si dhe duke i siguruar që ai do t'i ndihmojë me gjitha mundësitë.

Nga këto dokumente kuptojmë që kuria papnore e papës Gjoni XXII (1316-1334), jo vetëm që njihte statusin e Mbretërisë së Arbërisë si mbretëri legjitime, por madje njihte dhe saktësonte kufijtë e kësaj mbretërie, njihte mirë edhe klasën udhëheqëse të saj që në sytë e papatit ishte fisnikëria vendase. Duke u nisur nga këto dokumente papnore që kanë si qëllim që të arrijnë të gjithë forcat politike shqiptare, Shuflaj ka arritur të përcaktojë thelbin e Shqipërisë etnike të mesjetës. Si kufirin jugor ka marrë territoret që posedonte Mentul Muzaka që shkonin deri në Këlcyrë,⁴²⁸ si lindorë ka marrë territoret e Ohrit dhe të Dibrës, ku shtrinin sundimin e tyre Matrangët dhe si veriorë territoret e Blenishëve që posedonin Mirditën deri në Ulqin dhe Danjë. Do të ishte më e saktë nëse këto territore do t'i konsideronim si territoret e mbretërisë së Arbërisë si formacion politik dhe jo si territoret e Shqipërisë etnike që shtriheshin shumë më gjerë se kaq. Kjo kuptohet akoma më mirë po të kemi parasysh që papati në përgjithësi në mesjetë zhvillonte korrespondencë ose me vartësit e tij: subjekte religjioze si kryepeshkvë, ipeshkvë, kryedhjakë, dhjakë, abatë, etj), ose me pushtete politike të njohura prej tij si të tilla, dhe jo me kombe (koncept i cili nuk ishte i zhvilluar në atë masë në mesjetën e shek. XIV-të sa të kërkonte adresim si i tillë⁴²⁹). Duke pasur parasysh këtë, duhet tërhequr vëmendja tek fakti që papa Gjoni XXII-të, në dokumentet e tij i drejtohet formacionit politik të njohur prej tij dhe pikërisht Mbretërisë së Arbërisë, që këtej dhe kufijtë e këtij formacioni politik nuk duhen identifikuar me kufijtë etnikë të kombit shqiptar.

Nuk ndodh shpesh që papati t'i drejtohet me emër dhe me titull secilit nga fisnikët e një mbretërie. Rasti më i zakonshëm është që papa i drejtohet me bulë mbretit, dhe fisnikëve në përgjithësi, pa përmendur emrat e fisnikëve. Me këtë akt papa Gjon XXII donte njëkohësisht të tregonte që ai e njihte Mbretërinë e Arbrisë me këto kufij, dhe si forca politike udhëheqëse të saj këta fisnikë, më shumë se një mbret cilidoqoftë qoftë ai. Nëse Filipi i Tarentit, i biri i Karlit II Anzhu, të cilin shqiptarët e njihnin si zotin e tyre, do të ishte konsideruar nga papati mbret i Arbërit, kjo patjetër

⁴²² Ibid.

⁴²³ Mladeni II ishte Ban i Kroacisë dhe i Bosnjës deri në vitin 1322. Pas këtij viti ai u dëbua nga mbreti i Hungarisë, për shkak të ambicjeve të tij që preknin interesat e fronit hungarez. Për këtë sugjerojmë lexim të mëtejshëm të Michael Madil, *Historiarum*, cc. 17-19, në Schwantner, *Scriptores re. Hungaric.*, III 646 .ss.

⁴²⁴ ASV, *Reg. Vat. 109*, fol. 140r, ep. 571. Është dhënë edhe në *Acta Albaniae I*, no. 648, nga Tautu, *Acta Joannis XXII*, no. 22a; Theiner, *Mon. Hung.* I, 831 n. 1264; Farlati, *Illyricum Sacrum VII*, fq. 64B, dhe një fragment edhe nga Raynald, *Annales Ecclesiastique* (vol. XV, 178) 1318 & 35;

⁴²⁵ ASV, *Reg. Vat. 109*, fol. 140-140v, ep. 572, (shënjuar si letër sekrete). Përkthuhet pjesërisht nga Raynaldi, *Ann. Eccl.* 1318 & 35; përmendet nga Farlati, *Illyricum sacrum* 7, 63; dhe jepet edhe nga Theiner *Mon. Hung.* I, 831, n. 1264; si dhe në *Acta Albaniae I*, 649;

⁴²⁶ ASV, *Reg. Vat. 109*, fol. 140v, ep. 573.

⁴²⁷ Ibid.

⁴²⁸ K. Hopf, „Storia e genealogia della casa Musachia scritta da Giovanni Musachio despoto d'Epiro a suoi figli nel 1510.” Në *Chroniques Greco-Romanes inedites ou peu connues*, (Berlin, 1873), pp. 270-366.

⁴²⁹ Elementet e kombformimit kishin filluar tashmë që në shekullin e 12-të pas kryqëzatave të para, megjithatë ndërgjegjësimit për kuptimin dhe përdorimin e këtij koncepti filloi vetëm në shekullin e XVII dhe të XVIII.

që do të figuronte në dokumentacionin papnor, gjë që nuk ndodh. Në një dokument papnor të 12 majit të vitit 1319, ku papa Gjoni XXII i drejtohet Filipit, ai e quan atë "*Dilecto filio nobili viro Philippo clarae memoriae regis Siciliae filio, principi Tarentino,*"⁴³⁰ por asgjë më shumë se kaq, përsa i përket lidhjes së tij me Arbërinë. Konkluzioni i natyrshëm i gjithë kësaj është që papati njihte karakterin lokal vendor të kësaj mbretërie, dhe ishte i interesuar të theksonte identitetin lokalo-vendor të saj.

Këtë identitet nuk mund ta quajmë akoma kombëtar për asyet që përmendëm në fillim të këtij shkrimi. Për ta plotësuar duhet thënë që nga mënyra sesi papati u drejtohet forcave politike shqiptare, të bën të kuptosh që ai po nxit në radhë të parë bashkimin e këtyre forcave, si forca politike. Nuk është rastësi që papati u drejtohet atyre në grupe: në një letër Muzakajve, në një tjetër Blinishtëvë, Aranitëve, Matrangëve, dhe në një tjetër Radislaut Gonomes (Ladislau Jonima), kontit të Dioklesë dhe të Arbërisë bregdetare, me pothuajse të njejtat fjalë, të njejtat udhëzime, dhe u sugjeron të njejtin person-kontakti me rol udhëheqës: Ndreun e Krujës. Në këtë kontekst Ndreu i Krujës kishte edhe një mision indirekt: atë të bashkimit të forcave politike të Mbretërisë së Arbërisë. Sa më i fortë të ishte identiteti dhe karakteri lokal vendor i kësaj kështjelle mbrojtëse të krishtërimit, aq më pozitiv ishte ky fakt për papatin, që duke ofruar mbrojtjen e aleatëve dhe udhëheqje shpirtërore të bazuar në vullnet të lirë, mund të ushtronte ndikim në Ballkan.

⁴³⁰ ASV, *Reg. Vat.* 109 (Litt. Secr.) fol. 162v ep. 671.

KUMTESA

Anduana SHAHINI¹ (KERTALLI): BASHKËPUNIMI SHQIPTARO – TURK, TRAKTATI I MIQËSISË I VITIT 1923

¹Departamenti i Shkencave Politike dhe Juridike
Universiteti “ Aleksandër Moisiu” Durrës
E-mail: kanduana@yahoo.it

Në këtë punim paraqitet përpjekja për të evidentuar pozitivitetin e marrëdhënieve shqiptaro-turke. Sikurse dihet, zyrtarisht qëndrimi i perandorisë Osmane ndaj pavarësisë së Shqipërisë nuk ka qënë i favorshëm. Kështuqë pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë marrëdhëniet mes dy vëndeve pothuajse u shkëputën plotësisht. Nga njëra anë Shqipëria ishte e përfshirë në përpjekjet për njohjen e saj dhe nga ana tjetër perandoria Osmane po jetonte agoninë e saj drejt fundit.

Dy popuj të cilët kanë patur një jetëgjatësi të përbashkët dhe shkëmbime të ndërsjellta, llogjikisht nuk mund të kenë një shkëputje të tillë. Janë pikërisht problemet e brëndëshme që përjetojnë të dy vëndet të cilat i largojnë ato, deri ne vitet 1920. Në këtë periudhë pjesa më e madhe e Shqiptarëve dhe e intelektualëve të kohës e shikonin me skepticizëm marrëdhëniet me perandorinë Osmane. Duke i atribuar asaj të gjitha padrejtësitë dhe prapambetjen në vend. Ata mundoheshin të kthenin sytë drejt perëndimit. Osmanët nga anajtjetër i konsideronin shqiptarët pjesë të sferave të tyre të influencës, dhe ky përbënte thelbin e probemit për palwn Shqipëtare.

Një moment kthese mes marrëdhënieve të ndera politike mes dy vëndeve ishte *së pari* përpjekjet e Turqisë për tu reformuar dhe aplikimi i reformave të Ataturkut, pra një vizion i ri për Turqinë dhe për vëndet me të cilat ajo do të kishte marrëdhënie, *së dyti* tek shqiptarët filloi të kristalizohej idea mbi perandorinë Osmane të dikurshme dhe për Turqinë e re, e Ataturkun, *së treti* situata e brëndëshme e Shqipërisë së viteve '20 sidomos në aspektin ekonomik kërkonte partnerë, për të siguruar mbështetje, *së fundi* në aspektin diplomatik është evidente dëshira e palës shqiptare për të siguruar marrëdhënie me shtete të ndryshme përfshirë këtu edhe Turqinë.

Qëndrimet e politikanëve shqiptarë ndahen në dy kampe të mëdha, palën pro dhe kundër këtyre marrëdhënieve. Deputetë të parlamentit shqiptarë si Ali Këlcyra shprehën parimisht kundër, për arsye të ndikimit negativ të revolucionit Qemalist, sigurisht një aludim, mendoj paraprak i Këlcyrës. Ai shkante deri në një qëndrim të formës së prerë ku pohon se “ *nëpunës dhe oficerë të ardhur nga Turqia nuk duhet të merrshin në punë nga autoritetet Shqiptare*”⁴³¹ sigurisht që i studiuar në këndvështrimet e sotme dhe sistemin diplomatik aktual, është një mendim tejet konservator. Një pjesë e mirë e intelektualëve insistonin në sigurimin e marrëdhënieve diplomatike zyrtare dhe të përcaktuara mbi bazën e rregullave ndërkombëtare ku të dy vëndet do të kishin të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas marrëveshjeve të cfarëdo natyre që do të nënshkruanin. Traktati i miqësisë u nënshkrua pas një eventit tjetër mes dy palëve; hapja e legatës shqiptare në Turqi në 1922. Ky në fakt ishte objektiv i parë i politikës së jashtëme gjate viteve 1920 sepse objektiv i dytë ishte nënshkrimi i traktatit të miqësisë, përmes të cilit do të rregulloheshin shume çështje.

⁴³¹ Gazmend Shpuza “Ataturku” 8 Nëntori, Tiranë 1987, fq.33

Traktati ishte i domosdoshëm pasi dy popujt kanë një histori të përbashkët dhe për pasojë një pjesë e mirë e popullsisë emigratore shqiptare është vendosur pikërisht në qytetet e Turqisë si Stambolli, Izmiri etj. Për arsye të ndryshme ato punojnë dhe jetojnë atje, kujdesen të ruajnë gjuhën, traditat dhe vlerat kulturore Shqiptare. Sikurse kuptohet duhej domosdodhmërisht një marrëveshje për të rregulluar çështjet që përcillnin probleme mes dy palëve. Marrëveshja ishte edhe në funksion të rregullimit dhe sistemimit të marrëdhënieve diplomatike.

Pavarësisht kundërshtimeve të deputetit Ali Këlcyra, parlamenti Shqiptarë pati një veprimtari të ngjeshur. Pra, qeveria shqiptare i kushtoi rendësi kësaj çështje duke e vlerësuar pozitivisht nënshkrimin e traktatit dy palësh. Në këtë kuadër ministria e punëve të jashtme u lejuua të veprojë si më poshtë *“qeveria Otomane meqënëse i ka rrëzuar kapitulacionet që ka pasur, ka vendos që të ketë marrëdhënie me cdo shtet të huaj që dëshiron të ketë marrëdhënie diplomatike dhe të veprojë sipas ligjeve ndërkombëtare, vendosi t’i lejoje MPJ-së që të nënshkruaj konvensionet me vendim nr. 588, dt. 4.7.1922.”*⁴³². Ky vendim i parlamentit ishte i formës së prerë dhe do të hynte menjëherë në fuqi.

Për të realizuar më mirë këtë bashkëpunim qeveria shqiptare i jep seriozitetin e duhur delegacionit që do ta përfaqësojë. Ajo përmes vendimit nr. 588, dt. 4.7. 1922, jo vetëm që e pranon nënshkrimin e traktatit, por edhe formon komisionin përfaqësues për të nisur bisedimet në Turqi. Ngritja e komisionit ishte përgatitur me kujdes. Aty merrnin pjesë përfaqësues të njohur me funksione të larta shtetërore si dhe Nezir Leskoviku, i cili e njëjtte mirë terrenin politik turk dhe kishte themeluar bazën e Legatës tonë atje. Duket pra, një impenjim maksimal nga ana e qeverisë Shqiptare.

Më 10 tetor 1923 niset nga Shqipëria delegacioni për në Turqi, për të filluar bisedimet me qeverinë e re Turke të kryesuar nga Ataturku. Ardhja e delegacionit bëri bujë të madhe në qarqet politike sidomos ato greke, të cilët i druhenin një bashkëpunimi mes dy vendeve. Shtypi grek botoi mjaftë artikuj mbi këtë çështje. Një pjesë e tyre u dërguan nga Stambolli në MPJ. Kështu gazeta greke *“Amalthia”* më 20. tetor. 1923 shkruan: *“Nuk kalon ditë që të mos duket lufta e fshehtë që i bëhet në Turqi elementit grek, këtu ka ardhur edhe një delegacion shqiptar me burra shteti që të merren vesh me qeverinë e Qemalit. Në çfarë konsistojnë këto marrëveshje të dy shteteve myslimane dhe që kanë qëndrim armiqësor ndaj Greqisë?”*⁴³³. Po ashtu edhe gazeta *“Hora”* me 5 dhjetor 1923 shkruan në lidhje me traktatin e miqësisë: *“marrëveshja shqiptaro-turke kthehet kundra Greqisë.”*⁴³⁴. Sigurisht që ndoshta ky ishte një ngjyrim i njëanshëm që iu dha qëllimisht kësaj marrëveshje, për interes të palës greke, por në fakt të dy palët kishin pohuar se nuk do të dilnin jashtë ligjeve në fuqi.

Delegacioni ynë u mundua të kërkonte takimin sa më shpejt dhe të fillonte bisedimet. Më 7 nëntor 1923 relacioni i delegacionit shqiptarë nga Turqia tregon për takimin që do të caktohet sa më shpejt edhe marrëveshja mes dy vendeve do të diskutohej sa më parë, duke evituar procedurat e gjata. Të dy vendet ishin të interesuar për ta përmbyllur këtë lidhje, ndoshta pak më tepër Shqipëria, pozita e së cilës ishte më inferiore përkundrejt një shteti që dikur kishte qenë superfuqi e për më tepër edhe pushtues për pesë shekuj. Megjithatë, edhe qeveria turke shprehet, *“interesat e Turqisë e lypin që Shqipëria të konsolidohet dhe të afrohet në Ballkan.”*⁴³⁵. Këto deklarata u përmendën gjatë nga delegatë e përfaqësues të qeverisë turke. Gjithashtu ato u komentuan edhe më shtypin e kohës nga gazetatat shqiptare në Turqia a Shqipëria apo edhe të huaja.

Në gazetën *“Paqja”* në 19 nëntor 1923, në një artikull kryesor me titull *“Miqësia turko – shqiptare”* botohen fjalët e delegatit turk në takim me delegatët shqiptarë: *“Sot populli turk ka krijuar një mbretëri popullore dhe demokrate, qëllimi i saj është të qenit i lirë dhe independent brenda kufirit kombëtar. Detyra jonë është të vërtetojmë dhe të rrënjosim marrëdhënie miqësore.”*⁴³⁶. Ky qëndrim demonstron jo vetëm nga delegacioni turk por edhe nga qeveria turke, e cila u tregua e gatshme për të nisur bisedimet dypalëshe. Vazhdimësia e bisedimeve nxjerr në pah një qëndrim të dytë, të cilin e

⁴³² AQSH, F. 249, D. I-453, V. 1922, fq. 3

⁴³³ AQSH. F. 151, D. 200, V. 1923, fq. 19

⁴³⁴ AQSH. F. 151, D. 200, V. 1923, fq. 62

⁴³⁵ AQSH. F. 151, D. 200, V. 1923 fq. 34

⁴³⁶ Gazeta *“Paqja”* 19 nëntor 1923, nr. 2, fq. 1

shpreh dhe Shukri Kaja beu. Në deklaratën e tij mbi relacionet “turko – shqiptare” thuhet se “ *të dy palët kanë interes për të vendosur relacionet. Po në duhet njeriu të thotë të drejtën, le të themi se interesa jonë është morale dhe e shqiptarëve materiale.*”⁴³⁷. Përveç kësaj fraze nuk gjejmë asnjë koment tjetër në lidhje me faktin apo ecurinë e ngjarjeve të mëtejshme. Të njëjtët artikuj boton edhe gazeta “E drejta” në atë periudhë. Nuk ka asnjë të dhënë tjetër që ky të jetë një qëndrim i qeverisë turke. Deklarata mund të jetë edhe personale nisur nga rrethanat.

Këto marrëveshje do të merreshin në shqyrtim nga parlamenti jonë dhe më pas do të miratoheshin a do të hynin në fuqi menjëherë. Praktikisht marrëveshja u nënshkrua nga të dy palët në dhjetor të vitit 1923, por të dy qeveritë e njohën atë pas dy vjetësh. Në shkurt të vitit 1925 ato u ratifikuan nga parlamenti. Cila ishte përmbajtja e traktatit të miqësisë shqiptaro-turke dhe çfarë përcaktoi ai për popullsitë e të dy vendeve?

Duke marrë parasysh rëndësinë e tij po e nis që nga delegacioni që mori pjesë në bisedimet dypalëshe të zhvilluara në Turqi.

Delegacioni shqiptar përbëhej nga:

1. Eshref bej Frashëri, kryetar i parlamentit dhe i dërgatës shqiptare në Turqi.
2. Xheferr bej Villa, sekretar i përgjithshëm dhe ministër i MPJ-së.
3. Nezir bej Leskoviku, ministër i legatës shqiptare.

Përfaqësuesi i Turqisë është:

1. Shukri Kaja bej

Pas bisedimesh të gjata nga dhjetori i vitit 1923 deri në janar të vitit 1924 ranë dakord në këto dispozita:

1. Popullsitë respektive nëse kanë mundësi të jetojnë në trojet e njëri- tjetrit ta bëjnë lirshëm, vetëm konform ligjeve në fuqi.
2. Këto dispozita nuk marrin parasysh çështjen e emigracionit, për të cilin palët kanë të drejtë me e ndalu kur e shohin të arsyeshme.
3. Nënshtetasit e dy vendeve kanë të drejtë të merren me të gjitha llojet e tregtisë, zejeve si dhe nuk kanë për të paguar nëse janë vendosur në tokat e njëri- tjetrit apo për të paguar gjoba të ndryshme që kanë të bëjnë me ndërrim apo transfertë të pasurisë.
4. Në raste dëbimi të tyre për arsye legale të palave, pala dëbuese është e detyruar t’i paguaj shpenzimet e rrugës deri në kufi të dëbuarve.
5. Palët kanë të drejtë të shesin e blejnë të gjitha llojet e mallrave të pasurive të tundshme ose jo, përveç pasurive bujqësore të cilat do t’u nënshtrohen ligjeve të vendit, si akt dhurimi apo testament apo edhe shkëmbimi.
6. Respektivisht shtetasit e secilës palë nuk do të kenë detyrim ushtarak e as ndonjë detyrim tjetër që e lidh me shlyerjen e shërbimit ushtarak. Si dhe në rast detyrimesh të tjera në rast lufte.
7. Shoqëritë anonime apo tregtare, apo industriale që janë të themeluara në tokat e secilës, njihen nga palët, por i detyrohen ligjeve në fuqi të shteteve për taksat apo detyrimet dhe nuk do të kenë ekstra.
8. Nënshtetasit nuk mund të jenë të privuar nga pasuritë e tyre në shtetet përkatëse, por për çështje të tjera duhet të njohin ligjet në fuqi.
9. Për të gjitha çështjet legale që kanë personat do të kenë të njëjtin trajtim siç edhe bashkombasit e shteteve respektive.
10. Konventa do të hyj në fuqi një muaj, pasi të jetë nënshkruar e ratifikuar nga vendet, nëse nuk ka objeksione ajo do të jetë në fuqi për dy vjet, nëse do të ketë objeksione ajo do të rishikohet nga palët dhe do të shqyrtohet në një kohë të dytë.⁴³⁸

⁴³⁷ Gazeta “ Paqja” 23 nëntor 1923, nr. 3, fq. 2

⁴³⁸ AQSH, F. 151, D. 368, V. 1923, fq. 1-10

KUMTESA

Çështja e traktatit të miqësisë shqiptaro-turke është një çështje që u komentua gjatë në shtypin shqiptar. Ajo në fakt mori nota pozitive, por në disa raste edhe negative. Gazetat komentuan edhe ato klauzola që sipas tyre ishin në dëm të shqiptarëve që ishin vendosur atje.

Megjithatë traktati përfaqëson një tratativë të mirëfilltë diplomatike të shtetit tonë për të krijuar marrëdhënie të mira me shtetet e tjera.

Po të analizojmë çdo pikë të traktatit, në aspektin juridik, duket që është formuluar qartë dhe përkundrejt ligjeve në fuqi. Artikujt përmbajnë të gjitha çështjet më problematike mes Shqipërisë e Turqisë. Nacionaliteti ishte thelbi i problemit dhe vendimi që u mor ishte i pranueshëm për të dy palët. Problemi i pasurisë, tregtisë, emigracionit etj., u pranua që do të trajtohen sipas rregullave që shtetet kanë. Në pikën e fundit, të dy palët lënë mundësi të hapur për të ndryshuar artikujt në rast se do të jetë e nevojshme. Në një analizë të traktatit duken tre aspekte.

Së pari, në aspektin social përcaktohen të gjithë rregullat e kalimit të popullsisë mes dy vendeve. Pranohet që popullsia mund të jetojë në Shqipëri ose Turqi, por vetëm legalisht. Të gjitha problemet që përfshijnë emigracionin, palët pranojnë që mund të ndërhyjnë në çdo moment për ta ndaluar. Në rastet kur personat nuk respektojnë ligjet në fuqi për emigracionin dhe vendoseshin ilegalisht, qeveritë kishin të drejtë t'i rikthenin përsëri në vendet e tyre, duke i paguar shpenzimet e rrugës.

Së dyti, në aspektin ekonomik, popullsitë e të dy vendeve kanë të gjithë të drejtat që të zhvillojnë lirshëm bizneset e tyre, zejtarinë, tregtinë, bujqësinë etj. Në secilin nga rastet, të gjithë duhet të zhvillojnë veprimtarinë e tyre përkundrejt ligjeve të të dy shteteve. Përveç të drejtave ato duhet të njohin dhe zbatojnë detyrimet.

Së fundi, në aspektin politik të dy vendet prireshin të respektonin marrëdhëniet me njëri-tjetrin dhe të ruanin tërësinë territoriale të secilit. Sipas artikujve nuk duhet të kishte ndërhyrje në jetën e brendshme politike të vendeve për të imponuar mendime apo ndikime të ndryshme.

Traktati shënon një hap përpara në aspektin e marrëdhënieve diplomatike dhe në radhë të dytë një përcaktim të ri të rregullave që duhej të zbatoheshin nga palët.

Recenzentë :
Prof.dr. Ferit Duka
Prof.as.dr. Pranvera Dibra

Dr. Teki KURTI: VËZHGIME MBI DOKUMENTET ARKIVORE DHE SHTYPIN E KOHËS NË SHQIPËRI PËR DEMONSTRATAT E VITIT 1968 NË KOSOVË

Viti 1968 shënon periudhën kur e gjithë bota u trondit nga një valë protestash qytetare (ose urbane). Po në këtë vit, lufta në Vietnam po arrinte kulmin, kurse në Evropë ky vit do të hynte në kalendarin e historisë si viti i aktit të paprecedentë të okupimit të Çekosllovakisë nga ana e shteteve aleate të Traktatit të Varshavës, të udhëhequr nga Bashkimi Sovjetik. Po ky vit shënohet si viti i protestave të mëdha studentore. Kështu, më 1968, studentë nga më shumë se 200 universitete në shumë vende evropiane dhe në SHBA dhe do të ngriheshin në protesta.⁴³⁹

Për këtë situatë, profesori Arçibal Koksi i Fakultetit të Drejtësisë në Uni-versitetin e Harvardit do ta komentonte: *“Brezi i tanishëm i të rinjëve në univer-sitete është më i informuari, më i zgjuari, më idealisti që ka pasur ndonjëherë ky vend”*.⁴⁴⁰

Këto protesta prodhuan një krizë në marrëdhëniet shoqërore, politike e kulturore të botës euro-atlantike e ndëkohë ato shënuan momentin transnacional të revoltës kundër statusquos së ndarjes Lindje-Perëndim dhe kundër gjithë strukturate të autoritetit. Të gjitha autoritetet institucionale dhe kulturore u ndi-enë të kërcënuara si p.sh. autoriteti i shtetit, ai i univeritatit, i shkollës, i firmës private, i prindit etj.

Vala e këtyre protestave përfshiu edhe Federatën Jugosllave. Në këtë kohë, sa-po ishte shkarkuar dhe dënuar represioni policor i A. Rankoviçit e grupit të tij dhe vendi ishte përfshirë nga shumë trazira e kriza lokale brenda republikave të saj. Fermenti kryesor i këtyre krizave ishte nacionalizmi, një virus i vjetër që në 20 vjetët e komunizmit autoritar qe e mundur të mbahej nën kontroll, por nuk arritën ta zhduknin.

Protestat e studentëve të Beogradit u zhvilluan kryesisht kundër pasigurisë ekonomike si dhe kundër pushtetit që nuk ishte në gjendje të dialogonte më ta. Pas një fjalimi të Titos më 9 qershor, studentët u shpërndanë me pushime dhe lëvizja mori fund.

Krejt ndryshe do të ndodhte në Kosovë. Atje ngjarjet e kanë pikënisjen në fundin e Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1945, Federata Komuniste Jugosllave, si kundër dhe Jugosllavia mbretërore, do ta aneksonte Kosovën brenda ku-fijëve të saj. Ky aneksim u bë kundër dëshirës së popullit të saj, me dhunë të armatosur dhe me procedura juridike nën presjon e të fallsifikuara. Më pas, popullsia shqiptare përjetoi një kalvar të gjatë diskriminimi kombëtar dhe re-presioni komunist. Një rreze shprese duket pas rënies së Rankoviçit, kur Tito ishte interesuar që t'i ketë në krah shqiptarët në rivalitet e ndryshme etnike e politike, serbo-kroate-slllovene.

Procesi i decentralizimit të Federatës, që fillon më 1967, me vështirësi përfshiu edhe Kosovën. Intelktualët shqiptarë, me miratim të tërthortë dhe të drejtue-sve politikë shqiptarë të Krahinës, gjatë diskutimeve për amendametet kushte-tuese, kërkuan Republikën e Kosovës brenda Jugosllavisë, në bazë të parimit të së drejtës së vetvendosjes së popujve. Kështu u evidentua hapur mospërputhja e aspiratave kombëtare të shqiptarëve dhe statusit autonom të Kosovës. Në Gjakovë dhe Pejë u kërkua që Kosova të sanksionohej në Kushte-tutën Federative si “njësi federale”. Por edhe zhvillimet e mëtejshme të aktivite-teteve politike të komunave të Kosovës dëshmuuan qartë se aspirata e kosovarëve për Republikë ishte e fuqishme. Këtë aspiratë një delegacion shqiptar ia kishte shprehur edhe vetë Titosë, më tetor 1968. Por përgjigja e tij ishte se *“Republika nuk i zgjidh të gjitha problemet”*,

⁴³⁹Pol Xhonson, “Kohët moderne 2”, Aplonia, 2000, fq. 223.

⁴⁴⁰-Po aty, fq. 222.

nënkuptonte se Kosova do të vazhdonte të mbetej nën Serbi. Për shqiptarët kjo përgjigje do të thoshte gjitha-shtu se diskutimet në rrugë legale për Republikën e Kosovës do të ishin të mbyllura.

Atë që lanë në mes politikanët e Kosovës, e vazhduan studentët dhe veprim-tarët e Lëvizjes Ilegale në Kosovë. Ata u ndienë të deziluzionuar dhe të fyer në personalitetin e tyre njerëzor dhe kombëtar. Viti 1968 kishte dhënë plot shembuj sesi duhej shprehur revolta dhe forca e shembullit të bashkëmoshatarëve të tyre në Perëndim dhe në Lindje ishte e fuqishme, edhe pse motivet ishin të ndryshme. Edhe të rinjtë e Kosovës ngriheshin kundër autoritetit të shtetit, që për dekada i kishte shtypur, i kishte ndrydhur dhe vazhdonte të mos i dë-gjonte.

Duke studiuar dokumentet arkivore të kësaj periudhe, rezultoi se për gjendjen në Kosovë në vitet 1968-1979, shteti ynë shqiptar rriti interesimin për gjithçka që ndodhte në Kosovë. Kështu, strukturat përkatëse informoheshin mbi propo-zimet për ndryshimet në Kushtetutën e Kosovës, për qëndrimin e komisionit që kryesohej nga Fadil Hoxha dhe për propozimin që ky komision i bënte Federa-tës që Kosovë-Metohia të shkëputej nga Republika Serbe dhe të varej direkt nga organet federative.⁴⁴¹

Strukturat e shtetit informoheshin në detaje deri për qëndrimin e historianëve të Serbisë në Beograd ndaj studiuesit kosovar Ali Hadri, i cili dënoi krimet dhe padrejtësitë që i ishin bërë popullit shqiptar të Kosovës gjatë Rankoviçit, ku kroatët dhe sllovenët kishin vlerësuar fjalën e studiuesit kosovar dhe kishin dënuar me forcë padrejtësitë. Po ashtu, në dokumentet arkivore ka informacion për çdo detaj politik që ndodhte në Kosovë. Kështu përmendim vlerësimin që i ishte bërë artikullit të “Zërit të Popullit”, të datës 16 nëntor 1967 me titull: “*Demagogjia titiste nuk mund t’i mbulojë plagët e hapura të Kosovës*”, që sipas burimeve vlerësohej si artikulli më i mirë i 20 viteve të fundit.⁴⁴²

Strukturat përkatëse të informimit japin edhe detaje të ndryshme rreth vlerësimit të të deleguarit të LKJ në Prishtinë, Kiro Haxhi Vasilijev, i cili ka thënë: “*Ka qenë fatkeqësi e madhe për shqiptarët e Kosovës që kanë mbetur të izo-luar nga lidhjet me Shqipërinë. Kjo duhet ndrequr dhe një gjë e tillë mund të arrihet me anën e afrimit të Kosovës me Shqipërinë, por pa kërkuar ndryshimin e kufijëve.*”

Në informacionin arkivor përbildhen edhe mendime të intelektualëve kosova-rë për çështjen kombëtare shqiptare. Ata kritikojnë hezitimin e Shqipërisë për të ndihmuar Kosovën. Duke e shtyrë më shumë mendimin kërkohej nga ana e tyre që Kosova të bëhej për Shqipërinë si Vojvodina për Hungarinë, e cila anonte më shumë nga Hungaria se nga Jugosllavia. Për rrjedhojë, një Kosovë të tillë, kosovarët do të kenë mundësinë që të hyjnë e të dalin në Shqipëri, të shkollohen, të ndihmohen më shumë nga Shqipëria, me një fjalë, ekzistenca e kufijëve të jetë formale.⁴⁴³

Një intelektual kosovar, për çështjen kombëtare shkruan: “*Duhet të kuptoni situatën në të cilën ndodhemi ne shqiptarët e Kosovës. Ndarja e Kosovës nga Shqipëria qe një padrejtësi e madhe. Kaluan 50 vite dhe kjo ndarje vazhdon. Duhet të na ndihmoni që ne të ruajmë ndienjat kombëtare, të krijojmë një inteli-gjencë shqiptare të gjerë, sepse intelektualët janë sytë e popullit, dhe, pa krijuar një numër të konsiderueshëm syresh në Kosovë nuk ka mundësi të ndryshohet populli, që është shumë i prapambetur. Rinia kosovare ka ndienja të flakta nacio-naliste, ajo e don Shqipërinë.*”

Të gjitha këto materiale arkivore shërbenin vetëm për hierarkinë e lartë par-tiake e shtetërore, pasi vetëm ato kishin të drejtën për t’u informuar, të drejtën për të përpunuar veprimet dhe të koordinon politikën dhe propagandën në planin kombëtar. Kjo funksiononte në kushtet kur vetë Shqipërisë i mungonte sistemi shumëpartiak apo organizma të tjerë shoqërore e politike që duhet të ketë një shoqëri moderne pluraliste.

Duke e hedhur vështimin në brendësi të shtypit shqiptar, rezultoi se, megjithëse kishte një numër të konsiderueshëm organesh shtypi, si gazeta e revista me karakter kulturore e informative, shtypi që trajtonte çështjen e Ko-sovës ishte i pakët dhe i shtrirë vetëm në dy dhe në raste të veçanta

⁴⁴¹-AQSH, Fondi AP 14, Dosja 89, fq.1, “Informacion nga burime të Shqipërisë jashtë (tepër se-kret)”, dt. 03.01.1968.

⁴⁴²-AQSH, po aty, fq. 2.

⁴⁴³-AQSH, Fondi AP 14, Dosja 89, fq.4, “Informacion nga burime të Shqipërisë jashtë (tepër se-kret)”, dt. 03.01.1968.

në tri gazeta, siç ishin “Zëri i Popullit”, “Bashkimi” dhe “Zëri i Rinisë”, respektivisht or-ane të partisë, të frontit dhe të rinisë. Për hir të së vërtetës, duhet thënë se në artikuj të veçantë, redaksional, historia e popullit shqiptar në Shqipëri dhe popullit shqiptar në Kosovë shihet kryesisht si histori e një kombi. Kështu, artikulli “Zëri i Popullit” të muajit tetor 1967 hapet me titullin “*Mëma e paved-kshme Shqipëri nnderon bijën e saj të lavdishme kosovare*”.⁴⁴⁴

Një artikull tjetër i kësaj periudhe denoncon terrorin mbi popullsinë shqiptare në prag të 60-vjetorit të themelimit të alfabetit shqip në Manastir. Pasi shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi kishin vendosur ta festonin këtë ngjarje të madhe kombëtare të shqiptarëve. Për këtë shteti jugosllav ngriti gjyqin kundër “agjentëve shqiptarë” në Manastir.

Artikulli mbyllet me fjalët se e drejta është në anën e shqiptarëve “*prandaj ata janë edhe të fortë e të pamposhtur*”.⁴⁴⁵

Tri ditë përpara se të bëheshin demonstratat në Kosovë, pra më 24 nëntor 1968, “Zëri i Popullit”, organi kryesor i shtypit politik e propagandistik në Shqipëri, në një artikull të madh me titull “*Shqiptarët e Kosovës dhe Flamuri Kombëtar*”,⁴⁴⁶ do të shpaloste para popullit shqiptar dhe opinionit botëror se “*Për çdo popull e komb në botë është i dashur e i shenjtë flamuri i vet kombëtar*”. I dashur dhe i shenjtë është ai edhe për shqiptarët e Kosovës e Metohisë, si simbol i kombit të tyre, i ekzistencës së tyre si entitet kombëtar, i luftimeve shekullore që ata kanë zhvilluar me gjithë popullin shqiptar kundër shtypjes së huaj për lirinë e pavarësinë kombëtare, i dinjitetit dhe i krenarisë së tyre kombëtare si shqiptarë, si pjesë e pandarë e një populli të lavdishëm, trim e të papërkulur përballë çdo armiku, vështirësishë, pengesash e perversitetesh të historisë.⁴⁴⁷

Afërsisht keto rrethana janë vazhdim i këngës që sportistët shqiptarë të Shqipërisë së bashku me studentët shqiptarë të Kosovës kënduan në Beograd me fjalët “*Përpara...*”

Artikulli i “Zërit të Popullit” thekson se moslejimi i flamurit kombëtar në trojet shqiptare në Jugosllavi deri tani kishte të bënte me përpjekjet dhe synimet e shovinistëve serbë për shkombëtarizimin e shqiptarëve në trojet e veta.

Kështu, shkrimi thekson se “*megjithëse AVNOJ në nëntor të vitit 1943 dhe Ku-shtetuta e RSF të Jugosllavisë ka proklamuar barazi të çdo kombi dhe të drejtat e tyre për vetëvendosje deri në shkëputje, shqiptarët e Kosovës e Metohisë si entitet kombëtar edhe sot e kësaj dite akoma nuk i kanë fituar të drejtat kombëtare themelore*”.⁴⁴⁸

Artikulli nënvizon më tej se “*ato të drejta, që pas shumë vuajtjesh e përpjekjesh u janë njohur kosovarëve, qoftë edhe ajo e mbajtjes së flamurit kombëtar, janë akoma një gjë shumë e vogël dhe shqiptarët e Kosovës, më mirë se kushdo, e kuptojnë se ç’përfaqësojnë realisht ata në gjendjen e tyre të përgjithshme të shtypjes e të diskriminimit kombëtar*”. Artikulli bën apel kundrejt provokacioneve që fshehin shovinistët serbë ndaj shqiptarëve, “*për t’i mbyllur atij rrugën e sigurimit të të drejtave të veta kombëtare vendimtare e të plota*”.

Mbas këtij apeli që artikulli iu bën si autoriteteve të Beogradit për njohjen e të drejtave të shqiptarëve, shihet edhe fryma realiste e patriotike që përcillte tek opinion i brendshëm e i jashtëm e ndërkombëtar njëkohësisht.

Artikulli përfundon me një apel që iu bëhet drejtuesve të asaj periudhe në Kosovë, ku u kërkohet që të jenë më realistë, të studiojnë më thellë historinë e lavdishme të popullit shqiptar të Kosovës, i cili kurrë nuk është përlulur përpara-ra shtypjes, sado e egër dhe e pamëshirshme të ketë qenë ajo”.⁴⁴⁹

Siç shihet nga materialet që cituam më lart, që udhëheqja e asaj kohe në Shqipëri i përdorte për përdorim të brendshëm, del që në Kosovë situata ziente dhe pas tri ditësh shpërthyen demonstratat, që u zhvilluan më 27 nëntor në Prishtinë, Gjilan, Ferizaj e Podujevë. Ato shpërthyen një ditë përpara

⁴⁴⁴-Gazeta “Zëri i Popullit”, organ i KQPPSH, nr. 258, dt. 27 tetor 1967.

⁴⁴⁵-Gazeta “Zëri i Popullit”, organ i KQPPSH, nr 92, dt. 17 prill 1968.

⁴⁴⁶-Gazeta “Zëri i Popullit”, organ i KQPPSH, nr 282, dt 24 qershor 1968.

⁴⁴⁷-Gazeta “Zëri i Popullit”, organ i KQPPSH, nr 282, dt 24 qershor 1968.

⁴⁴⁸-Po aty.

⁴⁴⁹-Po aty.

KUMTESA

përvjetorit të shpalljes së Pavarësisë së shtetit shqiptar. Demonstratat kërkonin: “*Kushte-tutë, Universitet, Vetëvendosje, Republikë*”.⁴⁵⁰

Por demonstratat e Kosovës, ndryshe nga ajo që apelonte “Zëri i popullit” në Shqipëri, për autoritetet kosovare, Komiteti Krahinor i cilësoi si armiqësore.⁴⁵¹

Artikulli aludon se mbas gjithë këtyre krimeve monstruoze fshihej ndonjë pabesi tjetër deri për t’u cënuar integriteti territorial i Shqipërisë, pasi në Bull-gari ishin vendosur trupa sovjetike.

Këto ishin shkurtimisht disa reflektime për dokumentacionin arkivor si dhe periodikun shqiptar para dhe pas demonstratave të vitit 1968 në Kosovë në periudhën e Shtetit monopartiak të Tiranës.

Përfundime

Demonstratat e Kosovës nuk ishin të dhunshme, por shteti përdori dhu-në ndaj tyre. Ato ishin demonstratat e para në Kosovë pas viteve të Luftës së Dytë Botërore dhe si të tilla patën jehonë në popull, pasi u rikthye një kohë që pothuaj ishte harruar.

Demonstratat e Kosovës do të ndiqeshin nga demonstratat e shqiptarëve të Maqedonisë dhe në vitet e ardhshme do të përkujtoheshin po me të njëjtën mëyrë, me manifestime të hapura qytetare. Tito do të shprehej për demonstra-tat e vitit 1968 se “*nuk duheshin dramatizuar e hiperbolizuar dhe nuk duhej t’u jepej rëndësia që nuk e kishin*”. Pra, ai thjeshtë donte t’i kanalizonte si demonstrata të zakonshme studentësh. Por më prill 1969, F. Hoxha, në një bisedë me përfaqësuesit e Lidhjes së studentëve të shkollave të larta e të fakulteteve të Prishtinës, do të pohonte se “*studentët nuk dolën në rrugë thjesht për të zgjidhur çështjet e studentëve, por për diçka tjetër*”.

Demonstratat e vitit 1968 shprehin jo vetëm zhgënjimin dhe revoltën e një brezi në Kosovë, por edhe guximin e mënçurinë e tij. Ata që organizuan demonstratat e vitit 1968 në Kosovë e kishin shumë të qartë se nuk do të mund t’i detyronin pushtetarët serbë e federativë që të shpallnin Republikën e Kosovës. Por, në frymën e përgjithshme të protestave globale dhe në proceset decentralizuese të Federatës, studentët kosovarë të asaj kohe dhanë shumë mesazhe, të cilat u kapën nga pushtetarët që ishin të interesuar për një lloj detante brenda Federatës. Gjithsesi, e rëndësishme ishte që këto mesazhe u flisnin shqiptarëve të Kosovës për një tranzicion të gjatë e të vështirë, ku lufta për të drejtat kombëtare e për Republikë do të bëhej qëllimi kryesor i veprim-tarisë së tyre të ardhshme.

Recenzentë :
Dr. Asllan Zemani
Dr.Prof.as.Bernard Zotaj

⁴⁵⁰ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, Kosova në vështrimin enciklopedik, Toena, Tiranë 1999, fq.123.

⁴⁵¹ Gazeta “Zëri i Popullit”, organ i KQPPSH, nr. 282, datë 24 qershor 1968.

**Mr.sc Bedri MUHADRI: HISTORIOGRAFI MESJETARE SHQIPTARE NË KOSOVË
PËRBALLË HISTORIOGRAFISË SERBE**

Fillet e historiografisë mesjetare shqiptare në Kosovë datojnë mirëfilli në vitin 1968, me mbajtjen e Simpoziumit Ndërkombëtar Shkencorë në Prishtinë dhe Tiranë, me rastin e shënimit të vitit jubilar të 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Studiues të shumtë shqiptarë por edhe të huaj, vunë në pah rezultate të argumentuara shkencore për formimin dhe ekzistimin e Shtetit mesjetar shqiptarë të kohës së Gjergj Kastriotit Skënderbeut, por edhe argumentuan se në mesjetë popullata shqiptare në arealin e gjerë arbërore ishte etnikum i formësuar politik dhe ekonomik.

Historiografisë shqiptare hedhin poshtë shkrimet e shumta historike të autorë serbë që do të shfaqen me shkrime, artikuj, dhe vepra të shumta të dedikuara historisë së Kosovës dhe shqiptarëve, të cilët do të kenë për qëllim që të mohojnë autoktonin e shqiptarëve të Kosovës, dhe sipas tyre, territori i Kosovës qysh para ardhjes së Perandorisë Osmane ishte pjesë e shtetit serb mesjetar dhe se popullata e saj ishte në tërësi serbe, gjithnjë deri në shekujt XVII-XVIII. Kreatore e të gjitha “tezave shkencore” e propagandistike mbi Kosovën, ishte dhe është Akademia Mbretërore serbe 1888-1945 e deri tek Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve 1945 e deri në ditët e sotme.

Historiografi i parë shqiptarë në Kosovë qe Akademik Ali Hadri. Botimi i veprës “Pasqyrë e historisë Nacionale-Shqiptare” e autorëve Ali Hadri dhe Milan Perkaj, në vitin 1960 shënon edhe fillimin e shkuarjes së historiografisë në Kosovë dhe rinjohjen e historisë sonë nacionale, tek nxënësit dhe opinioni kosovarë. Kontributi i A. Hadrit në shkrimin e historisë nacionale në Kosovë në tekstet e historisë, u pasqyrua shkencërisht në tekstet vijuese: “*Pasqyrë e historisë së shqiptarëve*”, Beograd,1968; “*Historia e Popullit shqiptar për shkollat fillore*”, Prishtinë, 1970 dhe “*Historia e popullit shqiptar për shkollat e mesme*” Prishtinë,1971. Këto botime shënojnë arritjet e konsiderueshme shkencore pedagogjike në trajtimin e historisë në Kosovë

Në veprimtarin shkencore të Akademik Ali Hadrit rëndësishëm zënë vend të duhur edhe aktiviteti dinjitoz shkencor në përcjelljen më vëmendje të duhur të literaturës së huaj e sidomos asaj serbe, të cilët sa vinin e bëheshin në kohën e tij, tendencioze në shtrembërimin tej mase ndaj së vërtetës shkencore të historisë sonë që nga Antikiteti e deri te Lufta e Dyte Botërore. Kështu doemos, Prof. Ali Hadri, iu është dashtë të përballet me argumentin e fakteve historike, ndaj botimeve shkencore dhe te kolegjiujmeve profesionale siç ishte rasti me Enciklopeditë që botoheshin në atë kohë në vitet 1970 deri në vitin 1980, dhe autorëve të shumtë, kryesisht serb, që me publikimet e tyre, manifestohej pseudoshkenca e tyre, siç cilësohet nga Akademik Ali Hadri, në dëm, të historiografisë shqiptare në përgjithësi e në veçanti edhe ndaj epokës së lavdishme shqiptare të kohës së Skënderbeut. Kështu, duke e parë në volumin kohorë të historisë, themi se Akademik Ali Hadri, u bë monitorues i mbrojtjes së vlerave shkencore të historiografisë sonë, karshi tentimeve pseudoshkencore serbe dhe deri diku edhe asaj të Ish Jugosllavisë.

Veprimtari gjithëpërfshirëse shkencorë, e Akademik Ali Hadrit, ku trajtohen aspektet historike, që nga antikiteti, mbi çështje Ilire, pastaj, aspekte mesjetar, gjenezën e popullit shqiptar, Epokën e Skënderbeut, pastaj aspektet e Rilindjes shqiptare te fund shek XIX dhe aspektet e tjera gjate dy luftërave Botërore, dhe pas saj, i bën nder historiografisë sonë në Kosovë që prof. Ali Hadri njihet si themelues i saj. Epitetin e themeluesit të historiografisë në Kosovë, nga ana e Akademik. Ali Hadrit, e shprehu Akademik Rexhep Qosja, që konkludon se: “...Prej tij (prej prof. Ali Hadrit) ne, në Kosovë, e kishim dëgjuar fjalën histori, por historinë, si të popullit tonë, ashtu edhe të popujve të tjerë të Ballkanit ose nuk e dinim fare, ose e dinim fare dobët. Ai ishte historiani ynë i parë dhe më i njohur që në historinë tonë do ta bëjë dije, të çmuar, të nderuar dhe të dëgjuar. Në saje të punës së tij historike, ne, do të mësohemi ta kuptojmë të kaluarën e popullit tonë dhe të kuptojmë edhe të kaluarën

e popujve tjerë. Përpara tij mund t'i thoshim histori edhe kallëzimit, edhe legjendës, edhe këngës, edhe mitit: por, duke lexuar veprat e tij do të kemi mundësi të bindemi se historia është një dije, në të cilën njerëzit mësohen, të kuptojnë se kush ishin, se kush janë dhe, më në fund se kush duhet të jenë”⁴⁵²,

Historian serb Dimitrije Bogdanoviçiq “duke manipuluar me imputime politike, nuk ngurron që, para emrit të Akademik Ali Hadrit, të vë shenja te punonjësit kulmor të nacionalizmit të egër agresiv shqiptar dhe të sinkronizuesit të fushatës kundër popullit serb”. Akademik Ali Hadri në shkrimet e tij për Historinë e Popullit shqiptarë në Kosovë në kuadër të projekteve shtetërore të Ish Jugosllavisë me rastin e botimit të Enciklopedisë Jugosllave në vitet 70 të shekullit të kaluar shkroi për Principatën e Arbërisë si një formacion politik të formësuar shqiptarë të asaj kohe. Ai mbështetet në Burimet historike ku thuhet “*Dhimitri arhont i Arbanumit*” pra “*Dhimitri udhëheqës i Arbërisë*” dhe Dhimitri në dokumente bizantine mbante titullin “*Panhipesevast*” titull ky që jepej vetëm nga oborri mbretëror bizantin, dhe ishte titull i rangut të lartë politik sipas konceptimit politik të Perandorisë Bizantine⁴⁵³. Dhimitri si udhëheqës i Arbërisë u garantonte Republikës Raguzane se mund të merren me tregti në mënyrë të sigurt në shtetin e tij, nëpër tokë e det, pa kurrfarë takse doganore, janë këto burime që përdorë Ali Hadri në shpjegimin e Principatës së Arbërisë në kuadër të hartimit të projektit të Enciklopedisë Jugosllave. Mirëpo, qasja e thellë shkencore e Ali Hadrit bëhet objekt i shqyrtimit të madh të redaksive të shumta të republikave dhe të Krahinave të Ish Jugosllavisë dhe të Akademisë ushtarake Jugosllave. Ndër historianët më të zëshëm si Sima Qirkoviçiq, Millorad Ekmeçiç, Vlladimir Didjer etj, të cilët ishin edhe redaktorë për hartimin e Encikloedisë Jugosllave dhe të Historisë serbe të viteve 1972 dhe 1980. Sima Qirkoviçiq thotë se” Ali Hadri ka shkruar për Principatën e Arbërisë në atë mënyrë sa që sugjeron autonominë e njëfarë Principate të Arbërisë e cila tij nuk ka ekzistuar”. Pikësynimet e tija dhe të historianëve të tjerë serbë, janë që të mos shohin dhe të mos pranojnë etnikumin arbërorë të formësuar dhe të ngritur në aspektin politik me qëllim që të theksonin se deri në këtë kohë arbërit që dalin në shekullin e XI nuk kanë ndonjë kontinuitet politik të deri në shekullin e XV gjegjësisht me epokën e Skënderbeut. Sipas tyre nuk mund të flitet për kurrfarë formacioni politik e shtetëror e juridik. Mund të flitet për shqiptarë por jo edhe për Shqipëri si njësi shtet formues. Ndonëse historianët serb, shkruan Profesor Ali Hadri kanë njohuri të duhura për mesjetën edhe për Epokën e Skënderbeut qëllimshëm janë të njëanshëm dhe se nuk e shohin atë me qasje objektive shkencore. S. Qirkoviçiq, dhe B. Hrabaku e sulmuan Akademik Ali Hadrin se mendimi i tij për origjinën ilire të shqiptarëve dhe për shqiptarët në shek VIII lidhet me ideologjinë shqiptaro madhe⁴⁵⁴.

Hulumtimet në fushën ekonomike të shumë studiuesve qofshin të huaj apo shqiptarë tregojnë se gjatë periudhës mesjetare shek XIII-XV Kosova ishte ndër trevat më të pasura të Ballkanit. Kosova u bë qendër e zhvilluar ekonomike ën mesjetë me zhvillim të gjithanshëm ekonomik e posaçërisht ishte e zhvilluar xehetaria. Por historianët serb si B. Hrabak, Sima Qirkoviçiq të viteve 1980, vejnë në dukje se edhe pse territori i Kosovës ishte qendër shumë e zhvilluar e xehetarisë, shqiptarët –arbrit e Kosovës nuk janë marrë më xehetari në mesjetë që sipas tyre nuk dëshmojnë në burimet historike. Mirëpo për të kuptuar se kanë ekzistuar edhe minatorë shqiptarë në Kosovë asokohe, në numër të konsiderueshëm mjafton të shikohen studimet e Skender Riza⁴⁵⁵ ku autori përmend një numër xehetarësh shqiptarë të Kosovës që janë marrë me xehetari asokohe. Aspektet ekonomike të periudhës mesjetare në Kosovë janë marrë edhe studiues si J. Drançolli⁴⁵⁶, S. Daci⁴⁵⁷ të cilët vejnë në pah për

⁴⁵² R. Qosja, “Nekrolog për Akademik Ali Hadri”, *Gjurmime Albanologjike*, Seria e shkencave historike 18-19, Prishtina, 1989, f. 343.

⁴⁵³ A. Hadri – M. Prenkaj, *Pasqyrë e historisë nacionale shqiptare*, Prishtinë, 1960, f. 27.

⁴⁵⁴ Ali Hadri, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë, 2003, f. 27.

⁴⁵⁵ S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII Administrimi, ekonomia, shoqëria dhe lëvizja popullore*, Prishtinë, 1982.

⁴⁵⁶ J. Drançolli, *Raguzanët në Kosovë (prej fundit të shekullit XIII deri në vitin 1455)*, Prishtinë, 1968.

veprimtarit e shuma ekonomike si, Xehtaria, Bujqësia, Bletaria , Vreshtaria, ishin mjaft të zhvilluara në mesjetë.

Historiografia serbe, duke spekuluar mbi të dhëna historike serbe si aktdhurata e manastireve serbe të cilat posedonin prona të shumta në territorin e Kosovës, janë përpjekur të mohojnë autoktoninë dhe praninë e popullatës shqiptare në Kosovë gjatë mesjetë dhe ta paraqesin atë të ardhur pas fundit të shek. XVII nga viset malore të Shqipërisë. Duke u marrë me këtë çështje pothuajse në të gjitha punimet e saja historiografia serbe deri më sot, mban qëndrim të njëanshme në konstatimet se struktura etnike e popullsisë në territorin e sotëm të Kosovës gjatë mesjetës duke vazhduar deri nën sundimin osman (gjysma e dytë e shek. XV) e përbënte vetëm “popullata serbe”, pra në kuptimin se treva ishte e popullzuar vetëm nga “serbët”. Studiuesi serb St. Stanojeviq i cili edhe është marrë me çështje etnike në Kosovë gjatë mesjetës, në hulumtimet e tija – në Krisobulën e Deçanit, edhe pse i nxjerrë disa emra të paktë shqiptarë dhe vllahë që dalin në nga dokumentet sllave, vjen në përfundim se nuk ekzistonte ndonjë strukturë etnike heterogjene e popullsisë në atë trevë, pavarësisht se aty përmenden shqiptarët dhe vllahët, dhe se gjykuar sipas emrave të njerëzve brenda familjeve del se edhe ata ishin “serbë”⁴⁵⁸.

Studiuesi Muhamet Tërnavë në kritikën e bërë St. Stanojeviqit konstaton se “autori serb duke marrë parasysh emrat e paktë shqiptarë (*kupto vazhdimisht arbërorë*. B.M), dhe vllahë, në krahasim me numrin e madh të antroponimeve sllave që dalin në aktdhuratat e lëshuara nga sundimtarët serbë për manastiret dhe kishat, arrin në përfundim të gabuar se antroponimet karakteristike për shqiptarët dhe ato vllahe nuk kishin domethënie etnike, nuk paraqisnin shqiptarin e as vllahun, por paraqisnin serbin dhe ishin në funksion të antroponimisë dhe popullatës së feudit të Deçanit”⁴⁵⁹.

Me problemin demografik të Kosovës në të kaluarën për qëllime tendencioze janë marrë disa studiuës serbë të profileve të ndryshme të shkencave shoqërore. Hulumtimet e tyre bazohen në të dhëna gojore në terren e të paverifikuara. Ata krijuan teorinë pa asnjë mbështetje burimore shkencore se “*ata shqiptarë (kupto arbit, B.M) që nuk mund ta përcjellin gjenealogjinë e tyre të largët, apo ata të cilët e ruajnë përkatësinë e tyre fisnore të fiseve nga Shqipëria Veriore në Kosovë kanë ardhur nga pjesët veriore të Shqipërisë së sotme nga shekulli XVIII dhe se një pjesë e tyre është rezultat i asimilimit të serbëve në shqiptarë nën presionin asimilues të sundimit turk nëpërmjet islamizimit*”, nxjerrin përfundime ekstra-shkencore se Kosova gjatë sundimit të Nemanjidëve (fundi i shek. XII deri në vitin 1371) dhe në përgjithësi në periudhën para osmane ishte e popullzuar vetëm nga serbët. Kjo shihet në punimet e simpoziumit të Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve në vitin 1986, botuar në vitin 1988 në një vëllim të veçantë në serbokroatisht dhe frëngjisht “*Iliri i Albanci*” dhe në shumë botime të tjera si “*Kosova i Metohija u srpskoj istoriji*”, Beograd, 1989, “*Zadužbine Kosova O Kosovu i Kosovo (Spomenici i znamenja srpskog naroda)*, Prizren-Beograd, 1987, ku shfaqen pikëpamje tendencioze të llojit të vet si: “në Kosovë turqit gjetën dhe regjistruan një popullatë e cila ishte pothuaj e pastër serbe..., disa fshatra serbe të braktisura i popullzuan qysh në shek. XVI, blegtorë shqiptarë”⁴⁶⁰.

Studiuesi ynë i çështjes demografike mesjetare Muhamet Tërnavë vëren tek autorët serbë se, edhe pse hasen në këtë material gojor deklarime të këtilla, kishte një pjesë të shqiptarëve të këtij territori që nuk mbanin mend që të jenë të ardhur, por historianët serbë nuk i pranuan këto si fakte për ekzistimin e etnosit arbëror në kohën para osmane.⁴⁶¹

Historiografia shqiptare mbi studimet e dokumenteve mesjetare cirilike sllave , shkoqit se “Shqiptarët që nga fillimi i shekullit XIII u gjendën vijimisht nën sundimin e Nemanjidëve dhe duke qenë në rrethana të tilla, nuk patën mundësi të formimit të institucioneve fetare e as shtetërore, një

⁴⁵⁷ S. Daci, “Disa të thëna ekonomike për Kosovën gjatë mesjetës” *Buletini i Fakultetit Filozofik XIII/1993*, Prishtinë, 1993.

⁴⁵⁸ St. Stanojević, *Lična imena i narodnost u Srbiji srednjega veka*, Beograd, 1928, f. 29.

⁴⁵⁹ M. Tërnavë, *Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI*, Prishtinë, 1995, f. 16.

⁴⁶⁰ *Kosovo i Metohija u srpskoj istoriji*, (grup autorësh) Beograd, 1989, f. 8-9.

⁴⁶¹ M. Tërnavë, *Studime për mesjetën*, Pejë, 2000, f. 165.

pjesë e popullsisë me kohë mori përkatësinë e njëjtë fetare me pushtetmbajtësit – që ishte ortodokse dhe nën ndikimin e madh të kishës dhe shtetit është e qartë se ajo ishte veshur me shumicë antroponimia sllave. Prandaj, antroponimia sllave e përhapur gjerësisht në këtë treve nuk dëshmon se aty ishte popullsia kryesisht sllave, por dëshmon të kundërtën: “ Se aty ishte e pranishme me shumicë popullata shqiptare, që kishte antroponimi arbërore-shqiptare, por kishte edhe shqiptarë me antroponimi të huaj – sllave”⁴⁶².

Historianët serb (këtu përfshihen pothuajse të gjithë historianët serb) e shpjegojnë shtimin e popullatës shqiptare në Kosovë gjatë periudhës së hershme osmane, nëpërmjet emigrimit fizik: ata shpjegojnë se shqiptarët nga Malësia e Veriut terriore në Shqipëri u nxitën nga osmanët që të vendoseshin në Kosovë, dhe se shumë prej tyre kaluan në fenë islame për të shfrytëzuar mundësit për status më të mirë, gjegjësisht me marrjen e pronave të ndryshme, si timare etj, kurse serbët të cilët ishin bërë myslimanë, jo vetëm se u islamizuan tërësisht, por herët a vonë edhe u shqiptarizuan. Këto sugjerime të historianëve serb kundërshtohen bindshëm nga faktet që burojnë nga burimet osmane. Zyrtarët osman zakonisht në hartimin e dokumenteve regjistruese, shënonin se cilët krerë të familjeve ishin “ardhacak” (të ardhur) në vendbanimet e tyre. Në Sanxhakun e Prizrenit, me 1591, në mesin e 41 shqiptarëve të lindur aty, janë shënuar vetëm 5 emra të ardhacakëve shqiptarë⁴⁶³. Pastaj në vitet 1460-1490 në qytete e Kosovës shënohen gjithsej 25 të ardhur shqiptarë, por që 13 prej tyre kishin emra sllav dhe disa prej tyre kishin ardhur nga Bosnja. Kjo dëshmi hedh poshtë idenë e ardhjes së shqiptarëve nga Shqipëria e Veriut në Kosovë. Argumente të tjera më të përgjithshme kundër idesë së ardhjes, mbështetet në numrin relativ të popullatës si dhe në shkallën e shtimit të saj. Popullata e Kosovës gjatë kësaj periudhe ishte shumë më e madhe se sa popullatat e Shqipërisë së Veriut dhe asaj të Mesme. Prandaj, kjo nuk kishte mundësi të ndodhte⁴⁶⁴.

Kështu, me paraqitjen e të dhënave të mësipërme bazuar mbi burimet osmane, si *Regjistrimi i trevës së Brankoviçëve nga viti 1455-Vilajeti Velk- Vilajeti i Vukut; Defteri i Sanxhakut të Shkodrës nga viti 1455; Defteri i Sanxhakut të Vuçiternës 1462; Defteri i Sanxhakut të Prizrenit 1591 dhe Defteri i Sanxhakut të Dukagjint 1571-1591* arrijmë deri tek qëndrimet historianëve shqiptarë në Kosovë se, ilirët-dardanët-arbërorët ishin popullatë autoktone e territoreve të sotme të Kosovës që nga kohët e lashta, gjatë mesjetës e deri më sot, ku jeton populli shqiptar si pasardhës i drejtpërdrejt i tyre.

Beteja e Kosovës e vitit 1389 është zhvilluar në afërsi të Prishtinës e njohur si ndeshje mes koalicionit gjerë nga Ballkani dhe forcave të shumta të Perandorisë Osmane⁴⁶⁵. Historiografia serbe këtë betejë përpiket ta paraqesë si ngjarje vetëm ndërmjet serbe kundër osmanëve⁴⁶⁶. Qëllimi është që të paraqiten serbët si mbrojtës të Evropës nga ana e pushtimeve osmane në atë kohë. Historiografia serbe dhe propaganda e saj lidhur me pjesëtarët e koalicionit kundër osmanëve, thekson se në Betejë morën pjesë “shtetet e krijuara serbe” të udhëhequra nga Knazi L Lazar, sundimtar i shtetit “serb” të Moravës, “sundimtarit të Kosovës” Vuk Brankoviçit me ushtritë e tyre. Në këtë drejtim, ata u ndihmuan vetëm nga Bosnja, mbreti Tvrtko I, dhe ajo ka qenë një ushtri e vogël në përbërje siç theksohet jo fort e rëndësishme (6000 ushtarë) të udhëhequra nga komandanti Vlatko Vukoviç. Kështu që tendencat shihen qartazi se janë vetëm këta “serb” që zhvilluan luftë kundër depërtimeve osmane në Ballkan, njëherazi duke mbrojtur popullatën të krishterë të Ballkanit. Në anën tjetër, burimet historike, si osmane, bizantine, italiane, raguzane, shqiptare et., flasin për pjesëmarrjen e disa popujve të Ballkanit, si: shqiptarët, kroatët, hungarezët, vllahët, gregët, bullgarët, çekët etj., pra

⁴⁶² M. Tërnav, *Popullsia e Kosovës...*, f. 45-46.

⁴⁶³ M. Tërnav, *Popullsia e Kosovës...*, f. 401-465.

⁴⁶⁴ Po aty, f. 401-465.

⁴⁶⁵ M. Tërnav, *Diskursi shkurtër nga toponimia, beteja e Kosovës gjatë shekujve XIV-XV, dhe vendosja e atëhershme e pushtetit turk në Dardani-Kosovën e shekullit XV*, Prishtinë, 2007; I. Rexha, *Beteja e Kosovës në kronika-burime osmane të shekujve XV-XVI*, Gjurmime albanologjike, seria historike, nr. 19-1989, Prishtinë, 1990; M. Pirraku, *Pjesëmarrja e shqiptarëve në Betejën e Kosovës (1389)*, *Gjurmime albanologjike*, seria historike, XX-1990, Prishtinë, 1991.

⁴⁶⁶ *Kosovska bitka i posledice* (grup autorësh), Beograd, 1991; D. Bogdanović, *Kniga o Kosovu*, SANU, Beograd, 1985; S. Čirković, *The Serbs*, 2004

burime që anashkalohen nga historiografia serbe, dhe merr për bazë kryesisht epikën popullore serbe, që në kundërshtim me të dhënat burimore historike, shihet se mohojnë prezencën dhe pjesëmarrjen konkretisht të shqiptarëve dhe rolin e tyre në këtë ngjarje si dhe të popujve të tjerë.

Nga të gjitha këto që u thanë, do të shohim shumë pak autorë serbë që do të përmendin pjesëmarrjen e shqiptarëve në Betejën e Kosovës. Kështu D. K. Jovanović pranon se shqiptarët në Betejën e Kosovës i ka udhëhequr Theodori II Muzaka dhe Gjergji II Balshaj. Qëndrim identik me këtë mban edhe njohësi i mirë i Betejës së Kosovës J. Mishković. Ky bën të ditur se Balshaj ishte në Kosovë dhe se “në dokumente autentike ndryshe nuk mund të thuhet”.⁴⁶⁷ Pjesëmarrjen e shqiptarëve në Betejën e Kosovës e mbështesin në shkrimet e tyre edhe shumë studiues nga vendet e ndryshme të Evropës, ku më të rëndësishmit veçohen: N. Jorga, E. Durham, E. Jaque etj., Në këtë drejtim do ta veçonim edhe elaborimin e studiuesit frëng A. Dyselie. Sipas tij “popullsia shqiptare jo vetëm që nuk erdhi atje (në Fushën e Kosovës B.M.) e sjell nga armiku, por ajo, që nga Liqeni i Shkodrës deri në Kosovë, u bashkua dhe rezistoi me popullsitë e tjera të krishtera”.

Në historiografinë shqiptare sot Beteja e Parë e Kosovës, është trajtuar gjerësisht dhe ka dhënë rezultatet e saj të njohura për këtë çështje: Beteja e Parë e Kosovës ka karakter të një koalicioni të gjerë forcash nga të dyja anët. Forcat ballkanike ishin të përbëra nga zotërinjtë feudal në Ballkan të cilët edhe e shihnin rrezikun osman për lirin e tyre. Koalicioni ballkanik është udhëhequr nga Lazar Hrebelanović, me Kryezotërinjtë të tjerë, Gjergj Balshën, Theodor Muzakën Vlatko Vukovićin etj. Kurse koalicionin osman e përbënin forcat e shumta nga perandori dhe nga vendet vasale të saj. Këto forca janë udhëhequr nga Sulltan Murati I. Epilogu i betejës merr përfundimin e saj me vrasjen e të dy udhëheqësve Lazarit dhe Sulltan Muratit. Fitore korren forcat osmane me çka edhe vendosën fillimet e pushtimeve dhe të sundimit të treva në Ballkan. Me 1392 Perandori Osmane pushtoi Shkupin dhe këtu u bë qendra e mëtejme osmane për pushtime në Ballkan. Krye hero i kësaj betejë është Milosh Kopiliq, një shqiptar nga fshati Kopiliq i Drenicës. Këto rezultatet të historiografisë shqiptare janë elaboruar qartësisht në vitin 1989 me rastin e simpoziumit për Gjashtëqind vjetorin e Betejës së Parë të Kosovës. Nga ai simpozium kanë dalë studime të shumë studiuesve shqiptarë që zënë vend meritore për studimin e Betejës së Parë të Kosovës 1389, si Selami Pulaha, Petrika Thëngjilli, Pëllumb Xhufi, Luan Malltezi, Iljaz Rexha, Skender Rizaj, Jahja Drançolli, Flamur Hadri etj.

Në fund të themi se historiografia shqiptare në Kosovë ka rritën dhe rezultatet e saja shumë të rëndësishme. Por, sot nga kjo kërkohet të arrijë rezultate konkurruese evropiane. Kjo mbase arrihet me formë institucionalizuar, me përkrahje dhe mbështetje të duhur nga segmentet që mundësojnë avancimin e mëtejme të historiografisë në Kosovë. Mbajtja e “Javës së Shkencës” nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë – MASHT-it hap shtigje të dëshiruara për zhvillimin e shkencës në Kosovë.

Recenzentë:
Prof.dr. Izber Hoti
Prof. dr. Haki Kasumi

⁴⁶⁷ J. Mišković, *Kosovska gitka (15.juna 1389 godine)*, Beograd, 1933.

KUMTESA

Mr.sci. Faik SAHITI: MUZEALE TË KOSOVËS NË VEND DHE NË DISA MUZE TË SERBISË DHE MAQEDONISË

Përpyekjet e para në fushën e muzeologjisë në Kosovë

Kultura humaniste lindi atë ditë kur Terenci tha: “Çdo gjë që është njerëzore për mua s’është e huaj...”. Rreth njëzet shekuj më vonë, piktori flaman, Rubensi, këtij mendimi i dha një kuptim edhe më të thellë: “Gjithë botën e konsideroj atdhe timin”. Këtë porosi muzetë ua përcjellin të gjitha vendeve dhe njerëzve të botës, duke përdorur gjuhën ndërkombëtare të artit.⁴⁶⁸

Muzeumet janë dëshmitarë të kontinuitetit të njerëzimit, ndërsa kuptimi thelbësor i tyre është rezistenca kundër shkatërrimit, kundër vdekjes së trashëgimisë së lëvizshme, sepse grumbullimi, ruajtja, prezantimi, si dhe studimi i tyre mundësojnë ruajtjen e vlerave të qytetërimit, të realizuara nga etnikume, në periudha të ndryshme kohore. Ndaj, në detyrat parësore të muzeologjisë ngërthehen gjithashtu përpunimi i parimeve shkencore, puna praktike, kompletimi, pasurimi, regjistrimi, ruajtja, restaurimi i objekteve, ekspoziteve, fondeve, puna kërkimore, kategorizimi, ekspozimi, veprimtaria shkencore, kulturore, edukative, etj. Andaj, jo rastësisht thuhet se vizitat dhe takimet me monumente, pasurojnë shpirtin njerëzor.⁴⁶⁹

Edhe në viset tona, gjatë historisë, ishin grumbulluar dhe krijuar koleksione të veprave, si artistike ashtu edhe të gjinive të tjera me vlera historike. Andaj territoret etnike shqiptare patën fatin e rëndë historik që të jenë pre e lakmitarëve dhe pushtuesve, posaçërisht të atyre ballkanikë. Kosova, për dallim prej viseve tjera shqiptare, nuk ka arritur akoma të konsolidohet në aspektin e grumbullimit të fondeve për zgjerimin e rrjetit të muzeve në të gjitha hapësirat e vendit.

Kjo trashëgimi që paraqitet në një vazhdimësi të pandërprerë që nga parahistoria e këtej, edhe pse e rrënuar dhe e shkatërruar në masë të konsiderueshme, megjithatë, ofron një lëndë të bollshme me vlera të njëmendta, që do duhej studiuar mirëfilli dhe gjithanshëm⁴⁷⁰. Ajo krahas gjuhës prezanton me përpikëri etnitetin dhe identitetin kombëtar⁴⁷¹.

Në Kosovë ruhen që prej kohësh më të lashta materiale të vlefshme nëpër familje dhe institucione fetare. Reliktet muzeore ruhen nga dashuria ndaj të parëve. Shembuj të mirë për uajtje të këtij thesari të trashëgimisë kulturore ishin manastiret dhe kishat mesjetare, duke mos lënë anash as xhamitë, teqetë, tyrbet, si dhe familjet bujare. Në këtë kontekst po përmendim kishën e Prizrenit, manastirin e Deçanit, patrikanën e Pejës, kishën e Graçanicës, etj⁴⁷².

Thesaret e manastireve dhe kishave të Kosovës mund të konsiderohen si embrione të koleksioneve të muzeve, që shekuj me radhë i kanë qëndruar dhëmbit të kohës dhe e kanë ruajtur deri më sot trashëgiminë kulturore – historike, që lindi kryesisht në këtë trevë dhe u ruajt me kujdes nga banorët e këtyre viseve (nga banorët shqiptarë)⁴⁷³.

⁴⁶⁸ Grup Autorësh, Muzetë e Botës – Muzeo Britanik – Londër, Prishtinë 1980, p. 3.

⁴⁶⁹ Grup Autoresh, Muzete e Botes - Luvri – Paris, Prishtinë 1980, p. 9.

⁴⁷⁰ Flamur Doli, Arkitektura tradicionale- popullore e Kosovës, Katalog i ekspozitës shkencore Kosova 2001, p. 5.

⁴⁷¹ Fejaz Drancolli, Rrënimi i kullës shqiptare, Prishtinë 2004, p. 112.

⁴⁷² Deroko Aleksander, Monumentalna i dekorativno arhitektura u Srednjevekovnoj Srbiji, Beograd 1953, pp 59, 60.

⁴⁷³ Tefik Morina, Rrugja e zhvillimit dhe perspektiva e Muzeut të Kosovës, Prishtinë 1974, p. 228.

KUMTESA

Shembull të mirë paraqet thesari muzeor i manastirit të Deçanit. Në të ka monumente prej metalesh fisnike, dorëshkrime të rralla, ikona dhe gjësende të tjera të latuara artistikisht. Pos ikonave, freskave dhe koleksionit të 23 kryqeve (të shek. XIV), ka vlerë edhe koleksioni i gotave të argjendit me motive nga gjuetia, me shtazë të egra, fytyra shenjtorësh, etj. Më e bukura ndër to është gota e mitropolitit të Novobërdës, që iu dhurua manastirit më 1593⁴⁷⁴.

Në thesarin e këtij manastiri gjendet edhe një llambadar i realizuar në stilin e Renesancës gjermane. Llambadari në këtë manastir është ekspozat i dhuruar nga Gjergj Kastrioti-Skënderbeu⁴⁷⁵.

Si koleksion i parë muzeor i Kosovës, përmendet kulla e antikës⁴⁷⁶. Ky ishte “Muzeu” privat i familjes së bejlerëve Gjinolli, që ishin prijës turq me origjinë shqiptare⁴⁷⁷. Pjesëtarët e kësaj familje: Maliq Pasha, Jashar Pasha, Fuad Beu dhe të tjerë, në kthinat e shtëpive të tyre, ekspozonin në fillim një koleksion të pasur armësh të të parëve të tyre, si dhe armët e veta. Nëpër odat e kullës, e cila është mjaft e madhe dhe me një oborr e kopsht të madh, në mure ishin vendosur një serë koleksionesh të monumenteve⁴⁷⁸.

Në fillim të shekullit XX pallatin dhe konaqet e Gjinollit i vizitoi B. Nushioq. Sipas përshkrimeve të tij, thuhet se dhomat e Jashar pashës ishin plot me armë të vjetra, kishte një shumicë pushkësh të vjetra, shpatash, jataganësh, xhilitësh, pisqollash, kordhash, mëzdrakësh, etj. Aty ndodhej edhe gjijotina, me të cilën xhelati i Jashar pashës priste koka. Shpatat ishin të stolisura me ari dhe argjend me fragmente nga Kur’ani dhe me emrat e sulltanëve. Nushiq vë në dukje se këto konaqe paraqisnin një muze të tërë⁴⁷⁹.

Realisht kultura kombëtare gjendej në rrethana të rënda politike, shoqërore dhe në kushte të një baze ekonomike, herë-herë të shkatërruar plotësisht nga luftërat e vazhdueshme për çlirim kombëtar kundër pushtuesit osman, por edhe nën një presion të vazhdueshëm dhe të kërcënimit permanent nga fqinjët ballkanikë, me përkrahjen e gjithanshme të Rusisë. Me pak fjalë, kombi shqiptar u lind në rrethana lufte, vazhdoi rritjen nëpër luftëra që nuk pushuan⁴⁸⁰. Ashtu edhe kultura mbijetoi në saje të një konsolidimi të fortë, që ishte krijuar në shekuj.

Andaj personalitete të shquara, si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri, filluan që të jepnin kontributet e tyre në trashëgimi. Njëri nder ta ishte edhe At Shtjefën Gjeqovi. Qysh nga viti 1900 Gjeçovi u mor intensivisht me kërkime dhe zbulime të varrezave ilire e mesjetare, me mbledhjen e monedhave, mbishkrimeve dhe objekteve të ndryshme arkeologjike. Gjeçovi vazhdimisht bën thirrje duke ftuar njerëzit të kërkojnë për veten e tyre, “Visari i jonë, historia e jonë gjenden të mbuluara nën dhe, kush e din sa poshtë a pëllëmbë, e ne si biem mbrapa”. Për ne kanë çmim të madh sende të vjetra që mund të gjenden në gji të tokës sonë, pa marrë parasysh a janë të hekurta, të arta a të argjendta⁴⁸¹.

Kjo kulturë materiale e zbuluar në viset e Kosovës, përbën një thesar i cili është i pafund, ashtu si vetë jeta e popujve⁴⁸². Shqiptarët si popull autokton dhe më i vjetri në Ballkan kishin një traditë dhe kulturë të shumënduarshme, e cila ka ngelur deri në ditët e sotme. Lëndët e kësaj trashëgimie të lëvizshme dhe të pa lëvizshme, pos tjerash, kanë edhe vlera artistike. Shumë vlera muzeale të kulturës materiale shqiptare të periudhave më të hershme historike e deri në kohërat e reja janë ekspozate të muzeumeve të ndryshme, si botërore ashtu edhe rajonale.

⁴⁷⁴ Ibid, pp. 223,224.

⁴⁷⁵ Fejaz Drancolli, Rrënim i kullës, op cit, p. 43.

⁴⁷⁶ Milan Filipović, Prilog istoriji naših muzeja, Muzeji 8, Zagreb, 1953, pp. 126,127.

⁴⁷⁷ Vasilije Kozarac, Muzej Kosova i Metohije - rad od osnivanja do danas, Glasnik Muzeja Kosova i Metohije I, Priština, 1956, p. 9.

⁴⁷⁸ T. Morina, op cit p. 237.

⁴⁷⁹ Branislav Nušić, Kosovo, opis zemlje i naroda, II, Matica Srpska, Novi Sad, 1903, p. 19.

⁴⁸⁰ Muhamet Pirraku, Kultura Kombëtare Shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit, Prishtinë 1989, p. 258.

⁴⁸¹ Shtjefën Gjeqovi, Një argëtim arkeologjik, Zani i Shna Ndout VIII, nr 4, Shkodër 1920, p. 158.

⁴⁸² Aleks Buda, Etnografia shqiptare dhe disa probleme të saj, in Konferenca Kombëtare e Studimeve Etnografike, 28-30, VI, 1976, Tiranë 1977 p. 17.

Veprimtaritë e Muzeut të Kosovës

Lokacioni i Muzeut të Kosovës gjendet në vendin që paraqiste bërthamën-pjesën e vjetër të qytetit të Prishtinës në periudhës osmane. Mirëpo, ashtu siç pohuam më lartë, organizimi legjislativ dhe institucional i trashëgimisë kulturore, ka pasur fatin e njëjtë me trajtimin e fatit politik të Kosovës. Muzeu i Kosovës u themelua në vitin 1949. Gradualisht, me mjete modeste, u shndërrua në një muzeum të shumëllojshëm, i cili përparonte, mbliidhte materiale, kryente hulumtime, rekognoscime e gërmime arkeologjike, etj.

Ashtu si në politikë, organizimi legjislativ dhe institucional i trashëgimisë kulturore, ka pasur fatin e njëjtë me trajtimin e fatit politik të Kosovës. Dihet se që nga viti 1912 e deri në vitin 1945, i gjithë hulumtimi i monumenteve bëhej vetëm nga ekspertët serbë, të cilët, sipas përvojës së sprovuar, zbatonin detyrat e dala nga elaboratet e ndryshme për kolonizimin e Kosovës dhe me këtë edhe tjetërsimin e pasurisë kulturore monumentale.

Deri në vitin 1951, me vendim të entit të Serbisë ishin vënë nën mbrojtje 33 monumente, të gjitha të konsideruara si monumente serbe dhe të cilat ishin kryesisht të karakterit fetar. Mirëpo, kishte raste në të cilat muzeu arriti të bënte hulumtime të rëndësishme, gjithnjë duke hezituar në pohimin e të së vërtetës. Një nga vendbanimet e para parahistorike, të zbuluara në Kosovë, është lokaliteti në afërsi të Prishtinës, i cili u hulumtua në periudhën 1949-1951. Me këtë rast u zbuluan enë, vegla, plastikë etj. Pos tjerash, u gjetën edhe dy krena të idolëve monumentale si dhe një statujë e hyjnisë së ulur⁴⁸³. Me angazhim të punonjësve të muzeut, në vitin 1951 filluan hulumtimet në Novobërdë, për të vazhduar deri në vitin 1955, ndërsa më 1953 hulumtime të pjesshme në Ulpianë, te tjeritorja e Prishtinës, për të vazhduar mandej një veprimtari të gjerë hulumtuese deri në vitin 1956, kur punimet mbërritën kulmin dhe u bënë hulumtime të veçanta⁴⁸⁴.

Pos kryerjes së detyrave të rregullta, në vitin 1956 filloi të botojë edhe buletin e vet: "Buletini i Muzeut të Kosovës". Muzeu pati rol pionieri. Filloi të punojë mbi një trevë shumë të pasur, atraktive e të pa hulumtuar, e cila, prej një ambienti shumë konservator dhe ndikimesh të shumëllojshme, filloi të depërtojë shpejtë dhe të shkojë përpara drejt risive.

Në kuadër të muzeut veprojnë disa sektorë: Arkeologjik, Epigrafik, Numizmatik, Etnologjik, Historik si dhe sektori Natyral. Periudha prej vitit 1970-1980 ishte dekada më produktive e arkeologjisë së Kosovës, ndërsa faza që i parapriu okupimit të Kosovës dhe lufta që e pasoi ishte periudha më e pafavorshme për arkeologjinë kosovare⁴⁸⁵.

Trashëgimia kulturore e Kosovës i ka nismat në shtresimet e kulturave të para bujqësore të viteve 6000 p. k. (kultura e Starçevës, kultura e Vinçës), apo edhe më herët. Shumësia e idhujve me vlera të veçanta të epokës së neolitit dhe të eneolitit të hershëm, shpalojnë një botë të begatë shpirtërore të banorëve të Kosovës parahistorike

Duke jetuar në troje të pasura me minerale, banorët tonë të lashtë, shumë herët mësuan përdorimin e arit, argjendit dhe hekurit. Prej këtyre xeheve ata punuan vegla pune, armë e stoli të ndryshme. Qendra më e madhe xehetare dhe qytet me rëndësi në Dardani qe Damastioni, ku që nga shekulli IV p.e.s, preheshin monedha argjendi. Në simbolet e përdorura mbi monedha është çekani i minatorit, që dëshmon se qyteti ishte qendër e një treve të pasur me miniera argjendi⁴⁸⁶.

Perëndesha dardane, e lidhur ngushtësisht me besimin në fuqinë supreme të diellit dhe në kultin për të, u bë personifikim i këtij besimi që në fazën urbane dardane (IV – I p. k.). Kjo është vazhdimësi e koncepteve të shprehura përmes spiraleve parahistorike, të hijerores së Vlashnjës, e cila më pas trajtësohet në një kosmologji të Hyjneshës dardane të periudhës romake, të paraqitura bukur në monumentin e Smirës së Vitisë. Mozaiku polikrom i Orfeut të rrethuar me shtazë, mozaikët me shtazë

⁴⁸³ Radoslav Galović, Neolitsko naselje kod Prištine, Priština 1959, p. 37.

⁴⁸⁴ V. Kozarac, op cit pp. 13,14.

⁴⁸⁵ Edi Shukriu, Kosova Antike, Prishtinë 2004 pp. 11,12,13.

⁴⁸⁶ Jahja Drancolli, Arbërit ndërmjet perëndimit dhe lindjes gjatë mesjetës, Zagreb 2008, p. 16.

mendimtarët grekë, nga pallati në Nerodime, nekropolet e pasura të qyteteve Ulpiana, Municipiumi DD, Vendenis dhe shumë objekte tjera të zbuluara anekënd Kosovës, pasqyrojnë një jetë të lulëzuar kulturore gjatë periudhës romake⁴⁸⁷.

Veprat në fjalë dëshmojnë se edhe kjo gjini e arteve aplikative gjeti përdorim në artin e dardanëve në antikitet (dhe në mesjetë të hershme F. S.), përkatësisht në shekujt IV-VI. Këtu fjala është për artin, pikturën muzive-mozaikun, e cila u aplikua në disa ndërtime sakrale, publike dhe private të kohës në disa vendbanime të periudhës së sundimit romak në Dardani⁴⁸⁸.

Në antikën e vonë dhe në fillim të Mesjetës, Kosova, bashkë me gjithë viset përreth bie nën Perandorinë Bizantine. Kjo perandori, siç jemi në dijeni, arrin nivelin më të lartë politik dhe ekonomik nga koha e qeverisjes së perandorit me origjinë dardane, Justiniani. Nga kjo periudhë mbetën trashëgim një numër i madh objektsh, kryesisht kështjella. Vetëm në Dardani pos 8 kështjellave të rejave të ndërtuara, rindërtoi dhe vuri në përdorim edhe 61 të tjera⁴⁸⁹. Ndërsa prej monumenteve kishtarë apo bazilikave dallohen: Ulpiana, Vërmica, Harilaçi, bazilika e Shën Premtes në Prizren, ajo e Shën Florit në Lypjan etj.

Kështjellat, monumentet e krishtera dhe gjetjet sporadike të shumë monedhave, stolive dhe objekteve të tjera janë dëshmi e jetës intensive dhe e zhvillimit të kulturës materiale dhe shpirtërore gjatë periudhës bizantine⁴⁹⁰, por edhe më vonë në periudhën e pushtimeve bullgare, rasiane, osmane etj, shtojnë nevojën që kjo periudhë, jo aq e hulumtuar, ta zërë hapësirën e merituar në sfondin e trashëgimisë kulturore kosovare.

Objektet fetare ortodokse, u ngritën mbi objektet sakrale të mëparshme, u rindërtuan mbi themele të vjetra, si: Patrikana e Pejës, Kisha e Shën Prenës në Prizren dhe manastiri i Krye-engjëjve pranë qytetit, Manastiri i Deçanit, Graçanicës, Bajskës, etj.

Siç dihet nga të dhënat shkencore, kishën e Deçanit e ka ndërtuar një françeskan katolik shqiptar nga Kotorri, Vinko Kuqi, andaj po përmendim se, jo vetëm kjo kishë, por të gjitha kishat e vjetra, në kohën e sundimit turk i kanë ruajtur shqiptarët. Ato ekzistojnë të pa dëmtuara vetëm në saje të tolerancës shqiptare⁴⁹¹.

Arkitektura e vjetër qytetare zë një pozitë të veçantë në tërësinë e ndërtimeve popullore. Këto ekzemplarë paraqesin një thesar të pasur të së kaluarës së Kosovës.

Njësia themelore e komplekseve të pazareve ishte dyqani, i cili, jo rrallë, kishte punishten. Prodhimi zejtar, i cili zinte pjesën kryesore⁴⁹², përbënte muze të tërë, të mbuluar me eksponate nga lëmi i Arkeologjisë, etnografisë, etj.

Në saje të zhvillimit të mëtejshëm ekonomik të qyteteve dhe rritjes së rolit të tyre si qendra prodhimi e këmbimi, u krijuan edhe tregjet ndërkombëtare⁴⁹³. Ndërsa, sa i përket kullës, është tip origjinal dhe më i rëndësishëm i arkitekturës tradicionale shqiptare, jo vetëm në Kosovë, por në të gjitha trojet etnike shqiptare në Ballkan.

Ndikimi i rrethanave politike në veprimtaritë muzeale

Trashëgimia kulturore (e ruajtur nga koleksionistët e lartëcekur), jo vetëm që mohohet, por, në kushtet e okupimit serb të Kosovës (1912 e posaçërisht pas krijimit të Jugosllavisë së Versajës më 1919), pas fillimit të reformës agrare-kolonizuese dhe pas Luftës së Dytë botërore, tjetërsohet dhe bëhet luftë e hapur për përvetësimin e saj.

⁴⁸⁷ E. Shukriu, Kosova Antike, op cit, p. 114.

⁴⁸⁸ Fejaz Drancolli, Mosaic painting in Kosova during 4 – 6th century, in Kosova Arkeologjike 1, Prishtinë 2006, p. 120.

⁴⁸⁹ Burimet tegimtare bizantine per historine e Shqiperise, Tirane 1975, pp. 21, 22.

⁴⁹⁰ E. Shukriu, Trashëgimia, op cit, p.484.

⁴⁹¹ Mark Krasniqi, Gjurmë e Gjurmime, Prishtinë 1979, p. 129.

⁴⁹² Emin Riza-Njazi Halimi, Banesa qytetare Kosovare e shek. XVIII-XIX, Prishtinë 2006, p. 39.

⁴⁹³ Emin Riza, Qyteti dhe banesa shqiptare e mesjetës së vonë, Tiranë 1991, pp, 16,17.

Tani, është e qartë dhe ka filluar të pranohet edhe nga shkencëtarët serbë, siç është rasti me Pero Slijepceviqin, i cili shkruan: “Është vërtetuar se nga një numër i madh i shumë manastireve të vjetra serbe, vetëm një numër i vogël i tyre është themeluar nga serbët... Serbi nuk ka pasur kurrfarë tradite të veten, as në ndërtimtari, as në pikturim”⁴⁹⁴.

Kisha dhe shteti serb i kanë uzurpuar kishat e tona, duke bërë ndonjë meremetim në to, për ti shpallur pastaj monumente të kulturës së tyre. Për më tepër, historiografia pan-sllaviste serbe, për të përfituar opinionin ndërkombëtar për të drejtat serbe mbi Kosovën, bëri falsifikimin e tri fakteve historike, që i përkasin fushës së trashëgimisë:

- Kishat dhe manastiret në Kosovë,
- Beteja e Kosovës ndërmjet serbëve dhe turqve(1389), dhe gjoja
- Dyndja e madhe serbe nga Kosova, në krye me Arsenien III Černojeviq (1690)⁴⁹⁵.

“Faktet” të cilat u sajuan me kalimin e kohës, si formula e etiketimit, janë pohime krejtësisht të turpshme, se gjoja Kosova na qenka zemra, shpirti dhe djepi i serbëve. Pos tjerash, regjimi dhe disa qarqe të tjera të propagandës serbe, një kohë të gjatë trumbetonin për ekzistimin e “1300 kishave ortodokse serbe në Kosovë”. Të mos harrojmë se në Kosovë kemi pothuaj vetëm po aq fshatra dhe qytete. Sipas kësaj propagande del se në çdo fshat e qytet kemi nga një kishë ortodokse serbe⁴⁹⁶.

Nuk jemi të habitur! Ky është edhe një trillim tjetër i Qosiqëve e Cvijiqëve. Dobrica Qosiq shkruan: gënjeshtër është akt patriotik serb, ndërsa Cvijiq thotë: është fare lehtë të shtrembërosh e falsifikosh faktet duke mos e paraqitur realitetin, me qëllim përfitimi. Se me të vërtetë është kështu, edhe vetë Cvijiqi e dëshmon më së miri, duke i paraqitur serbët me shumë veti e aftësi të mëdha, të tepruara e të trilluara. Thuhet se mbretërit dhe sundimtarët serbë kanë ndërtuar kështjella e oborre mbretërore, kisha e objekte të kulturës, mirëpo në Kosovë nuk ekziston asnjë gjurmë e tillë e historisë serbe. Madje edhe gërmimet arkeologjike këtu Serbia i ka sabotuar, sepse në shumë raste janë zbuluar materiale të kulturës ilire (shqiptare), gjë që politikës serbe nuk i shkonte për shtati⁴⁹⁷.

Pra, indoktrinomi i popullit serb gjatë shekujve mbi “të drejtën historike të Serbisë në Kosovë”, bazohet në trillime dhe falsifikime të fakteve historike, të përsëritura me qindra herë në historiografinë, në etnografinë dhe në disa disiplina të tjera shkencore, si edhe në këngët popullore si në “Ciklin e Kosovës”, kështu që edhe sot në etnopsikologjinë serbe këto mashtrime mjerisht kanë legjitimitetin e të vërtetës shkencore⁴⁹⁸.

Natyrisht se realiteti objektiv është diçka krejt tjetër. Ngjarjet e bujshme historike, robëria pesëshkulllore osmane dhe regjimet e ndryshme antipopullore e vandaliste, kalitën banorët e këtyre viseve që krahas luftës për liri të bëjnë edhe një luftë; atë të ruajtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore.

Muzeale të Kosovës në Serbi dhe Maqedoni

E kaluara e Kosovës është e mbingarkuar me shfrytëzimin e trashëgimisë për nevoja politike, përkatësisht për krijimin e të drejtës false historike të serbëve mbi Kosovën. Dihet si ishte e vërteta historike për Kosovën, andaj pos përpjekjeve për mohim të vlerave, përvetësimin të tyre, bëhet plaçkitje serike e monumenteve kulturore. Grabitja e materialit filloi atëherë kur filluan edhe gërmimet e para arkeologjike. Nëse nisemi që nga monumentet më të vjetra të zbuluara, janë një varg sosh nga periudha neolitike, si p.sh, kulti Magna Mater apo Terrae Mater, të shoqërinë neolitike, mbahen nëpër muze të ndryshëm në Serbi.

⁴⁹⁴ Pero Slijepceviq, Stara srpske zadužbine, Ogledi, Beograd 1934 pp. 97,115. Mark Krasniqi, Rrënjët tona etnike, Prishtinë 2002, p. 104.

⁴⁹⁵ Skender Rizaj, Falsifikimet e historiografisë serbe, Prishtinë 2006, p. 31.

⁴⁹⁶ F. Drancolli, op cit, p. 119.

⁴⁹⁷ M. Krasniqi, Rrënjët tona etnike, op cit, pp. 49, 54.

⁴⁹⁸ M. Krasniqi, Rrënjët tona..., op cit, p. 55.

KUMTESA

Kulti i Perëndeshës së plleshmërisë te popullatat e Gadishullit Ballkanik deri tani ka qenë i njohur vetëm ndër popullatën Neolitike të Kosovës. Andaj statujëzat e famshme nga terakota që paraqesin Perëndeshën e plleshmërisë, kanë origjinën nga Mitrovica e Kosovës (Fafos) dhe datojnë rreth 4000 vjet para Krishtit.

Pos eksponateve të lartë-përmendura, për të cilat dihet me siguri se ndodhen në muze të ndryshme në Serbi (Nish, Zemun, Beograd) edhe në muzeun e Vrajës ka një numër të konsiderueshëm të eksponateve të tilla. Prej figurave antropomorfe që i përkasin epokës neolitike, përkatësisht kulturës Vinça, në Muzeun e Vrajës ndodhen 59 të tilla, ndërsa koleksioni i plotë i muzealeve të grabitura nga Kosova arrin në 130 eksponate. Ndër këto eksponate, për të cilat dihet se janë nga Kosova, ka enë kulti, vegla pune si: sëpata, dalta, thika, gurë peshoreje dhe monumente epigrafike. Ato me kohë janë inventarizuar dhe pjesa më e madhe janë marrë nga rajoni i Mitrovicës⁴⁹⁹. Një numër i konsiderueshëm i monumenteve të inventarizuara në muzeun e Vrajës, paraqesin figura antropomorfe të kokës, që po ashtu i takojnë epokës neolitike⁵⁰⁰.

Përveç monumenteve të përmendura antropomorfe, nga periudha neolitike, ka edhe figura interesante zoomorfe, disa prej të cilave i hasim në muzetë e Serbisë. Meqë jemi te muzeu i Vranjës, të potencojmë se vetëm në këtë muze ndodhen 12 figura të tilla⁵⁰¹. Mirëpo, pos këtyre monumenteve, duhet përmendur edhe Çatallin me kokën e bronzit të dërrit të egër, nga epoka parahistorike neolitike deri në ditët e sotme, që ka rol të madh në magjinë e disa fiseve dhe popujve në botë. Në këtë paraqitje, është shqyrtuar një objekt arkaik i epokës parahistorike të kohës së bronzit: dhëmbi, syri dhe koka e bronzit të dërrit të egër nga Istogu (Burimi) në anamalin e Dukagjinit që aktualisht ruhen në Zemun.

Në botën e shkencës është tashmë e njohur figura e bronzit, e quajtur “Vrapuesja e Prizrenit” (emrin e ka marrë sipas qytetit prej nga vjen dhe është e konservuar në Muzeun e Londrës). Por aty është edhe një vepër e çmuar arti, që daton nga epoka Helenike-Iliriane, me origjinë nga Prizreni, Theranda e vjetër. Objekti në fjalë është një figurinë bronzit që paraqet një cjan, në pozitë të shtrirë, i mbushur me plumb, që është një gjetje e rastësishme, me siguri nga fundi i shek. XIX, apo nga fillimi i shekullit XX. Kjo figurinë bronzit që paraqet cjanin në pozitë të shtrirë nga Theranda, është e gjatë 6.5 cm. e gjerë 3 cm. e lartë 6.5 cm dhe peshon 0.380 gr. Se çfarë tjetër është gjetur në atë rast nuk kemi njohuri. Figurinë fillimisht e ka poseduar një familje prestigjioze feudale pashallarësh turq në Prizren, ndërsa tani është në posedim të autorit të këtij punimi⁵⁰².

Në kuadrin e shantazheve të shumta që Serbia po i aplikon kundër shtetit tonë, një numër jo të vogël të tyre e zënë edhe ato që kanë të bëjnë me fushën e trashëgimisë kulturore. Njëri nga këto shantazhe që duhet përmendur me këtë rast, është moskthimi i 1247 eksponateve (676 eksponate arkeologjike dhe 571 etnologjike, eksponate që dihen dhe ishin të inventarizuar në muzeun e Kosovës), të cilat Serbia, në vitin 1998 “i mori” nga Muzeu i Kosovës, në emër të organizimit të një ekspozite në Beograd. Koleksioni në fjalë përbëhet nga eksponatet më të përzgjedhura të thesarit arkeologjik dhe etnologjik të Kosovës: eksponate të periudhës së neolitit, bronzit, hekurit, pastaj periudhës së mbretërisë dardane, periudhës ilire-arbërore si dhe eksponate të veshjeve popullore, stolive, punimeve të dorës etj, të cilat në vazhdimësi merren, pa pasur adresë të caktuar. Vlera e këtyre eksponateve është pa dyshim e madhe. Thesari arkeologjik, etnologjik dhe epigrafik është thelbi i trashëgimisë së luajtshme të Kosovës dhe rezultati i gërmimeve sistematike të Muzeut të Kosovës, që nga vitet ‘50-ta të shekullit të kaluar e deri në fund të shek. XX.

⁴⁹⁹ Aleksandar Bulatović, Nalazi Vinčanske kulture sa Fafosa i Valača, Narodni muzej u Vranje 2003, pp. 15-44.

⁵⁰⁰ Shih figurat me nr. inventari: 1842/T, 1839/T, 1844/T, 1847/T, 1843/T, 1846/T, 1850/T, 1855/T, 1870/T, 1849/T, 1853/T, 1848/T, 1859/T, 1862/T, 1854/T, 1845/T, 1838/T, 1835/T, etj.

⁵⁰¹ A. Bulatović, Nalazi Vinčanske kulture sa Fafosa i Valača, op cit, pp. 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53.

⁵⁰² Tatomir Vukanović, Bronze figurine representing the he-goat from Teranda (Prizren) of Hellenic-Illyrian epoch, in

Врањски Гласник књ. IX, Врање 1973, pp. 5, 8, 9, 19.

Qysh moti dihet se njohja e historisë së sundimit romak nuk ndriçohet aq sa duhet, pa shfrytëzimin e gjithanshëm të materialit epigrafik. Në trevën e Dardanisë, stela përbën kategorinë më të shumtë dhe më të përhapur të plastikës skulpturale gjatë kohës romake, kështu që zë vendin më të rëndësishëm në mesin e monumenteve të këtij karakteri⁵⁰³. Kjo është e kuptueshme, kur kemi parasysh faktin se pikërisht ky material na mundëson të njihemi me fenomenet juridiko-politike, kulturore dhe të kultit, të natyrës sociale dhe ekonomike të një territori përkatës. Materiali epigrafik është i rëndësishëm edhe për lingistikën.⁵⁰⁴ Na mundëson njohjen dhe shtrirjen etnike të popujve në vise të caktuara, përmes simbolikave të paraqitura në monumentet në fjalë. Mirëpo, edhe ky lloj i artefakteve nuk i mbetet dot vendit të origjinës. Shumë monumente të tilla: stelat, medaljonet, altarët, sarkofagët, reliefët, skulpturat, etj. na japin mjaft njohuri për sa i takon besimit, simbolikave të besimit, veshjeve, stolive etj.

Nga ky lloj materialit që i takon shekujve të antikitetit, edhe pse ishte me peshë më i rëndë se ai që inventarizohet në muze të Serbisë, tani printe Maqedonia, përkatësisht muzeu i Shkupit. Në këtë muze ndodhen me dhjeta stela, altarë, sarkofagë, skulptura, stoli, të cilat janë zbuluar në vise të ndryshme të Kosovës dhe mbahen padrejtësisht, duke zbehur dhe lënë boshe pjesë të rëndësishme të historisë sonë. Prej stelave të cilat ndodhen në muzeun e Shkupit, një pjesë e madhe u zbuluan në rajonet Pejë, Klinë, Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Kaçanik, etj. Prej tyre, pjesa më e madhe u plaçkit në rajonin e Pejës dhe Klinës, mirëpo një numër i konsiderueshëm ndodhet edhe në muzeun e Beogradit⁵⁰⁵. Monumentet në fjalë janë të punuara nga mermeri i bardhë dhe u takojnë periudhave të shekullit I, II, III e më vonë, janë të inventarizuar. Disa janë të dëmtuara pjesërisht e disa të tjera janë të ruajtura mirë me dëmtime të pjesshme.

Nevoja e rikthimit të fondeve dhe koleksioneve

Në periudhën e pasluftës kemi një lloj dezorientimi të përgjegjësive profesionale dhe institucionale, e cila gjë ka rezultuar me mosrespektimin e mekanizmave profesional-shkencorë në mbrojtjen e monumenteve. Forma e organizimit dhe menaxhimit në fushën e trashëgimisë lë shumë për të dëshiruar.

Ekspozati i vetëm që u kthye në vitin 2002, me ndërmjetësimin e ish administratorit të Kosovës Michael Steiner, është "Hyjnesha në fron". Edhe përkundër kërkesave, fushatave dhe kontakteve të herëpashershme të zyrtarëve kosovarë e ndërkombëtarë me ata serbë, deri më sot koleksioni në fjalë nuk u kthye në Kosovë, në nën-qiellin ku u krijua dhe ku e ka vendin. Se kur do të ndodhë kjo, këtë nuk mund ta thotë askush, edhe përkundër faktit se në disa dokumente të pranuar ndërkombëtarisht, siç është "Pakoja e Ahtisarit", obligohet Beogradi, me një nen të posaçëm, që brenda 120 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij dokumenti, t'i kthejë pronarit të ligjshëm të origjinës – Muzeut të Kosovës, 1247 ekspozatat e "huazuara".

Përveç këtij dokumenti edhe dokumente të tjera, të ratifikuara nga shtete anëtare të organizmave ndërkombëtar, siç është e Drejta Ndërkombëtare lidhur me Kthimin e Trashëgimisë Kulturore në rast konflikti të armatosur, pastaj Konventa Ndërkombëtare për Trashëgiminë Kulturore etj., i sqarojnë mjaft mirë problemet e kësaj natyre, por ç'është kur Serbia nuk ia varë veshin fare këtyre argumenteve, po edhe më tej vazhdon lojën e saj me ekspozatat tona.

Recenzentë:
Mr.sc. Pajazit Hajzeri
Mr. Qazim Namani

⁵⁰³ Exhlale Dobruna-Salihu, *Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës Romake-Sepulkrale dhe e kultit 1*, Prishtinë 2003, p. 74.

⁵⁰⁴ Zef Mirdita, *Antroponomia e Dardanisë në kohën romake*, Prishtinë 1981, pp. 11, 12.

⁵⁰⁵ Exhlale Dobruna-Salihu, *Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës Romake-Sepulkrale dhe e kultit 2*, Prishtinë 2005, pp. 704, 705, 707, 709, 711, 717, 749, 768, 769, 770, 771, 784, 823, 825-833.

Prof. dr. Izber HOTI: KRITIKA E MIRËFILLTË HISTORIKE

Kritika historike është e domosdoshme për përparimin e historisë si shkencë. Pasi ajo deri më tash nuk plotëson kriteret e domosdoshme që të jetë e mirëfilltë është e nevojshme që në vija të shkurtra të kujtojmë se çka në të vërtetë mbështetet kritika e mirëfilltë.

Në literaturën historike shqiptare jo vetëm që mungon kritika që përparon dhe thëllon shkencën e historisë, por mungojnë edhe kontributet rreth kësaj çështjeje.

Kritika e mirëfilltë historike, bile në këtë kohë, duhet të ketë parasysh një varg kriteresh në të cilat do të duhej të mbështetej.

Lënda e trajtuar në qendër vëmendjeje

Çështja e parë e cila do të duhej të merrej parasysh me rastin e shkrimit të një kritike historike është lënda që trajtohet dhe vështirësitë, format dhe mënyrat që lindin dhe shfrytëzohen gjatë trajtimit të saj. Pasi rezultati hulumtues është ai që synon çdo studiues, duhet që edhe kjo çështje të shqyrtohet dhe të vlerësohet me një objektivitet të pakontestueshëm. Që kjo të arrihet kritiku duhet kujtuar dhe duhet mbështetur në të arriturat e fushës përkatëse të historiografisë.

Në kuadër të shqyrtimit të lëndës së trajtuar nga studiuesi kritiku do të duhej të kishte parasysh mënyrën e qasjes së autorit ndaj temës së zgjedhur, por edhe shkasit dhe shkakun përse autori është përcaktuar mu për këtë temë. Në këtë frymë, natyrisht, do të duhej të hetoheshin dhe të theksoheshin edhe synimet afatgjata dhe afatshkurta të studimit, si edhe roli aktual i kësaj ndërmarrjeje. Edhe me këtë rast kritiku nuk duhet harruar që të japë mendimin e vet për rezultatet dhe lëshimet e studimit, ndërsa sipas mundësisë ai duhet të paraqes edhe sugjerimet, lëshimet, vërejtjet e ndryshme, madje edhe këshillat për ndonjë ribotim eventual të studimit.

Njohja me autorin dhe veprën e tij

Pasi shpeshherë dhe shumë studiues të së kaluarës *shkruajnë për të nesërmen* këtë duhet ta ketë parasysh gjithherë kritiku dhe për këtë duhet të njoftojë edhe lexuesin e studimeve historike. Me këtë rast kritiku nuk do të duhej anashkaluar edhe të dhënë se kujt ia dedikon studimin dhe punën e tij. Natyrisht, nëse kritiku ka të dhëna për jetën dhe veprimtarinë e autorit do të duhej që lexuesin ta informojë edhe për këtë, duke përfshirë këtu përgatitjen profesionale dhe prirjet e angazhimit e tij, veçanërisht në studimin e së kaluarës. Lidhur me këtë kritiku do të shkruajë edhe për stilin e autorit, pse jo edhe për formën dhe mënyrën e paraqitjes së kontributit të studiuesit. Ai do të duhej që këtu të përfshijë edhe format e ndryshme të studimit që ndihmojnë lexuesin, siç janë indeksi i emrave të njerëzve dhe të vendeve dhe indeksi lëndor, grafikët, hartat, skemat e llojllojshme apo CD-të, si dhe format e tjera të përfshira në studimin apo veprën në shqyrtim.

Njohuritë e domosdoshme të kritikut

Që një kritikë e një studimi historik të marrë konturat e nevojshme dhe t'i përgjigjet këtij togfjalëshi në kuptimin e plotë të fjalës kritiku duhet të ketë njohuri historike dhe të dijë se si

studiuesi përzgjedhi dokumentet arkivale dhe dokumentet e tjera dhe si i shfrytëzoi ato, ndërsa që kritika të plotësohet edhe më shumë kritiku do të duhej të dinte edhe çështjen e krahasimit të dokumenteve dhe mënyrën e këtij krahasimi. Gjatë këtyre vlerësimeve kritiku do të duhej të veçonte risitë e përdorura apo të arritura të autorit, si dhe të bëjë vlerësime për pohimet dhe qëndrimet e arritura të kontributit dhe veprës në shqyrtim. Duke vepruar kështu kritiku do paraqes edhe mbështetjet e tjera të autorit dhe të llojeve të mbështetjes. Që kjo të bëhet si duhet kritiku i studimeve historike duhet të dijë bile përafërsisht diakroninë dhe sinkroninë e çështjeve që trajtohen dhe këtë ta paraqes me akribi para lexuesve, duke përfshirë këtu dallimet që ka bërë autori në kohë dhe hapësirë gjatë studimit të tij.

Veçoritë e kritikës

Kritika e mirë historike duhet të shquhet me gjuhën dhe stilin e vet, i cili është sa letrar aq edhe shkencor, pra do të duhej të ishte një lloj eseje shkencore. Po kjo do të duhej të hetohej dhe t'i paraqitej edhe lexuesve për trajtimin që ka përpara, sikurse që do të duhej vënë haptazi në shënjestër edhe sinjeriteti i autorit, synimet e tij (nëse ka edhe propaganduese e kundër propaganduese).

Po kështu, me rastin e shqyrtimit të veprës apo studimit të historianit kritiku në vështrimin dhe qasjen e tij do të duhej të përfshinte edhe veshjen apo zhveshjen e autorit me interesa dhe manipulime të ndryshme të drejtpërdrejta apo të tërthorta. Në këtë punim nuk do të duhej të anashkalohehin as marrëdhëniet në mes të së përgjithshmes dhe të së veçantës, si dhe përputhja dhe shpërputhja e tyre në kontributin në trajtim, bashkë me të dhënë se sa ai ndikon në arritjet shkencore historike.

Kritere të përgjithshme e të pakapërcyeshme

Më në fund, që të sendërtohet një kritikë e shquar historike të gjitha këto kërkesa e kritere do të duhej të gërshetoheshin dhe ndërlihdeshin, por duke pasur parasysh edhe kërkesat dhe kriteret e përgjithshme për një kritikë të mirë historike, dhe jo vetëm historike.

Në kuadër të kërkesave të përgjithshme që duhet shoqëruar përherë kritikën pa dyshim janë paanshmëria dhe objektiviteti i kritikut, si dhe zhveshja e tij nga interesat subjektive (farefisnore, rajonale, ideologjike, fetare, njëmendore etj.).

Kritika historike duhet të jetë ndihmesë e sigurtë e historianëve dhe e studiuesve të tjerë të së kaluarës dhe të shoqërisë dhe jo shqim i kritikuesit. Vetëm në këtë mënyrë nëpërmjet kritikës historike do të sendërtohej interesi i përgjithshëm shkencor e shoqëror dhe përparimi i mëtejshëm i historisë si shkencë. Veç kësaj, kritiku i studimeve dhe i veprave historike do të duhej të braktiste subjektivizmin e mendimeve dhe të qëndrimeve të tij si dhe do të duhej që nëpërmjet kritikës të mos krijojë rrethana polemizuese, si formë më e rreptë e kritikës.

Kritiku, para së gjithash, nuk guxon t'i lejojë vetes të nënçmojë mundin dhe punën e të tjerëve, por jo edhe të "gëlltit" qëndrime dhe veprime që nuk shpien përpara shkencën e historisë dhe e njollosin historinë në përgjithësi. Nuk duhet harruar edhe faktin se nëse kritiku nuk di më shumë se autori, duhet bile të di sa ai, apo të jetë në një shkallë me të. Ndoshta këtu qëndron e dhëna se në historiografinë shqiptare mungon kritika dhe zhvillimi i saj, pa të cilën vështirë mund të pohohet se kemi shkencë të duhur të historisë dhe të historiografisë.

Recenzentë:
Prof.dr. Sabile Keçmezi-Basha
Prof.dr. Haki Kasumi

KUMTESA

SHKENCAT E EDUKIMIT

KUMTESA

Ma.sc. Bekim SAMADRAXHA, Mr.sc. Fehmi KRASNIQI: ECURI E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Përmbajtja

Vrojtimi në aspektin historik i Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës identifikohet me Universitetin e Prishtinës. Ky Universitet gjatë viteve të zhvillimit të tij, përveç vështirësive dhe periudhave jo të mira, ka njohur edhe rezultate dhe suksese të pakontestueshme në drejtim të avancimit të arsimit të lartë, duke e pajisur jetën akademike pothuajse me të gjitha drejtimet e studimeve, të cilat kanë bërë që Universiteti ynë të jetë shumë i respektuar në rajon dhe më gjerë. Nga vatra e tij kanë dalë shumë personalitete të shquara të jetës akademike e intelektuale, humaniste e shkencore, politike e ushtarake.⁵⁰⁶ Gjatë rrugëtimit të periudhës dyzet e dy vjeçare (42 vjeçare) pa dyshim se ky institucion i shenjët ka pasur pengesa dhe sfida të cilat e shoqëruan gjatë rrugëtimit dhe zhvillimit të tij. Fillimisht Universiteti i Prishtinës ka pasur katër fakultete, ndërsa tashë ky institucion i Arsimit të Lartë ka 17 fakultete. Viti 2012 e gjenë Kosovën me 3 Universitete Publike (Universiteti i Prishtinës, Prizrenit dhe i Mitrovicës), 1 Universitet Privat-Universiteti Amerikan i Kosovës, 15 Kolegje, 2 institute dhe 4 Shkolla të Larta Profesionale.

1. Arsimi lartë në Kosovë

Institucioni i parë i arsimit të lartë në Kosovë ishte:

❖ **Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë (1958), me programet:**

- Gjuhë dhe Letërsi Shqipe,
- Gjuhë dhe Letërsi Serbokrate,
- Biologji – Kimi.
- Fizik,
- Matematikë, dhe
- Bat.

Në vitin e parë akademik 1958-1959, u regjistruan 93 studentë të rregullt, dhe 55 me korrespondencë⁵⁰⁷, në të gjitha programet e asaj kohe.

⁵⁰⁶ Prof. dr. Mujë Rugova, rektor i UP-së, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë-webf.

⁵⁰⁷ Universiteti i Prishtinës, Botim i vaçant, Prishtinë, 2005, fq. 12.

1.1. Universitetet Publike,

Në Republikën e Kosovës, funksionojnë tri Universitete Publike, të cilat janë:

- ❖ Universiteti i Prishtinës,
- ❖ Universiteti i Prizrenit,
- ❖ Universiteti i Mitrovicës.

- ❖ Universiteti i Prishtinës

Universiteti i Prishtinës e themeloi Kuvendi i KSA të Kosovës, i cili, më 18 Nëntor 1969, nxorri Ligjin mbi themelimin e Universitetit të Prishtinës. Universiteti i Prishtinës “ burimisht “ është themeluar për të studijuar studentët shqiptarë në gjuhën e tyre amtare (shqipe).

Tabela nr. 1. Lëvizja e numërit të studentëve në Universitetin e Prishtinës nga viti 1969-‘70 deri në vitin 1990-‘91⁵⁰⁸

| Viti akademik | Numri i studentëve të rregullt | Numri i studentëve me korrespondencë | Numri i studentëve gjithësejt |
|---------------|--------------------------------|--------------------------------------|-------------------------------|
| 1969-70 | 1792 | 721 | 2513 |
| 1970-71 | 2735 | 1162 | 3837 |
| 1971-72 | 3380 | 1475 | 4855 |
| 1972-73 | 4138 | 1386 | 5524 |
| 1973-74 | 5611 | 2025 | 7636 |
| 1974-75 | 6663 | 2753 | 9416 |
| 1975-76 | 7749 | 2932 | 10681 |
| 1976-77 | 8181 | 3702 | 11883 |
| 1977-78 | 9843 | 3062 | 12905 |
| 1978-79 | 14638 | 4645 | 19283 |
| 1979-80 | 12014 | 5510 | 17524 |
| 1980-81 | 14905 | 8237 | 23142 |
| 1981-82 | 12137 | 8893 | 21030 |
| 1982-83 | 10879 | 9691 | 20570 |
| 1983-84 | 9307 | 9889 | 19196 |
| 1984-85 | 8820 | 9694 | 18514 |
| 1985-86 | 7490 | 10140 | 17630 |
| 1986-87 | 7156 | 9861 | 17017 |
| 1987-88 | 6618 | 8586 | 15204 |
| 1988-89 | 5105 | 5665 | 10770 |
| 1989-90 | 4528 | 4131 | 8659 |
| 1990-91 | 5920 | 4121 | 10041 |

Tabela nr. 2. Lëvizja e numërit të studentëve në Universitetin e Prishtinës nga viti 1991-‘92 deri në vitin 2010-‘11⁵⁰⁹

| Viti | Numri i studentëve të | Numri i studentëve me | Numri i studentëve |
|------|-----------------------|-----------------------|--------------------|
|------|-----------------------|-----------------------|--------------------|

⁵⁰⁸ Universiteti i Prishtinës, Botim i vaçant, Prishtinë, 2005, fq. 110.

⁵⁰⁹ Universiteti i Prishtinës, Botim i vaçant, Prishtinë, 2005, fq. 122.

KONFERENCA VJETORE E SHKENCËS 'JAVA E SHKENCËS 2012

| akademik | rregullt | korrespondencë | gjithsejt |
|----------|----------|----------------|-----------|
| 1991-92 | 15826 | 3796 | 19622 |
| 1992-93 | 11867 | 3812 | 15679 |
| 1993-94 | 8481 | 3612 | 12093 |
| 1994-95 | 7769 | 3763 | 11532 |
| 1995-96 | 9231 | 4574 | 13805 |
| 1996-97 | 10880 | 5495 | 16375 |
| 1997-98 | 10813 | 5902 | 16715 |
| 1998-99 | 9987 | 5037 | 15024 |
| 1999-00 | 14225 | 7833 | 22058 |
| 2000-01 | 14596 | 5681 | 20277 |
| 2001-02 | 16664 | 4534 | 21198 |
| 2002-03 | 20755 | 2420 | 23175 |
| 2003-04 | 24466 | 2324 | 26790 |
| 2004-05 | 24862 | 3706 | 28532 |
| 2005-06 | - | - | - |
| 2006-07 | - | - | 27274 |
| 2007-08 | - | - | 28757 |
| 2008-09 | - | - | 29051 |
| 2009-10 | 24116 | 3837 | 28092 |
| 2010-11 | 31080 | 3235 | 34315 |
| 2011-12 | 32137 | 3498 | 52166 |

Numri i studentëve që përsëritën vitin akademik ne vitin 2010- 2011 ishte 9815,nga numri i përgjithshëm 8918 ishin studentë të gjinisë mashkullore që përsëritën, kurse 897 studente që përsëriten vitin ishin të gjinisë femrore.

Numri i studentëve që diplomuan në vitin 2009- 2010 në nivelin master dhe magjistrature ishte: 4796 të diplomuar në nivelin master , nga ky numër student të rregull ishin 4415, kurse me korospondencë ishin 381.⁵¹⁰

❖ Universiteti i Prizrenit,

Universiteti i Prizrenit është universiteti i dytë publik në Kosovë, i cilësuar si universitet ndërkombëtar që do pranoj studentë perveç nga Kosova edhe nga vendet e rajonit. Qeveria e Kosovës, më datë: 09.10.2009, nr. 01/87, mori vendim për themelimin e Universitetit të Prizrenit. Universiteti i Prizreni. Në tabelen në vijim do të paraqesim numrin e studentëve sipas programeve dhe viteve akademike.

Tabela nr. 3 Numri i studentëve në Universitetin e Prizrenit⁵¹¹

| Numri i Rendit: | Drejtimi: | Të pranuar 2010: | Të pranuar af.I dhe II 2011: | Të shpallura af.plotësues (III): | Gjithsej : student ë |
|-----------------|-------------------------|------------------|------------------------------|----------------------------------|----------------------|
| 1 | Administrim biznesi | 395 | 237 | 20 | 652 |
| 2 | Menaxhment ndërkombëtar | 250 | 173 | 20 | 443 |

⁵¹⁰ Administrata Qendrore e Universitetit të Prishtinës, 2009- 2010

⁵¹¹ Universiteti i Prizrenit- Administrata e UPz, 2012.

KUMTESA

| | | | | | |
|----|---------------------------------|--------------|--------------|------------|--------------|
| 3 | Juridik | 295 | 165 | 20 | 480 |
| 4 | TIT | 238 | 149 | 41 | 428 |
| 5 | Software Design | 141 | 99 | 91 | 331 |
| 6 | Gjuhë Gjermane | 171 | 57 | 10 | 238 |
| 7 | FU/Gjuhë shqipe | 0 | 51 | 10 | 61 |
| 8 | FU/Programi fillor | 0 | 89 | 20 | 109 |
| 9 | FU/Gjuhë angleze | 0 | 52 | 10 | 62 |
| 10 | FU/Prog.parashkollor | 0 | 87 | 20 | 107 |
| 11 | FU/Kimi-Fizikë | 0 | 34 | 16 | 50 |
| 12 | FU/Matem.-Informatikë | 0 | 33 | 17 | 50 |
| 13 | FU/Matem.-Inform./boshnj. | 0 | 28 | 5 | 33 |
| 14 | FU/Gjuhë boshnjake | 0 | 30 | 5 | 35 |
| 15 | FU/Parashkollor/turq. | 0 | 30 | 5 | 35 |
| 16 | FU/Matem.- Informatikë/turq. | 0 | 25 | 5 | 30 |
| | Gjithsej: | 1.490 | 1.339 | 315 | 3.144 |

Kurse numri i studentëve të regjistruar në afatin e parë 2011/2012 në UPZ është **1280** studentë, ku pritet të rritet numri në afatin e dytë për **190** për shkakë interesimit të madhë të studentëve.

Kështu që numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar ne UPz në vitin akademik 2011-2012 është 630 studentë të rinjë dhe 5480 studentë komplet.

❖ Universiteti i Mitrovicës (Pjesa Veriore)

Themelimi i Univerzitetit të Mitrovicës është përkrahur nga UNMIK, dhe roli i UNMIK e veqanerisht kontributet personale të stafit të tij meritojne te pranohen qe nga fillimi. Profesor Michael Daxner, ish Administrator Nderkombetar pergjegjes per Arsimin e Lartë dhe Bashkëdrejtues i Departamentit të Arsimit punoi palodhshem dhe me nje diplomaci te jashtezakonshme prej 2000 – 2002 te krijojë Universitetin e Mitrovicë si nje furnizues vital te arsimit te larte i cili nuk do te jete vend perqendrimi per ballafaqime politike.

Pa perpjekjet e medha, per perkujdesje per angazhim nderkombetar dhe inkurajim per reforma evropiane, progresi, qe eshte bere ne sigurimin e te drejtes per arsimim per te gjithë qytetaret e Kosoves, nuk do te ishte i mundur. Ideja per perfshirjen e Asociacionit te Universiteteve Evropiane ne kete proces gjithashtu erdhi nga Profesor Daxner, prandaj nuk është e tepert te thuhet se pa te ky raport nuk do te ishte i mundur. Pakoja e Ahtisaarit parasheh që ky universitet të jetë autonom, por statuti i tij të jetë konform legjislacionit qendror kosovar. Universiteti i Mitrovicës vepron në përputhje me legjislacionin dhe plan-programet e Qeverisë serbe. Gjasat që universiteti serb në Mitrovicë të integrohet në sistemin e arsimit kosovar, duken të vogla, por Qeveria e Kosovës shpreson që kjo të ndodhë viteve të ardhshëm akademik.⁵¹² Numri I studentëve në këtë Universitet llogaritet të jetë rreth 5000 studentë në disa programe.

⁵¹² www.forumishqiptar.com/showthread.php?

1.2. Universiteti Privat,

❖ Universiteti Amerikan në Kosovë - AUK,

Universiteti Amerikan në Kosovë, i njohur zakonisht nga inicialet AUK tij, është i vetmi jo-fitimprurëse universitet privat në Kosovë. I gjithë procesi mësimor janë në anglisht, dhe të gjithë studentët janë të regjistruar në programet shkallë në Rochester Institute of Technology (RIT), i të cilit është Associate, diplomë ose gradë Master janë të fituara nga studentët e AUK. Të gjitha kurset AUK përdorin syllabi RIT-së dhe të zbatojë mësimet e njejta dhe standardet e provimit si në Rochester, edhe pse tarifat në AUK janë afërsisht një e katërta niveli i atyre për nxënësit që ndjekin në Rochester.

Në janar të vitit 2008, AUK kishte 425 studentë dhe 25 studentë pasuniversitare. AUK gjithashtu vepron një ndarje që ofron jo-shkallë kurse, përgatitjen dhe ngritjen Institutin TDI). TDI ofron një gamë të kurseve për certifikata ndërkombëtarisht të njohura në teknologji informative, menaxhim biznesi, dhe gjuha angleze.⁵¹³

❖ Kolegjet,

Sipas zyrës për Arsimit privat në MASHT, vitin 2012, numri i Bartësve Privat të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës është 14 Kolegje, 3 Institute, 4 Shkolla të Larta Profesionale.

15 BPrAL – KOLEGJE:

1. BPrAL Kolgeji AAB-Riinvest
2. BPrAL Kolegji FAMA
3. BPrAL Kolegji Iliria
4. BPrAL Kolegji UBT
5. BPrAL Kolegji Pjetër Budi
6. BPrAL Kolegji Dukagjini
7. BPrAL Kolegji Dardania
8. BPrAL Kolegji Victory
9. BPrAL Kolegji Universum
10. BPrAL Kolegji Biznesi
11. BPrAL Kolegji Globus
12. BPrAL Kolegji Gjilani
13. BPrAL Kolegji ISPE
14. BPrAL Kolegji Universi
15. BPrAL Kolegji Humanistica

2 BPrAL – INSTITUTE:

16. BPrAL Instituti ESLG
17. BPrAL Instituti Juridica

4 BPrAL – SHLP:

18. BPrAL SHLPA Evolucion
19. BPrAL SHLT Design Factory
20. BPrAL SHLP Tempulli
21. BPrAL SHLP QEAP Heimerer

⁵¹³ www.aukonline.org

KUMTESA

Qeveria e Kosovës është e përkushtuar që të zhvillojë politika gjithëpërfshirëse dhe të sigurojë një mjedis të përshtatshëm që promovon qasje të shtuar në arsimin e lartë për të realizuar përfshirjen e 35 % të grupmoshës përkatëse (prej 18 deri 24 vjeç) në arsimin e lartë deri në vitin 2015. Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në arsimin e lartë është rritur dukshëm për të arritur pothuajse dyfishin (rreth 18,000 në vitin 2009) krahasuar me numrin e studentëve në vitin 2008 (8,000).

Megjithatë, rritja e regjistrimit kërkon masa përcjellëse për të ruajtur dhe përmirësuar cilësinë e arsimit. Numri i studentëve që nga komunitetet është rritur sikurse edhe numri i vendeve të rezervuara për shqiptarët jashtë kufijve administrativë të Republikës së Kosovës. Një sfidë mbetet sigurimi i mundësive për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe me nevoja të veçanta arsimore për t'u kyçur në studime të arsimit të lartë.⁵¹⁴

Tabela nr. 4. Numri i studentëve në Arsimin e Lartë

| Viti akademik | Universitetet Publike- UP, UPz | Universiteti i Mitrovicës | Universiteti Privat | Kolegjet | Shkollat e larta profesionale | Numri i përgjithshëm i studentëve |
|---------------|--------------------------------|-------------------------------|-----------------------------|--------------------------------|-------------------------------|-----------------------------------|
| 2011-2012 | 52.166 ⁵¹⁵ studentë | 5.000 ⁵¹⁶ studentë | 425 ⁵¹⁷ studentë | 28.931 ⁵¹⁸ studentë | 1.069 ⁵¹⁹ studentë | 87.591 studentë |

Nesë e komentojme tabelë e më lartë atëherë konstatojmë se Universitetet Publike në Kosovë dominojnë me 56.7%, Universiteti i Mitrovicës (Pjesa Veriore) me 6.1%, AUK me 0.52%, Kolegjet Private me 35.3%, dhe SHLP me 1.3%. Po ta shiqojmë në retrospektivën e përgjithshme të popullsisë së Kosovës do të kemi disa të dhëna mjaftë premtuese për të ardhmen, sepse sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 Republika e Kosovës ka 1.733.872 banorë, kurse përqindjes e popullsisë në total e përfshirë në arsimin e lartë në vitin 2012 është 4.73%. Ndërsa për grup moshat e popullsisë 15-64 vjeçar (61% e popullsisë së Kosovës është në këto grup moshë) ose 8.18% e totalit të popullsisë janë të përfshirë në arsimin e lartë në vitin 2012.

Tabela nr. 5. Numri i të diplomuarëve sipas drejtimeve

Tabela nr. 3. Numri i studentëve që diplomuan në Universitetin e Prishtinës, prej vitit 1969-1970 deri në vitin akademik 2003-2004⁵²⁰

| Nr. | Fakulteti-SHL | Numri i studentëve të diplomuar sipas njësive akademike |
|-----|---------------------------------|---|
| O1 | Filozofik | 5106 |
| O2 | i Shkencave Matematike-Natyrore | 2743 |
| O3 | Filologjik | 2430 |
| O4 | Juridik | 5873 |
| O5 | Ekonomik | 5785 |

⁵¹⁴ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016.

⁵¹⁵ Statistika e studentëve për vitin akademik 2011-2012 për UP, UPz,

⁵¹⁶ Vlerësim.

⁵¹⁷ www.aukonline.org.

⁵¹⁸ Zyra e Arsimit Privat në MASHT, Statistikat sipas librave amë në vitin 2012.

⁵¹⁹ Po aty

⁵²⁰ Universiteti i Prishtinës, Botim i vaçant, Prishtinë, 2005, fq. 136.

KONFERENCA VJETORE E SHKENCËS 'JAVA E SHKENCËS 2012


| | | |
|-----------|---|-------|
| O6 | I Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës | 815 |
| O7 | i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike | 881 |
| O8 | i Inxhinierisë Mekanike | 583 |
| O9 | i Mjekësisë | 3511 |
| 10 | i Arteve | 750 |
| 11 | i Bujqësisë | 1187 |
| 12 | i Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë | 1115 |
| 13 | i Shkencave Sportive | 607 |
| 14 | i Edukimit (SHLP) | 13839 |
| 15 | Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në Biznes në Pejë- (SHLE) | 2682 |
| 16 | Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara në Mitrovicë – (SHLT) | 1350 |
| 17 | Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara në Ferizaj- SHLT | 970 |
| | GJITHSEJ | 50227 |

Universiteti i Prishtinës nga viti i parë akademik i themelimit të 1969- '70, deri në vitin 2003- '04, nxori 50227 eksperte te fusha perkatëse. Fakulteti i cili ka nxerrur numrin me te madhe te eksperteve në periudhën e cekur me lartë është:

- Fakulteti i Edukimit (SHLP) me 13839 ekspert të fushave arsimore,
- Fakulteti Juridik, ka nxjerrur 5873 ekspert të fushave juridike.
- Fakulteti ekonomik, ka nxjerrur 5785 ekspert të fushave ekonomike, etj.

Grafikoni nr. 1. Numri i të diplomuarëve sipas fakulteteve në vitin akademik 2004

KUMTESA



Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Departamenti i Arsimit të Lartë, me datën, 28, 29, 30. 03. 2012, ka organizuar puntorin tri ditore në lidhje me Rishikim e përbashkët vjetor, duke e u mbështetur në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë, PSAK, 2011-2016. Në vijim do të paraqesim në tri prioritetet sipas grupit të eksperteve për fushën e Arsimit Lartë (AL).

Prioriteti në AL sipas këtij grupi janë:

- Krijimi i një Sistemi për menaxhimin e informacionit të arsimit të lartë (SMIAL)
- Buxheti të rritet dhe efikasiteti të përmirësohet në ekzekutimin e buxhetit në harmoni me ligjin e ri të arsimit të lartë,
- Programet e studimit në harmoni me nevojat e tregut të punës.

Burimet e shfrytëzuara

1. Ministria e Arsimit , Shkencës dhe Teknologjisë, Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011- 2016.
2. Universiteti i Prishtinës, Botim i vaçant, Prishtinë, 2005.
3. Statistika e studentëve për vitit akademik 2011-2012 për UP, UPz.
4. Zyra e Arsimit Privat në MASHT, Statistikat sipas librave amë në vitit 2012.
5. www.forumishqiptar.com/showthread.php?
6. Administrata Qendrore e Universitetit të Prishtinës, 2009- 2010.
7. www.aukonline.org

PERFORMANCE HIGHER EDUCATION IN THE REPUBLIC OF KOSOVO

Ma.sc. Bekim Samadraxha, Mr.sc. Fehmi Krasniqi

Abstract

Observing the history of Higher Education in the Republic of Kosovo is identified with the University of Pristina. This University during its development except difficulties and bad periods has also recognized the indisputable results and successes towards the advancement of higher education, providing academic life with almost all aspects of the study, which has made our University to be highly respected in the region and beyond. From his spot came out many distinguished personalities of academic and intellectual life, humanistic and scientific, political and military. During the journey of forty two years absolutely this sacred institution saw the barriers and challenges that associate during its itinerary and development. Initially Pristina University had four faculties, and now this institution has 17 faculties. The year 2012 finds Kosovo with 3 Public Universities (University of Pristina, Prizren and Mitrovica), a private university-American University of Kosova, 16 Colleges and 4 Vocational High School.

Title (Font Times New Roman, Size 12 pt, Bold Block Letters, line space 1)

Authors (Font Times New Roman, Size 11 pt, line space 1)

The name of the presenting author should be in Bold.

Authors Affiliation (Font Times New Roman, Size 11 pt, line space 1)

Body text (Aim of study, Results, Conclusions)

(Font Times New Roman, Size 12 pt, not more 300 words, line space 1)

KUMTESA

Msc. Majlinda HALA¹: TRASHËGIMIA MUZIKORE, PJESE E EDUKIMIT NË KURRIKULAT SHKOLLORE E DOMOSDOSHËMRI PËR RUAJTJEN DHE TRANSMETIMIN E VLERAVE KOMBËTARE

(¹)Specialiste e kurrikulës së arteve
Instituti i Zhvillimit të Arsimit
Tiranë, Shqipëri

Hyrje

Krijimtaria popullore në përgjithësi përfshin trashëgiminë shpirtërore dhe krijimtarinë artistike tradicionale shpirtërore të një komuniteti, e cila përmes vlerave që transmetohen gojarisht ose me mjete të tjera, në thelb pasqyrojnë kulturën dhe identitetin e tyre. Vlerat e trashëgimisë shpirtërore krijohen në lidhje të ngushtë me trashëgiminë materiale dhe atë etnografike të banorëve, në unitet të pandashëm me peizashin dhe mjedisin gjeografik që i rrethon ata. Për këtë arsye trashëgimia shpirtërore shndërrohet në zëdhënësën e spikatur të identitetit kulturor të popujve përmes: *gjuhës së folur, folklorit gojor, i shkruar, i regjistruar, vokal, koreografik dhe instrumental, muzikës tradicionale, valleve, kostumeve, veglave muzikore popullore, zakoneve dhe dokeve tradicionale të jetesës, zejeve tradicionale të punës, etj.*

Këngët, lojërat dhe veglat muzikore për fëmijë, të cilat janë edhe objekt i këtij materiali, janë pjesë e pandashme e zhvillimit kulturor, e cila i shoqëron ata në familje dhe më gjerë. Ky material kërkon të prekë dhe njohë sadopak, *çfarë bën pjesë në krijimtarinë popullore për fëmijë, klasifikimet dhe llojet, si kanë ardhur ato deri në ditët tona, mënyrat e transmetimit të tyre të para këto rrafshin historik, gjeografik, gjuhësor, ndërtimor etj.*

Së pari, ky material evidenton dhe thekson rëndësinë e muzikës shqiptare dhe ruajtjes e transmetimit të saj nëpërmjet këngëve dhe lojërave muzikore për fëmijë.

Së dyti, muzika është një mjet i fuqishëm që fëmijët të lidhen me origjinën, me rrënjët e tyre. Një një ninullë apo këngë popullore për fëmijë, e njeh fëmijën me trashëgiminë kulturore të familjes dhe vendit të vet, ku lidhja me rrënjët është një tjetër mjet tjetër për t'u krijuar fëmijëve një mjedis të pasur që nxit zhvillimin social, emocional dhe intelektual tek ata.

Së treti, edukimi përmes muzikës popullore për fëmijë kërkon të formojë, të zhvillojë, vlerat e trashëgimisë tonë kulturore kombëtare *sa* dhe *si* duhet në breza e rinj dhe të ruajë e të transmetojë këtë krijimtari popullore për fëmijë.

Së katërti, edukimi i drejtë i vlerave të krijimtarisë popullore për fëmijë në përgjithësi dhe asaj muzikore në veçanti, duhet bërë edhe përmes kurrikulës shkollore, si domosdoshmëri për ruajtjen dhe transmetimin e këtyre vlerave.

Sigurisht këndimi i këngës fillon të mëtohet që me ninullat e kënduara në djep tek fëmijët nga nënat e tyre. **Këngët e djepit apo nina – nanat** (D.Shala, H. Kajtazi, F.Shkodra, M.Halimi)¹, janë vlera letrare gojore të krijuara, jo prej rastit në rast por të krijuara nga nënat, të cilat shprehin dashurinë e tyre foshnjeve që me shtatet e tyre kanë mbushur djepat dhe dëshirojnë rritjen e tyre. Ato janë këngë popullore me një zë që u këndohen fëmijëve deri në moshën 1-vjeçare, në përgjithësi, janë këngë të shkurtra, me të cilat nëna vë në gumë fëmijën. Këngë e djepit i gjejmë të kënduara vetëm nga gratë, kryesisht nga nënat dhe gjyshet. Ndërtohen me një ambitus brenda oktavës, në ritme dy ose tre pjesuese dhe përgjithësisht në monodi. Në shqiptarët e Maqedonisë njihen edhe me emrin “luli lulat”², por në përgjithësi njihen me emrin *ninulla*.

Larmia e organizimeve melodike dhe ritmike të krijimeve popullore në përgjithësi, dhe këngëve në veçanti i gjejmë edhe tek këngët për fëmijë apo ninullat. Kështu kemi:

Roli i ninullave, është tepër i madh, qoftë për fëmijën që dëgjon dhe rritet me gjuhën e nënës, por edhe për vlerën e madhe që ato kanë, pasi kjo këngë mësohet dhe imitohet nga fëmijët e tjerë të familjes të cilët e dëgjojnë, duke transmetuar një element tjetër përmes saj, gjuha shqipe.

Ashtu si edhe këngët e tjera që kanë një përmbajtje të caktuar edhe nina nanat i kategorizojmë në *disa lloje*:

- Këngë që aludojnë që fëmijët të rriten **me të gjithë të mirat ...** që më punë dhe dhe djerse të bëhen të parët në vendin ku jetojnë, pleqnarë e kuvendarë të shquar, të ftuar e të dëgjuar për trimëri dhe urti e për virtyte.
- Këngë që dëshirojnë që fëmijët të bëhen punëtorë² e gjejmë në vargjet “**...Ti mu bafsh çikë punëtorë**”... janë dëshmi e vlerësimit të punës. Këtë virtut njerëzor nënat kanë dëshiruar për fëmijët e tyre në të gjitha nina nanat.
- **...”Nuk e dua burrin çoban por e dua shkollovar”**... tregon për revoltën³ ndaj jetës së rëndë baritore dhe kërkesave për civilizim shoqëror. Ose
- p.sh gjejmë dëshirën e nënave që përveçse të bëhen barinj apo bujq shumë të mirë, të bëhen edhe mësues, inxhinierë, mjekë etj. Kështu p.sh kemi vargjet e këngës ... “**Si selvi me bel të hollë/ të çon nana ty në shkollë**”...
- Këngë që përfaqëjnë të renë dhe progresivën⁴, duke përcjellë çdo të re positive që sjell koha dhe shoqëria. Një këngë që përfaqon dhe dëshiron të renë e gjejmë edhe në çështjet e martesave ku nënat dëshirojnë më të mirën e mundshme për djemtë dhe vajzat e tyre psh e gjejmë në vargjet .: **...” Jo na çikën e kemi hasret/ a ardhë moda, e gjen vet.”**
- Shembujt e mirë të farefisit bëhen modele⁵ për fëmijët e tyre edhe në këngët që nënat krijojnë për ta. Kështu një shembull të tillë e gjejmë në vargjet “**Djali i jem, kujt i ka ga?/ Dajës Isuf e tezës Shah.**”
- Këto këngë dallohen edhe për tematikën e tyre patriotike, ku nënat u këndojnë fëmijëve, duke u mishëruar atyre ndjenjën e patriotizmit që në djep. E tillë është kënga **Ti mu bafsh çikë shqiptari**”...

Dëshirat që shprehin nënat gjatë këndimit të këtyre këngëve kanë një përmbajtje e cila varion sipas shtresës nga të cilat u krijuan apo sipas interesave që ata përfaqësonin dhe shtresave shoqërore që u përkisnin (fshatare dhe herë herë qytetare), atdhedashurisë që mbujtin etj.

Mjetet artistike. Figurat letrare që përdoren zakonisht janë

- Krahasimi: vajza krahasohet me gonxhen e trëndafilin, me lulen e shegës, me mollën kurse djali me pëllumbin, yllin.

¹ Nina – Nëna dhe këngë e lojna fëmijësh I, D.Shala, H. Kajtazi, F.Shkodra, M.Halimi, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i krahinës socialiste autonome të Kosovës, Prishtinë.

² Lit: Sokoli Ramadan, “Kangët e djepit”, gaz. “Shqiptarja e re”, 1962, nr. 7,8 etj.

³ Nina – Nëna dhe këngë e lojna fëmijësh I, D.Shala, H. Kajtazi, F.Shkodra, M.Halimi. Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i krahinës socialiste autonome të Kosovës, Prishtinë.

- Personifikimi: gjumi është pëllumbi që vjen dhe e merr fëmijën në krahët e tij.
- Metafora dhe epiteti: *flokt' e kuqe, vetullat e zeza, molla e kuqe, kumri, pëllumb, qingj, dash* etj., të cilat huazohen ose merren nga mjedisi natyror apo shoqëror për të portretizuar fëmijët e tyre;
- Ritmi, vargjet e këtyre këngëve rimojnë me rimë të pastër, me asonancë dhe alteracion, me lëvizjet që kryen përkundja e djepit.

Këngët lojë. Djepi i shumicës së shfaqjeve popullore është vetë jeta tradicionale e vendit. Në këtë klasifikim të lojërave popullore do të fusim të gjitha ato lojëra popullore të cilat kanë në strukturën e ekzistencës dhe të zhvillimit të tyre objektet, veglat dhe të kënduarin muzikor popullor si dhe vallëzimin. Sipas Zef Jubanit ⁴: *...kishte me qenë nevoja me themelue festa kombëtare, ku me konkurue e të gjithë pa dallim për me ushtrues në të gjyurit e shenjtit e ndër lojna gjimnastikore, ku kërcimet, vallet kombëtare duhet të jenë të frymëzuar prej muzikës dhe kjo kombëtare...* Në thelb, lojërat popullore të kujtojnë disi strukturën e tragjedisë së lashtë e cila kishte në qendër të saj unitetin mes fjalës, muzikës dhe vallëzimit. Këngët lojë:

- krijohen dhe improvizohen nga vetë fëmijët në kohëra të ndryshme, pa ndonjë koreografi të veçantë, për të plotësuar kohën apo mungesën e lodrave, duke krijuar vlera të dukshme në kulturën shpirtërore.
- shprehin ngjarje dhe lojra nga jeta e tyre e përditshme, nga natyra apo fenomene të ndryshme (shiu, breshëri, kafshët, bimët), ku fëmijët si krijues dhe ekzekutues, zgjerojnë horizontin e njohurive për botën që i rrethon.
- pasqyrojnë botën e fëmijëve (bisedojnë me retë, me kafshët, etj), shakatë dhe kënaqësitë e moshës, pafajësinë e tyre.
- ndihmojnë në njohjen e marrëdhënieve brenda familjes dhe jashtë saj, duke përfshirë në lojë edhe anëtarët e familjes apo të tjerët rreth e qark.
- mbrijtin patriotizmin, ku në disa këngë lojë që përmenden emra si të Skënderbeut, Bajram Currit, e tjerë, ku ata me shumë krenari i përmendin ato dhe shfaqin një urrejtje ndaj të atyre që janë vrasësit e tyre.
- luhen dhe këndohen zakonisht nga fëmijët e moshës 5-deri në 10 vjeç.

Lojrat popullore janë të shumta dhe të larmishme dhe si të tilla i gjejmë në të gjithë Shqipërinë. P.sh në Dibër, kemi disa lojra popullore për fëmijë që janë quajtur *këngë hoka*. Ndër këto lojëra do të evidentonim lojërat me këngë:

- *"Caf-caf"*⁴, *"Litari i gjatë"*, *"Suta"*, *"Bleta"*, *"Loja e gunave"* që i gjejmë në Elbasan, Gramsh, Berat, Durrës, Tiranë, Vlorë, Tepelenë, dhe Shkodër;
- lojën popullore me kungullishtet e thata të mbushura me guralecë: *"Qorthi në litar"*-Myzeqe, Pogradec, Shkodër, *"Gjetja e shoqes sipas zhurmës"*-Mirditë, *"Qorapetkat"*-Korçë, *"Në rreth të shokës"*-Mitrovicë, *"Shokaz"*-Opojë etj;
- lojën popullore me zile e këmborë: *"Baresha"*-Lezhë, *"Këmborët në kërrabat e çobanit"*-Gjirokastër;
- lojën popullore me tepsi *"Bluaj mulli"*-Lezhë dhe *"Loja e tepsisë"*-Shkodër etj.

⁴ Lit: Sokoli Ramadan, *"Gjurmime folklorike"*, Tiranë 1981; dhe Bushati Enver, *"Lojëra popullore"*, Tiranë 1990 etj.

¹ Nina – Nëna dhe këngë e lojna fëmijësh I, D.Shala, H. Kajtazi, F.Shkodra, M.Halimi, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i krahinës socialiste autonome të Kosovës, Prishtinë.

² Lit: Sokoli Ramadan, *"Kangët e djepit"*, gaz. "Shqiptarja e re", 1962, nr. 7,8 etj.

³ Nina – Nëna dhe këngë e lojna fëmijësh I, D.Shala, H. Kajtazi, F.Shkodra, M.Halimi. Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i krahinës socialiste autonome të Kosovës, Prishtinë.

⁴ Lit: Sokoli Ramadan, *"Gjurmime folklorike"*, Tiranë 1981; dhe Bushati Enver, *"Lojëra popullore"*, Tiranë 1990 etj.

⁵ R. Sokoli, P.Miso – Veglat muzikore të popullit shqiptar, 1991, Tiranë.

Disa nga këngët lojë nga rrafshi i Kosovës janë:

- Plak, plak, çufarrak – Desivojcë – Kamenicë,
- Faqekuqe, faqebardhë - Cernicë – Gjilan,
- ti shoq kallamoq – Cernicë – Gjilan,
- Jena dy shqiponja – Desivojcë – Kamenicë,
- Cic micë në Bullicë – Martinaj – Gusi,
- Bora po reshë, miki po keshë – Topanicë – Kamenicë,
- Lype lype diellin – Martinaj – Gusi,
- Zum,zum,zum - Cernicë Gjilan,
- Etj.

Mjetet shprehëse, ashtu sikurse tek këngët për fëmijë edhe tek lojërat muzikore përcjellin një moral të pastër dhe të kuptueshëm për atë që e dëgjon, vlera letrare gojore të gjalla, tërheqëse dhe të bukura (të cilat nuk zgjasin më shumë se 15 vargje) ku përveç fjalës që simbolizohet përmes figurave stilistike, gjendet shumë i zhvilluar **dialogu** midis *njerëzve, kafshëve, bimëve, insekteve*. Imitimi i zërave të natyrës apo të kafshëve, p.sh.: zum,zum, zum; ham, ham, ham; ciu,ciu,ciu; etj., si dhe shoqërimi me lëvizjet trupore apo gjetet, të cilat janë të thjeshta dhe të kapshme për të gjithë fëmijët janë pjesë e këngëve lojë. Mësimi i tyre ka shumë rëndësi në këtë moshë pasi fëmijët njihen në kopshitet apo shkollat që ata ndjekin elementet e para ritmike dhe melodike. Kështu që, mësimi lojërave muzikore të kënduara apo ligjërimeve ritmike popullore, fillon të edukojë tek ata elementet e para ritmike të vendit të tyre duke u mësuar elementet e para muzikore shqiptare.

Veglat muzikore popullore⁵ që ka trashëguar populli ynë brez pas brezi, përbëjnë një nga thesaret më të çmuar të popullit tonë. Arti, traditat dhe kultura në përgjithësi kanë plotësuar mungesën e arsimit në Shqipëri duke i edukuar brezat e rinj me përvojën e trashëguar. Shkenca e organologjisë gjatë studimit historik të krijimit dhe evoluimit të veglave muzikore, mbështetet ndër të tjera edhe tek *parimi i tingëllimit*, pasi janë veglat e mirëfillta, pikërisht aty ku nis të zbulohet gjeneza e e tipeve të ndryshme dhe etapave të zhvillimit të tyre. Çdo vegël muzikore është shqyrtuar nga pikëpamja e emërtimit dhe e lëndës përbërëse, e ndërimit, e mënyrës së punimit e të përdorimit e veçorive të tingëllimit, e mundësive shprehëse dhe repertorit, duke gjurmuar njëkohësisht prejardhjen dhe përhapjen e tyre në lidhje me krahinë apo vendin.

Veglat muzikore në studimin e përgjithshëm të tyre i shikojmë në disa rrafshë:

a) *Në rrafshin historik dhe geografik*, veglat muzikore do t'i prekim dhe japim një panoramë të shkurtër historike që nga mjetet paramuzikore e deri tek ndarja e tyre, duke u ndalur tek veglat muzikore për fëmijë.

- Vegla të kohëve parahistorike: mjete fare te thjeshta, tingëlluese të krijuara nga lëndë të ndryshme natyrore si: gur, bimë, dru, kocka, guaska etj.
- Vegla të periudhës së vonë të metaleve: mjete të thjeshta por më të përpunuara, si lugë, tepsia, zile, këmborë, etj.

Informacion mbi veglat muzikore merret nga:

- objektet arkeologjike, si: enët e zbukurura, monedhat, mbishkrime, skulpturat etj.
- veprat e artit, si: piktura, skulptura, afreske të cilat kanë edhe figura muzikantësh (Onufri, David Selenicasi, Andrea dhe Athinas Zografi, Ibrahim Kodra).
- veprat letrare, si të Marin Barletit, Gjon Buzukut, Pjetër Budit etj.

b) *Në rrafshin gjuhësor*, shqyrtimin e emrave dhe sinonimeve të veglave të ndryshme, ka shumë rëndësi për vetë faktin se këta emra janë një pasuri e thesarit gjuhësor, por sepse edhe

⁵ R. Sokoli, P.Miso – Veglat muzikore të popullit shqiptar, 1991, Tiranë.

nëpërmjet zbrërthimit etimologjik, mund të hetojmë prejardhjen e vetë veglave muzikore. Etimologjia e emërimit të veglave muzikore rrjedh nga:

- Vetëkumbimi që vjen nga shkëmbimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve përbërëse të fjalës p.sh.: tringëza, tring-tring etj.
- Veprimi i veglave, p.sh emri “gërrëzë” nga folja “gërryej”.
- Lënda përbërëse, p.sh. “ngallice” nga “rrabush l qepës” etj.
- Forma, p.sh.: “bicule”, “shtambukë” etj.
- Plotësimi me mbiemra i disa emrave, p.sh.: “culë –dyjare” , “ çifteli”, etj.
- Emërtimi sipas orendive të shtëpisë i disa mjete paramuzikore, p.sh.:“lugë“, “tepsi” etj.
- Emërtime të ndryshme për të njëjtën vegël muzikore p.sh: “glyrë” e gjejmë edhe me emërtimin *bibizë, borigë, hotë, kabëz etj.*
- Emërtime të njëjta për vegla të ndryshme si p.sh.: lahuta dhe llahuta.
- Huazimi nga vende të tjera si p.sh “zumare” emërtim arab; ose huazime lindore p.sh” buri”, “daulle”, “zurna” etj.

c) Në rrafshin ndërtimor/përbërës të lëndës dhe tingëllimor. Duke bërë një vëzhgim në veglat muzikore vërehet se ndërtimi i veglave tradicionale muzikore dhe përbërja e materialit është mjaft i thjeshtë, ku janë shfrytëzuar lëndë të ndryshme si nga drurërt, gjethet, bimët apo edhe lëndë të tjera me origjinë shtazore. Të tilla janë: gjetje, kallama, fije bari, gurë, guacka etj. E gjithë tregon lënda përbërëse dhe ndërtimi i saj ndikon në cilësinë e kumbimit të veglave. As koha, as rrethanat nëpër të cilën kanë shtegtuar këto mjete paramuzikore deri në ditët tona, nuk ka sjellë ndonjë ndryshim të dukshëm në ndërtimin e tyre. Pra:

- Materiali përbërës i veglave muzikore është i thjeshtë, si druri, gjethet, bimët, kallama, fije bari, gurë, guacka etj apo edhe lëndë të tjera me origjinë shtazore.
- Lustra i mbron veglat nga ndikimet atmosferike.
- Zbukurimet.
- Lënda përbërëse dhe ndërtimi i saj ndikon në cilësinë e kumbimit të veglave.

Në të kaluarën mjeshtrit popullore zgjidhin lëndën e përshtshme për çdo tip vegle p.sh : për veglat kordofonë ata njohin sh mirë vetitë e drurit, se cili dru punohet lehtë dhe cili dru kumbon më mirë, kështu bredhi i kuq shërben për gërroqen e veglave kordofonë, pasi ky lloj druri nxjerr tingull të kumbueshëm, pasi përmban lëndë rrëshinore se sa bredhi i bardhë.

Organologjia shqiptare ose shkenca e studimit të veglave të muzikës popullore, klasifikon bashkime të ndryshme veglash muzikore me parime të ndryshme të nxjerrjes së tingullit. Veglat muzikore klasifikohen në katë grupe bazë, mbështetur parimit të nxjerrjes së tingullit prej tyre: *aerofone, kordofone, membranofone dhe idiofone.*

Veglat muzikore popullore në përgjithësi dhe ato për fëmijë në vecanti, shërbejnë për luajtjen me to dhe shoqërimin e këngëve dhe këngëve lojë të fëmijëve.

Veglat idiofone: Kategori e klasifikimit të veglave muzikore popullore. Në këtë kategori futen vegla popullore si: *gurët, tokëza, çanga, cinglat, raketakja, rrekëza, gërrëza, tingëzat, stringlat, lugët, masha, tepsia, këmborët dhe zilet, cungrama etj.* Këto vegla i nxjerrin tingujt nga vibrimet e trupit të tyre të ngurtë të realizuara me goditje, fërkim, tundje etj.

Veglat më të përdorshme për fëmijë janë:

Aerofone: bilbili, me sqep të njëfishtë, pipëza, njëshe (përhapje mbarëkombëtare) dhe dyshe (vetëm në Shqipërinë Jugore).

Kordofone: çiftelija, që gjendet në veri të Shqipërisë.

Membranofone: poçi, lodra (vegël shoqëruese ose me funksion solistik).

Idiofone: raketakja (më e përhapur është ajo e ndërtuar me thupra, në formë shporte të mbyllur me një bisht mbajtës), gërrëza (mjet paramuzikor), cinglat (mjet paramuzikor, që përbëhen nga dy copa shkopinsh të drejtë, ose paksa të përkulur, dhe që nxjerrin tinguj të

papërcaktuar duke i përplasur me njeri tjetrin. Përgjithësisht cinglat përdoren gjatë lodrave të fëmijëve).

Në përfundim

Krijimtaria popullore për fëmijë tek ne përfshirë këngët, lojërat, veglat popullore për fëmijë, është shumë e pasur, e lashtë dhe e trashëguar mirë brez pas brezi. Janë të shumta arsyet se pse këngët dhe lodrat për fëmijë janë baza e formësimit, zhvillimit, ruajtjes dhe transmetimit të vlerave dhe trashëgimisë tonë kombëtare *sa e si* duhet brezat e fëmijëve. Zhvillimi i ndjenjës muzikore përmes këngëve dhe këngëve lojë, dhe jo vetëm i ndjenjës muzikore por që përmes tyre zhvillohen dhe shumë vlera të tjera si dashuria për punën, për të afërmit, për shioqërinë, për natyrën dhe vendin ku rriten. Është detyrë shumë e rëndësishme e të gjitha institucioneve, jo vetëm atyre artistike por edhe arsimore, historike që ta zhvillojnë krijimtarinë popullore për fëmijë si thesar të kulturës dhe trashëgimisë kombëtare, përmes:

- a) **njohjes** shumë të mirë të traditës muzikore folklorike shqiptare sidomos të këngëve dhe këngëve lojë për fëmijë;
- b) **krijimit** këngëve të reja për fëmijë me bazë *tekstuale* dhe *muzikore* nga krijimtaria popullore për fëmijë;
- c) **përdorimit** (luajtjes) me instrumente muzikore popullore për fëmijë, bazë për zhvillimin e ndjeshmërisë *ritmike* dhe *melodike* tek fëmijët në shoqërimin e këngëve, valleve dhe këngëve lojë;
- d) **përdorimit** (këndimit dhe ekzekutimit) të këtyre këngëve dhe lojërave muzikore për fëmijë, bazë për të ruajtur vlerat e trashëgimisë shpirtërore kombëtare të vendit/krahinës nga vijnë;
- e) **njohjes dhe transmetimit të vlerave** të këngëve dhe këngëve lojëra për fëmijë edhe nëpërmjet kurrikulës shkollore në parashkollor dhe arsimin fillor.

Dr.sc. Xhevdet THAQI, Mr.sc. Valbonë BERISHA¹: KONCEPTI I FUNKSIONIT DHE ÇASJA E TEKSTEVE SHKOLLORE NË KËTË KONCEPT

¹Fakulteti i Edukimit, Prishtinë

Abstrakt. *Koncepti i funksionit është një prej koncepteve bazike në matematikë dhe ka rol qendror në tërë fushën e matematikës. Ai po ashtu ka një karakter interdisiplinar, prandaj shfrytëzimi i shumëllojshmërive të paraqitjeve dhe interpretimeve të dukurive natyrore por dhe atyre shoqërore ndihmon në shpjegimin dhe kuptimin e tij. Si i tillë funksioni është një instrument shkencor me potencial të madh, prandaj duhet të ketë vendin e merituar në arsimin matematik. Të kuptuarit e rrënjësishëm të konceptit të funksionit nga ana e nxënësve është me rëndësi të madhe si për ngritjen e mëtejme arsimore të tyre, po ashtu edhe për përballje me problem të përditshmërisë. Te ne në Kosovë, koncepti i funksionit matematik shpjegohet për herë të parë në klasën e shtatë të shkollës së mesme të ulët. Me qenëse teksti shkollor është instrumenti kryesor si për mësimdhënësin ashtu edhe për nxënësin, shohim të rëndësishëm të analizojmë shtjellimin e konceptit të funksionit në testet shkollore. Gjithnjë duke patur në konsiderim se një çasje jo adekuate dhe e limituar, si në pikëpamje kualitative ashtu edhe në atë kuantitative ashpërsos pengesat e nxënësve në nxënien e këtij koncepti. Në këtë punim do të tentojmë të japim çasje më të plotë dhe gjithëpërfshirëse për këtë problematikë duke pasur për qëllim ngritjen e rezultatit në mësimdhënien dhe mësimnxënien e funksionit dhe matematikës në përgjithësi.*

Fjalët kyçe: matematikë, arsimi matematik, funksioni, testet shkollore.

Hyrje

E dimë se në shkollat tona, teksti shkollor është i vetmi burim dhe mjet i cili shërben për zhvillimin e orës mësimore, si për mësimdhënësin ashtu edhe për nxënësit. Prandaj, kemi konsideruar të nevojshme të analizojmë se si shtrohet procesi i të shpjeguarit të njohurive për funksionin dhe kuptimin e funksionit në shkollë bazuar në testin shkollor.

Funksioni është një nga konceptet më të rëndësishme në matematikë dhe njëherit është koncept i cili mundëson shtjellimin, përkufizimin dhe konstruktimin e koncepteve tjera matematikore. Me një fjalë, lirisht mund të themi se nëse nxënësi i cili nuk e ndërton drejtë konceptin e funksionit ai do të ketë vështirësi edhe në kuptimin, zhvillimin dhe konstruktimin e njohurive tjera matematikore.

Çasja kuptimit të funksionit tek nxënësit e shkollës së mesme të ulët, duhet të bazohet në fenomene dhe dukuri të jetës së përditshme (Harries, I, & Sutherland, R. 1988). Shembuj të tillë ka mjaftë dhe në çdo hap. Nga pikëvështrimi ynë, në rrethin ku jetojmë vërejmë gjëra dhe situata të ndryshme, por të vërejturit e tillë bëhet nga kënde të ndryshme varësisht nga individit dhe nga interesimet e tij. Një nga perspektivat e të vërejturit të tillë të botës që na rrethon është **ndryshueshmëria** e gjërave dhe situatave që na rrethojnë (Freudenthal, 1983), si të natyrës fizike ashtu edhe të natyrës sociale, e po ashtu edhe të natyrës mendore të individit.

Ky të vërejtur, na bënë të zbulojmë një numër të madh të fenomeneve të cilat vazhdimisht **ndryshojnë**. Fenomenet dhe situatat e tilla janë të shumta, p.sh. vullneti i njeriut për të zhvilluar ndonjë aktivitet, të menduarit e përgjithshëm në relacion me botën, forma dhe madhësia e trupit të njeriut, e të ngjashme, por ka gjëra tjera të cilat ndryshojnë dhe ato ndryshime mund të “kuantifikohen” (të caktohet sasia e ndryshimit të tyre) në ndonjë mënyrë, siç janë: temperatura e një vendi gjatë një dite,

KUMTESA

muaji apo viti; sasia e të reshurave atmosferike gjatë një periudhe të caktuar kohore; të hyrat materiale (financiare) të një familje apo të një ndërmarrje ekonomike gjatë një periudhe kohore, e të tjera.

Të gjitha këto procese mund të interpretohen, përpunohen dhe studjohen kur përdoret modeli matematik i përshkrimit të tyre. Pra këto fenomene i abstrahojmë dhe i studjojmë nga perspektiva e objekteve të ndryshueshme: *shuma apo prodhimi i dy numrave; trefishi apo gjysma e një madhësie të caktuar; syprina e një katrori në varshmëri të brinjës së katrorit; syprina e një rrethi në varshmëri të rrezes së tij; vëllimi i një trupi gjeometrik*, e shume shembuj tjerë.

Nëse i analizojmë pak me shumë këto fenomene, vërejmë se ndryshueshmëria e tyre u përgjigjet disa kushteve të *varshmërisë* së tyre nga disa shkaqe apo faktorë shoqërues, të cilat po ashtu ndryshojnë (Kleiner, I. 1989):

Textbooks and teachers usually introduce function via a situation with the related quantities already identified. What is required of the students or shown to the students is how to set up and represent the relationships in tables, graphs, and equation

Prandaj madhësitë e ndryshueshme i dallojmë në dy klasa - fenomenet e para i quajmë *ndryshore (variabël) të varura ose funksion* ndërsa të dytat *ndryshore të pavarura ose argument*. Ky do të ishte kuptimi intuitiv i funksionit, i cili konsiderojmë se është i përshtatshëm për nxënësit e moshës së arsimit të mesëm të ulët. Të shohim në vazhdim çasjet tjera të kuptimit të funksionit.

Koncepti i varshmërisë funksionale

Koncepti i funksionit mund të shpjegohet në forma të ndryshme (Chen, A., & Ennis, C. D. 1995):

Mathematics is not just about the study of numbers and shapes but also about the study of patterns and relationships. Function, which can define some of these relationships, is an indispensable tool in its study. Function is the central underlying concept in calculus. It is also one of the key concepts of mathematics that can model many quantitative relationships

Në vazhdim do të shtjellojmë kuptimin konceptit të funksionit si *varshmëri kauzale* (shkak-pasojë), funksioni *si relacion apo shoqërorizim* dhe funksioni *si rregull apo formulë* e cila i lidh dy apo më shumë ndryshore. Si mund të kuptohet funksioni nga këto këndvështrime?

Funksioni si varshmëri kauzale (shkaktuese). Po nisemi për shembull, të analizojmë *vullnetin* tonë për të zhvilluar ndonjë aktivitet të cilin mund të konsiderojmë si *ndryshore të varur*, mund të identifikojmë shkaqet të cilat e shkaktajnë ndryshueshmërinë e tij (vullnetit): dashuria ndaj punës, stimulimet materiale, e plotë arsye tjera të cilat mund t'i konsiderojmë si *ndryshore (faktorë) të pavarura*. Pra, vlerat e ndryshme të këtyre ndryshoreve të pavarura në një moment të caktuar dhe në një kombinim të caktuar (që është specifike për çdo individ) mund të përcaktojnë “nivelein” e vullnetit për punë në një moment të caktuar.

Shembulli i mësipërm i varshmërisë shprehë *varshmërinë kausale* (shkaktuese) dhe ndryshueshmëria e tyre është rezultat i shkaqeve apo arsyeve të cilat e bëjnë atë.

Funksioni si relacion. Nga ana tjetër, dallojmë edhe varshmëri të cilat nuk përshkruhen me anë të shkakut – efektit; por me anë të *relacioneve* apo të shoqërorizimit ndërmjet ndryshoreve. Ky relacion ndërmjet ndryshoreve mund të shprehet në disa mënyra. Në këtë kuptim, është ndryshorja e pavarur “*koha*” e cila “*rrjedh*” në mënyrë të pavarur nga çdo kush dhe në atë rrugëtim ajo manifeston ndryshime të një numri shume të madh të ndryshoreve tjera. Si ilustrim mund të konsiderojmë të gjitha ndryshimet (variablat) personale, fizike dhe psikologjike të cilat ndryshojnë sipas kohës; temperaturat, sasia e të reshurave, distancat e ndryshme ndërmjet dy vendeve, etj. Në të gjitha këto raste koha prodhon ndryshueshmëri e cila mund të observohet dhe mund të matet në secilën prej këtyre ndryshoreve të tjera. Por asnjëherë koha nuk është faktor në kuptimin e *ndryshimeve fizike* (rritja e fëmijës) apo të *temperaturës*, por i shoqëron ato ndryshime dhe ju shërben atyre si referencë dhe si kontrollë.

Funksioni si rregullë. Mënyrë tjetër e kuptimit të varshmërisë së një ndryshoreje në lidhje me ndryshoren tjetër është kur gjendet dhe ekziston *një rregull* apo *një formulë* e cila i lidhë ato madhësi të ndryshueshme.

Marrim në konsiderim syprinën e rrethit e cila është një madhësi e ndryshueshme e cila shprehet me rregullën e ngritjes në katror të rrezës së tij dhe prodhimi me numrin π . Pra, gjatësia e rrezes është ndryshoreja e pavarur e cila kur ngritet në katror dhe shumëzohet me numrin π na jep ndryshoren e varur - *syprinën e rrethit*.

E dimë të gjithë se kjo mënyrë e kuptimit të varshmërisë ndërmjet dy e më tepër ndryshoreve është shumë prezente sidomos në matematikë.

Rregulla “*dyfishi i ...*” mund të shprehet si shoqërorizim (pasqyrim) i çfardo dy numrave: $4 \rightarrow 8$, $5 \rightarrow 10$, etj., situatë në të cilën nënkuptohet se “*dyfishi i 4 është 8*” dhe numri 4 është ndryshore e pavarur, ndërsa 8 është ndryshore e varur, e kështu me radhë. Në këto raste themi se kemi varëshmëri funksionale të dhënë me anë të *rregullës*, siq është në rastin konkret rregulla “*dyfishi i ...*”.

Prezentimi i funksionit. Në matematikë, këto rregulla prezantohen në disa mënyra dhe kjo mënyrë e prezentimit të rregullave njihet edhe me emrin *simbolikë e matematikës*. Në këtë mënyrë, mund të themi se funksioni është *një objekt matematik i cili shërben për të studiuar fenomenin e ndryshueshmërisë – varshmërisë ndërmjet ndryshoreve*.

Ky termin është bërë pjesë edhe e fjalorit të zakonshëm, ngase mund të dëgjojmë shpesh se “*Rritja e rrogave të punëtorëve (ndryshore e varur) do të jetë në funksion të prodhimit të tyre (ndryshore të pavarura)*”, apo: “*Vendimi për të shkuar në piknik (ndryshore e varur) do të merret në funksion të kushteve klimatike (ndryshore e pavarur)*” *Kur lëvizim çelësin (ndryshore e pavarur) atëherë makina e veturës sonë nis (ndryshore e varur)*. *Kur kyçim rrymën dhe bëhet dritë në dhomë themi se rryma po funksionon mirë*. Në të gjitha rastet, themi se “*funksionon*”, kur një veprim sjell tek reaksioni i pritur dhe i dëshiruar.

1. Koncepti i funksionit matematik

Nuk është lehtë të jepet një definicion preciz për konceptin e funksionit, ngase siç e pamë më lartë, varshmëria ndërmjet variablave (ndryshoreve) manifestohet në mënyra të ndryshme: kauzale, relacionale apo me anë të formulave (rregullave). Po ashtu brenda mënyrës relacionale të manifestimit të varshmërisë dallojmë *relacionin* me një ndryshore si referencë, si *rregull* e cila përcakton korrespondencën apo *formulën* e cila shprehë atë varshmëri.

Prandaj, do të pajtohemi se: funksioni mund të kuptohet dhe pranohet si shprehje e një varshmërie *shkaku-efekti (kauzale)* ose si *një relación* ndërmjet ndryshoreve që mund të përshtatet me anë të *një rregulle*, të *një korrespondence* ndërmjet së paku elementeve të dy bashkësive, apo me anë të *një formule*.

Historikisht, për matematikanin e njohur Kline (1992)⁵²¹, si pikënisje për të shqyrtuar konceptin e varshmërisë funksionale ndërmjet variablave ka shërbyer fenomeni i lëvizjes. Edhe Galileo (1564-1642) ka studiuar dhe përkufizuar disa relacione (formula) ndërmjet ndryshoreve; *hapësira e përshkruar, shpejtësia dhe koha*. Përkufizimi me eksplicit për funksionin i dhënë në shekullin XVII është ai i Gregory (1667) që është: “*Sasi e cila fitohet nga sasi të tjera me anë të një vargu të operacioneve algjebrike apo me anë të operacioneve tjera*”. Po ashtu, konceptin e funksionit e shqyrtojnë edhe Leibniz (1673) dhe Bernoulli (1697), të cilët spjegojnë se “*funksioni është sasi e varur nga një ndryshore*”⁵²². Ndërsa vazhdon shqyrtimi i fenomenit të ndryshueshmërisë - varshmërisë ndërmjet ndryshoreve (variablave) pa ndonjë kushtëzim të madh gjatë tërë kohës në

⁵²¹ Kline, M. (1992). *El pensamiento matemático de la Antigüedad a nuestros días*. Madrid: Alianza.

⁵²² Shih: <http://mathworld.wolfram.com/Dirichlet/Function.html>

KUMTESA

vazhdim, po fiksojmë interpretimin e Dirichlet (1839) për konceptin e funksionit: "y është një funksion i x kur çdo vlerë të x në një interval të caktuar i korrespondon një vlerë e vetme e y". Në këtë interpretim të konceptit të funksionit kemi një shënim preciz (x, y, interval) në të cilin kemi një kushtëzim mjaft konkret të konceptit të funksionit: *çdo vlerë të ndryshores së pavarur (x) në një bashkësi të vlerave (në një interval të dhënë) i korrespondon një dhe vetëm një vlerë e ndryshores së varur (y)*. Me fjalë tjera, në rast se ndonjë vlerë të ndryshores së pavarur nuk i korrespondon asnjë vlerë (ose i korrespondojnë me shumë se një vlerë) e ndryshores së varur, ky relacion i varshmërisë nuk do të jetë funksion në kuptimin matematik.

Nëse shënojmë me shkronja A dhe B respektivisht Domenën dhe Kodomenën e funksionit, ndërsa me x dhe y shënojmë elementët përkatëse të këtyre bashkësive, me f shënojmë rregullën e varshmërisë së këtyre ndryshoreve - funksionin, atëherë të gjithë këtë proces mund ta shënojmë simbolikisht:

$f: A \rightarrow B$, ashtu që: $x \rightarrow y$ ose $x \rightarrow f(x)$ apo gjithashtu $f(x) = y$.

Zakonisht x quhet *originali* ndërsa y quhet *përfytyrë* e funksionit.

2. Aktivitetet për zhvillimin dhe kuptimin e konceptit të funksionit

Sa janë prezente dhe a zhvillohet koncepti i funksionit në përputhshmëri me aspektet e shtjelluara më sipër në kuadër të aktiviteteve mësimore nëpër tekste shkollore dhe në mësimdhënien e matematikës?

Po të marrim në shqyrtim tesktin e matematikës për klasën e VII të Shkollës së Mesme të Ulët (Grup Autorësh, 2002) në të cilin shqyrtohet koncepti i funksionit, vërejmë se të spjeguarit e konceptit të funksionit fillon me shembuj nga jeta e përditshme duke krahasuar lidhshmërinë apo mardhënien ndërmjet objekteve të "llojeve" të njejtë apo të ndryshme (fig.1):

Funksioni

1. Kuptimi i funksionit

Në jetën e përditshme dhe në matematikë shpesh kemi të bëjmë me lidhshmëri dhe marrëdhënie ndërmjet objekteve të të njëjtit lloj apo llojeve të ndryshme. Kështu, elementeve të një bashkësie, në njëfarë mënyre ua shoqërojmë elemente të të njëjtës bashkësie apo të ndonjë bashkësie tjetër. Për shembull, çdo nxënësi i caktojme klasën, secilit mall i caktojme çmimin, të gjitha faqeve të një libri, numrin përkatës natyror etj.

Shembull 1. Paga e Jetonit si instruktor vallëzimi varet nga numri i orëve, sa ai punon. Nëse për një orë Jetoni paguhet 7 euro, sa do të jetë paga e tij për 8 orë, 15 orë, 25 orë?

Figura 1

Bazuar vetëm në spjegimet e paraqitura në tekst, nxënësit do të kenë vështirë të familjarizohen me konceptin e funksionit, ngase edhe pse shembujt janë të kuptueshëm, të gjitha elementet tjera krijojnë konfuzitete, si psh.: fjalët "lidhshmëri" dhe "mardhënie" kan një kuptim të gjërë dhe të papërcaktuar; dhe për tu kuptuar ato nevojitet nga mësimdhënësi që këto kuptime t'i identifikojnë dhe t'i përpunojë në mënyrë më të detajzuar.

Po ashtu vlen të theksohet se të gjithë shembujt e marrur në tekst synojnë zhvillimin e konceptit të funksionit *si rregullë apo formulë* sipas të cilës elementeve të një bashkësie u korespondojnë elementet e bashkësisë tjetër (bashkësia e nxënësve ↔ bashkësia e klasëve, bashkësia e mallërave ↔ bashkësia e çmimeve, faqet e librit ↔ numri rendor), por nuk përmenden edhe kuptimet tjera të funksionit si ajo *kauzale* dhe kuptimi i funksioni si *relacion*.

Në tekstin shkollor Matematika 7, koncepti i funksionit si formulë është paraqitur drejtë (figura 2):

Matematika 7

Shembull 2. Syprina e sipërfaqes katrore është funksion i gjatësisë së brinjës së tij. Shpjegoni.

Nëse shënojmë me $A = \{2, 3, 4, 5\}$ bashkësinë e gjatësive a të brinjëve të katrorit, duke zbatuar formulën për njehsimin e syprinës së sipërfaqes katrore $S = a^2$, bashkësia korresponduese e vlerave të syprinës është: $B = \{4, 9, 16, 25\}$.

Kështu, "rregulla e shoqërimit" $S = S(a) = a^2$ është funksion i gjatësisë së brinjës, sepse:

Çdo elementi të bashkësisë A i shoqërohet pikërisht (as më shumë as më pak) një element i bashkësisë B .

Figura 2

Nga shembujt tjerë të analizuar mund të gjejmë se koncepti i funksionit si *formulë* paraqitet dhe shpjegohet në mënyrë korrekte edhe në tekstet tjera të matematikës.

Por, nga vështrimet tona të bëra në tesket shkollore të matematikës nuk mundëm të gjejmë shembuj të cilët zhvillojnë dhe ndërtojnë konceptin e funksionit si shkak-pasojë. Autorë të ndryshëm konfirmojnë se ndërtimi i drejtë i konceptit të funksionit bëhet duke zhvilluar shembuj të funksionit së pari si *shkak pasojë*, funksionit si *relacion* ndërmjet dy bashkësive të ndryshme, dhe mandej shembuj të funksionit të dhënë me anë të ndonjë *rregulle*, në mënyrë që të identifikojmë konceptin e funksionit si koncept i ndërtuar nga karakteristikat e përbashkëta të të tri shembujve. Shembuj të cilët mendojmë se do të ndihmonin të kuptohet lehtë koncepti i funksionit do të ishin:

Shembull të funksionit shkak pasojë, mund të merret niveli i lumenjëve. Niveli i lumenjëve ndryshon varësisht nga të reshurat atmosferike të cilat zakonisht janë karakteristikë e stinëve të vitit. Të marrim shembullin e një lumi, dhe të analizojmë ndryshueshmërinë e sasisë së ujit të lumit sipas mujave të vitit. Nga shërbimet profesionale mund të merren shënimet dhe të paraqiten në formë të një table. Shembulli është i përshtatshëm për të zhvilluar bisedë me nxënë, sepse fenomeni i rritjes dhe zvoglimit të nivelit apo të sasisë së ujit të lumenjëve është një fenomen i njohur për ta. Biseda do të orientohet në identifikimin e madhësive të ndryshueshme dhe varshmërisë së madhësive. Kuptohet në këtë rast, do të theksohet se kjo varshmëri shprehet nga *shkaku* (sasia e të reshurave atmosferike) dhe *pasoja* (rritja e sasisë së ujit në lum). Po ashtu do të theksojmë kuptimin e *ndryshores së varur* (sasia e ujit të lumit) dhe kuptimi i *ndryshores së pavarur* (të reshurat atmosferike).

Në tekstin shkollor Matematika 7 (shih Grup Autorësh, Matematika 7) gjejmë shembuj të cilët krijojnë konfuzion në të kuptuarit e funksionit si shoqërorizim apo relacion. Në të vërtetë autorët e tekstit shkollor Matematika 7 marrin shembullin e shoqërorizimit të numrit të artikujve dhe çmimeve përkatëse, duke dhënë porosinë se *në këtë rast nuk kemi funksion* (figura 3):

Shembull 3. A është çmimi funksion i numrit të artikujve? Shpjegoni.

| | | | | | |
|-------------------------------------|-----|----|-------|----|----|
| Numri i artikujve (vlera hyrëse) | 4 | 9 | 1 | 8 | 4 |
| Çmimi (vlera dalëse) | 2 € | 4€ | 0.50€ | 4€ | 3€ |

Katër artikuj mund të kushtojnë 2€, ose 3€ (vlerës hyrëse 4, i korrespondojnë më shumë se një vlerë dalëse). Kështu, çmimi nuk është funksion i numrit të artikujve.

Figura 3

Edhe pse këtu kemi të bëjmë me funksionin i cili çdo artikulli i shoqëron çmimin e tij, arsyetimi i dhënë në tekstin shkollor është mjaft diskutabil kur thuhet se “4 artikuj mund të kushtojnë 2Euro ose 3Euro” gjë që në realitet nuk është e mundur asnjëherë. Autorët harrojnë se 4 artikujtë që kushtojnë 2 Euro janë artikuj të ndryshëm nga ata që kushtojnë 3 Euro. Nga ky shembull vërejmë se nxënësit nuk do të ndërtojnë konceptin e funksionit si shoqërorizim apo relacion, për shkak të interpretimit të gabueshëm në tekstin shkollor.

Prezntimi i funksionit me anë të formulave apo paraqitja analitike e funksionit. Në matematikë është forma standarde e paraqitjes së funksioneve me anë të formulave, të cilën e quajmë paraqitja analitike e funksioneve (Ding, L. and Jones, K. 2009). Kjo formë e paraqitjes së funksioneve mundëson studimin më të lehtë të funksioneve, siç janë vetitë e funksionit, natyra e funksionit etj. Formulatat janë shprehje algjebrike (mund të përbejnë numra, veprime dhe simbole) të cilat paraqesin relacionet ndërmjet variablave të pavarura dhe variables (ndryshores) së varur.

Formulat janë mënyra më e përhapur dhe më praktike e shprehjes së funksioneve në matematikë sepse saktësisht janë përcaktuar operacionet sipas të cilave për vlerën e dhënë x gjendet (llogarit) vlera e funksionit y .

Për funksionin e dhënë në formë analitike bashkësia e përcaktimit nuk është e domosdoshme të jepet. Në këtë rast bashkësia e përcaktimit të funksionit $y = f(x)$ konsiderohet bashkësia e të gjitha vlerave reale të argumentit x për të cilat shprehja $f(x)$ ka kuptim në bashkësinë e numrave reale.

Për shembull, funksioni $f(x) = x^2 - 3x + 5$, është i përcaktuar për çdo $x \in R$, d.m.th, bashkësia e përcaktimit është bashkësia e numrave realë R . Ka shumë shembuj të paraqitjes së funksionit me anë të formulave edhe në testet shkollore.

3. Përfundim

Funksioni është ndër konceptet më të rëndësishme në matematikë, prandaj edhe duhet t'i jepet rëndësi e madhe në të spjeguarit dhe shtjelluarit e konceptit të funksionit në shkollat e mesme të ulëta. Të kuptuarit e drejtë dhe të plotë të konceptit të funksionit do të reflektohet me suksese të mira edhe në shkollimin e mëvonshëm dhe në fushat tjera mësimore. Prandaj kujdes të madh duhet të kemi gjat zgjedhjes së aktiviteteve në procesin mësimor të zhvillimit të kuptimit të funksionit, në mënyrën e shtjellimit të atyre aktiviteteve dhe në ilustrimin me shembuj adekuat. Në këtë punim kemi arritur të identifikojmë kuptime të ndryshme të funksionit si shkak-pasojë (funksioni si kuptim kauzal), kuptimi i funksionit si shprehje e relacionit ndërmjet elementeve të bashkësive të ndryshme, dhe kuptimi i funksionit i cili shpreh rregullën sipas të cilës elementeve të një bashkësie u shoqërohen elementet e të njejtës apo bashkësisë tjetër. Kemi vërejtë se kjo çasje në zhvillimin e konceptit të funksionit nuk është e evidente në testet shkollore.

Recenzentë:

Dr. prof. catedratico, Joaquim Gimenez, FFP, UB.

Dr. prof. Sabri Tahiri, Fakulteti i Edukimit, UP

Nazmi XHOMARA (PhD Student): KUALIFIKIMI PROFESIONAL I MËSUESVE NË PUNË

Specialist Edukimi- Instituti i Zhvillimit të Arsimit & Pedagog i Jashtëm-
Universiteti i Tiranës Fakulteti i Shkencave Sociale

Abstrakt

Studimi paraqet një analizë deskriptive të arritjeve të mësuesve në Kualifikimin Profesional 2011. Metodot e studimit përfshijnë analizën e vlerësimit të arritjeve të mësuesve në kualifikimin 2011, sikurse analizën e elementeve strukturorë të kualifikimit. Rezultatet e të dhënave të analizuara tregojnë që arritjet e mësuesve në kualifikimin 2011 janë më të larta se ato të kualifikimit 2010 në dy ekstremet e arritjeve. Për më tepër në kualifikimin 2011 janë bërë disa ndryshime strukturore krahasuar me strukturën e kualifikimit 2010.

1. Struktura e Kualifikimit të Mësuesve

Që prej vitit 2007 kualifikimi profesional i mësuesve, po zhvillohet sipas një skeme ku ndërthuren elementë strukturorë dhe përmbajtësorë, si edhe institucione në nivel qendror dhe lokal. Nëse në strukturën e vjetër të kualifikimit, që nga procesi i aplikimit e deri në marrjen e certifikatës përkatëse gjithçka mbyllej brenda nivelit të (DAR/ZA) Drejtoria Arsimore Rajonale/Zyra Arsimore, në strukturën ekzistuese procesi nis pranë DAR/ZA-ve dhe përfundon në nivelin qendror duke nënkuptuar (MASH) Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe (IZHA) Instituti i Zhvillimit të Arsimit. Gjithashtu nëse në strukturën e vjetër mësuesit kandidatë i nështroheshin një provimi me gojë përpara një komisioni në nivel DAR; në strukturën ekzistuese ata duhet të hartojnë produkte profesionale individuale për të cilat vlerësohen në nivel DAR/ZA, si edhe i nënshtrohen një testimi kombëtar të standartizuar.

Produktet profesionale individuale, të njohura si Portofoli i Mësuesit, të cilat vlerësohen nga komisione të ngritura në nivel DAR/ZA janë: (1) Plan mësimor vjetor; (2) Plan mësimor ditor; (3) Test kapitulli lëndor; (4) Projekt kurrikular; (5) Objektiva të arritjeve në një kapitull lëndor.

Secili prej elementeve të portofolit profesional të mësuesit vlerësohet me nga 3 pikë, duke nënkuptuar që në nivel DAR/ZA kandidati siguron një total prej 15 pikësh, që i korespondojnë gjithashtu 15% të vlerësimit përfundimtar. Elementi i dytë më i rëndësishëm për nga pesha që zë është testi, i cili përbëhet nga këta elementë : (1) Dokumentacioni shkollor; (2) Programi lëndor; (3) Aftësi metodologjike; (4) Aftësi shkencore (Rregullore e MASH, 2011).

Vlerësimi i secilit prej këtyre elementeve në kualifikimin 2011 është përkatësisht: 4, 8, 12, 13 dhe 45 pikë. Testi në vlerësimin përfundimtar zë 70%. Elementi i tretë i formatit të vlerësimit të mësuesve janë Bonuset, të cilët zënë secili nga 5 pikë duke prodhuar një total prej 15 pikësh, ose 15% në vlerësimin përfundimtar të kandidatit. Bonuset, përbëhen nga tre elemente : (1) Grada master ose doktoraturë (Ma, Dr); (2) Çertifikatë e gjuhës së huaj; (3) Çertifikatë (TIK) Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit.

Nivelet e vlerësimit të mësuesve në procesin e kualifikimit sipas skemës aktuale janë : A- Shkëlqyeshëm; B- Shumë Mirë; C- Mirë; D- Mjaftueshëm; E- Dobët

Pas fitimit të njërit prej katër niveleve të para të vlerësimit, mësuesit përfitojnë rritje page përkatësisht: kategoria e III, që nënkupton mësuesit që kanë 5 vite eksperiencë profesionale 5%, kategoria e II, që nënkupton mësuesit që kanë 10 vite eksperiencë profesionale 10%, kategoria e I, që nënkupton mësuesit që kanë 20 vite eksperiencë profesionale 20%.

2. Administrimi dhe Vlerësimi i Rezultateve

Procesi i kualifikimit realizohet bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për organizimin e kualifikimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”, si edhe të Rregullores së Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për provimet e kualifikimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.

Pas publikimit të dy dokumenteve zyrtare udhërrëfyese (IZHA) Instituti i Zhvillimit të Arsimit në bashkëpunim të ngushtë me (KK) Komisionin e Kualifikimit në MASH, kryen një sërë veprimtarishë të rëndësishme:

Përgatit programet orientuese për mësuesit sipas lëndëve dhe fushave lëndore ku vlerësohen mësuesit e sistemit arsimor parauniversitar. Këto programe përmbajnë aftësitë/kompetencat bazë që duhet të zotërojë mësuesi që merr pjesë në kualifikim si dhe burimet që mund të shfrytëzohen për zhvillimin e këtyre kompetencave.

Përgatit modelin e databazës së mësuesve, duke trajnuar DAR/ ZA-të për mënyrën e plotësimin të të dhënave personale të kandidatëve.

Harton kriteret e vlerësimit të portofolit të mësuesit të cilat përcillen në DAR/ ZA përmes seancave trajnuese dhe materialeve shpjeguese.

Harton fondin e pyetjeve për secilën nga lëndët e arsimit 9 vjeçar dhe të mesëm, të paraqitura në Udhëzimin e Ministrit (Udhëzimi i MASH, 2011).

Përzgjedh specialistët apo mësuesit që merren me hartimin e testeve në bazë të kriterëve të përcaktuara dhe monitoron procesin.

IZHA në bashkëpunim me Komisionin e Kualifikimit menaxhon dhe monitoron procesin e administrimit të testimit kombëtar, që zgjat 2 orë e 30 minuta.

Ngre komisionet e vlerësimit të përbërë nga dy specialistë të IZHA-s ose mësues të shkollave të Tiranës në bazë të kriterëve të paracaktuara.

Realizon hedhjen e pikëve në databazë si dhe nxjerrjen e rezultatit për secilin mësues.

Shpall rezultatet e arritjeve të mësuesve në DAR/ZA-të përkatëse, të cilat pas ankimeve të mundshme i përcjell në MASH.

3. Arritjet e Mësuesve në Kualifikimin 2011

3.1 Arritjet e Mësuesve në Nivel Kombëtar


Rezultatet e arritjeve të mësuesve në kualifikim përfaqësojnë një shumë arithmetike të arritjeve të tyre në tre komponentët kryesorë: Portofoli, i cili vlerësohet nga DAR/ZA-të, Bonuset dhe Testi, i cili vlerësohet në IZHA. Më poshtë janë paraqitur të dhëna përmbledhëse tabelare dhe grafike të arritjeve të mësuesve në kualifikimin 2011 sipas niveleve të vlerësimit: (A) Shkëlqyeshëm, (B) Shumë mirë, (C) Mirë, (D) Mjaftueshëm, (E) Dobët.

Tabela 1: Të dhëna përmbledhëse të arritjeve të mësuesve në kualifikimin 2011

| N r | DAR | A | % | B | % | C | % | D | % | E | % | Shum a |
|-----|---------|---|--------|-----|---------|-----|---------|----|---------|----|--------|--------|
| 1 | Berat | 3 | 1.90 % | 55 | 34.80 % | 81 | 51.20 % | 15 | 9.60% | 4 | 2.50 % | 158 |
| 2 | Dibër | 1 | 0.70 % | 44 | 29.50 % | 87 | 58.40 % | 16 | 10.70 % | 1 | 0.70 % | 149 |
| 3 | Durrës | 5 | 3% | 62 | 38.50 % | 83 | 51.50 % | 11 | 7.00% | 0 | 0% | 161 |
| 4 | Elbasan | 4 | 1% | 120 | 31.60 % | 216 | 56.80 % | 31 | 8% | 10 | 2.60 % | 381 |
| 5 | Fier | 6 | 1.50 % | 118 | 29.50 % | 237 | 59.20 % | 32 | 8% | 7 | 1.80 % | 400 |

KONFERENCA VJETORE E SHKENCËS 'JAVA E SHKENCËS 2012

| | | | | | | | | | | | | |
|----|---------------|---|--------|----|---------|-----|---------|----|---------|---|--------|------|
| 6 | Gjirokastr | 2 | 2.20 % | 36 | 39.50 % | 38 | 41.80 % | 14 | 15.40 % | 1 | 1.10 % | 91 |
| 7 | Korçë | 2 | 1% | 89 | 45% | 90 | 46.00 % | 10 | 5% | 6 | 3 | 197 |
| 8 | Kukës | 0 | 0% | 14 | 20.30 % | 41 | 59.40 % | 11 | 15.90 % | 3 | 4.40 % | 69 |
| 9 | Lezhë | 6 | 4% | 64 | 42.80 % | 72 | 48% | 7 | 4.60% | 1 | 0.60 % | 150 |
| 10 | Shkodër | 5 | 2.00 % | 97 | 34% | 147 | 52% | 28 | 10.00 % | 6 | 2% | 283 |
| 11 | Tiranë | 1 | 5.50 % | 12 | 49.60 % | 95 | 37.40 % | 16 | 6.50% | 3 | 1% | 254 |
| 12 | Tiranë Qark | 0 | 0% | 47 | 21.90 % | 127 | 59.30 % | 35 | 16.40 % | 5 | 2.40 % | 214 |
| 13 | Vlorë | 2 | 1% | 89 | 47.60 % | 83 | 44.40 % | 11 | 6.00% | 2 | 1% | 187 |
| | Totali | 5 | 1.86 % | 96 | 35.68 % | 139 | 51.86 % | 23 | 8.79% | 4 | 1.81 % | 2694 |



Grafiku 1: Të dhëna përmbledhëse në % të arritjeve të mësuesve në kualifikimin 2011

Duke parë me kujdes të dhënat rezultojnë se nga popullata e mësuesve që morën pjesë në kualifikimin 2011, 50 mësues ose 1.86% e tyre janë vlerësuar në nivelin më të lartë të arritjeve (A) Shkëlqyeshëm; 961 mësues ose 35.68% e tyre janë vlerësuar në nivelin (B) Shumë mirë; 1397 mësues ose 51.86% e tyre janë vlerësuar në nivelin (C) Mirë; 237 mësues ose 8.79% e tyre janë vlerësuar në nivelin (D) Mjaftueshëm dhe 49 mësues ose 1.81% e tyre janë vlerësuar në nivelin (E) Dobët, që do të thotë se nuk e kanë fituar shkallën e kualifikimit.


3.2 Arritje Krahasuese 2010 vs 2011

Në kualifikimin 2010 arritjet e mësuesve në vlerësimin përfundimtar janë vlerësuar me të njëjtat shkallë vlerësimi sikurse në kualifikimin 2011 (Raporti studimor, 2010). Më poshtë janë paraqitur të dhëna krahasuese të arritjeve në shifra dhe në %, tabelare dhe grafike në kualifikimin 2010 dhe në kualifikimin 2011.

KUMTESA

Tabela 2: Të dhëna krahasuese të arritjeve të mësuesve në kualifikimin 2010 dhe 2011

| | Shkëlqyeshëm | % | Shumë Mirë | % | Mirë | % | Mjaftueshëm | % | Dobët | % | Totali |
|------|--------------|-------|------------|--------|------|--------|-------------|--------|-------|-------|--------|
| 2010 | 11 | 0.47% | 471 | 19.97% | 1362 | 57.74% | 450 | 19.08% | 65 | 2.76% | 2359 |
| 2011 | 50 | 1.86% | 961 | 35.68% | 1397 | 51.86% | 237 | 8.79% | 49 | 1.81% | 2694 |



Grafiku2: Të dhëna krahasuese të arritjeve në % të mësuesve në kualifikimin 2010 dhe 2011

Duke krahasuar arritjet në kualifikimin 2010 me atë 2011, rezulton se kanë arritur vlerësimin (A) Shkëlqyeshëm 50 mësues në kualifikimin 2011 krahasur me 11 mësues që kishin arritur këtë rezultat në kualifikimin 2010, me një ndryshim numerik prej 39 mësuesish; ndërkohë në % ndryshimi është më i vogël vetëm 1.39% rritje në vitin 2011 krahasur me vitin 2010. Në kualifikimin 2011 kanë arritur vlerësimin (B) Shumë mirë 961 mësues nga 471 që e kishin arritur këtë nivel vlerësimi në kualifikimin 2010, me një diferencë numerike rritëse prej 490 mësuesish ose 15.71% më shumë. Në vitin 2011 kanë arritur vlerësimin (C) Mirë 1397 mësues krahasuar me 1362 që e kishin arritur këtë nivel në vitin 2010, me një diferencë numerike prej 35 mësuesish, por me një ulje në % prej 5.88%. Në vitin 2011 kanë arritur vlerësimin (D) Mjaftueshëm 237 mësues nga 450 mësues që e kishin arritur këtë nivel në vitin 2010, me një diferencë numerike pozitive prej 213 mësuesish dhe me një rritje në % prej 10.29%. Me nivelin e vlerësimit (E) Dobët në vitin 2011 janë vlerësuar 49 mësues nga 65 që ishin vlerësuar në vitin 2010, me një diferencë pozitive numerike prej 16 mësuesish ose 0.95%.

4. Konkluzione dhe Rekomandime

4.1 Konkluzione

KONFERENCA VJETORE E SHKENCËS 'JAVA E SHKENCËS 2012

- Më shumë se gjysma e mësuesve (52%) janë vlerësuar në nivelin C ose Mirë të arritjeve, duke treguar që përgjithësisht mbizotërojnë mësuesit që zotërojnë një nivel profesional në përputhje me standartet e duhura të mësimdhënies.
- Rreth 1/3 (36%) e mësuesve me nivel të arritjeve B (Shumë Mirë), tregojnë që një përqindje e konsiderueshme e tyre zotërojnë në nivel të lartë kompetencat e tyre në fushën e mësimdhënies duke garantuar në këtë mënyrë rritjen e cilësisë.
- Fakti që rreth 2% e mësuesve kanë arritur nivelin A (Shkëlqyeshëm), tregon që kemi një kontigjent të vogël mësuesish, të cilët përveç zotërimit në nivel të lartë të kompetencave profesionale, zotërojnë edhe kualifikime ekstra, të cilët plotësojnë më së miri konfiguracionin e një mësuesi eksellent.
- Shifra prej 10% e mësuesve të arsimit parauniversitar të cilët janë vlerësuar D Mjaftueshëm, ose E Dobët, tregon se kemi një kontigjent mësuesish, të cilët nuk e justifikojnë, ose e justifikojnë në një nivel mjaft të ulët detyrën e tyre të mësimdhënies.
- Arritjet e mësuesve në kualifikimin 2010 krahasuar me kualifikimin 2011 tregon se kemi tendencë në rritje në pothuajse të gjitha nivelet e vlerësimit, gjë që flet për një ndërgjegjësim në rritje të mësuesve për të arritur rezultate të larta.

4.2 Rekomandime

- Institucionet përgjegjëse të zhvillimit profesional të mësuesve duhet të hartojnë dhe të zbatojnë programe për zhvillimin profesional të mësuesve, që të përfshijë të gjitha kompetencat profesionale të mësuesve.
- Fakultetet e mësuesisë në universtete duhet të rishikojnë kurrikulat, me synim përgatitjen e mësuesve fillestarë më nivel të lartë profesional si në aftësitë shkencore ashtu edhe në aftësitë metodologjike apo në kompetencat e tjera.
- Institucionet administrative të edukimit duhet të promovojnë në karrierë mësuesit që arrijnë nivele vlerësimi A (Shkëlqyeshëm) dhe B (Shumë Mirë).
- Institucionet administrative të edukimit duhet shpërblejnë financiarisht në mënyrë të shkallëzuar në përputhje me nivelet e arritjeve të mësuesve.

KUMTESA

**Luljeta KABASHI M.A, Mehmet KASTRATI & Qëndrim PAJAZITAJ:
GJITHËPËRFSHIRJA E NXËNËSVE TË VERBËR DHE ME TË PARË TË DOBËSUAR NË
KLASA TË RREGULLTA- RASTE STUDIIMI**

Hyrja

Me Ligjin për arsimin parauniversitar gjithëpërfshirja pranohet si formë më e përshtatshme dhe se mundëson largimin nga izolimi i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në këtë rast edhe nxënësve të verbër dhe nxënësve me të parë të dobësuar. Në faktin se të verbërit shkollohen nuk ka asgjë të jashtëzakonshme. Tani pas gjashtë vjet themelimi të Qendrës së parë Burimore për mësim “Dr Xheladin Deda” në Pejë mund të analizojmë gjendjen e përkrahjes për nxënësit e verbër të integruar. Fëmijët e verbër si edhe fëmijët tjerë e dëshirojnë lojën dhe dëshirojnë të mësojnë, ta kenë klasën e tyre dhe mësuesin dhe të jetojnë me familjen e tyre. Që integrimi i fëmijës së verbër në shkollë të jetë i sukseshëm, të gjithë pjesëmarrësit në këtë proces duhet si ekip të marrin pjesë dhe çdo ditë të zgjerojnë kompetencat e veta me përvoja duke përcjellë literaturë, trajnime por edhe përvojën e arritur në punë me fëmijët e verbër.

Fakti që në shkollat e rregullta të Kosovës vijojnë mësimin nxënësit e verbër-mësimdhënësit mund t'i zë të papërgatitur për këto situata. Dhe në emër të proceseve gjithëpërfshirëse ka qenë nevojë e kohës të themelohen shërbimet për përkrahjen e nxënësve të përfshirë dhe mësimdhënëseve. Dhe kërkohet që nxënësi i verbër të përcjellë gjatë shkollimit përmes mësuesve udhëtues. Në Qendren Burimore për mësim “Dr Xheladin Deda” në Pejë aktualisht janë dy mësues udhëtues që mbështesin fëmijët e integruar në tërë Republikën e Kosovës.

Për këtë kemi analizuar dy raste studimi me fëmijë të verbër të integruar në sistemin e rregullt shkollor. Sa janë mësimdhënësit të përgatitur për përfshirjen e fëmijëve të verbër dhe më të parë të dobësuar dhe cilat janë nevojat e tyre për të ngritur kompetencën profesionale?

Detyrat e ndërlukuara që paraqiten para tyre, me nxënës të ndryshëm me nevoja të ndryshme në arsim është sfidë. Për këtë mësuesit duhet të jenë të drejtuar në punë ekipore me bashkëpunëtorë profesional dhe prindër, çka nënkupton zhvillim profesional të vazhdueshëm.

Praktika e mirë në mësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore varet nga faktor të numrët, dhe angazhimi i mësimdhënëseve është njëri nga më të rëndësishmit. Për të verbërit dhe atyre me shikim të dobësuar, dëgjimi dhe të prekurit janë shqisa kryesore, dhe kështu metodat e punës duhet të jenë të drejtuara nga këto dy shqisa.

Qendrat Burimore për mësim dhe procesi gjithëpërfshirës

Për shkaqe praktike përkrahja nga institucionet e specializuara siç janë Qendrat Burimore ka qenë nevojë e domosdoshme të realizohet edhe në praktikë.

Si paradigëm e re në edukim, nxënësit vinë si subjekt aktiv në procesin e përfshirjes për përmbushjen e nevojave individuale dhe duhet të shënohet se nxënësit kanë (a) karakteristika të ndryshme të stilit të nxënjes (b) objektiva të ndryshme të mësimin, (c) mjedise të ndryshme.

Kjo do të thotë se mbështetja me eksperiencë të përshtatshme tek individit kërkon metoda dhe burime për nxënje. Burimet për mësim dhe materialet çka përfshinë, libra, video-incizime, audio-kaseta, programe video, material didaktike dhe mjete tjera ndihmëse shtesë për specifikat e individit.

Qendra Burimore “Dr Xheladin Deda” Pejë

Tani pas gjashtë vjet themelimi të Qendrës së parë Burimore për mësim “Dr Xheladin Deda” në Pejë mund të analizojnë **gjendjen e përkrahjes** për nxënësit e verbër të integruar në sistem të rregullt arsimor. Qendrat Burimore për mësim janë themeluar me qëllim që ekspertizën e shkollave me nxënës me aftësi të kufizuara ta shpërndajnë në institucionet parashkollore, shkollat dhe organizatat e ndryshme, familjet dhe individët. Qendrat Burimore, janë njësi në përbërje të koordinatorit, mësimdhënësve udhëtues dhe grupit mbështetës për të dhënë përkrahje shkollave të rregullta për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.



Figura 1. Paraqitja skematike e funksionimit të Qendrës Burimore
Mësuesit udhëtues

Detyrat parësore të mësuesve udhëtues janë: identifikimi i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, dhënia e këshillave të nevojshme, organizimi i trajnime, ofrimi i materialeve, bashkëpunimi me arsimtar, prind, përgatitja e materialeve ndihmëse për nxënësit, krijimi i bazës së të dhënave.

“Puna e mësuesve udhëtues në teren ka ngritur vetëdijen dhe është pjesë e modelit social që nënkupton përcjelljen e përvojave nga shkollat me traditë në arsimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore drejt shkollave të rregullta. Kjo punë nënkupton edhe bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informatave nga të gjitha institucionet arsimore dhe gjithashtu organizatave të cilat janë të lidhura ngushtë me prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore”⁵²³

Sfidat e sistemit mbështetës

Numri i vogël i mësuesve udhëtues, numri i madh i nxënësve për tu dhënë ndihmë, shkollat e painformuara për organizimin e sistemit mbështetës, qëndrimet negative të udhëheqësve të shkollave, vet mësimdhënësve, terreni i largëta, mungesa e transportit sistematik, mësues udhëtues dhe ekipe bërthamë më kompetente, buxheti i ulët për shërbimet mbështetëse.

Hulumtimi

Për këtë kemi analizuar dy raste studimi me fëmijë të verbër të integruar në sistemin e rregullt shkollor. Rasti i parë është nxënësjja e verbër e integruar në shkollën “Ismail Qemali” në Prishtinë dhe rasti i dytë është në shkollën e muzikës “ në Ferizaj.

⁵²³ Luljeta Kabashi: Raporti vjetor i punës së mësuesëve udhëtues, MASHT 2010

Metodologjia

Me anën e pyetësorit janë intervistuar dy mësime të nxënës të integruar në shkollat e rregullta. Pyetësi ka përbajtur gjithsej 14 pyetje gjysëm të strukturura.

Qëllimi i hulumtimit:

- (a) Sa janë mësime të përgatitura për përfshirjen e fëmijëve të verbër dhe më të parë të dobësuar dhe
- (b) Cilat janë nevojat e tyre për të ngritur kompetencën profesionale në punë me nxënës të verbër dhe me dëmtime në të parë?

Rasti 1:

Nxënësjë me M.H e lindur në vitin 2006, është e përfshirë në klasën e rregullt në shkollën "Ismail Qemali" në Prishtinë nga klasa e parë. Në klasë ka gjithsej 36 nxënës, mësuesja e klasës nuk ka ndjekur asnjë edhe trajnim në Qendrën Burimore "Dr Xheladin Deda" në Pejë lidhur me punë me fëmijët e verbër. Në procesin arsimor të përditshëm mësuesja has në shumë vështirësi por me durimin dhe vullnetin e saj ajo ka filluar të përballojë sfidat. Mësuesja mëson nga përvoja e përditshme e saj duke tentuar të gjej zgjidhje të pranueshme. Orën mësimore mësuesja e realizon si me të gjithë nxënësit tjerë pa dallime në plan-program, vetëm se në orën e edukatës fizike në ndihmë vjen nëna e nxënëses për të përkrah pjesëmarrjen në aktivitet. Nxënësjë nuk i është hartuar plani individual i arsimit.

Bashkëpunimin më të madh e ka me mësuesit udhëtues të Qendrës Burimore "Dr Xheladin Deda" në Pejë dhe Shoqatën për të Verbër. Nga kjo Qendër ajo merr material të nevojshme siç janë letra e Brail-it, makinën dhe instrukcione të kohëpaskohëshme.

Brenga më e madhe e saj është vetëdijësimi i prindërve të fëmijëve të rregullt në klasë për të drejtën e shkollimit të nxënësve të përfshirë në klasë.




Figura 2. Test nga matematika




Figura 3. Diktim




Figura 4. Detyra nga matematika



Figura 5. Arti figurativ

Rasti 2

Nxënësi U.U i lindur me 31.07.1991 është transferuar nga Qendra Burimore “Dr Xheladin Deda” në Pejë në shkollën e mesme të muzikës në qytetin e Ferizajt prej nga vjen e dhe nxënësi. Mësimdhënësit fillimisht kanë pasur hezitimet lidhur me përfshirjen e nxënësit në proces arsimor dhe me kohe janë zbutur qendrimet dhe përfshirja konsiderohe si mjaft e sukseshme. Meritor për këtë sukses është nxënësi i cili ka dhënë shembull me sjellje dhe angazhim në këtë proces. Në klasë janë gjithsej 19 nxënës. Sfidë është ende mësimi i notave muzikore në Braill. Orët mësimore realizohen përmes dëgjimit dhe me shkrimin e Braillit. Ndërsa ora e edukatës fizike nuk realizohet.

Përfundim

E drejta për shkollim është e drejt themelore për të gjithë paramarr parasysh aftësisë ose joaftësisë. Prandaj përfshirja e nxënësve të verbër dhe me të parë të dobësuar është në përputhje me aktet ligjore dhe krejt çka i mbetet një shkolle moderne është përballja me sfidat që i ka.

Mësuesit udhëtues kanë një rol kyç në promovimin e praktikave përfshirëse dhe mund t'i japin një kontribut të çmuar zbatimit të arsimit gjithpërfshirës për fëmijët me nevoja të veçanta, për shkak të njohurive profesionale. Mësuesit udhëtues janë një burim njohurish për mësuesit e zakonshëm, por mbështetja që ata japin në klasë për nxënësit me nevoja të veçanta, organizohet nën përgjegjësinë e mësuesit të klasës ose të stafit pedagogjik në shkollë.

Mësuesit duhet të jenë të drejtuar në punë ekipore me bashkëpunëtorë profesional dhe prindër, çka nënkupton zhvillim profesional të vazhdueshëm. Praktika e mirë në mësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore varet nga faktor të shumë, dhe angazhimi i mësimdhënësve është më me rëndësi. Për të verbëritë dhe atyre me shikim të dobësuar, dëgjimi dhe të prekurit janë shqisa kryesore, kështu metodat e punës duhet të jenë të drejtuara nga këto dy shqisa.

Hartimi i planit individual të arsimit (PIA) nga mësuesja e klasës, mësuesit udhëtues, psikologu i shkollës, mësuesja gjithpërfshirëse, prindit etj.

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve është me rëndësi të veçantë për përfshirje kualitative.

Qendra Burimore “Dr Xheladin Deda” në Pejë duhet me urgjencë të organizoj trajnime të vazhdueshme për përgatitjen e mësimdhënësve të shkollave të rregullta për përfshirjen e nxënësve të

KONFERENCA VJETORE E SHKENCËS 'JAVA E SHKENCËS 2012

verbër dhe me të parë të dobësuar dhe trajnime informuese për prindërit e fëmijëve të verbër dhe atyre me shikim të “rregullt”

Arsimi gjithpërfshirës është në dobi jo vetëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të mësuar. Nga arsimi gjithpërfshirës përfitojnë të gjithë nxënësit, pavarësisht faktit në janë me aftësi të kufizuara apo jo, pasi dihet që të gjithë nxënësit kanë veçantitë e tyre në stilin e të nxënës dhe të shprehurit

Duke u rritur së bashku fëmijët mësojnë të bashkëjetojnë si të rritur dhe të punojnë bashkë për mirëqenien individuale dhe kolektive.

Recenzentë:
Prof.dr Behlul Brestovci
Dr.Murteza Osdautaj

KUMTESA

Doc. dr. Bojana GLOBAČNIK¹, Mr. sci. Vedat BAJRAMI²: VËSHTRIME MBI ARSIMIN NË MJEDISËT SHUMËKULTURORE (VIEWS ON EDUCATION IN MULTICULTURAL ENVIRONMENT)

¹*Ministry of Science, Education, Culture and Sport Republic of Slovenia*

²*Ministry of Science, Education and Technology Republic of Kosovo*

PËRMBLEDHJE

Ky artikull flet për pjesëmarrjen e fëmijëve të komuniteteve shumë gjuhësore në sistemet arsimore të disa shteteve të Evropës, të cilat sigurojnë qasje specifike arsimore ndaj këtyre fëmijëve dhe nxënësve. Në mesin e këtyre shteteve, si shembull shumë pozitiv, është përshkruar edhe situata e përfshirjes së fëmijëve me kultura të shumta gjuhësore në sistemin arsimor të Kosovës dhe atë të Sllovenisë.

FJALËT KYÇE

Fëmijët shumë gjuhësorë, shoqëria multikulturore, dialogu kulturor, sistemi arsimor, gjuha e pakicave, e para (gjuha amtare)

ABSTRACT

The goal of article is inclusion of disadvantaged children in education system in some of European countries, which needs specific approach of child or pupil. The articles how's also situation in education system on Kosovo and in Slovenia.

KEY WORDS

Disadvantaged children, multicultural society, cultural dialog, education system, minority language, first (mother) language

1. HYRJE

Në çdo proces arsimor është shumë me rëndësi përfshirja e fëmijëve të cilët janë bartës të shumë gjuhëve në meset ku jetojnë. Në procesin arsimor fëmijët mësojnë disa aftësi të nevojshme, dije dhe shkathtësi shoqërore, të cilat iu duhen për t'u inkuadruar në shoqërinë më të gjerë.

Në shoqëritë heterogjene, ndryshimin gjuhësor më së shumti e lidhim me marrëdhënien ndërmjet komunitetit shumicë dhe komunitetit pakicë, ose ndërmjet komunitetit dominues dhe jo dominues. Kultura, e me të edhe gjuha, është vetëm njëra nga përmbajtjet e cila e përcakton dallueshmërinë në shoqëri. Statuset e ndryshme dhe roli i ndonjë gjuhe, e bashkë me të edhe fuqia e ndonjë grupi individësh, më së shumti ka të bëjë me strategjitë e përshtatjes gjuhësore⁵²⁴.

⁵²⁴Lukanoviq, Novak. 2003

KUMTESA

Evropa dhe bota ndryshojnë sipas lëvizjeve të migracionit, të cilat kanë qenë gjithmonë karakteristike për Evropën. Në të kaluarën kryesisht shkaqet e migrimit kanë qenë të karakterit ekonomik, por sot përpos shkakut të përmendur ato vijnë edhe si rrjedhim i konflikteve etnike dhe luftërave. Mjerisht, në shumë vende të Evropës, popullata shumicë nuk e përkrah trashëgiminë kulturore të popullatës tjetër si pasuri të shoqërisë së vetë. Dallimet gjuhësore dhe kulturore ende shikohen si problematike.

Kultura është themeli kryesor i cilësdo shoqëri dhe është e lidhur me konceptin etik. Ajo paraqet sisteme të ndryshme të të menduarit dhe skemës njohëse të grupit të njerëzve ose identifikimin e ndonjë popullate. Shprehjen e vet, kultura e paraqet përmes vlerave të ndonjë mesi dhe e shpreh përmes bashkëveprimit të përditshëm⁵²⁵.

Në shumicën e kulturave, familja është e njohur si shembulli i vlerës përmes së cilës përcillet kultura dhe besimi kulturor nga një gjeneratë në tjetrën. Fëmijët mësojnë më së shumti nga modelet kulturore të prindërve të tyre në familje e më vonë edhe në çerdhe.

Etniteti është karakteristikë e disa grupeve të caktuara të cilat bëhen si: nacionale, kulturore ose gjuhësore. Ndonjëherë etniteti e zëvendëson racën. Kultura mund të bëhet edhe dobësi për pakicat etnike, për shkak të diskriminimit dhe mundësive të pakicave për inkuadrim në rrethet shumicë.

Standardet e zhvillimit në shoqëri formohen në bazë të: traditës historike, kornizës ligjore të disa shteteve dhe sistemit shoqëror.

Kohëve të fundit po diskutohet për problemet e integritimit evropian dhe globalizimit; lidhur me këtë përmendet edhe multikulturalizmi dhe *dialogu kulturor si aspekt i dallueshmërisë i cili është i lidhur me durueshmërinë*. Pa marrë parasysh këtë shtrohet pyetja, si të vihet kultura universale politike, e cila do të mundësonte drejtpeshimin ndërmjet individit dhe komunitetit, ndërmjet disa formave të jetesës dhe vlerave të ndryshme, të cilat hasen dhe ushqehen nga njëra-tjetra, duke treguar kështu karakteristikat individuale por dhe ato kolektive.

Çerdhja dhe shkolla janë vendet më të rëndësishme, ku mësojmë të jetojmë bashkërisht. Sa më i vogël të jetë fëmija, kontakti me kulturat dhe gjuhët tjera është më i natyrshëm. Për këtë edhe është shumë i rëndësishëm inkuadrimi i hershëm i fëmijëve në çerdhe.

2. FËMIJËT ME KOMUNIKIM SHUMËGJUHËSORË

Të dhënat për fëmijët me diversitet shumë gjuhësorë, është shumë vështirë të mblidhen sepse ekzistojnë sisteme të ndryshme statistikash dhe definicione të ndryshme të kësaj popullate të cilat nuk janë të harmonizuara në mes veti. Në nivel të Evropës deri tash nuk ka pasur asnjë instrument statistikor për përcjelljen e fëmijëve shumë gjuhësorë. Për këtë edhe të gjitha të dhënat janë të burimeve të ndryshme, prandaj ka shumë vlerësime të gjendjes. Për lidhjen e të dhënave ndërmjet fëmijëve shumë gjuhësorë dhe fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore (special education needs - SEN), është i rëndësishëm fakti të cilin e posedon agjencia evropiane për zhvillimin e arsimit në fushën e nevojave të veçanta (www.european-agency.org), se fëmijët shumë gjuhësorë të cilët njëkohësisht jetojnë edhe në varfëri, shpesh dërgohen për shkollim në institucione të specializuara⁵²⁶.

Në kuadër të aktivitetit profesional, flasim për fëmijët shumë gjuhësorë në dy shembuj:

- Kur fëmija dhe familja jetojnë së pari në territorin ku fliten shumë gjuhë (për shembull në Kosovë) dhe

- kur fëmija vjen në shtetin, i cili nuk është shteti i tij i lindjes, por këtu i ka kushërinjtë e vet (fëmijët në Suedi, Zvicër, Holandë, Gjermani, Finlandë, Slloveni etj.)

Në Evropë nuk ka harmonizim në përdorimin e një terminologjie për fëmijë ose nxënës të cilët flasin (shërbehen) në shumë gjuhë. Disa analiza përdorin shprehjen *pakica etnike* ose *grupe të*

⁵²⁵Rogoff, 2000 dhe Weisner. 1996

⁵²⁶Werning, 2008.

pakicës etnike (UNESCO, 1994, SIOS, 2004, 2006)⁵²⁷. Për dallim nga kjo OECD përdor shprehjen *fëmijë të emigracionit* (OECD, 2006) ose *fëmijë dygjuhësorë* ose *grupe pakicash* (Këshilli i Evropës, 2006).

Si *mjedis shumëkulturore*, mund ta marrim komunitetin shoqëror, ku janë të inkuadruar shumë folës në gjuhë të grupeve të ndryshme dhe ku janë në kontakt ose takohen kultura të ndryshme.

Fëmijët shumë gjuhësorë nuk janë fëmijë me invaliditet ose fëmijë me nevoja të veçanta në arsim, edhe pse shpesh ata mund të ngecin në zhvillimin arsimor dhe procesin e mësimin. Shkak për këtë është përdorimi i gjuhës që përdoret në çerdhe ose shkollë e cila është ndryshe nga gjuha që përdoret në familjen prej nga vjen fëmija. Për këtë shkak shpesh ndodhë që këta fëmijë të radhiten si fëmijë me nevoja të veçanta në arsimin. Më së shumti kanë mungesa në disa fusha të mësimin (vështirësi në lexim, shkrim dhe llogaritje). Këtij problemi kujdes të veçantë i kushton BE-ja dhe Këshilli i Evropës, sikur edhe UNESCO, e cila përcjell të dhënat statistikore për numrin e nxënësve romë në shkollat speciale dhe institucione. Nga ky shembull, së pari, është bërë i njohur problemi profesional, i cili ka dalë nga mosnjohja e situatës shume gjuhësorë të nxënësve, dhe, shpesh këtë situatë e përcjellin rastet e rënda sociale dhe ekonomike të këtyre familjeve.

2.1 Praktikrat e disa shteteve të Evropës

Gjermania

Është e përcaktuar me ligj, që në klasë nuk guxon të ketë më tepër se një e pesta e nxënësve fëmijë shumë gjuhësorë. Nëse në shkollë ka shumë fëmijë, atëherë është e mundur që për ta të formohen klasa të posaçme. Nëpër gjithë Gjermaninë janë formuar çerdhe për fëmijët parashkollorë, ku në këtë përbërje mësohet gjuha amtare. Një vit para fillimit të shkollimit, fëmijët kanë test gojor për njohjen e gjuhës gjermane. Nëse njohja nuk është e mjaftueshme, fëmijët ndjekin kursin e gjuhës gjermane. Fëmijët kanë mundësi që ta ndjekin kursin në tri nivele: themelor, të vazhdueshëm dhe si kurs mbështetës. Shkollat mund të shfrytëzojnë edhe orë shtesë për mësimin e gjuhës, sepse ato kanë autonomi që këto orë t'i rregullojnë vetë. Mesatarja për fëmijë është 2 orë në javë mësim plotësues.

Finlanda

Në Finlandë të gjithë fëmijët parashkollorë shumë gjuhësorë përfshihen në çerdhe. Qëllimi i përfshirjes së fëmijëve është qasja shumë gjuhësore (bilinguiste) e mësimin të gjuhës (finlandisht/suedisht dhe mësimi i gjuhës amtare). Shkollat fillore kanë koordinatorë për nxënës dhe grupe arsimtarësh për mësimin e fëmijëve shumë gjuhësorë. Në disa shkolla kanë edhe nxënës- tutorë dhe asistentë. Numri i orëve për mësimin e gjuhës është prej klasës së 6 – 10 nga 450 orë në vit, ndërsa për nxënës më të rritur deri në 500 orë. Shteti i financon disa aktivitete shtesë për fëmijët në gjuhën amtare. Finlanda në nivel kombëtar ka formuar rrjetin (network) të arsimtarëve, të cilët u ndihmojnë disa fëmijëve në shkollë.

Letonia

Në Letoni nga viti 2003, shkollat duhet të punësojnë koordinatorë për fëmijët e përkatësive shumë gjuhësore. Fëmijët emigrantë e ndjekin shkollimin si të tjerët, por kanë mundësi të mësojnë gjuhën letonishte në kurse plotësuese. Që në kohën parashkollorë ka mundësi të formohen grupe të posaçme. Numri i nxënësve në klasë, të cilët nuk kanë dije të mjaftueshme gjuhësore, mund të jetë më së shumti deri në 15. Për nxënësit të cilët kanë filluar të ndjekin shkollën fillore, por që nuk kanë kurrfarë dije të gjuhës **letoneze**, organizohen kurse intensive për mësimin e gjuhës. Kurset organizohen në kuadër të mësimin të rregullt shkollor.

Holanda

⁵²⁷Lindsay

KUMTESA

Sistemi ndihmës për fëmijët shumë gjuhësorë varet nga bashkësia lokale dhe disa shkolla. Shkollat dhe bashkësitë lokale, për format e ndihmës për fëmijët shumë gjuhësorë, kanë mjaft autonomi. Është karakteristikë e këtij shteti se klasat paraprake japin më shumë mundësi për qasje individuale në mësimin e gjuhës. Shkollat të cilat inkuadrojnë shumë fëmijë me nevoja të veçanta (*disadvantaged children*) marrin të holla shtesë (*staffinhours*) të cilat i shfrytëzojnë në forma të ndryshme: mund ta zvogëlojnë normativin nëpër klasa, mund të organizojnë orë shtesë të mësimin ose të kenë asistentë. Lartësia e mjeteve varet nga ajo se nga cili vend vijnë fëmijët dhe që se kohë jetojnë në Holandë.

2.2 Kosova

Kosova paraqet shembull të posaçëm dhe specifik të multikulturalizmit gjuhësor. Është e ditur se në Kosovë bashkë me popullatën shqiptare jetojnë edhe pjesëtarë tjerë të kombeve dhe komuniteteve si: serbët, boshnjakët, turqit, romët, ashkalinjtë, egjiptianët (RAE), gorarët dhe kroatët. Të gjitha komunitetet i kanë specifikat e veta të cilat janë në gjuhë, histori, kulturë, traditë dhe art. Duke pasur parasysh specifikat MASHT përpiqet t'u sigurojë të gjitha komuniteteve të cilat jetojnë në Kosovë arsimim cilësor në gjuhën e tyre.

Shumë kulturalizmi gjuhësor në Kosovë mund të tregohet në shumë mënyra. Mësimi parauniversitar mbahet në katër gjuhë: shqipe, serbishte, boshnjake dhe turke. Në bazë të të dhënave statistikore për vitin shkollor 2011/12 të SMIA në MASHT paraqesim pasqyrën e gjendjes së përgjithshme të numrit të nxënësve dhe paraqitjen në përqindje sipas niveleve të arsimit.

| Niveli | Shqiptarë | boshnjakë | ashkalinj | romë | kroatë | turq | egjiptianë | goranë | të tjerë | Gjithsej |
|--------------|--------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|---------------|
| Parashkollor | 5074 | 10 | 2 | 57 | 0 | 22 | 0 | 0 | 2 | 5167 |
| Përgatitor | 19546 | 295 | 159 | 79 | 3 | 154 | 52 | 0 | 0 | 20288 |
| Fillor | 282733 | 3926 | 3541 | 1566 | 31 | 2018 | 1378 | 12 | 9 | 295214 |
| I mesëm | 104320 | 1058 | 243 | 70 | 0 | 856 | 213 | 69 | 0 | 106829 |
| Gjithsej | 411673 | 5289 | 3945 | 1772 | 34 | 3050 | 1643 | 81 | 11 | 427498 |
| në % | 96,30 | 1,24 | 0,92 | 0,41 | 0,01 | 0,71 | 0,38 | 0,02 | 0,00 | 100,00 |

Mungojnë të dhënat për komunitetin serb.

Arsimimi shumëkulturore dhe arsimimi i fëmijëve në mesin tolerant çon drejt një begatie shumë kulturore të vërtetë.

Plani dhe programi mësimor është siguruar në të gjitha gjuhët e komuniteteve gjuhësore. Do t'i japim disa rezultate më të rëndësishme:

- Mësimi në gjuhën boshnjake mbahet në arsimin fillor dhe të mesëm për nevoja të boshnjakëve;
- Me mjete buxhetore të Qeverisë së Kosovës janë siguruar tekste nga Bosnja dhe Hercegovina për arsimin fillor dhe falas u janë shpërndarë nxënësve.
- Është siguruar dokumentacioni pedagogjik në gjuhën boshnjake, serbe dhe turke
- Janë zgjedhur 7 drejtorë boshnjakë në shkolla fillore dhe 1 drejtor turk dhe 3 zëvendësdrejtorë në mësimin turk dhe boshnjak.
- Për komunitetin RAE në Kosovë, MASHT është i fokusuar në implementimin e aktiviteteve të bazuara në “Strategjinë për integrimin e komuniteteve romë, ashkalinj dhe egjiptian në Kosovë 2009 -2015”. Njëri nga aktivitetet më të rëndësishme është fillimi i mësimin të gjuhës romë me elemente të kulturës dhe historisë si lëndë zgjedhore, që është realizuar në vitin 2011. Kjo lëndë ka filluar së zbatuari në 4 shkolla në Prizren dhe mbahet në 2 orë në javë. Ministria ka organizuar seminare me arsimtarë në temën lidhur me metodologjinë e gjuhës romë me elemente të historisë dhe kulturës romë.
- Me qëllim të gjithë përfshirjes (inkluzionit) në arsimin fillor, në shkollën “Selman Riza” të komunës së Fushë Kosovës janë regjistruar 53 nxënës nga komuniteti RAE, në vitin shkollor 2011/2012, të cilët nuk kanë qenë jashtë sistemit shkollor.

Mësimi universitar për komunitetet kombëtare

Është bërë përparim i madh viteve të fundit në kuadër të studimeve universitare në universitetet shtetërore (publike) në Prishtinë dhe Prizren, ku edhe pse ngadalë, është shtuar numri i vendeve për studim në gjuhën boshnjake dhe turke.

- Në vitin shkollor 2002/03 është hapur Fakulteti për biznes në Pejë në gjuhën boshnjake,
- Në vitin shkollor 2003/04 është hapur Fakulteti i Edukimit në Prizren në gjuhën boshnjake dhe turke, programi për mësim klasor
- Është mundësuar regjistrimi me kuotë lehtësimi në UP për pjesëtarë të komuniteteve të ndryshme, (boshnjakë, turq dhe RAE) duke filluar nga viti shkollor 2004/05 me qëllim të ngritjes së nivelit shkollor në kuadër të komuniteteve dhe integritimit të tyre në fakultetet e caktuara, ky numër vazhdimisht po rritet për 10 % për secilin vit.
- Janë hapur studimet pas universitare në Fakultetin filozofik në gjuhën turke.

Është i ditur fakti se edhe Kosova është mjedis shumëkulturore, ku jetojnë komunitete të ndryshme. Për këtë shkak kjo është temë e ndjeshme, e cila kërkon ndjeshmëri në procesin arsimor – edukativ edhe për ata që e planifikojnë politikën në nivelin lokal. Edhe shumë shtete të Evropës ndjekin politikë të posaçme për inkuadrimitin e fëmijëve të mërgimtarëve, të cilët vijnë në punë të përkohshme në botën e jashtme. Kështu janë fëmijët nga Kosova në ish- shtetet e Jugosllavisë: Slloveni, Bosnje dhe në shumë shtete të Evropës, SHBA-së dhe Australisë.

2. 3 Sllovenia

Sllovenia, me pozicionin e saj ndërmjet botës alpine, panonike dhe mesdhetare paraqet civilizimin, kulturën, gjuhët e një selie botërore, të cilat lidhin BE me shtetet e Ballkanit. Këto shtete me hapjen e tyre relative paraqesin hapësirë tolerante për dialog ndërkombëtar. Mësimi i gjuhës së shumicës dhe pakicës është qëllim i çdo politike bashkëkohore gjuhësore në territoret me popullsi të përzier në Slloveni. Suksesi i këtij qëllimi të përcaktuar tregohet në sistemin dygjuhësor të arsimit⁵²⁸.

Për Slloveninë mund të themi se kur e kemi parasysh popullsinë kombëtare është vend tipik njëkombesh. Në Kushtetutën e Republikës së Sllovenisë janë të pranura pakica italiane dhe hungareze, në territorin shtetëror, afër Italisë dhe Hungarisë. Fëmijëve që u përkasin pakicave kombëtare u janë siguruar të drejta të barabarta mësimore në italisht – sllovenisht ose sllovenisht - hungarisht. Në këtë mënyrë janë hartuar edhe tekstet për përcjelljen e mësimi. Arsimtarët duhet të kenë verifikim të dijes në të dyja gjuhët.

Prandaj, në Slloveni kornizë të vërtetë paraqet për të huajt qasja e arsimit të detyrueshëm shkollor në kushte të njëjta, sikur që është për qytetarët e Republikës së Sllovenisë dhe me mundësi të shkollimit edhe në shkollat e mesme dhe të larta.

Ligji për shkollën fillore paraqet kërkesë, që për qytetarët e Republikës së Sllovenisë, për të cilët gjuhë amtare nuk është sllovenishtja, në kuadër të respektimit të dokumenteve ndërkombëtare, mësimi organizohet edhe në gjuhën dhe kulturën e tyre amtare. Në këtë mënyrë stimulohet mësimi i të dy gjuhëve (qasja dygjuhësore), që është e dobishme për shumë aspekte. Të shprehurit në shumë gjuhë nxënësit i hap shumë mundësi plotësuese në kuadër të arsimit dhe zhvillimit profesional dhe përmirësimit të mundësive në kuadër të punësimit.

4. PËRFUNDIM

⁵²⁸Necal, Luk 2003

KUMTESA

Përfshirja e fëmijëve shumëgjuhësorë, si dhe fëmijëve të emigrantëve në sistemin arsimor po bëhet çdoherë e më shumë temë e rëndësishme për ata që krijojnë politikën në nivel kombëtar. Rezultati studimeve PISA (OECD, 2006), tërheqin vërejtjen në dallime të mëdha ndërmjet fëmijëve emigrantë dhe moshatarëve të tyre, që gjenden në rrethin shtëpiak. Përpos kësaj duhet pasur parasysh që këta fëmijë shpesh janë nga mese shoqërore të rrezikuara dhe që prindërit e tyre janë pak të arsimuar. Ky fakt na tregon, se edhe Evropa nuk ka ndonjë praktikë të mirë. Të gjitha shtetet e BE japin mundësi për shkollimin fillor të fëmijëve të vet.

Nxënësve u jepet ndihmë për të mësuar gjuhën më kryesore mësimore. Mënyra e ndihmës është e ndryshme, prej ofrimit të disa orëve në grupe të vogla ose individualisht. Përpos kësaj duhet theksuar, se së shpejti në të gjitha shtetet e BE ekziston mundësia, që fëmijët të mësojnë në gjuhën e tyre amtare. Zakonisht shkollat nuk pajtohen që të zbatohet ky mësim, por është vënë vetëm si kornizë ligjore. Kurset e gjuhës amtare mbahen në bazë të marrëveshjeve ndërmjet shkollës dhe shtetit të origjinës, prej nga janë nxënësit. Ky mësim në masë të madhe varet nga numri i nxënësve, interesimi i prindërve dhe kualifikimi i arsimtarëve. Të gjitha këto kushte nuk është e mundur që gjithherë të përmbushen. Më së shpeshti vjen deri te pengesa e përcjelljes sepse arsimtarët nuk kanë dije të mjaftueshme dhe material mësimor, në bazë të të cilit përmbajtjet shumëkulturore dhe dialogut shumëkulturore, t'i fusin në mësimin shkollor dhe në aktivitetet tjera shkollore.

Praktikat në disa shtete janë të shumëllojshme dhe për këtë është vështirë të përcaktohet cila është praktika më e mirë. Për këtë shkak secili shtet duhet të zhvillojë sistem të tillë në bazë të dialogut shumëkulturore, i cili do t'i kënaqte të gjithë qytetarët, pjesëtarë të pakicave të ndryshme të disa vendeve dhe do t'u ofronte përdorim të barabartë të gjuhës dhe pranim të kulturave të ndryshme.

Në kuadër të politikës gjuhësore e cila është me rëndësi për vendet ku veprojnë shumë gjuhë duhet zhvilluar durueshmëri ndaj gjuhës, zhvillimin e barabarësisë gjuhësore, respektim të ndryshueshmërisë dhe respektim të të drejtave të fëmijëve dhe të drejtave njerëzore.

Për Kosovën mund të konstatojmë se ka situatë specifike gjuhësore, që mund ta krahasojmë me praktikën e Sllovenisë, ku veprojnë pakica të caktuara kombëtare. Statusi i kombësisë dhe gjuhës së pakicës janë shpesh çështje e kornizës ligjore të disa shteteve. Duhet theksuar se në çerdhe dhe shkolla është hapësira ku zhvillohet durueshmëria (toleranca) kulturore dhe vihet dialogu shumëgjuhësor e shumëkulturore.

**Zeqir VESELAJ¹, DR. Mihallaq QIRJO², MA. Zenel KRASNIQI³: NXËNËSI SI
PROMOTOR I EDUKIMIT DHE VETËDIJËSIMIT MJEDISOR NË SHOQËRINË NË
TRANZICION- RASTI I KOSOVËS**

1. Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës

2. Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës
r., Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës

Abstrakt

Edukimi mjedisor po zë një vend gjithnjë e më të mirë në kurrikulin e sistemit arsimor në Republikën e Kosovës. Ky punim paraqet një analizë të procesit reformave të sistemit arsimor në vendin tonë ku qasja kryesore është ajo me nxënësin në qendër. Kështu nxënësi mund të jetë promotor i fuqishëm i përmirësimit të situatës mjedisore në shoqëri përmes një edukimi më të fuqishëm dhe modern. Nxënësi është anëtar i një familje, ndërsa familja baza e shoqërisë. Futja e edukimit mjedisor si lëndë e veçantë apo ndër-kurrikulare është temë e diskutimit jo vetëm në Kosovë por edhe më gjërë duke favorizuar herë njëherën e herë tjetrin opcion. Futja në sistemin arsimor e materialeve moderne didaktike mjedisore si Paketa e Gjelbër është një hap i madh në këtë drejtim. Mirëpo kjo Paketë aktualisht mbulon vetëm shkollën e mesme të ulët (klasa nga VI-IX), e jo edhe shkollimin fillor (klasa nga I-V).

Fjalët kyqe: edukimi, kurrikuli, mjedisi, nxënësi, paketa e gjelbër,

Hyrje

Definicioni edukim mjedisor, pas disa dekadash përdorimi në qarqet edukative qoftë si e zakonshme apo e rastit, më në fund është bërë pjesë e fjalorit bashkohor të edukimit. Kjo është me rëndësi të madhe, sepse definitivisht po adresohen nevojat e edukimit të qytetarëve të globit për marrëdhëniet e tyre me planetin Tokë.

Edukimi mjedisor nuk është dicka e re në botëkutimet e ekspertëve arsimor, dhe nuk është futur me rritjen e brengave për mjedisin dhe me nismat e reja kurrikulare. Ky proces ka evoluar për vite e dekada me radhë.

Ngjarja e parë e madhe në histori, që ka synuar ta definoj termin edukim mjedisor ishte Konferenca Ndërkombëtare për Kurrikulin e Edukimit Mjedisor me 1970 në Carson City (Nevada SHBA). Në Konferencë u propozua dhe u aprovua një definim klasik për edukimin mjedisor i cili thotë: edukimi mjedisor është një proces i njohjes së vlerave dhe qartësisht të koncepteve me qëllim që të zhvilloj aftësitë dhe qendrimet e domosdoshme për të kuptuar dhe vlerësuar marrëdhëniet dhe ndërveprimet në mes njeriut, kulturës dhe rrethinës së tij biofizike. Edukimi mjedisor gjithashtu p[er]fshin. praktikën në vendimmarrje dhe vet-formulimin e kodit për sjelljet që kanë të bëjnë me çështjet e cilësisë së mjedisit” (IUCN, 1970). Ky definim u promovua edhe më tutje, dhe po me 1970 në SHBA aprovohet Ligji për Edukimin Mjedisor që i jep një stimulim të fuqishëm ngritjes së vetëdijes për mjedisin.

KUMTESA

Konferenca e Stokholmit për Mjedisin Njerëzor e OKB me 1972, në parimin e saj të 19 deklaroi se “edukimi mjedisor është çështje e gjeneratave të reja aq sa edhe e të rriturve”. Pra, Konferenca i bën edhe femijët pjesë integrale të sistemit global për ruajtjen e mjedisit.


Me 1975 UNESCO/UNEP themelon Programin Ndërkombëtar për Edukimin Mjedisor (IEEP) si nisma e parë ndërqeveritare për edukimin mjedisor. Në takimin e parë, IEEP hartoi dokumentin e quajtur “Karta për Kornizën Globale për Edukimin Mjedisor” ku disa prej objektivave kryesore të saj ishin:

1. Të nxis vetëdijën dhe brengën për ndërlidhjen ekonomike, sociale, politike dhe ekologjike në zonat urbane dhe rurale;
2. Të ofroj për çdo person mundësitë për të fituar njohuri për vlerat, qëndrimet, angazhimet dhe aftësitë e nevojshme për të mbrojtur dhe përmirësuar mjedisin
3. Të krijoj modele të reja të sjelljeve të individëve, grupeve dhe shoqërisë si tërësi ndaj mjedisit.

Me 1997 mbahet Konferenca e Parë Ndërqeveritare e UNESCOs për Edukimin mjedisor me pjesëmarrjen e 66 shteteve. Kjo konferencë përgatiti themelet për aplikimin e gjërë të edukimit formal dhe joformal mjedisor. Edhe edukimi formal dhe ai joformal duhet të shfrytëzohet mjediset lokale dhe në distancë për të ofruar njohuri, trajnime në aftësi të duhura dhe përvoja nga dora e parë.

Nxënësit duhet të njihen me konceptet dhe vlerat mjedisore, praktikat e vendim-marrjes dhe tu ofrohen mundësitë për përfshirje individuale. Nxënësit duhet të trajnohen për të vlerësuar në aspektin kritik shumë pikëpamje të shfaqura deri sot në çështjet mjedisore.

Edukimi mjedisor duhet të përfshijë të gjithë kurrikulumin brenda dhe jashtë shkollës. Secila shkollë duhet të ketë aranzhimet adekuate për planifikim dhe implementim të programeve të edukimit mjedisor. Bërja e edukimit mjedisor si lëndë e vecantë është ose e padëshiruar ose e pamundshme.



Koncepti i qëndrueshmërisë dhe ndërlidhjes me edukimin mjedisor

Programi i edukimit mjedisor, duhet të fillojë në edukimin fillor, të vazhdojë në të mesmen dhe duhet të vazhdojë si edukim joformal mjedisor në jetën e mëvonshme. Edukimi mjedisor përmbledhet si:

- proces gjatë gjithë jetës;
- interdisciplinar dhe holistik në natyrën dhe aplikimin e tij

- një qasje që të mësohet në të gjitha lëndët se sa një lëndë e veçantë
- marrëdhënie reciproke dhe ndërlidhje mes njeriut dhe sistemit natyror.

Ka diskutime të hapura shkencore rreth termeve edukim mjedisor dhe edukimi për zhvillim të qendreshem. Në këtë aspekt duhet potencuar se “edukimi mjedisor mbështet por mbulon një spektër të ngushtë në krahasim me edukimin për zhvillim të qëndrueshëm. Integrimi i aspekteve të zhvillimit të qëndrueshëm në mendimin dhe veprimin akademik definohet si një qëndrueshm[ri ekonomike, socio-kulturore dhe mjedisore.

Edukimi mjedisor në kurrikulin e Kosovës

Korniza kurrikulimit e aprovuar në vitin 2011, promovon qasjen në kompetenca, të cilat zhvillohen përmes të nxëniet që bazohet në punën praktike. Kalimi nga kurrikulumi i bazuar në përmbajtje në kurrikulumi që bazohet në kompetenca synon mobilizimin e potencialit të rinisë kosovare që me sukses të konkurrojë në tregun e punës, si në vend ashtu edhe jashtë vendit. Aspirata është që përfitimet potenciale që mund të pasojnë nga numri gjithnjë në rritje i të rinjve të arsimuar, të shfrytëzohen maksimalisht për përmirësimin e shoqërisë kosovare, ekonomisë dhe mjedisit. Realizimi i procesit mësimor në arsimin fillor bëhet në mënyrë të integruar, duke mundësuar që raporti i fëmijëve me mjedisin natyror dhe mjedisin e krijuar të kuptohet në mënyrë sa më të plotë.

Aspekti më i rëndësishëm i Kurrikulimit është përcaktimi i tij si një fushë e veçantë mësimore në kuadër të fushës mësimore shoqëria dhe mjedisi. Kjo pastaj shkon duke u zbatuar përmes perspektivave dhe sfidave në shkallë të ndryshme të kurrikulimit. Në shkallën e kurrikulimit 0, fëmijët përmes lojës përkrahen në zhvillimin e hershëm personal përfshirë vetëdijësimin gradual për veten, të tjerët dhe mjedisin që i rrethon. Në shkallën e kurrikulimit 1, fëmijët do të ekspozohen qasjeve të të nxëniet më sistematik, përfshirë përvojat e të nxëniet si hulumtimi i mjedisit në mënyrë më sistematike. Në shkallën e kurrikulimit 2 fëmijët u ekspozohen sfidave të të kuptuarit e përgjegjësisë për vetveten, të tjerët dhe për mjedisin.

Në shkallën 3 synohet thellim i dijeve në kuadër të fushave të ndryshme mësimore, duke siguruar një bazë fillestare për orientim akademik dhe në karrierë. Nxënësit i ekspozohen sfidave për kultivimin e interesimit për njohje të mjedisit natyror e shoqëror si dhe zhvillimin e përgjegjshmërisë për pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore dhe mbrojtje të mjedisit.

Instrumentet për edukimin mjedisor në Kosovë

Paketa e Gjellbër është një kurikulum i edukimit mjedisor i nivelit mesatar kryesisht për fëmijë, i orientuar për mësuesit e shkollave nëntevjeçare dhe nxënësit e tyre që sot implementohet në 18 shtete. Ajo fokuson në mënyrë të veçantë aspektet e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm dhe përfshin një numër të madh materialesh edukative si: libri i mësuesit së bashku me planin e mësimor dhe fletët informuese për nxënësit, një koleksion me klipe filmash të shkurtër vizatimor dhe edukativë, CD me informacione më të zgjeruara mbi temat të ndryshme mjedisore si dhe lojërat e dilemave. Pra, përdoruesit do të mund të vijojnë planin mësimor, duke e plotësuar me prezantimin e përmbajtjes nga videoja, informacionet nga CD-ja dhe faqet e tjera të internetit mbi edukimin mjedisor.

Paketa e Gjellbër formon vlera të reja tek nxënësit, si dhe nxit një model të ri sjelljeve në shkollë, shtëpi dhe shoqëri. Ajo nuk është thjeshtë vetëm një përmbledhje njohurish në fushat e mjedisit. Nxënësit janë partnerë me mësuesit në kryerjen e aktiviteteve të ndryshme, diskutim dhe vendimmarrje. Mesazhet kryesore të saj shpërndahen nëpërmjet nxënësve dhe mësuesve, në mënyrë shumë efektive edhe tek anëtarët e tjerë të familjes dhe shoqërisë.

Paketa e Gjellbër përmban 22 tema në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm, të ndara në 5 kapituj si më poshtë:

| PËRBËRSIT MJEDISIT | EKËRCËNIMET DHE PRESIONET | AKTIVITETI NJERËZOR | SFIDAT GLOBALE | VLERAT |
|-----------------------|------------------------------|------------------------|-------------------|--------|
|-----------------------|------------------------------|------------------------|-------------------|--------|

KUMTESA

| | | | | |
|---------------------------------------|---|---|---|---|
| Ajri Uji Dheu Biodiversiteti | Urbanizimi Zhurma Mbeturinat Kimikatet | Energjia Transporti Industria Bujqësia Pyjet Turizmi | Ndryshimet klimatike Hollimi i shtresës së ozonit Acidifikimi Detet dhe oqeanet. | Shoqëria e konsumit Shëndeti dhe mjedisi Të drejtat e qytetarëve; Toka jonë në të ardhmen. |
|---------------------------------------|---|---|---|---|

Secili prej komponentëve kryesorë të Paketës së Gjellbër: CD-ja, Libri i mësuesit, DVD si dhe dilemat ndjekin të njëjtën strukturë në bazë të Planit mësimor të dhënë në fund të Paketsës.

Përfundime

Edukimi mjedisor tashmë është bërë pjesë e rëndësishme e fjalorëve të edukimit dhe si i tillë është duke u punuar në mënyrë të gjithanshme për promovimin sa më të mirë të tij. Edhe në Kosovë janë bërë hapa të rëndësishëm për përmirsimin e shkallës së vetëdijes mjedisore përfshirë gjeneratat shkollore. Futja e mjedisit si fushë e veçantë mësimore tek “Shoqëria dhe mjedisi” si dhe trajtimin ndër-kurrikular i temave është në trend me zhvillimet moderne në këtë fushë. Zhvillimi dhe implementimi i Paketës së Gjellbër nga shkencëtarët kosovar dhe të huaj ka ofruar para nxënësve kosovar dhe sistemit shkolror në përgjithësi një instrument të rëndësishëm dhe shumë modern të edukimit mjedisor. Megjithatë ende mungon një instrument i tillë për shkallën e kurrikulit 1 dhe 2 dhe i cili pritet të zhvillohet së shpejti në mënyrë që të kompletohet komponenta e edukimit mjedisor në sistemin fillor të arsimit.

Ma .Mirela KARABINA¹: PERCEPTIMI I MESUSEVE PER FORMEN DHE STILIN E DREJTIMIT TE SHKOLLES.

(¹)Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Shkencave Sociale
Departamenti Pedagogji-Psikologji

Abstrakt

Ky shkrim është një përpjekje për të krijuar mundësinë e njohjes së formës dhe stilin të drejtimit të shkollës, si një faktor i rëndësishëm në arritjen e rezultateve dhe klimës pozitive, mundësisë së ndërhyrjes për përmirësimin e formës së drejtimit. Pyetja e ngritur është: “Cili është stili i drejtimit që përdoret në shkollat 9-vjeçare të qytetit të Tiranës?” Për këtë është zhvilluar pyetësor me mësues për të parë perceptimin e tyre mbi formën e drejtimit të shkollës. Janë ballafaquar rezultatet e pyetësorit me teorinë dhe studimet aktuale të stilit të drejtimit të shkollës, rëndësisë së përdorimit të disa stileve të ndërthurura për të kuptuar rëndësinë dhe mundësinë e përmirësimit të tyre. Rezultatet e studimit kanë mbështetur hipotezën e ngritur se: ”Stili i përdorur është bashkëpunues dhe konsultativ”. Mbi këtë bazë janë dhënë konkluzione dhe rekomandime, të cilat janë parë si ndihmesa në këtë fushë dhe do të shërbejnë si mbështetje për njohjen dhe përmirësimin e drejtimit të shkollës.

1.Hyrje

Një nga çështjet me interes në fushën e drejtimit të shkollës është stili i drejtimit, dhe specifikisht lloji i stilit që përdoret nga drejtuesit, efikasiteti i tyre. Në trashëgojmë një traditë, e cila ka krijuar kulturën tonë të drejtimit. E kaluar nga një brez në tjetër, kjo formë vjen duke u ndryshuar për arsye të zhvillimit të shoqërisë. Në këtë shoqëri që ndryshon, roli i drejtuesit është i rëndësishëm, por edhe i vështirë. Përkushtimi ynë profesional, qytetar, human, duhet të jetë në ndihmesën për të treguar rrugët dhe mundësitë pozitive, koherente, efektive për përmirësimin e stileve të drejtimit (Fullan, 2010). Në kushtet aktuale drejtimi i shkollës paraqet probleme të karaktereve të ndryshme. Kapacitetet drejtuese herë-herë janë të diskutueshëm dhe sjellin problematikën e tyre në drejtim. Tradita, eksperiencia, gjendja aktuale kërkon një vemendje nga të gjithë aktorët për këtë çështje.

1.1 Qëllimi i studimit:

Vlerësimi i stileve të drejtimit që aplikohen sot në shkollat 9-vjeçare të qytetit të Tiranës.

1.2 Objektivat e studimit

- 1.Të identifikojë stilet e drejtimit në shkollat 9- vjeçare të qytetit të Tiranës.
- 2.Të pasqyrojë format dhe stilet e drejtimit në teorinë dhe studimet aktuale.
- 3.Të pasqyrojë opinionin e mësuesve mbi formën e drejtimit.
- 4.Të ofrojë rekomandime për përmirësimin e drejtimit të shkollës.

2.Shqyrtimi i literaturës

Eksperiencia e vendeve perëndimore afron analiza dhe raporte, ku roli i drejtuesit në arritjet e shkollës është parësor. Në praktikën tonë në analiza dhe raporte, drejtuesi është parë si një nga faktorët në ecurinë e shkollës, por jo si çelësi i suksesit të saj. “Drejtimi nuk është mobilizimi i të tjerëve për të zgjidhur problemin, sepse ato e dinë si ta zgjidhim, por t, i ndihmojë ato të përballen me problemin, i cili nuk është zgjidhur me sukses” (Fullan, 2004, fq.1).

Peter Drucker, teoricien i menaxhimit shprehte se menaxhuesit i japin organizatës drejtimin dhe vendosin si t’i përdorin burimet e organizatës, qoftë kjo ndërmarrje prodhuese apo shkollë. Duke

KUMTESA

udhëzuar punonjësit, duke afruar udhëheqësin, menaxherët arrijnë të realizojnë objektivat. (Nano, 2003).

Drejtimi një art, drejtuesi një krijues: dy koncepte të lidhura ngushtë me njëri tjetrin. "Një drejtues i mirë mendon dhe vepron duke u kujdesur për mësuesit dhe rezultatet e tyre, sepse mësuesit që ndjehen mirë në vetvete, me siguri arrijnë rezultate të mira" (Aliçka, 1998. fq 13). Drejtuesi duhet të marrë përgjegjësi dhe të krijojë një ekip rezultativ të jetë frymëzim, nxitje për stafin me shembull personal dhe marrje përgjegjësish. Një nocion i ri përdoret për: *drejtuesit vizionare, udhëheqje vizionare, udhëheqje e transformimit*. Rëndësia e vizionit, kur një drejtues është i qartë është atribut i një udhëheqje të suksesshme. Vizioni i drejtuesve përfshin ndryshimet në nivel shkollë: ndryshim në menaxhimin e mësimdhënies dhe të nxënës, në menaxhimin e njerëzve, në menaxhimin e politikës dhe të planifikimit të zhvillimit të shkollës, në menaxhimin e burimeve dhe financës së shkollës. Vizioni i drejtuesit është organizativ, ai përfshin gjithë sistemin, ndërsa vizioni i mësuesve përqëndrohet në veprime individuale dhe personale për ndryshimin e shkollës (Mita, 2004).

Organizimi dhe drejtimi i jetës së shkollës është një proces kompleks dhe i vështirë. Vështirësitë që has drejtori i shkollës në punën e tij janë se "... mësuesit janë konservatorë, individualistë dhe të orientuar drejt problemeve të çastit" (Pasku, 2003. fq.6).

Drejtori duhet të udhëheqë grupin dhe duhet të jetë: udhëheqës, komunikues, thithës, gjenerues, vendimmarrës, ndjekës, konsekuent i zbatimit të vendimit, vlerësues i vetes së tij, koordinues (Aliçka, 1998). Udhëheqësit duhet të jenë në gjendje të parashikojnë saktë nevojat e mësuesve të tyre, fuqizimin e tyre për të ndarë vizionin, dhe mundësimin të krijimit të një klime pozitive. Drejtimi ka thjeshtësinë, por dhe kompleksitetin (Fullan 2001).

Sipas Goleman (Fullan 2001), duke qene se drejtimi është një proces i ndërlikuar drejtuesi duhet të përdorë disa stile drejtimi. Ai listoi katër stile si të rëndësishme që krijojnë atmosferë pozitive dhe arrijnë rezultate: stili autoritar, bashkëpunues, konsultativ, demokratik. "Drejtesit që zotërojnë katër ose më shumë, sidomos stilin autoritar, demokratik, bashkëpunues dhe trajnues – kanë atmosferë më të mirë dhe punët iu ecin mirë. Dhe drejtuesit më të frytshëm kalojnë nga një stil në tjetrin, sipas nevojës. Ata arrijnë ta kuptojnë shumë mirë ndikimin që kanë mbi të tjerët dhe e përshtasin stilin në mënyrën e duhur, për të arritur rezultate më të mira" (Golemann, 2000; Fullan 2001, fq.226). Duke shqyrtuar literaturën del qartë se drejtori i shkollës duhet të ketë aftësi dhe zotësi për të kryer me sukses detyrën e tij. Ai duhet të jetë: vizionar, njerëzor, mbështetës, bashkëpunues. Drejtimi duhet të jetë i orientuar si në arritjen e rezultateteve, ashtu dhe në marrëdhëniet njerëzore. Për drejtuesin është i rëndësishëm; komunikimi me stafin, vendimmarrja, delegimi i kompetencave, motivimi i stafit, lidhjet publike, vlerësimi. Në situata të ndryshme ai të jetë vizionari, zgjidhësi i problemeve dhe ecurisë së procesit mësimor.

3. Metodologjia

Për qëllimin e këtij studimi është përdorur kërkimi deskriptiv, i cili përshkruan se cili është stili i drejtimit. sipas perceptimit të mësuesve. Përmes shqyrtimit kritik të literaturës është dhënë një tablo e teorive dhe studimeve aktuale. Ky studim realizon matje të llojit të drejtimit përmes një përjasjeje sasiore duke përdorur mbledhjen e të dhënave përmes pyetësorëve për mësuesit, për të kuptuar perceptimin e tyre për drejtimin e shkollës dhe analizës së tyre.

Instrumenti i përdorur në studim është pyetësor. Pyetësori është i standartizuar dhe përmban 23 pohime. Kampioni është: 35 mësues të shkollave 9-vjeçare të qytetit të Tiranës. Pyetësorët janë përpunuar me SPSS (Statistical Package for Social Scientists Sofëare) version 16, e cila ka lehtësuar nxjerrjen e të dhënave sasiore. Pyetësori ka synuar mbledhjen e informacionit specifik.

4. Gjetjet

Janë paraqitur rezultatet kryesore të pjesës sasiore të kërkimit, pyetësorëve të mësuesve.

Tabela

| Gjetjet kryesore | | Frekuenca e vlerave ne % | | | |
|------------------|---------------------------------------|--------------------------|------------|--------|-----------|
| | | Pothuajse asnjëherë | Ndonjëherë | Shpesh | Gjithmonë |
| 1 | Percentimi i mësuesve mbi komunikimin | | 8.6 | 40.0 | 51.4 |

| | e udhëzimeve nga drejtori (variabli 1) | | | | |
|---|--|------|------|------|------|
| 2 | Perceptimi i mësuesve për vendimarrjen për çështje të ndryshme në shkollë.(orët,kurrikula, plani i punës).(variabli 2) | 17.1 | 22.9 | 37.1 | 22.9 |
| 3 | Perceptimi i mësuesve për drejtorin për të qenë i hapur për të mirëpritur ide.(variabli 3) | 17.1 | 31.4 | 31.4 | 20.0 |
| 4 | Perceptimi i mësuesve për shmangien e konfliktit në shkollë.(variabli 8) | 25.7 | 17.1 | 28.6 | 28.6 |
| 5 | Perceptimi i mësuesve për marrëdhënien emocionale të drejtorit me mësuesit (variabli 9). | 34.3 | 34.3 | 22.9 | 8.6 |
| 6 | Perceptimi i mësuesve mbi krijimin e mundësive të bashkëpunimit me shkollat dhe institucione tjera(variabli 15) | 11.4 | 42.9 | 40.0 | 5.7 |
| 7 | Perceptimi i mësuesve për ndihmën e drejtorit për zgjidhjen e sfidave problemeve në punë (variabli 17) | 2.9 | 47.1 | 32.4 | 17.6 |
| 8 | Perceptimi i mësuesve për zhvillimin e analizave të hapura me të gjithë aktorët (variabli 23) | 22.9 | 20.0 | 25.7 | 31.4 |

Tabela: janë pasqyruar vetëm gjetjet, përkatësisht variablat,1,2,3,8,9,15,17,23.

5.Analiza e gjetjeve

Duke analizuar gjetjet, veme re se perceptimi i mësuesve për drejtuesin si komunikues i mirë i legjislacionit (variabli 1) dhe i informimeve që i adresohen shkollës është pasqyruar në përgjigjet e tyre; Rreth 91% mendojnë se drejtori e kryen *shpesh* dhe *gjithmonë* këtë veprimtari . Tregues ky i një forme autoritare, ku drejtuesi jep udhëzime dhe rëndësisë së realizimit të tyre. Kjo e vë drejtuesin në një përçues të udhëzimeve dhe zbatimin e tyre.

Vendimarrje me mësuesit brenda shkollës (variabli 2). Verejmë se 60% e mësueve mendojnë se drejtuesi i tyre *shpesh* dhe *gjithmonë* merr mendimin e tyre për kurrikulën, orët mësimore, por 40% e mësuesve mendojnë se drejtuesi *ndonjëherë* ose *asnjeherë* nuk mbështet mendimin e tyre. Vendimi që merret duhet të jetë i qartë dhe të motivojë stafin. Nje informacion merr jetë vetëm nëpërmjet procesit shoqëror. Të jesh kreativ dhe ndarës detyra është themelore për një drejtues.Individualisht mund të arrish në rritje të njohurive, por këto nuk mjaftojnë në qoftë se nuk ndahen me të tjerët. Ky perceptim i mësuesve ka një rënie në varablin 3.

Drejtuesi si gjenrues i ideve të reja (variabli3). Rreth 51% e mësuesve mendojnë se drejtuesit *gjithmonë* ose *shpesh* mirëpresin ide të reja.Përqindje jo e lartë për t'i klasifikuar drejtuesish si cilësisht të hapur dhe gjenerues idesh. Një drejtues bashkëkohor duhet t'i japë role parësore mësuesve, t'i dëgjojë, të pranojnë ide të tyre që të marrin përgjegjësi. Çdo iniciativë të lindur në shkollë, drejtuesi duhet të njihet dhe ta administrojë. Drejtuesi duhet t'i krijojë hapsirë mësuesve dhe të dijë ” ...se si t'i motivojnë mësuesit për ndërmmarrjen e veprimtarive, në dukje të vogla, por me vlera të mëdha në rritjen e efektivitetit të procesit të mësimdhënies dhe të nxënit...”(Pasku, 2003,fq.6). Një drejtues bashkëkohor i lejon mësuesit që të kene idetë e tyre dhe kur këto mund të jenë të gabuara , sespe do mësojnë nga gabimet. Kjo do sillte një frymë pozitive dhe drejtuesi do të kishte një rol të rëndësishëm si konsultativ, ku motoja do të ishte “provoje atë”.

Drejtuesi si zgjidhës i konflikteve. Rreth 56%, mendojnë se drejtuesi shmang konfliktet, një fenomen destruktiv në veprimtaritë në shkollë (variabli 8) . Por rreth 26% mendojnë se *anjëherë* drejtuesit e tyre nuk janë zgjidhës të konflikteve. Drejtori nuk mund të jetë indiferent ndaj dukurive negative, por duhet të jetë i vemendshëm, korrekt në zgjidhjen e tyre. “Nuk mund të qëndrojmë larg, as t'i drejtohem me fjalë të ashpra e të bërtituara , duke i thënë epitete fyese për ta detyruar të pranojë

këndvështrimin tonë. Duhet t'i bëjmë lëvizjet duke vlerësuar pozicionin e tij" (Leo Buscglia; Muka, 2004). Drejtuesi duhet të ndikojë mbi sjelljen e mësuesvë, në mënyrë që të arrijë rezultate pozitive që dëshiron. Të jetë zgjidhës i situatave, të cilat krijojnë klimën negative.

Drejtuesi si njohës i shqetësimeve të mësuesve (variabli 9). Rreth 79% e mësuesve mendojnë se drejtuesi *ndonjëherë, ose anjëherë* nuk kujdesen për këtë marrëdhënien njerëzore. Tregues jo pozitivë që nxjerr në pah një drejtues, i cili nuk ndërton marrëdhënie të mira me stafin, nuk krijon atmosfere pozitive dhe prioritet i punës së tij është arritja e rezultateve dhe jo marrëdhënia njerëzore. Ndërtimi i marrëdhënieve dhe zhvillimi i tyre është i rëndësishëm dhe shërben si bazë e fortë për të ardhmen.

Bashkëpunimi me shkollën dhe institucionin, lidhjet publike (variabli 15). Përballja me filozofi të tjera drejtuese duket sikur e tremb drejtuesin. Rreth 55% e mësuesve përgjigjen se kjo ndodh *ndonjëherë ose asnjëherë*. Ballafaqimi me ide, arritje, shkëmbime eksperiencash do krijojnë atmosferë pozitive, një mjedis edukues, një institucion të së ardhmes, rritje të efektivitetit dhe suksesit. Drejtuesi i shkollës, si institucione që prodhojnë ide dhe vlera, duhet të jetë projektues gjenerues dhe të ofrojë shërbime

Drejtuesi si mbështetës dhe motivues i stafit (variabli 17). Është një shpërndarje e njënjtë e frekuencës së vlerave, rreth 50% përgjigjen se drejtuesit ndihmojnë, lehtësojnë në zgjidhjen e sfidave në punë, ndërkohë që 50% mendojnë ndryshe. Herë shfaqen si bashkëpunues, e herë jo. Motivimi dhe dhënia e energjiive pozitive mësuesve, do të rriste rezultatet do krijojnë një klimë mbështetëse dhe bashkëpunuese, e cila do të sillte suksesin. Drejtuesi është pjesë e ekipit, kështu që ai duhet të projektojë, organizojë, motivojë dhe të mbështesë punën e mësuesit

Vendimarrje me bazë të gjerë (variabli 23). Mësuesit (57%) përgjigjen se organizohen takime të tilla, por 23% e tyre mendojnë që këto nuk organizohen *asnjëherë* dhe 20% *ndonjëherë*. Një shifër e lartë për një tregues shumë të rëndësishëm nga i cili varet dhe sukcesi i shkollës. Drejtuesit duhet të jenë të aftë të marrin vendime të mbështetur në analiza, por ata duhet ta zgjerojnë këtë vendimarrje duke bërë pjesë të gjithë aktorët. Ky është çelësi i suksesit

6. Përfundime, rekomandime.

Këtij studimi i janë imponuar disa kufizime. Mbështetjet në përgjigjet e drejtuesve dhe jo në vëzhgime, numri i respondentëve është i kufizuar, pyetësori nuk përmban gjithë problematikën e drejtimit. Përfundimet nuk janë përgjithësime të shkallës së fundit.

Duke analizuar rezultatet dalim në disa çështje me interes. Sipas perceptimit të mësuesve drejtuesit janë komunikues, kategorikë dhe informues të ndryshimeve, që tregojnë se ato janë të interesuar për rezultatin. Në nivele jo shumë të larta ato shfaqen si mbështetës, bashkëpunues dhe zgjidhës së konflikteve, por marrëdhënia emocionale me mësuesit nuk është pjesë e formës së tyre të drejtimit. Gjithashtu ato perceptohen si të mbyllur në filozofinë e tyre drejtuese dhe nuk janë të hapur për zhvillim dhe ballafaqim idesh me institucione të tjera.

Mbështetur në përgjigjet e mësuesve: stili i drejtimit që përdoret në shkollat e qytetit të Tiranës, është; *bashkëpunues-konsultativ*, përdorimi i stilit autoritar është i ndjeshëm, ndërsa ai demokratik është i rrallë. Kahu i drejtimit është i orientuar në arritjen e rezultateve, drejtuesit janë më të interesuar për rezultatin, sesa marrëdhënien njerëzore. Kështu për të pasur drejtues efektivë duhet: *krijimimi* i kritereve të vlerësimit dhe zgjedhjes së drejtuesve; *mekanizma* monitorues te vlerësimit të punës së tyre; *trajtime dhe ngritje* të kapaciteteve drejtuese. Duke analizuar rezultatet mbështetur vetëm në instrumentin-pyetësor, një pyetje për studime të mëtejshme është: A është i mjaftueshëm përdorimi vetëm i këtij instrumenti për përfundime përgjithësuese?

Dr.Sc. Mazllom KUMNOVA, Dr.sc.Kastriot BUZA: SFIDAT E VLERËSIMIT NË MËSIMDHËNIEN E FAKULTETIT TË EDUKIMIT

Abstrakt

Reforma e arsimit të lartë në Evropë e njohur si procesi i Bolonjes ka pasur reflektim të fuqishëm në shumë shtete. Kështu, edhe arsimit të lartë në Kosovë ka aderuar në këtë proces duke bërë përpjekje që të jetë pjesë aktive e hapësirës evropiane të arsimit të lartë. Një nga aspektet e kësaj veprimtarie, që edhe sot e kësaj dite është një sfidë e arsimit të lartë në Kosovë është rritja e cilësisë duke e harmonizuar atë me standardet e cilësisë evropiane, në kompleksitetin e së cilës është edhe vlerësimi i studentëve gjatë studimeve. Në këtë kontekst, arsimit të lartë është duke kaluar në periudhën e shkëputjes nga vlerësimi tradicional i studentëve dhe në periudhën e vendosjes së kriterëve të avancuara për të vlerësuar, për të matur arritshmërinë e studentëve gjatë studimeve. Krahas respektimit të veçantive të Fakultetit të Edukimit, kërkohet hartimi i Rregullores për vlerësimin e studentëve, avancimi i procedimeve dhe përcaktimeve në vlerësimin e studentëve, tejkalimi i mënyrave tradicionale në vlerësim dhe avancimi i mësimdhënësve përmes seminareve, projekteve, diskutimeve dhe vjeljes së përvojave të përparuara nga hapësira evropiane e arsimit të lartë.

Fjalë çelës: arsimit të lartë, vlerësimi, mësimdhënia, kriteret, metodat etj.

Përpjekjet intensive për reforma në arsimin e lartë, në fazën e tranzicionit që po kalon i tërë sistemi i arsimit në Kosovë, kanë imponuar përzgjedhjen e modaliteteve të veprimeve bashkëkohore edhe në fushën e mësimdhënies. Në arsimin e lartë, në vitet e fundit, angazhimet janë drejtuar te përmbushja e kërkesave të Bolonjes. Këto kërkesa, padyshim, janë përballur që në fillim me një platformë të paqëndrueshme teorike. Së pari, duhet nisur nga specifikat që kanë kushtëzuar këtë fazë të cilën jemi duke e kaluar, mungesa e mbështetjes së domosdoshme financiare për të siguruar një infrastrukturë elementare që nga objektet deri te infrastruktura digjitale. Po të nisemi nga një qasje multidisiplinare e vlerësimit të gjendjes së tanishme, vlerësime të cilat na mungojnë, me siguri do të arrijmë në konstatimin se përpara na mbetet një rrugë shumë e vështirë e përballur me kërkesa të ndryshme.

Në aspektin e aftësisë të mësimdhënësve për procesin e arsimit të lartë deri më tani janë organizuar forma të ndryshme të aftësisë, si: seminare, vizita në universitete të jashtme, konferenca etj. të mbështetura edhe nga asociacione dhe fondacione të ndryshme ndërkombëtare. Mirëpo, gjithnjë mbetet çështje e diskutueshme se sa kanë reflektuar këto forma të aftësisë të mësimdhënësit e tjerë, të cilët nuk kanë pasur mundësi të ndjekin këto forma të aftësisë ose te një kategori tjetër e tyre që i kanë mospërfillur për shkak të ndryshme.

Tradicionalisht janë bërë përpjekje që mësimdhënësit në arsimin e lartë t'i ofrohen mundësi më të mëdha të komunikimit me studentë në aspektin e fleksibilitetit të hapësirës dhe kohës, qoftë punën në grupe ose individuale. Padyshim, mësimdhënia duhet të mbështetet nga teknologjia, nga shfrytëzimi i përmbajtjeve interaktive për arritjen e një cilësie dhe aktiviteti më të lartë. Zbatimi i e-learning në

KUMTESA

mësimdhënien e lartë duhet pranuar se ka qenë i kufizuar në numrin e mësimdhënësve ose të fakulteteve, sidomos strukturimi i këtij projekti si nga ana teknologjike ashtu edhe në aspektin pedagogjik-didaktik. Në këtë kontekst, sipas mendimit tonë, motivimi i studentëve, respektimi i aftësive individuale të tyre, komunikimi i studentëve jo vetëm me mësimdhënës, por edhe në mes tyre, informacionet kthyesë dhe shumë mundësi tjera që ofron ky projekt.

Arritjen e një cilësie dhe efikasiteti të procesit të arsimit të lartë duhet pranuar se po e pengon ende qasja tradicionale e mësimdhënies që është prezente në auditorët e fakulteteve tona. Ligjëratat e organizuara nga mësimdhënësit dhe objektivi i tyre në përvetësimin e dijeve nga studentët kanë mangësi, të cilat reflektojnë jo vetëm në cilësi, në efikasitet, por edhe në motivimin e tyre. Duhet shqyrtuar me kujdes përse studentët tanë nuk kanë një interesim të shtuar për punën e pavarur në përvetësimin e dijeve si dhe për aftësimin e tyre për të nxënëit gjatë gjithë jetës që janë kusht i domosdoshëm për të ardhmen tonë drejt dijes.

Edhe në këtë drejtim, sipas mendimit tonë, nuk i kemi realizuar në nivelin e duhur nënprojektet e Komisionit Evropian për arsim që kanë të bëjnë promovimin e të mësuarit digjital, kampusin virtual evropian, e-bashkëveprimin e institucioneve të arsimit në Evropë dhe promovimin transversal e të nxënëit. (www.elearnineuropa.info).

Padyshim, vihet re mungesa e një strategjie për realizimin e qëllimeve të përcaktuara për të realizuar në tërësi jo vetëm këtë projekt, por edhe projektet tjera në nivelin evropian. Disa prej tyre që janë në vazhdim i ka kushtëzuar mungesa e zhvillimit të infrastrukturës, potencialeve njerëzore, mbështetja financiare sidomos e mësimdhënësve që kanë treguar jo vetëm interesim, por edhe rezultate si dhe sigurimi i cilësive dhe standardizimi i përmbajtjeve.

Gjithnjë mbetet problem kur përcaktojmë çështjen e cilësisë në mësimdhënie, programet e kurseve (lëndëve). Duhet pranuar se shpesh përcillen nga një vit akademik në vitin tjetër, mungon rishqyrtimi i tyre për të ndryshuar përmbajtjen si mundësi e zbatimit të arriturave shkencore të cilat ndodhin. Nuk mjafton që qëndrimi i mësimdhënësve ndaj përmbajtjeve të kurseve të jetë kritik dhe kreativ nëse nuk kemi një informacion kthyes edhe nga studentët. Mendimi jonë është se vetëm në disa raste ne hapim debat me studentët se çfarë duhet ndryshuar nga përmbajtjet e programeve të kurseve (lëndëve) apo sillabuseve aktuale dhe cilat mund të jenë nevojat e tyre konkrete. Duhet pranuar se ende këto programe janë të mbushura me fakte, të dhëna, përkufizime që realisht e pamundësojnë një fleksibilitet dhe tolerancë për diçka më të avancuar dhe duke kufizuar mundësinë interaktive, bashkëpunuese dhe kreative.

Nga gjashtë objektivat në Strategjinë e Zhvillimit të Arsimit të Lartë të Kosovës (2005-2015), njëra ndër këto, objektiva e tretë, ka përcaktuar se në këtë periudhë duhet “Të zhvillohet sistemi i menaxhimit të cilësisë së arsimit të lartë”.⁵²⁹ Përveç në disa raste, nuk kemi ndonjë informacion të mbështetur në hulumtime serioze në realizimin jo vetëm të kësaj, por edhe të objektivave tjera, të cilat ishin përcaktuar në këtë Strategji. Kur kemi të bëjmë me “fushën e sigurisë së cilësisë” është e domosdoshme që të vlerësojmë jo vetëm përcaktimin e standardeve, por edhe realizimin e tyre në fushëveprimet akademike, kërkimore, menaxhuese dhe të infrastrukturës. Është e qartë se pritshmëritë mund të ndryshojnë, mirëpo nuk mund të thuhet nëse kemi realizuar një akreditim nga ana e Agjensionit, edhe kjo me shumë dyshime në kompetenca, se është realizuar ky objektivi. Kjo nuk mund të mohojë angazhimet e njërive akademike të UP-së brenda fakulteteve dhe përpjekjet e tyre në mundësi mjaft të kufizuar për realizimin e cilësisë.

⁵²⁹ Strategjia e zhvillimit të arsimit të lartë të Kosovës 2006-2015, MASHT, fq.7

Padyshim duhet të pajtohemi me faktin se Universiteti i Prishtinës nuk e ka kaluar ashtu siç pretendohet procesin e vlerësimit sepse, sidomos vitet e fundit, është kërkuar të sforcohet ky evoluum pa kritere dhe standarde. Sigurimi i cilësisë dhe rritja e saj, zbatimi i sistemit të Bolonjës, studime të ndryshme, nuk janë matur asnjëherë dhe nuk kemi një tregues real dhe objektiv.

Por, nuk mund t'i mohojmë përpjekjet, edhe pse shumë herë të kufizuara, që janë bërë krahas sigurimit të cilësisë në realizimin e projekteve të ndryshme me përkrahje ndërkombëtare dhe përpjekje tjera për të realizuar përshtatshmërinë me zhvillimet evropiane të arsimit të lartë. Duhet të pajtohemi se këto përpjekje kanë për qëllim krijimin e një realiteti të ri. Besojmë se te profesoriati nuk ka dilemë se nuk mund të matet cilësia, rritja apo rënia e saj, por problemi qëndron se kush duhet ta bëjë këtë. Një Agjenci e Akreditimit që e ka bërë njëfarë aktiviteti deri më tani nuk ka qenë bindëse se ka një kompetencë të tillë profesionale pa anime politike dhe interesa të tjera. Këtë më mirë e dimë ne të Fakultetit të Edukimit.

Mund të themi se ka paqartësi e përse jo edhe injorim që i bëhet profesoriatit kur flitet dhe pretendohet të matet cilësia e punës së tyre, qoftë në mësimdhënie apo në punën kërkimore. Realisht, na mungojnë studime hulumtuese në bazën e të cilave gjetje/rezultate transparente duhet bërë përpjekje për të vlerësuar cilësinë e arsimit të lartë dhe aktivitetet kërkimore.

Në këtë kontekst, duhet përfutuar nga përvojat e shteteve tjera, të cilat kanë hartuar rregullore, ligje dhe kanë ngritur Këshille Kombëtare në nivel të vendit, që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me vlerësimin e cilësisë dhe aktivitetet kërkimore në arsimin e lartë. Ne kemi mbetur vetëm në disa nene të Statutit të Universitetit të Prishtinës, më saktë në 11 nene që përshkruhen në dispozita: Kontrolli i cilësisë dhe vlerësimit dhe asnjë hap serioz më tej. Sipas mendimit tonë duhej që secila njësi e Universitetit të hartonte Rregullore të veçanta duke zërthyer kritere dhe metoda të vlerësimit. Kjo nuk do të mënjanohte mundësinë e bashkëveprimit të fakulteteve jo vetëm në punën kërkimore, por edhe në matjen e cilësisë me objektivitet e me më shumë korrektësi. Së pari, duhet të pajtohemi me faktin se fakultetet tona të universitetit janë institucione të izoluar. Së dyti, te ne funksionojnë angazhimet e mësimdhënies nga një fakultet në një tjetër vetëm në mungesë të kuadrit përkatës, dhe aty kemi mbetur. Veçanti e Fakultetit të Edukimit, por edhe të fakulteteve të tjera që përgatisin profilin arsimor është se kur është çështja e mësimdhënies kemi të bëjmë me faktin se studentët përballen me modelin e mësimdhënies edhe pse është arsim i lartë. Fakultetet tjera nuk e kanë këtë specifikë.

Nuk duhet mohuar përpjekjet që edhe studentët të bëjnë vlerësimin dhe ata e kanë bërë në këtë vit akademik me një formular (Fletëpyetësor) të vlerësimit. Duhet theksuar në këtë rast se ky aktivitet i studentëve e ka mbështetjen në nenin 226 të Statutit të UP-së. Nëse e quajmë hulumtim, janë interpretuar të dhënat nga e cila ka dalë një listë e mësimdhënësve të njëjësive të universitetit, të cilët nuk mbajnë ligjërata ose nuk janë të rregullt në ligjërata. Por, një rezultat i tillë është kontestuar se i ka munguar objektiviteti dhe më tepër ka efekte të thashethemeve brenda fakulteteve. Mirëpo, këtu duhet vlerësuar se kjo punë e studentëve ka hapur problemin mjaft të ndjeshëm të mungesës së kontrollit të brendshëm në fakultete.

Nëse e fokusojmë çështjen e vlerësimit të studentëve gjithnjë në kontekstin e marrëdhënieve profesor-student në aspektin e vlerësimit, mbetet çështje e njëjësive/fakulteteve edhe pse në vitet e fundit po kërkohej evidentime të kalueshmërisë, por sa dhe kur janë diskutuar.

Studentët, ndoshta kam të drejtë kur paraqes shqetësimin se nuk mjafton vetëm një informacion për mënyrën e vlerësimit të tyre nga profesorët që në takimin e parë në shpjegimin e silabusëve të kurseve.


Një ndër metodat dominuese në mësimdhënien e arsimit të lartë është edhe zbatimi i punimeve seminarike, si qasje e orientuar nga studentët (student centered learning) për të zhvilluar aftësitë e të nxëniet gjatë gjithë jetës, të studimit dhe komunikimit në avancimin e kompetencave, që nuk kufizohen vetëm në lëndët në të cilat përgatitet për profesion. Aktualisht një zbatim i tillë që është i domosdoshëm nuk mund të realizohet për shkak të numrit të madh të studentëve në programe dhe mungesës së hapësirës përkatëse dhe është një formalizëm që nuk po tejkalohet. Mënyra më e zbatueshme formale është se angazhohen studentë, të cilët mbajnë ligjëratë për një temë të caktuar më

KUMTESA

parë ose mbetet çështje e asistentëve. Në raste të tilla realizohet si detyrim formal i studentëve duke mos e realizuar as qëllimin kryesor të punimit seminarik-debatin për temën. Roli i mësimit në seminare është i pazëvendësueshëm. Prandaj, përgatitja dhe realizimi i seminarëve në mësimit të lartë është e domosdoshme dhe paraqet jo veçse një sfidë intelektuale për studentët. Kur jemi te studimet themelore në Fakultetin e Edukimit më mirë është të mendohen dhe zbatohen forma dhe metoda tjera alternative se sa një mënyrë e realizimit të punimeve seminarike që e bëjmë sot. Në studimet master po përballlemi me numrin e madh të studentëve, mungesën e hapësirave përkatëse edhe përkundër përpjekjeve të mësimit. Rrjedhimisht mendojmë se nuk jemi duke e realizuar këtë metodë në mënyrë efektive. Ngritja dhe shqyrtimi i këtij problemi padyshim na shpie tek çështja e përgatitjes së punimit seminarik. Jemi të mendimit se këtu përballen mësimit tradicional jo ana pozitive e saj, megjë ka përpjekje që mësimit tradicional të trajtohet jo edhe si anë pozitive, si dhe kërkesa e domosdoshme sa jemi duke i aftësuar studentët për të shkruar një punim seminarik.


Qëndrimi i mësimit karshi studentëve, sidomos në procesin e vlerësimit, është problem kompleks, i cili ka qenë dhe është fushë e studimeve të ndryshme. Nota përfundimtare e studentëve performohet në të shumtën e rasteve nga testet, angazhimet e tyre në projekte, në diskutime dhe debate të ndryshme si dhe aktivitete të tjera që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me veçantitë e kurseve (lëndëve), drejtimeve dhe mënyrave të organizimit të studimeve. Që në fillim nuk duhet përjashtuar që vlerësimi ndodh që të jetë seleksionues jo vetëm për nga gjinia, por edhe nga stereotipet dhe paragjykimi në aftësinë e studentëve. Ndodh shpesh që shkak i vlerësimit jo të drejtë e ka burimin në mos vlerësimin e drejtë, mungesën e informacioneve dhe transparencës, gjykimet e ngutshme përse jo edhe rastet tjera të përgjithësimeve.

Nga rezultatet e një studimi me studentët e Fakultetit të Edukimit në Gjakovë, hulumtim në të cilin kanë marrë pjesë 153 studentët të programeve të ndryshme të vitit të tretë dhe të katërt, një hulumtim i kufizuar, na dalin këto rezultate:




Në pyetjen se si i vlerësojnë ligjëratat e profesorëve, rezultojnë sipas gjetjeve se 54.9 % e studentëve mendojnë se janë relativisht të kënaqur me ligjëratat e profesorëve kurse 28.1 % janë shumë të kënaqur; vetëm 15% janë pak të kënaqur dhe 2% aspak.

Ushtrimet nga asistentet



Ky raport ndryshon për stafin e asistentëve sepse 60% e studentëve kanë raportuar se janë shumë të kënaqur me ushtrimet e asistentëve; 27.5 janë relativisht të kënaqur; 9.8% më pak të kënaqur dhe 2% aspak të kënaqur.


Numri i madh i studenteve ne ligjerata



Në pyetjen se çfarë i pengon gjatë ligjëratave, një ndër faktorët dominues të cilin e kanë raportuar 85.6% e studenteve është numri i madh i studentëve, numër që i pengon në aktivitet e tyre gjatë ligjëratave, kurse 15.4 mendojnë se jo(pra, ky numër nuk paraqet shumë problem). Padyshim, ky tregues përforcon reagimet e profesoriatit dhe studentëve, sidomos në programin parashkollor dhe fillor, se në këto dy vitet e fundit pranimi i studentëve kanë qenë jashtë kriterëve të fakulteteve të edukimit në hapësirën evropiane.


Në këtë kontekst, gjetjet në këtë studim kanë mbështetur shqetësimin e Fakultetit të Edukimit, sidomos në programet parashkollor dhe fillor, për numrin deri në dhjetë herë më të madh në krahasim me fakultete e edukimit në hapësirën evropiane në realizimin e mësimit praktik.

Praktika Profesionale




Duke u nisur nga organizimi i studimeve në këtë fakultet ku 20% e studimeve kanë të bëjnë me praktikën mësimore, në pyetjet tona, 83.7% e studenteve mendojnë se praktika profesionale iu ndihmon atyre në përgatitjen e tyre profesionale, kurse vetëm 10.5 % mendojnë se iu ndihmon pak.

Mesimi praktik humbje ne ligjerata




Ndërsa, në pyetjen vijuese, nëse organizimi i mësimit praktik krijon humbje të pakompenzueshme të ligjëratave afër 51% e studentëve mendojnë se jo, kurse 49% mendojnë se po. Për këto shqetësime të studentëve, profesoriati i këtij fakulteti ka filluar të shqyrtojë qasje dhe mënyra tjera që sigurojnë cilësi. Mirëpo, pengesë kryesore është numri shumë i madh i studentëve , që nuk mundëson realizimin efikas dhe cilësor të kësaj veprimtarie themelore të studimeve.

Mundësi e diskutimit



Në pyetjen vijuese studentët janë pyetur se a zbatohet metoda e diskutimit gjatë ligjëratave. Ka rezultuar se 52% e studenteve mendojnë se në çdo ligjërate atyre u jepet mundësi e diskutimit, ndërsa 48.% janë përgjigjur se kjo mundësi u jepet atyre ndonjëherë.


Këshillimi me profesorët



Në pyetjen se sa studentëve tanë ju ofrohet mundësia për konsultime pas ligjëratave, për punime seminari dhe diploma ka rezultuar se 42.5% mendojnë se ata relativisht kanë mundësi të këshillohen me profesorët dhe mentorët e tyre, ndërsa 33% mendojnë se e kanë këtë mundësi çdo herë; të tjerët, 25% e studentëve, nuk kanë dhënë përgjigje. Kjo mund të komentohet në shumë mënyra, së pari a janë të informuar se konsultimet janë të domosdoshme dhe së dyti, duhet hapur problemin se si organizohen këto nga ana profesoriale.

KUMTESA


Menyra vleresimit nga profesoret



Në pyetjen e drejtpërdrejtë se sa janë të kënaqur me mënyrën e vlerësimit të tyre, 59.9% e studentëve kanë raportuar se janë relativisht të kënaqur me mënyrën e vlerësimit nga ana e profesorëve, kurse 26.4% janë pak të kënaqur; 12.4 % janë shumë të kënaqur.


Rezultatet padyshim kanë qenë befasuese sepse ndoshta kemi paragjykuar gjithnjë se studentët në këtë drejtim janë të prirë të shfaqin pakënaqësinë e tyre. Mirëpo, rezultatet e pyetjes vijuese hapin problemin tjetër.

Vleresimi i notes përfundimtare




Sa i përket pyetjes në lidhje me notën përfundimtare, afër 26% e studentëve kanë raportuar se profesorët marrin parasysh vetëm testimet periodike, 30% pjesëmarrjen, angazhimin, 21% punimet seminarike, 17% asnjërin prej tyre, por vetëm testin përfundimtar.

Reagim per noten perfundimtare




Në vazhdim të pyetësorit është kërkuar nga studentët që të shprehin reagimet e tyre për notën përfundimtare dhe ka rezultuar se 49% e studentëve kanë raportuar se së paku një herë kanë reaguar për vlerësimin me notën përfundimtare te profesorët, kurse 51% kanë raportuar se nuk kanë reaguar ndonjëherë edhe pse ka raste që nuk janë pajtuar me notën përfundimtare.

Prania ne biblioteke



Në pyetjet drejtuar studentëve se sa e shfrytëzojnë bibliotekën e fakultetit nuk jemi të befashuar me një përgjigje të tillë duke u nisur nga fakti se biblioteka e këtij fakulteti nuk është pajisur me literaturë në 25 vjetët e fundit dhe nuk u përgjigjet nevojave studimore të studentëve.

KUMTESA



Në pyetjen se a kanë nevojë studentët tanë , sidomos në vitin e parë të studimeve t'ju caktohet mentor nga profesorë,t ashtu siç veprohet në fakultetet e hapësirës evropiane, 94.1 e studentëve kanë raportuar se atyre iu nevojitet një mentor në fillim te studimeve për këshilla, kurse 5.9% kanë raportuar se nuk iu nevojitet. Padyshim, edhe ky problem është çështje që kërkon shqyrtim serioz.

Në kërkesën së çfarë sugjerojnë studentët për ngritjen e cilësisë dhe efikasitetin në studimet e tyre, gjetjet na kanë orientuar në këto çështje: ardhja me kohë e profesorëve në ligjërata, vlerësimi të jete më korrekt; kanë kërkuar që kushtet e studimeve të përmirësohen për gjeneratat e ardhshme, vijimi i rregullt i profesorëve në ligjërata etj.

Përfundimisht, ky pretendim është mjaft modest për të kërkuar problemet, ngritjen e çështjeve, hipotezave kur kemi të bëjmë më mësimdhënien e arsimit të lartë në tërësi dhe vlerësimin në veqanti që është mjaft kompleks. Kohë më parë Fakulteti i Edukimit pati planifikuar një Konferencë ndërkombëtare me këtë tematikë, mirëpo organizimi i saj po vonon, për shumë arsye. Mendimi jonë është që duhet përshpejtuar kjo nismë dhe të konkretizohet, çfarë presim studime serioze dhe një kontribut për problemet në mësimdhënien e arsimit të lartë, për sfidat dhe problemet aktuale. Padyshim, rezultatet e këtij hulumtimi hapin shumë çështje që kërkojnë studime serioze që kanë të bëjnë me problemet e mësimdhënies në arsimin e lartë edhe pse gjetjet janë marrë nga Fakulteti i Edukimit.

Në ditët e fundit ka informacione nga rektorati i Universitetit të Prishtinës së ky universitet nga disa asociacione ndërkombëtare është dalluar me mirënjohje për cilësi dhe efikasitet. Kjo na gëzon por edhe duhet të na bëjë më të përgjegjshëm për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies , të punës kërkimore dhe efikasitetit në studime universitare.

Dr.Prof. Anisa SUBASHI⁵³⁰: NDIKIMI I TELEVISIONIT TEK FËMIJËT E MOSHES 8-12 VJEC

“Fëmijës duhet dhënë atë që i duhet, jo atë që e kërkon”

Qëllimi i këtij studimi është të përcaktojë nëse kalimi i shumë orëve para televizorit nxit sjelljen agresive tek fëmijët e moshës 08-12 vjec

Hipoteza: Fëmijët që kalojnë shumë orë përpara televizorit, manifestojnë në jetën e tyre të përditshme, në shkollë apo shoqëri me shokët e tyre, sjellje agresive të cilat janë pasoja të asaj që shohin televizor.

Objektivat:

- 1- Të zbulojnë nëse orët e gjata që fëmijët kalojnë duke parë televizor, rrit sjelljen agresive tek to.
- 2- Të përcaktojnë nëse të parit televizorit ndikon në stilin e jetës së fëmijëve si psh: shtimin për mbipeshë trupore, crregullime në të ngrënë dhe sjellje agresive ndaj bashkëmoshatarëve.
- 3- Të zbulojmë ndikimin e televizorit në marrdhëniet komunikuese mes prindërve dhe fëmijëve.

Kampionimi :

- Kampioni përbëhet nga 60 pjesmarrës
- (28 femra dhe 32 meshkuj).
- Këta fëmijë studiojnë në shkollat 9-vjecare të qytetit të Tiranës.
- Janë përzgjedhur disa shkolla, në qendër dhe periferi të qytetit.
- Përzgjedhja e nxenesve në klase u bë në mënyrë rastësore.
- Fëmijët pjesëmarrës ishin të moshës 08-12 vjec, të gjinisë femërore dhe mashkullore, të racave dhe përkatësive fetare të ndryshme

Televizioni është një nga mediat më ndikuese në jetën e fëmijëve. Sipas një studimi nga federata e mësuesve kanadezë, i kryer në vitin 2003, 75 për qind e fëmijëve (vajza dhe djem) nga klasa e 3 deri në klasën 10, shprehen se televizioni është një nga lojërat më të pëlqyeshme nga ta.

Ndikimi që televizori ka mbi fëmijët, varet nga shumë faktorë: sasia e orëve që shikojnë, mosha dhe personaliteti i tyre, nëse ata shikojnë vetëm ose me të rriturit dhe nëse prindërit e tyre flasin me ta për atë që ata shohin në TV.

Për të minimizuar efektet e mundshme negative të televizorit, është e rëndësishme për të kuptuar se çfarë ndikimi mund të ketë për fëmijët.

Gjatë dy dekadave të fundit, qindra studime kanë shqyrtuar si programime të dhunshme në televizor ndikojnë tek fëmijët dhe të rinjtë. Studimet tregojnë se disa fëmijë mund të jenë të prekshëm nga imazhet dhe mesazhet e dhunshme që transmetohen në televizor.

Televizioni mund të ndikojë në aktivitetet e shkollës dhe procesin e të mësuarit. Fëmijët kanë nevojë për aktivitete të rëndësishme për zhvillimin e shëndetit mendor dhe fizik.

Shumica e kohës së lirë të fëmijëve, sidomos gjatë viteve të hershme të formimit, duhet të shpenzohet në veprimtari të tilla si duke luajtur, lexuar, duke eksploruar natyrën, për të mësuar në lidhje me

⁵³⁰ Shkolla e Lartë Private Vitrina- Fakulteti i Shkencave të Edukimit
Përgjegjëse Departamenti

muzikën apo marrja pjesë në sporte të ndryshme.

Televizioni ka anën e tij të mirë. Ai mund të jetë zbatimës dhe edukues dhe madje mund të hapë një botë të re për fëmijët duke ju dhënë atyre një mundësi për të udhëtuar drejt globit duke mësuar për kultura të ndryshme dhe ndaj ekspozimit të ideve të reja që mund të hasin më vonë në komunitetin e tyre.

Një nga problemet më të diskutueshme lidhur me të mësuarit e agresionit është efekti i dhunës që shihet në television. Studimet e bëra nga Insituti Ndërkombëtar i Shëndetit Mendor kanë nxerrë përfundime se ka një lidhje të madhe midis agresivitetit të ndjekur në television nga fëmija dhe shkallës së agresionit që ai ushtron mbi të tjerët

Të dhënat e studimit treguan se 21% e fëmijëve janë përgjigjur se qëndrojnë përpara televizorit 1-3 orë , 53% janë përgjigjur se qëndrojnë 3-5 orë, 24% janë përgjigjur se qëndrojnë 5-7 orë dhe 2 % qëndrojnë përpara televizorit më shumë se 7 orë

Rezultatet tregojnë që ka dy orare të ndryshme shikimi, në varësi të zhvillimit të mësimit.

Më shumë se gjysma e fëmijëve shikojnë televizor mbasdite ose në darkë dhe 38% shikojnë më shumë televizor paradite, të pakontrolluar shpesh here nga prindërit

85% e fëmijëve pohuan se pëlqejnë të shohin filma, pjesa tjetër programe të ndryshme ku përfshihen aktivitete sportive apo muzikë.

70% e tyre pëlqejnë më shumë të shohin filma me aksion, 12 % filma horror dhe 18% filma komedi. Nga rezultatet doli se 65% fëmijëve e shoqërojnë shikimin e televizorit duke ngrënë dhe 32% duke pirë.

Më shumë se gjysma e pjesëmarrësve në studim shprehen se prindërit e tyre nuk janë dakort që ata të shohin programe televizive që përmbajnë dhunë apo vrasje.

Masat që prindërit marrin janë fikja e televizorit (21%) dhe shpjegimi se programe të tilla nuk janë edukuese (28%) . Vetëm 8% shprehen se prindërit nuk reagojnë kur ata shikojne keto programe

Më shumë se gjysma e pjesëmarrësve në studim shprehen se pëlqejnë të imitojnë personazhe pozitive të filmave dhe 47% të tjerë personazhe negative.

Në përfundim

Shikimi i tepërt i filmave dhe sporteve të cilat përmbajnë kryesisht pjesë me dhunë rrit mundësinë e shfaqjes së sjelljes agresive ndaj bashkëmoshatarëve por jo vetëm. Kjo vjen si rezultat i programeve që ata ndjekin dhe prirjes për ti imituar ato.

Nga studimi doli se fëmijët qëndrojnë para televizorit një kohë të gjatë gjë që tregon një përqindje mjaft të konsiderueshme të kohës së tyre të lirë që harxhojnë për këtë fakt

Përgjigjet të cilët përforcojnë më tepër qëllimin e studimit janë se fëmijët parapëlqejnë të shohin filma me aksion, në krahasim me kategoritë e tjera të filmave dhe 65% e fëmijëve pëlqejnë sportet ekstreme si :mundje,karate,boks,ndërsa vetëm 35% e tyre pohojnë se nuk i pëlqejnë këto sporte.

Çka do të thotë se shanset për të kryer sjellje agresive janë të mëdha, duke u bazuar në këto përqindje. 62% e fëmijëve në studim shprehen se i kanë praktikuar me shokët pjesë të ndryshme filmash si psh:me lufte, aksion e karate apo sporte të tilla si mudja dhe boksi

Shumica e femijëve në studim shprehen se filmat me aksion dhe sportet e rrezikshme janë plot fantazi, spektakolar, kane shume personazhe dhe akrobaci.

Shumica fëmijëve gjatë kohës që janë duke parë TV preferojnë të hanë dhe të pinë. Ata pëlqejnë ta shoqërojnë shikimin e filmit të tyre të preferuar me ndonjë ushqim të shijshëm



Këto rezultate mbështesin dhe një herë gjasat dhe rrezikshmërinë e lartë të shtimit të peshës tek fëmijët e kësaj moshe.

Prindërit interesohen për fëmijët e tyre se çfarë shohin shpesh dhe duke i shpjeguar atyre faktin se sa të dëmshëm janë këto programe.

Por përveç kësaj një përqindje e konsiderueshme sipas fëmijëve del se shumë prej prindërve ndonjëherë thjesht i kanë bërë treguar çka tregojnë se nëpërmjet këtij veprimi ata kanë dashur të nënkuptojnë rrezikun e shikimit të filmave e sporteve të tilla, kur në fakt të nënkuptuarit nuk është një metodë shumë frytëdhënëse.

REKOMANDIME

- ✓ Edhe pse televizioni mund të ketë një ndikim negativ, mendohet se kjo media nuk duhet të përjashtohet tërësisht për fëmijët dhe të rinjtë.
- ✓ Me rëndësi është kontrollimi i shikimit të tij nga prindërit të cilët do të caktojnë emisionet që kanë rol pozitiv për informacion, argëtim e edukim tek fëmijët e tyre
- ✓ Konsumimi i programit televiziv duhet të bëhet në përputhje me moshën e fëmijës.
- ✓ Programi televiziv i cili është i përshtatur për moshën e fëmijës mund të ndikojë pozitivisht, duke e përshpejtuar procesin e të mësuarit të fëmijët.
- ✓ Programi i tillë kontribuon për zhvillimin e imagjinatës të fëmijët, i stimulon fëmijët të mendojnë dhe me ndihmën e televizionit fëmijët mund të mësojnë të lexojnë, mësojnë numra, forma, ngjyra etj.
- ✓ Fëmijët nuk duhet lejuar të shikojnë televizor vetëm. Ata kanë nevojë për “shoqërimin” dhe sqarimin e emisionit nga një i rritur.
- ✓ Sipas Akademisë Amerikane për pediatri të shikuarit Televizionit për fëmijët duhet të kufizohet në 1-2 orë në ditë.

Recensentë:
Prof.Ass.Dr Qazim Dushku
Dr. Teki Kurti

KUMTESA

**Mirela ÇEPELE – DIMO: PROBLEMATIKA PSIKO-PEDAGOGJIKE TË
RIKONCEPTIMIT TË MËSIMDHËNIES SË LETËRSISË NË SHKOLLAT E MESME
DREJT NJË MËSIMDHËNIE BASHKËKOHORE.**

Gjuha shqipe dhe letërsia janë themeli i procesit të të nxënës, i komunikimit, i formimit të identitetit personal e kulturor, si dhe i krijimit të marrëdhënieve shoqërore¹.

Në botën e sotme ku ndryshimet janë të përsheptuara, ku njohuritë grumbullohen e shtohen brenda një kohe të shkurtër dhe profesionet shndërrohen thellësisht, madje zhduken e lindin shumë të tjera brenda një brezi, arritjet shkollore kanë kuptim vetëm nëse vlejné për jetën dhe për të nxënës gjatë gjithë jetës. Shoqëria e sotme ka nevojë për individë të cilët përballojnë ndryshimet, përshtaten ndaj tyre, madje gjenerojné vetë ndryshime. Janë këta individë që do të kenë sukses në të ardhmen e do të prezantohen denjësisht në të ashtuquajturën *“Shoqëri e dijes”*.

Aktorët e edukimit, që nga hartuesit e kurrikulave, zyrtarët e politikave arsimore, pedagogët e arsimit të lartë, përpiluesit e teksteve shkollore e universitare ... e deri te mësuesit në klasë përballen me pyetjen kryesore:

Si t'i përgatitim fëmijët për një jetë të suksesshme? Si t'i përgatitim fëmijët që të jenë mendimtarë e arkitekt të dijes së tyre?

Shkolla është ngritur për përparimin e një komuniteti a vendi dhe mishëron përgjegjësinë e një brezi ndaj brezit pasues. *Mësuesi profesionist përfytyron te nxënësi përherë të rriturin. Ky është misioni i vërtetë i tij. Ai duhet ta nxitë nxënësin që të kërkojë dije edhe përtej shkollës, pasi kjo do t'i mundësojë atij suksesin për një përshatje më të mirë me botën që e rrethon¹.*

Si mund të interpretohet letërsia në këndvështrimin psiko-pedagogjik?

Transmetimi i letërsisë në shkolla është një proces që realizohet në mënyrë shumë dimensionale, përmes veprës letrare, tekstit shkollor të letërsisë, rolit të mësuesit dhe atij të vet marrësit nxënësit.

¹ *Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës së re të gjimnazit. IZHA Tiranë 2010.*

Nëpër këtë hierarki katër shkallëshe, secili aktor ka rolin e vet të pazëvendësueshëm, ku pozita e mësuesit është si një lloj regjisor apo koordinatori në funksionimin e këtij ansambli.

Letërsia është një lëndë e rëndësishme në shkollën tonë e cila ndihmon veçanërisht në formimin e shijeve dhe ideve estetike, në zhvillimin e sferës njohëse e emocionale të personalitetit të njeriut, në nxitjen e aftësive dhe forcave të tij krijuese. *Veçanërisht në moshën e adoleshencës, kjo lëndë luan rol të madh për problemin që po trajtojmë sepse dhe interesat mësimorë të të rinjve janë me drejtim nga lënda e letërsisë.* Fakti që adoleshentët e duan letërsinë, e vënë para përgjegjësisë mësuesin, për ta bërë akoma më interesante këtë lëndë, duke bërë përpjekje maksimale për rritjen e nivelit shkencor e perfeksionimin e metodave të të nxënës. Mësuesit duhet te punojné me një kurrikul (program mësimor, plan, tekst, metodologji, teknikë, strategji etj) që të transformojë shkollën nga karakteri i saj informues në atë formues, që t'i përgatitë nxënësit dhe studentët për t'u integruar në shoqërinë e dijes.

Nëse do t'u referoheshim përgjigjeve të pyetësorëve nga ana e nxënësve do të vinim në dukje:

KUMTESA

1. Letërsia interpretohet si një manual praktik e aktiv që ndihmon në zgjidhjen e mjaft problemeve të jetës së përditshme.
2. Letërsia konsiderohet si një mekanizëm që ndihmon në harmonizimin e marrëdhënieve, të komunikimeve të shumëllojshme ndërmjet njerëzve.
3. Njëpërmjet veprimtarisë së personazheve u ofron njerëzve modele sjelljesh të caktuara për t'i vënë në jetë.
4. Letërsia i ndihmon më shumë dhe më natyrshëm njerëzit, veçanërisht adoleshentët, të njohin botën e tyre.
5. Veprat letrare ndikojnë në jetën shpirtërore të nxënësve, ngjallin tek ata ndjenja të thella, mendime fisnike.
6. Letërsia formon njeriun e së nesërme, nxit vizionet e reja drejt një shoqërie në zhvillim e ndryshim të herëpashershëm.

Letërsia, ndikon fuqishëm në formimin kulturor demokratik e social, në formimin e personalitetit, në pasurimin e shpirtit dhe fisnikërinë e tij, në pajisjen me vlera bashkëkohore e evropiane, si: dialogu dhe toleranca, mirëkuptimi dhe debati i argumentuar, përzgjidhja e problemeve që përbëjnë problematikën sociale dhe edukative e humane për tërë njerëzimin.

Rikonceptimi i mësimdhënies e të nxënësve si dhe nxitja e të menduarit kritik

Zhvillimi i mendimit kritik, në mënyrë të vecantë gjatë mësimin të letërsisë duhet të jetë në qendër të kërkesave të një kurrikule të sotme. Zhvillimi i mendimit kritik, njohja e teknikave, strategjive, e freskon kurrikulën, tekstin, i jep jetë asaj, e pasuron me aktivitete të larmishme, ku bashkëpunimi dhe bashkëveprimi, hulumtimi, krahasimi, reflektimi, analiza, sinteza, interpretimi, gjetja, zgjidhja e problemave bëhen aktivitete mbizotëruese të mendimit kritik e krijues të nxënës-adoleshent. Ato u japin shumë mundësi nxënësve që duke bashkëpunuar në forma të ndryshme me njëri-tjetrin përmes punës në grupe, apo aktiviteteve të tjera mësimore ndërvepruese të rritin shkallën e të nxënësve, duke paraqitur cilësi, shprehje, aftësi e qëndrime kritike, krijuese e logjike argumenti e analize të nxënësve.

Cili është përkufizimi për të menduarin kritik?

“Mendimi kritik buron nga “ajka e të menduarit”, sikurse mençuria e cila kulmon si cilësi më e lartë e dijes, po ashtu edhe mendimi kritik është cilësia më e lartë e të menduarit”⁵³¹. Ai përfaqëson “leximin në mes të rreshtave”, mendimin e sofistikuar (të stërholluar) të cilën individi bën përpjekje ta mbrojë duke u mbështetur në argumente dhe fakte, dëshmi dhe arsye.

⁵³¹ ²Jaka B. “Metodika e mësimin elementar të matematikës”, Prishtinë, 2003.

Në procesin mësimor nuk ekziston ndonjë radhitje e hapave që do të duhej të ndiqen për të realizuar Mendimin kritik. Megjithatë ekzistojnë disa rregulla lidhur me rrethanat dhe kushtet në klasë, për të nxitur dhe aplikuar **Mendimin kritik**.

- *Preferenca e nxënësve dhe e mësuesit për ta vlerësuar mendimin kritik gjatë mësimdhënies dhe të nxënësve në lëndën e letërsisë.*
- *Bindja e mësuesit në aftësitë krijuese të çdo nxënësi për të bërë gjykime kritike, refleksione e interpretime personale.*
- *Koha e mjaftueshme për t'i shpalosur mendimet dhe përvojat, idetë, gjykimet, komentet esetë etj.*
- *Gatishmëria e nxënësve për të qenë pjesëmarrës aktiv në procesin e të nxënësve për të realizuar një mësimdhënie ndërvepruese bashkëkohore në lëndën e letërsisë.*
- *Respekti dhe të dëgjuarit e ideve me opinione të ndryshme, duke i marrë në konsideratë.*

Të flasësh për cilësinë e procesit të mësimdhënies në lëndën e letërsisë, do të thotë të jesh në gjendje të flasësh për:

- a) Përcaktimin e qartë të objektivave mësimorë gjatë mësimdhënies dhe të nxënësve në letërsi;*
- b) Për vendin që zë motivimi në këtë proces;*
- c) Për metodat që përdoren, zgjedhjen ose jo të tyre në varësi të lëndës, kushteve, nivelit etj;*
- e) Sa mësimdhënia u përshtatet interesave dhe përvojave të çdo nxënësi;*
- f) Si ndërtohet mjedisi shoqëror e fizik i klasës për të ndihmuar procesin e mësimdhënies dhe të të nxënësve në lëndën e letërsisë?*
- g) Sa i përgjigjet mësimi kërkesave të reja të kohës dhe sa gjejnë pasqyrim ato në punën e përditshme, etj?*

Të nxënësit, duhet vlerësuar, si proces përmes të cilit fitohen dituri, vlera, qëndrime, shkathtësi. Të nxënësve duhet vështruar si një proces i cili u takon atyre ta ndërtojnë dijen dhe pasurojnë më tej atë. Dija duhet parë si një arkitekturë e cila kompozohet dhe ndërtohet nga vetë nxënësi . ***“Ta vështrosh nxënësin si një arkitekt i të nxënësve të tij është një nga praktikat e sotme bashkëkohore të të mësuarit që kërkojnë dhe nxënësin për t’u kthyer në konstruktorë të dijeve të tyre”³.***

Rikonceptimi i mësimdhënies së letërsisë nga pikëpamja psiko-pedagogjike

Modernizimi i mësimdhënies së letërsisë lidhet edhe me një hallkë tjetër, shumë të rëndësishme që fillimisht nisët me hartimin e teksteve dhe pastaj me zberthimin në mënyrë aktive e krijuese të tij. Aparati pedagogjik përbën bazën e realizimit të të mësuarit logjik, të aktivizimit në shkallën më të lartë reflektuese, kritike e krijuese të nxënësit. *Ai është mekanizmi që drejton dhe orienton, sipas një platforme të qartë, lidhjen midis trashes: mësues-pjesë letrare-nxënësi.* Mësuesi dhe shkolla janë në fazën e sotme kërkon në radhë të parë një konceptim më të drejtë të rolit që duhet të luajë aparati pedagogjik në aktivizimin e nxënësit, në nxitjen tek ai si të ndjenjës ashtu edhe të logjikës, si të emocionit ashtu edhe të refleksionit kritik. Në këtë kuptim aparati pedagogjik është një tekst shkencor më vete dhe specifik që bashkon kërkesa të karakterit metodik, psikologjik, sociologjik, pedagogjik, estetik, ideor, gjuhësor, shkencor, argumentues, reflektues, kritik e krijues etj., dhe që qëndron pranë tekstit letrar me synime shumë të qarta.

E gjitha kjo kërkon një organizim të mësimdhënies mbi një mentalitet të ri e bashkëkohor, e cila lehtëson të nxënësve dhe:

- *Zhvillon aftësitë e nxënësve në lëndën e letërsisë, për të realizuar një të nxënë kritik, krijues e të pavarur.*
- *Zhvillon iniciativë dhe pavarësi në marrjen e vendimeve, në analizën e personazheve, në komentet e diskutimet brenda e jashtë klase.*
- *Nxit ndryshueshmërinë në të nxënësve dhe kreativitetin e tyre në përsosjen e vazhdueshme estetike e letrare.*
- *Zhvillon aftësi më të mira komunikative, zhvillon aftësi menaxhuese, organizuese, bashkëvepruese etj, ku shembullin dhe modelin parësor e prezanton mësuesi.*

KUMTESA

- *Nxit vetëvlerësim dhe vlerësim të përshtatshëm rreth rezultateve mësimore e akademike-shkencore.*
- *Eksplorimi i së ardhmes së mundshme, ofron hapësira të mëdha për të menduarit kreativ dhe imagjinues, si dhe për praktikimin e aftësive në një shkallë më të lartë njohjeje shkencore.*

Eseja, si një teknikë e përfshirë në grupin e madh të teknikave dhe të strategjive është konceptuar si një veprimtari e punës individuale me shkrim të nxënësve. Ajo jep mundësi të plota për t'i përfshirë nxënësit në proces të nxëni dhe, njëkohësisht, jep material autentik për të njohur shkallën e të mësuarit dhe reflektimit të nxënësve ndaj asaj ç'ka ata mësojnë, ndiejnë dhe bëjnë, në kufijtë e një ore mësimi, por edhe përtej saj.

Duke u mbështetur në sa thamë më sipër eseja dallon në:

- *Përmirëson cilësinë e mësimdhënies në lëndën e letërsisë.*
- *Kërkon gjetjen dhe përdorimin e teknikave efikase pararendëse në kuadrin e struktues mesimore bashkëkohore ERR-së.*
- *Shmang tendencën e të mësuarit me në qendër mësuesin e nxit të mësuarit me në qendër nxënësin .*
- *Nxit aktivitetin e pavarur të nxënësve.*
- *Përmirëson cilësinë e të shkruarit të nxënësve.*
- *Nxit nxënësit për të bërë kërkime rreth problemit për të cilin u duhet të bëjnë ese.*
- *Zhvillon mendimin kritik e krijues të nxënësve. Jep mundësi për një vlerësim më autentik të punimeve të nxënësve.*

Përfundime

1. Karakteristika e parë, prej së cilës varet gjithë suksesi i zhvillimit të letërsisë në shkollë është krijimi i një përfytyrimi më të saktë e më të plotë mbi specifikën e saj si dhe synimet që realizon ajo sipas grupmoshave në shkollën tonë.
2. Modernizimi i mësimdhënies së letërsisë lidhet edhe me një hallkë tjetër, shumë të rëndësishme që fillimisht niset me hartimin e teksteve dhe pastaj me zbrëthimin në mënyrë aktive e krijuese të tij.
3. Një ndër probemet më delikate të përmirësimit të mëtejshëm të mësimdhënies së lëndës së letërsisë është dhe konceptimi e zgjidhja e raportit të letërsisë me gjuhën. Cili është vendi i njohurive teoriko-letrare në tekstet e letërsisë?
5. Organizimi i punës së pavarur ndihmon jo vetëm në përvetësimin e materialit letrar, por edhe në zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve.
6. Të realizohet përjetimi emocional i mësimin në lëndën e letërsisë. Pa emocione nuk ka mësim.
 - *Fjala e mësuesit, të lexuarit e pjesës nga mësuesi duhet t'i prekë thellë në ndjenja nxënësit.*
 - *Të thyejë monotoninë në orën e mësimin, duke e bërë atë interesante dhe duke aktivizuar sa më shumë nxënës. Të përdorë sa më shumë mjete mësimore (tabela të përgatitura nga mësuesi, skeda të përgatitura nga nxënësit, magnetofon, televizor, piktura, poëer point, etj).*
 - *Kur shpjegon figurat letrare, të përqëndrohet në çështje thelbësore, me qëllim që nxënësit të aftësohen për të kuptuar lidhjen e figurave me njëra-tjetrën brenda tekstit letrar, si ndërtohen figurat letrare dhe cili është funksioni i përdorimit të tyre.*
 - *Të japë detyra që nxitin të menduarit e pavarur e krijues të nxënësit.*

Si perfudim, mund te themi se detyra, që synojnë të aftësojnë nxënësin në kërkimin, gjetjen, për zgjedhjen e përpunimin e informacionit të vlefshëm dhe me interes për të dhe për objektivat mësimore, duhet të zënë vend dhe gradualisht të dominojnë në procesin mësimor gjatë mësimdhënies në lëndën e letërsisë.

Msc. Ledia KASHAHU¹, MARRËDHËNIA PRIND-MËSUES, PARAGJYKIMET DY PALËSHE DHE ARRITJET AKADEMIKE TË ADOLESHENTËVE.

¹Universiteti "A. Moisiu" Durrës,
Fakulteti i Edukimit Departamenti i Pedagogjisë

Abstrakt

Qëllimi i studimit ishte të përcaktonte nivelin e marrëdhënieve mësues- prindër sipas perceptimit të prindërve dhe mësuesve, dhe se si ky nivel bashkëpunimi lidhet me rezultatet e nxënësve të klasave të 9^{ta} të shkollave 9-vjeçare të qytetit të Tiranës, si dhe eksploronte paragjykimet midis palëve. Për nevojat e këtij studimi u aplikuan dy pyetësor si dhe u mbajt evidence rigorozet për notat e fituara për çdo nxënës (N= 714) përgjatë vitit akademik 2010-2011. Njëkohësisht u realizuan intervista gjysmë të strukturuar me prindër dhe fokus grupe me mësues.

Mësuesit paragjykojnë rezultatet e nxënësve duke gjykuar se faktorët demografikë ndikojnë në to. Ka lidhje të rëndësishme midis notave të fituara nga nxënësit dhe bashkëpunimit dhe komunikimit të mësuesve me prindërit, gjinisë, nivelit të shkollimit të prindërve si dhe nivelit të të ardhurave mujore, por nuk ka lidhje midis gjendjes familjare të prindërve, apo dendësia e banesës.

Fjalët Kyçe: *marrëdhënia prind-mësues, marrëdhënia mësues prind, statusi social ekonomik, arritjet akademike.*

Hyrje

Me ndryshimet e vullshme që po pëson shoqëria jonë, arritjet akademike fëmijëve marrin një rëndësi gjithmonë edhe më të madhe. Çdo ditë shikojmë prindër, të cilët shqetësimin kryesor të jetës së tyre kanë *arritjet akademike të fëmijëve në shkollë*. Kjo për faktin e thjeshtë se pa qenë i arsimuar si duhet është e pamundur të gjesh vendin tënd në shoqëri dhe të krijosh një jetë të suksesshme ekonomike për veten dhe familjen si dhe të jesh një qytetar i denjë.

Arritjet akademike konsiderohet nga studiuesit si një nga synimet kryesore për moshën shkollore (García Coll & Szalacha, 2004). Në bazë të teorive bashkëkohore, zhvillimi i fëmijës dhe përparimi i tij në shkollë lidhet me disa faktorë si; cilësitë e personalitetit të fëmijës, ndërveprimi i fëmijës me ambientin familjar, dhe bashkëpunimi i familjes me shkollën (Bronfenbrenner, 1998. Cicchetti & Toth, 2000).

Epstein dhe kolegët e saj identifikojnë gjashtë aspektet e përfshirjes prindërore të cilat ndikojnë në arritjet akademike të fëmijëve: Aftësitë dhe shprehjet e prindërve; Komunikimi; Vullnetarizmi; Mësimi në shtëpi; Marrja e vendimeve në shkollë; Bashkëpunimi me agjencitë e komunitetit (Epstein, 1997) et al. Tipologjia e Epsteinit ka qenë dhe korniza teorike shume studimeve të dy dekadave të fundit. Shpesh komunikimi shkollë familje- është etiketuar si përfshirje prindërore, por në të vërtetë ai është informacion për prindin, si dhe një formë marrëdhënie midis palëve, ku si prindërit edhe mësuesit si specialistë duhet jo vetëm të japin por edhe të marrin informacion dhe të shkëmbejnë ide (Epstein, 1986).

Rëndësia e marrëdhënieve në mes të prindit dhe shkollës për arritjet akademike të fëmijës është tashmë e konsoliduar (Fan & Chen, 2001; Jeynes, 2003, 2007). Kërkimet tregojnë se një marrëdhënie e mirë mësues-prind përmirëson të nxënësit, zhvillimin, arritjet e nxënësve dhe suksesin në shkollë dhe në jetën e mëvonshme. (Allen, 2007; Blankstein,2010; Epstein et al., 2008; Sanders, 2006).

KUMTESA

Bashkëpunimi shkollë- familje është pjesë e punës së mësuesi është një detyrë e vështirë dhe një burim të përbashkët pasigurie dhe frike si për mësuesit ashtu edhe për prindërit. Në ciklin e lartë të shkollës 9-vjeçare, ku nxënësit janë duke kaluar pubertetit dhe po hyjnë në adoleshencë, mund të lindin si problemet por edhe sfidat në mësimdhënie, të cilat janë të panjohura në periudhën shkollës fillore. Prandaj, është shpesh një nevojë për mësuesit të bashkojnë forcat e tyre me prindërit për të mbështetur rritjen dhe zhvillimin e shëndetshëm të nxënësve.

Prindërit e vlerësojmë bashkëpunimin me mësuesit në shkollën fillore por niveli i bashkëpunimit zvogëlohet kur nxënësit hyjnë në ciklin 9-vjeçar. Ndarja e mësuesve sipas lëndëve gjykohet të jetë një nga arsyet kryesore për uljen e nivelit të bashkëpunimit por jo vetëm. Mungesa e barazisë për sa i përket niveleve arsimore, mungesa e besimit bazuar në përvojat e mëparshme, mungesa e disponueshmërisë në momentin e duhur, mungesa e përgjegjësive të qarta midis palëve, refuzimi për të dëgjuar, boshllëku i komunikimit (komunikimi formal) apo mbingarkesat, janë faktorë që ndikojnë në komunikimin midis prindit dhe mësuesit dhe për rrjedhojë edhe në marrëdhëniet midis tyre.

Secili nga ne e katalogon botën sipas mënyrës së tij. Perceptimi selektiv ndodh kur njerëzit bllokojnë informacionin nëse ky informacion bie ndesh me atë çka ata besojnë. Kur njerëzit marrin informacion, ata priren të dëgjojnë vetëm ato pjesë që konfirmojnë ose riafirmojnë besimet e tyre. Perceptimi final rezulton në stereotipizim. Krijimi i stereotipeve është një pengesë për komunikimin pasi tendenca e këtij komunikimi priret të dëgjojë vetëm ato elemente që konfirmojnë imazhet e tyre stereotipe dhe kështu krijohet mundësia për paragjykime.

Qëllimi i studimit

Ky studim synon:

- Të përcaktojë nivelin e *marrëdhënies prind- mësues dhe mësues- prind*.
- Të përcaktojë lidhje që ekziston midis niveli të *marrëdhënies prind- mësues dhe arritjeve akademike të nxënësve*.
- Të përcaktojë lidhjen që kanë; gjinia, faktorët demografikë të nxënësve (gjendja familjare e prindërve, arsimimi i prindërve, gjendja ekonomike) me arritjet akademike të nxënësve.
- Të zbulojë *paragjykimet* midis mësuesve dhe prindërve.

Metodologjia

Popullata e studimit ishin nxënës të klasave të 9^{ta} të shkollave 9-vjeçare publike të qytetit të Tiranës, prindërit e tyre si edhe mësuesit e gjuhës amtare dhe të matematikës që u jepnin mësim gjatë vitit akademik 2010-2011. Kampioni i këtij studimi qenë 714 nxënës dhe 173 prindër këtyre nxënësve, të cilët u përzgjedhën në mënyrë rastësore në 21 shkolla nga 66 shkolla publike që ka qyteti i Tiranës si dhe 22 mësuesit e gjuhës amtare dhe 24 mësuesit e matematikës.

Për nevojat e këtij studimi u përdor një instrument matës i përbërë nga tre pjesë; *Pjesa e parë* ishte një pyetësor me vetë-raportim që përmbante të dhëna personale dhe demografike për nxënësit (N=714) *Pjesa e dytë*, ishte pyetësori me vetë-raportim nga mësuesi “Shqyrtimi i marrëdhënies prind-mësues” (Vickers, & Minke, 1995) për të përcaktuar nivelin e marrëdhënies prind-mësues (N=714) i cili kishte dy nënshkallë, bashkëpunimin (19 artikuj) reabiliteti është $\alpha = .92$ dhe komunikimin (5 artikuj) reabiliteti $\alpha = .66$. *Pjesa e tretë*, ishte pyetësori me vetë-raportim nga prindërit “Shqyrtimi i marrëdhënies dhe mësues-prind” (Vickers, & Minke, 1995) për të përcaktuar nivelin e marrëdhënies dhe mësues-prind (N=173) i cili kishte dy nënshkallë, bashkëpunimin (19 artikuj), reabiliteti $\alpha = .82$ dhe komunikimin (5 artikuj) reabiliteti, $\alpha = .62$


U realizuan gjithashtu edhe 81 intervista gjysmë të strukturuar me prindër dhe dy fokus grupe me mësues për të zbuluar paragjykimit e palëve. Notat dhe mungesat e nxënësve u nxorën nga regjistrat e shkollave dhe klasave përkatëse.

Të dhënat statistikore u përpunuan me SPSS. U bënë analiza krahasuese ANOVA për të parë arrijtet akademike të nxënësve mbi bazën e disa prej faktorëve demografikë si dhe u krye regresioni me metodën enter, analiza correlacioni (correlation analysis, Pearson r) për të parë lidhjen e bashkëpunimit e prindërve me nivelin e notave. Për të krahasuar perceptimin e prindërve dhe të mësuesve mbi marrëdhënien e bashkëpunimit/lidhjes dhe komunikimit u përdor t-test për grupe çifte. Në këtë punim janë raportuar ato rezultate që janë të besueshme nga ana statistikore. Gjithashtu u analizuan shënimet e mbajtura nga intervistat dhe fokus grupet.

Rezultatet

Niveli i marrëdhënies *prind- mësues* dhe *mësues- prind*.

Niveli i marrëdhënies u studiua në dy dimensione: *bashkëpunimi* dhe *komunikimi*. Për të krahasuar perceptimin e prindërve dhe të mësuesve mbi marrëdhënien e bashkëpunimit/lidhjes dhe komunikimit u përdor t-test për grupe çifte. Rezultatet treguan se prindërit në krahasim me mësuesit deklarojnë një nivel më të lartë bashkëpunimi $t(n, 140) = -5.29, p < 0.001$. Nga ana tjetër del se mësuesit më shumë se prindërit deklarojnë se komunikojnë me prindërit $t(n, 172) = 5.71, p < 0.001$. Shih graf 1



te matematikës ashtu edhe me notat e provimit shtetëror të matematikës dhe me notën mesatare në përgjithësi. Po ashtu edhe komunikimi lidhet pozitivisht me rezultatet por me nivele më të ulta se bashkëpunimi.

Tabela 2 . Marrëdhëniet mësues-prind dhe arrijteve akademike (sipas raportimeve të mësuesve)

| | Bashkëpunimi | Komunikimi |
|-------------------------------------|--------------|------------|
| 1. Nota vjetore e gjuhës | 0.64** | 0.23* |
| 2. Nota e provimit të gjuhës | 0.50** | 0.16* |
| 3. Nota vjetore e matematikës | 0.82** | 0.60** |
| 4. Nota e provimit të matematikës | 0.70** | 0.53** |
| 5. Nota mesatare e lendeve kryesore | 0.80* | 0.61** |

Shënim: * $p < 0,05$. ** $p < 0,01$.

Marrëdhënia midis gjinisë, faktorëve demografik të nxënësve dhe arrijteve akademike

Analizat e regresionit me metodën enter nxorën se nota e matematikës parashikohet pozitivisht nga gjinia $\beta = .22, t = 5.37, p < .001, R^2 = 5.5\%$, arsimi i babait $\beta = .16, t = 3.15, p < .01, R^2 = 10.6\%$, dhe i arsimit nënës $\beta = .19, t = 3.53, p < .001, R^2 = 2.5\%$. Të ardhurat financiare $\beta = .09, t = 1.97, p < .05, R^2 = 7\%$ kontribuojnë në parashikimin e notës së matematikës pozitivisht, por me një variancë shumë të vogël. Po ashtu, nota e provimit të matematikës parashikohet pozitivisht nga gjinia $\beta = .19, t = 4.74, p < .001, R^2 = 4\%$, arsimi i babait $\beta = .22, t = 4.27, p < .001, R^2 = 16\%$, dhe i nënës $\beta = .19, t = 3.64, p < .001, R^2 = 3\%$. Të ardhurat financiare $\beta = .09, t = 1.94, p < .05, R^2 = 8\%$ kontribuojnë në parashikimin e notës së provimit të matematikës pozitivisht, por me një variancë shumë të vogël.

KUMTESA

Faktorët që parashikojnë notën e gjuhës amtare janë: gjinia $\beta=.27$, $t=6.80$, $p<.001$, $R^2=7\%$, arsimi i babait $\beta=.19$, $t=3.79$, $p<.001$, $R^2=14\%$, dhe i nënës $\beta=.19$, $t=3.64$, $p<.001$, $R^2=3\%$, dhe të ardhurat financiare $\beta=.11$, $t=2.52$, $p<.01$, $R^2=1.1\%$. Gjithashtu, nota e provimit e gjuhës parashikohet : gjinia $\beta=.31$, $t=8.00$, $p<.001$, $R^2=11\%$, arsimi i babait $\beta=.21$, $t=4.30$, $p<.001$, $R^2=13\%$, dhe i nënës $\beta=.18$, $t=3.50$, $p<.01$, $R^2=2.3\%$.

Faktorët që parashikojnë notën mesatare të lëndëve kryesore⁵³² janë: gjinia $\beta=.31$, $t=7.98$, $p<.001$, $R^2=11\%$, arsimi i babait $\beta=.17$, $t=3.34$, $p<.01$, $R^2=10.5\%$, dhe i nënës $\beta=.19$, $t=3.7$, $p<.001$, $R^2=2.6\%$.

Analizat statistikore treguan se struktura familjare nuk ka lidhje të rëndësishme me nota e nxënësve. Mbi bazën e analizës ANOVA konstatohet se nxënësit që kanë kushte më të mira jetese dhe konkretisht kanë dhomën e tyre deklarojnë nivel më të lartë note në provimin shtetëror të matematikës në krahasim me nxënësit që ndajnë dhomën me personat e tjerë të familjes $F(1, 712)=7.43$, $p<0.01$. Dendësia e banesës nuk lidhet në mënyrë të rëndësishme me vlerat mesatare të notave të matematikës, të gjuhës amtare, të provimit shtetëror të gjuhës.

Paragjykimet të para nga dy këndvështrime, prindërit dhe mësuesit

Nga intervistat me prindërit e nxënësve të klasave të 9^{ta} (N= 81), rezultoi se prindërit kanë paragjykimet e tyre për mësuesit e fëmijëve të renditura sipas këtij rendi zbritës në tabelën e mëposhtme:

| Tabela 5. Paragjykimet për mësuesit, sipas këndvështrimit të prindërve | |
|---|------|
| Interesi për të përfitur ryshfet apo favore nga prindërit e nxënësve | 68% |
| Interesi për të tërhequr nxënësit e tyre në kurse pas shkolle | 62% |
| Diferencimin e nxënësve sipas prejardhjes sociale dhe ekonomike | 49% |
| Prejardhjen e tyre dhe nivelin kulturor | 42% |
| Prepotencën në komunikimin me nxënësit dhe prindërit | 39% |
| Mosha dhe përvoja | 34% |
| Nuk i kuptojnë si duhet prindërit | 28 % |
| Paraqitja e jashtme | 12% |

Tabela 5: Paragjykimet për mësuesit, sipas këndvështrimit të prindërve

Nga analiza e të dhënave të dy fokus grupeve të realizuara me mësues rezultoi se mësuesit kanë më shumë paragjykimet për prindërit e nxënësve sesa prindërit për mësuesit. Mësuesit i vlerësojnë prindërit si: pak të interesuar për fëmijët (sa më problematik fëmija aq më i pa interesuar prindi), interesohen vetëm për notat, nuk kanë kërkesë llogarë për fëmijët, u mungon autoriteti, u japin fëmijëve më shumë liri se sa duhet, janë të pa kujdesshëm (fëmijët janë jashtë kontrolli pasi dalin nga shkolla), nivel i ulët arsimor i prindërve, as të kuptojnë as i ndihmojnë fëmijët, janë selektiv dhe i diferencojnë lëndët (për disa prej lëndëve shoqërore dhe djathtësive nuk interesohen fare), prejardhjen e tyre dhe nivelin kulturor, fëmijët e prindërve me status të lartë social dhe ekonomik kanë sjellje me problematike, prindërit me status të lartë social dhe ekonomik janë më të vështirë në komunikim (tregojnë fuqinë shoqërore apo financiare në çdo kohë), kërkojnë vlerësime të pa merituar për fëmijët, u besojnë verbërisht fëmijëve, nuk i respektojnë sa duhet mësuesit, kanë stile të pa pranueshme të jetuarit.

Nga bisedat me mësuesit e gjuhës shqipe mësojmë se nuk ka interesim të prindërve për lëndë të veçanta. Kryesisht prindërit drejtohen te mësuesit kujdestarë dhe rrallë vijnë të takohen me ta. Për këtë arsye ata mendojnë se do të ishte me mirë për nxënësit nëse atyre do t'u jepeshin në kujdestari klasat e 9^{ta}. Prindërit më të interesuar sipas tyre janë ose prindërit e nxënësve me rezultate të larta ose prindërit e nxënësve me rezultate shumë të ulëta. Prindërit e nxënësve mesatar qëndrojnë më indiferentë. Në ndryshim nga prindërit e nxënësve me rezultate të larta që frekuentojnë rregullisht takimet me prindër,

⁵³²Në këtë studim është nota mesatare është llogaritur për lëndët; gjuhë amtare, anglisht, matematikë, fizikë, kimi, biologji, histori, gjeografi.

prindërit e nxënësve me rezultate të ulëta zakonisht vijnë në fund të vitit shkollor pasi i shqetëson mundësia që fëmijët e tyre mund të jenë jo kalues.

Konkluzione

Studimi tregoi se bashkëpunimi shkollë-familje ka një lidhje pozitive substanciale arritjet akademike të nxënësve, por nga ana tjetër rezultojnë se palët në këtë bashkëpunim paragjykojnë njëra-tjetrën. Sa më larg që të qëndrojnë mësuesit dhe prindërit aq më shumë do të rritin qëndrimet paragjyquese për njëri-tjetrin. Për tu përballur me këtë, është e rëndësishme të bëhen përpjekje për të rritur nivelin e marrëdhënieve mësues-prind, pasi është pikërisht kjo marrëdhënie që përcakton se sa të koordinuara do të jenë të dy mbështetjet, si ajo e mësuesit ashtu edhe ajo prindërore, për të cilat nxënësit kanë aq shumë nevojë.

Gjithashtu, u pa se prindërit e deklarojnë një nivel më të lartë bashkëpunimi se mësuesit por nivel më të ulët komunikimi midis palëve. Mësuesit paragjykojnë rezultatet e nxënësve duke gjykuar se faktorët demografikë ndikojnë në to. Studiuesit Epstein (1995) dhe Gianzero (2001) kanë gjetur në studimet e tyre se mënyrat se si prindërit përfshihen në edukimin e fëmijëve është më e rëndësishme dhe ka ndikim më të madh në arritjet akademike të nxënësve se variablat e background familjar. Gjithashtu Henderson dhe Berla (1997) si dhe Gianzero (2001) theksuan se ku se kur shkollat punojnë së bashku me familjet për të mbështetur të nxënësit, fëmijët kanë prirjen të jenë më të suksesshme jo vetëm në shkollë por edhe jetë. Nga studimi rezultojnë se ka lidhje të rëndësishme midis notave të fituara nga nxënësit dhe gjinisë, nivelit të shkollimit të prindërve, si dhe nivelit të të ardhurave mujore, por nuk ka lidhje midis gjendjes familjare të prindërve, apo dendësia e banesës.

Pjesëmarrja e prindërve jo vetëm në takime me prindër, por përfshirja e tyre në jetën shkollore përfshirë këtu edhe veprimtaritë mësimore të çdo klase, do të ndihmonte krijimin e një klime pozitive bashkëpunimi dhe komunikimi që do të ndikonte në një njohje më të thellë midis palëve dhe për rrjedhojë do të shembte gradualisht paragjykimet që ekzistojnë midis mësuesve dhe prindërve. Gjithashtu, për të rritur nivelin e marrëdhënieve shkollë-familje, shkollat duhet të hartojnë një plan të detajuar ku të gjenden rrugë të ndryshme për krijimin e kontakteve dhe informimin në përshtatje me të gjitha llojet e familjeve. Ky të jetë një plan jo vetëm për veprim por me pas edhe për vlerësim. Paralelisht, ndërhyrja në kurrikulat e Fakulteteve të Mësuesisë duke krijuar kurse të veçanta për t'i përgatitur mësuesit e ardhshëm për partneritetin me prindërit, do të ndikonte në përmirësimin e gjendjes në të ardhmen.

Recensentë:

PhD Marina DALLA Universiteti i Athinës, Greqi
Dr. Muharrem JAKUPI Universiteti "A. Moisiu" Durrës

KUMTESA

Ma. Liridona JEMINI – GASHI1: PJEKURIA PËR KARRIERË DHE VENDIMARRJA E ADOLESHENTËVE KOSOVARË PËR ZGJEDHJE TË PROFESIONIT

¹Fakulteti Filozofik / Universiteti i Prishtinës

Marrja e një vendimi nënkupton alternativa të shumta për tu konsideruar, dhe në raste të tilla në nuk duam vetëm ti identifikojmë alternativat por të zgjedhim atë që 1) ka probabilitet më të lartë të suksesit dhe efikasitetit dhe 2) i përshtatet më mirë objektivave tona, dëshirave, mënyrave të jetesës, si dhe vlerave në përgjithësi (Harris, 2009). Zgjedhja e një alternative midis tjerave nuk është proces i lehtë. Njëra ndër vendimet më të rëndësishme jetësore është zgjedhja e profesionit, vendim ky merret kryesisht gjatë adoleshencës.

Vendimmarrja për zgjedhje të profesionit e karrierë shqyrtohet nga ana e shumë teorive. Gjatë shumë viteve të shkuara, pikëpamja teorike dominuese në studimet për zhvillimin e planeve profesionale, ka qenë ajo e Donald Super (1967). Pjekuria e karrierës, një koncept kryesor në teorinë e Super është manifestuar në realizimin me sukses të detyrave të moshës e fazave të zhvillimit në të gjithë jetën. Sipas Super (1957), fazat e zhvillimit profesional janë: rritja (4-13 vjec), eksplorimi (14-24), krijimi (25-44), mirëmbajtja (45-65) dhe rënia (mbi 65). Pjekuria për karrierë nënkupton gatishmërinë për tu përballur me detyrat e zhvillimit në një fazë të caktuar (Super, 1957). Sipas tij, (Super 1963) pjekuria profesionale nënkupton komponentët si: planifikimi i karrierës, eksplorimi i karrierës, njohuritë rreth botës së punës, shkathtësitë e vendimmarrjes për karrierë dhe njohuritë rreth profesionit të preferuar.

Pjekuria për karrierë është një konstrukt që bazohet në koncepte të tilla si: zhvillim karriere, vendimmarrja për karrierë, gatishmëria për karrierë, etj. Koncepti 'karrierë' i referohet një sekuence të profesioneve, punës dhe pozitave të pushtuara nga një individ gjatë jetës së tij ose saj (Super & Bohn, 1970). Ky koncept mund të sqarohet nga perspektiva të ndryshme, por shikuar nga aspekti psikologjik, një karrierë është një seri e roleve të luajtur nga një person, një zgjedhje e sukses, të cilat janë pjesërisht të determinuara nga prirjet, interes, vlerat, nevojat, eksperiencat e e para si dhe nga pritjet e personit në fjalë (Super & Bohn, 1970).

Pjekuria për karrierë si një aspekt i rëndësishëm i zhvillimit të karrierës është një variabël e shumë studimeve. Një sasi e konsiderueshme e hulumtimeve që janë realizuar, janë përqendruar kryesisht në studimin pjekurisë për karrierë të nxënësve të shkollave të mesme dhe studentëve të universiteteve (Flouri & Buchanan, 2002; Luzzo, 1995; Patton & Creed, 2001). Pjesa më e madhe e studimeve e analizojnë këtë konstrukt në mardhënie me faktorë tjerë, të dhëna demografike, vet-efikasitetin, sigurinë për vendimmarrje pa vendosshmërinë për karrierë dhe me shumë faktorë tjerë të natyrave të ndryshme.

Siguria për karriertë ka të bëjë me shkallën në të cilën individët ndihen të sigurt, të vendosur në lidhje me planet e tyre profesionale. Ky konstrukt konsiderohet si tejet i rëndësishëm për vazhdimin e suksesshëm të karrierës, por që si i tillë varet dhe ndërlidhet me shumë faktorë tjerë. Siguria për vendimmarrje është parë të ketë një ndërlidhje me pjekurinë për karrierë (CDS; Osipow, Carney, Winer, Yanico, & Koschier, 1976). Në bazë të teorive mbi karrierën dhe studimeve tjera të kësaj natyre, pjekuria për karrierë nënkupton gatishmërinë për të marrë vendim, që me fjalë tjera këto dy konstrukte konsiderohen ngusht të lidhura me njëra tjetrën (Powell & Luzzo, 1998). Hulumtimet kanë dhënë një shumëllojshmëri të instrumenteve të instrumenteve të dobishme për vlerësimin e sigurisë për vendimmarrje dhe pavendosshmërisë.

KUMTESA

Në bazë të studimeve është parë se vendimmarrja për karrierë, përkatësisht, siguria për vendimmarrjen ndërlidhet edhe me shumë faktorë tjerë. Studimi “Roli i prindërve në zhvillimin e karrierës së të rinjëve” (Keller, 2008) ka theksuar rëndësinë e përkrahjes prindërore në vendimmarrjen e adoleshentëve për zgjedhje të profesionit dhe për sigurinë mbi atë vendimmarrje. Me fjalë tjera, adoleshentët të cilët janë rritur në familje duke pasur mbështetje, dashuri, komunikim dhe ngrohtësi kanë treguar zhvillim më të mirë profesional dhe gatishmëri më të madhe për vendimmarrje (Keller, 2008). Në një studim tjetër të bërë nga Ferry (2000), është vu në pah rëndësia që ka familja, shkolla, bashkëmoshatarët dhe konteksti jetësor në procesin e vendimmarrjes së adoleshentëve për profesionin e ardhshëm. Sipas Ferry (2006), të rinjtë të cilët nuk kishin mbështetje nga shkolla, bashkëmoshatarët e në veçanti nga familja, kishin vështirësi të merrnin vendim për zgjedhje profesionale.

Mbështetur në Teoritë mbi karrierën dhe në studimet e shumta të bëra nga studiues të ndryshëm në vende të ndryshme të botës, mund të thuhet që vendimmarrja e adoleshentëve për zgjedhje të profesionit është një proces kompleks që ndikohet nga ndërveprimi i shumë faktorëve. Është parë se faktorët influencues të zgjedhjes profesionale janë të natyrave të ndryshme. Shumë studime kanë treguar se pjekuria për karrierë apo gatishmëria e adoleshentëve për të marr vendimin është një faktor predikues mbi vendimmarrjen për zgjedhje të profesionit. Në vendin tonë të rinjtë hasin në vështirësi të mëdha gjatë procesit të tyre të vendimmarrjes për profesion. Duhet ndërmarrë hapa të shpejtë në drejtim të edukimit e orientimit profesional të të rinjëve kosovarë. Për të ndihmuar të rinjtë në këtë drejtim në radhë të parë duhet bërë studime për të eksploruar e analizuar faktorët që po influencojnë vendimmarrjen e adoleshentëve kosovarë dhe studimi i tanishëm do të realizohet me këtë qëllim.

Studimi ka për qëllim të: 1) Kuptojë se të rinjë kosovarë në gjysmëvjetorinë e fundit të shkollës së mesme a kanë vendosur për profesionin e tyre të ardhshëm dhe a janë të sigurt e të kanaqur me zgjedhjen e bërë; 2) Analizojë pjekurinë/gatishmërinë e adoleshentëve kosovarë për vendimmarrje, ndërlidhjen e pjekurisë me vendimmarrje dhe predikimin e pjekurisë së adoleshentëve për karrierë në vendimmarrjen e tyre; 3) Analizojë ndërlidhjen e faktorëve kontekstual me sigurinë për vendimmarrjen e adoleshentëve kosovarë për zgjedhje të profesionit. 4) Analizojë ndërlidhjen e përkrahjes se prindërve me sigurinë për vendimmarrjen e adoleshentëve kosovarë për zgjedhje të profesionit. Pyetjet hulumtuese në këtë studim janë: 1. Sa adoleshentë kosovarë kanë vendosur për profesionin e tyre të ardhshëm e që janë të sigurt e të kënaqur me vendimin e marr? 2. Çfarë është mardhënia midis pjekurisë për karrierë dhe sigurisë për vendimin e marr për profesionin e ardhshëm? 3. Çfarë është mardhënia midis faktorëve kontekstual dhe sigurisë për vendimin e marr për profesionin e ardhshëm? 4. Çfarë është mardhënia midis përkrahjes familjare, shkollës e bashkëmoshatarëve dhe sigurisë për vendimin e marr për profesionin e ardhshëm?

Methodologjia

Pjesëmarrësit

Pjesëmarrës në këtë studim kanë qenë 250 maturant të klasëve të 12-ta të Gjimnazit “Sami Frashëri” në Prishtinë të cilët janë përzgjedh përmas metodës rastësore grupore. Pjesëmarrësit kanë qenë në muajin e fundit të shkollimit të mesëm. Sa i përket moshës, 94.4% e pjesëmarrësve kanë qenë maturant të moshës 18 vjec, ndërsa 5.6% të moshës 19 vjecare. Nga gjithë pjesëmarrësit sa kanë qenë në këtë studim, 68.4% kanë qenë të gjinisë femërore ndërsa 31.6% të gjinisë mashkullore. Te gjithë kanë qenë nga Regjioni i Prishtinës, megjithëse 89.2% jetonin në qytet dhe 10.2 në fshat.

Matjet / Instrumentet

1. Pyetësori mbi të dhënat demografike.

2. Pyetësori mbi pjekurinë e adoleshentëve për karrierë. Pyetësori konsiston në pesë pjesë që nënkuptojnë pjekurinë për karrierë: planifikimin për karrierë, eksplorimin për karrierë, shkathtësitë për vendimmarrje, njohuritë rreth botës së punës dhe profesionin e preferuar. Bazuar në rezultatet, koeficienti i Alphës së Cronbach-ut për pyetësorin e plotë është parë të jetë .779. Koeficientë të lartë janë parë të jenë edhe nga analiza e pjesëve të pyetësorit veç e veç. (.723 - .812)

3. Shkalla e vendimmarrjes për karrierë (Osipow, 1976). Kjo shkallë është e dizenuar për të matur nivelin e sigurisë për vendimmarrje dhe pavendosshmërinë. Koeficienti i Alphës së Cronbach-

ut për pyetësorin e plotë është parë të jetë .926. Shkalla e sigurisë për vendimmarrje ka treguar koeficient prej .949, ndërsa shkalla e pavendosshmërisë .946.

Dizajni i studimit

Studimi ka një dizajn deskriptiv që ka filluar me përshkrimin e karakteristikave kryesore të maturantëve dhe vendimmarrjes së tyre për profesionin e ardhshëm. Është bërë analiza e korelacionit për të parë ndërlidhjen midis pjekurisë për karrierë dhe sigurisë për vendimmarrjen.. Studimi është ex post facto ndërsa sa i përket dimenzionit kohor, studimi në fjalë është ndërseksional i vetëm.

Rezultatet

Në bazë të analizave statistikore është kuptuar se pjesa më e madhe e adoleshentëve kosovarë të regjionit të Prishtinës kanë vendosur për profesionin e tyre të ardhshëm, përkatësisht, 78.4% e maturantëve kishin bërë zgjedhjen e tyre profesionale ndërsa 21.6% akoma nuk kishin vendosur. Nga pjesëmarrësit që kishin vendosur për profesion, 59.6 kanë deklaruar se zgjedhjen e kanë bërë vet, 17.2 kanë deklaruar se profesioni që janë përcaktuar nuk është zgjedhje e tyre, ndërsa të tjerët janë deklaruar si neutral ndaj kësaj çështje.

Pjekuria për karrierë ka konsistuar në pesë komponente për të cilat kanë raportuar pjesëmarrësit dhe në saje të përgjigjjeve është kuptuar edhe niveli i tyre. Nga gjithë pjesëmarrësit, 32.4% kanë raportuar nivel të lartë të planifikimit për karrierë, 48.8 nivel të mesëm, ndërsa 18.8 kanë raportuar nivel të ulët. Sa i përket dimenzionit tjetër eksplorimit për karrierë, 70.8% kanë raportuar nivel të lartë të eksplorimit, 24.8% nivel të mesëm dhe 4.4% nivel të lartë. Përqindje po ashtu e lartë e pjesëmarrësve kanë raportuar nivel të lartë të shkathtësive për vendimmarrje, ku 88.4 kanë treguar nivel të lartë, 6.8% nivel të mesëm ndërsa 4.8% nivel të ulët. Për njohuritë rreth botës së punës, 76.8% kanë raportuar nivel të lartë të njohurive, 20.4% nivel të mesëm dhe 2.8% nivel të ulët. Njohuri të nivelit më të ulët janë parë të jenë për profesionin e preferuar ku 49.8% kanë raportuar nivel të lartë të njohurive, 37.2% nivel të mesëm ndërsa 13.0% kanë raportuar nivel krejtësisht të ulët të njohurive për profesionin e zgjedhur.

Profesionet e zgjedhura nga ana e të rinjve ishin nga më të ndryshëm, por Fakulteti Ekonomik ishte më i zgjedhuri ku 14.8% e pjesëmarrësve ishin përcaktuar për të. Profesionet tjera më të zgjedhura nga ana e të rinjve ishin Arkitektura, Psikologjia, Pedagogjia, Shkencat kompjuterike, etj. Për të kuptuar nëse profesioni i zgjedhur ka ndonjë ndërlidhje me profesionin e prindërve, motrës e vëllaut, është bërë analiza e ndërlidhjes së tyre në bazë të së cilës kemi këto gjetje: Cramer's V për profesionin e pjesëmarrësve të këtij studimi dhe profesionin e nënës është .385 dhe sig. prej .000, babait .366 e sig. prej .002, motrës .403 dhe sig. prej .000 si dhe vëllaut .415 dhe sig. prej .000.

Është parë nëse siguria për vendimmarrjen ka ndërlidhje me moshën, gjininë, vendbanimin, radhën e fëmijës, faktin se pjesëmarrësit jetojnë me prindër apo vetëm, dhe rezultatet tregojnë një ndërlidhje fare të ulët e pa domethënie statistikore. Për analizën e sigurisë për vendimmarrjen me gjininë Cramer's V doli të jetë .027 dhe signifikancë prej .669, për sigurinë e vendimmarrjes me moshën Cramer's V .028 dhe sig. prej .326. Sa i përket ndërlidhjes së sigurisë për vendimmarrjen me variablat tjera demografike rezultatet tregojnë ndërlidhje fare të ulët e pa domethënie statistikore, përkatësisht, për vendbanimin, Cramer's V doli të jetë .053 me sig. prej .402, për faktin se a jetojnë pjesëmarrësit apo jo me prindër Cramer's V .071 me sig. prej .531, për numrin e fëmijëve në familje Cramer's V doli .144 me sig. prej .393 dhe sa i përket radhës së fëmijëve që pjesëmarrësit ishin, Cramer's V ishte .062 me sig. prej .929.

Niveli i sigurisë për vendimin e marrë është parë të jetë i lartë tek 76.8% e pjesëmarrësve të cilët kishin bërë zgjedhjen e tyre profesionale ndërsa 23.2% e tyre kishin raportuar nivel krejtësisht të ulët. Siguria për vendimmarrje duket të jetë e lartë tek një përqindje e madhe e kampionit, por në këtë rast do të ishte e rëndësishme të kuptohet se me cilin faktorë kjo siguri po ka më shumë ndërlidhje në këtë studim. Për të kuptuar ndërlidhjen e pjekurisë për karrierë dhe sigurisë për vendimmarrjen është bërë analiza e korelacionit. Kjo analizë është përdorur për të kuptuar edhe ndërlidhjen e sigurisë për vendimmarrje me faktorët kontekstual, përkrahjes së prindërve, mësimdhënësve e

KUMTESA

bashkëmohatarëve. Koeficientët e korelacionit të Pearson-it për sigurinë e vendimmarrjes me të gjithë faktorët tjerë janë paraqitur në tabelën 1.

| | Siguria | | | Siguria | |
|--------------------------------|---------|------|---|---------|------|
| Pjekuria për karrierë | .314 | .000 | Njouritë rreth profesionit të preferuar | .391 | .000 |
| Planifikimi për karrierë | .308 | .000 | Faktorët kontekstual | .357 | .000 |
| Eksplorimi për karrierë | -.063 | .318 | Përkrahja e prindërve | .546 | .000 |
| Shkathhtësitë vendimmarrje për | .113 | .075 | Përkrahja emësimdhënësve | .293 | .000 |
| Njohuritë rreth punës | .185 | .003 | Përkrahja bashkëmohatarëve | .454 | .000 |

Tabela 1. Shënim. Koeficientët e korelacionit për variabël e pavarura me variablën e varur. Variabla e varur: Siguria për vendimmarrjen.

Diskutimi

Rezultatet e këtij studimi tregojnë se një përqindje e lartë e maturantëve e klasëve të dymbëdhjeta të regjionit të Prishtinës kanë vendosur për profesionin e tyre të ardhshëm, mirëpo, gjetjet po ashtu tregojnë se 21.6% e pjesëmarrësve nuk kishin vendosur edhe pse ishin në muajin e fundit të shkollimit të tyre të mesëm. Nga përqindja e atyre që kishin vendosur, 17.2 kanë deklaruar se për profesionin që kanë zgjedhur nuk kanë vendosur vet. Sa do që pjesa më e madhe kanë vendosur për profesion, përqindja e pjesëmarrësve që nuk kanë vendosur është prapë e lartë dhe kjo e dhenë nuk përkon me të dhenat mbi këtë çështje të studimeve tjera në botë.

Pjesëmarrësit kanë treguar nivel të lartë të pjekurisë për karrierë. Në bazë të analizës statistikore është kuptuar një ndërlidhje e nivelit mbi mesatar midis pjekurisë për karrierë dhe vendosjes apo jo për profesion (Cramer's V .545 dhe sig. prej .001) që do të thotë se maturantët të cilët kanë vendosur për profesion kanë raportuar nivel të lartë të pjekurisë për karrierë. Këto gjetje janë në kongruencë me studimet tjera dhe mbështeten edhe nga teoritë mbi zhvillimin për karrierë (Super, 1957). Pjesëmarrësit kanë qenë të moshës 18 dhe 19 vjeçare, moshë kjo që përkon me karakteristikat e fazës së zhvillimit për karrierë. Me fjalë tjera, sipas teorisë së Super (1957) faza e tretë e zhvillimit për karrierë është faza e eksplorimit që përfshinë moshën prej 14 – 23 vjeç dhe njëra nga detyrat e kësaj faze është përcaktimi / vendosshmëria për profesion. Niveli i lartë i sigurisë për vendimmarrje tregon se pjesa më e madhe e pjesëmarrësve të cilët kishin vendosur për profesion janë të sigurt për vendimin e marrë.

Siguria për vendimmarrjen nuk është parë të jetë e lidhur me të dhënat demografike të pjesëmarrësve të këtij studimi. Nuk është parë të jetë ndonjë dallim gjinor në kuptimin e sigurisë për vendimin e marrë. Këto rezultatet përkojnë me shume studime (Neice & Bradley, 1979; Stead, 1989), ndonëse ka edhe studime tjera në të cilat meshkujt kanë treguar siguri më të lartë (Kishor, 1981; Richardson, 1974), por edhe ka edhe studime në të cilat femrat kanë raportuar nivel të lartë të sigurisë (Lokan, Boss, & Patsula, 1982; Vondracek, Hostetler, Schulenberg, & Shimizu, 1990; Wallace-Broschious et al., 1994). Dallime për sigurinë e vendimit të marrë nuk janë parë as në aspektin moshor, gjetje këto që janë në konsistencë të disa studimeve të bëra vite më parë (Neice & Bradley, 1979; Stead, 1989). Të gjitha ndërlidhjet e sigurisë për vendimmarrje me variablat demografike kanë qenë jashtëzakonisht të ulëta dhe pa domethënie statistikore.

Bazuar në analizën e korelacionit, mund të thuhet se siguria për vendimmarrjen ka ndërlidhje me pjekurinë për karrierë. Shkalla e ndërlidhjes së sigurisë me pjekurinë për karrierë me korelacion pozitiv prej .314 dhe signifikancë prej .000 nënkupton se sa më i lartë të jetë niveli i pjekurisë për karrierë, aq më i lartë është edhe niveli i sigurisë për vendimmarrje. Signifikanca prej .000 tregon se kjo ndërlidhje ka domethënie statistikore. Ndërlidja midis këtyre dy faktorëve mbështetet nga teori e studime të shumta (CDS; Osipow, Carney, Winer, Yanico, & Koschier, 1976). Disa teori e studime pjekurinë për karrierë nënkuptojnë madje si gatishmëri për të marrë vendim për profesion (Poëll & Luzzo, 1998). Njohuritë për profesionin e preferuar ka pasur ndërlidhjen e nivelit më të lartë me

sigurinë për vendimmarrjen me koeficient prej .391 dhe signifikançë prej .000 që nënkupton se sa më shumë njohuri që të rinjtë kanë për profesionin e tyre të preferuar, aq më të lartë e kanë sigurinë për vendimmarrje.

Bazuar në të njëjtën analizë statistikore, siguria për vendimmarrjen është parë kë ketë ndërlidhje edhe me faktorët kontekstual dhe përkrahjen prindërove, mësimdhënësve e bashkëmohatarëve për zgjedhje të profesionit. Rëndësia dhe ndërlidhja e faktorëve kontekstual me vendimmarrjen është potencuar edhe nga studime tjera (Lent, K W., Brown, S, D., & Hackett, G. 1996; Ferry, (2006). Përkrahja prindërore është parë të jetë faktori me nivel më të lartë të ndërlidhjes me sigurinë për vendimmarrje, por ndonëse në nivel pak më të ulët, edhe shkolla dhe bashkëmohatarët janë parë të jenë faktorë mjaft të rëndësishëm për sigurinë e vendimmarrjes, gjetje këto që konsistojnë në një linjë të drejtë me rezultatet e studimeve të bëra për analizë të faktorëve të tillë (Ferry, 2006). Rezultatet mbi ndërlidhjen e vendimmarrjes me përkrahjen e prindërove, shkollës, bashkëmohatarëve e faktorëve tjerë kontekstual janë në konsistencë edhe me gjetjet e studimit të bërë në Kosovë (Jemini – Gashi, L. 2010).

Bazuar në të gjitha rezultatet e këtij studimi, mund të thuhet se vendimmarrja për profesion është një process i ndërlikuar edhe për të rinjtë kosovarë të regjionit të Prishtinës. Rezultatet tregojnë se pjesa më e madhe e maturantëve kanë vendosur për profesion, por është mjaft shqetësuese që rreth njëzet përqind e pjesëmarrësve nuk kishin bërë zgjedhjen e tyre profesionale edhe pse ishin në fund të shkollimit të mesëm. Shqetësues po ashtu është fakti që disa prej pjesëmarrësve kanë deklaruar se profesioni i zgjedhur nuk është vendim i tyre. Ky studim jep një pasqyrë të qartë të të dhënave mbi sigurinë e vendimmarrjes ndërlidhur me shumë variabla të rëndësishme, por janë më se të nevojshme dizenjime tjera të studimeve duke përfshirë edhe faktorë tjerë.

KUMTESA

Msc. Jehona Ferizi MIFTARI, Besa FERIZI: PËRSHKRIMI I FRIKËS SHKOLLORE TE FËMIJËT QË NISIN KLASËN E PARË

Studente e doktoraturës, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë

Asistente për lëndët e pedagogjisë, Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës

I. Hyrje

Me përfundimin e luftës në Kosovë, nisi reformmi i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet, nga arsimit dhe edukimi parashkollor deri në arsimin e lartë, me qëllim të sëndërtimit të një sistemi të arsimit bashkëkohor. Me këtë rast, dukshëm vërehen ndryshimet në të gjitha fushëveprimtaritë arsimore, u përmirësua infrastruktura shkollore, u organizuan programe trajnimi e aftësimi profesional të mësimdhënësve, u hartuan dhe u implementuan ligje e dokumente të shumta që rregullojnë veprimtarinë shkollore siç janë: *Korniza e Kurrikulit të Ri të Kosovës, Strategjia e Zhvillimit të Arsimit në Kosovë(2007-2017)* etj. Ndryshimet në legjislacionin shkollor sollën edhe zgjatje të shkollimit të detyrueshëm, organizim të ri të niveleve të shkollimit.⁵³³ Në bazë të këtij legjislacioni shkollor të tanishëm, edukimi parashkollor merr karakter obligativ dhe parashihet që fëmijët para se të nisin klasën e parë, të ndjekin dy nivele të edukimit atë parashkollor (mosha 1-5) dhe parafillor (mosha 5-6), e kjo shpie drejt përgatitjes më të mirë të fëmijëve që nisin jetën shkollore. Edhe në *Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë (2011-2016)*, del të jetë prioritet dhe çështje strategjike „zhvillimi dhe përkrahja e shërbimeve të zhvillimit në fëmijërinë e herëshme... zhvillimi i ambienteve miqësore shkollore për fëmijët”.⁵³⁴ Megjithë këta hapa pozitivë të hedhur deri tani, jemi dëshmitarë të një situate jo të mirë në këtë rrafsh. Edhe pse proklamohet rëndësia e edukimit parashkollor dhe parafillor, si dhe e drejta për pjesëmarrje e secilit fëmijë në te, përfshirja e fëmijëve në këto nivele të edukimit është e vogël. Dhe, me këtë rast rriten gjasat që pikërisht këta fëmijë, të cilët nuk kanë pasur ndonjë parapërgatitje profesionale për të nis klasën e parë, përkatësisht një hallkë të re në vargun e hallkave të mëtejme të edukimit dhe arsimimit, refuzojnë të shkojnë në shkollë dhe kanë frikë para se të shkojnë në shkollë. Fillim viti shkollor, takimi i parë me mësuesin apo mësuesen bënë që te shumë fëmijë të dridhet buza dhe gati sa edhe nuk pikon loti. Që në klasën e parë do të kemi „, fëmijë, i cili di të flas për jetën në mars, po nuk di t'i mbledhë 2+2,... fëmijë i cili si pa kokë nxiton ta kryejë detyrën, i pari e kryen, po asgjë nuk është e saktë... fëmijë i cili nuk do të shkojë në shkollë, në vend të saj shpik probleme lukthi, temperaturë ose kokëdhembje”⁵³⁵ Ky ilustrim situatë, kjo laramani në klasë tregon më së miri se mënyra se si fëmijët iu përgjigjen kërkesave në mjedisin shkollor, se si ata e përjetojnë jetën shkollore, varion nga fëmija

⁵³³ Shih më shumë: MASHT, Korniza e Kurrikulit të Ri të Kosovës

⁵³⁴ Shih më shumë: MASHT, Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë (2011-2016)

⁵³⁵ Miller, Bonnie. Komunikimi me fëmijë. Ferizaj: QPEA, 2004, fq.98.

në fëmijë. Secili fëmijë, botë në vetë! Kur flasim për fëmijët e moshës 6 vjeçare, që nisin klasën e parë, mund të themi që nuk janë të paktë fëmijët, të cilët nuk iu përshtaten shpejt ndryshimeve, tregohen të druajtur, nuk marrin pjesë me entuziazëm në aktivitetet mësimore, për ta vajtja në shkollë, angazhimi në aktivitete mësimore, detyra të ndryshme, mund të jetë edhe burimi i mundshëm i vuajtjeve, dhe që ata të refuzojnë të shkojnë apo edhe të qëndrojnë në shkollë. Ky problem, i dalë në shesh me emrin tani *frika shkollore* ka qenë i rrënjësor qysh para shumë kohësh dhe as atëherë e as tani nuk është trajtuar në mënyrën adekuate.

Vlerësojmë, që edhe prindërit e edhe mësuesit nuk kanë qenë në dijeni sa duhet për rëndësimë që ka përgatitja e fëmijës për kalim sa më të lehtë nga nivelet e shkollimit dhe se kjo periudhë e nisjes së klasës së parë, është një periudhë delikate në jetën e fëmijës dhe mund të gjurmë në jetën psiko-fizike të tij.

II. Qasje metodologjike e problemit

Qëllimi i hulumtimit: Qëllimi ynë ishte fillimisht të ndihmojmë me informacion dhe me sugjerime për tematikën në fjalë, të identifikohen shkaqet e mundshme dhe të sugjerohen ndërhyrjet për evitimin e rasteve që çojnë në shfaqjen e frikës shkollore te fëmijët që nisin klasën e parë.

Detyrat e hulumtimit: Të nxirren të dhëna për për praninë e frikës shkollore, te fëmijët e moshës 6–vjeçare që nisin klasën e parë; Të nxirren rekomandime, në ndihmë gjashtëvjeçarëve që kanë frikë të shkojnë në shkollë apo refuzojnë të qëndrojnë në shkollë; T'i nxisim psikologët dhe mësimdhënësit, që të marrin iniciativat profesionale, në dobi të përmirësimit të gjendjes në shkollat tona, në drejtim të evitimit të frikës shkollore te fëmijët e moshës 6 vjeçare që nisin klasën e parë;

Hipoteza:

H: Te fëmijët që nisin klasën e parë, është e pranishme frika shkollore

H': Te fëmijët të ndryshëm, frika shkollore varion në format e shprehjes së saj

Pjesëmarrësit në hulumtim: Fillimisht me ndihmën e drejtorëve të shkollave dhe mësuesëve, janë selektuar rastet për hulumtim dhe i kemi kontaktuar prindërit e këtyre fëmijëve, gjithsej 15 prindër, prej tyre 10 femra dhe 5 meshkuj, prej tyre 7 me edukim superior. Për mbledhjen e të dhënave për tematikën në fjalë, pjesëmarrës në hulumtim ishin edhe mësuesit e fëmijëve që kishin refuzuar shkuarjen, qëndrimin në shkollë. Pyetëtori i'u është shpërndarë pjesëmarrësve, duke iu rikujtuar atyre konfidencialitetin. Hulumtimi është realizuar në qytetin e Vushtrisë, përkatësisht në 4 shkolla fillore.

Metodat dhe instrumentet e hulumtimit: Si instrument hulumtimi për të nxjerrë të dhëna nga terreni, për problematikën në fjalë kemi përdorur *pyetësin*. Pyetësi përmbante pyetje të thjeshta që kërkonin nga pjesëmarrësit të përshkruanin situatat me të cilat janë ballafaquar dhe mënyra se si ia kanë dalë që t'i bindin fëmijët e tyre që të mos refuzojnë shkuarjen apo qëndrimin në shkollë. Prindërit e edhe mësuesit nuk kishin shumë informacione në këtë rrafshin psikologjik të problemit, bile emërtimi *fobi shkollore* nuk ishte shumë i qartë për ta. Ata ishin në gjendje të flasin e të na ofrojnë informacion vetëm në tipet e pyetjeve të mëposhtme si: *A mund ta sillni ndërmend për ne reagimet e fëmijës tuaj në fillim vitin shkollor?; A mund të na tregoni me hollësi se si vepruat në këtë rast?; Sa i fuqishëm mendoni se ka qenë bashkëpunimi shkollë-familje (mësues-prindër) për t'u zbutur problem? etj.* Pyetëtori iu është shpërndarë pjesëmarrësve, duke iu rikujtuar atyre konfidencialitetin. Koha për të plotësuar pyetësin ishte 20 minuta. Pjesëmarrësit në hulumtim treguan seriozitet, gatishmëri në trajtim të çështjes. Metoda e përdorur në hulumtim është ajo *analitike* dhe *deskriptive* (përshkruese).

III. Përshkrimi i frikës shkollore

Në cilat raste mund të flasim për frikë shkollore? Për frikën nga gjërat, objektet specifike flasin shumë studime. Duke u nisur nga përkufizimi i kuptimit të nocionit frikë/fobi, në fjalorin psikologjik gjejmë se,, fobia (greq.phobia = frikë), frikë e sëmurë te disa individë ndaj objekteve, ndaj dukurive ndaj

situatave⁵³⁶. Dhe, sigurisht që çdo njeri ndjenë disi frikë apo pasiguri në situata të caktuara në jetë, por kur kjo frikë bëhet pengesë në funksionimin normal të jetës, atëherë mund të themi që kemi të bëjmë me një frikë specifike⁵³⁷ që edhe mund të jetë rast për t'u brengosur. Kur flasim për fëmijët e moshës 6 vjeçare, të cilët nisin klasën e parë mund të themi që sa sjell hare në jetën e fëmijës vajtja në shkollë, angazhimi në aktivitete, detyra të ndryshme, në të njëjtën kohë mund të jetë edhe burimi i mundshëm i vuatjes, frikës. Që në ditët e para të shkuarjes në shkollë, do të dalin në pah fëmijët që i përtojnë shkuarjes në shkollë, për arsye që kanë qef të qëndrojnë në shtëpi, meqë aty e kanë mundësinë të vazhdojnë të merren me aktivitete, punën që iu pëlqen, aty kanë prindërit afër dhe fleksibiliteti ditor në shtëpi i tërheqë ata. Janë një mori arsyesh që shtyejnë fëmijët të mos pajtohen për të marrë rrugën për në shkollë ose të refuzojnë të qëndrojnë në shkollë. Ka mundësi që vajtja në shkollë të sjellë frikë apo të shoqërohet me një dozë frike, e cila përmban në vetvete dimensione psikologjike, konsiderohet si një lloj depresioni psikik.⁵³⁸ Nga shfletmi dhe analiza e literaturës që trajton tematikën në fjalë, del se janë një mori faktorësh që bëjnë të rriten gjasat që fëmijët që nisin klasën e parë të refuzojnë shkuarjen apo qëndrimin në shkollë. Fëmijët me frikë shkollë fillimisht kanë kinse simptomat e sëmundjes dhe të tillët zakonisht „sëmuren” derisa ai /ajo të mos jetë i/e sigurtë se do të mbetet në shtëpi dhe nuk do të marrë rrugën për në shkollë. Përpjekjet për të definuar frikën shkollë datojnë kaheerë, që në vitin 1932 nga **Droadwin**, pastaj

Johnson, Kenocily e të tjerë.⁵³⁹ Sot, frika shkollë shihet si,, frikë intenzive e fëmijës, që lidhet me shkollën ... stres kronik, i cili emocionalisht e godet fëmijën, ... prek shëndetin e fëmijës, ndikon në funksionimin e disa organeve, ul rezistencën dhe shkakton pengesa psikofiziologjike ose psikosomatike”⁵⁴⁰. Ankesat nga më të ndryshmet vijnë gjithëherë pothuajse në kohën e njëjtë, në kohën kur nisin përgatitjet për të shkuar në shkollë, atëherë fëmijët zakonisht ankohen se kanë dhimbje koke, dhimbje të fytit, barkut me qëllim që t'u lejohet të qëndrojnë në shtëpi.⁵⁴¹

Përvoja dhe hulumtime të shumëta tregojnë se për frekuentimin e fëmijës në shkollë, ambientimin e tij në mënyrë të tërthortë kanë përgjegjësi edhe prindërit e fëmijëve. Sa më i kënaqshëm të jetë raporti i bashkëpunimit të prindërve me mësuesin, aq më sukseshëm do të integrohet fëmija në jetën shkollë meqë prindëritë do të kontribuojnë në përzgjedhjen sa më adekuate të përmbajtjeve të ndryshme, të cilat janë të përshtatshme për shkollën e zhvillimit të fuqive dhe aftësive, interesave, emocioneve, përvojës së përditëshme të fëmijëve. Nuk do të ishte korrekte, që në këtë proces të shihet mësuesi apo mësuesja si faktor i vetëm me rëndësi në këtë proces, meqë edhe prindërit kanë përgjegjësi. Në vargun e faktorëve me rëndësi jetike në këtë proces, është edhe ndikimi i mësimdhënësit, shkalla e njohurive

⁵³⁶ Nushi, Dr Pajazit. Fjalor i psikologjisë. Prishtinë. 1987, fq.70.

⁵³⁷ Shih më shumë: Morris, Charles& Maisto, Albert. Psikologjia-shkenca e proceseve mendore dhe e sjelljeve njerëzore. Tiranë: CDE, 2008, fq. 427.

⁵³⁸ www.telegrafi.com/.../perse-femijet-refuzojne-shkollen-53-8.html

⁵³⁹ Kearney, Christopher A.Silverman, Wendy K.TITLE. Children and Adolescents with School RefusalBehavior | PUB DATE Nov 91NOTE14p.; Paper presented at the Annual Convention of the American Association for Advancement of BehaviorTherapy (25th, New York, NY, November 21-24,1991).

⁵⁴⁰ Grup autorësh. Shkolla dhe shëndeti mental. Ferizaj: QPEA, 2007, fq.181.

⁵⁴¹ http://www.aacap.org/galleries/FactsForFamilies/07_children_who_wont_go_to_school.pdf

psikologjike e posaqërisht të psikologjisë fëmijërore e tyre. Është fakt që suksesi akademik vazhdon të jetë prioritet i shumë mësuesëve, ata harrojnë të përdorin „fjalët, foljet, pasthirrat, gjestet ose grimasat që i tregojnë nxënësit se po i kuptojnë ndjenjat e tyre”.⁵⁴² Harrohet faktin që rruga e suksesit është inkurajimi i fëmijëve, ofrimi i një mjedisi stimulues, mbështetës për nga ana emocionale do ta trimëronte fëmijën meqë „ gjashtëvjeçari merr krahë kur nxitet, dështimet i ka të vështira... shkolla zëvendëson shtëpinë si influencë ambiente më e rëndësishme”⁵⁴³ Figura e mësueses apo mësuesit, përshtypjet e fëmijëve për të janë shumë të rëndësishme në këtë proces. Jo rrallëherë na ka rastisur të dëgjojmë, se si fëmijët i ekspozohen frikës shkollore edhe nga fjalët kërcnuese të ndryshme të prindërve si, „kamera e mësueses është në shtëpinë tonë, ajo sheh gjithçka që ti po bën”. Pa e nisur mirë ende jetën e shkollarit, fëmijët nisin të krijojnë përshtypjet e tyre për shkollën, punën që i pret atje figurën e mësuesit dhe dita e parë e shkollës, është momenti kur fëmija vërteton personalisht përshtypjet pozitive dhe ato negative që i ka për shkollën”⁵⁴⁴. Që në ditën e parë në shkollë fëmijëve iu bënë jashtëzakonisht përshtypje toni i zërit të mësueses apo mësuesit, mimika e tij, qëndrimi dashamirës, përkujdesi, interesimi, *komunikimi që iu jep zemër* (ledhatim koke, thirrja me emër).

IV. Rezultatet e hulumtimit

Frika shkollore del të jetë rezultat i shumë faktorëve dhe sigurisht që po qe se do të bënim një studim më të thellë dhe më të gjatë në kohë do të gjenim edhe një mori arsyesh (frikësimesh) të ndryshme, që i shtyejnë fëmijët të refuzojnë shkuarjen apo qëndrimin në shkollë. Harmonizimi i të dhënave nga pyetësori qetë në pah këto pika:

- Janë shumë të rëndësishme përshtypjet e nxënësve për ditën e parë të ardhjes në shkollë, takimin me mësuesin (nxënia është proces i gëzueshëm). Klima jo e mirë në shkollë, struktura dhe dinamika e klasës, tipi i mësuesit, kërkesat që shtron ai në procesin e të nxënësit, janë arsye që të shfaqet te fëmija frika shkollore.
- Fëmija, zhvillimi psiko-fizik i tij, janë një faktor me vete, me peshë në çështjen e shfaqjes së refuzimit për të shkuar në shkollë. Të qenit ndryshe nga të tjerët- dallimet trupore mund të jenë arsye për t’u shfaqur refuzimi për të shkuar në shkollë (mbipesha dhe ora e edukatës fizike)
- Të nxënësit dhe rezultatet e fëmijës mund të jenë një shkak i shfaqjes së refuzimit për të shkuar, qëndruar në shkollë(harrimi i librave, mosbërja e detyrave të shtëpisë etj.)
- Nuk punohet sa duhet në drejtim të përgatitjes së fëmijëve për një kalim sa më të lehtë nga nivelet e shkollimit (mungesa e dokumentimit të zhvillimit psikofizik të fëmijëve, raporti MM dhe MK, pikat e dobëta dhe të forta të fëmijës); Numri i madh i nxënësve minimizon përkujdesjen individuale të mësuesit për secilin fëmijë.
- Kontributi i psikologut në shkollë është i domosdoshëm
- Përgatitja jo e mirë e mësimitdhënësve në çështjet psiko-pedagogjike, në zotërim të teknikave për menaxhimin e dukurive afektive (laramania e rasteve dhe situatave). Ata e shohin veten pa përvojë paraprake, pa modele të mirëfillta veprimi për tematikën në fjalë.

⁵⁴² Ismaili, Xhafer. Efektet stresuese të mësimitdhënies dhe ecuritë e reduktimit të tyre. Prishtinë: Libri shkollor , 2011, fq.241.

⁵⁴³ Grup autorësh . Krijimi i klasave me në qendër fëmijën (6-7 vjeç). Tiranë:Extra, 1999, fq. 15.

⁵⁴⁴ Ismajli, Xhafer: Motivimi dhe emocionet në shkollë. Shkëndija, dhjetor ,2000.fq 2.

- Niveli arsimor i prindërve dhe reagimet prindërore, shpesh herë nuk ndihmojnë fëmijën (besimet personale të gabuara, moskëshillimi me psikologun, përgatitja e gabuar e fëmijës për ndryshime - ,, kamera e mësueses në shtëpi”)
- Tipi i prindit, qëndrimi që mbanë ai ndaj fëmijës, situatat e pakëndshme në familje (ndryshimet në strukturën familjare- divorci i prindërve), qëndrimi i gjatë kohor larg nënës mund të nxisin refuzimin për të shkuar në shkollë.
- Në një nga rastet që hulumtuam, del se edhe përvojat e këqija rrugës për në shkollë, mund të nxisin fobi shkollore(gjarpëri, aksidenti)

V. Rekomandimet

Del të jetë domosdoshmëri njohja e problematikës në fjalë nga të gjithë partnerët pjesëmarrës në procesin mësimor dhe koordinimi i tyre, ashtu që të konstatohet me kohë arsyeja e shfaqjes së frikës shkollore dhe të merren hapa konkretë për t'i ndihmuar fëmijëve ta mposhtin frikën dhe rezistencën ndaj shkollës. Mësuesit dhe prindërit, mund ta ndihmojnë reciprokisht njëri- tjetrin, duke përzgjedhur aktivitete interesante, argëtuese për fëmijët, ashtu që pasurohet përvoja ditore e fëmijës në shkollë, reduktohen aktivitetet stresuese në klasë. Psikologu shkollor është agjent i ndryshimeve në këtë proces. Me kontributin e psikologut do të mundësohet krijimi i një mjedisi mbështetës, inkurajues për të gjithë fëmijët - le të mos harrojmë shkolla zëvendëson shtëpinë.

Ndihet nevoja për fushatë ndërgjegjësuëse, hartim të doracakëve, që do të ofrojnë informacione për mësimdhënësit dhe prindërit, për procesin e trajtimit të frikës shkollore, me udhëzime konkrete për rolin, përgjegjësitë e mësimdhënësit dhe prindërve në këtë proces (pasqyrimi i laramanisë së rasteve dhe situatave).

KUMTESA

Rozafa Ferizi- SHALA¹, Violeta BUZA²: SFIDAT DHE MUNDËSITË PËR NGRITJEN E CILËSISË NË EDUKIMIN PARASHKOLLOR

¹Fakulteti i Edukimit- Universiteti i Prishtinës

²Fakulteti i Edukimit- Universiteti i Prishtinës

Hyrje

Kosova si shtet i ri në rajon dhe në Evropë ende po kalon në procesin e saj të rimëkëmbjes dhe rifunksionimit në të gjitha dimensionet e jetës shoqërore. Edhe pse tashmë faza e emergjencës ka kaluar dhe themelimi i institucioneve të pavarura të Kosovës është bërë, para vetës kemi shumë sfida tjera të cilat na presin në këtë fazë pas shtet formimit. Përmirësimi i cilësisë së jetesës në përgjithësi dhe plotësimi i standardeve drejt integritimeve evropiane janë synimet drejt së cilave po lëvizin ndryshimet në shoqërinë tonë.

Edhe arsimit ashtu si të gjithë sektorët e tjerë po lëvizë me hapa konkret drejt ndryshimeve. Përmirësimi i legjislativitetit, rritja e hapësirave shkollare, riaftësimi i mësimdhënësve, provimi shtetëror, arsimit fillor i obligueshëm, riorganizimi i shkollave profesionale, janë disa nga hapat konkret që janë ndërmarrë në këtë drejtim. Edukimi parashkollor po ashtu është pjesë përbërëse e sistemit arsimor në Kosovë, sistem ky i cili organizohet sipas niveleve ISCED⁵⁴⁵. Sipas saj, edukimi parashkollor paraqet nivelin 0 të shkollimit, ku moshën 0-5 vjeç paraqet arsimin parashkollor, ndërsa moshën 5-6 vjeç paraqet arsimin parafillor, funksioni i së cilës është përgatitja e fëmijëve për klasën e parë.

Edukimi parashkollor i institucionalizuar sot paraqitet si domosdoshmëri e kohës. Në studimet e shumta nga fusha e psikologjisë, pedagogjisë parashkollore, neurobiologjisë, si dhe shumë shkencave tjera të cilat merren me studimet e ndryshme në fëmijërinë e hershme, mbrojnë qëndrimin se eksperiencat dhe të nxëniet e fëmijës në fëmijërinë e hershme janë shumë të rëndësishme në zhvillimin e gjithmbarshëm të personalitetit të tij.

Me gjithë ndryshimet që janë bërë, gjendja në institucionet parashkollore vazhdon të jetë e pa kënaqshme. Situata në të cilën ndodhemi sot tregon se fëmijët nuk janë të përfshirë aq sa duhet në institucionet parashkollore. Janë të nevojshme investimet në infrastrukturë sidomos në zonat rurale. Në zonat urbane mungojnë hapësirat e nevojshme për fëmijët, ku numri i fëmijëve është mbi mesataren e lejuar me ligj.⁵⁴⁶ Shqetësues vazhdon të jetë statusi i ulët i edukatoreve në shoqëri, gjë e cila tregon për një shkallë të ulët të vetëdijes nga popullata e gjerë. Të gjithë këta faktorë, si dhe shumë të tjerë ndikojnë në cilësinë e punës që zhvillohet në institucionet parashkollore.

Qëllimi i studimit:

Të bëhet një analizë rreth gjendjes faktike mbi cilësinë e punës në edukimin parashkollor, me sfidat që përballen dhe mundësitë për ngritjen e cilësisë brenda institucioneve.

Objektivat e studimit:

- Të tregojmë sfidat me të cilat përballen edukatorët gjatë realizimit të veprimtarisë edukative-arsimore në institucion.

⁵⁴⁵ ISCED- Klasifikimi Standardë ndërkombëtar i Arsimit SNKA (UNESCO-ISCED)

⁵⁴⁶ Ligji mbi Edukimin Parashkollor Nr. 02/ L-52, http://www.masht.gov.net/advCms/documents/7_LEP_ligji_mbi_edukimin_parashkollor.pdf

KUMTESA

- Të analizohen kushtet në të cilat punojnë edukatorët në kuadër të institucioneve parashkolllore.
- Të paraqesim të dhënat statistikore mbi bazën e pyetësorëve të plotësuar nga edukatorët e përfshira në hulumtim dhe të dhënat nga vrojtimi i drejtpërdrejtë.

Metodologjia:

Hulumtimi është realizuar me edukatore të cilat punojnë me fëmijë të grup-moshës 5-6 vjeçare, në kuadër të institucioneve parashkolllore dhe në kuadër të shkollave në klasë parafillore.

Kampioni për këtë studim është përzgjedhur në mënyrë të qëllimshme, për shkak të nxjerrjes së rezultateve sa më konkrete. Kampioni përbëhet nga 64 pjesëmarrës - edukatore dhe përfshinë gjashtë komuna të Kosovës. Prizreni dhe Gjakova me 25%, Peja dhe Theranda me 17 %, Deçani dhe Burimi me 8 % të pjesëmarrjes.

Instrumentet e hulumtimit përfshijnë pyetësorët dhe vëzhgimin e drejtpërdrejtë në disa nga institucionet parashkolllore. Të dhënat nga vrojtimi dhe përgjigjet e dhëna në pyetësorët e plotësuar nga ana e edukatoreve, janë analizuar në mënyrë kualitative dhe kuantitative .

Rezultatet e studimit:

Këto të dhëna kualitative na ndihmojnë që të japim një vlerësim më real për punën që realizohet me këta fëmijë në institucionet parafillore. Korniza e Kurrikulës e mbështetur në strukturën e re të arsimit parasheh që moshë 5 – 6 vjeç të jetë klasë përgatitore e fëmijës për klasën e parë. Fëmijët në këtë moshë do të njihen me elementet e shkronjave dhe strukturën e një teksti të thjeshtë duke shfrytëzuar fotografi, vizatime etj. Ata do të njihen me numrat dhe veprimet e thjeshta matematikore, grupime të elementeve, zgjidhje të problemeve konkrete etj. Aktivitetet nga fusha e artit duhet të jenë pjesë e rëndësishme e programit me qëllim të zhvillimit të ndjeshmërisë dhe anës afektive të fëmijëve.⁵⁴⁷


Kjo kërkesë e re nxjerr edukatorët para një sfide të re. Por,

- A ka hapësirë të mjaftueshme për numrin e fëmijëve të cilët vijnë në arsimin parafillor?

- A janë institucionet tona të pajisura mirë me mjete dhe materiale të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve me fëmijë?

Këto dhe shumë pyetje tjera shtrojnë dilemën rreth asaj se a jemi vërtetë të përgatitur për këtë nivel shkollimi, pra a do të mund t'i përgatisim fëmijët me këto elemente të nevojshme për këtë moshë?

Nga rezultatet e hulumtimit kemi arritur të vërtetojmë se nuk është punuar aq sa duhet për këtë nivel shkollimi. Me plotë të drejtë mund të konstatojmë se nevojitet një punë më e intensifikuar për të ngritur edukimin parafillor në një nivel më të kënaqshëm dhe gjithëpërfshirës. Për një edukim sa më cilësor nevojitet një funksionim sa më i mirë i të gjitha institucioneve që kanë përgjegjësinë për edukimin parafillor që nga instancat më të larta deri tek edukatorët të cilat punojnë drejtpërsëdrejti me fëmijët.



Grafiku 1.


Sa i plotëson institucioni ku ju punoni kushtet për punë?

Në rezultatet e hulumtimit tek grafiku 1 - 41% e pjesëmarrësve pohojnë faktin se institucionet ku ato punojnë mesatarisht i plotësojnë kushtet për punë. Me një kujdes të shtuar vërejmë se përqindjet më të

⁵⁴⁷ Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.(2011). *Korniza e Kurrikulës e Arsimit*

Parauniversitar të Republikës së Kosovës. Prishtinë. fq. 28.

mëdha anojnë tek përgjigjet negative sesa ato pozitive. Me ç'rast arrijmë të kuptojmë se në zonat e përfshira në hulumtim jo të gjitha institucionet plotësojnë kushtet, qoftë edhe ato mesatare për punë. Nga vëzhgimi në teren arrijmë në përfundim se infrastruktura në disa nga institucionet është e vjetërsuar. Në disa institucione tjera infrastruktura plotëson kushtet mesatare për punë por mungon mirëmbajtja dhe pastërtia në klasa. Arrijmë gjerë në konkludimin se ekziston pamjaftueshmëri e materialeve për punë si letër, plastelinë, ngjyra e ngjitës të llojllojshëm, mjeteve konkretizuese dhe lodrave didaktike. Disa nga ndryshimet që duhen bërë brenda klasave për fëmijët parafillor janë kompetencë dhe përgjegjësi vetëm e edukatores, si p.sh. ndërrimi në mënyrë sistematike i punimeve të fëmijëve, ristrukturimi i orendive në klasë, klasifikimi i lodrave, mjeteve didaktike dhe mirëmbajtja e tyre etj. Përdorimi i materialeve ricikluese i ndihmon edukatores që të plotësojë mungesën e materialeve dhe i ndihmon të gjeneroj aktivitete të ndryshme të cilat sigurojnë një bashkëpunim dhe ndërveprim më të madh në mes të edukatores dhe fëmijëve. Në të njëjtën kohë kjo i lejon edukatores të vë në lëvizje kreativitetin e fëmijëve dhe të plotësojë veprimtarinë edukative - arsimore brenda ditës së punës. Nga vëzhgimi në institucionet parafillore dhe klasat parafillore në kuadër të shkollave, në disa prej tyre nuk është parë të jetë përdorur aq sa duhet materiali ricikluar.




Grafiku 2.

Për përkrahje nga institucioni 33 % e edukatoreve janë përgjigjur se mesatarisht përkrahen nga institucionet ku punojnë dhe vërehet një frymë pozitive drejt asaj që edukatores gëzojnë një përkrahje nga institucionet ku ato janë të punësuar. Ndërsa 31% e edukatoreve pjesëmarrëse në hulumtim janë përgjigjur që përkrahen mirë nga institucioni apo shkolla ku ato janë të punësuar dhe 14 % e tyre janë shprehur që përkrahen shumë, gjë e cila lë për të kuptuar se gëzojnë çdo të drejtë, që nga organizimi i veprimtarisë mësimore e deri tek avancimi për ngritje profesionale.

Për diskutim mbetet çështja se të njëjtat pohime nuk janë vërtetuar edhe përmes vrojtimit të drejtpërdrejtë nëpër institucione. Trajtimi me indiferencë nga shkollat i cituar shpesh herë gjatë bashkëbisedimit, nuk është një tregues i fuqishëm edhe në plotësimin e pyetësorëve. Gjatë bashkëbisedimeve me edukatores në procesin e vrojtimit rezultoi se nga ana e edukatoreve mungon kompetenca për të kërkuar më shumë nga institucionet. Ekziston një lloj hezitimi nga ana e tyre për të kërkuar të drejtën për t'u trajtuar të barabarta qoftë me edukatores me qëndrim tërë ditore apo me mësimdhënësit në kuadër të shkollave. Një pjesë e edukatoreve të cilat punojnë në kuadër të shkollave theks të veçantë i vendosën çështjes së mosnjohjes së karakteristikave nga ana e udhëheqësve për karakteristikat e edukimit parafillor. Ky pohim nuk mund të përgjithësohet por as të mohohet në tërësi, për faktin se kemi edukatores të cilat mbrojnë qëndrim se edhe "inspektorët arsimor të cilët janë të thirrur për të monitoruar punën në edukimin parafillor, nuk kanë njohuri të mirëfillta nga kjo fushë". Sendërtimi i këtij niveli të edukimit është sa delikat po aq edhe kompleks. Një mos njohje e qasjes ndaj profesionit mund të sjellë pasoja negative për fëmijët kur vazhdojnë klasën e parë. Kemi mjaft raste kur edukatores pa dashje ngatërrohen me kompetencat e mësueses së klasës së parë dhe fillojnë të punojnë me fëmijët në formën tipike shkollore. Jemi dëshmitarë të asaj që fëmijët shkojnë në klasën e parë me njohuri krejtësisht të ndryshme varësisht se ku e kanë vijuar edukimin parafillor. Ekspozimi i fëmijës me elementet nga gjuha, matematika, artet, ndodhë në forma të ndryshme

KUMTESA

varësisht se ku fëmija ka ndjekur edukimin parafillor, në kuadër të kopshteve me qëndrim tërë ditor, shtetëror apo privat, qëndrim gjysmë ditor apo klasë parafillore në kuadër të shkollave. Kjo laramani formash në ofrimin e shërbimeve për këtë grup - moshë bënë që edukatorët të gjenden përballë një sfide të re. Një planifikim orientues për edukatorët në nivel vendi do të ndihmonte, orientonte punën e tyre. Po ashtu ngritja e vazhdueshme profesionale dhe ofrimi i trajnimeve të vazhdueshme për edukatorët në përgjithësi, e në veçanti ato që punojnë me grup-moshën 5-6 vjeçare do të ndihmonte shumë në ngritjen e cilësisë në këtë nivel bazë të shkollimit.



Grafiku 3.

Bashkëpunimi institucion parashkollor –familje duhet të jetë njëri nga komponentët më të rëndësishme në ndërtimin e programeve edukative – arsimore dhe pjesë e pandashme e të gjitha veprimtarive që zhvillohen në institucionet parashkollore. Nga gjetjet rezultojnë 37.5% e edukatoreve dhe 20.3% e tyre kanë dhënë përgjigje pozitive drejt asaj që prindërit përkrahin punën e edukatoreve parafillor. Një përqindje jo e vogël, rreth 34.3% e tyre janë shprehur se prindërit mesatarisht përkrahin edukatorët gjatë punës së tyre. Nga vëzhgimet e drejtpërdrejta, dhe nga bisedat me edukatorët arritëm në përfundim se prindërit në shumicën e rasteve, përkrahin edukatorët vetëm me lavdërime dhe komplimente. Mungon përfshirja aktive nga ana e prindërve në punën e drejtpërdrejtë në klasë. Ndërveprimi në mes të edukatores dhe familjes mungon, edukatorja sheh si element pozitiv kur prindërit e komplimentojnë për punën, por nuk i sheh prindërit si pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në veprimtarinë edukativo- arsimore. Gjetja e formave të ndryshme për një bashkëpunim dhe ndërveprim konstruktiv në mes të institucioneve parashkollore, familjes dhe komunitetit është një tregues i mirë për ngritjen e vetëdijes për rolin e madh dhe të pa kompromis që ka familja dhe komuniteti në avancimin përpara të punës së edukatoreve parafillore.

Problemi i shkallës së ulët të vetëdijes vazhdon të na shoqëroj edhe në këtë kohë, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale ekzistojnë raste të tjera të cilat ende nuk janë identifikuar dhe vazhdojnë t'iu mohojnë fëmijëve të drejtën për përfshirje në edukimin parashkollor e parafillor. Me theks të veçantë këto fushata sensibilizuese duhet të orientohen në ato zona ku paraqitet vështirësi permanente për procesin e integritit të hershëm të fëmijëve në këto institucione. Shumë prej këtyre shqetësimeve dhe të tjera i gjejmë në Planin Strategjik Të Arsimit Në Kosovë 2011-2016 të cilat janë të kategorizuara si sfidat me të cilat përballlet edukimi parashkollor në vazhdimësi. Nëse ne jemi të vetëdijshëm për sfidat atëherë e kemi shumë më të lehtë të dimë se nga t'ia fillojmë. Rezultatet e këtij hulumtimi hapin shtigje të reja hulumtuese të cilat do të na ndihmojnë që t'iu japim zgjidhje problematikave të caktuara.

Rekomandime

- Organizimi i fushatave sensibilizuese për ngritjen e vetëdijes së shoqërisë për rolin dhe rëndësinë e edukimit të institucionalizuar që në moshën e fëmijërisë së hershme.
- Të mendohet një zgjidhje konkrete drejt harmonizimit të plan-programeve për grup-moshat e caktuara në nivel vendi.
- Të kërkohet ngritja e vazhdueshme profesionale nga ana e edukatoreve dhe gradualisht të ngritet kompetenca e tyre profesionale.

KONFERENCA VJETORE E SHKENCËS 'JAVA E SHKENCËS 2012

- Të krijohen kushte me të mira për punë, aty ku ato mungojnë dhe të shfrytëzohen maksimalisht hapësirat e disponueshme për fëmijët parafillor.
- Të krijohet një partneritet funksional në mes të institucioneve parashkollore, familjes dhe komuniteti.

Recensentë:
Dr.sc. Mazllom Kumnova
Dr.sc. Murteza Osdautaj

KUMTESA

Zamira HYSENI-DURAKU¹: NDËRVEPRIMI I FAKTORËVE AKADEMIKË DHE EMOCIONALË NË PËRFORMANCËN E STUDENTËVE TË PROGRAMEVE BACHELOR NË KOSOVË

¹Fakulteti i Shkencave Sociale
Universiteti i Tiranës

Hyrje

Në botë ekzistojnë arsye të ndryshme pse një numër i madh i studentëve nuk arrijnë ta përfundojnë arsimimin e tyre. Mundësitë financiare, problemet sociale, problemet shëndetësore, apo ndryshimet emocionale, janë konsideruar si faktorë me ndikim në këtë proces. Mirëpo, përveç këtyre faktorëve, me ndikim të veçantë në tërë procesin e edukimit të studentëve janë konsideruar edhe format e mësimdhënies dhe vlerësimi nga mësimdhënësit.

Edhe përkundër fillimit të procesit reformues në sistemin e arsimit në Kosovë përgjatë viteve të fundit, në praktikë edhe sot në vitin 2012 vërehen mjaftë sfida. Vlerësues të arsimit të lartë, potencojnë mungesën e qasjes edukative e cila reflekton nevojat, interesat dhe ndryshimet tek studentët. Po ashtu, potencohet se edhe përkundër zhvillimeve të fundit në fushën e edukimit, Universiteti i Prishtinës, ende nuk është duke funksionuar në përputhje me Sistemin e Bolonjës, as me standardet ndërkombëtarë për edukimin e lartë. Sidoqoftë, deri më sot, mungojnë të dhëna konkrete të cilat e masin në hollësi, se cilët faktorë janë më me ndikim gjatë periudhës së shkollimit të rinjë në vend.

Qëllimi i studimit

Qëllimi kryesorë i këtij studimi është identifikimi i ndërveprimit të faktorëve akademikë dhe emocionalë në përformancën e studentëve të programeve Bachelor në Kosovë. Ky qëllim do të realizohet duke identifikuar tezat analitike të këtij studimi. Teza e parë do të vërtetojë nëse cilësia e edukimit të lartë në Kosovë është faktorë ndikues në përformancën e studentëve përgjatë realizimit të studimeve të tyre në Universitetin e Prishtinës, përkatësisht përgjatë studimeve Bachelor; ndërsa teza e dytë analitike do të identifikojë se përveç faktorëve akademikë deri në çfarë mase mund të ndikojnë edhe faktorë të tjerë, në përformancën e studentëve.

Metodologjia

Për identifikimin e tezave analitike të këtij studimi, janë përdorur metoda të kombinuara hulumtuese, sasiore dhe cilësore. Për të prezantuar mënyrën e funksionimit dhe organizimit të studimeve Bachelor në Kosovë, si dhe faktorët më me ndikim tek studentët në përgjithësi, janë shqyrtuar një sërë publikimesh, analizash dhe vështrimesh teorike, të realizuara deri më tani nga njohës të fushës së edukimit. Ndërsa, për të matur nivelin e ndikimit të këtyre faktorëve tek studentët e UP, është dizajnuar instrumenti matës, në formë të pyetësorit, i cili është realizuar tek 1006 studentët të Universitetit të Prishtinës, të cilët aktualisht janë duke vijuar studimet Bachelor në këtë Universitet. Analiza e rezultateve të mbledhura është bërë duke përdorur statistikat deskriptive nga paketa statistikore për shkencë sociale, SPSS.

Vlerësime për funksionimin e Sistemit të Lartë të Edukimit në Kosovë

Për mënyrën e funksionimit dhe cilësinë e edukimit të lartë në Kosovë, ekzistojnë vështrime të ndryshme. Sipas Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim, Misioni në Kosovë, thuhet se ekziston

motivim i ulët i personelit akademikë në Universitetin e Prishtinës dhe komuniteti i arsimit të lartë në përgjithësi, nuk e kanë këtë të qartë në tërësi, procesin e Bolonjës (OSCE, 2004). Po ashtu, nga vlerësues të tjerë të kësaj çështjeje, potencohet se edhe përkundër pjesëmarrjes së mesimdhënësve në trajnime të ndryshme për metodat e mësimdhënies, serish mësimdhënësit e edukimit të lartë në UP, hezitojnë të ndryshojnë dhe vazhdojnë ta përdorin stilin e vjetër apo tradicional të të nxënit. (Mustafa, Gashi, Demukaj, Havolli, Kotorri, 2004). Në disa nga vlerësime të tjera, thuhet se ngecja e funksionimit të plotë të reformave arsimore në Kosovë, është si pasojë e njohurive të pamjaftueshme të personelit akademikë vendor për procesin reformues akademikë dhe mungesa e informacioneve të duhura dhe komplete për këtë sistem, që nga koha e fillimit të këtij procesi nga Misioni Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), (Sommers dhe Buckland (2004), në Tahirsylaj, 2008).

Faktorët ndikues në përfundimin e studentëve përgjatë studimeve

Sipas, Helme & Clarke (2001), gjatë studimeve studentët bartin me vetë edhe një numër tjetër të karakteristikave të cilat ndikojnë në zhvillimin njohës apo kognitiv të tyre. Këto karakteristika i përfshijnë: aftësitë e tyre, njohuritë, dispozitat, aspiratat, pritjet, perceptimet, nevojat, vlerat dhe qëllimet (fq. 138). Ndërsa, sipas disa vështrimeve të tjera teorike, thuhet se motivimi është vërtetuar të jetë ndikues në procesin e të nxënit tek studentët gjithashtu. (Helme & Clarke, 2001; Jenkins, 2001). Hansen & Joe (2000) potencojnë se në përfundimin akademikë të studentëve, ndërveprojnë faktorë të tjerë si aftësitë e tyre individuale për të mësuar, gjinia, raca, etj. Faktorë të tjerë me ndikim janë veçuar edhe mos durimi i mjaftueshëm i studentëve (Kirby dhe Winston, 2002), jeta në vendbanime studentore (Alexander, Gur et al. 1974; Fraser, Beamn et al. 1977) dhe ambienti ku jetojnë studentët (Hyman & Rosoff, 1985), si dhe koha e kaluar në gjumë apo niveli i stresit me të cilën ata ballafaqohen. (Wooten, 1998).

Një varg tjetër i studimeve, kanë vërtetuar se mënyrat e mësimdhënies mund të pengojnë motivimin e studentëve dhe iniciativat e tyre gjithashtu. Sipas (Ericksen, 1978), shumë student u përgjigjen në mënyrë shumë pozitive kurseve më të organizuara dhe të udhëhequra nga instruktor entuziast, të cilët zgjojnë interesim tek studentët dhe mënyrat se si ata mësojnë. Lloje të tilla të kurseve e promovojnë të nxënit tek studentët, dhe i motivojnë ata për të mësuar. Forma konstruktive e të mësuarit u ndihmon studentëve të marrin përgjegjësi për të nxënit, dhe u mundëson atyre të jenë të pavarur dhe të zhvillojnë konceptet e tyre për atë se çfarë mësojnë (Brooks and Brooks 1993, fq. 13). Ndërsa, sipas një analize tjetër, të realizuar me studentët të cilët kërkonin shërbime këshilluese, nga Gallagher, Gill dhe Sysko (2000), është vërejtur se tek shumica e studentëve përveç faktorëve akademik, një varg faktorësh kanë ndikuar në gjendjen e tyre jo të mirë emocionale, si faktorët social, kulturorë, e personal, si ndarja nga partneri, familja jo funksionale, marrëdhëniet jo të mira me prindërit, toleranca e ulët, dhuna, dhe marrëdhëniet jo të mira ndër personale.

Faktorët Akademikë : Vlerësimi i mësimdhënies dhe vlerësimit nga studentët

Të dhënat e mbledhura nga 1006 përfutues të sistemit të lartë të Edukimit në Kosovë, studentët e Universitetit të Prishtinës, tregojnë se vlerësimi i mësimdhënësve është jo aq i lartë, por në nivel mbi mesatarë. (N=560 apo 55.7%) dhe (N=146, apo 14.5%) pajtohen dhe pajtohen plotësisht me deklaratën se mësimdhënësit e tyre prezantojnë për studentët përmbajtjen e lëndës në përputhje të plotë me lëndën dhe zhvillimet e fundi të disiplinën të cilën udhëheqin; ndërsa (N=405, apo 40.3%) dhe (N=135, apo 13.2%) nga gjithsej studentët pjesëmarrës në hulumtim, pajtohen me deklaratën se mësimdhënësit e tyre janë në gjendje të komunikojnë në mënyrë efektive me studentët e tyre (shih tabelën.:1 në vijim).

Tabela.: 1

Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga studentët

| Nuk pajtohen në | Nuk pajtohen | Pajtohem | Pajtohen plotësisht | Neutral |
|-----------------|--------------|----------|---------------------|---------|
|-----------------|--------------|----------|---------------------|---------|

| | | ansnjë | | mënyrë | |
|--|--|--------------|--------------|--------------|--------------|
| | | N(%) | N(%) | N(%) | N(%) |
| Prezantojnë për studentët përmbajtjen e lëndës në përputhje të plotë me lëndën dhe zhvillimet e fundit në atë disipline | | 81 (8.1) | 170 (16.9) | 560 (55.7) | 146 (14.5) |
| | | | | | 49 (4.9) |
| Janë në gjendje të komunikojnë në mënyrë efektive me studentët; | | 118 (11.7) | 285 (28.3) | 405 (40.3) | 135 (13.4) |
| | | | | | 63 (6.3) |

Shënim: Nën shkurtesën N dhe % janë paraqitur të dhënat nga rezultatet me numra dhe përqindje

Ngjashëm mund të prezantohen edhe vlerësimet e studentëve, për faktorët e tjerë akademikë, më saktësisht për nivelin se sa ata pajtohen me nivelin e vlerësimit nga mësimdhënësit në Universitetin e Prishtinës. Nga gjithsej (N=1006) pjesëmarrës në hulumtim, (N=340, apo 33.8) dhe (N=102, apo 10.1 %) vlerësojnë në nivel mbi mesatar, mënyrën se si mësimdhënësit e tyre vlerësojnë provime dhe detyrat e tyre, ndërsa (N=436, apo 43.8%) dhe (N=153, apo 15.2%), pajtohen se mësimdhënësit e tyre u ofrojnë udhëzime konkrete dhe me kohë për natyrën dhe llojin e provimit.

Tabela.: 2

Vlerësimi I studentëve për cilësinë e vlerësimit akademikë nga mësimdhënësit në UP

| | Nuk pajtohen në asnjë mënyrë | Nuk pajtohen | Pajtohem | Pajtohen plotësisht | Neutral |
|---|------------------------------|--------------|-----------|---------------------|---------|
| | N(%) | N(%) | N(%) | N(%) | N(%) |
| I vlerësojnë provimet brenda afatit të cilin përcaktojnë fillimisht; | 132(13.1) | 269(26.7) | 457(45.4) | 87(8.6) | 61(6.1) |
| Ofrojnë udhëzime konkrete dhe me kohë për natyrën dhe llojin e provimit; | 80(8.0) | 264(26.2) | 436(43.8) | 153(15.2) | 73(7.3) |

Shënim: Nën shkurtesën N dhe % janë paraqitur të dhënat nga rezultatet me numra dhe përqindje

Faktorët emocionalë me ndikim në përformancën e studentëve

Nga gjithsej (N=1006 studentë), (26%) e pjesëmarrësve në hulumtim, kanë deklaruar se menaxhimi jo i mirë i kohës, është ndër faktorët kryesorë me ndikim në përformancën e tyre; ndërsa faktorët e tjerë ndikues, por të veçuar nga një % më e vogël e pjesëmarrësve janë nostalgjia e studentëve për familjen dhe shtëpinë (14%); vështirësitë në përshtatjen me rregullat akademike (

12%); përqendrimi i tepërt në jetën sociale (11%); vështirësitë financiare(8%); gjendja shëndetësore (6%) dhe vështirësi në zhvillimi e aftësive për të mësuar (6%); (shih figurën 1) në vijim:




Fig.1: vlerësimi i studentëve për faktorët më me ndikim në performancën e tyre akademike

Performanca akademike

Të dhënat e mbledhura nga pjesëmarrësit në hulumtim tregojnë po ashtu se edhe përkundër se më shumë se gjysma e studentëve pjesëmarrës në hulumtim, janë pajtuar se cilësia e mësimdhënies dhe vlerësimit nga mësimdhënësit e tyre është në nivel mbi mesatar, niveli i kënaqësisë së studentëve me performancën akademikë të tyre nuk është mjaft i kënaqshëm. Nga gjithsej 1006 studentë, (N=476 apo 47.3%) janë deklaruar se janë mesatarisht të kënaqur me studimet e tyre, (N=249, apo 24.8%) kanë thënë se janë mjaftë të kënaqur me performancën e tyre akademike, ndërsa (N=154, apo 15.3%) janë të kënaqur, (N=92, apo 9.1%) janë shumë të kënaqur, dhe (N=35, apo 3.5%) nuk janë aspak të kënaqur me performancën e tyre akademike përgjatë studimeve në Universitetin e Prishtinës.




Fig. 2.: Niveli i kënaqësisë së studentëve me performancën e tyre akademike

Konkluzione

Edhe përkundër fillimit të procesit reformues në sistemin e lartë të Edukimit në Kosovë, të dhënat e publikuara deri më tani për vlerësimin e këtij sistemi, theksojnë se për tu arritur një edukim i nivelit më të lartë, dhe në përputhje me sistemin e Bolonjës, Kosova duhet të tejkalojë edhe shumë sfida, të cilat ndërlidhen me mënyrën e organizimit të edukimit të lartë në përgjithësi, por edhe cilësinë e mësimdhënies. Rezultatet e studimit tregojnë se një numër i konsiderueshëm i studentëve të Universitetit të Prishtinës, nuk janë mjaft të kënaqur me performancën e tyre akademike, dhe ky nivel i kënaqshmerisë, ndërlidhet me nivelin e vlerësimit të paraqitur nga ta, për cilësinë e vlerësimit dhe mësimdhënies në këtë Universitetit. Sidoqoftë, nga rezultatet e arritura, mund të konkludohet se ndikues në performimin akademik të studentëve, përveç faktorëve akademik, janë vërejtur të jenë edhe faktorët e ndërlidhur direkt me studentët, si mos menaxhimi i mirë i kohës, eksperiencat personale, apo faktorët ekonomik.

KUMTESA

Albano Zhapaj¹: MËSIMI GJATË GJITHË JETËS, RIKTHIMI I ADULTËVE NË SHKOLLA.

¹MASH Shqipëri

"Facere docet philosophia – shkruante filosofi i vjetër Seneka": "Puna jonë duhet udhëhequr nga dituria". Është puna jonë, veprimet tona, aksionet që ndërmarrim, marrëdhëniet njerëzore që krijojmë, ato të cilat na bëjnë të zbulojmë vetveten, se kush jemi, çfarë kërkojmë nga vetja e të tjerët, përse sillemi në këtë apo atë mënyrë, përse mbajmë një qëndrim në vend të një tjetri, etj.

Qysh kur kemi lindur e deri në fund të ditëve tona, është tek të vepruarit që ne ndërtojmë veten tonë, botën që na rrethon dhe instrumentet për ta njohur e kuptuar botën. Në fillimet e kulturës së lashtë, në shkollat (skole) Aristoteliane apo Platonike, kush mësonte në to ishin të rriturit dhe jo fëmijët. Pra objekt i edukimit nuk ishte fëmija por ishte aduti (i rrituri), adult i cili mbante në këmbë një sistem arsimimi e të nxëni të domosdoshëm për kohën në fjalë.

Vetëm pas shumë shekujsh, nën presione të vazhdueshme politike apo fetare, censurash e kontrollesh u bë i mundur mbyllja përfundimtare e skole-ve spontane dhe zëvendësimi i tyre me struktura arsimit dhe edukimi, në fillim të niveleve elitare e më pas të urdhrave fetarë, organizimeve ushtarake dhe të korporatave profesionale. Në këto shkolla nxënësi ishte akoma një djalosh i rritur, por në ndryshim nga ajo antike duhej të ishte i shkëputur nga ambienti i punës apo i profesionit. Më tej me ardhjen e industrializimit filloi të merrte formë arsimimi i planifikuar i të rinjve dhe në shkollën moderne filloi edhe i ashtuquajti "detyrim" i përndjekjes së shkollës nga ana e nxënësve.

Ky organizim i ri, i programuar dhe i modeluar për grup moshë të ndryshme dhe që përgatiste tashmë të riun për në jetë, nga moshë e fëmijërisë deri në adoleshencë, vazhdoi gjatë për të arritur deri në ditët tona. Arsimit modern në këtë mënyrë la jashtë skenës arsimore të rriturisë, adutin, i cili një herë përfunduar ciklin e detyruar shkollor, supozohej jashtë çdo koncepti edukues, dhe i dhurohej me kaq tregut të punës, me preokupimet e mbarëvajtjes së prodhimit dhe lënies së botës së diturisë shkollore pas krahëve.

Sot shikojmë se kohët kanë ndryshuar dhe tregu i punës, teknologjitë dhe komunikacionet ndryshojnë vazhdimisht në mënyrë radikale, dhe me to edhe shoqëria. Tregje të ndryshme, të ndryshme nga këndvështrimi gjeografik sesa përmbajtjesor, kanë filluar të ndërliken gjithnjë e më shumë në mënyrë dinamike, duke thyer kështu kufijtë territorialë duke ushqyer një konkurrencë që bëhet gjithnjë e më aktive. Paralelisht me evoluimin e habitshëm të teknologjive të fabrikimit në prodhimin e të mirave materiale, këto të fundit synojnë të jenë produkte cilësore dhe është pikërisht cilësia e tyre ajo që i nxjerr nga uniformizmi e i bën të dallojnë nga të tjerët.

Për t'u bërë e tillë kërkon punë gjithashtu cilësore, e puna cilësore vjen nga njerëz të përgatitur e të formuar, jo vetëm nga ana praktike, por të mbartur edhe me njohuri e dituri shkencore teorike. Me fjalë të tjera, burimet njerëzore duhet të jenë të axhornuara e të pajisura vazhdimisht me teori "të freskët", të jenë të trajnuara e të edukuara në mënyrë permanente.

Për këtë arsye ne sot shikojmë kthimin e adutit në procesin e të nxënit të vazhduar, pra në "mësim". Tashmë i rrituri mëson jo jashtë procesit të aktiviteteve të tij profesionale, por koherent me punën dhe

KUMTESA

profesionin e tij, në kurse, seminare, aktivitete trajnuese e shkëmbime të eksperiencës. Sot në skenën e edukimit permanent, po rikthehet një i nxënë i vazhduar i mbartur prej adultëve të cilët shfaqen në këtë skenë me eksigjenca e nevoja të reja, me prirje e vullnet për të mësuar gjëra të reja, me dëshirë për të krijuar marrëdhënie njerëzore cilësore, në mënyrë për të përmirësuar e forcuar identitetin e tyre përballë diturisë dhe punës që i lidh ata me botën përreth.

Nisur nga këto premisa, natyrisht që lind natyrshëm nevoja për një formim të vazhdueshëm për të gjithë, sidomos për mësimdhënësit, në mënyrë që të jenë të aftë të realizojnë këtë pedagogji të re, që përveç transmetimit të dijes, ka qëllim të mbështetet mbi kolonat e komunikimit dhe bashkëbisedimit, dhe që ecën drejt një formimi personal e profesional të njeriut, si domosdoshmëri e kërkuar nga tregu i sotëm i punës dhe shoqëria njëkohësisht.

Kurset e shumtë të trajnimit e formimit profesional, kultural e gjuhësor dhe numri i shumtë i pjesëmarrësve në to, vërtetojnë më së miri atë që ne po quajmë “Rikthimi në dije i adultëve”, dhe duke shtuar do t'a quaja një revolucion të thellë në praktikën edukative dhe mësimdhënëse, edhe pse akoma në kontekstin tonë nuk po i jepet aq sa duhet rëndësia e merituar këtij “rikthimi”. Për të kuptuar plotësisht proceset e transformimit edukativ adult që është në vijim, edhe praktikën edukative kanë të domosdoshme përfshirjen e të rriturve në procesin edukativ permanent, si dhe duhet të analizojnë më mirë artikulet gjithnjë e më të ngushta që po lindin midis tregut të punës dhe edukimit permanent të të rriturve, axhornimin e vazhdueshëm, mësimin përgjatë gjithë jetës.

Në këtë mënyrë fillojnë e vihen edhe bazat e përvetësimit të komunikimit pedagogjik të përgjegjshëm, duke futur mësues e nxënës së bashku, në praktikën e teknikave të reflektimit dhe formimit të vazhduar mbështetur jo vetëm në transmetim mekanik të dijes, por mbi të gjitha në ndërveprim të ndërsjellë të përvojave njerëzore të gjithsecilit. Rrjedhimisht këtu futen në punë kujtesa, inteligjenca, imagjinata e ndjenjat për të kuptuar domethënien dhe vlerën thelbësore të asaj që quhet filozofi e komunikimit edukativ, për të zbuluar lidhjen me aspekte të tjera të njohjes së aktivitetit njerëzor, për të çmuar implikimet në një kërkim të vazhdueshëm të dijes dhe së vërtetës.

“Life-long-education”- të mësuarit gjatë gjithë jetës është një ekzigjencë që vërehet tashmë në çdo lloj forme organizuese, qoftë shtetërore apo private, dhe ajo çka është më e rëndësishme qëndron në faktin se edukimi permanent nuk fokusohet vetëm në nivelet drejtuese, por shtrihet tek çdo individ, në çdo nivel, pasi ajo që ka më rëndësi në shoqërinë e sotme është të ketë anëtarë të saj në gjendje të jenë autonomë e të përgjegjshëm, njerëz me kompetenca dhe zhvillim jo vetëm profesional por edhe shoqëror e njerëzor.

Në këtë kontekst shoqëror të formimit të vazhduar natyrisht që aduti përveç se realizimit personal dhe profesional të vetvetes, duhet patjetër të bashkëpunojë edhe me faktorë të tjerë të kontekstit dhe shoqërisë, në mënyrë që të gjithë të jenë pjesë dhe të kenë në konsideratë kontekstin real në të cilin jeton edhe vet njeriu, d.m.th. familja, kushtet shoqërore, vetë ambienti arsimor, politika, ekonomia, klima kulturore etj.

**Dr.Xhevdet ZEKAJ¹, Monika HODAJ², Albano ZHAPAJ³, Nertila TABAKU⁴:
BARRIERAT PSIKOLOGJIKE NË KOMUNIKIMIN PROFESIONAL-
PEDAGOGJIK**

¹Universiteti Shteror "A.Xhuvani" Elbasan

²Universiteti Shteror "A.Xhuvani" Elbasan

³MASH

⁴Universiteti Shteror "A.Xhuvani" Elbasan

Abstrakt

Ngjarjet e 11 shtatorit të vitit 2001 shtruan përpara botës sfida të reja edhe tek sistemi ynë i arsimimit në raport dhe me komunikimin pedagogjik dhe ardhjes së kohës së re "të aparteidit informativ", edhe në kushtet kur falë teknologjisë, jemi në gjendje të ruajmë dhe shfrytëzojmë gjithë përvojën dhe dijet të grumbulluara nga shoqëria njerëzore, dhe se mund ta bëjmë në çast atë të dobishme dhe të aplikueshme nga çdo person në BOTE! Për ne është e domosdoshme një revolucion në të mësuar, e cila plotëson më së miri revolucionin e mjeteve të pafundme të komunikimit, - dhe ky revolucion po ndodh në ditët tona prej disa vitesh. Përveç këtyre, na duhet patjetër në mënyrë rrënjësore të rishikojmë dhe ridimensionojmë të gjitha aspektet e sistemit të arsimimit shkollor, duke u përqendruar edhe në rreziqet, që lindin nga programet arsimore të ngushtë, afatshkurtër, pa vizion, por edhe barrierat psikologjike të komunikimit pedagogjik.

Në procesin i komunikimit mësues-nxënës, njeriu shpesh ndeshet me vështirësi të panumërta, me barriera psikologjike, disa ngë të cilat nganjëherë i qëllon mos ti kapërcejnë dot.

Dhe e gjitha kjo ndodh, në lidhje me atë, se shumë njerëz nuk i njohin vështirësitë objektive, që lindin midis këtyre partnerëve në situatat e komunikimit pedagogjik, brenda dhe jashtë procesit të të mësuarit. Vështirësi të tilla shpesh thyejnë dhe çënojnë komunikimin pedagogjik. Në ndryshim nga barrierat e jashtme që varen e lidhen me faktorë të jashtëm, barrierat psikologjike janë në varësi të faktorëve të brendshëm.

Shekulli që jetojmë është shekulli i komunikimit dhe medias, por komunikimi pedagogjik është një domosdoshmëri për të siguruar cilësinë në shkollë sipas ritmeve të revolucionit në të mësuar.

Fjalë Kyçe: Komunikim pedagogjik, barriera psikologjike, barriera të temperamentit, cilësi. gëzim, vuajtje, turp, faj etj.

BARRIERAT PSIKOLOGJIKE NË KOMUNIKIMIN PEDAGOGJIK PROFESIONAL

Në praktikën e komunikimit profesional të specialistëve jo vetëm të sferës pedagogjike jo rrallë si shkaktar vështirësimi bëhen faktorët subjektivë, që lidhen me veçoritë individuale të partnerëve të ndodhur në dialog mes tyre. Shpesh vendosja e kontaktit përcaktohet prej vetive psikologjike individuale të secilit. Ndryshe nga barrierat që lidhen me kuptimin, të cilat ngrihen si rrjedhojë e ndikimit të faktorëve të jashtëm, dhe si të tilla mund të mënjanohen me ndryshimin e sjelljeve të komunikuesve, pengesat me natyrë individuale, të njohura si *barriera psikologjike*, mënjanohen më me vështirësi, madje në shumë raste ato mbeten pengesa të pamënjanueshme në rrugën e

marrëdhënieve ndër individuale të partnerëve. Në numrin e këtyre faktorëve të brendshëm po veçojmë:

- Të dhënat fizike të partnerëve (përfshi në këtë mes dhe sakatimet fizike e defektet e të folurit), të cilat faktikisht është e pamundur që të riparohen.
- Veçoritë e temperamentit që shfaqen gjatë marrëdhënieve në sjellje dhe në qëndrime të shoqëruara prej emocioneve të caktuara.
- Disa të dhëna të karakterit (kryesisht me kah negativ).
- Gjendje të caktuara emocionale me natyrë dhe me modalitet të qëndrueshëm negativ.

Dhe tani të merremi me shqyrtimin më të hollësishëm të shfaqjes së disa **varianteve të barrierave psikologjike**.

Barrierat që lidhen me temperamentin. Janë ato që vendosen ndërmjet njerëzve me tipa të ndryshëm sistemi nervor. Për shembull, një njeri që reagon fort, që merr flakë shpejt, që është impulsiv dhe tekanjohet në shfaqjen e dëshirave (që është kolerik) zakonisht e fillon dialogun pa pasur as në mend e as në fjiqir që të grindet me të tjerët, por gjatë bisedimit nxehet, indinjohet, kapet pas një thënie apo pas një kritike pa të keq, por që atij i duket fyese për personin e tij. Tek e ndien veten të fyer, bashkëbiseduesi kolerik shpalos një agresivitet të papërligjgur si verbal ashtu dhe jo verbal në adresë të partnerit, me të cilin është në komunikim. Pa mundur ta kontrollojë dot veten, i shpëtojnë fjalë dhe shprehje fyese, të tilla që e lëndojnë tjetrin, e bëjnë që ta humbasë kontrollin e vetes dhe barspeshën shpirtërore gjatë dialogut. Ndërkohë për partnerin kolerik ajo që thotë nuk përmban ndonjë gjë të veçantë, të tillë që del nga korniza e stilit të zakonshëm të komunikimit ndërmjet njerëzve. Ndërsa partneri, tip i ndjeshëm, me sistem nervor të dobët (për shembull, një tip melankoliku), me reaktivitet të dobët, njeri i turpshëm dhe i mbyllur në vetvete, tip që alarmohet dhe merakoset shpejt, ndaj një sjellje si kjo e tipit kolerik reagon krejt ndryshe: ky mbyllet në vetvete, e ruan gjatë brenda vetes fyerjen e pamerituar që iu bë dhe u shmanget kontakteve të mëtejshme. Trauma shpirtërore që i shkakton koleriku e nxjerr melankolikun nga binarët e jetës së përditshme, i rri mendja tek ajo që iu tha, ky i kthehet dhe i rikthehet situatës që ia shkaktoi dhimbjen dhe e përjeton ligsht fyerjen që iu bë. I mungon qetësia e duhur për t'iu kthyer punëve, mund të ndihet i shkrehur, madje mund ta humbasë besimin në forcat e veta, gjithë më tepër u largohet njerëzve.

Me plotgojën mund të thuhet se komunikimi ndërmjet një tipi kolerik dhe tipi flegmatik shoqërohet me vështirësi të dukshme. Ky i dyti, duke qenë tip i ngadaltë, shpesh i mefshët, e percepton dhe e përvetëson ngadalë informacionin e ri, ndërkohë që përvetësimi i vonuar i informacionit nga bashkëbiseduesi e irriton kolerikun impulsiv. Qëndrimi i rrëmbyer, reagimi prej gjaknxehiti, veprimet e njeriut të nxituar të kolerikut nuk i imponohen dot flegmatikut.

I vënë në një plan me flegmatikun, sanguini na paraqitet më aktiv, më i lëvizshëm, por edhe më i ekuilibruar, i tillë që përshtatet shpejt me kushtet e krijuara. Sanguini shquhet për plasticitetin e qëndrimeve dhe të veprimeve, e kjo atij i jep mundësi të orientohet shpejt dhe ashtu si duhet në rrethanat e krijuara, i jep mundësi të vendosë shpejt dhe ashtu si duhet kontakt me mjedisin rrethues dhe pa sforcimin më të vogël të ruaj kontaktet e duhura me partnerët.

Më i vështirë në komunikim me të tjerët është melankoliku, tipi i ndjeshëm deri në lot, që flet me zë të ulët, gjoksor, është i avashtë në veprime, madje me shenja ngathësie. Me natyrën e tij të mbyllur, si tip i heshtur që është, si njeri pasiv që tregohet, melankoliku i tulat bashkëbiseduesit aktivë dhe të nxehtë, i lodh dhe i mërzit ata. Për pedagogun është e rëndësishme që ta dijë mirë të veçantën psikologjike të secilit tip dhe ta mbajë këtë parasysh në procesin mësimor tek hyn me secilin në dialog. Po ashtu duhet të ketë informim edhe për shfaqjen së jashtmi të veçorive të tipave me të cilët ka të bëjë, të ketë dijeni për reagimet dhe qëndrimet emocionale të secilit, për sjelljen e secilit tip, si dhe për të veçantat e gjuhës që flet secili nxënës apo student.

Tipat sanguinë shquhen për aktivizimin e tyre të lartë që shfaqet përmes karakterit të tyre energjik dhe veprimeve të vullshme, përmes këmbënguljes dhe kapacitetit të lartë në punë. Këta tipa janë të lëvizshëm, të gjallë, të folurit e shoqërojnë me mimikë dhe me gjeste të shumta, por edhe me të folmen e shkoqur e ritmike. Një gjendje emocionale ia lë vendin tjetrës, ndërkohë që epërsia u takon përjetimeve me kah pozitiv. Lëvizjet i kryejnë të shpejta, të ecurit e kanë të fortë, të vullshëm, afrohen shumë me bashkëbiseduesin, kërkojnë të hyjnë me të në kofidencë, shikimin e kanë të ngulur, të drejtpërdrejtë, shtrëngimin e duarve të fortë, janë tipa që hyjnë kollaj në komunikim me tjetrin.

Tipat kolerikë bien në sy me karakterin e tyre gjaknxehtë, me padurimin e ngahershëm që manifestojnë, me prirjen për shpërthime dhe shuarje të menjëhershme të emocioneve. Lëvizjet dhe mimikën e kanë shpejt të ndryshueshme, eksitohen shpejt dhe tulaten po shpejt, flasin me zë të lartë, janë të vullshëm, kalojnë vazhdimisht nga njëra temë në tjetrën, fjalët i shoqërojnë me intonacion të thekshëm. E mbulojnë bashkëfolësin me shikime të zjarra që shuhën shpejt dhe në mënyrë të befasishme, tregohen sa të afruar aq dhe të ftohtë. Vërejtjeve me zë të lartë të bashkëbiseduesve u përgjigjen po me zë të lartë, me ton ngulmues dhe me këmbëngulje kokëngjeshurish. Kur shprehin dëshpërimin apo zhgënjimin, janë sa të mbushur me emocione, aq dhe ekspresivë, e humbasin shpejt ekuilibrin dhe mund të futen në debate pa pasur ndonjë shkak me peshë.

Tipat flegmatikë kanë si veti kryesore të tyre durimin, qëndresën, aftësinë për të punuar kokulur. Tregohen të matur në arsyetime, janë të ekuilibruar në sjelljen me të tjerët. Janë të ngadalë, mimikën dhe lëvizjet i kanë të matura, tregohen të vetëpërmbytur, të qetë, flasin shtruar dhe vënë në përdorim logjikën dhe arsyen, flasin me zë të ulët. Lëvizjet i kanë të avashta, veprimet të matura. E ndalin shpesh bashkëbiseduesin dhe i drejtohen me gjithfarë pyetjesh, sidomos kur ky u flet shpejt, vetë në komunikim janë të ngathët, tregohen pasivë dhe të mbyllur. Lidhen me vështirësi me miqësi, por tregohen të qëndrueshëm, besnikë, të sigurt. Veçori kryesore e tipave flegmatikë është sjellja prej njerëzish inertë që përshtaten me vështirësi në rrethanat e krijuara, në regjimin e ri, reagojnë ngadalë në mjediset e reja, në kushtet e reja të jetesës.

Tipat melankolikë karakterizohen prej ndjeshmërisë së lartë, ndonjëherë të sëmurë, ndaj ndikimeve të jashtme (fyhen dhe zemërohen shpejt, tregohen shumë të turpshëm, me sedër të sëmurë, të pasigurt e të pavendosur). Thuajse nuk i vlerësojnë aftësitë vetjake në çdo gjë, tregohen të tërhequr edhe në ato raste, kur kanë bindje se kanë të drejtë. Në qoftë se hasin vështirësi në kryerjen e detyrave mësimore, tipat melankolikë dorëzohen, nuk ngulin këmbë për ta çuar deri në fund punën e nisur. Lodhen shpejt, manifestojnë ngathtësi dhe mungesë fuqie, shpallsin me tepri emocione negative, priren për nga pesimizmi. Reagimet ata i kanë të avashta, lëvizjet të ngathëta, sjelljen apatike, kurdoherë manifestojnë shenja lodhjeje dhe kapitjeje, kurse mimikën dhe gjestet i kanë të kursyera dhe të tilla, që i shprehin tendosje, flasin me zë të ulët dhe pa intonacion në zë. Shikimin e mbajnë mënjanë, larg bashkëbiseduesit, i shmangen “ndeshjes së shikimeve” me bashkëfolësin, buzët i mbajnë të lëshuara apo të shtrënguara. Bie në sy sidomos mungesa e vijimësisë në punë, atë ata e kryejnë me hope, sidomos kur u bërtasin e i qortojnë, kur u bëjnë vërejtje. Nuk tregohen nismëtarë, tuten përpara çdo sipërmarrjeje, qëndrojnë mënjanë në shoqërinë e njerëzve të panjohur. Vështirësohen që të mbajnë fjalime publike, reagojnë ngadalë ndaj asaj që u thuhet, u mungon sensi i humorit, rrallë ata i sheh me buzën në gaz, e humbasin kollaj toruan edhe kur situatat nuk janë aq të ndërlikuara. Pas ndonjë fatkeqësie apo çrregullimi, e marrin ngadalë veten në dorë, mezi qetësohen. Me vështirësi kalojnë nga njëra punë në tjetrën.

Pas gjithë këtyre konstatimeve, bëjmë përfundimin se **barriera psikologjike e karakterit është rezultat i theksimit jo sa dhe si duhet i çështjeve, por është rezultat edhe e ndalesës jo të mjaftueshme të vëmendjes në shqyrtimin e saktë të vetive individuale të bashkëbiseduesve, të cilët hyjnë në komunikim.**

Në literaturën psikologjike kushtuar temës së tipave psikologjike gjejmë të përcaktuar këta tipa kryesorë karakteresh:

1. Tipat hipertimë. Janë energjikë, kanë etje për komunikim, janë iniciatorë, e kërkojnë me etje të renë, shquhen për optimizmin e pa kufi. Ndërkohë tregohen mendjelehtë, priren për veprime të

nxituara e jo fort të moralshme, ngacmohen, nxehen dhe nervozohen shpejt, mbajnë qëndrim jo serioz ndaj detyrave dhe detyrimeve.

2. Tipat distimikë. Janë seriozë, njerëz me moral të lartë, të vetëdijshëm, të drejtë e të përgjegjshëm. Ndërkohë tregohen pasivë, të avashtë, të ngurtë në marrjen e vendimeve, apatikë në veprime dhe me prirje për të rënë shpejt në gjendje depresioni.

3. Tipat cikloidë. Janë natyra hipertoniqe, e shfaqin këtë veti sidomos në çaste vendimtare, kurse në çaste rënieje tregohen distimikë.

4. Tipat e eksitueshëm. Kur nuk i gjen të zemëruar, tregohen të ndërgjegjshëm në detyrë, të rregullt në veprime, i duan fëmijët dhe kafshët. Ndërkohë eksitohen dhe nervozohen shpejt, janë gjaknxehtë, përplasen me epurorët, ndonjëherë tregohen të pamëshirshëm, e kontrollojnë keq veten.

5. Tipat me amorprop. Janë këmbëngulës dhe synojnë arritjen me çdo kusht të së paracaktuarës, janë shumë kërkues dhe të drejtë. Ndërkohë tregohen me shumë sedër, preken dhe fyhen shpejt, janë dyshues, hakmarrës, kryelartë dhe kanë besim të tepruar në forcat e tyre.

6. Tipat pedantë. Janë shumë të vetëdijshëm, të rregullt, të përpiktë, të besueshëm, kanë humor të qetë, janë seriozë në çdo veprim dhe bëjnë kujdes në çdo rast. Ndërkohë tregohen formalistë, kapen për çdo vogëlsirë, priren nga dëshira për t'ua kaluar fajin apo mangësinë të tjerëve.

7. Tipat e alarmuar. Janë të dashur, të ndjeshëm, u vjen keq për tjetrin, mbajnë qëndrim autokritik, janë të përpiktë dhe përpiqen të jenë brenda. Ndërkohë tregohen të tutur, të vetëpërmbytur e të vetëfrenuar, vetja u duket e pambrojtur prej askujt. U tremben shpotive dhe vënies në lojë nga të tjerët.

8. Tipat emotivë. Janë të thjeshtë, nuk e lakmojnë karrierën, gëzohen nga arritjet e miqve, e kanë të zhvilluar ndjenjën e detyrës, janë të përpiktë. Ndërkohë tregohen tej mase të ndjeshëm dhe bëjnë kujdes që të mos gjenden në pozitë qesharake.

9. Tipat demonstrativë. Janë të sjellshëm, lajkatarë, këmbëngulës në të vetën, dinë të bëjnë për vete të tjerët. Ndërkohë manifestojnë egoizëm, mungesë të vetëpërmbytjes, e bëjnë të zezën të bardhë, kur ua do puna, përulen përpara të tjerëve, janë mburraveçë dhe nuk e kursejnë dinakërinë kur ua do puna.

10. Tipat labilë. Janë të ndershëm deri në fanatizëm, marrin pjesë në fatkeqësinë e tjetrit, kanë shije artistike, janë elokuentë dhe të këndshëm në bisedime, dinë ta shpalojnë sinqeritetin. Ndërkohë janë tej mase të prekshëm e të ndjeshëm, emocionohen shpejt, bien shpejt në panik.

Në bashkëveprimin e pedagogut me nxënësit dhe me studentët është e nevojshme që të mbahen parasysh veçoritë e tipave, të theksuarit tek ata të këtij apo atij tipari. Se qëndrimet deri diku mendjehlehta, jo serioze, të njërët tip, optimizmi i tepruar i ndokujt mund të bëhet shkaktar i reagimit të tipit tjetër me veti karakteri të përkundërta. Egoizmi, natyra e papërmbytur e njërët tip, mburrjet e tij të shfrenuara, bishtnimi punës prej tij, shihen shtrembër dhe dënohen prej tipit tjetër që është i prekshëm, dyshimtar dhe i tillë, që parashtron kërkesa të ngritura ndaj mjedisit rrethues.

Tipat me tipare të theksuara të karakterit tregohen tejet të ndjeshëm ndaj shfrytëzimit si duhet apo jo të mjeteve jo verbale të komunikimit. Kështu prekja me dorë për ta përkëdhelur një tip të caktuar e irriton këtë, e nervozon dhe e shtyn të reagoj jo mirë, kurse një tip tjetër ajo e qetëson, e nxit për veprime të mira. Reagimi i parë ndodh me tipat e ndjeshëm, dyshues, reagimi i dytë ndodh me tipat e eksitueshëm, të hedhur dhe entuziastë. Përkatesisht përdorimi jo adekuat e *takesikës* (prekjes, kontaktit trupor) shoqërohet me vështirësimin e komunikimit. Sidomos duhet bërë kujdes kur partneri është më i ri në moshë apo ndodhet në pozitë varësie, për rrjedhojë nuk mundet t'ia lejojë vetes shmangien apo mënjanimin e prekjes edhe kur ajo është për të e pakëndshme.

Jo vetëm natyrat me ndryshime në karakter, por edhe ato me ngjashmëri karakteri nuk e arrijnë dot përsosjen në komunikim. Vështirësi më të mëdha kanë tipat me prirje ndjeshmërie jo të zakonshme. Si rregull, vështirësi më të mëdha në komunikim hasin ose tipat me ngjashmëri shumë të madhe, ose tipat me tipare polare, ekstreme, në karakter. Vetëm se po të tregohet vullnet dhe dëshirë, pengesat mund të kapërcëhen, të paktën ato mund të zvogëlohen deri në minimum, duhet vetëm që secili bashkëbisedues të bëjë përpjekje për ta pasur parasysh të veçantën e tjetrit.

Barrierat e emocioneve negative të qëndrueshme po ashtu mund të jenë një faktor me peshë, që e vështirëson procesin e komunikimit ndër individual.

Emocionet bëjnë pjesë ndër rregullatorët më kryesorë të komunikimit njerëzor: ndikojnë në zgjedhjen e bashkëbiseduesit, përcaktojnë mënyrat dhe mjetet e komunikimit. Jo çdo lloj emocioni, por emocionet e qëndrueshme negative janë të tilla, që mund të ngrënë barriera psikologjike gjatë procesit të komunikimit. Ndër këto emocione bëjnë pjesë ato, të shkaktuara nga vuajtjet, nga zemërimi, nga neveria, nga përbuzja, nga frika dhe tmerri, nga turpi dhe nga ndjenja e fajit.

Vuajtja përjetohet si shkaktare e pikëllimit, si rënie e gjendjes shpirtërore, si shkaktare e vetmisë dhe e tjetërsimit emocional të njeriut. Paraqitja jo verbale e vuajtjes manifestohet me vetullat e ngrysur apo të ngritura lart, me rrudhjen e rrudhave të ballit, me lëshimin poshtë të çipit të buzëve, me zgjatjen e fytyrës, me zërin ankues dhe me lotët. Shkak tipik për vuajtjen mund të jetë mungesa e suksesit në mësim, dështimet në karrierë, në dashuri e të tjera. Gjatë komunikimit, vuajtja e shprish perceptimin e botës që na rrethon, sepse gëzimi i tjetrit mund të shoqërohet me zilinë, mund ta acarojë ndjenjën e egoizmit (keqardhja për veten), por mund të shkaktojë dhe altruizëm, për të mbytur brenda vetes fajin që ndjen ndaj tjetrit (vihet re në marrëdhëniet pedagog nxënës).

Zemërimi lind si përgjigje ndaj pengesës që paraqitet në realizimin e një kërkesë apo nevojë konkrete. Reagimi kur ndërpritet një veprimtari argëtuese e zbavitëse, kur dëgjojmë fyerje, kur shkohet kundër dëshirës që ke. Mësuesi e mban klasën pas mbarimit të mësimëve për të plotësuar një detyrë të lënë pasdore, nxënësit zemërohen. Indinjimi mund të shoqërohet me fjalë fyese në adresë të ndaluesit, lind konflikti. Zemërimi dëshmon për thellësinë e ndjenjës së përjetuar; sa më i fortë është zemërimi, aq më e fortë është kërkesa për ta nxjerrë atë jashtë nesh. Zemërimi shoqërohet me ndryshime të caktuara në pamjen e jashtme dhe me tronditje të brendshme.

Irritimi në varësi nga intensiteti mund të shkaktojë nervozizëm, nxehje, protestë, përdorim fjalësh të shkëputura, mund të shoqërohet nga dridhja e buzëve, e duarve.

Neveria lind për shkak të mosrespektimit të higjienës nga bashkëbiseduesi, për shkak të sjelljes së tij jo të mirë, por dhe të mosgesës së autokontrollit. Në rastin e komunikimit duhet bërë çmos që të mposhtet e të kapërcehet, duhet përqendruar vëmendja në brendinë e informacionit.

Përbuzja lind në situata të caktuara, kur partneri kryen akte jo të moralshme. Ndikon në uljen e kontakteve të bashkëbiseduesve, prandaj dhe duhet kapërcyer. Mund të lindë edhe mbi bazën e paragjyqimeve raciale. Emocionet negative që lindin mbi këtë bazë nuk është e lehtë të kapërcehen, por duhet të vihet në punë logjika dhe vullneti. Kërkohej zotësi për ta ndarë aktin që kërkon përbuzje nga tërë personaliteti i partnerit. Si dukuri, përbuzja është shprehja demonstrative e epërsisë së njërit bashkëbisedues mbi tjetrin. Është dhe zotësia për të mënjeluar emocione të tilla negative si zemërimi, neveria, turpi, e të tjera.

Treshen *zemërimi, neveria dhe përbuzja* psikologët e kanë quajtur treshe armiqësore. Shprehen përmes injorimit hapur të personit, me të cilin jemi në bashkëbisedim, apo përmes shpërfilljes së asaj që ai komunikon.

Frika (tmerri) mund të shkaktohet nga faktorë biologjikë (rrezikim i jetës, i shëndetit), por edhe nga faktorë socialë (frika nga humbja e të mirave materiale, frika nga privimi prej miqësisë, frika nga kërcënimi i marrë prej tjetrit, frika nga nëpërkëmbja e vlerave intelektuale vetjake). Në rast se frika provohet e përsëritur, lind rreziku i humbjes së qetësisë në përgjithësi. Shpesh frika paraqitet si paralajmëruese e fatkeqësisë. Shembull tipik është frika që ndjen studenti përpara një pedagogu. I ndodhur nën ndikimin e barrierës psikologjike dhe sociale, studenti i emocionuar nuk përgjigjet as për gjëra, të cilat i zotëron mirë.

Turpi, faji dhe pendimi lindin si ndjenja reagimi ndaj të mos qenit dakord me atë që ndodh, si ndjenja ngurrimi të vetë personit dhe të tjerëve rreth tij. Më shpesh një barrierë e tillë psikologjike në procesin e komunikimit lind kur personi kritikohet apo lavdërohet tej mase. Në këtë kohë bashkëbiseduesi ndihet i përhumur, pulit sytë, skuqet dhe përpiket të largohet që aty sa më parë. Si turpi, si faji janë emocione tepër të fuqishme, të dhimbshme, të cilat është e vështirë që t'i fshehësh. Zakonisht vihen në përdorim mekanizma të tillë mbrojtës si mohimi, ndrydhja e vetvetes, kompensimi me veprime të tjera.

Barriera e humorit të keq. Zakonisht nuk veçohet në grup më vete, sepse përmban shumicën e emocioneve që përmendëm më sipër, por duhet mbajtur parasysh, sepse reagimi intensiv emocional i

KUMTESA

njërit prej bashkëbiseduesve në mënyrë të pavullnetshme indukon gjendje të caktuara në humorin e partnerit. Kjo sepse humori është ngjitës, ai përçohet nga njëri partner te tjetri. Tek shfaqim fyerjen tonë, ne induktojmë te partneri ndjenjën e fajit, tek krenohemi, induktojmë zilinë, tek krekosemi, induktojmë dëshirën që dhe partneri të krekoset. Emocionet negative të partnerit, si rregull, bëhen shkak për përjetime negative nga ana e tij, e kjo mund të shoqërohet prej vështirësisë të komunikimit, sepse indukon dëshirën për kufizimin e kontakteve me njeriun për ne të pakëndshëm.


Më të prekshëm nga emocionet negative janë njerëzit që *kanë vetëvlerësim më të lartë apo më të ulët*. Kjo sepse reagimi i këtyre ndaj mosukseseve është i fuqishëm. Ata që e kanë të ulët vetëvlerësimin, prirën për nga mohimi i gjendjes reale, duke dashur që të renditen përbri atyre që e kanë të ngritur ndjenjën e vetëvlerësisë. Njerëzit me nivel të lartë vetëvlerësimi prirën për nga lartësimi i sedrës së tepërt të tyre. Këto veçori është e domosdoshme që të mbahen parasysh jo vetëm gjatë komunikimit ndërmjet individëve, por dhe në çdo lloj tjetër komunikimi. Në çdo rast individë të ndryshëm japin shenja të caktuara, që dëshmojnë për shkallën e vetëvlerësisë apo për shkallën e mungesës së vetëvlerësisë të personit të tyre. Meqë mënjanimi i shfaqjeve në të dyja rastet nuk është punë e lehtë (duhet thënë se ai është faktikisht i pamundur), atëherë duhet punuar që të pranohen ashtu si paraqiten dhe komunikimi të vazhdojë sa më normalisht.

Duhet theksuar se barrierat psikologjike në përgjithësi i nënshtrohen me shumë vështirësi mënjanimi, sepse lidhen me veçoritë e individualitetit të bashkëbiseduesve. Shumë shpesh vihet re mungesa e dyanshme e dëshirës për të hyrë në kontakt. Është vënë re se barrierat psikologjike përfundojnë me prishjen e çdo lloj marrëdhënieje ndërmjet bashkëbiseduesve. Nuk duhet harruar se barrierat psikologjike që lidhen me kuptimet janë ngushtësisht të lidhura me njëra-tjetrën. Mospranimi i komunikimit me një individ shoqërohet prej shtrembërimit të vetë informacionit. Moskuptimet e çdo lloji mund të shoqërohen prej emocioneve negative të qëndrueshme, për shembull, prej frikës e tmerrit, prej ndjenjës së fajit dhe të zemërimit e të tjera.

Murteza OSDAUTAJ: IDENTIFIKIMI I FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA - PENGESË E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT SPECIAL (INKLUZIV) NË KOSOVË

Me anë të këtij studimi dua të paraqes fakte statistikore dhe rezultate nga terreni të cilat dëshmojnë se sistemi i arsimit special në Kosovë nuk po zhvillohet ashtu siç është menduar dhe, përkundrazi, po stagnon në masë të madhe. Në studim do të mundohemi të dëshmojmë se si një nga hallkat e rëndësishme të zhvillimit të këtij sektori të arsimit nuk funksionon thuaja tërësisht dhe, si pasojë, i tërë sektori, praktikisht, nuk zhvillohet. Identifikimi I fëmijëve me nevoja të veçanta është problem që do ta shqyrtojmë në këtë punim dhe këtij problemi do t'i qasemi tek fëmijët në shkollim dhe tek fëmijët jashtë procesit arsimor. Në studim janë marrë si raste studimi komunat e Klinës dhe Suharekës si dhe shkollat e rajonit të Hasit.

Për ta studiuar këtë problematikë ne u bazuam në statistikat aktuale të dala nga MAShT në vitin shkollor 2010/2011 nga të cilat, për dallim nga viti shkollor 2007/08, nuk kishte ndryshuar thuaja asgjë në këtë sektor. Për t'i sjellë këto konstatime ne u nisem nga një statistikë që vjen nga SHBA e cila tregon një rritje suksesive të nxënësve që përfitojnë arsim special⁵⁴⁸ me një rritje deri në 30%.



Pastaj këtë rritje e kemi krahasuar me proporcionet tona duke u bazuar në vitet shkollore nga 2004 -05 deri në vitet 2008-09. Po e sjellim më poshtë këtë tabelë për të parë se si ky proces në Kosovë për disa vite ka stagnuar nëse nuk ka shënuar rënie në përqindje:

| Viti shkollor | Numri I tërësishëm I NX. | Numri I Nxënësve ne arsimin | Numri I klasave të bashkangjitura | Përqindja e FNV ne ars. special | Rënia e e FNV ne Ars. Special |
|---------------|--------------------------|-----------------------------|-----------------------------------|---------------------------------|-------------------------------|
| | | | | | |

⁵⁴⁸ Arsimi special në vendet perëndimore kuptohet çdo lloj mësimi i specializuar që i jepet një fëmije duke mos e marr parasysh se në ç' lloj shkolle i vijon mësimet.

KUMTESA

| | | Sp. | | | me % |
|------------------|---------|-----|----|-------|------|
| 2004/2005 | 421635 | 940 | 64 | 0.2% | |
| 2005/2006 | 428876 | 884 | 62 | 0,17 | 9.8% |
| 2006/2007 | 4316258 | 925 | 61 | 0,18% | 2.2% |
| 2008/2009 | 4375453 | 909 | 60 | 0.17% | 1.8% |

Këto shënime i kemi krahasuar me vitin shkollor 2010/11 kemi këtë numër të nxënësve:

| Viti shkollor | Numri I teresishem I NX. | Numri I Nxënësve ne arsimin Sp. | Numri I klasave të bashkangjitura | Përqindja e FNV ne ars. special | Rënia e e FNV ne Ars. Special me % |
|------------------|--------------------------|---------------------------------|-----------------------------------|---------------------------------|------------------------------------|
| 2010/2011 | 433916 | 1179 | 545 | 0.39% | |

Ndërsa qëllimi i studimit tonë ishte të gjejmë se në ç'masë ky proporcion zyrtar në vendin tone pasqyron gjendjen e vërtetë të numrit të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe në mos ky proporcion paraqet numrin e tërësishëm të këtyre fëmijëve.

Për ta ngushtuar fushën e veprimit ne morën tri komuna të cilat i studiuam dhe gjetjet që dolën aty, paraqesin krejt një gjendje tjetër nga ajo që mund gjendet në statistikat zyrtare. Ne në këtë komunë u orientuam të gjejmë fëmijë që kanë problem në të nxënë dhe fëmijë që kanë probleme më të rënda të natyrave të ndryshme. Shumë çka në këtë studim është varur edhe nga angazhimi i mbledhësve të të dhënave dhe dëshirës së tyre që këtij problem t'i qasen në mënyrë sa më shteruese.

Në studim u inkuadruan katër studentë të cilët studiuam gjendjen në disa shkolla dhe u morën edhe me gjendjen e regjistrimit të këtyre fëmijëve në entet sociale të komunave.

Ta shohim se si ekziston gjendja në Klinikë:

| Niveli i shkollimit | Nr.i nxënësve | | | Personeli i shkollave | | | |
|---------------------|---------------|------|-------|-----------------------|-----------|------------|-----------------------------|
| | M | F | Gj | Mësimdhë. | Administ. | Nd.punëtor | Pedagog, Psikolog Mjek, etj |
| 0 | 40 | 14 | 54 | 4 | 1 | 5 | S'ka |
| 1 dhe 2 | 3994 | 3872 | 7866 | 435 | 26 | 60 | S'ka |
| 3 | 1229 | 928 | 2157 | 110 | 5 | 13 | S'ka |
| Gjithsej | 5263 | 4814 | 10077 | 549 | 32 | 78 | S'ka |

Shihet se numri i tërësishëm i nxënësve në Klinë në shtator 2011 ishte 10977. Sipas gjendjes në shkolla, pa u bazuar në regjistrimet e FNV në entin social komunal dhe organizatat e ndryshme që merren me fëmijët me nevoja të veçanta, dalin këto të dhëna:

| | Lloji i dëmtimit | Niveli i shkollimit | |
|---|---|---------------------|----|
| | | FMU | ML |
| 1 | Dëmtime intelektuale | 17 | 3 |
| 2 | Dëmtime në të folur komunikim dhe gjuhë | 28 | 7 |
| 3 | Vështirësi në të nxënë | 45 | 2 |
| - | Me disleksi | 19 | - |
| - | Me disgrafi | 14 | - |
| - | Me diskalkuli | 12 | - |
| 4 | Dëmtime emocionale dhe sjellje (të pavëmendshëm,hipëraktiv etj.) | 27 | 11 |
| 5 | Dëmtime të shumëfishta | 9 | 9 |
| | Gjithsej më dëmtime | 126 | 32 |

Këta janë fëmijët të cilët janë identifikuar në shkollat e komunës në të cilat nuk ka shërbime specialistike arsimore që do të thotë se 1.7% të nxënësve kanë probleme në mësim dhe të tjera dhe të cilët nuk marrin shërbim specialistik mësimor. Në anën tjetër nga shënimet e entit social ku një pjesë e familjeve me fëmijë me nevoja të veçanta marrin ndihma sociale sipas ligjit, dalin se janë, vetëm në Klinë, rreth 182 për të cilët, sipas të dhënave, nuk kanë vijuar asnjëherë mësimet ose ato i kanë braktisur në fillim të shkollimit. Ky numër, që paraqet rreth 1.9% të fëmijëve që vijnë në mësimin nëpër shkolla, edhe pse mendojmë se nuk është real, tregon se përqindja e fëmijëve që nuk marrin ndihmë specialistike arsimore, qofshin brenda shkollës, qoftë jashtë saj, arrin 3.5% gjë që për një shoqëri që tenton të jetë 'inkluzive' është e palejueshme. Duke e marrë parasysh se në Therandë ky numër është rreth 300 (që nuk vijnë në shkollimin por që janë të regjistruar në entin social për ndihma) atëherë del se rreth 3.8% e nxënësve në këto komuna janë jashtë shkollave apo nuk i nënshtrohen arsimit special. Në Has kemi arritur t'i identifikojmë vetëm fëmijët nëpër shkolla të cilët kanë probleme në të nxënë por që nuk marrin ndonjë mbështetje arsimore të nevojshme⁵⁴⁹.

Të dhënat më të gjithanshme i kemi mbledhur në Therandë ku janë hulumtuar shkollat e rregullta, klasat e bashkangjitura por edhe enti social dhe organizata Hendikos.

Në një situatë hipotetike kur do t'i krahasonim këto të dhëna dhe të njëjtat t'i aplikojmë në nivel vendi atëherë do të konstatojmë se përqindja e përgjithshme e fëmijëve me nevoja të veçanta të identifikuar që vijnë dhe nuk vijnë është diku rreth 3.7% që, shprehur me numra, do të thotë rreth 16000 fëmijë të cilët, së paku, janë të privuar nga arsimimi qoftë i rregullt, qoftë special. Në anën tjetër duke e marrë parasysh se në shkollim special i kemi 1179 nxënës del se gjithsej arsim special marrin vetëm 7.36% nga të gjithë

⁵⁴⁹ Këto të dhëna janë mbledhur vetëm në disa shkolla prandaj nuk besoj se e paraqesin gjendjen reale në terren. Për këtë arsye nuk kemi bazuar aq shumë në ato shënime.

KUMTESA

fëmijët e përlogaritur. Ndërsa nëse konsiderojmë se përqindja e njohur botërore e fëmijëve me nevoja të veçanta është diku rreth 5% nga popullacioni i përgjithshëm i fëmijëve, atëherë si rezultat del gjendja aspak e lakmueshme e vendit në këtë aspekt.

Prandaj është koha e fundit që me masa të shpejta dhe radikale t'i qasemi këtij problemi ashtu që kualitativisht dhe kauntitativisht t'i afrohemi mesatares evropiane të shkollimit dhe përfshirjes së fëmijëve tanë me nevoja të veçanta.

SHKENCAT EKONOMIKE DHE SOCIALE

KUMTESA

Prof. Dr. Sc. Sejdi REXHEPI⁵⁵⁰ dhe Altin N. ADEMI⁵⁵¹: DILEMAT DHE MUNDËSITË E ZHVILLIMIT LOKAL(Rasti i Skenderajt)

Hyrje

Në fillim të vitit 2007, kur tregjet financiare shënuan rënien graduale dhe fillimin e “*krizës globale*” zhvillimi i ekonomisë botërore akoma shihej në një kontekst të tërësisë, krahasuar me shumën e pjesëve përbërëse të saj. Zhvillimi ekonomik i bazuar në një rrjet të gjerë korporatash të shtrira në shumë vende, megjithatë tregoi se maksima se “*çfarëdo që është e mirë për biznesin, është e mirë edhe për shtetin*” të mos ishte e vërtetë, për arsye se rënia e një biznesi në një vend, ndikoi në rënien zinxhimore të bizneseve në vende tjera.

Ndonëse ekonomia botërore në tre dekadat e fundit shënoj një rritje të konsiderueshme edhe falë procesit të globalizmit (integrimi e shpejtoj rritjen e Bruto Produktit Botëror prej 3.2% në periudhën 1988-1997 dhe prej 4.4% nga 1988-2008⁵⁵²), megjithatë zhvillimi ekonomik në tre dekadat e fundit është promovuar me të madhe edhe përmes alternativave të tjera, në mesin e së cilave një vend të veçantë zë valorizimi dhe futja në funksion e resurseve ekonomike lokale.

Në shikim të parë emërtimi “*zhvillim ekonomik lokal*” në rrethanat e ekonomisë së Kosovës na duket si një koncept i njohur dhe shpesh i dëgjuar, jo vetëm në ambientet publike si pjesë e debateve të përditshme zhvillimore por edhe si pjesë e procesit të zhvillimit ekonomik, ndonëse pa tërhequr ndonjë vëmendje të veçante. Së fundmi, ky proces ka filluar të trajtohet edhe në ambientin shkencor, përderisa në vendet e zhvilluara që bartin statusin e zhvillimit modern ekonomik, çështja e zhvillimit ekonomik lokal, tashmë përbën një disiplinë të tërë shkencore dhe një nocion aplikativ të lidhur me politikën ekonomike dhe atë publike. Megjithatë, në një shikim më të hollësishëm, shtrohen pyetjet se *a mundemi në të vërtetë ta vizuelizojmë zhvillimin ekonomik lokal? Kush janë akteret në këtë proces dhe si na shërben i njëjti për zhvillimin dhe avancimin tonë ekonomik, social e kulturor? Si mund ta masim zhvillimin ekonomik lokal?* etj.

Në këtë studim, jemi përpjekur të sjellim sfondin e procesit të zhvillimit ekonomik lokal në komunën e Skenderajt, me ç'rast gjatë hulumtimit jemi përpjekur që tërthorazi të përgjigjemi në pyetjet e sipërshtuara. Njëherit, përmes rastit tonë të studimit, kemi kuptuar që zhvillimi ekonomik lokal është një proces më kompleks sesa që e kemi menduar dhe përceptuar në fillim dhe se formati i tij definohet nga shumë faktorë, nderveprimi i të cilëve nuk mund të kontestohet në mënyrë që të arrihen rezultatet e pritura nga ky proces, gjë që e konfirmojnë edhe

⁵⁵⁰ Prof.Dr.Sc Sejdi Rexhepi, Fakulteti Filozofik, Universiteti I Prishtinës,

⁵⁵¹ Msc. Altin N. Ademi, Instituti për Politika Ekonomike Lokale, IPEL

⁵⁵² Blakely, J. Edward and Nancy Green Leight “**Planning Local Economic Development**” SAGE, 2010, fq.2;

përvojat e vendëve të zhvilluara sipas së cilave, planifikimi i zhvillimit ekonomik që pikë nisje e ka lagjen, lokalitetin, komunën apo regjionin, paraqet bazë për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe një alternativë të domosdoshme për ngritjen dhe fuqizimin ekonomik, social dhe politik të qytetarëve dhe komunitetit në përgjithësi.

Zhvillimi Ekonomik Lokal në Kosovë

Para se të interpretojmë të gjeturat e studimit, është me rëndësi që të theksohet se zhvillimi ekonomik lokal definohet në më shumë sesa një interpretim të vetëm. Arsyja për këtë është për faktin se si diciplinë shkencore është relativisht shumë e re⁵⁵³, ndërsa rastet e studimit të kësaj fushe tradicionalisht e kanë interpretuar zhvillimin ekonomik lokal brenda kornizave abstrakte të makro-çështjeve dhe zhvillimit ekonomik në përgjithësi e jo të natyrës specifike që ai paraqet⁵⁵⁴. Në kontekstin më universal, zhvillimi ekonomik lokal mund të përmbledhet si **“rritje e standardit të përgjithshëm të jetës dhe mirëqenies në një lokalitet të caktuar”**⁵⁵⁵. Në mënyrë më praktike, definimi që i bën Banka Botërore këtij procesi, e përshkruan zhvillimin ekonomik lokal si **“tërësinë e mekanizmave dhe mundësive që kanë qeveritë lokale, sektori privat dhe ai jo profitabil, si dhe komuniteti për të punuar së bashku me qëllim të përmirësimit të ekonomisë lokale”**⁵⁵⁶, definim ky që është mjaft i pranuar përgjithësisht dhe shërben si një bazë teorike për të ndërtuar platforma më konkrete në teren. Përveç këtij definimi, ekzistojnë edhe përshkrime më të ngushta apo specifike. Në këtë rast, ne kemi adaptuar definimin e mëposhtëm, sipas së cilit **“zhvillimi ekonomik lokal, është një proces kompleks që krijohet nga shkrirja dhe fuzionimi i ndërmarrësisë, edukimit dhe aftësive të komunitetit, të drejtuara në mënyrë të konsiderueshme edhe nga forcat e tregut.”**⁵⁵⁷

Në kontekstin tonë, Kosova gjatë procesit të shtet-ndërtimit është karakterizuar me një agjendë mjaft komplekse si pasojë e rrethanave historike të njohura. Duke pasur parasysh tendencat për të rivendosur një paqe të qëndrueshme në mes të realitetit të shtetit të pavarur të Kosovës dhe minoritetit serb, Bashkësia Ndërkombëtare e angazhuar në Kosovë⁵⁵⁸ dhe institucionet tjera janë përkujdesur që akoma pa u konsoliduar shteti në kuptim nacional, i njëjti t’i nënshtrohet një procesi të decentralizimit politik, në fokus të së cilit ishte krijimi i qendrave administrative, kryesisht për banorët serbë që jetonin në Kosovë. Natyrisht se në kuptimin modern të demokracisë, decentralizimi paraqet një aspekt të zhvillimit demokratik dhe një indikator që përfshirja e shtetit në orientimin e jetës së qytetarëve kushtimisht është minimale. Në këto raste, boshllëku që lë mungesa e shtetit, plotësohet (hipotetakisht) nga qytetaria aktive dhe veprimtaria komunitariste e qytetarëve në fushën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore.

Megjithatë, rrethanat dhe kritikrat me të cilat është përcjellur procesi i decentralizimit në Kosovë, ka bërë që reputacioni i tij dhe proceseve bartëse të mos prodhojnë një mendim, se

⁵⁵³ Shih Ed.Rowe, James “Theories of Local Economic Development: Linking theory to practice”, Ashgate, 2009.

⁵⁵⁴ Rowe, James Ed. “Theories...”, fq 4

⁵⁵⁵ Greenwood, T. Daphne and Richard P.F Holt ”Local Economic Development in the 21st Century: Quality of Life and Sustainability” M.E Sharpe Inc. 2010, Fq.6

⁵⁵⁶ <http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/TOPICS/EXTURBANDEVELOPMENT/EXTLED/0,,contentMDK:20185186~menuPK:399161~pagePK:148956~piPK:216618~theSitePK:341139,00.html>;

⁵⁵⁷ Rowe, J. Ed. “Theories of Local Development ..” fq 6;

⁵⁵⁸ Në kontekstin e paraqitur, Bashkësia Ndërkombëtare në Kosovë nënkupton prezencën e Misionit të Kombeve të Bashkuara (UNMIK) e rregulluar me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së.

përmes këtij procesi krijohen kushte për një adresim më të afërt të kërkesave, ofertave dhe tregut në të cilin këto të dyja përmbushin nevojat e njëra-tjetrës. Si rrjedhojë, planifikimi i zhvillimi ekonomik lokal ka mbetur paksa i hijezuar nga perceptimi i decentralizimit politik dhe nuk është futur në agjendë të temave me rëndësi për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Republikës së Kosovës. Kjo ka pasur për pasojë investimet joracionale (pa analiza të kërkesave dhe mundësive të komuniteteve përkatëse) dhe pa një fokus të qartë të lidhur me perspektivë afatgjatë dhe të qëndrueshme. Po kështu duhet pranuar se modeli i procesit të privatizimit nuk është shkëputur nga *“dilema e privatizimit pa kriter”* kurse procesi i organizimit dhe menaxhimit nuk ka arritur që të shkëputet nga *“modeli socialist”* në veçanti lidhur me zhvillimin e iniciativës, inovacioneve, familiarizmit, burokracisë, etj. Qarkullimi i idesë se rritja ekonomike e qëndrueshme do të mund të mbështetet në shfrytëzimin e përparësive krahasuese, siç qarkullojnë disa propozime të ekonomistëve dhe të një pjese të opinionit publik, e që ka të bëjë me atë që Kosova të jetë eksportues i madh i energjisë për rajon, shpesh është bërë pa një analizë kost-benefit, si në kuptim të punësimit, të ardhurave, rritjes ekonomike apo edhe të mirëqenies shoqërore.

Si rezultat i tranzicionit politik, ekonomik e social, shteti nuk ka arritur që të definojë qartë rolin e vet në ekonomi, qoftë si rregullator, qoftë si planifikues i politikave apo edhe si nxitës i zhvillimit. Politikat e zhvillimit ekonomik janë vështuar kryesisht përmes politikave afatmesme buxhetore pa një strategji zhvillimore ku do të ishin të përcaktuar sektorët strategjik dhe objektivat përkatëse strukturore dhe zhvillimore. Po kështu komuniteti lokal (komunat si entitete shtetërore) nuk kanë arritur që të adresojnë kërkesat e tyre zhvillimore duke u mbështetur në resurset e tyre reale. Duke aprovuar apriori parimet e ekonomisë së lirë të tregut, zhvillimi lokal është mbështetur kryesisht në iniciativën private, e cila duke marrë parasysh të kaluarën, nuk ishte në gjendje që të bëjë një ndryshim rrënjësor në strukturën e trashëguar ekonomike, në punësim dhe në mirëqenie në përgjithësi. Poashtu në menyrë që të ketë një planifikim të mirëfilltë të shfrytëzimit të resurseve ekzistuese në lokalitete, përmes së cilave do të gjenerohej punësimi, zhvillimi ekonomik dhe ngritja e standardit të përgjithshëm dhe mirëqenjes sociale, institucionet lokale dhe komuniteti i biznesit nuk i kanë kushtuar rëndësi të gjeturave shkencore që janë në funksion të zhvillimit lokal, praktikë kjo e suksesshme e vendeve të zhvilluara.

Dilemat e zhvillimit të ekonomisë së Skenderajt

Komuna e Skenderajt është një ndër komunat më të varfra të Kosovës, me karakteristika të një urbanizmi të vonë, një strukture sociale me arsimim të ultë, dhe me një ekonomi shumë modeste. Pas luftës të viteve 1998-99, qyteti dhe fshatrat kanë pranuar asistencë të formave të ndryshme nga një numër organizatash qeveritare dhe joqeveritare ndërkombëtare, të cilat i janë qasur kësaj komune në vazhden e rindërtimit të vendit. Ndonëse disa tregues tradicional të zhvillimit ekonomik kanë shënuar përmirësim të dukshëm, në veçanti ato që kanë të bëjnë me infrastrukturën e rrugëve dhe të telekomunikacionit, apo aspektet administrative që kanë të bëjnë me fillimin e punës së bizneseve, megjithatë procesi i ndërtimit të një baze të qëndrueshme për zhvillim ekonomik të lokalitetit dhe zhvillimit të bizneseve, sipas vlerësimit preliminar mbetet akoma i varur nga shumë faktorë të tjerë ekonomik dhe shoqëror të cilët kërkojnë trajtim të veçantë. Teoritë bashkëkohore shkencore rekomandojnë se për të bërë një planifikim të mirëfilltë të zhvillimit ekonomik lokal, nuk mund të anashkalohen trendët e përgjithshme ekonomike e sociale që prekin zhvillimin lokal,

përfshirë këtu globalizmin, internacionalizimin e tregtisë si dhe ndryshimin e dinamikës së punë-zënies⁵⁵⁹.

Në formulimin preliminar të qasjes së hulumtimit të zhvillimit ekonomik lokal të Skenderajt, kemi aprovuar qasjen tradicionale dhe atë bashkëkohore që ka të bëjë me kushtet ekonomike dhe shoqërore që ofron ky lokalitet për nxitjen e krijimit të bizneseve të reja, mbajtjes së bizneseve ekzistuese dhe tëreqjes së biznesve nga lokalitetet e tjera dhe më gjerë si gjenerator të prodhimit, punësimit dhe të rritjes së mirëqenies.⁵⁶⁰ Megjithatë, realiteti ekzistues i Skenderajt dhe ndoshta i të gjitha komunave të tjera të Kosovës, është i lidhur me faktin se: 1) Komunitat me marrjen e kompetencave të reja⁵⁶¹ pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, janë ballafaquar me mungesë të kuadrit profesional që do të mund të implementonte funksionet jo vetëm administrative legale por edhe vetë “*administrimin*” e zhvillimit ekonomik, brenda kuadranit të shtrirjes⁵⁶²; 2) Dokumentet strategjike nga të cilat do të duhej të derivonin të gjitha planet për zhvillim lokal, janë të ndërtuara kryesisht mbi planifikimin “*nga zyra*” dhe jo mbi një bazë të “*kërkimit profesional e shkencor*”; dhe 3) Strategjitë për zhvillimin ekonomik lokal, pavarësisht rëndësisë që kanë, asnjëherë nuk janë materializuar tërësisht në aspektin financiar në mënyrë që të prodhojnë efektet e pritura, si pasojë e investimeve elektorale që udhëheqësit e komunave i kanë premtuar gjatë procesit zgjedhor.

Duke kuptuar natyrën komplekse të procesit si pasojë e elementëve të përmendura më lartë, dhe me qëllim të analizës së hollësishme të planifikimit dhe aktiviteteve ekonomike, kemi hulumtuar ndaras fushën ekonomike, sociale dhe atë të qytetarisë aktive, duke ndjekur njëherazi praktikën tashmë të zakonshme të kombinimit të metodave shkencore, me theks të veçantë atë empirike, korrelative, krahasuese dhe vlerësuese, si dhe me një qasje epistemologjike të kombinuar pozitiviste dhe interpretuese. Qëllimi i hulumtimit ka qenë që t’i kontribuohet disiplinës shkencore të zhvillimit ekonomik lokal përmes trajtimit të modeleve të planifikimit që zbatohen në Kosovë, përkatësisht në rastin tonë të studimit, në komunën e Skenderajt, si dhe futjes në agjendën e rëndësisë së kërkimeve dhe hulumtimeve shkencore për procesin e zhvillimit ekonomik lokal. Fokusi i studimit ka qenë teorik por edhe praktik, duke e trajtuar teorinë e zhvillimit ekonomik lokal si procese ekonomike, sociale dhe publike (politike), si dhe në analizën dhe krahasimin e tyre me rastin e hulumtimit tonë.

Për të krijuar një bazë logjike hulumtuese, kemi shfrytëzuar dokumentin e “*Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal të Skenderaj 2005-2010*”⁵⁶³, realizmi i të cilës ka pas për qëllim “*krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin shoqëror, ekonomik e kulturor të bashkësisë*”, përmes zhvillimit të infrastrukturës rurale dhe kushteve të mira për zhvillimin e biznesit; modernizimit të bujqësinë; përmirësimit të mundësive për punësim; përmirësimit

⁵⁵⁹ Rogerson, M. Christian “**Pro Poor Interventions for Local Economic Development: The case of sectorial targeting**” University of Witwatersrand, Johannesburg, 2002, fq 3;

⁵⁶⁰ Blakely, J. Edward and Nancy Green Leight “**Planning Local Economic Development**” SAGE, 2010, fq. 256

⁵⁶¹ Ligji Nr.03/L-040 Mbi Vetëqeverisjen Lokale, aprovuar me 20.02.2008

⁵⁶² Trajtimi i “*kuadranit të shtrirjes dhe fuqisë*” është mjaft prezent në fushën dhe teorinë politike. Trajtimi i plotë të këtij aspekti mund të gjindet tek F. Fukuyama “**Ndërtimi i Shtetit: Qeverisja dhe rendi botëror në shek XXI**” 2004;

⁵⁶³ Strategjia Zhvillimore Lokale (më tutje në tekst SZHL) është një dokument i përpiluar me ndihmën e Komisionit Evropian në vitin 2008. Ky dokument mund të gjindet në: <http://www.logincee.org/file/22451/library>

dhe menaxhimit të mjedisit natyror, si dhe përmes përkrahjes së zhvillimit shoqëror-ekonomik të bashkësisë.

Ndonëse qasja e ndërtimit të kësaj strategjie, theksohet të jetë ndërtuar sipas modelit nga “*poshtë-lartë*”, mund të vihet në pikëpyetje nëse produkti final i kësaj strategjie është në të vërtetë përfaqësues i orientimit të qytetarëve, kur kemi parasysh se kjo strategji nuk është ndërtuar si rezultat i një diskutimi të gjerë publik dhe social mbi prioritetet për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Esenca e ndërtimit dhe përpilimit të strategjive sipas teorisë ekonomike, qëndron në të kuptuarit dhe bashkë-vepruarit me konkurrencën⁵⁶⁴, prandaj hartimi i çdo strategjie duhet të ketë për bazë vlerësimin real të t’gjitha resurseve në dispozicion dhe krijimit të një ambienti të përshtatshëm për një zhvillim të qëndrueshëm rrethanat e ekonomisë së lirë të tregut.

Sipas të dhënave të prezantuara në Strategji, ekonomia lokale bazohet në bujqësinë familjare, ndërsa sektori privat bazohet kryesisht në bizneset e vogla, përderisa sektori privat industrial është e bazuar kryesisht në fabrikën e tullave dhe atë të miellit. Shëndetësia ka kapacitete të kufizuara, sidomos për qendrat periferike. Arsimi është i organizuar në tre nivelet, atë parashkollor, fillor dhe atë të mesëm, ndërsa së fundmi kësaj komune i është shtuar edhe Qendra e Kompetencës që bazohet në një kurrikulë profesionale. Është me rëndësi të theksohet se sipas përshkrimit të kësaj strategjie, toka është e cilësisë më pak se mesatare dhe e ekspozuar ndaj erozionit dhe me pamundësi të përmirësimit për shkak të mungesës së ujitjes së qëndrueshme. Prodhimi bujqësor bazohet kryesisht në drithëra (78 % e tokës së kultivuar) dhe foragjere (18 % e tokës së kultivuar), gjë që tregon se ka mungesë të ujitjes. Madhësia e fermave është shumë e vogël, ku në një territor prej 18 000 Ha, shtrihen 7,700 sosh apo mesatarisht 2.3 ha. për fermë, që është shumë pak për një zhvillim profitabil ekonomik. Vetëm 10% e tokës së punueshme bën pjesë në kategorinë e parë (I), ndërsa pjesa tjetër në kategorinë III – IV, ndërsa nga të gjitha fermat, 99.6% janë mikroferma kurse vetëm 0.4% janë ferma të specializuara.

Po kështu vlen të theksohet se në analizën SWOT potenciali njerëzor është konsideruar si përparësia më e rëndësishme që ka komuna, ndërsa dobësia më e madhe është qasja e kufizuar në arsimin cilësor. Megjithatë, në rangimin e temave, në një shkallë të vlerësimit prej 1-30 pikësh, prioritet kryesor i është dhënë bujqësisë me 27 pikë gjithsej, pastaj infrastrukturës rurale me 19 pikë, ndërsa menaxhimi i resurseve humane në kuadër të së cilit futet edhe arsimimi cilësor dhe ngritja profesionale është vlerësuar me 4 pikë⁵⁶⁵. Kjo mund të duket kontradiktore për arsye se përderisa thuhet se kualiteti i tokës dhe mungesa e hapësirës për shtrirjen e prodhimit të produkteve bujqësore është mjaft e shprehur, në të njëjtën kohë, bujqësia dhe infrastruktura rurale mbeten dy prioritetet kryesore mbi të cilat është i përqendruar zhvillimi ekonomik lokal, dhe duke e minuar kështu përkushtimin ndaj ngritjes së arsimit dhe fushave të tjera ekonomike si mundësi konkrete për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe afatgjatë. Për më tepër, statistikat e Zyrës për Punësim në komunën e Skenderajt na japin shifra sipas të cilave thuhet se nga 21,562 qytetarë që janë të regjistruar të papunë dhe që janë në kërkim të punës, 12,247 janë të pakualifikuar apo 56.8%⁵⁶⁶.

Disa të dhëna dhe interpretimi analitik i tyre

⁵⁶⁴ Porter, E. Michael “**Five forces that shape strategy**”, Harvard Business Review, January 2008, fq. 79.

⁵⁶⁵ SZHL, fq 29;

⁵⁶⁶ Strategjia e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Skenderajt, 2005-2010, UNDP, Fq 28

KUMTESA

Duke njohur faktin se zhvillimi i ekonomisë lokale është i lidhur me krijimin, mbajtjen dhe tërheqjen e bizneseve, kurse ato kontribuojnë⁵⁶⁷ në të hyrave për familje si dhe në rritjen e konsumit; fuqizojnë rolin dhe ndikimin e furnizuesve dhe kontraktuesve të vegjël; nxisin dhe mundësojnë përfshirjen e komunitetit në negociimin me akterët lokal; dhe përmirësojnë mirëmbajtjen si dhe kanë një kujdes më miqësor në raport me ambientin.

Në pyetjen e shtruar mbi identifikimin e modelit të preferuar, më të përshtatshëm dhe më të sigurt të organizimit të ekonomisë lokale, një shkallë prej 49.9 %, kanë preferuar organizimin e ekonomive bazuar në modelin e ndërhyrjes publike dhe rregullimit shtetëror, pasuar nga sektori privat 26.6% dhe partneriteti publiko-privat 24.1%. Në kushtet e një ekonomie të lirë të tregut, një përgjigjeje kaq e fuqishme pro ndërhyrjes publike në ekonominë lokale nuk mund të kalojë pa u vërejtur. Si rrjedhojë, në kontekstin e hartuesve të politikave lokale mund të ngritet një pyetje se “si mund të shpjegohet kjo kërkesë e lartë e qytetarëve për rregullimin e ekonomisë?” Natyrisht se përgjigjet mund të jenë reflektim i kërkesës për një model ekonomik që në radhë të parë ka gjasa të zbusë papunësinë e cila mbetet shumë e lartë dhe është brenga kryesore e qytetarëve. Përvoja që ata mbajnë mend në kushte të një punëzënie të lartë i referohet një sistemi ekonomik i cili, edhe pse me efikasitet të ultë, prapëseprapë krijonte vende punë. Duke qenë kryesisht një vend agrar dhe me një ekonomi të varur nga produktet që importohen, pa një të kaluar të qëndrueshme dhe të njohur për zhvillim ekonomik dhe gjenerim të mirash, mallrash dhe shërbimesh, është e kuptueshme që pronësia apo orientimi i menaxhimit të ekonomisë lokale bashkë me elementet përcjellëse të saj në duart e sektorit privat të shoqërohet me një dozë frike. Në anën tjetër, duke ditur se jo të gjitha format e ndërhyrjes së sferës publike në ekonomi janë të dështuara⁵⁶⁸, dhe përderisa një pritshmëri e lartë ekziston në mesin e qytetarëve pikërisht për “dorën e shtetit”, një gatishmëri e institucioneve lokale për të “rregulluar” ekonominë e Skenderajt, nuk do të duhej t’i ngjasonte punës dhe veprimtarisë së deritanishme të komunës si një institucion administrativ. Është e nevojshme që modeli i sjelljes së institucioneve lokale si “administratë” të zëvendësohet me modelin e sjellës si “administrues” duke ndërmarrë politika publike aktive që nxisin dhe promovojnë zhvillimin ekonomik lokal.....

(Kjo pjesë është shkëputur nga hulumtimi në vazhdim e sipër me temë “Zhvillimi Ekonomik Lokal dhe Ndikimi në Mirëqenjen Sociale-Rasti i Komunës së Skenderajt”).

⁵⁶⁷ ILO “**Employment, Poverty Reduction and Local Development**” Training Center, Training on local resource based approaches held in Bangkok, 23-27 April, 2007;

⁵⁶⁸ Për më gjerësisht, lexo Aurelia George Mulgan “**Japan Interventionist’s State: Bringing Agriculture Back In**” (Japanese Journal of Political Science 6, Cambridge University Press 2006), Marie Anchordouy, David Arase (2003), Richard Katz (1997), Yasusuke Murakami (1982) etj.

Msc Bislim LEKIQI¹: MOTIVIMI I BURIMEVE NJERËZORE NË PUNË NË KUSHTET E EKONOMISË KOSOVARE

¹Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit – UBT

Hyrje

Tentimi për gjetjen e përgjigjes në pyetje se pse të punësuarit tregojnë sjellje dhe rezultate të ndryshme në punë, i shpie menaxherët në rrugën e kërkimit se çka i motivon të punësuarit që ata i menaxhojnë. Secili menaxher ka për synim të zotëroi situatën me të punësuarit nën mbikëqyrje, por motivimi për punë është një nga fushat më misterioze në fushën e menaxhimit sepse në motivimin në punë, përpos aftësive të menaxherit dhe kushteve të punës, ndikojnë edhe faktor të tjerë, të cilët e bëjnë situatën edhe më të ndërlikuar. Se sa është e komplikuar çështja e motivimit për punë, dëshmon fakti se asnjëra nga teoritë e motivimit nuk arrin në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse të definoi çështjen e motivimit për punës. Për këtë arsye, menaxherët, në harmoni me synimet dhe mundësitë e ndërmarrjes, aftësitë e tyre menaxhuese, rrethanave të ndikuara nga mjedisi, e sidomos në bazë të karakteristikave të individuale të të punësuarve aplikojnë forma të ndryshme të motivimit të burimeve njerëzore, me synim motivimin e tyre sa më të lartë.

Bazuar në kushtet e ekonomisë Kosovare, hulumtimi kërkon përgjigje në dy lloj pyetjesh: ato të cilat përfshijnë faktorët që ndikojnë direkt dhe indirekt në motivimin e punëtorëve në punë me nivel ndikimi dhe grupi i dytë i pyetjeve që kanë të bëjnë me informata shtesë personale për të anketuarin. Ky kombinim na jep informata të shumta për hulumtimin e nivelit të motivimit në punë bazuar në moshë, gjini, arsimim, përvojë punë etj.

Objektivi kryesor: Analiza e gjendjes aktuale e motivimit në punë e të punësuarve në ndërmarrjet përpunuese.

Metodat

Për përgatitjen e këtij materiali u studiua literature në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore me theks të posaçëm në motivim (posaçërisht ajo në gjuhën gjermane), u shfrytëzuan studime të mëparshme në këtë fushë si dhe është kryer një hulumtim në janar 2012, duke përfshirë ndërmarrjet përpunuese të cilat kanë 4 e më shumë të punësuar në Komunën e Ferizajt - Kosovë.

Përzgjedhja e mostrës

Duke u fokusuar në objektivat e studimit, është menduar që mosterizimi për të punëtorit, të përdoret zgjedhja empirike paraprake që ka të bëjë me zgjedhjen e individëve para se të pyeten. Kështu individët janë konsideruar njëlloj përfaqësues të popullimit. Kjo mënyrë u përzgjedh për faktin se anketimi është bërë nga vetë studiuesi. Kështu mënjanohet mangësia e kësaj mënyre dhe konkretisht fakti që anketuesit janë të gabueshëm.

KUMTESA

Korniza e mostrës përbëhet prej regjistrit të MTI të ndërmarrjeve e korrigjuar me numrin e ndërmarrjeve aktive dhe numrin e ndërmarrjeve pasive në momentin aktual të hulumtimit. Kështu që madhësia e mostrës së synuar varet nga situata aktuale e ndërmarrjeve që plotësojnë kriteret e përcaktuara.

Intervistimi është bërë duke përdorur anketimin ballë për ballë, i cili na lejon të ndihmojmë të anketuarit për të bërë modifikime të nevojshme gjatë intervistimit. Lokalizimi i studimit është Komuna Ferizaj në Kosovë. Bazuar në kriteret e mostrës, janë anketuar 90 të punësuar në 19 ndërmarrje përpunuese që për lëndë të parë përdorin produktet agrare me 4 e më shumë të punësuar.

Hartimi i pyetësorit dhe përpunimi i të dhënave

Pyetësori është formuluar kryesisht sipas shkallës së LIKERT-it. (sistem i bazuar në tabelën 1) por sipas problematikës nuk mungojnë edhe pyetjet e hapura.

Së pari është kryer kontrollimi logjik i pyetësorit. Ai është bërë menjëherë pas përfundimit të punës në teren dhe në rast të gabimeve serioze do të kontaktohej personeli i intervistuar për evitimin e dështimeve eventuale. Pas kontrollit është bërë kodimi i tyre.

Përpunimi i të dhënave bëhet me programet GrafStat V.4.250 Ausgabe 2011 dhe MS EXCEL, me synimin për të evituar probleme që kufizimi i ndonjë programi na e privon.

| Shkalla e vlerësimit | Ndikimi në motivimin për punë | Niveli i motivimit në punë |
|----------------------|--|---|
| 5 | Shumë i madh Faktori ka ndikim shumë të madh në gjendjen aktuale të motivimit për punë | Motivim shumë i lartë |
| 4 | I madh Faktori ka ndikim të madh në gjendjen aktuale të motivimit për punë | Motivim i lartë |
| 3 | Neutral Faktori ka ndikim neutral në gjendjen aktuale të motivimit për punë | Motivim fillestar * |
| 2 | I ulët Faktori ka ndikim të ulët në gjendjen aktuale të motivimit për punë | Motivim i ulët = Demotivim i ulët |
| 1 | Shumë i ulët Faktori ka ndikim shumë të ulët në gjendjen aktuale të motivimit për punë | Motivim shumë i ulët = Demotivim shumë i ulët |
| * | Realizim i punëve dhe detyrave në bazë të përshkrimit të punës dhe në pritje të pagesës së paraparë, pa iniciativë personale për përmirësim. | |

Tabela 1: Sistemi i vlerësimit të motivimit në punë për të punësuarit në ndërmarrjet përpunuese

Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi është kryer në bazë të pyetjeve të parashtruara të cilat përfshijnë faktorët që ndikojnë direkt dhe indirekt në motivimin e punëtorëve në punë me nivel ndikimi, ku janë përfshirë:

- 1) Punëdhënësi dhe vendi i punës, me 21 pyetje.
- 2) Ndikimi personal, me 5 pyetje.
- 3) Ambienti / Rrethina, me 4 pyetje
- 4) Vlerësimi i gjendjes aktuale, me 2 pyetje

Vlerësimi i nivelit të motivimit për punë bëhet duke marrë parasysh shumën e të gjithë faktorëve ndikues në motivim dhe është përlogaritur me formulën vijuese:


$$MP = \frac{\sum(FM_{n1} + FM_{n2} + \dots + FM_{nn})}{NFM}$$

MP - Motivimi për punë
 FM_n - Faktori Motivues në renditje sipas numrit
 NFM - Numri i Faktorëve Motivues

Rezultatet


Hulumtimi na sjellë rezultatet vijuese:

- **Ndikimi i vendit të punës dhe i punëdhënësit gjithsej:** Vlera mesatare motivuese e faktorëve individuale sillet në mes 3,07 dhe 4,61 kurse vlera mesatare e ndikimit në motivim ishte 3,814. Faktorët që kanë ndikim më të lartë në motivimin për punë, të shprehur në mesatare ishin: Kualiteti dhe sjellja e kolegëve / të punësuarve me vlerë mesatare ndikimi 4,61 njësi nga 5 të mundshmet, pasuar nga Kultura e ndërmarrjes, vlerat dhe klima e ndërmarrjes, Renomeja e firmës, Qëndrimi ndaj vlerave: familja, ambienti, angazhimi social, Stili i udhëheqjes, kualiteti dhe kompetenca e udhëheqësve, Infrastruktura, Pajisjet për punë e kështu me radhë (grafiku 1).



Grafiku 1: Ndikimi i punëdhënësit dhe vendit të punës në motivimin e të punësuarëve për punë - vlera mesatare

- **Ndikimi personal gjithsej:** Ndikimi personal tek idolët vlerësohet si motivatori më i theksuari me shkallë vlerësimi 4,29, kurse me më së paku ndikim vlerësohet ndikimi personal në arsimim, ngritje profesionale me shkallë vlerësimi 3,3.




Grafiku 2: Ndikimi individual në nivelin e motivimit për punë – vlera mesatare

- **Ndikimi i Ambientit / Rrethinës:** Ndikimin më të madh ka faktori 3.1. Bashkëshortja, fëmijët, prindërit, shoqëria me shkallë ndikimi 4,76 nga 5 të

KUMTESA

mundshme, kurse ndikim më ulët në motivim ka faktori 3.3. Tatimi, taksat, stimuluesit financiar dhe kushtet tjera të krijuara nga shteti me 2,58 nga 5 të mundshëm.



Grafiku 3: Ndikimi i ambientit në motivimin për punë


- **Vlerësimi i gjendjes aktuale të motivimit:** të anketuarit vlerësojnë se motivimi i tyre (4,47 nga 5 të mundshme) për punë është më i lartë se i kolegëve të tyre që ishte 4,02 njësi. Në përgjithësi të anketuarit vlerësojnë se motivimi i të punësuarve është në nivelin e duhur por me mundësi rritjeje.

Vlerësimi i nivelit individual të motivimit të të anketuarve.- Bazuar në formulë, nxjerrim vlerësimin se në rastin tonë, i anketuari i parë ka nivelin e motivimit 4,69 njësi nga 5,00 të mundshme, që vlerësohet se ky person ka Motivim shumë të lartë për punë. Motivimi në rastin tonë llogaritet përmes vlerësimit të faktorëve: Punëdhënësi dhe vendi i punës (me njëzet e një elemente), Ndikimi personal (me pesë elemente), Ambienti/Rrethina (me katër elemente), Vlerësimi i të anketuarit mbi gjendjen aktuale motivuese të ti dhe të kolegëve (me dy elemente).

$$MP = \frac{5+5+5+4+5+5+4+5+5+4+5+5+5+4+5+5+5+4+5+4+5+5+5+4+4+5+5+5+5+5+4+4+5+5}{32}$$

$$MP = 4,69$$

Vlerësimi i përgjithshëm është se motivimin më të lartë në punë e kishte i punësuar i anketuar me numrin rendor 3 që kishte nivelin e motivimit në punë prej 4,88 njësi nga 5 të mundshme, gjegjësisht motivim shumë të lartë në punë. Nivelin më të ulët në punë kishte i punësuar i anketuar me numrin rendor 31, i cili kishte nivelin e motivimit prej 2,38 njësi nga 5 të mundshme që do të thotë se ai ishte i demotivuar në punë (grafiku 5). Motivimi mesatar i të gjithë të anketuarve vlerësohet me vlerën 3,78 njësi nga 5 të synuarat, që d.m.th. është nivel i lartë i motivimit por me disa ndryshime ka mundësi të rritet akoma ky nivel i motivimit momental të të punësuarve.



Grafiku 4: Ndikimi i faktorëve të aplikuar në motivimin individual të të anketuarëve

Në nivelin e përgjithshëm të motivimit, vlerë më të madhe ndikimi kishin faktorët: “Bashkëshortja, fëmijët, prindërit, shoqëria” 4,76 pikë pasuar nga “Kualiteti dhe sjellja e kolegëve/të punësuarve” 4,61 njësi nga 5 të mundshmet.

Konkluzionet

Nga hulumtimi i kryer në ndërmarrjet përpunuese që kanë 4 e më shumë të punësuar (gjithsej janë 19 ndërmarrje aktive të tilla) konkludojmë se:

- Të punësuarit janë individë me karakteristika të ndryshme dhe për këtë arsye i njëjti motivator ndikon në mënyra të ndryshme tek individë të ndryshëm në të njëjtën kohë.
- Tek individ, i njëjti motivator në periudha të ndryshme kohore ka ndikim jo të njëjtë.
- Ndikimi i ndryshëm i të njëjtit faktor në periudha të ndryshme dhe tek individ të ndryshëm bën që të mos përcaktohet një korrelacion ndërmjet instrumentit të motivimit dhe performances.
- Të punësuarit, nga punëdhënësit presin një ndryshim pozitiv në rritjen e instrumeteve financiar motivues, siq janë paga, stimulimi sipas rezultateve, mirënjohja për punën e bërë etj. të cilat duhet të jenë të përfshira në programet adekuate të motivimit.
- Të punësuarit vlerësojnë se kontribuojnë në motivimin personal në punë sidomos përmes ndikimit pozitiv tek menaxherët përmes angazhimit të tyre.
- Gjatë kryerjes së punës, ndikim të fortë kanë faktorët rrethor, ku familja është faktorë i lartë motivues kurse taksat dhe të ngjashme janë demotivator në punë.
- Të punësuarit vlerësojnë se ata vetë dhe kolegët e tyre kanë motiv të lartë për punë, motivim i cili mund të përmirësohet edhe nga faktorët tjerë të lidhur me punën dhe punëdhënësin dhe faktorët tjerë ndikues.

KUMTESA

Mr. Sc. Sherif DOBRA: PRODHIMI DHE EKSPORTI IMPERATIV PËR EKONOMINË E KOSOVËS

- **Në prodhim krijohet vlerë e re;**
- **Pa pavarësi ekonomike nuk mund të ketë as pavarësi politike të Kosovës;**

Zhvillimi ekonomik i Kosovës në periudhën e pasluftës, gjegjësisht pas vitit 1999, mund të thuhet se është realizuar në masë shumë më të vogël se sa që ka qenë e dëshirueshme, e pritur e ndoshta edhe e mundur. Janë të kuptueshme rrethanat dhe trashëgimia e pavolitshme, mirëpo nuk mund të kuptohen se si për një kohë të gjatë kemi papunësi rekorede, varfëri në rritje, deficit tregtar enorm etj. Veprimet e pamjaftueshme dhe joadekuate, apo, më mirë të themi, mosveprimet e institucioneve të caktuara që kanë qenë përgjegjëse për zhvillimin ekonomik të Kosovës, që nga vendosja e UNMIK-ut me të drejta të rezervuara në fushat më të rëndësishme, e deri tek bartja e kompetencave tek Qeveria e Kosovës, kanë bërë që ekonomia e Kosovës, as për së afërmi të mos gjasojë në një ekonomi të organizuar. Analizuar „ex post“ mund të thuhet se nuk kishte pasur vendosmëri të duhur dhe vizion të qartë se ku do të jetë vendi i ekonomisë së Kosovës në ndarjen ndërkombtare të punës në kontekst të tranzicionit, integritimit dhe globalizimit. Përderisa Kosova është shtet, ajo pa tjetër duhet faktorizohet edhe si ekonomi, duke u përcaktuar për modalitet zhvillimor, në harmoni me potencialet e saja dhe përparësitë krahasuese. Pra, mosmarrjen e masave adekuate për nxitjen e veprimtarisë prodhuese dhe të eksportit ka bërë që këto kategori jetike për çdo vend të mbesin në margjina. UNMIK-u më tepër ishte kujdesur nga viti në vit që ta sigurojë një buxhet në shuma modeste për nevoja të shpenzimeve publike, se sa që me largpamësi t'i vërë bazën një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik të Kosovës. Ekonomia e Kosovës po kalon një periudhë të gjatë tranzicioni, ku ende nuk ka konturat e një ekonomie të tregut, përkundrazi, ku baza e gjenerimit të të hyrave është e ngushtë, sikundër që është i ngushtë edhe tregu. Kur këtyre u shtohet fakti se ekonomia informale dhe korupcioni janë të pranishme në mënyrë permanente, atëherë gjendja mund të kuptohet. Problemet më të theksuara me të cilat Kosova vazhdon të ballafaqohet për më shumë se një dekadë, janë: norma tejet e lartë e papunësisë, me mbi 40 %, deficit i lartë tregtar, rrjedhimisht varfëria e theksuar në një përqindje të madhe të popullatës, privatizimi i ndëmarrjeve shoqërore pa rezultate të dukshme, infrastruktura ekonomike ende jofunkcionale, mungesa e investimeve direkte etj. Ekonomia e Kosovës ka pasur dhe vazhdon të ketë varshmëri të madhe nga remitencat si dhe nga donacionet, kur është fjala për ndihmë finaciare dhe teknike. Ka shumë arsye dhe motive që të nxitet, ndihmohet dhe të promovohet prodhimi në mënyrë që të sjellë në treg produkte standarde. Kjo do të mundësonte zëvendësimin e produkteve të

KUMTESA

importit me ato vendore, si hapi i parë dhe hapi tjetër do të ishte përpjekja për të nxjerrë produktet kosovare edhe në tregjet e jashtme. Por, këtyre doemos duhet t'i paraprijë strategjia e shtimit të eksportit. Sidoqoftë, prodhuesit kosovarë duhet ta kenë të qartë se tregu i jashtëm mund të arrihet vetëm me cilësi dhe standarde të pranueshme ndëkombëtarisht. Shtimi i aftësisë konkurruese si dhe vetë zhvillimi ekonomik e shoqëror duhet kuptuar si domosdoshmëri para antarësimit në Bashkimin Evropian. Bazuar në traditë, në Republikën e Kosovë bujqësia dhe industria do të duhej të ishin sektorë me rol vendimtarë në zhvillimin ekonomik.⁵⁶⁹ Bujqësia është konsideruar veçanërisht si sektor i rëndësishëm në fazën initiale të zhvillimit, gjë që në Kosovë zhvillimit të bujqësisë, pas vitit 1999, nuk i është dhënë përkrahje. Ishte dashur të kalojnë më shumë se 10 vjet që një qeveri e Kosovës (aktuale) t'i jep mbështetje konkrete prodhimit primar bujqësor dhe blegtoral (përmes subvencionimit).

Anketat e bëra me qytetarë të Republikës së Kosovës, në fund të vitit 2011, kanë treguar se preokupimi kryesor i tyre aktualisht është papunësia dhe varfëria, atribute tipike të një vendi me ngecje në zhvillim ekonomik.⁵⁷⁰

Si ekspertët ndërkombëtarë edhe ata vendorë, kishin theksuar se nxitja e prodhimit vendor si dhe eksportit është domosdoshmëri dhe shans për intensifikimin e zhvillimit të përgjithshëm. Që nga suprimimi i autonomisë së Kosovës nga ana e Serbisë, Kosova kishte qenë treg i saj i sigurt dhe profitabil, e cila këtu i shiste prodhimet e veta me kualitet të dyshimtë dhe me çmime monopoliste, e me inercion të njëjtë kjo gjendje vazhdon deri sot. Pra, edhe sot po ngjet e njëjta gjë, me ndryshim se tani nuk jemi vetëm treg i saj, por edhe i shumë shteteve tjera. Është e kuptueshme që t'i pranojmë parimet e ekonomisë së tregut dhe të jemi për bashkëpunim me vendet e rajonit e të botës, por nuk është e kuptueshme që në Kosovë vetëm të sillen mallëra nga jashtë dhe ne të mos eksportojmë, apo kjo të jetë në sasi të papërfillshme. Për të qenë dhe më keq, ne nuk mbulojmë as nevojat tona me produkte vendore. Bilanci tregëtar tejet i pavoritshëm, siç është rasti me Kosovën, me vite e dekada është indikator i një sistemi ekonomik jofunksional, jokonkurrent dhe të paorganizuar. Në qoftë se koeficienti i mbulimit të importit me eksport, gjatë këtyre viteve, sillet nga 1,54 për të rritur memzi në 14,2 % siç është rasti me Kosovën⁵⁷¹, kjo tregon mjaft dhe është alarm për krijuesit e politikës ekonomike. Kur kësaj i shtojmë faktin, se në vëllimin e përgjithshëm të importit, 40% e përbëjnë prodhimet bujqësore, është e qartë pse kemi normë kaq të madhe të papunësisë. Por le t'i paraqesim disa të dhëna në shuma absolute dhe relative të bilancit tregtar të Kosovës nga viti në vit.

Tabela 1. Ecuria e importit dhe eksportit të mallrave në Kosovë, 2001-2011 (në 000,000 €)

| Vitet | Eksporti | Importi | Bilanci tregtar | Koefi. i mbulimit të importit me eksport |
|-------|----------|---------|-----------------|--|
| 2001 | 10.6 | 684.5 | - 673.9 | 1,54 |
| 2002 | 27.6 | 854.8 | - 827.2 | 3,23 |
| 2003 | 35.6 | 973.2 | - 937.5 | 3,66 |

⁵⁶⁹ / The agropocessing industry and economic development;


⁵⁷⁰ / UNDP, Economic development

⁵⁷¹ / Folow of goods on external trade, të dhëna nga web-faqja e Entit të Statistikave të Kosovës-2005

| | | | | |
|------|----------------|-----------------|-----------|------|
| 2004 | 56.6 | 1,063.3 | - 1,006.8 | 5,32 |
| 2005 | 56.3 | 1,157.5 | -1,101.2 | 4,86 |
| 2006 | 110.8 | 1,305.9 | -1,195.1 | 8,48 |
| 2007 | 165.1 | 1,557.6 | -1,410.4 | 10.6 |
| 2008 | 195.9 | 1,927.9 | -1,732.0 | 10.1 |
| 2009 | 165.3 | 1,935.5 | -1,770.2 | 8.5 |
| 2010 | 295.9 | 2,157.7 | -1,861.8 | 13.7 |
| 2011 | 313.1 | 2,479.6 | -2,166.5 | 12.6 |
| 2012 | 18.7 (janar) | 131.5 (janar) | - 112.8 | 14.2 |

Burimi: Folow of goods on external trade, të dhëna të Entit të Statistikës së Kosovës

Figura 1. Ecuria e importit dhe eksportit në Kosovë, 2001-2011



Sipas disa vlerësimeve, shuma e importit të mallrave dhe shërbimeve së fundi paraqet 50 % të B.P.V. Po t'i bëhet një vështrim strukturës së impoiteve dhe eksporteve të Kosovës, ato janë indikative. Bie fjala, pjesëmarrje më të madhe në eksport vite me radhë kanë pasur mbeturinat e metaleve dhe produkte tjera me shkallë të ulët të përpunimit. Vetëm pas privatizimit të Ferronikelit, dhe aktivizimit të vijave të prodhimit me kapacitet relativisht të lartë, dominon eksporti i nikelit në Ferronikel, i cili në vitin 2010 kap shumën prej 140 milionë €, apo 47.6 % të gjithë eksportit kosovar.⁵⁷² Nga vlera e impoiteve, pjesëmarrje më të madhe kanë produktet primare dhe produktet e përpunuara ushqimore. Në vitin 2007 dhe në atë 2008, në importet e Kosovës, vendin kryesor prej shteteve e zinin Serbia dhe Maqedonia.

Në të vërtetë, deficitin tregtar negativ ka shpjegim të tillë, që shuma të konsiderueshme parash apo pagesash bëhen nga ekonomia vendore në llogari të bizneseve të jashtme, gjë që është në

⁵⁷²/ Sfidat dhe mundësitë e Kosovës për eksport në BE, Shoqata e Eksportuesve të Kosovës, f.4. Prishtinë 2011.

disfavor të vendit. Pra, doemos do të duhej të synohet të paktën një bilanc tregtar ku importet përafërsisht janë në shuma të njëjta me eksportet.⁵⁷³

Megjithatë, deficieti i madh tregtar nuk mund të sanohet vetëm me masa ndalim importi, por sidomos me investime, prodhim industrial e shërbime prodhuese konkurrense si në aspektin e cilësisë, po ashtu edhe të çmimeve.

Por çfarë pikëpamjeje kanë ekonomistët lidhur me deficitet tregtar enorm në vendet e fuqishme ekonomike? Peter Morici, profesor i ekonomisë në Universitetin e Maryland shkruan: “Si pasojë e efektit kumulativ të deficitit tregtar gjatë dhjetë vjetëve të fundit, ekonomia e SHBA-ve në vitin 2006 do të jetë më e vogël afërsisht për 1,7 trilionë \$ se sa që do të kishte qenë në të kundërtën e kësaj gjendjeje”⁵⁷⁴; SHBA ndërmjet viteve 1950 dhe 1960 kanë pasur bilanc tregtar pozitiv dhe pikërisht në këtë periudë kohore, rritja mesatare vjetore e G.D.P kishte qenë 4.3 %. Që nga viti 1970 deri me 2000 kur kishte pasur deficit tregtar, rritja mesatare vjetore e GDP kishte qenë 3.1 %, ndërkaq nga viti 2001 deri në v. 2008, kur deficieti tregtar kishte shënuar rritje nga 400 miliardë \$ në 700 miliardë, norma mesatare e rritjes së GDP kishte qenë 2.4 %.⁵⁷⁵ Prej këtyre të dhënave, shihet se bilanci tregtar negativ dhe norma vjetore e shtimit të G.D.P janë në përpjestim të zhdrejtë dhe kanë lidhje funksionale.

Kjo shihet qartë dhe nga formula e bruto produktit vendor $GDP = C+G+I + (X - M)$

GDP = Bruto produkti vendor

C = Konsumi

G = Shpenzimet qeveritare

I = Investimet (kapitale)

X = Eksporti dhe

M = Importi

Presidenti Obama më 27 janar 2010 kishte shpallur iniciativën kombëtare të eksportit, duke deklaruar: - Kështu sot ne kemi vendosur objektiv të ri: ne do të dyfishojmë eksportin tonë në pesë vitet e ardhshme. Kjo rritje e eksportit, do të ndikojë në hapjen e dy milionë vendeve të punës.⁵⁷⁶ Këto le të shërbejnë si shembull se çfarë trajtimi ka eksporti (doemos edhe prodhimi) nga ana e ekonomistëve dhe liderëve të vendeve të fuqishme ekonomike, siç janë SHBA.

Në vazhdimi kanë qenë evidente dhe të arsyeshme ankesat e disa prodhuesve potencial në Kosovë, për shkak të ngulfatjes së iniciativës së tyre me norma të larta të doganave dhe të akcizës, edhe pse importonin lëndën e parë për të prodhuar për eksport, burime të energjisë (mazuti) apo paisjeve prodhuese. Por, jo vetem kaq, as rrethanat tjera nuk kishin qenë më të volitshme si: normat e interesit për kredi biznesi, mungesa e subvencioneve, konkurrenca jolojale etj. Regjimi i tregtisë së jashtme të Kosovës me botën duhej përshtatur nivelin e zhvillimit të ekonomisë së Kosovës, duke u rishikuar, në funksion të bashkëpunimit tregtar me shtetet tjera dhe para së gjithash të rritjes së prodhimit vendor dhe punësimin.⁵⁷⁷

⁵⁷³ / Balance of trade deficit; www.amosweb.com

⁵⁷⁴ / www.onlinetes.com; The trade balance matters: focusing on trade inbalance to create millions of jobs, f. 2

⁵⁷⁵ / www.onlinetes.com; The trade balance matters: focusing on trade inbalance to create millions of jobs, f. 2

⁵⁷⁶ / www.whitehouse.gov.

⁵⁷⁷ / Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës dhe Oda Ekonomike e Kosovës- Prishtinë 2002; Strategjia e zhvillimit ekonomik, f. 63


Sidoqoftë, Qeveria e Kosovës duke filluar nga viti 2009 ka ndarë mjete buxhetore për subvencionim të prodhimit primar bujqësor dhe blegtoral dhe në këtë mënyrë ka kurajuar prodhuesit potencial për të zgjerruar bizneset e tyre. Cilat janë shumat e ndara për subvencionime sipas viteve, shihen në tabelën vijuese:

Tabela 2. Buxheti i ndarë për subvencione sipas viteve

| Nr. re. | VITI | SUBVENCIONET – SHUMAT SIPAS VITEVE | Në € |
|---------|------|------------------------------------|--------------|
| | | | Indeksi bazë |
| 1 | 2009 | 5,246,294.39 | 0 |
| 2 | 2010 | 5,625,750.00 | 107.2 |
| 3 | 2011 | 7,830,000.00 | 149.3 |
| 4 | 2012 | 8,400,000.00 | 160.1 |

Burimi: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Figura 2. Subvencionet ne Kosovë, 2009-2012



Çka ka ndodhur si pasojë e mungesës së masave të politikës ekonomike për të stimuluar prodhimin vendor dhe eksportin dhe mungesës së investimeve direkte?

Së pari: me apo pa vetëdije kreatorët e zhvillimit ekonomik (mos zhvillimit) kanë dekurajuar ndërmarrësin - prodhues. Si pasojë e neglizhencës së autoriteteve përgjegjëse të UNMIK-ut dhe qeverive pasuese, prodhuesit e paket kosovarë kanë përjetuar presion nga konkurrenca jolojale e vendeve fqinje.

Së dyti: Kanë stimuluar dhe kanë “prodhuar” shtresa parazite apo stërshitës (kontrabandë). Kjo kishte krijuar rrethana që malli nga prodhuesit (e jashtëm) e deri tek blerësit e fundit të kalojë nëpër disa duar, me ç’rast shtesat tregtare apo marzhën siç thuhet, të gjithë këtyre ndërmjetësuesve ua paguajnë blerësit e fundit (konsumatorët). Kështu, mallrat e konsumit me një kualitet mesatar, e në shumë raste dhe të dobët, ishin më të shtrenjtë se në shumë vende përendimore. Në të vërtetë, me qenë se qytetari i Kosovës realisht merr pagë disa herë më të ulët se të punësuarit në ato vende, çmimet e mallrave të cekura, për të, ishin shumëfish më të larta.

Së treti: Rritja në vazhdimësi e numrit absolut të të papunëve si dhe norma e papunësisë, dhe jo vetëm kaq, por dhe rritja e varfërisë në përmasa shqetësuese. Pos kësaj edhe struktura e të punësuarëve edhe sot e kësaj dite është tejte e pavolitshme, me qenë se, siç dihet pjesa dërmuese e tyre janë punëtorë në sferën joprodhuese të cilët mbahen nga buxheti..

Së katërti: Struktura e të hyrave buxhetore ka qenë e pavolitshme, pasi që siç dihet pjesëmarrje më të madhe në formimin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës kanë doganat, gjegjësisht tatimet në kufij, e jo tatimet e brendshme, gjë që nuk është praktikë me vendet e zhvilluara. Pos kësaj, baza tatimore ka qenë e ngushtë, pos tjerash edhe për faktin se numri i të papunëve ka qenë i madh, ndësa një sasi e konsiderushme e buxhetit është shpenzuar për skema sociale.

Gjendjes së tanishme të ekonomisë së Kosovës i kanë kontribuar dhe shumë faktorë dhe rrethana tjera, si: privatizimi gati i dështuar (pak ndërmarrje të privatizauara sot kryejnë funksionin e tyre me kapacitet optimal dhe në kushte të biznesit bashkëkohor), investimet direkte të pamjaftueshme etj.

Ku qëndron përparësia e veprimtarisë prodhuese?

Në bazë të literaturës ekonomike por dhe njohurive praktike është e ditur se vlera e re krijohet kryesisht në prodhim dhe në shërbime prodhuese (në prodhimin e produkteve të ndryshme dhe atë me shkallë sa më të lartë të finalizimit si dhe në shërbime prodhuese etj.), ndërkaq në tregti realizohet ajo vlerë e re e krijuar⁵⁷⁸. Në literaturën ekonomike, por edhe në vjetarë të ndryshëm statistikorë, në të cilët në njërin apo formën tjetër analizohet zhvillimi ekonomik⁵⁷⁹ i një vendi, doemos hasen nocionet: prodhim industrial, prodhim bujqësor, strukturë e prodhimit, shërbime prodhuese, shtimi i eksportit, investime direkte etj. Pra, është gjë e rëndomtë që kur flitet për zhvillim ekonomik, para se gjithash mendohet në prodhim⁵⁸⁰. Këtu te ne në Kosovë, aktualisht, jo vetëm që nuk ishte bërë asgjë në stimulimin e prodhimit, por rrallëherë zihen në gojë fjalët **prodhim dhe eksport** në çfarëdo konteksti. Ndërmarrja e veprimeve të para konkrete në subvencionimin e prodhimit primar bujqësor e blegtoral, nga ana e Qeverisë së Kosovës është një ogur i mirë për farmerët dhe për ardhmërinë e sferës së prodhimit kosovar. Kohë të gjatë ishte bërë dominante ideja se ne do jemi shoqëri e shërbimeve, se do përparojmë nga ndihmat, se të gjithë duhet të merren me tregti dhe se vetëm aty është profiti etj. Manifestimet e ndryshme të organizuara në formë të panairëve, të quajtur si java e biznesit kosovar, apo të ngjashme, ndoshta më mirë do të ishte që të organizohen dhe të quhen, **java e prodhimeve kosovare**, ku do të ftoheshin kryesisht prodhuesit vendorë, pa pretenduar që të mohohet roli i tregtisë si degë ekonomike.

⁵⁷⁸ / R.J. Teoria e tregut dhe e çmimit; Pr. 1996, fq. 306

⁵⁷⁹ / Zhvillimi ekonomik dhe rritja ekonomike kanë shpejgime që dallojnë njera nga tjetra.

⁵⁸⁰ / Economia 1-2, 2003, faqe 97

Manifestimi i tillë do të ishte reklamë shumë e mirë për produktet vendore si dhe një promovim i tyre.

Në të vërtetë çka do të thotë prodhimi për një vend (shtet)? Do të thotë punësim i një numri të konsiderueshëm të të papunëve, shtimi i aftësisë blerëse të popullatës për atë numër të të punësuarish, shtim i numrit të njerëzve të cilët do të paguajnë tatim për buxhetin e Kosovës (tatim në pagë), pakësim i presioneve të mundshme sociale, rritje e buxhetit, përmirësim i bilancit tregtar, shtim i konsumit etj. Pra prodhimtaria është domosdoshmëri ekzistenciale e njeriut, prandaj edhe e shoqërisë si tërësi. Çdo e mirë materiale që njeriu e përdor, për mirëqenien e tij është rezultat i prodhimit, kudo që ai ndodhet. Ajo është diç e natyrshme. Çdo gjallesë në ruzullin tokësor ka vetinë e shumimit dhe prodhimit të fryteve, madje edhe pa kultivim të veçantë nga ana e njeriut.

Autori Ultër Laker, në librin e tij “Evropa në kohën tonë“ pos tjerash shkruan: “Britania e pas Luftës së Dytë Botërore duhej të eksportonte ose të vdiste”⁵⁸¹. Këtu autori në njëfarë mënyre paraqet rëndësinë e prodhimit dhe të eksportit për një vend, konkretisht në këtë rast për Britaninë e asaj kohe, e cila megjithatë është konsideruar dhe vërtetë ishte djep i revolucioneve shkencore-teknike. Kosova sot bënë të kundërtën e asaj që bëjnë apo tentonin që ta bëjnë shtetet e zhvilluara dikur, por edhe sot, nuk ka strategji të zhvillimit të prodhimit vendor dhe eksportit, por edhe kur hartohen nuk zbatohen me këmbngulësi të duhur. Në të vërtetë, rendi i ri ekonomik botëror, pra integrimet dhe globalizimi nuk nënkupton lënien anash të prodhimit vendor e as të eksportit, apo të shndërrimit të Kosovës në treg të vendeve tjera. Që nga viti 1999, mund të thuhet se subjektet përgjegjëse për zhvillimin ekonomik kanë pranuar rolin inferior të ekonomisë kosovare në këtë proces.

Është iluzore të mendohet për pavarësi të plotë pa zhvillim ekonomik, prodhim, shërbime prodhuese, eksport etj. As personi fizik nuk është i pavarur nëse nuk krijon diç, apo nuk e ka pavarësinë ekonomike e lëre më shteti. Popullata e Kosovës është dëshmuar se ka kulturë të punës, ka aftësi ndërmarrëse, por mbetet që këtyre virtyeteve t’u jepet rasti për zhvillim dhe përparim të mëtutjeshëm. Kosova duhet të bëhet subjekt në ndarjen ndërkombëtare të punës. Norma kaq e lartë e papunësisë, nënkupton mosaktivizim të faktorit më të rëndësishëm zhvillimor, pra resurseve humane, me dijen dhe përvojën e tyre. Kjo drejt për se drejti reflektohet në humbjen e investimeve që Kosova bën në arsimim dhe aftësim të faktorit njeri. Pse? Mosangazhimi i të diplomuarëve për një kohë të gjatë bën që ata të largohen në vende tjera, sidomos kuadrot deficitare e më të kërkuar siç janë ata të fushave të informatikës, mjekësisë, inxhinierisë etj. gjë që i bie se Kosova ka investuar në arsimin e tyre dhe vendet tjera i marrin. E njëjta gjë ndodh edhe me ata që pas diplomimit për shumë vite nuk gjejnë punë, me qenë se ata doemos, në një mënyre do e harrojnë profesionin. Për këta të fundit duhet investuar pësëri në riorsimim apo riaftësim, para se eventualisht të aktivizohen në profesionet e tyre.

Çka duhet të ndërmarrin autoritetet përgjegjëse për zhvillim më të hovshëm ekonomik të Kosovës?

- Identifikimi i shkaqeve që sollën deri te parametrat e pavolitshëm ekonomik

⁵⁸¹/ Uolltër Lakër, Evropa në kohën tone, Tiranë 1996, f. 44

KUMTESA

- Hartimi i planit strategjik të eksportit si pjesë e strategjisë së zhvillimit ekonomik nga ana e ekspertëve të fushave të ndryshme, duke u bazuar në trendet bashkëkohore teknologjike, inercionin integruar të Kosovës, çështje të ambientit dhe në përgjithësi duke respektuar standardet evropiane dhe ato ndërkombtare;
- Rishikimi i politikave fiskale si dhe mënjanimi i dukurisë së fshehjes së tatimeve (evazioni fiscal, siç është bërë modë të thuhet) dhe kontrabandës në përgjithësi, në masën më të madhe të mundshme (eliminimi i kësaj dukurie sigurisht se do të shtonte dukshëm vëllimin e të hyrave buxhetore);
- Rrumbullakësimi i infrastrukturës ligjore me anën e së cilës rregullohet fusha e ekonomisë;
- Mbështetja konkrete edhe më e madhe e prodhuesve dhe eksportuesve ekzistues apo potencial. Në grupin e këtyre masave do të mund të merreshin edhe këto: lirimi i prodhuesve nga tatimi në fazën e parë të aktivitetit të tyre, kontrollimi i importit me instrumente jodoganore dhe stimulimi i eksportit, shtimi i sigurisë, subvencionimi në vazhdimsi i produkteve të caktuara, kreditë zhvillimore, formimi i tregjeve të fermerëve etj. Duhet bërë sakrificat afatshkurtra për realizim të objektivave afatgjata;
- Riaktivizimi i minierave të Trepçës të cilat mbajnë në vete rezerva të mëdha plumbi, zingu, argjendi, ari etj.
- Përpjekja për anëtarim në organizatat ekonomike regjionale dhe ndërkombëtare ;
- Shtimi i sigurisë për investitorë të huaj dhe të vendit, në funksion të integriteteve prodhuese ndërkombëtare;
- Luftimi i dukurisë së korupcionit në vazhdimësi;
- Përmirësimi qenësor i infrastrukturës ekonomike si parakusht për shtimin e prodhimit industrial dhe bujqësor;
- Mbrojtja e prodhimit vendor nga konkurrenca jolojale, me mjete jashtdoganore dhe eliminimi i informalitetit;
- Riformulimi i politikave të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe përshpejtimi i ritmit të këtij transformimi pronësor;
- Identifikimi i fushave të cilat veçanarisht mund të jenë atraktive për investime direkte dhe ndërmarrja e hapave konkret që atyre investitorëve në baza të interesit të ndërsjell t'u hapet dera (Kompleksi turistik Brezovica etj.)

Veli LECAJ: ROLI I TREGTISË SE JASHTME NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË KOSOVËS

Kosova vështruar nga aspekti historik ishte pjesa më e pa zhvilluar e ish-Jugosllavisë, krahasuar me ish pjesët tjera federale dhe në relacionet ballkanike e evropiane.

Baza ekonomike që trashëgoi Kosova në ish-Jugosllavi, është faktor me ndikim të madh për zhvillimin ekonomik gjatë periudhës së mëvonshme, edhe pse në politiken zhvillimore ish-Jugosllave, politika e zhvillimit të barabartë ekonomik parashtrohej si qëllim i rëndësishëm. Në teorinë e zhvillimit ekonomik është konstatuar dhe vërtetuar përmes analizave empirike, se ekziston lidhshmëria e ngushtë dhe reciproke mes sistemit ekonomik dhe zhvillimit ekonomik shikuar nga aspekti sektorial dhe territorial.

Sistemi ekonomik përkufizon rregullatorin kryesor në procesin e prodhimit i cili përmes nënsistemeve dhe mekanizmave të tij si sistem i financimit të riprodhimit të zgjeruar, sistemi i planifikimit, sistemi i çmimeve, sistemi i marketingut, sistemit devizor, sistemit monetar kreditor, sistemit politikës së jashtme, sistemi i tregtisë së jashtme etj. mundëson realizimin e qëllimeve të projektuara në kuadër të ekonomisë kombëtare në tërësi.

Ndërsa politika e zhvillimit ekonomik formulon objektivat dhe masat për sendërtimin e tyre në rrafshin sektorial, shtetëror, rajonale e më gjerë.

Zhvillimi bashkëkohor i ekonomisë botërore dëshmon për thellimin e ndërvarësisë ekonomike, financiare e informative midis vendeve.

Por edhe zhvillimi ndërkombëtar tekniko-teknologjik dhe migrimi i fuqisë punëtore, janë po ashtu faktorë tjerë mjaft të rëndësishëm që karakterizojnë karakterin dhe ndërvarësinë reciproke ndërkombëtare të ekonomisë. Rëndësi të madhe në strukturën e sistemit ekonomik të çdo vendi ka edhe tregtia e jashtme si pjesë përbërë e tij.

Çështja e rolit të eksportit dhe importit në zhvillimin ekonomik, sot e kësaj dite mbetet çështje thelbësore e sigurimit të pozitës konkurruese në tregun ndërkombëtar.

Është vështirë të imagjinohet funksioni i një ekonomie në gjendje të izoluar nga ekonomitë tjera, pra nga tregu i mallrave dhe shërbimeve, tregu i kapitalit, tregu i fuqisë punëtore e kohëve të fundit dhe ai i informacioneve.

Edhe ndër varshmëria ekonomike i ka pasojat dhe përparësitë e veta gjatë zhvillimit ekonomik, të cilat kanë reflektuar në çdo ekonomi dhe do të reflektojnë po ashtu edhe në ekonominë e Kosovës.

Dihet se hapja e ekonomive botërore dhe ndër varshmëria ekonomike mes tyre ka ndikuar në humbjen e vendeve të punës për një numër të konsiderueshëm të punëtorëve. Mundësitë për të lëvizur përtej kufijve, për të gjetur një jetë më të mirë janë rritur kohëve të fundit. Kjo ka ngritur zërat se vendet e punës në vendet e zhvilluara po zaptohen nga të huajt. Në këtë kontekst duhet potencuar se Kosova ka një numër të konsiderueshëm të qytetarëve të vet

jashtë, ndikimi i të cilëve në ekonominë e vendit është i jashtëzakonshëm. Për më tepër, Kosova ka një bilanc tejet negativ tregtar që tregon pozitën e dobët konkurruese të Kosovës në tregun botëror.

Pavarësisht nga niveli i zhvillimit ekonomik dhe sistemit ekonomiko-shoqëror, tregtia e jashtme luan një rol të rëndësishëm duke u paraqitur kështu si një komponent zhvillimore e domosdoshme dhe e patjetërsueshme.

Tregtia e jashtme, jo rrallë mundëson furnizimin e tregut kombëtar me të mira materiale për konsum apo për investime të mëtejme për procesin e riprodhimit në ekonominë e vendit, por nga ana tjetër krijon mundësin që të eksportohen të mira materiale jashtë vendit, proces ky që mundëson funksionimin normal të zhvillimit ekonomik kombëtar. Kosova do të duhej synuar që me përpikëri të aplikoj këtë formë të funksionimit të zhvillimit ekonomik.

Por do të ishte interesant që të theksohen shkurtimisht çështjet kryesore që e kanë përcjellur realitetin e ekonomisë së Kosovës para luftës deri në vitin 1999 dhe pas kësaj periudhe kur Kosova realisht edhe u pavarësua.

2. Tregtia e jashtme në Kosovë para vitit 1999

Sistemi ekonomik Jugosllavë njihet si sistem në mes të dy sistemeve botërore, nga njëra anë, i bazuar në tregun e lirë dhe në anën tjetër në sistemin ekonomik të llojit Sovjetik.

Prandaj sfera e prodhimit dhe e këmbimit brenda dhe jashtë Jugosllavisë janë bazuar në mekanizmat e tregut, ndërsa elementi socialist-vetëqeverisës në lidhje me pronën mbi mjetet e prodhimit dhe qeverisjen, kishte pronësi shoqërore që nënkuptonte së punëtorët ishin pronarë të këtyre mjeteve të punës, për dallim nga shumë shtete tjera socialiste lindore që pronësia mbi mjetet e punës ishte e karakterit shtetëror.

Mjetet nëpër Organizata të Punës së Bashkuar (OPB) i qeverisnin me nikoqirllëk punëtorët të cilët kishin rolin kryesor në strukturat vendimmarrëse të OPB-ës, përmes këshillit të punëtorëve si organ i tyre, edhe pse asetet (mjetet e ndërmarrjes së sotme) e tyre i takonin shoqërisë.

Qasja e tillë liberale në ekonominë Jugosllave nuk zgjati shumë kohë, sepse diku pas viteve të shtatëdhjeta filloi të rritet me të madhe roli i shtetit në ekonomi ndërsa aktiviteti i pavarur i ndërmarrjeve u kufizua në masë të konsiderueshme.

Rritja e rolit të shtetit në ekonomi arsyetohet me atë se mekanizmat e tregut në ekonomi ndikuan që të paraqiten ciklet të shpeshta ekonomike në ekonominë Jugosllave, të rritet niveli i papunësisë, erdhi deri te rritja e disparitetit të jashtëm dhe të brendshëm, rritja kontinuele e borxheve të jashtme dhe deficitit tregtar, përkundër që zhvillimi ekonomik Jugosllavë, u fokusua në zhvillimin rapid industrial me norma të larta të investimeve në industrinë prodhuese.

Mirëpo, sidomos gjatë kësaj periudhe deficiti tregtar rritej në mënyrë drastike, sa që borxhi i jashtëm arrin shifrën prej disa miliarda dollarë, me që rast u kufizua edhe aktiviteti i bizneseve të asaj kohe që shoqërohej me pengimin e themelimit të ndërmarrjeve të reja në tregun Jugosllavë, normalisht përfshirë edhe Kosovën si pjesë të saj.⁵⁸²

⁵⁸² Dr. Skender Berisha "Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare" Universiteti i Prishtinës, 1998, fq. 231

Kështu që gjatë kësaj periudhe vërehej një rritje e eksportit prej 15.40% në nivel vjetor, por importi në këtë kohë shënoi një rritje me të madhe diku rreth 20.40% ,si rezultat i këtij ndryshimi të vazhdueshëm gjatë disa viteve paraqitet deficitit tregtar.

Gjatë periudhës kohore të viteve 1970/1-deri afërsisht në vitin 1988, kontributin si eksportues kryesor më të madh në paraqitjen e rritjes së eksportit në Jugosllavi e kishin dhënë republikat e zhvilluara, si Sllovenia, Kroacia, dhe Serbia (së bashku me Vojvodinën por pa Kosovën), që kanë gjeneruar së bashku rreth 80.00% të eksportit të përgjithshëm Jugosllavë.⁵⁸³

Ndërsa nga regjionet më pak të zhvilluara, kontributi i Kosovës, Malit të Zi dhe Maqedonisë ishte shumë i vogël krahasuar me republikat e cekura më lartë, sa që Maqedonia me 5.10% ; Kosova me 2.00 %; dhe, Mali i Zi me 1.80% mesatarisht për periudhën e njëjtë kohore.

Bilanci tregtar i Kosovës me botën, gjatë kësaj periudhe kishte tendenca të ndryshme të mbulimit të importit me eksport, që ishte përafërsisht i njëjte me atë të Jugosllavisë, sa që nëse analizojmë dallimet i shohim se p.sh ne vitin 1979 mbulimi ishte 43 % për Kosovën ndërsa për Jugosllavinë ishte 48%, ndërsa në vitin 1987 indeksi i mbulimit ishte 98% për Kosovën, me 90% për Jugosllavinë, ne veçanti duhet të shihen të dhënat e vitit 1988 kur indeksi i mbulimit ishte 123% për Kosovën ,me 89% për Jugosllavinë, kjo ishte një tregues që Kosova konform fuqisë ekonomike dhe financiare kishte mundësi të mira për mbulim importi me eksport në krahasim me Jugosllavinë Socialiste të asaj kohe si tërësi.

në miliona dinarë

| <i>Vitet</i> | <i>Eksporti</i> | <i>Importi</i> | <i>Saldoja</i> | <i>Mbulimi i importit me eksport</i> | <i>Mbulimi i importit me eksport</i> |
|--------------|-----------------|----------------|----------------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| | | | | <i>Kosova</i> | <i>Jugosllavia</i> |
| 1971 | 23,565 | s'ka te dhëna | s'ka te dhëna | s'ka te dhëna | s'ka te dhëna |
| 1972 | 43,560 | 35,158 | 8,402 | 124 | 69 |
| 1973 | 56,378 | 65,657 | (9,279) | 86 | 63 |
| 1974 | 120,689 | 105,796 | 14,893 | 114 | 51 |
| 1975 | 146,807 | 155,182 | (8,375) | 95 | 53 |
| 1976 | 149,156 | 132,278 | 16,878 | 113 | 66 |
| 1977 | 155,079 | 146,283 | 8,796 | 106 | 54 |
| 1978 | 155,796 | 236,173 | (80,377) | 66 | 57 |
| 1979 | 193,061 | 446,033 | (252,972) | 43 | 48 |
| 1980 | 259,502 | 476,187 | (216,685) | 54 | 60 |

⁵⁸³ Savezni zavod za statistiku, br.2, Beograd, 1988, str.201

KUMTESA

| | | | | | |
|----|---------|---------|-----------|-----|----|
| 19 | | | | | |
| 81 | 252,510 | 476,120 | (223,610) | 53 | 69 |
| 19 | | | | | |
| 82 | 241,114 | 288,567 | (47,453) | 84 | 77 |
| 19 | | | | | |
| 83 | 233,531 | 287,607 | (54,076) | 81 | 82 |
| 19 | | | | | |
| 84 | 252,088 | 257,556 | (5,468) | 98 | 85 |
| 19 | | | | | |
| 85 | 264,274 | 253,567 | 10,707 | 104 | 87 |
| 19 | | | | | |
| 86 | 220,996 | 256,837 | (35,841) | 86 | 85 |
| 19 | | | | | |
| 87 | 219,700 | 225,122 | (5,422) | 98 | 90 |
| 19 | | | | | |
| 88 | 279,885 | 226,877 | 53,008 | 123 | 89 |

Vlerat janë të shprehura sipas paritetit 1\$=1262.00 din.

Burimi: Vjetari statistikor i Kosovës, 1989, fq. 195


Me që në raport me bilancin e tregtisë së jashtme të Jugosllavisë, Kosova nuk pati aq deficit të madh, madje gjatë periudhës së shqyrtuar 6 vjet pati suficit në bilancin tregtarë, Jugosllavia asnjë vit nuk pati suficit tregtar por edhe mbulueshmërinë e importit me eksport, Kosova e kishte diku rreth 90%, ndërsa Jugosllavia diku 70%.⁵⁸⁴

Duke analizuar strukturën e eksportit kosovar sipas industrive vërejmë së dominues në eksportin e Kosovës ishin kategoria e mjeteve dhe pajisjeve; prej 10 % sa merrnin pjesë në totalin e eksportit në vitin 1978, ndërsa në vitin 1986 kjo kategori mbulonte rreth 40 % të totalit të eksportit, me përfshirje më të madhe të kategorisë së produktit si bateritë për automjete dhe pjesët rezervë të tyre.

Nga statistikatat e raportuara lidhur me partnerët tregtar kryesor të Kosovës nga viti 1972 deri në vitin 1986 ishin vendet socialiste, të cilat absorbuan në mënyrë konstante rreth 58 % të eksportit të Kosovës, e sidomos periudha kohore 1981-1983 ishte diku rreth 70 % të eksportit të Kosovës. Është interesante dhe indikative të përmendet se përdërisa eksportet e Jugosllavisë në këtë periudhë shkonin në drejtim të vendeve të zhvilluara të Perëndimit, eksportet e Kosovës drejt vendeve socialist ndërsa në drejtim të OECD-së, apo të Perëndimit pësonin zvogëlim.

⁵⁸⁴ Dr. Skender Berisha "Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare" Universiteti i Prishtinës, 1998, fq. 332

Struktura e eksportit të prodhimeve koosvare sipas industrive, 1986,



Një komponentë tjetër e rëndësishme në totalin e eksportit të Kosovës ishin produktet e tekstilit dhe veshmbathjeve, edhe pse me një trend rënës, por këtu duhet cekur sidomos kishin rënie të theksuar metalet ndërsa eksporti i energjisë kishte shënuar një rritje krejtësisht kah fundi i viteve të tetëdhjeta, megjithatë përkundër rritjes nuk ishte komponentë e rëndësishme e eksportit të Kosovës.

| Struktura e eksportit Kosovar sipas industrive, 1976 – 86, në % ⁵⁸⁵ | | | | |
|--|---------------|---------------|---------------|---------------|
| Periudha kohore | 1976-78 | 1979-81 | 1982-84 | 1985-86 |
| Prodherimet ushqimore, pijet, dhe duhani | 5.09 | 5.88 | 3.38 | 1.25 |
| Produktet e tekstilit | 25.46 | 21.07 | 15.52 | 12.18 |
| Prodherimi i energjisë | 0.00 | 0.32 | 2.11 | 6.81 |
| Metalet | 45.78 | 30.34 | 23.62 | 23.85 |
| Prodherimi i makinerisë dhe i pajisjeve | 9.92 | 14.52 | 33.36 | 36.82 |
| Të tjera | 13.75 | 27.87 | 22.01 | 19.09 |
| TOTALI | 100.00 | 100.00 | 100.00 | 100.00 |

⁵⁸⁵ Vjetari statistikor i Kosovës, Prishtinë, 1988, fq. 169

KUMTESA

| Partnerët kryesor tregtar të Kosovës, 1972 – 1986, në % ⁵⁸⁶ | | | | | |
|--|---------|---------|---------|---------|---------|
| Vendet e OECD-së/Periudha kohore | 1972-74 | 1975-77 | 1978-80 | 1981-83 | 1984-86 |
| <i>Gjermania</i> ⁵⁸⁷ | 16.6 | 8.21 | 11.12 | 8.51 | 9.67 |
| <i>Italia</i> | 4.03 | 5.19 | 6.23 | 4.39 | 4.07 |
| <i>SHBA-të</i> | 10.01 | 14.15 | 10.48 | 4.07 | 1.55 |
| <i>Totali</i> | 30.64 | 27.55 | 27.83 | 16.97 | 15.29 |
| Vendet socialiste | | | | | |
| <i>BRSS</i> | 24.57 | 43.57 | 36.94 | 47.24 | 39.59 |
| <i>Çekosllovakia</i> | 18.4 | 8.35 | 7.49 | 17.17 | 13.21 |
| <i>Shqipëria</i> | 0.8 | 0.55 | 2.15 | 1.68 | 0.9 |
| <i>Bullgaria</i> | 4.71 | 0.58 | 1.7 | 1.35 | 0.49 |
| <i>Rumania</i> | 4.41 | 4.11 | 2.52 | 2.32 | 5.38 |
| <i>Totali</i> | 52.89 | 57.16 | 50.8 | 69.76 | 59.57 |
| Vendet tjera | 16.47 | 15.29 | 21.37 | 13.27 | 25.14 |
| TOTALI | 100.00 | 100.00 | 100.00 | 100.00 | 100.00 |

Siç është e ditur botërisht, në Jugosllavin Socialiste filluan ndryshimet të mëdha politike në vitin 1989, sa që Kosova humbi pozitën e saj kushtetuese brenda Jugosllavisë Socialiste. Në Kosovë pati ndikime substanciale nga aspekti ekonomik dhe politik, duke suprimuar autonomin e KSAK si quhej në atë kohë Kosova dhe duke iu marrë të gjitha ingerencat në duart e Beogradit.

Në Kosovë menjëherë filluan të bien në mënyrë drastike aktivitetet ekonomike, nuk kishte rrjedh normale të informatave për situatën ekonomike, edhe ato që ishin shumë të pakta dhe jo përmbajtjesore.

Këto ndryshime politike në Jugosllavin Socialiste të asaj kohe patën ndikime të mëdha në Kosovë me karakter shumë dimensional si: rënien drastike të produktit shoqëror, largimin e pjesës dërmuese të punësuarve, shpejt filluan bashkimin e ndërmarrjeve kosovare me ato të Serbisë, zëvendësimin e udhëheqjes së ndërmarrjeve me organe të dhunshme, instalimin e menaxhmentit të ri në ndërmarrje, vërehet rënie drastike e nivelit të investimeve dhe së fundi humbjen pothuajse të tërësishme të tregjeve të eksportit të Kosovës.⁵⁸⁸

Prandaj nga ky vit e tutje për Kosovën, pjesa më e madhe e treguesve ekonomik prezantoheshin së bashku me treguesit ekonomik serb, që sipas treguesve statistikor të Serbisë, vetëm brenda tri viteve 1990 – 1992 eksportet nga Kosova shënuan rënie për 81.00% , duke mbetur kështu në të njëjtin nivel për shumë vite në vijim, ndërsa importet rriteshin me një përqindje të madhe, sa që në mbarim të vitit 1997 deficitit tregtar ishte enorm.

⁵⁸⁶ Vjetari statistikor i Kosovës, Prishtinë, 1987, fq.190

⁵⁸⁷ Shënim: Të dhënat për shtetin Gjerman janë të përmbledhura për të dy ish-Gjermanit

⁵⁸⁸ Instituti për hulumtime zhvillimore RIINVEST: “Aktivitetet Ekonomike dhe Zhvillimi Demokratik i Kosovës”, 1997/98, f.18-21

3. Kosova, tranzicioni dhe aktivitetet eksportuese pas vitit 1999

Ndërtimi i sistemit të ekonomisë së hapur është domosdoshmëri e kohës, sepse si vend i vogël dhe ekonomikisht i pazhvilluar, Kosova është e detyruar të orientohet në ekonominë e hapur drejt tregut të jashtëm. Vet liberalizimi i tregtisë në Kosovë orienton vemendjen në tri drejtime si që janë: racionalizimi dhe zëvendësimi i importit, lehtësimet në tregti, dhe promovimi i eksportit.⁵⁸⁹

Në praktikën e zhvillimit ekonomik ndeshemi me modele alternative të ekonomisë së hapur ndaj tregut, modele këto që kërkojnë përshtatje konform përvojave ndërkombëtare të vendeve në zhvillim e sidomos të vendeve të rikrijuara si që janë Kroacia, Slovenija, Estonia etj. Ndërtimi i ekonomisë së hapur ndaj tregut të jashtëm në Kosovë, ballafaqohet me probleme të trashëguara zhvillimore, gjatë krijimit të strukturave të menaxhmentit të ri, aktivizimin e kapitalit privat në ndërtimin e institucioneve të ekonomisë së tregut etj.

Pra, problemet kryesore në këtë rast janë: problemi me pronësinë e pa transformuar, shkalla e ulët e zhvillimit dhe papunësia e madhe, pamundësia e plotë e vetëfinancimit, trendi i gjatë kohor i recesionit, vëllimi dhe shkalla e dobët e cilësisë së prodhimit, shkalla dhe struktura e pavolitshme e eksportit, bilanci tregtar dhe i pagesave i pavolitshëm, ballafaqimi sfidues me korrupsionin dhe kontrabandën etj.

*Kështu që biznesi kosovar edhe sot e kësaj dite përballet me probleme të brendshme të natyrës financiare -mungesa e kapitalit, pastaj mungesa e theksuar e shërbimeve të marketingut dhe aktivitetëve të tjera promovuese, duke u mbështetur ekskluzivisht në shitjen personale, pasojë e cilës është mospasja e shërbimit të marketingut në strukturën e tyre organizative.*⁵⁹⁰

Përvoja dhe teoria botërore nuk njeh ndonjë vend të mbyllur dhe të zhvilluar njëkohësisht. Kështu Kosova përmes hapjes ndaj tregut të jashtëm, përmes politikave që mbështesin fushat që tërheqin investimet e jashtme dhe atyre sektorëve që prodhimet e tyre i kanë të orientuara për eksport, ka shans që të nisë drejt rrugës zhvillimore ekonomike të ndjekur nga "Tigrat e vegjël aziatik" (Singapori, Koreja Jugore, Hong Kongu, Tajvani etj)⁵⁹¹ por me orientim të veçantë drejt konsolidimit të ekonomisë eksportuese kosovare.

Hapja ndaj ndikimeve tekniko-teknologjike dhe shkencore, Kosovës i mundëson që t'i identifikojë, analizojë, shfrytëzoj potencialet dhe prioritetet e veta komparative si shansë e mirë për inkuadrim në proceset e integrimi rajonale dhe evropiane, të cilat janë bërë sot realitet i zhvillimeve botërore, problem kyq dhe synim afatgjatë i rendit të ri botëror. Për Kosovën do të ishte me interesë të bëhet pjesë të gjitha integrimi rajonale ekonomike përveq CEFTA-as, edhe e UE, EFTA, APEC etj, por jo vetëm formalisht.

Prandaj, vlen të përmendet p.sh. marrëveshja e CEFTA-s vazhdon të mos implementohet në tërësi, pasi që eksportet e prodhuesve të Kosovës vazhdojnë të bllokohen nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, ndërkohë që ekspertët bëjnë thirrje që të fillojë dialogu me Brukselin për zgjidhjen e kësaj çështje, ose të merren masat e reciprocitetit.⁵⁹²

⁵⁸⁹ Strategjia e integruar e eksportit e UNCTAD-it, (Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Tregti), 2009, fq.28

⁵⁹⁰ Veli Lecaj, "Roli i promociionit në nxitjen e zhvillimit ekonomik të Kosoves", Punimi i magistraturës, Prishtinë, shtator, 2008, fq.98.

⁵⁹¹ http://www.osce.org/publications/eea/2006/07/19786_640_sq.pdf

⁵⁹² www.Kosovapress, Prishtinë, 3 gusht 2010 Koha 10:57

KUMTESA

Objekt i vështrimit tonë janë vetëm format e integrimve rajonale ekonomike, të cilat varësisht nga shkalla dinamike integruese, shkojnë kah niveli preferencial për tregti të lirë, union doganor, union ekonomik dhe unionin monetar.⁵⁹³ Me 18 shtator 2000, Komisioni Evropian nxorri rregulloren Nr.2007/2000, me të cilën BE-ja formalisht e ka pranuar Kosovën si zonë doganore të pavarur dhe i ka dhënë preferenca tregtare duke eliminuar kufijtë maksimal tarifor për produkte industriale dhe duke përmirësuar kushtet për qasje në treg për produktet bujqësore.

Por që nga viti 2009 Banka Botërore dhe FMN, kur e pranuan Kosovën si një anëtare të tyre ishte një hap i rëndësishëm në sigurimin e ndihmës aq të nevojshme ndërkombëtare dhe konfirmimin e statusit të pavarur të Kosovës. Pas anëtarësimit në Bankën Botërore, Kosova do të jetë në gjendje të tërheqë investitorë të mëdhenj, si dhe do të jetë pjesë e integruar e tregut global.⁵⁹⁴

Kështu, Kosova nga aspekti demografik, aspekti i moshës (me një popullatë relativisht të mirë dhe të re) mbi mesataren evropiane, të edukuar dhe profesionalisht të ngritur ka hapësirë potenciale për tregti të lirë në EJT dhe inkuadrimi i saj në integrimet ekonomike rajonale dhe botërore, posaçërisht në UE, si një integrim i suksesshëm dhe i qëndrueshëm duhet të jetë prioritet mbi prioritetet e Kosovës në të ardhmen sa më të afërt.

Prandaj të inkuadruarit në integrimet ekonomike rajonale mund të bëhet duke i pranuar rregullat e lojës demokratike përëndimore në rrafshin e sigurisë, stabilitetit rajonal, atij evropian dhe në rrafshin civilizues euro përëndimorë.

Në ekonominë kosovare paraqitet liberalizimi tregtar i Kosovës si çështje esenciale për ndërtimin e një ekonomie të hapur dhe për forcimin e konkurrencës së ekonomisë vendore për t'u ballafaquar me importin në Kosovë dhe për të ngritur për formansën e eksportit.

Në Kosovë, liberalizimi tregtarë është realizuar në rrethana tejet specifike dhe dallon nga përvoja e vendeve të tjera të tranzicionit dhe atë :⁵⁹⁵ pasojat e luftës, vonesa 10 vjeçare në tranzicion, mungesa e një qëndrueshmërie ekonomike dhe sociale, nivel i ulët i bizneseve prodhuese, veprimi i instrumenteve asimetrike tregtare, mungesa e politikave për mbrojtjen e prodhuesve në fazën initiale të liberalizimit tregtar.

Prandaj liberalizimi i shpejtë tregtar edhe në disa vende të tranzicionit nuk është shoqëruar me përkrahje të duhur institucionale, duke dhënë të kuptohet se krijimi i institucioneve mbështetëse nuk është krijuar dhe nuk mund të krijohet brenda natës.

Pasi që liberalizimi i tregtisë nuk ka qenë i shoqëruar me përmirësimin e aftësisë konkurruese të sektorëve prodhues vendorë të sapokrijuar, Kosova po ballafaqohet me deficit të lartë tregtar.

Krijimi i kapaciteteve administrative dhe institucionale konsiderohet si element kyç për suksesin e reformës së politikave tregtare.⁵⁹⁶

Kosova si shtet i ri, me status sapo të zgjidhur politik dhe i pranuar ndërkombëtarisht, si kusht themelor për antarësim në bankën botërore dhe fondin monetar ndërkombëtar ka mundësi të mira të ecjes drejt stabilitetit ekonomik, drejt reformave dhe zhvillimit në nivel

⁵⁹³ Blerim Reka "E drejta e unionit evropian, Instituti kosovar për integrimet euroatlantike, 2000, Prishtinë, fq. 187-189

⁵⁹⁴ Klan Kosova me datën 05 qershor 2009, 16:50

⁵⁹⁵ Instituti për Hulumtime Zhvillimore "Rinvest" Politika tregtare dhe promovimi i eksportit në Kosovë, 2004, fq. 18

⁵⁹⁶ Trade Policy during the Transition, Lessons from the 1990s, CERT.

rajonat. Për tu arritur këto synime në Kosovë për promovimin dhe realizimin e investimeve, tregtisë dhe të eksportit janë të involvuara këto institucione dhe këta akterë:

1. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI),⁵⁹⁷
2. Ministria e punëve të jashtme ;
3. Ministria për integritet europian ;
4. Oda Ekonomike e Kosovës/Euro Info Qendra,
5. USAID - KBS,
6. Shoqata e Eksportuesve të Kosovës (SHEK),
7. Aleanca Kosovare e Biznesit (AKB),

Sipas shumë indikatorëve makroekonomik, ekonomia kosovare pas stagnimit shumëvjeçar ka shpërpjesëtime në tregtinë e jashtme, shpërpjesëtime këto që kanë implikime afatgjata makroekonomike nga aspekti i qëndrueshmërisë, konkurrueshmërisë, stabilitetit dhe të rritjes ekonomike.

Pra ekonomia e Kosovës, përkundër masave të ndërmarra në konsolidimin e saj, ajo ka shënuar rritje relativisht të ulët por jo edhe të favorshme në periudhën e pas-luftës.

Së këndejmi, reduktimi i këtyre shpërpjesëtimeve duhet të jetë një prioritet afatgjatë i Kosovës.

Nëse nisemi nga analiza e bilancit tregtar të Kosovës, si faktor mjaft relevant, vërejmë se gjatë kësaj periudhe kohore 2001- prill 2010, ekziston një diferencë e lartë negative e bilancit tregtar si pasqyrë e nivelit të ultë konkurrues të produkteve Kosovare në tregun e jashtëm, si pasqyrë e promovimit të pamjaftueshëm të eksportit, si tregues përmes së cilëve mund të vërehet varshmëria e ekonomisë kosovare nga importi etj.

vlera në 1000 €⁵⁹⁸

| Periudha | Eksporti | Importi | Bilanci tregtar | Përqindja e mbulimit |
|------------------|----------|-----------|-----------------|----------------------|
| 1 | 2 | 3 | 4=2-3 | 5=2/3 |
| 2001 | 10,559 | 684,500 | -673,941 | 1.5 |
| 2002 | 27,599 | 854,758 | -827,159 | 3.2 |
| 2003 | 35,621 | 973,265 | -937,644 | 3.7 |
| 2004 | 56,567 | 1,063,347 | -1,006,780 | 5.3 |
| 2005 | 56,283 | 1,157,492 | -1,101,209 | 4.9 |
| 2006 | 110,774 | 1,305,879 | -1,195,105 | 8.5 |
| 2007 | 165,112 | 1,576,186 | -1,411,074 | 10.5 |
| 2008 | 198,463 | 1,928,236 | -1,729,773 | 10.3 |
| 2009 | 165,328 | 1,935,541 | -1,770,213 | 8.5 |
| Janar-Prill 2010 | 78,003 | 564,956 | -486,953 | 13.8 |

⁵⁹⁷ Duhet të bëhet e qartë se rolin kryesor në procesin e bërjes së politikave tregtare e ka MTI, megjithëse ekziston një numër aktorësh tjerë qeveritar dhe të tjerë relevant të përfshirë në këtë proces për shkak të ndërvarshmërisë së madhe të politikës tregtare me funksionet e ndryshme ekonomike

⁵⁹⁸ Enti Statistikor i Kosovës /Tregtia e jashtme, Prishtinë, 2010, fq.20

KUMTESA

Duke analizuar të dhënat gjatë periudhës 2001-2009 vërehet se në vazhdimësi kemi një rritje të eksportit dhe të importit.

Eksportet në periudhën e pasluftës kanë shënuar rritje të vazhdueshme mirëpo nga një nivel shumë i ultë fillestar. Nëse krahasohet eksporti i vitit 2002 me vitin 2001 kemi një rritje prej 161 %, e në anën tjetër kemi një rritje të importit për 25% , për të njëjtën periudhë. Vlera e ulet fillestare e eksporteve përkundër rritjes se vazhdueshme prapë se prapë nuk ka pasur mundësi mbulimi të importit,sepse mbulimi i importit me eksport në vitin 2001 ishte 1.5% ndërsa në vitin 2002 ishte vetëm 3.2%, përkundër rritjes se theksuar me lart të eksportit prej 161 %, në vitin 2006 mbulimi i importit me eksport ishte vetëm 8.5%, në vitin 2007 ishte 10.5%,në vitin 2008 ishte 10,3% si më specifik është viti 2008,sepse eksporti është rritur në krahasim me vitin paraprak për 20% ndërsa importi është rritur 22% në të njëjtën periudhë,në vitin 2009 kemi rënie të përqindjes së mbulimit në 8.5% krahasuar me vitin e mëparshëm,si dhe në kuartalin e parë të vitit 2010 kemi përqindjen e mbulimit me një rritje të theksuar prej 13,8%,krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2009 ku mbulimi ishte vetëm 6.8%.*Megjithatë pavarësisht nga përmirësimet jo të vogla të eksportit kosovar, i cili që nga viti 2001-2009 më së shumti është 10.5% të vlerës së importit dmth se është jashtëzkonisht i ultë. Evoluimi pozitiv i importeve,shiquar nga aspekti i shkëmbimeve tregtare shpreh një faktorë jo të favorshëm për Kosovën,duke e bërë ekonominë kosovare gjithnjë e më të varur nga importet .*

Kjo rritje e madhe e importeve ka pamundësuar mbulimin edhe simbolik të importeve nga eksportet,sa që nga viti 2004 kur importi ishte në vlerë prej 1,063,347,000 euro u dyfishua përafërsisht sa që në vitin 2009 arriti vlerën prej 1,935,541,000 euro ndërsa eksporti mezi u rrit nga vlera 56,567,000euro në vitin 2001 në vlerën 165,328,000 euro në vitin 2009,apo 12 herë ishte importi më i lartë se eksporti në kuptimin e vlerës monetare,apo shprehur edhe në përqindje eksporti është rritur diku rreth 200% ndërsa importi diku afër 100 %, por pa ndonjë efekt të madh.

Një pasqyrë më premtuese do të shfaqej po që se merret në konsideratë edhe i ashtuquajhuri eksport virtual – që përfshinë konsumin e ndërkombëtarëve në Kosovë – sipas të cilit eksporti mbulon 20 % të importit (në llogaritë kombëtare kjo pjesë e eksportit konsiderohet si ‘eksport në shërbime’).


(Vlera në 000 €)

| Partneret kryesor te Kosovës ne vitin 2009 për tregtinë e jashtme | | | | | |
|--|----------------|---------------|------------------|---------------|-----------------|
| Vendet | Eksporti | % | Importi | % | Bilanci tregtar |
| Italia | 46,218 | 28.00 | 87,646 | 4.50 | -41428 |
| Shqipëria | 26,182 | 15.80 | 58,385 | 3.00 | -32203 |
| Maqedonia | 17,355 | 10.50 | 291,837 | 15.10 | -274482 |
| Gjermania | 7,563 | 4.60 | 246,120 | 12.70 | -238557 |
| Turqia | 6,512 | 3.90 | 141,545 | 7.30 | -135033 |
| Serbja | 3,504 | 2.10 | 210,901 | 10.90 | -207397 |
| Slovenija | 2,882 | 1.70 | 66,249 | 3.40 | -63367 |
| Kina | 1,596 | 1.00 | 128,318 | 6.60 | -126722 |
| Totali | 111,812 | 68 | 1,231,001 | 64 | -1119189 |
| Vendet tjera | 53,516 | 32 | 704,540 | 37 | -651024 |
| Totali | 165,328 | 100.00 | 1,935,541 | 100.00 | -1770213 |

Burimi: Enti Statistikor i Kosovës /Tregtia e jashtme,Prishtinë, 2009

Lidhur me eksportin dhe importin e Kosovës, partner kryesor tregtar janë vendet ballkanike të cilat marrin pjesë me 36.3% për eksport dhe 43.1% për import, ndërsa BE merë pjesë me 43.1% për eksport dhe 39.0% për import, në raport me totalin e vitit 2009 (vendet me pjesëmarrje me të lartë nga BE janë Italia me 28% eksport dhe 4.5% import ,Gjermania me 4.6% eksport dhe me 12.7% import.). Për sa i përket eksporteve të Kosovës me vendet ballkanike, Shqipëria merr pjesë me 15.8%, Maqedonia me 10,5%, Turqia me 3.9% në raport me totalin e vitit 2009, ndërsa pjesëmarrjen më të madhe të importeve në Kosovë nga vendet ballkanike e kanë Maqedonia me 15.1%, Serbia me 10.9% dhe Turqia me 7.3%.⁵⁹⁹

Duke krahasuar të dhënat e periudhës 2005-2009 për disa grupmallrash vërejmë se mesatarisht përbërësit kryesor të eksportit janë: mallra të përpunuara me 40%,materiale të papërpunuara 30%,lëndë djegëse 6%, yndyrat bimore dhe shtazore kanë vlerë simbolike të eksportit,produktet kimike 1%, makineritë dhe pajisjet e transporti 8%, pijet dhe duhani 3%, mallrat të tjera të përpunuara 4% dhe ushqimi dhe kafshët e gjalla 8%.




Sa i përket importeve kishte rritja vjetore mesatare me pak se dhjetë % ndërsa rritja e importit në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 kishte një rritje simbolike prej 0.38% Duke parë strukturën e përbërësve kryesor të importeve (makineritë dhe pajisjet e transporti me 21%, materiale të papërpunuara me 2%,produktet kimike 10%, mallrat të tjera të përpunuara 9%, mallra të përpunuara me19%,mallra të pa klasifikuara diku tjetër kanë rënie dhe vlerë simbolike importi, pijet dhe duhani me 5%, yndyrat bimore dhe shtazore me 1%,lëndët djegëse 16% dhe ushqimi dhe kafshët e gjalla me 17%)vijmë të konkluzioni se ekonomia kosovare gjendet në gjendje të shumë të rëndë,me që nevojat themelore për

⁵⁹⁹ Enti Statistikor i Kosovës /Tregtia e jashtme,Prishtinë, 2009,fq,25-27

KUMTESA

ushqim është e detyruar t'i mbulojë përmes importit, por importohen po ashtu një sasi e konsiderueshme e mallërave tjera të përpunuara dhe atyre kimike, sigurisht për shkak të mungesës së potencialit tekniko-teknologjik për përpunimin e tyre. Logjikisht në vazhdimësi është duke u rritur importi i të mirave kapitale (makineritë dhe pajisjet e transporti me 21%), i cili është i domosdoshëm për prodhimtarinë vendore dhe paraqitet si imperativ e kohës pasi që momentalisht është jo në nivel të knaqshëm. Andaj është brengosës fakti së shumë produkte nga importi janë të prodhuara në vendet fqinje, e disa prej tyre edhe në ato rajonale, tek të cilat niveli i zhvillimit ekonomik dhe tekniko-teknologjik nuk është shumë më i avancuar se i Kosovës.

Importi sipas grupit të mallrave (totali në %, 2005- 2009)



Prandaj, këto të dhëna për tregtinë e jashtme të Kosovës, pasqyrojnë nivelin e ultë të zhvillimit të forcave prodhuese dhe njëherit janë dëshmi e ngecjes së ekonomisë kosovare. Shumica e prodhuesve vendor plasmanin e produkteve të veta e bëjnë në tregun e Kosovës. Në bazë të analizës së çmimeve të produkteve vendore, të bëra nga MIT rreth 80% e produkteve kosovare kanë çmim më të lartë se ato të importuara. Kjo ndodh pikërisht për shkak të kostos së lartë të prodhimeve vendore që rrjedh si pasojë e: aplikimit të normave të larta doganore në importimin e lëndës së parë, repromaterialeve dhe mjeteve të punës, mungesa e energjisë elektrike, mungesa e lëndës së parë dhe teknologjia e vjetër. Një sërë problemesh ndikojnë në aktivitetet eksportuese në Kosovë; këto probleme janë të natyrës ekonomike, historike dhe politike, janë probleme të brendshme dhe të jashtme, kurse disa prej tyre janë të trashëguara e disa janë të lidhura me tranzicionin dhe me funksionimin e shtetit të ri të Kosovës.

Përveç kësaj, rrjedhja e eksportit të Kosovës është penguar nga masat dhe instrumentet e aplikuara në politikat tregtare të vendeve të tjera; eksportuesit Kosovar ishin detyruar të ndeshen me ngarkesa tarifore (për shembull, taksat transit), si dhe me ngarkesat jo-tarifore (të tilla si subvencionet). Veçanërisht këto të dytat kanë qenë revalente, dhe kanë marrë forma nga më të ndryshmet.⁶⁰⁰

Ndër arsyt kryesore të efikasitetit të dobët tregtar janë:

- statusi i sapo zgjedhur politik i Kosovës,
- ekonomi e trashëguar me kompani dhe industri pothuajse në kolaps pas shkatërrimeve dhe vjedhjeve ,
- komplikimet dhe vonesat e shumta gjatë procesit të privatizimit të kompanive shoqërore,
- të qenurit e Kosovës shumë kohë jashtë iniciativave regjionale ekonomike,
- prezenca në mas të madhe e ekonomisë joformale,
- orientimi i ndërmarrjeve të sapoformuar private pas luftës kryesisht në tregti,
- ambienti jo i sigurt për investime ,
- kufizimet kreditore dhe normat e larta të kamatës,
- mungesën e informatave,
- përkrahjen e dobët institucionale
- prezenca e dukurive negative në ekonomi si krimi organizuar dhe korrupsioni ,
- politika tatimore jo favorizuese për prodhimin vendor dhe norma uniforme e doganave dëkurajuese për zhvillimin e bizneseve prodhuese në Kosovë
- institucionet jo funksionale për sigurimin e cilësisë dhe ekspertizave ,
- problemet e brendshme të firmave në Kosovë(mungesa e kapitalit,mungesa e përvojës për bërje biznesi në tregjet e ndërkombëtare)
- marketingu dhe aktivitetet promovuese të dobëta
- problemi i qarkullimit të lirë të personave.
- ekonomia jo ⁶⁰¹formale
- masat dhe instrumentet e aplikuara në politikat tregtare të vendeve tjera etj⁶⁰².

Këto probleme, të cilat që nga fillimi kanë qenë të lidhura me realitetin e ri kosovar në korrelacion me politikat jo integrale ekonomike dhe institucionet joefikase kanë ndikuar në zhvillimin jo efikas të sektorit privat të ndërmarrjeve, sektor ky i cili do të duhej të bartte barrën kryesore të eksportit.

Por ekonomia e Kosovës me faktorët e vetë të prodhimit ;burimet natyrore jo të pakta, burimet njerëzore ndër me të rejtat në rajon e më gjerë dhe me potencialin e vet prodhues ,ka një mundësi reale për mbështetje të zhvillimit ekonomik,njëherit shfrytëzimi racional dhe efikas i këtyre faktorëve kërkohet që ekonomia kosovare sa më shpejt të inkuadrohet në rrjedhat bashkëkohore ekonomike dhe në proceset integruese me vendet e Ballkanit, Evropës dhe më gjerë.

⁶⁰⁰ MTI,Poltika Tregtare e Kosovës,2009,fq.14

⁶⁰¹ Në bazë të EC (2008) ekonomia joformale në Kosovë llogaritet sipas disa vlerësimeve 30% të BPV-së në Kosovë, apo 700 milion € në vit (The European Commission Liaison Office to Kosovo press release of 27 August 2008)

⁶⁰² Pasi që Kosova nuk i kontrollon të gjitha pikat edoganore të saj,me që një pjesë e kufirit të Kosovës në veri sot e kësaj dite mbetet jashtë kontrollit doganor dhe tatimor kosovar në masë të madhe.Kjo krijon mundësin që përmes kësaj pike kufitare të pa mbikëqyrur nga organet kosovare të realizohet evazioni fiskal.

KUMTESA

Orientimi i zhvillimit ekonomik në Kosovë në ditët e sotme, përkundër privatizimit të bërë nuk është duke dhënë sinjale të mira për mirësimin për ndonjë ndryshim të theksuar pozitiv brenda një afati të shkurtër kohore, bile as për avancimin e tregtisë së jashtme.

Prandaj si prioritet afatgjatë, i Kosovës përveç zvogëlimit të shpërpjesëtimeve në tregtinë e jashtme, politika kosovare për tregti të jashtme duhet të fokusohet në :

- përmirësimi i organizimit institucional dhe koordinimi i aktiviteteve ndërmjet akterëve kryesor përmes krijimit të njësisë koordinuese në kryeministri,
- rritjen e aftësisë konkurruese përmes përmirësimit të cilësisë së produkteve,
- zvogëlimin e mundshëm të shpenzimeve të panevojshme në procesin prodhues,
- rritja e shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese,
- promovimin e eksportit,
- krijimi i ambientit të sigurt për investime ,
- politikave kreditore favorizuese për eksport (ulja e kufizimeve kreditore dhe normave të larta të kamatës),
- ndërtimi sistemit informativ,
- përkrahjen e fortë institucionale për bizneset eksportuese,
- luftimi i prezencës së dukurive negative në ekonomi, si krimi organizuar dhe korrupsioni ,
- politika tatimore favorizuese për prodhimin vendor dhe norma jo uniforme e doganave si inkurajuese për zhvillimin e bizneseve prodhuese në Kosovë,
- krijimi institucioneve funksionale për sigurimin e cilësisë dhe ekspertizave ,
- rritja e rolit të marketingut dhe aktiviteteve tjera promovuese,
- lehtësimi i qarkullimit të lirë i personave,
- ekonomia jo formale (zvogëlimi i saj në minimum),
- Lidhja e sa më shume marrëveshjeve tregtare me vendet tjera etj.

Nga e tërë kjo që u tha më lartë, me plot të drejt mund të themi se nuk ka ndonjë formulë specifike për sukses por duhet të punohet në vazhdimësi në zhvillimin e politikave promovuese të tregtisë së jashtme, sidomos të eksportit si determinuese për shtim eksporti dhe zhvillim ekonomik.

4. Konkluzionet

- a) Problemi kryesor me të cilin ballafaqohet ekonomia kosovare është importimi i pjesës dërmuese të mallërave . Prandaj përkrahja e bizneseve vendore sidomos atyre të vogela dhe të mesme , për ndërtimin e kapaciteteve konkurruese në tregun e brendshëm me synim të ballafaqimit me konkurrencën e jashtme, përmes rritjes së aftësisë konkurruese, përmes përmirësimit të cilësisë së produkteve dhe shërbimeve të ofruara për treg, përmes zvogëlimit të mundshëm të shpenzimeve të panevojshme në procesin prodhues etj. do të ishte politika më e mirë zhvillimit.*
- b) Me që sektori privat në Kosovë është relativisht i ri, sika mundesi financimi personal në teknikë dhe teknologji të re , remitencat nga diaspora janë në zvogëlim e sipër , investimet e përbashkëta të pamundshme, dëpërtimi në tregje të jashtme i pa arritshëm, rezulton së aftësia konkurruese kosovare edhe për një periudhë jo të shkurtër kohore do të jetë mjaft e dobët.*

- c) *Sektori shtetëror është jofunksional, ska tregje ,si pjesë e ekonomisë së trashëguar me kompani dhe industri pothuajse në kolaps pas shkatërrimeve dhe vjedhjeve para dhe gjatë luftës ,ndërsa ai privat jo i konsoliduar dhe mjaft i brishtë ,i cili funksionon në një ekonomi e cila ska mundësi akumulimi financiar të madh që t'iu mundësoj pjesëmarrje bizneseve kosovare në tregun e jashtëm.*
- d) *Mungesa e strategjisë dhe politikave të mirëfillta zhvillimore paraqet pengesë për terheqjen e investimeve të jashtme ,mungesa e informacioneve , mungesa e luftimit të prezencës së ekonomisë jo formale(zvogëlimi i saj në minimum), mungesa e krijimit të ambientit të sigurt për investime,mos afrimi i projekteve adekuate dhe alternativave zhvillimore nga faktori vendor, ndikon në humbjen e besimit të investitorëve të jashtëm në aftësitë dhe gatishmërinë e kreatorëve kosovar të politikave ekonomike dhe zhvillimore.*
- e) *Ndërmarrja e nismave rreth hartimit dhe zbatimit të politikave si dhe shkathtësive zhvillimore fiskale për stimulimin e eksportit duke u bazuar në rekomandimet e ekspertëve kosovar dhe ndërkombëtarë,që mund të bëhet përmes këtyre instrumenteve:*
- *Politika tatimore favorizuese për prodhimin vendor dhe norma jo uniforme e doganave si inkurajuese për zhvillimin e bizneseve prodhuese në Kosovë,*
 - *Implementimi i sistemit dy tarifor me 0% në mallërat kapitlae të importuara si dhe për pjesën dërmuese të llojeve të lëndës parë.*
 - *Shqyrtimi i shtyerjes së afatit të pagesës për TVSH për bizneset fillestare, si dhe përcjellja e rezultateve të kësaj mase.*
- f) *Mos krijimi i lehtësirave dhe finacimeve të NVM, pa përkrahjen e fortë institucionale për bizneset eksportuese,mos lehtësimi i qarkullimit të lirë të mallërave dhe personave, që natyrisht do të thot mos zhvillim,mos depërtim në tregje qoft vendore apo ndërkombëtare, rritje të papunësisë, varfërim të popullsisë,humbje besimi në institucionet kosovare,paraqitje tensionesh sociale etj. janë sfida jo lehtë të tejkalueshme dhe të zgjidhshme për institucionet e Kosovës. Prandaj në kuadër të nje ekonomie të tillë, konkurrenca e së cilës është shumë e pavolitshme,që dmth se përmes eksportit depërtimi në tregjet e jashtme është i pamundur.*
- g) *Përmes zhvillimit te kuadrit ligjor dhe atij institucional, Insatitucionet e Kosovës duhet të thellojnë angazhimet e tyre për mbështetjen e zhvillimit të sektorit privat,si vetmi sektor me perspektivë në drejtim të forcimit të kapaciteteve të biznesit prodhues sidomos atij me orientim kah eksporti, me qëllim që këto biznese të jenë të sukseshme në tregjet jashtme.*
- h) *Biznesi kosovar duhet te intensifikoje dhe dinamizojë perpjekjet, veçanërisht në drejtim te zhvillimit te produktit dhe ofrimit të shërbimeve, menaxhimit dhe shërbimit të marketingut konform standardeve rajonale dhe më gjërë.*
- i) *Intensifikimi i punës në drejtim të krijimit të institucioneve funksionale për sigurimin e cilësisë dhe ekspertizave ,si kusht themelorë për rritjen e konkurrueshmërisë se produkteve “ Made in Kosova”.*

KUMTESA

Redaktor
Murteza Osdautaj

Ndihmuan në përgatitjen e librit
Ukë Osmanaj
Mensur Neziri
Sebahate Jupolli

Kopërtinën dhe radhitjen kompjuterike
Murteza Osdautaj

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

001(496.51)

Kumtesat : nga konferenca vjetore e shkencës “Java e shkencës 2012” / [Redaktor Murteza Osdautaj]. - Prishtinë : Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë : Departamenti i Shkencës dhe Teknologjisë, 2012. - 586 f. : ilustr. ; 24 cm.

1. Osdautaj, Murteza

ISBN 978-9951-16-047-6



WEEK
SCIENCE

JAVA
SHKENCËS

WEEK
SCIENCE

JAVA
SHKENCËS

WEEK
SCIENC

WEEK
SCIENCE

JAVA
SHKENCËS

WEEK
SCIENCE

JAVA
SHKENCËS

WEEK
SCIENC

WEEK
SCIENCE

JAVA
SHKENCËS

WEEK
SCIENCE

JAVA
SHKENCËS

WEEK
SCIENC

WEEK
SCIENCE

JAVA
SHKENCËS

WEEK
SCIENCE

JAVA
SHKENCËS

WEEK
SCIENC

WEEK
SCIENCE

JAVA
SHKENCËS

WEEK
SCIENCE

JAVA
SHKENCËS

WEEK
SCIENC

WEEK
SCIENCE

JAVA
SHKENCËS

WEEK
SCIENCE

JAVA
SHKENCËS

WEEK
SCIENC

WEEK
SCIENCE

JAVA
SHKENCËS

WEEK
SCIENCE

JAVA
SHKENCËS

WEEK
SCIENC

ISBN 978-9951-16-047-6



9 789951 160476

WI
SC

SHKENCËS

WEEK
SCIENCE

JAVA
SHKENCËS

WEEK
SCIENC